

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

dhe

**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**

**SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE
KULTURËN SHQIPTARE**

**Materialet e punimeve të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën,
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare
Prishtinë, 13-25 gusht 2012**

FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË – TIRANË

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN
SHQIPTARE

THE XXXI INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,
LITERATURE AND CULTURE

PRISHTINË, 2012

Fakulteti i Filologjisë – Prishtinë
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë – Tiranë

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN
SHQIPTARE

Prishtinë, 13-27 gusht 2012

THE XXXI INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,
LITERATURE AND CULTURE

Kryeredaktor:

Bardh Rugova

Redaksia:

Anton Berishaj, Sala Ahmetaj, Enver Mehmeti, Ferit Rrustemi,
Naser Mrasori, Bajram Kosumi

Drejtore: Bardh Rugova

Bashkëdrejtore: Ymer Çiraku

Sekretar: Anton Berishaj

Bashkësekretar: Adem Jakllari

Sekretar profesional: Blertë Ismajli

Drejtore nderi: akademik Idriz Ajeti

Këshilli Drejtues i Seminarit në Prishtinë

Bardh Rugova, Anton Berishaj, Sala Ahmetaj, Enver Mehmeti, Ferit Rrustemi,
Naser Mrasori, Bajram Kosumi

Këshilli Drejtues i Seminarit në Tiranë

Ymer Çiraku, Shezai Rrokaj, Ethem Likaj, Floresha Dado, Adem Jakllari,
Dhurata Shehri, Aljula Jubani

Redaktor teknik: Besfort Krasniqi

Lektorë: Shpëtim Elezi, Bahri Koskoviku, Mensur Vokri

Botues: Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

Bardh RUGOVA, drejtor i Seminarit

**FJALA E HAPJES SË SEMINARIT XXXI NDËRKOMBËTAR PËR
GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE**

*I nderuari drejtor nderi i Seminarit, professor Ajeti,
I nderuari ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, dr. Ramë Buja,
I nderuari zëvendësministër i Kulturës, zoti Hajdin Abazi,
I nderuari kryetar I Komunës së Prishtinës, akademik Isa Mustafa,
I nderuari nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve, akademik
Pajazit Nushi,
I nderuari rektor, kolegë profesorë, mysafirë, zonja dhe zotërinj,*

Tridhjetë herë të tjera një drejtor Seminari ka dalë në një tribunë si kjo për të hapur punimet e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. I nxora nga arkivi ato fjalime, i lexova një nga një, vetëm për të kuptuar se në një fjalim i tridhjetenjëte nuk mund të ketë ndonjë risi të madhe, pos të përmbledhë ato që janë thënë a nënkuptuar tridhjetë herë të tjera rresht.

Sot në ceremoninë e hapjes së punimeve të Seminarit XXXI, ky Seminar mbetet i njëjti projekt si në ditën e e themelimit të tij në vitin 1974.

Është një projekt që synon ndikim në tri fusha të ndryshme.

Ndikimi i parë është ai kulturor. Seminari mundëson shkëmbime kulturore me vende dhe kultura të tjera, mundëson përfaqësimet kulturore të albanologjisë në botë dhe përthime të veprave në gjuhën shqipe në gjuhë të ndryshme të botës.

Ndikimi i dytë është ai arsimor dhe shkencor. Pjesa më e madhe e Departamenteve të Shqipes a të Ballkanistikës në botë drejtohen dhe udhëhiqen nga nxënës të dikurshëm të këtij Seminari. Veç kësaj, Seminari vit për vit është një vend ku nëpërmjet referimeve dhe kumtesave shtrohen dhe diskutohen problem të caktuara të albanologjisë, duke e shtyrë gjithnjë përpara këtë fushë.

Ndikimi i tretë është ai integrues. Krijimi i kontakteve me institucione dhe individë të interesuar për shkencën gjithandej botës, lidhja e bashkëpunimeve dhe raportet kontraktuale janë baza e ekzistencës së këtij Institucioni.

Kur tash një vit një drejtor do t'i hapë punimet e Seminarit të tridhjetë e dytë, ai do ta ofrojë të njëjtin project: investimin e sigurt për të ardhmen e sigurt të albanologjisë.

Unë mund të mos e di sot se cili do të jetë ai drejtor, por mund të vë bast se projekti do të mbetet i njëjtë. Mund të vë bast lirshëm, sepse e di se ky projekt nuk është vepër e një drejtori të tashëm a të nesërm, por vizioni i intelektualëve kosovarë që e themeluan këtë institucion.

Të dashur miq,

Viti mes dy seminareve nuk qe i lehtë për albanologjinë. Përjetuam dhe ndamë dhimbjen për humbjen e studentëve të shqipes të Universitetit të Elbasanit në një aksident tragjik në afërsi të Himarës. U ndamë nga profesor Fadil Raka, ish-drejtor i këtij Seminari. Na la poeti emblemantik Ali Podrimja.

Do të përpiqemi t'i nderojmë, duke ruajtur sistemin e vlerave me të cilin jetuan, sistemin e njëjtë të vlerave që mban edhe ky Seminar.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni t'i falënderoj të gjitha institucionet që e kanë mbështetur Seminarin XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare dhe të gjithë ata që kanë shprehur gatishmëri për të ndihmuar.

Ndihmën e tyre do ta nderojmë me punën tonë.

Ju faleminderit.

LIGJËRATA

Enver MEHMETI

MITI SERB I KOSOVËS

Koalicioni i popujve të Ballkanit në Betejën e Kosovës të vitit 1389, siç është e njohur historikisht pëson disfatë të rëndë. Kjo ngjarje e madhe historike e përballjeve të dy botëve, e përballjeve të dy civilizimeve, në kujtesën kolektive të popujve ballkanikë do të lërë gjurmë të pashlyeshme dhe me kohë do të marrë përmasa të një sage ballkanike. Shumica e popujve të Ballkanit, por sidomos shqiptarët dhe serbët, në krijimtarinë e tyre gojore do të thurrin legjenda dhe këngë të shumta për këtë ngjarje të rëndësishme.

Sipas dëshmimeve historike në traditën serbe Beteja e Kosovës dhe kulti i knjaz Lllazarit, gjegjësisht, miti i Kosovës për herë të parë përmenden në fund të shek. XVI, saktësisht më 1598 në një letër në të cilën një grup kallugjerësh – murgjish serbë ia dërgojnë Papatit. Nga kjo kohë, gati dy shekuj nuk gjenden dëshmi të shkruara për mitin e Kosovës. Vetëm nga gjysma e dytë e shek. XVIII dhe gjatë gjithë shek. XIX, miti i Kosovës, që rrejshëm e paraqet Kosovën si zemër të Serbisë, si tokë të shenjtë serbe, do të fillojë të kultivohet. Ky mit në bërthamën e vet fillestare nis në shkri-mtarinë legjendare krishtere në manastire nga qarqet udhëheqëse të kallugjerëve. Ndër manastiret më të njohura ku zuri fill miti serb i Kosovës janë: Manastiri i Tro-noshit në Hercegovinë, Manastiri i Shishatovcit në Srem, Mitropolia e Karllovcit etj. Kursa nga librat në dorëshkrim, të cilët shumëzo-heshin duke u kopjuar nga kallu-gjerët kaligrafë të cirilicës nëpër manastire dy janë më të njohurat, libri „Tronoški rodoslov” dhe „Pri a o Kosovskom boju”. Në këta dy libra, por dhe në libra të tjerë të traditës krishtere serbe në dorëshkrim të gjysmës së dytë të shekullit XVIII, princi Lllazar i Betejës së Kosovës nis të shenjtërohet dhe në traditën legjendare krishtere fillon të zhvillohet kulti i tij si vazhdues i Dinastisë së Nemanjiqëve. Legjendat kishtare për Betejën e Kosovës dhe kultin e Knjaz Lllazarit në fakt ishin tregimet e para, me ndonjë dhjetërrokësh apo tetërrokësh si rezultat i rrëfimit emocional të tyre. Pra, rrënjët e legjendës historike të Kosovës apo të mitit serb të Kosovës dhe të Dinastisë së Nemanjiqëve gjenetikisht nuk janë prodhim gojor, nuk janë prodhim folklorik, por janë prodhim i qarqeve udhëheqëse të kallugjerëve në manastire. Këto legjenda e gojëdhëna paraqesin etapën e parë apo fazën e parë të krijimit të mitit serb të Kosovës, të cilat si të tilla në këtë fazë nuk kishin

gjithaq premisa nacionale, por më tepër të besimit gojëdhënor krishter për këtë ngjarje të rëndësishme historike.

Fryma legjendare e Betejës së Kosovës e krijuar në librat në dorëshkrim në manastire, në pjesën e parë të shek XIX do të hyjë në traditën epike gojore dhe do të zhvillohet paralelisht me krijimtarinë letrare serbe me këtë temë. Pra, në etapën e dytë të zhvillimit të vet, miti i Kosovës që kishte origjinë kishtare, ndërtohet dhe popullarizohet përmes modelit të epikës gojore dhe letërsisë së shkruar. Autorët më të njohur të kësaj kohe që trajtojnë mitin e Kosovës në krijimtarinë letrare dhe historike ishin Zaharije Orfelini me veprën „Pla ”, Vasilije Njegoš me veprën „Istorija o Crnoj Gori”, Petar Petrovi Njego me veprën „Gorski vjenac”, Milan Raki etj.

Kapërcimi i legjendës historike serbe të Kosovës nga librat në dorëshkrim të manastireve në krijimtarinë epike dhe në letërsinë e shkruar, në fazën e vet të dytë nis në fillimet e periudhës së zgjimit kombëtar serb, i cili zgjim vjen nga serbët e Austrisë. Përvoja e serbëve të Austrisë e fituar për dekada në kushte historike, sociale, kulturore dhe politike të tjera nën Austri, fillimisht zhvilloi mendimin nacional dhe nacionalizmin serb, i cili me kohë bartet dhe te serbët nën perandorinë Osmane. Mendimi nacional serb i përhapur tek serbët nën Austri, së bashku dhe me legjendën krishtere të Betejës së Kosovës dhe të kultit të knjaz Lllazarit në librat në dorëshkrim në manastire, nxitin krijimin e këngëve epike të Kosovës dhe të Nemanjiqëve, të cilat, si krijime poetike, janë të shek. XIX. Mirëpo, origjina e mirëfilltë folklorike gjegjësisht gojore e këtyre dy cikleve epike është e diskutueshme, sepse këto këngë, siç do të shohim, nuk janë produkt i muzës popullore, por i shkollës së kultivuar folklorike serbe. Në kushtet dhe rrethanat në të cilat u krijua mendimi nacional serb, që fillimisht erdhi në Serbi nga serbët e Austrisë duke filluar nga dekadat e fundit të shek XVIII dhe pothuaj gjatë gjithë shek XIX, siç u tha më lart, krijohen vepra të shumta letrare e historike me temën e kultit të Lllazarit dhe të Betejës së Kosovës. Në këto kushte historike lindi edhe shkolla e kultivuar folklorike serbe e gjysmës së parë e shek XIX e mbështetur në idetë e mistifikimit letrar dhe në nacionalromantizëm. Prijetar i kësaj shkolle ishte përfaqësuesi më i njohur i saj - Vuk Stefanoviq Karaxhiqi. Shkolla e kultivuar folklorike serbe në krye Vuk Karaxhiqin i krijoi këto këngë me anë të të cilave arriti që në nivel të lartë artistik ta ndërtojë dhe të popullarizojë mitin e Kosovës.

Vuk Karaxhiqi dhe përfaqësues të tjerë të shkollës së kultivuar folklorike serbe, siç ishin Llukjan Mushniqi, Teshan Podrugoviqi, Avram Milletiqi, Begisheviq etj., mendimin nacional serb e gjejnë dhe e përqafojnë në mesin e serbëve të Austrisë. Prandaj, Vuk Karaxhiqi krejt punën e tij në futjen apo bartjen e mitit të Kosovës në epikën gojore e përqendroi në Srem, në Mitropolinë e Karlovcit, në manastirin e Shishatovcit që gjeografikisht ishin nën Austri si qendrat më të rëndësishme të zhvillimit e të mendimit nacional serb.

Karaxhiqi punën e vet rreth projektit të mitit të Kosovës në epikën gojore, fillimisht e nis me interesimet për këngët e vjetra (stara pesme), të cilat mendonte se mund të jenë të gjalla në Kosovë. Prandaj, këto këngë ai do t'i gjurmojë nga rapsodët me origjinë nga Kosova të vendosur në Serbi apo dhe nga rapsodët në kufi apo në afërsi me Kosovën, në pamundësi që vetë të shkojë në Kosovë, sepse autori-tetet Osmane e ndalojnë të hyjë për shkak të lidhjeve të tij të ngushta me botën antiosmane perëndimore, sidomos me Austrinë dhe me Rusinë. Kështu, ai fillimisht hulumtoi këngët e Betejës së Kosovës nga rapsodët Angjellko Vukotiq me origjinë nga Rahoveci, Starac Rashko nga Kollashini dhe Starac Milija po ashtu nga Kollashini, mirëpo nga kjo përpjekje ndahet i zhgënjyer, sepse asnjëri prej tre rapsodëve të njohur epikë nuk dinte as edhe një këngë të vetme të periudhës së Nemanji-qëve apo për knjaz Lllazarin dhe Betejën e Kosovës. Vuku, pasi nuk gjen këngë të tilla nga këta rapsodë të njohur, do t'i kthehet konceptit mistifikues evropian të krijimit të të ashtuquajturave epe gojore, në bazë të të cilave koncepte ishin krijuar „Këngët e Osionit”, „Kalevala” etj., teknologjinë e krijimit të të cilave e njihte shumë mirë. Prandaj, nuk është i kotë përdorimi nga Vuku i shprehjes „stare pesme apo pesme iz starine”. Shprehja „stare pesme apo pesme iz starine” sipas Vukut nënkuptonte jo vetëm mbushjen e tyre me lëndë epike historike të lashtë – mesjetare, por sidomos periudhën e lashtë të krijimit të tyre. Kuptimi i dytë i kësaj shprehjeje i hap rrugë punës mistifikuese të Vuk Karaxhiqit. Në mungesë të këngëve të hershme të krijuara për Betejën e Kosovës dhe për Nemanjiqët, si njohës i shkëlqyer i strukturës artistike të këngëve epike serbe të vargut të shkurtër (pesme kratkog stiha), vetë dhe me përfaqësuesit e tjerë të shkollës së kultivuar folklorike, do ta bartë dhe do ta fusë mitin e Kosovës nga legjenda krishtere në këtë model të epikës gojore.

Bartjen e mitit të Kosovës nga legjenda krishtere në këngët epike të vargut të shkurtër, shkolla folklorike serbe e kultivuar e bën për shkaqe praktike të popullarizimit të këtij miti, sepse ky model i epikës gojore ishte shumë i receptueshëm për shijën estetike kolektive serbe, ndryshe nga këngët e vargut të gjatë apo bugarshticat, gjegjësisht, këngët e moçme epike serbe, të cilat duke e humbur funksionin e vet historiko-shoqëror kishin përfunduar fazën produktive dhe nuk ushqenin fuqishëm ndjenjën ideo-emocionale, estetike dhe psikologjike si këngët e vargut të shkurtër.

Teknologjia e ndërtimit të mitit të Kosovës e Vuk Karaxhiqit fillimisht mbështet pra në parimet e njohura të mistifikimit letrar. Ai në mungesë të këngëve të Betejës së Kosovës, në fjalorin e tij „Srpski rje nik” fut nën shkronjën „L” fjalën „Lazarica”, të cilën gjoja e kishte dëgjuar nga lahutarët e verbër në Srem dhe në Hercegovinë. Sipas tij, lahutarët e verbër me këtë shprehje nënkuptonin një këngë të gjatë që këndonte lavdinë e knjaz Lllazarit dhe Betejën e Kosovës. Vuku, më kot e hulumton këtë këngë të gjatë, atë nuk mund ta gjejë askund, prandaj vetë do t'i përvishet punës që ta krijojë. Si njohës i mirë i poetikës së këngëve epike serbe të

vargut të shkurtër, krijon këngë që, gjoja, i kishte shënuar nga baba Stefani dhe axha Toma, të cilët i kishin mësuar nga gjyshi i Vukut Joksimi dhe që i mbanin në mend vetëm si fragmente apo pjesë të një kënge të gjatë, të një tërësie të madhe epike. Këto këngë të shënuara që më 1815 Vuk Karaxhiqi i quan në fillim „Komadi kosovski pesama iz Llazarice” dhe shprehej se të gjitha këngët e Kosovës janë pjesë të Llazaricës „Sve kosovske pjesme su komade iz Lazarice”.

Variantet të Llazaricës apo epit të shpikur gojor të mitit të Kosovës, nën ndikimin e Vukut krijojnë edhe poetët e tjerë popullorë, gjegjësisht, përfaqësuesit e tjerë të shkollës folklorike serbe të kultivuar, prej të cilave disa ishin lahutarë – gusllarë të njohur si p.sh Teshan Podrugoviq, Avram Miletqi nga Shishatovci i Sremit. Në Manastrin e Shishatovcit, të Ravanicës dhe në Mitropolinë e Karlovocit, Vuku së bashku me Teshan Podrugoviqin, Avram Miletqiin, Llukjan Mushniqin dhe me përfaqësuesit të tjerë të shkollës folklorike të kultivuar ftonin lahutarë – gusllarë të njohur si Filip Vishniqin, Starac Rashkon, Starac Milijen, etj., me të cilët bashkëkrijonin tekste të këngëve për Betejën e Kosovës dhe për Nemanjiqët dhe këto tekste mandej përhapeshin dhe bëheshin popullore. Ndër manifestimet e njohura që kanë pasur rëndësi në popullarizimin e mitit të Kosovës përmes këngëve të vargut të shkurtër ishin tubimet në Manastirin e Ravanicës në Frushka Gorë, ku për çdo vit që nga shek. XVII kur ishte bartur kufoma e knjaz Llazarit nga Manastiri i Ravanicës i Serbisë në këtë Manastir, festohej në mënyrë madhështore Vidovdani. Lahutarët të shumtë nga Hercegovina, Serbia, territoret serbe nën Austri, në këto tubime mësonin tekste të këngëve të vargut të shkurtër për kultin e Llazarit dhe Betejën e Kosovës të krijuara fillimisht nga përfaqësuesit e shkollës folklorike të kultivuar. Kështu, shkolla e kultivuar folklorike serbe në krye me Vuk Karaxhiqin në pjesën e parë të shek. XIX krijoi ciklin e këngëve të Betejës së Kosovës dhe ciklin epik të Nemanjiqëve. Se vërtet këto këngë janë krijime të kësaj periudhe dhe të kësaj shkolle folklorike dëshmojnë më së miri edhe përmbledhjet e hershme të botuara me këngë epike serbe siç janë: „Dorëshkrimi i Erlangenit” i vitit 1723, përmbledhja e Avram Miletqiit, Millutinoviqiit etj., në të cilat nuk gjendet asnjë këngë e vetme për Betejën e Kosovës dhe për Nemanjiqët. Këngët epike të vargut të shkurtër me anën e mitit të Kosovës të krijuara nga shkolla e kultivuar folklorike serbe do të përvetësohen nga lahutarët e mëdhenj epikë të kësaj periudhe. Vuk Karaxhiqi së bashku me përfaqësuesit e tjerë të shkollës së kultivuar folklorike do t’i mbledhin këto këngë, do t’i redaktojnë duke i plotësuar dhe rregulluar dhe do t’i botojnë në përmbledhje të veçanta.

Pas botimeve të koleksioneve të Vuk Karaxhiqit me këngë për Betejën e Kosovës, kultin e Llazarit dhe me këngë të Nemanjiqëve, do të fillojë gradualisht ndikimi i këtyre veprave të shtypura në zhvillimin e mëtutjeshëm të mitit të Kosovës. Studiuesi i njohur i epikës gojore serbe dhe njeri ndër njohësit më të mirë të biologjisë së saj në ambientin e mirëfilltë folklorik, në terren, Matija Murko konsta-

tonte se shumë lahutarë këndonin këngë që i kishin lexuar dhe mësuar nga „Pjesnarnicat” e botuara të Vukut. Me fjalë të tjera, shfaqja dhe përhapja e mitit të Kosovës në epikën gojore serbe pas Vukut është rezultat dhe ndikim i drejtëpërdrejtë i përmbledhjeve të tij me këngë epike të botuara, në bazë të të cilave krijohen këngë të reja për Betejën e Kosovës dhe për Nemanjiqët. Në këtë mënyrë, miti i Kosovës tani përhapet në gjithë Serbinë , në Mal të Zi, në Hercegovinë dhe te serbët e Austrisë, duke marrë kështu hov të madh të zhvillimit, sepse krijohen këngë të reja nën ndikimin e koleksioneve të Vukut.

Në gjysmë e parë të shek. XIX, sidomos, por dhe gjatë gjithë këtij shekulli miti i Kosovës përhapet jo vetëm me anë të këngëve epike, veprave letrare, veprave historike, po edhe përmes manifestimeve të tjera kulturore, shkollës, arsimit, etj.,. Qarqet udhëheqëse të kallugjerëve për nevojat e nxënësve në manastire, sidomos, në Mitropolinë e Krllovcit, hartojnë tema për ushtrime të retorikës, ku dominojnë temat e mitit të Kosovës. Po ashtu tema e mitit të Kosovës nga murgjit në manastire e kisha nxitet edhe në pikturën kishtarë të kësaj kohe, në stematografi etj. Tani miti i Kosovës në botën serbe ndodhet çdokund. Nën ndikimin e tij gjithë Serbia bëhet Kosovë.

Kështu, shpirtin kolektiv serb të ushqyer, të mëkuar me mitin e Kosovës, në kohën kur Perandoria Osmane ishte në rënie, kisha dhe intelgjencia serbe po përgaditëte për rikrijimin e perandorisë mesjetare serbe të Shtefan Dushanit.

Aq sa ishte e rëndësishme puna që Vuk Karaxhiqi e kishte bërë me përhapjen e mitit të Kosovës përmes modelit të këngës epike të vargut të shkurtër, po aq ishte e rëndësishme puna që ai bëri në plasimin e këtyre këngëve në qarqet kulturore evropiane në përkthimin e tyre, sidomos në përkthimin në gjuhën gjermane. Në këtë drejtim, Vukun e ndihmoi dijetari sloven Jernej Kopitari, i cili e lidh me studiues të njohur, filozofë, historianë, poetë, gjuhëtarë, etnologë, dhe folkloristë gjermanë. Internacionalizimi i mitit të Kosovës përmes përkthimit të këngëve epike bëhet për qëllime politike, që të binden qarqet kulturore dhe shtetërore evropiane për të ashtu-kuajturën „të drejtën shtetërore historike” që do duhej ta ketë Serbia në Kosovë. Për të arritur këtë qëllim, intelgjencia serbe e shek. XIX përktheu në gjermanisht dhe në gjuhë të tjera evropiane dhe disa vepra të zgjedhura letrare që trajtonin mitin e Kosovës. Ndër to rëndësi të madhe pati, sidomos, vepra e Njegoshit „Kurora e maleve” (Gorski vijenac). Pra, në etapën e tretë miti i Kosovës përhapet në të gjitha territoret serbe përmes modelit të këngës epike të vargut të shkurtër dhe kështu mëkohet shpirti kolektiv serb me këtë mit si dhe internacionalizohet përmes përkthimeve, së pari në gjermanisht, po edhe në ndonjë gjuhë tjetër, me qëllim të krijimit të opinioneve kulturore dhe politike në Evropë për gjoja të drejtën shtetërore historike të Serbisë në Kosovë.

Nga gjithë kjo që u tha, shihet se këngët e Kosovës nga Vuku për Betejën e Kosovës, kultin e Lllazarit dhe për Nemanjiqët janë prodhim i mendimit nacional serb

të shek. XIX dhe nuk janë krijime të periudhave historike që u këndojnë. Fryma nacionale në epikën gojore të të gjithë popujt e Ballkanit nuk shfaqet në periudhën parakombëtare, por në periudhën e zgjimit kombëtar të këtyre popujve. Kjo frymë në epikën gojore shqiptare nis me këngët e kaçakëve, të grekët me këngët e kleftëve, të bullgarët me këngët e komitëve, të serbët e kroatët me këngët e hajdutëve dhe të uskokëve. Prandaj në këtë drejtim, epika gojore serbe nuk mund të bëjë përjashtim. Kjo vërteton se mendësinë mitologjike të traditës serbe të Kosovës në periudhën e zgjimit kombëtar serb, dmth në shek. XIX kisha dhe inteligjencia serbe e shndërrojnë në aspiratë historike. Kështu që argumenti serb për Kosovën si tokë e shenjtë serbe si zemër e Serbisë mesjetare nuk është argument historik por mitologjik, është mit i krijuar për qëllime pushtuese dhe aneksioniste.

Miti i Kosovës në këngët epike të vargut të shkurtër të botuara në përmbledhjet e Vukut dhe në krijimtarinë epike të mëvonshme, që nxitet nga veprat e botuara prej tij, do të bëjë jetë jo vetëm gjatë shek. XIX, por edhe gjatë gjithë shek. XX. Në mbështetje të mitit të Kosovës do të bëhen plane të shumta nacionale serbe për krijimin e Serbisë së madhe, gjegjësisht, të mbretërisë serbe të Nemanjiqëve. Ndër ideologët nacionalë serbë të këtyre planeve njihen sidoms Ilija Garashanin, Jovan Cvijiq, Vasa Çubrilloviq etj. Projekti më famëkeq në këtë drejtim mbetet „Naçertanije” e Ilija Garashaninit, që ishte platformë politike e frymëzuar edhe nga miti i Kosovës dhe që parashihte Serbinë si trashëgimtare e drejtëpërdrejtë e Perandorisë mesjetare serbe e Stefan Dushanit. Programi i „Nacertanjes” i mbështetur edhe në mitin e Kosovës ka qenë prioritet themelor i politikës serbe që nga viti 1844. Ky projekt do të realizohet pjesërisht gjatë Luftës së Parë Ballkanike, kur Serbia më 1912-1913, në bazë të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, aneksoi Kosovën, Dibrën dhe vise të tjera lindore të Shqipërisë. Me fjalë të tjera, e ashtuquajtura e drejta shtetërore historike e Serbisë në Kosovë, e kënduar aq shumë në këngët epike dhe e shtjelluar në letërsinë serbe të shek. XIX dhe më vonë, gjegjësisht, miti i Kosovës, të cilin e kishte krijuar kisha dhe intelegjencia serbe, nga Lufta e Parë Ballkanike e këndej fillon të jetësohet apo të bëhet realitet.

Pra, në etapën e vet të fundit, d.m.th, nga koha kur në frymën e mitit të Kosovës fillojnë të bëhen projekte nacionale për krijimin e Serbisë mesjetare të Njemanjiqëve dhe të knjaz L Lazarit, ky mit për shqiptarët ka prodhuar urrejtje, spastrim etnik dhe gjenocid. Kulmi i kësaj urrejtjeje, spastrimi etnik dhe gjenocidi arrin në kohën e Millosheviqit.

Në fund mund të konstatohet se miti serb i Kosovës si projekt politikokulturor i elitës së kallugjerëve apo murgjve në Manastire dhe i intelegjencies serbe të shek.XIX, është krijuar për qëllime ekspansioniste, pushtuese dhe aneksioniste ndaj Kosovës dhe territoreve të tjera shqiptare dhe si i tillë ka prodhuar fatkeqësi të mëdha, jo vetëm për shqiptarët por edhe për vetë serbët.

Hovi i ekspansionizmit serb, i nxitur nga miti i Kosovës, përfundimisht do të ndalet nga lufta e armatosur e shqiptarëve dhe ndërhyrja ushtarake perëndimore kundër makinerisë shfarosëse militare serbe. Mirëpo, është për të ardhur keq se edhe sot e kësaj dite politika e Serbisë, kisha ortodokse serbe, por fatkeqësisht edhe pjesa më e madhe e kombit serb, karshi Kosovës si shtet, nuk po mund të çlirohen nga fryma ekspansioniste e mitit të Kosovës dhe nga ana tjetër ky mit po vazhdon ende ta mbajë peng Serbinë dhe të ngadalësojë procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor si nevojë e domosdoshme e integritimeve evropërëndimore të këtij rajoni. Mirëpo, shpresojmë fuqishëm se edhe Serbia do ta kuptojë se në kushte të sotme mendësia mitike ekspansioniste është pengesë e zhvillimeve demokratike dhe e integritimeve dhe se kësaj mendësie serbe të dy shekujve të fundit më i ka ikur koha përgjithmonë.

Bibliografia

1. Mareti , T. (1966), *Naša narodna epika*, Beograd.
2. Mati , Svetozar. (1964), *Naš narodni ep i naš stih*, Novi Sad.
3. Lazarica, Beograd 1906.
4. Popovi , Miodrag (1972) *Vuk Stef. Karadži , 1787-1864*, Nolit, Beograd.
5. Narodna srpska pjesnarnica, (1815) Be .
6. Karadži , V. St. (1954) *Srpske narodne pesme II*, Beograd.
7. Karadži , St. Vuk (1896) *Srpske narodne pjesme, knjiga IV*, Biograd.
8. Gezeman, Gerhard (1925) *Srskohervatske narodne pesme*, Sremski Karlovac.

Shkumbin MUNISHI

**MBI DREJTIMET E MUNDSHME TË ZHVILLIMIT TË STUDIMEVE
SOCIOLINGUISTIKE TË SHQIPES**

Abstrakt

Në këtë punim paraqiten të gjitha zhvillimet e deritashme të studimeve sociolinguistike në fushën e shqipes dhe gjendja e tanishme e studimeve sociolinguistike, si dhe trajtohen mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre studimeve. Në fillim jepen të dhënat kronologjike lidhur me problemet e ndryshme sociolinguistike të shqipes, të cilat janë trajtuar nga autorë të ndryshëm të huaj e shqiptarë, që nga shfaqja e kësaj qasjeje studimore në fushën e shqipes dhe, pastaj, paraqitet gjendja e studimeve aktuale sociolinguistike të shqipes. Në fund, trajtohen hapësirat potenciale për lëvrimin e mëtejshëm të problemeve e çështjeve të ndryshme sociolinguistike të shqipes dhe parakushtet që duhet krijuar për avancimin e mëtejshëm të studimeve sociolinguistike.

Fjalët kyçe: sociolinguistika, shqipja, planifikimi gjuhësor, politikë gjuhësore, ideologjia, hulumtim sasior, variacion gjuhësor, analizë diskursi.

Hyrje

Para katër-pesë vitesh pata një komunikim përmes emailit me sociolinguistin e mirënjohur Nikolas Coupland, në atë kohë kryeredaktor, bashkë me sociolinguistin Allan Bell, i revistës shkencore “Journal of Sociolinguistics”, të cilit i shpreha interesimin tim për ta dërguar për botim një punim lidhur me situatën gjuhësore të shqipes në Kosovë. Mëbeta i befasuar nga interesimi dhe gatishmëria e tij për ta marrë në konsideratë për botim punimin tim. Couplandi m’i dërgoi kriteret teknike që duhet t’i ketë teksti, të cilat “Journal of Sociolinguistics” i zbaton për punimet që botohen në të dhe kërkoi nga unë që t’i propozoj dy recensentë, të cilët do ta shqyrtonin punimin tim. “Kërkoj falje, por unë nuk njoh ndokënd që merret me probleme sociolinguistike të shqipes, prandaj ju sugjeroj që vetë t’i propozoni dy recensentë”, ishin fjalët e Couplandit. U ndala dhe mendova se kë mund ta

propozoja përveç Rexhep Ismajlit, pasi emrat e tjerë që m'u kujtuan ishin në vetë fillimet, e marrjes madje fragmentare me sociolinguistikë.

Po e filloj këtë ligjëratë duke treguar këtë përvojë timen, e cila shpërfaq më së miri gjendjen e studimeve sociolinguistike të shqipes dhe nevojën për ta ndryshuar këtë gjendje, temë kjo për të cilën do të flasim në vazhdim.

Gjuhësia shqipe zhvillimin e saj më të madh e ka arritur gjatë shekullit të kaluar, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Forcimi i entiteteve shtetërore shqiptare në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni ndikoi drejtpërdrejt në krijimin e kushteve më të përshtatshme institucionale, arsimore e shkencore për avancimin e studimeve linguistike shqipe. Kjo ndikoi që të zgjerohej gama e interesimeve shkencore dhe të shtohej numri i studiuesve të cilët merreshin me probleme të shqipes. Kur flasim për profilin dhe fushat e studimeve linguistike shqipe gjatë shekullit XX, duhet theksuar se këto studime shtriheshin në disa fusha. Fillimisht, falë interesimeve të autorëve të huaj, si: Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokl, Agna Desnickaya, Eric Hamp dhe të tjerë, vëmendja u përqendrua në trajtimin e probleme nga fusha e historisë së gjuhës shqipe dhe të lidhjeve të saja me gjuhët e rajonit e me gjerë. Studimet historike-krahasimtare të autorëve të huaj, u pasuan nga studimet e autorëve shqiptarë, si: Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti, Besim Bokshi dhe të tjerë, të cilët plotësuan mozaikun e të arriturave në fushën e historisë së shqipes. Në kuadër të këtyre studimeve u trajtuan çështje që kanë të bëjnë me etimologjinë e shqipes, me probleme të fonologjisë dhe gramatikës historike, si dhe me çështje të tjera që kanë të bëjnë me afërsinë dhe me përkimet e shqipes qoftë me gjuhët e Ballkanit, qoftë me gjuhët e tjera evropiane.

Përveç studimeve në fushën e historisë së shqipes, pas Luftës së Dytë Botërore morën hov edhe studimet në fushat e tjera të gjuhësisë shqiptare. Në atë periudhë pati një përqendrim paralel në dy fusha kryesore studimore. Së pari, iu kushtua vëmendja procesit të normimit të shqipes, proces ky që u vu në qendër të vëmendjes së elitave politike e kulturore në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Aktivitetet kryesore u përqendruan në hartimin e dokumenteve normative të shqipes standarde, siç ishin drejtshkrimet e fjalorët e ndryshëm të shqipes të botuar në Shqipëri dhe në Kosovë që nga viti 1947 e deri më 1972. Së dyti, puna kryesore që përqendruar në studimin e problemeve në fushën e fonetikës, morfologjisë, sintaksës, leksikut, si dhe në hartimin e gramatikave dhe të fjalorëve të shqipes. Si rezultat i këtyre studimeve u botuan shumë gramatika e botime të tjera shkencore, të cilat nuk do t'i përmendim një nga një, por të cilat kontribuuan në përparimin e studimeve linguistike shqiptare. Gjithashtu, vlen të përmendet së në atë periudhë në fushën e dialektologjisë pati një sërë aktivitetesh të vazhdueshme për studimin e dialekteve e të folmeve të shqipes, studime këto që kishin për qëllim hartimin e Atlasit Dialektor të Shqipes. Këto studime dialektore ndihmuan në krijimin e një

pasqyre sadopak të qartë për të folmet e arealit të shqipes, për tiparet dhe për gjendjen e tyre.

Megjithatë, kur po flasim për këto studime, përkundër përpjekjeve dhe të arriturave studimore, gjuhësia shqiptare e asaj periudhe vazhonte të mbetej e pa ndikuar nga drejtimit moderne linguistike të shekullit XX, siç ishin strukturalizmi, funksionalizmi e gramatika gjenerativiste transformacionale. Drejtimit interdisiplinare, siç ishin sociolinguistika e psikolinguistika, të cilat filluan të zhvilloheshin gjatë viteve '50 të shekullit të kaluar, pothuajse ishin të panjohura për gjuhësinë shqiptare të para 3-4 dekadave. Arsyet për mosdepërtimin e këtyre drejtimeve linguistike në Shqipëri mbase duhet kërkuar në rrethanat politike, ekonomike e kulturore, të cilat mbretëronin në Shqipërinë e asaj periudhe. Mbyllja hermetike dhe izolimi i vendit pengonin kontaktet me botën tjetër dhe ndikonin në përcjelljen e rrjedhave studimore moderne të kohës.

Mungesa e informatave dhe mosnjohja e drejtimeve linguistike të kohës, manifestohej përmes kompleksit të refuzimit ideologjik të drejtimeve moderne linguistike. Ideologjia bëhej mburojë për mosdije dhe refuzim. Pikëpamjet e pakta teorike të strukturalizmit, gjenerativizmit e funksionalizmit, për të cilat ndonjë gjuhëtar kishte informacione të kufizuara, hidheshin poshtë nga të tjerët, duke u stigmatizuar e cilësuar me përplottribute negative ideologjikesht të motivuara. Në anën tjetër, kishte edhe gjuhëtarë, që edhe pse mund të kishin sadopak njohuri për zhvillimet moderne në fushën e gjuhësisë, pikërisht për shkak të stigmatizimit ideologjik, nuk zbatonin dot në studimet e tyre metoda e skema teorike të drejtimeve të përmendura linguistike. Në atë periudhë gjuhësia shqiptare mbeti e izoluar dhe e pandikuar nga shkollat e drejtimit e atëhershme moderne linguistike. Kjo situatë ndikoi drejtpërdrejt në nivelin e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare dhe pati për pasojë shfaqjen e mangësive të shumta teorike e praktike në studimet në fushën e gjuhësisë. Në fakt, gjuhësia shqiptare edhe sot e gjithë ditën nuk ka arritur të dalë krejtësisht nga skemat e gjuhësisë tradicionale, në të cilat ka qenë e ngujuar për gati 5 dekada.

Ndryshimi i rrethanave politike, ekonomike e kulturore, si dhe zhvillimi i teknologjisë informative, në këto dy dekadat e fundit, i ka hapur rrugë depërtimit të drejtimeve moderne linguistike, të cilat kanë filluar të përqafohen nga studiuesit e brezit të ri. Këto zhvillime sigurisht që do të ndikojnë në zhvillimin pozitiv të gjuhësisë shqiptare në shekullin në të cilin po jetojmë.

1. Zhvillimi i sociolinguistikës si shkencë interdisiplinare

Pak më parë u tha që drejtimit interdisiplinare siç është sociolinguistika kanë depërtuar fare pak në gjuhësinë shqiptare. Studimet sociolinguistike, në fakt, janë vazhdimësi e studimeve dialektore të ndërmarra në Europë, SHBA e gjetiu gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX. Kalimi nga

studimet dialektore në studimet sociolinguistike është i ndërlidhur me përfshirjen në anketim të respondentëve nga qendrat urbane, krahas modelit tradicional dialektologjik të gjetjes së informatorëve në zonat më të thella të izoluara rurale, te të cilët kërkoheshin izoglosat e caktuara. Ky element ka ndikuar që në studimet dialektore të dalë në shesh edhe ndikimi i faktorëve shoqërorë në ligjërim, pikërisht për faktin se shtresëzimi shoqëror i qendrave urbane është shumëdimensional. Elementet e para të studimeve gjuhësore që marrin parasysh ndikimin e faktorëve shoqërorë i gjejmë në studimet e autorëve indianë dhe japonezë, por sociolinguistika e mirëfilltë mund të thuhet se fillon me studimet e gjashtë studiuesve, të cilët mund të konsiderohen si pionierë të sociolinguistikës. Në këtë mes, në radhë të parë duhet përmendur William Labovin, i cili me punimet e tij të para në fushën e sociolinguistikës sasiore në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar konsiderohet si themelues i kësaj disipline. Përveç tij, themelues të sociolinguistikës mund të konsiderohen edhe sociologu britanik Basil Bernstein, i cili me punën e tij mbi kodet e ndërlidhura me klasat hapi shtigje të rëndësishme për studimet sociolinguistike. Autorët e tjerë që ndihmuan në konsolidimin e kësaj disipline janë: Dell Hymes, i cili formësoi të ashtuquajturën “etnografi të komunikimit”, John Gumperz, i cili mund të konsiderohet si themelues i sociolinguistikës interaksionale, si dhe Charles Ferguson dhe Joshua Fishman të cilët zgjeruan edhe më tej hapësirat e studimeve sociolinguistike, duke përfshirë trajtimin e varieteteve gjuhësore dhe dukurive që ndërlidhen me raportet midisi varieteteve gjuhësore. Të gjithë këta autorë, përveç Bernsteinit, ndonëse edhe ai ishte ftuar, qenë të pranishëm në Institutin Gjuhësor në Bloomington, në verën e vitit 1964, ngjarje kjo që i dha shtytje studimeve sociolinguistike. Këta autorë, të cilët ndonëse tashmë mund të quhen klasikë, mbeten të patejkaluar në studimet sociolinguistike. Autorë të tjerë, si Peter Trudgill, Lesley e James Milroy, Walter Wolfram, Nikolas Coupland, Deborah Tannen, Norman Fairclough e të tjerë, me punimet e tyre ndihmuan në avancimin e sociolinguistikës si disiplinë shkencore. Përndryshe, duket që për herë të parë termin sociolinguistikë ta ketë sajuar, më 1939, Thomas Callan Hudson.

Sot, sociolinguistika është disiplinë që ka arritur përparime e rezultate të shumta studimore dhe ka konsoliduar metodologjinë kërkimore, sidomos në SHBA dhe në Europën Perëndimore. Përveç gjuhësisë, ajo ndërthuret edhe me disiplina të tjera shoqërore, si: sociologjia, psikologjia, antropologjia e etnologjia, gjë që ka ndikuar që kjo disiplinë të marrë karakter me të vërtetë interdisiplinar. Krahas problemeve dhe çështjeve tashmë tradicionale nga fusha e politikës dhe planifikimit gjuhësore, nga fusha e kontakteve të gjuhëve, në kuadrin e sociolinguistikës sot trajtohen edhe çështje të variacionit gjuhësore, të varieteteve e të stileve funksionale, probleme të gjuhës, kulturës e mendimit, si dhe çështjet e problemet nga fusha e sociolinguistikës interaksionale e të analizës së diskursit. Me fjalë të tjera, gama e interesimeve sociolinguistike përfshin pothuajse çdo modalitet të ndikimit të

faktorëve shoqërorë, kulturorë e psikologjikë në ligjërimin e individit dhe të grupeve të ndryshme shoqërore. Në SHBA dhe në Europë, sociolinguistika zë vend qendror në planet dhe programet e institucioneve të ndryshme universitare dhe instituteve të ndryshme, të cilat në kuadrin e tyre kanë edhe departamentet e gjuhësisë.

2. Gjendja e sotme e studimeve sociolinguistike shqipe

Sa i përket studimeve sociolinguistike në fushën e shqipes, ato janë krejt të pakta dhe nuk mund të flitet për një disiplinë të konsoliduar studimore në gjirin e shqipes. Në bibliografinë e studimeve albanologjike mund edhe të hasësh shpesh tituj punimesh që përmbajnë atributin “sociolinguistik”, por në shumicën e atyre punimeve ka pak ose aspak sociolinguistikë. Mjafton të bëhet një kërkim në Google duke përdorur fjalët kyçe “studime” (studies), “sociolinguistike” (sociolinguistics) dhe “shqipe” (Albanian) dhe literatura kryesor e vetme që shfaqet është një publikim i veçantë, nr. 178, i revistës “International Journal of the Sociology of Language”, revistë që ka si kryeredaktor sociolinguistin e mirënjohur Joshua A. Fishman, me titull: “Sociolinguistic Studies on the Albanian language” (2006). Në këtë botim, i cili është redaktuar nga Eda Derhemi dhe Pandeli Pani, janë të përfshirë disa punime të autorëve të ndryshëm shqiptarë e të huaj, si: Gjovalin Shkurtaj, Bahri Beci, Eric P. Hamp, Eda Derhemi, Pandeli Pani, Basil Schader, Xheval Lloshi, Jani Thomaj, Rami Memushaj dhe Wilfried Fidler, shumica e të cilëve nuk shquhen për ndonjë fokusim të veçantë në fushën e sociolinguistikës. Çdo kërkim tjetër për referenca lidhur me studimet sociolinguistike në fushën e shqipes rezulton mjaft i varfër.

Studimet e para sporadike që trajtojnë probleme sociolinguistike të shqipes janë kryer në fillim të viteve ’70 të shekullit të kaluara. Ndër studimet e para të karakterit sociolinguistik që trajton probleme të shqipes, mund të konsiderohet studimi i Peter Trudgillit (1975) në fushën e kontakteve të gjuhëve, lidhur me gjendjen e arvanishtes në Greqi (Trudgill, 1990). I po të njëjtës periudhë është edhe studimi i parë i mirëfilltë sociolinguistik në fushën e politikës dhe planifikimit gjuhësor të shqipes i autores amerikane Jannet Byron (1976), i cila trajton rrjedhat e planifikimit të shqipes në Shqipëri dhe ndikimin e faktorëve shoqërorë e ideologjikë të kohës në këtë proces. Në një punim tjetër ajo merr në trajtim edhe procesin e planifikimit të shqipes në hapësirat e ish-Jugosllavisë (1979). Një autor tjetër i huaj që është marrë me probleme të shqipes, më konkretisht të arvanishtes, është Lukas D. Tsipis, i cili në librin e tij “*A Linguistic Anthropology of Praxis and Language Shift: Arvanitika (Albanian) and Greek in Contact*” gjithashtu trajton gjendjen e arvanishtes në Greqi.

Sa u përket autorëve shqiptarë, është Rexhep Ismajli (1978, 1990, 1994, 1998, 2003, 2005) ai që e hapi i pari dritaren e sociolinguistikës për botën shqiptare, siç bëri edhe me drejtimet e tjera moderne linguistike (Munishi, 2012). Nga gjysma e

dytë e viteve '70 të shekullit XX, në disa punime të tij, Rexhep Ismajli në mënyrë të vazhdueshme u mor me trajtimin çështjeve të planifikimit gjuhësor dhe të shqipes standarde, duke mos u kufizuar vetëm në përshkrimin e normës së saj e në çështje të kulturës së gjuhës, që ishte bërë zakon në atë periudhë, por duke trajtuar problemet e planifikimit të shqipes nga një këndvështrim deri atëherë i ri në gjuhësinë shqiptare – nga këndvështrimi sociolinguistik. Po ashtu, ai trajtoi edhe tema të tjera të natyrës sociolinguistike, siç janë çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën, kulturën, etninë dhe kombin. Veprimtaria e tij pioniere në fushën e sociolinguistikës jo vetëm që u bë model për disa linguistë të rinj që ta ndjekin rrugën e tij, por pati ndikim të drejtpërdrejtë në rrjedhat e kahet e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare.

Ndër autorët e tjerë që kanë trajtuar problemet e shqipes në rrafshin sociolinguistik është edhe Mariana Ymeri, e cila në një punim të saj që i takon rrafshit të sociolinguistikës është marrë me qëndrimet e studentëve lidhur me raportet gjuhë standarde/dialekt. Ky punim paraqet njërin ndër hulumtimet e para të nivelit edhe kualitativ, edhe kuantitativ sociolinguistik në rrafshin e shqipes (Ymeri, 1993). Më pas, në punimet e tjera kjo autore trajtoi edhe çështjet e ekonomizimit gjuhësor në kuadrin e planifikimit të gjuhës (1994), si dhe tiparet e ligjërimit të folur në chat (2005). Një kontribut të veçantë Ymeri dha me rastin e përkthimit të librit të Richard A. Hudson, Sociolinguistika (2002). Ky libër edhe sot shërben si një tekst i dobishëm universitar për studentët e degëve të gjuhësisë, ndonëse ka ankesa nga studentët (së paku këta të Prishtinës) lidhur me stilin dhe kuptueshmërinë e tekstit në gjuhën shqipe. Një tjetër tekst në shqipe të sociolinguistikës e kemi të botuar më herët, më 1996, të autorit Gjovalin Shkurtaj. Aspektit teorik të planifikimit gjuhësor i është qasur edhe Rahmi Memushaj (1996, 1997). Çështjet e politikës gjuhësore dhe të planifikimit të shqipes në Shqipëri janë trajtuar edhe nga Bahri Beci, në një sërë punimesh të botuara gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar, punime këto të cilat janë përmbledhur në një libër të titulluar “Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri” (Beci, 2003).

Ndërkaq, ndikimi ideologjik në standardizimin e shqipes është përshkruar nga Ardian Vehbiu (1997). Në vitet e fundit Vehbiu ka botuar dy libra të tjerë: “Fraktalet e shqipes, rrëgjimi i gjeometrive të standardit” (2007) dhe “Shqipja totalitare, tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990” (2009), në të cilat trajton më thellë problemet e shqipes standarde dhe ndikimin ideologjik në procesin e standardizimit të shqipes.

Pas vitit 2002 kemi një varg punimesh nga fusha e sociolinguistikës, të botuara kryesisht në Kosovë, të cilat trajtojnë çështje të politikës dhe të planifikimit gjuhësor të shqipes, probleme të kontakteve gjuhësore, të rrezikshmërisë së gjuhëve e çështje të analizës së diskursit. Ndër autorët që janë marrë me probleme të ndryshme sociolinguistike të shqipes po përmendim Eda Derhemin, e cila ka trajtuar çështjen e rrezikshmërisë së një varieteti të shqipes, të arbërishtes, dhe dukuri të

caktuara të lidhura me të. (Derhemi, 2002, 2003, 2006). Duhet theksuar se, në këto 10 vitet e fundit, pikërisht Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare u bë tribunë e shqyrtimeve sociolinguistike. Nën drejtimin e Rexhep Ismajlit është krijuar thuaj një qerthull i studimeve sociolinguistike në Prishtinë. Kështu, Bardh Rugova (2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011) ka trajtuar çështje të analizës së diskursit, me theks të veçantë në diskursin e medieve, dukurinë e dizajnit të audiencës dhe çështje të statusit të gjuhëve. Rrahman Paçarizi (2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010) i është qasur problemit të planifikimit gjuhësor të shqipes nga aspekti psiko-sociolinguistik, ka trajtuar dukurinë e komunikimit përmes mesenxherit, si dhe problemin e rrezikshmërisë së gjuhës shqipe. Shkumbin Munishi (2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012) është marrë me çështje të politikës dhe planifikimit gjuhësor, me çështje të variacionit gjuhësor, çështje të barazisë së gjuhëve e ideologjisë gjuhësore, ndikimin e Internetit në shqipe e kështu me radhë. Ndër autorë të tjerë që kanë trajtuar probleme të ndryshme të natyrës sociolinguistike janë edhe Lindita Tahiri (2009), e cila ka trajtuar çështje të stileve të gjuhës, Ferit Rustemi (2011), Ledi Shamku – Shkreli (2005, 2010), Ardian Doka (2008), Merita Hysa dhe Orjeta Baja (2009), Julie May Kolgjini (2010), Bregasi (2008, 2010, 2011) e që mund të ketë edhe autorë të tjerë, të cilët mbase kam harruar t’i përmend në këtë rast, ose mund të mos kem pasur informacionin e duhur. Këtu të shtojmë se ka edhe një numër studimesh nga fusha e kontakteve të gjuhës, siç janë disa studime të Vesel Nuhiut, Blerta Mustafës, Haxhi Shabanit dhe të disa autorëve të tjerë, të cilat ka një qasje sociolinguistike dhe të cilat dallojnë prej studimeve tradicionale të huazimeve gjuhësore që janë kryer edhe më parë në gjuhësinë shqiptare, por në studimet në fushën e kontakteve të gjuhës nuk do të ndalem më gjatë.

Me pak fjalë, u përpoqa t’i përmbledh kontributet e deritanishme në fushën e studimeve sociolinguistike të shqipes, për të dhënë një pasqyrë të gjendjes së sociolinguistikës ndër ne. Po ritheksoj, sigurisht, mund të ketë edhe punime të tjera, të cilat ose mund t’i kem harruar, ose mund të mos jem në dijeni për to, por kontributet që i përmenda konsideroj se janë më kryesoret për zhvillimin e sociolinguistikës shqiptare.

3. Hapësirat e mundshme të hulumtimeve sociolinguistike

Pasqyra e studimeve sociolinguistike, të cilën u përpoqa ta paraqes pak më parë, dëshmon qartë se sociolinguistika shqiptare vazhdon të mbetet në fillimet e saja, pa shenja të dallueshme të një përparimi modest. Ajo vazhdon të mbetet fushë e interesimeve të kufizuara individuale, në të cilën mungojnë studimet sistematike, por edhe ekipore.

Sot, bota shqiptare, areali shqipfolës në Ballkan dhe diaspora, paraqet një parajsë më vete për studime sociolinguistike, pikërisht për shkak të gjendjes politike, ekonomike e kulturore të trojeve shqiptare. Ambienti kulturor e politik në të cilin jetojnë shqiptarët, në Shqipëri e Kosovë, por edhe në Maqedoni, Mal të Zi e në diasporë, aktualisht paraqet një burim të pashtershëm për shfaqjen e dukurive të ndryshme sociolinguistike. Prandaj, studimi i tyre do të ishte me interes dhe dobi të veçantë.

Zhvillimi i sociolinguistikës nënkupton braktisjen e studimeve tradicionale dialektore, që edhe ashtu kanë ngecur, dhe përqendrimin në studime të varieteteve të ndryshme të shqipes, me theks të veçantë në studimin e vernakularëve urbanë, të regjistrave e stileve të tjera funksionale të shqipes. Kjo nënkupton braktisjen e formave dhe metodologjisë tradicionale të studimeve dialektore, përvetësimin e metodave sociolinguistike dhe zbatimin e metodave kualitative e kuantitative sociolinguistike në studimet gjuhësore. Në këtë kuptim mund të kryhen edhe hulumtime e anketime sociolinguistike edhe në nivel kombëtar. Në fushën e politikës gjuhësore dhe të planifikimit të shqipes ndonëse ka disa përparime, mbetet ende punë për t'u bërë. Në fushën e politikës gjuhësore mungon një politikë gjuhësore brenda shoqërisë shqiptare, mbi të cilën do të bazoheshin qëndrimet ndaj gjuhës.

Planifikimi i statusit është trajtuar deri diku, por mbetet mjaft hapësirë të hulumtohet adekuaciteti i statusit të shqipes në arealin shqipfolës, planifikimi i funksioneve dhe realizimi i statusit në praktikë, punë këto që mund të kryhen përmes hulumtimeve empirike e sasiore. Planifikimi nxënies mbetet fushë që ka ngecur prapa. Me interes paraqesin studimet sociolinguistike në ndërlidhje me praktikën arsimore. Kështu, mund të ketë studime të nxënies së gjuhës, të analizës së bisedave në klasë, ndikimi i faktorëve sociolinguistikë të nxënies në procesin mësimor, çështjet e pabarazisë gjuhësore dhe lidhja e gjuhës me prejardhjen regionale e sociale të nxënësve, si burim i pabarazisë gjuhësore, përfaqësimi i kontekstit me rastin e procedimit të informatave, si dhe shtrëngimet psiko-sociolinguistike të nxënies së shumë e shumë aspekte të tjera. Edhe planifikimi i korpusit është fushë ku mund të bëhen studime të shumta sociolinguistike, të cilat do të ndihmonin në praktikën standardologjike të shqipes, sidomos në këtë kohë kur flitet aq shumë për rishqyrtimin eventual të normës. Në fushën e planifikimit të korpusit të shqipes standarde, ose më mirë të themi të rishqyrtimit të tij, mund të thuhet se studimet kanë ngecur aty ku kanë qenë më 1972. Lëvizje të vetme pozitive në këtë drejtim paraqesin veprimtaritë e Këshillit Ndërkademiç dhe Konferenca e Durrësit e vitit 2010.

Fusha krejtësisht të paprekura mbeten sociolinguistika variacionale dhe sociolinguistika interaksionale, si dhe analiza e diskursit. Studimi i varieteteve gjuhësore, analiza e bisedave dhe ndërlidhja e tyre me faktorët shoqërorë dhe

studimet e diskursit, sidomos të teksteve të folura, do të ishin një kontribut i çmuar për shqipen, por për t'u kryer studime të tilla duhet përgatitje paraprake metodologjike në fushën e sociolinguistikës.

Për ta tejkaluar këtë gjendje mendoj se duhet angazhim më i madh i institucioneve arsimore e shkencore në hapësirat shqiptare për të dhënë orientimin e duhur studimor dhe për t'i orientuar kërkuesit shkencorë drejt hapësirave sociolinguistike. Studimet sociolinguistike do të ndihmonin më së tepërmi në paraqitjen e gjendjes aktuale të shqipes dhe të varieteteve të saja, si dhe ndikimin e faktorëve të shumtë kulturorë, ekonomikë dhe politikë në fenomenet që i hasim në shqipe.

Një element tjetër i rëndësishëm është edhe orientimi i studentëve për t'u kapur me probleme sociolinguistike qysh në kohën e studimeve të tyre. Kjo do të ndikonte që edhe brezat e studiuesve të rinj të përgatiten në aspektin teorik, metodologjik e praktik për të trajtuar çështje nga fusha e studimeve sociolinguistike dhe kjo do të ndihmonte që ata të lidhen me trendët studimor botërorë.

Një avantazh, i cili është në dobi të përparimit të studimeve sociolinguistike, është edhe përparimi që është arritur në fushën e teknologjisë informative. Sot, ka mjaft softuerë të zhvilluar të cilët përdoren për studimet sasiore në shkencat shoqërore. Si shembull po japim softuerët, si "IMB SPSS software", i cili përdoret për hulumtimin dhe analizimin e të dhënave statistikore në studimet kuantitative dhe softueri "Praat", i cili mund të ndihmojë në analiza të ndryshme fonetike të të folurit. Natyrisht, ka edhe softuerë të tjerë që mund të përdoren për analiza të tekstit e të konkordancave, si dhe shumë e shumë aspekte të tjera që janë me interes për studime linguistike, por që nuk do të ndalem më gjatë te ta.

Lëvrimi i fushave studimore sociolinguistike që u përmendën pak më parë, jo vetëm që do të ndihmonte në zhvillimin e sociolinguistikës shqipe, por përfitimi kryesor që do të vinte nga studimet e problemeve aktuale sociolinguistike të shqipes do të ishte ndërtimi i një pasqyre të qartë të gjendjes së sotme të shqipes dhe të kodeve të saja. Njohja e kësaj baze do të ndihmonte në kanalizimin dhe zgjidhjen e problemeve të cilat i ka shqipja e sotme, si dhe në afrimin më të madh të kodeve të shqipes me folësit e saj.

Përfundime

Në këtë punim i përpoqa të paraqes një tablo sa më të qartë të gjendjes aktuale të studimeve sociolinguistike të shqipes. Studimet sociolinguistike të shqipes janë vazhdimësi e studimeve të tjera të karakterit linguistik që janë kryer në fushën e gjuhësisë shqiptare gjatë shekullit të kaluar. Ndonëse kanë kaluara më shumë se 5 dekada që kur sociolinguistika është shfaqur si shkencë inderdisiplinare në SHBA dhe në Europën Perëndimore, ajo ka shënuar të arritura të pakta në fushën e

gjuhësisë shqiptare. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave politike e ekonomike që kanë mbretëruar në Shqipëri e Kosovë gjatë gjysmës së dytë së shekullit XX dhe refuzimit ideologjik që u është bërë drejttimeve moderne linguistike kryesisht në Shqipëri, e më pak edhe në Kosovë.

Në dy dekadat e fundit janë shtuar interesimet për trajtimin e problemeve të shqipes nga këndi sociolinguistik. Studimet kryesore sociolinguistike janë kryer në fushën e planifikimit të shqipes dhe të politikës gjuhësore e, deri diku, janë trajtuar edhe çështjet e ndikimit ideologjik, të variacionit gjuhësor të shqipes, të kontakteve të gjuhës e kështu me radhë. Por, mbeten ende fusha fare pak të prekura, siç janë: analiza e bisedave e të diskursit, trajtimi më i thellë i variacionit gjuhësor përmes studimeve sasiore dhe i dukurive që dalin nga variacioni gjuhësor, siç është rasti i ndërrimit të kodit, e kështu me radhë.

Për t'i çuar përpara studimet sociolinguistike mendoj se në radhë të parë duhet të ndryshohet qasja dhe perceptimi që njerëzit e kanë për këtë fushë. Marrja me probleme të sociolinguistikës nënkupton në radhë të parë përgatitjen interdisciplinare teorike të studiuesve potencialë në fushat e tilla, si: gjuhësia, sociologjia, filozofia e antropologjia. Po ashtu, është e nevojshme që studiuesit potencialë të jenë të përgatitur në aspektin metodologjik dhe t'i njohin metodat tashmë të etabluara të hulumtimit empirik e sasior të ligjërimit. Këto janë parakushtet e domosdoshme që duhen plotësuar, në mënyrë që të kemi studiues, të cilët do t'u rrekeshin problemeve të shumta nga fusha e sociolinguistikës seriozisht dhe me përkushtim. Hulumtimet sociolinguistike të shqipes janë më se domosdoshme për shqipen, sepse jo vetëm që do të paraqitnin më së miri gjendjen aktuale të shqipes në kontekstin e tanishëm shoqëror në të cilin funksionon ajo, por edhe do ta përvijonin rrugën për zgjidhjen e problemeve të cilat i ka shqipja.

Referencat

1. Beci, Bahri (2003), *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë.
2. Bregasi, Majlinda (2008), *Minoritetet gjuhësore në Kosovë*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 28/1, Prishtinë.
3. Bregasi, Majlinda (2010), *Biseda në debatet televizive politike në Shqipëri dhe Kosovë*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29/1, Prishtinë.
4. Bregasi, Majlinda (2010), *Gjuha e keqe*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 30, Prishtinë, 2011.
5. Byron, Jannet (1976), *Selection among alternates in language standardization – The case of Albanian*, Mouton The Hague, Paris.

6. Byron, Jannet (1979), *Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia*, Word vol. 30, nr. 1-2, April-August.
7. Çepani, Anila (2006), *Probleme të kulturës së gjuhës në përdorimin e shqipes në internet*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 25/1, Prishtinë, 2006.
8. Derhemi, Eda (2002), *The Endangered Arbresh Language and the Importance of Standardised Writing for its Survival: The Case of Piana degli Albanesi*, Sicily, International Journal on Multicultural Societies (IJMS) Vol. 4, No. 2, 2002, "Protecting Endangered Minority Languages: Sociolinguistic Perspectives.
9. Derhemi, Eda (2003), *New Albanian immigrants in the old Albanian diaspora: Piana degli Albanesi*, Journal of Ethnic and Migration Studies (JEMS). Vol. 29, no. 6, University of Sussex, England, 2003, p. 1015-1033.
10. Derhem, Eda (2006), *Features of dysfunctional attrition in the Arbresh of Piana degli Albanesi*. The International Journal of the Sociology of Language. # 178, 2006. p. 31-55.
11. Doka, Ardian (2008), Ligjërimet rinore, entitete pa kufij, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 27/1, Prishtinë.
12. Hysa, Merita – Baja, Orjeta (2009), *Standardi dhe perspektivat pragmatike të variacionit gjuhësor*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 28/1, Prishtinë.
13. Ibrahim, Mustafa, (2009), *Ndikimi i faktorëve sociolinguistikë në zhvillimin dhe përhapjen e gjuhës së përbashkët shqipe*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 28/1, Prishtinë.
14. Ismajli, Rexhep (2005), *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
15. Ismajli, Rexhep (2003), *Standarde dhe identitete*, Dukagjini, Pejë.
16. Ismajli, Rexhep (1998), *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"*, Dukagjini, Pejë.
17. Ismajli, Rexhep (1994), *Etni e modernitet*, Dukagjini, Pejë.
18. Ismajli, Rexhep (1991), *Gjuhë dhe etni*, Rilindja, Prishtinë.
19. Jorgaqi, Kristina (2009), *Aspekte të politikës gjuhësore në Shqipërinë paskomuniste*, Studime Filologjike, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
20. May-Kolgjini, Julie (2010), *Mundësia e përdorimit të paskajores në standardin e gjuhës shqipe*, Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore – Durrës 15-17 dhjetor 2010), Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011.
21. Kostallari, Androkli (1984), *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë* (referat), në: *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1988.

22. Memushaj, Rami (1996), *Planifikimi gjuhësor si objekt i sociolinguistikës*, Studime albanologjike 1, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë.
23. Memushaj, Rami (1997), *Planifikimi gjuhësor si element i strategjisë kombëtare*, Studime 4, ASHAK, Prishtinë, 1998.
24. Munishi, Shkumbin (2002), *Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe*, punim i magjistraturës, Prishtinë.
25. Munishi, Shkumbin (2005) *Rishikimi i normës një aspekt i standardizimit të gjuhëve*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare 24/1, Prishtinë, 2005.
26. Munishi, Shkumbin (2006), *Gjuha standarde dhe variacioni sociolinguistik*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 25/1, Prishtinë, 2006.
27. Munishi, Shkumbin (2006), *Gjuha standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimet e zhvillimit të saj*, disertacion i doktoratës, Prishtinë.
28. Munishi, Shkumbin (2007), *Pikëpamjet e Idriz Ajetit për bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe*, ASHAK, Prishtinë.
29. Munishi, Shkumbin (2008), *Globalizimi, komunikimi gjuhësor dhe gjuha shqipe*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 27/1, Prishtinë, 2008, f. 321-341; shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>.
30. Munishi, Shkumbin (2009), *Barazia e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane*, 1 Uluslararası Balkanlarda Tarih ve Kültür Kongresi, Bildirler Kitabı, (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik), 10-16 Mayıs, 2009, Kosova, Pri tine. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
31. Munishi, Shkumbin (2009), *Gjuha shqipe dhe Interneti*, Filologji, 16, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2009, f. 75-95. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
32. Munishi, Shkumbin (2009), *Variacioni gjuhësor në mediet audio-vizuele*, Media, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2009, f. 93-101. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
33. Munishi, Shkumbin (2009), *Gjuha standarde shqipe dhe konvergjenca e gjuhës së folur*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 28/1, Prishtinë, 2009. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
34. Munishi, Shkumbin (2009), *Vështrim sociolinguistik i pikëpamjeve të Selman Rizës për formimin e shqipes standarde*, Konferencë Shkencore: Selman Riza – gjuhëtar dhe atdhetar i shquar, me rastin e 100 vjetorit të lindjes, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Tiranë, 2009, Studime 18, ASHAK, Prishtinë 2012. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
35. Munishi, Shkumbin (2010), *Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë*, Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Mal të Zi në krahasim me atë në përgjithësi (sesion shkencor i organizuar më 19.12.2010 në Ulqin – Mali

- i Zi), Art Club, Ulqin, Mali i Zi, 2010. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
36. Munishi, Shkumbin (2010), *Konfliktet dhe kontaktet gjuhësore*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29, Prishtinë, 2010. shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
 37. Munishi, Shkumbin (2010), *Mbi mundësinë e integritit të paskajores në gjuhën standarde shqipe*, Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore – Durrës 15-17 dhjetor 2010), Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
 38. Munishi, Shkumbin (2011), *Gjuha dhe ideologjia*, Filologji 18, UP, Prishtinë, 2011. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>).
 39. Munishi, Shkumbin (2011), *Politika dhe planifikimi gjuhësor i shqipes në kontekstin e sotëm*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 30, Prishtinë, 2012.
 40. Munishi, Shkumbin (2011), *Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë*, Sesioni Shkencor “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2012.
 41. Munishi, Shkumbin (2012), *Rexhep Ismajli - nismëtar i drejtimeve moderne linguistike shqiptare*, Festschrift për nder të 65 vjetorit të lindjes së Akademik Rexhep Ismajlit, Prishtinë (në botim).
 42. Mustafa, Blerta (2005), *Factors influencing Code-Switching in Kosova*, Filologji 13, Univrsiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.
 43. Mustafa, Blerta (2006), *Between-speaker variacion in the success rate of language aquisition in spite of the same teaching input*, Filologji 14, Univrsiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.
 44. Nuhju, Vesel (1995), *Interferenca morfologjike e anglishtes në shqipen e Amerikës*, Studime 2, ASHAK, Prishtinë, 1996.
 45. Paçarizi, Rahman (2005), *Raportet standard/dialekt dhe rrezikshmëria e shqipes në raportet globale*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 24/1, Prishtinë.
 46. Paçarizi, Rahman (2006), *Vendi i analizës psikolinguistike në rishikimin e gjuhës standarde*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 25/1, Prishtinë.
 47. Paçarizi, Rahman (2006), *Gjuha e mesenxherit*, Filologji 14, Univrsiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.
 48. Paçarizi, Rahman (2008), *Shqipja – globalizimi dhe glocalizimi*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 27/1, Prishtinë.
 49. Paçarizi, Rahman (2009), *Interferenca ndërmjet gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar gjatë prodhimit gjuhësor*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 28/1, Prishtinë.

50. Paçarizi, Rrahman (2010), *Natyra psikologjike e gjuhës si veti unike njerëzore*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29/1, Prishtinë.
51. Paçarizi, Rrahman (2010), *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit*, Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore – Durrës 15-17 dhjetor 2010), Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011.
52. Paçarizi, Rrahman (2011), *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë.
53. Rugova, Bardh (2007), *Parimet e rregullave të tekstit të titujt e gazetave*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 26/1, Prishtinë.
54. Rugova, Bardh (2008), *Globalizimi dhe gjuha e gazetave në Kosovë*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 27/1, Prishtinë.
55. Rugova, Bardh (2009), *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë.
56. Rugova, Bardh (2010), *Gjuha e gazetave të Kosovës*, Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore – Durrës 15-17 dhjetor 2010), Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011.
57. Rugova, Bardh (2011), *Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit*, Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, Prishtinë, 2012).
58. Rustemi, Ferit (2011), *Qëllimet e planifikimit gjuhësor në shqipen kombëtare standarde sot*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 30, Prishtinë.
59. Spolsky, Bernard, *Sociolinguistics and the Sociology of Language*, Part 1 History of Sociolinguistics, në Internet: http://www.sagepub.com/upm-data/35389_5434_Wodak_Chap_01.pdf, qasja për herë të fundit më 2 gusht 2012.
60. Shabani, Haxhi (2007), *Rrezikimi i gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë.
61. Shamku-Shkreli, Ledi (2005), *Për një sociolinguistikë funksionale*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 24/1, Prishtinë.
62. Shamku-Shkreli, Ledi (2007), *Standard dhe neostandard*, Çabej, Tiranë.
63. Shamku-Shkreli, Ledi (2010), *Neostandardi i shqipes – traditë dhe përtrimje*, Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore – Durrës 15-17 dhjetor 2010), Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011.
64. Schader, Basil (2004), *Hulumtim rreth kod-suiçingut shqip-gjermanisht në Zvicrën gjermanishtfolëse*, Studime 11, ASHAK, Prishtinë, 2005.
65. Shkurtaj, Gjovalin (1996), *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë.
66. Shkurtaj, Gjovalin (1996), *Nga gjeografia gjuhësore tek dialektologjia urbane*, Studime albanologjike 1, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë.

67. Tahiri, Lindita (2009), *Përdorimi i ligjërimeve bisedore në gjuhën e mediave në Kosovë*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 28/1, Prishtinë.
68. Trudgill, Peter (1975), *Kontakti gjuhësor në Greqi, Ndikimet Ndërgjuhësore*, Vesel Nuhiu, Rilindja, Prishtinë, 1990.
69. Vehbiu, Ardian (1997), *Standard Albanian and the Gheg Renaissance: A Sociolinguistic Perspective*, International Journal of Albanian Studies, Vol. 1 Issue 1. Fall 1997.
70. Vehbiu, Ardian (2007), *Fraktalet e shqipes, rrëgjimi i gjeometrive të standardit*, Çabej, Tiranë.
71. Vehbiu, Ardian (2009), *Shqipja totalitare, tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990*, Çabej, Tiranë.
72. Ymeri, Mariana (1993), *Raportet gjuhë standarde-dialekt në opinionet e studentëve*, Gjuha jonë 1-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.
73. Ymeri, Mariana (1994), *Ekonomia e gjuhës në planifikimin gjuhësor*, Gjuha jonë 1-4/ 1994, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.
74. Ymeri, Mariana (2005), *Tiparet e ligjërimit të folur në chat*, Gjuha jonë 1-4/ 2005, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Agim VINCA

MIHAL HANXHARI, NJË POET NDRYSHE

Shkrimtari që doli nga sirtari

Në letërsinë shqipe të pas Luftës së Dytë Botërore, Mihal Hanxhari (1930-1999) paraqet një rast të veçantë: ai është i vetmi shkrimtar shqiptar që nuk botoi asgjë për të gjallë të tij, madje jo vetëm gjatë sundimit të regjimit komunist në Shqipëri, por edhe pas rënies së tij në vitin 1990, edhe pse jetoi edhe nëntë vjet pas, deri në qershor të vitit 1999. Dhe nuk botoi jo pse e kishte të ndaluar botimin, si shumë bashkëkohës të tij, e as pse i qenë refuzuar dorëshkrimet nga ata që vendosnin për botimin e tyre, por thjesht sepse nuk desh. Ishte ai vetë që vuri “embargo” mbi shkrimet e tij, për të cilat nuk fliste as me miqtë e tij më të ngushtë.

Deri në vitin 2000, kur shtëpia botuese “Elena Gjika” e Tiranës, e drejtuar nga botuesja dhe përkthyesja e njohur Donika Omari (ish-redaktore në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”), botoi librin me poezi të Mihal Hanxharit me titull *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, mund të thuhet lirisht se emri i tij, me përjashtim të një rrethi të ngushtë miqsh, as që njihej nga lexuesit shqiptarë.

Botimi i këtij libri dhe pastaj edhe i dy librave të tjerë që do të vijnë pas tij: *Na ishte njëherë...* (2000) dhe *Ti vdekja ime mbushur me jetë* (2001), që të tre në botim të shtëpisë botuese “Elena Gjika”, do të nxjerrin në dritë një krijues të veçantë, me një botë të pasur e specifike interesimesh tematike dhe me një origjinalitet të theksuar artistik.

Do thënë se “zbulimi” i Mihal Hanxharit si krijues është meritë e Donika Omarit, e cila, pos që botoi, brenda dy vitesh, tri vepra origjinale të Mihal Hanxharit, shkroi edhe disa tekste në formë parathëniesh, të cilat i gjejmë brenda kopertinave të librave në fjalë. Botimi i veprave të një krijuesi si Mihal Hanxhari në vitet 2000 ishte në harmoni me konceptin e ruajtjes së kontinuitetit kulturor me të kaluarën dhe në funksion të lidhjes së fijeve të këputura të një tradite kulturore (qytetare) shqiptare gati të zhdukur, për të cilën zonja Omari flet në librin e saj me titull *Kulturë e ndërprerë* (2009), ku përfshihen edhe shkrimet për Hanxharin.

Në letërsinë shqipe të periudhës së komunizmit, ndryshe nga ç’ndodhte në vendet e tjera të Lindjes (në Bashkimin Sovjetik, në Poloni, në Çekosllovakë, në

Hungari etj.), nuk ka ekzistuar praktika e “samizdatit”, term i ardhur nga rusishtja (), që nënkupton botimet klandestine, private, jozyrtare, që shtypeshin e shpërndareshin në mënyrë ilegale a gjysmilegele nga vetë shkrimtarët dhe adhuruesit e tyre. Në Shqipërinë e vogël, të sunduar nga një regjim totalitar i tipit oruellian, ku gjithçka kontrollohej nga aparati partiak dhe shtetëror i partisë-shtet, botimet e tilla ishin të pamundura. E vetmja gjë që mund të ndodhte në Tiranë ishte qarkullimi i ndonjë dorëshkrimi në një rreth fare të ngushtë miqsh dhe asgjë më shumë.

Siç do të shihet pas vitit 1990, kur, bashkë me sistemin e vjetër, ra edhe doktrina e realizmit socialist që kishte instaluar ai, në Shqipëri ka pasur shkrimtarë që kanë krijuar në heshtje, për vete, që s’kanë dashur t’i botojnë veprat e veta në kushtet e diktaturës dhe që i kanë lënë ato në dorëshkrim si dëshmi për brezat e ardhshëm. I tillë është, fjala vjen, poeti Zef Zorba (1920-1993), i cili la në dorëshkrim, pos përkthimeve të shumta, edhe një përmbledhje vjershash origjinale me titull *Buzëqeshje e ngrirë në gaz*, e cila u botua pas vdekjes së autorit në vitin 1993. Është shumë i njohur edhe rasti i Kasëm Trebeshinës (1926), një shkrimtar shumë i frytshëm, i cili shkroi pa pushim gjatë tërë periudhës së pasluftës (madje edhe në burg, ku i kaloi, me ndërprerje, plot 17 vjet), por nuk botoi pothuajse asgjë para viteve ’90, me përjashtim të një libri të vetëm, poemës për fëmijë *Artani dhe Min’ja*, që doli si botim i Ndërmarrjes Shtetërore të Botimeve "Naim Frashëri" në vitin 1961, në një kohë kur në Shqipëri, si rezultat i rrethanave të krijuara pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, zotëronte një klimë paksa liberale në jetën letrare dhe kulturore.

Mirëpo, rasti i Mihal Hanxharit ndryshon nga ai i dy të parëve - i Zorbës dhe i Trebeshinës - dhe i shumë shkrimtarëve të tjerë të persekutuar (Pjetër Arbënor, Jorgo Bllaci, Visar Zhiti, Daut Gumeni etj.), për dy arsye: një pse ai nuk kishte qenë në burg e as i persekutuar hapur si kolegët e tij dhe, e dyta, ngaqë ai nuk deshi të botonte as pas vitit 1990, kur u bë e mundur të botonin edhe shkrimtarët që deri atëherë e kishin pasur të ndaluar botimin.

Mihal Hanxhari e mori me vete, në varr, sekretin e mosbotimit të shkrimeve të veta, të cilat, siç dëshmojnë miqtë dhe të afërmit e tij, i kishte daktilografuar e sistemuar me kujdes me dorën e vet dhe i kishte lënë të gatshme në sirtar.¹

Pa dashur të zgjatemi më tej në këtë çështje, e cila, në thelb, as nuk e rrit e as nuk e zvogëlon vlerën e veprës së një shkrimtari dhe nuk çon peshë në vlerësimin e saj, le të na lejohet të shtrojmë edhe një pyetje: përse intelektual i Mihal Hanxhari, i cili tërë jetën e kaloi në Tiranë, i rrethuar nga miq të shumtë, kurse një kohë të gjatë qëndroi në krye të një institucioni të rëndësishëm, siç ishte Biblioteka e Universitetit

¹ Shih: Zef Rrakacolli, *Fjala në mbledhjen përkujtimore të mbajtur në Tiranë më 24 maj 2001*, me rastin e trevjetorit të vdekjes së Mihal Hanxharit.

të Tiranës, deri vonë të vetmit universitet në Shqipëri, nuk deshi t'i botonte shkrimet e veta, të shkruara në kohë të ndryshme, edhe pse realisht për këtë kishte mundësi?²

Edhe pse Hanxhari, me sa dimë, ndryshe nga shumë krijues që kanë qenë skeptik ndaj punës së tyre, ashtu siç ka gjasa të ketë qenë edhe ai (Franc Kafka, siç dihet, pat lënë amanet që dorëshkrimet e tij të digjeshin, por miku i tij Maks Brod nuk e çoi në vend këtë porosi), nuk ka lënë ndonjë testament lidhur me këtë çështje, mosbotimi i shkrimeve nga ana e këtij autori në kohën e diktaturës, ishte shprehje e revoltës dhe e mospajtimit me të. Revolta dhe skepticizmi i këtij shkrimtari, pra, kishte para së gjithash karakter politik, kurse heqja dorë nga publikimi mund të cilësohet si një akt moral.

Poet, pushoje këngën

Në një poezi të tij me titull *Poet*, e cila mund të quhet *credo* e poetit, duke iu drejtuar poetit të kohës së vet, pra poetit bashkëkohor shqiptar, poeti e fton atë që ta pushojë këngën, sepse “s’është koha për gëzim”, por “për vajtim”. Për shkak se e konsideroj të rëndësishme për shpjegimin e “fenomenit Hanxhari” dhe të heshtjes së tij, por edhe për shkak se është një nga poezitë më të bukura e më kuptimplote të dala nga pena e këtij poeti, po e citojmë në tërësi këtë poezi:

*Poet pushoje këngën
S’është’ koha për gëzim
Dëgjo dëgjo zinxhirat
Si hekuri tingëllin
Poet pushoje këngën
S’është’ koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S’është’ koha për gëzim
Dëgjo dëgjo furtunën
Si shfryn e ulërin
Poet pushoje këngën
S’është’ koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S’është’ koha për gëzim
Shiko si shuhen vatrat
Syrgjyn e internim
Poet pushoje këngën
S’është’ koha për gëzim*

² R. Përnaska, njeri që e ka njohur nga afër M. Hanxharin gjatë qëndrimit të tij në Paris, thotë se Mihali, me nxitjen e tij, ishte bindur t’i botonte shkrimet e veta, por “për vonesa të rëndomta me një shtëpi botuese, ato nuk e panë dritën e botimit...”. *Mihal Hanxhari. Njeriu dhe vepra*, f. 59.

*Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim
Na ndan' na shan' na vran'
O Zot do ket' shpëtim
Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim
Sa varre hapën natën
Dhe plumbi korr e grin
Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim
Vëllanë ta kryqëzuan
E vran' dhe poezin'
Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim
Po si e puth atë dor'
Që kundërmon veç krim
Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim
Naimi Gjergji Noli
Nën dhe po drithërijn'
Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim*

*Poet pushoje këngën
S'është' koha për gëzim
Po s' do ta qash mor nënën
Qyqaren me jetimë
Poet pushoje këngën
Ësht' koha për vajtim³*

³ Mihal Hanxhari, *Se sytë e mi kështu e shohin botën*. Poezi. Shtëpia botuese “Elena Gjika”, Tiranë 2000, f. 97-99.

Do thënë se kjo poezi nuk është kundër “këngës” në përgjithësi, por kundër atij lloji të këngës (poezisë, artit), që u vu në shërbim të politikës së ditës, duke u tjetërsuar nga natyra e vet, siç ndodhi me një pjesë të madhe të letërsisë së realizmit socialist. Poetët që thurnin ditirambe edhe atëherë kur Atdheu ishte në zi, e tradhtuan misionin e artit dhe traditën e bukur të poezisë shqipe.

Secila strofë e kësaj vjershe hapet dhe mbyllet me vargjet: “*Poet pushoje këngën/ S’është’ koha për gëzim*”, të cilat janë në funksion të forcimit të idesë së saj: thirrjes për të mos u bërë pjesë e korit të poetëve zyrtarë, që s’e pushojnë këngën edhe kur burgosen e internohen njerëzit; kur tingëllojnë zinxhirat, kur ulërin furtuna e shuhen vatrat, siç bënin letrarët servilë të kohës së diktaturës, bashkëkohës të Hanxharit. Kush këndon në zi është bashkëfajtor; kush e legjitimon të keqen, dhunën, krimin, bën mëkat e krim. Poetët e mëdhenj të kombit: Naimi, Fishta, Noli dridhen atje tek janë, nën dhé, kurse “nëna e shkretë” është shndërruar në “qyqare me jetimë”.

Vargu: “Poet pushoje këngën”, i intonuar si thirrje, jo vetëm e thellon kuptimin e vjershës, por luan edhe rolin e një lloji refreni në strukturën e saj.

Është e vështirë, në mos edhe e pamundur, të përcaktohet koha kur është shkruar kjo poezi, sepse nuk ka datë në fund, por duke u nisur nga përmbajtja dhe fjalori i saj, ku ka shumë folje në mënyrën urdhërore (pusho, dëgjo, shiko etj.), mund të supozojmë se ajo do të jetë shkruar në vitet ’70, pas Plenumit IV famëkeq të KQ të PPSH të mbajtur në qershor të vitit 1973, kur filloi fushata e egër kundër të ashtuquajturave “ndikime të huaja, borgjeze e liberale, në art dhe në letërsi”, fushatë kjo në të cilën pësuan shumë krijues dhe intelektualë të shquar shqiptarë.

Sido që të jetë, vjersha *Poet*, e pavërejtur sa duhet nga ata që kanë shkruar për krijimtarinë e autorit të saj, i jep përgjigje pyetjes se përse heshti Mihal Hanxhari.

E ngjashme me këtë, por me një strukturë tjetër metrike dhe me një shkallë më të lartë abstragimi poetik, është edhe vjersha *Fjalët*. Derisa tek e para poeti fton poetët që të mos bëhen instrument në duart e pushtetit dhe të pushtetarëve, aq më shumë kur ato kundërmojnë dhunë e krim, tek e dyta “evidencon” pasojat e kësaj dhune: vrasjen e fjalës si simbol i lirisë së njeriut si individ dhe të shoqërisë si bashkësi. Kjo gjendje - mungesa e lirisë së shprehjes - jepet në mënyrë dramatike që në vargjet e para të vjershës, në formë pyetëse dhe në vetën e parë shumës. “*Ku i vramë fjalët/ Ku i lamë fjalët/ Muzikën këngët që më s’këndojmë/ Vallë u mësuam vërtet memecë/ Dhe me alarme u shurdhuam...*”.

Në kushtet e trysnisë politike, kur fjala e lirë mbytet nga zhurma e propagandës, njerëzit bëhen memecë si statujat dhe të urtë e të dëgjueshëm si thneglat: “*Dhe ne të gjithë jemi memecë/ Ngjajmë me thnegla që ven’ e vinë/ Me nga një mal sipër në shpinë/ Vetëm me sy do flasim vallë/ Vetëm me dhembjen me ngadalë/ Statuja jonë vetëm mendon/ Qëndron e pret veç n’ëndrra flet*” (f. 101).

Poezia *Hije resh* flet po ashtu për fatin e poezisë në një vend të rrethuar me “tela me gjemba”, figurë që e hasim edhe te Bilal Xhaferi. Poezia e Hanxharit i ngjan muzikës së dhomës, që s’ka asgjë të përbashkët me fjalimet në tribuna e sheshe. Ajo është: “hije resh” dhe “mërmërimë”, që vjen në orët e vona të natës dhe largohet sapo afrohet agimi.

Vjersha fantazma
Që vinit në majë të gishtërinjve
Që duhet të ktheheshit në agim
Tek varreza juaj

Aty ku sundon frika dhe errësira, vargjet e poetit, edhe kur joshen nga iluzioni i qiellit të hapur, janë si ato dallëndyshet që s’fluturojnë dot. Ato pleksen me gjethet, degët dhe flokët e fëmijëve; bredhin lagjeve të qytetit portë më portë, duke kërkuar më kot “kopshtin e Edenit”, për t’u bërë “varri i vetvetes”, si vargjet heretike të Migjenit.

Dhe ikën sot tok si poezi të një vëllimi
Që s’do të botohej kurrë
Që kurrë
S’do preknin një zemër të huaj
Vërtet djepi e varri i vetvetes
Si pikëllimi që pati Ai

Nëpërmjet figurës së “kryqit të drunjtë” konkretizohet imazhi i “varrezës së vargjeve”, ndërsa thirrja “Aleluja” sugjeron çastin e gëzueshëm të ringjalljes së fjalës, që patjetër do të vijë një ditë.

Fjalët: gjethe, stinë, re, muzg, heshtje, fjalë etj. - janë fjalë-kyçe edhe në poezinë *Besomëni*, ku subjekti lirik kërkon t’i besohet për atë që thotë. Është vjeshtë, koha kur bien gjethet dhe poeti kujton idhujt e tij: Naimin e sëmurë nga tuberkulozi dhe fytyrën e tij të zbehtë si gjethi në vjeshtë; Jeronimin plak e të varfër me xhaketën e grisur dhe me një cironkë në xhep; Luigjin e shtrirë në trotuar në dhë të huaj dhe vargjet e Nolit kushtuar “viganit liberator“, “pesë strofa të derdhura në bronx”; Çajupin që ngryt jetën larg atdheut, në shkretëtirë, me imazhin e fshatit të tij në sy; Migjenin me buzëqeshjen e hidhur në natën pa gjumë, lagjen e varfër, gjelin kryengritës dhe murgeshën që “çon dashni me shejtënt”; Gjergjin atje tej n’Malci, ku fryn era e ftohtë e dhjetorit (muaji kur vdiq Fishta) dhe resh dëborë, ndërsa ai “Luhat Lahutën”, si shprehet poeti; Theofanin, Birin e madh të mërguar, që e për afron me Krishtin e kryqëzuar dhe këngëtarin finosh, Lasgushin, që këndoi me afsh të rrallë për Liqerin dhe Nositin që në gjirin e tij hap varr... Këto janë detajet

nëpërmjet të cilave poeti evokon figurat e korifenjve të fjalës shqipe: Naimit, De Radës, Gurakuqit, Çajupit, Migjenit, Fishtës, Nolit dhe Lasgushit, të cilët i kujton në çastet e fundit të jetës, kur merr fund jeta e tyre tokësore dhe fillon përjetësia. Ndërsa vlerësimin e tyre të përgjithshëm e bën në mënyrë sintetike në vargjet përmbyllëse të vjershës: “*zëra lumenjsh në dënesje/ Kryq e tërthor nëpër dheun tonë*”; “*që ikën duke kthyer kokën për të na parë për të fundit herë*”.

Bie në sy fakti që ky poet, që komunikon aq shpesh me etërit e traditës poetike shqipe, sikundër edhe me mjeshtrit e poezisë botërore, nuk ka në vargjet e tij asnjë referencë për poezinë bashkëkohore shqipe; nuk përmend në vargje, as edhe një herë të vetme, emrin e ndonjërit nga poetët tanë bashkëkohorë, përfshirë edhe ata më të shquarit. Asnjë fjalë për ta, madje as edhe ndonjë aluzion, me përjashtim të vjershës *Poet*, të cituar më lart. Të shtojmë se as në vargjet e kësaj poezie, ku shprehet mospajtimi me poetët që këndojnë në zi, nuk ka asnjë aluzion konkret te aksh poet a shkrimtar. Kujtojmë se kjo gjë nuk është e rastit. Jokonformist si njeri dhe poet, Hanxhari refuzon t’i denjësojë “bardët” e kohës, por serioz si krijues, ai nuk e shndërron poezinë e tij (as prozën) në qërim hesapësh me bashkëkohësit e vet, sepse nuk dëshiron ta politizojë e bastardojë poezinë e tij, duke i dhënë asaj karakter estrad e pamfletist.

Zot, shpëtoje Tiranën

I lindur në Kentaki (SHBA), por i kthyer në moshën një vjeç bashkë me prindërit në atdhe, Mihal Hanxhari pjesën dërrmuese të jetës (hiq vitet e studimeve në Budapest dhe të qëndrimit në Paris) e kaloi në Tiranë, në shtëpinë e vjetër prindërore, imazhin e së cilës e kujton me dashuri në vargjet e vjershës *Shtëpia e vjetër*.

Mihal Hanxhari si rrallë ndonjë poet tjetër bashkëkohor shqiptar, hiq ndoshta Mustafa Greblleshin, mund të quhet me plot gojën këngëtar i Tiranës. Mund të thuhet, madje, se pas botimit të krijimtarisë së tij, Tirana do të marrë në letërsinë shqipe statusin që e kanë pasur qytete si Shkodra (Koliqi, Migjeni), Vlora (Ali Asllani), Gjirokastra (Musine Kokalari, por edhe Kadareja, tek i cili del shpesh, pos Gjirokastrës, edhe Tirana, sikundër edhe Parisi e Moska) ose krahina si Myzeqeja (Xoxa), Dukagjini (Camaj) etj.

Poetin Mihal Hanxhari e frymëzoi pothuajse gjithçka në Tiranë: rrugët, lagjet, urat etj. Por i theri si hanxhar në zemër rrënimi i shtëpive të vjetra tiranase, uzurpimi i kopshtit të fëmijërisë dhe shembja e objekteve me vlerë arkitektonike, simbole të një kulture të lashtë e autoktone.

Në poezinë *Shtëpia e vjetër*, poeti trajton temën e rrënimit të shtëpive tradicionale qytetare dhe ndërtimit të të ashtuquajturave “pallate” në vend të tyre. Me vargje të lira monokolone jepet akti i rrënimit të shtëpive të tilla, që janë simbol

i një bote në zhdukje. Shtëpia është një simbol i madh i njerëzimit; simbol i jetës familjare, i qenies kolektive, i kujtesës dhe identitetit. Brenda mureve të shtëpisë ndodh gjithçka: lindje, vdekje, dashuri, ninulla, vajtime, ëndrra, gëzime... Fjala më e përdorur në vargjet e kësaj vjershe është fjala mur (mure), që në këtë kontekst, ndryshe nga ç'ndodh zakonisht, ka kuptim pozitiv: shpreh ngrohtësinë dhe intimitetin e jetës në gjirin e familjes. Madje, sipas poetit, ëndrrat gjithmonë i shohim në shtëpinë e vjetër: "*Pse ëndrrat i shohim gjithmonë/ Tek shtëpia e vjetër/ Që s'është më*".⁴

Zhdukja e shtëpive të vjetra është zhdukje e kujtesës, andaj subjekti lirik habitet e revoltohet me njerëzit që kalojnë indiferentë pranë këtij akti të shëmtuar.

*Përpara këtyre shtëpive
Si bark i çarë
Si njeri i varur që e tund era
Kalojnë idiferentë njerëzit
Sikur s'kanë patur kurrë një shtëpi
Sikur s'kanë patur kurrë fëmijëri
Sikur s'kanë patur kurrë një gjyshe
Sikur s'kanë parë kurrë pranverën në oborr*

Poezia *Shtëpia e vjetër* mund të lexohet edhe si alegori e rrënimit të Shqipërisë së vjetër, jetike, në periudhën e socializmit, që bëhej në emër të së resë dhe progresit. Poeti nuk i kundërvihet këtij "rrënimi" nga pozita konservatore, por e bën në emër të ruajtjes së traditës dhe të pacenueshmërisë së botës intime të njeriut.

Pas rrënimit të shtëpisë vjen shkretimi i kopshtit të uzurpuar nga "pushteti popullor" (vjersha *Kopshti*). Në secilën strofë të kësaj vjershe të gjatë, me nota satirike, që poeti e quan "përrallë", përmendet një pemë: bajamja, shega, qershia, ftoi, pjergulla. Të gjitha "i prenë", thotë poeti. Mbetet vetëm një mollë që s'jep fryt, sterile, që e selisin "një tabor me kopshtarë", aluzion te poetët mediokër dhe shterpësia e "prodhimit" të tyre letrar. Në atë kopsht të shkretë nuk do të këmbehen më stinët e vitit: pranvera, vera, vjeshta, dimri, por do të zotërojë vetëm "një stinë pa emër". Nga shprehja metaforike poeti kalon në të folur të drejtpërdrejtë: "... *kish vetëm një stinë/ të cilën një ditë/ E quajten epokë*".⁵ Molla e spërkatur "me helme" prodhon një shije të keqe: dëshpërimi, mjerimi, hidhësie dhe vetmie, shije që vetëm ai që e ka provuar mund ta dijë.

⁴ Po aty, f. 91.

⁵ Po aty, f. 108.

Edhe poezia *Kopshti* është alegori e fatit të Shqipërisë nën diktaturë. Është një rrëfim i gjatë, ngapak prozaik, për fatin e këtij “kopshti” të izoluar, që lufton shumësinë, pluralizmin dhe stimulon uniformizmin në jetë dhe në art.

Poezitë: *Tiranë Tiranë, Tirana, Ngjyrat e Dajtit, Dajtit*, si dhe poezitë pa titull, që fillojnë me vargjet: *Priste goca në penxhere dhe Në rrugët e mbrëmjes ndizen dritat* etj., kanë po ashtu objekt frymëzimi Tiranën dhe rrethinën e saj.

Poeti shkruan baladë për Tiranën e fëmijërisë së tij, që e ruan në kujtesë me peizazhin dhe aromat e saj të papërsëritshme. I lutet Zotit që ta shpëtojë atë nga buldozeri i revolucionit, që tremb shpirtrat e stërgjyshërve: *“Zot shpëtoje Tiranën/ Lërja këto ura nate bërë me hënë/ Lërja këto mure rrugëzash që kanë mbetur/ Lëre që degët të vizatojnë mbi to/ Shpirtrat e pemëve/ Lërja kopshteve gjumin e vjetër/ Ah dhe zërin e nallaneve nëpër oborr/ Lëri o Zot/ Se dheu është mësuar me ato hapa/ Dhe fle i qetë se i njeh/ Lërja aromat e lashta që derdhin pjergullat/ Lëri mos i tremb shpirtrat e bardhë/ Të stërgjyshërve tanë / Që janë aty aty”*.⁶

Urat, muret, pemët, kopshtet, pjergullat e, madje, edhe nallanet orientale janë detajet që evokon poeti. Ato janë pjesë e kujtesës. E kujtesa është gjëja më e shtrenjtë që ka njeriu. “Bëni sa të doni operacione plastike; operoni hundë, buzë, veshë, lëkurë e flokë; transplantoni veshka e zemra të huaja, por kujtesën mos e prekni” - thotë Elias Kaneti.

Socializmi si sistem shoqëror, në emër të ndërtimit të së resë, jo rrallë zhduku traditën shekullore, duke cenuar jo vetëm pronën, por edhe jetën private të njerëzve.

*Ta çojmë grushtin! Minat botës vjetër!
Se ne do të farkojmë përmbi dhe
Një botë më të mirë: botën tjetër!*

shkruante poeti Andrea Varfi në një poezi të shkruar në vitin 1935. Koha tregoi se minat që shkatërruan botën e vjetër jo vetëm që nuk farkuan një botë më të mirë, por i sollën dëme të riparueshme shpirtit njerëzor.

Siç ka vërejtur me të drejtë A. Papeleka, ura është motiv i shpeshtë i poezisë së M. Hanxharit. Sikurse shtëpia, ura është simbol i kulturës materiale të njerëzimit. Një simbol universal, që shenjon lidhjen, komunikimin, dashurinë. Libri *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, që është libri i parë i botuar i Hanxharit, ka në ballinë një tablo të autorit në të cilën shihet një urë me harqe, me një gjysmëhënë në sfondin e qiellit blu të errët dhe një kalë që pi ujë në lumë. Njohësit e krijimtarisë së poetit pohojnë se kjo është Ura e vjetër e Tabakëve (një objekt i bukur arkitektonik, që ka frymëzuar shumë poetë tiranas e të tjerë, nga Mihal Hanxhari e gjer te Ervin Hatibi), ndërsa ai vetë, në një shënim të tij, thoshte se Nolin gjatë kohës së qëndrimit të tij si

⁶ Po aty, f. 88.

kryeministër në Tiranë, nuk mund ta përfytyronte ndryshe pos duke kaluar nëpër Urën e Tabakëve. Mirëpo, siç konstaton me të drejtë Pappleka në parathënien e tij, pos për urat reale, çfarë është Ura e Tabakëve (një urë me këtë emër ka edhe në Gjakovë), Hanxhari këndon edhe për urat metafizike, dimension që e shquan poezinë e këtij poeti nga masivi i poezisë shqipe të kohës.

Libri *Se sytë e mi kështu e shohin botën* hapet me poezinë *Një urë antike e këputur*, në të cilën flitet për një urë të tillë, metafizike, që sajohet nga ajo që është më e bukur e më sublime te njeriu: dashuria.

Arketipi i dashurisë

Pjesa dërrmuese e poezive të Mihal Hanxharit trajton, në mënyra të ndryshme, temën e dashurisë. Erosi është, siç do të thoshte Rolan Barti, mitemë e krijimtarisë së këtij poeti. Këtë temë poeti e trajton në vjershat: *Gjersa erdhi* (që në një version tjetër haset me titullin *Të kam menduar*), *Pa ty, Ashtu ndofta ka filluar jeta*, *Dëgjoj një zog*, *Zemrën marr në duar*, *Natën vonë*, *Pranverë e dashurisë*, *U dashuruam*, *Trëndafili*, *Kur ti fle*, *Fjeta mbi rërë*, *Ku janë ato net*, *U ndezën diejt e shuar*, *Të mos zgjohesha kurrë*, *Konstelacion*, *Zambak deti*, *Re të zeza*, *Të jesh vetëm*, *Mesi i natës*, *Ti shkon ngadalë*, *U ktheva përsëri*, *Ti ankora ime*, *Pa thënë një fjalë*, *Veç një pranverë*, *Si ikën betime*, *Digjet në heshtje*, *I mjeri më i lumtur* e shumë të tjera. Për dashurinë poeti këndon me zemër në dorë, si thuhet në njërën nga poezitë e tij më të bukura të dashurisë: *Zemrën marr në duar*. Shprehja “me zemër në dorë” në gjuhën shqipe do të thotë: me ngrohtësi, çiltërsi e dhembshuri, por edhe me frikë se mos ndodhë diçka jo e mirë, me ankth.

Dashuria është muza e poetit; është ajo që ia zgjedh ngjyrat për pikturat dhe fjalët për poezitë; është ajo që e shpie buzë lumit “për të gjetur gurët si zemër” dhe buzë detit (dekor i përhershëm i frymëzimit erotik të poetit) “për të shkruar në rërë një emër”; është ajo që e bën të mjerë e të lumtur; është ankora që e lidh me fundin e detit. Kjo “muzë-grua” a “grua-muzë” vjen natën, sepse nata është e poetit, i cili përfytyrohet rëndom si “sonambul”, siç shprehet poeti ynë në vjershën homonime, në të cilën kuvendon me hënën që noton mbi ujëra te ura e vjetër.

Në poezinë e Mihal Hanxharit nuk përmendet asnjë emër konkret gruaje, me përjashtim të Evës, personazhit të skicës *Ndizemi e shuhemi*, ku flitet për një dashuri të hershme të Mihalit (në këtë rrëfim autobiografik, krahas emrit të vajzës, Eva, shfaqet edhe emri përkëdhelës i autorit, Misha) me një vajzë hungareze gjatë kohës së studimeve në Budapest. Nuk e dimë në është kjo “dashuria e tij e madhe”, “prelud

i një lumturie të këputur në mes”⁷, por meqenëse përmenden “studimet universitare”, kjo duhet të jetë.

Për Mihal Hanxharin e edukuar në frymën e traditës më të mirë të poezisë shqipe dhe asaj botërore, sidomos franceze, dashuria nuk është thjesht pasioni për një grua, por shumë më tepër. Edhe pse në vargjet e tij nuk mungojnë, herë-herë, elementet sensuale, dashuria për të është, sikurse jeta, një mister; e tillë çfarë është edhe Gruaja, një qenie që njëjtësohet me Botën.

*Ndoshta ti dhe Bota ishit një për mua
Dhe qiell e diell e stinë e mot
Unë pija jetën në buzët e tua
Kërkoja në gjirin tënd atë që s' gjendet dot
Ndoshta ti dhe Bota ishit një për mua*

Gruaja për të cilën këndon Hanxhari qëndron mes gruas konkrete, tokësore, reale dhe qenies sublime, eterike, astrale. Një koncept pak a shumë i ngjashëm me atë të Lasgushit. Gruaja dhe Bota për të janë një: burim jete dhe mister.

Poetë të mëdhenj si Dante, Petrarka, Pushkini, Leopardi, Aragoni kanë kënduar për Beatricet, Laurat, Anat, Silvat dhe Elsat e tyre reale, italiane, ruse ose franceze, të cilat me vargjet e tyre gjeniale i kanë bërë të pavdekshme, kurse poeti shqiptar Mihal Hanxhari, ky beqar i përjetshëm, ia blaton këngën e tij një femre të paemër, ekzistencën e së cilës, herë-herë, e vë në dyshim. “*Ndoshta ti s'ke ekzistuar/ Ndoshta ka qenë vetëm fantazia ime/ Ndoshta je imazh i ëndërruar*” - shprehet poeti në njërin nga poezitë e tij, që mban titullin *Ndoshta ti s'ke ekzistuar*.

Dashuria në vizionin e poetit Mihal Hanxhari, sikurse te pararendësit e tij (Naimi, De Rada, Serembe, Lasgushi), është e pandarë nga vuajtja dhe dhembja, e shkaktuar nga largësia dhe mungesa e së dashurës: “*Si iku kjo verë pa njëri-tjetrin*”; “*Si po ikën kjo jetë pa njëri-tjetrin*”, apo edhe për arsye të tjera, të njohura e të panjohura.

Librin *Ti vdekja ime mbushur me jetë*, pjesën dërrmuese të të cilit e zënë poezitë e dashurisë (gjithsej 57 sosh), Hanxhari e hap me një strofë të Arshi Pipës, në të cilën thuhet: “*Timonieri ynë asht fati/ Velat tona dashunia/ Për me vuejtë jemi ba gati/ Jemi nisë kah bukuria!*”.

Kjo strofë, e vënë si moto në krye të librit, luan rolin e paratekstit, që shenjon orientimin tematik të poetit dhe shpreh konceptin e tij për poezinë. Hanxhari është, në radhë të parë, siç e ka cilësuar miku i tij i afërt, Zef Rrakacolli, poet i Dashurisë, i Dhimbjes dhe i Bukurisë. Mund të thuhet, prandaj, se koncepti i tij për poezinë është

⁷ Prof. Muzafer Xhaxhiu, *Shkrimtari i madh francez Andre Gide në shqipërimin e Mihal Hanxharit*. Parathënie e romanit *Ushqimet tokësore*, “Erik”, Tiranë 2002, f. 4.

i ngjashëm me atë të simbolistëve, sipas të cilëve poeti s'është tjetër veçse një njeri që zbulon "fshehtësitë e jetës" dhe i këndon Bukurisë, e cila është burim i dhimbjes dhe pikëllimit. Gjakimi i së bukurës dhe i dashurisë vë në lëvizje imagjinatën poetike, kurse kërkimi i tyre në art dhe në jetë kalon shumë herë nëpër purgatorin e vuajtjes dhe të pësimit.

Poema *Aldebaran*, me të cilën hapet libri në fjalë, është cilësuar me të drejtë si një himn kushtuar dashurisë. Dashuria është ndjenja më e fuqishme e shpirtit njerëzor, universale në kohë dhe në hapësirë, ashtu siç është Aldebarani ylli më i ndritshëm i yllësisë së Demit (shenja e dytë e Zodijakut), që përbëhet nga gjithsej 126 yje. Për ta bërë më të qartë simbolikën e kësaj figure, të shtojmë se Aldebarani, ndonëse shumë larg nga planeti ynë, Toka (65 vjet drite larg), shihet me sy natën dhe duket sikur ndjek Yllësinë e Plejadës, që personifikon principin femëror, kurse në disa qytetërime është edhe simbol i flijimit.

Nuk ka dyshim se Aldebarani është në këtë rast simbol i Dashurisë, që vë në lëvizje universin - tok me njeriun si shëmbëlltyrë e tij - dhe krijon baraspeshë mes tokës dhe qiellit. Dashuria është e pavdekshme si koha dhe pavdekësinë e saj, sipas poetit, më parë se arti, e shpreh natyra, universi. Në natën e qetë, kur dëgjohet muzika e erës dhe e detit, shpirti i njeriut arratiset lart në qiell, tek ylli Aldebaran.

Fjala është për një krijim me përmbajtje dhe strukturë polivalente, që përbëhet nga tetë këngë të shkruara në vargje 12-rrokëshe dhe strofa pesëvargëshe të rimuara sipas skemës ABBAA, ku vargu i parë i secilës strofë përsëritet në fund të saj,⁸ skemë kjo që poeti i përmbahet nga fillimi deri në fund.

*O natë erdh muzika zbatheur nëpër erë
Deti nisi zërat me gjemit' e tia
Këngë o këngë ku mbytet dashuria
Shpirti rri i zgjuar dhembjen ve të flerë
O natë erdh muzika zbatheur nëpër erë*

Nata dhe muzika, siç shihet që nga kënga e parë e poemës, që shërben si një prolog, janë dy koncepte pa të cilat nuk mund të merret me mend dashuria. Shtegtimi në qiell fillon nga toka dhe përfundon po aty: "*Pas çdo shtegtimi vijmë sërish në skelë*".

Hipur mbi krahët e fantazisë, në këngën e dytë, poeti shëtit në brigjet e Nilit, pranë piramidave të lashta madhështore, aty ku dashurinë e ka përjetësuar në gur faraoni Tutankhamon.

⁸ Këtë tip strofe, që Hanxhari e përdor edhe në krijime të tjera, e hasim edhe te Agolli (*Poçari, Lamtumirë* etj.).

*Natën ma sjell deti aty tek ballkoni
Një dashuri të hidhur të largët antike
Një dashuri shkretëtire të fshehtë e besnike
Dashurinë e vetme që kish Tutankhamoni
Natën ma sjell deti aty tek ballkoni*

Për dashurinë dhe fshehtësitë e saj, sipas poetit, më mirë se papiruset, flasin gurët. (*Ata gurë të Nilit e dinë historinë*). Nga brigjet e Nilit, që ndryjnë në vete shumë histori dashurish dramatike, poeti zbret në brigjet e Egjeut, aty ku ka jetuar poeti i parë i botës, Orfeu, që s'pushon së kërkuari Euridikën e tij.

Në këngën e tretë, ku secila strofë fillon me fjalën Dashuri (me "D" të madhe), bëhen përpjekje të përkufizohet dashuria; të tregohet se ç'është ajo. Dashuria është "si lumi që derdhet në det", "si nata që s'di ç'është gjumi"; dashuri është "hëna që thyhet në gjethe" dhe "Aldebarani që digjet në ethe"; dashuri janë sytë, duart, buzët dhe "një e trokitur natën në derë".

Edhe kënga e katërt hapet me imazhin e detit dhe të natës, që zgjon ndjenjën e mallit, fjalë që arbëreshët e përdorin edhe sot në vend të fjalës dashuri. Ndërfutet, paksa i modifikuar, vargu i parë i *Milosaos*: "*Lis jeta e Poetit në ujë të kaltëruar*".⁹ Sistemi i të shprehurit poetik ruhet edhe këtu, në atë mënyrë që secila strofë hapet dhe mbyllet me togfjalëshin: "Ja deti...". Dëgjohet kënga magjepsëse e sirenavë, ndërsa Odiseu i lidhur për direktet e anijes përpiqet t'i bëjë ballë tundimit...

Këngët vijuese, e pesta, e gjashta, e shtata dhe e teta, shpërfaqin, sikurse edhe të mëparshmet, aspekte të ndryshme të objektit të këngëtimit, yllit Aldebaran, që është sundues absolut i shpirtit të poetit. (*O Aldebaran ti ylli im i vetëm*). Ai është kudo: në tokë e në qiell, në det e në lumë, në rërë e në shkretëtirë... Me të poeti identifikohet plotësisht: "*O Aldebaran jam binjaku yt*" (f. 31).

Poema *Aldebaran* është krijimi më i gjatë poetik i Mihal Hanxharit. Ajo përbëhet nga gjithsej 355 vargje, të kompozuara në një tërësi kuptimore prej tetë njësisish. Nuk besoj të jetë e rastit kjo ndarje e poemës në tetë pjesë (formalisht ato ndahen me nga një yllëz në mes), ngaqë Hanxhari si krijues me njohuri nga astronomia do ta ketë ditur se numri tetë është numër që shpreh "harmoninë kozmike".¹⁰ Emri i yllit Aldebaran vjen nga arabishtja dhe ka kuptimin "ndjekës". Besohet se ai ndjek yllësinë e Plejadës, prandaj, sado spekulativ që mund të duket ky pohim, numri tetë në këtë rast - në poemthin erotik tetëpjesësh të Hanxharit - sugjeron shtatë yjet e Plejadës plus Aldebaranin si ndjekës i tyre.

⁹ Stilemen "Lis-Jeta" poeti e ka përdorur edhe në poezitë që ka përkthyer nga frëngjishtja: te *Abeli dhe Kaini* e Bodlerit, *Moti përtërtej* e Renjerit, *Perëndim IV* e Hygoit dhe *Përtëritje* e Malarmesë si zëvendësim për fjalë e shprehje që në frëngjisht shprehin rritjen, shtimin, gjallërinë dhe përtëritjen.

¹⁰ Shih: J. Chevalier & A. Gheerbrant, *Rje nik simbola*, f. 465.

Më shumë se me numrin e vargjeve dhe vëllimin e saj, poema në fjalë imponohet me gjerësinë e përmbajtjes, me thellësinë e mendimit, me shumësinë e metaforave dhe simboleve, me rrezatimet e shumta asociative dhe me strukturën e saj kompozicionale, solide në çdo pikëpamje. Si formë letrare *Aldebaran*-i mund të quhet poemë lirike meditative, pse jo edhe filozofike, që me frymën e saj ezoterike ta kujton *Bukurinë* e Naimit dhe sidomos *Vallen e Yjve* të Lasgushit, veçse është pak më e rëndë për lexim se të parat dhe kërkon angazhim më të madh nga lexuesit.

Aldebaran-i është nga ato krijime poetike që nuk shijohen që në leximin e parë.

I njëjti konstatim vlen, madje akoma më shumë, edhe për poemthin *Menhir*, që është mbase krijimi më kompleks i poetit.¹¹ Në shënimin e vënë në fusnotë (nga botuesi) lidhur me titullin e tij jepet ky shpjegim: “*Gur i lartë, zakonisht i pagdhundur, i drejtë, që përdorej në monumentet neolitike, i vetmuar ose pjesë e një rreshiti ose rrethi*”. Poet me kulturë, Hanxhari solli në poezinë shqipe tema dhe simbole, që nuk hasen te poetët e tjerë. *Menhirët* janë gurë të mprehtë, që vihen pranë ose sipër varrit dhe që, sipas besimit, luajnë rolin e rojtarit të varrezës. Te keltët ata janë ngritur për nder të njerëzve të mëdhenj: priftërinj, poetë, profetë. Simbolika falike është po ashtu, sipas antropologëve, një nga kuptimet e mundshme të gurit prehistorik me emrin “menhir”.

Nuk është aspak i lehtë deshifrimi i kësaj figure te Hanxhari. *Menhir*-i është një krijim poetik jolinear, ku mbresat, impresionet, ndjesitë dhe imazhet derdhen si në një ujëvarë. Subjekti lirik rrëfen udhëtimin e tij imagjinar vetë i dytë (*Kur u ngjitem të dy për herë të parë mbi kodër*) në një kohë dhe hapësirë të papërcaktuar. Deti, rëra dhe retë janë tri figurat-bazë të tekstit poetik, që personifikojnë tri dimensione të kozmosit: tokën, ujin dhe qiellin. “*Rërë det e ré/ Menhirin e dashurisë sonë ah e keni ju*”.

Poemthi *Menhir* është, siç është thënë, apoteozë e dashurisë. Në vargjet e tij himnizohet dashuria si ndjenjë në plan universal dhe evokohet një dashuri e pastër, sa reale, tokësore, aq edhe nebuloze, qiellore, që ndodh buzë detit: “*Kur u ngjitem të dy për herë të parë mbi kodër/ Kur e ndjemë që deti ish atje përtej...*”.

Imazhi i kodrës ku ngjiten dy të rinjtë dhe i detit përtej - ta kujton doemos dashurinë e Milosaos me Rinën te vepra rinore e De Radës, *Këngët e Milosaos*. Dhe jo vetëm kaq. Më shumë se thjesht imazhi, është pasioni me të cilin i këndohet dashurisë: “*O dashuri/ Je ti që na bën të zgjohemi të ngazëllyer që u zgjuam/ Ashtu si klithi pulëbardha e poezisë Jeronim Poeti*”.

Dashuria dhe natyra shkrihen natyrshëm me gjendjen shpirtërore të subjektit lirik, e cila i ngjan një dehjeje të shkaktuar nga nektari i dashurisë. Dashurinë poeti e sheh të shkrirë në natyrë, tek deti në tallaz dhe bunacë. Toni i ligjërimit është i lartë,

¹¹ Kam parasysh variantin e plotë, të botuar te libri *Gdhend një statujë* (2005).

emotiv, për të mos thënë edhe emfatik (vargjet fillojnë pothuajse secilën herë me apelativin: “o dashuri”), kurse vargu i gjatë, i çliruar nga konvenca e metrit dhe e rimës, por me një ritëm të brendshëm dinamik. Si në një kaleidoskop, poeti derdh fjalët, tingujt, ngjyrat, figurat, krahasimet, metaforat dhe apostrofimet e zjarrta: “*O dashuri lot i vesës në qepallë të mëngjesit/ Dashuri dashuri dritë e butë e muzgut plot gjemi*”.

Po përse poeti e quajti *Menhir* këtë krijim poetik, aq më shumë, që, pos në titull, kjo fjalë përmendet fare pak në vargjet e tij (gjithsej tri herë)?

Përgjigjja është e thjeshtë. Menhiri është arketip i dashurisë, por edhe i artit, poezisë, pavdekësisë. Ashtu si menhirët e lashtë monumentalë, edhe dashuria është e pavdekshme dhe në thelb edhe e pandryshueshme, që nga koha e neolitit e gjer më sot.

*Mbi tok' e det e qiell në dritë e errësirë
O dashuri që mbive u bëre zog i lirë
Je gjithkund njëlloj si dit'n e parë*

Dashuria është stina më e bukur e jetës; ajo është dehëse si muzika e Vivaldit.

Mihal Hanxhari këndon për dashurinë në mënyrën e tij, me pasionin e një romantiku latent, i cili e ngre lart atë si ndjenjë, duke i dhënë përmasa kozmike. Ai i ngre përmendore të lartë e të fortë si menhirët neolitikë ndjenjës së dashurisë, e cila sjell gëzim e lumturi, por edhe trishtim e vetmi.

Mihal Hanxhari e pasuron lirikën shqipe të dashurisë me tema, motive, përmbajtje e frymëzime pothuajse të patrajuara nga poetët e tjerë, por edhe me mjete e forma të reja shprehëse. Por si krijues me kulturë të gjerë dhe me kërkesa të larta estetike, ai është i vetëdijshëm se mënyra e tij e të kënduarit për dashurinë nuk është as e vetmja e as më e mira, siç deklaroi me modesti në vargjet e mëposhtme:

*Le të këndojë kush di më bukur se sa unë
Më shumë ka këngë se dashuri në botë.*

Dashuria është kudo si ajri, uji dhe zjarri. Yjet në qiell, gurët në tokë, lumi, deti, rëra, retë, zogjtë shpallin triumfin e saj në botë, ndërsa arti, muzika, poezia përjetësojnë zjarrin që ndez ajo në shpirtin njerëzor.

*Atë zjarr në shpirt je ti që ma ndez
Je ti zë i detit që vjen e më kërkon
Që vjen si një ëndërr e si ëndërr shkon
Dhe kur vjen mëngjesi ëndërra prap më vdes
Atë zjarr në shpirt je ti që ma ndez*

Si për Arshi Pipën e kohës së rinisë (strofa e cituar më sipër është marrë nga libri i tij i parë me poezi *Lundërtarë*, 1944), edhe për Hanxharin, që mbeti përherë i ri, në jetë dhe në poezi, Dashuria është shtysa që e shpie anijen e Fatit drejt limanit të Vuajtjes dhe Bukurisë. Udhërrëfyes në këtë rrugëtim të pasosur drejt Dashurisë është ylli i ndritshëm Aldebaran, kurse cak i tij guri prehistorik Menhir, që duke qenë gur varri e shndërron himnin në epitaf.

Kronotopia e Parisit

Në vitet 1994-1995 Mihal Hanxhari qëndroi në Paris si lektor i gjuhës shqipe dhe i qytetërimit shqiptar në INALCO, institucion në të cilin, krahas gjuhëve të tjera, mësohet edhe gjuha shqipe. Qëndrimi në këtë qytet, Mekë e poetëve dhe artistëve të botës, që i frytshëm për të. Gjatë kësaj kohe ai shkroi, ndër të tjera, ciklin prej dhjetë poezish me titull *Poezitë e Parisit*, që përfshin vjershat: *Saint Merri*, *Chartres*, *Në muret e metrosë*, *Muzg*, *Bulevardi Saint-Germain*, *Stadiumi antik*, *Place de la Concorde*, *Centre culturel George Pompidou*, *Në Parkun Montsouris* dhe *Mais où sont le neiges d'antan*, ndonëse temës së Parisit poeti i referohet edhe në vjersha të tjera jashtë këtij cikli.

Janë këto ndër poezitë më të bukura të Mihal Hanxharit dhe ndër poezitë më të bukura kushtuar Parisit të shkruara nga ndonjë poet shqiptar. Siç është e natyrshme për poezitë e këtij lloji, ato evokojnë mjedise pitoreske të qytetit buzë Senës (kafene, parqe, sheshe, bulevarde, metronë e famshme parisienne, kejet me antikuarë etj.), si dhe objekte të njohura kulturo-historike (kisha, katedrale, muzeume, galeri e sallone, që frekuentohen nga piktorët dhe artistët), por më së shumti flasin për poezinë dhe poetët, aq sa mund të thuhet se në vargjet e këtij cikli zhvillohet një dialog në vargje me poezinë dhe poetët francezë të dy shekujve të fundit.

Cikli hapet me poezinë e bukur *Saint Merri*, e cila është një mrekulli e vërtetë tingujsh, rimash dhe figurash. Personazhe të saj janë dy klosharë parisienë, që strehohen në kishën “Saint-Merri”. Bën ftohtë e bie shi dhe çifti i klosharëve të pastrehë gjen strehë në kishë. Aty, pranë ikonës, nën dritën e zbehtë të qirinjve, bëjnë dashuri dhe, ashtu të përqafuar, i zë gjumi. Të bësh dashuri në kishë e në xhami është mëkat - përdhosje e shtëpisë së Zotit, por ja që poeti nuk mendon ashtu. Dashuria është dhuratë e perëndisë, andaj bijtë e tij, njerëzit, qofshin mbretër a klosharë, e shijojnë njëlloj atë. Vjersha mbyllet me vargjet në të cilat mbizotërojnë, sikurse në strofat e tjera, rimat me zanoren *i* dhe *e*, që sugjerojnë heshtjen dhe qetësinë:

*Dhe ajo fle dhe ai fle
Dy klosharë gjë në gjë
Zot askush nuk i përze
Që nga kisha Saint Merri*

Pason vjersha dystrofëshe *Chartres*, e përbërë nga dy katrena, në të cilën subjekti lirik përsiat për përkohësinë e njeriut në këtë botë, duke marrë shkas nga qelqet e ndezura të kishave të Shartrit, qytet në jugperëndim të Parisit, i njohur për katedralen e tij të bukur mesjetare, një kryevepër arkitektonike e llojit të vet.

*Dhe ika që të mbetem mes fushave me ves'
Në qelqet me ngjyra të kishave të Chartres*

Fantazinë e poetit e nxisin, doemos, krahas kishave e katedraleve, edhe metroja e famshme e Parisit, që është një botë më vete (*Në muret e metrosë*), pastaj muzgu parizien, që i shërben vizitorit si shkas për meditim (*Muzg*); bulevardi Sen-Zhermen me shenjat e tij dalluese (*Bulevardi Saint-Germain*); stadiumi antik i qytetit me shkallët e mbuluara nga bari (*Stadiumi antik*); Sheshi Konkord me Obeliskun e sjellë nga Egjipti i lashtë, që ëndërron mërmërimën e largët të Nilit (*Place de la Concorde*); Qendra Kulturore “Zhorzh Pompidu”, e njohur me emrin popullor “Beaubour” (*Centre Culturel George Pompidou*) dhe Parku Monsuri në afërsi të Qytetit Ndërkombëtar të Studentëve, ku ka banuar një kohë Hanxhari gjatë qëndrimit të tij në Paris (*Në Parkun Montsouris*).

Secila nga këto poezi ofron një pamje, një peizazh ose një përjetim nga qyteti të cilin Valter Benjamini e quajti “kryeqyteti i shekullit të nëntëmbëdhjetë” dhe i tillë mbeti edhe në shekullin e njëzetë. Mirëpo, më shumë se vjersha përshkruese, që ofrojnë pamje tërheqëse për syrin si ato që ofron me bollëk Parisi, vjershat e mësipërme janë, cila më shumë e cila më pak, poezi lirike meditative, që duke marrë shkas nga kontakti me bukuritë e rralla të këtij qyteti, shprehin vizionin e poetit për jetën, dashurinë, artin, vdekjen dhe pavdekësinë, të ngjizura në mënyrë mjeshtërore në vargje kryesisht të rregullta, strofike, pa thyerje të mëdha metrike e formale, por të çliruara nga ngurtësia ritmike, figurative dhe semantike e poezisë tradicionale.

Raporti që vë poeti me Parisin është dialogues, në kuptimin që këtij nocioni i japin përfaqësuesit e teorisë intertekstuale. Hanxhari citon, parafrazon, komenton vepra, fakte, të dhëna, emra etj. Por mjeshtëria e tij si poet qëndron në mënyrën si e bën këtë: lehtë, natyrshëm, pa sforcime. Sintezën fatlume të këtyre motiveve dhe të kësaj teknike të shkrimit e gjejmë në vjershën përmbyllëse të ciklit, që mban si titull vargun e famshëm të Vijonit: *Mais où sont les neiges d’antan*.

Mirëpo, para se të kalojmë në analizën e kësaj poezie, le të themi ndonjë fjalë për poezitë e tjera të këtij cikli, të cilin vetë poeti e quajti thjesht: *Poezitë e Parisit*.

Qendra Kulturore me emrin e ish-presidentit francez, Zhorzh Pompidu¹², bëhet objekt frymëzimi në poezinë *Centre Culturel George Pompidou*. Atmosfera që mbretëron në këtë tempull modern kulturor është krejt tjetër nga ajo e tempullit fetar (*Saint-Merri*): e gjallë e dinamike dhe jo e heshtur e statike. Kjo është botë e librit, e kompjuterit, e konferencave shkencore, e ekspozitave, e koncerteve dhe e shfaqjeve filmike e teatrore, ku hyjnë e dalin njerëz të profileve të ndryshme, studentë, intelektualë e të tjerë. Pasi përshkruan në hollësi arkitekturën e këtij objekti dhe gjallërinë e tij, poeti e mbyll vjershën me një kontrast: kloshtarët që flenë nën hijen e këtij “tempulli” mbuluar me gazetën *Libération*.

Poezia *Bulevardi Saint-Germain* sajohet nga tri pamje, që shfaqen me këtë rend: statuja e Dantonit te stacioni “Odeon”, ku vazhdimisht hyjnë e dalin njerëz në nëntokën e metrosë; kafeneja e frekuentuar nga Sartri po në këtë bulevard (nuk përmendet emri i lokalit, por fjala është për kafenenë “Flora” ose “Les deux magots”, ku Sartri dhe Simonë dë Bovuar ishin mysafirë të shpeshtë) dhe një çezmë që rrjedh aty pranë.

Dantoni personifikon politikanin, që ëndërron të presë koka njerëzish në gijotinë, nga e cila pësoi edhe vetë; Sartri - filozofin dhe intelektualin, që mbi çdo gjë vë idetë dhe prestigjin e tij intelektual, kurse çezma - jetën e gjallë. Kësaj logjike i nënshtrohet edhe kompozicioni i vjershës, që sajohet nga tri njësi strofike (4+3+3). Figurën e Dantonit, poeti e karakterizon me fjalët prozaike: “i nxirë”, “i enjtur”, “shpirt demon”, “me bulçiltë e mbushur plot”, për ta përmbyllur tiradën me një “denoncim” klasik të këtij politikani kontravers, që ishte avokat me profesion:

Krekoset aty Dantoni por ai as sot s'e di
Që historia nxori që avokati i ndritur
Tek anglezët për flori pat shitur
Francë Revolucion dhe shpirt'n e tij

Nga Dantoni poeti kalon tek Sartri, për të evokuar në tri strofat vijuese bëmat e tij si shkrimtar, filozof e intelektual. Përmendet titulli i veprës kryesore filozofike të Sartrit *L'Être et le Néant* (Qenia dhe Hiçi) dhe refuzimi i Çmimit Nobel nga ana e tij si akt rebelimi intelektual. Sa për shkak të rimës, po aq edhe në shenjë revolte ndaj konformizmit, poeti përdor fjalët: “përmori” dhe “shurruar”, që nuk i shkojnë shumë poezisë së tij në përgjithësi skofiare, të kundërt me poezinë avangarde.

Edhe në një mjedis si ai i bulevardit Sen-Zhermen, ku ka aq shumë gjëra për të parë, poetit i bën përshtypje një detaj në dukje i parëndësishëm, por kuptimplotë: currili i ujit që rrjedh pahetueshëm aty pranë. Prandaj, fton lexuesin të lërë Dantonin

¹² Georges Pompidou (1911-1974), president i Francës në vitet 1969-1974, njihet, ndër të tjera, edhe si autor i një antologjie të poezisë frënge: *Anthologie de la Poésie française*, Hachette, Paris 1961.

e Sartrin dhe të hedhë sytë tek çezma ku pinë ujë njerëzit dhe pëllumbat. Një mur i vjetër, një kishëz dhe dy cirka uji që rrjedhin pareshtur si nga një botë tjetër, mjaftojnë për të sugjeruar idenë se politika, karriera, fama e pasuria dhe, mbase, edhe arti e filozofia, janë hiçgjë përpara rrjedhës së ujit, që është simbol i jetës.

N'atë mur të vjetër pështetur në një kish'
Ku rrëmet' i rrugës sikur s'ndihet më
Harroi shpirt të gjitha nuk ia vlen asgjë
O shpirt me pëllumbat shko aty të pish

Poezia *Bulevardi Saint-Germain* është përsiatje për politikën, historinë, filozofinë, artin, jetën. E ngjashme me të është poezia *Në muret e metrosë*, veçse këtupoeti niset nga një fakt konkret: afishimi i vargjeve të poetëve anonimë në muret e metrosë parisienne. Udhëtarët i lexojnë në heshtje ato vargje, që flasin për gjëra jo të zakonshme. Vjersha ka tone elegjiake dhe i ngjan një përrshpirtjeje për poetin “e mallkuar”, që jeton me “vojtitjen e bekuar”. Fjalët: kryq, ikonë dhe rekuem janë në funksion të krijimit të kësaj atmosfere.

Në poezinë *Place de la Concorde* poeti nuk flet për historinë e bujshme të sheshit me këtë emër, që në shqip do të mund ta quanim “Sheshi i Pajtimit”, por apostrofon Obeliskun madhështor që ngrihet në qendër të tij. Animizimi i pirgut të ardhur nga brigjet e Nilit, që duket i fjetur gjatë ditës dhe zgjohet kur vjen nata dhe metaforat e tipit “kurm palme bërë gur”, i japin tonin kësaj poezie dhe shprehin qëndrimin e poetit ndaj historisë.

Vjersha përmblylëse e ciklit, që ka si titull një varg të Vijonit, vargun e famshëm *Mais où sont les neiges d'antan*, është një shëtitje poetike nëpër Paris. E shkruar me vargje të rimuara, të strukturuar në strofa katërshe sipas skemës ABAB, kjo poezi, që është më e gjata e ciklit (gjithsej 37 strofa), hapet me imazhin e fluturimit të një aeroplani që ndan më dysh qiellin e Parisit:

Brazd' e bardhë e një avioni
E ndan qiellin mes për mes
O sytë e mi çfarë po shikoni
Zemrën time në dy pjesë

Apostrofimi i syve dhe i zemrës që në strofën e parë, sugjeron aktin e të parit dhe të përjetuarit të Parisit jo vetëm si një qytet i madh e me bukuri të rralla, por edhe si djep i kulturës, artit dhe poezisë.

Balzaku, një nga kronistët më të mëdhenj të shoqërisë franceze të kohës, thotë se Parisi është qyteti më zbavitës dhe më filozofik në botë.¹³ Poeti shqiptar Mihal Hanxhari, në poezitë e tij kushtuar këtij qyteti, mëton të kapë të dyja këto përmasa, por si poet me prikje refleksive, anon nga e dyta: ana filozofike e Parisit. “Fluturimin” e tij mbi qytetin buzë Senës, ai e fillon nga një pikë konkrete: nga streha e kafenesë me emrin e aktorese së njohur franceze të viteve ’20-’30, Sara Bernar, prej nga, në një ditë me shi, niset në “pushtimin” e tij.

*Në kafe Sara Bernhardt
Rri nën strehë tek bie shi
Ah Sena shpie në Pont des Arts
Poet’ e vdekur një nga një*

*Poetët gjethe poet’ gjemi
Ikin mjegull nëpër lumë
Zot poetët një nga një
Vijnë tuliten në gji tek unë*

Shtegtimi i poetit vazhdon në këtë frymë. Strofa katërshe dhe vargu i rimuar i përgjigjen synimit që i ka parashtruar ai vetes: të këndojë për urat, rrugët, sheshet, bulevardet, monumentet dhe kejet e Parisit, por akoma më shumë për ata që u japin frymë dhe kuptim atyre: artistët dhe poetët. “Takimi” me bardët e poezisë franceze, klasike dhe moderne: Apolinerin, Vijonin, Rembonë, Vërlenin, Desnosin, Lotreamonin, Aragonin, Elyarin, Sen-Xhon Persin; me piktorët gjenialë Pikaso e Modiliani dhe këngëtarët popullorë Zhak Brel, Zhilber Beko e Pjer Bulez, paraqesin shtresën kryesore të këtij kokteji poetik. Ata janë “ura” që lidh tokën dhe qiellin, kohën dhe hapësirën, realitetin dhe ëndrrën. Poeti dialogon me ta, evokon detaje nga jeta e tyre, përmend tituj veprash dhe citon vargje, shtron pyetje e bën vlerësime, krijon rima të bukura e interesante, tërheq paralele befasuese.

*Mbi një urë ëndërroj
As Jacques Brel e as Becaud
Unë me Guillaumin kuvendoj
Si mbi urën Mirabo*

*Ashtu vetëm përmbi urë
Flokë thinja nëpër erë*

¹³ Ky mendim i Balzakit haset te novela e tij e njohur *Sarrazini*, e përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

*Ah Guillaumi s'kthehet kurrë
Si dëborë që ran' një herë*

Subjekti lirik identifikohet plotësisht me “poetët e vdekur”, kurse teksti i vjershës i ngjan një rrjeti ndërtekstor të thurur me mjeshtri. Në tekstin shqip poeti fut fraza, shprehje dhe emërtime frëngjisht, kurse emrat e poetëve dhe titujt e veprave të tyre i shkruan në origjinal, duke përfutur kështu atmosferën autentike të mjedisit dhe ngjyrimin gjuhësor e stilistik të vargut.

Nuk mungojnë as aluzionet për degradimin e vlerave në shoqërinë e sotme të qytetërimit teknik. Kështu, lulet që rriten në xham janë pa erë; Trëndafilat e Saadiut s'gjenden dot; Lulet e hidhura të Bodlerit lypin lëmoshë në metro ose mbyten në smog; pikturat nxijnë; krijuesi gjenial i *Një stinë në ferr*, Artyr Rembo, mund të shesë çelësa në rrugën Rivoli, ndërsa “*Në ferr veturash ulërijnë/ Mija demonë me një zë*”.

Për titull të vjershës poeti ka zgjedhur vargun e njohur të Vijonit: *Mais où sont les neiges d'antan*, të cilin vetë Hanxhari e përkthen në shqip: “Por ku janë dëborët që ranë njëherë?”. Koha rrjedh si lumi që kalon përmes qytetit, Sena legjendare, ndërsa shpirtin e poetit e kaplon pikëllimi. Kalueshmëria e jetës dhe fundi i saj i pashmangshëm - vdekja, është lajtmotivi i kësaj poezie të Hanxharit, që hapet me kujtimin e “poetëve të vdekur” dhe mbyllet me vargun që na përkujton ikjen nga kjo botë: “*Ditëlindje e tokës që do lëmë pas*”.

Vargu inicial i vjershës mbi poetët e vdekur, që vijonë “nji nga nji”, haset edhe te poezia *Në Parkun Montsouris*, ku shiu që bie pa pushim - një element tjetër i përbashkët i të dyja vjershave, krahas ndjenjës së trishtimit dhe melankolisë, zgjon edhe asociacionin e përtëritjes së natyrës:

*Dhe shiu i prillit bie
Me mërmërim' të mekur
Ja po vijnë si hije
Gjithë poet' e vdekur*

“Festë lëvizëse” (A Moveable feast), e pat quajtur Hemingueji Parisin në librin e tij me të njëjtin titull, ku evokonte kujtimet e qëndrimit të tij në këtë qytet në vitet 1921-1923 dhe shtonte se “Parisi është qytet ideal për shkrimtarët”.

Për Parisin është shkruar më shumë se për cilindo qytet tjetër në botë dhe është shkruar në mënyra nga më të ndryshmet. Mihal Hanxhari paraqet Parisin e vet, ashtu siç e sheh ai me sytë e tij: me simbolet, dritat dhe hijet e tij. Parisi i Hanxharit nuk është Parisi i Balzakut, i Hygoit, i Prustit, i Heminguejit, i Remarkut, i Preverit apo edhe i Kadaresë, për të përmendur vetëm disa nga korifenjtë e tij. Parisi i Hanxharit është para së gjithash qytet i artit dhe i kulturës, i poezisë, i muzikës, i

pikturës, por edhe i idealeve të mëdha shoqërore dhe në radhë të parë i idealit të lirisë. Parisi i Hanxharit është para së gjithash Parisi i poetëve Bodler, Rembo, Vërlen, Apoliner, Aragon, Elyar e të tjerë (disa prej të cilëve ai edhe i përktheu në gjuhën shqipe) dhe akoma më shumë i “poetit të parë modern”, siç është quajtur Fransoa Vijoni, tejet problematik si njeri, por gjenial si poet, i njohur sidomos për baladat e tij. Vijonit (apo Vilonit) poeti i referohet në së paku dy poezi: *Mais où sont le neiges d’antan* dhe *Variacion nga një temë e Villonit*, që mund të thuhet se edhe janë variacione të njëra-tjetrës. Shprehja: “ku janë” (frëngjisht: *où sont*), nëpërmjet së cilës përftohet ideja e ikjes në pakthim të kohës, ia jep tonin edhe njëërës edhe tjetrës.

“Poezitë e Parisit” Hanxhari i shkroi gjatë qëndrimit të tij në këtë qytet, në vitet 1994-95, pra vetëm 4-5 vjet para se të largohej edhe vetë përgjithmonë nga kjo botë.

Kënga për Kosovën

Krijimi i fundit poetik i Mihal Haxharit është poezia *Elegji për Kosovën*. Kjo poezi lindi në kohën e eksodit të shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri e gjetkë (mars-qershor 1999), disa prej të cilëve poeti i strehoi në shtëpinë e tij në Tiranë. Vjersha mban në fund shënimin: “Tiranë, prill 1999”, që do të thotë se ajo është shkruar rreth dy muaj para se poeti të ikte nga kjo botë. (Hanxhari vdiq më 3 qershor 1999). Fryma dhe përmbajtja e kësaj vjershe, me të cilën mbyllet vëllimi *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, paralajmërohet qysh në titull: *Elegji për Kosovën*. E, elegjia, s’është tjetër, pos vajtim; këngë ku mbizotëron ndjenja e dhembjes dhe e pikëllimit. Mirëpo, edhe pse në krye të vjershës në fjalë qëndron fjala “elegji”, ajo i ngjan më shumë një lutjeje të poetit drejtuar Zotit për shpëtimin e Kosovës nga tragjedia e madhe që i shkaktuan asaj pushtuesit serbë, që poeti refuzon t’u bëjë vend në vargje, veçse tërthorazi dhe vetëm në strofën e dytë, ku përmenden “zërat e çmendur”, “tamtamet”, “klithmat e marra”, që zgjojnë asociacionin e dhunës dhe të propagandës.

Koha kur u shkruan këto vargje ishte kohë e lutjes së madhe për shpëtimin e Kosovës dhe njerëzve të saj të derdhur nëpër botë. Dashuria dhe dhimbja e poetit për këta njerëz është e madhe, ndërsa optimizmi i tij për fatin e tyre i përmbajtur, gjë që shprehet me përdorimin e shpeshtë, në secilën strofë, të lidhëzës “nëse”, që përdoret rëndom në fjalitë kushtore.

Elegjia e Hanxharit për Kosovën, më shumë se elegji është psalm a litani, që fillon e mbaron me fjalën Zot, e cila, në tekstin prej gjithsej njëzet vargjesh të kësaj poezie, përdoret plot nëntë herë.

*Zot nëse njerëzit s'dinë të shohin sot
Dhe nesër askush s'do të ketë më sy
Shpëto o Zot vetëm sytë e fëmijëve të Kosovës
Zot shpëto ata sy të kaltër të peshqve blu
Që flenë në shi dhe ëndërrojnë engjëjt e tu*

Të vihet re gjithashtu edhe përdorimi i dendur i fjalës “sy” në këto vargje, që është jo vetëm fjalë e preferuar e poetit, por ka edhe funksion semantik: shpreh idenë e (mos)mylljes së syve para fatkeqësisë së njerëzve dhe posaçërisht të fëmijëve të pafajshëm, që poeti i përqsas me engjëjt dhe “peshqit blu”, që janë peshq migrues, njësoj si fëmijët shqiptarë të shndërruar në refugjatë.

Ndryshe nga poetët tanë të tjerë, që e kanë trajtuar temën e fatit tragjik të Kosovës, përfshirë edhe Kadarenë (*Terrori në Kosovë*), më shumë se te shkaktarët e saj, vëmendja e poetit Hanxhari fokusohet te njerëzit e Kosovës të degdisur nëpër botë, në shi e në baltë, kurse në epiqendër janë vënë: fëmijët, pleqtë, gratë dhe përsëri fëmijët (foshnjat) dhe nënat e tyre (nuset), që krahasohen me yjet e “Yllnajës së Mjellmës”, figurë kozmike me kuptim simbolik, nga ato që Hanxhari përdor shpesh në poezinë e tij (le të kujtojmë poemën *Aldebaran* etj.). E vetmja fjalë, që mbase stonon në këtë vjershë të shkruar me frymëzim dhe të kompozuar me mjeshtri, është fjala e huaj “delyzhë” (nga frëngjishtja: *déluge* - shi i rrëmbyer, rrebesh i madh, përmytje, kijamet). Kjo fjalë, me origjinë biblike, është futur në këtë rast për të treguar përmasat apokaliptike të tragjedisë së Kosovës, që ishte tragjedi e një populli të tërë, që i kanosej rreziku i shfarosjes.

*Dhe nëse s'do ketë shenjë nga delyzhi ku pirgu do bëhet
Gropë dhe gropa kodër mbill nëpër rrugët e Kosovës
Dyqind qiparisa dy mijë qiparisa dyqind mijë qiparisa
Dhe dy milionë rrape o Zot
Dhe ai do të jetë pylli i parë i Lirisë në botë.*

Bie në sy, si thamë, përdorimi i shpeshtë i fjalës *Zot* në vargjet e kësaj poezie. Kurse *Zotit* njeriu i drejtohet kur është në kulm të hidhërimit dhe kur e humb besimin te njerëzit, por jo edhe shpresën, që vdes e fundit.

Nëse qiparisat t'i kujtojnë varret, rrapet simbolizojnë qëndresën.

Pylli i Lirisë, që del në vargun përmyllës të vjershës *Elegji për Kosovën*, u bë realitet, ndonëse poeti që e krijoi këtë metaforë të madhe e vizionare, nuk arriti ta shihte dot me sytë e vet.

Imazhi poetik, muzika e fjalës

Poezia e Mihal Hanxharit është fryt i dhuntisë krijuese dhe i kulturës së gjerë letrare, që e karakterizon këtë krijues të talentuar e erudit, i cili, edhe pse nuk e studioi letërsinë në shkollë, tërë jetën ia kushtoi asaj. Poezia e tij, për shumëçka origjinale, është vazhduese e traditës poetike shqiptare, e pjesës më të mirë të saj, gjë që na kujton pikëpamjen e Eliotit se “pjesët më të mira dhe më individuale të veprës së një poeti janë ato me të cilat poetët e vdekur, *paraardhësit e tij*, e kanë dëshmuar pavdekësinë e vet”. Hanxhari e njihte mirë verbin poetik shqiptar, që nga poeti anonim e gjer tek poetët e spikatur kombëtarë, si: De Rada, Naimi, Fishta, Çajupi, Noli, Asdreni, Lasgushi, Migjeni etj., emrat e të cilëve përmenden shpesh në poezinë e tij. Më i afërt nga të gjithë për të është Lasgushi, me të cilin e ka të përbashkët, përpos dashurisë për atdheun, gjuhën shqipe dhe natyrën shqiptare, edhe trajtimin e motiveve të përhershme poetike si dashuria, përjetësia, vizionet kozmike, simbolika që derivon nga kjo sferë dhe mbi të gjitha muzikën e vargut.

Poezia e Mihal Hanxharit është fryt i komunikimit me traditën poetike shqiptare, të cilën ai e njihte mirë dhe e çmonte lart, por edhe me traditën e poezisë evropiane e botërore dhe sidomos të poezisë moderne franceze nga Bodleri e deri në ditët e sotme. Sikurse edhe Kadareja, Agolli, Arapi, Bllaci, Spahiu e të tjerë, Mihal Hanxhari ishte jo vetëm poet, por edhe përkthyes i poezisë. Ai përktheu, po ashtu në heshtje dhe pa e bërë publike as punën e tij si përkthyes, poezi të poetëve francezë: Bodler, Hygo, Vërlen, Rembo, Mallarmé, Elyar, Renjer, Vijon, Sypervjel të tjerë, sonetet e Shekspirit, *Gitanjalin* e Tagorës, veprën me të cilën bardhi indian mori çmimin Nobel; një libër me poezi të Mikelanxhelos, të cilin e shoqëroi me një ese të gjatë, model i esesë së vërtetë, çfarë mund të hasen rrallë në letërsinë shqipe etj. Në vargjet e tij, sikurse edhe në tregimet e librit *Na ishte një herë...* defilojnë emrat e shumë poetëve, filozofëve, shkrimtarëve dhe intelektualëve të kulturës perëndimore, por edhe asaj lindore; ka citate nga Bibla dhe Kurani, vargje nga cikli i kreshnikëve (*Lum për ty o i lumi Zot, shum po shndrit njaj diell e pak po nxe dhe Ç’pe merr frima rrapin e Jutbinës*), të cilat shoqërohen me komente; ndërkallet *Kënga e këngëve* e mbretit Salomon dhe tregimi i Psikes dhe Erosit i mitologjisë së lashtë greke, kurse për vargun e De Radës: “*U zgjua e ngazëllyer që u zgjua*” thuhet se është “mbase vargu më i bukur i poezisë sonë”¹⁴.

Ndërkohë, që nuk ka asnjë referencë për poezinë e sotme, ndaj së cilës duket kishte rezerva të mëdha.

Mihal Hanxhari i takon kategorisë së poetëve të ditur (poeta doctus). Ishte njeri me kulturë të gjerë letrare, estetike, filozofike. Duket se ka pasur njohuri të gjera edhe nga astronomia, botanika, zoologjia. Përveç që shkruante vargje dhe

¹⁴ Shih tregimin *Varrimi*, te libri *Na ishte njëherë...*, f. 77.

prozë (në heshtje të plotë), merrej edhe me përkthime dhe pikturonte. E njihte mirë muzikën, si atë popullore, ashtu edhe atë klasike. Ishte në shërbim të dijes dhe kulturës. Ata që e kanë njohur dëshmojnë se me punën e tij si drejtor i Bibliotekës Shkencore të Universitetit të Tiranës, në krye të së cilës qëndroi plot 15 vjet, derisa e transferuan si të papërshtatshëm në një vend krejt të parëndësishëm (sportelist në bibliotekën e njërit prej fakulteteve), ai i bëri shërbime të çmueshme kulturës kombëtare.¹⁵ I pasuroi fondet e saj me libra e revista; vuri kontakt me shumë biblioteka të botës dhe personalitete të shquara të kulturës; e shndërroi zyrën e tij në një klub të elitës intelektuale të Tiranës. Një dëshmi të shkruar për këtë mision të Mihalit, ka lënë edhe shkrimtari Mitrush Kuteli.

“Mihal Hanxhari i ka të gjitha ç’duhen për të qenë një shkrimtar i vërtetë: ndjeshmërinë, prirjen për filozofim, fantazinë, kulturën” - nënvizon Donika Omari në parathënien e librit të tij me tregime *Na ishte njëherë...*¹⁶. Poezia e tij, edhe pse nuk është në asnjë rast didaktike, ofron një informacion të gjerë artistik e, madje, herë-herë, edhe shkencor (ajo është poezi e një eruditi prej së cilës njeriu mund të mësojë mjaft gjëra që s’i ka ditur për artin, natyrën etj.), ndërsa në prozën e tij mund të lexohet një nga vlerësimet më të bukura e më origjinale, që janë shqiptuar ndonjëherë për letërsinë popullore. Te tregimi me titull *Liqeni B.*, që është proza më e gjatë e tij, personazhi narrator, pasi citon vargun e një kënge popullore shqiptare të dashurisë: “*Pash nj’at sy, qi ma çil e ma mbyll, posi hana nëpër pyll...*”, bën këtë koment për poetin anonim shqiptar dhe perlat që ka krijuar ai: “*sa e sa herë kam menduar për atë poet që i ka kënduar këto vargje, për gjithë ata poetë anonimë që kanë kënduar gjërat më të bukura të gjuhës sime, dhe janë pa dyshim nga më të bukurat që kanë kënduar poetët e gjithë kohërave të të gjithë botës, dhe s’kanë një emër, dhe as kanë kënduar për t’i shitur inxhitë e tyre, as i kanë paraqitur nëpër komisione për t’i gykuar, kjo s’bën, as kanë marrë porosi të këndojnë që të marrin një nishan, një titull, një çmim, as kanë menduar të bëhen të pasur me këngët e shpirtit të tyre, as kanë menduar t’i përkthejnë në të tjera gjuhë që të bëhen të dëgjuar dhe ashtu të marrin të tjera nishane, dhe të bëjnë jetë zotërinjsh, asgjë nga këto, vetëm kanë kënduar si u ka thënë shpirti, ashtu si janë dehur nga bukuria, ajo dorë e Perëndisë, nga bukuria e asaj që kanë dashur, dhe nga dashuria për bukurinë e vendit që kanë parë që në fëmijëri...*”.

Një profil i tillë poeti, që shkruan ashtu si i dikton shpirti dhe pa kurrfarë kompleksi e prapavije, pos dëshirës për të qenë në shërbim të bukurisë dhe i dehur prej saj, është vetë Hanxhari. Ai nuk këndoi për nishane, për t’u bërë i famshëm, e as

¹⁵ Shih për këtë artikullin e Zef Rrakacolliit “Oaza e Mihalit”, botuar në gazetën “Drita”, 4 shkurt 2001 dhe në librin *Mihal Hanxhari. Njeriu dhe vepra*, “Florimont”, Tiranë 2004, f. 47-51.

¹⁶ Donika Omari, *Parathënie*, f. 8.

për të përfituar në planin material. Krijuesi për të cilin flitet në paragrafin e mësipërm është gjedhe e krijuesit të lirë e autonom në çdo pikëpamje.

Hanxhari është i vetmi poet bashkëkohor shqiptar nga ata që kanë krijuar në Shqipëri që i hoqi shenjat e pikësimit nga vargjet (ndryshe nga ç'ndodhte në Kosovë, fjala vjen, ku kjo dukuri ishte shumë e përhapur), duke mos i përdorur ato fare, kurse në prozë i reduktoi në maksimum. Natyrisht se heqja e shenjave të pikësimit nuk është *a priori* shenjë e modernitetit të poezisë. Përkundrazi, kur bëhet për modë, siç ka ndodhur shumë herë në Kosovë, mund të jetë edhe e kundërta e asaj që synohet - shprehjes moderne. Me vetë faktin që nuk botonte, Hanxhari nuk ishte nga ata krijues që duan të imponohen e bien në sy, prandaj shmangia e interpunksionit tek ai shkon në favor të forcimit të shprehësisë së vargut dhe është njëkohësisht edhe shprehje e dëshirës së autorit për të qenë kundër rrymës.

Mihal Hanxhari është poet që, siç pohon vetë në vjershën *Sytë e mi*, e sheh botën me sytë e fëmijës: “*Se sytë e mi kështu e shohin botën/ Se Zoti m'i la përgjithmonë sytë e fëmijërisë*”.¹⁷

Nga ky aspekt ai ta kujton mendimin e kritikut dhe filozofit francez Zhorzh Bataj, i cili duke folur për Kafkën, njërin nga tre shkrimtarët e adhuruar botërorë të Hanxharit (dy të tjerët janë Prusti dhe Xhojsi), thotë se njerëzimi nëpërmjet naivitetit fëmijëror, në zanafillën e tij, shpreh thelbin e vet (f. 79).

Në hyrje të librit *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, hasim edhe këtë paragraf: “*Jetova me mrekullinë e jetës, me bukurinë e saj e çudinë e saj të pafund, në gjithësinë plot gëzim e mister*”.

Poezia e Mihal Hanxharit është poezi për bukurinë dhe fshehtësitë e jetës; përsiatje për pozitën e njeriut në hapësirë dhe në shoqëri. Poet me prirje të theksuar meditative dhe me një diapazon të gjerë kulturor, që ishte shoqëruar në vazhdimësi me korifentët e poezisë shqipe (Naimi, De Rada, Fishta, Noli, Lasgushi) dhe botërore (nga Mikelanxhelo, Bodleri, Vërleni, Nervali, Remboja, Malarmeja e gjer tek Elyari e Meterlinku) dhe kryeveprat e tyre, Hanxhari do të hulumtojë në vargje fshehtësitë e natyrës dhe të shpirtit njerëzor, duke e parë këtë të fundit në dy plane kryesore: në raport me botën që e rrethon dhe me shoqërinë që i takon. Ai është nga ai soj poetësh që gjejnë jetë edhe te një kokërr rëre dhe është i gatshëm të dialogojë me të, duke parë atë si pjesë të universit:

*O rërë
Me një diell brenda çdo kokërrize
Me një stinë brenda çdo thërrmie*

Ti rërë muzikë e fshehur që kumbon brenda çdo grimce

¹⁷ *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, f. 141-142.

*Rërë me pikëllimin e çdo ylli në gjirin tënd
Me pasqyrën e thërrmuar të hënës në më të vjetrin mot*

*Rërë rërë jetë e tërë*¹⁸

Kur e lexojmë dhe rilexojmë poezinë e Mihal Hanxharit dhe veçanërisht vjershat dhe poemat e tij më të realizuara, që shquhen me thellësinë e ndjenjës dhe mendimit, por edhe me bukurinë e shprehjes dhe konkretësinë e imazhit poetik, na kujtohen fjalët e Marc Chagall-it, i cili thoshte: “*Kur mbaroj një pikturë, e mbaj pranë disa objekteve natyrale - një guri, një luleje, një dege peme apo dorës sime - si një lloj prove përfundimtare. Nëse piktura rri mirë pranë një objekti që nuk është bërë nga njeriu, atëherë piktura është autentike. Nëse nuk shkon diçka, arti s’është i arrirë*”.

Poezi si: *Dëgjoj një zog* (një alkimi tinguish dhe ngjyrash; i afrohet principit bodlerian të sinestezisë, i quajtur ndryshe edhe “audition colorisé”), *Buzë detit nëpër rërë, Ika i vetëm, Dhe ti, Fije fije, Askush s’troket, Saint Merry, Mais où sont le neiges d’antan, Zemrën marr në duar*, poemat lirike *Aldebaran* e *Menhir* dhe shumë krijime të tjera të këtij poeti, i qëndrojnë denjësisht “provës” së Shagallit për të qenë të gjalla e autentike si një degë peme, si një gur apo një lule e gjallë, jo artificiale.

Është e vështirë, në mos edhe e pamundur, që poezia e Mihal Hanxharit të përcaktohet nga pikëpamja e përkatësisë së saj ndonjë rryme letrare a metode krijuese. Citatat, referencat dhe elementet e tjera ndërtekstore e afrojnë atë me gjedhen post-moderne. Shmangia e shenjave të pikësimit, që ai i përmbahet në mënyrë strikte në poezi dhe, pjesërisht, edhe në prozë, ku përdor vetëm presjen, t’i kujton poetët avangardë evropianë të viteve ’20-’30 të shekullit XX, por ndryshe nga krijimtaria e futuristëve dhe surrealistëve, poezia e Hanxharit nuk është radikale as në formë as në përmbajtje. Poezia e tij nuk ka shumë risi formale e as eksperimente gjuhësore (përpos depunktuimit), siç ndodh në poezinë bashkëkohore në botë dhe, pjesërisht edhe tek ne, posaçërisht pas viteve nëntëdhjetë (në Kosovë edhe më parë). Në planin përmbajtësor dhe konceptual, madje, ajo afrohet më shumë me traditën romantike dhe sidomos atë pasromantike (simboliste në radhë të parë), me vetë faktin që temat më të preferuara të saj janë: tema e dashurisë, e natyrës, e vetmisë, e vdekjes dhe e vetë artit, poezisë.

E shkruar në vetmi, larg vorbullës së modës dhe shijeve letrare të kohës, por edhe larg vlerësimit të kritikës dhe lexuesve, poezia e Hanxharit i ik skemës së përkufizimeve teorike dhe historiko-letrare, të cilat, siç dihet, kur më shumë e kur

¹⁸ *Ti vdekja ime mbushur me jetë, f. 37.*

më pak, e dhunojnë natyrën specifike të veprës letrare dhe të procesit letrar në përgjithësi.

Mihal Hanxhari është poet që “e pa botën me sytë e tij”; me sytë e një njeriu që synon të depërtojë në thellësi të gjërave e jo të mbetet në sipërfaqe të tyre (e ç’është tjetër arti, pos mënyrë të pari?) dhe që, falë këtij “shikimi” të thellë, sa transparent, aq edhe mistik, që ka ruajtur diçka nga shikimi i pafajshëm dhe naiv fëmijëror, arriti të krijojë një vepër jashtë skemave të kohës, një vepër origjinale e me vlerë, që tërhoqi, si rrallë ndonjë tjetër në letrat shqipe, menjëherë pas shfaqjes në publik, vëmendjen e lexuesve dhe të kritikës sonë letrare.

Mehdi POLISI

SAMI FRASHËRI NË FUSHËN E GJUHËSISË

1. Ndonëse ka kaluar një kohë bukur e gjatë, afër 110 vjet, prej se Sami Frashëri është ndarë nga kjo jetë, megjithatë, emri i tij, falë punës së tij vëllimore, të shumanshme dhe, pa dyshim, cilësore, vazhdon të jetë në kujtesë të secilit njeri që sadopak është i lidhur me botën e letrave. Për Sami Frashërin dhe veprën e tij janë bërë shumë studime, si nga studiues vendës, shqiptarë, ashtu dhe nga studiues të huaj.¹ Secili prej tyre ka shkruar në mënyrën e vet, e ajo që është e rëndësishme të thuhet këtu është fakti se të gjithë studiuesit e veprës së Sami Frashërit takohen domosdo në një pikë, të thonë se Sami Frashëri është dijetar i madh, dijetar i kalibrit ndërkombëtar. Dhe, sigurisht, nuk gabojnë sepse këtë cilësim dhe këtë nder, Samiu e meriton. Sa është vepra e Samiut vëllimore, e shumanshme, e thellë dhe cilësore, këtë më së miri mund ta dëshmojnë ata që janë të rrethuar me të, e shumë më mirë ata që janë të detyruar ta shfrytëzojnë atë: albanologë, orientalistë, turkologë, leksikografë, gjuhëtarë, filologë, gramaticientë, letrarë, historianë, gjeografë etj. Mund të them prandaj me ndërgjegjeje profesionale e shkencore se, gati se nuk ka fushë të dijes ku emri i Sami Frashërit nuk është pikë reference. Me këtë rast do të përpiqemi të trajtojmë disa mendime e pikëpamje të Samiut nga fusha e gjuhësisë, fushë kjo në të cilën ai dha kontributin e tij më të çmuar shkencor. Por, para së gjithash e ndiej të nevojshme të jap një pasqyrë të shkurtër për përgatitjen e tij si gjuhëtar, sepse kjo përgatitje do ta përcjellë Samiun gjatë tërë punës dhe veprimtarisë së tij gjuhësore.

¹ Sami Frashëri, Vepra 00 – 20, Logos-A, Shkup, 2004. Kjo është vepra më e plotë deri më tash e Sami Frashërit në gjuhën shqipe. Vëllimin 00 është *Bibliografia e veprave të Samiut dhe kumtesa*, kurse nga numri 1- 20 janë veprat e tij (po i shënojmë vetëm titujt sipas radhitjes): *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhet?*; *Personalitetet shqiptare në Kamus al-Alam*; *Viset shqiptare në Kamus al-Alam*; *Abetare e gjuhësë shqip*; *Shkronjëto e gjuhësë shqip*; *Dheshkronjë*; *Gjuha*; *Besa*; *Dashuria e Talatit me Fitnetin*; *Fjalë të urta*; *Anekdota*; *Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit*; *Qytetërimi Islam*; *Zëdhënësi i Lindjes*; *Gratë*; *Qielli*; *Toka*; *Njeriu*; *Përsëri njeriu*; *Mitologjitë*. Sami Frashëri, Vepra 8, *Bibliografia e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*, Rilindja, Prishtinë, 1984; Hikmet Turhan, *emsettin Sami, Hayati ve Eserleri*, Istanbul, 1934; A.S. Levend, *emsettin Sami*, Ankara, 1969; Hasan kareshi, *Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke*, në: Gjurmime albanologjike, nr. 1, Prishtinë, 1968; Mehdi Polisi, *Sami Frashëri – njeriu që shkeli në shumë fusha të dijes*, Filologji, nr. 14, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006 etj.

Sami Frashëri, siç dihet, lindi në Frashër më 1850. Mësimet e para i mori në vendlindje. Që në moshën fëmijërore i vdiqën pridërit. Prandaj, për familjen shumanëtarëshe² u përkujdes vëllai më i madh, Abdyl. Meqë Abdyl nuk shihte ndonjë të ardhme në Frashër për t'u mundësuar shkollimin vëllezërve të tij më të vegjël dhe për të krijuar kushte më të mira, vendosi ta shpërngulte familjen në Janinë.³ Këtu në Janinë, Samiu, bashkë me të vëllanë Naimin, u regjistruan në gjimnazin e njohur *Zosimea*, të cilin e mbaroi para kohe, për 7 vjetë, në vend për 8 sa ishte paraparë, gjë që tregon talentin dhe aftësitë intelektuale të tij. Samiu këtu kishte marrë njohuri për greqishten e vjetër dhe të renë, latinishten, frëngjishten, italishten si dhe për historinë, historinë e natyrës, gjeografinë, matematikën, filozofinë etj. Samiu edhe këtu, ashtu si në Frashër, do të vazhdojë të mësojë në mënyrë sistematike nga myderrizët më në zë, edhe turqishten, arabishten dhe persishten dhe kështu ai u pajis me njohuri të thella për gjuhët e Lindjes, nga njëra anë, dhe të Perëndimit nga ana tjetër. Samiu, pas mbarimit të gjimnazit, më 1871, në moshën 21 vjeçare, u shpërngul edhe nga Janina për t'u vendosur përgjithmonë në Stamboll, atëherë kryeqendër e Perandorisë Osmane.

Njohja e thellë e gjithë atyre gjuhëve, të Lindjes e të Perëndimit, siç do të vërehet në vazhdim të këtij punimi, mësimi sistematik i fushave të ndryshme të dijes, guximi shkencor e intelektual, i ndihmuan Sami Frashërit, këtij gjeniu, të shtrihet e të shkelë në shumë disiplina kulturore e shkencore, duke filluar nga viti 1872, kur del për herë të parë me shkrime në opinion, e deri kur ndërroi jetë, më 18 Qershor 1904.

E kam thënë edhe më parë dhe detyrohem ta them përsëri, se S. Frashëri ka shkruar mbi 65 vepra, disa me më shumë vëllime, ose shprehur ndryshe, mbi 20 mijë faqe, pa llogaritur veprat e tij në dorëshkrim dhe artikujt e shumtë nëpër gazeta e revista të kohës, me tema shkencore nga më të ndryshmet dhe në shumë gjuhë: shqip, turqisht, arabisht, frëngjisht, greqisht, persisht etj. për një periudhë 32-33 vjeçare. Është kjo, pa diskutim, punë e madhe, punë që kërkon energji, punë që vetëm mendja e ndritur e S. Frashërit ka mund ta bëjë.⁴

Duke u mbështetur në veprën origjinale të Samiut, kam vënë re në të dy gjëra kryesore: 1. Se të gjitha veprat dhe punimet e tij, edhe pse janë shkruar para një shekulli, janë punuar e shkruar në atë mënyrë që janë, thuajse, në përputhje të plotë me kriteret e sotme shkencore: kanë qëllimin, hyrjen, brendinë dhe përfundimin dhe,

² Sipas A.S. Levendit, *emsetin Sami, Ankara, 1969, f. 45* ishin gjashtë vëllezër: Abdyl, Sherifi, Naimi, Samiu, Tahsini e Mehmeti dhe dy motra: Nefisja dhe Shahinisja.

³ Më gjerësisht shih: Sami Frashëri, *Personalitetet shqiptare në Kamus al-a'lam*, zëri Abdyl Frashëri, Logos-A, Shkup, 2004, bot. i tretë dhe mban numrin serik 03 të këtij botimi (Zgjedhje, përktheu dhe shpjegoi Mehdi Polisi)

⁴ Shih: *Vepra 8, Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit* (përgatitur nga Z. H. Bakiu), Rilindja, Prishtinë, 1984

sado e vogël të jetë vepra, megjithatë, të bënë të besosh se tema është shtjelluar në tërësi. Kjo do të thotë se Samiu ka zotëruar shumë mirë teknikën dhe metodologjinë e punës shkencore, dhe 2. Temat që trajton Samiu nuk janë zgjedhur pa ndonjë arsye, domethënë se ato kanë një pikësynim, gjë që tregon se Samiu ka ndjekur në vazhdimësi dhe me kujdes zhvillimet e shoqërisë përgjithësisht. Edhe shtrirja e Samiut në gjuhësi ka një domethënie, edhe politike, edhe shkencore. Ai, kur dëshiron ta vërë në dukje rëndësinë e gjuhës për ruajtjen e kombit, shkruan: “Kombet ndahen në gjuhët, një komb që humbet gjuhën e vet është i humbur e i harruar që me të humburit të gjuhës së tij është i humbur edhe ai vetë. Njeriu nuk humbet por me të ndërruar gjuhën ndërron edhe kombin dhe bëhet i një kombi tjetër. Kështu janë humbur shumë kombe të vjetër që i shohim nëpër historirat e s’i gjejmë sot mbi dhe”.⁵

Veprimtaria e Samiut, siç u tha dhe më lart, është shumëdimensionale, por, megjithatë, duhet pranuar se gjuhët dhe gjuhësia qenë bërë pjesë të pandashme të jetës së tij. Ato e ndiqnin atë në çdo hap. Pikëpamjet e tij për gjuhën në përgjithësi, si dukuri shoqërore me rëndësi dhe për shumë gjuhë veç e veç (për shqipen, turqishten, arabishten, persishten, frëngjishten, latinishten, greqishten etj.), Samiu i kishte shprehur qysh në fillim të veprimtarisë së tij në gazeta e revista të kohës,⁶ në parathëniet e fjalorëve të tij të mirënjohur,⁷ sidomos në parathënien e fjalorit normativ të gjuhës turke, *Kamus-i Turki*⁸, në enciklopedinë e tij 6 vëllimore, *Kamus al-’lam*⁹, në polemika e debate që ka zhvilluar ai për probleme të ndryshme gjuhësore¹⁰ etj. Problemeve të gjuhës e të gjuhësisë, Samiu u ka kushtuar një vend të gjerë edhe në revistën *Hafta* (Java).¹¹ Në këtë revistë shkruan një artikull të gjatë,

⁵ Sami Frashëri, *Gjuha shqip*, në: *Alfabetare*, Konstandinopojë, 1879, f. 27.

⁶ A. S. Levend, *vep. e cit.*, f. 106-112.

⁷ *Kamus-i Fransevi: Fransızcadan Türkçeye lugat* (Fjalori Turqisht – frëngjisht), Istanbul, 1299h./1883; është ribotuar edhe tri herë, gjithnjë i plotësuar: 1889, 1902, 1905; *Kamus-i Fransevi: Türkçeden Fransızcaya lugat* (Fjalori Turqisht – frëngjisht), Istanbul, 1885; *Kamus-i Arabi: Arapçadan Türkçeye lugat* (Fjalori Arabisht – turqisht), Istanbul, 1898 etj.

⁸ *Kamus-i Türki*, Istanbul, 1317h./1900.

⁹ *Kamus al-’lam, I – VI*, Istanbul, 1889 – 1898. Shih më gjerësisht: Mehdi Polisi, *Kamus al-’lami i Sami Frashërit vepër me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën , Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 23/1, Prishtinë, 2004, f. 51 -62.

¹⁰ A.S.Levend, *vep. e cit.* f. 127 – 142.

¹¹ Revista “Hafta” ka qenë revistë javore: letrare, shkencore dhe artizanale. Është botuar në osmanisht më 1298h./1881 në Stamboll. Kanë dalë 20 numra; çdo numër përbëhet nga 16 faqe, pra gjithsej 320 faqe. Përmban tema të llojllojshme: gjuhësore, letrare, shkencore, edukative, kulturore etj. Ajo që është e rëndësishme të thuhet është fakti se të gjithë artikujt e botuar në këtë revistë janë shkruar nga shkencëtari, enciklopedistidhe poliglotti ynë, Sami Frashëri. Kjo flet vetvetiu për seriozitetin e revistës.

në 6 vazhdime¹², për prejardhjen, klasifikimin gjenealogjik të gjuhëve në familje, grupe e nëngrupe, për marrëdhëniet në mes tyre etj. Edhe studimi “Historia e shkrimeve” botuar këtu (nr.12, f.181-186) është me mjaft interes. Në revistën “Hafta” ka edhe artikuj të tjerë për gjuhën. Por, megjithatë, për probleme të përgjithshme, teorike të gjuhës, në mënyrë më të hollësishme, Samiu është shprehur në librin **Lisan (Gjuha)**¹³, i cili u botua në kuadër të serisë “Biblioteka e xhepit.” Në serinë “Biblioteka e xhepit” janë botuar 32 vepra, 15 prej tyre janë të Samiut. Edhe vepra e fundit e kësaj serie është e Samiut: **Usul-i Tenkit ve Tertip** (Shenjat e pikësimit dhe radhitjes),¹⁴ po ashtu një vepër që trajton probleme gjuhësore. Duke u mbështetur në përmbajtjen e veprës **Lisan**, në aftësitë gjuhësore të autorit të saj, Sami Frashërit, si dhe me synim që kjo vepër e rëndësishme gjuhësore të bëhet pronë edhe e lexuesit shqiptar, në vitin 2001 e përktheva në gjuhën shqipe nga osmanishtja.¹⁵

Vlen të thuhet se Sami Frashëri ka qenë pionier në shumë fusha të diturisë. Ai ka qenë i pari që ka shkruar edhe për probleme të ndryshme gjuhësore, filologjike në Perandorinë Osmane. “Kjo shkencë (gjuhësia) te ne ende është e panjohur. Përveç disa artikujve sipërfaqësorë dhe të shkurtër që i kam shkruar para disa vitesh në gjuhën turke-osmane në revistën Hafta (Java), lidhur me këtë çështje nuk është shkruar asgjë më tepër, prandaj, është e qartë që edhe emri i saj të mos njihet sa duhet”¹⁶ – shkruan Samiu në librin e tij “Gjuha”. Mendoj se të hysh në një fushë të pashkelur, sidomos në një fushë komplekse, siç është gjuhësia, duke trajtuar tema të ndryshme teorike e praktike të saj, duhet pasur në radhë të parë dy cilësi: Guximin intelektual dhe njohuri të thella gjuhësore. Samiu, pa dyshim, i kishte të dyja këto cilësi. I pajisur me një kulturë të gjerë gjuhësore e filologjike, siç u vu në dukje më lart, Samiu kishte mundësi të ndiqte arritjet e gjuhësisë në Evropë dhe më gjerë, pikërisht në kohën kur ajo nisi të përparonte me shpejtësi, në gjysmën e shekullit 19.

Pikëpamjet e tij për gjuhën, si dukuri shoqërore dhe si një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut, si mjete kryesor që bën dallimin midis njeriut dhe gjallesave të tjera, për rëndësinë e njohjes dhe studimit të gjuhëve të lashta e të reja, për dallimin midis zërit të artikuluar dhe tingullit (britmës), për dallimin e gjuhëve për

¹² Hafta, Lisanların insab ve taksimati nr. 1, f. 11-14; nr. 2, f. 29-31; nr. 4, 60-62; nr. 5, f. 76-78; nr. 109-110; nr. 8, 122-126.

¹³ Sami Frashëri, *Lisan*, Istanbul, 1303h./1886. Është shkruar në osmanisht dhe shtrihet në 128 faqe të formatit 10/15 cm.; mban shënimin vëllimi 1 dhe numrin rendor 27.

¹⁴ Sami Frashëri, *Usul-i Tenkit ve Tertip*, Istanbul, 1303h./1886. Është shkruar në osmanisht dhe shtrihet në 139 faqe të formatit 10/15 cm. Mban numrin 32 të serisë.

¹⁵ Sami Frashëri, *Vepra 11, Gjuha*, Prishtinë, 2001 (përktheu Mehdi Polisi); bot. i dytë: Sami Frashëri, *Gjuha*, Logos-A, Shkup, 2002; bot. i tretë, Sami Frashëri, *Gjuha*, Logos-A, Shkup, 2004. Ky botim mban numrin 07 të serisë. *Referencat e përdorura në këtë punim do t'i japim sipas këtij botimi të fundit.*

¹⁶ Sami Frashëri, *Vepra 07, Gjuha*, bot. i tretë, Logos-A, Shkup, 2004, f. 24.

sa i përket numrit të tingujve, për lidhjen e gjuhës me mendimin, për përcaktimin e emrave dhe shfaqjen e fjalëve, për lidhjet e gjuhësise me gjeologjinë, antropologjinë dhe historinë, për shfaqjen dhe zanafillën e gjuhës, për ndarjen e gjuhëve nga aspekti tipologjik (në gjuhë monosilabike, aglutinative dhe flektive), për klasifikimin e gjuhëve nga aspekti gjenealogjik: gjuhë ariane, gjuhë semite e hamite dhe gjuhë turanike, për grupimin, degëzimin dhe afritë e gjuhëve, duke marrë shembuj përkatës edhe nga gjuha shqipe, si dhe shumë e shumë çështje të tjera kanë zënë vend në veprën e tij gjuhësore “Gjuha”. Në këtë vepër Samiu, siç shihet, ka prekur shumë probleme që kanë qenë objekt diskutimi në kohën e tij. Për shumë probleme të ndieshme gjuhësore Samiu nuk është pajtuar me të tjerët. Ai është përpjekur që për probleme të tilla të japë dhe mendimet e tij origjinale, duke u shprehur në mënyrë të qartë se “... askush nuk do të flasë kundër ndërgjegjes së vet, edhe unë , thotë Samiu, nuk do të heq dorë e të mos shpjegoj veçanërisht mendimin tim...”.¹⁷ Duhet thënë se mendimet e tij në të shumtën e rasteve kanë qenë më të përparuara se ato të bashkëkohësve të tij në Perandorinë Osmane. Mendimet e tij për gjuhën, si mjet komunikimi dhe për gjuhësinë si shkencë, me ndonjë korrigjim të vogël, edhe pas njëqind e sa vitesh vazhdojnë të mbesin vlera dhe si të tilla prandaj i kanë rezistuar e qëndruar kohës dhe kanë bërë që të tërheqin vëmendjen e studiuesve. Tani do të përpiqemi t’i elaborojmë disa çështje të ndieshme gjuhësore të Sami Frashërit të përfaqësuara në veprën “Gjuha”, duke ia lënë fjalën kryesisht atij.

2. Sami Frashëri, pranon me të drejtë se gjuha është një dukuri shoqërore, se gjuha lind bashkë me shoqërinë, zhvillohet dhe përsoset paralel me zhvillimin dhe përsosjen e saj, se “Gjuha është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut; vetëm njeriu është zotëruar i gjuhës; gjuha shërben për komunikim”.¹⁸ Këtu Samiu, pasi shpjegon se edhe kafshët mund të shprehin qëllimin e tyre, varësisht nga shkalla e nevojës, nga aftësia e komunikimit, varësisht nga zhvillimi i organeve të tyre, pastaj, pasi shpjegon se edhe shpezët mund të nxjerrin tinguj të ndryshëm, për shembull, papagalli, ai do të thotë në mënyrë të prerë se, “megjithatë, ai që me të vërtetë flet, është vetëm njeriu, dhe se gjuha është veçori vetëm e racës njerëzore”.¹⁹

Për të përforcuar mendimin e tij se gjuha është vërtet pronë e shoqërisë njerëzore, Samiu sjell prova të ndryshme. “Historia e natyrës, thotë Samiu, e vendos njeriun në mesin e shumë kafshëve. Edhe anatomia krahasimtare e afron njeriun me disa kafshë ose ato kafshë i afron me njeriun. Megjithatë, vazhdon Samiu, gjuha është mjeti që i vë në pikëpyetje të gjitha këto afrime dhe pikërisht gjuha vendos një mur të madh ndërmjet njeriut dhe kafshëve”.²⁰ Për Samiun është fare e qartë se, sado

¹⁷ Po aty, f. 69.

¹⁸ Po aty, f. 13.

¹⁹ Po aty, f. 13.

²⁰ Po aty, f. 13.

primitivë e të prapambetur të jenë njerëzit, nuk mund të gjendet farë e racës njerëzore që nuk ka aftësi të flasë dhe, sado të zgjuara të jenë kafshët dhe shpezët, nuk ekzistojnë lloje të tyre, që mund të flasin një gjuhë e cila me të drejtë do të quhej gjuhë. Në fakt, sipas Samiut, nocioni gjuhë është më i gjerë, domethënë, gjuhë është jo vetëm ajo që e flasim me gojë, por edhe ajo që e shfaqim me shenja grafike, me shkrim.

3. Në veprën e tij “Gjuha” Sami Frashëri vend të meritueshëm u ka dhënë çështjeve që lidhen me shkencën e gjuhësisë. Këtu ai sqaron një varg problemesh. Interesimi i popujve të lashtë për gjuhën e njëri-tjetrit; mendimet e dijetarëve të vjetër e të rinj për gjuhën; fillet e interesimit të dijetarëve për gjuhësinë dhe zhvillimi e përparimi i saj; roli dhe ndihmesa e gjuhësisë për shkencat e tjera; gjuhësia në Perandorinë Osmane etj., janë çështje që ka ngritur Samiu në veprën e tij.

Edhe nga historia është i njohur fakti se në kohët e lashta nuk ka pasur bashkësi dhe marrëdhënie të ngushta mes popujve. Secili popull e ka konsideruar veten të privilegjuar. Kështu, për shembull, izraelitët e kanë parë veten si popullin e zgjedhur dhe të dashur nga Zotit, kurse të tjerët i shihnin si pabesimtarë dhe të mallkuar; grekët, të cilët ishin më të qytetëruarit e popujve të lashtë, të gjithë të tjerët, jogrekë i quanin barbarë; kinezët emrin njeri e kishin kufizuar vetëm për vete, kurse të tjerët i kanë quajtur të egër, ujq etj.²¹

Një popull që ka mendim dhe vlerësim të këtillë për fqinjët e vet e humb interesimin për të mësuar gjuhën e tyre, e sidomos, duke i menduar ata madje të ndryshëm nga prejardhja e tyre, a mund të paramendohet e të shpresohet se do të përpiqeshin për të hulumtuar dhe për të mësuar gjuhën e tyre, lidhjet dhe ngjashmëritë mes tyre? – pyet Samiu. Historianët e vjetër grekë, shkruan ai, sado që bënin fjalë për fiset dhe popujt më të njohur të kohës së tyre, nuk jepnin asnjë njohuri për gjuhët e tyre. Edhe ata që kishin udhëtuar nëpër Azi dhe Egjipt, si për shembull, Herodoti dhe Platoni, vazhdon Samiu, nuk kanë lënë të dhëna për gjuhët e vendeve ku kishin shëtitur.²² Për gjuhëtarin tonë, Sami Frashëri, ishte e qartë se ai që nuk mëson një gjuhë të huaj, edhe rregullat e imtësitë e gjuhës së vet nuk do të mund t’i dallojë lehtë. Sipas tij, ishin popujt e tjerë që, duke qenë të detyruar të mësonin gjuhën e popujve pushtues, u interesuan për rregullat e gjuhëve. “Pas rënies së qytetërimit të lashtë grek, rregullat e gjuhës greke janë regjistruar në Aleksandri nga ana e maqedonasve të lashtë, kurse rregullat e gjuhës arabe i kanë regjistruar nga asirianët dhe iranianët”²³, shprehet Samiu. Fillet e interesimit të dijetarëve për gjuhën, siç mund të vërehet, Samiu i lidh me këto zhvillime. Samiu pohon se në Perëndim mësoheshin greqishtja dhe latinishtja që nga koha e romakëve, kurse në

²¹ Po aty, f. 17.

²² Po aty, f. 17.

²³ Po aty, f. 18.

Lindje mësoheshin arabishtja, persishtja dhe turqishtja. Pas një përparimi të rregullave të këtyre gjuhëve, sidomos pasi dijetarët vërejtën fjalë të ngjashme e të përafërta në mes gjuhëve, zuri fill edhe interesimi i tyre për prejardhjen e këtyre fjalëve. Në këtë mënyrë, thotë Samiu, filloi të shfaqet etimologjia, degë e gjuhësisë që ndriçon lidhjet dhe marrëdhëniet si në mes vetë fjalëve të një gjuhe, ashtu dhe lidhjet e përbashkëta në mes gjuhëve të ndryshme. Etimologjia në atë kohë, sipas Samiut, që në nivelin sa “ende nuk mund të jepte asnjë mendim dhe asnjë dëshmi të qartë”.²⁴ Për lidhjet dhe marrëdhëniet në mes gjuhëve nuk ishte shfaqur ndonjë mendim i drejtë, pohon Samiu. “Në Evropë, vazhdon ai, për shkak të besimit fetar, besohej se të gjitha gjuhët kishin prejardhje të përbashkët nga hebraishtja, por po të shihet me sy kritik thelbi i këtyre mendimeve dhe i kësaj gjuhe, gjykon Samiu, del se ata janë munduar kot të gjejnë lidhje dhe marrëdhënie në mes gjuhëve evropiane dhe hebraishtes.”²⁵ Pra, duke u mbështetur në shpjegimet e dhëna më lart, kemi të drejtë të besojmë në pikëpamjet e Samiut se: “Mënyra e ndarjes së gjuhëve në lloje e në grupe, në nëngrupe e në degë; mënyra e klasifikimit të gjuhëve të popujve dhe kombeve, si dhe njohuritë dhe përfundimet e drejta shkencore për lindjen e gjuhës dhe për mënyrën e formimit të saj, janë zbulime të kohës së re. Këto fusha, vazhdon Samiu, përbëjnë një shkencë të veçantë (gjuhësinë) që nga gjysma e këtij shekulli (gjysma e shek. 19 – M.P.)”.²⁶

4. Sami Frashëri vë në pah rëndësinë e madhe që ka gjuhësia²⁷ jo vetëm si shkencë që merret me çështjet gjuhësore, por edhe si një shkencë që ka lidhje të ngushtë me historinë. Ai vë në dukje edhe lidhjet e saj me gjeologjinë dhe antropologjinë. Duke folur për rëndësinë që kanë për historinë antropologjia dhe gjuhësia, të cilat sipas tij mbështeten në gjeologjinë, Sami Frashëri shkruan: “Antropologjia dhe gjuhësia, që janë krijuar pas gjeologjisë, kanë hapur një faqe të re në historinë e njerëzimit. Kjo shkencë e re, duke shembur godinën e vjetër të historisë, i ka vënë themelin një godine të re, të mbështetur në fakte dhe në argumente. Tashmë historia e njerëzimit nuk përbëhet nga disa përralla të mbinatyrshme të sajuara nga rrëfime të prapambetura, as nga disa pushtues të dyshimtë të botës, e as nga ngjarjet e trilluara të disa heronjve të pavërtetë. Është e domosdoshme të bëhet fjalë për historinë e njerëzimit, për qenien dhe racën e njeriut në përgjithësi

²⁴ Po aty, f. 19.

²⁵ Po aty, f. 18.

²⁶ Po aty, f. 19.

²⁷ Në gjuhët evropiane emërtohet *Linguistikë*. Edhe pse kishte pasur mendime të ndryshme sa i përket emërtimit, meqë ky term është i thjeshtë, i qartë dhe i përshtatshëm, thotë Samiu, fitoi ndaj të tjerëve dhe gjeti shtrirje më të madhe. Në osmanishte Samiu e emërtoi *Ilmu-l-lisan* (Shkenca mbi gjuhën). Këtë shpjegim Samiu e kishte dhënë në veprën e tij *Yine Insan*, nr. 26, Istanbul... (Në gjuhën shqipe e përktheu Mehdi Polisi, Sami Frashëri, *Përsëri njeriu*, nr. 19, Logos-A, Shkup, 2004.

dhe për gjendjen e natyrshme e për sjelljet e përgjithshme të kombeve dhe të popujve në veçanti. Dhe kjo ka të bëjë me antropologjinë e gjuhësinë, që kanë ndjekur metodat e gjeologjisë. Këto shkencë shënuan përparime shumë të mëdha për një kohë shumë të shkurtër”²⁸, shkruan Samiu, për të thënë më poshtë se “Arritjet e tyre të mëtejme do të nxjerrin në shesh shumë të vërteta dhe do të shërbejnë për të zbuluar fshehtësitë e natyrës dhe të krijimit të saj”.²⁹

Gjuhësia, si shkencë e re dhe si shkencë që hodhi hapa gjigantë dhe të pandërprerë që kur zuri të shfaqet, thotë Samiu, duke hyrë në mesin e shkencave më të rëndësishme, tërheq vëmendjen e dijetarëve në tërë Evropën dhe sidomos në Gjermani, në Angli dhe në Francë, ku kanë dalë dijetarë që merren rregullisht vetëm me këtë shkencë.³⁰ Sipas Samiut, “ajo që i shërbeu më së shumti përparimit të shkencës së gjuhësisë, është dëshira për të mësuar më shumë gjuhët që fliten anekënd rruzullit tokësor”.³¹ Kjo bëri që në Evropë, përveç greqishtes dhe latinishtes dhe bijave të tyre, evropianët të interesohen, thotë Samiu, edhe për mësimin e hebraishtes, asirishtes, arabishtes, indishtes dhe kinishtes (kinezishtes), të njohura me emrin “Gjuhë të Lindjes”. Kështu, gjuhëtarët evropianë, duke i krahasuar gjuhët që i dinin dhe, duke i shënuar e duke i regjistruar lidhjet e marrëdhëniet midis tyre, ata themeluan **gjuhësinë**.

Si gjuhëtar e filolog, Samiu shfaqti interesim të veçantë për gjuhët e lashta. Duke bërë fjalë për detyrën e gjuhësisë në studimin e gjuhëve të lashta, ai shkruan: “Zbulimi i gjuhës së lashtë indiane, që quhet **Sanskrite** dhe i gjuhës së vjetër iraniane, që i thonë **Zend**, thuajse ka hapur një derë të ndritshme për gjuhësinë. Gjurmët e këtyre gjuhëve, të cilat shihen te gjuhët që fliten sot në çdo anë të Evropës, ruajnë dhe paraqesin një pjesë shumë të rëndësishme të peregjistruar të

²⁸ Sami Frashëri, Gjuha, f. 20.

²⁹ Po aty, f. 21.

³⁰ Sami Frashëri ka qenë në dijeni të plotë me të arriturat e gjuhësisë në Evropë. Në enciklopedinë e tij Kamus al-a’lam II, f. 1366 shkruan për biografinë e gjuhëtarit të njohur gjerman të gjuhësisë krahasimtare Frantz Bopp-in: “Ishte nga më të mëdhenjtë e dijetarëve që është marrë me linguistikë, d.m.th. me studimin e thelluar të gjuhëve. Ky është dijetari i cili ka zbuluar gramatikën (metodën) krahasimtare të gjuhëve të ndryshme në mes të të cilave gjenden afërsi dhe marrëdhënie. Ka lindur më 1791 në qytetin Majnsa të Gjermanisë dhe ka vdekur më 1867. Një kohë të gjatë, shkruan Samiu për të, ka qenë mësues i gjuhës sanskrite në Berlin. Është pranuar dhe anëtar akademie në Akademinë Franceze. Ka shkruar disa libra për marrëdhëniet, afërsitë dhe ngjashmëritë në mes indishtes së vjetër e persishtes dhe gjuhëve evropiane. Më e rëndësishmja nga këto vepra është Gramatika krahasimtare e gjuhëve të lartpërmendura, e cila është vepër shumë e respektuar e që përbëhet nga 4 vëllime. Kjo vepër është përkthyer në shumë gjuhë”, shkruan Samiu. Samiu në Kamus al-a’lam shkruan edhe për një numër të konsiderueshëm dijetarësh evropianë (unë i kam nxjerrë rreth 50 zëra të këtyre fushave) që janë marrë jo vetëm me gjuhët e Perëndimit por edhe me ato të Lindjes, nga më të lashtat: sanskritishten, zendishten, pehlevishten, asirishten, haldeishten, indishten, hebraishten, arabishten, sirianishten, kinishten etj.

³¹ Sami Frashëri, Gjuha, f. 22.

historisë njerëzore dhe përfytyrimet e formuara mbi bazën e një mendimi krejtësisht të gabuar për gjuhën hebreje, si gjuhë nënë e gjuhëve të tjera, janë shembur dhe janë zëvendësuar me gurthemelin e gjuhësisë³², shkruan Samiu. Gjithashtu hebraishtja, asirishtja dhe arabishtja bashkë me veprat që i kanë lënë pas vetes disa popuj të lashtë, si: fenikasit, egjiptasit, asirasit, nga njëra anë, së bashku me hulumtimet dhe krahasimet e gjuhëve: turke, mongole, ujqure, jakute, lapone dhe hungareze, nga ana tjetër, të gjitha këto kanë shërbyer mjaft për përparimin dhe përhapjen e gjuhësisë³³, – gjykon Samiu.

5. Ndërsa në Evropë gjuhësia përparonte dita më ditë, duke u hapur shkolla, biblioteka, shtypshkronja, qendra për mësimin dhe studimin e gjuhëve të ndryshme, në Lindje gjuhësisë as që i njihej emri, përveç disa artikujve, siç u tha më lart, që i kishte shkruar vetë Samiu. Dhe kjo e shqetësonte gjuhëtarin tonë, Sami Frashërin. E shqetësonte për faktin se ai, duke u mbështetur në osmanishten, për njohjen e së cilës duhet të mësohen tri gjuhë: turqishtja, arabishtja dhe persishtja, të cilat u takojnë tri grupeve më të mëdha që fliten në rruzullin tokësor: turqishtja gjuhëve turanike, arabishtja gjuhëve semite e hamite dhe persishtja gjuhëve indoveropiane, merr përgjegjësinë të thotë se jemi në gjendje që ta hulumtojmë shkencën e gjuhësisë edhe më mirë se të gjitha kombet dhe popujt e tjerë. Tri gjuhët e përmendura, që janë pjesët përbërëse kryesore të osmanishtes, janë të mjaftueshme për të mësuar edhe për degët e tjera të këtyre tri grupeve të gjuhëve, për të dhënë idenë rreth lidhjeve që ekzistojnë në mes tyre, shkruan Samiu. Arsyet e mosnjohjes dhe mosinteresimit për shkencën e gjuhësisë në Shoqërinë Osmane, Samiu i shihte në mendimet e mbrapshta të njerëzve të caktuar të kësaj shoqërie, të cilët konsideronin se të mësuarit e sankritishtes dhe zendishtes është largim nga rruga e drejtë dhe se të mësuarit e këtyre gjuhëve nuk sjell kurrfarë përfitimesh materiale. Ja pra, “për shkak të ndarjes së mendimit tonë të përgjithshëm në këtë mënyrë të çuditshme, shkruan Samiu, ende nuk kemi të ne një shkollë të posaçme e të ngritur në një shkallë për të mësuar jo vetëm gjuhët, si: sanskrite, asiriane dhe hebreje..., por edhe për gjuhën arabe, që e vlerësojmë më se të nevojshme. Dhe, kështu, një shkencë me emrin gjuhësi, ka mbetur për ne ende e panjohur.”³⁴

6. Pasi shpjegon në vija të trasha disa çështje, si, historikun, rëndësinë, përparimin, detyrat etj. të gjuhësisë, Samiu dalëngadalë futet në thelbin e problemit. Ai, në këtë studim të tijin, së pari trajton çështjen se a ka ndryshim mes njeriut dhe kafshëve të tjera për sa i përket zërit dhe tjetra, që lidhet me këtë, zëri, qoftë te njeriu, qoftë te kafsha, është natyror apo lidhet me të mësuarit, pra i përfutur? Sa i

³² Po aty, f.22.

³³ Po aty, f. 23.

³⁴ Po aty, f. 24-26.

përket çështjes së parë, menjëherë mund të themi se, sipas Samiut, zëri i njeriut dhe shumicës së kafshëve është i njëjtë kur del, pra, zëri nuk është i veçantë vetëm për njeriun, sepse edhe kafshët e tjera janë të afta të shqiptojnë zëra të ndryshëm. Vetëm se “Të folurit e nyjëtuar, thotë Samiu, që ndërtohet prej tingujsh (zërash) të ndryshëm të, është veçori vetëm për gjininë njerëzore”³⁵, domethënë se tingujt a zërat e artikuluar, dallohen nga britma, ushtima dhe ulurima e kafshëve. Duke folur për format dhe mënyrat e ndryshme të zërave, Samiu me të drejtë thotë se zëri është dukuri fiziologjike, që del nga mënyra e zhvillimit dhe funksionimit të organeve anatomike. Meqë formimi dhe zhvillimi i organeve anatomike nuk është i njëjtë te të gjitha kafshët, nuk ka mundësi që çdo lloj kafshe të jetë e aftë të nyjëtojë të gjitha format e tingujve, thotë samiu. Ndërkaq, dallimin në mënyrën e nyjëtitimit të tingujve në mes popujve, Samiu nuk ia ngarkon ndryshimit anatomik (sepse ky dallim nuk ekziston te e njëjta gjini) por këtë e mbështet vetëm në rezultatet e ushtrimit dhe mësimit.³⁶ Sa i përket çështjes së dytë, a është i natyrshëm apo i përfutur zëri? Samiu, në radhë të parë, gjurmon të gjejë dallimin ndërmjet “tingullit” (britmës) dhe “zërit”. Duke e përqëndruar vëmendjen në këtë, Samiu shkruan: “mund të themi se tingulli është natyror, kurse zëri është i përfutur, prandaj, lidhet me të mësuarit dhe të ushtruarit. Tingulli formohet nga shtyrja e ajrit me shumë pak fuqi, kur goja është vetëm e hapur. Ai del në mënyra të ndryshme, varësisht nga ndërtimi i fytit, gojës dhe hundës së kafshës ... kurse zëri përfutet nga trajta e veçantë që merr tingulli (britma) ... Gjendja e njerëzve, që kanë lindur të shurdhër ose që e kanë humbur aftësinë e dëgjimit sa kanë qenë të vegjël, shkruan Samiu në vazhdim, është e mjaftueshme të dëshmojë se tingulli është i natyrshëm dhe zëri është i lidhur ngushtë me të mësuarit. Ata të pafat, që e kemi zakon t’i quajmë memec, thotë Samiu, nuk janë të pagjuhë, por për shkak se kanë qenë të shurdhër, nuk kanë mundur të mësojnë gjuhë. Po të ishte zëri i natyrshëm, këta njerëz do të dinin gjuhë. Për ta argumentuar edhe më tutje çështjen se zëri (i artikuluar) është i përfutur, Samiu merr si shembull fëmijën. “Fëmija nuk ka mundësi të artikulojë tinguj derisa nuk i ka mbushur nëntë a dhjetë muaj, e ndonjëherë, derisa nuk i ka mbushur një vit a një vit e gjysmë dhe, kur fillon të flasë për herë të parë edhe tingujt që nxjerr, janë shumë të mangët, porse për disa vjet ia arrin ia të shqiptojë tinguj të plotë.”³⁷ Lidhur me këtë çështje Samiu sjell shembuj edhe nga bota shtazore.

³⁵ Po aty, f. 26.

³⁶ Po aty, f. 31, 32. Këtu Samiu jep një varg tingujsh që mund t’i shqiptojë një popull, por nuk mund t’i shqiptojë populli tjetër, p. sh. tingujt emfatikë ajn, s, d, t, z, h, që janë karakteristikë vetëm për gjuhën arabe nuk mund t’i nyjëtojë asnjë popull pa i mësuar dhe ushtruar. Po t’i përmendim një nga një, diskutimi do të zgjatej shumë.

³⁷ Po aty, f. 35, 36.

7. Një problem tjetër të cilit Samiu u përpoq t'i japë përgjigje ishte çështja e ndryshimit dhe dallimit mes njeriut e shtazëve të tjera lidhur me kuptimin e shprehjen, pra e lidhjes së gjuhës (të folurit) me kuptimin (mendimin). Sipas tij fjala shoqërohet me kuptimin (pra me mendimin) dhe vetëm në këtë rast ajo bëhet mjet komunikimi midis njerëzve. Duke u përpjekur të argumentojë këtë tezë, Samiu në veprën e vet "Gjuha" shkruan: "Meqenëse të folurit është një cilësi vetëm e gjinisë njerëzore a mund t'i themi folës edhe papagallit? Mjerisht jo, nuk mund t'i themi, përgjigjet Samiu. "Të folurit nuk përbëhet vetëm nga shqiptimi i atyre zërave, e madje, as nga shqiptimi i fjalëve të plota e të përsosura. Të folurit do të thotë, *të shprehësh qëllimin dhe të kuptosh qëllimin, që shprehet me fjalë dhe fjali, të formuara me zëra të artikuluar (nënvizimi i M.P)*. Megjithatë, askush nuk ka parë se ka komunikim mes një njeriu dhe një papagalli ose në mes dy papagajve. Kur papagalli interpreton fjalët e mësuara nga njeriu, këto i bën vetëm sepse imiton dhe jo se i ka kuptuar fjalët. Gjuha pra, nuk është e përbërë vetëm nga shqiptimi i fjalëve nga zëra të ndryshëm. Qëllimi është të shfaqësh një ide nëpërmjet atyre fjalëve dhe të kuptosh idenë e shfaqur nga të tjerët",³⁸ shpjegon Samiu. Pyetjeve: "Kafshët e tjera a nuk mund t'i shprehin ndonjë qëllim njëra-tjetrës ose njeriut dhe, a nuk mund të kuptojnë ndonjë qëllim që synohet t'u shpjegohet atyre? Samiu preferon që këtyre pyetjeve të mos u përgjigjemi me nxitim. "Duke u mbështetur në mundësitë e shqiptimit të disa fjalëve të papagallit me anë të imitimit, do të jetë gabim të besosh në të folurit e kafshëve dhe, duke u mbështetur dhe në faktin se kafshët nuk kanë aftësi e mundësi për të folur si ne, do të jetë po aq e padrejtë të mendosh e të gjykosh se kafshët në asnjë mënyrë dhe asnjëherë nuk kanë aftësi e mundësi për të kuptuar e për të shprehur qëllimin e tyre".³⁹ Megjithatë, "kur shtrohet çështja e krahasimit mes njeriut e kafshëve të tjera, për çfarëdo çështje qoftë, përfundimi është i qartë, - shkruan Samiu – dallimi dhe ndryshimi mes tyre qëndron pikërisht në përsosuri dhe në mangësi; te njeriu nuk ka asnjë veçori e cila është sadopak e përsosur që të mos jetë e mangët te kafshët".⁴⁰ Të kuptuarit dhe të shprehurit janë dy llojesh: i pari, thotë Samiu, shprehet me tundje, lëvizje të kokës, mimikë, me shenja ose me disa veprime të tjera dhe, i dyti shprehet me tingull e me zë. Që të dyja këto mënyra i shohim të pranishme edhe te njerëzit edhe te kafshët, por te kafshët në një masë më të vogël. Për të vërtetuar dy pikat e sipërpërmendura, Samiu zbrit në rrafshin praktik, duke marrë si shembull për pikën e parë komunikimin e bariut me qenin e tij;⁴¹ kurse për pikën e dytë merr si shembull komunikimin e kllonës me zogjtë.⁴²

³⁸ Po aty, f. 38.

³⁹ Po aty, f. 39.

⁴⁰ Po aty, f. 39.

⁴¹ Mjafton një veprim i bariut, thotë Samiu, për ta nxitur qenin e tij të sulmojë me një zemërim të madh dhe, po ashtu, mjafton që me një veprim tjetër ta nxisë të qetësohet dhe ta ndërpresë menjëherë atë sulm dhe atë zemërim". (S. Frashëri, Gjuha, f. 40.)

Këto gjëra mund t'i provojë vetë çdokush për çdo ditë. Pasi i merr këto shembuj, do të thosha mjaft të përshtatshëm, në fund të këtij kapitulli, Samiu do të shprehet shkurt: “Edhe kafshët e kuptojnë dhe e shprehin qëllimin e tyre, si me zë, si me shenja ose me sjellje, lëvizje dhe me veprime të ndryshme. Kjo veçori që është mjaft e mangët te pjesa dërrmuese e kafshëve, te njeriu është shumë e përsosur. Por, padyshim, te njeriu është madje në shkallë të ndryshme. Çdo njeri dhe çdo popull është zotërues i gjuhës varësisht nga nevoja dhe shkalla e zgjuarsisë dhe qytetërimit të tij... Megjithatë, meqë dallimi në mes njeriut më të qytetëruar dhe atij më primitiv, është i pa rëndësishëm në krahasim me dallimin që ekziston në mes njeriut më primitiv dhe kafshës më të zgjuar, mund të themi se vetëm njeriu është ai që flet me atë mënyrë të qartë e të vlefshme, që quhet gjuhë, dhe të gjithë njerëzit janë zotërues të gjuhës”.⁴³

8. Vend të rëndësishëm në veprën e Samiut “Gjuha” zënë dhe çështja që lidhen me shfaqjen e gjuhës; me mënyrën e lindjes së gjuhës; me përcaktimin e emrave dhe shfaqjen e fjalëve si dhe me gjendjen e zanafillës së gjuhës.

Mendimet e të lashtëve se “gjuha është shfaqur menjëherë dhe në formë të përsosur së bashku me njeriun e parë”⁴⁴, ose se “gjuha është më e vjetër se vetë njeriu”⁴⁵ për gjuhëtarin tonë të madh, Sami Frashëri, janë të papranueshme dhe të paqëndrueshme. “Shkenca, thotë Samiu, mbështetet sot me arsyetime dhe me argumente. Ajo ka treguar në mënyrë të qartë se në shfaqjen e parë, njeriu ka qenë në një shkallë të ulët zhvillimi por, me kalimin e kohës, ka përparuar shkallë-shkallë. Prandaj, gjuha, pohon Samiu me plotë të drejtë, lidhet me përparimin mendor të njeriut”.⁴⁶ Linguisti Sami qëndron në pozita të drejta kur shprehet se njeriu në paraqitjen e parë ka pasur shumë të meta dhe ka qenë shumë i prapambetur, megjithatë, ka qenë shumë më i zhvilluar dhe më i zgjuar se të gjitha kafshët e tjera, prandaj nuk mund të mbetet farë dyshimi përse ka shkuar shumë përpara llojeve të tjera. Pasi në vazhdim shkruan për njeriun e periudhës së terciarit dhe kuaternarit, për të metat e mangësitë e tij, për mundësinë e nxjerrjes së pak tingujve të thjeshtë, të cilët dalngadalë kanë marrë vlerën e tingujve dhe pas disa kohësh kanë marrë vlerën e fjalës, Samiu thotë: “Ky përparim i tillë nuk është bërë shumë lehtë. Janë dashur me miliona vjet. Njerëzit kanë jetuar shumë kohë në një gjendje që mund të quhej pa gjuhë dhe, pas kësaj kohe, kanë folur me gjuhë shumë të mangëta, sa nuk

⁴² “Kur i thërret zogjtë për ushqim klluçka përdor tjetër zë, kur nuhat se i kërcënohet ndonjë rrezik dhe kur do t'i thërras nën krahë, zë tjetër, si dhe kur dëshiron që t'i vijnë prapa zë tjetër, e nga ana tjetër, thotë Samiu, zogjtë, nuk gabojnë në asnjë mënyrë për ta çuar urdhrin e saj në vend.(S. Frashëri, Gjuha, f. 41.)

⁴³ S. Frashëri, Gjuha, f.42

⁴⁴ Po aty, f. 43.

⁴⁵ Po aty, f. 43.

⁴⁶ Po aty, f. 44.

do të mund t'i thuhej gjuhë. Gjuha, jo vetëm që nuk ka ekzistuar para daljes së racës njerëzore, por ajo është zhvilluar pas shfaqjes së njeriut ose, thënë më drejt, gjuha është krijuar dhe ka përparuar shkallë-shkallë”.⁴⁷

Pikëpamjet e S. Frashërit lidhur me mënyrën e lindjes së gjuhës janë plotësisht të drejta. Duke e konsideruar çështje me rëndësi gjuhësore dhe që meriton t'i kushtohet kujdes, Samiu shtron këtu një varg pyetjesh. Pasi njeriu është krijuar pa gjuhë, thotë Samiu, si ka mundur të mendojë që çdo gjëje që e rrethonte t'i vinte emër, ta emëronte, pastaj, kush i ka menduar këta emra, kush i ka vënë, shkaku i emërtimit cili është? etj. Mendimin e shumicës së dijetarëve të vjetër se njerëzit e parë janë marrë vesh mes vete që, për shembull, asaj t'i themi ashtu e kësaj kështu, edhe Samiu, ashtu siç kanë vepruar dhe natyralistët, e ka konsideruar të pakuptimtë, pa bazë shkencore, madje qesharak e të çuditshëm.⁴⁸ Samiu pranon se, meqë njerëzit e parë kanë pasur organe anatomike përkatëse të të folurit, kanë qenë të aftë të nyjtojnë çdo zë që kanë dëgjuar, e zëra të tillë në ato kohë nuk kanë mundur të dëgjojnë përveçse prej kafshëve. Njerëzit e lashtë, thotë Samiu, së pari kanë zënë t'i imitojnë kafshët dhe jo vetëm në gjuhë, por edhe në shumë çështje të tjera, kafshët janë bërë mësuesit e parë të njeriut, - thotë Samiu. Do të duket paksa e çuditshme që kafshët e pagjuhë dhe pa aftësi kuptimi të jenë bërë mësues. Kjo nuk është e pamundshme, por përkundrazi, shumë e natyrshme, përgjigjet Samiu, duke shtuar se “sikurse çdo njeri, që ka periudhën e fëmijërisë, edhe bota njerëzore përgjithësisht ka kaluar një periudhë fëmijërore. Ajo është koha e shfaqjes së parë të gjuhës”.⁴⁹ Krahasimi që bën këtu Samiu është plotësisht i arsyeshëm. Dallimi në mes fëmijërisë së secilit njeri dhe fëmijërisë së gjinisë njerëzore në përgjithësi qëndron në faktin se e para zgjat dy-tri vjet, kurse e dyta zgjat shumë kohë.

Sami Frashëri pranon se njeriu ka mësuar së pari të nyjëtonte zëra të ndryshëm nëpërmjet imitimit të kafshëve, por, megjithatë, ai nuk pajtohet se çdo gjë ka lindur nga imitimi i zërit të tyre. Sipas gjuhëtarit tonë, njeriu i asaj periudhe shumë herë ka imituar edhe lëvizjet e veprimet e kafshëve dhe të gjësendeve. Kështu, për shembull, ndërsa qyqes, sorrës dhe shumë shpezëve të tjera u ka vënë emrin sipas zërit të këndimit të tyre, kalin⁵⁰, lopën, peshkun etj., thotë Samiu, i ka imituar sipas zhurmës së vrapimit, lëvizjes së kërcimit të ndonjë objekti ose shushurimës së notimit. Emërtimet a trajtat e ndryshme të fjalëve për një koncept, Samiu i lidh me pamundësinë e imitimit me përpikëri të zërit të kafshëve ose të zhurmës së sendeve. “Rrjedhimisht, te emrat që lidhen me këtë imitim, thotë Samiu, do të shihen kundërthënie nga dy pikëpamje. Së pari, vazhdon ai, emërtimi i çdo

⁴⁷ Po aty, f. 45.

⁴⁸ Po aty, f. 47.

⁴⁹ Po aty, f.48.

⁵⁰ Sipas Samiut emri i kalit në gjuhën sanskrite është esve, në persisht esb. Rrënja është es, që e lidh me këtë foljen turke esmek dhe fjalën shqipe eci (S. Frashëri, vep. e cit. f. 50).

gjëje bëhet në rrugë të ndryshme, ose sipas gjendjes dhe mënyrës që i ka rënë në sy më së pari, ose sipas gjendjes dhe mënyrës që ka arritur ta dëgjojë, ose sipas zërit dhe zhurmës së sendit dhe, së dyti, për shkak të pamundësisë së imitimit me përpikëri të të njëjtit zë ose të së njëjtës zhurmë, përpiket ta paraqesë në mënyra të ndryshme”⁵¹, thotë Samiu. Përcaktimin e emrave ose shfaqjen, lindjen a sajimin e fjalëve të reja në kohë të lashta, Samiu e shihte edhe në imitimin e vetë gjendjeve dhe lëvizjeve të njerëzve, sidomos në britmat dhe thirrjet e tyre. Njeriu, thotë Samiu, lëshonte thirrma, si: a!, ah!, oh!, of!, ha!, hi! kur lodhej, kur hidhërohej, kur gëzohej ose kur ndiente diçka tjetër të brendshme. Thënë shkurt, vazhdon Samiu, “atë që e bën cilido në fëmijërinë e vet, atë e ka bërë edhe gjinia njerëzore në kohën e shfaqjes së parë, në periudhën fëmijërore të saj.”⁵² Lidhur me lindjen e gjuhës Samiu nuk ndalet me kaq. Ai nuk pajtohet me mendimin e atyre dijetarëve që mbajnë qëndrimin se gjuha ka lindur vetëm nga imitimi, e as me mendimin e atyre të cilët nuk e pranojnë fare imitimin. “Meqenëse të dyja këto rrugë e kanë tepruar, mendoj se e vërteta, thotë Samiu, duhet kërkuar në mesin e tyre.”⁵³ Për Samiun janë të pranueshme edhe njëra edhe tjetra tezë. Sipas Samiut, njerëzit, sa herë që kanë dashur ta shprehin diçka në gjendjen fillestare, fillimisht e kanë treguar me shenja e lëvizje të ndryshme të trupit dhe, për ta dhënë më të qartë këtë përshtkrim, përpiqeshin që së bashku me këto veprimeve të riprodhonin a të nxirrnin rastësisht edhe një zë a tingull. Në këtë kuptim, njëri nga njerëzit e parë, thotë Samiu, i cili ka dashur t’i komunikonte shokut të tij lëvizjet a veprimet “vij” dhe “shkoj” ka riprodhuar rastësisht tingullin **g** ose **v**; kur ka dashur të shprehte “afrimin” dhe “ardhjen” ka riprodhuar tingullin **a** ose **e** dhe, kur ka pasur qëllim të shprehte “tërheqjen” dhe “largimin”, ka riprodhuar tingullin **i**. Të gjitha këto, vazhdon Samiu, në krye të herës, sigurisht janë thënë rastësisht, por me kalimin e kohës ato, duke u bashkuar e duke u kombinuar, janë përgjithësuar dhe njerëzit kanë filluar t’i shprehin këto kuptime. Për të dëshmuar vjetërsinë edhe të gjuhës shqipe Samiu në këtë kuadër përmend tingujt **e**, **a**, **i**, të cilët ruajnë kuptimet e sipërpërmendura, p. sh. në shqip **ea-ke** ose **ja-kë** që shpreh kuptimin “vij, ardhje” dhe **i-kë**, që shpreh kuptimin “tërheqje ose largim”. Samiu këtu merr në shqyrtim edhe tingullin **d**, që shpreh kuptimin “jap”, “me dhënë”, që haset te fjalët: persisht **dâden**, në greqisht **dhune**, **dhidho**, në latinisht **dare**, **das**, në shqip **dha**, në arabisht **i’t**, duke u shpreh në vazhdim për afërsinë e vendnyjtimit të shkronjave **d**, **dh**, **t**. Samiu jep edhe shembuj të tjerë të formimit të fjalëve të reja në këtë mënyrë. “Shkurt, thotë Samiu, ashtu siç do të mund t’u themi “*fjalë imituese*” fjalëve që lindin vetëm nga imitimi, edhe këtij grupi të dytë të fjalëve të njohura, edhe pse disa gjuhëtarë u kanë thënë

⁵¹ Po aty, f. 51. Këtu Samiu jep si shembull variantet e ndryshme të lehjes së qenit: *hav*, *av*, *ham* etj. dhe variantet e krismës së armës kur zbrazet: *pam*, *bam*, *bom*, *dank* etj.

⁵² Po aty, f.53.

⁵³ Po aty, f. 53.

“*fjalë për marrëveshje*”, mendoj se do të jetë më e qëlluar nëse quhen “*fjalë rastësie*”⁵⁴, shprehet Samiu.

9. Gjuhëtari ynë, Sami Frashëri, pasi shpjegoi në mënyrë të hollësishme gjendjen e gjuhës në periudhën e parë të shfaqjes së saj, mangësitë dhe vështirësitë e komunikimit të njeriut të parë, zhvillimin e gjuhës shkallë-shkallë, arrin të thotë shkallën e zhvillimit e të begatimit të saj, e si rezultat i kësaj edhe komunikimin e lehtë. “Për të komunikuar, thotë Samiu, sot përdorim lloj-lloj fjalësh, të cilat ndahen në klasa të ndryshme: në emra, përemra, mbiemra, folje, ndajfolje; në forma të njëjësit, të shumësit; në rasa emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, në gjini mashkullore, femërore; në veta; e parë, e dytë, e tretë etj., e kur shtojmë edhe fjalë shërbyese, e kemi të gatshme ligjëratën tonë të plotë e të sistemuar”⁵⁵, - shkruan Samiu.

“Të besosh se gjuha ka qenë kështu e përsosur, që kur është shfaqur për herë të parë, se të parët tanë kur nisën të flisnin me qindra e mijëra vjet më parë i kanë përdorur gjithë fjalët dhe trajtat e tyre, se kanë mundur të flasin fjalë të lidhura dhe të sistemuara në këtë mënyrë, është sikur të përpiqesh të nxjerrësh nga barku i nënës njeri të përgatitur shkencëtar, dijetar, artist”⁵⁶, - thotë Samiu. Sipas enciklopedistit tonë, Sami Frashërit, një tingull që e riprodhonin njerëzit e asaj periudhe qoftë si imitim, qoftë të rastësishëm, ka qenë njëherësh edhe emër, edhe mbiemër, edhe folje, edhe ndajfolje dhe, sipas nevojës, është përdorur në çdo pozicion. E për të shprehur e për të shpjeguar llojin dhe gjendjen e tyre, mangësitë i kanë plotësuar me gjeste⁵⁷, shkruan Samiu. Për t’i argumentuar këto mendime të tij, Samiu merr si shembull gjuhën e fëmijëve që posa fillojnë të flasin dhe gjuhën e popujve primitivë. Fëmijët në moshën një a dy vjeçare përdorin vetëm një fjalë në klasën e emrit, mbiemrit dhe foljes, kurse fjalët shërbyese, siç e shohim nga jeta e përditshme, thuajse nuk i përdorin dot. Kjo gjendje është edhe te popujt primitivë, thotë Samiu. Gjuha nuk mbeti në pozicionin e shfaqjes së saj fillestare, ajo u zhvillua për një kohë shumë të gjatë dalëngadalë dhe shkallë-shkallë bashkë me zhvillimin e njeriut, bashkë me zhvillimin e botës njerëzore. “Sa më tepër që njerëzit e kthjellonin mendjen dhe

⁵⁴ Po aty, f.56.

⁵⁵ Po aty, f. 56.

⁵⁶ Po aty, f. 57.

⁵⁷ Këtu Samiu merr si shembull tingullin d (u zu ngoje edhe më lart) dhe shkruan: “...kur u nevojitej (njerëzve të parë) të shprehnin kuptimin “*jap, me dhënë*” me tingullin d për të nxjerrë nga ky tingull kuptimet, si “*jap*”, “*jepet*”, “*dhënie*”, “*dhashë*”, “*kam dhënë*”, “*do të japë*”, “*është dhënë*”, nuk e kanë parë të nevojshme e të domosdoshme t’i jepnin forma të ndryshme këtij tingulli, ose të riprodhonin fjalë të tjera të prejardhura nga ky tingull. Ky tingull i thjeshtë ishte i mjaftueshëm të shprehte çdo kuptim, i përgjigjej në mënyrë të pafund botës mendore a kuptimore, e po të mos ishte i mjaftueshëm, atëherë mangësinë do e plotësonin gjestet.” (S. Frashëri, Gjuha, f. 58.)

trurin, aq më shumë detyroheshin të gjenin rrugë dhe mundësi për të komunikuar më shumë qëllimet e tyre; sa më shumë që shtoheshin mjetet, gjërat dhe lëndët që përdornin ose i njihnin, shtoheshin, natyrisht, edhe emrat e tyre, zgjeroheshin, përsosej e pasurohej gjuha⁵⁸, shprehet me të drejtë Samiu

10. Në veprën e tij “Gjuha” Samiu përpiket të japë mendime edhe për klasifikimin e gjuhëve. Duke njohur mirë të arriturat e gjuhëtarëve evropianë për gjuhësinë në përgjithësi dhe për gjuhësinë krahasimtare në veçanti, si dhe duke vënë në veprim dhe njohuritë e përvojën e tij gjuhësore, S. Frashëri, përveç ndarjes së gjuhëve sipas gjenealogjisë së tyre në tri grupe më të rëndësishme: *grupi i gjuhëve ariane, ai i gjuhëve semite e hamite dhe grupi i gjuhëve turanike*, siç u vu në dukje më lart, bën dhe ndarjen e tyre sipas veçorive tipologjike. Edhe sipas këtyre veçorive gjuhët i ndan në tri grupe: *gjuhë monosilabike* (njërrokëshe), *gjuhë aglutimative* (përngjitëse) dhe *gjuhë flektive* (eptimore). Samiu jep edhe karakteristikat e secilit tip.⁵⁹ Njohësi i rrethanave gjeografike, historike e gjuhësore, Sami Frashëri, përpiket të përcaktojë shtrirjen e këtyre tri grupeve të gjuhëve jo vetëm nga aspekti hapësinor, por edhe nga aspekti kohor. Sipas Samiut, gjuhët njërrokëshe (monosilabike) fliten në juglindje të Azisë, gjuhët përngjitëse (aglutimative) fliten në shumë treva të Azisë Veriore dhe në Afrikë, në Amerikë e në Australi, kurse gjuhët e eptueshme (flektive) fliten në Azinë Perëndimore, në Afrikën Veriore dhe në Evropë. Nga aspekti kohor, ndërkaq, vazhdon Samiu, gjuhët njërrokëshe janë shfaqur në periudhën e lindjes së gjuhës, gjuhët përngjitëse në periudhën e dytë, pasi përparoi mjaft mendimi njerëzor

⁵⁸ Po aty, f. 59.

⁵⁹ Samiu shpjegon se gjuhët njërrokëshe nuk njohin eptimin (lakimin dhe zgjedhimin), sepse fjalët e këtyre gjuhëve janë njërrokëshe, që tregojnë vetëm një ndodhi a ngjarje. Me pranëvënien e një, dy a më shumë fjalëve të këtyra, ndonëse formohet fjalë pa u bashkuar dhe pa u përngjitur me njëra-tjetrën, çdonjëra prej tyre e ruan kuptimin e vet të veçantë (gjuha kineze është gjuhë monosilabike). Edhe te gjuhët përngjitëse përsëritet e njëjta gjë, thotë Samiu, por kur disa fjalë njërrokëshe vijnë pranë njëra-tjetrës dhe formojnë një fjalë me kuptim të caktuar, kuptimin themelor e ruan vetëm njëra prej tyre, kurse të tjera shndërrohen në fjalë shërbyese a elemente formuese të saj. Këto fjalë, duke e humbur mëvetësinë, përngjiten në mes tyre (pa u bashkuar). Një nga karakteristikat kryesore të gjuhëve përngjitëse është fakti se një prapashtesë e cila ndërhyt në një fjalë, ndikon dukshëm tek ajo, sepse mund të tregojë një kuptim që te ndonjëra nga gjuhët flektive do të shprehej me disa fjalë. Këtu Samiu merr si shembull fjalën yazdıramadim të gjuhës turke, si gjuhë përngjitëse, e cila në gjuhën shqipe do të shprehej me një fjali të përbërë nga nëntë fjalë “Unë nuk kam mundur ta shtyj dikë të shkruaj”. Këtë shembull të turqishtes Samiu e përkthen në gjuhën frënge dhe del me të njëjtin fond fjalësh si në shqipe. E sa u përket gjuhëve flektive, thotë Samiu, çdo fjalë që tregon një ngjarje a një send, duke iu nënshtruar ndryshimit sipas kuptimit dhe përdorimit që synohet, merr trajta të ndryshme dhe ndërtohen shumë fjalë të prejardhura.. Te këto fjalë të prejardhura nuk dallohet bashkimi dhe përngjitja me elemente formative dhe me fjalë shërbyese. Në thelb eptimi është tipar i posaçëm në këto gjuhë (gjuhët indoevropiane dhe gjuhët semite janë gjuhë eptimore).(S. Frashëri, Gjuha, f. 61-63).

dhe, gjuhët flektive janë paraqitur në periudhën e tretë, që vazhdon deri në ditët tona⁶⁰, shprehet Samiu. Pra, sipas tij, gjuhët monosilabike janë të parat, prej tyre janë zhvilluar gjuhët aglutinative, e prej tyre janë zhvilluar gjuhët flektive. Mënyrën dhe shkakun e lindjes së gjuhëve përngjitëse nga gjuhët njërrrokëshë dhe të atyre flektive nga gjuhët përngjitëse, Samiu e sheh si proces të lehtë, shumë të rregullt dhe të drejtë dhe rezultat i natyrshëm i përparimit të mendjes së njeriut.⁶¹ Pyetjes: a nuk kanë qenë të nevojshme të mos ekzistonin këto tri grupe sot? Samiu i përgjigjet në mënyrë shumë të thjeshtë “...raca njerëzore, thotë Samiu, e marrë në përgjithësi nuk ka përparuar menjëherë, kanë mbetur shumë popuj në shkallë të ndryshme. Përveç kësaj, vazhdon Samiu, është e domostoshme të theksohet se përparimi i gjuhës nuk varet, nuk lidhet përherë me përparimin e qytetërimit, sepse ka edhe disa rrethana që, së bashku me përparimin e qytetërimit, kushtëzojnë edhe ngecjen e zhvillimit të gjuhës, ose mbetjen e saj në gjendjen e mëparshme⁶², shprehet Samiu.

11. Një problem tjetër gjuhësor, në të cilin Samiu e ka përqëndruar vëmendjen e tij është edhe problemi i origjinës së përbashkët të gjuhëve. “Në rruzullin tokësor fliten shumë e shumë gjuhë. Të gjitha këto gjuhë, që fliten sot, a janë degëzuar nga një trung dhe nga një gjuhë e përbashkët, apo secili grup a secili nëngrup i gjuhëve është formuar dhe është shfaqur veças; a nuk ka në mes tyre ndonjë afri dhe marrëdhënie”⁶³, pyet Samiu.

Samiu pranon se kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe nga më të vështirat për t’u analizuar. Ai nuk pajtohet me mendimin e atyre natyralistëve të cilët pranonin vetëm afrinë në mes degëve të disa grupeve gjuhësore e as të atyre që mohonin lidhjet dhe afrinë e këtyre gjuhëve me degët e grupet e gjuhëve të tjera. Samiu, pasi i konsideron të tepruara mendimet e natyralistëve, ashtu siç vepron gjithnjë në studimet e tij, paraqet dhe mendimet e tij origjinale lidhur me këtë problem të ndieshëm gjuhësor. “Sidoqoftë, disa dijetarë mbështeten në orientimet e shkencave natyrore, të cilat duhet t’i marrin si shembull, por për shkak se askush nuk do të flasë kundër ndërjegjes së vet, edhe unë, thotë Samiu, nuk do të heq dorë e të mos e shpjegoj veçanërisht mendimin tim lidhur me këtë çështje”.⁶⁴ Samiu pranon ngjashmëritë mes gjuhëve të ndryshme, që formojnë grupet e tyre, si për shembull, gjuhët ariane, gjuhët semite dhe gjuhët turanike. Lidhja e gjuhëve të këtyre grupeve, sipas tij, është më lehtë për t’u kuptuar. Pastaj, vazhdon Samiu, “si të gjykojmë se nuk ka asnjë afri dhe marrëdhënie në mes gjuhëve ariane dhe gjuhëve semite, ose në mes dy gjuhëve të lashta, kur trunghi dhe baza e secilës prej tyre janë

⁶⁰ Po aty, f. 63.

⁶¹ Po aty, f. 64.

⁶² Pa aty, f. 65. Shih dhe në faqen 60.

⁶³ Po aty, f. 65.

⁶⁴ Po aty, f.69.

nga këto dy grupe gjuhësh⁶⁵, shprehet Samiu. Pra, sipas Samiut, ka edhe gjuhë që nuk burojnë nga e njëjta gjuhë, por, megjithatë edhe midis tyre ka një lidhje, e cila mund të vërehet vetëm nga specialisti i gjuhësisë. Lidhur me këtë Samiu shkruan: “Për shembull, të gjithë e vënë re ngjashmërinë midis frëngjishtes e italishtes, midis rusishtes e sërabishtes, ose midis gjermanishtes e holandishtes dhe ai që di njërën nga këto çifte, gati shumë mirë do ta kuptojë edhe tjetrën. Mirëpo, për shembull, që të mund të dallosh marrëdhëniet mes frëngjishtes dhe gjermanishtes ose të italishtes dhe rusishtes, duhet të jesh gjuhëtar⁶⁶”, shkruan Samiu. Sipas S. Frashërit pra, të larguarit për një shkallë të afri, e pakson a e zvoglon ngjashmërinë e tyre gjithashtu për një shkallë, siç është rasti frëngjisht-gjermanisht ose italisht-rusisht. Afërsia mes gjuhëve ariane dhe gjuhëve semite, që është e natyrshme të jetë dy a tri dhe ndoshta katër a pesë shkallë më larg, thotë Samiu, nuk lë vend për një ngjashmëri që të kuptohet lehtë. Megjithatë, vazhdon ai, po t’u kushtohet vëmendja e duhur, do të shihet një lidhje dhe një ngjashmëri e mjaftueshme në mes këtyre dy grupeve të mëdha të gjuhëve.⁶⁷

Për të dëshmuar qëndrimet e veta lidhur me afritë dhe marrëdhëniet e gjuhëve, madje dhe në mes grupeve të ndryshme: të gjuhëve ariane, semite dhe turanike, Samiu merr disa shembuj, duke thënë se shembujt e këtillë mund të shumëfishohen. Sipas Samiut, për shembull, fjala arabe *umm*, ka ngjashmëri me fjalën shqipe *ëmë*, domethënë me gjuhën shqipe si gjuhë ariane. Ngjashmëria e saj vërehet edhe me fjalët në gjuhët: persiane *mam*, greke *mami* dhe në gjuhët evropiane *maman*. Ose fjala arabe *eb* (shq. babë), ka ngjashmëri me fjalët e gjuhëve ariane: persisht *bab* dhe në gjuhët evropiane *papa*. ”Ngjashmëri si këto duhen kërkuar, së paku, te fjalët që kanë qenë të shtrënguar t’i përdornin njerëzit që në krye të herës⁶⁸”, thotë Samiu. Duke arsyetuar dhe shpjeguar mundësitë e lidhjeve dhe marrëdhënieve të gjuhëve turanike (gjuhë përngjitëse) me gjuhët ariane (gjuhë flektive), Samiu merr shembuj përkatës: fjala turke *iyi* (=iji) “mirë,i mikrë” shihet se tregon ngjashmëri me fjalën greke *ev*, e cila në gjuhën e vjetër greke është shqiptuar *iji*, pastaj fjala turke *ata*, shihet se ka ngjashmëri me fjalën që në shqip përdoret *atë*, në latinisht *atavus*. Për këtë problem gjuhësor Samiu nuk ndalet këtu. “Mund të pohojmë, thotë Samiu, se ka mundësi që edhe kinishtja (kinezishtja), që është nga gjuhët njerërore, ka lidhje me grupet e gjuhëve të lartpërmendura, e sidomos me gjuhët ariane⁶⁹. Samiu, pasi krahason fjalët “*pader*” dhe “*mader*”, të cilat përdoren në mënyrë të njëjtë gati në

⁶⁵ Po aty, f. 69.

⁶⁶ Po aty, f. 69. Të gjitha këto gjuhë që u përmenden këtu hyjnë në grupin e gjuhëve ariane, por, natyrisht, ato që janë të familjes së ngushtë kanë afri më të mëdha mes vete, prandaj kuptohen më lehtë. Grupi i gjuhëve ariane përfshin gjuhët iranike, gjuhët latine, gjuhët gotike, gjuhët sllave. Ai përfshin edhe disa grupe të vogla gjuhësh.(S. Frashëri, Gjuha, f. 69.)

⁶⁷ Po aty, f. 70.

⁶⁸ Po aty, f. 70.

⁶⁹ Po aty, 71.

të gjitha gjuhët ariane: në greqisht *patir* dhe *matir*, në latinisht *pater* dhe *mater*, në gjermanisht *fater* dhe *muter*, në anglisht *father* dhe *madher*, në lituanisht *moter*, që është sinonim i fjalës *mader*, edhe në gjuhën shqipe, e njëjta fjalë (*mader*), duke e ndryshuar kuptimin, përdoret me kuptimin *motër*⁷⁰, rrënjët e këtyre fjalëve *pa-*, *ma-/mu*, *mo-* (*-ter*, *-der* janë pjesë fundore të fjalëve), Samiu pastaj i krahason edhe me kinishten, në të cilën gjuhë babës i thonë *fu*, nënës *mu*.

Pra, duke u mbështetur në këto krahasime, Samiu shprehet “*Kemi plot të drejtë të pohojmë se ka lidhje mes gjuhëve të përmendura, grupet dhe nëngrupet e të cilave janë të ndryshme, sepse vendet e zanafillës së gjuhëve që u përkasin këtyre tri grupeve dhe katër familjeve, janë rrezëmalet Himalaje*”.⁷¹

Samiu nuk i ka lënë punët në gjysmë të rrugës. Çështjes së lidhjeve dhe ngjashmërive të gjuhëve, ai do t’i kthehet edhe një herë në një kapitull të veçantë “*Rrënja, degët dhe afërsia e gjuhëve*” të botuar në librin e tij “*Gjuha*”, duke ritheksuar se “*ana më e rëndësishme dhe më e vështirë e gjuhësisë është çështja të përcaktohet se cila prej gjuhëve është burimore dhe cilat janë degë të saj*”⁷². Për gjuhëtarin tonë, Sami Frashërin, ishte e qartë se nuk janë krijuar të gjitha gjuhët në kohët historike.⁷³ Duke u nisur nga fakti se shumica e gjuhëve dhe veçanërisht gjuhët e vjetra, janë formuar dhe janë shfaqur në kohë aq të lashta, saqë historia mund të ndihmojë fare pak për të caktuar rrënjët e tyre dhe për afërsitë që janë krijuar mes tyre, Samiu thotë se “*Përveç formave dhe gjendjeve të këtyre gjuhëve nuk ka diçka që do të mund të jepte të dhëna të drejta për këtë çështje. Siç mund të gjendet në shtresat e dheut historia më e drejtë dhe më e shëndoshë e rruzullit tokësor, mund të gjendet edhe për fjalët e gjuhës te eptimi (lakimi dhe zgjedhimi), te rregullat si dhe te mënyra e formimit të fjalive, te dukuri e rrethana të tjera të natyrshme*”⁷⁴, shprehet Samiu.

Për të përcaktuar se një gjuhë cilit grup, cilit nëngrup dhe cilës degë i takon, Sami Frashëri caktonte në studimet e tij krahasimtare disa parime, rregulla e kritere të përgjithshme, të cilave u përmbahej dhe mund të thuhet se janë të pranueshme edhe sot në studimet e kësaj fushe shkencore. Këto parime, këto kritere e rregulla, pa dyshim se do t’i ndihmonin studiuesit për të nxjerrë përfundime të meritueshme dhe për të depërtuar në thelbin e çështjeve të gjuhësisë krahasimtare.

⁷⁰ Po aty, f. 72. Këtu Samiu vë në dukje edhe ndryshimet fonetike të këtyre dy fjalëve; ndryshimin e a-së në o dhe ndryshimin e p-së në f. Në këtë kuadër shpjegon dhe fjalët *birader*, *dader*, *fratel*, *bruder*.

⁷¹ Po aty, f. 73.

⁷² Po aty, f. 84.

⁷³ Për gjuhët e dëshmuara historikisht, dihet cila është gjuhë bazë dhe cilat janë degë të saj. Për shembull, frëngjishtja, italishtja, spanjishtja dhe disa gjuhë të tjera janë degë të gjuhës bazë, latinishtes.

⁷⁴ Po aty, f. 85.

Për të mos u gabuar në gjetjen dhe trajtimin e lidhjeve, ngjashmërive dhe marrëdhënieve mes gjuhëve, këto rregulla e kritere, të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje, Samiu i ka përmbledhur në disa pika:

E para, nuk duhet t'u jepet rëndësi disa fjalëve që ngjajnë rastësisht ose që janë afër njëra-tjetrës. Pa u shqyrtuar ngjashmëria dhe afërsia të disa fjalëve edhe nga disa aspekte të tjera, nuk mund të gjykohej se në mes dy gjuhëve ka afërsi;

E dyta, gjuhët që nuk kanë kurrfarë marëdhëniesh në mes tyre nga aspekti i llojit (tipologjik) dhe i prejardhjes (gjenetik), huazojnë vazhdimisht fjalë nga njëra-tjetra. Këto fjalë duhen trajtuar si huazime e nuk duhet gjykuar se ka afërsi. Fjalë të tilla janë huazuar vazhdimisht në gjuhë të ndryshme nëpërmjet tregtisë dhe teknikës. Kështu, ndonëse greqishtja e vjetër është nga gjuhët ariane, në të gjejmë mjaft fjalë të përbashkëta me gjuhët semite. Për shembull, *devesë* greqisht i thonë *kamilos*, lat. *camelus*, frëngj. *chamelle*, gjerm. *kameel*; të gjitha këto rrjedhin nga fjala arabe *xhemel*. Prandaj, për të mos gabuar, më shumë se fjalëve, duhet t'i kushtohet kujdes *epitimit/ndryshimit*, *formimit* të fjalisë, fjalëve shërbyese e të tjerave, sepse, sado që një gjuhë merr shumë fjalë nga një gjuhë tjetër, ato asnjëherë nuk e huazojnë mënyrën e ndryshimit, pra të lakimit e të zgjedhimit dhe mënyrën e formimit të fjalisë. Ngjashmëria që ekziston në këtë pikëpamje, me siguri do të gjendet në mes gjuhëve të përbashkëta, si për nga lloji, si për nga prejardhja. Për shembull, ndonëse më se gjysma e fjalëve që gjenden në fondin leksikor të gjuhës angleze i përkasin latinishtes, afër një e katërta gjuhës së vjetër kelte dhe një e treta gjuhës gjermane, gjuha angleze nuk është as gjuhë latine e as gjuhë kelte.. Ajo, megjithatë, hyn në grupin e gjuhëve gjermanike, sepse *epitimi* i fjalëve të tyre, mënyra e formimit të fjalisë, *nyja* shquese dhe fjalët e tjera shërbyese, janë formuar nga gjermanishtja e vjetër, domethënë nga gjuha gotike, e cila është e afërt me gjermanishten.. Edhe turqishtja ka numër të madh të fjalëve arabe e persiane, por nuk është as gjuhë semite, si arabishtja, e as ariane, si persishtja, por është gjuhë e familjes turanike. Persishtja e sotme, megjithëse përmban shumë fjalë arabe dhe gjuha e vjetër *pehlevite*, shumë fjalë asiriane, si persishtja, si *pehlevishtja* janë gjuhë ariane, kurse arabishtja dhe asirishtja, gjuhë semite.

E treta, në çdo gjuhë, e veçanërisht në gjuhët e meta të popujve primitivë, gjenden shumë fjalë që burojnë nga imitimi. Meqenëse natyra a karakteri që çon në këtë imitim është i përbashkët të të gjithë njerëzit, në mes gjuhëve që nuk kanë asnjë lloj marrëdhëniesh, do të gjenden fjalë që përngjajnë në këtë mënyrë;

E katërta, meqë ka disa shkallë të afërsisë në mes gjuhëve, atëherë të gjuhët, të të cilat dihet shkalla e afërsisë në mes tyre, duhet kërkuar lidhja brenda kufijve dhe nevojave të kësaj shkalle, kurse të gjuhët, të të cilat nuk dihen shkallët e afërsisë, duhet kërkuar lidhja, varësisht nga sasia dhe cilësia e marrëdhënieve që janë midis tyre. Për shembull, ngjashmërinë ndërmjet gjuhëve latine: frëngjishtes, italishtes dhe spanjishtes, të cilat kanë lindur nga latinishtja, ose ndërmjet gjuhëve gjermane:

gjermanishtes, holandishtes, skandinavishtes dhe anglishtes, që kanë lindur nga gjuha gotike, ose të gjuhëve sllave, nuk mund ta gjejmë njësoj ndërmjet, për shembull, frëngjishtes dhe gjermanishtes, grupet gjuhësore të të cilave janë të ndryshme, megjithëse, edhe këto, duke qenë nga gjuhët ariane, janë ndarë nga një trung ... Thënë shkurt, të gjitha klasat a kategoritë e gjuhëve (njërrokëshe, përngjitëse dhe flektive) janë ndarë në grupe të mëdha; shumica e këtyre grupeve janë ndarë në nëngrupe dhe nëngrupet në degë/çifte. Meqenëse ka shumë grupe, është e nevojshme t'i kushtohet kujdes përcaktimit, se në gjirin e cilës familje (grupi të ngushtë), cilit nëngrup, cilit grup (të madh) dhe cilës klasë/kategori i përket çdo gjuhë;

E pesta, çdo nëngrup që bënë pjesë në një grup të madh ka shqiptim dhe të folme të posaçme, çdo degë, që përbën një nëngrup, ka shqiptim dhe të folme të posaçme, çdo gjuhë e një çifti a dege ka shqiptim e të folme të posaçme, e madje çdo fjalë e një gjuhe shqiptohet në mënyrë të veçantë. Meqë në të shumtën e rasteve, bashkëtingëlloret dhe zanoret ndryshojnë sipas atij shqiptimi dhe të folmeje, dhe sado që disa herë, nuk shihet asnjë ngjashmëri dhe afri nga aspekti formal mes fjalëve që u përkasin dy gjuhëve, gjuhësia nuk luhetet në përcaktimin se të dyja gjuhët janë të njëjta, sepse dihet se në çfarë rruge kanë ndryshuar bashkëtingëlloret dhe zanoret e gjuhëve që njihen. Duke u nisur nga ky këndvështrim, thotë Samiu, duhet parë se në çfarë rruge e ka ndryshuar persishtja, gjuhë sanskrite nga gjuhët ariane, tingullin s në h. Kështu, fjalët e gjuhës sanskrite Sind “India” dhe sept “shtatë”, në persisht kanë marrë formën Hind dhe heft, kurse në greqisht epta dhe Indhia (India);

E gjashta, duhet të përcaktohet se cila nga gjuhët e dëshmuara, që kanë lidhje mes tyre është burimore, cilat janë degë, duke përcaktuar gradualisht dallimet midis tyre. Sipas Samiut, gjuhëtarët kishin gabuar kur kishin menduar se latinishtja ishte formuar nga greqishtja dhe se trungu i gjuhëve ariane kishte qenë gjuha sanskrite. Megjithatë, sot, vazhdon Samiu, është kuptuar se këto tri gjuhë, së bashku me gjuhën kelte, gotike, sllave dhe ilire kanë dalë nga një trung i përbashkët dhe asnjëra prej tyre nuk ka qenë gjuhë bazë. Emri i gjuhës burimore edhe sot e kësaj dite mbetet i panjohur. Arsyet e mosnjohjes së gjuhës burimore, S. Frashëri i sheh në mungesë të shkrimit të asaj gjuhe. Kështu, për shembull, po të mos kishim vepra të shkruara latine ose gotike, sigurisht do të besonim se italishtja do të ishte gjuhë burimore, gjuhë bazë e gjuhëve latine, kurse gjermanishtja, gjuhë burimore e gjuhëve gjermanike.⁷⁵

12. Një problem tjetër që ka trajtuar Samiu në librin e vet “Gjuha” është dhe çështja e jetës dhe zhvillimit të gjuhës. “Gjuha ka jetën e vet. Ashtu si njeriu, lind,

⁷⁵ Po aty, f. 84-91.

jeton dhe vdes”⁷⁶, thotë Samiu. Ky koncept i tij i mbështetur në pikëpamjet e natyralistëve, në gjuhësinë tonë të sotme konsiderohet i gabueshëm. Mendoj se lidhur me thënien e Samiut nuk duhet të ngutemi të japim vlerësim të menjëherëshëm, kur dihet se ai, sa herë që flet për gjuhën, shprehet në mënyrë të qartë se gjuha është dukuri shoqërore, se gjuha lind bashkë me shoqërinë, zhvillohet dhe përsoset paralel me zhvillimin dhe përsosjen e saj etj. Pastaj, mendimet e tij për lindjen, zhvillimin dhe zhdukjen e gjuhës, Samiu i arsyeton me shumë shembuj që sjell për zhdukjen e shumë gjuhëve në të kaluarën. Kur romakët e nënshtruan tërë Evropën, thotë Samiu, u zhdukën gjuha e etruskëve, e iberëve, e keltëve dhe gjuhë të tjera, që fshiheshin në anët jugore të këtij kontinenti dhe në vend të tyre kaloi latinishtja. Si dëshmi për zhdukjen e gjuhëve, Sami Frashëri sjell edhe fatin e latinishtes, e cila duke u shtrirë në një territor shumë të gjerë në kohën e Perandorisë Romake, filloi ta humbë mëvetësinë e saj. Duke u zhvilluar në tri forma të ndryshme, formoi tri gjuhë më vete: frëngjishten, italishten dhe spanjishten, kurse vetë latinishtja si gjuhë e folur pushoi së ekzistuari.⁷⁷ Rrethanat që e kanë përcjellë latinishten, thotë Samiu, vazhdojnë të shfaqen në gjuhën arabe që pas një kohe nga ndryshimet që do të pësojë kjo në shtetet arabe, do të vijë dita kur irakianët, egjiptasit, sirianët, jemenasit, tunisianët etj, nuk do të mund të kuptohen mes vete e as nuk do ta kuptojnë gjuhën letrare arabe. Ja pra, nëse arabishtja vazhdon kështu, thotë Samiu, do të mbesë vetëm e shkruar, ashtu si latinishtja dhe, të folmet e Irakut, Sirisë, Egjiptit, Magrebit dhe të tjerat, ashtu si gjuhët e latinishtes, do të kalojnë në gjuhë të mëvetësishe. Kështu, vazhdon Samiu, nga një gjuhë bazë do të lindin gjashtë-shtatë gjuhë. Fatin e njëjtë, vazhdon Samiu, e kanë pasur edhe gjuhët gjermanike e edhe ato sllave.⁷⁸ Duke u mbështetur në këto shpjegime, lidhur me gjuhën bazë dhe lindjen e gjuhëve të reja, Samiu do të shprehet kështu: “Në një kohë shumë më të lashtë, në këtë mënyrë janë ndarë e degëzuar nga një gjuhë bazë edhe gjuhët ariane, edhe gjuhët semite, edhe gjuhët turanike. Është e mundshme që në një kohë akoma më të lashtë, gjuhët bazë të këtyre tri grupeve të mëdha dhe, edhe gjuha bazë e gjuhëve njërrrokëshe në anët e Kinës, të jenë ndarë nga një gjuhë bazë, që është folur në anët e Himalajeve”.⁷⁹ Sipas Samiut gjuhët e reja janë krijuar mbi bazën e gjuhëve të vjetra dhe nga mbetjet e tyre dhe ky është një përparim. Por nuk ndodh kurdoherë kështu, thotë Samiu, sepse disa herë madje, gjuhët humbin dhe zhduken. Gjuhët që kanë lënë pasardhëse janë shumë, por ato që janë zhdukut janë më të shumta, thotë Samiu. “Kur arianët u shpërngulën në vendet e Evropës, natyrisht, nuk e gjetën këtë kontinent të zbrazët, sepse dëshmitë historike të gjetura aty, thotë samiu, kanë treguar se ky vend ka qenë i banuar që në kuaternar.

⁷⁶ Po aty, f. 73.

⁷⁷ Po aty, f. 75.

⁷⁸ Po aty, f. 76.

⁷⁹ Po aty, f. 76.

Megjithatë, nga gjurmët e atyre popujve të lashtë, kanë mbetur vetëm gjurmët e gjuhës baske. Gjurmët dhe emrat e popujve të tjerë janë zhdukur fare.”⁸⁰ Këto të dhëna tregojnë se formime e shformime, tjetërsime, degëzime e zhdukje të gjuhëve në rruzullin tokësor ka pasur që nga kohët më të lashta dhe do të ketë gjithmonë. “Ja pra, këtu qëndron rëndësia dhe pesha e gjuhësisë. Këto rrethana i sjellin vështirësi kësaj shkence, sepse po të bëheshin këto ndryshime në kohët historike dhe në gjuhët, letërsitë e të cilave janë të dokumentuara, mësimi dhe studimi i tyre do të ishte i lehtë. Natyrisht, janë të vështira hulumtimet që bëhen te gjuhët para kohëve historike ose te gjuhët që nuk janë shkruar, e sidomos, kur në këto hulumtime nuk u kushtohet rëndësi ngjashmërive të jashtme dhe të rastësishme, atëherë, zbulimet e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të vërteta të tyre janë shumë të vështira”⁸¹, shkruan Sami Frashëri në librin e tij “Gjuha”.

13. Duke folur për zhvillimin e gjuhës Samiu pranon dy lloj zhvillimesh: të përgjithshëm a të natyrshëm dhe të sajuar a artificial. Zhvillimi i natyrshëm i gjuhës, si: ndarja dhe shumfishimi i formave të eptimit (lakimit dhe zgjedhimit); dallimi i gjinisë mashkullore dhe femërore; shumësia e fjalëve shërbyese, elementeve formative dhe lidhëzave të ndryshme; llojllojshmëria e fjalëve; rregullsia dhe përsosuria e formimit të fjalisë etj., sipas Samiut, janë gjëra që janë shfaqur me përparimin e zgjuarsisë dhe të aftësisë krijuese të një populli. Ndërsa zhvillimin artificial ai e lidh me ndikimin që ka përparimi i shoqërisë mbi gjuhën, me zhvillimin e shkencës dhe të kulturës, me faktin që gjuha i përgjigjet zhvillimit shoqëror. Ky zhvillim, thotë Samiu, është rrjedhojë dhe rezultat i njeriut, e jo rrjedhojë dhe rezultat natyror. Përparimi i sajuar a artificial i gjuhës, varet gjithnjë nga përparimi material, teknik dhe mendor i popujve. Prandaj nga kjo pikëpamje, gjuhë më e përsosur është gjuha e një populli më të qytetëruar. Megjithatë, krahas përparimit të natyrshëm e të sajuar (artificial) të gjuhëve, ekziston, sipas Samiut, edhe ndërprerja e zhvillimit të tyre dhe se shkalla e zhvillimit të popujve nuk përkon gjithmonë me nivelin e zhvillimit të gjuhëve të tyre. Për ta argumentuar mendimin e tij, Samiu shkruan: “Ndonëse banorët e anëve të Kinës, Tibetit dhe Ananit, janë popuj të qytetëruar më së pari, gjuhët e tyre kanë mbetur deri më sot në formën e gjuhëve njerërore ... ndërkaq, gjuhët e disa fiseve primitive të Australisë, Afrikës dhe Amerikës, që tregojnë gjurmët se kanë qenë nga njerëzit e kuaternarit, janë në formën e gjuhëve përngjitëse (një shkallë më lartë se ata të Kinës)”⁸². Kjo tregon se shkalla e zhvillimit të gjuhëve të tyre nuk përkon me shkallën e prapambetjes së këtyre popujve. Shkaqet e kësaj dukurie, sipas Samiut, duhet kërkuar në rrethana dhe në faktorë të jashtëm. Për shembull, për shkaqet e ngecjes a ndërprerjes së

⁸⁰ Po aty, f. 77.

⁸¹ Po aty, f. 78.

⁸² Po aty, f. 80.

kinishtes (kinezishtes) në shkallën e gjuhëve njërrrokëshe, S. Frashëri shkruan: “Kinezët u qytetëruan që në kohën kur kanë folur me një gjuhë njërrrokëshe dhe gjuhën e tyre kanë filluar ta shkruajnë që atëherë. Në qoftë se është gjuhë e shkruar, e regjistruar që atëherë, vetvetiu kuptohet se është vështirë të kenë ndodhur ndryshime qenësore. Për më tepër, meqë kinezët nuk janë nga popujt që e ndryshojnë gjendjen e tyre shumë lehtë, janë përpjekur ta ruajnë gjuhën e tyre deri më sot në atë gjendje burimore. Edhe shkrimi i tyre madje, duke u sistemuar sipas një gjuhe të këtillë njërrrokëshe dhe, meqë nuk është shumë i përshtatshëm për shkrimin e gjuhës së një kategorie tjetër, ka shërbyer që gjuha e tyre të mbetet në gjendje të vjetër – të thjeshtë.”⁸³ Sami Frashëri gjykon shumë drejt kur thotë se gjendja e natyrshme e gjuhëve, nga aspekti gjuhësor, ka më shumë peshë, është më e rëndësishme se përparimi i sajuar a artificial i gjuhëve. Përparimi i sajuar dhe letrar është shfaqur më vonë, kurse gjendja e natyrshme është ajo themelore. Në gjuhësi nuk ka gjuhë më pak të respektuar. Për këtë shkak, gjuhëtarët nuk e shohin asnjë gjuhë me vështrim nënçmues. Përkundrazi, u kushtojnë vëmendje më të madhe gjuhëve, që çdokush i nënçmon dhe ua ul vlerën. Në këtë kuptim “*kurdishtja nuk është më pak e respektuar ose e rëndësishme se persishtja, shqipja më pak se greqishtja e vjetër*” ose “*gjuha jakute, një nga gjuhët e familjes së gjuhëve turanike*”⁸⁴, që e flet një popull primitiv në lumenjtë e ngrirë të Siberisë, sipas gjuhëtarëve, ashtu si turqishtja dhe hungarishtja, ka përparuar deri diku dhe është shumë më e rëndësishme se gjuhët e qytetëruara (të përziëra), sepse është burimore, kurse këto të qytetëruarat, janë degë”⁸⁵, shprehet Samiu.

Në librin e tij “Gjuha” Sami Frashëri jep dhe disa njohuri të veçanta për disa nga gjuhët njërrrokëshe (gjuhët kineze, ananeze, siameze, birmaneze dhe të Tibetit) dhe të disa gjuhëve përngjitëse – për gjuhët afrikane (gjuhët hotentote, bushmane, të zezakëve, bantu, fulane dhe nubiane). Meqë mundësitë e punimit nuk na lejojnë të zgjatemi më tepër, do të mjaftohem vetëm të them se si ka mundur Sami Frashëri t’i grumbullojë gjithë ato informacione gjuhësore: fonetike, morfologjike, të fjalëformimit, të na japë njoftime për strukturën e fjalisë dhe për shumë karakteristika të tjera të këtyre gjuhëve që i përmendëm më lart.⁸⁶ Kjo me të vërtetë është për t’u habitur. Ne, sa jemi në dijeni, na mungojnë informacione të tilla edhe sot në gjuhën shqipe, ndonëse mundësitë teknike, në raport me ato të kohës së samiut, janë të pakrahasueshme – të pakta.

⁸³ Po aty, f. 81. Lidhur me përparimin dhe ndërprerjen e zhvillimit të gjuhës merr shembuj edhe gjuhët e popujve të tjerë; gjuhët ariane, semite etj.

⁸⁴ Për gjuhët turanike, afritë dhe marrëdhëniet në mes tyre, si dhe për ndarjen e tyre në pesë grupe shih: Sami Frashëri, *Kamus al-a’lam III*, f. 1683.

⁸⁵ Sami Frashëri, *Gjuha* f. 83, 84.

⁸⁶ Sami Frashëri, *Gjuha*, f. 91-106. Për gjuhët flektive nuk shkruan në mënyrë të veçantë.

14. Sami Frashëri nuk u ndal vetëm me trajtimin e problemeve teorike të gjuhës. Duke shfrytëzuar përgatitjen e tij gjuhësore, filologjike, e sidomos talentin e tij të rrallë, Samiu do të futet në fusha shumë të ndishme praktike gjuhësore, si: në hartimin e fjalorëve njëgjuhësh e dygjuhësh, madje mjaftë të vëllimshëm; në përpilimin e gramatikave dhe teksteve të tjera nga fusha e gjuhësisë; në përpilimin e alfabetit të gjuhës amtare shqipe dhe të asaj turke etj. Të gjitha këto punë të mëdha e bën Samiun të pavdekshëm, e bën shkencëtar me famë botërore. Ndiheza e Samiut në këto fusha të dijes është e madhe, por megjithatë, ndihmesën më të madhe në gjuhësi, Samiu do ta japë në leksikologji. I pakënaqur me fjalorët e hartuar në kohën e tij, ai do t'i qaset kësaj punë të mundimshme, por, pa dyshim, shumë të vlefshme. Kur jemi te fjalorët, vlen të thuhet se Samiu bashkë me të vëllanë, Naimin, kanë hartuar një fjalor të gjuhës shqipe, por, mjerisht, tash për tash fjalori ka mbetur i pabotuar dhe nuk i dihen gjurmët. Botimi i një fjalori të tillë të gjuhës shqipe do të ishte një ngjarje e madhe shkencore e kulturore për shumë arsye.⁸⁷ Ai, megjithatë, në këtë fushë ka botuar fjalorët: Frëngjisht-turqisht, me 2240 faqe; turqisht-frëngjisht, me 1208 faqe; fjalori i vogël i frëngjishtes: Frëngjisht-turqisht, me 650 faqe; arabisht-turqisht, me 504 faqe (i pambaruar); fjalori i turqishtes me 1593 faqe. Të gjithë së bashku, pra, shtrihen në mbi 6000 faqe.⁸⁸ Kjo flet për një punë energjike e kolosale të Samiut. Sa për vlerën e tyre janë dhënë mendime në shumë studime deri më tash, sidomos nga leksikografët turq.⁸⁹ Duke u mbështetur në ato studime dhe duke u nisur nga përvoja ime personale, jam thellë i bindur se të gjithë ata që merren me probleme të orientalistikës, të turkologjisë, të osmanistikës dhe të fushave të tjera të kësaj natyre, janë të detyruar, madje edhe studiuesit më të njohur të tyre, t'i përdorin e t'i shfrytëzojnë këta fjalorë të Samiut. E sa i përket metodologjisë që ka përdorur Samiu, do të thosha se nuk janë mbrapa fjalorëve të hartuar në kohën tonë, sepse janë punuar nga kryemjeshtri i kësaj disipline shkencore. Thënja e Samiut për vetvete *“Në qoftëse ka një punë me të cilën unë krenohem dhe për të cilën jam specializuar, ajo është përgatitja dhe hartimi i fjalorëve, që është një shkencë e posaçme”*⁹⁰, është shumë domethënëse. Kriteret që ka përdorur ai për përgatitjen dhe hartimin e fjalorëve nuk mund të hidhen poshtë as sot, pas njëqind e sa vitesh. Për t'u bindur për këtë mjafton të marrim si shembull fjalorin e turqishtes të hartuar prej tij. Në këtë fjalor, pasi shënon fjalën që e trajton, ai jep llojin e saj, etimologjinë,

⁸⁷ Më gjerësisht për këtë shih, Jorgo Bulo, *Sami Frashëri dhe kodifikimi i shqipes*, Sami Frashëri, Vepra 00, Bibliografi dhe kumtesa, Logos-A, Shkup, 2006.

⁸⁸ Shih shënimet plotësuese të këtyre fjalorëve në fusnotat 7 dhe 8.

⁸⁹ Në këtë rast po shkëpusim një fjali nga fjala e botuesit të Fjalorit të turqishtes, Ahmet Xhevdetit, lidhur me autoritetin e Samiut si leksikograf: *“Është e tepërt të harxhojmë fjalë për të përcaktuar cilësinë e veprës së botuar me titullin “Kamus-i Turki”, thotë ai, sepse vetëm të përmendurit e emrit të të respektuarit të hartuesit të fjalorit flet mjaft për rëndësinë, peshën dhe shkallën e përsosurisë së tij.”*

⁹⁰ Parathënia e Kamus-i Turki (Fjalori normativ i turqishtes)

kuptimin sipas rëndësisë duke i shënuar me numra 1, 2, 3 etj., frazeologjizmat, kuptimet e figurshme etj.

Si leksikograf, Samiu i jepte një rëndësi mjaft të madhe hartimit të fjalorit të një gjuhe dhe rregullave gramatikore të saj. Në Parathënien e gjatë dhe të dendur të Fjalorit të turqishtes (Kamus-i Turki), Samiu shkruan: “Një gjuhë që nuk ka fjalor dhe rregulla gramatikore kurrë nuk mund të numërohet si gjuhë letrare. Fjalori dhe gramatika janë baza e letërsisë ... Një popull që dëshiron ta ruajë gjuhën e pastër dhe të pasur, duhet të ketë një fjalor të pasur dhe libër morfologjie e sintakse të mirë”, thotë Samiu.

Rëndësi të madhe Samiu i jepte mësimin të gjuhëve të huaja. Në të vërtetë, vetë Samiu që një shembull në këtë drejtim, sepse, siç thamë më lart, ai njihte thellësisht disa gjuhë të huaja. Njohjen e gjuhës së huaj Samiu e shihte si mjet për të rritur shkallën e kulturës e të dijes. Duke njohur gjuhën e një populli ti futesh në botën e kulturës dhe zhvillimit të atij populli; - shprehet Samiu. Shpjegimet dhe këshillat e Samiut për mësimin e gjuhëve të huaja janë të pafund. Për mësimin e gjuhëve të huaja, Samiu e shihte të domosdoshme, përveç tjerash, edhe njohjen e gjuhës amtare, gramatikën, strukturën dhe stilin e saj. Duke bërë fjalë për domosdoshmërinë e një fjalori dygjuhësh Samiu ka shkruar në parathënien e fjalorit të tij frëngjisht-turqisht: “Fjalori është ura që lidh dy gjuhë, që të lejon të kalosh nga njëra gjuhë në tjetrën”. Ai është pra, siç u tha më lart, autor i disa fjalorëve dygjuhësh. Dhe kjo është e mjaftueshme t’i japë vetes të drejtë të këshillojë e të porosisë të tjerët për mësimin e gjuhëve të huaja.

15. Sami Frashërin, këtë dijetar të madh, e shqetësonte së tepërmi mënyra e të mësuarit të nxënësve nëpër shkolla. Kjo mënyrë e mësimdhënies dhe përgatitja e teksteve shkollore për Samiun ishte e vjetruar dhe tani e tejkaluar. Për t’u dalë në ndihmë nxënësve që “jo të mundohen shumë e të fitojnë pak, por të mundohen pak e të fitojnë shumë”, Samiu, duke shfrytëzuar sigurisht tekstet shkollore të përgatitura në Evropë dhe përvojën e tij personale, do të nisë hartimin dhe botimin e serisë së veprave didaktike, të teksteve shkollore. Edhe në këtë fushë Samiu do të jetë shumë i suksesshëm, sepse nga mendja dhe dora e tij do të dalin disa vepra shkollore për të gjitha nivelet. Në gjuhën shqipe për këtë qëllim do të botojë veprat “*Abetare e gjuhësë shqip*”, “*Dheshkronjë*”, “*Shkronjëtoe e gjuhësë shqip*” etj. Këto tekste Samiu ynë i bëri në kohën e duhur, në kohën kur shqiptarët dhe shkolla shqipe kishin nevojë më së shumti për to. Në veprën “*Abetarja e gjuhësë shqip*”, e vogël për nga vëllimi, por me peshë të rëndë kulturore e shoqërore u shfaqën edhe një herë dhuntitë e jashtëzakonshme të Samiut si pedagog, si psikolog, si gjuhëtar, si shkrimtar dhe në të njejtën kohë mendimi i tij i lartë patriotik. Tekstet e përfshira në të, Samiu i kishte zgjedhur në mënyrë që së bashku me mësimin e gjuhës amtare t’u ngjallë fëmijëve ndjenja fisnike si dashurinë për punë e ditori, respektin për njerëzit

dhe mbi të gjitha dashurinë për gjuhën shqipe dhe për Shqipërinë. Sa për vlerën e veprës “Shkronjëtorë e gjuhës shqip”, që njihet si *Gramatika e gjuhës shqipe e Sami Frashërit*, fjalën e vet e kanë thënë specialistët e kësaj fushe: prof. Idriz Ajeti, prof. Rexhep Ismajli, prof. Anastas Dodi etj, sa herë që ka qenë e nevojshme. Edhe për mësimin e arabishtes dhe turqishtes Samiu përpiloi disa vepra didaktike - gjuhësore, si: *Tasrifat-i Arabiyye* (Lakimet arabe); *Kavaid-i Sarfiyye-i arabiyye* (Rregullat e gramatikës arabe); *Kavaid-i Nahviyye-i Arabiyye* (Rregullat e sintaksës arabe); *Tatbikat-i Arabiyye* (Ushtrime arabe); *Kuçük elifba* (Abetare e vogël e turqishtes); *Yeni Usul Elifbay-i Turki* (Abetare e turqishtes sipas metodës së re); *Nev Usul Sarf-i Turki* (Gramatika e turqishtes sipas metodës së re).⁹¹

16. Mendime të shumta ka dhënë Sami Frashëri edhe sa i përket alfabetit të gjuhës. Sipas tij, alfabeti duhet të jetë sa më praktik, më i thjeshtë, më i lehtë dhe t'i përgjigjet gjuhës përkatëse. Pikëpamjet e tij për alfabetin Samiu i ka shfaqur në shumë shkrime të tij. Për të kuptuar konceptet e tij për alfabetin në përgjithësi, mjafton të shkëpusim ndonjë fjali nga parathënia e Fjalorit të tij Turqisht-frëngjisht, ku shkruan: “Një gjuhë nuk mund të shkruhet në mënyrë konkrete dhe të pastër me një alfabet të papërshtatshëm, prandaj është e nevojshme që alfabeti i çdo gjuhe t'i përgjigjet nevojave të saj, të mund t'i shfaqë drejt të gjithë tingujt”. Samiu, duke kritikuar alfabetet e disa gjuhëve me shkronja dyshe, këmbëngul në kërkesën e tij të përgjithshme – në parimin fonetik: një tingull një shkronjë. Dhe këtë parim e zbatoi në përpilimin e alfabetit të gjuhës shqipe në Stamboll më 1879. Ky alfabet, i quajtur Alfabeti i Stambollit, i propozuar prej sami Frashërit, gjeti një përkrahje të gjerë dhe u përhap në të gjitha trojet shqiptare. S. Frashëri, me gjasë, në të njëjtën kohë kishte menduar edhe për përpilimin e alfabetit të turqishtes mbi bazën e alfabetit latin, domethënë, zëvendësimin e alfabetit arab me alfabetin latin. Arsyeet për një propozim të këtillë Samiu, ky filolog i mirëfilltë, ky njohës i përpiktë i sistemit tingullor të arabishtes dhe turqishtes, i shihte në faktin se alfabeti arab nuk e mbulonte sistemin tingullor të turqishtes pa krijuar vështirësi të ndieshme gjuhësore. Pyetjes se “a mund të bëhet një alfabet latin për turqishten, Samiu i përgjigjet pozitivisht, po, se gjuha turke, që të përfaqësohet saktë e të shënohet qartë, nuk ka nevojë për më tepër se 30 shenja, të cilat nuk mungojnë në alfabetin latin.⁹² Dhe, vërtet, ky propozim i Samiut u realizua pas 30-40 vjetësh, pikërisht më 1928.

17. Në fund do të thosha se Sami Frashëri pikëpamjet e veta për gjuhën shqipe, për gjuhën e tij amtare, i ka shfaqur gati në të gjitha shkrimet e tij, si në gjuhën shqipe si në gjuhën turke, greke etj. Atdhetari Sami Frashëri për gjuhën

⁹¹ Sami Frashëri, Vepra 8, Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit, (nga Z.H. Bakui), Rilindja, 1984, f. 222.

⁹² Hasan Kaleshi, Sami Frashëri në Letërsinë dhe Filologjinë turke, Gjurmime albanologjike 1, Prishtinë, 1968, f. 65.

shqipe do të shkruajë edhe në një vepër të tillë, siç është Enciklopedia e tij Kamus al-a'lam, ku në zërin kushtuar shqiptarëve shkruan: “Ç’është e vërteta, të gjithë këta (e ka fjalën për ata që kishin mendime jo të drejta, jo objektive,) e kanë ditur që në gjuhën shqipe ka fjalë të ngjashme me greqishten e vjetër, latinishten dhe sllavishten ose të përbashkëta me këto, por mendonin se këto fjalë ishin nga ato gjuhë. Më në fund, kur disa dijetarë të mirëfilltë evropianë u thelluan në studimin e gjuhës shqipe, shkruan Samiu, e kuptuan se cila ishte natyra e marrëdhënieve me gjuhën e vjetër greke, si dhe me gjuhët: latine, sllave, gotike, persiane dhe sanskrite. Duke marrë në shqyrtim thelbin e gjuhës shqipe dhe duke studiuar hollësisht edhe historinë e tyre (të shqiptarëve), gjetën rrënjët dhe prejardhjen e popullit shqiptar. Kjo çështje që kishte mbetur me shekuj enigmë dhe e paqartë, tani është zgjidhur në tërësi, thotë Samiu... Mund të themi, vazhdon ai, se po të hartohet një fjalor etimologjik i fjalëve të gjuhës shqipe, do të dilnin shumë pak fjalë që nuk do të kishin lidhje e ngjashmëri me një ose me disa nga gjuhët që u përmendën më lart. Mirëpo nuk mund të pohohet në mënyrë bindëse se këto fjalë janë marrë nga ndonjë gjuhë tjetër, sepse dihet qartë se ka shumë fjalë, rrënjët e të cilave janë në gjuhën shqipe, dallohen nga rrënjët e fjalëve të gjuhës së vjetër greke dhe latine... Disa fjalë shqipe, vazhdon Samiu, kanë ngjashmëri dhe lidhje me gjuhët persiane, zende dhe sanskrite më shumë se të gjitha gjuhët e tjera ariane të Evropës. Kjo tregon se gjuha shqipe nuk është një degë me gjuhët latine, greke e sllave, porse është një degë e drejtpërdrejtë e familjes së vjetër të gjuhëve ariane”, shkruan Samiu

18. Duke e përmbyllur këtë punim, mund të mbajmë qëndrimin tonë të paluhatsëm se pikëpamjet, mendimet, idetë, pohimet dhe gjykimet teorike të Sami Frashërit, lidhur me gjuhësinë në përgjithësi dhe me gjuhët në veçanti, ndonëse të përfaqësuara në veprën e tij para 100 e sa vitesh, mbase me ndonjë përjashtim të lehtë, i qëndrojnë dhe i rezistojnë edhe sot e kësaj dite kritikës, kur shkenca mbi gjuhësinë ka arritur kulminacionin e zhvillimit të saj. Pikëpamjet e tij për përkufizimin e gjuhës, për zanafillën e shfaqjes së saj, për përcaktimin e emrave, për zhvillimin e saj paralel me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, për dallimin e tingullit (britmës) nga zëri i artikuluar, për klasifikimin e gjuhëve nga aspekti tipologjik dhe gjenealogjik, për kriteret që duhet mbajtur gjatë klasifikimit dhe ndarjes së gjuhëve, për krahasimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve jo vetëm të gjuhëve të të njëjtit grup, por edhe të grupeve të ndryshme, të dëshmuara e të argumentuara dhe me shembuj të mjaftueshëm e të përshtatshëm, i ka shpjeguar e argumentuar në baza plotësisht shkencore dhe nuk lë vend për hamendësime. Sami Frashëri mban qëndrim të drejtë shkencor edhe për vendosjen e gjuhës shqipe në gjirin e gjuhëve, siç i gjuan ai ariane (=indoevropiane). Njohuritë e thella teorike gjuhësore Samiu i zbaton edhe në praktikë. Edhe në sintezën teorike-praktike Samiu është shumë i suksesshëm,

sidomos në leksikologji, në përpilimin e fjalorëve të ndryshëm njëgjuhësh e dygjuhësh, si dhe në përgatitjen e teksteve shkollore nga fusha e gjuhësisë.

Krejt në fund mund të thuhet se sa i thellë, sa i ngritur, sa i gjithanshëm ka qenë Sami Frashëri në trajtimin e problemeve të shkencës së gjuhësisë në përgjithësi dhe i gjuhëve në veçanti, kjo që u tha këtu është shumë pak në krahasim me realitetin.

Dhurata SHEHRI

KANONI LETRAR SOT

Kanoni si kuintesencë e estetikës së çdo kohe dhe vendi, refuzon apriori çdo ndërhyrje nga jashtë. Këtij pohimi do t'i përmbahemi gjatë analizës së kanonit, kanonizimit, mungesës së kanonit, përmbysjes apo rindërtimit të kanonit të letërsisë shqipe.

Etimologjikisht, termi Kanon është me origjinë semitike. Ai dokumentohet tek shumë autorë antikë, mes të cilëve tek Platoni dhe Aristoteli dhe ka kuptimin “shkop i gjatë i drejtë”, term që ka marrë më pas metaforikisht kuptimin e rendit, normës a masës. Gramatikanët aleksandrinë e konceptonin kanonin si listë autorësh e veprash që vendosin një standard ekselence formale të konsideruar si model shprehjeje. Por, lista e parë e autorëve dhe teksteve që shërbeu si model për të gjitha kanonizimet e ardhshme, është krijuar nga kanoni biblik: tërësi tekstesh me autoritet të veçantë për shkak të zanafillës hyjnore të frymëzimit të tyre. Një përdorim tjetër të termit kanon e ndeshim relativisht vonë në vitin 1885, dhe këtu termi “kanon platonik” u referohet veprave dhe autoritetit të një autori. Kanoni, varësisht traditës së përdorimit të termit, shenjon njëherësh një listë objektesh letrare si dhe një tërësi rregullash formale të nevojshme për përzgjedhjen e këtyre objekteve si pjesë të kanonit.

Kritikë si Harold Bloom-i apo Frank Kermode-i duke e analizuar kanonin janë përpjekur të japin disa nga karakteristikat një objekt letrar duhet të ketë për t'u përkufizuar si kanonik. Këto karakteristika janë: autenticiteti; universaliteti; pakohësia, e kuptuar si aftësi për të kapërcyer të gjitha epokat; veçantësia; origjinaliteti; përfaqësueshmëria e një spektri sa më të gjerë të njerëzve etj¹. Mes tyre kriteri më i rëndësishëm për të hyrë në kanon, apo për t'u përjashtuar nga kanoni në mungesë të tij, është origjinaliteti. Sipas Bloom-it, “origjinaliteti që është i aftë t'u japë veprave letrare statusin kanonik është një veçanti që nuk asimilohet kurrë ose që bëhet një e dhënë kaq e zakonshme sa nuk na lejon ta dallojmë si të veçantë. Dante është shembulli sipëror i mundësisë së parë. Shekspiri, shembulli i pakapërcyeshëm i të dytës. Shkrimtarëve bashkëkohorë nuk u pëlqen të dëgjojnë se duhet të konkurrojnë me Shekspirin dhe Danten, por për Joyce-in kjo betejë që stimuli për të mbërritur

¹ Harold Bloom, *Il canone occidentale*, I libri e le scuole delle Eta, Bur 2012, Milano f. 3

madhështinë, ose atë famë që ndahet mes autorëve modernë vetëm me Beckett-in, Proust-in e Kafka-ën.”² Ky stimul origjinaliteti është shndërruar sipas Bloom-it në një “ankth ndikimi” i cili është thelbi i veprës së autorëve kanonikë. “Kanonit letrar nuk na pagëzon dhe nuk na jep të drejtën e hyrjes në kulturë; ai nuk na çliron nga ankthi kulturor. Përkundrazi, ai i konfirmon ankthet tona kulturore, por, nga ana tjetër u jep atyre formë e koherencë.”³ – shkruan Bloom-i duke kaluar nga skaji i dhënësit të mesazhit estetik (autori) tek marrësi i këtij mesazhi (lexuesi). Kështu, çështjet që lidhen me kanonin dhe kanonizimin mund të shihet nga dy anë, nga ana e objekteve dhe e subjekteve. Nga ana e objekteve, veprat e letërsisë shqipe do të hynin në kanon duke u përputhur me normat retorike, të shijes, të poetikës që themelojnë një traditë. Tradita e letërsisë shqipe e formuar nga kanoni ekzistues është ajo e letërsisë funksionale, e letërsisë së përdorur dhe të përdorëshme, që ka krijuar shijen, normat retorike (në kuptimin e procedimeve bindëse) të letërsisë shqipe në një prerje diakronike. Por, këndvështrimi i kanonit nga ana e subjekteve (subjekteve receptuese) duke folur për vlerat kulturore që karakterizojnë një popull në një periudhë të caktuar, domosdoshmërisht na çon tek këndvështrimi i parë. Pyetja, nëse e prodhon kanoni lexuesin apo lexuesi kanonin, vështirë se merr ndonjëherë një përgjigje përfundimtare por, përjasja e të dy këndvështrimeve të mësipërme është rruga e vetme drejt një përgjigjeje. Në vetvete, përgjigja, cilado qoftë ajo nxjerr në pah nevojën për një marrëveshje termash mbi konceptin e objektit dhe të subjektit. A është objektiv kanoni, pra a ka të bëjë ai vetë me objektet (aq sa mund t’i quajmë me marrëveshje fjale objekte artefaktet) apo është subjektiv, pasi është një subjekt, apo një shumësi subjektësh që e ndërton atë? Pranimi i hipotezës mbi marrëdhëniet e vështira dhe të deformatuara të letërsisë shqipe me lexuesin dhe sidomos nevoja e rileximeve është një mënyrë për ta vënë në diskutim kanonin.

Dukuria e kanonizimit në Shqipëri është shumë e komplikuar për disa arsye:

1. Letërsia e kultivuar është shkruar vonë
2. Paraletërsia është veneruar si letërsi
3. Shkolla si institucioni *par excellence* i kanonit është shfaqur shumë vonë në shoqërinë shqiptare
4. Shteti shqiptar është krijuar vonë
5. Nga njëqind vite jetë të këtij shteti për gati 50 vjet shteti shqiptar ka qenë një shtet diktatorial. Pjesa tjetër e kombit shqiptar u përfshi në shtete të tjera.

Revolucioni francez e tronditi idenë e institucioneve të përjetshme dhe të paprekshme dhe prej asaj kohe shoqëritë dhe kulturat evropiane janë futur në një

² Po aty, f. 18

³ Po aty, f. 167

proces të fuqizimit dhe shfuqizimit ciklik të kanoneve. Ndryshe nga shoqëritë dhe kulturat evropiane, shoqëria dhe kultura shqiptare është karakterizuar jo nga stabiliteti, por nga mungesa e tij, kështu që tronditja ka qenë gjendja permanente e kulturës dhe shoqërisë shqiptare. Për shkak të kësaj gjendjeje permanente paqëndrueshmërie, ka qenë gati e pamundur ruajtja e një korpusi veprash, vlerash a normash në mos estetike, të paktën morale. Pezhorativizimi i termit kanon (kanonik) në fjalorin e gjuhës shqipe, nuk reflekton tronditjen e kanonit, por atë që ka lënë pas tronditja, zhdukjen e kanonit të vjetër (dogmës) dhe lindjen e kanonit të ri, traditës (përparimtare), pra në thelb mungesën e tij⁴. Ja si përkufizohet termi kanon në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe 1980:

KANONIK *mb.*

1. fet. Që ka të bëjë me ligjet a rregullat e vendosura nga kisha; që u përket këtyre ligjeve a rregullave; që përmban këto ligje a rregulla. E drejta kanonike. Libër kanonik.
2. fet. Që bën pjesë në grupin e klerikëve të një kisha, të cilët zakonisht jetojnë bashkë.
3. libr. Që është caktuar a është pranuar si **model**, që lidhet me një rregull tepër të ngurtë dhe që zbatohet në mënyrë **dogmatike**. Stil kanonik.

KANONIZOJ *kal.*

1. fet. Njoh diçka si rregull a si ligj të kishës; e quaj dikë a diçka të shenjtë.
2. libr. I jap karakter të shenjtë a kanonik, e quaj a e bëj si një model që duhet të zbatohet në mënyrë dogmatike.

Kuptimi i termit Kanon (letrar) mbulohet pjesërisht në këtë fjalor nga termi traditë, ndonëse edhe këtu ngushtimi ideologjik është i dukshëm.

TRADITË, *em.*

4. let., art. Trashëgim i arritjeve më të mira në fushën e letërsisë e të artit, gjithçka e mirë e **përparimtare** që na kanë lënë brezat e kaluar në këtë fushë. Ruajtja e traditave. Mbështetja në traditën.

Në studimet letrare bashkëkohore, zhvillohet një debat i hapur për çështjet e kanonit letrar mes teoricienëve të *Cultural Studies* dhe konservatorëve të

⁴ Me çështjet e terminologjisë së letërsisë do të merremi në një kapitull tjetër të këtij libri.

përfaqësuar në këtë rast nga Harold Bloom-i me veprën e tij të famshme “Kanoni perëndimor”⁵. Të parët propozojnë t’i japin të njëjtin dinjitet letrar të gjitha veprave dhe teksteve që të mund të mbërrihet në një vizion të gjerë dhe sa më demokratik të mundshëm të letërsisë, duke u dhënë hapësirë edhe atyre autorëve që tradita i përjashton. Harold Bloom-i, në kundërshtim me multikulturalizmin e shfrenuar të shkollës anglese propozon një kanon të ngurtë, unik dhe tradicional, të përbërë nga 26 autorë me në qendër Shekspirin. Për të, kanoni estetik është gjithnjë një sfidë agnostike e veçantësive të pa reduktueshme, mes tyre dhe të pakapërcyeshme nga vdekja. Këtë ide të Bloom-it e kundërshtojnë disa nga perspektivat postmoderne të teorizimit të kanonit, të cilat janë të orientuara në mënyrë të rrezikshme drejt një demokratizimi fals dhe nivelizues dhe që synojnë ta shndërrojnë kanonin në një arkiv të pafund ku ka vend për të gjithë, e pashmangshmërisht s’ka vëmendje për asnjë. Këtë debat studiuesi Umberto Motta e shtron në formën e pyetjes: “Letërsia dhe shkolla: kanon apo bibliotekë?”⁶

Kjo po ndodh në teoritë moderne dhe rezultatet e këtij debati, që fillesat i ka në analizat e Shkollës së Frankfurtit, kanë filluar të përhapen në letërsitë nacionale të vendeve të ndryshme. Është shkruar për kanonin letrar të letërsisë italiane, gjermane, angleze e me radhë, duke kaluar tashmë në planin e historisë së letërsisë. Në këtë kontekst, &do histori letërsie shihet ose si pranim i pjesshëm i një kanoni, ose si përmbysje e kanonit. Në rastin e dytë, vetë hierarkia, (e përmbysur), pret të pranohet (kanonizohet).

Kundërshtarët e idesë së kanonit shprehen se: “ideja moderne se tekset kanonike janë në thelb të pasura dhe plot variacione kuptimore buron prej nevojës së kritikëve profesionistë dhe mësimdhënësve për të kontrolluar praktikatat e leximit”⁷. Kjo sfidë që e kundërshton idenë e një kanoni të ngurtë në favor të një kanoni “demokratik” paradoksalisht, në letërsinë shqipe lidhet me ideologjinë, jo në kuptimin çideologjizimit të kanonit (bërjes së tij “demokratik”), por me pranimin se kanoni i letërsisë shqipe është në krye të herës ideologjik, që me ideologjinë e Rilindjes Kombëtare, e deri në bashkëkohësi. Kështu, letërsia njëherë kanonizohet sipas ideologjisë për t’u kanonizuar më pas si antimodel i ideologjisë. Në këtë kuptim, sfida për ta shqyrtuar kanonin e letërsisë shqiptare është e dyfishtë. Duke e pranuar këtë sfidë me modesti, hetimet mbi kanonin e letërsisë shqipe do t’i shohim përmes marrëdhënieve të tij me shkollën, me avangardat dhe me kritikën (apo statusin bashkëkohor të kritikës letrare në Shqipëri) sepse në mungesë të një historie

⁵ Harold Bloom, *Il canone occidentale*, I libri e le scuole delle Eta, Bur 2012, Milano

⁶ Umberto Motta, *La letteratura e la scuola. Canone o biblioteca?*, in « La Modernità Letteraria », IV (2011).

⁷ T. Ross, *The making of English Literary Canon. From the Middle Ages to the Late Eigteenth Century*, McGill-Queen’s Up, Quebec City 1998, f. 19

“zyrtare” të letërsisë shqipe, dhe në mungesë edhe të një “pluraliteti” historish të letërsisë shqipe⁸, mund të shqyrtohen tekstet dhe programet parauniversitare.

1. Kanoni dhe shkolla

Që në shekullin II para Krishtit. Aulo Gellio mbështeste idenë se kanonikë janë shkrimtarët klasikë, ata që lexohen në shkollë, nëpër librat shkollorë. Kanonikë janë ata autorë e ata libra që një kulturë apo një qytetërim i ndjen si të domosdoshëm, të detyrueshëm për të ndërtuar e përkufizuar identitetin e vet, modelet e veta. Janë veprat me vlerë, po të përdorim shprehjen e shkollës Tartu: vepra që mund të përfaqëjë një “model bote”, janë libra që, siç ka deklaruar George Steiner-i, ja vlen t’i takosh: vepra që venë në diskutim vetë qenien tonë. Historia e letërsisë është prova e kanonit letrar.

Harold Bloom-i i përmbahet idesë se formimi i një kanoni nuk është një proces arbitrar, poetët mbijetojnë në kanon jo për shkak të përzgjedhjes së shijes së kritikëve apo profesorëve, por për shkak të forcës së vet të brendshme, për shkak të mundësisë që kanë për t’i përçuar lexuesit pathosin e një jete më intensive, pra me më shumë kuptim. Forca e asaj çka është kanonike – shkruan Bloom-i, shpërfaqet në këmbënguljen e heshtur të shkrimtarëve më të fuqishëm; fuqia e tyre ndikuese në planin edukativ është e pashtershme, për arsien dhe zemrën e njeriut ata janë të pakundërshtueshëm. Edhe vetë Trocki, i cili natyrisht nuk mund të quhet intelektual i pa impenjuar, refuzonte ta shihte “Komedinë hyjnore” thjeshtë si një dokument historik.

Por a është kanoni vërtet, siç ka teorizuar Kermode, thjesht dhe vetëm një ngurtësim i traditës? Të lexosh një autor të së shkuarës, - shkruante Eliot-i do të thotë të bësh një sakrificë, të heqësh dorë momentalisht nga e tashmja jote dhe personaliteti yt në këmbim të diçkaje më të çmuar. Të krijosh intimitet me të vdekurit. – kjo është për Eliot-in dija e fshehtë e letërsisë, gjë kjo që shënon një progres individual dhe kolektiv. Një intimitet që na ndryshon dhe na rizgjon, që na detyron të punojmë e të luftojmë për të vetmen fitore, të denjë ta mbajë këtë emër, edukimin e vetvetes.

* * *

Kostandin A. Chekrezi e botoi më 1921 në Boston tekstin *Këndime për rrjeshtin e fundmë të shkollave fillore*. Në hyrjen e librit shkruhet: “Sikundër duket nga një vështrim që munt të hedhë këndonjësi në tryezën e lëndës, këndimet

⁸ Floresha Dado, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota shqiptare, Tiranë 2009, për një trajtim të detajuar të problemit të historisë së letërsisë shqipe.

përbëhen prej copash të zgjedhura nga shkrimtarë shqiptarë ose të huaj, në mes të cilave disa munt të quhen kryevepra të letraturës shqipe e disa të letraturës së huaj. Ata që kanë vajtur në shkolla turke dhe greke do të mbajnë mend se ç'këndime kishin patur në rrjeshtën e fundme, si dhe në të parat e atyre shkollave. Do të binden pra, siç besonj menjëherë janë të ndryshme nga ato që kanë patur ata.”⁹ Një nga tekstet më të vjetra shkollore të letërsisë shqip, që në krye të herës përcakton një kanon (kryevepra), një kanon subjektiv (copë të zgjedhura nga hartuesi i tekstit) dhe një kanon të ndryshëm (nga ai që ofrohet në shkollat greke dhe turke). Kjo vetëdije, ndonëse e kushtëzuar nga rrethanat e hartimit të tekstit të këndimit (“E di që ka dhe shkrimtarë të tjerë shqiptarë, shkrimet e të cilëve do t'i bënin nder të math dhe do t'i shtonin vlerën kësaj libre, por për fat të keq sot s'kemi as librari (bibliotekë) publike ose private...”¹⁰) dhe nga koha kur hartohet (1921), ka përzgjedhur disa tekste si: *Malli i Atdheut* – F. Konitza; *Gjuha shqip në të shkruar dhe në të folur* – F. Konitza; *Kushtrimi ose La Marseillaise e Shqiptarëve* – F. Konitza; *Një lules veshkun* – Gegë Postrippa; *Mvehtësia e Shqipërisë* – L. Gurakuqi; *Plaku i Ylynecit* – L. Skëndo (autor që nuk është i përfaqësuar në tekstet e letërsisë shqipe aktuale); *Kthimi i Gjerq Katritit në Krujë* – F. S. Noli; *Burri (Pirrua)* – Geg Postrippa; *Dita e flamurit* – F. S. Noli; etj të botuara në gazetat *Albania*, *Dielli*, *Rivista Adriatike* dhe *Illyria*¹¹. Kanoni i letërsisë botërore është shumë më pak bashkëkohor dhe përfshin pjesë nga Shekspiri, Tolstoi, Hygo e Poe.

Vetëm katër vite më vonë, më 1925 Justin Rrota boton tekstin *Letratyra shqype*. Viti duket i largët po të kemi parasysh kohët e letërsisë shqipe, por shumë i afërt po të kemi parasysh traditën e këso tekstesh në përvojën e botës. Në këtë tekst bashkohen në mënyrën më harmonike parime që në debatin e sotëm mbi programet e tekstet shkollore duken të pabashkueshme, të papajtueshme, përjashtuese: parimi i letërsisë si shkrim (literatura për letra); parimi i letërsisë si komunikim (përmasa e receptuesit); parimi i letërsisë si e tillë (letërsia dhe dominanca e parimit estetik); parimi i letërsisë si formë (gjinitë) dhe parimi i letërsisë si referencë (historike, identitare, ideore, politike, gjeografike etj).

Teksti përmban librin e parë: *Parime letrare* ku shpjegohet ç'është subjekti, ç'është të shprehurit, ç'është stili, ç'është trajta, ku në prozë specifikohet përshkrimi, kallximi, parashtrimi në poezi masat metrike e llojet e poezisë sipas trajtës a formës.

⁹ Costandin A. Chekrezi, *Këndime për rrjeshtin e fundmë të shkollave fillore*, Boston Mass 1921, f. 5

¹⁰ Po aty, f. 6

¹¹ Po aty, f. 7

Libri i dytë është një Histori e Letratyrës Shqype ku autori rendit “autorët ma në shej”¹² duke i shoqëruar me një antologji tekstesh të përzgjedhura nga vepra e tyre.

Në vitin 1925, vetëm pak më shumë se një dekadë nga krijimi i shtetit shqiptar, Justin Rrota e gjen me vend të shpjegojë arsyet e strukturës së sipërpërshkruar të librit. Parimet letrare i shërbejnë nxënësit shqiptar për të njohur e mësuar modelet e shkrimit letrar e jo vetëm, në një kulturë të mbizotëruar nga oraliteti; histori e letratyrës i ndihmon nxënësit të njohin e të mësojnë se,, megjithëse “inter arma silent Musae” kombi shqiptar diti ta ruej ekzistencën e vet me forcë e ta përmirësojë atë përmes dijës e letërsisë”.

Krijimi letrar në këtë tekst të parë mësimor të letërsisë shqipe baraspeshon letërsinë si të tillë me letërsinë si utilitet e më shumë si identitet për një komb që me “motin e madh” të De Radës kish nisur rrugën për rigjetjen e vetvetes. Mitet e mëdha të letërsisë së Rilindjes, miti i Skënderbeut dhe i Motit të madh, mite letrare që migrojnë prej historisë, marrin përmasën mitike në letërsi dhe i kalojnë sërish reales si mundësi veprimi.

Libri me dy vëllime *Shkrimtarët shqiptarë*, i botuar nën kujdesin e Ernest Koliqit, ministër i arsimit i Shqipërisë së viteve '40 është ndalesa tjetër. Autorët e kanë konceptuar këtë libër si antologji të komentuar, të pajisur me shënime të shumta filologjike dhe me një jetëshkrim të shkurtër të autorëve. Përfshirja në këta vëllime edhe e atyre shkrimtarëve që duke u nisur nga parime të pastra vlerash letrare nuk do të ishin pjesë e antologjisë komentohet kështu në pasthënie: “Ky vëllim përmbledhi shkrimtarët e perjudhës të quejtun e Rilindjes ... shumë prej sish u janë kushtuem letravet ma fort me një qëllim të jashtëm: patën parasysh apostullimin kombtar – si e lypte n’atë kohë nevoja e atdheut – sesa artin... Këta meritojnë qi rinija jonë t’i ket si shembull veprimi dhe të shofë si të Parët e saj të një kohe punuen pa pushim simbas zotsis... për t’i vum themele të shëndosha ides kombtare, gjuhës e letërsis qi janë vula pavarisje.”¹³

Ndryshimi i regjimit do të sillte edhe ndryshimin mendësisë edhe të parimeve mbi të cilat do të studiohej letërsia në shkollat shqiptare. Kryet e vendit e zuri ideologjia marksiste leniniste, siç shprehet qartë edhe në hyrjen e botimit të *Historisë së letërsisë shqipe 1959*:

“... nevoja e domosdoshme për ta vënë arsimin dhe shkencën tonë në bazat e marksizëm-leninizmit; programet dhe tekstet e reja shkollore, arsimit i cili u vu në shërbim të popullit dhe të ndërtimit socialist të vendit, kërkon njohuri shkencor e të sakta dhe të gjera...” Një nga kriteret e hartimit të këtij teksti është: “të

¹² Justin Rrota, *Letratyra Shqype për shkollat e mjesme*, Botimet Franceskane 2006, Libri sipas botimit të vitit 1925

¹³ *Shkrimtarët shqiptarë*, Pjesa e dytë, Pakti, Tiranë 2007, f. 360. Libri sipas botimit të vitit 1941

*përpiqemi, brenda mundësive të vëmë në dukje disa nga autorët dhe veprat përparimtare me një farë vlere artistike, që në regjimet antipopullore dhe fashiste janë lënë në harresë dhe në errësi*¹⁴.

Në programet zyrtare të shkollës tetëvjeçare të *Gjuhës shqipe* dhe të *Leximit letrar* të vitit 1963 shfaqet po e njëjta mendësi: “Studimi i leximit letrar ka rëndësi të madhe për formimin e bazave të botëkuptimit marksist-leninist të nxënësit ... në mësimet e leximit letrar vëmendje të veçantë i kushtohet zhvillimit të ndjenjave të patriotizmit, qëndrimit socialist ndaj punës, detyrës dhe nderit, mundësisë dhe zotësisë për të çmuar krejt karakteret dhe sjelljet e njerëzve, zgjimit të dëshirës për të kryer akte si të heronjve pozitivë të pjesëve dhe veprave letrare.”¹⁵

Pjesët e përzgjedhura janë grupuar sipas disa kriterëve krejt jo estetike si: *Shkrimtarët tanë për traditat e popullit dhe luftat e tij për liri; Pjesë për luftën nacional –çlirimtare; Puna. Ndërtimi i socializmit; Pjesët për paragjykimet fetare etj.*

Duke u bërë gjithnjë e më i ngushtë e gjithnjë e më ideologjik, kanoni i letërsisë shqipe dhe botërore të mësuar në shkollën shqiptare për gati pesëdhjetë vite ka pasur të bëjë shumë pak me shijen, apo traditën. Në kanon nuk qëndrojnë ata autorë gjenialë të së shkuarës që janë të aftë që me fjalët e veta të na plotësojnë nevojat e të sotmes. Me “aktualitetin e vet banal dhe fyes, ai na jep një pikë nga ku mund të vendosemi për të parë përpara ose pas”¹⁶.

Le të shohim tekstin e vitit 1979 *Leximi letrar*¹⁷. Teksti “kanonik” i leximeve është i ndarë në 4 kapituj me këtë rend: “të folklorit, të letërsisë së realizmit socialist, të letërsisë së Rilindjes dhe të Pavarësisë si dhe të letërsisë së huaj”¹⁸. Në kapitullin e parë, nga dhjetë pjesët që kanë autor Popullin spikasin vjersha si *Pesëvjeçarët u bënë gjashë; I dridh bjeshkët fuqia e klasës*. Në kapitullin e dytë kanoni i letërsisë së realizmit socialist përfaqësohet mes të tjerësh nga: *Me gjoks mbi tanks; Në inaugurimin e uzinës mekanike; Kooperativistet e Këmishajt; Heronjtë e Linasit*. Edhe përzgjedhja e pjesëve nga autorët e letërsisë së Rilindjes dhe të Pavarësisë nuk i shmanget parimit të funksionalitetit me *Bagëti e bujqësi; Kthimi i Skënderbeut ë Krujë; Shpell e Dragobisë apo Kanga e rinisë*. Kapitulli i fundit jep këtë model kanonik të letërsisë botërore: *Vladimir Iliç Lenini* i Majakovskit; *Mësuesi* i Barbysit; *Faustini* i L. Vijeiro; *Gavroshi* i Hygoit dhe *Dëshpërimi i Harpagonit* nga Molieri.

¹⁴ Historia e letërsisë shqipe, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Historisë, Tiranë 1959

¹⁵ Programi i shkollës tetëvjeçare Gjuhë shqipe dhe Lexim letrar, Botim i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Tiranë 1963, f. 22

¹⁶ Italo Calvino, vep.cit. f. 21

¹⁷ G. Marko, I. Nelaj, Leximi letrar 7, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1979

¹⁸ G. Marko, I. Nelaj, Leximi letrar 7, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1979, f. 3

Nga *Leximi letrar* për shkollën tetëvjeçare shkojmë në programet e shkollës së mesme të vitit 1983¹⁹. Mosha e nxënësve është rritur, është kaluar nga edukimi me “shijen” e leximit, tek analiza e veprave të plota dhe e periudhave e rrymave letrare, por kanoni dhe qasja ndaj tij mbetet e njëjtë. Në vitin e dytë të shkollës së mesme, nxënësit shqiptarë e mësojnë letërsinë e bejtësinjve duke theksuar vlerat pozitive të saj, shprehjen e pasigurisë së masave të varfra të popullit dhe të pakënaqësisë spontane të tyre në kushtet e sundimit të egër feudal dhe të marrëdhënieve kapitaliste që po lindin²⁰; veprën e Naim Frashërit, specifikisht *Historinë e Skënderbeut* (pjesë nga e cila kanë pasur edhe në shkollën tetëvjeçare) si vepër të plotë e analizojnë në kërkim të “idesë së luftës së armatosur të masave”²¹; *Andrra e jetës*, një nga poemat brilante të lirikës shqipe që nuk ka asgjë të përbashkët me kanonin funksional të letërsisë shqipe analizohet si “realiste në pasqyrimin e jetës” duke theksuar “shqetësimin e autorit për gjendjen e fshatarësisë”²². Pak a shumë të njëjtin fat kanë edhe *Këngët e Milosaos*. Letërsia kanonike botërore duket më e mbrojtur kur has autorë si Homeri, apo Shekspiri, por tek *Iliada* analizohet “pasqyrimi i marrëdhënieve shoqërore në vepër”²³ ndërsa *Makbethi* analizohet në filtrin e “artit realist dhe kritikës ndaj sistemit feudal dhe marrëdhënieve kapitaliste që po lindin”²⁴, sa për të përmendur vetëm disa përfaqësues. Këndvështrimi i skajshëm kontekstual i programit të ndërmend disa teori ultramarksiste bashkëkohore të *Cultural Studies* që refuzojnë kanonin e Shekspirin si qendër të kanonit (sipas Bloom-it²⁵), ose më saktë e reduktojnë atë në kontekst, me shpresën se kështu do të mundin “tiranin”

Kanoni, siç e ka shpjeguar Northrop Frye tek *Anatonia e kritikës*, është trashëgimia, pasuria kulturore që shkolla ka për detyrë të konservojë dhe të transmetojë. Kjo detyrë nuk përmbushet as në tekstin e vitit 1991. Në tekstin *Leximi letrar* 6²⁶ të këtij viti, janë përfshirë në program autorë si Gjergj Fishta, Faik Konica, Ali Asllani me tekste që mund t’i afroreshin kanonit të letërsisë shqipe të viteve ’30-’40. Por ky “arnim” nuk ka sjellë asnjë ndryshim në “kanonin” e letërsisë shqipe që konservon dhe transmeton shkolla. Nga Çajupi mbetet kanonik *Fshati im* apo *Vdiq Naimi*; nga Naim Frashëri *O sa bukuri ka tufa* ose *Skënderbeu dërgohet peng*; nga Ndre Mjeda *Malli për atdhe*; nga Mihal Grameno *Lufta e Mashkullorës*; nga

¹⁹ Programet për shkollat e mesme për klasat II,III, IV, Gjuha shqipe dhe letërsia, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1983

²⁰ Po aty, f. 17

²¹ Po aty, f. 19

²² Po aty, f. 20

²³ Po aty, f. 21

²⁴ Po aty, f. 22

²⁵ Harold Bloom, *Il canone occidentale*, I libri e le scuole delle Eta, Bur 2012, Milano, f. 48

²⁶ Gj. Zheji, N. Xhafka, *Leximi letrar 6*, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1991

Lasgush Poradeci *Dremi liqeri* dhe *Si lindi himni kombëtar Flamurit pranë të bashkuar*; ndërsa poeti më i përfaqësuar mbetet Populli.

Për të vendosur se çfarë duhet të kujtojmë nga një letërsi, duhet të kuptojmë se çfarë nuk duhet të harrojmë. Që nga koha e Aristotelit janë përvijuar dy tipa kujtese: *mneme* dhe *anamnemis*. E para është totalizuese: kujton gjithçka, por në mënyrë pasive, gati patologjike, thjesht duke shtuar të dhëna. E dyta, përkundrazi, është një proces aktiv, që përmes përzgjedhjes, synon rindërtimin. Teksti i parë i një programi të rindërtuar të letërsisë në shkollën e mesme shqiptare i vitit 1996 priret të rindërtojë kanonin e letrarisë duke iu referuar *anamnemis*-it. Kanë ndryshuar rrethanat, por, mbi të gjitha qasja: ajo e shmang përgjithësisht jashtëletraren. Kjo pikënisje e ndryshme ndjehet që në hyrje të tekstit “Letërsia shqiptare e vjetër”: *“Pjesa e parë përshkrohet nga synimi që letërsia shqiptare që nga lindja e saj deri në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të mos trajtohet më si dokument gjuhësor i një kohe, por si letërsi e një periudhe të caktuar. Ky qëllim arrihet nëpërmjet interpretimit të veprave të autorëve të moçëm shqiptarë, duke u mbështetur në tekstet e më pak në ideologjinë sunduese të kohës. Te secili autor është kërkuar veçoria letrare karakteristike, për të arritur në një përmbledhje veçorish të kësaj periudhe të rëndësishme të letërsisë shqiptare...”*²⁷

Natyrisht do të duhej që ndërtimi i kanonit të letërsisë në shkollën shqiptare të kalonte përmes projektit dhe pashmangshmërisht përmes konfliktit të veprave që zgjidhen për të qenë pjesë e kanonit, përmes këndvështrimeve të shijes dominante dhe shijes elitare, si dashuri e ndryshme, por, gjithnjë e njëjtë për letërsinë si të tillë, si njohje të vetvetes e botës. Por, nuk ka ndodhur kështu. Nga vitit 1996 në shkollën shqiptare programet janë ndërruar të paktën 10 herë, tekstet edhe më shumë se kaq, përfaqësimi i autorëve dhe veprave të tyre, vetëkuptohet. Që prej vitit 2001 në shkollat shqiptare, mësimi i letërsisë nuk është më histori e letërsisë. Jo vetëm nuk është histori autorësh, siç mësohej tradicionalisht letërsia në shkollë, por nuk është as histori tekstesh, as histori veprash, as histori rrymash, as histori gjinish. Thjeshtë, letërsia nuk është më historike. Dhe nuk ka sesi të mos biesh dakord me këtë. Letërsia është e pakohë, si e bukura dhe e shëmtuara.

Po cilët janë veprat e autorët e letërsisë shqipe dhe botërore të përfaqësuar sot në tekstet shkollore aktuale? Programet shkollore aktuale nuk japin asnjë “listë rekomanduese” për autorët e letërsisë shqipe dhe botërore që mund të përfshiheshin në tekste. “Demokratizimi” ka dhënë këtë rezultat:

Numri i autorëve nga letërsia shqipe dhe botërore tekstet e të cilëve lexon një nxënës nga nisja deri sa bëhet 14 vjeç janë: 27 autorë vetëm në klasën e dytë; 47 në klasën e tretë dhe vetëm 15 prej tyre janë nga autorët e lexuar në klasën e dytë; 51 autorë në klasën e katërt dhe vetëm 20 nga autorët e lexuar në klasat pararendëse;

²⁷ S. Hamiti, *Letërsia shqiptare e vjetër*, SHBLSH, Tiranë 1996

*Për të shprehur kohën kur kryhet ose kur ka filluar, ose mbaruar një veprim e përdorim parafjalën **me**. Në rastet të tilla në gjuhën maqedonase, kemi përdorimin e parafjalës ekuivalente **me** dhe ajo është parafjalë .

- kufizim:

Nuk donte të ndahej nga ne, sadoqë me moshë ishte më i vogël.

-lëndën me të cilën është ndërtuar ose është mbushur një send:

Inxhenerët po ndërtonin me shpejtësi një urë me trungje pishash.

*Për shprehjen e një kufizimi në gjuhën maqedonase kemi përdorime edhe të parafjalës së njëjtë edhe përdorimin i parafjaës që është ekuivalenti i parafjalës **me** në gjuhën maqedonase.

- shkak:

*Të gjithë gajaseshin **me** shakatë e xha Kadriut.*

*Në shembullin e parë dhe të dytë vërejmë përdorimin e së njëjtës parafjalë edhe në gjuhën maqedonase, kurse në shembullin e tretë kemi përdorimin e ekuivalentit të parafjalës *me* në gjuhën maqedonase dhe ajo është .

- tipar, cilësi:

*Pyjet **me** dushk kishin marrë një ngjyrë të kuqe.*

*Në të gjithë shembuj që i kemi më lart, shihet përdorimi i së njëjtës parafjalë edhe në shqipe edhe në maqedonishte, kemi përdorim të së njëjtës parafjalë kur shprehim tipar apo cilësi.

- kusht:

***Me** një kujdes më të madh mund të ishin shmangur edhe këto mangësi.*

*Për shprehjen e kushtit, përdorimi i parafjalës së përshtatshme në gjuhën maqedonase është i njëjtë, parafjalët ***me – c*** , dhe nga kjo pamje mund të them se gjuha shqipe dhe gjuha maqedonase janë shumë ngjashme kur bëhet fjalë për përdorimin e parafjalës *me*.

Parafjalë MBI

Mendohet se edhe parafjala ***mbi*** ka prejardhjen greke. Në krahasim me parafjalën *me* e cila përdoret dendur te Buzuku, parafjala *mbi* gjendet rrallë. Përdorimi i rrallë i saj nuk do të thotë se s'është një parafjalë e hershme.

Parafjala ***mbi*** përdoret në rasën kallëzore, përdorimi me këtë rasë është një dëshmi për vjetërsinë e saj. Me përdorimin bashkë me një emër ose një përemër, shënon sendin, vendin etj., në sipërfaqen e të cilit ndodhet ose lëviz dikush a diçka, bëhet ose zhvillohet diçka.

Sendin, vendin etj., në hapësirën sipër të cilit ndodhet ose lëviz dikush a diçka, kryhet një veprim etj. Dikë, kundër të cilit veprimë ose një vend, drejt të cilit hidhemi, përdoret zakonisht në tituj veprash shkencore, publicistike etj. Dikë a diçka që është nën një tjetër ose diçka sipër, përtej a jashtë së cilës bëhet një punë, krijohet një gjendje e re etj. Sendin që shërben si objekt i veprimit, një shkallë të lartë të cilësisë a të gjendjes që shprehet nga emri etj.

ç) Gjymtyra e prirë nga parafjala ***mbi*** mund të tregojë:

-vendi mbi të cilin gjendet diçka a ndodh një veprim:

*Aeroplani këtë radhë fluturoi fare ulët **mbi** kokat tona.*

*Drapri i artë i hënës shkëlqente **mbi** malin e Dajtit.*

*Kuptimi kryesor i parafjalës *mbi* është shprehja e vendit mbi të cilit gjendet diçka ose ndodh një veprim ashtu siç kemi në këta shembuj. Prej këtyre shembujve vërejmë se përdorimit të parafjalës *mbi* i jepet edhe gjuhës maqedonase dhe kemi përdorim të së njëjtës parafjalë dhe në gjuhën maqedonase.

-Nga ky kuptim konkret është zhvilluar kuptimi i fytyruar i të qenit në një shkallë më të lartë sesa e një madhësi e caktuar

Ishte tre kg mbi peshë.

*Përdorimi i parafjalës *mbi* dhe kuptim i saj nuk dallohet shumë nga kuptimi e përdorimi i saj në gjuhën maqedonase dhe për atë shkak e gjejmë përdorimin e të së njëjtës parafjalë edhe në gjuhën maqedonase.

- objektin e të kuptuarit, të mendimit, të ndjenjeve etj:

Sidoqoftë pikëpamjet e tua mbi jetën e njerëzit, mbi paqen e luftën-tha Besimi-shpeshherë janë të thata.

*Prej këtyre shembujve vërejmë një parafjalë e gjuhës maqedonase që është parafjalë ekuivalente e parafjalës *mbi* e shqipes. Kjo parafjalë e ka të njëjtin kuptim në gjuhën maqedonase si parafjala sepse ato janë parafjalë sinonimike, por përdorimi i saj do të varet nga konteksti i fjalisë.

(Përdorimin e parafjalës *mbi* me këtë kuptimin e fundit që ndeshet kryesisht në stilin publicistik e shkencor, është ndikim prej gjuhësh të huaja dhe prandaj në këto raste duhen përdorur parafjalët shqipe për (za), rreth ():

U diskutua për (ose rreth)...., Foli për...., Dekret për.....

()....,,

Gjorgje BOZHVIQ

**THEKSI I FJALËS NË MORFONOLOGJI TË SHQIPES:
TEORIA METRIKE DHE E OPTIMALITETIT**

Theksi i fjalës në shqipen rregullisht vendoset mbi morën e parë të këmbës metrike dymorëshe të fundit të rrënjës së fjalës, ashtu që të gjithë tema gramatikore janë paroksite apo trokaikë. Mbaresat flektive janë metrikisht të parëndësishme për rregullat e vendosjes së theksit në morfonologjinë e shqipes, ashtu që theksi i fjalës në shqipen mbetet i palëvizshëm në morfologji të fjalëve. Përbrenda teorisë së optimalitetit, shtrëngesat fonologjike të theksimit dhe të këmbëve metrike të fjalëve në gjuhën shqipe do të thonë, mes të tjerave, që këmbët në fonologji të shqipes janë binare dhe trokaikë, dhe në fjalët strukturohen nga djathtas–majtas; që çdo rrokje në fjalë duhet t’i përket këmbës së saj; edhe që theksimi i shqipes në përgjithësi varet nga sasia fonologjike.

1. Hyrje

§I. Përshkrimi gjuhësor i strukturës prozodike të gjuhës shqipe mbetet midis çështjeve ende të pazgjidhura në kërkimet e sotme të morfonologjisë së shqipes. Ashtu p. sh. vendosja e theksit të fjalës në gjuhën shqipe në literaturën albanologjike zakonisht merret si një fenomen fonetik, i parregullt dhe i paparashikueshëm. Kryesisht në gramatikat deskriptive–tradicionale të gjuhës shqipe qëndron mendimi se vendosja e theksit të fjalës në prozodinë e shqipes nuk mund të përcaktohet me rregullat gramatikore (kq. p. sh. Dodi & Gjinari 1983: 129).

Theksi i fjalës, apo theksi leksikor, përkufizohet në fonetikë dhe në fonologji si efekti i prodhuar nga shqiptimi më i fuqishëm i njëres prej rrokjeve të fjalës — asaj të theksuar; se shqiptimi i të tjerave — të patheksuara. Ky lloj i theksit, andaj, bëhet jo vetëm thjesht fonetik, por edhe njësi morfonologjike e gjuhës, se funksionon si shenja e qëndrueshme e fjalëve në të folurit. Kështu theksi leksikor ndryshon nga ai i fjalisë, apo theksi sintaksor, i cili varet nga konteksti paralinguistik ose pragmatik, dhe prandaj nuk bëhet njësi strukturore e gjuhës vetë. Ky dallim midis të dy llojeve të theksit — njëri në përgjithësi thjesht fonetik e paralinguistik, dhe i tjetri krejt strukturor morfonologjik — mbetet ende i pavëzhguar në studimet gjuhësore deskriptive–tradicionale të shqipes, ashtu siç të gjuhëve të tjera.

2. Themelimi i aksentologjisë së shqipes

§II. Nga ana tjetër, për shkak që gramatika transformativë–gjenerative e ka një aparat eksplanator më të fortë se ai i gramatikës deskriptive–tradicionale, në literaturë shfaqen edhe ca shpjegime teorike të vendosjes së theksit leksikor në gjuhën shqipe përbrenda kësaj teorie të gjuhës. I pari që ka provuar t’i formulojë rregullat e vendosjes së theksit të fjalës në gjuhën shqipe sipas fonologjisë gjenerative standarde, të themeluar në veprën e Chomsky-t & Halle-s (1968), ishte Bevington-i (1974: 24–25); kq. rregull të tij në (1):

$$(1) \quad V \rightarrow [+ \text{theksuar}] / _ C_0]_{\text{temë}} \begin{pmatrix} e \\ a \\ o \\ \text{ə}(C) \\ as \\ ut \end{pmatrix} \quad [- \text{folje}]$$

Megjithatë, kjo rregull, siç e ka formuluar Bevington-i, nuk i referohet klasës natyrale fonologjike, dhe e ndryshon vendosjen e theksit në temat emërore prej asaj në temat foljore të shqipes. Gjithashtu, nuk i përfshin ato tema emërore që mbarojnë me zanoret [e], [a] dhe [o] të theksuara (si p. sh. *kafé, pará, byró*, etj.), ato q’ e kanë zanoren [ə] në rrokjen e theksuar (si p. sh. *jasték*), apo ato tema njërrrokëshe me mbaresat në (1), të cilat sipas Bevington-it nuk do të merrnin asnjë theks (p. sh. *fe, ka* etj.). Bevington-i me rregull të tij gjithashtu nuk i përfshin as ato tema emërore me mbaresën –[ur] të patheksuar (siç *flútur*), dhe duhet t’i trajtojë temat që mbarojnë me diftong me një rregull fare tjetër (Canalis 2007: 5; Bevington 1974: 26).

§III. Mirëpo, qëndrimi i shpallur te Bevington-i — që rregullat e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen zbatohen vetëm brenda domenit të temës, apo rrënjës së fjalës, në mënyrë që mbaresat flektive janë metrikisht të parëndësishme, por sufiksët të derivacionit të fjalëve janë nënshtruar rregullave ciklike të vendosjes së theksit të fjalës, dmth. që vendosja e theksit në gjuhën shqipe është e ndjeshme ndaj kontekstit morfologjik të fjalës, siç më vonë pikërisht do të jetë hulumtuar brenda teorisë së fonologjisë leksikore (p. sh. Kiparsky 1982; Mohanan 1986); — faktikisht e ka mundësuar përgjithësimin teorik të rregullave të vendosjes së theksit në morfologjinë e shqipes. Qëndrim të njëjtë ndaj temës gramatikore të fjalës si domenit të vërtetë të vendosjes së theksit do ta marrin edhe kërkuesit e tjerë të sistemit aksentor të gjuhës shqipe. Edhe pse në të vërtetë më shumë intuitivisht, sesa krejt formalisht, kjo ishte e vërejtur edhe te Newmark-u et al. (1982: 15) dhe Buchholz-i & Fiedler-i (1987: 53).

3. Teoria e optimalitetit

§IV. Pas Bevington-it, disa hulumtime të tjera gjuhësore të aksentologjisë së shqipes kanë vazhduar të bëheshin sipas teorisë transformative–gjenerative të fonologjisë, kryesisht në fushën e teorisë së optimalitetit (Maynard 1997; Trommer 2004; 2009), si edhe në fushën e teorisë metrike të fonologjisë (Canalis 2007). Të gjithë pajtohen patjetër që domeni i vërtetë i rregullave të vendosjes së theksit leksikor në shqipen është vetëm tema gramatikore e fjalës, dmth. që ato morfema flektive djathtas kufirit të temës janë të parëndësishme për vendosjen e theksit, prandaj rregullat e saj nuk zbatohen mbi to. Të dhënat e gjuhës shqipe e konfirmojnë këtë qëndrim, se mbaresat flektive në shqipen kurrë nuk janë të theksuara. (Përveç mbaresave të numrin shumë të emrave, të tipit $[-iɲ]$, $[-eɲ]$, p. sh. *lúm* : *lum-énj*, por ato mbaresa janë të rimorfologjizuar sipas analogjisë me mbaresën e shumësit $[-ɲ]$ < $*-n-ai$, siç në *ftua* : *ftonj*, që të sillen në gjuhë si mbaresat e përbërë nga zgjerimi i temës gramatikore të fjalës, i tipit $[-in]$, $[-en]$, me mbaresën e numrin shumë të emrave $[-j]$ < $*-ai$, kështu që faktikisht temat e plotë të rimorfologjizuar t'atyre emrave janë në sinkroni të gjuhës të theksuara sipas analogjisë, dhe jo mbaresat; kq. edhe tek Orel-i 2000: 230–231).

§V. Pra, një kërkim tjetër fonologjik i sistemit theksor të gjuhës shqipe ka qenë i kryer nga Maynard-i (1997) sipas teorisë së optimalitetit të fonologjisë së gjuhës, një teorie të re në gjuhësinë gjenerative, të themeluar në veprën e Prince-it & Smolensky-t (1993). Analiza e saj e theksit leksikor të shqipes i ka zbuluar ca shtrëngesa të rëndësishme të fonologjisë së gjuhës shqipe (p. sh. orientimin e djathtë të theksit në shqipen), ashtu si rangun e tyre në strukturën morfonologjike të shqipes, por prapëseprapë asaj i mungon një formulim krejt i pranueshëm i rregullave të vendosjes së theksit të fjalës në shqipen; kq. në (2).

(2) FUTJE FONOLOGJIKE: *pú.në.-tór*

	Një theks për fjalë	Besnikëria e nxjerrjes	Theksoje anën e djathtë
<i>pú.në.-tór</i>	*!		
<i>pú.në.-tor</i>		*	*!
➤ <i>pu.në.-tór</i>		*	
<i>pu.në.-tor</i>		**!	

§VI. Një analizë tjetër, e kryer nga Trommer-i (2004; 2009), gjithasthu përfundon që theksi i fjalës në shqipen e ka orientimin e djathtë, por që është i


ndjeshëm ndaj cilësisë, apo kualitetit të zanoreve, ashtu si edhe ndaj peshës së rrokjeve të fjalës. Trommer-i (2009) e bëri një kërkim edhe më tutje në palëvizjen morfologjike të theksit leksikor të shqipes, duke vënë në dukje një analizë ciklike të palëvizjes së theksit të shqipes (kq. Bermúdez-Otero 2011); kq. formulimin e tij të shtrëngesave të vendosjes së theksit të fjalës, dhe rangun e tyre në shqipen në (3), si e paraqitur te Canalis-i (2007); dhe analizën e tij të palëvizjes së vendosjes stratale-ciklike të theksit të fjalës në (4), siç e paraqiti Bermúdez-Otero (2011).

- (3) $*[\text{ə}]_{\sigma}[\text{temë}] \gg \text{peshë/theks}[\text{temë}] \gg *[-\text{mbyllur} -\text{hapur}]_{\sigma}[\text{temë}] \gg$
 VENDOSE(, djathtë, temë, djathtë) $\gg *[\text{+mbyllur}]_{\sigma}[\text{temë}] \gg *[\text{+hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$

Shtërngesa fonologjike VENDOSE(, djathtë, temë, djathtë) e thekson anën e djathtë të temës së fjalës, por shtërngesa $*[-\text{mbyllur} -\text{hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$ parandalon që të theksohen zanoret gjysmë të mbyllura kur janë në fundin e djathtë të temës. Mirëpo, zanoret gjysmë të mbyllura janë të theksuara kur ndodhen në një rrokje të mbyllur, dhe shtërngesa për vendosjen e theksit mbi rrokjen e mbyllur, sipas peshës së rrokjes (peshë/theks) $[\text{temë}]$, e mundëson atë se rreshtohet më lart sesa shtërngesa $*[-\text{mbyllur} -\text{hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$. Zanoerja [ə] është më rrallë e theksuar, dhe rangu i shtërngesës fonologjike $*[\text{ə}]_{\sigma}[\text{temë}]$ e pasqyron atë fenomen. Më në fund, shtërngesat fonologjike $*[\text{+mbyllur}]_{\sigma}[\text{temë}]$ dhe $*[\text{+hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$ e pasqyrojnë dukurinë që zanoret [i] e [a] janë më shpesh të theksuara në shqipen, kur ndodhen në rrokjen e fundit të temës së fjalës.

Megjithatë, sipas Canalis-it (2007: 6–8), ka edhe disa probleme me atë analizë teorike të theksit të fjalës në shqipen, të Trommer-it, siç në (3). Një shpjegim plotësisht i pranueshëm i ekzistencës së rrokjeve të theksuara me zanoren [ə] në gjuhën shqipe te Trommer-i mungon. S'ka shpjegim për temat që mbarojnë me $-\text{[u]}$ të patheksuar, dhe shpjegimi i Trommer-it për temat që mbarojnë me $-\text{[ur]}$ të patheksuar nuk i përfshin të gjithë raste të kësaj dukurie. Po në fund të fundit, qëndrimi teorik më origjinal i analizës së tij — ai, që cilësia e zanoreve ndikon vendosjen e theksit të fjalës në shqipen — sipas tipologjisë së gjuhëve duket pak i çuditshëm, sepse Trommer-i e lidh theksimin e zanoreve jo me sonoritetin e tyre, por me periferalitetin e tyre në sistemin zanoresh, kështu që zanoret joqendrore gjysmë të mbyllura, [e] dhe [o], tek ai duken të jenë tipologjisht më të preferueshme kur janë të patheksuara sesa, siç pritet, kur janë të theksuara (Canalis 2007: 6–7); në fjalët e Canalis-it:

There are some problems with this proposal. Some involve further constraints, which [...] look more descriptive than explicative. [...] With regard to one of [Trommer's] central claims, that regarding the influence of the vowel quality on stress position, from a typological point of view stress systems influenced by vowel quality are attested [...]. But they are all based on the sonority scale: more sonorous vowels tend to attract stress, and less sonorous vowels tend to avoid it. Instead according to Trommer in Albanian there would be a hierarchy of stressability /i a u y/ > /e o/ > /ə/ (going from the most easily stressable vowels to the least stressable), since central vowels would avoid stress more than peripheral vowels. Now, in numberless languages [ə] is typical of unstressed vowels, but this proposal is much less well-grounded for mid non-central vowels. As a matter of fact, in several languages mid vowels are possible only if stressed [...]. Moving from more theoretical problems to the empirical, [...] the validity of [Trommer's] constraints is only statistical [...].




4. Teoria metrike e fonologjisë

§VII. Canalis-i (2007) e ka kryer një analizë teorike të theksit të fjalës të shqipes sipas teorisë metrike të fonologjisë (kq. Liberman & Prince 1977; Hayes 1995). Analiza metrike e tij e vendosjes së theksit leksikor në shqipen është bazuar në propozimin që theksimi i gjuhës shqipe varet nga pesha e rrokjeve, ashtu si te Trommer-i (2004; 2009), që zbatohet vetëm në domenin e temës së fjalës, ashtu si te Bevington-i (1974) e të tjerët, dhe q'ë ka një orientim të djathtë, ashtu si te Maynard-i (1997). Sipas Canalis-it, shqipja është në morfonologjinë e saj e ndjeshme ndaj sasisë metrike, apo kuantitetit të rrokjeve, dmth. ndaj numrit të morave të tyre, apo peshës së tyre, dhe jo ndaj cilësisë së zanoreve në rrokje. Rrokjet mund të jenë të rënda, kur janë të gjata ose të mbyllura, apo kur e përmbajnë ndonjë diftong, e prandaj përbëhen nga dy mora; apo mund të jenë të lehta, kur janë të shkurta dhe të hapura, e prandaj përbëhen nga një morë metrike. Rrokjet dhe morat e tyre i formojnë këmbët metrike. Prandaj, në prozodinë e shqipes, në fjalët e Canalis-it, këmba kryesore dhe e theksuar gjendet në fundin e djathtë të temës së fjalës, dhe është e përbërë nga dy mora me aksentin paroksiton.

Në fjalë të tjera, rregulla e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen do të thoshte se, në çdo fjalë të gjuhës shqipe, theksi kryesor vendoset mbi morën e parë të këmbës më të djathtë dymorëshe të temës së fjalës, dmth. që të gjithë temat e shqipes janë paroksitone, me theksin në morën e parafundit (dmth. $\overset{\sim}{\sim}$]_{temë}, $\overset{\sim}{\sim}$]_{temë}, $\overset{\sim}{\sim}$]_{temë}). Kështu, në qoftë se tema mbaron me dy rrokje të lehta, të shkurta dhe të hapura, si *púnë, lúle, bórë, yndýrë, prápa, brénda, anembánë* etj., të dy e përbëjnë një këmbë trokaike dymorëshe, me theksin paroksiton. Në qoftë se tema mbaron me një rrokje të rëndë, qoftë e gjatë ose e mbyllur, qoftë me diftong, ajo rrokje vetë e përbën një këmbë dymorëshe, e prandaj është e theksuar, si *vénd, bilbíl, shtëpí, barí, kalá* etj. (për ato emra me theksin e fundit të temës, të cilat në toskërishten e kanë një morë të përfjetur që aktivizohet nëpër rasa, si *shtë.pí_{μ(μ)} : shtë.pí_μ.së_μ*, derisa gegërishtja e ka një rrokje të gjatë dymorëshe, si *shpí_{μμ} : shpís_{μμ}*, kq. te Canalis-i 2007: 11–13), edhe si *pú:n, bó:r, anembá:n* etj. në gegërishten; kq. në (5) dhe (6). Kjo do të thotë se vendosja e theksit në shqipen zbatohet jo thjesht në nivelin e rrokjeve të fjalëve, por edhe më ulët dhe hollësisht, në nivelin e morave dhe të këmbëve metrike *t'* atyre rrokjeve.

(5) Vendosja e theksit në shqipen mbi rrokjet e lehta:




Mbaresat e patheksuara $-[ur]$ dhe $-[u\text{t}]$ Canalis-i (2007: 10–11) i shpjegon në mënyrë fonotaktike, si pasojën e sipërfaqësor të rregullave të organizimit të rrokjes së shqipes, dmth. të shtrëngesave fonotaktike të rrokjes, q’ e parandalojnë shfaqjen e bashkëtingëlloreve $[r]$ dhe $[t]$ në fundin e rrokjes së mbyllur. Prandaj zanorja $[u]$ në raste të tillë funksionon si zanorja e sipërfaqësor fonologjike që s’ka vlerë të asnjë more për vendosjen e theksit të fjalës, e prandaj mbetet pa theks; kq. në (5).

(6) Vendosja e theksit në shqipen mbi rrokjet e rënda:


a) mbi rrokjet e mbyllura

b) mbi rrokjet me diftongun



c) mbi rrokjet me morën e përfjetur (tosk.)

d) mbi rrokjet e gjata (geg.)



5. Përfundim

§VIII. Që ta shpjegojmë këtë analizë metrike të theksimit paroksiton të shqipes sipas teorisë së optimalitetit (Prince & Smolensky 1993), duhet t'i formulojmë shtrëngesat e sakta fonologjike të sistemit aksentor të shqipes. Siç u tha, shtrëngesat e optimalitetit fonologjik të formuluar nga Trommer-i (2004; 2009) janë më shumë thjesht statistike, sesa janë krejtësisht strukturale dhe formale. Përkundrazi, shtrëngesat formale fonologjike të vendosjes së theksit të fjalës në shqipen duhet t'i përcaktojnë sistemin e theksimit shqip në tërësinë e tij, jo vetëm tendencat e tij që shfaqen në sipërfaqe. Sipas analizës metrike të theksimit shqip të Canalis-it (2007), mund t'i përcaktojmë këto shtrëngesa të optimalitetit fonologjik që funksionojnë në sistemin morfonologjik dhe prozodik të gjuhës shqipe (kq. Prince & Smolensky 1993; Tesar & Smolensky 2000): FOOTBIN, apo KËMBA ËSHTË BINARE (dmth. këmba metrike duhet të jetë dymorëshe ose dyrokëshe); TROCHAIC, dmth. KËMBA ËSHTË TROKAIKE (këmba metrike e shqipes është paroksitone); ALL-FEET-RIGHT dhe MAIN-RIGHT, dmth. KËMBËT E FJALËS STRUKTUROHEN NGA DJATHHTAS–MAJTAS (orientimi i strukturës prozodike të shqipes është i djathtë, dmth. nga kufiri i djathtë i rrënjëve të fjalëve); PARSE– , apo ÇDO RROKJE DUHET T'I PËRKET KËMBËS (dmth. secilës prej rrokjeve të fjalës duhet t'i jetë caktuar një këmbë); edhe WEIGHT-TO-STRESS-PRINCIPLE (peshë/theks]_{temë}), apo THEKSIMI VARET NGA SASIA E RROKJES (dmth. rrokjet e rënda e tërheqin theksin; rreth kontekstit areal–gjuhësor të kësaj dukurie të veçantë fonologjike kq. te Staniši -i 2003). Rangu i saktë i këtyre shtrëngesave të optimalitetit fonologjik do ta përcaktojë tërësisht vendosjen e theksit të fjalës në morfonologjinë e shqipes.

Referencat

1. Bermúdez-Otero, R. (2011). Cyclicity. In press, in: M. van Oostendorp et al. (eds.), *The Blackwell Companion to Phonology*. Malden, MA: Wiley-Blackwell.
2. Bevington, G. L. (1974). *Albanian Phonology*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
3. Buchholz, O. & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag.
4. Canalis, S. (2007). To what extent is Albanian word stress predictable?. In: A. Bisetto & F. Barbieri (eds.), *Proceedings of the XXXIII Incontro di grammatica generativa* (pp. 1—14). Bologna: University of Bologna.

5. Chomsky, N. & Halle, M. (1968), *The Sound Pattern of English*. New York: Harper & Row.
6. Dodi, A. & Gjinari, J. (1983), *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II: *Fonetika*. Tiranë: AShSh.
7. Hayes, B. (1995), *Metrical Stress Theory*. Chicago: University of Chicago Press.
8. Kiparsky, P. (1982). From cyclic phonology to lexical phonology. In: H. van der Hulst & N. Smith (eds.), *The Structure of Phonological Representations*, vol. I (pp. 131—175). Dordrecht: Foris.
9. Liberman, M. & Prince, A. (1977). On stress and linguistic rhythm'. *Linguistics Inquiry*: 8 (pp. 249—336).
10. Maynard, K. L. (1997), *An optimality analysis of Albanian word stress*. In: Xingzhong Li et al. (eds.), *Papers from the 1997 Mid-America Linguistics Conference* (pp. 94—100).
11. Mohanan, K. P. (1986), *The Theory of Lexical Phonology*. Dordrecht: Kluwer.
12. Newmark, L. et al. (1982), *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press.
13. Orel, V. (2000), *A Concise Historical Grammar of the Albanian Language: Reconstruction of Proto-Albanian*. Leiden: Brill.
14. Prince, A. & Smolensky, P. (1993), *Optimality Theory: Constraint Interaction in Generative Grammar*. In manuscript, Boulder: University of Colorado Boulder.
15. Staniši , V. (2003), *Srpsko-albanski jezi ki dodiri i dva tipa fonoloških sistema u balkanskim jezicima*'. *Balkanica*: 34 (pp. 105—117).
16. Tesar, B. & Smolensky, P. (2000), *Learnability in Optimality Theory*. Cambridge, MA: MIT Press.
17. Trommer, J. (2004), *Albanian word stress*. In manuscript, Osnabrück: University of Osnabrück.
18. Trommer, J. (2009), *Stress uniformity in Albanian: morphological arguments for cyclicity*. In manuscript, Leipzig: University of Leipzig.

**Word Stress in the Morphology of Albanian:
Metrical and Optimality Theories**

Word stress in Albanian regularly falls on the first mora of the stem-final bimoraic metrical foot, so that all grammatical stems are trochaic paroxytona. Inflectional endings are metrically irrelevant for the stress assignment rules in the morphology of Albanian, so that word stress in Albanian is paradigmatically fixed. Within the Optimality Theory, phonological constraints on prominence and metrical feet that can be posed to reflect this generalization in Albanian include FOOTBIN, TROCHAIC, AFR, MAIN-R, PARSE, and WSP.

Maria MOROZOVA

SHËNIME PËR STANDARDIN MORFOLOGJIK TË KORPUSIT NACIONAL TË SHQIPES

Dihet se një nga fushat e linguistikës kompjuterike, që sot për sot ka një rëndësi të veçantë, është përpunimi i korpuseve gjuhësore reprezentative. Korpusi i tillë e pasqyron gjuhën e dhënë në të gjithë larminë e zhanreve, stileve dhe varianteve territoriale dhe sociale, në periudha të ndryshme të historisë së saj. Korpusi është burimi i pasur i materialit gjuhësor për studime të ndryshme në rrafshin sinkronik dhe diakronik. Përveç kësaj, rrethi i gjerë i përdoruesve, që mund të shfrytëzojnë informacione nga Korpusi i gjuhës së dhënë, përfshin të gjithë folësit e kësaj gjuhe, studentët e huaj, mësuesit e gjuhës etj.

Gjuha shqipe më përpara nuk kishte Korpusin e vet reprezentativ të pajisur me anotimin dhe me sistemin e kërkimit. Në vitin 2011 hapat e para në krijimin e Korpusit të tillë kanë bërë gjuhëtarët nga Moska dhe Sankt-Peterburgu. Projekti ynë ka marrë emrin *Korpusi nacional i gjuhës shqipe*.¹ Në krye të grupit të shkencëtarëve nga Moska është Prof. Dr. Vladimir Plungian, një prej drejtorëve dhe pjesëmarrësve aktiv të projekteve “Korpusi nacional i gjuhës ruse” dhe “Korpusi nacional i armenishtes lindore”.² Specialistët nga Moska sigurojnë mbështetjen programore dhe teknike të projektit tonë dhe marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve të tjera të lidhura me përpunimin e Korpusit. Shkencëtarët nga Sankt-Peterburgu me Prof. Dr. Aleksandër Rusakov-in në krye përfaqësojnë institucione të tilla si Instituti i studimeve linguistike i Akademisë së shkencave të Rusisë dhe Universiteti shtetëror i Sankt-Peterburgut, dhe merren me zgjedhjen e teksteve për bazën tekstuale, përpunimin e sistemit anotimi dhe me krijimin e fjalorit gramatikor të Korpusit.

Version prove i Korpusit nacional të shqipes me rreth 750000 përdorime fjalësh (sipas të dhënave të gushtit 2012) ekziston online: <http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/>. Projekti planifikohet si korpusi i tipit “të ha-

¹ Përpunimi i Korpusit mbështetet nga Programi i kërkimeve fundamentale të Akademisë së shkencave të Rusisë “Corpus linguistics”, granti “Korpusi nacional i gjuhës shqipe”.

² Versione të plota të korpuseve të përmendura janë paraqitura në Internet: Korpusi nacional i armenishtes lindore (), <http://www.eanc.net>; Korpusi nacional i gjuhës ruse (НКРЯ), <http://www.ruscorpora.ru>.

pur” (ndryshe nga Korpusi nacional Britanik) dhe nënkupton zgjerimin e mëtejshëm. Pjesa më e madhe e punës së bërë deri më sot u takon përgatitjeve paraprake, siç është përpunimi i bazës teorike dhe programore, kurse aktivitete të tjera si zgjerimi i Korpusit do të vazhdojnë në të ardhmën e afërt.

Në bazën tekstuale e Korpusit për momentin ka rreth 15 vepra letrare dhe publicistike. Pjesën programore e përbëjnë: platforma kërkimore e përpunuar prej specialistëve të kompanisë *Corpus Technologies*, programi i analizës morfologjike (*parser-i*), programi indeksimi dhe ndërfaqja e përdoruesit. Pjesa e rendësishme e sistemit përfshin *fjalorin gramatikor*, i cili përmban informatën për veçoritë gramatikore të fjalëve, dhe *sistemin e shënimeve* ose *anotimin*. Korpusi nacional i shqipes është pajisur me *anotimin metatekstual*, që përmban informatën për çdo tekst dhe për autorin e tij, dhe me *anotimin leksiko-morfologjik*, me ndihmën e të cilit përdoruesi mund të kërkojë fjalët dhe togfjalësha të ndryshme. Anotimi leksiko-morfologjikpërmban shenjat leksikore dhe gramatikore (*tag-ët*), që u shtohen përdorimit të fjalëve si rezultati i analizës së teksteve në Korpusin me anë të programit lemmatizimi, ose *parser-it*. Sipas modelit të Korpusit të armenishtes lindore, gjuha ndërmjetësuese e shënimeve gramatikore të Korpusit tonë ka për bazë sistemin e *tag-ëve*, që njëson atë të *Leipzig Glossing Rules*.³ Kur bëhet kërkimi në Korpusin, informacion leksikor dhe gramatikor mbi fjalëformat del në dritarëza të veçanta. Për shembull, kështu shfaqet fjalëforma *djalin* në Korpusin nacional të shqipes:

1) lemma (forma bazë e fjalës): *djalë*

2) trajtat gramatikore e fjalës së dhënë (pjesa e ligjëratës, gjinia e emrit, emri frymori / jofrymori, folja kalimtare / jokalimtare etj.): (*N, m, anim*)

3) trajtat gramatikore e fjalëformës së dhënë (rasa, numri dhe shquarsia / pashquarsia e emrit; veta, numri dhe koha e foljes etj.): *def, sg, acc*

4) ekuivalenti në anglishten: *boy*.

Paraqitja e posaçme e të dhënave në Korpusin arritet me anë të *Standardit morfologjik*. Standardi, si një gramatikë teorike, përcakton inventarin e kategorive gramatikore, strukturën e paradigmes së fjalës, formën bazë të fjalës, mënyrën e pasqyrimin të normës gramatikore në Korpusin (cilat fjalëforma konsiderohen standarde dhe cilat janë jo standarde). Standardi morfologjik i Korpusit tonë merr parasysh parime kryesore të *Gramatikës së gjuhës shqipe* së përpunuar nga Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler (O. Buchholz, W. Fiedler. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopädie, 1987).

³ Leipzig Glossing Rules. Conventions for interlinear morpheme-by-morpheme glosses. URL: <http://www.eva.mpg.de/lingua/resources/glossing-rules.php>. Rregullat e përpunuara nga B. Comrie, M. Haspelmath dhe B. Bickel përmbajnë një numër shkurtesash për kategoritë gramatikore më të përhapura në gjuhët e botës dhe përdoren si standardi tipologjik ndërkombëtar.

Siç e vë në dukje Geoffrey Leech, një nga krijuesit e Korpusit nacional Britanik (British National Corpus), skema e analizës në sistemin anotimi, ose skema e anotimit, duhet të bazohet në parime ose vija drejtuese që i pranon dhe i njeh përdoruesi.⁴ Prandaj standardi i Korpusit tonë përputhet në mënyrë harmonike me traditën gramatikore të shqipes, të cilën e pranon shumica e gjuhëtarëve dhe shqipfolësve. Nga ana tjetër, standardi përmban edhe dallime nga kjo traditë, që dolën për arsye të ndryshme teorike dhe praktike. Së pari, të gjitha dukuritë gjuhësore që kanë më shumë se një interpretim në gjuhësinë bashkëkohore, marrin një trajtim të përbashkët në standardin morfologjik të Korpusit. Së dyti, ka kategori, që paraqiten në standardin tonë në mënyrë më të detajuar sesa i pasqyron përshkrimi tradicional.

Për shembull, në trajtimin e përemrave marrim parasysht, nëse ata pranojnë ose mungojnë kategoritë gramatikore tipike të pjesave të tjera të ligjëratës. Kështu i veçojmë klasa të tilla si: përemri-emri, përemri-mbiemri, ndajfolja përemërore. Veçohen edhe ata përemra, që kanë funksionin sintaksor të veçantë (trajta e shkurtër). Në sajë të trajtimit të tillë të detajuar përdoruesi mund ta formulojë kërkesën më të saktë dhe, si rezultat, të përfitojë një grumbull shembujsh të nxjerrë nga Korpusi me sasinë minimale të gabimeve kërkimore.

Për më tepër, përveç rasave të gramatikës tradicionale të shqipes (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore), anotimi i Korpusit nacional të shqipes përmban shënimin e përveçëm për rrjedhoren e dytë (rrjedhore II). Kishim ca arsye për ta veçuar këtë formë nga rrjedhorja “tradicionale”. Së pari, nga pikëpamja formale kjo trajtohet si rasa, e cila pranon formën e veçantë me mbaresën *-sh* në shumës. Së dyti, ka veçori funksionale të rrjedhores së dytë, që u bënë arsye për ta dalluar atë në sistemin e rasave. Rrjedhorja II përdoret zakonisht pa parafjalë; ka shprehje ku përdoren më shpesh format e rrjedhores II (për shembull, shprehje me përcaktor (1)), kurse në shprehje të tjera të dyja forma janë të pranueshme (2).

(1) *lesh dele-sh* (ABL)

(2) *prej fshatra-sh*(ABL2) = *prej fshatra-ve* (ABL)

Paraqitja e rrjedhores II si një rasë e veçantë e lehtëson procesin e kërkimit për një përdorues që studion, për shembull, përdorimin e rrjedhores pranemërore në shqipen. Ndërkaq, studiuesi që ka interes për përdorimin e të gjitha formave të rrjedhores mund ta bëjë kërkesën si “rrjedhore + rrjedhore II”, dhe më në fund të gjitha format e duhura do të dalin normalisht si rezultat i kërkimit.

Me interes është çështja e përfshirjes së rasës së paveçuar (gjerm. *Merkmalloser Kasus*) në standardin morfologjik të Korpusit. Sipas gramatikës së O. Buchholz dhe W. Fidlerit, kjo rasë u ngjan emërores dhe kallëzores së

⁴ “The scheme of analysis presupposed by the annotations – the annotation scheme – should be based on principles or guidelines accessible to the end-user” (Leech G. Corpus annotation schemes // *Literary and Linguistic Computing* 8/4, 1993. P. 275–281).

njëjësit të pashquar dhe shërben në fjali si ndajshtim (3) dhe si përcaktor i emrave me kuptimin e sasi, numrit etj. (4) [Buccholz, Fiedler 1987: 226].

(3) *lumi Shkumbin*

(4) *një kovë ujë*

Ndërkaq, ka edhe një rast, i cili mund të trajtohet si rasti i përdorimit të rasës së paveçuar. Kjo është rasi e emrit në togfjalëshin emëror me përcaktorin e vendosur përpara:

(5) *Kërkonte trupin e të ziut djalë*. [Buccholz, Fiedler 1987: 329]

Të gjitha rastet e lartpërmendura mund të interpretohen në Korpusin në të njëjtën mënyrë, d.m.th. si rasi e paveçuar. Kuptohet që nëse rasi e paveçuar futet në modelin gramatikor, çdo përdorim i emërores dhe të kallëzores së pashquar do të ketë edhe një variant homonimik të analizës (d.m.th. forma e rasës së paveçuar). Prania e homonimisë së tillë do të ndërlikojë realitetin gjuhësor të shfaqur në Korpusin, dhe prandaj do të kërkojë një trajtim të veçantë teknik. Duket se në këtë situatë fjalëforma të tilla, që janë të pakta në shqipen, mund të gjeten dhe të shënjohen me dorë, së bashku me eliminimin e homonimisë, që zakonisht konsiderohet si punë dore në përpunimin e Korpuseve gjuhësore të ndryshme. Më në fund, elementi i anotimit “rasi e paveçuar” do të pranohet vetëm në nënkorpusin pa homonimi gramatikore.

Pra, siç vumë në dukje më sipër, qëllimi kryesor i standardit tonë morfologjik është paraqitja e sistemit të veçorive gramatikore të fjalëve sipas parimeve të pranuar nga shumica e përdoruesve dhe të lidhura sa më shumë me traditën gramatikore ekzistuese. Nga ana tjetër, krijuesit e Korpusit kanë mendimin e lirë për të krijuar sistemin optimal dhe të posaçëm nga pikëpamja teorike dhe teknike, i cili përshtatet për analizën e sasive të mëdha tekstesh në Korpusin nacional të gjuhës shqipe.

Anna KAPITANOVA

**“KAJ NAS” FOLËSIT E FSHATIT TË BOBOSHTICËS NË
KONTAKT ME POPULLIN AUTOKTON**

Bashkëjetesa shumëshekullore e popujve të Ballkanit ka favorizuar zhvillimin e një gjuhe të përbashkët kulturore, ku qarkullojnë tipare të ngjashme. Deklarimi “ballkanas jemi” nuk është i rastit. Dhe anasjelltas. Edhe pse ballkanasit e kanë parë botën me të njëjtin sy, mënyra homogjene e jetesës faktikisht e ka bërë të mundur këtë komunikim të gjatë kulturor. Ballkani nuk është thjesht një fuçi baruti siç shpeshherë konsiderohet. Kuptohet se në kohë lufte kemi luftuar, por çfarë kemi bërë në kohë paqe?

Kontaktet e para mes shqiptarëve dhe bullgarëve datojnë qysh nga Mesjeta. Tepër të forcuara ishin marrëdhëniet në mes të dy popujve në trojet e sotme të Shqipërisë së Jugut përmes të cilave kalon *Via Egnatia* – njëra nga rrugët më të njohura ushtarake, e ndërtuar nga romët gjatë shekullit të II-të para erës së re. Këtu gjurmë kanë lënë popuj të ndryshëm, të cilët ishin nisur për në Lindje apo kishin ardhur nga Lindja. Pra, sllavët janë ata që dekada të tëra bashkëjetonin me vendasit dhe hynin në përbërje të shteteve të ndryshme. Gjatë shekullit të VII-të një pjesë e sllavëve të shpërngulur u bashkua me bullgarët e lashtë që kishin ardhur në Ballkan nga Azia Qendrore. Më 681 u themelua shteti bullgar dhe që nga ai moment filluan të thelloheshin marrëdhëniet bullgaro-shqiptare. Bile në fillim të shekullit të XX-të disa ushtarë austriakë gjetën në afërsi të qytetit të Ballshit një mbishkrim me shkronja greke, i cili dëshmon për pagëzimin e mbretit bullgar Boris që u krye në pranimin e perandorit bizantin Mihail në vitin 866. Origjinali ruhet në Muzeun Arkeologjik të Tiranës, ndërsa sot në vendin ku u zbulua mbishkrimi ngrihet një kolonë mermeri, mbi të cilën shkruhet në shqip: “U pagëzua sundimtari i Bullgarisë Boris quajtur Mihail së bashku me popullin e dhënë atij prej Perëndisë – viti 866.”¹

Dëshmi të gjallë të bashkëjetesës midis sllavëve dhe popullit autokton përbën fshati i Boboshticës, ku flitet gjuha “kaj nas” (gjuha e atyre që flasin si ne), e cila

¹ Informacioni është dhënë nga Emil Ivanov, profesor i Historisë së Kishës dhe Arkeologjisë së Krishterimit në Fakultetin e Teologjisë pranë Universitetit të Sofjes “Shën Kliment i Ohrid”

trashëgohet me gojë brez pas brezi. Boboshtica është ndërmjet një numri të madh fshatrash që mbajnë emra sllavë në kufijtë jugorë të Korçës.

Sot “kaj nas” praktikohet vetëm në 2/3 shtëpi. Cilit nëngrup të gjuhëve sllave i përket e folmja e Boboshticës, këtë çështje ia lemë gjuhëtarëve. Disa shqiptarë të fshatit dhe përreth e quajnë atë bullgarçe. Vetë boboshtarët, ata “kaj nas” folësit e konsiderojnë veten shqiptarë dhe nuk e lidhin konkretikisht të foluren e tyre me familjen e gjuhëve sllave. Në periudhën kur numri i folësve sllavë u pakësua ndjeshëm në jug të Shqipërisë, këta të ardhur ishin krejtësisht të përgatitur të bënin pjesë në bashkësinë shqiptare. Për shkak të mungesës së fakteve historike, studiuesit e kanë të vështirë të argumentojnë arsyet lidhur me pakësimin e numrit të sllavëve dhe përkatësisht me shtimin e shqiptarëve në territoret jugore të vendit. Gjithsesi kjo mungesë të dhënash historike lind pyetjen se si motivohen marrëdhëniet paqësore ne mes të bullgarëve dhe shqiptarëve.

Natyrisht, martesat e përziera në fshatin e Boboshticës dhe përreth përforcuan lidhjet e sllavëve me shqiptarët ortodoksë, kurse lëvizja e krijimit të atdheut shqiptar përshpejtoi procesin e përfshirjes në bashkësinë shqiptare. E gjitha kjo u bë pa u vërejtur konflikt gjuhësh. Bile mund të flitet për paralelizëm gjuhësor në ritet që kemi marrë në shqyrtim. Festa *Rosica*, riti *Dordolecët* dhe *Dita e Verës* dëshmojnë për karakterin pagan të jetesës së popujve në kontakt, ndërsa ushtrimi i këtyre riteve deri vonë tregon për një bashkëjetesë miqësore, ku i ndryshmi për nga të folurit ka parë bazë komunikimi përkisht në tiparet e përbashkëta kulturore.

Rosica është një festë e adhurimit të pranverës, e cila praktikohet vetëm nga gratë javës së tretë pas Pashkëve. Sot dy ditët e festimit janë bërë vizitkarta e Boboshticës, sepse ky është i vetmi fshat në Shqipëri ku bëhet *Rosica*. Ditën e parë gratë gatuajnë brumërat dhe bëjnë gati kostumet më të bukura të cilat do të veshin. Ditën e dytë, të zbuluarat dalin nëpër fshat dhe ndajnë ushqimet mes njëra-tjetrës. Në darkë mblidhen në lokal dhe festojnë deri në mëngjes. Festa shoqërohet me këngë dhe valle. Poshtë vijojnë teksti “kaj nas” i këndimit, i regjistruar sipas sistemit fonetik të shqipes (majtas) dhe përkthimi nga “kaj nas” në gjuhën shqipe (djathtas).

Mi pushti Rusica, da mi dade brashenjce,
Da mi dade brashenjce, ta i eno jajcjence,
Ta i eno jajcejence, da premjesam pogaça,
Da praimë liturja dhe krestata.
Ristoz enash vo godina,
Zaradva ni, zaradva ni...

Më dërgoi Rosica, të më japë pak miell,
Të më japë pak miell, edhe një vezë,
Edhe një vezë, të bëjmë pogaçe,
Liturgjinë dhe kreshmët t’i mbajmë.
Ristozi një herë në vit,
Na gëzoi, na gëzoi...

Megjithëse është veshur me simbolikë fetare – gëzim nga lajmi që Jezu Krishti u ngrit në qiell, festimi ruan karakterin e vet pagan dhe ka të bëjë me adhurimin e fushave të gjelbëruara. Kjo automatikisht lidhet me idenë e lindjes dhe

femrën që sjell jetë. Kështu p.sh., mes shqiptarëve në rrethin e Devollit, ku festa njihet si Dita e Rusicave, shtatzënat patjetër bëjnë pjesë në të. Gratë e moshuara ua shpërndanin atyre bukën, duke u besuar se nuk rrezikohen nga aborti.

Pjesëmarrja e domosdoshme e grave na bën ta lidhim *Rosica* apo *Rusicat* me fjalën latine *rosalia*<dita e trëndafilave>. Lulja e çelur simbolizon lindjen, natyrën e gjelbëruar, kurse ngjyra e kuqe – abortin. Jam i mendimit se gjembat kanë ngjallur shoqërimi me gjakun, përkatësisht me dështimin. Trëndafili kënaq syrin dhe është lajmëtar i natyrës së rilindur, por njëkohësisht mund të lëndojë. Kështu siç janë perënditë – dashamire dhe shkatërrimtare. Ja pse të lashtët janë përvulur para fuqive të mbinatyrshme, duke e kërkuar përkrahjen hyjnore për t’i shmangur fatkeqësitë eventuale.

Mes bullgarëve *Rusalia*, siç njihet zakoni në Bullgari, lidhet kryesisht me ritin e fjetjes në livadh që e bëjnë të sëmurët dhe sidomos gratë që nuk mund të bëjnë fëmijë me qëllim kurimi. Këto janë livadhe ku rritet shkurrja bullg. *rosen* për të cilën pohohet se e ka prejardhjen te fjala lat. *rosa* “trëndafil”. Lulet e saj shërojnë, por gjithashtu edhe bëjnë plagë. Në mitologjinë sllave kjo është lulja e vashë detit (lulja e bullg. “*rusalka*”). Sipas besimeve popullore kur figura mitologjike të vishet me lulen, atëherë bëhet e mirë dhe i ndihmon njerëzit. Zakonisht “fjetja në livadh” kryhet në të gdhirë të Ditës së Ngritjes së Jezusit në qiell, d.m.th. 40 ditë pas Ringjalljes.

Dordolecët është riti i ndjellës së shiut. Është interesante të ndiqet transformimi i tij te boboshtarët dhe shqiptarët e tjerë në rajon. Këndimi, të cilin kujtojnë “kaj nas” folësit, është vetëm variant shqip. Pra, kuptimi etnografik i fjalës *dordolec* është fëmijë që në fillim të verës ose në kohë thatësire e zhvishnin lakuriq, e mbulonin me fier e me shpendra dhe i hidhnin ujë përsipër, duke e shoqëruar me një këngë të veçantë gjoja për të ndjell shiun. Në Boboshticë *dordolecë* zakonisht bëheshin burrat dhe ata të varfrit me shumë fëmijë, të cilët pasi e kanë mbështjellë trupin me fletë barisnin të gjithë fshatin. E zonja e shtëpisë dilte me një kanë të mbushur me ujë dhe ia hidhte *dordolecit*. Kur hidhej uji ai kërcente, kurse uji binte si pika shiu. Në dokumentet arkivale të fshatit gjejmë këndimin karakteristik interpretuar dikur nga fëmijët dhe shokët të *dordolecit*:

Rona, Rona – Peperona,
Bjerë shi në arat tona,
Të na rritet bereqeti,
Bereqeti sa çatia,
Gruri misri sa perëndia.

Dordolecit në çdo vend i jepej miell, gjizë, gjalpë dhe vezë. Të gjitha këto produkte ai i shpinte në shtëpi që t’i hante me fëmijët. Ky zakon tani nuk ekziston. Ndryshe nga festa e Rosicës, këtu kemi të bëjmë me një rit, i cili pamjen e jashtme e

ka pagane – veshjen, hedhjen e ujit, këndimin, por synon mirëqenie materiale, sigurimi i të cilit i takon burrit. Mungon personazhi i djalit.

Në rrethin e Devollit ceremonia e ndjelljes së shiut u transformua në një lojë fëmijësh. Të vegjlit shëtisnin shtëpi më shtëpi me një dru i veshur me rroba të vjetra dhe degë shkurreje. Drurin e quanin *dudule* apo *dodole*. Loja shoqërohej me këndimin karakteristik dhe fëmijët i hidhnin ujë *dodoles*. Këtu vërehet zhvillimi i kuptimit leksikor të fjalës *dordolec*. Fillimisht ka pasur të bënte me ujin, kurse në një etapë më të vonë – me figurëqë tremb shpendët dëmtues, siç është përhapur sot në gjuhëshqipe. Mirëpo, në Kosovë fjala përdoret në kuptim të togfjalëshit *njeriu prej bore*, d.m.th. elementi i ujit është ruajtur në një farë forme.

Në Bullgari riti quhet “flutura”, ndërsa në disa rajone të vendit – *dodola*. Dodolja, sipas besimeve popullore bullgare, është një vajzë e cila vishet me të gjelbër nga shoqet e saj më të mëdha, të cilat i hedhin ujë në trup dhe këndojnë refrenin “*dodole, dodole*”. Riti quhet “flutura”, sepse lëvizjet e vajzës i ngjanjë mënyrës sipas së cilës flutura i hap krahët. Personazhi i djalit mungon në traditën folklorike bullgare të ndjelljes së shiut.

Më 1 Mars në fshatin e Boboshticës festohet *Dita e Verës*. Në Shqipëri, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Rumani dhe Moldavi festa karakterizohet me lidhjen në duar të fijeve të dridhura me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë. Kjo bëhet që të ketë bulmet dhe shëndet. Emërtimi i atributit në gjuhët të cilat formojnë Lidhjen Gjuhësore Ballkanike ka të bëjë me marsin, vetëm në shqip fjala *verore* ndryshon. Krah. bullg. *martenica*, gr. μ ose μ , rum. *m r i or*, derisa në shqip emërtimi lidhet me stinën e verës. Kjo do të thotë se verorja te shqiptarët ka qenë e përhapur në një kohë relativisht të hershme, kur të lashtët ende e kanë ndarë vitin në dy stina – në atë të verës, d.m.th. ditët e ngrohta dhe përkatësisht në ditët e ftohta të dimrit. Marsi ishte muaji i parë i kalendarit të Romës. Mbase kontaktet e sllavëve të Boboshticës dhe përreth me shqiptarët kanë qenë mjaft të thelluara, përderisa përdorin fjala *verore*, e cila nuk ka origjinë sllave, siç mund të vërehet në ngjitjen e prapashitesave tek *Rosica* dhe *Dordolecët*.

Dita e verës te boboshtrët ka ruajtur tërësisht karakterin e vet pagan dhe përbën një ftesë të pranverës në shtëpi. Fëmijët, që quhen zoga, mblidhnin degë lisi dhe thane, pas kësaj i hidhnin ato në oborrin e shtëpisë, duke kënduar. Poshtë vijojnë teksti “*kajnas*” i këndimit, i regjistruar sipas sistemit fonetik të shqipes (majtas) dhe varianti i refrenit në gjuhën shqipe me kuptim të njëjtë (djathtas).

Ciu-ciu, vak-vak,	Ciu-ciu, vak-vak,
Dit’ e verës prapa derës,	Den na ljeto zad portata,
Dil moj zonja e shtëpisë,	Jzhlezjete mor nikokia ot kashtat,
Hiqi lloze derës,	Torni llozo ot portata,
Se vjen dit’ e verës.	Sh oda vleje çilimijata.

Dikur verorja hiqej kur të shihej dallëndyshja e parë. Sot si në Boboshticë, ashtu edhe mes shqiptarëve ortodoksë ajo hiqet më 25 Mars, Ditën e Lajmërimit të lindjes së Jezusit.

Në traditën bullgare gjithashtu haset motivi i dallëndyshes, por nuk është përhapur masivisht. Bullgarët e heqin veroren kur të shikojnë lejlekun e parë ose kur të gjethojnë bimët. Ndërsa fëmijët me degët e gjelbra (zogat) u ngjajnë figurave të djalit dhe të vajzës që bëhen me pe të bardhë dhe të kuq, të cilat bullgarët i quajmë Pizho dhe Penda. Duhet përmendur se populli bullgar është i vetmi në Ballkan tek i cili lidhja e verores është festë masive, derisa tek shqiptarët vetë ceremonia e lidhjes më tepër ka karakter individual. Në Bullgari ditëve të para të marsit në çdo qoshe shiten figura të ndryshme të dridhura me penj të kuq dhe të bardhë.

Në çdo vend të Ballkanit gjenden bashkësi bilinge të cilat konsiderohen minoritete në shtetin e dhënë, pavarësisht a janë shpallur zyrtarisht apo jo si të këtilla. Le të kujtojmë p.sh., shqipfolësit e mbetur sot në Bullgari, ata të fshatit të Mandricës, ose folësit sllavë në Shqipëri, të përqendruar në disa fshatra të Gollobordës, Gorës, në krahinën e Prespës së Vogël, në fshatin e Boboshticës dhe në atë të Vërnikut. Këto lloj bashkësish ndryshojnë kryesisht për nga të folurit e tyre në raport me bashkësitë tjerë. Mbase kjo është arsyeja e cila na bën të drejtojmë vëmendje ndaj bashkësisë përkatëse, duke e studiuar atë si të huaj në ambientin rrethues dhe të mbyllur në vetvete, pa marrë parasysh traditën kulturore, kështu të thuhet “zyrtare”, ku zhvillohet në kontakt. Normalisht, gjuha është baza logjike në të cilën mbështetemi kur përcaktojmë përkatësinë kulturore të bashkësisë që studiojmë, por në asnjë rast nuk duhet mënjanuar faktori, i cili e ka favorizuar ekzistencën e kësaj bashkësie.

Bibliografi

1. Mazon, A. (1936) *Les chausous et les contes slaves de suol*, Paris, (cituar nga një përkthim i gjuhës shqipe)
2. Panajoti, J. (1982), *Këngë popullore të rrethit të Korçës*, “Mihal Duri”, Tiranë, shënimet e f. 674
3. Saraçi (Maxhe), A. *E folmja e Devollit (Sprovë etnosociolinguistike) – Tezë doktorature*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, f. 165
4. Xhuvani, A. (1980), *Trashëgimia kulturore e popullit shqiptar*, Shtypshkronja e Re, Tiranë, f. 463 dhe 487
5. Fjalori elektronik shpjegues (FESh)
6. Fjalori Etimologjik i Bullgarishtes (2002), (titulli original) :
, VI. АИ „Проф. ”, .

Naser FERRI

POLITIKAT RELIGJIOZE TË PERANDORËVE ROMAK

Në kohët më të hershme romakët kishin besuar në forca të panumërta abstrakte të natyrës, dhe hyjnitë e tyre të shumtë që ishin pa gjini identifikoheshin me dukuri të ndryshme si për shembull Vesta identifikoheshin me shtëpinë, Terminusi me gurin e megjes, Venera me bujqësi e kështu me radhë.¹

Prej kohës së mbretit Tarkvinus (Tarquinius Superbus, 534-509) kishte filluar ndikimi i madh i mitologjisë greke² dhe kjo është koha kur hyjnitë romake fituan trajtat antropomorfe dhe filluan të identifikohen me hyjni greke,³ ndërsa si hyjni më të lartë kishin filluar të nderohen Jupiteri (që njëjtësohej me Zeusin), Junona (njëjtësohej me Herën) dhe Minerva (njëjtësohej me Athenën greke).⁴

Në kohën e luftërave punike (Lufta e parë 264-241, e dyta 241-218, e treta 149-146 para erës sonë) romakët ishin njoftuar me filozofinë greke dhe si pasojë e kësaj besimet religjioze, mitologjia, hyjnitë dhe zakonet e lashta romake kishin filluar të zbehen.⁵

Me themelimin e Perandorisë romake në vitin 27 p.e.s. perandori August tentoi t'i ringjallë besimet e lashta religjioze romake, por arriti sukses të pjesshëm, meqë në këtë kohë romakët i kishin pranuar dhe kishin përvetësuar shumë nga kultet e hyjnive me origjinë nga Orienti.⁶ Fal eklekticizmit, nga panteoni egjiptian në qytetin e Romës dhe anëmbanë shtetit romak kishin depërtuar kulti i hyjneshës Isis (Izida) dhe ai i hyjit Serapis.⁷

Në fakt, qysh Jul Cezari si dhe Mark Antoni të cilët kishin qëndruar në Egjipt, e kishin pëlqyer mënyrën e jetesës në Egjipt dhe kishin filluar t'i adhurojnë hyjnitë egjiptiane. Në kohën e Perandorisë kultet e hyjnive nga Lindja e Afërtë i preferonin posaçërisht perandorët Komodi (Marcus Aurelius Commodus Antoninus Augustus, 161-192), Septim Severi (Lucius Septimius Severus Augustus; 145 –211), i cili

¹ Musi 1942, 164; Cavendish&Ling 1982, 136; Schmidt 2004, 24-69.

² Lisi ar 1971, 278.

³ Cavendish&Ling 1982, 137-138.

⁴ Schmidt 2004, 70-88.

⁵ Lisi ar 1971, 313-323.

⁶ Musi 1942, 165.

⁷ Selem 1997, 43.

madje identifikohet me hyjin universal sinkretik greko-egjiptian Serapis,⁸ Karakala (Marcus Aurelius Severus Antoninus Augustus, 198-217), i cili e kishte ngritur edhe një tempull luksoz kushtuar Izides dhe e kishte ngritur kultin e saj ne nivel shtetëror, Diokleciani (Gaius Aurelius Valerius Diocletianus Augustus, 284-305), i cili e kishte ngritur edhe një tempull te ri, kushtuar Izides dhe Serapisit e po ashtu edhe bashkësundimtarët e tij Maksimiani (Marcus Aurelius Valerius Maximianus Herculius), bashkësundimtar me Dioklecianin prej vitit 286 deri 305, perandor prej v.305 deri 311) dhe Galeri (Gaius Galerius Valerius Maximianus Augustus, 305 - 311.).⁹

Kah fundi i erës së vjetër dhe gjatë shekullit I të erës sonë, romakët kishin rënë në kontakt me besimin monoteist judaist, por kishin aversion ndaj tij, e madje kur e shkatërruan Jerusalemin në vitin 70 të e.s. e kishin shkatërruar edhe Tempullin e Madh çifut nga i cili kishte shpëtuar vetëm muri perëndimor, sot i quajtur “Muri i vajtimit”,¹⁰ dhe nga aty kishin dëbuar pjesën dërrmuese të popullit çifut duke e shpërndarë në diasporë.¹¹

Në fillim të erës sonë kishte zënë fill krishterimi si vazhdimësi e judaizmit¹² dhe ky besim për një kohë kishte hasur në kundërshtimin romak, e madje shumë perandorë si Tiberi, Neroni, Aureliani, Diokleciani,¹³ Galeri dhe Licini kishin qenë ithtarë të flaktë të Mithrës¹⁴ dhe, përkundër faktit që anëtarët e familjeve të tyre e kishin përqafuar krishterimin, ata kishin ndërtuar dhe rindërtuar tempuj për nder të Mithrës¹⁵ dhe i kishin persekutuar të krishterët. Vetëm në Koloseun e Romës, të cilin e kishte ndërtuar Vespaziani për katër shekuj (prej ndërtimit e deri në kohën e Dioklecianit) ishin ekzekutuar mbi 700000 të krishterë.¹⁶ Politikën e persekutimeve të të krishterëve e kishin vazhduar edhe perandorët Neroni, Domiciani, perandori-filozof Mark Aureli¹⁷ e perandorët e tjerë.¹⁸

⁸ Jovi 1994, 11.

⁹ Selem 1997, 42; Collins&Price 2000, 38.

¹⁰ Đakovac&Bigović 2006, 272.

¹¹ Collins&Price 2000, 33.

¹² Collins&Price 2000, 8

¹³ Collins&Price 2000, 54.

¹⁴ Cunliffe 1978, 278-281.

¹⁵ Collins&Price 2000, 54.

¹⁶ Cunliffe 1978, 161.

¹⁷ Collins&Price 2000, 47.

¹⁸ Collins&Price 2000, 45.



Skulptura e Mithrës nga mithreu nën kishën San Clemente në Romë

Kah fundi i erës së vjetër së bashku me kultet e tjerë me origjinë orientale në shtetin romak kishte arritur mithraizmi, respektivisht kulti i hyjit indopersian Mithras, të cilin shumë shpejtë e kishin përqafuar shtresat e ulëta e gjatë shekullit II të e.s. edhe ato të larta romake e madje edhe perandorët siç ishte rasti me Aurelianin, Dioklecianin e mjaft të tjerë.¹⁹

Mithra, Mithras ose Mitra ishte hyj indo-persian i dritës dhe i diellit²⁰, kulti i të cilit ishte tejet i përhapur në Azi, ndërsa gjatë periudhës së antikës edhe në Perëndim, posaçërisht në Perandorinë Romake. Pos në mitologjinë induse²¹ dhe persiane²² Mithra përmendej edhe në mitologjinë armene, por këtu njihej me emrin Mherr ose Mehrer dhe konsiderohej hyj kozmopolit.²³ Kulti i tij bazohej mbi dualizmin mazdaist që kishte të bëjë me luftën e vazhdueshme ndërmjet të së mirës, që e përfaqëson Ahura Mazda (hyj krijues dhe simbol i metamorfozës nga besimet pagane në ato monoteiste)²⁴ dhe së keqës, e cila ishte e mishëruar në qenien negative dhe shkatërruese të Ahrimanit²⁵.

¹⁹ Ferri 2012, 27-48.

²⁰ Forty 1999, 156.

²¹ Robinson&Wilson 1976, 63; Bellinger1997, 302;

²² Curotto 1958, 324-325; Robinson&Wilson 1976, 63.

²³ Cavendiish&Ling 1982,201.

²⁴ Forty 1999, 64; Srejovi & Cermanovi 1996, 363.

²⁵ Philip 2001, 21; Melgar-Valero 2008,33.

Hyjin Mithra e nderonin sklleverit, të liruarit me origjinë nga Lindja, por edhe shtresat e ulëta të popullit në Perandorinë Romake, kurse që nga koha e sundimit të perandorit Vespasian (69-79) edhe shtresat fisnike.



Pllaka me paraqitje të Mithrës duke flijuar demin e gjetur në Janjevë

Ky kult, i cili u paraqit në kohën e cila pak a shumë korrespondon me paraqitjen e judaizmit monoteist, dhe më përpyjekjen e pasuksesshme të faraonit Amenofisi IV (1379-1362 p.e.s.), i njohur si Eknaton²⁶, për futjen zyrtare të monoteizmit në Egjipt shumë shekuj para krishterimit dhe islamit ka lënë gjurmë të pashlyeshme në besimet abrahamike, posaçërisht në krishterim, i cili e luftoi në mënyrë aq të egër, por i cili megjithatë i përvetësoi shumë elemente nga ky kult paraardhës i monoteizmit.

Mithraizmi i arritur në Romë në shekullin I të erës sonë, së bashku me kultin e perëndisë Dolichenus, me origjinë nga Azia e Vogël²⁷, dhe aty e kishin sjellë ushtarët e perandorit Neron (54-68) që kishin qenë në shërbim në Lindje²⁸, ndërsa nga Roma në kohën e perandorit Vespasian (69-79) kishte filluar të përhapet anembanë Perandorisë romake²⁹ deri në ishullin e Britanisë dhe gjatë shekullit II të erës sonë kishte depërtuar në provincat danubiane, që do të thotë se ishte përhapur në pjesën më të madhe të Perandorisë romake³⁰

²⁶ Armour 2002, 166.

²⁷ Cumont 1913, 36.

²⁸ Cumont 1913, 36.

²⁹ Girardi-Jurki 2005, 211-212.

³⁰ Philip 2001, 21.

Mithraizmin e kishin pranuar madje edhe disa nga perandorët siç ishte rasti me perandorët Komodi (Commodus), Galeri (Caius Galerius Valerius Maximianus), Licini (Lucius Valerius Licinianus Licinius)³¹ e madje edhe Konstantini.i Madh (Flavius Valerius Aurelius Constantinus).³² Liberalizëm ndaj të krishterëve kishin treguar Aleksandër Severi (Marcus Aurelius Severus Alexander Augustus, 222 -235) dhe Filipi Arab(Marcus Julius Philippus Augustus, i njohur si Filipi Arab, 244 to 249), pas vdekjes së të cilit në vitin 249 ndërkaq kishin rifilluar persekutimet e egra.³³



Në Koncilin e Nikesë Zoja e bekuar ishte Krishti në kryq në arte filloi të paraqitet shpallur Nënë e hyjit vetëm nga shekulli X

Gjatë shekullit III të erës sonë, e posaçërisht prej vitit 250 të erës sonë, ishte zhvilluar një garë e ashpër mes mithraizmit dhe të krishterimit për religion zyrtar të Perandorisë Romake,³⁴ për shkak se mithraizmi nderohej në mënyrë të organizuar

³¹ Srejovi & Cermanovi -Kuzmanovi 1996, 365; Veh 2001, 74; Lexikon für Theologie 2006, 907.

³² Cunliffe 1978, 285.

³³ Collins & Price 2000, 45.

³⁴ Dixon-Kennedy 1998, 210.

dhe kishte doktrinën dhe rregullat e qarta dhe të kapshme për të gjitha shtresat popullore.

Kjo garë kishte filluar më herët e posaçërisht kishte filluar të ashpërsohet pas shpalljes së edikteve mbi tolerancën fetare të vitit 260 nga ana e perandorit Galien (260-268)³⁵ dhe më vonë edhe të ediktit mbi tolerancë (prill 311) të perandorit Galer (së bashku me Konstantinin dhe Licinin).³⁶ Rivaliteti mes mithraizmit dhe krishterimit ka vazhduar edhe pas vitit 313 kur perandori Konstantini i Madh për hir të të së ëmës Helena, së bashku me bashkësundimtarin Licinin (307-323) e kishte shpallur Ediktin e Milanos si akt tolerance³⁷ dhe një lloj amnistie për të gjitha besimet ekzistuese të kohës, pagane e monoteiste³⁸ e në këtë kontekst edhe për krishterimin dhe për të krishterët³⁹. Edhe pse njihet si “perandori i parë i krishter dhe mbrojtës i kishës”⁴⁰ vetë Konstantini kishte mbetur ithtar i mithraizmit deri në momentin e vdekjes kur edhe ishte pagëzuar dhe pastaj ishte varrosur në kishën apostolike,⁴¹ ndërsa monedhat e prera gjatë kohës së sundimit të tij në revers (shpinë) kishin të shënuar legjendën Claritas et Invicto Soli (Diellit apo Mithrës së Ndrirshëm dhe të Pamposhtur).⁴²

Pas vdekjes së Konstantinit bijtë e tij Konstantini II, Konstansi dhe Konstanci ishin grindur mes veti dhe njëri nga ata, Konstanci kishte pranuar arianizmin.⁴³ Ata kishin filluar t’i shtypin besimet politeiste, por pikërisht kjo shtypje dhe paraqitja e neoplatonizmit e kishin ringjallë dhe e kishin forcuar përkohësisht paganizmin.⁴⁴

Gjatë sundimit të vet nipi i Konstantinit, perandori Juliani II (Flavius Claudius Iulianus, 331-363) i quajtur Apostata, apo i rebeluar nga feja⁴⁵ (i cili kishte sunduar nga viti 361 deri në vitin 363), nën pretekstin se paraqitja dhe përhapja e krishterimit kishte qenë shkak i shkatërrimit të Perandorisë Romake, e kishte ndaluar krishterimin në vitin 361 dhe i kishte rikthyer kultet e hyjnive pagane,⁴⁶ kishte rindërtuar tempuj hyjnive pagane dhe i kishte vu portretet e hyjnive në monedha, por për çudi, përkundër mllefrit dhe urrejtjes ndaj të krishterëve, ai nuk i kishte persekutuar ata.⁴⁷ Pas vrasjes së tij, pasardhësi i tij, perandori Jovian (Flavius Iovianus Augustus, 363-364) e kishte anuluar vendimin e Julianit mbi ndalimin e

³⁵ Veh 2001, 38.

³⁶ Veh 2001, 37; HrvatskaEnciklopedija 2002, 94; LexikonfürTheologie 2006, 267.

³⁷ Jovi 1994, 20.

³⁸ Kova i 2004, 77.

³⁹ Đakovac&Bigović 2006, 158.

⁴⁰ Cunliffe 1978,57.

⁴¹ Leksikon anti kih autora 1996, 69-71.

⁴² Cunliffe 1978, 285.

⁴³ Jovi 1994, 36.

⁴⁴ Kova i 2004, 78.

⁴⁵ Marevi 2000, 179.

⁴⁶ Op a Enciklopedia 1978, 183; Kova i 2004, 75.

⁴⁷ Jedin 1995, 51, 54.

krishterimit dhe rikthimin e paganizmit, e kishte privilegjuar Kishën dhe i kishte ndaluar ritet magjike që i kishte lejuar Edikti i Konstantinit mbi tolerancën fetare.⁴⁸ Masa kundër besimeve pagane siç ishte largimi i altarëve të hyjneshës Viktoria nga Kuria e qytetit dhe vendet publike kishte ndërmarrë edhe perandori Graciani(Flavius Gratianus, 367-383).⁴⁹

Megjithatë shumica nga pasardhësit e Konstantinit kishin qenë ithtarë të flaktë dhe promotorë të krishterimit.Madje perandori Theodosi I (Flavius Theodosius, 379-395) e kishte shpallur një edikt më 28 shkurt 380, sipas të cilit ishte larguar nga arianizmi dhe kishte shpallur krishterimin nikeian fe obligative shtetërore,⁵⁰ dhe tjetrin në vitin 391, me të cilin kishte ndaluar ritet pagane dhe kishte urdhëruar rrënimin e tempujve paganë dhe ndërtimin e kishave mbi themelet e tyre, pas të cilit krishterimi kishte ngadhënjyer definitivisht.⁵¹Mund të thuhet që me këtë vit mbaron edhe toleranca fetare dhe se krishterimi suprimon politikën e deriatëhershme liberale shtetërore ndaj besimeve religjioze në Perandori Romake.Përkundër kësaj, gjurmë të nderimit të kultit të Mithrës ka deri në shekullin V të erës sonë.⁵²

Shikuar në aspektin kronologjik mund të vërehen fazat e ndryshme të politikës religjioze të shtetit romak dhe qasjeve të ndryshme ndaj besimeve të ndryshme:

- prej shekullit VIII p.e.s. e deri në shekullin I të e.s.-nderoheshin hyjnitë e lashta italice e më vonë filloi të nderohej panteoni zyrtar i hyjnive romake që ishte konceptuar sipas modeleve greke (12 hyjni olimpikë në krye me Jupiterin-Zeusin).⁵³

- gjatë periudhës prej shekullit I deri në shekullin IV e.s., filluan të depërtojnë kultet nga Lindja e Afërt, në mesin e tyre kultit i Izidës, Serapisit si dhe mithraizmi, i cili madje ishte pretendent për religjion zyrtar të Perandorisë posaçërisht mes viteve 260, 311 dhe 313 të erës sonë kur perandorët Galieni, Galeri dhe Konstantini i kishin shpallur dekretet mbi tolerancës fetare, por edhe më vonë deri në shpalljen e ediktit të Theodosit I të vitit 391.Kjo ishte periudha e tolerancës fetare dhe politikës liberale shtetërore ndaj të gjitha besimeve.

- prej shekullit IV kishin pushuar persekutimet dhe kishte filluar të lejohet predikimi i lirë i krishterimit, ndërsa kah fundi i këtij shekulli zyrtarizohet krishterimi, i cili pasi del fitues në garë për religjion zyrtar, kishte filluar persekutimin e ithtarëve të kulteve të hyjnive pagane, e posaçërisht të mithraizmit nga i cili përkundër kësaj, i kishte përvetësuar shumë elemente siç janë: lindja nga virgjër-resha e papërlyer (Anahita, Shën Mëria), uji i bekuar, pagëzimi, një lloj kungimi,

⁴⁸ Edward 1993, 517-529; Collins&Price 2000, 59.

⁴⁹ Veh 2001, 41.

⁵⁰ Veh 2001, 103.

⁵¹ Collins & Price 2000, 59.

⁵² Ferri 2012, 27-48.

⁵³ Bellinger 1997, 386; Forty 1999, 228-337.

pastaj celibati, buka e shënuar me kryq dhe vera qe simbolizonte gjakun,titujt fratres (vëllezër) dhe Pater (atë, prift)të cilët i përdornin mithraistët, 25 dhjetori, dita e diel (lat.Soli dies- dita e Diellit) e cila pas Ediktit të Milanos ishte shpallur ditë pushimi,⁵⁴ por kjo ditë më vonë ishte riuemëruar nga krishterët në domenica (dita e Zotit) duke u bazuar në mitin biblik të krijimit, sipas të cilit Zoti e kishte krijuar botën për 6 ditë ndërsa ditën e shtatë kishte pushuar⁵⁵, 12 apostujt, Darka e fundit, apoteoza, ardhja e Shpëtimtarit (Mesia) e shumë të tjera.⁵⁶

Pas vitit 391, Roma dhe Konstantinopoja ishin në luftë të vazhdueshme për tu bërë qendra të krishterimit, ndërsa pas ndarjes së kishës në vitin 1054 Stambolli u bë seli e patrikëve ortodoksë, ndërsa Roma, respektivisht Vatikani, u bë dhe mbetet seli e papëve dhe qendër e kishës katolike.⁵⁷

Faktet historike dëshmojnë se në krijimin e politikave religjioze të Shtetit romak rol tejet të rëndësishëm kishin pasur perandorët me origjinë ilire siç janë bie fjala Diokleciani, Galeri, Licini, Konstantini e më vonë këtë e kishin vazhduar Justiniani⁵⁸ dhe disa perandorë të tjerë nga Iliriku.

Literatura

1. Armour, R. (2002), *Zotat dhe mitet e Egjiptit të lashtë*, SHB Dudaj, Tiranë.
2. Bellinger, G.(1997), *Leksikon mitologjie*, Državna Založba, Ljubljana.
3. Cavendish, R & Ling T. (1982), *Mitologjija, Ilustrirana enciklopedija*, Mladost, Zagreb.
4. Collins, M. & Price M. (2000), *Krš anstvo, 2000 godina vjere*, Znanje, Zagreb.
5. Cumont, F. (1913), *Les Mystheres de Mithra*, Bruxelles.
6. Cunliffe, B. (1978), *Rome and her Empire*, McGraw-Hill Books Company Limited, Maidenhead (UK).
7. Curotto, E. (1958), *Dizionario della mitologia universale, con tavole fuori Testo, fonti e bibliografia*, Sovieta Editrice Internazionale, Torino, Genova, Padova, Parma, Roma, Napoli, Bari, Catania, Palermo,Torino.
8. Dixon-Kennedy, M. (1998) *Encyclopedia of Greco-Roman Mythology*, Santa Barbara-California, Denver-Colorado, Oxford-England.
9. Dhama, T. (1987), *Fjalor i mitologjisë*, Tiranë.

⁵⁴ Đakovac & Bigović 2006, 172.

⁵⁵ Cavendish & Ling 1982,159; Đakovac & Bigović 2006, 218.

⁵⁶ Dhama 1988, 169; Cavendish & Ling 1982, 154.

⁵⁷ Jovi 1994, 21.

⁵⁸ Veh 2001, 26, 37, 74, 71-72, 68.

10. Đakovac, A. & Bigovi , R. (2006), *Leksikon hriš anstva, judaizma i islama*, Beograd.
11. Edward, G. (1993), *The history of decline and falloff the Roman Empire, vol.2, New York I.*
12. Ferri N. (2012), *Mithraizmi rival i krishterimit*, revista Kosova, Instituti i Historisë i Kosovës, nr. 35-36/2011-2012, Prishtinë.
13. Forty, J. (1999), *Mythology, A vizual Encyclopedia*, Parkgate Books, London.
14. Girardi-Jurki V. (2005), *Duhovna kultura anti ke Istre*, Školska Knjiga Zagreb.
15. Krleža, Miroslav (2002), *Hrvatska Enciklopedija, svezak 4 Fr-Ht*, Leksikografski Zavod, Zagreb.
16. Jedin, H. (1995), *VelikapovijestCrkve*, sv. 2., Krš anskasadašnjost, Zagreb.
17. Jovi , M. (1994), *Rano hriš anstvo na Balkanu*, Niš.
18. Kova i , S. (2004), *Krš anstvo i Crkva u starom i srednjem vijeku*, Verbum Split.
19. Latina & Greaca (1996), *Leksikon anti kih autora, Lexicon scriptorum antiquorum*, matica Hrvatska, Zagreb.
20. Herder (2006), *Lexikon f r Theologie und Kirche, vierter band, Franca bis Hermenegild*,
21. Lisi ar, P. (1971), *Grci i Rimljani*, Zagreb.
22. Marevi , J. (2000), *Latinsko-hrvatskienciklopedijski kirje nik, IsvezakA-L*, MaticaHrvatska, Zagreb.
23. Melgar-Valero, L. T. (2008), *Enciclopedia de la Mitologia*, Libsa, Madrid.
24. Musi , A. (1942), *Nacrt gr kih i rimskih starina*, Zagreb.
25. *Op a Enciklopedia*, (1978), JLZ, svezak 4, Iz-Kzi, Zagreb.
26. Philip, N. (2001), *Annotated Myths & Legends*, Kindersley Dorley, London.
27. Robinson, H.S. & Wilson, K. (1976), *Mitovi i legende starih naroda*, Beograd.
28. Shmidt, J. (2004), *Roman Mythology*, Grange Books Rochester.
29. Selem, P. (1997), *Izidin trag, Književni Krug*, Split.
30. Srejovi , D. & Cermanovi -Kuzmanovi , A. (1996), *Leksikon religija i mitova drevne Evrope, drugo, dopunjeno izdanje*, Savremena administracija, Beograd.
31. Veh, O. *Leksikon rimskih careva, Od Augusta do Justiniana I. 27. pr. Kr-565 posl. Krista*, Naklada Slap, Jastrebarsko, Zagreb.

Naser FERRI

POLITIKAT RELIGJIOZE TË PERANDORËVE ROMAK

(Rezime)

Besimet religjioze në Romën e lashtë , e lidhur me të politika shtetërore ndaj tyre, kishin kaluar disa faza.

Në kohët më të hershme, romakët kishin besuar në forca të panumërta abstrakte të natyrës, dhe hyjnitë e tyre të shumtë që ishin pa gjini identifikoheshin me dukuri të ndryshme si për shembull Vesta me shtëpinë, Terminus me gurin e megjes, Venera me bujqësi etj.

Prej kohës së mbretit Tarkvinius kishte filluar ndikimi i madh i mitologjisë greke dhe kjo është koha kur hyjnitë romake fitojnë trajtat antropomorfe dhe filluan të identifikoheshin me hyjni greke, ndërsa si hyjni më të lartë fillojnë të nderohen Jupiteri (që njëjtësohej me Zeusin), Junona (njëjtësohej me Herën) dhe Minerva (njëjtësohej me Athenën greke).

Gjatë periudhës prej shekullit I deri në shekullin IV e.s., kishin filluar të depërtojnë kultet nga Lindja e Afërt, në mesin e tyre kulti i Izidës, Serapisit si dhe mithraizmi, i cili madje ishte pretendent për religjion zyrtar të Perandorisë posaçërisht mes viteve 250-311 të erës sonë kur perandori Galeri e kishte shpallur dekretin e tolerancës fetare, por edhe më vonë deri në shpalljen e ediktit të Theodosit I të vitit 391.Kjo ishte periudha e tolerancës fetare dhe politikës liberale shtetërore ndaj të gjitha besimeve.

Prej shekullit IV pushojnë persekutimet dhe fillon të lejohet predikimi i lirë i krishterimit, ndërsa kah fundi i këtij shekulli zyrtarizohet krishterimi, i cili pasi del fitues në garë për religjion zyrtar, fillon persekutimin e itharëve të kulteve të hyjnive pagane e posaçërisht të mithraizmit, nga i cili, përkundër kësaj, i kishte përvetësuar shumë elemente siç janë: lindja nga virgjëresha e papërlyer (Anahita, Shën Mëria), uji i bekuar, pagëzimi, një lloj kungimi, pastaj celibati, buka e shënuar me kryq dhe vera qe simbolizonte gjakun,titujt fratres (vëllezër) dhe Pater (atë, prift), të cilët i përdornin mithraistët, 25 dhjetori, dita e diel (lat.Soli dies- dita e Diellit) e cila pas Ediktit të Milanos ishte shpallur ditë pushimi, por kjo ditë më vonë ishte riemëruar nga krishterët në domenica (dita e Zotit) duke u bazuar në mitin biblik të krijimit,

sipas të cilit Zoti e kishte krijuar botën për 6 ditë ndërsa ditën e shtatë kishte pushuar, 12 apostujt, Darka e fundit, apoteoza, ardhja e Shpëtimtarit (Mesia) e shumë të tjera.

Pas edikteve të viteve 380 dhe 391 të Theodosit II definitivisht përfundon liberalizmi dhe toleranca shtetërore ndaj besimeve të ndryshme, të cilët rreptësisht ndalohen dhe lejohet vetëm predikimi i krishtërit.

Faktet historike dëshmojnë se në krijimin e politikave religjioze të Shtetit romak rol tejet të rëndësishëm kishin pas perandorët me origjinë ilire: Galeri, Diokleciani, Licini, Konstantini e më vonë edhe Justiniani dhe disa perandorë të tjerë nga Iliriku.

Jahja DRANÇOLLI

SHKOLLA E ARBËRORËVE NË VENEDIK

Marrëdhëniet e arbërore – venedikase datojnë së paku nga shek. XI. Ato u intensifikuan pas Kryqëzatës së Katërtë (1204). Nga kjo kohë e sidomos nga kapërcyelli i shk. XIV, Republika e Venedikut, pasi që kishte zhvilluar shtetin, fuqinë ekonomike dhe zotëronte gati me tërë bregdetin lindor të Adriatikut dhe me pjesën e madhe të ishujve të Bizantit, pra edhe me disa qytete bregdetare të Arbërisë, qendra e saj ishte bërë jo vetëm një vend takimi i shumë mërgimtarëve, por edhe rrugë për afirmimin e kulturave të tyre në kulturën e Rilindjes Europiane. Minoriteti më i madh i ngulitur këtu ishte ai hebraik. Pas tyre vinin minoritetet të ardhur nga Bizanti, Gjermania, Armenia, Arbëria dhe Kroacia. Kishte, edhe nga Polonia, Bohemia dhe madje edhe nga vende islame. Me shpërnguljen dhe ngulitjet e tyre kishte pësuar edhe onomastika vendore.

Këtej, sipas minoriteteve, nisën të quheshin edhe pjesët ca më të vogla të qytetit. Ndërkaq, selitë e tyre në godina të veçanta të huazuara nga autoritetet venedikase quheshin *fondaci*. Në këtë kontekst, sipas komunitetit arbëror, i cili ishte shpërndarë në zona, si ato, *Castello*, *San Croce*, *San Polo*, *Cannaregio* dhe *San Marco*, u quajtën gjashtë rrugë *Calle degli Albanesi*. Në zonën San Marcou vendosën edhe toponimet të cilat ndërlidheshin me familjen bujare Zguri nga Kotorri, të vendosur këtu nga kapërcyelli i shek. XV. Pallati tyre gjendet në sheshin e Shën Mauricit, shumë afër objektit të Shkollës arbërore. Përballë këtij pallati, po në këtë shesh, skaj shkollës në fjalë gjendet Pallati Molin, pronë e Skënderbeut, të cilën ia kishte dhuruar Republika me rastin e shpalljes së tij Qytetar nderi të Venedikut.

Valët më të mëdha të mërgatës arbërore i ndeshim nga koha e pushtimeve rasiene nga gjysma e dytë e shek. XIII, dhe sidomos nga koha e pushtimeve osmane, ku pjesa më e madhe, siç është e njohur u vendos së pari në Bizant, dhe që këtej më vonë në Jug të Italisë. Ndërkaq, pjesa tjetër duke kaluar nëpër Raguzë dhe Zarë, qendra këto që ruanin lidhje të ngushta me Republikën, por edhe me Arbërinë zunë vend në Veri e sidomos në Venedik. Veç Venedikut dhe ishujve përreth, mërgimtarët arbërorë i ndeshim edhe në Ancona, Rimini, Fano, Senigallia, Pesaro,

Vicenza, Padova, Treviso, etj. Në këtë rrugë ekzili ishin nisur kryesisht arbërit nga Arbëria Venete (*Albania Veneta*), e cila përfshinte territoret prej Durrësi në jug deri te Boka e Kotorrit në veri (me Kotorrin si qendër e regjionit), duke i përfshirë edhe qytetet, të tjera me popullatë të rritur roman, si, Tivari, Shasi, Ulqini, Shkodra, Shën Gjini, Lezha, Drishti, Novobërda, etj. Për të gjithë këta të ardhur nga qytetet në fjalë, në perceptimin e përditshëm si dhe në dokumente zyrtare venedikase është përdorur apelativi *Albanese*.

Të kalojmë tani te Shkolla Arbërore ose *Scuola degli Albanesi* e themeluar në tetor 1442 në famullin San Severo në pjesën lindore të zonës së qytetit Castello. Është fjala për një tip të shkollave të vogla (*Le scuole piccole*), numri i të cilave ishte bukur i madh. Shkolla në fjalë ishte një lloj qendre nacionale për artet, artizanët dhe zejtarët. E konsiderojmë gjithashtu për qendër të parë fetare ku mbaheshin shërbesat në gjuhë arbërore. Organizimi saj është bazuar në shkolla të vogla të qytetit. Këtej, ajo kishte këtë strukturë: *Banca, Gastaldo* (ose *guardiano*), *Vicario, Scrivano*, dhe *Degani*.

Shkolla Arbërore në fillimet e saj i ishte kushtuar Zojës së Këshillit të Mirë (*Madona del Buon Consiglio*, e quajtur edhe *Nostra Signora di Scutari*), si dhe Shën Galit. Që në vitin 1447 sipas vendimit të Këshillit të Dhjetëve, selinë e veprimtarisë së saj e kishte transferuar në famullinë San Maurizio, në zonën e Shën Markut, pjesë e qendrës së qytetit. Në kishën e Shën Mauricit, mërgimtarët arbërorë kishin të drejtë të tuboheshin, t'i mbajnë reliktet që i adhuronin, t'i varrosnin anëtarët e bashkëvëllezërisë. Për shkaqe të rritjes së numrit të mërgimtarëve arbër, autoritet e kishës venedikase nga kapërcyelli i shek. XV u japin të drejtën për ta përdorur varrezën në bazilikën e njohur dominikane SS Giovanni e Paolo. Në kishën e përmendur gjenden shumë varre të bashkëvëllezërisë arbërore. Në varrezën e kësaj kishe ruhet ky mbishkrim: QUESTA SEPULTURA SI E DELLA SCHOLA DE/ LA NATION DI ALBANESI MCCCCLXXXI. Ndërkaq, në kishëzën S. Orsola është gjendur mbishkrimi: SEPVLTVRA SCHOLAE SANCTAE MARIAE/SANTI GALLI NATIONIS ALBANIE/SIUM I. ORTE IN SANCTO MAVRITIO. MCCCCLXXXI.

Në vitin 1489, bashkëvëllezëria arbërore, tashmë kishte ndërtuar objektin e vetë. Godina e Shkollës ishte ngritur midis kishës së Shën Mauricit dhe kumbonarit, gjë që mund të vërhet fare lehtë edhe sot. Ajo kishte një ballinë të ngushtë me proporcion shumë të thellë, e cila mbështetej drejtpërsdrejti me kishën e Shën Mauricit. Për fasadën e godinës, përkatësisht ballinën, përveç qemerëve të dyerve dhe dritareve që për material ndërtimi u përdorë guri i Istrisë, pjesa tjetër e fasadës u ndërtua ndërkaq me tullë. Ballina e Shkollës, duke qenë në një lini me kishën, shikonte sheshin Piovan (*Calle del Piovan*). Kundruall Shkollës kanë qenë të

ngritura shtëpitë e kapelanëve, që shtriheshin deri te procka e afërme e Shën Mauricit dhe më pastaj duke u zgjatur deri te ndërtesa e kuvendit të Shën Mauricit. Në mes të godinës, është gjendur oborri pitoresk bashkë me një pus në qendër dhe me një galeri druri, e cila rrethonte oborrin në tërësi me hardhi. Nga oborri kishte tri dalje për në shesh, për në prockë në vendin e zbarkimit dhe në drejtim të kishës së Shën Mauricit. Shkolla zinte pjesën e pasme të godinës së gjatë. Më pastaj vinin shtyllat në gjërësi, dhe më pastaj bujtina e famullitarit. Në katin përdhësës është gjendur ashtuquajtura *Albergo da basso (bujtinae poshtme)*, ku është vendosur një altar guri pak i ndriçuar, gjë që dëshkohet edhe nga radhonjat e *Statutit* ose *Amzës* së shkollës. Kur është fjala për Statutin, respektivisht Amzën e bashkëvëllezërisë arbërore ose si e ndeshim në dokumente *Mariegola*, respektivisht *Matricola*, është ruajtur vetëm kopja nga viti 1750, e cila sot ruhet në Arkivin Shtetëror të Venedikut dhe në Biblioteca Nazionale Maraciana. Bashkëvëllezëria kulmin e zhvillimit e kishte arritur gjatë gjysmës së dytë të shek. XV dhe gjatë gjithë shek. XVI.

Bashkëvëllezërit të mërguar arbërorë nuk kursyen fare mjete për dekorimin e shkollës së tyre. Ata kishin një qëllim që shkolla e tyre gjithëherë të ruaj pamjen solemne. Përveç pjesës së brendshme apo enterierit të ndërtesës së shkollës, e cila në kuptimin e plotë të fjalës që një galeri e shkëlqyeshme, ajo zotëronte vlera të mëdha artistike edhe në relievin ballor të objektit të realizuar përfundimisht në vitin 1532.

Midis dy dritareve të katit të parë të shkollës është vendosur një pllakë e forcuar nga guri i Istrisë me një basoreliev madhështor, i cili edhe sot shihet e lexohet mirë. Aty, veç konfirmimit dhe rëndësisë qytetit të Shkodrës në politikën venedikase mbi Adraitik dhe Mediteran, shihet edhe rëndësia e mërgimtarëve shkodranë në historinë e mërgatës të komunitetit arbëror në Republikën e Venedikut. Në pjesën e epërme të kornizës e shohim paraqitjen e luanit të Shën Markut (Leone di San Marco), si dhe stemat e familjeve bujare venedikase Loredani e Lezze, dëshmia e rrethimeve më shkatërruese të Shkodrës (1474 2 1478-1479), dhe një mbishkrim që të kujton një kohë të suksesshme nga vitit 1474. Nën mbishkrim janë paraqitur relievet e figurave plastike të Shën Galit, Zojës Virgjër me fëmijën, dhe Shën Mauricit. Autori i këtyre veprave mendohet të jetë *Pirgoteli*, një skulptor zulmëmadh i Renesansës. Në fund, në arkitra të objektit përvijohet mbishkrimi. SCOLA S.MARIA SAN GALLO DI ALBANESI. Bashkëvëllezëria arbërore, numerikisht dhe ekonomikisht më e fuqishme pikërisht në kohët e vështira për ekzistencë, në vitet 1502-1508, për dekorimin e selisë së saj do ta angazhojë piktorin e madh Viktor Karpaçin i njohur me opusin e tij *Cikli i Arbërve*, ku paraqitën piktura me skena nga jeta e së Lumës Zojë Mëri: 1. *Nascita della Vergine (Lindja e Virgjërshës)*, 2. *Presntazione della Vergine al Tempio (Paraqitja e Mërisë në tempull)*, 3. *Madonna con il Bambino tra i Santi Caterina e Gerolamo (Zoja Mëri*

me fëmijën midis Shenjtorëve Katarina dhe Jeronimi), 4. *Sposalizio di Maria Vergine* (Kurorizimi i Mërisë Virgjër), 5. *L' Annunciazione* (Festa e Mërisë së Virgjër), 6. *La Visitazione* (Vizita e Zojës Maria Elezabeta) dhe 7. *La morte della Vergine* (Vdekja e Mërisë së Virgjër). Shkodra ishte paraqitur edhe në një pikturën *Gloria di Sant'Orsola* (Lavdi Shën Ursulës) të Karpaçit nga vitit 1491. Detaji i pikturës i paraqet shkodranët dhe osmanët dhe në prapaskenë paraqitet profili i fortifikatës dhe liqeni i Shkodrës. Kjo paraqitje i gjason paraqitjes së Shkodrës në librin e Rosacciòv-it, *Viaggio da Venetia a Constantinopoli* (Venezia 1598). Rrethimin e Shkodrës e ka paralajmëruar në pikturën me përmasa të mëdha të paraqitur në sallën e Këshillit të Madh të Pallatit të Dukës (*Salla del Maggior Consiglio*) edhe piktori i njohur venedikas, Paolo Veronese, rreth vitit 1585. Motive të ngjashme ndeshim edhe të Mark Basaiti, një piktor tjetër i madh arbëror, që ruante lidhje të afërta me pjesëtar të Shkollës arbërore. Këto lidhje nuk i kanë shkëputur asnjëherë edhe intelektualët e tjerë arbërorë, të cilët vepronin në Venedik dhe rrethe. Vargu i tyre është bukur i madh. Në këtë rast mua më pëlqen ta përmend, Marin Barlecin, Marin Beçikemin, Leonik Nikollë Tomeun, Gjin Gazullin, Martin Segoni, Lukë Paneti – Ulqinaku, Bernardin dhe Matej Vitali - Albanesoti dhe Nikollë Blashin.

Shkolla arbërore ishte aktive deri në 1780, bashkëvëllezëria shpërndahet në këtë vit dhe ndërtesa kalon në duart e korporatës *dei Pistori* (të bukëpjekësve). Shumë orendi dhe pajisje të brendshme me vlera të mëdha do të shitën apo do të humbasin. Në sallën e shkollës edhe më tej do të ruhen 43 piktura. Gjashtë prej tyre janë të Karpaçit. Ndërkaq, për të tjerat nuk kemi njohuri. Këto gjashtë piktura të Karpaçit i kishte parë në vitin 1784 edhe G. B. Mengardi, sipas të cilit këto kishin nevojë për mbrojtje urgjente.

Muhamet MALA, Muhamet QERIMI

NDIKIMET E NDËRSJELLA KULTURORE TË BIZANTIT DHE TË SHQIPTARËVE NË MESJETË

Ky punim trajton një segment të veçantë të fokusuar në fushën kulturore të ndikimeve të marrje - dhënieve në mes Bizantit dhe Arbërisë duke dëshmuar kështu kontributin dhe prezencën e vazhdueshme shpesh herë të mohuar arbërore në trevat autoktone dhe njëherit duke shprehur edhe forcën kulturore dhe jo vetëm prezencën fizike e pa gjurmë krijuese të arbërve mesjetarë siç dikur padrejtësisht potencojë. Në fakt, pozicioni gjeografik, prezenca e vazhdueshme në territoret kufitare në mes lindjes dhe perëndimit si dhe forca rezistuese ndaj presioneve asimiluese të dyndjeve barbare janë faktorë që e përcaktuan vazhdimësinë e kontakteve në mes arbërve dhe pjesës tjetër të Bizantit. Shikuar nga aspekti gjeografik dhe historik, roli i jashtë-zakonshëm i trevave iliro-shqiptare në kuadrin e Perandorisë Bizantine përcaktohej nga pozicioni kufitar me gadishullin Apenin, me të cilin interesat e Bizantit mbetën deri në fund të lidhura ngushtë. Nga ky kontest trevat arbërore u kthyen në një nyjë komunikimi të Lindjes me Perëndimin dhe anasjelltas. Një rol të tillë e favorizonte ekzistenca e porteve të rëndësishme gjatë bregdetit të Adriatikut e të Jonit ose e arterieve rrugore që fillonin prej tyre dhe zgjateshin në thellësi të Gadishullit duke lidhur bregdetin me qendra të tjera dhe duke mundësuar akomodimin më të lehtë të arbërve në rrethanat e reja shoqërore e historike të krijimit të perandorisë lindore. Ky akomodim ishte aq i theksuar sa që arbërit kontribuan, vepruan, por edhe mbeten të fshehur për një kohë prapa emrit romanoj derisa aktiviteti politik i ndërlidhur me atë kulturor e gjuhësor i nxori ata nga emri i përbashkët me romejet. Në kulmin e periudhës bizantine, në shek. XI, kur shqiptarët shfaqen për herë të parë me emër në literaturën historike, kronisti M. Ataliati pohonte se ky popull ishte “bashkëfetar” me bizantinët¹ e ne do të thonim edhe bashkëveprues me ta në pushtetin politik dhe krijimtarinë kulturore. Në fakt, Bizanti përbente në vete një konglomerat popujsh e kulturash që në fillim është vështirë të përcaktohet identiteti i secilës tërësi etnike aq më tepër që me kalimin e kohës materiali lidhës i këtyre kulturave dhe njëherit përcaktuesi i kësaj kulture bëhet gjuha greke e më vonë religjioni ortodoks. Në rastin e raporteve me arbërit, mungesa burimore e vështirëson identifikimin etnik në fazat

¹ Pëllumb Xhufi, *Ndjenja fetare në Shqipëri gjatë mesjetës*, S.Historike/1-4, Tiranë 1997, f 6.

më të hershme, por kultura materiale veçmas ajo e tipit të Komanit flet për elemente të veçanta etnike arbërore brenda sfondit politik e kulturor bizantin. Veçantitë etnike vijnë e forcohen me ndryshimet e reja që sllavët shkaktuan me dyndjet e tyre në Ballkan, ndërkaq këto ndryshime marrin tipare dalluese e të qarta etnike arbërore në kohën e krijimit të formacioneve politike arbërore. Shtrirja dhe përgjithësimi i hershëm i emrit Arbën/Arbër në trevat e ndryshme, ku flitej arbënisht/arbërisht, dëshmon për një vetëdijshmëri të atyre që flisnin këtë gjuhë, se i përkisnin një etnosi të vetëm. Siç pohon A. Buda, “Kjo ishte një dukuri që nuk kishte të bënte me pushtime, por me krijimin e një bashkësie ekonomiko-shoqërore dhe kulturore të përbërë nga trevat historike të shqiptarëve. Fakti se me emrin e njëjtë etnik Arbën, shqiptarët emërtohen në mënyrë të njëjtë si nga burimet mesjetare të hershme greko-bizantine (shek. XI e këndej), nga burimet perëndimore të së njëjtës periudhë, si edhe nga ato serbe e bullgare (shek. XII-XIII), pavarësisht nëse ishte fjala për trevat më jugore apo më veriore e lindore shqiptare, tregon tashmë për konsolidimin e tipareve të kësaj bashkësie etnike në etapën e saj më të lartë, si “kombësi”, proces i pasqyruar pikërisht në këtë emërtim të përbashkët”. Tani kur i kemi të qarta këto procese historike na jepet mundësia t’i përcjehim ndikimet e ndërsjella kulturore të njëjës apo tjetrës palë, duke kaluar nga e përgjithshmja bizantine në të veçantën arbërore dhe këto veprime të ndërlydhura u pasqyruan në shumë fusha si në ndërtime, arte figurative, muzikë religjion etj. Në fakt duke filluar nga shek. XIII pranë klerikëve në veprimtarinë kulturore të zhvilluar në tokat shqiptare shfaqen edhe përfaqësues të aristokracisë vendase, më shpesh si klitor (themelues) ndërtimesh monumentale kishtarë ku nëpër freska kemi paraqitjet vendore që dallojnë nga ato bizantine. Fuqizimi ekonomik e politik i jepte aristokracisë vendore mundësinë të angazhonte artistë e mjeshtër dhe të ndërmerre ndërtime të kushtueshme. Në kohën kur arti bizantin i periudhës së komnenëve dhe sidomos ai i kohës së paleologëve mori tiparet e një arti të konsoliduar, të një rryme artistike përparimtare, e cila është përgjithësuar me emrin “Rilindja e artit Bizantin”² në viset arbërore kjo rrymë përkon me etapën e lulëzimit të jetës qytetare dhe me krijimin e formacioneve shtetërore feudale shqiptare. Midis ikonave dëshmohen punime të rralla si ajo e tre Jerakëve në kishën e Shën Vlashit (Vlorë), si dhe ikona me përmasa monumentale ku duhet veçuar ajo e Kishës së Shën Mëhillit. Këtë të fundit kritikë të huaj të artit bizantin e kanë quajtur “Xhokonda shqiptare”³. duke e ndarë me emërim nga sfondi kulturor bizantin. Artistët ndërthurën mirë artin bizantin me atë lokal. Rezultat i këtyre tendencave në rritje qe formimi i shkollave të artit. Secila prej tyre kishte traditat e saj specifike e lokale, por të gjitha ishin pjesë e shkollës bizantine të artit. Shkolla lokale gjithnjë e më shumë largohej nga tiparet

² *Historia e popullit shqiptarë...vep.cit, f. 367.*

³ Po aty, f. 368.

universale karakteristike për stilin bizantin në përgjithësi. Veçoritë lokale apo e thënë ndryshe ngjyrat vendase (shqiptare) u reflektuan kryesisht tek fryma dhe elementet humaniste⁴. Në skenat biblike depërton hap pas hapi mjedisi real. Depërtimet më të hershme datohen në shpellën e Bllashtojës dhe atë të liqenit të Prespës në të cilat kanë gjetur shprehje “shumë skena të pazakonta për bizantin”⁵. Në shprehjen të pazakonta për bizantin le t’i kuptojmë tiparet lokale. Në këtë kuadër duhen përmendur afresket e kishës së Shën Klementit të Ohrit që u porositën nga bujari shqiptar Progon Zgura në vitin 1295. Po në Ohër në vitin 1361 përmendet si porositës peshkopi Grigor i Devollit. Gjergj Balsha porosit epitafin e Glavinicës (i zbuluar në manastirin e Ballshit)⁶, kurse veprat murale të piktorit anonim në kishën e Maligradit dhe të Shën Thanasit në Kostur, të realizuara në vitin 1385 ishin porosi të vëllezërve Muzakaj⁷. Krahas porositësve shqiptarë, fisnikë dhe klerikë në gjinitë e ndryshme të artit figurativ të bie në sy pasqyrimi i figurave laike dhe më së shumti figura princërore. Në këtë aspekt duhen përmendur portreti i princit shqiptar Balsha me të birin në kishën e Shën Dhimitrit (Pejë)⁸, një fakt ky pak i njohur dhe i potencuar në opinionin e gjerë për arsye se kisha e Pejës për shkaqe politike identifikohet vetëm me trashëgiminë serbe duke i fshehur gjurmët ndikimeve tjera. Mendojmë se paraqitja e personave realë në pikturën tonë kishtare është një traditë e lashtë që nis që me mozaikun e Durrësit. Kjo natyrë paraqitjeje ka ndikuar në pasqyrimin më jetësor të shenjtoreve, për dallim nga ato bizantine ku figurat janë me statike dhe më pak të lirshme, apo thënë më saktë tek tërësia e artit figurativ bizantin dominojnë me rigorozitet spiritualizmi dhe ngurtësia. Figurat njerëzore paraqiteshin në mënyrë asketike, me ndjenja të përgjumura, kurse elementi vendas, parapëlqen dinamizmin dhe të lirshmën. Elementët laikë e realistë, tek të cilat gjenden më shumë veçori lokale, janë të pranishme edhe në pikturat monumentale të fasadave. Në këtë rrafsh duhet përmendur paraqitja e sundimtarit lokal në fasadën e kishës së Maligradit. Ai është paraqitur me stoli princërore dhe i stolisur me zhaba (shkaba) dykrenore⁹. Kulmin në aspektin krijues vendor e shënon treva e Apollonisë. E rëndësishme është se tradita apoloniote u zhvillua gjatë shek. të XIV edhe në pjesë të tjera të territorit shqiptar. Shumë autorë përvetësuan arritjet e shkollës apoloniote dhe u prezantuan me punime që kishin për model këtë shkollë në vise të tjera. Këto dëshmohen në afresket e Maligradit, të Mborjes, në një pjesë të afreskeve të kishës

⁴ Petrika Thëngjilli, *vep.cit.*, f. 117.

⁵ *Historia e popullit shqiptarë... vep.cit.*, f. 365.

⁶ Dhorka Dharmo, *Mbi disa tipare të përbashkëta...f.* 108.

⁷ Petrika Thëngjilli, *vep.cit.*, f. 117-18.

⁸ Gojko Subotic, *L'eglise Saint Demetrias a la Patriarcie de Pec*, Beograd, 1964, f. V-VI. Sipas Dhorka Dharmo, *Mbi disa tipare të përbashkëta...f.* 108.

⁹ Petrika Thëngjilli, *vep.cit.*, f. 118.

së Deçanit, të Shën Dhimitrit (Pejë)¹⁰. Shikuar nga ky kontekst është gabim që sot trashëgimia paleo kristiane dhe ortodokse e Kosovës identifikohet vetëm me vlerat serbe aq me tepër që kristinizimi i tyre është për tetë shekuj më i vonshëm se ai iliro-arbëror. Në këtë kontekst serbizimit të këtyre vlerave pa dyshim se i kontribuoi pushtimi mesjetar i Kosovës nga serbët, por edhe islamizimi i mëvonshëm i shumicës shqiptare gjë që e lehtësoi përvetësimin e vlerave paleo-kristiane dhe bizantine vetëm nga serbët duke i dhënë njëherit ngjyrën serbe këtyre objekteve të cilat edhe sot vazhdojnë të jenë të tilla madje me përfitime të theksuara politike. Vazhdimësia e ndikimeve reciproke arbërore-bizantine përveç në artet kishtare u shpreh padyshim në fushën e muzikës dhe këtë ndërlidhje mund ta përcjellim përmes personalitetit të muzikantit Jan Kukuzeli. Ky përfaqësuesi më i spikatur në periudhën e mesjetës në Perandorinë e Bizantit del se ka lindur rreth viteve 1078-1088¹¹, në trevat e Arbrit. Thuhet se pas mësimeve të para që i mori në vendlindje e dërguan në Kostandinopojë, për të vazhduar studimet në shkollën perandorake¹². Me zërin e bukur, me prirjen artistike, zgjuarsinë dhe punën ngulmuese, djaloshi arbër përparoi shumë në atë mjedis të huaj, derisa arriti të emërohej drejtues i lëvizjes muzikore në kryeqytet dhe të nderohej me titull “Mjeshtër”¹³. Kukuzeli këndonte në oborrin perandorak, në foltoren e Shën Sofisë dhe dëgjohej nga shumë njerëz, të cilët mahniteshin me mjeshtërinë dhe të kënduarit e tij.¹⁴ Ky artist i madh, hartoi sistemin e tij, për shkrime muzikore, përpiloi metodën e tij mësimdhënëse, krijoi himnet dhe këngët më të bukura, deri sa u plak dhe vdiq në moshën 80-vjeçare ndoshta nga gjysma e dytë e shekullit XII. Të gjitha këto padyshim patën ndikimin e vet të pamohueshëm në zhvillim e artit muzikor bizantin

Çështja fetare paraqet një fushë tjetër shumë me rëndësi të kompleksitetit bizantin dhe arbëror ku vërehen ndikime dhe fërkime që e bëjnë specifikën arbërore të multi konfesionalitetit si tipar dallues nga popujt tjerë të Ballkanit.

¹⁰ Dorka Dharmo *Mbi disa tipare të përbashkëta*, f.102

¹¹ Në Historiografi ekziston mendimi i ndarë rreth kohës se kur ka jetuar dhe vepruar Jan Kukuzeli. Sipas studiuesit Ramadan Sokoli, *16 Shekuj*, Tiranë, f 50, ky artist jetoi dhe veprroi në fundin e shek.XI dhe në gjysmën e dytë të shek.XII, ndërsa sipas studiuesit A.Jakovleviq, David Redestinos i Jovan Kukuzel u srpskoslovenskim prevodima, Zbornik radova vizantologog instituta XII, Beograd 1970, Kukuzeli jetoi dhe krijoi në shek.XIV. Në fakt, ky studiues thekson se është i njohur edhe një muzikant me emrin e njëjtë, por që kishte jetuar në shek.XII apo ndoshta edhe në shek.e XI. Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë me saktësi kohën e veprimtarisë së Jan Kukuzelit dhe të sqarojmë problemin se a është fjala për dy persona që jetuan në kohëra të ndryshme apo bëhet fjalë për një pëson tek i cili nuk është përcaktuar ende me saktësi koha kur jetoi dhe veprroi. Megjithatë ne mendojmë se për këtë problem duhet të studiohet dhe të konsultohet një literaturë më e gjerë dhe të vihet në një përfundim të drejtë.

¹² Po aty.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

Krishterimi filloi të përhapej në Shqipëri që në kohën apostolike (shek. I i erës sonë) si fe ilegale. Shën Pali, apostull me shoqëruesit e tij, zbritën në Apoloni për t'u shpërndarë në Ilirik, Epir e Maqedoni¹⁵. Deri në shekullin e VIII kisha në Iliri ishte direkt nën varësinë e Romës. Ky është shkaku që terminologjia e kishës Shqiptare është latine si bie fjala (meshë, kungatë, prift, shenjtë, pagëzim, peshkop, kryq, mallkim etj. Kjo terminologji mund të shërben edhe si dhe dëshmi e autoktonisë iliro-arbërore e cila duke qenë prezente në vazhdimësi në ato treva e pranoi krishterimin në formën dhe terminologjinë fillestare shumë kohë para sllavëve dhe të tjerëve. Në këtë periudhë, strukturat kishtarë në Iliri u organizuan mbi bazën e provincave të Dardanisë, të Prevalit dhe të Epirit. Pas shpalljes së krishterimit si fe zyrtare shtetërore në Perandorinë Romake (380) u themeluan peshkopatat e para në Shqipëri¹⁶. Duke qenë zonë kufitare terreni i Arbërisë mesjetare paraqet arenën e fërkimeve fetare dhe njëherit të ndikimeve nga të dy kishat e krishtera të krijuara pas skizmës së madhe të gjysmës së shek.XI¹⁷. Riti lindor, përhapjen më të madhe e pati në shek. X, ende pa përfunduar ndarja atëherë kur mitropolia e Durrësit shtrihej nga Tivari deri në Vlorë dhe kishte nën vartësi 15 seli peshkopale¹⁸. Në shek. XI kisha latine u riafirmua në Shqipërinë e Veriut nëpërmjet degëzimeve të skajshme dalmatinase¹⁹. Midis enklavave që ruanin lidhje solide me Romën ishin provinca e Prevalit në të cilën ishin instaluar qytetet: Shkodër, Drisht, Danjë, Shas, Tivar dhe Ulqin. Mendohet që Lumi i Matit të ketë qenë vijë ndarjeje ndërmjet Bizantit dhe Romës. Megjithë tendencën e kishës perëndimore që të përhapej drejt lindjes përmes trevave shqiptare, vendasit e viseve jugore e ruajtën ritin lindor. Për më tepër mbreti i bullgarëve, Borisi në vitin 866 u pagëzua me popullin e tij në Kishën e Ballshit (në tokat e Arbrit) një fakt ky domethënës i trashëgimisë tradicionale krishtere në Arbëri. Zbarkimet e normanëve, më 1081 dhe më 1105 si dhe zhvillimi i kryqëzatës së parë më 1096 shkaktuan lëkundje për unifikimin e kishës së krishterë. Pushtimi i Kostandinopojës më 1204 nga Kryqëzata e IV dhe mbajtja e saj për 60 vjet nën sundimin francez, sollë edhe murgjit francezë benediktinë në Arbëri (1230) e më këtë edhe ndikimet perëndimore. Pavarësisht prej veprimit intensiv të kishës katolike, në jug të vijës Durrës-Ohër, pozitat e kishës ortodokse nuk u rrezikuan seriozisht. Qendrat e mëdha ortodokse bizantine vepronin dhe punonin në mënyrë

¹⁵ Radomir Popovic, *Le christianisme sur le sol de l'Illyricum oriental jusqu'à l'arrivée de slaves*, Thessaloniki, 1996, f. 21-27 ; Bernard Bavant, *L'Illyricum, dans Le Monde Byzantin I, L'Empire romain d'Orient (330-641)*, Paris 2004, f. 318-320; Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis lindjes dhe perëndimit 1506-1839 (Fusha Fetare)*, Tiranë, 2002, f. 13

¹⁶ Kristo Frashëri, *The History of Albania*, Tiranë, 1964, f. 30.

¹⁷ Christiaë Fraïsse-Coué, *L'incompréhension croissante entre l'Orient et l'Occident*, dans Les Elgises d'Orient et d'Occident, tome III, Desclée 1998, f. 175; Myzafer Korkuti, *Parailirët, Ilirët, Arbërit*, f. 80 ;

¹⁸ Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis lindjes dhe perëndimit...* f. 14.

¹⁹ Moroco della Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944*, Tiranë, 1994, f. 66.

intensive. Midis tyre duhen përmendur peshkopatat e Durrësit, dhe Ohrit. Formimi i despotatit të Epirit do të vazhdojë traditën bizantine në trevat jugore Arbërore nga pikëpamja shtetërore e kishtarë. Ky Despotat që në një farë mënyre një imitim i perandorisë Bizantine dhe vazhdimësi e traditës së saj kulturore e politike. Edhe pse tokat dhe popullsia shqiptare në shek. XI-XV, u përfshin në dy përkatësi fetare (ortodokse e katolike), nuk arriti asnjëherë të kishte karakter të jotolerancës e të fanatizmit fetar. Nuk gjenden të dhëna historike që të dëshmojnë ekzistencën e konflikteve fetare midis shqiptarëve ortodoksë dhe atyre katolikë dhe kjo është një specifikë tjetër e veçantisë arbërore në kuptimin fetar nga e përgjithshmjia bizantine apo katolike që njëra -tjetrën e shihnin përmes antemimeve dhe armiqësive të pa pajtueshme. Mirëpo pas shembjes së Perandorisë serbe dhe asaj Bizantine, ortodoksia humbi përfundimisht mbështetjen politike. Për rrjedhojë, katolicizmi pati shtrirjen më të madhe. Katolikë ishin rajonet e Pultit, të Arbërisë e të Kandavisë, veçanërisht familjet princore të Topisë, të Krujës, të Kaninës, të Muzakajve, të Shpatajve, të Zenebishtëve, të Balshajve, të Arianitëve²⁰. Pra, në kontekst me Bizantin aspektet fetare të Arbërisë na dalin multi fetare madje me tendencë konvertimi kah katolicizmi siç është rasti i familjeve të përmendura duke mundësuar kësisoj edhe hapjen e derës për religjionin e tretë që do të vijë më vonë me osmanët. Nën ndikimin e kishës lindore, gjuha kishtarë (greqishtja) shërbeu edhe si gjuhë shkrimi në administratën shtetërore. Ajo u përdor si e tillë dhe nga një pjesë e aristokracisë shqiptare, ndërkohë që pjesa tjetër përdorte latinishten dhe më pak sllavishten. Midis sundimtarëve shqiptarë që përdorte gjuhën greke duhet veçuar familja e Muzakajve. Kishte familje aristokratike shqiptare që i përdornin në të shkruar të tria gjuhët e sipërpërmendura si Karl Topia dhe Kastriotët. Kjo dëshmohet në manastirin e Shën Gjonit pranë Elbasanit, në të cilin janë fiksuar mbishkrime me autor Karl Topinë dhe që i përkasin vitit 1383²¹. Një pasuri të trashëgimisë bizantine dhe të inkorporimit kulturor të shqipatrëve paraqesin pa dyshim edhe kodikët e grumbulluar në një koleksion brenda të të cilit përfshihen mbi 100 vëllime në vepra të plota. Kodiku më i vjetër është “Kodiku i Purpurtë i Beratit” (Codex purpureus Beratinus), i shkruar në gjuhën greke, jo më vonë se shek. VI pas Krishtit. U zbulua në vitin 1868 nga A. Aleksidhi dhe u studiua e publikua nga francezi P. Battifol në vitin 1884²². Është shkruar në shek. e VI me ngjyrë të kuqe prej nga ka marrë dhe emrin “i purpurt”. Ky është dorëshkrim me vlera historike, sepse këtu janë kërkuar fillimet e letërsisë biblike. Sipas kronologjisë kodiku i dytë, i quajtur “Beratinus-2” është përgjithësuar me emrin “Kodiku i Artë” (Codex aureus) dhe është shkruar në pergamenë, në gjuhën greke me shkronja të vogla të arta dhe i takon shek. IX. Sipas një shënimi

²⁰ D. Shan Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, f. 51.

²¹ Po aty, f. 354.

²² Petrika Thëngjilli, *vep.cit*, f. 113.

kronikal të vitit 1346, këta kodikë ruheshin në një bibliotekë të qytetit të Beratit²³. Krahas kodikëve të përmendur dëshmojnë edhe dhjetëra dorëshkrime të tjera, që përgjithësisht kanë marrë emrat e qyteteve ku janë zbuluar. Midis tyre duhen përmendur: “Kodiku i Vlorës” që i përket afërsisht shek X, “Kodiku i Përmetit” dhe “Kodiku i Shkodrës” që u përkasin shek. XIV²⁴ etj. Informacioni i grumbulluar dhe i paraqitur këtu na lejon të konkludojmë se niveli kulturor i trevave shqiptare përkonte me nivelin e kohës madje me një gërshetim lindor dhe perëndimor si specifikë e veçantë e Arbërisë. Në fillim, siç theksuam, veprat ishin shkruar në gjuhët zyrtare të kohës, por më vonë shqipja e shkruar mund të dokumentohet qartazi gjatë shekullit të XV në dy dialektet e saj kryesore: të veriut dhe të jugut dhe me dy alfabetet: latin e grek. Fakti i fundit është një tregues për zhvillimin e kulturës shqiptare nën ndikimin e kulturave latino-katolike dhe bizantino-ortodokse. Pra ashtu si në kuptimin fetar edhe në kuptimin e gjuhëve dhe alfabetëve trevat shqiptare paraqesin një laramani dhe një pikë ku takoheshin ortodoksia me katolicizmin, lindja me perëndimin, greqishtja me latinishten dhe kjo ishte specifikat e trevave shqiptare në kontekstin e mesjetës. Përmes këtij shkrimi ne nuk pretendojmë të barazojmë ndikimet apo vlerat e ndikimeve të arbërve në Bizant, sepse një pjesë e kësaj kulture para se gjithash u zhvillu në kuadër të këtij sfondi, por para së gjithash dëshirojmë të potencojmë kontributin që kultura lokale e dha duke dalë jashtë shablloneve të përgjithshme bizantine dhe me specifikat lokale e begatojnë koloritin e kulturës bizantine duke qenë njëherit edhe një pjesë e kulturës mesjetare.

Për fund të themi po ashtu se qëllimi i këtij punimi ishte që përmes fakteve konkrete të shprehet edhe fuqia krijuese kulturore vendore e arbërve gjatë mesjetës duke kundërshtuar kështu klishetë tradicionale që arbitri i portretizonin vetëm si elemente luftarake apo baritore në ekspansion të vazhdueshëm biologjik gjatë mesjetës.

²³ Po aty.

²⁴ *Historia e popullit shqiptarë...*, f. 353.

Burak KABA

SHQIPTARËT NË PERANDORINË OSMANE

Otomanët janë një shtet që rreth 500 vjet kanë sunduar territoret shqiptare. Një nga periudhat më të rëndësishme në historinë shqiptare është periudha e Osmanëve. Kjo periudhë sa e rëndësishme është për historinë shqiptare aq e rëndësishme është edhe për historinë turke. Me sistemin e rekrutimit që ka zbatuar Perandoria Osmane, kultura shqiptare ka ndikuar në administratën, në letërsinë, në artin dhe në kulturën Osmane.

Marrëdhëniet në mes shqiptarëve dhe Osmanëve zgjasin mëparshme të sundimit së Perandorisë Osmane. Në skenën e historisë, takimi i shqiptarëve me osmanët është periudha e babait të heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Gjon Kastrioti. Gjergj Kastrioti ka ardhur në pallatin e Osmanëve dhe trajnimet i ka kryer këtu dhe është bërë një ushtarak mjeshtër, në Ballkan dhe në Anadoll ka bërë punë të rëndësishme dhe të mëdha. Më vonë ,revoltimi i Gjergj Kasrtiotit kundër Osmanëve, mbrojtja e shqiptarëve në Krujë dhe krijimi sovranitetit në këto troje, i ka shtuar marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe osmanëve deri në shekullin 20.

Në periudhën Osmane vendi dhe rëndësia e shqiptarëve është aq e rëndësishme sa s'mund të diskutohet. Vetëm në pallatin e Osmanëve kanë qënë 32 vezirë të mëdhenj (Sadriazemë). Vendi i shqiptarëve në periudhën osmane nuk është i kufizuar vetëm në pallat, por shqiptarët në politikë, në arkitektonikë, në art dhe në letërsinë kanë bërë vend të rëndësishëm. Vendet e shqiptarëve në periudhën Osmane mund t'i shqyrtojmë në 4 tema kryesore.

- 1) Shqiptarët në fushën politike
- 2) Shqiptarët në fushën e letërsisë
- 3) Shqiptarët në fushën e artit dhe arkitekturës
- 4) Shqiptarët dhe efektet në kulturën Osmane-Turke

Shqiptarët në politikën osmane

Sistemi i rekrutimit i zbatuar nga kombet nën sovranitetin Osman ka prodhuar shtetarë shumë të rëndësishëm. Dhe shqiptarët në këtë sistem e kanë edukuar shumë mirë veten dhe kanë bërë shumë punë të rëndësishme. Kështu që kanë qënë 32

vezirë me orgjinë shqiptare si Gedik Ahmet Pashai, Koxha Davut Pashai, Dukakinzade Ahmet Pashai dhe Tarhunxhu Ahmet Pashai.

Në historinë Osmane familja ‘Qypriyly’ është një emër i dëgjuar shpesh në lidhje me punët që ka bërë, 27 vjet në pallatin ku familja ka jetuar në historinë Osmane quhet “Periudha e Qypriylsë”.

Nëse një njeri tjetër që është shquar në fushën politike është Abdullah Hysni Beu që njihet nga shqiptarët si Abdyl Frashëri. Abdyl Frashëri është një intelektual që shërbeu si deputet në Parlamentin Osman.

Duke pyetur se cila është arsyeja e mungesës së zhvillimit të perandorisë Osmane, ai e ka hapur këtë temë në Parlamentin Osman. Përseri në kuvendin e XV. se parlamentit në datën 25 janar 1878 është mbajtur një fjalim për mungesat në fushën e arsimit.

Në sistemin ushtarak të Osmanëve themelin e përbëjnë boshnjaket dhe shqiptarët. Kuptimi i fjalës ARNAVUT në turqishten e vjetër është “drejtues te shpejtë në luftë” që kjo tregon rëndësinë e shqiptarëve në periudhën Osmane jo vetëm në fushën politike dhe administrative, por edhe në fushën ushtarake.

Shqiptarët në letërsinë turke

Emri më i dëgjuar në literaturën turke është autori me orgjinë shqiptare Shemsedin Samija që njihet nga shqiptarët si Sami Frashëri. Punimet e tij janë burime shumë të rëndësishme në literaturën turke. Romani i parë turk "Taa uk-i Talat ve Fitnat" (Dashuria e Talatit me Fitnatën) është një trashëgimi e madhe që i ka lënë letërsisë turke Sami Frashëri. Sami Frashëri për herë të parë ka përdorur shenjat e pikësimit në këtë libër. Sami Frashëri ka punuar në shumë revista dhe gazeta, edhe romanin “Robinson Crouse” të Daniel Defos dhe romanin “Sefiller” të Victor Hugos e ka përkthyer. Sami Frashëri për letërsinë turke nuk ka shkruar vetëm romane, por ai ka shkruar edhe fjalorin e parë turqisht-turqisht (Kamus-i Turki) dhe fjalorin frëngjisht-turqisht, turqisht-frëngjisht (Kamus-i Fransevi). Si pasojë e këtyre punimeve a ka marrë një shpërblim shumë të madh nga Sulltani Abdyhamit i II’ të.

Në fund të punimeve që ka bërë Sami Frashëri në turqisht ka shkruar edhe enciklopedinë e parë turqisht me titull Kamus-al A-lam. Punimet që ka bërë Sami Frashëri për gjuhën dhe letërsinë turke jo vetëm në kohën e hershme, por edhe sot kanë vend shumë të rëndësishëm në letërsinë turke.

Një tjetër emër që ne e dimë me identitetin shqiptar në letërsinë turke është Mehmet Akif Ersoj. Babai i tij emigroi në Stamboll dhe ai është İpekli Tahir Efendi që ka qenë mësues në shkollën Stamboll Fatihu. Edhe pse ka qenë i lindur në Stamboll, Mehmet Akif Ersoj kurrë nuk e harroi atdheun e vërtetë Kosovën dhe me vargjet;

“Kudo që ndodhem para syve më del një fushë përgjakur

A je ti, apo përfytyrimi yt; Kosovë e papërkrahur”

e tregon mallin që ka për atdheun.

Mehmet Akif Ersoj ka folur shumë herë për Shqipërinë, Shqiptarët dhe Kosovën në veprat e tij. Mehmet Akif Ersoj në poezitë e tij shkruante për problemet e Shqipërisë të sapo pavarur. Mehmet Akif Ersoj me gjuhën dhe stilin që ka përdorur të poezitë ka pasur pë qëllim t’i tregonte të vërtetat lexuesit dhe ta çonte lexuesin të problemet e njeriut. Një tjetër gjë që mund ta themi për veprat e tij është se në përgjithësi ka shkruar me temën fetare. Mehmet Akif Ersoj asnjëherë nuk ka përdorur tregime ultra-nacionaliste në veprat e tij. Mehmet Akif Ersoj nga që shkruajti himnin kombëtar të Republikës Turke ai është emëruar si poet kombëtar nga parlamenti Turk dhe Turqia për të ruajtur trashëgiminë e tij në Turqi janë hapur shumë shkolla dhe universitete me emrin e tij.

Shqiptarët në fushën e artit dhe arkitekturës

Shqiptarët mbas politikës dhe letërsisë kanë treguar efektet edhe në fushën e arkitekturës. Kur themi arkitektura e Osman, emri i para që vjen në mend është Arkitekt Sinani. Arkitekt Sinani që ende ka në këmbë mbi 300 vepra nga Beogradi deri në Meke, është një arkitekt me orgjinë shqiptare. Gazeta më e njohur në botë New York Times ka thënë për Arkitekt Sinanin se “Sinani është ylli i parë arkitekt në botë.” Arkitekt Sinani ka punuar i lidhur me pallatin Osmane dhe ka punuar në një nivel të njohur sot si "Ministria e Urbanizmit". Nga qindra gjëra që ka bërë më e rëndësishmja është Xhamia Selimije që e ka bërë kur ka qenë 80 vjeç dhe i thotë “puna e mjeshtërisë”.

Nëse një tjetër Arkitekt i periudhës Osmane me orgjinë shqiptare është nxënësi i Arkitekt Sinanit, Sedefkar Mehmet Agaja nga Elbasani. Edhe Sedefkar Mehmet Agaja është një arkitekt i rëndësishëm që ka bërë shumë vepra të mëdha dhe vepra më e rëndësishme e tij është Xhamia e Sulltan Ahmetit, e cila është simboli i Stambollit.

Shqiptarët dhe efektet në kulturën osmane-turke

Gjurma e marëdhënieve midis shqiptarëve dhe Osmanëve akoma vazhdon sot dhe këto gjurma kanë marrë vendin në kulturën Turke. Sot në fjalorët e gjuhës turke fjala “Arnavut” do të thotë "njerëz që jetojnë në Shqipëri dhe në atë zonë" dhe emrat dhe frazat që rrjedhin nga fjala Arnavut kanë gjurmë nga kultura shqiptare.

Për të dhënë disa shembuj;

- kalldërëmi shqiptare (Arnavut kaldırımı); trotuar ose shteg i bërë me gurë të vegjël. (gjatë periudhës osmane është quajtur kështu për punëtorët shqiptarë që punojnë në këtë biznes.)

- inati shqiptar (Arnavut inadı); inat shumë i fortë.

- spec shqiptar (Arnavut Biberi); spec i kuq shumë djegës.

- valle shqiptare (Arnavut halayı); nje valle popullore që është luajtur zakonisht nga gratë në Anadollin e brendshëm.

- te jesh shqiptar (Arnavutla mak); kokëfortë.

- melçi shqiptare (Arnavut ciğeri); nje lloj meze nga mushkiritë e deles ose të qengjit

Në lojrat qendrore tradicionale Turke dhe në lojrat Karagöz e Haxhivati bën rol karakteri që nevrikoset shpejt, i drejtë dhe i mirë shqiptar. Ngjashmëria midis këtyre dy kombeve ka përsheptuar shkëmbimet kulturore dhe kulturën shqiptare edhe në kulturën turke rëndësia që i jepet familjes dhe respekti që i tregohet të mëdhenjëve duket shumë hapur. Njerëzit e patrembur, të ndershëm të popullit turk dhe popullit shqiptar kanë ndikuar në për veprimet deri tani.

Mund të japim shumë shembuj të tilla të tjera për gjurmat e shqiptarëve në kulturën turke, sepse marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë nuk janë marrëdhënie të bazuara në një histori të kohëve të fundit, por është një marrëdhënie gati 600-vjeçare. Si vëllezër që kanë jetuar 624 vjet këto dy komunitete dhe me ndihmën e Perendisë do jetojnë si vëllezër përgjithmonë. Historiani shqiptarë PARIM KOSOVA e tha në një intervistë me gazetarin HAKAN ALBAYRAK; “*Sa kanë qenë Turq Otomanët kanë qenë Arabë edhe Shqiptarë*”. Me këto fjali na ka treguar lidhjet në mes dy komuniteteve dhe rënia e 15000 shqiptarëve për popullin e tyre në betejën e Galipolit ka qenë dëshmi.

Tolga D LL O LU

SHQIPTARET E TURQISË MODERNE

Migrimi i parë i shqiptarëve në Anadoll, filloi me sundimin Osman në Shqipëri, në tokat shqiptare. Shqiptarët që jetonin në këto rajone emigruan në një rën nga qendrat e rëndësishme të Perandorisë Osmane në Anadoll që nga shekulli 15 (pesëmbëdhjetë), migrimet këto që kryesisht ishin për çështje arsimore dhe ekonomike.

Shqiptarët e parë që emigruan në Turqi kanë qenë shqiptarët që kanë ardhur në pallatin Osman dhe kanë pasur detyra si pashallarë, kujdestari etj. Këta kanë ardhur me familje. Shqiptarët që kanë ardhur për herë të parë në periudhën e Fatih Sulltan Mehmetit janë vendosur në një pjesë të madhe të Stambollit që sot njihet si Arnavutköy (apo fshati shqiptar), i cili fshat sot gjendet pranë Detit të Marmarasë. Në të njëjtën kohë shqiptarët kanë banuar edhe në vendet tjera si: Rize të Detit të Zi, në Samsun dhe Trabzon etj.

Njeri ndër personalitetet më të njohura në historinë Osmane, është edhe Abdurahman Abdiu një emër i njohur me orgjinë shqiptare, mbi 70 vjeç, u vra me shpatë në dorë pa u dorëzuar te armiku duke mbrojtur Kalanë e Budinit dhe vilajetin e Budinit, duke vazhduar më pas edhe me një emër tjetër, po ashtu me origjinë shqiptare Tahsin Pashën, guvernatori i fundit që mbrojteti Selanikun në fund të Luftërave Ballkanike.

Një emër tjetër i nderuar si në Turqi, ashtu edhe në Shqipëri, është edhe mjeshteri i madh i gjuhës turke, Shemsedin Samiu, ideologu i Lëvizjes Kombëtare Shqiptar. Emër tjetër i njohur gjithashtu edhe në botën turke edhe në atë shqiptare është edhe Ibrahim Temo ideologu i Lëvizjes së Turqve të Rinj, apo siç njihet te shqiptaret Lëvizja Xhon-turke, e cila ka patur pasoja të mëdha për dy popujt, turqit dhe shqiptarët. Por, nga emrat shumë të respektuar në Turqi, për faktin se shkroi himnin e Turqisë, i cili dhe sot në përdorim dhe i përuar mbi 70 milion turq, ishte me origjinë shqiptare dhe në anën tjetër asnjëherë nuk e harroi vendlindjen e babit të tij Pejën, Kosovës dhe krejt shqiptarët duke iu shkruar me shumë përkushtim dhe dhimbje edhe në veprën e tij "Safahat", e cila është përkthyer edhe në gjuhën shqipe me emrin "Fletët", ai është Mehmet Akif Ersoj.

Në këtë periudhë përveç ekzistencës e tyre në stafin administrativ osman, shqiptarët kanë emigruar edhe në Anadoll për arsye ekonomike.

Këto emigrime kanë vazhduar më pas edhe nëpër territoret e tjera shqiptare nga luftërat ballkanike dhe mbas luftës së parë botërore, për të shpëtuar nga sllavët pas luftës së dytë botërore.

Shqiptarët përbëjnë 70 (shtatëdhjetë) për qind të minoritetit turk-folës në Jugosllavi. Njëra nga arsye e emigrimit të detyruar e shqiptarëve në Turqi ishte edhe aspekti fetar.

Në një studim të kryer në vitin 1965 në Turqi mbi bazën e refugjatëve , janë identifikuar 535. 520(pesqindë mijë e pesqinë e njëzetë) shqiptarë. Shpërndarja dhe vendosja e shqiptarëve në krahina të ndryshme të Turqisë, kryesisht, mbulon Anadollin perëndimor dhe qendror. Janë vendosur në qytete si; Samsun, Tokat, Yozgat, Stamboll, İzmir, Bursa, Ankara dhe Sakarya. Shumica e folësve të gjuhës shqipe kanë qenë në Stamboll. Gjithashtu, në fshatrat më poshtë të Adanas, Amasjas, Kajserisë, Elazës dhe Kahramanmarashit.

Është shumë e vështirë të parashikosh numrin e saktë të shqiptarëve në Turqi dhe, në fakt, shumica nuk e dëshirojnë që të bëhet ky dallim, por sipas vlerësimeve afërsisht janë 5 milionë shqiptarë, të cilët e kanë harruar gjuhën, por vazhdojnë të mbajnë kontakte me të afërmit e tyre dhe vazhdojnë të jetojnë në Turqi.

Jo vetëm në Turqi gjatë Perandorisë Osmane, pothuajse, në çdo rajon të perandorisë, si në ushtri, shef të administratës civile, si një njeri të ligjit etj.

Ne sot shohim rrënojat e kolonisë me shqiptarë në të gjitha vendet e Lindjes së Mesme dhe në vendet afrikane. Me ata shpesh ballafaqohemi si një diplomat ministër sirian me orgjinë shqiptare, si kryeministër në Arabinë Saudite, si një biznesmen me orgjinë shqiptare në Libi dhe Egjypt. Kolonitë shqiptare, pothuajse të gjithë prej tyre varen nga Turqia, e shikojnë Turqinë me dashuri dhe pothuajse të gjithë prej tyre kanë të afërmit në Turqi, më një fjalë Turqia u bë si një urë lidhëse e emigrimit për në vendet e Lindjes së Mesme, ku shumë familjarë të tyre mbetën në Turqi.

Sipas informatave që i kemi marrë nga njerëzit vendet ku shqiptarët jetojnë janë; Ankara, Sakarya, Çanakkale, Samsun, Antalya, İzmir, Tokat, İstanbul, Bursa, Elazığ, Konya, Manisa, Eskişehir, Rize, Kütahya dhe Aydın. Shumica më e rëndësishme e shqiptarëve jeton në Stamboll, İzmir, Bursa dhe Sakarya.

Nga Ankaraja e Stambolli ekzistojnë lagje që sot njihen si “Arnavut mahallesi”, lagje të shqiptarëve.

Shqiptarët nën sundimin e Perandorisë Osmane kanë pasur përfitime të rëndësishme në aspektin e kulturës dhe jetës së shtetit. Reformat Osmane dhe revolucionet e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë është e pamundur të mendohen pa kontributin e shqiptarëve dhe boshnjakëve.

Shqiptarët që jetojnë në Turqi e ndjejnë vetën si Turqit. Islami shërben si një institucion shoqëror dhe bashkon dallimet etnike. Sipas kësaj, shqiptarët kanë ruajtur

jetën e tyre në një realitet shoqëror. Por me kalimin e kohës shqiptarët ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre sociale dhe kulturore kanë pasur shumë vështirësi.

Për të mbrojtur jetën social-kulturore dhe për ta transportuar këtë punë te brezat e ardhshëm, aty sot janë krijuar shoqata. Më e rëndësishmja nga këto shoqata është “ Shoqata e vllëzerisë turko-shqiptare“

Në Turqinë e sotme jo vetëm në shoqatat që kanë krijuar shqiptarët, por edhe në të gjitha shoqatat ballkanike, shqiptarët luajnë rol shumë të rëndësishëm.

Kur flasim për shqiptarët e Turqisë në përgjithësi shikojmë se marrëdhëniet familjare janë shumë të lidhura. Traditat vazhdojnë të jenë të njëjtat sikurse që i vrejme në Kosovë, p. sh, nuk mund të bëhet fjalë të sillen njerëzit pa respekt përpara të mëdhenjve. Babai dhe gjyshërit janë më të mëdhenjtë në familje të cilëve iu merret gjithmonë mendimi. Ne vendet ku janë të mëdhenjtë e familjes çdo njeri sillet me kujdes. Për shembull nuk mund të flitet me zë të lartë ose nuk mund të shtrihen njerëzit përpara stërgjyshërve.

Një tipar i shqiptarëve që dihet në të gjithë Turqinë është inati shqiptar. Sipas disa shqiptarëve inati është tipar i mirë ndërsa për disa është tipar i keq.

Ka një kulturë të rreptë të solidaritetit mes shqiptarëve. Ata gjithmonë ndihmojnë në vështirësi njëri- tjetrin. Në kuptimin e ngushtë nacionalizmi lokal është ruajtur në pikat më të larta.

Sot, ka shkallë të ndryshme të kulturës dhe ruajtjes së gjuhës shqipe në Turqi. Ajo dhe zakonet e saj vazhdojnë të ruhen edhe në fshatra të tilla si Baфра në Samsun dhe Kapiagzi në qytetin Tokat, por edhe në shumë emigrantë të brezit të dytë dhe të tretë që jetojnë në Stamboll, veçanërisht në rrethet Zeytinburnu dhe Gaziosmanpasa, të cilët janë përshtatur tashmë me jetën dhe me kulturën turke.

Shqipja tash flitet rrallë në mesin e të rriturve mes 25-35 vjeç, me përjashtim të atyre që jetojnë në Bayrampasa. Shqiptarët në jetën e përditshme flasin edhe turqisht edhe shqip. Ata preferojnë të flasin me njëri-tjetrin në gjuhën shqipe. Megjithatë, nëse njëri prej tyre nuk është shqiptar flasin turqisht.

Mbështetja e shqiptarëve në Turqi në formësimin e strukturës turke sociale do të mbajë një vend të rëndësishëm në formësimin e së ardhmes.

Kultura e kuzhinës shqiptare është shumë e pasur. Sidomos byreku shqiptar dhe mëlçia shqiptare janë shumë të famshëm. Shqiptarët sidomos byrekun e duan shumë. Paraardhësit e shqiptarëve për të siguruar ngrohje të trupit në ditët e dimrit hanin byrekë të nxehtë. Gratë shqiptare e kanë të zhvilluar pasion aq shumë për byrek pothuajse secila është bërë mjeshtër. Emri i byrekut shqiptar është i dëgjuar në të gjithë Turqinë. Ka pesë lloje byreku që kemi mësuar nga shqiptarët e Turqisë moderne. Ato janë; 1. Kaşık Böreği .2. Pergeç, 3. Manti/mantı, 4. Kırılone, 5. Laknur. Edhe të gjitha janë shume të lezetshëm.

Vlen të cekët se një hap shumë i rëndësishëm sipas nesh nga ana e administratës turke sot, përveç aspekteve politike është edhe hapja e para 6 viteve e Katedrës së albanologjisë ne universitetin e Trakias në Edirne, e cila padyshim së është një urë edhe më shumë për afrimin e dy kulturave dhe popujve.

Maja ALEKSANDROVA, Rusana BEJLERI

EMËRTIMET E ERËZAVE NË GJUHËT BALLKANIKE VËSHTRIM GJUHËSOR, BOTANIK DHE ETNOKULTUROR (RIGONI)

Projekti mbi emërtimet e erëzave në gjuhët ballkanike parashikohet si një libër me format enciklopedik. Çdo artikull përfshin një bimë me disa elemente studimore: emërtimet në gjuhët ballkanike, sllave dhe në gjuhë të tjera; etimologjia, përshkrimi botanik, përdorimi në kuzhinë dhe në mjekësi; përdorimet rituale dhe simbolika dhe ilustrime nga krijimtaria popullore dhe letërsia. Për gjuhën shqipe përdoren dy burime gjuhësore bazë: Fjalorthi etnobotanik i gjuhëtarit Sh. Sejdiu (1984) dhe Fjalori i emrave të bimëve i kolektivit të përbashkët të Institutit të Kërkimeve biologjike të ASHASH në Tiranë dhe i Seksionit të Shkencave të Natyrës në ASHAK, Prishtinë (2003). Në këtë kumtesë është zgjedhur si ilustrim *rigoni*. Shqipëria sipas statistikave të jashtme është ndër eksportuesit më të mëdhenj të kësaj bime aromatike dhe në këtë forum meriton të tërheqim simbolikisht vëmendjen te pasuritë e vyera natyrore kombëtare. Në prezantim ndërkaq aspektet jo filologjike të projektit do të piketohen skematikisht për llogari të disa vëzhgimeve përgjithësuese mbi këtë lëndë konkrete gjuhësore, që kanë dalë në pah gjatë punës.¹

1. Emërtimet

Emri latin: *Herba Origani*. Familja *Lamiaceae* – familja e mendrës.

Në gjuhën bullgare dhe shqipe *rigoni* ka shumë emërtime popullore, që dëshmojnë njohjen dhe përdorimin e gjerë. Kjo bimë ndërkaq është shembull i përshtatshëm i vështirësive që lidhen me precizimin gjuhësor në diferencimin e barërave, të cilat janë me përdorim të gjerë dhe njëkohësisht kanë afri biologjike.

1.1. Emërtimet në gjuhën bullgare dhe shqipe

Në gjuhën bullgare ndeshen këto variante: душица, черновръх, черновръшко, черновръшка, черновръхче, черновръхчи, горски чай, руски чай, овчарски босилек, вранилова трева, риганова трева, витошки чай, руски чай, ориган, риген, чубрица, кеклич, маеран.²

¹ M. Aleksandrova hulumton temën e erëzave, R. Bejleri kontribon mbi aspektet e shqipes.

² Materiale për Fjalorin Botanik Bullgar, 1939, f. 223-224.

Në gjuhën shqipe në Fjalorin e Sh.Sejdiut kemi: Rigon i egër, rigoni i zakonshëm, çaj mali, lulëçaji, çaj i egër, çajbjeshe, çajmali, rigon, rigon i rëndomtë³.

Në fjalorin e kolektivit akademik marrim këto të dhëna: *Origanum*=rigon; *Origanum majorana*=manxuranë, zaranë, nazaranë, nazardinë; *Origanum vulgare*=rigon, lule çaji, çaj mali, çaj i egër, çaj bjeshe, rigon i egër⁴

1.2. Emërtimet në gjuhët ballkanike:

Greqisht: ; μ

Greqishte e vjetër: ὄϊ, ὄϊ

Rumanisht: Oregano, Sovârf, Măgheran sălbatic, Arigan, Rigan

1.3. Emërtimet në gjuhët sllave:

Rusisht: Душица, материнка, ладанка, даданка, лебедушка, пчелолоб, духовой цвет, мацердушка, душица, душмянка, синявка, дрок, зановка, зеновка, кара гыных, звирак, звираж, тавшана, тавшава, орегано, лесная мята, блошничник, клоповная трава, костоломная трава

Vjelorusisht: Мацярдлушка

Ukrainisht: Материнка, Материнка звичайна

Polonisht: Dziki majeranek, Lepiodka pospolita, Oregano

Çekisht: Oregáno, Dobromysl

Slovakisht: Pamažorán obyčajný, Oregano

Serbisht: Оригано, Дивљи мажуран, Враниловка, Вранилова трава

Kroatisht: Mravinac, Oregano, Vranilova trava⁵

Slovenisht: Origano

1.4. Ilustrimi me emërtimet në gjuhë të tjera:

Anglisht: Wild marjoram, Oregan

Frëngjisht: Marjolaine bâtarde, Marjolaine sauvage, Origan, Pelevoué, Marazolette, Penevoué, Thé rouge, Thym de berger, Doste

Gjermanisht: Oregano, Wilder Majoran, Dost, Kostets

Hollandisht: Wilde Marjolein

Italisht: Erba acciuga, Oregano

Spanjollisht: Orégano

Portugalisht: Orégão, Orégano, Oregãos

³ Seidiu, Sh., *Fjalorth etnobotanik i shqipes.*, Prishtinë, 1984, p. 164.

⁴ Karsniqi, F., B.Ruci, J. Vangjeli, R.Susuri, A. Mullaj, Q. Pajazitaj. *Fjalor i emrave të bimëve*. Tiranë-Prishtinë, 2003

⁵ Materiale për Fjalorin Botanik Bullgar, 1939, f. 224.

Hungarisht: Oregánó, Szurokfű; vadmajoránna, Kaslók, Fekete gyopár
Turqisht: Kekik otu, İzmir kekiği, Güveyik otu, Kekikotu

2. Etimologjia

Rigoni e ka origjinën në Mesdhe, ku ndeshen disa variante të tij, por vetëm disa prej tyre përdoren si erëza. Në gjuhën bullgare emërtimi është huazim nga greqishtja e re “⁶ Sipas H. Friskut një prejardhje e huaj e *ó í* mbetet e paqartë, prandaj ai supozon etimologjinë popullore të brendshme prej dy gjymtyrëve *ō* dhe ⁷, që mbështetet në faktin se *rigoni* rritet në një lartësi të madhe mbi detin. Kjo vije etimologjike pranohet edhe nga studiuesit shqiptar: „Nga fjalët gr. *oros*=mal dhe *gonos*=zbukurim, d.m.th. bimë që zbukurojnë malet. Emrin origanon helenët e përdornin për disa buzore me erë të këndshme“⁸. Semantikë të ngjashme vërejmë edhe në disa gjuhë skandinave: norvegjisht *bergmynte* dhe islandisht *bergminta* “meandër mali”; finlandisht *mäkimeirami* “manxurana e kodrës” që shkon me gjuhën farsi *avishan kuhi* [آویشن کوهی] “manxurana e malit”. Baza biologjike në këtë rast është fakti se *rigoni* bashkë me *mendrën* dhe *manxuranën* hyjnë në një familje të ngushtë *Lamiaceae*. Ky shpjegim etimologjik ka disa dobësi që lidhen pikërisht me anën botanike, sepse nuk mund të konsiderohet i sigurt identiteti botanik midis bimës antike *origanon* [ò í] dhe *rigonit* modern. Emri antik mund t’i përkiste një lloji të manxuranës dhe gjatë shekujve ta kenë ngatërruar shumë herë me rignonin, aq më tepër se për *origanon* paraqiten edhe etimologji jo greke, p.sh. huazime nga gjuhët aziatike perëndimore ose afrikane veriore semite. Një konfuzion sjell edhe fakti se emri i *rozmarinës* në arabisht dhe persisht gjithashtu përmban elementin “mal”. Në shumë gjuhë *rigoni* shënohet si manxuranë e egër: anglisht *wild marjoram*, suedisht *vild mejram*, hungarisht *vadmajoránna*, polonisht *dziki majeranek*, dhe frëngjisht *marjolaine sauvage* ose *marjolaine bâtarde*. Nga pikëpamja botanike kjo nuk është korrekte, sepse kur është fjala për bimë të ndryshme, edhe pse nga një familje, nuk duhet që njëra të shënohet si variant i egër i tjetrës. Nga pikëpamja etnoligustike ngatërresat në emërtimet popullore janë interes-sante dhe domethënëse për përdorimin. Një shembull i tillë është emri *çaj mali* për *rignonin*, emër ky që i përket një bime aromatike të famshme *Sideritis syriaca*⁹ dhe në këtë rast paraqitet si homonim funksional, bazuar në vendin

⁶ BER, v. VI, Sofje, 2002, f. 248.

⁷ Frisk, H., *Griechisches etymologisches Wörterbuch*, Band II, Heidelberg, 1970, f. 417.

⁸ Karsniqi, F., B.Ruci, J. Vangjeli, R.Susuri, A. Mullaj, Q. Pajazitaj. *Fjalor i emrave të bimëve*. Tiranë-Prishtinë, 2003, f. 204.

⁹ Ibid, f. 269.

ku mblidhen dhe përdorimin e të dyja barrëve. E njëjta gjë vërehet edhe në gjuhën bullgare ku kemi emërtime popullore si *çaj mali*, *çaj Vitoshe*, *çaj rus*.

3. Aspekti botanik

Në këtë artikull nuk do të ndalemi hollësisht mbi përshkrimin botanik të rignonit, do të shënojmë vetëm se më i përdoruri është *Rigoni i zakonshëm* [*Origanum vulgare*], i cili ka një shijë më të butë, gjethe më të gjera dhe më të trasha. Lloje të tjera origjinale janë *Origanum onites* (Greqi, Turqi) dhe *Origanum heracleoticum* (Gadishulli Ballkanik, Itali, Azia Perëndimore).

Ka edhe disa lloje të kultivuara kryesoret ndër të cilat janë:

Origanum vulgare gracile (= *O. tyttanthum*) me origjin nga Kirgjistani

Origanum vulgare hirtum (Rigon Grek; Rigon Italian). Më i mirë nga llojet e kultivuara për përdorim kulinar, veçohet nga gjethet e forta ngjyrë jeshile të errët.

Origanum vulgare onites (Rigoni i Kretës; Rigoni Turk) me gjethe jeshile të çelët dhe jeshile në gri me aromë shumë intensive pikante.

Origanum vulgare syriacum (Rigoni i Sirisë; Rigoni i Libanit)

4. Përdorimi i rignonit

4.1. Vetitë e rignonit

Rigoni është shumë i përdorur për aromën e fletëve që mund të jetë më intensive kur gjethet janë të thara. Shija është e butë, e ngrohtë, ka lloje në të cilat ndihet shije e hidhur. Rigoni i mirë mund të ketë një shije kaq të fortë saqë të shkaktojë mpiksje të gjuhës. Llojet e kultivuara në zonat më të ftohta klimatike kanë aromë më të dobët. Faktorët si klima, stinët dhe përbërja e dheut ndikojnë më ndjeshëm mbi aromën e rignonit, sesa lloji konkret i bimës.

4.2. Përdorimi i rignonit në kuzhinë

Grekët e lashtë lëshonin bagëtinë të kulloste në fushat e rignonit me bindjen se mishi do të bëhej më i shijshëm.¹⁰ Në kohën moderne rigoni është *condicio sine qua non* në kuzhinën italiane, por është më i përhapur në pjesën jugore të vendit, ndërsa në pjesën veriore përdoret manxurana. Gjella që në mënyrë tradicionale lidhet me rignonin është pica. Sipas legjendës pica e sotme ka lindur në vitin 1889 ., kur mbreti Umberto me të shoqen Margarita ndalen shkurt gjatë udhëtimit në Napoli. Ushqimi tipik i të varfërve ka qenë salca e lyer mbi brymë buke të pjekur, por për nder të çiftit mbretëror dhe flamurit italian bukëtari do të sajonte një variant të ri, duke i shtuar salcës së kuqe djathtë të bardhë *Mozzarella* dhe gjethe jeshile të

¹⁰ Internet, <http://www.angelfire.com/journal2/flowers/o.html>

borzilokut. Pikërisht kjo gjellë mori emrin pica “Margarita” dhe u përhap në Itali dhe më gjerë. Në picat e sotme statistikisht tregojnë se rigoni mbizotëron mbi borzilokun, kurse pica nuk është më ushqim për të varfrit, por delikatesë. Rigoni preferohet në kuzhinën turke për aromatizimin e mishit të lopës dhe të qengjit. Në restorantet tradicionale turke në tavolinë bashkë me kripën, piperin e zi dhe piperin e kuq ofrohet edhe rigoni. Rigoni është ndër erëzat më të rëndësishme edhe në Greqi. Më të përdorura janë gjethet e tij të thata që i shtohen sallatës greke të famshme (lexohet *choriatiki salata*); përzihen edhe me lëngun e vajit të ullirit dhe limonit, i cili është shtesë e zakonshme për peshkun dhe mishin në skarë. Gjethet e rigonit shtohen edhe në duhan.¹¹ Është interesant rasti i Hungarisë, ku erëza në fjalë u bë popullore në dhjetëvjeçarët e fundit, kur filloi të shitej me emrin e njohur ndërkombëtar “Oregano” në mbishkrimin e paketave, deri atëherë shitej me emrin popullor hungarez *szurokf* (lexohet *sur-ok-foo*), që fjalë për fjalë do të thotë “bar katrani”. Ky shembull ilustron një rast të rrallë të erëzat kur aspekti gjuhësor mund të dominojë mbi aspektin funksional në përdorim. Jashtë Mesdheut rigoni përdoret shumë më pak sesa mund të pritej veç në bashkësitë emigrante italiane.

4.3. Përdorimi i rigonit në mjekësi

Historiku i shkruar i përdorimit të rigonit daton nga grekët e lashtë, të cilët e përdornin në praktikën mjekësore. Hipokrati e përdorte si mjet antiseptik dhe si kurë për shqetësimet e tretjes dhe acarimet në organet e frymëmarrjes. Me vajin eterik të rigonit helenët e vjetër trajtonin plagët, kafshimet e gjarpërinjve dhe merimangave, si edhe dhimbjet muskulore.¹² Përdorej edhe si antidot për helmin *kukutë*, lat. *Conium maculatum*, me të cilin është vetëvrare Sokrati. Shkencëtarët supozojnë se pikërisht për rigonin flitet në tekstin “Pseudopiutarchi de fluviorum et montium nominibus”, ku thuhet se thrakasit e lashtë e përdornin si mjet qetësues dhe drogues dhe pas darke hidhnin në zjarr një grusht majash rigoni dhe thithja e aromës i vinte shpejt në gjumë.¹³ Shkolla eklektike mjekësore që promovonte barnat mjekësore më vonë përfshin edhe stimulimin e menstruacionit të fenomenet që trajtohen me vaj rigoni, sepse intensifikon qarkullimin e gjakut në pjesën e poshtme të belit, dhe pikërisht për këtë arsye nuk rekomandohet gjatë shtatzënisë.¹⁴

Në Egjipt rigoni përdorej shpesh për dezinfektim.¹⁵ Deri më sot vaji i rigonit është substanca aktive e ilaçeve kundër morrave dhe insekteve të tjera si mole dhe milingona. Ka të dhëna se romakët kombinonin rigonin, manxuranën, rozmarinën

¹¹ Stojanov, N., Kitanov, B. *Divi polezni rastenia v Bulgaria*, Sofia, 1960, f. 334-335.

¹² Internet, <http://www.angelfire.com/journal2/flowers/o.html>

¹³ Materiale për Fjalorin Botanik Bullgar, 1939, f. 224.

¹⁴ Gerard, John. 1975. *The herbal or general history of plants: the complete 1633 edition as revised and enlarged by Thomas Johnson*. New York: Dover. (HSA Library)

¹⁵ Bremness, Lesley (1988), *The complete book of herbs*. London: DK. (HSA Library)

dhe livandën dhe i vendosnin në qese të vogla linoje në banjë.¹⁶ Sot është përhapur në kozmetikë si mjet kundër celulitit dhe mjet për pastrimin e lëkurës dhe kundër inflamacioneve të saj. Në mjekësinë popullore bullgare rigoni përdoret kryesisht në formën e çajit.¹⁷ Shumë studime bashkëkohore pohojnë “aftësitë e vajrave eterike të erëzave natyrore për të asgjësuar trupat infektive, që njihen prej Antikitetit”¹⁸

5. Përdorimi ritual dhe simbolika e rigonit

Rigoni është një prej barnave magjike, sepse ekziston besimi se e kanë krijuar perënditë në malin Olimp dhe më konkretisht hyjnesha e dashurisë Afërdita, e cila i ka dhuruar aromën e ëmbël. Me këtë bimë lidhen edhe hyjnesha greke Artemida dhe hyjnesha romake Diana, që të dyja kanë shëmbëlltyra me kurore prej *Rigonit të Kretës*¹⁹ Sipas folklorit magjik pikërisht *Rigoni i Kretës* lat. *Origanum vulgare onites* kur digjet "thërret shpirtrat" ose projektimet e tyre astrale.²⁰ Mbase ky besim është në thelb të përfshirjes së rigonit në bimët aromatike që përdoren gjatë festës pagane kelte *Samhain*, mbi të cilën bazohet edhe festa e njohur deri në ditët tona Halloween.²¹ Grekët e lashtë mbillnin rigon mbi varret e të afërmeve, për të garantuar lumturinë e tyre në jetën e përtejme.²² Popujt gjermanë e konsiderojnë rigonin, sikurse koprën dhe të tjera si mjet kryesor për t'u ruajtur nga shtrigat keqbërëse. Mendojnë se ndihmon kundër syrit të keq ndaj qumështit dhe prandaj varet në ahuret e bagëtisë dhe në shtëpi.²³ Më vonë në Mesjetë rigoni është përdorur si simbol i dashurisë së përjetshme, prandaj gjatë martesës të rinjve iu vinin kurore prej rigoni; e shtonin edhe në ushqim për të mbajtur gjallë dashurinë dhe e përhapnin rreth shtëpisë për të shtuar emocionet e këndshme.²⁴ Për shkak të efektit qetësues të kësaj bime, rekomandohet për kthjellimin e mendjes dhe besohet se parandalon veprimet

¹⁶ Belsinger, Susan and Carolyn, Dille (1984), *Cooking with herbs*. New York: Van Nostrand Reinhold. (HSA Library)

¹⁷ Doçev, S. (2008), *Orglezhdane i izpolzovane na podpravki*. Sofia, f. 247.

¹⁸ Internet, <http://www.optimalhealthsystems.com/index.asp>

¹⁹ Picton, Margaret, (2000). *The book of magical herbs: herbal history, mystery, & folklore*. London: Barron's

²⁰ Cunningham, Scott (2000), *Cunningham's encyclopedia of magical herbs*. St. Paul, MN: Llewellyn Publications. (HSA Library)

²¹ Hopman, Ellen Evert (1995), *A druid's herbal for the sacred earth year*. Rochester, VT: Destiny Books. (HSA Library)

²² Northcote, Lady Rosalind, (1997), *The book of herb lore*. New York: Dover. (HSA Library)

²³ Handwörterbuch des deutschen Aberglaubens, Band II, Berlin und Leipzig, 1929-1930, f. 361-362.

²⁴ Internet, <http://www.doityourself.com/stry/marjoram>

negative impulsive të njeriut.²⁵ Mund të jetë kjo arsyeja që rigoni dhe manxurana sipas besimeve tërheqin pasurinë dhe simbolizojnë pasurinë në interpretimin e së ardhmes.²⁶ Në traditën hebraike sefarade rigoni është ndër bimët mbi të cilat lexohet shkaku real i një sëmundjeje.²⁷

6. Erëzat në krijimtarinë popullore shqiptare

Në Fjalorin Elektronik Shpjegues (FESH), i cili bazohet në botimin FGJSSH 1980 gjejmë tri njësi frazeologjike, në përbërjen e të cilave ndeshet rigoni:

E vë në hije të rigonit dikë kujdesem shumë për dikë, tregoj kujdes të madh për një njeri që nuk e meriton.

Hipi miza në rigon iu rrit mendja, u bë mendjemadhe

Rigoni s'bëhet lis fj. u. Njeriu i thjeshtë nuk ka mundësi të kapërcejë veten

Në të trija rastet baza semantike e përdorimit të leksemës që na intereson nuk janë vetitë specifike të bimës aromatike, por mungesa së lartësisë. Është vështirë të merret me mend pse është zgjedhur pikërisht kjo bimë. Një shpjegim i mundur është se rigoni është një bimë e njohur dhe e përdorur gjerësisht në popull. Ky shpjegim nisat nga fakti se emrat e erëzave ndeshen në mënyrë tepër sporadike në krijimtarinë frazeologjike si p.sh. *E bëri borzilok* “e pastroi mirë, e bëri dritë (dhomën, shtëpinë)” dhe thënia më e famshme *Në çdo gjellë majdanos* iron. “thuhet kur dikush, me vend e pa vend, merr pjesë në të gjitha punët a çështjet ose kur diçka përdoret për shumë punë edhe kur s’është nevoja.”

Përmbledhjet kryesore të krijimtarisë së kulturës popullore shqiptare nuk dëshmojnë ndonjë prirje ndaj erëzave. Edhe pse sjell njëfarë zhgënjimi për hulumtuesin, ky fenomen ka logjikën e vet dhe duhet pranuar si rezultat.

Bibliografia

1. Belsinger, Susan and Carolyn, Dille. (1984). *Cooking with herbs*. New York: Van Nostrand Reinhold.
2. BER, v. VI, (2002), Sofje.
3. Bremness, Lesley, (1988), *The complete book of herbs*. London: DK. (HSA Library)

²⁵ Internet, <http://styx.bg/index.php?page=aroma§ion=etericoils&aid=44>

²⁶ Campbell, Mary Mason, et al., ed. (1983), *A basket of herbs: a book of American sentiments*. Brattleboro, VT: Stephen Greene Press. (HSA Library)

²⁷ Levy, Isaac Jack and Rosemary Levy Zumwalt, (2002), *Ritual medical lore of Sephardic women: sweetening the spirits, healing the sick*. Urbana: University of Illinois Press

4. Campbell, Mary Mason, et al., ed. (1983), *A basket of herbs: a book of American sentiments*. Brattleboro, VT: Stephen Greene Press. (HSA Library)
 5. Cunningham, Scott (2000), *Cunningham's encyclopedia of magical herbs*. St. Paul, MN: Llewellyn
 6. Doçev, S. (2008), *Orglezhdane i izpolzvane na podpravki*. Sofia.
 7. Frisk, H. (1970), *Griechisches etymologisches Wörterbuch, Band II*, Heidelberg.
 8. Gerard, John (1975), *The herbal or general history of plants: the complete 1633 edition as revised and enlarged by Thomas Johnson*. New York: Dover. (HSA Library)
 9. Handwörterbuch des deutschen Aberglaubens, Band II, Berlin und Leipzig, 1929-1930.
 10. Hopman, Ellen Evert (1995), *A druid's herbal for the sacred earth year*. Rochester, VT: Destiny Books.(HSA Library)
 11. Karsniqi, F., B.Ruci, J. Vangjeli, R.Susuri, A. Mullaj, Q. Pajazitaj. (2003), *Fjalor i emrave të bimëve*. Tiranë-Prishtinë.
 12. Levy, Isaac Jack and Rosemary Levy Zumwalt (2002), *Ritual medical lore of Sephardic women: sweetening the spirits, healing the sick*. Urbana: University of Illinois Press
 13. Materiale për Fjalorin Botanik Bullgar, (1939).
 14. Northcote, Lady Rosalind, (1971), *The book of herb lore*. New York: Dover. (HSA Library)
 15. Picton, Margaret (2000), *The book of magical herbs: herbal history, mystery, & folklore*. London: Barron's Publications. (HSA Library)
 17. Seidiu, Sh. (1984), *Fjalorth etnobotanik i shqipes.*, Prishtinë.
 18. Stojanov, N- Kitanov, B. (1960), *Divi polezni rastenia v Bulgaria*, Sofia.
-
1. Internet,
<http://styx.bg/index.php?page=aroma§ion=etericoils&aid=44>
 2. Internet, <http://www.angelfire.com/journal2/flowers/o.html>
 3. Internet, <http://www.angelfire.com/journal2/flowers/o.html>
 4. Internet, <http://www.doityourself.com/stry/marjoram>
 5. Internet, <http://www.optimalhealthsystems.com/index.asp>

Martin SUROV ÁK

FRAZEOLÓGJIZMAT E GJUHËS SHQIPE QË LIDHEN ME TË FOLURIT

Në referimin tim do të shqyrtoj çështjen e frazemave të gjuhës shqipe që lidhen me të folurit. Njeriu përdor gjuhën në çfarëdo lloj rrethanash, prandaj grupi i këtyre frazemave është relativisht i madh. Për të gjetur strukturën e brendshme të këtij grupi duhet përkthyer tipologjia e situatave, në të cilat përdoren, prandaj së pari do të ndalemi te parimet pragmatike.

Është interesante mënyra se si zbatohen parimet pragmatike të komunikimit në frazema. Ato zakonisht nuk pasqyrojnë të gjitha situatat e mundshme, por vetëm ato që shmangen nga ideali i një komunikimi të suksesshëm, p. sh. në gjuhën shqipe nuk ekziston asnjë frazemë me kuptim thjesht “ai po flet”, ndërsa ka një numër të konsiderueshëm frazemash me kuptim “ai hesht.” Nga kjo rrjedh edhe fakti se frazemat të cilat tregojnë mënyrën e të folurit plotësojnë funksionin rregullues.

Në radhë të parë duhet përmbytur kushti që vetë situata lejon komunikim. Procesi i komunikimit i cakton folësit rolin e dhënësit, i cili kodon përmbajtjen e ndërgjegjes së vet me anë të valave zanore, kurse dëgjuesit i caktohet roli i marrësit që dekodon përmbajtjen e ligjëratës. Siç u vu në dukje, frazemat nuk reflektojnë thënie të tipit “ai po flet” pa nuanca të holla që pasurojnë kuptimin themelor, mirëpo ato mund të shprehin që u kapërcye pengesa, e cila më herët e pamundësonte komunikimin dhe për momentin komunikimi është i mundshëm, siç është rasti i frazemave:

Ka hapur/çelur/vënë/shthurur gojë.

Më së shumti hasen frazemat që tregojnë të kundërtën:

S'i bën goja. S'i vete goja. Mbeti pa gojë. E mban gojën mbyllur. Rri me gojë të mbyllur. S'e hapi gojën fare. Iu muar goja. Nuk tha asnjë gjysmë fjale. I ngeci/ngriu fjala në grykë. S'bëri as gëk as mëk. Iu lidh gjuha komb.

Në gjuhën shqipe ekzistojnë edhe disa frazema që lidhen me kontekste më të veçanta, p.sh. frazema *I zuri goja barë* tregon që komunikimi është objektivisht i pamundur për shkak të mospranisë së dëgjuesit. Përkundrazi, frazema *Shet e nuk*

blen përdoret në situata ku komunikimi është objektivisht i mundshëm, mirëpo dështon mekanizmi i bashkëveprimit të folësit dhe të dëgjuesit. Një kuptim të ngjashëm gjejmë edhe te frazemat *Ia rrëmbeu/preu fjalën, Ia zuri fjalën në gojë/frymën* të cilat tregojnë që njëri pjesëmarrës i aktit të komunikimit pengon të tjerët në reagim. Situata e kundërt, d.m.th. njëri pjesëmarrës i imponon tjetrit me zor të komunikojë, pasqyrohet në frazemat *Ta nxjerr gjuhën nga qafa* ose *Ia nxjerr me darë fjalët*. Frazema *E kam në majë të gjuhës* tregon që folësi për momentin nuk është në gjendje ta kodojë përmbajtjen e ndjenjës së vet, kurse frazemat *I flas derës të dëgjojë qilari* dhe *I bie pragut të dëgjojë dera* tregojnë që ligjërata nuk i është caktuar atij që po e percepton.

Duke qenë se gjuha shërben si mjet komunikimi, shkëmbimi i informacioneve mes folësit dhe dëgjuesit duhet patjetër të zhvillohet mbi baza bashkëveprimi. Sipas gjuhëtarit dhe filozofit anglez Pol Grajs folësi duhet t'u përmbahet katër përku-fizimeve, të cilat vetë i kishte quajtur "maksima": **maksima e sasisë, maksima e cilësisë, maksima e përkitshmërisë dhe maksima e mënyrës.**

Lidhur me maksimën e sasisë Grajsi thotë se folësi duhet të japë vetëm aq informacione sa duhet ose, thënë më ndryshe, të arrijë maksimumin e qëllimit me përpjekje më të pakta fonetike. Në rast se sasia e informacioneve kalon masën e pritur nga dëgjuesi përdoren frazemat e tipit:

Çel e s'e mbyll gojën. Nuk i rri gjuha/goja rehat. S'i mbyllet/pushon goja. I mbeti goja çark. Harxhon frymën. Bluan në të thatë. Ka ngrënë plëndës pule. Është pllakë gramafoni. Flet si çakalle mulliri. I bie teneqes. Teneqe e shpuar.

Për më tepër, sipas parimit të ekonomisë të të folurit nuk duhen përsëritur të njëjtat fakte në ligjëratë:

I nguli/mbeti goja. E ka në gojë. Avazi i Mukës/i vjetër. I bie një avazi. S'di tjetër avaz/ tjetër këngë. I shkoi buza prapa. I ra goja.

Maksima e përkitshmërisë nënkupton që çdo thënie krijon te dëgjuesi pritjen për diçka me dobi a interes për të, prandaj folësi nuk mund të largohet shumë nga tema thelbësore e bisedës, përndryshe ligjërata konsiderohet nga dëgjuesi e pavlerë:

Flet ç't'i vijë për gojë. E ka qafën të shkurtër. E ka gjuhën/llapën të gjatë. I lëshon fjalët si lopa bajgën. Flet pa kandar. Flet si ëma e Zeqos majë thanës. E zgjati gjuhën si lëpjetë. Të hedh kodër me kodër. Unë për lisa e ti për fshesa.

Maksima e cilësisë kërkon që folësi t'u përmbahet fakteve reale, përndryshe në anën e dëgjuesit krijohet njëfarë mosbesimi, i cili tregohet me frazema të tipit:

*E bën ferrën pëlle. E bën buall. Ta bën babën burrë. I vë pleshtit zile.
Përrallë mizash/me mbret.*

Maksima e mënyrës kërkon që folësi të shprehet duke ndjekur një rregullsi edhe duke shmangur paqartësi. Kësaj gjendjeje i përgjigjet kuptimi i frazemës:

I quan gjërat me emrin e vet.

Situatat e shkeljes së maksimës të mënyrës tregohen nga frazemat:

Ia bie/hedh/sjell fjala rrotull. Flet me gjuhën e Ezopit.

Meqë parimet pragmatike nuk janë të mjaftueshme për të përshkruar plotësisht strukturën e këtij grupi frazemash, është i nevojshëm edhe hulumtimi në planet e tjera të gjuhës. Shikuar nga pikëpamja psikolinguistike një vëmendje të posaçme meriton parimi i **vetëkontrollit të folësit**. Në situata të zakonshme folësi gjykon nëse përmbajtja e ligjëratës i përshtatet situatës. Kësaj gjendjeje i përkasin frazemat:

Them me mend. S'i bie fjala në tokë. S'e lë fjalën të bjerë në tokë. I përtyp fjalët. E ka holluar gjuhën.

Madje, vetëkontrolli i folësit mund të jetë aq i fortë saqë pamundëson komunikim më tutje:

S'e bën për fjalë. S'ia nxë goja. S'rrëfeket me gojë. Mban gjuhën pas dhëmbëve. I vuri kyçin gojës. E rrudhi gojën. E mbërtheu gojën. E ka gojën të mbërthyer. I vuri fre gojës. I ha gjuha.

Ndërkohë, sidomos në situata të afektuara mallëngjimi ose të frikës ndodh që folësi ta humbë përkohësisht aftësinë e vetëkontrollit, çka mund të shoqërohet më vonë edhe me ndjenjë keqardhjeje. Në këtë kategori mund të futen frazemat:

E ka lëshuar gojën/llapën. I shpëtoi/rrëshqiti/shkau goja. I bredhërin gjuha para mendjes. S'i mban goja arra. Foli larë e palarë. E thotë me plot gojën. S'i hahet goja. I ka dhënë liri gjuhës. Foli pa lesh në bark. I foli me zemër të hapur/në dorë..

Një faktor tjetër që varet nga gjendja aktuale shpirtërore është **ndikimi i përmbajtjes së ligjëratës të dëgjuesi**. Frazemat që tregojnë situatën kur folësi merr qëndrim pozitiv ndaj përmbajtjes së ligjëratës janë:

I zë vend fjala. Është i gjuhës/i gojës. E ka gojën të ëmbël/ajkë/bilbil. Të lumtë goja! (urim)

Në situata të kundërta dëgjuesi reagon në mënyrë mohuese ose kur folësi ka për qëllim ta ndyjë dëgjuesin. Në këtë kategori futen frazemat:

E ka gojën të thartë/hudhër/brisk/shpat. Është i zoti i gjuhës. I hedh kripë bisedës. I trashi fjalët. E trashi muhabetin. E prishi /ndyu gojën. E merr nëpër gojë. Gojë e liga. Gojë e këqija. T'u thaftë goja! (mallkim)

Në rastet kur ligjërata nuk plotëson funksionin apelativ të gjuhës, d.m.th. folësi nuk arrin dot ta shtyjë bashkëfolësin që të veprojë në mënyrë të kërkuar, hasen frazemat e tipit:

Flet në tym/në erë/ në arë e në vreshtë/va e pa va/flet mbarë e prapë. I bie cyles. Bie daullja në vesh të shurdhërit. Fol me murin. Grin sallatë.

Parimeve pragmatike dhe psikolinguistike u shtohen edhe parimet fonetike, sidomos **intensiteti i zërit**. Frazemat e tipit *E ngre zërin në qiell. Bërtet sa i hanin mushkëritë/sa i ha gurmazi* përdoren në qoftë se intensiteti i zërit kalon një nivel të zakonshëm. Në anën tjetër ekzistojnë edhe frazemat që tregojnë intensitetin e ulët të zërit: *Flet me gjysmë zëri. Flet si miza në qyp*. Përveç intensitetit të zërit frazemat pasqyrojnë edhe **qartësinë e artikulimit** (*I përtyp fjalët.*) ose **tempo e të folurit** (*I tjerr fjalët.*).

Mund të nxirret si përfundim se gjuha shqipe ka një inventar të pasur frazemash lidhur me të folurit, të cilat përdoren në çfarëdolloj situatash, shikuar nga pikëpamja pragmatike, psikolinguistike si dhe fonetike.

Atdhe HYKOLLI

KARAKTERI RITUAL I KËNGËVE TË MOTMOTIT

Është bërë zakon që të gjitha krijimet që shoqërojnë ritet periodike të quhen këngë të motmotit. Në zanafillën e tyre këto këngë lipset të kenë pasur një lloj erotizmi që lidhej ngushtë me plleshmërinë e tokës, mbarështimin e gjësë së gjallë, të shpezëve dhe veselitjen e pemëve. Njeriu primitiv besonte se duke i kënduar ato do të mund të ushtronte një ndikim magjik në rritjen e frytshmërisë së botës së gjallë.

Me ndryshimin e raporteve ekonomiko-shoqërore, kjo përmasë erotike që zumë ngoje më lart nis të zbehet. Nga ana tjetër ka të ngjarë që të njëjtit proces, d.m.th. atij të zbehjes, t'i jetë nënshtuar edhe besimi tek ato. Ndryshe nuk ka se si shpjegohet ajo ngjyresë humori me të cilën na shfaqen këto këngë në gjendjen e sotme. Pa dyshim, këtu ka ndikuar edhe fakti që ato, krejt ndryshe nga ç'ndodhte më parë, sot i dëgjon thujtë vetëm nga goja e fëmijëve. Kaq e vërtetë është kjo, sa që dikush e ka parë me vend t'i klasifikojë edhe si këngë fëmijësh.¹

E vërteta është se ndër në këngët e motmotit kanë nisur të shënohen relativisht vonë. Të tilla këngë regjistroi Thimi Mitkoja në *Bëletën shqiptare*, Spiro Dine në *Valët e detit*, Vinçenc Prenushinë *Kangë popullore gegnishte*, në *Hyllin e dritës*, në *Visaret e kombit*, por edhe Stavro Frashëri te *Folklori shqiptar* etj. Studimit të tyre, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, i kanë kushtuar vëmendje të posaçme emrat më të mëdhenj të folkloristikës shqiptare në të dyja anët e kufirit politik, si Qemal Haxhihasani, Shefqet Pllana, Jorgo Panajoti, Mark Tirta, Dhimitër Shuteriqi, Anton Nikë Berisha, Demush Shala, Ali Ahmeti, Sadri Fetiu etj., ndihmesave të të cilëve u duhen shtuar pa më të voglën mëdyshje edhe prurjet fort interesante të një muzikologu si Ramadan Sokoli. Prandaj nuk mund të pohojmë se këngët e motmotit i janë përvjedhur vëmendjes së studiuesve tanë. Format dhe nivelet e zhvillimit të jetës shoqërore të të gjitha shtresave të shoqërisë, janë përcjellë në mënyrë të përhershme nga lloje të ndryshme të krijimtarisë gojore të popullit tonë, duke u bërë kështu shprehësja më e mirë dhe më e saktë e preokupimeve jetësore të tij. Llojet e shumta të krijimtarisë gojore, njeriu i krijoi dhe i ruajti gjatë zhvillimit të tij që nga

¹ Shih Sadri Fetiu, *Folkloristikë*, IAP, Prishtinë, 2009.

fazat më të hershme të ekzistimit.²Së këndejmi del se krijimtaria gojore lindi dhe u zhvillua si nevojë e njeriut për të shprehur botën e brendshme, ndjenjat dhe meditimet që lidhen me jetën, me punën e tij, pa u shkëputur asnjëherë nga ndikimi i dukurive natyrore dhe i rrjedhave të jetës shoqërore. Jo rastësisht, në këngët kalendarike janë shtresuar gjithë përvojat e jetës shoqërore dhe jetës shpirtërore të njeriut tonë, varësisht prej ndikimit të atyre dukurive, qoftë ato të natyrës, qoftë të rrethanave shoqërore. Prandaj, aty gjejmë të pashkëputura sisteme të gjykimit dhe të mendimit që kanë të bëjnë me raportet e marrëdhënieve të njeriut me natyrën dhe të marrëdhënieve të njeriut me jetën e tij brenda shoqërisë. E veçanta e këtyre krijimeve është se kanë ruajtur gjithë shtresimet e kohës së krijimit të tyre. Përmes këtyre krijimeve gojore u zhvilluan forma më të larta marrëdhëniesh të komunikimit artistik, që pasuroi më tej botën shpirtërore dhe ngriti nivelin e të menduarit të njeriut, duke ruajtur përherë karakteristikat e periudhave kohore, veçmas ato parake, të krijimit. Këtë karakteristikë e gjejmë edhe te popujt e tjerë, veçmas tek ato lloje të krijimtarisë gojore, që ruajnë shtresa të mitologjisë së popujve të lashtë, gjurmë të të cilave janë ruajtur edhe në proceset e ndryshimeve shoqërore³. Krijimet e këtilla gojore nuk u krijuan dhe nuk u zhvilluan vetëm në një periudhë, apo vetëm nga një brez i shoqërisë shqiptare. Ato erdhën të përcjella gojë më gojë duke kaluar nëpër shekujt e jetës shoqërore, përherë duke u zhvilluar dhe duke u transformuar, por edhe duke ruajtur gjurmët e këtij përpunimi nëpër kohë. Mirëpo, ndonjëherë, edhe duke u zbehur e duke u harruar. E vjetër sa vetë populli, krijimtaria gojore e popullit tonë në tërësinë e saj, andaj edhe këngët kalendarike, mbeten përherë të freskëta. Nuk është rastësi që krijimi fillestar, me kalimin e kohës, të takohet në variante të ndryshme. Fjala vjen, siç dëshmohet nga puna e ekspeditave të folkloristëve tanë, dihet se janë mbledhur deri mbi 2000 variante të këngëve të epikës heroike. Prandaj, mund të thuhet se gjatë këtij procesi, edhe këngët kalendarike, kanë pësuar ndryshme të ndjeshme, nga të cilat janë krijuar variante të ndryshme. Doemos, të krijuar nga individë më të ngritur, ato si krijime individuale, me kohë marrin karakterin e një prodhimi kolektiv. Dhe, duke u bartur gojë me gojë nëpër vite e shekuj, është e natyrshme që mbi këtë krijimtari gojore të ndikojnë dhe të veprojnë edhe valët e

² Grup autorësh, *Këngë dhe lojëra fëmijësh*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, (tash e mbrapa IAP shënimimi im. A.H.), Prishtinë, 1983, f.23-24; Grup autorësh, *Letërsia gojore e Krahinës së Plavës dhe të Gucisë*, IAP, Prishtinë, 2004, f. 155-157; Tvrtko Çubeliq, vep. e cit., f. XIV-XV; Anton Nikë Berisha, *Mbi letërsinë gojore shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1987, f.14.

³ Tvrtko Çubeliq, vep. e cit., f. XVII-XVIII; Grup autorësh, *Këngë të ndryshme popullore*, IAP, Prishtinë, 1982, f.16; Qemal Haxhihasani, *Disa të dhëna rreth figuracionit artistik të lirikës popullore shqiptare*, *Studime filologjike*, 2, 1972, f. 17-21; Haki Baçi, *Folklori shqiptar (për shkollat e mesme)*, Shtëpia botuese "Libri shkollor", Prishtinë, 2001, f.3.

“detit të harresës”. Megjithatë karakteri shumëstresor i këngëve rituale kalendarike, për të cilin kanë bërë fjalë një aradhë dijetarësh, së paku që nga gjysma e dytë e shekullit XX e kënde, si një prej tipareve thelbësore të tyre, tregon njëherësh rrugën historike që ka përshkuar edhe ky monument i vyer i mjeshtërisë popullore shqiptare.

Njohësit më të përmendur të teorisë së oralitetit duke shpjeguar faktorët artistikë që kanë bërë të mundur përcjelljen gojë më gojë të këtyre krijimeve kanë vënë në dukje lidhjen traditë – improvizim – audiencë kritike, e cila, në të gjitha format e shprehjes së saj, mund të përcaktohet si një lidhje trekëndore; një nga lidhjet më të qëndrueshme dhe më pak të lëvizshme në krahasim me çdo lidhje tjetër rrethore, shumëkëndore, të cilat shprishen më lehtë. Kushtëzimi i gjallimit të këtyre këngëve nga një lidhje e tillë e pashmangshme trekëndore (variant – invariant – audiencë) ka bërë që epokat historike nëpër të cilat ka kaluar edhe ky lloj prodhimi të lënë gjurmë të pabujshme. Vetë prania e shtresave për të cilat flasim e dëshmon këtë. Sidoqoftë, nuk jemi të prirur të besojmë se invarianti e ka fituar luftën me variantet e improvizuara. Përpyekjet për të depërtuar brenda për brenda karakterit shumëstresor të këtyre krijimeve do të ishin të dështuara po të niseshim nga një kriter i vetëm. Kombinimi i disa kriterëve hap rrugën e një kërkimi me më shumë gjasa për sukses. Këto kritere duhet të mbajnë parasysh karakterin e përfytyrimit filozofik dhe estetik të botës; shkallët progresive të zhvillimit të mendimit njerëzor; rrjedhjen e natyrshme kronologjike të cikleve të zhvillimit të shoqërisë; tiparet kryesore të prozodive që ka njohur arti botëror prej antikitetit deri më sot; historinë politike dhe gjeografinë historike; si dhe dukuri të tjera që hyjnë në marrëdhënie ndryshimi midis tyre. Një procedim i këtillë nënkupton një krahasim të shumëfishtë letrar e joletrar, të brendshëm e të jashtëm, historik e kombëtar. Ai është i domosdoshëm edhe për rastin e kërkimit të një shtrese ndikimesh orientale në këngët rituale të motmotit, në të njëjtën masë që do të ishte i nevojshëm edhe për veçimin e shtresave të tjera. Kushtet e pafavorshme të afirmimit të këtyre këngëve që përballë ciklit shqiptar të kreshnikëve, apo prodhimeve të epikës historike, lehtësisht të politizueshme, ngjajnë si ‘punë çiliminjsh’, edhe pse nuk janë të tilla, e bëjnë të domosdoshme që kërkimet rreth shtresave historiko-letrare në to të fillojnë nga kundërvënia minimale e vet – e huaj. Kjo kundërvënie krijon lehtësi për identifikimin dhe përshkrimin e karakterit shqiptar të këngëve të këtilla. Këtu shkrihen interesa të ngushta të shkencës folklorike me çështje më të rëndësishme të etnografisë, gjuhësisë e historisë. Veçimi i shtresës vendase nga ajo e huajtur është nga problemet më të vështira. Së pari, sepse nuk ka një kufi të dukshëm ndërmjet tyre. Thuajse gjithë letërsia gojore është zhvilluar me një gjuhë artistike që është quajtur universale. Raporti antike vs moderne në prodhimet e letërsisë gojore shqiptare duket se ka tërhequr vëmendjen edhe për shkak të ndikimit të metodës së

kërkimeve, e cila jo rrallë ka qenë e ndikuar prej mitologjizmit, romantizmit dhe prirjes së etnocentrizmit, prirje që, siç pranohet gjerësisht në dijen e sotme, është krejt e natyrshme për vlerësimin e çdo kulture kombëtare. Çdo popull është i prirur të besojë dhe ta vlerësojë formën e vet të të modeluarit të mendimit dhe të emocionit si sipërane ndaj të tjerave. Në këtë kuptim, etnocentrizmi shihet si nxitje për afirmimin e kulturave, së paku deri sa nuk ka çuar në vetveçim. Po kaq i fortë e ngulmues ka qenë interesimi i studiuesve për të nxjerrë në pah vendin e historisë në krijimet tona folklorike, veçmas tek ato që i takojnë ciklit të kreshnikëve. Nismat shkencore për vlerësimin e raporteve histori – letërsi gojore kanë pasur për qëllim të paraqesin kushtëzimin relativ të këtij produkti me historinë e tij. Nëpërmjet këtij krahasimi është bërë e mundur të tërhiqet vëmendja mbi çështjet themelore të debateve dhe polemikës së dijetarëve mbi këtë fushë; të sqarohen në një plan të gjerë raportet midis artit popullor dhe zhvillimeve historike, varësitë dhe pavarësitë ndërmjet kujtesës kolektive dhe dokumentacionit arkivor mbi këto zhvillime; të theksohet roli i etnokulturës për sqarimin e burimit historik dhe hapësinor të shqiptarëve si popull, të vendformimit të tyre dhe të vazhdimësisë së pandërmjetme të botës së vlerave kombëtare në truallin shqiptar; të nxirret në pah specifika e evolucionit historik të kulturës kombëtare dhe të vlerësohet në frymë kritike metoda tradicionaliste.

Pa më të voglin mëtim për të hartuar një histori të kulturës popullore shqiptare, që mund të jetë një nevojë e afërt e shkencës albanologjike, nëpërmjet krahasimit të prodhimeve të letërsisë gojore me historinë janë bërë përpjekje të hidhet dritë mbi rrugën historike të zhvillimit të zhanreve të saj, mbi pasurimin dhe bjerret, mbi ruajtjen e arketipave të lashtë të saj, në kushtet e një performance që karakterizohet nga shumësia e varianteve. Që në filluesën e saj krijimtaria gojore lindi si shprehje në vargje, pra si poezi, por e përcjellë edhe me melodi. Në të shumtën e rasteve, ajo shoqërohej, madje shpesh, edhe me lëvizje, pra me elementet e para të valles. Në këtë mënyrë, mund të thuhet, ajo i nënshtrohet procesit të sinkretizmit, gjë që krijimtarinë gojore e bën vlerë të pashterueshme artistike dhe estetike. Këtyre proceseve dhe këtyre rrugëve të zhvillimit u është nënshtruar edhe pjesa e krijimtarisë gojore të këngëve kalendarike, si njëra prej krijimeve burimore, ku shpalohej me tërë larushinë e saj muza poetike e krijuesit popullor nëpër të gjitha periudhat kohore të jetës individuale dhe kolektive të njeriut tonë, për të arritur tek ajo që quhet gjallim i shpirtit të gjeniut popullor. Jeta e individit dhe jeta e kolektivit, edhe në këtë pjesë të krijimtarisë gojore, pra në këngët kalendarike, ka arritur, thuajse, nëpër të gjitha periudhat kohore, edhe të ruajë diçka nga individualja, edhe ta transformojë karakterin e saj të krijimit kolektiv. Realizimi estetik i këngës popullore varet jo vetëm nga fuqia imponuese e së kaluarës për mosndryshim; jo vetëm nga dhuntia vetjake e këngëtarit për improvizim, domethënë nga aftësia e tij për ta përdorur e administruar mirë lirinë dhe disiplinën krijuese që i

njuh mekanizmi specifik i komunikimit oral, por edhe nga situata emocionale që i krijohet rapsodit prej audiencës së tij, situatë e cila mund të drejtojë vëmendjen kryesore nga aspekte historike, informative, rikrijuese, zbatimëse apo didaktike.

Në komunikimin artistik popullor midis bartësit të rapsodisë dhe dëgjuesve të saj ekziston një pozitë autorësie e barabartë. Interpretuesi dhe dëgjuesi performojnë këngën e tjetrit. Autorësia është po aq impersonale për këngëtarin rapsod, sa ç'është edhe për njerëzit që e rrethojnë, e nxisin të vazhdojë, i thonë fjalë lavdëruese apo, përkundrazi, e përgëzojnë thatë. Informimi ka një funksion të veçantë preferencial kur rapsodi u këndon trimërive epike me kërkesën e audiencës. «Rapsodi jo vetëm përcjell epin, por në të njëjtën kohë ai del si ndërmjetës i informacionit artistik. Si ndërmjetës i së shkuarës me të sotmen, si bartës i traditës dhe shërbyes i saj, si artist i shuguruar në një urdhër të veçantë artistësh, të quajtur aedë, bardë, rapsodë. Këngëtar i eposit ka ftuar diçka nga koha e tij për t'i bërë vend brenda 'këngës së tjetrit'». ⁴ Karakteri i hapur i rapsodisë dhe forca krijuese e rapsodit kanë bërë të mundur që në epos të hyjnë shtresa kohësh dhe kulturash disanivelëshe. «Ashtu si në një përmendore të lashtë brezat mund të vënë lule apo të zhgarravisin ankimet e kohës, ashtu një rapsod a një brezni rapsodësh mund të ftojë të sotmen për vlerë apo për dhunë artistike». ⁵ Njeriu i sotëm përgjithësisht nuk beson në fuqinë hyjnore të heronjve legjendarë, por e merr rapsodinë si një realitet të hiperbolizuar, duke i dhënë vlerë konvencionale. Kur rapsodi e përfundon rapsodinë me klishe: «Kshtu m'kan' thanë/atje s'jam kanë», ai në fakt i shpjegon audiencës se e vërteta artistike dhe ajo historike nuk janë e njëjta gjë.

Veçanërisht kjo manifestohej gjatë përgatitjes së punëve në bujqësi, gjatë kujdesit për punët në blegtori, por edhe në përcjelljen e përtëritjes së jetës në natyrë gjatë ndërrimit të stinëve. Ngjashëm me këngët lirike të punës, edhe te këngët lirike rituale, shpaloset dashuria e njeriut për punën, për natyrën dhe të panjohurat e saj, për bagëtinë që ishte pjesë e jetës së njeriut, për pasjen dhe pjellshmërinë, që dëshmon për kërkesën e ripërtëritjes së ciklit të jetës. si në këta shembuj për ardhjen e muajit maj:

*Maji, maji rritna leshtë,
Si vllastareja në vneshtë.
Si bishti i kalitë,
Si drurët e malitë,
si kut i pazaritë⁶*

⁴ Shaban Sinani, *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, Star, Tiranë, 2000, f. 115.

⁵ Shaban Sinani, po aty, f. 115.

⁶ Astrit Bishqemi, *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë*, Sejko, Elbasan, 2001, f. 32.

ose

*Dallëndyshe bisht gërshërë
Na këtë gajtan të gjërë
Hidhe në det,
Bjemë dhjet' okë shëndet*

*Dallëndyshe faqe kuqe
Na këtë gjerdhan të kuqe,
Të më shpiesh anës detit
Të më sjellësh bukë shëndetit⁷*

Ritet e këtilla, si ky për ardhjen e pranverës, apo i pritjes dhe i përcjelljes së dallëndyshes, i kanë të gjithë popujt e Ballkanit. Në traditën tonë folklorike ruhen edhe sot thuajse në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët, në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, në Kosovën Lindore dhe në Çamëri, por ruhen edhe tek arbëreshët e Italisë e të Zarës..Edhe në ditët tona janë të gjalla veprimet magjike te fëmijët, por madje edhe besimi, sipas të cilit, kur e heqin veroren (që është një pe i kuq, a i bardhë, i verdhë, a i kaltër, të cilin e kanë vënë në dorë, në këmbë, a në qafë, ditën e parë të marsit, si nisje e pranverës, dëshmon për besimin se janë kaluar të këqijat që sjell stina e dimrit).

Besëtytni të këtilla kanë përcjellë jetën e të gjithë popujve të kësaj hapësire, ku janë ndeshur e kanë bashkëjetuar kultura të ndryshme, të popujve dhe gjuhëve të ndryshme, që nga koha e antikitetit e këndeje. Por, siç mund të shihet, shembulli që ka regjistruar në jug të Shqipërisë Stavro Frashëri, më 1936, është më bindës se gjithë përkufizimet e mundshme teorike. Në këngët e këtilla dhe në ritet e këtilla shihen qartë dëshirat e bujkut të ardhshëm. Dallëndyshja, që simbolizon ardhjen e pranverës, beson se i sjell bukë e shëndet, në radhë të parë. Në një këngë të shënuar në Përmet, shprehet dëshira e njerëzve që vera t'u sjellë bereqet, foshnje dhe nuse punëtore:

*Ikni, ikni o gjarpënj,
Se vjen Vangjelizmoj
Pa na vret, na shkurton
Dhe në gropë na mbulon!⁸*

⁷ Ernest Koliqi, *Vepra 6*, "Faik Konica", Prishtinë, 2003, f. 225.

⁸ Ramadan Sokoli, *Këngët rituale në të kremtet vjetore të popullit tonë*, Studime filologjike, 4, 1964, f. 167.

Këngë fëmijësh janë bërë, për këtë arsye pothuajse të gjitha këngët rituale si ato për shiun, këngët e kolendrave, këngët për Vitin e Ri, këngët e Llazoreve e të tjera të ngjashme. Në jetën e popullit tonë ka pasur shumë festa pagane, të përcjella me rite të ndryshme, të cilat në të shumtën e herës shoqëroheshin edhe me këngë. Mirëpo, me kalimin e kohës pjesa më e madhe e këtyre riteve përfunduan te lojërat e fëmijëve duke ruajtur elementin përcjellës të tyre, këngën. Ato edhe sot janë të përshtatshme dhe zgjojnë kureshtjen dhe fantazinë e botës së fëmijëve.

Që nga fazat e hershme të zhvillimit të jetës shoqërore janë krijuar këngë dhe rite, thuajse për të gjithë muajt e vitit. Edhe sot, kur lexohen me vëmendje, kur përcillen me këmbëngulje, qoftë në formën kur janë regjistruar si rite e si këngë, qoftë në formën e tashme, kur janë shndërruar kryesisht në lojëra fëmijësh, njeriu çuditet me saktësinë e tyre edhe në planin e përshkrimit të muajve të vitit, edhe në zbërthimin e përbërësve kryesorë të karakteristikave të veçanta të secilit muaj, por edhe për kuptimin e rëndësisë së tyre në jetën e përditshme të njeriut të asaj kohe⁹. Në vargjet e këtyre këngëve hetohet prania e madhe e punëve në bujqësi dhe në blegtori, që ishin dy prej mundësive më të mëdha të mbajtjes së jetës së njeriut. Në këto këngë ruhen kultet, ritet, doket dhe zakonet në të cilat që nga lashtësia u krijuan dhe u shtresuan besimet popullore pagane, gjurmët e të cilave i gjejmë deri në ditët tona:

*Shkurti shkurton urët',
Marsi ngre lëkurëtë.*

Festat që shënojnë ngjarje për muajt e ndryshëm të vitit duhet përmendur *Kolendrat* (nga latinishtja *calendae* – dita e parë e muajit), të cilat fillimisht kremtoheshin me 24 dhjetor. Në këtë ditë, pra ditën e kolendrave, fjala vjen, fëmijët dalin në grupe, djem dhe vajza duke shkuar shtëpi me shtëpi dhe para familjarëve këndonin këngë, si kjo që kishte mbledhur Spiro Dine, e cila, varësisht prej krahinës ku është mbledhur, ruhet në variante të ndryshme:

*Kollendra, mellendra,
ciu, ciu, vak, vak,
nem moj babo një kulaç,
se të bije me çakmak,
po ta bëj kokën me gjak!*¹⁰

⁹ Shih edhe Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2004.

¹⁰ Shih Demush Shala, *Letërsia popullore shqiptare*, ETMM i Kosovës, Prishtinë, 1974.

Kurse në muajin mars, më 25 të atij muaji, kremtohej *Vangjelizmoi*. Në jetën e myslimanëve njihet si Nata e Nevruzit (nga persishtja, që do të thotë pranverë). Në këtë ditë, fëmijët duke bërë zhurmë me enë të zbrazëta, apo edhe me kambana bagëtish, dalin fushave për të trembur gjarpinjtë. Këto rite përcillen me këngë:

*Ikni gjarpinj, ikni shtërpinj,
Ikni shtëza dhe ju minj,
Se vjen marsi ju përpinj*¹¹

Këngë të ndryshme ka edhe për *Llazoret*. Kjo festë lidhet me Shën Llazarin, e religjionit të krishterë, të cilin Krishti e ngjalli pas vdekjes. Me këtë rast fëmijët shkojnë nga dera në derë duke kërkuar nga zonja e shtëpisë vezë të ngjyrosura. Ata këndojnë dhe luajnë për *Rusicat*, duke shpaluar rite, doke e zakone të kësaj kremteje, që mendohet se është shumë e lashtë. Në kulturën tonë shpirtërore këto vlera, të ruajtura brez pas brezi, paraqesin nivele të caktuara të qytetërimit tonë, përkundër faktit se ka pasur periudha kohore kur janë injoruar dhe janë vlerësuar me cinizëm këto relikte të lashtësisë. Ka pasur periudha kohore në jetën e popullit tonë, kur çdo gjë, qoftë edhe vlerat e këtyre riteve, të këngëve kalendarike, bëhej përpjekje ose të harroheshin, ose të transformoheshin duke u dhënë ngjyrimë nga më të ndryshmet të përkatësive ideologjike të sistemeve. Mirëpo, si përherë gjatë historisë, ato qoftë me vlerën e tyre, qoftë me pasurinë e madhe që i japin jetës së përditshme të njeriut dhe të fëmijëve, përballuan edhe këto mistifikime ideologjike.

Intelektualë të të gjitha kohërave në jetën e popullit tonë, të pajisur me kulturë të mirëfilltë dhe me informacion shkencor të kohës, kanë pasur përherë respekt për vlerën dhe peshën e tyre si rite dhe zakone me vlerë, jo vetëm për jetën e të parëve, por për kulturën në përgjithësi, andaj i kanë vlerësuar dhe i kanë njohur si njërin prej vlerave themelore të kulturës sonë. Ngjashëm me si vëllezërit e tyre evropianë e ballkanikë kanë vepruar edhe intelektualët tanë, sidomos ata të Rilindjes sonë kombëtare. Kështu kanë vepruar rilindësit tanë të mëdhenj Naimi e Samiu, Çajupi e Mjeda, më vonë Gurakuqi e Konica, si dhe të tjerë, të cilët mbledhin, botojnë dhe studiojnë këto vlera të traditës¹².

¹¹ Shefqet Pllana, *Kangët e motmotit ndër shqiptarë*, Gjurmime albanologjike, 2, 1965, f. 272.

¹² Maja Boshkoviç-Stulli, *Narodna predaja o vladarevoj tajni*, Zagreb, 1967, f. 141-161; Po ajo, *O pojmovima usmena i pučka knjizhevnost i njihovim nazivima*, *Umjetnost riječi*, nr. 3. Zagreb, 1973, f. 149-157; Tvrtko Çubeliq, vep. e cit., f. VIII-LXIV; Josip Kekez, *Uvod u knjizhevnosti*, Zagreb, 1983, f. 236; Ali M. Ahmeti, vep. e cit., f. 11-20; Aleksandër Stipçević, vep. e cit., f. 101-118; Kosta Horman, *Narodna pjesa muslimana*, 2, Sarajevë, 1978, f. 74-87; Eqrem Çabej, *Për gjenezën e*

Populli shqiptar gjatë rrjedhës së shekujve, përveç formave të tjera të krijimtarisë shpirtërore e materiale, ka kultivuar edhe lojërat e ndryshme, kryesisht me frymë pagane, që janë një lloj domethënës i krijimtarisë gojore dramatike. Si të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit, apo te shumica e tyre, lojëra të tilla janë luajtur në raste të veçanta, sidomos gjatë stinës së dimrit, pastaj në festa të ndryshme pagane e fetare, në festa të ndryshme të riteve kalendarike familjare, në dasma dhe në kremte të tjera. Lojërat, me gjithë tiparet e përbashkëta me kulturat e popujve të këtij nënqielli, kanë edhe tipare të veçanta. Të krijuara dhe të ruajtura brez pas brezi, nëpër periudha të ndryshme, që nga lashtësia e deri në ditët tona, subjektet që i kanë kultivuar i përkasin asaj shtrese të shoqërisë shqiptare, e cila në një mënyrë, ose në një tjetër ka përfaqësuar një lloj elite të shoqërisë në atë periudhë. Pra, të gjitha këto krijime, pa marrë parasysh karakterin e tyre, qoftë pagan, qoftë fetar, janë krijuar, janë kultivuar dhe janë bartur nëpër gjenerata, falë kësaj elite krijuese të shoqërisë shqiptare. Mund të thuhet se edhe këto subjekte që doemos i kanë trashëguar, ato lojëra janë krijuar, janë ruajtur, janë kultivuar dhe janë ekzekutuar në kontekste të ndryshme kohore. Prandaj, si pjesë e kulturës sonë popullore ka ruajtur gjatë shekujve ato elemente të qenësisë sonë që na kanë shpëtuar të mos zhdukemi si popull. Në proceset e mëvonshme historike, janë bërë pjesë e formimit dhe e afirmimit si komb modern. Sot është me rëndësi të ruhet ky thesar i kulturës sonë të mos zhduket para dallgëve të dinamikës së kohëve moderne.

Arti i krijimtarisë gojore në përgjithësi, por edhe i krijimeve të këtij lloji, e pasqyron jetën dhe fenomenet e saj duke u bërë zëdhënës i realitetit jetësor të periudhave të ndryshme, duke evoluar dhe duke u zhvilluar bashkë me të. Marrë në këtë rrafsh të vlerësimit, këto krijime janë më shumë se një regjistruer i ngjarjeve që kanë ndodhur, i mënyrës së jetës që kanë bërë banorët e këtij nënqielli, i përballimit të vështirësive shoqërore e natyrore me të cilat janë përballur. Ato janë edhe shpirtësia e gjithë këtyre tronditjeve të mëdha, qofshin ato të ligjeve shoqërore, qofshin të fenomeneve natyrore. Ndryshe nuk do të kishin mundur të përballonin kërkesat e kohërave që ndryshojnë, edhe pa këtë anë të vlerës së tyre të madhe. Në këtë vështrim, nëpërmjet vargjeve janë kapur dhe janë paraqitur dukuri përherë të reja në perceptimin estetik të atyre fenomeneve jetësore, duke shpalosur vazhdimisht anën e madhërisë të tyre.

Në radhë të parë, ato bëhen shprehëse dhe mbrojtëse të idealeve të përparuara të kohës për jetën e popullit që i krijon, duke shpaluar të madhërishten, por duke ruajtur dhe duke realizuar edhe funksionin e idealit estetik, si del nga ruajtja e kulteve të ujit, të gurit, të drurit, të pjellshmërisë, por edhe të plotësimit të kërkesave për jetën e përtëjvarrit të të ndjerit. Kultet e këtilla, të ngjeshura përherë me figura

dhe qenie mitike, janë përbërës të strukturës së këngëve lirike të riteve kalendarike, jo vetëm në krijimtarinë gojore të popullit shqiptar, por edhe te popujt e tjerë të Ballkanit. Ato nuk u zhdukën as para frymës religjioze, por as para normave të sistemeve totalitare që sollën valët e periudhave të ndryshme kohore.

Një element i përhershëm i strukturës së këtyre krijimeve është hapësira. Në strukturën e tyre këto krijime kanë ngjeshur hapësira të pafundme, qiellore e tokësore, duke mundësuar kështu atë anën e përjetshme të artit, edhe të këtyre krijimeve, që shkrijnë në shtratin e tyre atë befasinë e madhe të zhvillimit të ngjarjeve, të ndodhive, të fenomeneve, që për mendjen e zakonshme të njeriut të zakonshëm janë të pakapshme, ose të pamundura. Ajo, si sistem dhe si mjet komunikimi, është e vjetër sa vetë jeta e njeriut. Duke u lidhur me ngjarje shumë të hershme të jetës së njeriut, aty gjejmë të shtresuar që nga yshtjet e fallet, lutjet e magjtitë, ritet e ndryshme, si dhe festat pagane. Por, dihet kaherë, si gjatë lutjeve, ashtu edhe gjatë magjive, përherë ekzistonin hapësira të caktuara. Edhe festat e ndryshme pagane ceremonitë e tyre i kishin gjithnjë të lidhura me hapësirën si dhe kohën e caktuar.

Dihet se këto festa përcillen me ceremoni dhe veprime që shpalojnë dukuri të ndryshme magjike. Vendi i këtyre ceremonive dhe i këtyre veprimeve magjike ishte i caktuar. Fjala vjen, në Natën e Buzmit, ai sillej nga një vend i hapur, siç ishte mali a fusha, në një mjedis të mbyllur, në vatrë. Mbi të vihen të gjitha ushqimet që ishin përgatitur për këtë festë. Pas këtij veprimi, në ndërkohë shtrohej sofra, e cila po ashtu ishte e mbushur me të gjitha llojet e ushqimeve. Prandaj, ka gjasë, që nga ajo kohë të ketë mbijetuar kulti i tryezës si një rit shumë i përhapur. Në kulturën popullore shqiptare, siç dihet, është e ndaluar shkelja, por edhe kapërcimi i tryezës. Pra, shtëpia, kulla me tërë infrastrukturën e saj: carrani i vatrës, vatra, buzmi, tryeza etj., janë shenja të shprehjeve gjuhësore që dëshmojnë për lashtësinë e tyre. Në veprimet që shprehin këto rite, si dhe në bazë të normave të jetës tradicionale dhe të rregullave kanunore, andaj edhe në këngët e vjetra që lidhen me këto festa pagane, ato, veprimet pra, kanë kuptime magjike. Një pjesë e këtyre objekteve dhe këtyre gjësendeve ruhen dhe respektohen edhe sot e kësaj dite. Nuk di diçka tjetër në jetën e njeriut tonë, që çmohet më tepër se nderi i shtëpisë, i vatrës, i oxhakut, i magjes dhe i tryezës.

Dita e Verës, si festë pagane, përcillet me shumë veprime, që ngjajnë me dukuri magjike, të cilat shprehin mirëqenien njerëzore, të bagëtisë dhe të të korrave. Dita e Verës, sipas kalendarit të vjetër, festohet më 1 mars, kurse sipas kalendarit të ri, festohet më 14 mars. Në këtë ditë, në disa vise të Kosovës, fëmijët e dy gjinive shkojnë në kopsht, në arë, në punishte, në pyll a gjetiu dhe mbledhin lule, gjethe e thupra me të cilat thurin kurora. I mbajnë në kokë një kohë, ditën ose natën, kurse të nesërmen i hedhin në pus. Këto rite dhe veprime magjike i kanë ruajtur mirë këngët që janë mbledhur në anë të ndryshme të vendit:

*Ka ra hanëza n'dardhë e n'dardhë,
o shkojmë me i plasë thuprat në bunar.
Na ka ra hanëza për krye t'bjeshkës,
Po i çojmë kularat te lugi i qeshmes*¹³

Vargjet e kësaj kënge rituale krahas besimeve popullore lidhur me fuqinë magjike të thuprës së gjelbër apo të larme, tregojnë edhe se kularët i hidhnin në pus ose në krua, ngaqë besonin se uji kishte fuqi pastruese, andaj futja në të i bënte kularët të pathyeshëm. Njëkohësisht në këngët e ndryshme të kësaj feste ka vargje të tilla që dëshmojnë se në krua të caktuar edhe uji merrej në kohë të caktuar.

Me festën e Ditës së Verës lidhen edhe këngët e Dallëndysheve të Parë. Motivi është dëshira e njerëzve që dallëndyset të jenë bartëse të fatit, të jetës, të shëndetit dhe të ardhmërisë, siç del edhe në shembujt e përmendur. Kuptohet lehtë se motivin e këtyre këngëve e përshkon gëzimi për ardhjen e dallëndysheve të para, ku përmasat e hapësirës janë thujtë të vetëkuptueshme, sepse bëhet fjalë për ardhjen e dallëndysheve të para nga viset e ngrohta. Po ashtu, këngët dhe ritet e kësaj feste janë të lidhura edhe me kohën e një stine të caktuar. Si shprehet në vargje të ndryshme të këtyre këngëve, fëmijët porosisin dallëndyset që t'u sjellin verore të kuqe, gjerdan të kuq, si dhe çdo gjë që mund të ketë lidhje me ngjyrën e kuqe, e cila, sipas besimeve, ka fuqi të madhe apo tropikë, por të gjitha këto me kusht që dallëndyshja t'ua çojë “diku përtej detit” përcjellë edhe me një dëshirë “që t'u sjellë bukë e shëndet”. Nga vargjet e cituara shohim se fjala është për një hapësirë të pakufizuar, të cilën njeriu bënte përpjekje ta perceptonte vetë. Sipas bindjes së tij, ajo ishte një hapësirë shumë e gjerë, shumë e largët, tutje përtej detit. Mirëpo, edhe në përmasat e një hapësirë të këtillë nuk mungon fuqia e përfytyrimit estetik, ku jepet porosia për realizimin e dëshirës për pasje e begati, për jetë e për shëndet.

Në festën e Shën Gjergjit, krahas përgatitjeve që shprehin gëzimin e njerëzve për ardhjen e festës, janë të njohura edhe veprime dhe rite të ndryshme magjike, që përcillen gjithnjë me formula të caktuara, me veprime dhe lëvizje mimike e olfatike e me shprehje, ndonjëherë të pakuptueshme, në formë lutjesh e yshtjesh, si dhe me këngë të ndryshme, që i këndojnë fëmijët, apo e imitojnë këndimin e tyre gjatë ditëve të kësaj feste. Në këtë plan, më të gjalla, më aktive, janë veçanërisht vajzat. Këto, pothuajse për çdo element të kësaj feste bëjnë veprime të karakterit ritual dhe magjike, të cilët shpesh përcillen me këngë lirike. Në hyrje të veprës së tij, të cilën Gjeçovi e shkroi në Gjakovë, në prill të vitit 1927, për ritet e doket e popullit

¹³ Shih Demush Shala, vep. e cit.

shqiptar, mbledhur nga viti 1900 deri në vitin 1926, gjendet ky shënim: “Në këtë fletore përmbledha ca punë (nënvizimi im. A.H.) e doke që i kisha nëpër fletë që të mos më shkojë puna dëm dhe literatura shqipe të mos varfërohet. Gjakovë 23.VI.1927”¹⁴. Dorëshkrimi ka rreth 200 faqe dhe ndodhet në arkivin e Muzeut Popullor në Shkodër, regjistruar në numrin rendor 2130¹⁵.

¹⁴ Shefqet Pllana, art. i cit., f. 290.

¹⁵ Demush Shala, vep. e cit.

Arbnora DUSHI

PRURJE TË REJA NË FOLKLORISTIKË: MODELE NGA FINLANDA

Folkloristika, si një fushë e përcjelljes së shpirtit krijues të njeriut dhe të masës, në vazhdimësi ndërtohet dhe zhvillohet ashtu siç ec dhe zhvillohet vetë lënda e saj. Ky është edhe parimi kryesor sipas së cilit është konceptuar folkloristika, jo shumë pas definimit të saj si shkencë për folklorin. Modelet ndërkombëtare të zhvillimit të folkloristikës, në përgjithësi, janë të ndërtuara sipas këtij parimi dhe sot ato i shohim me kufij shumë të zgjeruar konceptualë në krahasim me ata që i kanë pasur në fillimet e veta. Kjo e tregon më së miri aspektin evolutiv të vetë kësaj shkençe.

Atëherë pyesim si qëndron puna me folkloristikën shqiptare? Folkloristika shqiptare, ajo që ne e njohim, që është krijuar dhe vazhdon të zhvillohet në shkollat, universitetet dhe institutet shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në gjendjen që është sot lë shumë për të dëshiruar. Hapat me të cilët zhvillohet shoqëria shqiptare janë shumë më të shpejtë, si edhe ndryshimet që pëson ajo janë shumë rapide, prandaj mendojmë se folkloristika shqiptare si një fushë e përcjelljes së shpirtit krijues të njeriut shqiptar, nuk është duke shkuar hapave të lëndës së saj.

Për të sqaruar më tej këtë ide, do të ofrojmë modelin finlandez të zhvillimit të folkloristikës, rrugët e zhvillimit të saj historik, lidhjen e madhe me nacionalizmin dhe ndërtimin e vetëdijes kombëtare për të ardhur tek modelet aktuale dhe prirjet e saj moderniste ku nëpërmjet një krahasimi përvijues do të shohim ku jemi në krahasim me të tjerët. Ndoshta kjo do të na ndihmojë të marrim edhe ndonjë ide që do të na duhet e përshtatshme, qoftë në aspektin praktik të qasjes ndaj saj ashtu edhe në atë teorik të metodave të hulumtimit e të studimit.

Sjellja e një modeli të këtillë në studimet shqiptare, na u mundësua pas realizimit të studimeve të post-doktoratës në Departamentin e Folkloristikës, në Fakultetin e Shkencave Humane të Universitetit të Turku-t në Finlandë.

Finlanda – një prezantim shkurtër

Për të krijuar një koncept më të qartë lidhur me rrethanat e krijimit të folkloristikës si shkencë si edhe të gjendjes që ajo gëzon sot, na duhet të japim një

prezantim të shkurtër për Finlandën si shtet, por edhe finlandezët si popull, pasi që folklori dhe zhvillimi i tij nuk mund të kuptohet i ndarë nga rrethanat historike e politike të vendit dhe vetë popullit që e krijon.

Finlandezët, shtetin e tyre e quajnë Suomi e veten suomalaisen, dhe gjuha e tyre finlandishtja është një gjuhë fino-ugrike që i takon familjes së gjuhëve të Uralit, të cilat nuk hyjnë në familjen e gjuhëve indoevropiane. Pra duke mos qenë gjuhë indoevropiane edhe fjalët e kësaj gjuhe është shumë e vështirë të kuptohen pasi që nuk kanë kurrfarë lidhje me gjuhët e njohura evropiane.

Finlanda ka pesë milion e katërqind mijë banorë në një sipërfaqe prej 338,424 km dhe është e banuar rrallë, kur kemi parasysh që banohet nga 17 banorë në një km². Finlanda është vend me pyje të pafundshme, me net të gjata me diell në verë e me ditë të shkurtëra dhe të errëta në dimër. Finlanda është vendlindja e babadimrit dhe vendi me 1.5 milion sauna.¹

Finlanda është shtet nordik në Evropën veriore, i cili gjendet përkrah gadishullit skandinav. I pozicionuar midis Suedisë dhe Rusisë, dominimet e këtyre dy shteteve, në periudha të ndryshme të historisë, lanë gjurmët e veta të thella tek finlandezët, në aspektin historik, kulturor, arsimor, gjurmë këto që vazhdojnë të jenë të pranishme edhe sot, ndonëse në forma të tjera. Që në shekullin e XII ku territor verior matanë gjirit të Botnia-s ra nën sundimin e Mbretërisë suedeze. Ndonëse i banuar me popullatë tjetër nga suedezët, banorët e këtij territori për shtatë shekuj me radhë u zhvilluan sipas koncepteve të kësaj mbretërie. Dominimi suedez në shekullin e XVII hapi universitetin e parë në Finlandë, universitet suedez sigurisht, në qytetin juglindor, Turku, ku edhe u shfaqën mësimet dhe shkollat e para. Siç shkruan William Willson në librin e tij “Nacionalizmi në Finlandën modern” ky universitet i quajtur Akademia Mbretërore e Turkut, ekzistoi për një periudhë të gjatë, mbi dyshekullore (1640 – 1828) dhe aty edhe u shkolluan brezat e parë të finlandezëve të arsimuar². I kësaj periudhe është krijimi i Antikuarit shtetëror, i cili ishte një projekt mbretëror suedez që kërkonte mbledhjen e të gjitha kronikave, historive, rrëfimeve për njerëzit e famshëm, kështjellat, manastiret, legjendat, këngët për drangojt, gjigantët etj. Meqë Finlanda atëherë nuk ishte e ndarë nga Mbretëria suedeze, kronikanët regjistruan gjithçka edhe nga territori finlandez. Këta kronikanë e shfrytëzuan folklorin për të konstruktuar të kaluarën, për të shkruar kronikat. Në këto kronika kishte shumë fantazi, si p.sh. që finlandezët ishin pasardhësit e djalit të Noes. Nga këto kronika erdhi edhe shënimi i përpiluar nga lidhja e disa legjendave se ishte një herë një gjigant që quhej Kaleva, i cili kishte 12 djem e

¹ Shih më tepër Finland: a cultural encyclopedia, O.Allho, H. Hawkins, P. Vallisaari (red.), Finnish Literature Society, Helsinki, 1999.

² Shih, William A. Willson, Folklore & Nationalism in Modern Finland, Indiana University Press, Bloomington and London. 1975.

që më të njohurit ishin Vainamonen dhe Ilmarinen. Legjenda të ngjashme tregoheshin edhe për origjinën e suedezëve apo të popujve të tjerë skandinavë.³

Mirëpo këta shekuj nuk tregonin për një identitet të shquar finlandez, të ndryshëm nga suedezët. Përkundrazi, përderisa shkollimi dhe administrata ishte në gjuhën suedeze edhe vetë finlandezët nuk kishin shkrimet dhe librat në gjuhën e tyre, edhe nuk ekzistonte ndonjë dëshmi për ndonjë identitet shkrimor kombëtar. Historia njih disa nga prijatarët e këtyre ideve, pra të shprehjes së identitetit kombëtar nëpërmjet një vetëdijeje të avansuar arsimore dhe kulturore, por fatet e tyre si edhe të shumë popujve të tjerë në Evropë që ishin nën dominimet e mbretërive të fuqishme, ishin të destinuara të shuheshin dhe të mbeteshin të vetmuar në histori.

Fillimisht kulli i XIX (1809) e gjeti Finlandën nën sundimin e Mbretërisë ruse, pra pushtuesit që i vinin nga lindja dhe për gati njëqind vitet e ardhshme, ky territor u quajt Dukata e madhe ruse, me ç'rast pati një status të veçantë nga territoret e tjera të pushtuara nga kjo mbretëri. Duke qenë nën sundimin e Carit rus, finlandezët, tanimë mjaft sosh të shkolluar në shkollat dhe universitetet suedeze, me ardhjen e sundesve të tjerë, të cilët tashmë kishin tjera kërkesa për shfaqjen e identitetit të tyre, pra kërkoni të shpallehin rusë, e panë se kishte ardhur koha të tregoheshin me identitetin e tyre të vërtetë, as si suedezë as si rusë, por siç ishin vërtetë – finlandezë⁴.

Ishin fillimet e shekullit të XIX, kur në Evropë tek shumë popuj filluan të shfaqen idetë për theksimin e identiteteve kombëtare. Më e shquara në këtë kohë ishte shkolla e Herderit⁵, ndikimi i së cilave ide po i tregonte frutet e veta edhe në Finlandë. Kështu në vitin 1814 zhvillohet në Turku ajo që njihet si Fenomania, apo orientimi kulturor me theks në idetë e para për identitet të dallueshëm nga suedezët dhe rusët (nën ndikimin e Herderit). Fenomania cilësohet si një pasion për të shprehur me çdo kusht kulturën finlandeze, i cili pasion i karakterizoi studentët finlandezë të shkolluar në gjuhët suedeze dhe ruse. Mungesa e një vetëdijeje kombëtare dhe arsimimi në finlandisht, i bëri këta studentë të luftonin për këtë çështje. Në emër të këtij koncepti në vitin 1831, entuziastët finlandezë e hapën **Shoqatën letrare finlandeze** me në krye folkloristin Elias Lönnrot, i cili duke qenë mësues i shumë prej tyre e pati zhvilluar tek ta vetëdijen për vlerat kombëtare finlandeze⁶. Mbështetje e madhe ishte epi nacional finlandez Kalevala, të cili Lönnrot e kishte mbledhur në shumë zona të banuara me finlandezë dhe duke i tubuar këto

³ Kaarle Krohn, Folklore methodology – formulated by Julius Krohn and expanded by Nordic researchers, (trans. Roger Welsch), AFS, University of Texas Printing, Austin, 1971, fq. 35.

⁴ W. Wilson, burimk I cit. fq. 27.

⁵ Po aty, fq. 29.

⁶ Po aty, fq. 42.

këngë kishte arritur t'i jepte një strukturë më të qëndrueshme. Kalevala në të vërtetë ishin këngët popullore, të bazuara në heroizmat e heronjve Vainamonen dhe Ilmarinen, të cilët në luftë me forcat e natyrës, por edhe më vonë me pushtuesit e tokave finlandeze, morën statusin e heronjve kombëtarë⁷. Elias Lonrot më 1835 i botoi 32 poema (12 mijë vargje) të Kalevalës, të mbledhura në popull, të cilat i tuboi duke i dhënë formën e poemës, siç thoshte vetë “sipas modelit të Homerit, ose së paku, të Hesiodit”⁸. Kjo datë, data e botimit të parë të Kalevalës, sot në Finlandë është festë kombëtare dhe për çdo përvjetor njerëzit tubohen dhe recitojnë e këndojnë përmendësh vargje nga Kalevala.

Epika kombëtare finlandeze, më shumë se një epikë popullore, ajo për vetë finlandezët ishte një manifest kombëtar ku thuhej se ajo e përbënte tërë programin kombëtar – gjuhën, historinë, territorin. Ata nëpërmjet Kalevalës arritën ta mbajnë gjallë frymën kombëtare dhe ta zhvillojnë vetëdijen për formësimin e kombit dhe më vonë edhe vetë ndërtimin e shtetit. William WEilson thotë se finlandezët tri herë iu kthyen Kalevalës: herën e parë për të ngritur vetëdijen kombëtare tek populli me qëllim çlirimin nga suedezët kur edhe u shfaqën poetët e romantikët e parë dhe sollën vetëdijen për vlerat kombëtare; herën e dytë, pas njëqind viteve të pushtimit rus kur e panë të nevojshme se ka ardhur koha të çlirohen edhe nga rusët dhe ishte ky fillimi i shekullit të njëzetë kur ata edhe e fituan pavarësinë nga Rusia më 1917 dhe herën e tretë kur filluan t'i vënë bazat e shtetit të tyre kombëtar – Finlandës, pra pas pavarësisë.⁹ Vetëdija që i udhëhiqte prijësit e ideve kombëtare vërehet edhe në thënie e luftëtarëve të atyre ideve: ““Vetëm njeriu i lirë mund ta bartë shpatën, jo skllavi dhe jo ai që ka mendje servile. Në këtë tokë ne jemi zgjedhur të luftojmë për ta nderuar kulturën tonë, të cilën e kemi trashëguar. Shpatën do ta mbajmë në dorë derisa ta bëjmë folklorin - shkencën tonë kombëtare, të frymojë i lirë, se pa shkencën e lirë, atdheu ynë të cilin i shërbejmë, nuk mund të lulëzojë” thoshte Martti Haavio.¹⁰

Pas pavarësisë, ideologët kombëtarë po i ktheheshin Kalevalës nëpërmjet një interpretimi të ri. Tani, Kaarle Krohn-i, i biri i Julius Krohn-t që njëhej edhe si themeluesi i metodës historike-gjeografike për mbledhjen dhe gjurmimin e origjinës së variantevetë folklorit, duke e vazhduar punën e të atit mbi kërkimet e formave të para të Kalevalës, po vinte në përfundime të reja ku thoshte se:

- Lönrott ishte këngëtari fundit popullor – vetë i këndoi dhe i kompliloi këngët;
- këngët e Kalevalës nuk janë krijime të huazuara (nga perëndimi), por krijime origjinale të finlandezëve;

⁷ Kaarle Krohn, burim i cit. fq. 63.

⁸ William Wilson, burim i cit. fq. 55.

⁹ Po aty, fq. 22.

¹⁰ Po aty, fq. 112.

- Kalevala kishte lindur në fund të periudhës pagane, në kohën e vonshme të gurit (vitet 700 – 1100);
- është e bazuar jo në legjenda, por në ngjarje historike dhe në vepra reale të heronjve finlandezë;¹¹

Katedra akademike e studimeve të folklorit

Pra me mbledhjen, botimin dhe studimin e Kalevalës që po i bënin brezat e studiuesve erdhi koha që finlandezët të hapnin katedër të veçantë për studimin e folklorit, pasi ata po i venin bazat e këtyre studimeve. Kështu, Akademia Mbretërore e Turkut e hapur nga Mbretëria suedeze e ushtroi veprimtarinë e saj brenda periudhës 1640 – 1828. Me pushtimin rus, kjo akademi u transferua në Helsinki dhe u quajt Universiteti Mbretëror i Aleksandrit në Finlandë, ku edhe funksionoi brenda viteve 1828 – 1919, dhe me pavarësimin e Finlandës, e njëjta mori emrin e Universitetit të Helsinkit, i cili vazhdon të quhet dhe të jetë i tillë edhe sot¹². Mu në këtë universitet, Karl Kroni u emërua profesor për lëndën *Studimi i poezisë popullore finlandeze dhe krahasimtare* dhe në vitin 1908 u themelua Katedra e studimeve të folklorit, e cila që nga ajo kohë fitoi status të përhershëm dhe vazhdon të jetë edhe sot. Ajo sot konsiderohet Katedra më e vjetër e studimeve të folklorit në botë.

Në vitin 1917 Karl Kroni u vu në krye të *Shoqatës letrare finlandeze*, e cila, e themeluar më 1831 nga Lonroti, kishte arritur të bëjë punë të konsiderueshme me ndërtimin e arkivave për tubimin e njësive të mbledhura nga Kalevala si edhe tubimin e dorëshkrimeve të poetëve finlandezë. Kishte arritur gjithashtu të realizonte edhe botimin e shumë këngëve të Kalevalës, përfshirë këtu edhe ribotimin. Me ardhjen e Kronit në krye të Shoqatës vazhduan ribotimet e Kalevalës, u mundësuan botimet e veprave të poetëve si edhe u konsolidua Arkivi i folklorit finlandez. Sot *Shoqata Letrare Finlandeze* është shndërruar në Institut për hulumtime ndërko-mbëtare, për ruajtjen e kujtesës kombëtare dhe për zhvillimin e kulturës kombëtare¹³. Sot ajo disponon me 1. Arkivin e Folklorit që përmban 4 milionë njësi të regjistruara që nënkuptojnë 535 metra rafte me material, ka 16 mijë orë incizime zanore, 1.110 orë video incizime, materialet e mbi 10 mijë subjekteve nga terreni dhe dosjet e mbi 1 mijë mbledhës terreni bashkë me 250 mijë fotografi; 2. Arkivin e Letërsisë ku ruhen 1.800 arkiva privatë të shkrimtarëve; 3. Bibliotekën me 230 mijë libra; 4. Departamentin e botimeve dhe të përkthimeve dhe 5. Departamentin e

¹¹ Karle Krohn, burim i cit. fq. 123.

¹² Hannu Laaksonen, Alma Mater Aboensis, University of Turku, 2006, fq.137.

¹³ Finland: a cultural encyclopedia, O.Allho, H. Hawkins, P. Vallisaari (red.), Finish Literature Society, Helsinki, 1999, fq. 95.

hulumtimeve.¹⁴ Ky institut i ka edhe seritë e revistave shkencore si organe të veta botuese, të cilat botohen në finlandisht dhe në anglisht dhe këto janë: Studia Fennica Folkloristica, Studia Fennica Ethnologica, Studia Fennica Litteraria, Studia Fennica Linguistica dhe Studia Fennica Historica, në të cilat botojnë bashkëpunëtorë profesionistë nga mbarë bota.

Rikontekstualizimi i folklorit dhe i traditës

Koncepti kombëtar por edhe shtetëror për zhvillimin e folklorit nuk ka shënuar asnjëherë rënie në Finlandë. Ky koncept është zhvilluar, zgjeruar dhe rritur nëpërmjet përparimit të vazhdueshëm të metodave të hulumtimit dhe qasjeve të reja studimore. Përderisa në departamentet e folkloristikës që i kanë katër universitete finlandeze dhe një universitet suedez (prej 17 universiteteve publike sa i ka gjithsej Finlanda), folklori hulumtohet dhe studiohet me metodat e kërkimit dhe të mësimdhënies, në institutin e sipërpërmendur, folklori vazhdon të mblidhet dhe të arkivohet e shumëherë edhe botohet si njësi, të cilat pastaj bëhen material të gatshme për t'u studiuar. Sot p.sh. në këtë institut përdoren metoda shumë të avansuara për mbledhjen e folklorit. Duke qenë se kufijtë e folklorit konsiderohen shumë më të gjerë se ata të definimit klasik edhe metodat për regjistrimin dhe mbledhjen e tij bëhen sipas kushteve dhe mënyrës së jetesës. Përparimi i teknologjisë që ka hyrë në jetën e secilit individ nuk e lejon që folklor të konsiderohet vetëm ai krijim “i pakontaminuar” nga zhvillimi i teknologjisë. Duke e pranuar cilindo element të jetës së njeriut të sotëm si material për hulumtim, nuk përjashtohet të konsideruarit folklor edhe të asaj bote që krijohet si pasojë e kushteve të ndryshuara të jetesës. Kështu, nëpërmjet teknologjisë së avansuar, shpërndahen pyetësorët në internet si edhe radiostacione lokale, ku kërkohen të shtjellohen tema rrëfimore apo edhe këngë e forma të tjera të krijimeve gojore dhe pastaj subjektet nëpërmjet kontaktimit me institutin i sigurojnë këto materiale duke i bërë njëkohësisht material terreni, gjegjësisht lëndë për studim. P.sh. kërkohen të plotësohen pyetësorë që lidhen me temat: A i shihni në ëndërr zgjedhjet presidenciale?; Cila janë besimet tuaja? Në çka besoni?; Hiri vullkanik dhe përvoja ime në udhëtim; Jeta në zonat kufitare: kultura, traditat; Kujtimet e veteranëve finlandezë dhe mbijetesat 1939 – 2010; Përvojat me digjitalizimin (1996-2007) etj.

¹⁴ WEB-faqja e Shoqatës <http://www.finlit.fi/index.php?lang=eng> (shikuar së fundi 10.V.2013).

Organizimi dhe programet e studimeve

Katër universitete finlandeze dhe një universitet suedez në Finlandë kanë departamente të veçanta ku studiohet folklori, tradita gojore, kultura tradicionale. Departamentet e tilla quhen Departamente te Folkloristikës, e jo të Folklorit, për faktin se aty hulumtohet dhe studiohet folklori, por nuk krijohet ai. Ajo që bëhet është puna me folklorin si lëndë krijuese, por jo vetë krijimi i tij. Këto departamente i kanë programet për studimet bachelor, master dhe ato të doktoratës e post-doktoratës. Departamentet e tilla janë në Universitetin e Helsinkit <http://www.helsinki.fi/university/>, Universitetin e Turkut <http://www.utu.fi/>, Universitetin e Jyväskylä <https://www.jyu.fi/en> si edhe Universitetin e Finlandës lindore apo Universitetin e Joensuu http://www.joensuu.fi/tutkimustuki/koovee2/sisallot/the_university_of_joensuu.htm. Departamenti i quajtur *Folkloristika nordike* është në kuadër të universitetit suedez, të vetmit në Finlandë që gjendet në Turku¹⁵, pra në Universitetin Abo-Akademi <http://www.abo.fi/>, por që ka fakultete edhe në qytetet Helsinki dhe Vasa. Të gjithë doktorantët e studimeve të folklorit në të gjitha universitetet në Finlandë e përbëjnë “Shkollën doktrale të interpretimeve kulturore”, shkollë kjo e cila mban përherë pranë vetes folkloristët e doktoruar në këto universitete dhe nëpërmjet punës së tyre, angazhimit në zhvillimin dhe përparimin e teorive dhe metodave hulumtuese në çështjet e kulturës, ata arrijnë të jetë sistematikë dhe të organizuar në aspektin e studimeve të folklorit. Kjo shkollë organizon ligjërata dhe konferenca shkencore, në të cilat i prezantojnë rezultatet e punës së tyre anëtarët, të cilët njëkohësisht janë edhe specialistë të folkloristikës në universitetet përkatëse¹⁶.

Dy universitetet më të shquara në aspektin e studimeve të folklorit janë ai i Helsinkit me katedrën e folkloristikës më të vjetrën në botë dhe ai i Turkut ku pos departamentit në universitet e ka edhe Institutin Kalevala ku bëhen studimeve të ngushta në fushën e folkloristikës. Këto dy universitete janë më të organizuarat në studimin e folklorit finlandez dhe krahasimtar, kur kemi parasysh se edhe kanë dhënë emrat e teoricientëve më të njohur të folkloristikës finlandeze, e jo vetëm, por edhe vazhdojnë të dëshmojnë me punë cilësore dhe me përparimin e vazhdueshëm të metodave të hulumtimit dhe teorive të studimit. Programet që zbatohen në këto shkolla teorike nuk janë identike, por veçohen për nga qasja ndaj lëndës së studimit. Për shembull shkolla e Helsinkit është më tepër e orientuar kah analizimi i teksteve gojore, dhe hulumtimi e studimi i lëndëve arkivore, përderisa shkolla e Turkut është

¹⁵ Turku është qytet në juglindje të Finlandës, i cili për shkak të prezencës së popullsisë suedeze është edhe qytet ku gjuha e dytë zyrtare është suedishtja. Prandaj edhe qyteti quhet Turku për finlandezët dhe Abo për suedezët. Si i tillë e ka edhe universitetin suedez, përkrah atij finlandez, në të cilin kanë të drejtë shkollimi finlandezët suedishtfolës.

¹⁶ <http://www.joensuu.fi/kultukoulu/english.html> (shikuar së fundi më 10. V. 2013)

më tepër e orientuar kah punët e terrenit dhe mënyra e qasjes ndaj aktit performues. Në këtë kontekst përmendim teoricientin Matti Kuusi nga Universiteti i Helsinkit, i cili me studimet e veta bëri kthesë në folkloristikën finlandeze, kur duke qenë në krye të Katedrës në vitet '60 dhe me të parë se folklori në kufijtë e atëhershëm konceptualë, pra si botë krijuese e njerëzve të paarsimuar të zonave rurale të pakontaminuara nga moderniteti, po zbehej dhe folkloristët po rrezikoheshin të mbeteshin pa lëndën e vet të parë, thënë kushtimisht, pra që atëherë ai vendosi të tubojë folkloristët finlandezë dhe të merren vesh që t'i zgjerojnë kufijtë konceptualë të folklorit, dhe kështu u bënë pjesë e studimeve të folklorit edhe kultura pop, mas-media dhe interneti si edhe kultura e të rinjve. Në anën tjetër, teoricienti Lauri Honko, nga Universiteti i Turkut me studimet e veta, të ndikuara edhe nga kontekstualistë amerikanë Richard Dorson, Richard Bauman, Dan Ben-Amos, nga "teksti në qendër" studimet e folklorit i orientoi kah "performansa në qendër" dhe kështu i bëri vendin folkloristikës finlandeze në kuadër të studimeve kontekstuale për folklorin në rang botëror¹⁷.

Sot studimet e folklorit në këto departamente janë të orientuara kah tri fusha:

1. Zhanret klasike të Kalevalës: poezia metrike, rrëfimet, legjendat, besimet, mitologjia sipas qasjes komparativiste të ndikuar metodologjikisht nga teoritë kontekstualiste të folklorit, teoritë e narratologjisë dhe antropologjia, p.sh antropologjia linguistike

2. Historia gojore : materialet biografike, politikat e historisë dhe të kujtesës, si edhe studimet e folklorit të ditëve të sotme. Problemet e ndryshimeve të çdo ditshme në kulturë, sidomos studimi i ndryshimeve rapide të tranzicionit kulturor nga Finlanda para-bujqësore në një vend modern dhe post-industrial.

3. Tema të tjera të hulumtimeve që lidhen me interaksionin midis komunikimit gojor dhe formave letrare

E veçanta e këtyre departamenteve të folkloristikës, përveç programit shumë të pasur të lëndëve dhe kurseve që ofrojnë është edhe puna aktive praktike që duhet të bëjnë studentët si pjesë e aftësimit profesional për t'u bërë folkloristë. Kështu, këto departamente kanë arkivin me materiale audio dhe video të mbledhura nga studentët si edhe dhomën e traskriptimit e të traslterimit me pajisje kompjuterike, ku studentët bëjnë punën praktike nën mbikëqyrjen e arkivistit si edhe të mësimdhënësit ku aftësohen si të punojnë me lëndën.

Kurset që sot janë pjesë e programeve të këtyre departamenteve janë: Hyrje në studimet e kulturës Zhanret e folklorit dhe historia e studimeve, Folklori dhe kultura e ditëve të sotme, Folklori dhe nacionalizmi, Studimet paremiologjike , Rrjedhat aktuale në studimin e poezisë popullore finlandeze dhe Kalevala , Historia gojore në

¹⁷ Shih, Lauri Honko, Textualizing the Siri epic, Folklore Fellows' Communication, Academia Scientiarum Fennica, Helsinki, 1998

studimet e folklorit, Historia gojore: teoritë dhe metodat, Rrëfimi dhe tradita narrative, Identiteti etnik dhe trashëgimia kulturore, Mendësia (mentaliteti) popullor, Studimi i religjionit popullor, Muzika popullore finlandeze, Mjekësia popullore, Bazat e studimeve dhe metodologjia e folklorit , Folklori në tregun e punës etj.

Përfundim

Nga sa pamë në modelin finlandez të studimeve për folklorin, ajo që e karakterizon është vazhdimësia në zhvillimin e hulumtimeve dhe studimeve nga kjo fushë, e cila pavarësisht se në fillimet e veta ishte e lidhur me nacionalizmin e patriotizmin, sot në një formë shumë të moderuar vazhdon të ketë statusin e një shkence kombëtare dhe të shprehë nevojën dhe gatishmërinë për të qenë pjesë e kombit dhe e shtetësisë. Nëpërmjet projekteve hulumtuese, gjithmonë të kombinuara me metodologji moderne të kërkimit dhe studimit, folkloristika finlandeze mban primatin e studimeve të folklorit në botë. Në mos si tërësi, atëherë edhe vetëm si forma modelesh, përvoja finlandeze do të ishte shumë e adaptueshme dhe e mirëseardhur edhe për folkloristikën shqiptare. Mjafton të ekzistojë vullneti dhe gatishmëria në nivel institucional.

Literatura dhe burimet

1. , O.Allho, H. Hawkins, P. Vallisaari (red.), Finland, *a cultural encyclopedia*, Finish Literature Society, Helsinki.
2. Honko, Lauri (1998), *Textualizing the Siri epic, Folklore Fellows' Communication*, Academia Scientiarum Fennica, Helsinki.
3. Krohn, Kaarle m(1971), *Folklore methodology – formulated by Julius Krohn and expanded by Nordic researchers*, (trans. Roger Welsch), AFS, University of Tezas Printing, Austin.
4. Laaksonen, Hannu, Alma Mater Aboensis (2006), University of Turku.
5. Willson, William, A. (1975), *Folklore & Nationalism in Modern Finland*, Indiana University Press, Bloomington and London.

Nga interneti

1. <http://www.finlit.fi/index.php?lang=eng> (shikuar së fundi 10.V.2013).
2. <http://www.joensuu.fi/kultukoulu/english.html> (shikuar së fundi më 10. V. 2013)

Aleksandra DUGUSHINA

“FËMIJË TË KRIPUR” NË TRADITËN E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS

Në kulturën tradicionale të kolonistëve shqiptarë, që u vendosën në jug të Perandorisë Ruse (tani është rajoni i Priazovjes në rrethin e Zaporozhjes të Ukrainës) në vitet 60 të shekullit XIX, ka një element interesant të lidhur me fërkimin ritual të lëkurës së fëmijës së sapolindur me kripë. Duke larë fëmijën për herë të parë, vjehrra ose mamia bënin tri prerje të vogla në gjoksin e saj me thikën e mprehtë ose me briskë, dhe u fusnin plagëve kripë. Mendonin që veprimi i tillë do ta mbrojë njeriun nga era e pakëndshme e djersës në të ardhmen. Për fëmijët e kripura pak pas lindjes thoshin me shaka: *turqit e kripur*. Kuptohet se, përveç qëllimeve praktike të fërkimit të fëmijëve me kripë, në mendjen e njerëzve kripa kishte edhe funksionin e diferencimit etnik, për shkak të ndikimit të ndërsjellë të grupeve të krishtera dhe ato myslimane në periudhën osmane. Sipas të dhënave të N.S. Derzhavinit, i cili bënte studime gjuhësore dhe etnografike në fshatrat shqiptare të Ukrainës në vitet 1911–1925, kur e sillnin foshnjën në shtëpi pas pagëzimit, thoshnin: “*E morëm turkun, prapë e sollëm të krishterin*” [Державин 1949: 161]. Klishe gjuhësore e tillë shqyrton kalimin e fëmijës nga kategoria e “të huajve” në atë të “tonave” duke ua kundërvënë etninë dhe fenë “tonë” atyre “të huaja”, dhe variantet e ndryshme të kësaj shprehjeje janë shumë të përhapura ndër popujt e Ballkanit që praktikojnë pagëzimin. Si “të huajt”, që u kundërvihen “tonave” dhe marrin një vlerësim negativ, dalin turqit, romët, hebrenjtë etj. [2007]. Tradita për t’ua kundërvënë osmanëve grupin e vet etnik dhe fetar me anë të praktikave rituale gradualisht ka humbur aktualitetin e saj ndër shqiptarët e Ukrainës për shkak të qendrimit të tyre të gjatë larg nga trojet shqiptare, dhe në vetëdijen popullore kjo traditë ka mbetur vetëm në nivel të mitologjemave. Sipas të dhënave të grumbulluara në ekspeditën e vitit 2009, interpretimi i mëvonshëm i sasisë së prerjeve në gjoksin e foshnjës, që duhet të jenë tri, lidhet me idenë e Trinisë (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë). Kjo, më sa duket, është shkaktuar me ndikimin e krishterimit, të cilit tradita popullore i ka dhënë në këtë rast kuptimin mitologjik.

Tradita e fërkimit të fëmijëve me kripë ekziston edhe ndër grupet etnike fqinje me shqiptarët, për shembull, ndër kolonistët bullgarë të Priazovjes, që u shpërngulën së bashku me shqiptarët nga Bullgaria lindore në fund të shekullit XVIII. Riti me

kripë është shumë i përhapur në Trakinë jugore, në verilindje dhe në përqendrim të Bullgarisë së mesme (sipas të dhënave etnografike të Vakarellski-t [Толстой 1991: 45]), duke dalë në mënyrë krejt të ndryshme. I kripnin bërrylat, nyjet e këmbëve dhe qafën e fëmijës, pastaj e mbështillnin me pelena dhe e linin foshnjën, që qante, për disa orë ose madje për një ditë. Riti me kripë kishte një shpjegim praktik – e bënin me qëllim, që të mos djersitej fëmija dhe që të mos kishte erën e pakëndshme. Kundërshtimi i theksuar me osmanët e plotëson shpjegimin e dhënë: «за да не мирише като турчин» (të mos ketë erë si turku), por mungon në motivimin shqiptar. Ka arsye të supozojmë që shqiptarët e kanë huazuar këtë rit nga një grup i caktuar i bullgarëve, sepse riti i tillë me prerjen e lëkurës dhe fërkimin me kripë është shumë i veçantë për etnografinë bullgare dhe shqiptare, sepse ndër kolonistët shqiptarë në Karakurt ky rit mungon krejtësisht. Më sa duket, riti për të cilin bëhet fjalë është huazim i lashtë, sepse tipari që po realizohet dukshëm, është zhvendosje e akcentit etnik (“tonë” – “të huaj” = “bullgarët” – “turqit”), i cili u bë objekti i shpërbërjes, pastaj e mori kuptimin e ri dhe shkallë-shkallë u fut në traditën lokale shqiptare me një kuptim krejt të kundërt. Deri në momentin e pagëzimit fëmija i kripur konsiderohet turk, d.m.th. “i huaj”, “jo jonë”, ose i fesë tjetër. Pas pagëzimit fëmija bëhet “jonë” duke u socializuar me anëtarët e familjes dhe të shoqërisë nëpërmjet pranimit të krishterimit.

Prania e ritit të fërkimit të fëmijëve me kripë ndër shqiptarët e Ukrainës, pa dyshim, nuk mund të trajtohet si reflektimi i thjeshtë të të njëjtit riti bullgar. Kripa si një substancë ka funksione dhe kuptime të ndryshme në traditën e shqiptarëve të Priazovjes. Pra, riti me kripë mund të konsiderohet pjesa e pandashme e traditës, që e plotëson dhe trashëgohet nga brezi në brez. Përdorimi i kripës në ritet e lindjes vihet në dukje në traditat e popujve të Ballkanit (ndër grekët, serbët, maqedonasët, shqiptarët, bullgarët, vllahët, sarakacanët) dhe, më sa duket, e përbën pjesën e kodit kulturor në mbarë Ballkanin. Duke analizuar ritet e lidhura me fëmijët, mund të veçojmë funksione të përgjithshme të kripës, siç janë:

1. *Funksioni higjenik.*

Lëkurën e fëmijës e fërkojnë me kripë (ndër shqiptarët e Priazovjes, bullgarët) që të mos ketë ajo erë në të ardhmen. Variantet: **a**) mbështjellje me çarçafë të kripur që praktikohet ndër grekët e Pontit [Попов: 118] dhe shpjegohet me efektin kurues të kripës që mund të mënjanojë pezmatimin e lëkurës të shkaktuar me djersitjen; **b**) hedhje e kripës në ujë, së bashku me një monedhë argjendi, barra, verë, hudhër ose vezë, që bëhet për të përmirësuar dhe zbardhuar lëkurën [Halimi 2000: 182; Требјешанин 2000: 92]

2. **Funksioni i etnodiferencimit.**

Fërkimi me kripë ka për qëllim përcaktimin e përkatësisë etnike dhe fetare me anë të kundërshtimit me të huajt “e pakripur” (për bullgarët, shqiptarët e Priazovjes, grekët). Riti i fërkimit me kripë ka lidhjen e fortë me ritualin e pagëzimit, i cili simbolizon kalimin nga kategoria e “të huajve” në kategorinë e “tonave”.

3. **Funksioni mbrojtës.**

a) sendi që funksionon si hajmali. Kripa është hajmalia tipike, që përdoret për të mbrojtur fëmijën nga syri i keq. Shqiptarët e Priazovjes bënin hajmalitë e tipit krejtsisht ballkanik, siç është një leckë me kripë. Hajmalinë e fushin në djep për të nxjerrë fuqi të këqija nga foshnja. Përmes sendeve me kuptim të veçantë në mitologjinë popullore, kripa konsiderohet një nga gjërat apotropeike kryesore të përdorura kundër syrit të lig. Pra përmendet në veprat e përgjithshme për çështjet e etnografisë së shqiptarëve, maqedonasve, bullgarëve dhe serbëve [Речник 2000: 30; 1993: 69, 201; Halimi-Statovci 1998: 190; Костић 1996: 77-95; Drada 1990: 138].

Kripa mund të përdoret së bashku me sende të tjera për të përforcuar cilësitë e tyre mbrojtëse. Këto janë: grurë, oriz, hudhër, fshesë, gërshtë, dhëmbi i ujkut ose i gjarprit, fik, etj., në varësi të traditës lokale specifike. Nga ana tjetër, vetëm kripa, për shkak të statusit të saj në magjinë mbrojtëse, mund të përdoret së bashku me simbole fetare, si kryqi ndër të krishterët, ose me hajmalitë e shkruara me fjali të Kuranit [Костић 1996: 92].

B) fjala si hajmalia. Në nivelin verbal kripa, që ka kuptimin e hajmalisë së përdorur kundër fuqive të liga, del në format e vogla folklorike, siç janë formula e idioma rituale të shqiptuara për qëllimin e mbrojtjes nga fuqitë e këqija. Për shembull, shprehja “*unë rrah kripë*” (bullgarisht «
») duhet të shqiptohet tri herë në rastin e ndeshjes me fuqi të liga për të larguar rrezikun.

4) **Funksioni magjik, përdorimi në mjekësinë popullore.**

Kripa përdoret si mjete i shërimit të fëmijës nga sëmundjet që e prekin për shkak të veprimeve dëmtuese, siç janë syri i keq, trembja, etj. Për t’ia kthyer prapë dëmin personit që e ka shkaktuar, përdorin kripën e yshtur. Zakonisht e kripin kokën, trupin dhe gjymtyrët, ose marrin një pisk kripë dhe bëjnë veprime magjike rreth e rrotull kokës së fëmijës së sëmurë. Mendohet se ashtu si tretet kripa, do të zhduket sëmundja. Prandaj në fund

të procedurës së tillë zakonisht e djegin kripën në zjarr apo e tretin në ujë [Krasniqi 1987: 121; Siqeca, Kullashi 1987: 144-145; : 144]. Shprehjet që përdoren së bashku me veprimet magjike, e përfytyrojnë këtë ide në mënyrë shumë të saktë: “*Plaçin sytë i këqij si këto kokrra t’krypës!*” [Hajrizaj 1990: 289]; “*plast syni i keq, plast si krypa*” [Lajçi 1990: 168]; «

» («u trettë syri i keq nga fëmija, ashtu si trettet kripa në ujë») [Речник 2000: 50-51].

Pa dyshim, përdorimi i kripës në ritet e lindjes ka paralele të qarta ballkanike. Mirëpo, gjeografia e ritit del jashtë kufive të gadishullit Ballkanik. Praktika e fërkimit të fëmijëve me kripë pranohet ndër armenët, grekët e Pontit [Попов: 118], azeriturqit, kurdët, persët, turqit e Azisë së Vogël, arabët, popujt e Evropës mesjetare (gjermanët, francezët, anglezët). Praktikën e tillë e dinin dhe e përdornin hebrenjtë e lashtë [олстой 1991: 45)]. Nga një anë, ky fakt na tregon për lidhje të forta me rrënja të krishtera: për shembull, kripën e sjellin në kishë për ritin e pagëzimit; në Mesjetë ata që i linin foshnjët fshehurazi në jetimore, linin kripë së bashku me foshnjën, duke u lutur kështu, që të mbronin dhe të pagëzonin fëmijën [Orme 2003: 96]. Në simbolikën e krishterë buka së bashku me kripën, kryqin dhe ikonën, janë nga hamajlitë më të forta dhe më të përdorura, që mund të largojnë çfarëdo fuqie të lig [2002: 166]. Nga ana tjetër, praktika e fërkimit me kripë në Lindje dhe në Azi e vë në dukje rëndësinë e ritit nga pikëpamja e vlerave të tjera sakrale. Prandaj është mjaft vështirë t’i japim përgjigjen e saktë pyetjes së mundshme për vendin e lindjes së këtij riti dhe për procesin e përhapjes së tij. Fakti pa dyshim është që të gjitha rastet e përdorimit të kripës bazohen në besime popullore në cilësitë e saj mbrojtëse. Kripa në mendjen popullore është faktor i ruajtjes së shëndetit, mirëqenies dhe pasurisë. Këtë besim e kanë për bazë të gjitha ritet e lidhura me lindjen dhe rritjen e fëmijës.

Literatura

1. , (1993), Българска народна митологија. Изд.: «изкуство», Софија.
2. Державин, . . (1949), Албанцы-арнауты на Приазовье Украинской ССР// Советская этнография, №2.
3. Ђ, . (1996), j je у народним веровањима у источној Србији // Гласник етнографског музеј , 60. .77-95.
4. , . . (2002), Славјанскиј оберег. Семантика и па. Изд.:«Индрик», Москва.

5. . (2008), Категориите близина и дистанца: Етнолошко-Антрополошко истражување на народната култура. Скопје.
6. . . . Понтийские греки // Красная книга, Бюллетень №2. [http://history.kubsu.ru/pdf/kn6_102-133.pdf].
7. . Вражиновски (2000), j македонците.. Прилеп-Скопје.
8. . . (2007), Лингвокултурные основы родинного текста болгар. Авт. дисс. ... [http://www.ruthenia.ru/folklore/sedakova2.htm].
9. Толстой Н.И. (1991), Солёный болгарин // Studia slavica. К 80. - тию С.Б.Бернштейна. М. .38-46.
10. Требј , Ж (2000), j J
11. Drada, N (1990), *Nga mitologja e Anës së Malit // Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullor shqiptare*. Materiale nga sessione shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 dhe 8 dhjetor 1989. Prishtinë. f. 133-142.
12. Hajrizaj, F (1990), *Mbi disa besime e bestytни në Kotorr e Radishevë të Drenicës // Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullor shqiptare*. Materiale nga sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 dhe 8 dhjetor 1989. Prishninë. Ff.287 – 294.
13. Halimi, K. (2000), *Nga mjekësia popullor e Kosovës // Trajtime dhe studime etnologjike*.Prishtinë.
14. Halimi-Statovci, D (1998), *Etnologjia flet*. Prishtinë, 1998.
15. Krasniqi, M.(1987), *Mjekësia popullor e Rugovës// Rugova*.Monografi etnografike. Red.M.Krasniqi.Prishtinë.
16. Lajçi, B. (1990), *Disa të dhëna për syrin i keq në Rugovë // Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohor në kulturën popullor shqiptare*. Materiale nga sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 7 dhe 8 dhjetor 1989. Prishtinë. F. 163- 169.
17. Orme, N. (2003), *Medieval Children*. Yale University Press, New Heaven and London.
18. Siqeca, Sh. Kullashi Z. (1987), *Doke e zakone të Rugovës rreth lindjes, martesës e vdekjes // Rugova*.Monografi etnografike. Red. M. Krasniqi.Prishtinë. F.144-145.

Denis ERMOLIN

VËSHTRIMI NGA E KALUARA: SHQIPTARËT E UKRAINËS NË FOTOGRAFI ARKIVORE

Më 6 qershor 2012 kemi festuar 90-vjetorin e lindjes së Julias Vlladimirovna Ivanova (1922-2006), shkencëtare e njohur ruse që ka dhënë kontribut jashtëzakonisht të madh në fushën e studimit të etnografisë shqiptare dhe greke. Në vitin 1948 Julia Ivanova për herë të parë ka shkuar në fshatrat me popullsi shqiptare, bullgare dhe gagauze në rajonin e Zaporozhjes të Ukrainës. Më 1949 në ekspeditën e organizuar nga Julia Ivanova ka marrë pjesë dialektologu i famshëm shqiptar Selim Islami (Islami 1955). Në këtë ekspeditë etnografja ruse ka bërë shumë fotografi të cilat janë në ditët tona pasuri e dukshme në fushën e kulturës së diasporës shqiptare. Për këto fotografi do të bëhet fjalë në referimin tim.

Koleksioni i fotografive i Julias Ivanova nuk është përshkruar dhe atributuar në mënyrë të duhur, d.m.th. sipas rregullave të reja të antropologjisë muzeore vizuale. Si pasojë këto fotografi nuk janë shfrytëzuar nga shkencëtarët e tjerë. Në ditët tona do të ishte shumë e dobishme studimi i këtij fondi të fotografive që janë bërë në periudhën pas luftës së dytë botërore në fshatrat shqipfolëse. Fotografitë e bërë në vitin 1949 me pamjet e shtëpive tradicionale, veshjeve popullore, prodhimëve të zejeve, artizanateve, të kulturës së jetesës, të festave etj. kanë të bëjnë me qëndresën e kulturës së shqiptarëve në Ukrainë 60 vjet më parë. Kështu studimi i materialeve fotografike të Julias Ivanova dhe analiza e tyre shkencore mund të ndihmojnë në rekonstrukcionin e pikturës së historisë etnike të shqiptarëve. Pa diskutim fotografitë e etnografes ruse janë burim i pasur shkencor.

Sivjet me rastin e 90-vjetorit të lindjes së Julias Ivanova Muzeu i Antropologjisë dhe Etnografisë (Shën Peterburg) dhe Instituti i Etnologjisë dhe Antropologjisë (të dyja institucionet përkasin Akademisë së shkencave të Rusisë) realizojnë projekt të përbashkët për studimin e këtij fondi ilustrativ. Ky bashkëpunim institucional mund të ndihmojë në shqyrtim të shumë çështjeve të historisë së shqiptarëve të Ukrainës që janë aktuale, pikërisht: çështjet e prejardhjes së këtij grupi etnik, mekanizmat e ruajtjes, transmetimit dhe transformimit të kulturës etnike në kushtet e bashkëjetesës me etni të tjera.

Koleksioni i Julias Ivanova përfshin 207 negativa bardh-e-zi. Tematika e materialeve fotografike është shumë e gjerë dhe ka të bëjë me anët e ndryshme të

jetesës së shqiptarëve në Ukrainë në vitet 1940. Duke analizuar temat dhe objektet e fotografive mund të sistemojmë materialet në këtë mënyrë:

- ritet e dasmës;
- festat dhe vallet;
- mjetet e transportit dhe veglat e punës;
- orenditë dhe mënyra e jetesës;
- banesa dhe ndërtimet;
- zejet, ekonomia shtëpiake, profesionet;
- tekstilet, qëndisjet, dantellat;
- portretet e njerëzve;
- veshjet.

Në koleksionin e Julias Ivanova ka shumë fotografi të cilat janë bërë në dasmën tradicionale shqiptare. 39 fotografi i përkasin dasmës. Mund të shikojmë jo vetëm ritet dhe momentet kryesore të ciklit dasmor (si p.sh. vizita e dhëndrit në shtëpinë e nuses, ardhja e nuses në shtëpinë e dhëndrit etj.), por edhe vallet e lojërat e të rinjve që ishin një element i domosdoshëm i dasmës në të kaluarën: vallet e vajzave në krye të procesionit të mysafirëve; vallëzimi i lashtë tos-tamedto i grave të moshuara që kërcëhej në momentin e ardhjes së nuses në shtëpinë e dhëndrit; ritet qesharake që kishin vend në ditën e dytë të dasmës. Një rol të veçantë në këtë koleksion kanë fotografitë me pjesëmarrësit e ceremonive dasmore veshur në kostumet tradicionale. Këto fotografi janë burime të rëndësishme ilustrative për studime të mëtejshme të dasmës shqiptare (në vitet e ndryshme kompleksi dasmor është përshkruar nga studiuesit Nikollaj Derzhavin, Julia Ivanova, Oksana Budina, Aleksandër Novik).

Vlerë të veçantë kanë fotografitë me banesat, ndërtimet shtëpiake dhe shoqërore. Janë shumë të vlefshme për atë shkak që shumica e objekteve të arkitekturës popullore nuk është ruajtur deri në ditët tona. Nuk ekzistojnë më jo vetëm shtëpitë e vjetra, por edhe teknologjitë e ndërtimit. Veçoria karakteristike e teknikës së ndërtimit në këtë zonë deri në vitet 1970 ishte përdorimi i samanit (material ndërtimi prej balte) (Budina 1984: 17-19). Që nga viti 1970 për ndërtim dhe renovim të banesave, shqiptarët filluan të përdornin tulla të prodhimit industrial që ndikon në pamje moderne të fshatrave shqiptare. Shumë interesante është fotografia e furrës gura (# 21556). Furrat e tilla përdoren për pjekjen e bukës dhe gjellëve të ndryshme deri në ditët tona.

Në fondin e Julias Ivanova ka shumë fotografi me portretet individuale ose kolektive, disa prej tyre janë anonime dhe janë bërë me qëllim të fiksimit të përfaqësuesve të këtij grupi etnik (## 21622, 21627 etj.). Për këtë tregon edhe stili lakonik i atributimit të vet autores: “Kooperativiste”, “Vajzë-kooperativiste – bija e një shqiptare dhe një rusi” etj. Shumë pak fotografi të këtij tipi kanë atributime:

kryetari i kooperativës A.P. Oprev (## 21621, 21629), kryetari i kooperativës “Kaganoviç” Dimitrashko (# 21657), informanti N.H. Georgiev (# 21593).

Duke fotografuar sende, objekte dhe ngjarje Julia Ivanova ka fiksuar kulturën shqiptare në mes të shekullit XX. Shpesh imazhet e fotografive nuk janë lidhur me temat e studimeve të asaj kohe (ndryshe nga incizimi i bisedës e cila shkon sipas planit dhe dëshirës së studiuesit në terren). Çdo imazh që ka dalë në fotografi mund të jetë temë e veçantë për studimet e mëtejshme në shekullin XXI. Kështu në një fotografi me mbishkrimin “Grupi i kooperativistëve shqiptarë në festë” (# 21591) shihet gruaja që ka dy gërsheta të holla. Në atë kohë shumë gra mbanin flokët në këtë mënyrë. Në ditët tona moda ka ndryshuar fare.

Studimi i materialeve fotografike që ruhen në koleksionet muzeore, shkencore dhe shtëpiake, nëpër bibliotekat ashtu me radhë, duhet të jetë një nga drejtimet e rëndësishme të shkencës moderne antropologjike. E kaluara që është ruajtur në fotografi, ngjallet dhe bëhet një pjesë e realitetit.

Literatura

1. . . . О соотношении общих и локальных традиций (на примере балканских этнических групп на Украине и в Молдавии) // Советская этнография. 1984. № 2. С. 15 – 27.
2. Islami, S. (1995), *Material gjuh sor nga kolonit shqiptare t Ukrain s* // Buletin për shkencat shoqërore. Nr. 2. F. 163 – 180.

Renata HAMIDULINA

KONCEPTI I TRIMIT N KËNGËT PATRIOTIKE TË SHQIPËRISË MODERNE

Së pari dua të them diçka rreth këngës si subjekt dhe objekt i artit popullor. Çdo njeri njihet me këngët qysh në ditët e para të jetës së tij, përdërisa i dëgjon ninullat që këndohen prej nënës së tij. Megjithatë, ekziston mendimi se këto këngë nuk shërbejnë vetëm për ta qetësuar dhe ndihmuar fëmijën që të fle, por edhe për t'i dhënë atij idetë e para në lidhje me botën, përshtypjen e parë në lidhje me sjelljen, kontributin social e kështu me radhë. Në këtë aspekt mund të themi se këngët janë mjete të rëndësishme që ndihmojnë zhvillimin e fëmijes, e që ndikon në vendosjen e tij në botë, që në njëfarë mënyre është subjekti i gjithë kësaj. Sigurisht që këngët nuk janë entitet i pavarur në komunikim me njeriun, pasi që edhe ato janë të krijuara, sajuara, shkruara dhe kënduara nga vetë njeriu. Që nga kohët e lashta, këngët janë ndarë nga baladat, duke u ndarë në ato që mund të ngrisin humorin, ato që rrisin frymën ushtarake, dhe disa të tjera që janë krijuar si një mënyrë për ruajtjen dhe percjelljen e informacioneve, siç janë këngët e riteve, qoftë duke kënduar ose duke folur dhe shoqëruar me muzikë emocionin. Në këtë mënyrë u përcillen atyre njohuritë për botën, traditat e njerëzve të atij populli dhe atij komuniteti, për t'i njohur brezat e ardhshme me cilësitë e tyre, dhe veprimtarinë e tyre. Kështu këngët kanë shërbyer që të mund të krijohet një pamje e njeriut ideal, dhe t'u jepet mundësia brezave të rinj që t'i përsërisin heroizmat e tyre.

Në këtë aspekt, këngët mjaft ngjasojnë në përralla, por janë kryesisht të shkurtra, të japin një ndjenjë kënaqësie më të lartë, krijojnë më shumë përshtypje në shqisa duke shkaktuar një dëshirë të përsëritjes dhe kujtimit të tekstit në të ardhmen.

Si objekt të hulumtimit tonë kemi zgjedhur këngët patriotike në gjuhën shqipe që kanë ndodhur kohët e fundit, si të tilla ka mjaft pas një ngjarjeje të e madhe emocionale si ajo e viteve të 90-ta. Kjo do të thotë se mund të analizojmë një numër të madh materialesh dhe të gjejmë tiparet e përbashkëta të heroizmit të burrave, cilët janë këngëtarët shqiptarë dhe çfarë kërkon kombi tek këta djem të rinj për t'i konsideruar heronjtë. Gjatë hulumtimit tonë ne kemi dëgjua këngë nga albumet “Garda e Kosovës”, “Këngët e përngritjes..”, “Bota e Rinisë “Kujdes Lirinë” të Ilir Shaqirit.

Në këta tituj jemi duke kërkuar këngë rreth familjes, paraqitjes, performancës, si dhe sjelljes para dhe gjatë luftës, rreth ngjarjeve me të cilat ata ishin njohur në këtë periudhë si dhe procesin e vdekjes.

Duke analizuar me kujdes tekstet kemi arritur në grupimet e mëposhtme.

- *Që ndërlidhen me familjen*

"Thuaj Nenës të mos mbaj zi theva gurin Shqipni-Shqipni " (Këngë për Abaz Thaqin)

"Luan i luanëve" (Këngë për Luan Haradinajn)

-"Nënë lokja Llapjane ngritet si Ajkunë" (Këngë për Zahir Pajazitin)

-"Loke puthma Ballin e jepma bekimin se do të ngjitem malit ta lëshoj kushtrimin" (Këngë për Fehmi Lavdrocin)

Në këtë tematikë, kemi gjetur mjaft fjali që japin më shumë shpjegime edhe rreth marrëdhënieve me heronjtë e tjerë si dhe heronjtë e familjes së tyre të më hershëm – apo të vetë popullit:

"Hej Jam nipi i Eminit" (Tahir Meha)

"Ju ngjatjeta vëllezer" (Ushtar Kavaja)

"Vëllai i Adem Jasharit, Nipi i Skënderbeut" (Ushtar Kavaja)

"Për Ty, nënë Kosovë" (Ilir Lushtaku)

"Djemtë e Dardanisë" (Ushtar Kavaja)

"Djemtë e saj (e Drenicës) kurrë s'kanë vdekur" (Bekim Hyseni)

"Oh ngrihu n' kambë o Mic Sokoli" (Drita Qiriri dhe Naimi)

- *Që ndërlidhen me shëndetin fizik, pamjen e jashtme*

" Ku ai hec shkrihet bora"(në Baladë për Mujë Krasniqin)

"Nuk ka forcë Hej, që lidh trimin" (Tahir Meha)

- *Rreth sjelljes së tij*

"Kryetrimi fjalëpakë" (Sërish vjen marsi, rreth Adem Jasharit)

"Neper kulla rrin këmbëkryq AgimZeneli" (Këngë për Agim Zenelin)

- *Që ndërlidhet me gjithë guximin*

E kam zemrën si bjeshka, jam vetë balli me shqiponjë" (K ng për Abaz Thaqin)

„Ai dy kroje mban në shpinë ujë e gjak si dy drita“ (K ng për Enver Dobrën)

„Kush ka zemër guri si Fehmi Lladrovci“ (K ng per Fahmi Lladrovcin)

*„Tahir Meha s’njeh dorëzimin“ (Tahir Meha)
„si Bardhyl i lirisë
Del në ball Bardhyl Osmani
I ndez flakën djalërisë
Fryn e shfryn o si murlani“ (Bardhyl Osmani)*

- *Që ndërlidhet me veprimtarinë e tij gjatë luftës:*

*„N’malet e Koshares Shkrep një Pushkë e Vjet r“ (Keng për Agim Ramadanin)
„Ti që theve mur guret e kufinit ti je vet kalaja kulla e bashkimit“ (Zemra e Kumanoves, për Ismet Jashari „Kumanova“)
„Gurin e kufirit e shkul si dhemballën (K ng për Luan Haradinajn)
„kush po e ben hej pushken flakë?
Tahir Meha me babën plak,
Një kullë vetem në Malsi
Ball për ball me një ushtri.
Po shkrin hekur babë e djalë
Tankun topin e kan ndal“ (Tahir Meha)*

- *Që ndërlidhen me mjetet e përdorura*

*„Armët krahut te paskan hije lart u ngrit lavdia jote“ (K ng për Agim Zenelin)
„Me mortaje në dorë vjen “ K ng për Xhevat Demakun”
„I ka shkri tanket serbe Abaz Thaqi me ushtri“ (K ng për Abaz Thaqin)
„Pushka e tij hej 20 vjet, oo n’ball armikun e godet“ (Tahir Meha)*

- *Që ndërlidhen me vdekjen*

*„Ferri nuk ka emer,
prita nuk ka masë plumbat perzihen
naten e bëjnë shoshe“
(K ng për Luan Haradinajn)*

„Ra pa u ndje (K ng për Fehmi Ladrovcin)

Siç e shohim në këngët e tjera bashkëkohore, nuk kemi ndonjë përshkrim teknik të pamjes së jashtme të këtyre trimave, ndoshta për shkak se ngjarjet kanë ndodhur pothuajse tërësisht pas zhvillimit të fotografisë, medias dhe teknologjisë në përgjithësi, nuk është parë e udhës pasi që në ditët e sotme mund t’i shohim si janë dukur këta heronj, sa herë që kemi dëshirë.

Kemi vërejtur gjithashtu se pothuajse asgjë nuk është e thënë në lidhje me familjen e vërtetë, në këngë, trimi konsiderohet si djali apo vëllau Kosovës , nipi i Skënderbeut apo kushëriri i Adem Jasharit. Pothuajse asgjë nuk thuhet në lidhje me gjendjen fizike ose mjekësore, vetëm pak thuhet për fuqinë e tyre dhe gjithçka ndërlidhet më shumë me kushtet emocionale dhe guximin e tyre. Më së shumti i këndohet faktit se si trimi e mori epitetin që tani ka, si është bërë ai, ai që është dhe si ndikon kjo pastaj në “ familjen e tij të madhe” (farefisin) dhe popullin shqiptar në përgjithësi.

Zanita HALIMI

ROMANI “LIGATINA” E MUSA RAMADANIT DHE ETNOLOGJIA

Jeta moderne po ec me ndryshime të mëdha. Thuhet se kaluara nuk mund të jetojë gjatë, sepse ajo ndërtohet, restraurohet, skalitet, pikturohet dhe ajo duhet të shkruhet, të studiohet, të dokumentohet e të prezantohet në forma përkatëse për të. Ne, studiuesit e rinj duhet të jemi gjurmues të kujtesës shoqërore, që na transmetohet nga paraardhësit. Rrëfimet për të kaluarën, dokumentimit të tyre, si dhe analizat krahasuese janë mjete të metodava bashkëkohore që na mundësojnë rezultate të dëshirueshme në këtë drejtim.

Në këtë punim unë nuk do të ndalem në përshkrimin e ngjarjes në romanin “Ligatina”, të autorit Musa Ramadani, por do të mundohem të paraqes komunikimin e këtij Romani me Etnologjinë-Antropologjinë kulturore.

Etnologjia- Antropologjia Kulturore dhe linguistika e studiojne gjuhën si një formë e cila ka shërbyer për njohjen e botës dhe na njohton se si i ka rregulluar ajo marrëdhëniet mes njerëzve, si e ka shprehur respektin, familjaritetin etj.

Romani “Ligatina” e Musa Ramadani, tregon një lidhje të ngushtë mes letërsisë dhe etnologjisë. Autori ndërton ngjarjen mbi baza të mënyrës së jetës së banorëve të Gjilanit, e që në rrafshin më të gjerë komunikues do të përkujtojmë se objekt studimi i Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore është pikërisht mënyra e jetës së njeriut-popujve.

Romanin “Ligatina” mund ta quajmë lirisht etnografi narrative, në të cilën kuptojmë së autori ka njohuri të shkëlqyra për traditën. Në çdo ngjarje që shtron autori Ramadani, mund të merren informata të bollshme për të kaluarën, madje, si në askpetin gjeografik, kulturor, ekonomik e atë historik.

Herbert Blumer (1969) një herë ka argumentuar se konceptet shoqërore sa janë procedural, janë edhe teorike. Ato nuk ofrojnë vetëm kuptim, por edhe na senzibilizojnë për mënyrat e përqafimit të botës empirike. I tillë është rasti me *Etnografinë Narrative*. Koncepti është teorik në atë që specifikon një fushë një objekt- hulumtimi, praktikë narrative. Kjo çështje shfaqet procedurale në aspektin që rekomandon se metodat janë të rëndësishme për të kapur materialin empirik në kontekstin e tij të kompleksitetit.

Romani në fjalë mund të shërbejë njëherit edhe si një dokument për qytetin, meqë për fat të keq asgjë nuk ka mbetur nga arkitektura e vjetër e qytetit të Gjilani. Ura e Maskatarit (gjeneratat e reja nuk kanë fare njohuri se Gjilani ka patur urë e lëre më të dinë së ku ka qenë e vendosur kjo urë), Kafeneja e Maskatarit, Hanet e ndryshme, kalldërmi, shatërvani, shtëpi të vjetra, sahat kulla etj nuk janë më pjesë aktuale të qytetit, por ende mund të jenë vetëm në kujtesën e të moshuarëve, që tregojnë se dikur kanë ekzistuar.

Pra, këto ndërtime paraqesin një arkitekturë të veçantë të kujtesës historike. Kur e them arkitekturë, dua t'i referohem John Ruskinit, i cili për arkitekturën ka thënë” Ne mund të jetojmë pa të, dhe të admirojmë pa të, por ne nuk mund të kujtojmë pa të. (Ruskin 2002).

Gjilani është shquar edhe për zejtarinë, zejen e qelshpunuesëve, nallbanëve, teneqexhinjëve, vorbëtarëve, armëpunuesve, tregëtarëve të njohur si, tuxharë etj, ndërsa autori Ramadani e përshkruan shumë mirë në këtë roman rëndësinë e kytëre zejeve për qytetin. Po ashtu për zejen e qelshpunuesëve, tregon edhe materialet përpunuese për ndërtimin e plisit. Zejet, përkatësisht punëtoritë e dyqanet zejtare kanë qenë të vendosuara të gjitha në një vend, ku edhe i kanë dhënë qytetit një pamje më të veçantë. Sot këto zeje e zejtarë nuk ekzistojnë më, përveç artarëve të shumtë, të vendosur prapa xhamisë Atik në qendër të qytetit, të cilët përkujtojnë se dikur kjo hapësirë ka qenë vend i zejtarëve. Këto zeje gjithashtu kanë paraqitur edhe një vlerë ekonomike dhe ambientale, respektivisht hapësinore, sepse kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik-urban dhe në strukturën e panoramën e vendit-qytetit.

Zakonet e festave pagane, si të shëngjergjit, po ashtu edhe atyre fetare si dhe ritualet e dasmave dhe të vdekjes, gjithashtu zënë vend në këtë Roman. Njëherit mund të informohemi edhe për besime e bestytini të ndryshme që kanë pasur qytetarët në atë kohë, e që disa prej tyre, por mjaft të moderuara i gjejmë të praktikohen edhe sot në familjet e këtij qyteti.

Romanet e këtilla tregojnë se kujtesa shoqërore zbulon dhe identifikon të kaluarën si mbetje e rëndësishme në jetën e njerëzve. Por, na ndihmon ta kuptojmë më mirë të sotmen dhe ta vlerësojmë të kaluarën si trashëgimi tonën jetësore e kulturore. Autori dhe romani Ligatina na ndriçojnë elementin e pashmangshëm të quajtur etnokulturë në antropologjinë modern dhe komunikimin e shkëlqyeshëm të autorit me këtë rrafsh etnokulturor.

Pierr Nora e konsideron kujtesën shoqërore si një medium tradicional për ta kuptuar të kaluarën. Në këtë rast edhe Romani “Ligatina” paraqet një medium, sepse si i tillë është në gjendje ta konsumojë bazamentin etnokulturor, të komu-nikojë, të ofrojë informata për ngjarje apo bëma të caktuara, në vende e kohë të caktuara.

Ne jemi të lidhur me kujtesën shoqërore nga ngjarjet e kaluara, të cilat mund të jenë të shprehura në momente e në forma të ndryshme, duke lexuar apo dëgjuar,

ose në përkujtime dhe në raste festive ku njerëzit mbledhen së bashku që të kujtojnë në mënyrë të përbashkët një akt solemn, heroik ose ndonjë tjetër të përmbushur nga anëtarët e një mjedisi antropologjik kulturor e të një grupi njerëzor..

Rrëfimet në këtë Roman përveç informatave, mund të shërbejnë edhe si metoda hulumtuese për etnologun. Personazhi kryesor i Romanit nëpërmjet të cilit ndërtohet e tërë ngjarja, informatat i ka mbledhur në bazë të vëzhgimit pjesëmarrës në vende të ndryshme të qytetit si: tek berberi, këpuctari, qeleshpunuesi. Vëzhgimi pjesëmarrës në Etnologjinë dhe Antropologjinë Kulturore është një prej metodave më të rëndësishme për punën hulumtuese në terren.

Romani “Ligatina”, si dhe romane të tjera të ngjashme me këtë, janë të një rëndësie të veçantë, sepse në rend të parë shfaqen si përcaktuese të kohës. Po ashtu paraqesin një material të rëndësishëm dokumentues dhe në vete përmbajnë vlerë simbolike, si ato të trashëgimisë tradicionale dhe gjithsesi vlera për shprehjen e identitetit të një komuniteti më të gjerë.

Autori në këtë roman ka potencuar diçka shumë të rëndësishme për qytetin e Gjilanit, e që as sot nuk ekziston. Në mikrolokalitet që përmend autori Ramadani, do të ishte e pritshme të jetë ndërtuar ndonjë muze, por as tash në kohën tonë kur vlerësohen lart të mirat e trashëgimisë kulturore, nuk meditohet për diçka të tillë., Qytetarët e Gjilanit, por edhe institucionet gjegjëse për trashëgimi, besojnë se nëntoka e Gjilanit me rrethinë “vlon” nga objektet, të cilat posa të shihnin dritën do të fitonin vlerë muzeale”. Këtë e potencoi autori Ramadani para më shumë së 30 viteve, ndërsa sot kujtimet për qytetin vdesin për çdo ditë. Ky roman, me vlera e karakter etnoantropologjik, edhe sot na jep një porosi shumë të qartë: *për ta ruajtur kujtesën dhe historinë e qytetit duhet punë institucionale.*

Aleksandër NOVIK

EKSPEDITAT SHKENCORE TE SHQIPTARËT E UKRAINËS: ÇËSHTJE TË ETNOLINGUISTIKËS

Etnolinguistika është një disiplinë relativisht e re në kuadrin e studimeve të njeriut dhe të botës njerëzore. Lënda kryesore e kësaj shkence ndodhet në kufi mes gjuhësisë dhe etnologjisë. Problemet e etnolinguistikës kanë të bëjnë me çështjet kryesore të shtjellimeve humane që janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Në Rusi etnolinguistika ka marrë zanafillë si shkencë e veçantë në librat e Nikita Iljiç Tollstoj-t dhe në veprat e nëpunësve dhe pasardhësve të tij (Svetlana Tollstaja, Irina Sedakova etj.). [Slavjanskije drevnosti 1; Plotnikova 1996; Plotnikova 2004; Plotnikova 2009; Sedakova 2007]. Ky kolektiv i studiuesve dhe trashëgimi i tij shkencor është njohur tani si Shkolla e etnolinguistikës e Moskës. Në artikujt dhe në librat e përfaqësuesve të kësaj shkolle si metodë studimi shfrytëzohet analiza e materialit gjuhësor dhe jo gjuhësor nga parimet dhe pozicionet e hulumtimit të tekstit.

Kjo metodikë me përpunime dhe përmirësime në teori ashtu edhe në praktikë është shfrytëzuar në projektin e Atlasit të vogël të gjuhëve ballkanike (udhëheqësi dhe kryeredaktori Andrej Sobolev) [Sobolev 1998]. Puna shkencore në terren në kuadrin e këtij projekti është zhvilluar në 13 pika të gadishullit Ballkanik (dy prej tyre në teritorin e Republikës së Shqipërisë, konkretisht në Dibrën e Vogël (Muhurr) dhe në Skrapar (Leshnjë)). Materialet etnolinguistike të këtyre hulumtimeve janë botuar në Gjermani dhe Rusi.

Vitet e fundit metodika e shkencës etnolinguistike është provuar në studimet e kulturës tradicionale të shqiptarëve të Ukrainës. Katër fshatrat me popullsinë shqiptare në jug të Ukrainës (fshati Zhovtnevoe (ish Karakurt) në rrethin e Odesës; Gamovka (ish Xhandran), Devninskoe (ish Taz) dhe Georgievka (ish Tyshki) në rrethin e Zaporozhjes) janë bazë e rëndësishme për studimet e diasporës shqiptare për kohë të gjatë. Tradita e studimeve të shqiptarëve në Perandorinë Ruse / në ish Bashkimin Sovjetik / në Ukrainën e sotme vazhdon më shumë se një shekull. Rezultatet e këtyre studimeve janë ndriçuar në veprat e lingvistëve, etnografëve, historianëve, folkloristëve, antropologëve (antropologjia fizike). Na duhet të përmendim emrat: Nikollaj Derzhavin, Julia Ivanova, Agnia Desnickaja, Irina Voronina,

Oksana Budina etj. [Derzhavin 1914; Derzhavin 1926; Derzhavin 1933; Derzhavin 1948; Desnickaja 1987; Ivanova 1981; Ivanova 1995; Ivanova 1999; Ivanova 2000; Budina 2000]. Këta shkencëtarë kanë dhënë kontribut jashtëzakonisht të vlefshëm në studimet e ruajtjes së gjuhës dhe kulturës shqiptare në Buxhak dhe Priazovje.

Ekspeditat e viteve të fundit që nga 1998 bazohen në përvojë të mësuesve tanë shkencorë. Duke u bazuar në eksperiencën e studiuesve të shquar në përpqimi të mbledhim dhe të analizojmë materialet gjuhësore dhe etnologjike me metodikën e re e cila ka të bëjë me sfidat e kohës moderne.

Kështu vitet e fundit jemi përqendruar në temat e mitologjisë së shqiptarëve të Ukrainës, me ritet e ciklit jetësor, d.m.th. me ritet e lindjes, të inicimit (p.sh. të pagëzimit, të dasmës, të vdekjes etj.). *Rites de passages* (frëngjisht, ritet e kalimit) janë lidhur ngushtë me sistemin e festave kalendarike si nga pikëpamja e organizimit të ritualeve edhe në thelbin e parafytyrimeve njerëzore. Nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë studim serioz shkencor pa marrë parasysh rolin e huazimeve në gjuhën, në traditat, në mënyrën e jetesës.

Ndër parimet tona kryesore (fjala vjen për kolektivin e ri të studiuesve) ka një pikë shumë të rëndësishme. Nuk bëjmë dallim dhe nuk analizojmë veç e veç tiparet e kulturës së ashtuquajtur shpirtërore dhe atë materiale. Ky dallim bazohet në radhë të parë në teorinë e marksizmit që ndërton kufi të pakalueshëm mes bazës dhe mbindërtimit. Në kulturën njerëzore nuk ka mundësi të ndërtohet kufi të fortë mes hapësirës materiale dhe atë shpirtërore. Nëse diçka abstrakte mund të planifikohet që nga fillimi nga njeriu dhe pastaj mund të çmohej nga individit ose shoqëria ka të drejt të konsiderohet si pjesa e botës shpirtërore. P.sh. çfarë është më shumë nga sfera shpirtërore, një pikturë e artistit të njohur ose një gozhdë hekuri në të cilën është varur kjo pikturë? Kjo çështje retorike, ka të bëjë me problemet e filozofisë. Megjithatë ne duhet të kemi parasysh lidhje të ngushta dhe të paqarta mes dukurive të ndryshme të kulturës dhe të jetës njerëzore.

Duke analizuar materialet e mbledhura në terren nuk kemi të drejtë të sistemojmë faktet etnologjike dhe të dhënat gjuhësore veç e veç duke mos bërë paralele dhe duke mos vërejtur lidhje mes realitetit dhe leksikut, mes dukurisë konkrete dhe pasqyrimin të saj në mendje dhe në reflekset psikike.

Vitet e fundit pjesëmarrësit e ekspeditave tona janë përqendruar në disa çështje të kulturës dhe të folmes së shqiptarëve të Ukrainës. Interesat kryesore janë lidhur me ruajtjen e gjuhës. Në këtë fushë materialet e pasura i kanë mbledhur Maria Morozova (përshkrimi i emrit dhe të sistemit foljor në të folmen e diasporës shqiptare), Ekaterina Averjanova (termat farefisnore ndër shqiptarët e Ukrainës dhe të Ballkanit), Natalia Biçurina (çështjet sociolinguistike), Varvara Diveeva (sistemi i mbiemrave) etj.

Problematika etnografike në përputhje me çështjet linguistike është koncentruar në studimet në terren të autorit të kësaj kumtese (çështjet e vetëdijes etnike,

ruajtja e kulturës tradicionale, mitologjia, veshjet, zejet, artizanatet ndër shqiptarët e Ukrainës). Aleksandra Dugushina merret me ritet e lindjes (tema e doktoratës së tij në Akademinë e Shkencave të Rosisë). Me ritet dasmore dhe me problemet e martesës ndër shqiptarët e Priazovjes merret Ilja Uçitel. Një kontribut të veçantë në fushën e hulumtimeve të riteve të vdekjes ka bërë Denis Ermolin. Në vitin 2011 ky shkencëtar i ri ka mbrojtur në Muzeun Kunstkamera (Akademia e Shkencave e Rosisë) doktoratën e tij kushtuar sistemit të riteve të vdekjes dhe të vajtimeve ndër shqiptarët e Buxhakut dhe të Priazovjes.

Studimet në terren dhe analiza e materialeve të incizuara na japin mundësinë të botojmë artikujt shkencorë në revista dhe përmbledhje të ndryshme artikujsh në Rusi, Gjermani, Francë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe në Kosovë dhe Shqipëri (kjo është shumë e rëndësishme për ne).

Punimet shkencore të viteve të fundit kanë të bëjnë me raportet e ndryshme të kulturës tradicionale shqiptare dhe rolin kryesor në këto hulumtime shpesh herë luajnë metodat interdisiplinare. Në studimet e përmendura më lart përshkrimi i materialeve etnologjike jepet në lidhje të ngushtë me analizën e materialit gjuhësor (në radhë të parë me leksikon, me etimologjinë, me paralelet në gjuhët e tjera të Ballkanit dhe të Evropës në përgjithësi). Kjo bëhet me një qëllim – të ndriçojmë çështjet e zanafillës, të zhvillimit dhe të transformimit si dukurive kulturore ashtu edhe ato gjuhësore. Në shumë raste rezultatet e hulumtimeve na japin vështrime të reja mbi problemet që kanë të bëjnë me historinë e popullit shqiptar dhe me mekanizmat e hyrjes së inovacioneve gjuhësore dhe kulturore në jetën e grupit etnik që është izolur për periudhë shumë të gjatë nga areali kryesor etnik.

Bibliografi

1. Budina 2000 – , . . . Научный отчет об экспедиционной работе Приазовского отряда в 1973 г. // Итоги полевых исследований / Отв. редактор З.П. Соколова. – .: этнологии и антропологии РАН, 2000. . 239-255.
2. Derzhavin (1914) – Державин, . . (1914), (Таврическая, Херсонская и Бессарабская губернии). Т. 1. *Материалы по славянской этнографии* – СБНУ XXIX. : Издательство на Бълга .
3. Derzhavin (1926) – Державин, . . (1926), // *Язык и литература*. Т. 1. Вып. 2-3. . . 171-192.
4. Derzhavin (1933) – Державин, . . (1933), *Из исследований в области албанской иммиграции на территории бывшей России и* // Сборник в чест на проф. Л. Милетич за седемдесет годиштината от рожден (1863-1933). . . 504-512.

5. Derzhavin 1948 – Державин, . . (1948), -
Приазовье Украинской ССР // Советская этнография. № 2. С. 156-169.
6. Desnickaja 1987 – Десницкая, . . (1987),
албанский язык. :: . . 204-252.
7. Ivanova 1981 – , . . (1981), *Тенденция развития этнических групп в многонациональной среде: На примере албанских поселений на юге Украины XIX – XX вв. // СЭ. 1981. № 4. . 95-107.*
8. Ivanova 1995 – , . . (1995),
взаимоотношений в Северном Приазовье и в Крыму: история и // Исследования по прикладной и неотложной этнологии. № 82. М.: ИЭА РАН.
9. Ivanova (1999) – , . . (1999),
енки устойчивости этнокультурной среды // Методы этноэкологической экспертизы / Научный .В. Степанов. – М.: ИЭА РАН. . 217-218.
10. Ivanova (2000) – , . . (2000), *Албанские села в Приазовье. Этнографические наблюдения за пятьдесят // исследований / . . . – :: этнологии и антропологии РАН. . 40-53.*
11. Plotnikova (1996) – , . . (1996), *Материалы для . . .*
12. Plotnikova (2004) – , . . (2004),
география Южной Славии. :: . 768 .
13. Plotnikova (2009) – , . . (2009), *Материалы для (Plotnikova A.A. Materijali za etnolingvisti ko prou avanje balkansko-slovenskog areala / Prevod M. Ili). - :: . 160 .*
14. Sedakova (2007) – . . (2007),
языке и культуре болгар. Родинный текст. М.: Индрик. 432 .
15. Slavjanske drevnosti 1 – .
Этнолингвистический словарь / Под ред. Н.И. Толстого. – ., 1995. . 1.
16. Sobolev 1998 – Sprachatlas Ostserbiens und Westbulgariens. Bd. I. Problemstellung, Materialien und Kommentare, Kartenanalyse / Hrsg. von A.N. Sobolev. – Marburg: Biblion Verlag, 1998. XIV. 420 S.

P emysl VINŠ

**MBRESAT NGA TROJET SHQIPTARE NË SHKRIMET E
PJESËTARËVE ÇEKË TË USHTRISË AUSTRO-HUNGAREZE
GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

Në kuadrin e kumtesës sime para një viti, në të cilën paraqita vepra çeke për shqiptarët në dy shekujt e fundit, përmenda shkurt edhe ushtarët me kombësinë çeke, që arritën në troje shqiptare me ushtrinë austro-hungareze gjatë luftës së parë botërore. Ky fakt luante një rol të madh në njohjen e shqiptarëve nga ana e çekëve. Me këtë impuls të rëndësishëm në marrëdhëniet e ndërsjella çeko-shqiptare merrem në kumtesën e sotme në mënyrë më të hollësishme për t'ju prezantuar mbresat e atyre ushtarëve nga lufta në Shqipëri dhe për të theksuar rëndësinë e përvojave të tyre për krijimin e imazhit të shqiptarëve në Çeki.

Shpërthimi i luftës së parë botërore ndodhi në kohën kur rajonet historike të Çekisë – Bohemia, Moravia dhe një pjesë e Silezisë – ishin pjesë përbërëse e Monarkisë Austro-Hungareze dhe kështu edhe burrave çekë iu desh të merrnin pjesë në fushata ushtarake që u përgatitën në shtabin e Vjenës. Kështu arritën mijëra çekë në Ballkan dhe në fund të vitit 1915 hynë në rajonet jugperëndimore të Ballkanit, ku u takuan edhe me popullsinë shqiptare. Pas fushatës së suksesshme kundër Serbisë në vitin 1915, ushtria austro-hungareze hyri në fillim të vitit 1916 edhe në territorin e Shqipërisë për të parandaluar evakuimin e ushtrisë serbe nga portet shqiptare në Korfuz. Siç dihet, këtë qëllim austro-hungarezët nuk e arritën dhe pas krijimit të frontit të Selanikut, ushtria e perandorit Franz Joseph I. pushtoi pjesën veriore dhe të mesme të Shqipërisë. Me disa ndryshime të vogla e mbajti nën kontroll deri në ofensivën e trupave të Antantës në shtator 1918. Gjatë kësaj periudhe, që zgjati përafërsisht dy vite e gjysmë, në Shqipëri vepronte një numër i madh ushtarësh me kombësi çeke. Një nga njësitë ushtarake në Shqipëri, ku mbizotëruan ushtarë çekë, ishte një regjiment këmbësorie me numrin 28 (Regjimenti i Pragës) ose regjimenti 98 nga qyteti Vysoké Mýto. Sidomos i pari vepronte në Shqipëri gjatë tërë periudhës së pushtimit të vendit nga Austro-Hungaria. Ushtarët e këtij regjimenti morën pjesë në mbrojtjen e bregdetit Adriatik dhe në luftimet kundër italianëve në zonën e lumit të Vjosës. Në atë kohë baza e tyre ndodhej në Kavajë. Në fund të prillit 1916 regjimenti mori urdhër që të transferohej në Elbasan ku qëndroi gati një vit. Pjesëtarët e tij ndihmonin me ndërtimin e rrugës strategjike në drejtimin e Frontit

Maqedonas në zonën e Liqenit të Pogradecit. Në luftimet e drejtpërdrejta u përfshin nga marsi 1917 kur Regjimenti i Pragës vepronte në zonën e Pogradecit. Atje luftoi kundër francezëve, të cilët patën nën kontroll rajonin e Korçës. Nga zona e Pogradecit u tërhoqën më në fund me trupat e tjera austro-hungareze pasi trupat e Antantës në shtator të vitit 1918 thyen frontin maqedonas. Ky ishte fillimi i tërheqjes së përgjithshme të Austro-Hungarisë nga Shqipëria dhe më gjerë nga Ballkani.¹

Prania e numrit të madh të çekëve në Shqipëri për një kohë relativisht të gjatë nuk mund të mos pasqyrohej në krijimtarinë e disa pjesëmarrësve të fushatës ushtarake në Shqipëri. Midis tyre mund të gjejmë disa personalitete të njohura nga jeta politike dhe kulturore, si p.sh. presidentin e mëvonshëm komunist Antonín Zápotocký ose poetin, gazetarin dhe përkthyesin e njohur çek **Stanislav Kostka Neumann** (1875 - 1947). Ai i kushtoi Shqipërisë librat e tij të titulluar „*Elbasani: kujtimet e luftës*“ (çekisht „*Elbasan; Válečné vzpomínky*“) dhe „*Bragozhda dhe kujtime të tjera luftarake*“ (çekisht „*Bragožda a jiné válečné vzpomínky*“). Kujtimet e Neumann-it përmbajnë përshkrime të hollësishme dhe të bukura të Elbasanit dhe të qytetarëve të tij. Shpesh del në pah dashuria e tij ndaj Shqipërisë dhe popullit të saj. Duke gjetur frymëzim në ambientin shqiptar, ai shkroi edhe një përrallë dhe disa vjersha. Neumann gjithashtu vizatoi disa akuarele që shfaqin rrugët e Elbasanit. Nga veprat e botuara, që u shkruan në bazën e përvojës personale nga qëndrimi në Shqipëri gjatë luftës së parë botërore, zënë vend të rëndësishëm ato prej ish-ushtarit **Jaroslav K enek** (1890 - 1964). Libri i tij „*Kujtimet për luftën në Shqipëri*“ (çekisht „*Vzpomínky na vojnu v Albanii*“) përshkruan jo vetëm bukuritë e natyrës shqiptare, atmosferën orientale të qyteteve si të Elbasanit dhe të Tiranës, por tregon simpatinë e autorit ndaj shqiptarëve. Në vitin 1931 shkroi „*Katër tregime shqiptare*“ (çekisht „*Čtyři albánské povídky*“) në të cilat ai lidhi përvojat e veta nga qëndrimi në Shqipëri me tregimet, që mësoi atje. Bëhet fjalë për tregime dhe përralla që kanë lidhje me gjakmarrjen, besën dhe trimërinë e shqiptarëve. Këto tregime zhvillohen në sfondin e ngjarjeve reale dhe shpesh në to flitet për personalitete historike, si p.sh. për Esat Pashë Toptanin ose për mbretin e Vidit. Nga autorët e tjerë që u frymëzuan nga qëndrimi në Shqipëri, dua ta përmend ish-ushtarin **Karel Stellner** (1873 - 1955) i cili botoi në vitin 1925 „*Përrallat e mbrëmjeve të majit*“ (çekisht „*Pohádky májových večerů*“). Edhe pse tregimet e tij janë të trilluara kanë një bazë reale. Këto tregime i shkroi për ushtarët e tjerë dhe për të birin në Çeki.

Veprat e tyre përshkruajnë fushatën ushtarake të Austro-Hungarisë në Shqipëri, por para së gjithash na shërbejnë si mjet i vlefshëm, me të cilin del në dritë mënyra e jetesës në Shqipëri para njëqind vitesh dhe pasojat e luftës së parë botërore në këtë vend. Falë këtyre librave, gjithashtu ringjallim përshtypjet e thella, me të cilat u kthyen çekët nga Shqipëria në atdhe. Ambienti i panjohur shqiptar, zakonet e

¹ Fučík, J.: Osmadvacátníci: spor o českého vojáka Velké války 1914 – 1918, f. 296-316.

shqiptarëve, kushtet e tyre ekonomike dhe kulturore si dhe natyra e egër dhe kushte të vështira klimatike të Shqipërisë kishin ndikim të madh për krijimin e imazhit të Shqipërisë dhe të shqiptarëve në Çeki.

Në rreshtat në vijim do të doja të theksoja mbresat dhe përshtypjet karakteristike që përmenden në çdo libër kushtuar qëndrimit në Shqipëri në periudhën e luftës së parë botërore.

Para shpërthimit të luftës, Shqipëria ishte pjesa më e panjohur e Evropës dhe në Çeki mungonin krejtësisht informacione për këtë vend. Kur ushtarët morën dijeni për nisjen në Shqipëri, ishin shumë kureshtarë të vizitonin një vend të tillë të panjohur. Ata përfytyronin se qëndrimi i tyre në Shqipëri do t'i ngjante më shumë një ekskursioni romantik sesa një fushatë luftarake. Qartë e tregon Jaroslav Křenek i cili kujton: *"Na dhanë mundësi për të zgjedhur – Rusi, Itali ose Shqipëri. Shumica prej nesh vendosi për Shqipërinë, ndoshta nga dëshirat romantike. Unë si adhuruasi i Detit Adriatik, e përfytyrova atë vend me tiparet më të bukura."*²

Përshtypjet e para reale zakonisht korrespondojnë me këto imagjinata. Ushtarët përshkruanin Shqipërinë si një botë tjetër me natyrën e mahnitshme, por të egër ku mungonin rrugët, urat dhe ku lëvizja ishte shumë e ngadaltë dhe e vështirë - sidomos gjatë motit të keq. Të gjithë, sikur të flisnin me zërin e përbashkët, gjetën në Shqipëri atë çfarë imagjinonin për botën orientale në Lindjen e Mesme dhe çfarë imagjinonin duke lexuar përrallat Një mijë e një net. Theksohet prania e feve të ndryshme, rrugë të ngushta të qyteteve me xhami, fytyrat e mbuluara të femrave dhe atmosfera e pazareve me mallrat që çekëve u dukeshin ekzotike. Si një surprizë e papritur shpesh përmendnin kafe dhe duhan me cilësi që ushtarët mund të blinin në çdo qytezë.

Duke u ballafaquar me furnizimin e pamjaftueshëm, me rrugët plot me baltë, me vapën në verë dhe me të ftohtën në dimër dhe sidomos me sëmundje të ndryshme, edhe ushtarët çekë shpejt kuptuan se as në Shqipëri nuk i priste asnjë përrallë. Pas disa javësh, armiku më i rrezikshëm për gjithë ushtrinë austro-hungareze në Shqipëri u bë epidemia e malaries dhe e kolerës. Këto epidemi vranë një numër më të madh të ushtarëve sesa plumbat e armikut. Kjo vlen edhe për ushtarët çekë që u infektuan nga malaria në fushat bregdetare të Adriatikut. Kur u transferuan në Elbasan, gjendja e tyre shëndetësore u përkeqësua akoma më shumë. Deri në shtator 1917 qindra ushtarësh çekë vdiqën dhe vetëm në Regjimentin e Pragës numri i ushtarëve të aftë për luftë zbriti nga 1000 në 204.³ Këto kushte të vështira pasqyroheshin natyrisht në kujtimet e ushtarëve. Pjesën e konsiderueshme të të gjithë librave të botuar e përbëjnë përshkrimet e këtyre çasteve të vështira. Përballimi i sëmundjeve, kërkimi i ushqimeve më të mira dhe ankesa në adresën e

² Křenek, J.: Vzpomínky na vojnu v Albanii; f. 11.

³ Fučík, J.: Osmadvacátníci: spor o českého vojáka Velké války 1914 – 1918, f. 304.

komandantëve ishin temat më të përhapura nga periudha e vendosjes së ushtarëve në Elbasan. Megjithëse përshtypjet e tyre u ndikuan negativisht nga këto vuajtje, shumë prej tyre krijuan lidhje të fortë me vendin, ku kalonin shumë muaj dhe ku humbën shokët e tyre. Kjo i takon sidomos Elbasanit. Në veprat e ish-ushtarëve mund të gjejmë përshkrime të hollësishme të lagjeve, të dyqaneve ku ata rregullisht shkonin. Shpesh përmendnin dhe vizatonin edhe ndërtesa konkrete si xhami, kisha, ose shtëpi të thjeshta që u lanë mbresa pozitive. Nga vepra e Neumann-it ruhen edhe sot disa akuarele në të cilat shihen rrugët e Elbasanit. Elbasanit ia kushtoi edhe vjershën me titullin Vera në Elbasan (çekisht „*Léto v Elbasanu*“)⁴ në të cilën përshkruan jetën e banorëve të tij dhe të ushtarëve në sfondin e epidemive dhe të pasojave të gjendjes së luftës.

Për sa i përket kontaktit me banorët shqiptarë, autorët e vlerësojnë si përvojë pozitive për ushtarët. Shkaku kryesor ishte pa dyshim fakti se shumica e popullatës shqiptare nuk e konsideronte ushtrinë austro-hungareze si armik dhe nuk luftonte kundër saj. Kontaktet me popullsinë lokale u intensifikuan pasi komanda e lartë e ushtrisë austro-hungareze dha urdhër që ushtarët të furnizoheshin nga burimet lokale. Kjo ishte e leverdishme edhe për palën shqiptare që përfitonte nga tregtia me ushtrinë. Në shumë kujtime përmenden probleme me pagimin, sepse tregtarët lokalë s’kishin asnjë besim ndaj monedhës austriake dhe në tregti me shumicë kërkonin pagesa në argjend ose në ar. Në kontaktin me ushtarët e thjeshtë mbizotëronte këmbimi i mallrave. Ushtarët kujtojnë se këmbenin sheqer, rum dhe vajgur për ushqime, sidomos për mish.

Gjatë periudhës disamujore të qëndrimit në Elbasan ose në qytetet e tjera të Shqipërisë së Mesme shumë çekë lidhnin kontakte miqësore me banorët vendas. Në shumicën e rasteve vlerësohej mikpritja e njerëzve të thjeshtë, edhe pse ata vetë shpesh jetonin në varfëri. Pengesa e kuptueshme në thellimin e kontakteve të ndërsjella ishte gjuha. Por burimet e botuara dëshmojnë se shumë shqiptarë dinin disa fjali serbisht ose bullgarisht, gjë që lehtësonte komunikimin edhe me ushtarët e kombësisë çeke. Nga ana tjetër, disa çekë u pasionuan kaq shumë pas shqiptarëve dhe gjuhës së tyre se me kalimin e disa muajve ishin të aftë të flisnin pak dhe të kuptonin. Një prej tyre ishte edhe autori i lartpërmendur Jaroslav Křenek. Por edhe të tjerët përmendin në ditarët e tyre të paktën disa fjalë dhe fraza të nevojshme.

Nëse ushtarët çekë hynë në Shqipëri në fillim me paragjykimet ndaj një kombi krejtësisht të panjohur, kontakti i drejtpërdrejtë me shqiptarët ndryshoi shpejt mendimet e tyre. Kjo u theksua nga fakti se shumica e çekëve nuk donte të luftonte më për monarkinë dhe për perandorinë në Vjenë. Pra, çekët i konsideruan shqiptarët si një nga viktimat e luftës. Kjo dallohet qartë p.sh. nga kujtimet e ish-ushtarit Artuš Černík i cili shkruan: *"Për shqiptarët flitet si për një komb primitiv, por kjo luftë*

⁴ Neumann, S. K.: Elbasan, válečné vzpomínky, f. 92.

*tregon qartë kush është primitivi i vërtetë. Nga ana e këtij populli gjithmonë morëm mikpritjen e ngrohtë.*⁵ Këto mendime s'ishin të rralla dhe Neumann në një vjershë shprehu keqardhje dhe kërkoi falje për faktin se ai kishte marrë pjesë në pushtimin e Shqipërisë.

Ndërsa çekët në përgjithësi ndjenë simpati ndaj shqiptarëve, nuk vlerësonin lart trupat e mercenarëve shqiptarë të cilat mbështetnin operacionet luftarake të ushtrisë austro-hungareze. Shpjegimet e ushtarëve theksonin se këto trupa luftonin në anën e atij, i cili u jepte më shumë para. Trupa të tilla, sipas shumë dëshmimeve, u larguan menjëherë nga lufta, pasi armiku përdori artileri.

Edhe pse lufta në Shqipëri u zhvillua në kushte shumë të vështira dhe u solli ushtarëve vuajtje të dukshme, vlerësimet e shkruara pas kthimit në Çeki humbnin gradualisht karakterin negativ. Me kalimin e kohës mbizotëronin ndjenja nostalgjie për atë vend të largët, të egër, por njëkohësisht të bukur me njerëzit të varfër, por të mirë. Shembulli tipik i këtij vlerësimi është vjersha e Neumann-it me titullin Përsëritje dhe kujtime (çekisht „*Pozdrav a vzpomínky*“).⁶ Nga njëra anë përsërit vuajtje të përjetuara, por nga ana tjetër shkruan për Shqipërinë duke përdorur shprehje si: „*përralla e largët*“, „*vendi i ëndrrave të thella*“, „*pëshpëritjet e lumit të Shkumbinit*“, „*Tirana si princesha e bukur*“, „...*kujtime kalojnë si njerëz në pazar*“, „*Elbasan – vendi i trishtimeve të gjata dhe i gëzimeve të shkurtra*“.⁷

Qëndrimin e ushtarëve çekë në kuadrin e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri mund ta karakterizojmë si momentin e parë kur pjesëtarët e të dyja kombeve takoheshin në mënyrë intensive për një periudhë relativisht të gjatë. Përshtypjet e tyre kishin ndikim të rëndësishëm për krijimin e imazhit të shqiptarëve në Çeki. Pas përfundimit të luftës dhe pas krijimit të shtetit çekoslovak u morën me Shqipërinë dhe me kulturën shqiptare pikërisht ata ish-pjesëtarë të ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri. Në vitin 1922 u themelua në Pragë Shoqata çekoslovakoshqiptare, anëtarët e së cilës ishin përveç të tjerëve edhe J. Křenek dhe S. K. Neumann.

⁵ Černík, A.; Červený, V.; Jirout, J.; Kuchař, K.; Matoušek, J., Neumann, S. K.; Vinař, J.; Vokáč, L.: *Albanie: Úvahy o postavení Albanie ve světě, o jejích dějinách a zemi, o albánské politice, národním hospodářství a albánské kultuře*; f. 129.

⁶ Neumann, S. K.: *Válčení civilistovo, Elbasan, Bragožda a jiné válečné vzpomínky*; f. 125-127.

⁷ Po aty.

Bibliografie

1. Černík, Artuš; Červený, Václav; Jirout, Josef; Kuchař, Karel; Matoušek, Josef, Neumann, Stanislav, K.; Vinař, Josef; Vokáč, Lev (1938), *Albanie: Úvahy o postavení Albanie ve světě, o jejích dějinách a zemi, o albánské politice, národním hospodářství a albánské kultuře*; Praha.
2. Fučík, Josef (2006), *Osmadvacátníci: spor o českého vojáka Velké války 1914 – 1918*, Praha.
3. Hradečný, Pavel (2008), Hladký, Ladislav: *Dějiny Albánie*; Praha.
4. Kadlec, Josef, M (1927), *Diplomatické dějiny Albánie*; Praha.
5. Klaus, Alois (1914), *O Albánii. Cesta do Albánie*; Nymburk.
6. Křenek, Jaroslav, *Čtyři albánské povídky: Zlatá studně, Mejrem, Matka Thasů, Lujó-Goci* ; Praha 1931-1935.
7. Křenek, Jaroslav (1924), *Vzpomínky na vojnu v Albanii*; Jihlava.
8. Neumann, Stanislav, K (1928), *Bragožda a jiné válečné vzpomínky*, Praha .
9. Neumann, Stanislav K (1928), *Elbasan, válečné vzpomínky*, Praha 1922.
10. Neumann, Stanislav, K (1976), *Válčení civilistovo, Elbasan, Bragožda a jiné válečné vzpomínky*; Praha.
11. Neumann, Stanislav K (1925), *Válčení civilistovo*, Vyškov.
12. Stellner, Karel (1925), *Pohádky májových večerů*, Praha.

Ewa BEKTESHI

STEREOTIPI I SHQIPTARIT NË OPINIONIN PUBLIK POLAK

Tema e referimit tim është stereotipi i shqiptarit në opinionin publik në Poloni. Në hyrje do të doja të theksoja se, të dhënat të cilat disponoj si dhe materialet, mbi bazën e të cilave përgatita këtë referim, vijnë nga arkivat e shtypit të revistave kryesore polake, gazetave si dhe faqeve të internetit të radiove dhe televizioneve. Gjithashtu dua të them se komentet e cituara nga unë për shqiptarët, jo gjithmonë pasqyrojnë opinionin tim.

Në fillim do të doja të theksoja faktin se në shtypin polak nuk flitet shumë për shqiptarët, pra kultura dhe zakonet e tyre nuk janë shumë të njohura për polakun e thjeshtë. Për Shqipërinë dhe Kosovën dimë në Poloni që është një rajon shumë i varfër, me tradita islame krejtësisht të panjohura për ne, të cilat lejojnë për shembull gjakmarrjen. Për shumë polakë, niveli i diturisë për këto vende është ndalur pak a shumë në epokën e komunizmit dhe problemeve të tranzicionit të viteve 90-të. Kësaj i shtohen edhe stereotipet për mafien shqiptare dhe ata dhjetëra mijëra emigrantë që punojnë në Itali dhe Greqi. Pra Shqipëria dhe Kosova janë në sytë tanë simbol i prapambetjes totale, varfërisë dhe kriminalitetit, të cilat në mënyrë të çuditshme u gjenden në kufijtë e Evropës, megjithëse nuk i përshtaten aspak për sa i përket kulturës dhe civilizimit¹. Ia vlen të theksohet fakti që edhe në Qeveri punojnë persona, të cilët për fat të keq e ushqejnë një stereotip kaq të cunguar dhe le ta themi hapur, këtë tablo primitive për Shqipërinë dhe Kosovën. Konferenca e shumë-përfolur e kryeministrit Donald Tusk me hartën e Evropës prapa, ku Polonia, si i vetmi vend u shënua me ngjyrë të gjelbër, që tregonte rritje ekonomike (GDP), ka mbetur në ndërgjegjen e opinionit publik polak. Fjalimin e tij Kryeministri e mbështeti në të dhënat e vendeve të tjera dhe mbi këtë bazë tregoi se ekonomia polake prosperon më mirë. Për fat të keq, njerëzit e stafit të tij nuk e përmendën asnjëherë Shqipërinë, e cila kishte rritje ekonomike më të madhe, prandaj kryeministri Tusk tha se nuk ka të dhëna për këtë vend². Opozita menjëherë filloi të sulmojë punonjësit e kancelarisë së tij. U publikuan disa artikuj interesantë që treguan se çfarë fshihej

¹ Aleksander Kaczorowski, „Coraz bliżej Europy”, Gazeta Wyborcza, 10.01.2006

² Leszek Baj, Agata Nowakowska, „Jeszcze polska (gospodarka) nie zginęła”, Rzeczpospolita, 30.05.2009

pas shprehjes „mungojnë të dhënat” të përdorur nga stafi i kryeministrit Tusk. Gazetarët, nën sugjerimet e opozitës, analizuan situatën ekonomike të Shqipërisë dhe treguan se ky vend, në dekadën e fundit kishte treguesit më të lartë të rritjes ekonomike në të gjithë Ballkanin Perëndimor, mesatarisht 5-6% në vit (deri në vitin 2008)³. Shkruajtën gjithashtu se Shqipëria ka shumë për të ofruar në sektorë të rëndësishëm si energjetika, turizmi, industria minerale, tekstilet dhe bujqësia, ndërsa numri i papunësisë bie gradualisht që nga viti 2002, duke shkuar 13,3% në vitin 2007. Polakët patën rastin të dëgjonin edhe për rënien e numrit të të punësuarve në sektorin publik si pasojë e reformave sistematike në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe si rrjedhojë e privatizimit të sektorëve të ndryshëm, për shembull Banka Tregtare Shqiptare⁴. Mediet polake pyetën nëse punonjësit e kancelarisë së kryeministrit Tusk me të vërtetë nuk patën mundësi të gjenin asnjë informacion për Shqipërinë apo qëllimisht nuk përmenden asgjë për ndryshimet që ndodhën në këtë vend. Faktet janë shumë të habitshme: Shqipëria është lidere e ndryshimeve ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu opozita e akuzoi Kryeministrin për injorancë, sepse siç dihet, prej disa kohësh, Shqipëria është aleati ynë, anëtare e NATO-s dhe të paktën për këtë arsye duhet të interesohemi për këtë vend. Prandaj thënia se për Shqipërinë nuk ka të dhëna sipas opozitës që një gabim i madh. Falë kësaj gafe mund të vërejmë se edhe në politikën polake nuk ka një tablo të njëjtë për Shqipërinë, disa e shikojnë atë si një rajon për të cilin nuk ia vlen të flasësh, por disa të tjerë mendojnë ndryshe, shikojnë aty një potencial që nuk duhet nënvlerësuar.

E nëse në politikën polake nuk ka një tablo të njëjtë për shqiptarët a mund të pretendojmë që 40 milionë polakë të kenë të njëjtin mendim për shqiptarët? Sigurisht që jo, prandaj nuk çudit fakti që në shtypin polak publikohen artikuj që i paraqesin banorët e Shqipërisë dhe Kosovës si katundarë të prapambetur dhe të varfër, por ka edhe nga ata ku lavdërohen banorët e këtij rajoni për njohjen shumë të mirë të gjuhëve të huaja, kulturën personale dhe dashamirësinë. I përsëritur shpeshherë në mediat polake stereotipi i shqiptarit gangster është rezultat i mungesës së diturisë ose i qëllimeve dashakeqëse. Duhet parë ai në kontekstin e portretit të thjeshtësuar të këtij kombi, i cili funksionon në mediet polake dhe që nuk ka shumë gjëra të përbashkëta me realitetin e komplikuar të shoqërisë shqiptare. Autorët e artikujve për mafien shqiptare e shpjegojnë shpesh forcën e saj me karakterin arkaik të strukturave shoqërore në Shqipëri dhe Kosovë. Ata theksojnë se shqiptarët jetojnë në klane që veprojnë sipas zakoneve të Kanunit. Shumë i rëndësishëm për kundërshtarët e shqiptarëve është aspekti moral, trafiku i njerëzve dhe narkotikëve duhet dënuar, prandaj nuk mund të mendojmë mirë për ata që merren me këto gjëra. Në imazhin negativ të shqiptarëve dominojnë tri koncepte karakteristike për porter-

³ Tomasz Bielecki, „Bałkański Tygrys”, Gazeta Wyborcza, 13.07.2009

⁴ si më lart

tin e vendit të tyre: prapambetja, ekzotika dhe izolimi. Dëshpërimi i emigrantëve që kërkojnë punë shpesh identifikohet me mungesë morali dhe skrupujsh⁵.

Por do të doja të theksoja faktin se në mediet polake prej disa vitesh gjithnjë e më shpesh po shfaqen artikuj shtypi dhe programe televizive që promovojnë Shqipërinë dhe Kosovën. Autorët e këtyre publikimeve si argument japin faktin se prej më se 10 vjetësh shoqëria shqiptare është nën ndikimin e ndryshimeve të thella shoqërore, si urbanizimi në shkallë të madhe, emancipimi i grave dhe rinisë. Ia vlen të kujtohet, siç theksojnë gazetarët, se grupet mafioze shqiptare numërojnë me qindra persona, por janë miliona shqiptarë që merren me punë të zakonshme dhe jo trafik heroine⁶. Autorët theksojnë gjithashtu se strukturat e krimit të organizuar në Ballkan janë më të forta në Kosovë, por vetëm për arsyen se ndërtimi i strukturave shtetërore filloi më vonë se në çdo vend tjetër të rajonit. Vihet re përmirësimi i situatës në Kosovë dhe besohet se bashkë me forcimin e institucioneve shtetërore do të dobësohen ndikimet e mafies. Përmirësimin e situatës e vërtetuan edhe statistikat e policisë kosovare (rënia e vazhdueshme e numrit të vrasjeve) në 12 muajt e fundit⁷.

Artikujt e shtypit dhe debatet e politikanëve në medie nuk pasqyrojnë mendimin e polakut të thjeshtë, por me siguri formojnë opinionin që shprehin masat. Mbi bazën e sondazheve të ndryshme të bëra nga stacionet televizive dhe portalet e internetit, Instituti Polak për Studimin e Opinioneve Publik arriti në përfundimin se pyetjes „Cili është mendimi yt për shqiptarët” 39% e të anketuarve iu përgjigj se nuk e di ku është Shqipëria, nuk kishte mendim për statusin e Kosovës (para pavarësisë) dhe nuk kishte dëgjuar asgjë për banorët e këtyre shteteve. 41% tha se shqiptarët janë hajdutë dhe pjesëtarë të mafias që merren me trafik narkotikësh dhe njerëzish, ndërsa 20% e të anketuarve u shprehën në mënyrë shumë pozitive për banorët e Shqipërisë dhe Kosovës, duke i quajtur njerëz të arsimuar, me kulturë dhe të gatshëm të ndihmojnë⁸.

Duke marrë parasysh faktin që shumica e artikujve vitet e fundit mund të konsiderohen si pozitivë për portretin e shqiptarëve, ia vlen të mendohemi nëse këto statistika paraqesin realitetin e vërtetë. Për këtë qëllim vizitova disa forume interneti për të lexuar përshtypjet e polakëve për kontaktet me shqiptarët gjatë udhëtimeve të tyre nëpër Evropë. Me keqardhje duhet të them se nëse diskutimet e gazetarëve mbështeten mbi argumente konkrete, diskutimi në forume lë shumë për të dëshiruar. Megjithatë arrita në përfundimin se gjatë viteve 2004-2008 shumica dërrmuese e diskutuesve përdorte sillogane të tipit: atje (në Shqipëri dhe Kosovë) nuk ka rrugë, të gjithë vrapojnë me kallashnikovë nëpër rrugë dhe grabisin të huajt, e nëse shkon me

⁵ Anna Słojewska, „Ostrożne otwieranie granic”, Rzeczpospolita, 10.11.2010

⁶ Dominika Cosić, „Albania, mały kraj wielkich nadziei”, Wprost, nr 37/2010

⁷ Marta Gmiter, „Kosowo wciąż nie jest samodzielne”, Rzeczpospolita, 15.02.2012
⁸<http://www.rp.pl/artukul/56780.html?print=tak> (hyra në korrik 2012)

pushime atëherë kthehesh vetëm me të mbathura, sepse pas disa orësh të vjedhin gjithçka. Njerëz që nuk kishin qenë asnjëherë në Shqipëri dhe Kosovë shkruanin se nëpër rrugë ecnin vetëm mercedesë të vjedhur, mafia bën ligjin, Shqipëria dhe Kosova janë pika për kalimin e drogës, prostitutave dhe emigrantëve në Evropën Perëndimore, provinca është e minuar, çdo banor ka armë. Gjithçka duket si në Poloni para 20 vitesh, pra nuk ka dyqane, e nëse janë, aty nuk mund të blesh asgjë, nuk ke çfarë të vizitosh, pra përse të shkosh në Shqipëri dhe Kosovë kur në atë rajon sundon uria dhe varfëria. Këto janë vetëm disa nga citatet ku shqiptarët shfaqen si njerëz krejtësisht të prapambetur⁹.

Por me kënaqësi mund të them se këto shkrime janë vetëm një pjesë e forumeve shumëfaqëshe. Duke parë komentet vura re se gradualisht, nga viti 2008, shfaqen gjithnjë e më shumë opinione pozitive për shqiptarët. Në forume mund të lexojmë se ata janë njerëz shumë simpatikë, të hapur dhe miqësorë ndaj të huajve, komb shumë mikpritës dhe që ndihmon njerëzit nga vende të tjera, e shohin jetën me optimizëm, të gatshëm për punë dhe tregti. Gjithashtu gjeta një koment se shqiptarët janë shumë të lidhur me kulturën e tyre, të cilën e kultivojnë dhe ruajnë lidhjet familjare e kombëtare¹⁰. Nga viti 2011 ka gjithnjë e më shumë komente për Kosovën. Do të lexoj një nga ato, i cili më pëlqeu shumë: "Të gjitha përfytyrimet tona për këtë shtet mbi bazën e stereotipeve u rrëzuan. Thuhet se është një nga shtetet më të varfra të Evropës, por në këtë varfëri nuk e pamë gjatë udhëtimit tonë. Kudo shtëpi të bukura me mure, shumë duke u ndërtuar. Nuk takuam të varfër duke lypur siç na ndodhi në Rumani, Bullgari apo Maqedoni. Rrugët në gjendje të mirë, madje edhe ato malore si dhe shpirti tregtar i njerëzve që shihej në çdo hap, edhe më shumë hodhën poshtë përfytyrimet tona të gabuara për prapambetjen e këtij vendi."¹¹

Duke përmbledhur të gjitha këto do të doja të theksoja se në Poloni kur flitet për stereotipin e shqiptarit kemi të bëjmë me portretin zyrtar të krijuar nga opinioni publik, ku nga njëra anë flitet për mafien shqiptare dhe prapambetjen në fshatra ku mungon drita elektrike dhe uji i pijshëm, ndërsa nga ana tjetër flitet për ekonominë që prosperon gjithnjë e më mirë, për shumë shqiptarë të rinj dhe të arsimuar dhe për turizmin që ecën përpara. Njëkohësisht në forumet e internetit dhe në banesat private zhvillohet debati jozyrtar, në të cilin marrin pjesë polakët e thjeshtë, që në shumicën e rasteve nuk ia kanë idenë për çfarë flasin. Meqë sipas anketave 39% e banorëve të vendit tim nuk e di se ku ndodhet Shqipëria, atëherë ata nuk mund të flasin për shqiptarët. Një pjesë e madhe e polakëve përsërit pa pushim opinionet për trafik njerëzish dhe varfëri që shihet kudo. Megjithatë gjithnjë e më shumë persona vendosin të kalojnë pushimet në këtë rajon dhe vizitorët e Shqipërisë e Kosovës jo vetëm kthehen në Poloni pa asnjë dëmtim trupor apo traumë psikologjike, por edhe

⁹ <http://forum.gazeta.pl/forumSearch.do?&query=albanzcycy> (hyra në korrik 2012)

¹⁰ <http://forum.gazeta.pl/forumSearch.do?&query=turystyka+albania> (hyra në korrik 2012)

¹¹ <http://forum.gazeta.pl/forumSearch.do?&query=kosowo> (hyra në korrik 2012)

me kujtime shumë të bukura e dëshirën për t'u rikthyer. Pikërisht këta njerëz që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me shqiptarët, po bëjnë që stereotipi i gangsterit analfabet dalngadalë po zhduket dhe po zëvendësohet me portretin e njeriut mikpritës, i cili është i lidhur me kulturën dhe traditën e tij. Siç shihet bota po ndryshon, mentaliteti po ndryshon dhe ajo, që dikur ishte temë tabu, diçka që nuk mund të akceptohej, tani ngadalë po depërton në ndërgjegje dhe çudit gjithnjë e më pak. Nuk mbetet asgjë tjetër veç të presim momentin kur në Poloni do të ndryshojë stereotipi për shqiptarët, që në të ardhmen e rëndësishme për ne do të jetë ajo çfarë përfaqësojnë njerëzit, çfarë personaliteti kanë, çfarë vlerash paraqesin dhe jo se nga çfarë shteti vijnë.

Bibliografia

1. Leszek, Baj, Agata, Nowakowska (30.05.2009), *Jeszcze polska (gospodarka) nie zginęła*, Rzeczpospolita.
2. Tomasz, Bielecki (13.VII. 2009), *Balkański Tygrys*, Gazeta Wyborcza.
3. Tomasz ,Bielecki (26.01.2011), *Podejrzany premier Kosowa*, Gazeta Wyborcza.
4. Dominika, Cosi (2010), *Albania, mały kraj wielkich nadziei*, Wprost, nr 37.
5. Marta, Gmiter (15.02.2012), *Kosowo wciąż nie jest samodzielne*, Rzeczpospolita.
6. Aleksander, Kaczorowski (10.01.2006), *Coraz bliżej Europy*”, Gazeta Wyborcza.
7. Polska Agencja Prasowa (15.06.2011), *Niech NATO się nie dzieli*, Gazeta Wyborcza, 15.06.2011
8. Anna Słojewska (10.11.2010), *Ostrożne otwieranie granic*, Rzeczpospolita.
9. <http://www.rp.pl/artukul/56780.html?print=tak> (hyra në korrik 2012)
10. Forume interneti:
<http://www.gazeta.pl/forum>
<http://www.kafeteria.pl>
<http://www.portalwiedzy.pl>
<http://www.wyborcza.pl>

Artur ST PLEWSKI

ALBANIA IN THE EYES OF POLISH TRAVELERS OF THE XIXTH CENTURY

The nineteenth century in European culture is a time of the great interest of the past, finding the roots of their own people, but also finding what unites Europe culturally. Traveling and collecting of any relics was an important element of life for many people, who formed the basis of modern science. Many of their theories evoke smile today, even if we still can not clearly give a scientific explanation. These theories often corresponded to the political or social needs, or as far as the linguistics, were the product of common sense or folk etymology.

Aleksander Jabłonowski (1829 – 1919) - Polish traveler and ethnographer - during his journey through the Balkans, he was also in the Albanian areas. His information about the Albanians and their culture, physical characteristics, religions is one of the first in the Polish ethnography and linguistics. His memoirs called *Albania. memoirs and essays* have been written in Preweza and published in the Polish journal *Ateneum* in 1879.

He described the Albanians as a simple people, smiling, full of joy of life, but also very brave. Albanians were for Jablonowski a big surprise, "the latest discovery of modern Europe", unknown people who lived in isolation for two thousand years, preserving the old legends, customs and language. His description of the Albanians, but also of other Balkan peoples, alikes the typical description of the Other / Foreign as in Jean-Jacques Rousseau works. Albanians therefore are raised by nature, they live according to its cycles. In contrast to savage character in the European Enlightenment and Romanticism Albanians are a nation of great cultural traditions, which are forgotten by Europe. Jablonowski assumes that by learning about the Albanian culture, once will learn the ancient past. The Albanian language was to him what was for Indo-european studies Sanskrit and Lithuanian - treasure of knowledge about the life of ancient Europeans and beginning of their intellectual and material culture. Classical education, of course, gave knowledge (much better than today), that the Greeks were late arrivals in the Balkans. Before them Illyrians and Pelazgians lived here. It was therefore likely that many elements of social culture and unclear Greek words are autochthonous and inherited. If Pelazgians were

able to pass the word to the Greeks, they could also pass the elements of their own religion.

The Pelazgians, enigmatic and lost people, were and still are an important key to the history of the Balkans. Lost or maybe not. In the nineteenth century, when modern European nations formed, an important foundation for their identity was historical or mythical ancestor. When Jablonowski was in Albania, important texts for the Albanian national ideology are printed. Polish researcher had certainly known Naum Veqilharxhi, Pashko Vasa and Abdyl Frashëri publications about the relationship between Pelazgians and modern Albanians. National myth that was needed for Albanians to show their national roots, was also directed against the theories of the cultural domination of Greece. Polish science in the nineteenth century was not particularly interested in the Greek struggle for an independent state. Interest of the Poles, who were themselves subordinate nation, were closer to Turkey and the small Balkan nations. This is probably the way to explication, why so easy accepted Jablonowski the Pelazgian theory.

I'd like to focus my presentation only on Pelazgian roots of the names of Greek gods. Most of those have elements of Pelazgian language, which one can find also in modern Albanian or only in one of the dialects.

Giovanna NANJI

DRITË QË VJEN NGA HUMNERA: ANALIZA E PËRKTHIMIT NË ITALISHTE TË DITARIT DHE TË VJERSHAVE TË DRITA ÇOMOS

Në kuadrin e studimeve të mia për doktoraturën në fushën e traduktologjisë, u mora me redaktimin e përkthimit në italishte të veprës shqipe *Dritë që vjen nga humnera*¹. Bëhet fjalë për ditarin me vjersha të Drita Çomos, e bija e Liri Belishovës, e cila u nda nga jeta në moshën 23-vjeçare, për shkak të një sëmundjeje të pashërueshme, zhvillimin e së cilës vajza e talentuar për shkrimin letrar e përshkruan në mënyrë prekëse në shënimet e saj personale, të cilat u mbledhën nga e ëma pas vdekjes së saj, në vitin 1981, dhe u botuan nga shtëpia botuese “Onufri” në Tiranë në vitin 1997 (edicioni i dytë dhe i tretë dolën përkatësisht më 2001 dhe 2004, nga e njëjta shtëpi botuese), me parathënien e Ismail Kadaresë². Shkrimtari i madh interesohet për talentin letrar të autores së re me fat tragjik dhe, siç shpjegon në një intervistë të lëshuar në rastin e hedhjes në qarkullim të librit në Francë, u angazhua për botimin e shënimeve dhe të vjershave të saj: “Libri i Drita Çomos përbën një befasi për lexuesin francez. E kanë krahasuar me “Ditarin” e famshëm të Ana Frankut dhe në disa aspekte me “Pavijonin e kancerozëve” të Sollzhenicit. [...] Libri i Drita Çomos është i rëndësishëm, jo vetëm se dëshmon për talentin e një autoreje me fat tragjik, por tregon ç’finesë dhe ç’pasuri shpirtërore mund të fshihte

¹ D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 1997, (2001, 2004). Në këtë shkrim i referohem edicionit të vitit 2004.

² “Fletoret dhe blloqet ishin në shtëpi, por unë nuk i lexoja për të respektuar intimitetin e saj. Ajo vetë më ka lexuar poezitë ose ndonjë pjesë të ditarit. E kam lexuar ditarin pas vdekjes së saj. Atëherë as që mund të mendoja për botimin e tij. Ditari u botua më në fund nga shtëpia botuese “Onufri” në 1997, në sajë të interesimit direkt të Ismail dhe Elena Kadaresë. Pas përmbysjes së diktaturës, pasi ishim kthyer në Tiranë bashkë me tim shoq, Maqo Çomon, i bëmë një vizitë Ismail Kadaresë. Gati që në fillim të bisedës ai më tha se e dinte fatkeqësinë e madhe që na kishte ndodhur, sepse për time bijë, Dritën, i kishte folur aktorja Rajmonda Bulku (ishin shoqe të ngushta kur mësonin në gjimnazin e Cërrikut), se dinte që ajo shkruante poezi... Kur i thashë se Drita kishte lënë një ditar, ku ka shkruar edhe poezitë, ai më kërkoi t’i lexonte. Ia çova pas 2-3 ditësh dhe të nesërmen më mori në telefon. E kishte lexuar, si i thonë me një frymë, ishte emocionuar dhe më tha se ai ditar duhej botuar patjetër. Ai u kujdes për gjithçka, për shtëpinë botuese, siguroi sponsorizimin, formuloi titullin kaq të goditur, sugjestionues dhe kryesorja shkroi parathënien që dini.” Kështu tregon zonja Liri Belishova gjatë intervistës me gazetaren Elsa Demo, “Të lindësh me biografi ‘të mallkuar’”, *Shekulli*, 11 korrik 2004, f. 19.

një vajzë shqiptare në një vend që dukej i ngrirë e i mbaruar. Për sytë e lexuesit perëndimor ky është një tjetër befasim”.³

Historia e dhimbshme e Dritës, e shndërruar në emblemën tragjike të fatit të shumë vajzave të tjera që përjetuan dënimin i pamëshirshëm të internimit nga ana e regjimit komunist, i dha Kadaresë frymëzimin për një roman të ri, kushtuar “vajzave shqiptare, që lindën, u rritën dhe u vajzëruan në internim”, siç lexojmë në kushtimin e librit. Bëhet fjalë për romanin *E Penguara, Requiem për Linda B.*, që u shkrua midis Malit të Robit dhe Parisit, gjatë verës dhe dimrit 2008-2009 dhe u botua nga Onufri, në Tiranë, në vitin 2009.⁴

Disa pasazhe nga ditari i Dritës u përfshin edhe në antologjinë e përgatitur nga Ardian Klosi dhe Elsa Demo, e cila përmbledh 28 autorë që shkruajnë për ngjarjet dhe përvojat personale në Shqipëri gjatë periudhës midis mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe përmbyesjes së diktaturës komuniste (1944-1991).⁵

Ditari dhe vjershat e Drita Çomos u përkthyen në gjuhën italiane nga zonja Klara Kodra dhe u botuan në fillimin e vitit 2012 nga shtëpia botuese italiane, “Rubbettino”, me titullin *Luce che sgorga dall’abisso*.⁶ Disa vite më parë, ato ishin përkthyer edhe në gjuhën frënge, nga Edmond Tupja dhe ishin botuar në Paris, në serinë “Lettres albanaises” (Letërsia shqipe) – e drejtuar nga vetë Kadareja – të shtëpisë botuese “Editions du Rocher”, e cila tregon një interes të veçantë për dëshmitë që vijnë nga shkrimtarët që kanë përjetuar tmerret e internimeve dhe të dënimeve në perandorinë ish-komuniste, siç ishte ajo e Hoxhës.⁷

Dritë që vjen nga humnera është një vepër e veçantë, që nuk u lind nga një projekt i mirëfilltë letrar, pasi autorja nuk kishte aspak qëllimin e botimit, por buroi nga shpirti i trazuar i një vajze, e cila jetoi ekzistencën e saj tepër të shkurtër nën kërcënimin e pashmangshëm të atyre që Kadareja, në parathënien e librit, emërton si “dy nga përbindëshat më të zezë të kohës: diktatura dhe kanceri”.⁸

E fuqishme dhe e mprehtë është përshtkrimi i ditarit nga ana e nënës së autores së ndjerë: “Dua t’ju kujtoj se ditarin e Dritës e kanë quajtur “Ditari i Ana Frankut shqiptar”. Ditari i Ana Frankut është akuza ndaj mizorisë naziste mbi bazën e urrejtjes raciale për hebrenjtë. Ditari i Dritës është akuza ndaj skafandrit të egër komunist mbi bazën e urrejtjes ideologjike e klasore, një lloj tjetër racizmi. Ky ditar

³ Ilda Lumani, “Ismail Kadare, vdekja e një poeteje si Drita Çomo, tragjedi”, postuar më 06.04.2010 në <http://botimetshqiptare.wordpress.com/2010/04/06/ismail-kadare-vdekja-e-nje-poeteje-si-drita-como-tragjedi/> (01.10.2012)

⁴ I. Kadare, *E Penguara, Requiem për Linda B.*, Onufri, Tiranë, 2009.

⁵ A. Klosi, E. Demo, *Shqipëria kujton, 1944-1991*, K&B, Tiranë, 2009, f. 301-314.

⁶ D. Çomo, *Luce che sgorga dall’abisso*, Prefazione di I. Kadare, Rubbettino, Catanzaro, 2012.

⁷ D. Çomo, *Cette lueur qui monte de l’abîme*, Préface de Ismaïl Kadaré, Edition du Rocher, Paris, 2004.

⁸ D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004, f. 8.

nuk është vetëm tragjedia e një vajze, por një dëshmi e mijëra të rinjve me prindër ose të afërm të dënuar. Kjo ka qenë ana më mizore e diktaturës komuniste. Sa të rinj e të reja e kaluan jetën në qendrat e internimit, u privuan nga e drejta e studimit në shkollat e larta, nuk mundën të martohen ose u ndanë nga bashkëshortët e tyre. Dhe sa të tjerë u futën në burgje. A mundet ta kuptojnë vallë të rinjtë e vendeve demokratike se ç'ishte *biografia*, që ua nxu jetën të rinjve shqiptarë?⁹

Drita u lind më 19 mars 1958 në Tiranë. Është e bija e Liri Belishovës, një nga gratë më të fuqishme në piramidën e Partisë, si anëtare e Byrosë Politike dhe si sekretare e Komitetit Qendror, dhe e Maqo Çomos, Ministrit të Bujqësisë. Në vitin 1960 prindërit e saj u dënuan si “revizionistë”, “armiqtë e Partisë dhe të Popullit” dhe për 30 vjet u persekutuan egërsisht në burgje dhe në internime nga diktatura komuniste. Kur prindërit u dënuan, Drita ishte vetëm dyvjeçare dhe fillimisht e ndoqi nënën në internim, në rajonin e Gjirokastrës. Së shpejti u kujdesën për të dhe për vëllanë e saj, Petritin, dajat e tyre, Agron Belishova, në Lezhë dhe më pas Fiqir Belishova, në Elbasan. Kur e ëma u transferua në Cërrik, afër Elbasanit, më në fund fëmijët iu bashkuan nënës. Në moshën 18-vjeçare, Drita u prek nga sëmundja e pashërueshme që ia hoqi mundësinë që të kryente gjimnazin dhe që ia kufizoi tmerrësisht jetën e shkurtër që i mbeti. Për ngjarjet dhe mbresat e saj gjatë sëmundjes, ajo shkruan në ditarin e saj, në të cilin shprehen hapur ndjenjat personale më intime, ndërsa mendimet që kanë të bëjnë me diktaturën e Enver Hoxhës mbeten të përmbajtura dhe të fshehura, për t’u shmangur dënimit të regjimit. Drita filloi shërimin në sanatoriumin e qytetit të Elbasanit dhe e vazhdoi pastaj në spitalin onkologjik të Tiranës. Kështu filluan udhëtimet e saj të shpeshta për në Tiranë dhe trenat e mjerueshëm shqiptarë u bënë skenari i episodeve më interesante të përditshmërisë së Dritës. Ajo ishte shumë e bukur dhe tërhiqte gjithmonë vëmendjen e djemve, prandaj në çdo udhëtim përjetonte ndonjë histori të vogël, e cila, megjithatë, asnjëherë nuk kishte vazhdim, sepse statusi politik i familjes së saj i frikësonte të tjerët dhe i mbante larg. Megjithatë, Drita u përpoq të jetonte sa më shumë një jetë normale: mësonte gjuhë të huaja, lexonte libra, dëgjonte muzikë, dhe sidomos jepej pas poezisë dhe mbante një ditar. Përkufizimet e jetës së dukshme kompensoheshin nga liria dhe thellësia e jetës së saj të brendshme, të begatshme dhe plot me vullnet. Me karakterin e saj komunikues dhe me prirjen e saj për t’u shoqëruar me njerëzit, Drita kalonte çaste të këndshme madje edhe gjatë shtrimeve në spital bashkë me pacientët e tjerë, me të cilët lidhte shpejt marrëdhënie miqësie, duke përballuar në këtë mënyrë vetminë që i vinte nga largësia e familjes së dënuar ashpër nga diktatura. Edhe pse Drita ishte e vetëdijshme për gjendjen e saj shëndetësore, që e çonte te vdekja dhe vuante thellësisht për fatin e zi të prindërve, shënimet në ditarin

⁹ Nga intervista me gazetaren Elsa Demo, “Të lindësh me biografi ‘të mallkuar’”, *Shekulli*, 11 korrik 2004, f. 19.

dëshmojnë se ajo nuk lëshonte veten në dëshpërim apo në rënkim, nuk ushqej me urrejtje dhe rebelim ndaj jetës dhe njerëzimit, nuk mbyllej në vetveten; përkundrazi, ajo gëzohej nga çastet e lumtura dhe sidomos u jepte atyre, që e rrethonin, momente gëzimi dhe ngushëllimi. Me këtë fuqi luftoi deri në fund për ta shtyrë vdekjen sa më larg dhe kur ajo erdhi, më 19 shkurt 1981, e gjeti në një shtrat të spitalit onkologjik të Tiranës, në vetmi të plotë, pasi së ëmës nuk iu dha leja ta vizitonte të bijën në çastet e fundit të jetës së saj.

Shënimet e para të ditarit i përkasin së dielës, më 13 qershor 1976, ndërsa shënimet e fundit janë nga e hëna, më 9 shkurt 1981, edhe pse Drita – siç vetë sqaron në rreshtat e para të shkrimit të saj¹⁰ – kishte shkruar edhe dy fletore të tjera, të cilat u humbën. Vepra e botuar, pra, siç shkruhet në shënimet hyrëse të librit, nuk është e plotë. Zonja Liri Belishova, në një intervistë me gazetaren Elsa Demo, tregon se dorëshkrimi përbëhet nga 600 faqe dhe shpreh shpresën se dikur do të zbulohen fletët që mungojnë, për të cilat ajo ka dijeni.¹¹ Fragmentet u zgjodhën në bazë të përmbajtjes, siç shpjegon më tej zonja Liri: “Kjo zgjedhje u bë, sepse jeta e saj ishte kaq monotone sa ditët përsëritnin njëra-tjetrën. Në dorëshkrim kishte pa fund fragmente autorësh nga letërsia, listë librash që vajza e re i pat lexuar apo që mendonte të lexonte; dhe së dyti janë hequr paragrafë intime për të mos fyer ndonjë person, që sot është gjallë.”¹²

Rrëfimet e botuara përshkruajnë vetëm disa ditë në muaj, pa ndonjë vazhdimësi të rregullt. Edhe për sa u përket vjershave, u bë një përzgjedhje me rastin e botimit, dhe u përfshinë në tërësi 58 poezi, nga periudhat e ndryshme, duke u nisur nga vjershat që Drita shkroi për shoqen e saj, Rajmonda Bulkun, në majin e vitit 1975, me titullin “E bukura”¹³, deri te poezia “Dashuria” e janarit 1981¹⁴. Përveç

¹⁰ “E diel, 13.VI.1976 – Përsëri vendosa të shkruaj. Uroj që kjo fletore të mos ketë fatin e dy të tjerave”. Në fusnotën përkatëse, që u bazohen informacioneve të treguara nga zonja Liri Belishova, lexohet: “Dy fletoret e para të Ditarit, ku kishte dhe mjaft poezi, i kishin ‘humbur’. Një bllok me shënime, pas botimit të parë të këtij libri, na i dha e shoqja e një ish oficeri të sigurimit”. D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004, f. 17.

¹¹ “Janë disa fletore dhe blloqe. Në fletore shkruante kur ishte në shtëpi, kurse në blloqe kur ishte e shtruar në spital. Bllokun e vogël mund ta fuste në xhep kur largohej nga dhoma, për të evituar humbjen. Gjithsej, janë mbi 600 faqe ditari, disa poezi e shkrime me përmbajtje direkt kundër diktaturës i shkruante në fletë të veçanta dhe i mbante të përziera me shumë fletë të tjera, me shënime e detyra shkollore, me fletoret e librat e shkollës, që të mos binin në sy në rast kontrolli. Fatkeqësisht disa prej këtyre, si një variant i “Dashuri siberiane”, një poezi e gjatë mbi Nako Spirun, disa shënime mbi “Dimrin e vetmisë së madhe”, tre strofat e poezisë “Skifteri” (për diktatorin) etj., nuk i kam. Si duket i ka grisur në momente të acarimit të situatës”. Fjalim i nxjerrë nga intervista me gazetaren Elsa Demo, “Të lindësh me biografi të mallkuar”, *Shekulli*, 11 korrik 2004, f. 19.

¹² Nga intervista e lartpërmendur.

¹³ D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004, f. 103-104.

këtyre, në fund të vëllimit u shtuan edhe pesë vjersha që, siç lexohet në fusnotën e vjershës së parë të këtij grupi, “Skifteri i Xh. Suiftit”, Drita kishte shkruar në fletë të ndryshme, të përziera me fletore shkollë dhe libra, ndërsa nuk i kishte hedhur në ditar, disa nga droja prej Sigurimit, të tjerat sepse i quante të papërfunduara.¹⁵

Nga lindi interesi për këto shkrime intime të një vajze fatzezë, së cilës fati nuk ia dha mundësinë të shprehë më tej talentin e saj krijues? Arsye të dukshme jepen nga Kadareja në parathënien e vëllimit, ku mjeshtri i artit letrar ia njeh shkrimtares së re përkatësinë në botën e krijuesve, falë fuqisë gjallëruese që buron nga shkrimet e saj, të cilët ngadhënjëjnë mbi terrorin komunist, mbi sëmundjen fizike, mbi padrejtësitë e botës reale, mbi vet vdekjen dhe i japin jetë një bote tjetër, botës letrare, që nuk kufizohet prej asnjë ligji tokësor.¹⁶

Tiparet e veçanta, që dallojnë shkrimet e Drita Çomos nga veprat letrare të mirëfillta, i bien në sy poeteshës Klara Kodrës, e cila ndërmer punën e përkthimit të tyre në gjuhën italiane. Në vjershat që ajo i kushton shkrimtares së re fatzezë dhe në komentin e saj letrar, të cilët plotësojnë vëllimin e botuar në italishten, përkthyesja thekson fuqinë e ditarit dhe të vjershave të Dritës për të përhapur një mesazh të ngritur, sublim, me një formë letrare shumë të thjeshtë. “Bëhet fjalë – shkruan përkthyesja – për një vepër, arti i së cilës përbëhet, në mënyrë paradoksale, nga mungesa e artit”¹⁷.

Ditari përbëhet prej faqesh të ndryshme, qoftë nga ana e përmbajtjes, qoftë nga ana stilistike. “Një pjesë të kësaj vepre e përbën kronika e spitalit dhe e zhvendosjeve për shkak të tij, hyrjet dhe daljet në ndërtesën e trishtueshme, analizat, shtimi ose pakësimi i leukociteve, grafitë e njëpasnjëshme, portrete të sëmuresh të tjerë, pasditet e mërziqshme, vizitat e të njohurve, ardhja e njeriut të dashur, prapë analiza, grafi, shpejtim ose ngadalësim i përkohshëm i hapave të vdekjes”¹⁸. Pjesa tjetër e ditarit përbëhet nga shqyrtimet e saj të mprehta psikologjike, që dëshmojnë pjekurinë e mendimeve të vajzës së re, thellësinë e shpirtit të saj, dashurinë e saj ndaj jetës – motivi, ky i fundit, që shoqëron të gjitha shkrimet e saj. Për t’u përmendur janë gjithashtu disa përshkrime peisazhesh që dallohen për lirizmin e

¹⁴ *Ibidem*, f. 181-182.

¹⁵ Në fusnotën në fjalë jepen gjithashtu informacione rreth kësaj lirike: “*Skifteri-n* e ka shkruar për diktatorin. Ndërmjet strofës së parë dhe asaj që vijon ka lënë një hapësirë bosh – këtu duhej të viheshin tre strofa që ajo ai lexoi nënës dhe i grisi, se kishin përmbajtje të hapur kundër diktatorit”. D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004, f. 183.

¹⁶ D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004, f. 7-14.

¹⁷ D. Çomo, *Luce che sgorga dall’abisso*, Prefazione di I. Kadare, Rubbettino, Catanzaro, 2012, f. 192. [Përkthimi nga italishtja nga autorja.]

¹⁸ D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004, f. 13.

tyre, sikur pena e shkrimtares së re të ishte peneli i një piktori të shquar. Edhe vjershat kanë një karakter të veçantë që tërheq vëmendjen e përkthyeses, siç marrim vesh nga komenti i saj letrar, i përfshirë në botimin italian. “Edhe në lirikat e Dritës, cilësia më e madhe përbehet nga sinqeriteti dhe freskia prekëse, madje nga një farë naiviteti që shkrihet me një pjekuri të parakohshme mendimesh”.¹⁹

Klara Kodra, nga këndvështrimi i saj prej poeteshe, dallon në to talentin potencial të shkrimtares së ndjerë, e cila, me krijimet e saj të hershme – madje krejtësisht vetjake, aspak të përpunuara me synimin e botimit – dëshmon një shijë poetike personale dhe tregon përdorimin e një stili individual që, duke injoruar skemat dhe kufizimet e caktuara nga realizmi socialist, shkon në drejtimin e një lirike të pavarur nga metrika tradicionale, të shprehur me një ligjërim të thjeshtë, të drejtpërdrejtë, gati të përditshëm, aspak hermetik. Megjithatë vjershave të saj nuk u mungojnë rimat, muzikaliteti, lirizmi, herë-herë edhe një lloj dramatizimi, i shprehur nëpërmjet metaforave të thekshme.

Në bazën të të dhënave të shqyrtuara në këtë artikull, mund të analizohet përkthimi i veprës shqipe në gjuhën italiane, duke vëzhguar qoftë procesi përkthimor, qoftë rezultati i këtij veprimi, si edhe funksioni i tekstit të përkthyer.²⁰ Me anë të analizës deskriptive mund të shprehen komente edhe për strategjinë e përkthimit, e cila udhëheq të tërë aktin e përkthimit, duke garantuar vazhdimësinë e pandërprerë të metodologjisë së zgjedhur paraprakisht dhe zbatimin e kësaj në të gjithë tekstin. Caktimi i strategjisë së përshtatshme përkthimore është një hap vendimtar për rezultatin e përkthimit, sepse për të marrë këtë vendim është e nevojshme, së pari, që të njihet vepra origjinale në të gjitha dimensionet e saj, tekstuale dhe paratekstuale, dhe së dyti, që të dallohet vendi i kësaj brenda sistemit kulturor, të cilit ajo i përket, dhe pozicioni që do të zërë në sistemin letrar dhe kulturor që do të pranojë përkthimin. Në këto parametrat bazohet teoria e njohur me emërtimin “teoria e polisistemit”²¹,

¹⁹ D. Çomo, *Luce che sgorga dall'abisso*, Prefazione di I. Kadare, Rubbettino, Catanzaro, 2012, f. 194. [Përkthimi nga italishtja nga autorja.]

²⁰ Që nga vitet '80-ta të shekullit të XX, falë hulumtimeve të shkencëtarit anglez J. S. Holmes, studimet e përkthimit morën një drejtim të ri, të quajtur deskriptiv, në kundërshtim me prirjen tradicionale, e cila quhej normative. Dallimi qëndron në mënyrën sesi përkthimi studiohet dhe trajtohet nga shkencëtarët: studimet deskriptive të përkthimit (*Descriptive Translation Studies, DTS*) mbajnë kontakt të drejtpërdrejtë me dukuritë empirike që i përkasin përkthimit, sipas një perspektive analitike të trefishuar, që merr përsipër përshtatshmin e produktit, të funksionit dhe të procesit të përkthimit; studimet normative, përkundrazi, bazohen kryesisht në parimet dhe modelet teorike për të paracaktuar çfarë është përkthimi, për t'i dhënë atij një vijë teorike, së cilës produkti dhe procesi përkthimor duhet t'i afrohen. Shih. J. S. Holmes, *Translated! Papers on Literary Translation and Translation Studies*, Rodopi, Amsterdam, 1988.

²¹ Formulimi teorik i sapopërmendur zhvillohet brenda së ashtuquajturës “teori e polisistemit”, themeluesi i së cilës është shkencëtari i njohur izraelit, Itmar Even-Zohar, nga Universiteti i Tel Avivit, i cili, në fillim të viteve '70, formulon këtë teori sipas së cilës vepra

nga e cila rrjedhin riformulime të mëtejshme që ofrojnë jo vetëm një mbështetje shkencore teorike, por edhe një metodologji konkrete për të analizuar një përkthim. I tillë është rasti i teoricienëve që kanë formuar grupin shkencor “Shkolla e Manipulimit”²², dhe kanë botuar një përmbledhje artikujsh²³ veçanërisht interesante, ku është i përfshirë, ndër të tjera, një shkrim që na ofron mjaft shkase gjatë kësaj analize të përkthimit. Bëhet fjalë për artikullin me titull “On describing translations” (shq. *Mbi përshkrimin e përkthimeve*), në të cilin, autorët – José Lambert dhe Hendrik van Gorp – propozojnë një skemë me anën e të cilit mund të krahasohen teksti original dhe përkthimi në perspektivën e sistemeve letrare ku marrin pjesë, duke përshkruar edhe marrëdhëniet e tyre.²⁴ Skema e tyre parashikon katër faza, sipas të cilave përkthimi do të analizohet: e para fazë kërkon që të mblidhen të dhënat paraprake për veprën, si p.sh. informacione për kapakun, për metatekstin, për strategjinë e përgjithshme; e dyta merret me organizimin e tekstit në nivelin makro-tekstual, d.m.th. për sa u përket ndarjes në kapituj, strukturës së tregimit, elementeve veçuese të autorit; faza e tretë i përket nivelit mikro-tekstual të veprës dhe ka të bëjë me identifikimin e ndryshimeve në nivele të shumta gjuhësore (leksik, sintaksë, gramatikë, këndvështrimi dhe modaliteti i tregimit, etj.); faza e fundit përbehet nga

letrare nuk duhet të studiohet si një njësi individuale dhe e izoluar, por si pjesë e një sistemi letrar, i cili merr gjithashtu pjesë në një rend më të gjerë me sisteme të ndryshme. Edhe letërsia e përkthyer zë vend në këtë polisistem, dhe pozicioni i saj është i lëvizshëm, mund të jetë parësor apo dytësor: kur letërsia e përkthyer mban pozitën parësore, ajo merr pjesë në formimin e thelbit të polisistemit, është një fuqi përtëritëse; përkundrazi, kur gjendet në pozitën dytësore, siç më shpesh ndodh, ajo përfaqëson një sistem periferik brenda polisistemit dhe nuk ka ndikim të madh në zhvillimin e sistemit qendror, por përbën një element konservativ. Sipas Even-Zoharit, vendi që letërsia e përkthyer mban në polisistemin letrar vepron mbi strategjinë përkthimore: nëse letërsia e përkthyer është parësore, përkthyesi ndihet i autorizuar që të shkelë rregullat konvencionale dhe të krijojë një tekst që riprodhon marrëdhëniet tekstuale të origjinalit; ndërsa, nëse është dytësore, përkthyesi ndjen detyrimin që të ndjekë modelet e letërsisë së mbërritjes. Shih: I. Even-Zohar, “The position of translated literature within the literary polysystem”, 1978, në L. Venuti, *The Translation Studies Readers*, Routledge, London/New York, 2000, f. 192-197.

²² *Shkolla e manipulimit* (Manipulation School) është grupi studimor i themeluar, rreth viteve '80, nga anëtarët e Shoqatës Ndërkombëtare e Letërsisë Krahasimtare, me seli në Belgjikë, Izrael dhe Vendet e Ulëta, që kanë organizuar konferenca dhe takime mbi temën e letërsisë së përkthyer dhe kanë përvetësuar shumë nocione të përpunuara nga dy eksponentët e teorisë së polisistemit, Even-Zohar dhe Toury dhe kanë propozuar një metodë pune në fushën e traduktologjisë të bazuar në ndërveprimin e pandërprerë të praktikës me teorinë. Shih: J. Munday, *Introducing Translation Studies, Theories and Application*, Routledge, London/New York, 2001, f. 119-121.

²³ T. Hermans (ed.), *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Beckenham, 1985.

²⁴ J. Lambert e H. van Gorp, “On describing translations”, në Hermans (ed.), *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Beckenham, 1985, f. 42-53.

krahasimi i të dhënave mikro dhe makro-tekstuale, në mënyrë që të dallohen normat e përkthimit dhe të zbrërthehen marrëdhëniet ndërtekstuale (ndërmjet teksteve të tjera, përfshirë përkthimeve) dhe ndërsistemike (me zhanret e tjera).

Vendi në dispozicion në këtë shkrim nuk është i mjaftueshëm për një analizë të tillë të plotë, por nga ky formulim teorik mund të nxirren disa parametra të dobishëm për shqyrtimin e çështjeve përkthimore që vijnë.

Përkthimi i ditarit – ndryshe nga përkthimi i vjershave, që i kërkon përkthyesit një vëmendje të veçantë ndaj muzikalitetit, ritmit, strukturës metrike, etj. - mund të konsiderohet një operacion relativisht i thjeshtë, sidomos për sa i përket kronikës së sëmundjes së autores dhe të ngjarjeve të saj në spital. Më ndryshe ndodh, gjithsesi, në ato pasazhet ku shkrimtarja shprehet në mënyrë poetike, ku përdor ligjëratën e drejtë dhe shprehjet e gjuhës së përditshme, ku hasen elemente kulturore që kërkojnë zgjedhjen përkthimore të posaçme – ose përshtatje me kulturën e mbërritjes ose ruajtje sipas kulturës origjinale²⁵ – duke ushtruar një ndikim të fortë mbi caktimin e strategjisë globale²⁶. Metoda e përgjithshme e punës, si edhe solucionet e ndërmarra nga përkthyesja në disa raste të veçanta – thënë ndryshe, strategjitë lokale – dëshmojnë se ajo ka adoptuar një strategji përkthimore, e cila bën që lexuesi italian t’i afrohet kontekstit kulturor, shoqëror dhe historik shqiptar. Me anë të fusnotave, për shembull, përkthyesja sqaron ato fjalë që emërtojnë ndonjë dukuri të panjohur për publikun italian. Një rast i tillë është fjala “pesëkatësh” (v. or., f. 19) që përkthehet me shprehjen italiane “cinque-piani”, dhe në fusnotë parafrazohet: “gioco albanese di carte” (lojë shqiptare me letra), (përkth., f. 24).²⁷

²⁵ Në rastin kur ekziston një ndryshim i dukshëm midis elementeve kulturore të pasqyruara nga teksti origjinal dhe kulturës në të cilën do të pranohet teksti i përkthyer, është e nevojshme që përkthyesi t’i njohë dallimet kulturore dhe të vendosë sesi të veprojë. Pyetja është: a duhet të ruhen elementet kulturore të origjinalit duke bërë që lexuesi i përkthimit t’u afrohet atyre, t’i mësojë dhe t’i mbajë si dukuri dalluese të një kulture të huaj? Apo përkthyesi duhet të bëjë një përshtatje në kulturën e mbërritjes për ato elemente kulturore që hasen në origjinalin, duke afruar tekstin të lexuesit të rinj? Strategjia përkthimore, në rastin e parë, caktohet si “foreignization”, ndërsa e dyta quhet “addomestication”, sipas terminologjisë angleze të zgjedhur nga autori i këtyre nocioneve, studiuesi amerikan, Lawrence Venuti, e cila u pranua gjerësisht edhe nga teoricienët e tjerë. Shih. L. Venuti, *The Translator’s Invisibility: A History of Translation*, Routledge, London/New York, 1995.

²⁶ Dallimi midis strategjive globale dhe strategjive lokale trajtohet nga studiuesit e ndryshëm (Delisle et al, Venuti, Chesterman, etj.). Këtu jepet caktimi i përpunuar nga studiuesi finlandez Jääskeläinen, i cili pohon se strategjitë globale “u referohen parimeve dhe mënyrave të të vepruarit të përgjithshme të përkthyesit”, ndërsa strategjitë lokale “u referohen aktiviteteve të veçanta në lidhje me zgjidhjen e problemeve dhe me marrjen e vendimeve nga ana e përkthyesit”. Shih. R. Jaaskeläinen: *Translation Strategies : What Are They ? An Expertise Workshop*, Oslo, 18-20.02.2005. [Përkthimi nga anglishtja nga autorja]

²⁷ Tani e tutje, shkurtimi “v. or.” i referohet veprës origjinale: D. Çomo, *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë, 2004; ndërsa shkurtimi “përkth.” i

Nga pikëpamja leksikore, në përgjithësi, mund të dallohen katër shtresa të veçanta të fjalëve, me të cilat zgjedhjet e përkthyeses janë hasur:

- terminologjia mjekësore, që gjen korrespondentin e drejtpërdrejtë në gjuhën italiane: leukocitet → *i leucociti*; sedimenti → *il sedimento*; hemoglobina → l'emoglobina (v. or., f. 40; përkth., f. 44).

- fjalët me karakter kulturor dallues, d.m.th. ato që u përkasin traditave, zakoneve dhe dokeve të një populli a një kombi, të cilat mbeten në shqip në tekstin e përkthyer dhe sqarohen në fusnotë: qilim (v. or., f. 34) → *qilim* (me parafrazë në fusnotë: "Tappeto tipico della tradizione albanese, lavorato al telaio con spessi fili di lana, di cotone o altro, solitamente di più colori e con decorazioni, che si mette sul pavimento o si appende al muro come abbellimento" (Shtrojë tipike e traditës shqiptare e punuar në vegjë me fije të trasha leshi, pambuku etj., zakonisht me disa ngjyra e me zbukurime, që vihet mbi dysheme ose varet në mur si stoli) (përkth., f. 38).

- fjalët e gjuhës së folur, shprehjet e përditshme që nuk mund të përkthehen drejtpërdrejt, por me anë të një shprehjeje të barabartë në gjuhën e përkthimit: "poçit" (v. or., f. 25) → "*alla pupetta*" (përkth., f. 29).

- termat që u referohen institucioneve politike dhe shoqërore shqiptare gjatë kohës së komunizmit, të cilat janë elemente përbërëse të përmbajtjes së veprës origjinale, sa që edhe në tekstin e përkthyer duhet të përmenden me të njëjtin konotacion që kanë në origjinalin, duke i treguar lexuesit italian realitetin e popullit shqiptar në atë fazë historik të caktuar: sigurimi (v. or., f. 17) → "*Sigurimi*" (përkth., f. 21).

Këta grupe leksikore të ndryshme ngulen në një rrafsh gjuhësor që dallohet për një strukturë sintaksore të thjeshtë, të përbërë nga fjalitë e shkurtra, sidomos të bashkërenditura, që shpeshherë ndërtojnë një ligjëratë fragmentare, por harmonike dhe muzikale, që pasqyron rrethanat jetësore të autores. Stili i tillë lirik konsiderohet si sinjal veçues për krijimin e strategjisë së përkthimit: mjeshtëria poetike e saj, i jep përkthyeses, Klara Kodrës, përparimin që të dallojë ritmin e prozës së Dritës dhe ta rikrijë nëpërmjet strukturës leksikore dhe sintaksore të gjuhës italiane.

Lidhur me argumentin e ndryshimeve të përkthimit nga origjinali²⁸, përveç disa pasaktësive gramatikore dhe shtrembërimeve sintaksore, që, për mendimin tim, lidhen me faktin që përkthyesja, me gjithë përvojën e saj të gjatë me italishten, e ka shqipen si gjuhë nënë, unë, si redaktore italiane e përkthimit të saj në italishten, kam dalluar ndonjë paqartësi në përkthimin e shprehjeve idiomatike dhe frazeologjike.

referohet tekstit të përkthyer në gjuhën italiane: D. Çomo, *Luce che sgorga dall'abisso*, Prefazione di I. Kadare, Rubbettino, Catanzaro, 2012.

²⁸ Bëhet fjalë për ato ndryshime që në terminologjinë shkencore quhen "translation shifts", sipas përcaktimit të propozuar nga J. C. Catford në vëllimin e tij *A Linguistic Theory of Translation* (1965), dhe të pranuar ndërkombëtarisht nga studiuesit e tjerë.

Është rasti, për shembull, i shprehjes: “rashë tepër në sy” (v. or., f. 43) që përkthyesja thjeshtëson me fjalinë “mi hanno notata abbastanza” (shqip: më kanë dalluar mjaft), e cila, edhe pse komunikon mesazhin e përgjithshëm të origjinalit, nuk përmban të njëjtën ngjyresë stilistike që shprehet me anë të një frazeologjizmi. Propozimi im është: “ho dato molto nell’occhio” (përkth., f. 47), duke përdorur gjithashtu një shprehje frazeologjike, e cila ndërtohet, si ajo origjinale, në simbolikën e syrit.

Në raste të këtij lloji, që janë relativisht të numërta, ndërhyra në punën e bërë, duke përshtatur tekstin e përkthyer me kriteret gjuhësore të italishtes, dhe sidomos për të saktësuar ato nuanca kuptimore dhe shprehëse, që herë-herë mjetet ekspresive të përkthyeses nuk kishin arritur efektin e krijuar nga shkrimtarja në tekstin origjinal.

Për sa i përket punës së redaktimit të vjershave, përkundrazi, situata është më delikate dhe më e ndërlikuar, jo vetëm për arsyet e njohura që poezia paraqet më shumë vështirësi sesa proza për t’u përkthyer, por, në rastin tonë, edhe në lidhje me zgjedhjen e strategjisë përkthimore.

Sipas mendimit të zonjës Klara Kodrës, vjershat e Dritës janë “vjersha lirike të çiltra e naive, gjysmën e bukurisë të së cilave e përbën muzikaliteti”²⁹. Prandaj, siç ajo më shpjegon në një korrespondencë elektronike private, synimi i përkthimit të saj është “ruajtja e muzikalitetit të origjinalit, duke ruajtur numrin e rrokjeve (deri diku) dhe sidomos rimën”. Për këtë arritje, iu desh të përdorë disa ndryshime në leksik dhe në sintaksë, duke i qëndruar besnike idesë.

Për mendimin tim, nga ana tjetër, më shumë se muzikaliteti dhe lirizmi që padyshim shijohen në ato vjershë, ajo çfarë karakterizon lirikën e vajzës së ndjerë është natyra e tyre naive dhe e përkohshme, diletantizmi poetik të shtyrë, jo vetëm nga pasioni për letërsinë por dhe nga përkufizimet e jetës shoqërore për shkak të pengesave politike dhe të shqetësimeve të rënda shëndetësore, përkufizime të pranishme në botën reale, të cilave Drita përpiqet t’u shmanget në botën imagjinare që ndërton letërsia.

Pra, lidhur me temën e strategjisë përkthimore, mendoj se, për çështje njëjlojshmërie dhe koherence me strategjinë e zbatuar në pjesën në prozë, edhe përkthimi i vjershave duhet të bëhet sipas kriterit që publikut italian, t’i ofrohen poezi që përfaqësojnë plotësisht natyrën e poezive origjinale, qoftë në përmbajtjen, qoftë në nivelin artistik, pra, përsëri, të afrohet lexuesi te teksti, dhe jo anasjelltas.

Pajtohem me synimin e përkthyeses që të rikrijojë në gjuhën italiane kumbimin poetik të vjershave origjinale, por, nga ana tjetër, zgjedhja e saj leksikore

²⁹ Nga korrespondenca personale me zonjën Klara Kodrën, me anë të postës elektronike, më datë 16.07.2012.

dhe stilistike kundërshtohet, sipas perceptimit tim të gjuhës italiane, me thjeshtësinë stilistike të atyre vjershave, veçori dalluese, kjo, që vetë përkthyesja u ka njohur.

Përveç kësaj, zonja Kodra, në komentin e saj letrar që shoqëron botimin italian, shpjegon se poezitë e Dritës përbëhen nga “vjershat gati të lira, që shkelin rregullat ritmike, dhe kanë një ritëm individual”.³⁰ Në këtë konstatim u bazova kur ndërhyra në përkthimin e bërë, me qëllimin që të zëvendësoja shprehjet e rafinuara dhe të formuluar me fjalë italiane gati arkaike, me shprehjet që përfaqësojnë karakterin e thjeshtë dhe të përditshëm të gjuhës së përdorur nga poetesha e re në vjershat e saj, që shpeshherë kanë formën e një rrëfimi intim, të cilave u mungon përpunimi artistik që dallon poezitë e hartuara “në tavolinë” nga vjershat e shkruara në burg apo në ballin e luftës.

Qëllimi i redaktimit tim ka qenë, si përfundim, ruajtja e përshtypjes tek lexuesit italianë se ato vjersha u shkruan nga një vajzë e re që poezinë e konsideronte si një mundësi për ta lehtësuar shpirtin e rënduar nga sëmundja dhe nga dënimi i familjes. Është e nevojshme, sipas mendimit tim, t’i jepet publikut italian perceptimi i kushteve jetësore në të cilat ato vjersha u formuluan, dhe për këtë arsye, më duket e nevojshme të ruhet në përkthimin niveli artistik që u përket vjershave origjinale, të cilat u shkruan nga një diletante, edhe pse jashtëzakonisht e talentuar, por pa ndërgjegjen e mirëfilltë të poeteshtës, pa synimin e botimit, me freskinë e ligjërimit të përditshëm, me lirinë stilistike më të plotë, me spontanitetin dhe natyrshmërinë e një proze lirike, sesa të lirikës së mirëfilltë.

Bibliografia

a) Veprat origjinale dhe përkthimet:

1. Çomo, Drita (1997, 2001, 2004), *Dritë që vjen nga humnera*, Parathënia nga I. Kadare, Onufri, Tiranë.
2. Çomo, Drita, (2004), *Cette lueur qui monte de l'abîme*, Préface de I. Kadaré, Edition du Rocher, Paris.
3. Çomo, Drita, (2012), *Luce che sgorga dall'abisso*, Prefazione di I. Kadare, Rubbettino, Catanzaro, 2012.
4. Kadare, Ismail (2009), *E Penguara, Requiem për Linda B.*, Onufri, Tiranë.
5. Klosi, Ardian-Demo Elsa (2009), *Shqipëria kujton, 1944-1991*, K&B, Tiranë, 2009.

30 D. Çomo, *Luce che sgorga dall'abisso*, Prefazione di I. Kadare, Rubbettino, Catanzaro, 2012, f. 194.

b) Vëllimet mbi teorinë e përkthimit:

1. Catford, John C. A (1965), *Linguistic Theory of Translation*, Oxford University Press, London.
2. Even-Zohar, Itmar (1978), “*The position of translated literature within the literary polysystem*”, në Venuti, L. (2000), *The Translation Studies Readers*, Routledge, London/New York, f. 192-197 .
3. Hermans, Theo (ed.) (1985), *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Beckenham.
4. Holmes James, S. (1988), *Translated! Papers on Literary Translation and Translation Studies*, Rodopi, Amsterdam.
5. Jaaskalainen ,Ritta (18-20. 2005) *Translation Strategies : What Are They ? An Expertise Workshop*, Oslo.
6. Lambert, José e H. van Gorp (1985), *On describing translations*, në T. Hermans (ed.), *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Beckenham.
7. Munday, Jeremy (2001), *Introducing Translation Studies, Theories and Application*, Routledge, London/New York.
8. Venuti, Lawrence (1995), *The Translator’s Invisibility: A History of Translation*, Routledge, London/New York.

Shpresa HOXHA

PËRKTHIMET E PASAKTA NË SERITË TELEVIZIVE NË KOSOVË

Se përkthimi është art më vete është dëshmuar me kohë përmes veprave të përkthyer, shkrimeve të ndryshme, emisioneve të ndryshme televizive e në veçanti filmave dhe serive të shumta të filmave të cilët emitohen në programet e ndryshme të kanaleve tona televizive.

“Përkthimi është një veprim që ka karakter gjuhësor; një proces i zëvendësimit të tekstit të një gjuhe të caktuar me tekstin në gjuhën tjetër. Përkritazi me këtë secila teori e përkthimit duhet të nxirret nga teoria gjuhësore – teoria e përgjithshme e përkthimit”.¹

Ajo që lë përshtypje jo të mirë dhe vret syrin dhe veshin është përkthimi joadekuat dhe gabimet në shkrim të këtyre filmave që lejohen nga personat “kompetentë”, përgjegjës të këtij zhanri televiziv dhe mjaft të shikuar nga të gjitha moshat pa dallim çka përbën subjektin e këtij shqyrtimi. Përgjegjësve si duket nuk iu pengon cilësia e përkthimit dhe shkrimi jo i drejtë që do të duhej të ishte i mbështetur në gjuhën e unifikuar letrare shqipe, pra në pajtim me standardin e gjuhës së sotme shqipe.

“Gjuha është realitet i mendimit, po edhe pasqyrë e edukatës, e koncepteve dhe e moralit të një shoqërie, të një mjedisi të saj, po edhe të çdo individi të veçantë që e përdor gjuhën kombëtare.

Kur dhuntisë së lindur të njeriut për të folur bukur i shtohet edhe njohja teorike e studimi i gjuhës, atëherë forca e zotërimit të tij dyfishohet, trefishohet. Gramatika nuk e krijon talentin, porse ajo i jep talentit forcë të madhe”²

Ana morale e kulturës së gjuhës nuk është vetëm në të folurit e drejtë por edhe në respektimin dhe zbatimin e rregullave të drejtshkrimit të saj. Në veçanti përkthimi mund të merret edhe si punë artistike me dhunti natyrore që kombinohet me njohjen e gjuhës, letërsisë dhe të kulturës së gjuhës.

“Gjuha artistike përbën stilin a variantin më të gjerë e më të larmishëm të gjuhës sonë letrare kombëtare. Ajo ka gjithashtu mundësitë më të mëdha për të

¹ J. C. Catford, A Linguistic Theory of Translation, Oxford University Press, London 1965, 1.

² Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, shulu, Tiranë 2006, 28.

qëndruar fort në truallin e gjuhës popullore e për t'u ushqyer prej saj dhe njëkohësisht për t'u lidhur më ngushtë me traditën e gjuhës letrare, sepse në asnjë fushë gjallëria e forca e gjuhës letrare nuk është aq e fuqishme e jetëgjatë, sa në letërsinë artistike”³

Përkthimi gramatikor është ngushtë i lidhur me përkthimin leksikor, që është përkthim i përkufizuar, ku fjalët e gjuhës burimore të një teksti zëvendësohen me ekuivalentin e fjalëve të gjuhës së shenjave, por pa zëvendësim gramatikor.

Fjalët dhe shprehjet që prishin dhe dëmtojnë vlerat e gjuhës letrare të ndërtuar me shumë mund dhe përkushtim të madh me dekada të tëra i ndeshim në përkthimet e serive të filmave turq nga përkthyes jo të përgjegjshëm, ku qartazi shihet që e njohin turqishten, por kanë mangësi përkthimi dhe mosnjohje të duhur të fjalëve dhe të shprehjeve përkatëse në gjuhën shqipe, njohje të pamjaftueshme të gramatikës, sintaksës, etj. Ja disa shembuj:

Kjo ishte një natë shumë qesharake. Për: Kjo ishte një natë shumë gazmore.

Nuk është asgjë më me rëndësi se e ëma ime.

Nuk është askush më i rëndësishëm se nëna ime.

Të gjitha (ushqimet, gjellët) qenë shumë të bukura.

Të gjitha (ushqimet, gjellët) qenë shumë të mira (të shijshme).

Mos e kurorëzo Hyremen, se të shlyej nga fëmijëria.

Mos e kurorëzo Hyremen se të shlyej që të kam djalë.

Dua të bisedoj vetmas me ju.

Për: Dua të bisedoj veçmas me ju.

Ty na fal Allahu...

Për: Të na fal Allahu... .

Të thashë të mos qitësh.

Për: Të thashë të mos qesësh.

Lëshimet apo më mirë thënë gabimet gjuhësore gjatë përkthimeve të këtyre filmave serikë janë nga më të ndryshmet. Kështu, përdorimi i panevojshëm i shkronjës – ë në fund të fjalës dhe shumë shpesh i përsëritur vërehet në këto përkthime që si duket po bëhen sa “për të kryer punë”.

Shembuj:

Pashë dikë që e njohë..në vend se të shkruhet drejt: Pashë dikë që e njoh.

³ Androkli Kostallari, Gjuha letrare kombëtare shqiptare dhe epoka jonë, (Referat), Tiranë 1984, 38.

...gendëra tregtare për: qendra tregtare, lumëpër: lum – i,

(Unë) do të ju shpëtojë juve.

Për: (Unë) do të ju shpëtoj juve.

Si mund ta tolerojë (unë)këtë turp?

Për: Si mund ta toleroj këtë turp?

Ha ushqim, mos u sëmurë.

Për: Ha ushqim, mos u sëmur.

Sikur të kishte qëndruarë edhe pak!

Për: Sikur të kishte qëndruar edhe pak!

A ka ndonjë lajmë ?

Për: A ka ndonjë lajm?

Ka një lajmë.

Për: Ka një lajm.

Ai është tradhtarë.

Për: Ai është tradhtar.

Ai do ta humbë..... .

Për: Ai do ta humb

Perandorit i ka hije kjo llojë kurore.

Perandorit i ka hije kjo lloj kurore.

Përdorimi në mënyrë të gabueshme ose gabim shtypi i – ë :

Nuk mund të këtë guximin të më sulmojë.

Nuk mund të ketë guximin të më sulmojë.

Më bezdis më sjelljet e saj!

Në vend se të shkruhet: Më bezdis me sjelljet e saj!

Qeshet më së mirë, ai që qeshet i fundit.

Qeshet më së miri ai që qeshet i fundit.

Erdhi sulltaneshë.

Për: Erdhi sulltanësja.

A do të këtë dasëm?

Për: A do të ketë dasmë?

Po mendohem që dy ditë.

Për: Po mendohem që dy ditë.

Thonë se merr ngjyrë të zëzë.

Për: Thonë se merr ngjyrë të zezë.

Në fjalët dhe fjalitë e përkthyer vërehet shpeshherë mosrespektimi i përdorimit të shkronjës – ë

Mos u bëni merak sulltanesh.

Për: Mos u bëni merak sulltanëshë.

Elegancë vend se të shkruhet elegancë.

Sulltanesh, ju lutem!

Për: Sulltanëshë, ju lutem!

Urdhrat janë ekzekutuar.

Për: Urdhëratë janë ekzekutuar.

Ju urojm rrugë të mbarë.

Për: Ju urojmë rrugë të mbarë.

Dihet që e gjitha popullata e do Mustafain.

Dihet që e gjithë popullata e do Mustafain.

Përkthimet e tekstit të këtyre serive bëhen edhe me paskajoren e dialektit gegë, madje në mënyrë jo të drejtë, të cilën nuk e ka standardi i gjuhës letrare shqipe, por që ka mbetur formë dialektore e gegërishtes dhe sot dëgjohet vetëm në gjuhën e folur dhe jo në atë të shkruar:

...mos me harru në vend se të shkruhet: ...mos të harrojmë meqë sipas kuptimit të tërë fjalisë së përkthyer bëhej fjalë për shumësin.

...me vlerësu për: për të vlerësuar

Të përsëritshme janë fjalitë e përkthyer, mendoj pa vend, me përdorimin e nyjës së përparme të para emrit, si p.sh.:

Dua ta shoh të bijën (time).

Për: Dua ta shoh bijën time.

Unë bisedova me të bijën.

Për: Unë bisedova me bijën time.

Kjo buron nga dhimbja për të bijën (time).

Kjo buron nga dhimbja për time bijë (bijën time).

Do të jem një nënë e mirë për të birin.

Do të jem një nënë e mirë për birin tim.

Si se kam kuptuar problemin e të birit!?

Si se kam kuptuar problemin e birit tim!?

Viset tona nuk i bëjnë mirë të bijës sonë.

Viset tona nuk i bëjnë mirë bijës sonë.

Nuk ka mundësi deri sa e kam të birin.

Nuk ka mundësi deri sa e kam të birin.

Tërë kohën e kaloj me bijën dhe të birin.

Tërë kohën e kaloj me bijën dhe të birin.

Vërehet edhe përdorimi i gabuar në gjini, atëherë kur flitet për personin e gjinisë femërore fjalja përkthehet me përemër të gjinisë mashkullore ose edhe e kundërta:

Fjalët e tij..... Fjalët e saj....

E dashura im me fytyrë si hëna. Për: E dashura ime me fytyrë si hëna.

Shembull tjetër i përkthimit të gabueshëm është edhe përdorimi i pasaktë i përemrave pronorë:

Ajo është bija e neve.

Për: Ajo është bija jonë.

Le të jetë shtëpi e neve. Për: Le të jetë shtëpi e jona.

Ajbige ka dalë, është në pritje të juve.

Ajbige ka dalë, është në pritje të juaj ose: ju pret juve.

Fëmija është i juve të dyve. Për: Fëmija është i juaji.
Ose: Fëmija është i të dyve.

Do ta mbash atë si sytë tuaj. Për: Do ta mbash atë si sytë e tu.

Vërehet përdorim i pa vend i vetes së foljeve si p.sh.:

Sulltaneshë, si mund te vijë këtu? Për: Sulltaneshë, si mund të vini këtu?

Bëre të lumtur birin tim. Për: Bëje të lumtur birin tim.

Ndeshim shpesh herë edhe gabime shtypi, mbase të lëshuara pa dashur gjatë shtypjes së fjalive, të cilat lehtë do të mund të korrigjoheshin edhe përmes mundësive lehtësuese me kompjuter, si p. sh.:

Nuk më bleri mua me flori. Për: Nuk më bleu mua me flori.

... duke e shkuar në sy... Për: ... duke e shikuar në sy... .

Edhe ti je vrasës sikur to. Për: Edhe ti je vrasës sikur ata.

Në çfarë gjendjen keni rënë! Për: Në çfarë gjendje keni rënë!

Zoti qoftë i kënaqur prej tej. Për: Zoti qoftë i kënaqur prej teje.

Tani që është bërë synet e merr edhe princin.

Tani që është bërë synet e marr edhe princin. (Nëna thotë për të birin)

Eja kërko falje nga pashi. Për: Eja kërko falje nga pashai.

Mos po imagjinon diçka tjera? Për: Mos po imagjinon diçka tjetër?

Hasim në përdorimin e pa vend dhe me gabime të foljeve si p.sh:

Vëri fëmijët në gjumë. Për: Veni fëmijët në gjumë.

Unë e vëra atë.... Për: Unë e vura atë....

Unë u bënë shkas për këtë. Për: Unë u bëra shkas për këtë.

Prapë jam këtu, nuk më vritën! Për: Prapë jam këtu, nuk më vranë!

A duhet të pyet ty? në vend se të shtrohet pyetja: A duhet të pyes ty?

Të mos shoh me sy!, ndërsa më mirë do te ishte te shkruhej:

Mos të të shoh me sy!

Të mos bie të fiktë! Për: Të mos bie të fikët!

...nëse më humbasësh edhe mua... Për: ... nëse më humb edhe mua...

Dua të fli. Për: Dua të fle.

Vishini ti shohim! Për: Vishni ti shohim!

Nëse ikësh me mua... Për: Nëse ik me mua...

Unë i kam vënë. Për: Unë i kam vënë.

A ngjakemi? Për: A ngjakmë?

Në shembullin e mëposhtëm kemi permutacion të përdorimit të emrave ku pason përemri pronor i përkthyer gabimisht në gjininë femërore.

Zoti i dhuroftë jetë mbesave dhe nipave të mija, në vend se të shkruhet:

Zoti i dhuroftë jetë nipave dhe mbesave të mija.

Më pastaj ndeshim edhe përkthimin e gabuar të gjinisë së përemrit dëftor si p.sh.:

Kjo fletëautorizim... në vend se të përdoret drejt gjinia mashkullore e përemrit në fjalë: *Ky fletëautorizim...*

Tutje, kur burri i drejtohet gruas në një episod filmi, hasim në përkthimin e pasaktë të numërorit të pakufishëm të gjinisë femërore në vend se të përdoret gjinia mashkullore:

Na lejuan që të jemi shërim për njëra tjetrën., në vend se të thuhet: për njëri tjetrin.

Të përsëritshme janë foljet e përkthyer në fjali të mënyrës urdhërore të përdorura gabimisht, si p.sh.:

Bëre atë çfarë thotë sulltanësja . Për: Bëje atë çfarë thotë sulltanësja.

Shko dhebëre diku tjetër. Për: Shko dhe bëje diku tjetër.

Me gjithë këto përkthime të pasakta, gabime e lëshime, adhuresi i serisë televizive do ta kuptojë domethënien e fjalisë, mbase nuk do t'i shkojë asgjë huq nga të shikuarit dhe të kuptuarit e përmbajtjes së filmit, por po t'i kthehemi aspektit gjuhësor dhe drejtshkrimin të fjalive të përkthyer, atëherë ndeshim parregullsi dhe anomali të mëdha gjuhësore në gramatikë, në sintaksë dhe në rendin e fjalive po ashtu.

Gabime dhe lëshime të tilla vërehen jo vetëm tek këto seri, por edhe në përkthimet e filmave të tjerë dhe përgjithësisht në programet e tjera televizive, mirëpo punimi në fjalë është mbështetur vetëm në përkthimin e filmave serikë turq.

Programet e radios dhe të televizionit si edhe i gjithë shtypi ditor, javor e mujor, më herët (mendoj në periudhën menjëherë pas mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimin në Tiranë në nëntor të vitit 1972, kanë qenë shembull i përdorimit dhe

i respektimit të gjuhës së unifikuar letrare, “të zbatueshme nga të gjitha institucionet kulturore, arsimore dhe botuese të Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e deri në diasporën historike shqiptare”.⁴ Në këtë drejtim janë bërë përpjekje të mëdha që të mos lëshohen gabime gjuhësore dhe përfillja e standardit ka qenë në nivel të lakmueshëm. Mirëpo, sot kjo dukuri sikur nuk ua vranë veshin përgjegjësve të medieeve elektronike e më gjerë dhe mosrespektimi i përdorimit të drejtë të gjuhës letrare shqipe i ka kaluar kufijtë e normales.

“Përvetësimi i gjuhës standarde në të vërtetë shpreh vetëdijen e krijuar se vetëm gjuha që përfaqëson krejt kombin, domethënë se vetëm gjuha e përbashkët gjithëkombëtare mund të përmbushë kërkesat e tij më të larta shpirtërore.”⁵

Kultura e gjuhës së një populli është pjesë përbërëse e cultures, jo vetëm profesionale, por edhe kombëtare. Njëpërmjet gjuhës shprehim mendimet tona, përhapim dije, etj., “që do të thotë se është në marrëdhënie të ngushta me çdo fushë studimi, me risitë dhe frytet e tyre, me përhapjen kulturore dhe me çfarëdo zhvillimi të natyrshëm a shndërrimi të hovshëm shoqëror, ekonomik dhe ideor.”⁶

Përderisa, për shembull një Amerikë, me shumë milionë banorë, flet, shkruan dhe komunikon me një anglishte amerikane (American English) dhe e respekton standardin e saj, a thua se ne shqiptarët e kemi të vështirë ta bëjmë të njëjtën gjë?

“Kultura e gjuhës është e domosdoshme për çdo shkrimtar, për çdo gazetar, për çdo intelektual, për çdo njeri. Ai që nderon gjuhën, nderon atdheun. Përpikëria, qartësia, thjeshtësia dhe koloriti i gjuhës janë aq të nevojshme për çdo shkrimtar sa gjithë veglat e punës për punëtorin”.⁷

Ndaj mendimin se duhet të vetëdijësohemi më tepër dhe të ndërgjegjësohemi në vijimësi, sa i përket aspektit gjuhësor, kur dihet se pothuajse çdo gjë në jetë e kemi të lidhur ose ka të bëjë drejtpërdrejt me gjuhën, me shkrimin e saj, që në fakt, edhe çdo shkrim i cilës do natyrë që të jetë mbetet vulë e pashlyer përgji-thmonë.

Një mendim të përafërt me atë që u tha më lart e dëshmon edhe studiuesja e gjuhës shqipe, Shefkije Islamaj:

“Shqetësimi kryesor i gjuhëtarëve dhe i të tjerëve duhet të lidhet me shkallën e zbatimit të normës dhe me mënyrën se si shkruhet në shqipen standarde”.⁸

Mendoj se vlera e një përkthimi të mirëfilltë qëndron edhe në mënyrën e përdorimit të drejtë të gjuhës në të cilën përkthejmë, përkatësisht shqipes, në të përshtaturit e fjalëve dhe shprehjeve nga njëra gjuhë në tjetrën, në respektimin e rregullave gramatikore, sintaksore dhe përshtatjen e rendit të fjalëve në fjali.

⁴ Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës, shulu Tiranë 2006, 16.

⁵ Gj. Shkurtaç, Kultura e gjuhës, shblu, Tiranë 2006, 23.

⁶ Po aty, 22.

⁷ Dritëro Agolli, “Gjuha jonë”, 1, 1986, 8.

⁸ Shefkije Islamaj, Gjuha dhe identiteti, Botimet TOENA, Tiranë 2008, 70.

PËRMBLEDHJE

Kohëve të fundit në mjetet e informimit në përgjithësi, si dhe në ato elektronike në veçanti po mbizotërojnë kalke dhe përkthime joadekuate në praktikën gjuhësore ndër ne. Jemi dëshmitarë të një cilësie jo të lakmueshme të përkthimit, që njëkohësisht përcillet me bastardim të gjuhës shqipe e në shpërputhje të plotë me standardin e gjuhës së sotme shqipe.

Shembuj të përkthimeve të pasakta, gabimeve gjuhësore, lëshimeve dhe të një redakture të dobët gjuhësore ka mjaft dhe këto janë përmendur si fenomene që lëndojnë pastërtinë e gjuhës, mungesën e leksikut të pasur të gjuhës sonë dhe vjeljen shumë të varfër të fjalëve burimore të gjuhës shqipe. Me këtë rast kemi parasysh injorimin e fondit leksikor të shqipes dhe inkuadrimin e ngulmët, të panevojshëm të fondit të huaj leksikor. Vlen të theksohet se nga një varg përkthimesh krijohen parregullsi të mëdha sintaksore e gramatikore, renditja e çakorduar e fjalive dhe lëndimi i paskrupullt i vlerave të njëmendta të kulturës gjuhësore shqiptare.

Valbona GASHI - BERISHA

INTERPRETIMI I MITIT MODERN – RASTI KADARE

Shkrimet e Kadaresë janë veçanërisht të rëndësishme kur bëhet fjalë për interpretimin e mitit modern. Personazhet e tij vijnë nga tradita e popullit shqiptar dhe në cilësinë e avokatit, Kadare paraqet karakterin e mirëfilltë të njeriut me vlerat më të larta njerëzore. I tërë universi i Kadaresë sillet rreth njeriut, njeriut me cilësi të trashëguara nga thellësia e historisë shqiptare : **nderi** dhe **besa** janë vlera të shenjta që janë ruajtur brez pas brezi dhe kanë marrë formën e mitit. Këto vlera, Kadare nuk i përshkruan, por i paraqet në formën e tyre shumë dimensionale.

Duke shkruar për mitet, Kadare u jep veprave të tij një domethënie simbolike. Ai është përshkruar i mirë edhe i kanunit në *Prilli i thyer*, pastaj edhe si rapsod me *Kush e sollti Doruntinën ?* dhe *Ura me tri harqe*. Dy legjendat « Konstantini dhe Doruntina » dhe « Kështjella e Rozafës » shërbejnë si shembull i kulturës shqiptare e cila mbijetoi gjatë shekujve e që Kadare i ringjalli këto legjenda dhe ua ktheu identitetin e tyre të vërtetë. Për të kuptuar më mirë krijimin e mitit të Kadare, është mirë të kemi disa ide rreth termave që i përkasin kësaj fushe.

Sot termi „mit“ dhe „mitologji“ është mjaft aktual dhe po tregon një ndryshim të theksuar në fushën e njohurive akademike sidomos në Francë, Itali dhe Gjermani. Është një çështje shumë e rëndësishme në fushën e studimeve letrare, veçanërisht në atë të letërsisë së përgjithshme dhe krahasuese, e po ashtu edhe në art, filozofi dhe shkencën në përgjithësi.

Ç'është miti sot ? pyet Roland Barthes në pjesën teorike të *Mythologies*. « Miti është një fjalë »¹. Faktikisht, në mënyrë etimologjike, muthos do të thotë, në greqishte : « fabulë, tregim ». Northrop Fry, duke u bazuar nga *Poetika* e Aristotelit, bën një dallim në mes “mythos” dhe “mythe”. *Mythos* vjen nga greqishtja që paraqet « intrigë ose zhvillim të një historie faktike »². Sipas tij *mythos* ndahet në katër pjesë : « *Comedy, Romance, Tragedy, Irony&Satire* ». Termin « mythe » e paraqet si një lloj historie që ka të bëjë me zotin ose me çdo hyjni tjetër. Për të « mitet bëjnë pjesë në kMorpusin e historisë që secila shoqëri e ka në fazat e para të

¹ Roland Barthes, *Mythologies* [1957], *Œuvres Complètes*, 1952-1980, éd. présentée par Eric Marty, Paris, Seuil, 2002, t. 1-5, p. 823.

² Northrop FRYE, « *Littérature et mythe* », *Revue Poétique*, n°8, Paris, 1971, p. 489-514 (traduit de l'anglais par Jacques Ponthoreau).

zhvillimit. Ato janë të ngjashme, për nga forma e tyre, me historitë e tjera në të cilat dallojmë legjendat dhe tregimet popullore, mirëpo përmbajtja e tyre ka një element të një rëndësie të veçantë dhe primordiale »³. Kjo rëndësi e veçantë përmban dy lloj interpretimesh: interpretimi alegorik, karakteristike të tradita e krishterë, dhe interpretimi « arketipal », është kryesisht ajo e poetëve që qëllimi i tyre nuk është të interpretojnë, por të paraqesin. Në fakt, «interpretuesi ose komentuesi i mitit gjen kuptimin e thellë të mitit në domethënien e tij si *alegori*, poeti duke krijuar mitin gjen kuptimin e thellë në strukturën arketipale»⁴.

Northrop Fry paraqet një evolucion kronologjik. Në fillim janë mitet, histori të zotrave; pastaj „mitet organizohen në një shkrim të shenjtë që i përmbledhin të gjitha këto histori“; ky shkrim është quajtur „mitologji“, dhe „paraqet idenë që ka një shoqëri për lidhjen e saj me zotrat, paraardhësit dhe ligjin e natyrës“⁵. Këtu sipas N. Frye bëhet dallimi i theksuar në mes mitit dhe tregimit: tregimi ka „një histori kulturore *nomade*“ (në mbarë botën), ndërsa miti „rritet në lidhje me një religjion që ka rrënjët në një kulturë“. Disa vite më pas N. Frye shkruan se „mitet që nuk u besojmë më, të cilët nuk kanë të bëjnë me kultin dhe ritualin, shndërrohen në letërsi të pastër“⁶.

Këtu paraqitet vështirësia për të dalluar „identitetin në mes letërsisë dhe mitologjisë“. Shpjegimi sipas Frye është në potencialitetin letrar që përmban çdo mit:

[...] është i pamohueshëm fakti që tërë shkrimi i mitit, i tregimit popullor, i legjendës dhe i gjithë asaj që del nga tradita gojore, tanimë bënë pjesë në një nga aspektet e letërsisë ; nuk ka asgjë tjetër që do të transformohej në letërsi. Është vetëm një ekonomi e të shprehurit që ne flasim për një mit, për një tregim popullor ose për një legjendë ; asnjë nga këto subjekte nuk ekzistojnë realisht vetëm nëse është në formën verbale specifike, dhe kjo formë verbale është një formë letrare.⁷

Në fjalorin e sotëm mund të gjejmë shpjegime të ndryshme sa i përket fjalës mit, mirëpo kohëve të fundit kjo fjalë është e lidhur ngushtë me fjalën „e shenjtë“ dhe „originë“. Këtë më së miri e qartëson definicioni i Mircea Eliade: „Miti tregon një histori të shenjtë ; lidh një ngjarje që ka ndodhur në kohën fillestare, kohën e mrekullueshme të fillimeve“⁸. Krahas këtij definicioni, ka edhe studime tjera sidomos studimet që janë bërë në Francë viteve të fundit, të cilat mitin e konsiderojnë si diçka që nuk ekziston. Kjo “shkollë franceze“ e përbërë nga Jean-Pierre Vernant, Marcel Détiene, Vidal-Naquet etj., shkruan se :

³ Ibid., f. 495-496.

⁴ Ibid., f. 498.

⁵ Ibid., f. 490.

⁶ Northrop Frye, *La Parole souveraine*, Paris, Seul, 1994, f. 54.

⁷ Ibid., f. 495.

⁸ Mircea Eliade, *Aspect du mythe*, Paris, Gallimard, 1963, f. 15.

« Miti është një koncept që antropologët e kanë huazuar, kuptohet prej traditës intelektuale të Perëndimit : shtrirja e tij nuk është universale ; nuk ka kuptim të njëzëshëm, nuk përshtatet me asnjë realitet specifik. Me një fjalë, fjala mit nuk nënkupton asgjë⁹.

Mirëpo, mitet janë « shpirti » i veprës letrare, thoshte Aristoteli në *Poetikë* dhe Platoni në *Republikë* i quante poetët « mjeshtër të mitit ». Duke u bazuar në këto shprehje mund të themi se është në interes të historisë, filozofisë e po ashtu edhe të letërsisë të studiohet zhvillimi dhe çështja ideologjiko-politike e konceptit të mitit, të dihet dhe të shpjegohet se si dhe pse duke u nisur nga fjala greke e kemi përpunuar konceptin e mitit.

Fjala „mitologji“ përdoret gjithashtu në ditët e sotme dhe ka të bëj me një sistem të vlerave bashkëkohore. Gjatë vitit 1950, shkencëtari strukturalist francez Roland Barthes publikoi një seri të analizave semiotike të miteve moderne, dhe krijimtarinë e tyre e përmbledhi në librin *Mitologjitë*. Në këtë libër, ai përshkruan mitet nga më të ndryshme si vera, citroeni, fytyra e Greta Garbos etj. Ai analizon gjithashtu fenomenin e vet mitit dhe thotë se miti është një shenjë : „Secili objekt në botë mund të kalojë nga një ekzistencë e mbyllur, pa zë, në një gjendje tregimi (gojore), e gatshme të përshtatet në shoqëri“¹⁰.

Në saje të ideve të reja të strukturalizmit dhe antropologjisë historike, studimet mitologjike nuk përkufizohen më me iden hermeneutike të miteve ((hermeneutique) art interpretimi, është teori e leximit, e shpjegimit dhe interpretimit të teksteve.), dhe pasurohen duke iu afruar gjithnjë e më shumë antropologjisë.

Strukturalizmi në mitologji është lansuar veqanërisht me artikullin e Claude Levi-Strauss „Struktura e miteve“ në librin *Anthropologie structurale* në 1958. Ai paraqet mitet në një vijë, gjatësi narrative, që supozohet se kanë ekzistuar si të tilla, jashtë çdo konteksti, në formë të tregimeve gojore të transmetuara nga gjenerata në gjeneratë dhe nga një shoqëri në tjetrën. Pas ideve të Levi-Strauss, strukturalizmi ka dhënë lloje të ndryshme të studimeve, sidomos në domenin grek me studiues si Jean-Pierre Vernant, Pierre Vidal-Naquet, Marcel Detienne.

Nocioni i « mitit modern » bën pjesë përtej interpretimit socio-historik të mitit, sipas analizës së Jean-Pierre Vernant, i cili e vë në opozitë epokën e mitit, atë me të para *Republikës* së Platonit, në pajtim me Logos, të mendimit racional që mitin e konsideron të padobishëm. Teoricientë të tjerë, si Mircea Eliade, theksojnë më tepër universalitetin e miteve antike, qëndrueshmërinë e mitit deri në modernitet, bashkëjetesa e tij me historinë. Për këtë Eliade cek vështërsinë e shkencëtarëve për të gjetur definicione të pranueshme për mitin dhe në fakt thotë se varet nga leximi i

⁹ Jean-Pierre Vernant, « Le mythe au réfléchi », Le Temps de la réflexion, n°1, Paris, Gallimard, 1980, f. 22.

¹⁰ Roland Barthes, *Mythologies*, Paris, Seuil, 1957, f. 216.

teoricientëve të mitit që çdo tentativë për definim të konceptit tani më është interpretim:

„Përveç kësaj, a është e mundshme të gjindet një definicion i vetëm që mund të përfshijë të gjitha llojet dhe funksionet e miteve, në të gjitha shoqëritë arkaike dhe tradicionale? Miti është një realitet kulturor mjaft kompleks, i cili mund të shtjellohet dhe interpretohet në perspektiva të shumta“.¹¹

Përkundër asaj që mendohet se miti i takon kohës antike, në ditët e sotme kemi shumë më shumë mite se në të kaluarën dhe terminologji të shumta. Njëri prej tyre është edhe termi “mitopoetikë” i cili është dhënë kohëve të fundit nga Pierre Brunel si një vazhdim i “mitokritikës” për të parashikuar pranimin dhe zbulimin e miteve. Termi “mitokritikë” është që nga fillimi i rrënjësuar në “psikologjinë e thellësive” dhe e ka zëvendësuar “mitanalizën” që e ka dhënë Denis Rougemont¹² dhe e ka vazhduar Gilbert Durand: “psikalanlizës së Frojdit i përgjigjej mitanaliza e Denis Rougemont. Psikokritikës së Charles Muron i përgjigjet mitokritika e Gilbert Durand”, shpjegonte Pierre Brunel¹³.

Mund të themi si përfundim se nuk është çështja këtu të japim një konkluzion të këtyre teorive mbi mitin por të lëmë hapsirë për studime të mëtejme në këtë fushë të gjerë të territoreve mitike dhe të gjinden kufijtë që letërsia i tejkalon. Nëse letrari është një *homo viator* (njeri udhëtar), është, sepse dëshira e tij është të tejkalojë kufijtë dhe se historia e miteve u jep një shembull këtyre shkeljeve krijuese.

Merita më e madhe e Kadaresë është se përmes shkrimeve të tij arriti të tregojë historinë e Shqipërisë, mitet dhe legjendat e saj që udhëtuan nëpër kohë e që morën identitetin e duhur në letërsinë moderne dhe postmoderne. Kadare i shndërroi mitet në realitet dhe realitetin në mit. Duke i modernizuar mitet, autori tregon historinë e Shqipërisë, e cila gjindet në një udhëkryq e që sistemi totalitar nuk mundi të prishte folenë e miteve dhe legjendave. Ai nuk ngurroi të përdorte këto mite dhe legjenda për t'i shndërruar në simbole. U bë edhe vetë simbol. Simbol i Shqipërisë, sikurse Eskili, simbol i Greqisë. Dy mijë e pesëqind vjet më vonë, Kadare mori rrugën e mërgimit për të shkuar gjurmëve të Eskilit, për të vazhduar mitin e tij dhe në një mënyrë “të gjej te ai pishtarin e vet“¹⁴.

Kadare, sikurse Eskili, i vendos personazhet në një univers mitik ku nderi dhe dinjiteti i njeriut udhëhiqen nga rregulla shoqërore të krijuara në një kohë të caktuar. Duke e ndjekur rrugën e Eskilit dhe të Homerit, Kadare krijon personazhe të përjetshme në atë mënyrë që miti „liron njeriun modern nga provincializmi i tij

¹¹ Mircea Eliade, *Aspect du mythe*, Paris, Gallimard, 1963, f. 16.

¹² Shih, Denis Rougemont, *Les Mythes de l'amour*, Paris, Albin Michel, 1961 (réédition Gallimard, coll. “idée”, 1972, f. 25.

¹³ Pierre Brunel, *Mythocritique, Théorie et parcours*, Paris, PUF, “Litterature”, 1992, f. 46-47.

¹⁴ Éric Faye, *Ismail Kadaré, Prométhée porte-feu*, Paris, José Corti, 1991, f. 9.

kulturor“ për t’i dhënë „një dimension të ri ekzistencial“¹⁵. Duke u nisur nga ky parim, Kadare gjen inspirimin e tij në mite, legjenda dhe balada dhe këtë inspirim e vendos në një dimension të ri të ditëve të sotme. Ky dimension i universit të Kadaresë krijon vepra, që janë vepra monumentale, të përjetshme.

Nga të gjitha romanet, *Prilli i thyer*, është vizioni i mitit me dimension tragjik, ku gjaku këtu paraqitet si barometër i çështjes njerëzore. Realiteti në këtë roman është i tmerrshëm dhe në kundërshtim me normat humane që njeriu i krijoji gjatë ekzistencës. Gjakmarrja dhe besa këtu marrin vlera mitike dhe kulti i tyre bëhet simbol i indentifikimit të popullit shqiptar. Edhe gjakmarrja edhe besa janë kulte të pacënuara që Kadare i përshkruan në mënyrë origjinale duke i dhuruar kështu lexuesit vlerat morale të vetëdijes së njerëzimit që janë aktuale edhe në ditët e sotme. Gjakmarrja si temë kryesore është paraqitur në shumë vepra letrare, duke u nisur prej autorëve grekë, si Eskili, për të vazhduar me autorë si Shekspiri dhe autorë të shumtë ku gjakmarrja luan rolin e gjykimit njerëzor. Kadare ka ditur t’i marrë normat e Kanunit dhe t’i parqesë me vlera letrare pa prekur në realitetin e hidhur që përjeton njeriu kur gjindet në labirintin e gjakmarrjes. Origjina e gjakmarrjes vjen zakonisht pas ndonjë shkeljeje nderi, e cila çon deri në zënka familjare e që këto zënka përfundojnë me derdhje gjaku. Kjo gjendje tragjike vazhdon me vite të tëra. Mjafton një derdhje gjaku që vrasësi të futet në një sistem të mbyllur. Kështu « ...në shtëpitë ku kishte hyrë gjaku, kishte një tjetër rrjedh ditësh dhe stinësh, një si dridhje të brendshme dhe njerëzit dukeshin si më të bukur ...¹⁶.

Në *Prillin e thyer*, Kadare ka dashur të tregojë fenomenin tragjik të gjakmarrjes, një univers i Atridëve në ditët e sotme. Ai e gjen mënyrën letrare të inspirimit tek Eskili, mirëpo, realiteti i jetës së përditshme ishte një bashkëdyzim që dha romanin me ndjenja nga më tragjike. Këtë më së miri e afirmon E. Faye, i cili thotë se Kadare « ka vendosur në *Prillin e thyer* ndjenën tragjike dhe frymëmarrjen që ngjall *Orestin* »¹⁷.

Fati i personave në gjakmarrje është se ndjena e tyre nuk i lë të qetë në asnjë çast, ata mund të reagojnë në çdo kohë, në çdo vend vetëm që të kryejnë detyrën që e kanë obligim.

« Një nga veçoritë e gjakmarrjes është se mund të shpërthejë në çdo moment në një shpirt, qoftë në atë të një njeriu të dashur dhe të qetë sado pak, që një ofendim i rëndë ka ardhur të zgjojë në te nevojën shekullore të bëjë drejtësi për vete ». ¹⁸

¹⁵ Mircea Eliade, *Image et symbole*, Paris, Gallimard, 1952, f. 44.

¹⁶ Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë 2003, f. 34.

¹⁷ E. Faye, op., cit., f. 170.

¹⁸ Valbona Gashi, *Perspectives comparatistes à partir de l'œuvre de S. Frasheri*, A.N.R.T., Lille, 2000, f. 213.

Gjakmarrja vjen si rezultat i ruajtjes së nderit të familjes që është detyra kryesore e imponuar nga ligji i natyrës. Çështja më e rëndësishme për Gjorgjin, personazhin e *Prillit të thyer*, është jo vetëm të marrë gjakun e humbur dhe t'ia kthejë nderin familjes, por edhe të tregojë për burrërinë e tij. Gjorgji është njeriu i vetëm i cili e paramendon vdekjen e Zef Kryeqyqes, e cila është e lidhur me vdekjen e tij dhe se varrimi është gjithashtu i tij. Është hero i gjakmarrjes dhe roli i tij është të pranojë fatin duke iu afruar vdekjes pa asnjë dridhje. Në këtë gjendje shpirtërore ai shprehet: «Dy gishta nderi mbi ball... Ai prekte ballin me dorë, si për të gjetur përkitas vendin ku mund të ishte nderi» “Nderi e ka vendin e vet në mes të ballit, sepse ky ishte vendi ku plumbi duhej ta prekte kokën e tjetrit”¹⁹.

Ekzistenca e tij si hero nuk do të zgjaste shumë. Ai duhej të përfitonte sa më shumë në fatin që iu kishte rezervuar që para lindjes në këtë zonë “ku rregullat e vdekjes sundojnë mbi ato të jetës”²⁰. Bota e të gjallëve dhe bota e të vdekurve janë të lidhura aq ngushtë njëra me tjetrën sa që personazhet e Kadaresë shndërrohen në mit dhe jetojnë botën mitologjike moderne me një realitet ku gjaku jep jetën, por edhe e merr. „Kështu, Kadare, i inspiruar nga Eskili, Shekspiri dhe shumë autorë të mëdhenj, ka shkruar më larg sesa ata jo vetëm për nga rëndësia e ligjit të lashtë, për nga tmerrri i detajeve, por edhe për nga tema e gjakut”²¹.

Tërë procesi i gjakmarrjes ndodh gjatë ditës dhe para syve të lexuesit, mënyrë kjo që të shihet më mirë fuqia e tmerrit të gjakut. „Për Gjorgjin gjithçka është përcaktuar më heret, ora e vdekjes është një moment që e pret. Ai e gjen vdekjen në mbarim të ditës në mënyrë që gjakmarrja të mund të rifillojë qysh të nesërmen...Mund të themi se në *Prillin e thyer*, vdekja i jep një lloj fisnikëri jetës”²².

Fati i Gjorgjit është shënuar në gurët e kullës së Oroshit dhe pikërisht në këtë kullë ai duhet të paguaj tatimin që e ka marrë gjakun e pastaj ai mund të presë në mënyrë të ndershme vdekjen. Nëse tragjedia greke tregon pafuqinë e njeriut para asaj që është e shkruar në qiell në romanin *Prilli i thyer*, njeriu është i pafuqishëm përball Kanunit. „Ky Kanun, i cili i nxit njerëzit të marrin gjakun në emër të nderit, e përgjon edhe gjestin më të vogël të personit që duhet të marrë gjakun. Në këtë aspekt Kanuni është më i ashpër sesa Erinit e Eskilit „Erinit nuk i ndiqnin të gjithë vrasësit sikurse është rasti te Kanuni, mirëpo vetëm ata që kanë bërë që të derdhet gjaku i vet (familjes së qumshtit). Ato akuzojnë djalën që e vret nënën, por jo gruan që vret burrin”²³.

¹⁹ Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, op., cit., f. 45.

²⁰ Ibid., f. 66.

²¹ Valbona Gashi, op., cit., f. 218.

²² Ibid., f. 218.

²³ Ibid., f. 224.

Të gjithë e dinë mitin e besës në dimensione të ndryshme e sidomos atë të gruas së murosur. Kjo legjendë është shkruar shumë herë në ciklin epik shqiptar të titulluar si: Kështjella e Shkodrës, Ura e Artës... Tema e murosjes është paraqitur gjithëherë si fljirim i një personi që kërkon ura ose kështjella. Zakonisht në të gjitha legjendat është një grua që fljohet, ndërsa në *Ura me tri harqe* të Kadaresë, fljohet një burrë, Murrash Zebenishte, i vrarë nga muratorët ndoshta para se të murosej. Në këtë roman, kronika e priftit Gjon është një narracion i historisë dhe imagjinatës e paraqitur në vitin 1377. Këtu prifti Gjon shkruante historinë e urës së mallkuar Ouyane për të transmetuar dualitetin në mes të legjendës dhe të vërtetës. Pesë shekuj më vonë, Tungj Hata, në *La niche de la honte*, kalon urën e mallkuar, me kokën e Ali Pashë Tepelenës. Kjo urë i përkujton se këtu ka ndodhur epizodi i parë dhe ishte skuqur nga gjaku i turqve.

Pritja e vdekjes së Murrash Zebenishtës në *Ura me tri harqe*, na bënë të mendojmë për vdekjen e Gjorgjit të *Prilli i thyer*, kronikë e gjatë e një vdekjeje të paralajmëruar. Këto dy personazhe bëhen të famshëm prej momentit kur vdekja zbukuron imazhin e tyre.

Te Kadare miti është prezent në të gjitha shkrimet dhe elementet që e krijojnë atë janë të theksuara edhe në romanin *Ura me tri harqe*. Në këtë legjendë ura bëhet miti më i madh dhe fenomeni i lashtë i fljimit, murimi i qenies njerëzore në themelet e një ure apo të një kështjelle, ka të gjitha tiparet e një simboli. Rrëfimi i autorit në këtë roman është i jashtëzakonshëm dhe misteri i çështjes së murimit shndërrohet në simbol. Përshkrimi i detajizuar dhe konkret i figurës së njeriut të murosur i jep tekstit simbole që e lidhin atë me kompleksitetin dhe ndërvidjen e njeriut. Pothuajse në të gjitha variantet, femra është viktima e cila fljohet. Figura e femrës është simbol që lidh, në një rënë anë burrin, i cili e ka mbajtur besën dhe, në anën tjetër fëmijën si vazhdimësi e jetës. Fati i saj tragjik, pra përcaktohet nga burri i saj, zakonisht është vëllai i vogël, ai që e mban besën. Ajo që e bën femrën e fljuar si figurë mitike është dëshira e saj të ruajë funksionet e saj si nënë:

„Nusja që po murohej, u lutej vrasësve që t'i linin njërin gji jashtë murit në mënyrë që edhe pas vdekjes të mund të mëkonte foshnjen“²⁴.

Femra e fljuar nuk kundërshton në asnjë rast, ajo e çmon lart virtytin e besës që burri i saj e ka mbajtur dhe krahas dëshirës për lidhjen e saj me djalin, ajo shpreh edhe dëshirën që burri i saj besnik të martohet dhe të vazhdojë jetën.

Derisa në legjendë përshkruhet nusja e murosur që lë gjirin jashtë për të ushqyer djalin e lënë, te *Ura me tri harqe* është përshkrimi misterioz që Kadare i jep tekstit duke e futur lexuesin në labirintin e mitit. Këtu lexuesi gjindet në botën mitike, ku fjala e dhënë ka rëndësinë e filozofisë së jetës dhe i tërë rrëfimi paraqet efektet emocionale të familjes.

²⁴ Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Onufri, Tiranë, 2008, f. 90.

Kadare nga një aspekt alegorik e paraqet pozitën gjeografike të Shqipërisë si një rrugë kalimi me një urë me tri harqe, secili i ngritur nga të huajt gjatë pushtimit të gjatë: Romak, Bizantin dhe Turk. I fljuari simbolizon popullin e përndjekur shqiptar.

Te Kadare ura nuk është një urë bashkimi apo lidhjeje, por një urë kërcënimi dhe pushtimi, një urë mbi të cilën do të kalojnë pushtuesit e Azisë drejt Evropës. Murgu Gjon e shpreh shqetësimin e vet çdo ditë dhe thotë se :”Në të gjitha viset e Ballkanit ushtritë turke po bëjnë manovra të mëdha”²⁵.

Nëpërmes mitit, Kadare shpreh interpretimin e historisë së popullit shqiptar. Miti i flijimit ka ekzistuar qysh në shkrimet e para të letërsisë antike greke. Një nga shembujt e shumtë është flijimi i Ifigjenisë, vajzës së Agamemnonit, i cili ka frymëzuar shumë autorë ndër të cilët është edhe Kadare. Interpretimi modern i mitit të flijimit është stili i veçantë që Kadare i ka dhënë nëpërmes imagjinatës së tij krijuese.

Gjithpërfshirja e besës të Shqiptarët ka krijuar një mit të vërtetë. Madje edhe në botën e të vdekurve, miti i besës ka një kuptim sublim. Shembulli më i mirë i kësaj bese është te legjenda *Konstantini dhe Doruntina*, e njohur edhe me tituj të tjerë si *Fjala e dhënë*, *Udhëtimi i vëllaut të vdekur*, *Kalërimi i të vdekurit*. Këtu besa shqiptare mbretëron në mendjen e secilit duke transmetuar kulturën e pasur të legjendave që arritën të mbijetojnë deri në ditët e sotme. Legjenda *Konstantini dhe Doruntina* përmban elementin e besës që lidh jetën me vdekjen: „forcë sublimë, e aftë të forcoj ligjet e vdekjes“.

Historia e kësaj legjende prek thellë në bredësinë e koshiencës së secilit prej nesh. Ngjarja zhvillohet në mes të ëmës së Konstantinit dhe vëllezërve të tij, të cilët refuzonin martesën e Doruntinës me një të huaj të largët. Vetëm Konstantini, vëllau më i vogël prej 12 vëllezërve, ka insistuar për këtë martesë dhe i ka dhënë besën të ëmës se çdoherë që ajo dëshiron të ketë Doruntinën pranë, ai do t’ia sjellë. Besa luan rolin kryesor në vendimin e kësaj martese dhe lidhjes së fortë në mes Konstantinit me nënën e tij. Pas martesës së Doruntinës, një tragjedi ndodhi në familjen e saj: lufta ia mori të dymbëdhjetë vëllezërit. Tani besa nuk mund të realizohet dhe krahas dhembjes për humbjen e djemve dhe mallin për të parë të bijën, nëna përkujton besën. Dhembja e saj është aq e madhe sa që kur shkon mbi varrin e Konstantinit e vajton dyfish dhe ndez dy qirinj, për dallim nga varret e tjera ku ndez një qiri. Për shkak të shkeljes së besës, dhembja ishte dyfishuar : besa ishte tanimë e varrosur, ajo gjindej nën dhe së bashku me Konstantinin:

²⁵ Ibid., f. 139.

„Konstantin, të ardhhtë gjëma,
Ku e ke besën që më dhe,
Besa jote nën dhe! »²⁶

Fuqia e besës i tejkalon të gjitha. Kjo fuqi e ngrit nga varri Konstantinin dhe e bën hero në të dy botërat. Është hero i mitit, jo vetëm i të gjallëve, por edhe i të vdekurve. Ai kryen veprimet e një heroi dhe përmbush detyrën duke sjellë të motrën nga vendi i largët dhe kur afrohet te shtëpia e lë dhe kthehet në varr. Udhëtimi i Konstantinit me Doruntinën, pas mallkimit për shkelje të besës, ka diçka madhështore e në të njëjtën kohë është edhe reale edhe joreale. Reale, sepse Konstantini e kishte dhënë besën dhe joreale, sepse kishte vdekur. Një udhëtim fascinues i të vdekurit dhe i të gjallit i ka gjurmët nga mitologjia e vjetër e besës, prej nga Kadare e merr dhe e paraqet në *Kush e solli Doruntinën?*: „Secili prej nesh ka pjesën e vet në këtë udhëtim, sepse besa e Konstantinit, e cila e solli Doruntinën, ka dalë këtu në mesin tonë“²⁷.

Dimensioni i besës është i pranishëm kudo në jetën e përditshme : mund ta gjejmë edhe nëpër rrugë (rrugë e besës), fenomen i veçantë të shqiptarët e që Kadare i dha një ngjyrë jete në romanet *Prilli i thyer* dhe *Eskili ose humbësi i madh*: „...në disa krahina të Shqipërisë, rrugë të tëra shpallehin „në besë“, domethënë të siguruara plotësisht për këdo që udhëtonte nëpër to“²⁸.

Për të treguar fisnikërinë e popullit shqiptar Kadare, « mitolog », i jep shkrimeve të tij një forcë sublime që i vë ato në nivel të mitit. Kanuni i ka shërbyer Kadaresë si thesar me perla për të krijuar vepra nga më madhështore të vlerave të shqiptarëve. Një nga këto vlera është besa, fjala e dhënë, prezente në çdo roman, në çdo legjendë dhe në çdo baladë të Kadaresë.

Shkrimtar i Kohës moderne, Kadare tejkalon kufijtë e mitit duke i modernizuar tragjeditë greke në mënyrën më origjinale, jo në formën sikurse që e ka përpunuar Sartri *Orestin* në *Les mouches*, ose Girodu në *Elektrën*, por në formën më të mundshme reale të identitetit shqiptar.

Bibliografi

1. BARTHES, Roland *Mythologies* [1957], *Œuvres Complètes*, 1952-1980, éd. présentée par Eric Marty, Paris, Seuil, 2002, t. 1-5.
2. BRUNEL, Pierre (1992), *Mythocritique, Théorie et parcours*, Paris, PUF, “Litterature”.

²⁶ Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën ?*, Onufri, Tiranë, 2004 f. 64.

²⁷ Ibid., f. 188.

²⁸ Ismail Kadare, *Eskili ose humbësi i madh*, Onufri, Tiranë, 2009, f. 308.

3. ELIADE, Mircea (1963), *Aspect du mythe*, Paris, Gallimard.
4. ELIADE, Mircea (1952), *Image et symbole*, Paris, Gallimard.
5. FAYE, Éric, Kadare, Ismail (1991), *Prométhée porte-feu*, Paris, José Corti.
6. FRYE, Northrop, (1991), *Littérature et mythe*, Revue Poétique, n°8, Paris, (traduit de l'anglais par Jacques Ponthoreau).
7. FRYE, Northrop (1994), *La Parole souveraine*, Paris, Seul.
8. GASHI, Valbona (2000), *Perspectives comparatistes à partir de l'œuvre de S. Frasheri*, A.N.R.T., Lille.
9. KADARE, Ismail (2003), *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë.
10. KADARE, Ismail (2004), *Kush e sollli Doruntinën?*, Onufri, Tiranë.
11. KADARE, Ismail (2009), *Eskili ose humbësi i madh*, Onufri, Tiranë.
12. KADARE, Ismail, (2008) *Ura me tri harqe*, Onufri, Tiranë.
13. ROUGEMONT, Denis, *Les Mythes de l'amour*, Paris, Albin, Michel, (1961), (réédition Gallimard, coll. "idée", 1972).
14. VERNANT, Jean-Pierre (1980), *Le mythe au réfléchi*, Le Temps de la réflexion, n°1, Paris, Gallimard.

Berton SULEJMANI

GAZETA “FLAKA E VËLLAZËRIMIT”¹ DHE GJUHA SHQIPE

Siç dihet, gjuha e shtypit, sjell disa karakteristika që dalin, para se gjithash, nga funksionet themelore të shtypit si mjet i informimit publik, siç janë: funksioni komunikues, ekspresiv, impresiv, kontaktues e poetik, nga të cilat, tri të parat janë kryesore². Gjuha e shtypit është e llojllojshme. E karakterizojmë si të tillë sepse shprehjet gjuhësore të shtypit paraqesin dallime edhe atë varësisht nga lloji/gjinia i/e gazetarisë. Çdo gjini e gazetarisë shtron kërkesa të ndryshme para gazetarit që më pastaj reflektohen edhe në gjuhë. M’u për këtë arsye mund të flitet dhe për stile të veçanta të llojeve të gazetarisë. Por, marrë në përgjithësi në aspektin e gjuhës mund t’i ndajmë në një të ndërmjetme anë llojet e informimit (lajmin dhe raportimin) dhe komentin si gjini analitike (me nënlojet: shënimin, kronikën shoqërore, artikullin dhe recensionin) dhe nga ana tjetër intervistën dhe reportazhin. Te të gjitha gjinitë e lartpërmendura mbizotëron ndonjë nga funksionet e gazetarisë (te lajmi – funksioni komunikues, te reportazhi – funksioni ekspresiv, e kështu me rradhë), por një element, për të gjitha gjinitë e gazetarisë është i përbashkët: duhet të shkruhen në gjuhën letrare (d.m.th. gjuhën standarde, në kët rast në shqipen standarde) gjegjësisht duhet të shkruhen në përputhje me normën letrare.

Gjuha e shtypit tonë ka qenë, është dhe vazhdimisht do të jetë objekt i vëmendjes së gjuhëtarëve shqiptarë të cilët, shtypin, kryesisht e shikojnë nga këndvështrimi i zbatimit të standardit të shqipes. Objekt i këtij studimi është që të nxjerr në sipërfaqe nivelin e zbatimit të normës letrare të gazetës së përditshme³ (e cila më nuk botohet për arsye të panjohura) “Flaka e vëllazërimit” dy vjet para dhe pas Kongresit të Drjetshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), më saktësisht prej vitit 1970 - 1990.

Numri i parë i gazetës “Flaka e vëllazërimit” doli më 1 prill 1945 në Shkup. Dalja e një organi si ky, në mjediset gjuhësore të Shkupit, Tetovës, Kumanovës, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës, Strugës, Ohrit, Manastirit, d.m.th. në këto treva shqiptare të ish-Jugosllavisë (sot Maqedoni) kishte një rëndësi të madhe, përveç të

¹ “Flaka e vëllazërimit” ishte organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë.

² , Журналистическо маисторство, (përkthyer nga polonishtja), Sofje, 1980, fq. 68.

³ Në fillim gazeta ka dalur tri ditë në javë: të dielën, të mërkurën dhe të premten.

tjerave, edhe për përhapjen e ngulitjen e normës së gjuhës së shkruar letrare. Zbatimin e standardit të shqipes në gazetën “Flaka e vëllazërimit” e hasim edhe para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972). Numrat e viteve 1970 – 1972 mund të themi se luanin një rol kryekreje në pasqyrimin e prirjeve të shqipes standarde brenda dy vjetëve para Kongresit të Drejtshkrimit⁴. Gjeografia gjuhësore e shkri-meve kapte jo vetëm qytetet e Maqedonisë, por edhe të Kosovës e më gjerë. Që do të thotë se përfshinte të gjitha veçoritë e të folmeve që me punën e kujdesshme të redaktorëve njësoheshin mirë në faqet e gazetës. Nuk mungonin edhe shkrimet e autorëve joshqiptarë (serbë, kroatë, maqedonas) që i përkthenin e i redaktonin mirë. Është për t’u vënë në dukje që gazeta u ruajt mjaft mirë nga dialektizmat e krahinarizmat, të papranueshme për stilin publicistik. Që në shkrimet e para të vitit 1970, hasim dukuri fonetike e morfologjike që po bëheshin të mbarë shqipes standarde, si: shkrimi i grupeve të bashkëtingëlloreve (mb, nd, ng). Ja disa shembuj të nxjerrë nga nr. 971, 22 kallnor (janar) 1970: *Këto ditë Këshilli Ekzekutiv i RSM mbajti mbledhje nën kryesinë e nënkryetarit të Këshillit Morie Romano. (fq. 1)... në periudhën 1971 -1975 do të duhet kryesisht të sigurohet mbajtja e rrugëve, përfundimi i rregullt modernizimit dhe rikonsrtukcionit (për: rikonstruksionit) të drejtmeve të reja. (fq. 1); Ndërtesa e re shkollore tanimë është e vogël. (nr. 971/3; 22. I. 1970, fq.1); gjithashtu respektohet rregulli i shumësit të emrave dhe mbiemrave me –nj, si: kallinj, mullinj, të rinj, ullinj etj.*

Fill pas Kongresit të Drejtshkrimit, në gazetën “Flaka e vëllazërimit” u bë një punë e madhe për zbatimin e vendimeve të Kongresit. Kjo u krye në dy mënyra, së pari, me kujdesin që gjuha e shkrimeve të ishte sa më e pasur dhe e përpunuar, sipas normave të përcaktuara, dhe, së dyti, me rubrika të veçanta për njohjen e zbatimin e vendimeve të Kongresit⁵, me shkrime të mirëfillta shkencore, si të Androkli Kostallarit, Remzi Nesimit, Petro Janurës, Sefedin Sulejmanit, Xhevat Lloshit, Gjovalin Shkurtajt, Rexhep Ismajlit etj.

Megjithëse pas Kongresit të Drejtshkrimit kultura gjuhësore e shkrimeve dhe kërkesat ndaj tyre qenë rritur shumë, prandaj do të vëmë në dukje, pranë arritjeve më të mira, edhe shmangie të normës.

Në fushë të morfologjisë dhe drejtshkrimit. Në të gjitha shkrimet e rubrikave të ndryshme të gazetës (prej vitit 1970 deri para Kongresit të Drejtshkrimit) vërehet një punë shumë e mirë për ruajtjen e ë-së, sidomos në trup të fjalës, si p.sh.: *Në pikëpamje ushtarake - të zhdukeshin rrënjët e tradhtisë dhe të paaftësisë.* (FV, nr. 1007, 1 tetor 1970, f. 1); *Në fillim të vitit 1960 Naseri gjithnjë e më shumë paraqitet në plan të parë edhe në politikën botërore. (Po aty, në artikullin me titull “Vdiq Naseri – prijës dhe luftëtar për paqe”); Në parashikimet e gjertanishme konstatohet*

⁴ Hulumtimi përfshin periudhën 1970 – 1990.

⁵ Nga Maqedonia morën pjesë tre delegate: Petro Janura, Sefedin Sulejmani (sot të ndjerë) dhe Remzi Nesimi (ende është i gjallë).

se Komuna e Tetovës në periudhën e ardhshme të pesëvjeçarit. Gjatë kësaj periudhe priten të investohen më se 400 milion dinarë, kurse industria të jetë bartëse e aktiviteteve... (FV, nr. 1020/21, 31 dhjetor 1970, f. 3); *Shkrija e lehtë dhe përbërja e barabartë granulometrike, mundësojnë ndikim të shpejtë dhe efikas te kulturat bujqësore.* (FV, nr. 1019, 24 dhjetor 1970, f. 1); *Në këtë ditë u kremtua edhe pesëdhjetë vjetori i formimit të Komunës së kuqe.* (FV, nr. 1014, 19 nëntor 1970, f. 2) Në numrat e viteve 1970-1972 është bërë një punë e mirë edhe për mënjanimin e ë-së përpara prapashtesës –shëm. P.sh.: *Është i mundshëm edhe pastrimi poshtë mobileve. Shumë i përshatshëm për gratë-nënat* (FV, 17 dhjetor 1970, f. 6); ... *zhvillim të mëtejshëm në bazë barazie të plotë.* (FV, nr. 1014, 19 nëntor 1970, f. 1); *»Darwill« me elegancë të jashtëzakonshme, në modelet LADY 71 KALENDAR* (FV, nr. 1020/21, 31 dhjetor 1970, f. 8). Mospërdorimi i ë-së, sigurisht për arsye teknike, vërehet në të gjitha titujt e artikujve që janë shkruar me shkronja të mëdha. Në tekstet e po të njëjtëve tituj përdoret ë-ja, por mungon në titujt. P.sh.: **VASHA DHE NJE PASHA NE FONTANEN E MUZEUMIT TE VATIKANIT** (NJE për: NJË; NE për: NË; FONTANEN për: FONTANËN; TE për: TË) (16 tetor 1970, f. 5); **SEMINAR PER PUNETORET E ARSIMIT** (14 janar 1977); **PREZENTIM I SUKSESEM I POEZISE SHQIPE** (Po aty); **SUKSESE TE REJA PUNE** (30 janar 1977, f. 10) **PA VESHTIRESI TE MEDHA NE KOMUNIKACION** (11 janar 1985, f. 1); **DREJT TEJKALIMIT TE VENDOSUR TE DOBESIVE** (24 mars 1985, f. 6).

Dihet që numërori rreshtor, kur shkruhet me shifër romake, përdoret pa prapashtesë dhe pa nyje të përparme⁶: *klasa I, Kongresi V, Mehmeti II* etj. Kjo rregull respektohet në shkrimet e gazetës. Ja disa shembuj: *Në realizimin e transformimit socialist vetëqeverisës në edukim dhe arsim, në frymën e konkluzave (për: përfundimeve) dhe të Rezolutës së Kongresit X të LKJ (duhet: LKJ-së), janëbërë ...*(14 janar 1977, f. 3). *Libri i parë “Josip Broz Tito (duhet: Titos): fjalime dhe artikuj” doli nga shtypi në vitin 1961, kurse libri XV u botua në vitin 1971.* (12 janar 1977, fq 4); *aktiviteti është zhvilluar në kuadrin e përgatitjeve të Kongresit XI të LKJ (duhet: LKJ-së) dhe 40-vjetorit të ardhjes së shokut Tito në krye të Partisë* (26 janar 1977, fq. 9)

Në emërtimet e shkurtuara të institucioneve, të zyrave, të ndërmarrjeve, të organizatave etj; viza lidhëse në këtë rast vihet midis tyre dhe nyjës së prapme ose mbaresës⁷: *SMT-ja e Lushnjës, Komiteti Qendror i BRPSH-së, sesioni i 28-të* etj. Mosrespektimi i kësaj norme, në “Flakën e vëllazërimit” vërehet shumë. P.sh: *Kryesia e Kuvendit të RSM, (duhet: RSM-së) nën Kryesinë e Bllagoja Taleski* (12 janar 1977, fq 4); *avangardës së saj – PKJ (duhet: PKJ-së)* (28 prill 1970, f. 3); *Po*

⁶ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, fq. 137, Tiranë, 1973.

⁷ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, fq. 138, Tiranë, 1973.

*ashtu shtrohet edhe detyra që në aksionin e LKJ (duhet: LKJ-së) të fillojë realizimi ... Në mbledhje merrte pjesë edhe sekretari në KE të KKQ të LKJ, (duhet: sekretari i KE-së të KKQ-së të LKJ-së) Dr. Aleksandar Gërliçkovi. (14 janar 1977, fq.3); ... udhëheqës në kuadrin e OPB (duhet: OPB-së) ashtu edhe në nivel të komunës. (26 janar 1977, fq. 9). Krejt ndryshe, pra në të mirë, qëndron puna me numrat e viteve 1981-1989. Kjo shmangie thuhet nuk vërehet më, edhe pse aty-këtu rrallë e hasim. P.sh.: Tubim shkencor “Armatat në konceptin strategjik të **LNC-së** dhe revolucionit”. Qëndrim treditör i kryetares së **KEF-it**, Millka Pllanincit në Francë. (16 janar 1985, fq. 1); Po ashtu ë këtë tubim të **LMM-së** u paraqit nevoja ... (16 janar 1985, fq. 15); Si organ i Frontit Nacionalçlirimtar, përkatësisht i **LSPPM-së**, u tha me këtë rast “Flaka e vëllazërimit” në periudhën e kaluar 40-vjeçare luajti një rol të rëndësishëm. (17 shkurt 1985, fq. 1) etj.*

Vërehen gabime në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Dihet se jo vetëm në gjuhën shqipe, por në të gjitha gjuhët e lëvruara të botës ka rregulla të qarta për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Ndër të më kryesoret janë që një shkronjë e vetme nuk mund të mbetet në fund të rreshtit. Nuk ndahen në fund të rreshtit prapashtesa e një numërori rreshtor të shënuar me shifra arabe dhe nyja e prapme e mbaresat në ato raste kur shkruhen me vizë lidhëse (Drejtshkrimi ..., fq 164). Po kështu nuk und të ndahet një tog çfarëdo shkronjash në fund të rreshtit, në qoftë se nuk formon rrokje (*sh-qiptar, A-merika, S-hqipëria, të sh-tunën, fëm-ija* etj). Ja disa shembuj të nxjerrë nga gazeta: *Nga përfaqësuesit zyrtar të SHBA-ve, BRSS-së (-ve; -së është ndarë në fund të rreshtit); (27 shkurt 1985, fq 5); Inkurajon e-dhe rezultati i Napredokut të Kërçovës (është ndarë lidhëza) (20 mars 1985, f. 15); edhe parathënien a-nalitike (duhet: ana-li-ti-ke) të këtij libri (28 janar 1977, f. 13);*

Një kujdes të veçantë i kushtohet shkrimit të emrave të përveçëm të huaj, kur dihet që sot kjo normë e shqipes shumë pak respektohet. Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Por, një çështje tjetër që do vë në dukje si e metë e përsëritur, është edhe përdorimi i tyre pothuaj rregullisht në formë të pashquar në rasën emërore të shembujve të mëposhtëm. P.sh.: Çka arriti **Margaret Theçer**(duhet: **Margaret Theçeri**)(17 mars 1985, f. 5); U lexua edhe telegrami i kryesuesit të OKB-së **Pol Lusaka**, i cili gjendet për vizitë në vendin tonë (22 mars 1985, f. 1); **Xhesi Ovensi** fenomenal; djaloshi fenomenal **Karl Luis** (duhet: **Karl Luisi**) i cili në Lojërat Olimpikë në **Los Anxhelos**; do të fluturojë edhe përtej ëndrrave – thotë trajneri i tij **Xho Daniels** (për: **Xho Danielsi**) (22 mars 1985, f. 15); Jemi të bindur – i deklaroi **Li Ciang** (duhet: **Li Ciangu**) Tanjugut (26 janar 1977, f. 16); **Manuel Fraga Iribarne**, shpalli programin e vet politik (28 janar 1977, f. 1); 600 përfaqësues diplomatikë dhe konsullarë (duhet: konsullorë) në **Uashington** (28 janar 1977, f. 7); Konferencës së **Helsinki**(sot në shumë gazeta e

hasim formën e gabuar, Helsinkut) dhe të dokumentit përfundimtar (30 janar 1977, f. 4) etj.

Një çështje tjetër e veçantë, që ka qenë mjaft drastike deri në fund të viteve nëntëdhjeta (1990), është shkrimi i vendeve (toponimeve) shqiptare me format sllave. Në tekstet shkollore për nxënësit shqiptarë në Maqedoni përdorimi i formave sllave ka qenë i pranishëm⁸. Mirëpo, një gjë e tillë nuk ndodh në numrat e gaztës "Flaka e vëllazërimit" të viteve 1970-1989 të cilat po i vëzhgojmë. Ja disa shembuj të nxjerrë nga numra të ndryshëm: *Në mbledhjen e Kryesisë të Këshillit komunal të Lidhjes së Sindikatave të Kërçovës*⁹(1 prill 1977, f. 9); *Shkup*¹⁰, 22shkurt (23 shkurt 1977, f. 1)); *Qytetarë të Shkupit* (23 korrik 1970, f. 2), *organizatat partiake të Manastirit*¹¹, *Prilepit, Velesit dhe Shkupit* (30 korrik 1970, f. 3); *në komunën e Dibrës*¹² janë organizuar (09 korrik 1970, f. 2); *për këtë arsye para banorëve të Ohrit*¹³ çfaqet (duhet: shfaqet) *problemi* (23 korrik 1970, f. 2) etj.

Brenda normës morfologjike vlen të përmendet edhe përdorimi i gabuar i emrave të përveçëm, sidomos në bashkëvjajtje me mbiemrat përkatës (shih më lart edhe te shkrimi i emrave të përveçëm të huaj). Nga vetë funksioni i tyre, emrat e përveçëm janë të dalluar kuptimisht, andaj përdorimi i tyre në trajtë të shquar a të pashquar s'ka vlerë kuptimore. Megjithatë, në përputhje me natyrën e shqipes si gjuhë me eptim (lakim dhe zgjedhim), këta emra duhet t'u nënshtrohen gjedheve të saj të lakimit. Në gazetën "Flaka e vëllazërimit", emrat e përveçëm, sidomos mbiemrat e familjeve të huaj i shohim në trajtë të pashquar, që bie në kundërshtim me natyrën e shqipes si gjuhë me lakim të zhvilluar. P.sh.: *Dollanc, Stamboliq dhe Mojsov* (për: *Dollanci, Stamboliqi dhe Mojsovi*) biseduan me Nkomo (për: *Nkomon*) (26 janar 1977, f. 2); *Me urdhrin e kryetarit të Republikës, Josip Broz Tito* (për: *Josip Broz Titos*), me titullin *Qytet Hero u dekoruan...* (26 janar 1977, f. 10); *Tito* (për: *Titoja*) i dërgoi urim *Zhiskarit; Kadar (Janosh Kadar)* (për: *Kadari*) priti *Miniqin (Millosh Miniq)* (2 shkurt 1977, f. 1); *Veselin Gjiranoviq* (për: *Veselin Gjiranoviqi*) kandidat për kryetar të KEF-it (16 shkurt 1977, f. 3); *Abate* (për: *Abatja*) (*Atenafu Abate*) do të vizitojë *Jugosllavinë* (23 shkurt 1977, f. 1); *Gligorov*(për: *Gligorovi*)priti *Makoten* (2 mars 1977, f. 1); *Usmahoxhajev* (për: *Usmahoxhajevi*) priti *Karajanovin* (18 janar 1985, f. 2); *Zoran Filipoviq* (duhet: *Zoran Filipoviqi*) shënoi golin e parë për reprezentacionin tonë; *Partizani avansoi* (për: *avancoi*) nëpërmes *Dragan Todoriq* (duhet: *Dragan Todoriqit*) (09 shkurt

⁸ Shih: Qemal Murati, *Drejt përdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore*, SHB Asdreni, Shkup, 1996, f. 95-97.

⁹ Kiçevo haset në shumë tekste shkollore për shqiptarët.

¹⁰ Skopje e gjejmë në tekstet shkollore.

¹¹ Bitolla e gjejmë në tekstet shkollore.

¹² Debar e gjejmë në shumë tekste shkollore për shqiptarët.

¹³ Ohrid në tekstet shkollore.

1977, f. 15) etj. Ka raste që i gjejmë të përdorur drejt: *pjesë nga referati i Dr. Timo Vllashkaliqit* (16 shkurt 1977, f. 2) etj.

Në fushën e leksikut. Në gazetë është bërë një punë e kujdesshme edhe për pastrimin e fjalëve të huaja e zëvendësimin e tyre me fjalë shqipe. Megjithatë, aty-këtu, sidomos gjatë viteve 1983-1989¹⁴, shfaqen e rishfaqen edhe fjalë të huaja, krejt të zëvendësueshme e të zëvendësuara me fjalë shqipe, si: *Konkluzionet* (mund të zëvendësohet me fjalën shqipe përkatëse: **përfundimet**) e *LKJ-së për sendërtimin e rolit prijatar dhe për forcimin e unitetit* (mundet: **bashkimit**) ideor; *Konstatimi* (në këtë rast: **zbulimi**) (20 mars 1985, f. 6 dhe f. 16); *Duke u nisur nga konkluzionet* (për: **përfundimet**) e *Mbledhjes së 16-të; Kontribut* (për: **ndihmesë**) fitores ndaj fashizmit (22 mars 1985, f. 1 dhe f. 4); *Bisedimet jugosllavo-algjeriane në nivel të kryetarëve të qeverive do t'i qasen para se gjithash shqyrtimit të marrëdhënieve bilaterale* (mund të mënjanohet me fjalën shqipe: **dypalëshe**) dhe *bashkëpunim-sipas burimeve të njëjta, iniciativën* (mund të zëvendësohet me fjalën shqipe: **nismë, d.m.th. nismën**) e ka ndër marrë; në vijim e sipër është *sondazhi* (mund të zëvendësohet me fjalët shqipe: **hetim, vëzhgim, anketë**, në këtë rast: **vëzhgimi i terrenit të Holandës, e cila (duhet: i cili) *kah fundi i vitit...* (24 mars 1985, f. 2); *Lenini ishte dhe mbeti inspirator* (për: **frymëzues**) i klasës punëtore të popujve të Jugosllavisë dhe *avangardës* (për: **pararojës**) së saj – PKJ-së; për *progres* (për: **përparim**) dhe *socializëm* (23 prill 1970, f. 3); për *aksion* (për: **veprim**) konkret (13 janar 1985, f. 3); *qarqet diplomatike në Gjenevë janë tejet racionale* (mund të zëvendësohet me fjalën shqipe: **të arsyeshme**) në *matjen e mundësive* (06 janar 1985, f. 1); *Shtabet madhore kishin karakter nacional* (për: **kombëtar**) (11 shkurt 1977, f. 4) etj.**

Mangësitë që bien në sy më shumë në fushën e sintaksës, janë:

- përdorimi i panevojshëm i frazave të gjata e të ndërlikuara, ku pështjellohet mendimi deri në moskuptim;

- përshtatja e gabuara e fjalëve përcaktuese me emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me –e dhe –ra;

- vërehet shumë ndikimi i sintaksës së huaj, sidomos asaj sllave¹⁵ (gjegjësisht, asaj serbe, kroate, sidomos asaj maqedonase) dhe në drejtimin (*reksionin*) e foljeve në shkrimet e përkthyer. Shumë shkrime (artikuj) të rubrikave të ndryshme në “Flakën e vëllazërimit” janë autorë joshqiptarë (serbë, kroatë, sllovenë, maqedonas etj), andaj dominon sintaksa e këtyre gjuhëve në gazetë. Përkthyesit e shkrimeve të tilla, kanë bërë punë të nxituar dhe sigurisht nuk e kanë njohur mirë as gjuhën e huaj, as shqipen, si: *i kontribuon zhvillimit të arsimit* (duhet: *kontribuon për zhvillimin e arsimit*); *dy skuadra që rrezikojnë rënien nga kategoria* (duhet: *rrezikojnë të*

¹⁴ Nuk mungojnë edhe para vitit 1983.

¹⁵ Burim kryesor i lajmeve ka qenë TANJUG-u, MIA.

bien nga kategoria). Ja disa shembuj të tjerë: *numri i shikuesveshumë ndeshje do t'i përcjellin* (krejt e paqartë, duhet: *një numër (i madh a i vogël) i shikuesve shumë ndeshje do t'i përcjellin (ose: shumë shikues ndeshjet do t'i përcjellin)*) (09 shkurt 1977, f. 15), *U theksua edhe rëndësia e përparimit e mëtejme* (duhet: *rëndësia e përparimit të mëtejme*); *të gjitha këto aktivitete do të përcillen edhe me programe dhe me plane gjegjëse në lëmën e bujqësisë, veçanërisht në përparimin e sektorit individual* (duhet: *të gjitha këto aktivitete do të përcillen me programe dhe me plane gjegjëse të lëmit të bujqësisë, për përparimin e sektorit individual*) (11 shkurt 1977, f. 1); *Komisioni mbi çështjet e zgjedhjeve* (duhet: *Komisioni i çështjeve të zgjedhjeve*) (11 shkurt 1977, f. 3, 4); *në botim të “Nasha kniga” të Shkupit* (duhet: *të botuara nga “Nasha kniga” e Shkupit*); *aktivitet të dukshëm kultural* (duhet: *kulturor*); *në botim të shtëpisë botuese “Svjetlost” të Sarajevës* (duhet: *të cilën e botoi SHB “Svjetlost” e Sarajevës*) (13 shkurt 1977, f. 14, 17) etj. Hasim edhe shprehjen *me në krye (një delegacion me në krye sekretarin F.F.)* në vend që të përdorin: *një delegacion ... me sekretarin F.F. në krye* (sepse në gjuhën shqipe parafjala nuk mund të ndahet nga fjala që lidh: *me ministrin*). Për dallim nga ndikimet e huaja në leksik e morfologji, ndikimet sintaksore rrallë mund të hetohen edhe nga gjuhëtarët e ç'mund të presim nga gazetarët e përkthyesit e papërgatitur të cilët as që mund t'i vërejnë. Po e jap një shembull të qartë ku sintaksa e huaj sjell edhe keqkuptime: *Një person i pidentifikuar u gjet i vrarë nga policia zvicerane me një plumb pas koke në një lulishte të Gjenevës*; në gjuhën shqipe shkon më mirë ndërtimi vepror: *Policia zvicerane gjeti një person të vrarë me një plumb ...*

Në mbyllje të këtyre shënimeve do të theksojmë edhe një herë se, me gjithë këto mangësi, gazeta “Flaka e vëllazërimit” në periudhën prej vitit 1970 – 1989, ishte jo vetëm shumë e nevojshme për kohën, e vetme gjatë këtyre viteve për shqiptarët e Maqedonisë, por ishte edhe rrezatuese e gjuhës së përpunuar letrare shqipe (sot: shqipes standarde). Ajo ka ndikuar te lexuesit për të zotëruar¹⁶ e zbatuar drejt normat e gjuhës së shkruar letrare (shqipes standarde) në të gjitha nivelet e saj.

Literatura

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe (1973), ASHSH; IGJL, Tiranë.
2. Gramatika e gjuhës shqipe 2 (2002), (Sintaksa), ASHSH, IGJL, Tiranë 2002.
3. Murati, Qemal (1996) *Drejtpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore*, SHB Asdreni, Shkup.
4. , , (1980) *Журналистическо маисторство*, (përkthyer nga polonishtja), Sofje.

¹⁶ Pas Kongresit të Drejtshkrimit s'kanë munguar rubrikat e veçanta për drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e shqipes të dala nga Kongresi i Drejtshkrimit të vitit 1972.

Drago FLIS

SYNERGJIA LETRARE E ÇIFTIT KADAREJA

*Koha e pamjaftueshme, Onufri 2011
(N)nje gruaje nga Tirana*

Filloi me ngjarjen e vogël në Ballkanin, në Gradska kafana, në Dubrovnikun pothuajse të shkatërruar. Bashkëshortes së shkrimtarit sapo i erdhi një ndjesi »hareje të pazakonshme«(f.13). Jo, kujtimet nuk do të dëmtojnë balancën delikate, ndonëse do të jenë relativisht të sakta. Pikërisht në atë kohë në pjesën e ish-Jugosllavisë të porsa shkatërruar pas luftës 1996 ra vendimi për librin prej asaj mbi tij, për siç pranoi ajo, për »terapinë e te shkruarit«(f.13). »Ballkanasit mos t'i harrojnë gjithë këto shkatërrime.. Ismaili, Is, quajtur në parametrin bashkëshortor nuk i shmangej bisedës për Ballkanin, në atë kohe në Dubrovnik heshturazi edhe aprovoi tregimin letrar dhe i jetes.

I ka jashtëzakonisht shumë kujtimet prej dy rrugëtimeve. Përpos librit *Koha...*, që është e ngjeshur me ta, i ka edhe në romanin e vetvetes: *Një grua nga Tirana*. Helena Gushi ka pasur ambiciet letrare të veta e do të na tërthorazi njoftoj që iu ka nënshtruar atyre të Isit, por më pastaj. Së pari qe dashuria platonike në poetin shqiptar që ka pasur mundësi për të shkruar për studimet letrare ne Institutit Gorki në Moskë në vitet e pesëdhjeta. Nje ditë studenti i letërsisë ruse shpresëndjellës i ka dërguar Helenës letren prej Moskës me permendimin inkurajues për një tregim, qe ajo sapo u botua ne *Zëri i Rinisë*.Mënyra klasike e afrimit.

Edhe një mënyrë tjetër klasike që është shumë e ruajtur mes Shqiptarëve: Helena u fejuar, por aime jo me Isin, megjithatë me inxhinierin e mirë të paemëruar. U prish fejesa solide për shkak të Isit...Mengjesin ku Helena Gushi ishte bërë grua s'e kemi në kujtimet, por në romanin e saj. *Një grua nga Tirana*(f.49), ku çifti paraqitet si Suzana dhe Viktori, vendndodhja klasike shqiptare për gjërat të këtilla-Pogradec buzë liqenit.

Pastaj Helena ngarkohet me të shkruarit mbi »jetën në çift«. Problemet bashkëshortore ka pasur, por jo probleme letrare. Këtu Helena tërësisht iu nënshtrua bashkëshortit Is, pothuajse shuhet krijimtaria e vet.Rritja e saj letrare mbetet vetëm në përcelljen e etapave romaneske të tij: Qyteti pa reklama është sjell prej Moskës. Pastaj Gjenerali i ushtrisë së vdekur, romani historik Rrethimi(Keshjtjella), Kronikë

në gur, Koncerti në fund të dimrit deri te Pallati i ëndrrave. Jeta letrare e Helenës behet përcjellëse e krijimtarisë së bashkëshortit.

Helena na jepet shikimin edhe në qarqet letrare që kanë ndikuar në »monarkun e letrave shqipe« të mëpastajshëm. Si shokun dhe mentorin i tij letrar, Helena permendi se pari kritikun dhe poetin Drago Siliqin. Ai e ka lexuar si i pari Gjeneralin...Siliqi ka njohur shumë mirë intrigat mes Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut. Kjo lehtësoi botimin e veprave Kadarejane madje në kohëra te hekurta. Siliqi ka qenë edhe personaliteti tragjik, ka vdekur në një fatkeqësi ajrore nëpër Irkutsk në Siberi, siç thuhej, me dorshkrimet letrare kur ka rënë në tokë.

Personaliteti tjetër që ka ndikuar shume ishte poeti prej Pogradeci, Lasgush Poradeci. Në Pogradec Ismajli u angazhua shumë në bisedimet të pafundme me Lasgushin dhe me Sterjo Spasen, që ka qenë i lidhur me Prespën e vogël, etnikisht maqedonase.

Ai ka mësuar e biseduar shumë edhe me gjuhëtarin më të famshëm shqiptar Eçrem Çabej. U bisedua me Çabejn në mënyrën disi kundërthënëse, mendimet e gjuhëtarit dhe të shkrimtarit binin shpeshherë ndesh. Edhe me politikanin djathtist-kombëtarist Sabri Godon kanë pasur kontakte të frytshme. Ai dhe Ismajli paraqiten si njëllorj mentori ose madje kujdestarët e Bashkim Shehut pasi babai i tij ka qenë katranosur prej Enverit.

Me komunitetin letrar të Kosovës deri në vitet 70-ta ka pasur pak kontakte, pas zbutjes ndaj Kosovës ka kontaktuar me Esad Mekulin, Ali Aliun, Rexhep Ismailin, Rexhep Qosjen, dëshmon Helena. Miku i tij letrar ka qenë edhe shkrimtari serb me prejardhje hebreje Danilo Kish.

Helena përshkrohet edhe disa probleme banale bashkëshortore. Ajo sugjerohet që s'paskemi me bërë me shenjtooren. Lexojmë disa përshkrime të flirteve të shkrutra ose me pak shkurtra... Ka pasur mjaft raste në Moskë, pastaj flirti me balerinën e Teatrit Kombëtar në Tiranë(ndoshta me i fortë), edhe një flirt me një vajzë të re në Kosovë, ...por të dyjat mbeten çift në jetë dhe në letërsi, njëra kushtezohet nga tjetra...

Helena ka punuar shumë edhe me përkthyesit te veprës se tij: Jusuf Vrioni si i pari në frëngjisht. Këtu mbetet ende punë për t'u bërë, sidomos për përkthimet e drejtpërdrejta në gjuhët e vogla. Shpeshherë qasja ndaj gjuhëve te vogla s'është shumë ndryshe nga qasja e tyre ndaj shqipes. Para se gjithash duhen shmangur përkthimet prej dorës së dytë, nëpër gjuhëve te mëdha. U bë pikërisht kjo. Pa përkthimet të drejtpërdrejta ka edhe më pak jehona letrare në gjuhë përkatëse.

Helena i adresohet edhe çështjes së disidencës. Helena nuk mundi të bëhej disidente klasike...(f.354). Do të ishte vetëm »menjanimi nga jeta aktive letrare«.«Duke parë spekulimet me fjalën »disident«, ai e bëri te qartë se nuk e konsideronte veten te tillë. »S'kishte nevojë për te, i mjaftonte letërsia«, thoshte Helena.

Me vajtjen e tij bashkë me familjen e tij në Paris më 1990 ai u bë ndërkaq një lloj disidenti i vonuar, këtë gjë Helenna nuk e zhvillohet më tutje.

Befasisht, Helena na njoftoi, qe Ismaili nuk do të shkruante me romane. I citoi prerazi: »nuk donte te shkruante më prozë artistike dhe pikë...ka thënë pa zemërim, pa qejfmbetja, pa dramacitet..« Romani i shkurt E penguara mbetet ashtu romani i fundit i tij. Ndoshta, ai mbetet një lloj komentuesi e çështjeve letrare, por edhe politike..

Ndonëse Kadarenjve mbeten edhe shume vite për të jetuar si çift, Helena në epilogun në mënyrën subtile letrare do të thosha edhe bukur, foli edhe për gjërat te fundit:

(f. 683) «Lidhur me këtë, kur kishte rënë fjala se cili nga ne të dy do te ikte i pari nga kjo botë, ai kishte shprehur bindjen se e natyrshme, madje e domosdoshme do të ishte qe ta linte ai i pari botën. As qe e mendonte dot mundësinë tjetër, ikjen time, sa që mua, si për shumicën e gjërave, ma kishte mbushur mendjen edhe për këtë. Duhej te ngelësha, pra, njëfarë kohe pas tij, për të kryer ca punë të fundit, ashtu siç qëllonte që pas një darke të gëzueshme, te vonohesha për të sistemuar enet dhe gotat e kristalilt , ose për të fikur shandanet.»

Griselda DOKA

RRETH POEZIVE TË PËRKTHYERA ITALISHT TË AZEM SHKRELIT DHE TË ALI PODRIMJES

Është i njohur fakti se në themel të konceptit të përkthimit qëndron interesi për të kuptuar dhe njohur “tjetrin”, përkatësisht interesi për të njohur gjuhën, kulturën, shkencat dhe arritjet që janë shprehur në një gjuhë tjetër. Përkthimi si shkencë është ende në qendër të debatit të përgjithshëm për sa i përket terminologjisë, përcaktimit të kufijve dhe kompetencave. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore fillon e zhvillohet literatura e specializuar që përqafon shkencën e përkthimit në përgjithësi, studime kritike dhe teori të ndryshme të kësaj fushe.

Qysh nga studimi i Jakobson-it *On the linguistic aspects of translation*, i cili në mënyrë shkencore nënvizoi rëndësinë e përkthimit si një proces i cili kalon faza të ndryshme deri sa të arrijë në formën përfundimtare, vëmendja mbi fushën e përkthimit erdhi duke u shtuar.

Vetëm pas viteve '70 mund të themi se përkthimi zhvillohet si shkencë e përparuar me kritere dhe metodologji të caktuar edhe pse debati mbi përcaktimin e rolit dhe të kompetencave të tij është akoma i hapur, që natyrisht nuk është objekt i këtij studimi.

Në vija të përgjithshme do të prekim këto çështje: disa veçori të përkthimit letrar duke analizuar përkthimet e disa poezive të Azem Shkrelit dhe Ali Podrimjes në italisht dhe duke vënë në pah metodat dhe problemet që dalin rreth tyre.

Dihet se, nga njëra anë poezia paraqet për përkthyesin një pikënisje dhe detyrim, ndërsa nga ana tjetër ajo e vë atë në një pozitë të ngjashme me atë të poetit: të shkruajë (përkthejë) për të gjithë lexuesit e mundshëm të kulturës së dytë (Target), jo vetëm lexuesin e përgatitur, siç ndodh me tekstet e shkencave ekzakte.

Lotman mendon se gjuha e letërsisë është një gjuhë e “veçantë” që ngrihet mbi gjuhën e natyrshme dhe si e tillë ajo i dallon shenjat gjuhësore nga ana e formës dhe shprehjes duke u vendosur si karakter ikonik dhe paraqitës. Ai arrin në përfundimin se teksti letrar është një njësi e tërë, si shenjë me një përmbajtje të veçantë për ndërtimin e të cilit autori ka pasur në dispozicion variante të ndryshme, ndërsa lexuesi dhe bashkë me të edhe përkthyesi nuk e ka këtë mundësi. Ky arsyetim i Lotmanit është i rëndësishëm për procesin e përkthimit, gjatë të cilit teksti duhet trajtuar si *unicum*, prandaj çdo vendim i marrë duhet të jetë pjesë e një

strategjie bazë, koherente dhe e menduar më parë, ashtu siç edhe autori ka ndjekur një strategji ndërtimi të tekstit dhe i ka qëndruar koherent asaj.

Me pak fjalë, përkthimi letrar është një akt krijues i cili mbështetet në themele teorike dhe ka një strategji të vendosur që më parë dhe që duhet ta ndjekë. Të shumta janë strategjitë e përkthimit, por Newmark flet për dy qasje të mundshme; e para e quajtur *reader-oriented* ose përkthimi komunikues, i cili ka të bëjë me përkthimin që angazhohet në përcjelljen e mesazhit në mënyrë sa më të plotë duke i “lehtësuar” punën lexuesit. E dyta *writer-oriented* ose përkthimi kuptimor, përqendrohet në njohjen e thellë të tekstit të nisjes, por pa e thjeshtuar në kulturën e mbërritjes, ndaj mund të dalë jo vetvetiu i kuptueshëm. Në fakt, qasjet midis tyre mund të integrohen falë metodologjive shkencore që ofrojnë sot kurset e ndryshme të studimit të përkthimit.

Përkthimi duhet të jetë një shtysë për t’iu afruar tekstit të nisjes, ai duhet të ndihmojë të kuptojmë jo vetëm atë çka thuhet në tekstin e përkthimit, por edhe të ndezë kureshtjen për të shkuar më tej, për t’iu qasur një hapësire kulturore që nuk na përket, por që vetëm me anën e përkthimit dhe kureshtjes intelektuale mund ta zotërojmë dhe të na pasurojë.

Gjuha letrare e një teksti poetik është e lidhur ngushtë me stilin individual të autorit dhe është pikërisht struktura e brendshme e poezisë që i sjell probleme përkthyesit dhe i cakton kufi. Mirëpo, duke ndjekur edhe atë që Benjamin përmend si njërin nga detyrat e përkthyesit, nuk është e thënë të shkohet medoemos jashtë kufijve të tekstit të nisjes, por të kërkohen të shfrytëzohen të gjitha mundësitë gjuhësore në tekstin e mbërritjes, në mënyrë të ngjashme me autorin e veprës. Mund të duket se përkthimi krijues shkon kundër idesë qendrore të përkthimit si riprodhim besnik, por përkthyesi i tillë është ai që vendos të hedhë hapa të sigurtja jo vetëm midis dy gjuhëve por edhe midis dy kulturave duke arsyetuar zgjedhjen e vet.

Për të skematizuar dhe thjeshtuar pak analizën e përkthimit sjellim më poshtë disa pika të quajtura këtu *rrafshe* të cilat janë rimarrë nga pasqyra e paraqitur nga teoria e përkthimit e traditës italiane.

Rrafshi fonik

Këtu hyjnë problemet e lidhura me simbolizmin tingullor, onomatopenë dhe efektet e pavetëdijshme të provokuara nga tingujt. Ky rrafsh gjuhësor është më i rëndësishmi në poezi sepse, është përmasa fonike ajo që mundëson krijimin e një pjese të efektit integral estetik (Berisha, 1979). Sipas Crystal ky rrafsh ka të bëjë me prirjen e gjuhës që të zhvillojë forma tingullore të cilat folësit i ndejnë të lidhura ngushtë me sende dhe situata të botës së jashtme. (Crystal 1993:174)

E rëndësishme në këtë rrafsh është se përkthyesi duhet të kuptojë se autori ka përdorur në mënyrë të vetëdijshme mjetin fonetik, për të arritur efekte të caktuara

duke mundësuar kështu ndërtimin e një stili individual. Pra, detyra e përkthyesit është që në një farë mënyre t'i përcjellë në gjuhën e mbërritjes dhe mos t'i anashkalojë këto zgjedhje të autorit, i ndërgjegjshëm me faktin *se nuk mund të ketë asnjëherë korrespondencë të plotë*.

Rrafshi metrik

Për sa i përket qasjes së përkthimit të poezisë, Renzi thotë se i rëndësishëm është edukimi i estetik dhe jo ai historik. Në bazë të këtij pohimi përkthyesi pasi t'i ketë kuptuar të gjitha arsyet e zgjedhjes metrike i mbetet zgjedhja e lirë nëse do të përkthejë në të njëjtën formë metrike apo jo. Për sa u përket përkthimeve të poezive në italisht, Rega mendon se i rëndësishëm është ritmi dhe jo rima e cila mund të dalë si imponim në veshët e një italianit, duke u theksuar më shumë dhe duke mos respektuar kështu qëllimin e origjinalit. Probleme të tjera janë gjithashtu gjatësia e vargut dhe theksi i tij, për të cilat në përgjithësi përkthyesi bashkëkohor lëkundet midis zgjedhjeve të një përkthimi të lirë dhe ruajtjes së ritmit të gjuhës së mbërritjes kur bëhet fjalë për një qasje komunikative; në rastin e qasjes letrare respektohet ritmi i origjinalit, duke kufizuar komunikimin në gjuhën e mbërritjes.

Duhet theksuar gjithashtu se edhe përkthimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj muzikalitetit dhe intonacionit të ligjëratës poetike si edhe ndaj harmonisë fonetike duke pasur parasysh se ritmi i poezisë është një element që buron nga brendia e saj, aftësia e përkthyesit matet nëse ai arrin apo jo ta përcjellë atë.

Rrafshi sintaksor

Edhe pse ky rrafsh është më i rëndësishëm për prozën, ai sjell disa probleme edhe në poezi. Sipas Beccaria-s, përkthimi i një fjale nuk ka aq rëndësi sa përkthimi i një fjalie apo ritmi. Në këtë rrafsh përkthyesi duhet të zotërojë njëfarë “ndjeshmërie gjuhësore” (Rega 2001:123) për një përkthim të paanshëm dhe objektiv, ku pragmatika dhe gjuhësia e tekstit ofrojnë mjetet e duhura. Përveç organizimit të fjalisë duhet të kihet parasysh edhe të dhëna të tjera si koherenca, kohezioni, tema etj. Sigurisht çdo përkthyes ndërton stilin e vet dhe nuk mund të flitet në mënyrë të përgjithësuar. Gjithashtu edhe tipologjia e gjuhëve ruan rolin e saj.

Rrafshi leksikor

Në këtë rrafsh problemet e përkthimit nuk janë ato më të rëndësishmet, por janë më të shumtat në numër. Përkthyesi jo vetëm duhet ta kuptojë tekstin, por duhet

të dijë të zgjedhë fjalën e duhur në gjuhën e mbërritjes dhe nuk janë të pakta rastet ku haset në neologjizma të autorit apo kur i duhet t'i krijojë vetë ai. Në të vërtetë, përkthyesi ka në dispozicion një sërë regjistrash gjuhësorë, por duhet të dijë të zgjedhë midis tyre duke mos banalizuar efektet estetike të veprës; teksti i nisjes është gjithmonë një *unicum*. Disa shembuj kritikë në rrafshin leksikor janë përkthimet e titujve, ndërtimeve të figurshme si metafora dhe metonimitë, emrat me origjinë të huaj etj.

Problemi më tipik në rrafshin leksikor është ai i përkthimit të fjalëve që nuk kanë një referent në gjuhën e mbërritjes, të ashtuquajturat “Realia”. Për sa u përket neologjizmave ato janë një sprovë guximi për përkthyesin dhe dëftojnë njohjen e thellë teknike si të autorit ashtu dhe të gjuhës.

Së fundmi ekzistojnë edhe disa elemente të lidhura me kulturën e veçantë të nisjes dhe mund të sjellin probleme në përkthim. Strategjitë e ndjekura në këtë rast janë të shumta, me anë të fusnotave dhe shpjegimeve hyrëse duke kërkuar të shmangin ngatërresa të mundshme që lindin nga ndryshimet midis kulturave.

Për të hyrë më konkretisht në objektin e këtij studimi na duhet të japim një panoramë të shkurtër të përkthimeve dhe studimeve të poezisë bashkëkohore kosovare në italisht.

Poezia kosovare e pasluftës shfaqet për herë të parë me antologjinë e Ernest Koliqit, *Antologia della Lirica Albanese* e vitit 1963. Në paragrafin e hyrjes kushtuar poezisë shqipe të Kosovës theksohet shpirti revolucionar i poetëve të rinj dhe dëshira për rilindje shpirtërore dhe gati unike në Ballkan, pasi këta poetë, thotë Koliqi, ndajnë nevojën të shprehen në shqip duke lënë gjurmë të një primitiviteti sugjestiv.

Në antologjinë me titull *Poesie scelte albanesi dei nostri giorni* të vitit 1969, të përgatitur nga Adriatik Kallulli, paraqiten vlerat e poezisë së realizmit socialist, por fatkeqësisht nuk gjejmë asnjë gjurmë të poezisë shqipe të Kosovës. Në këtë rrjedhë duhet vendosur dhe antologjia e Koço Bihikut, *Storia della Letteratura Albanese*, 1981, ku, po ashtu, ngrihen lart vlerat e poezisë së realizmit socialist brenda kufijve të Shqipërisë.

Në vitin 1977 një studiuese e guximshme italiane paraqet një antologji të shkurtër të titulluar *La poesia degli albanesi*. Në studimin e gjatë autorja godet indiferencën italiane ndaj kulturës shqiptare duke theksuar detyrimet morale të saj ndaj këtij populli që ka dhënë një ndihmesë në historinë e Italisë. Antologjia trajton vetëm 6 autorë që nga Migjeni deri te Kadare, çuditërisht asnjë kosovar.

Një vit më vonë, falë angazhimit të Podrimjes dhe Hysni Hoxhës, me përkthim të Giacomo Scotti-t gjejmë një antologji të shkurtër, por të mirëfilltë kosovare me titull *Poeti albanesi in Jugoslavia*. Në studimin paraqitës me titull *Dal sentimentalismo all'intellettualismo*, Hoxha përshkon udhën që ka bërë poezia bashkëkohore kosovare, mënyrat e të shprehurit dhe veçoritë e saj. Në këtë studim

autori thekson se akoma nuk mund të flitet për rryma moderne letrare, por vetëm për prirje stilistike ku veçohen Podrimja, Shkreli, Dedaj etj.

Në vitin 1979, përsëri falë angazhimit të Podrimjes dhe Sabri Hamitit, sheh dritën e botimit vëllimi dygjuhësh shqip-italisht “Dega e pikëlluar” (Ramo sofferente), me përkthimin e Carmelo Candreva-s dhe Giuseppe Chiaromonte-s. Theksojmë këtu se nga ana e formës ky vëllim është më i arrituri nga ata që kemi shfrytëzuar, pasi përkrah përkthimit, lexuesi ka mundësi edhe të konsultojë tekstin e origjinalit.

Pas vitit 1979 kemi një periudhë relativisht të heshtur e cila varet edhe nga kushtet social-politike të Kosovës. Duhet të mbërrijnë vitet e bujshme të luftës '98-99 që të zgjohet përsëri interesi ndaj saj. Kështu, gjatë periudhës '98-99 kemi disa numra të revistës gjashtë mujore “Quaderni” të Fondit të Shoqatës Moravia, drejtuar nga Dacia Mariaini që merren dhe me çështjen kosovare dhe sjellin tekste poetike. Në “Quaderni”, 1, 1998 kemi disa tekste të Muhamedin Kullashi, kurse në numrin e dytë të po atij viti paraqiten disa tekste të Podrimjes, Zhitit si edhe një intervistë e M. Kullashit. Në numrin e parë të 1999 sillen poezi të Din Mehmetit dhe Agim Vincës. Po në këtë vit, falë angazhimit të studiuesit të shquar italian Filippo Bettini, gjejmë botimin e një përmbledhjeje poetike të titulluar *Quel Dio che non avemmo* (Atë diell që s'e kemi), ku përfshihen 20 poetë evropianë që kanë marrë pjesë në konkursin “Feronia-Comune di Fiano”, të paraqitur si në gjuhën e nisjes ashtu edhe në italisht; ndër ta gjendet edhe Ali Podrimja, madje edhe titulli i përmbledhjes është shkëputur nga një varg i tij.

Po ashtu në vitin 1999 del në Messina vëllimi i parë i antologjisë së poetëve mesdhetarë me titull *Lingue di mare lingue di terra*, përgatitur nga Costanza Ferrini. Në vëllimin e parë poezitë e Podrimjes janë përkthyer nga Blerina Suta, ndërsa në vëllimin e dytë, i vitit 2000, poezitë nga shqipja janë përkthyer nga Anilda Ibrahimit.

Më 1998 botohet në Lecce përmbledhja e studimeve *Miscellanea di Lingua e Cultura Albanese*, përgatitur nga Emil Lafe me përkthime të M. G. Fracasso e M. Abbondanza Greco. Midis studimeve të ndryshme këtu gjejmë edhe një të Ferdinand Lekës me titull *Lingua e letteratura in Albania nei secoli XIX e XX* ku sillen disa veçori të zhvillimit të letërsisë moderne shqiptare. Në paragrafin kushtuar poezisë kosovare veçohen Mekuli dhe Podrimja, ku i fundit cilësohet si paraprirës i ideve perëndimore në poezinë shqipe të Kosovës.

Më 2000, nën kujdesin e Daniele Giancane, nga shtëpia botuese “Besa” e Lecce-s del në dritë përmbledhja poetike *Poesia dal Kossovo*. Aty paraqiten 10 poetë e midis tyre edhe Podrimja dhe Shkreli. Studimi hyrës është bërë nga D. Giancane, ku thuhet se poezia e kësaj periudhe duhet parë nën dritën e një vizioni ballkanik. Natyrisht, poezitë e zgjedhura lëshojnë klithma lirike duke kërkuar kohë më të mira. Poeti që cilësohet më tepër nga ky studiues është Podrimja si ai më i

angazhuari si nga ana poetike dhe nga ana personale. Studimi përmbyllës është bërë nga D. Paticucci e R. Kubati ku kujtojnë disa ngjarje të rëndësishme historike të Kosovës dhe theksojnë se poezitë e paraqitura kanë si synim të nxisin emocione e përsiatje të një populli që me dinjitet i ka qëndruar fatit. Poeti që cilësohet më shumë nga këta autorë është Shkreli i cili falë forcës filozofike të poezisë së tij ka arritur të gërshetojë më së miri dualitetin jetë-arsye, si edhe ka sjellë kontribute të rëndësishme për pasurimin e gjuhës shqipe. Poezitë janë përkthyer nga një grup studiuesish, por ato të Podrimjes janë përkthyer nga B. Suta, A. Gnisci e D. Paticucci, ndërsa poezitë e Shkrelit nga D. Paticucci. Vëllimi përmban gjithashtu një faqe me fusnota shpjeguese mbi elementet historiko-gjeografike të përmendura në poezi, si edhe disa shënime biografie të autorëve.

Pas këtyre rasteve nuk kemi hasur më antologji apo përmbledhje të përbashkëta, por kemi gjetur dy vëllime të veçanta për secilin poet.

I pari është botuar në Bari në 2005 dhe i përket Azem Shkrelit: *Parole di pietra*, që përmban 28 poezi të përkthyer nga Amik Kasoruh. Në hyrje të vëllimit gjejmë një hartë të Ballkanit me disa të dhëna mbi pozicionin gjeografik të Kosovës. Më pas redaktorja ka bërë një paraqitje të gjendjes shoqërore dhe politike të Kosovës dhe disa të dhëna historike. Libri përmban një parathënie të hartuar nga Anton Nikë Berisha, i cili ka zgjedhur edhe poezitë e vëllimit. Berisha kryen një udhëtim në artin poetik të Shkrelit, ku theksohen veçantitë e strukturës së tekstit dhe të mesazhit të poezisë së Shkrelit, mënyrën sesi ai i shfrytëzon mundësitë e përpunimit gjuhësor deri në maksimum duke u përqendruar tek njësitë më të vogla të strukturës gjuhësore, për të vazhduar tek poezia si njësi tërësore, pastaj te përmbledhja si njësi shprehje e stili.

Parathënia ndiqet nga një shënim bibliografik dhe nga një shënim i përkthyesit, i cili shpjegon strategjinë e tij të përkthimit. Ai thotë se është përqendruar më shumë në mesazhin e poezisë duke ndjekur një përkthim “të lirë” i cili respekton renditjen e fjalëve të dhënë nga poeti, por nuk ndikohet nga rima edhe metrika.

Siç e përmendëm poezitë janë 28 dhe janë zgjedhur sipas një kriteri të caktuar poetik, domethënë ato që trajtojnë poezinë, idenë e poetit mbi poezinë, një lloj metateksti poetik. Janë poezi që kanë të bëjnë me përsiatje mbi fjalën dhe ndikimin e saj, fuqinë e kumtit poetik, mospërputhjen me realitetin, shqiptimi i këtyre ndjenjave përmes vargjeve, domethënë vargje zjarri e vargje guri, siç e sugjeron edhe titulli.

Më 2007 kemi vëllimin e Ali Podrimjes *Deserto invasivo* përgatitur dhe përkthyer nga Blerina Suta, nën mbikëqyrjen e studiuesit të shquar, Filippo Bettini, president i shoqatës kulturore *Allogorein*. Vepra hapet me një përshëndetje të Vincenzo Maria Vita, i cili vë në pah rolin e poezisë që bashkon dhe nuk ndan si edhe meritën e jashtëzakonshme të Podrimjes të shprehë nëpërmjet një retorike sublime nevojën e vazhdueshme për rindërtim dhe kërkimin e përsosjes. Në hyrjen e

B. Sutës ndriçohen vlerat artistike të poezisë së Podrimjes që nga fillimet e saj e deri në 2007. Në vijim Bettini sqaron nismën e këtij botimi, që bën pjesë në një projekt më të gjerë që përfshin autorë të veçantë të Mesdheut, ndër ta edhe Podrimja. Në fund kemi një cilësim të veçantë nga Visar Zhiti ku kujton letrën e dërguar nga Podrimja komitetit organizues të festivalit ndërkombëtar të poezisë në Itali. Në të, ndër të tjera thuhet se poeti nuk merrte pjesë në festival pasi ishte i zënë të varroste të vdekurit e vendit (atdheut) të tij. Podrimja thotë Zhiti ka krijuar një poezi instiktive që ulurit dhe nuk duron padrejtësinë.

Siç e përmenda më lart vëllimi është i ngjeshur dhe përmban 72 poezi të zgjedhura nga vetë poeti dhe të ndara në disa cikle me tituj të ndryshëm si *La finestra aperta*, *Tu viaggi ancora*, *Vivere*, *Finchè non scriverò la poesia per la madre*, *Un tronco brucia su una pianura sorda*, *Scivola una liburna*.

Natyrisht, të shumta janë rastet e përkthimeve dhe nismave individuale në botën e internetit si edhe botime në gazeta apo revista në format elektronik. Ne këtë grup futet edhe e nënshkruara e cila në 2011 botoi në revistën online *Excursus.org* (nr. 22, 23 e 26) dy punime dhe një paraqitje me të përkthyer në italisht dhe të shoqëruara nga komente të shkurtra.

Fatkeqësisht, për një analizë të hollësishme të përkthimeve që përmenda do të duhej me shumë hapësirë, në mënyrë që të trajtoheshin gjerësisht dukuritë dhe problemet e studim më vete. Për këtë arsye po ndalem vetëm në tri poezi, duke krahasuar dhe versionet e ndryshme.

Poezinë “Motive të verdha” të Azem Shkrelit e kemi në tri versione në italisht: Candreva/Chiaramonte, Scotti dhe Kasoruh. Për thjeshtësi shënojmë përkthyesit me shkronjën e parë të mbiemrit, kështu Ch.C. për Chiaramonte/Candreva, S (Scotti) dhe K (Kasoruh). Ndryshimi i qasjeve të ndryshme haset që në vargun e parë: “Po ikim nga gjaku im motive të verdha”, kemi përkthimin shumë të lirë dhe larg origjinalit *Sempre fuggiamo dalla nostra gente tristezza* të Ch.C., të cilët nisin vargun me ndajfoljen “gjithmonë” dhe sjellin “njerëzit tanë” për “gjaku im” dhe mbi të gjitha “motive të verdha” është zhdukur për t’i lënë vendin sinonimit të thjeshtuar “trishtim”. Edhe K. sjell “njerëzit e mi” për “gjaku im”, ndërkohë që ruan pjesën tjetër. Vetëm S. Në këtë rast ka ushtruar një përkthim të drejtpërdrejtë, duke ndjekur të njëjtin rend të autorit. Vargu i tretë “Po lindim mes bimëve të tjera” përkthehet në mënyrë të njëjtë nga K. dhe Ch. C. duke respektuar rendin e fjalëve të autorit dhe përcjellin kumtin e vargut, vetëm S. dallohet përsëri me *andiamo a nascere in una vegetazione diversa* (shkojmë të lindim në një bimësi të ndryshme). Siç shihet përkthimi është i lirë dhe vargu shumë më i gjatë se origjinali; ai jep idenë e së ardhmes jo të së tashmes të shprehur në origjinal. Vargu që vijon “Aty e tej janë pishat” i ndan kështu përkthyesit: vetëm Ch. C. vazhdojnë në linjën e korrespondencës së plotë të fjalëve në italisht, ndërsa K. me

imagjinuar, ose reale. Në fakt, temat ishin të trilluara, të imagjinuara pa fare shije, dhe të vakëta për shpirtin dhe syrin e spektatorit. Sytë tanë (spektatorit) janë në aparatin marrës, shkrihen me sytë e personazheve. Personazhet shohin me sytë tanë. Ky është një proces psikologjik i integruar brenda dy kufijve, shpërndarëse dhe pranuese, dhe duhet të ringjallet në mënyrë sa më të shëndoshë, të depërtojë dhe të reflektoj reciprokisht, koncepti , realizmi dhe qëllimi regjisorial, bashkë me spektatorin si gjykatës më të sinqertë. Publiku është i sinqertë, por ofruesi ose shpërndarësi i fotografisë lëvizëse, koordinuesi nuk arriti të depërtoj asnjëherë brenda një periudhe dhjetë vjeçare, të ndërtoj një film ose të metrazhit të shkurtë ose të gjatë, pa marr parasysh, të jetë bile një film. Për fat të keq kjo nuk ndodhi. Buxheti u harxhua, arti estetik i filmit, doli në dritë, me një mori kritikash që ishin me vend, dhe kjo si duket nuk depërtoj tek regjisorët ngase ata vazhduan dhe vazhdojnë, të “Thithin” buxhetin pa asnjë mëshirë, dhe prapë të shfaqin diçka jo pranuese. Ata nuk janë në dijeni se arti kinematografik ndërthen rregulla të një vrapimi më të shpejt se artet e tjera, dhe derisa Evropa si zanafilla e filmit, dhe përpunuesi dhe zhvilluesi i këtij arti SHBA-ja, vrapojnë me rregulla tejet të shpejta Kosova, ende ka stagnuar në gjumin e rëndë dimëror të këtij lloj arti. Shumë filma cilësor botëror janë bërë edhe me pak para, derisa ideja dhe koncepti mbretërorin dhe kafshonin frontin. Nëse filmi i metrazhit të gjatë, është një arenë tejet e rrezikshme, atëherë, është mese e nevojshme të krijohet një film i shkurtër, me një temë reale, me ngjyra artistike, me estetikë të qëndrueshme, dhe me një montazh profesional t’i tregoj Evropës se ka ekzistuar diçka dhe ende ekziston në Kosovë, dhe se nuk jemi ajo grimca e fundit mëshirë kërkuese për të gjithë!

Filmat e dështuar pas luftës

Duhet theksuar se me daljen e artit kinematografik nuk lindi vetëm një art i ri. Tek njeriu u zhvilluan veti të reja për të perceptuar, kuptuar artin që po pushton me hapa të shpejtë botën. Perceptuesit e filmit, apo publiku, nuk është më teatral, por filmik , i shpejt dhe brenda një kohe të shkurtër duhet të thuhet shumë, dhe regjisorët e filmit në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojnë të vërehen skenat lirshëm sipas rastit të humorit apo të çastit, por duhet të na detyrojnë të ndjekim kuadrot e njëpasnjëshme nëpërmjet renditjes së montazhit. Nuk duhet treguar vetëm pamjet, por me ndihën e interpretimit na komunikon kuptimin. Esteti i kinemasë Bela Balzas pohon se historia e artit deri më tani nuk ka shqyrtuar sa duhet e si duhet natyrën e këtij subjekti, që duhet të përfillet si mbartësi i kulturës artistike. Edhe në kinemanë kosovare, mungon dukshëm historia e filmit, kritika e sinqertë ndaj këtij arti, debate të shumta nëpërmjet të cilëve do shpaloset ana më e sinqertë artistike. Duhet përmendur rastin e filmit Kukumi (2005, 107 min, 35 mm), bashkëprodhim në mes të "Kosovafilmit" dhe “Jadran- Filmit” nga Zagrebi. Regjisor i filmit është Isa

Qosja, skenarist Mehmet Kraja, producent Gani Mehmetaj, muzikën e kompozoi Naim Krasniqi. Filmi është groteskë e situatave dhe e ngjarjeve, përqeshje e njerëzve dhe e karaktereve, por që merr kahjen e dramës së zymtë. Është ndër projektet më serioze të kinematografisë shqiptare të Kosovës dhe të “Kosovafilmit”. Të gjithë priten shumë nga ky film, si në fotografi, vijë dramaturgjike, ndërtim të personazheve, kuadro, montazh etj... Mirëpo, kjo nuk ndodhi!¹ Të dy protagonistët të çmendur, që jetojnë në një çmendi, Luan Jaha dhe Anisa Ismjali, të informuar mirë me rolet, kanë studiuar thellësisht edhe parabiografinë e personazhit, anën e brendshme emocionale, dhe të jashtmen treguese, koordinohen mrekullisht nga të dy protagonistët, edhe pse i tërë filmi është me pak tekst, veprimet nëpërmjet mimikës së dy protagonistëve, janë bindëse, të ndërtuara mire me një natyralizëm të lartë filmik. Kuptimi i emocionit dhe shtrëngata shpirtërore e shpërthimeve prej një gjendje në gjendjen tjetër, shpërfaq transformimin profesional aktoreskt, duke shpalosur edhe ngjarjen e filmit. Dashuria që krijohet në mes këtyre dyve, shpesh kalonte edhe në parodi, groteskë, komedi të zezë ku emocionet më të sinqerta pushtojnë raportet e dy aktorëve. Ana më e gabuar e filmit është kur aktori Luan Jaha, qëndron në mes të protestuesve të cilët e anashkalojnë pa ë vërejtur. Këtu kemi një situatë në mes protagonistit dhe roleve statike të cilat shërbejnë për shpalosjen e ngjarjes. Mos vërejtja e tyre nuk arsyetohet fare, ngaqë asnjë reagim i vogël nuk shpërfaqet për identifikimin e aktorit Jaha. Madje, me renditje të saktë skenike ata e anashkalojnë. Përse regjisori Qosja, nuk përdore bile një reagim për të theksuar në mënyrë të pavetëdijshme, në jetën e përditshme secili do të reagonte, derisa dihet që filmi i nënshtrohet rregullave të të përditshmes. Këtu ballafaqohemi me një situatë të ikur apo absurde të filmit. Filmi fillon me çmendi, dhe prapë personazhet kthehen në vendin ku filluan. Asnjë fund i lumtur, madje po të ekzistonte një personazh i lumtur i cili do të bënte një kthesë të madhe në mes ngjarjes, dhe personazheve. Por, jo fatkeqësisht publiku u zhyt në një krahurë psikologjike, në një dramë e cila në asnjë moment nuk krijon marrëdhënie me të bukurën apo të lumturën. Kemi filmin tjetër të regjisorit Agim Sopi “Anatema”, film i përfolur, i realizuar dobët, si në strukturë, montazh, vijë dramaturgjike filmi dështon dukshëm. Asnjë ngjarje nuk zbërthehet deri në fund. A duhet në këtë formë të shpjegohet lufta e Kosovës 1999?! Përmes imazheve, mbresave vizive reale, tregohet dhunë e paramilitarëve serb ndaj popullatës së pafajshme kosovare. Por, nuk mjafton vetëm me kaq. Dhënia e kuptimit është edhe një detyrë e pashmangshme, mbasi kërkimi i kuptimit është një proces që kryhet automatikisht tek spektatori dhe kur regjisori mos ta dojë. Parëzimi, lidhja e imazheve të ndryshme do të ngjallin kurdoherë te shikuesi një seri shoqërimi idesh. Por, tek Anatema lidhja e imazheve është paksa e gabuar. Pjesa e cila është e gabuar ndodhë në një kishë. Buri me gruan zhvillojnë marrëdhënie

¹ Bela Balzas, Filmkultura, Tiranë, 2008 f.43

seksuale, kurse të nesërmen futen paramilitarët serb, dhe dhunojnë femrat. Dhunimet bëhen tejet artificiale, vetëm për të gënjyer syrin e shikuesit, britma e vajzave është artificiale dhe figurat që shfaqën pas dhunimit i ngjajnë më shumë pjesës teatrale sesa filmike. Ndërkaq, pas një kohe, përfundon lufta, burri takohet me gruan dhe e braktisë atë, si shkak i braktisjes është dhunimi i ndodhur dhe dyshimi tek fëmija e tij. Përse regjisori krijon një moment kontradiktor, aspak real, por iluziv që nuk i shkon asnjë filmi, e hiç më pak kësaj ngjarje. Seria e imazheve nxit tek spektatori një proces të gabuar psikologjik, që automatikisht nën trysinë e imazheve nuk ndalohej, por regjisori do bënte mirë t'i japë këtij procesi që në fillim një drejtim të përpiktë për tek ajo e vërtetë që ai ka synuar qysh kur vendosi të xhirojë filmin. Gjithmonë regjisori duhet të grumbullojë imazhe të realitetit. Kemi filmin “Kodi i jetës” i Ekrem Kryeziut. Filmi u kritikua dhe ende kritikohet, të gjitha mendimet u shprehen haptas, jo nëpër kafene. Por, sa janë relevante këto kritika, përderisa autokritika nuk ekziston në Kosovë! Kritikat këtu ngërthejnë edhe disa pyetje për amoralitetin në dhënien e vlerësimeve për krijimet artistike në Kosovë. Kush e ka etalonin për të dhënë vlerësime të pagabuara në Kosovë? Ai që ka lidhje e që imponohet në media? Klanet me ndikim në rrethet e kuazi-rrethet artistike? Dhe, sa janë të sakta vlerësimet përderisa gjithçka në Kosovë kritikohet - varësisht nga preferencat e klaneve - dhe pothuaj secili thotë se nuk ka vlera këtu, qoftë në teatër, qoftë në film, muzikë, pikturë etj.? Kodi i jetës” trajton jetën përmes luftës së fundit në Kosovë, mes forcave të UÇK-së dhe atyre policore e ushtarake të Serbisë. Në fokus të ngjarjes janë dy personazhe, Lani dhe Maria, të cilët i shpëtojnë vrasjeve masive. Ata i bashkon fati personal dhe ai kolektiv. Ndërsa, mbijetesat e tyre është rruga e gjatë e mbijetesës së vetë popullit shqiptar. Kodi i jetës” është film i metaforave. Simboli mbi të cilin ngritet filmi është “ringjallja” e Lanit. Mbi këtë mit, i cili pulson në etnopsikologjinë e popullit shqiptar, autori e ndërton fabulën shumë shtresore, përplot simbole, të cilat për t'i kuptuar duhet njohur stilin dhe jetën e Kryeziut.

Simboli tjetër është titulli “Kodi i jetës”, i zbërthimit të artit të të jetuarit, në një botë të urrejtjes ndërnacionale dhe ndërnjerëzore, dhe në rrafshin që trason rrugëtimin e kryepersonazhit Lani në kërkim të familjarëve të tij. Gabimet në film janë, ku në disa pjesë vërehen reklamat e kompanive sigurimeve që nuk kanë ekzistuar gjatë luftës. Po ashtu edhe uji Rugovë i cili u shpikë më vonë se ngjarja e filmit. Gabime minimale, por tek një dramaturg dhe regjisor siç është Kryeziu nuk guxojnë të ndodhin. Filmi është një art kompleks, një art që kushton shumë, sidomos në Kosovë ku nuk ka teknikë qoftë për produksionin e postproduksionin të tij. Ajo që duhet të përmendur është filmi i Bosnjës “10 minutes”. Film i shkurtër, ku ngjarja fillon në Itali me një fotograf i cili bredh rrugëve, për të kërkuar zhvillimin e fotografive. Futet brenda dhe pyet se për sa kohë mund të zhvillohen fotografitë të cilat i bart në fotoaparate, përgjigja është : për dhjetë minuta. Menjëherë ngjarja

zhvendoset në Bosnje ku ndodh një luftë e tmerrshme. Brenda dhjetë minutave, masakrohet një familje, derisa në Itali zhvillohen fotografitë. Filmi ndërtohet mbi imazhin, konceptin, strukturën. Ajo që është e veçantë është koha, ku për dhjetë minuta në botë mund të ndodh çdo gjë. Filmi bëri bujë të madhe, u prit mirë nga kritika botërore, dhe nuk ishin kushtet materiale ato që e ngritën filmin, por ideja, qasja, realizmi dhe sinqeriteti i punës së regjisorit. Edhe Kosova mund të ketë një film, por nëse vazhdohet të punohet individualisht duke grabitur projekte sa për të “Vjedhur” para, ende do të vazhdon “Hendikepimi” i kinemasë.

Përfundimi

Me analizën e gjuhës së filmit zbulohet diçka nga realiteti që me sy të zakonshëm nuk shihet dot dhe as që mund t’i afroshesh. Aparati marrës krijon, zbulon dhe na sjell një botë të panjohur. Çdo art bazohet mbi një lloj distance midis veprës dhe konsumuesit të saj, filmi përjashton këtë mundësi duke ndryshuar me këtë dhe marrëdhëniet tona me botën. Filmi nuk mund të shikohet thjesht si një novitet teknik, apo thjesht si një nga mënyrat e dëfrimit të qytetarëve. Filmi është kurorëzim i formave artistike të deritatherhisme, një pranim dialektik i tij. Është një art që na zbulon sfera të reja të realitetit ose na i zbulon të njohurat e mëparshme në një mënyrë të re.

Literatura:

1. Bela Balzas, *Filmkultura*, Tiranë, 2008
2. Alfred Uci, *Estetika*, Tiranë, 1989
3. Vladimir Jevtovic, *Uzbudljivo pozoriste*, 1997, Beograd

Maciej SZYMANSKI

DEGA E BALLKANISTIKËS NË POZNANJ

Deri tani gjuha shqipe mësohej vetëm në Universitetin „Mikolaj Kopernik” në Torunj, dhe para disa vitesh për një kohë të shkurtër në Kolegjiun Evropian në Gniezno (ku është filiali i Universitetit të Poznanjit). Shqipja mësohet edhe në Varshavë, por vetëm si lektorat gjuhe.

Prej dy vitesh në Institutin e Filologjisë Sllave në Universitetin “Adam Mickieviç” në Poznanj funksionon dega e re – ballkanistika, ku studentët mësojnë dy gjuhë ballkanike. Deri tani ato janë shqipja dhe maqedonishtja. Në plane janë edhe gjuhë të tjera të Ballkanit: rumanishtja, greqishtja e re, turqishtja, por gjithmonë bashkë me një gjuhë sllave. Dega ka karakterin e studimeve kulturore dhe me këtë dallohet nga degë të tjera që janë në Institutin e Gjuhëve Sllave, sepse ato janë filologji (filologji bullgare, serbe, kroate dhe ajo çeke). Ballkanistika është degë e veçantë, e cila mbahet në Poloni vetëm në Universitetin e Poznanjit.

Tani do të përshkruaj shkurt programin e studimeve. Mbi të gjitha ato janë studime interdisiplinare, gjë që shihet më lehtë në faktin se mësimet realizohen në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë (konkretisht me Institutin e Historisë dhe me Institutin e Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore) edhe me Fakultetin e Shkencave Politike dhe të Gazetarisë në Universitetin tonë.

Përpos dy gjuhëve kryesore studentët vazhdojnë mësimin e një gjuhe perëndimore. Fitojnë edhe dijeni të gjithanëshme kulturore mbi rajonin dhe mbi letërsinë dhe historinë e vendeve ballkanike. Studenti ka mundësi të diplomohet në sistemin baqelor brenda disiplinës së zgjedhur me profil filologjik ose etnologjik, antropologjik ose atë historik.

Lëndët që jepen përfshijnë: letërsinë e gjuhëve që mësohen, letërsinë bizantine, letërsinë e sllavëve të jugut, folklorin gojor të Ballkanit, lidhjen gjuhësore ballkanike, historinë e vendeve ballkanike (që prej vjetërsisë), historinë e shtetit dhe të ligjit në Ballkan, marrëdhëniet politike ndërkombëtare në Ballkan; ka lëndë nga fusha e etnologjisë, antropologjisë kulturore, ka edhe bazë për islamin dhe fenë ortodokse. Që prej semestrit të tretë studentët zgjedhin specializimin: turizëm kulturor apo komunikim kulturor. Secili prej këtyre specializimeve përfshin lëndë të veçanta. Pra, studentët fitojnë dijeni të shumëllojshme për Ballkanin, të cilën mund ta thellojnë duke shkuar në vendet ballkanike.

Siç shihet lëndë albanologjike të mirëfillta janë lektorati i gjuhës dhe historia e letërsisë shqiptare. Numri i orëve të mësimit të gjuhës shqipe në çdo semestër është 60 (pra 2 herë në javë me nga 90 minuta), vetëm në semestrin e fundit janë 45 orë.

Historia e letërsisë shqiptare mbahet në vitin e dytë në formën e leksioneve dhe të ushtrimeve. Në gjithë vitin e dytë ka 30 orë leksione dhe 60 orë ushtrime. Qëllimi i kësaj lënde është njohja e fakteve më të rëndësishme nga historia e letërsisë shqiptare, njohja e faktorëve historiko-shoqërorë të zhvillimit të saj në Shqipëri, Kosovë, dhe në Itali, leximi i teksteve të përkthyer polonisht dhe pjesë të zgjedhura në origjinal. Studenti pas kalimit të kursit në këtë lëndë ka aftësi: 1) të bëjë periodizimin e letërsisë shqiptare; 2) të tregojë lidhjet midis etapave të veçanta të zhvillimit të letërsisë me historinë dhe me kulturën shqiptare; 3) të përshkruajë tiparet më esenciale të periudhave historike letrare; 4) të sqarojë specifikën e zhvillimit të kësaj letërsie në kontekstin e ndikimit të rretheve të ndryshme kulturore; 5) të përshkruajë letërsinë bashkëkohore të përkthyer polonisht, ta interpretojë në kontekstin e ngjarjeve politike dhe të ndryshimeve kulturore pas Luftës së Dytë Botërore dhe në kohën e transformimit të viteve të fundit.

Siç kam thënë më parë, lënda mbahet në vitin e dytë të studimeve, pas kursit njëvjeçar me 120 orë. Kjo për fat të keq akoma nuk e lejon leximin e librave në gjuhën shqipe. Për këtë arsye mësimi vazhdon dyanshëm. Gjatë leksioneve flitet për historinë e letërsisë në mënyrë kronologjike, njëkohësisht gjatë orëve të ushtrimeve diskutohet mbi ato libra që i kanë lexuar studentët. Mesa duket tani, kjo është mënyra e vetme për ta mbajtur këtë lëndë.

Nuk duhet harruar se dega e ballkanistikës nuk është degë filologjike, por kulturore. Edhe trajtimi i çështjes së letërsisë shqiptare ka një dimension tjetër. Vërehen faktorë të jashtëm të krijimit të veprave të veçanta, biografia e autorit, kërkohen motive karakteristike, të cilat mund të ekzistonin vetëm në ambientin kulturor shqiptar ose janë prezentuar në mënyrë tipike.

Kontakti vetëm me letërsinë e përkthyer shkakton mungesën e njohjes së drejtpërdrejtë të veprave të vjetra, për shembull nga koha e Rilindjes ose periudha para Luftës së Dytë Botërore. Këtë udhëheqësi i kësaj lënde përpiqet ta plotësojë gjatë leksioneve me përkthime të veta të fragmenteve të veprave më të rëndësishme.

Mendoj se këtu ia vlen edhe të përmenden titujt e librave të përkthyer në gjuhën polake, të cilat mund t'i shfrytëzojnë studentët. Ata janë: disa vepra të Ismail Kadaresë: *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, *Prilli i thyer*, *Kush e solli Doruntinën*, *Dosja H.*, *Përbindëshi*, *Pallati i ëndrrave*, *Vajza e Agamemnonit*, *Pasardhësi*; Fatos Kongoli: *Lëkura e qenit*, Ylljet Aliçka: *Kompromis*, Luan Starova: *Koha e dhive*, Gazmend Kapllani: *Ditar i shkurtër kufiri*, Ornela Vorpsi: *Vendi ku nuk vdes kurrë*, *Dora që nuk kafshon*, Elvira Dones: *Virgjëresha e betuar*. Nga poezia ka vjersha të

përmbledhura të Ali Podrimjes, një libër me vjersha të Eqrem Bashës edhe një antologji me poezi të autorëve të ndryshëm bashkëkohorë.

Kultura e një vendi tjetër njihet prej burimeve të ndryshme, edhe prej letërsisë, megjithatë burimi më i mirë dhe më i pasur është kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit. Shpesh vetëm vizita në vendin, gjuhën e të cilit mëson dikush, e shtyn të punojë me intensitet dhe të thellojë studimet.

Prandaj, duke shfrytëzuar rastin, e falenderoj përzemërsisht drejtorin, të gjithë organizatorët dhe të gjithë personat e angazhuar në këtë seminar, që studentët tanë kanë këtë mundësi të vijnë në Kosovë dhe të shikojnë e përjetojnë atë që mësojnë në universitet.

Orkida BORSHI

**RILINDJA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË UNIVERSITETIN
E KARLIT NË PRAGË**

Abstrakt

Studimet Jugo-sllave me specializim për gjuhën shqipe titullohet programi i ri në nivelin bachelor, hapur nga viti akademik 2001/2012 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Karlit në Pragë. Në kuadër të këtij programi realizohet mësimdhënia e gjuhës e lingistikës shqipe, historisë e literaturës shqiptare në kontekst më të gjërë ballkanik dhe jugoevropian.

Aktualisht (2012) është duke u përgatitur dhe në pritje të aprovimit zyrtar programi master për të njëjtin specializim. Kjo shtesë e domosdoshme e programit bachelor ka si synim zgjerimin dhe njëkohësisht përforcimin e degës së gjuhës shqipe në FFUK në Pragë.

Fjalë kyçe: gjuhë shqipe, studime albanologjike, rilindje, Universiteti i Karlit, Pragë, Republikë Çeke.

**A REVIVAL OF ALBANIAN STUDIES AT CHARLES UNIVERSITY
IN PRAGUE**

Abstract

South Slavonic and Balkan Studies with Specialisation in Albanian is a new study programme launched at the Faculty of Arts (Charles University in Prague) from the academic year of 2011/2012 at the B.A. level. Integrated into a larger framework, subjects such as Albanian language, Albanian linguistics, Albanian history and literature are taught hand in hand with those of other South European countries.

In addition to that, a new accreditation material (2012) for the follow-up M.A. programme also counts on Albanian studies and philology.

Keywords: Albanian language, Albanian studies, revival, Charles University, Prague, Czech Republic.

Rilindja e studimeve albanologjike në Universitetin e Karlit në Pragë

Roli i shqipes në konteaksin evropian konceptohet si i rrezikuar. Kjo ndodh nga disa arsye. Në radhë të parë, kemi të bëjmë me një numër të pakët folësish të shqipes si gjuhë të parë. Burimet oficiale janë të pasakta, megjithatë flitet për një numër ca 7 milionë nëpër botë. Ky numër ndeshet me modifikime qoftë nga ana demografike, ekonomike, gjeografike, etj. Sa vjen e më tepër shfaqet veprimi i diasporës shqiptare nëpër botë.

Nëse pikat e mësipërme janë sporadike, është më se e qartë se numri i folësve të gjuhës shqipe (si gjuhë të dytë) është shumë i vogël për disa shkaqe. Shqipja, megjithëse konsiderohet si gjuhë indoevropiane, nuk bën pjesë në asnjë nëngrup të këtyre gjuhëve dhe njëlloj si p.sh. greqishtja ose armenishtja konsiderohet si gjuhë më vete. Kjo do të thotë se relativisht shqipja është një gjuhë me pak afërsi me gjuhët e tjera indoevropiane nga aspekti gjeanologjik, i cili sjell me vete vështirësi në planin gramatikor e fonetik të gjuhës. Izolimi linguistik i shqipes, nuk është i vetmi në eksistencën e saj; të paktën këtu janë edhe dy pikëpamje të tjera, ana historike dhe politike.

Tradita e mësimdhënies dhe punës shkencore në fushën e albanologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Karlit në Pragë themelohet në shekullin e 19-të nën drejtimin e linguistit të shquar J.U.Jarnikut (Gosturani, 173). Vazhdimësia e këtij projekti është herë pas here e rrezikuar qoftë për shkak të ngjarjeve politike në Evropë, qoftë nga financimi i ulët i kësaj dege. Pas një ndërprerjeje të gjatë, ndodh që shqipja të rishfaqet në të njëjtin fakultet në periudhën e viteve 50 të shekullit të kaluar. Disa nga emrat e shkencëtarëve të shquar të asaj kohe janë: Vl. Buben, V. Polák, B. Havránek, P. Novák, etj. (Gosturani, 281-283). I vetmi prej këtyre, që është marrë plotësisht me shqipen, ka qenë J.U.Jarniku. Shkencëtarët e tjerë e kanë konsideruar kërkimin dhe punën shkencore në këtë fushë si shtojcë të specializimit të tyre.

Në të njëjtën kohë, pra po në vitet 50-të Universiteti i Karlit ofron mundësi studimi të gjuhës shqipe për studentët a interesuar. Kjo ofertë ndërpritet po në të njëjtët vite për arsye politike. Pas një pauze mjaft të gjatë, në vitet 90-të të shekullit të kaluar ripërtërihet studimi i gjuhës shqipe në Pragë, prapë për arsye politike, kësaj radhe në lidhje me konfliktin në Kosovë po në të njëjtën periudhë. Programi i rinovuar është trevjeçar, pra për nivelin bachelor, dhe nuk qëndron gjatë.

Shekulli XXI sjell disa të reja në fatin e gjuhës shqipe në FFUK-në e Pragës. Në radhë të parë Katedra e studimeve Jugosllave e ballkanike e strehon shqipen nën krahët e saj duke i hapur mundësi etablimi e zhvillimi programit të akredituar me titull: *Studime Jugo-sllave e ballkanike me specializim në gjuhën shqipe*, i cili i hap dyert për të pranuar studentët e parë nga viti akademik 2011/2012 në nivelin bachelor. Më tutje shqipes, kulturës dhe historisë shqiptare i hapet mundësia të

integrohet në kuadër të studimeve ballkanike dhe jugoevropiane duke përdorur metoda krahasimi midis shqipes dhe gjuhëve të tjera fqinje si dhe gjuhëve të tjera indoevropiane. Fjala është për studime areali që marrin parasysh anën filologjike të gjuhës.

Kështu mësimdhënia e shqipes në Fakultetin Filozofik të Pragës vendoset në të njëjtën shkallë me atë të bullgarishtes, kroatishtes, rumanishtes, serbishtes apo sllovenishtes. Pikët përbërëse më me rëndësi në programin studimor janë historia dhe letërsia, të cilat trajtohen duke marrë parasysh tërë arealin. Gjuha shqipe dhe linguistika e saj qëndrojnë më vete në këtë program. Mësimdhënia e linguistikës bazohet në aspektin sinkronik të gjuhës në nivelin bachelor. Lëndët përbërëse janë: fonetika dhe fonologjia, morfologjia dhe sintaksa; pjesërisht leksikologjia dhe etimologjia e gjuhës shqipe. Metodologjia gjuhësore zhvillohet në bazë të trashëgimisë së Shkollës linguistike të Pragës – Pražský lingvistický kroužek.

Lënda e gjuhës praktike nënvizon domosdoshmërinë e normës së shqipes standarde, megjithatë mbulon edhe pika e veçanti të dialektit gegë. Kjo e dyta jepet edhe nga fakti se metoda kryesore, e cila përdoret në kurset e gjuhës praktike, është teksti mësimor Colloquial Albanian nga Isa Zymberi. Studentët e gjuhës shqipe anës normës standarde ndeshen edhe me shprehje geqe. Ky fakt shërben si një përgatitje për ta nëse vendosin të vazhdojnë më tej me studimet e shqipes në programin master, ku ballafaqohen konkretisht me dialektet e ndryshme të gjuhës shqipe, duke përshkruar natyrisht ngjashmëritë e ndryshimet midis tyre. Metoda e I. Zymberit është krijuar me të vërtetë për studentët anglofonë të gjuhës shqipe, por autori ka lejuar një adaptim të kësaj metode për gjuhën çeke si dhe shpërndarjen e këtij materiali për nevojat e kursit. Përveç librit të mësipërm, kursi i gjuhës shqipe në FFUK merr parasysh edhe materiale të tjera, si p.sh.: Angély, 1998 ; Boissin, 1975 ; Buchholz, 1987 ; Camaj, 1984; Demiraj, 2002; Kostallari, 1974; Neziroski, 2003 ; Newmark, 1957 ; Pani, 2007 ; Shkurtaj, 2001; Thomai, 2006, etj.

Meqenëse nga pikëpamja liguistike gjuha shqipe zë vend mënjanë, krahasimet me gjuhët e tjera, përveç gjuhëve sllave, janë të domosdoshme. Për këtë arsye në kurs përdoren shembuj nga gjuhët gjermanike (anglisht, gjermanisht), latine (frëngjisht, italisht), etj. Kjo metodë kontrastive i ndihmon studentët të krijojnë paralele midis shqipes dhe gjuhëve të tjera evropiane në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i përshkruajnë ngjashmëritë dhe ndryshimet e shqipes me gjuhët e tjera.

Dega e gjuhës shqipe në FFUK në Pragë mund të ketë perspektivë në të ardhmen, vetëm nëse plotësohen disa pikëpamje. Në radhë të parë nuk duhet të ndërpritet vazhdimësia e mësimdhënies së gjuhës, ashtu siç ka ndodhur disa herë në të kaluarën. Më tutje studentëve duhet t'u hapet mundësia për të vazhduar studimet në nivelin master. Aktualisht, kurset e programit master janë gati, në pritje të akreditimit të shqipes nga Ministria e arsimit të shtetit çek. Një pikë gjithashtu me mjaft rëndësi është puna shkencore dhe mbështetja e saj në fushën e gjuhës shqipe

në Çeki. Vendosja e shqipes së bashku me gjuhët e tjera të arealit, i krijon asaj mundësi të vëzhgohet nga pikëpamje të ndryshme krahasuese dhe njëkohësisht integruese, jo vetëm në kuadrin evropian, por edhe në atë shkencor.

Programi bachelor i titulluar: *Studime Jugo-sllave me specializim për gjuhën shqipe* nuk do të realizohej pa ndihmën e mbështetjen e personave të mëposhtëm. Ata të gjithë me mundësitë dhe punën e tyre e ndihmuan e po e ndihmojnë kthimin e kësaj gjuhe të lashtë evropiane në tokën akademike të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Karlit në Pragë dhe për mundimin e tyre u takon të falënderohen. Ata janë: doc. PhDr. Jan Pelikáni CSc. (Drejtori i Katedrës të studimeve jugo-sllave e ballkanike, historian), doc. PhDr. Michal Stehlíku, PhD. (Dekani i FFUK-së në Pragë), prof. PhDr. Aleš Klégri (Gjuhëtar-anglist), Mgr. Přemysl Vinši (Antropolog-albanolog), Bc. Šárka Frantová (Drejtoresha e bibliotekës së FFUK-së), Mgr. Livia Vrzalová (Drejtoresha e CeSIS-it). Falënderim i veçantë i takon (posthum.) doc. PhDr. Pavel Novákut, CSc.

Bibliografi

1. ANGELY, Robert, de, (1998): *Grammaire albanaise comparée*. Paris: Gerfau SN.
2. BOISSIN, Henri (1975), : *Grammaire de l'albanais moderne*. Paris: L'Harmattan.
3. BUCHHOLZ, Oda, FIEDLER, Wilfried (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig: VEB Enzyklopädie.
4. CAMAJ, Martin (1984), *Albanian Grammar with Exercises*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
5. DEMIRAJ, Shaban (2002), *Morfologjia dhe sintaksa e gjuhës së sotme shqipe I, II*. Tiranë: Universiteti shtetëror i Tiranës – katedra e gjuhës shqipe.
6. GOSTURANI, Xheladin (1999), *Historia e albanologjisë*. Tiranë : Albin.
7. KOSTALLARI, Androkli a kol. (1974), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
8. NEWMARK, Leonard (1957), *Structural Grammar of Albanian*. Bloomington, Ind.: Indiana University.
9. NEZIROSKI, Fatmire (2003), *Manuel de conjugaison des verbes albanais*. Paris: L'Harmattan.
10. PANI, Pandeli (2007), *Albanisch intensiv*. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag.

11. SHKURTAJ, Gjovalin, HYSA, Enver (2001), *Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut*. Tiranë: Botimet Toena.
12. THOMAI, Jani (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Toena.
13. ZYMBERI, Isa. (1991), *Colloquial Albanian*. London, New York: Routledge.
14. ZYMBERI, Isa (2001), *Colloquial Albanian*. London, New York: Routledge.
15. www.elsie.de

Edmond ÇALI

BOTIMET ‘NOVELLISTICA ITALO-ALBANESE’ TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE SHQIPTARE NË UNIVERSITETIN ‘LA SAPIENZA’ TË ROMËS

I francesi non leggono, a quanto pare. E, per giunta chi stabilisce queste impietose statistiche mescola, senza distinzioni, alta e bassa letteratura, guide turistiche e libri di cucina. I libri sui libri, altrimenti detti di critica, attirano soltanto una piccola minoranza di un gruppo già esiguo: qualche studente, alcuni appassionati. Ma con la critica della critica si arriva a un culmine, segno forse della futilità dei tempi: chi potrebbe trovarvi motivo d'interesse?¹

I. Studimet gjuhësore dhe letrare në fushë të shqipes në Itali – pjesë themeltare e sistemit të letrave shqipe. Lidhje sistemike në sistemin letrar shqiptar midis veprës së shkrimtarit dhe veprës së kritikut (dhe filologut).

Në këtë punim analizojmë fare shkurt studimet hyrëse të tri vëllimeve që përmbledhin krijimtarinë e arbëreshëve të botuara nga Instituti i Studimeve Shqiptare në universitetin “La Sapienza” të Romës në periudhën 1966-1972 (në vitet 1966, 1970 dhe 1972²).

Kemi të bëjmë me krijimtarinë popullore në prozë të arbëreshëve të Italisë. Botimet filluan nën kujdesin e prof. Ernest Koliqit, i cili është edhe autor i studimit hyrës të vëllimit të parë.

Studimin hyrës të Koliqit edhe e sjellim pothuajse të plotë në citim me përkthimin shqip karshi. Kështu veprojme edhe me studimin hyrës të prof. G. Gradilone-s. Shkrimin e Martin Camajt e citojmë shkurt vetëm në italishte (edhe sepse një pjesë e hyrjes së vëllimit përbëhet nga një riparaqitje e studimit të Michele Marchianò-së³).

¹ TODOROV, 1986, f. 3.

² KOLIQI, 1966, GRADILONE, 1970, CAMAJ, 1972. Kujtojmë edhe MIRACCO 1985 të botuar shumë vite më pas.

³ “Canti popolari albanesi della Capitanata e del Molise di Michele Marchianò”, në CAMAJ 1972, f. XI-XVIII. Botimi i mëvonshëm, MIRACCO 1985, është thelbësor në këtë kuadër

II. Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia. Vol. I: Novellistica italo-albanese. Testi orali raccolti dal Prof. Luca Perrone ordinati e tradotti in italiano a cura dell'Istituto di Studi Albanesi della Università di Roma.

Përveç pjesës së parë pa nëntitull studimi i Koliqit ndahet në pesë pjesë:

1) Origini delle comunità arbreshe; 2) Letteratura orale italo-albanese; 3) Precedenti raccolte; 4) Luca Perrone e la sua raccolta; 5) La novellistica popolare italo-albanese.

Vijon në f. XXV një sqarim i Luca Perrone-s në lidhje me alfabetin, me përdorimin e theksit dhe të apostrofit dhe një sqarim tjetër (i Angelo Fabi-t) në lidhje me mënyrën e klasifikimit të tregimeve, të pajisjes së tyre me një numër rendor dhe me ndarjen e tyre tematike (f. XXV).

Shqyrtojmë këtu vetëm punimin e Koliqit. Koliqi nuk ishte filolog. Nuk ishte filolog as edhe Luka Perrone. Me sa duket edhe për këtë arsye tekstet e grumbulluara nga Luka Perrone janë rregulluar dhe janë përkthyer në italishte nën kujdesin e Institutit të Studimeve Shqiptare të Universitetit të Romës. Nga punimet kritike të Ernest Koliqit na rezulton se ai ishte një kritik shkrimtar⁴. Kritika e tij me kalimin e viteve u bë ajo vetë një formë letërsie. Këtë shkrim të Koliqit, që po shqyrtojmë shkurt këtu dhe që po e paraqesim në dy gjuhë, mund ta vendosim pranë *Histori e popullit në vargje* të Ismail Kadaresë. Dy punimet mund të jenë bashkëplotësuese të një pjese të sistemit studimor në pjesën e tij që i përket krijimtarisë popullore të popullit shqiptar. Koliqi është, pra, një kritik shkrimtar. Kurse Kadareja është një shkrimtar kritik, d.m.th. shkrimtar që shkruan (edhe) kritikë.

Ja dhe materiali: në kolonën majtas në italishte dhe në kolonën djathtas në përkthimin tonë në shqip⁵.

Letteratura orale italo-albanese

(p. XIII) Il patrimonio espressivo degli Albanesi d'Italia colpì di meraviglia gli studiosi di folklore italiani e stranieri, quando Girolamo De Rada e Niccolò Jenò dei Coronei pubblicarono nel 1866 le "Rapsodie d'un poema albanese". Altre raccolte che seguirono (p. XIV)

Letërsia gojore italo-shqiptare

(f. XIII) Pasuria shprehëse e shqiptarëve të Italisë i mrekulloi studiuesit e folklorit, italianë dhe të huaj, atëherë kur Jeronim De Rada dhe Nikolo Jenò dei Koronei botuan në vitin 1866 "Rapsodie d'un poema albanese". Përmbledhje të tjera që vijuan (f. XIV) nuk bënë gjë tjetër veçse

studimi. Materiali i teksteve pothuajse i tëri është grumbulluar, transkriptuar dhe përkthyer nga vetë prof. Miracco.

⁴ Për këtë shiko "I critici scrittori: Sartre, Blanchot, Barthes", në TODOROV, 1986, f. 52-79, f. 52.

⁵ KOLIQI, 1966, f. XIII-XVI, XX-XXIV.

non fecero che confermare il suo valore etnografico ed estetico. Gli stessi Albanesi, che le tristi vicende storiche avevano tenuto fino allora all'oscuro dei preziosi valori conservati nella loro memoria collettiva, e mai fermati sulle carte, furono scossi da un fremito di commosso orgoglio alla lettura specie dei canti popolari vivi e palpitanti di aneliti repressi di rinascita, scrigno della loro ignorata spiritualità.

Nelle rapsodie raccolte dal De Rada raggiava di epica gloria la bellezza della lotta sostenuta da Skanderbeg e dal suo popolo contro i Turchi. Era un messaggio che da un remoto passato vibrava pieno d'incitamenti nel presente e si proiettava nell'avvenire.

Ma non solo di riflessi d'epopea sfolgora la poesia popolare arbreshe, che il rinomato studioso tedesco di letteratura popolare, Alois Schmaus, considera come il primo esempio di canto epico nei Balcani, ma anche ne sgorgano nobili accenti umani in una effusiva e suggestiva liricità. Piena di doti musicali e cromatiche si rivela anche la lingua fresca e genuina di questi antichi canti anonimi. Lamartine scrisse al De Rada "*La poésie est venue de vos rivages et doit y retourner*". La letteratura orale italo-albanese, come le consorelle di altri popoli, comprende le due note categorie: il patrimonio narrativo popolare in prosa e la poesia popolare. Quest'ultima assume varie forme fra gli Albanesi d'Italia: rapsodie o canti tradizionali, importati dall'Albania nei secoli XV e XVI e poi una svariatissima gamma di componimenti lirici come le ninnenanne, i canti d'amore, le ballate nuziali, gli stornelli, gli sfoghi satirici, i compianti funebri ecc. L'Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma intende anzitutto procedere alla raccolta

konfirmuan vlerën e saj etnografike dhe estetike. Vetë shqiptarët, që ngjarjet e dhimbshme të historisë i kishin mbajtur deri atëherë larg njohjes së vlerave të çmuara të ruajtura në kujtesën e tyre kolektive, dhe që nuk kishin mbetur mbi letër, u tronditën nga një dridhje krenarie plot mallëngjim sidomos kur lexuan këngët popullore të gjalla dhe që rrihnin nga dëshirat e shtypura për rilindje, peshtaf i botës së tyre shpirtërore të panjohur. Në rapsoditë e mbledhura nga De Rada rrezatonte me lavdi epike bukuria e luftës që kishte bërë Skënderbeu dhe populli i tij kundër turqve. Ishte një kumtim që nga një e kaluar e largët kumbonte plot nxitje në të tashmen dhe lëshohej drejt së ardhmes.

Por poezia popullore arbëreshe nuk shkëlqente vetëm nga jehonat e epopesë, të cilën studiuesi gjerman i letërsisë popullore Alois Schmaus e konsideron si shembullin e parë të këngës epike në Ballkan, por prej aty burojnë fjalë njerëzore fisnike në një lirizëm efuziv dhe magjepsës. Plot me dhunti muzikore dhe kromatike del edhe gjuha e freskët dhe e pastër e këtyre këngëve të lashta të autorëve pa emër. Lamartini i shkroi De Radës "*La poésie est venue de vos rivages et doit y retourner*". Letërsia gojore italo-shqiptare, ashtu si simotrat e popujve të tjerë, përfshin dy kategoritë e njohura: trashëgiminë rrëfimore popullore në prozë dhe poezinë popullore. Kjo e fundit merr forma të ndryshme midis shqiptarëve të Italisë: rapsodi ose këngë tradicionale, të importuara në Itali nga Shqipëria në shekujt XV dhe XVI dhe pastaj një gamë shumë të larmishme të krijimeve lirike si ninananat, këngët e dashurisë, baladat e dasmave, stornelet, krijimet lirike, këngët e vdekjes etj. Instituti i Studimeve Shqiptare i Universitetit të Romës ka ndërmend para së gjithash që të kryejë grumbullimin dhe botimin e teksteve

e alla pubblicazione dei testi orali narrativi in prosa, cioè della novellistica, la quale, non essendo racchiusa in ritmi poetici, che ne facilitino la conservazione nella memoria collettiva, corre il pericolo di andar in breve tempo perduta. Speriamo in seguito di completare il panorama delle tradizioni popolari italo-albanesi anche con raccolte di altri generi sia in prosa che in versi (gli indovinelli, i proverbi, gli scongiuri e tutto il complesso delle tradizioni popolari).

p. XV

PRECEDENTI RACCOLTE

Poche sono le pubblicazioni che riguardano la letteratura orale italo-albanese. Abbondano invece quelle di prosa e poesia popolare d'Albania dove il patrimonio espressivo nazionale negli ultimi cinquant'anni è stato oggetto di accurata raccolta e di diligente studio. La preziosa materia folkloristica arbreshe rimane in gran parte inesplorata e sta scomparendo rapidamente o va perdendo la fisionomia originaria. Le due ultime guerre ruppero l'isolamento in cui vivevano molte di quelle comunità. L'abbandono dei paesi per affluire verso le città provoca l'impoverimento della humus etnica. Ogni persona anziana che muore porta con sé incalcolabili tesori di lingua e di patrimonio tradizionale collettivo. Il contatto, ora molto più intensificato con le popolazioni finitime e tutte le inevitabili trasformazioni della vita sociale che reca il progresso, minano alle radici usi e costumi conservati gelosamente per secoli. Nelle prime raccolte di Girolamo De Rada, di Demetrio Camarda, di Michele Marchianò, di Giuseppe Schirò sr., di Maximilian Lambertz ecc. vibrano i lieviti originari della stirpe. Non che siano attualmente del tutto inariditi, ma

gojore rrëfimtare në prozë, pra të novelës, e cila, duke mos qenë e mbyllur në ritme poetike, që të lehtësojnë ruajtjen në kujtesën kolektive, ka rrezikun që brenda një kohe të shkurtër të humbasë. Shpresojmë që në vijim të mundemi ta plotësojmë panoramën e traditave popullore italo-shqiptare edhe me përmbledhje të gjinive të tjera qoftë në prozë qoftë në vargje (gjëagjëzat, fjalët e urta, përбетimet dhe tërësinë e traditave popullore).

f. XV

Përmbledhjet e mëparshme

Janë pak botimet që kanë të bëjnë me letërsinë gojore italo-shqiptare. Janë me shumicë ato në prozë dhe në poezi popullore të Shqipërisë ku trashëgimia shprehëse kombëtare e pesëdhjetë viteve të fundit ka qenë objekt i një grumbullimi të kujdesshëm dhe i një studimi të zellshëm. Materja e çmuar folklorike arbëreshe mbetet në pjesën më të madhe e pazbuluar dhe po zhduket me shpejtësi ose po e humbet fizionominë e origjinës. Dy luftërat e fundit e thyen izolimin ku jetonin shumë prej këtyre komuniteteve. Braktisja e fshatrave për t'u derdhur drejt qyteteve shkaktonte varfërimin e humusit etnik. Çdo i moshuar që vdes merr me vete thesare të pallogaritshme të gjuhës dhe të trashëgimisë tradicionale kolektive. Kontakti, tashmë shumë më i intensifikuar me popullsinë fqinje dhe të gjitha shndërrimet e pamënjanueshme të jetës sociale që bart përparimi, i minojnë në rrënjë traditat dhe zakonet e ruajtura me xhelozë për shekuj me radhë. Në përmbledhjet e para të Jeronim De Radës, të Demetrio Camarda-s, të Michele Marchianò-së, të Giuseppe Schirò plakut, të Maximilian Lambertz-it jetojnë shkëndijat e origjinës së popullit. Nuk është se tashmë kanë shterpur, por depërtimet e zakoneve të huaja ua ulin

le infiltrazioni di consuetudini straniere ne attenuano il vigore primordiale e ne affievoliscono le specifiche qualità etniche. Bisogna affrettarsi a trascrivere scrupolosamente quanto prima attingendolo dalla bocca del popolo, ciò che rimane di tradizioni popolari nella memoria delle comunità arbreshe, specie nei luoghi di migliore conservazione, cioè in alcune località del Molise, della Lucania, della Calabria e della Sicilia. (p. XVI) Se si tarda ancora qualche anno, la letteratura orale italo-albanese perderà l'impronta originale prima di scomparire del tutto. Negli archivi e nella fonoteca dell'Istituto di Studi Albanesi della Università di Roma, da più di quindici anni sta accumulandosi e aumentando il materiale delle tradizioni degli Albanesi d'Italia. Uno stuolo di studenti hanno percorso e stanno ogni anno percorrendo i centri arbreshë in cerca di novellatori e novellatrici locali per farsi dettare testi orali del fondo novellistico popolare. Il materiale raccolto essi poi lo elaborano nelle tesi di laurea di cui già un buon numero arricchisce la biblioteca dell'Istituto. Ma non è sufficiente l'opera, sia pur appassionata e solerte, di questi giovani. Occorre organizzare una équipe di raccoglitori provetti e servirsi di ricercatori locali per salvare in tempo dall'oblio il folklore italo-albanese.

Luca Perrone e la sua raccolta
Il Dott. Luca Perrone, di Eianina, località calabro-albanese nelle vicinanze di Castrovillari da anni si dedica con esemplare amoroso zelo, alla raccolta del folklore arbresh. Conosce bene non soltanto la parlata del suo paese nativo Eianina, ma tutte le variazioni dialettali delle località albanesi della Calabria nonché l'albanese ufficiale d'Albania.

forcën parake dhe ua zbusin cilësitë e veçanta etnike. Duhet të nxitohemi që të transkriptomë sa më shpejt me shumë kujdes, duke e nxjerrë nga goja e popullit, atë që mbetet nga traditat popullore në kujtesën e komuniteteve arbëreshe, sidomos në vendet ku janë ruajtur më mirë, pra në disa lokalitete të Molizes, të Lukanas, të Kalabrisë dhe të Siçilisë. (f. XVI) Nëse vonohemi edhe ndonjë vit tjetër, letërsia gojore italo-shqiptare do ta humbasë originalitetin deri sa të zhduket krejtësisht.

Në arkivat e fonotekës të Institutit të Studimeve Shqiptare të Universitetit të Romës, që prej më shumë se pesëmbëdhjetë vjetësh po grumbullohet dhe po shtohet materiali i traditave të shqiptarëve të Italisë. Një numër i madh studentësh kanë vizituar dhe çdo vit po vizitojnë qendrat arbëreshe duke kërkuar rrëfyes dhe rrëfyese përrallash vendas që ata t'u diktojnë tekstet gojore të fondit të novelave popullore. Materialin e grumbulluar ata pastaj e përpunojnë në punimet e temave të diplomës prej të cilave tashmë një numër i madh pasuron bibliotekën e Institutit. Por nuk mjafton puna, edhe pse e pasionuar dhe e zellshme e këtyre të rinjve. Duhet të organizohet një ekip grumbulluesish me përvojë dhe duhen përdorur kërkues vendorë për të shpëtuar në kohë nga harresa folklorin italo-shqiptar.

Luka Perrone dhe përmbledhja e tij
Dott. Luka Perrone, nga Eianina, lokalitet calabro-shqiptar pranë Castrovillari-t, prej vitesh i kushtohet me një zell shembullor plot dashuri, grumbullimit të folklorit arbëresh. Njeh mirë jo vetëm të folmen e fshatit të tij të lindjes Eianinës, por të gjitha variantet dialektore të lokaliteteve shqiptare të Kalabrisë si edhe shqipen zyrtare të Shqipërisë. Transkriptimi i

Irreprensibile è la sua fedeltà nella trascrizione dei testi orali. Un richiamo del sangue lo spinge a quest'opera di trascrizione precisa e fedele, da cui trae ispirazione per comporre fresche liriche nell'idioma dei prischi padri. Con questo volume di testi orali da lui appassionatamente raccolti, il Perrone ci offre una collana di vivide perle del patrimonio narrativo calabro-albanese, interessantissimo dal punto di vista linguistico ed etnografico e attraente come libro di lettura ricreativa.

Egli comincia a darci racconti, fiabe, facezie e aneddoti di sei paesi, di quello nativo che è Eianina e di altri cinque che non ne distano molto.

La novellistica popolare italo-albanese (f. XX)
Non crediamo necessario accennare qui alla questione della genesi (monogenesi e poligenesi) delle favole (o racconti di animali e piante o in genere di esseri inanimati) e delle fiabe. Si sa che si tratta di motivi migratori. Anche se parecchie narrazioni della raccolta del Perrone non si possono classificare secondo i tipi dell'indice Aarne-Thompson, le somiglianze col patrimonio espressivo universale saltano subito agli occhi. Come altrove così qui spesso c'è intreccio e commistione di vari temi in una stessa favola o fiaba o racconto; altre volte invece il motivo che serve altrove di ossatura a una sola narrazione qui si scompone in due parti a sé stanti. (p. XXI) Nella fervida fantasia del popolo si fondono gli spunti venuti da ogni dove e ne scaturiscono nuove creazioni. Ogni gente elabora la materia narrativa per adattarla al proprio particolare gusto. Inavvertitamente, nel crogiolo della fantasia dei novellatori, spunti e frantumi di motivi universali germogliano e sbocciano in nuove fioriture. Ogni popolo, impossessandosi

teksteve gojore nga ana e tij është bërë me besnikëri të patëmetë. Një thirrje e gjakut e shtyn në këtë vepër transkriptimi të saktë dhe besnik, nga e cila nxjerr frymëzim për të krijuar poezi lirike në gjuhën e të parëve. Me këtë vëllim tekstesh gojore të përmbledhur prej tij me pasion, Perrone na ofron një gjerdan perlash plot jetë të trashëgimisë rrëfimore kalabro-shqiptare, shumë interesant nga pikëpamja gjuhësore dhe etnografike dhe tërheqës si libër leximi çlodhës.

Ai fillon të na japë tregime, përralla, hoka dhe anekdota të gjashtë fshatrave, të fshatit të lindjes që është Eianina dhe të pesë fshatrave të tjerë që nuk janë shumë larg prej tij.

Novela popullore italo-shqiptare
Nuk mendojmë se është e novojshme që të prekim këtu çështjen e gjenezës (monogjenezë dhe poligjenezë) të fabulave (ose tregimeve të kafshëve dhe të bimëve ose në përgjithësi të qenieve të pashpirta) dhe të përrallave. Dihet që bëhet fjalë për motive shtegtare. Edhe pse shumë rrëfime të përmbledhjes së Perrone-s nuk mund të klasifikohen sipas modelit të tabelës Aarne-Thompson, ngjashmëritë me trashëgiminë e përgjithshme bien menjëherë në sy. Ashtu si edhe në ndonjë vend tjetër edhe këtu shpesh kemi ndërthurjen dhe përzierjen e temave të ndryshme në të njëjtën fabul ose përrallë ose tregim; kurse ndonjë herë tjetër motivi që shërben diku tjetër si skemë e një rrëfimi të vetëm këtu çmontohet në dy pjesë që rrinë më vete. (f. XXI) Në fantazinë e zjarrtë të popullit shkrihen pikënisjet e ardhura nga kudo dhe prej aty lindin krijime të reja. Çdo popull e përpunon lëndën rrëfimore për t'ia përshtatur shijes së vet të veçantë. Pa e vënë re, në furrën e shkrirjes së fantazisë së treguesve të novelave, pikënisje e

dei temi comuni a tutto il mondo, ne rielabora la sostanza, la rimaneggia nel suo idioma e le imprime, con evidenza più o meno palese, la propria impronta etnica. La quale appunto si manifesta non tanto nell'originalità del motivo quanto all'accentuazione di alcuni episodi o momenti o passaggi più sentiti e più aderenti alla sensibilità collettiva della stirpe.

Un fugace studio comparativo fra le narrazioni italo-albanesi e quelle dell'Albania, sia nella preferenza data nella scelta ad un gruppo piuttosto che ad un altro nella miriade dei comuni universali motivi sia nelle sottolineature di alcune piuttosto che di altre fasi della loro rielaborazione, rivela una identità sorprendente di sentimento e di gusto. L'alto concetto del senso d'onore e della "besa" (promessa giurata), entrambi qualità distintive della gente albanese, che del resto anche in altri paesi esistono, ma sentite ed esposte però senza un particolare rilievo, appaiono fra gli Albanesi d'Albania e fra gli Italo-Albanesi identicamente marcati col più vivo accento. Basta sfogliare le raccolte di prosa popolare apparse in Albania, - e accenno qui per brevità soltanto a due di esse ottime fra tutte, - quelle cioè di P. Donat Kurti e di Anton Çetta, per constatare subito l'identico risalto che hanno nelle narrazioni popolari sia albanesi (schipetare) sia italo-albanesi (arbreshe) alcuni tratti specifici della natura umana e alcune tipiche reazioni di essa come la assoluta lealtà nei rapporti con amici e il vicinato, tenaci impulsi vendicativi in chi subisce torti o sorpresi, la mancanza di pregiudizio in fatto di classi sociali (le antiche leggi consuetudinarie del popolo d'Albania, il cui spirito è tuttora vivo e operante nel sangue in ognuno dei suoi figli, considerano tutti gli

copëza të motiveve të përgjithshme mbijnë dhe çelin në lulëzime të reja. Çdo popull, duke bërë të vetat temat e përbashkëta të të gjithë botës, përpunon thelbin e tyre, e ripunon në gjuhën e vet dhe i vë, në mënyrë të dukshme ose të padukshme, vulën e vet etnike. E cila del në pah pikërisht jo dhe aq në origjinalitetin e motivit se sa në theksimin e disa episodeve, ose çasteve, ose kalimeve më të ndjera dhe më të lidhura me ndjeshmërinë kolektive të popullit.

Një studim i shpejtë krahasues midis rrëfimeve italo-shqiptare dhe atyre të Shqipërisë, qoftë në parapëlqimin e dhënë në zgjedhjen për një grup dhe jo për një tjetër në morinë e motiveve të përgjithshme të përbashkëta qoftë në nënvizimin e disa fazave dhe jo të disa të tjerave në ripërpunimin e tyre, nxjerr në pah një identitet befasues ndjenje dhe shijeje. Vlerësimi i lartë i nderit dhe i besës, të dyja cilësi dalluese të popullit shqiptar, që egzistojnë edhe në vende të tjera, por që ndjehen dhe paraqiten pa një rëndësi të veçantë, shfaqen midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe midis italo-shqiptarëve të theksuara plot gjallëri në një mënyrë identike. Mjafton të shfletosh përmbledhjet e prozës popullore që kanë dalë në Shqipëri, - dhe kujtoj këtu shkurt vetëm dy shumë të mira prej tyre, - pra ato të Atë Donat Kurtit dhe të Anton Çettës, për të konstatuar menjëherë rëndësinë e njëllëjtë që kanë në rrëfimet popullore qoftë shqiptare qoftë italo-shqiptare (arbëreshe) disa sjellje të veçanta të natyrës njerëzore dhe disa reagime tipike të saj si sinqeriteti në marrëdhëniet me miqtë dhe fqinjët, vrullet e forta hakmarrëse tek ai që pëson padrejtësi, mungesa e paragjyqimeve përsa u përket klasave shoqërore (ligjet e lashta zakonore të popullit shqiptar, fryma e të cilave është ende e gjallë dhe vepron në gjakun e kujtdo prej bijve të tij, i konsiderojnë të

Albanesi uguali fra loro), l'attrazione verso le più pericolose avventure, l'ammirazione per i bei colpi riusciti mercè l'astuzia senza tener troppo conto di qualche deviazione dalla comune linea morale. (p. XXII)

Il novellatore anonimo popolare, indotto a ciò dalle esigenze del gusto della collettività a cui si rivolge, nel corso del suo raccontare, dove eccelle sovente una sua rudimentale tecnica non priva di abilità, concede tutta la sua simpatia all'individuo che affronta le vicende della vita con coraggio ma anche con astuzia. Cosicché appare evidente l'intenzionale fusione, nell'eroe protagonista della fiaba, delle due nature, la leonina e la volpina, auspiccate dal Macchiavelli come dati precipue del suo ideale tiranno. Qui non si vuole affermare che simili elementi psicologici siano esclusivi dell'indole albanese; nulla di assolutamente originale esiste nella novellistica di nessun popolo: qui si vuole segnalare soltanto che alcune caratteristiche nelle narrazioni popolari sia albanesi che italo-albanesi e certi sentimenti sono accentuati con maggior rilievo.

Considerazioni comparatistiche queste che meriterebbero una trattazione più ampia e confortata da appropriate citazioni, a cui qui per brevità soprassediamo. Evidentemente un certo divario esiste fra il patrimonio novellistico degli Albanesi d'Italia e quello attuale della loro patria d'origine. Cinque secoli di distacco sono molti ed è stata grande la diversità del destino storico. Entrando a far parte dello sterminato e babilonico impero ottomano, estendentesi su tre continenti, gli Albanesi d'Albania ricevettero apporti che penetravano nel vivo del loro spirito, massime nelle città del litorale. L'elemento fantastico della

gjithë shqiptarët të barabartë midis tyre), tërheqja brenda aventurave më të rrezikshme, admirimi për goditjet e arrira falë dinakërisë pa marrë shumë parasysh ndonjë largim nga linja morale e zakonshme.(f. XXII)

Rrëfyysi popullor anonim i novelave, i shtyrë për këtë nga kërkesat e shijes së kolektivitetit të cilit i drejtohet, gjatë rrëfimit të tij, ku shkëlqen shpesh një teknikë elementare jo pa aftësi, ia jep gjithë simpatinë e tij individit që ndeshet me ngjarjet e jetës me guxim por edhe me dhelpëri. Kështu del e qartë shkrirja e qëllimshme, tek heroi-protagonist i përrallës, i dy natyrave, ajo e luanit dhe ajo e dhelpës, që uron Macchiavelli si cilësi kryesore të tiranit të tij ideal. Këtu nuk duam të pohojmë se këto elemente psikologjike janë vetëm të shpirtit shqiptar; asgjë plotësisht origjinale nuk egziston në novelën e asnjë populli: këtu duam vetëm të vëmë në dukje se disa karakteristika në rrëfimet popullore qoftë shqiptare qoftë italo-shqiptare dhe disa ndjenja theksohen me më shumë rëndësi. Këto vlerësime krahasuese do të meritonin një trajtim më të gjerë dhe të mbështetura nga citime të sakta, të cilat këtu për t'i rënë shkurt nuk i shqyrtojmë. Del në pah një farë dallimi midis trashëgimisë së novelës të shqiptarëve të Italisë dhe asaj aktuale të atdheut të tyre. Pesë shekuj shkëputje janë shumë dhe ka qenë i madh ndryshimi i fatit historik. Duke hyrë për të bërë pjesë në perandorinë otomane që ishte e pafund dhe e rrëmujshe, që shtrihej në tri kontinente, shqiptarët e Shqipërisë morën ndihmesa që depërtuan në pjesën e gjallë të shpirtit të tyre, sidomos në qytetet e bregdetit. Elementi fantastik i novelës italo-shqiptare është ndërhyrja e shenjtoreve, e vetë Jezu Krishtit, e zanave, e katallanëve, e murgjërve, e djajve, e cubave. Kurse në Shqipëri rrëfimet janë plot më dervishë,

novellistica italo-albanese consiste nell'intervento di santi, dello stesso Gesù Cristo, di fate, di orchi, di monaci, di demoni, di briganti. In Albania invece le narrazioni pullulano di dervisci, pascià, geni, maghi, di stregoni negri, di muftù (vescovi maomettani), di cadì (giudici religiosi islamici) ecc. Soltanto nelle montagne d'Albania compare nella letteratura orale una viva mitologia pagana di antichissima origine ario-europea: le Zâna (dee alpestri), le Ore (semidee che proteggono gli eroi nelle più temerarie imprese), la Kulshedra (l'idra dalle sette teste), i drangoj (guerrieri sovrumani che difendono il paese dalla Kulshedra e dai nemici), la Lubia (mostro malefico metà belva e metà rettile), Nuset e detit o Këshetat (le spose del mare o sirene), Floçka (la ninfa che vive nelle sorgenti e nel pozzo di casa), viktorija (il serpente che dimora nelle fondamenta della casa e s'identifica col destino della medesima) ecc. (p. XXIII)

Nelle più antiche narrazioni italo-albanesi non si trova una specifica presenza dell'elemento fantastico orientale, se si prescinde da quelle generiche tracce di fiabe importate fin dalle più remote epoche dall'Oriente e comuni a tutto il patrimonio fiabesco europeo. Gli Arbreshë uscirono dalla patria con tutto il bagaglio della loro novellistica prima che il dominio turco spalancasse le porte dell'Albania ai pieni influssi orientali. Invece in alcune fiabe arbreshe sono avvertibili i ricordi della antichissima tipica mitologia delle montagne albanesi (e bukra e jets, in Albania e bukura e dheut ecc.) soltanto che l'essere mitologico pagano nella variante italo-albanese è stato di solito sostituito, se benefico, da un santo cristiano e, se malefico, da un demonio. Santi e demoni non appaiono mai nella

më pashallarë, me shpirtëra, me magjistarë, me shtrigj, me zezakë, me muftinj (peshkopë myslimanë), me kadilerë (gjykatës fetarë islamikë), etj. Vetëm në malet e Shqipërisë shfaqet në letërsinë gojore një mitologji e gjallë pagane me origjinë shumë të lashtë indoevropiane: Zanat (perëndeshat e alpeve), Orët (gjysmëperëndesha që i mbrojnë heronjtë në ndërmarrjet më të guximshme), Kulshedra (kuçedra me shtatë koka), dragojtë (luftëtarë mbinjerëzorë që e mbrojnë vendin nga Kulshedra dhe nga armiqtë), Lubia (përbindësh i keq gjysmë kafshë dhe gjysmë reptil), Nuset e detit ose Këshetat (sirenat), Floçka (nimfa që jeton në burimet ose në pusin e shtëpisë), viktorija (gjarpri që jeton në themelet e shtëpisë dhe njëjtësohet me fatin e saj), etj. (f. XXIII)

Në rrëfimet më të lashta italo-shqiptare nuk gjendet një prani e veçantë e elementit fantastik oriental, nëse lëmë mënjanë ato gjurmë të përgjithshme të përrallave që janë importuar që nga kohët më të largëta nga lindja dhe që janë të përbashkëta për të gjithë trashëgiminë evropiane të përrallave. Arbëreshët dolën nga atdheu me gjithë bagazhin e novelës së tyre para se pushtimi turk t'ia hapte dyert e Shqipërisë ndikimit të plotë lindor. Kurse tek disa nga përrallat arbëreshe ndjehet kujtimi i mitologjisë tipike shumë të lashtë të maleve shqiptare (e bukra e jets, në Shqipëri e bukra e dheut, etj), vetëm se qënia mitologjike pagane në variantin italo-shqiptar është zëvendësuar zakonisht, nëse e mirë, nga një shenjt i krishterë dhe, nëse e keqe, nga një djall. Shenjtër dhe djaj nuk dalin kurrë në novelën e Shqipërisë.

Etnografi do të gjejë një lëndë studimi interesante në këtë përmbledhje dhe historiani do të mund të gjejë aty të dhëna shumë të dobishme që rikrijonë

novellistica d'Albania.

L'etnografo troverà interessante materia di studio nella presente raccolta e anche lo storico vi potrà scoprire dati utilissimi che ricreano l'atmosfera di certi lontani o recenti eventi albanesi o balcanici, ma soprattutto il glottologo sarà attratto dai fenomeni linguistici che caratterizzano il linguaggio di queste narrazioni, linguaggio staccatosi da centinaia di anni dal ceppo originario e in alcuna parte rimasto immutato e in altra soggetto a trasformazioni più o meno differenti da quelle subite dalla lingua nella madrepatria. Le parlate delle comunità albanesi d'Italia, nella gamma della loro grande varietà, nascondono tesori lessicali e fraseologici di capitale importanza per l'approfondita conoscenza e per lo sviluppo della lingua albanese. Elementi comuni dei due principali dialetti dell'Albania, il ghego e il toscano, rimasti fra gli Italo-Albanesi pressoché intatti nella loro struttura arcaica, aprono spiragli improvvisi sulla evoluzione dell'albanese. Non si può concepire una storia della lingua albanese senza una precisa scientifica cognizione delle parlate arbëreshe. Molti fenomeni fonetici, morfologici e sintattici, molti etimi saranno lumeggiati e molti problemi linguistici risolti dallo studio dei testi orali arbëreshë che qui presentiamo.

Dal punto della linguistica generale, poi, lo studio dei vari sottodialetti arbëreshë servirà a chiarire molte idee sulle fasi evolutive di una qualsiasi altra lingua, poiché difficilmente altrove s'incorre nella possibilità di seguire passo passo le fasi di una parlata, recisa dal tronco originario, e conservatasi per cinque secoli viva in terra straniera, e che si è esposta, dove più dove meno, alla infiltrazione di vocaboli o modi di dire

atmosferën e disa ndodhive shqiptare ose ballkanike të largëta ose të afërta, por sidomos gjuhëtari do të bëhet për vete nga dukuritë gjuhësore që karakterizojnë gjuhën e këtyre rrëfimeve, gjuhë e shkëputur prej qindra vjetësh nga trangu i origjinës dhe që në disa pjesë ka mbetur i pandryshuar dhe në disa pjesë të tjera u është nënshtruar shndërrimeve pak a shumë të ndryshme nga ato që ka pësuar gjuha në atdheun mëmë. Të folmet e komuniteteve shqiptare të Italisë, në gamën e larmisë së tyre të madhe, fshehin thesare leksikore dhe frazeologjike me rëndësi shumë të madhe për njohjen e thellë dhe për zhvillimin e gjuhës shqipe. Elemente të përbashkëta të dy dialekteve kryesore të Shqipërisë, dialektit geg dhe atij tosk, të mbetura tek italo-shqiptarët pothuajse të paprekura në strukturën e tyre arkaike, hedhin dritë papritmas mbi zhvillimin e shqipes. Nuk mund të konceptohet një histori e gjuhës shqipe pa një njohje të saktë shkencore të të folmeve arbëreshe. Shumë dukuri fonetike, morfologjike dhe sintaksore, shumë prejardhje fjalësh do të ndriçohen dhe shumë probleme gjuhësore do të zgjidhen nga studimi i teksteve gojore arbëreshe që po paraqesim këtu.

Nga pikëpamja e gjuhësisë së përgjithshme, pastaj, studimi i nëndialekteve të ndryshme arbëreshe do të shërbejë për të sqaruar shumë ide mbi fazat e zhvillimit të çdo gjuhe, meqë vështirë se mund të gjejmë diku tjetër mundësinë që të ndjekim hap pas hapi fazat e një të folmeje, të shkëputur nga trangu prej të cilit ka prejardhjen, dhe të ruajtur e gjallë për pesë shekuj në dhe të huaj, dhe që mund të pësonte, ku më shumë e ku më pak, ndikimin e depërtimit të fjalëve ose të shprehjeve të fshatrave fqinje me një gjuhë tjetër ose me një dialekt tjetër. (f. XXIV) Në disa prej tetëdhjetë fshatrave italo-shqiptare gjuha e

dei paesi finitimi di altra lingua o dialetto che sia. (p. XXIV)

In alcuni degli ottanta paesi italo-albanesi la lingua degli antichi padri fiorisce tuttora con una stupefacente vitalità, intatta o quasi nel sistema del lessico e nella struttura espressiva fondamentale, profondamente imbevuta di linfa idiomatica, che la rende idonea a creazioni artistiche originali come ne fanno testimonianza le opere di molti scrittori arbreshë che la usarono innalzandola a strumento espressivo letterario. In altri resiste tenacemente ma incrinata da irruzioni di vocaboli e modi di dire dai dialetti circosvicini di altra lingua. In altri ancora l'albanese sopravvive stentatamente con termini e frasi galleggianti in una straripante inondazione di elementi linguistici estranei. Ma anche dove sembra del tutto scomparsa, l'albanese resiste coi suoi calchi tipici nel dialetto o nella lingua che l'hanno sopraffatto. E' un ampio arco di fenomeni glottologici che speriamo interesseranno gli studiosi quando potremo presentare in tutta la sua singolare dovizia il Corpus delle tradizioni italo-albanesi.

Confidiamo nell'appoggio dei molti amici che abbiamo nelle località italo-albanesi per assolvere questo compito difficile e faticoso, ma assolutamente necessario e pieno di fruttuose prospettive.

Sentiamo l'obbligo di esprimere qui la nostra più viva gratitudine al Consiglio Nazionale delle Ricerche il cui concreto appoggio dà all'Istituto di Studi Albanesi della Università di Roma la possibilità di salvare il patrimonio delle tradizioni popolari italo-albanesi, tanto prezioso sia dal punto di vista della filologia comparata in particolare sia in genere di quello delle discipline umanistiche.

etërve të lashtë lulëzon ende me një gjallëri mahnitëse, e paprekur ose pothuajse e paprekur në sistemin e fjalorit dhe në strukturën shprehëse themelore, të mbushur thellësisht me limfë idiomatike, që e bën të aftë për krijime artistike origjinale siç e dëshmojnë veprat e shumë shkrimtarëve arbëreshë që e përdorën duke e ngritur në nivelin e një instrumenti shprehës letrar. Në fshatra të tjerë reziston me këmbëngulje por e cënuar nga dyndje fjalësh dhe shprehjesh nga diektet e afërta të gjuhës tjetër. Në fshatra të tjera shqipja mbijeton me vështirësi me terma dhe me fjali që pluskojnë në një përmytje me elemente gjuhësore të huaja. Por edhe ku duket se është zhdukur krejtësisht, shqipja reziston me kalket e saj tipike në dialektin ose në gjuhën që e ka mposhtur. Është një hark i gjerë dukurish gjuhësore që shpresojmë se do t'u interesojnë studiuesve kur do të mundim të paraqesim korpusin e traditave italo-shqiptare me të gjithë pasurinë e vet të veçantë.

Kemi besim në ndihmën e shumë miqve që kemi në lokalitetet italo-shqiptare për t'i bërë ballë kësaj detyre të vështirë dhe të lodhshme, por plotësisht të nevojshme dhe plot me perspektiva të frytshme.

Ndiejmë detyrimin që të shprehim këtu falënderimin tonë për Këshillin Kombëtar të Kërkimeve, ndihma konkrete e të cilit i jep Institutit të Studimeve Shqiptare të Universitetit të Romës mundësinë që të shpëtojë trashëgiminë e traditave popullore italo-shqiptare, shumë të çmuar qoftë nga pikëpamja e filologjisë së krahasuar në veçanti qoftë në përgjithësi nga pikëpamja e disiplinave humanistike.

Ernesto Koliqi

III. Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia. Vol. II: Novellistica italo-albanese. Racconti popolari di S. Sofia d'Epiro – S. Demetrio Corone – Macchia Albanese – S. Cosmo Alb. – Vaccarizzo Alb. – S. Giorgio Alb.

Vëllimi i dytë ka një hyrje të Giuseppe Gradilone-s. Le të shohim më parë parathënien e vëllimit. Theksohet vazhdimësia me vëllimin e parë:

“A distanza di qualche anno dal primo volume vede la luce il secondo della sezione “Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia”, il quale ne è la continuazione e per la materia contenuta e per la sua disposizione e per la metodologia usata nell'inchiesta”⁶.

Përcaktohet përmbajtja e materialit të botuar:

“Esso comprende la novellistica raccolta in altre sei comunità degli Albanesi d'Italia nella provincia di Cosenza, tra loro vicine per ubicazione. Si stendono infatti al di qua del Crati una dopo l'altra, per un arco di 32 km., di collina in collina.

Ciò che rese loro più facili gli incontri e di conseguenza comuni le vicende storiche e le esperienze umane.

Le sei località sono: Shën Sofia (Santa Sofia d'Epiro), Shën Mitri (S. Demetrio Corone), Maqi (Macchia Albanese), Stringari (S. Cosmo Albanese), Vakarici (Vaccarizzo Albanese), Mbuzati (S. Giorgio Albanese)⁷”.

Prof. Gradilone paraqet edhe veçorinë e këtij punimi në krahasim me vëllimin e mëparshëm:

“I testi, questa è la novità rispetto al primo volume, sono stati raccolti e tradotti in italiano da studenti arbreshë, i quali hanno frequentato per più anni i corsi impartiti nell'Istituto di studi albanesi dell'Università di Roma e hanno concluso i loro studi con una dissertazione in albanologia.

Il libro è, quindi, il risultato di quella attiva e feconda collaborazione fra docenti e allievi, che ha sempre ispirato e caratterizzato l'insegnamento della nostra disciplina.

I testi e la corrispondente traduzione in italiano sono stati revisionati e ordinati a cura dell'Istituto”⁸.

Përsa i përket punimit hyrës Gradilone thekson lidhjen e ngushtë me vëllimin e parë:

⁶ GRADILONE, 1970, f. V.

⁷ GRADILONE, 1970, f. V.

⁸ GRADILONE, 1970, f. V.

“Nella seguente breve introduzione ci si è limitati a dare rapide informazioni sulle sei comunità, per ricreare in qualche modo l’ambiente in cui è stata svolta l’inchiesta ed è stato raccolto il materiale novellistico.

Sarebbe superfluo ripetere quanto è stato detto con autorevole competenza dal Koliqi, nella sua introduzione al primo volume, sulla origine delle comunità arbreshe, sulla loro letteratura orale, sulle precedenti raccolte del patrimonio popolare.

Si rimanda a quelle pagine il lettore che volesse avere una chiara e sicura visione di questi argomenti”⁹.

Ja dhe teksti i një pjese të *Hyrjes* së vëllimit, në origjinalin italisht si edhe përkthimi shqip:

Giuseppe Gradilone, *Introduzione*

Nella dedica della sua grammatica della lingua albanese alla principessa Elena Gjika (Dora D’Istria) Giuseppe De Rada, figlio del grande poeta Girolamo De Rada, definisce le sei comunità di S. Sofia d’Epiro, S. Demetrio Corone, Macchia A., S. Cosmo A., Vaccarizzo A., S. Giorgio A., “il cantone albanese che meglio sé conserva”.

L’affermazione, sebbene oggi non possa essere condivisa in pieno da chi ha una buona conoscenza delle comunità albanesi in Italia, sta tuttavia a testimoniare una certa tendenza di presentare come campione di esse proprio questi paesi, che al di qua del Crati sembra si rincorrono l’un l’altro senza interferenze di altri di origine italiana.

Infatti da quando la Calabria non è stata più una terra da attraversare di notte o da evitare col battello da Napoli diretto in Sicilia (a conferma basta scorrere il classico e il più noto dei diari di viaggio in Italia, quello di Goethe) ogni visitatore straniero ha identificato le numerose colonie che si stendono

Giuseppe Gradilone, *Hyrje*

Në kushtimin e gramatikës së tij të gjuhës shqipe për princeshën Elena Gjika (Dora D’Istria) Xhuzepe De Rada, djali i poetit të madh Jeronim De Rada, i përkufizon gjashtë komunitetet e Shën Sofisë, Shën Mitrit, Maqit, Strigarit, Vakarcit, Mbuzatit, “kantoni shqiptar që e ruan më mirë veten”.

Ky pohim, edhe pse sot me të mund të mos jetë plotësisht dakord ai që i njeh mirë komunitetet shqiptare në Itali, dëshmon një farë prirjeje për t’i paraqitur si kampion i tyre pikërisht këto fshatra, që në këtë anë të Kratit duket sikur ndjekin njëri tjetrin pa ndërhyrjen e fshatrave të tjera me origjinë italiane.

Në fakt që kur Kalabria nuk qe më një rajon ku duhej kaluar natën ose që duhej mënjeluar me anijen nga Napoli në Siçili (si provë mjafton t’i hedhësh një sy ditarit klasik dhe më të njohur të udhëtimit nëpër Itali, atij të Gëtes), çdo vizitor i huaj i ka njëjtësuar kolonitë e shumta që shtrihen nga Abruco nëpërmjet Molizes, Puljas, Bazilikatës, deri në Kalabri dhe në Siçili me grupin që ka si qendër Shën Mitër Koronen.

Le të vlejnjë si shembull veprat *Vecchia*

⁹ GRADILONE, 1970, f. VI.

dall'Abruzzo attraverso il Molise, le Puglie, la Basilicata, fino alla Calabria e alla Sicilia con il gruppo che ha come centro S. Demetrio Corone.

Valgano come esempio le opere *Vecchia Calabria* di Norman Douglas (1915) e *L'anima della Calabria* di Kazimiera Alberti (1950); entrambi dedicano dei capitoli interi a questo nucleo e da essi traggono spunto per giudicare e ammirare tutti gli Albanesi d'Italia. (p. X)

Ciò si spiega col fatto che negli ultimi secoli S. Demetrio Corone è stato il centro spirituale e intellettuale degli Albanesi d'Italia grazie al secolare collegio di S. Adriano e che in questi paesi hanno avuto i natali grandi personalità poetiche, quali, per limitarci a qualche nome Giulio Variboba, Giuseppe Serembe, e soprattutto il grande Girolamo De Rada.

Le sei comunità, come ho già accennato, hanno avuto le stesse vicende storiche.

La stessa loro fondazione o ripopolazione di centri esistenti risale ai medesimi avvenimenti.

Infatti esse ebbero origine dall'esodo iniziatosi con la morte dell'eroe nazionale Giorgio Castriota Skanderbeg, avvenuta in Alessio nel 1468, quando la gente albanese, stremata dalle sofferenze e dai pericoli della guerra, preferì l'esilio alla sottomissione al "cane turco" e alla perdita delle avite tradizioni, dirigendosi nella penisola italica, là dove comuni vincoli di sangue (si ricordi il Virgiliano *cognatas urbes... populusque propinques*) e i recenti contatti avuti con il regno di Napoli facevano prevedere un'ospitale accoglienza, che in realtà non mancò.

E' opinione comune che di questi profughi alcuni si diressero in Puglia, altri in Calabria sulle coste del Corigli-

Calabria e Norman Douglas-it (1915) dhe *L'anima della Calabria* e Kazimiera Alberti-t (1950); të dyja i kushtojnë kapituj të tërë kësaj bërthame dhe marrin shkas prej tyre për të gjykuar dhe për të admiruar të gjithë shqiptarët e Italisë. (f. X)

Kjo gjë shpjegohet se në shekujt e fundit Shën Mitri ka qenë qendra shpirtërore dhe intelektuale e shqiptarëve të Italisë falë kolegjit shekullor të Shën Adrianit dhe që në këto fshatra kanë lindur personalitete të rëndësishme të letrave si, për t'u kufizuar vetëm me ndonjë emër, Jul Variboba, Zef Serembe, dhe sidomos i madhi Jeronim De Rada.

Të gjashtë komunitetet, siç e thashë më parë, kanë pasur të njëjtën përvojë historike.

Vetë themelimi i tyre ose ripopullimi i qendrave paraegzistuese lidhet me të njëjtat ngjarje.

Në fakt ato e kanë origjinën e tyre nga egzodi që filloi me vdekjen e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në Lezhë në vitin 1468, kur populli shqiptar, i dërrmuar nga vuajtjet dhe nga rreziqet e luftës, parapëlqeu mërgimin dhe jo nënshtrimin ndaj "qenit turk" dhe humbjen e traditave të të parëve, duke u drejtuar në gadishullin italian, atje ku lidhjet e përbashkëta të gjakut (le të kujtojmë Virgjinin *Cognatas urbes... populosque propinques*) dhe kontaktet e fundit të pasura me mbretërinë e Napolit linin që të parashikohej një pritje e mirë, që në realitet nuk mungoi.

E dinë të gjithë se disa prej këtyre refugjatëve u drejtuan për në Pulje, të tjerë në Kalabri në brigjet e Koriljano Kalabro-s, ku për arsye të mungesës së banorëve autoritetet vendore nuk e shpërfillnin ardhjen e popujve të huaj: prej këtu, pas një qëndrimi të shkurtër plot aventura, për arsye të malarjes dhe për arsye të pranisë së

ano Calabro, dove per la scarsità della popolazione le autorità locali non disdegnavano l'afflusso di gente straniera: di qui, dopo breve avventurosa dimora, per la malaria e per la presenza del mare che costituiva in quel tempo un costante pericolo, forse anche per motivi sentimentali (la memoria della loro terra), si spinsero verso le colline viciniori. (p. XI)

Sorgevano così le nostre sei comunità. E' chiaro che i profughi, all'inizio, in questa zona risentirono anch'essi le conseguenze della particolare situazione storico-sociale della terra ospitante, inserendosi tra le strutture feudali del tempo, è chiaro che contrasti dovevano ineluttabilmente sorgere per questioni religiose, essendo essi di rito greco-bizantino.

Ma ben presto si crearono sempre più dignitose forme di esistenza, stabilirono i loro obblighi verso i proprietari terrieri sia laici che ecclesiastici con regolari atti giuridici, i Capitoli.

Di poi i casali furono elevati a comuni, scomparendo ogni distinzione, in concordanza con l'evoluzione della società e della vita nazionale italiana: il soffio delle nuove idee, che esaltavano il rispetto e la dignità umana, spazzava via pregiudizi e privilegi feudali.

E allora gli Albanesi d'Italia cominciarono ad avere nell'arte due anime e nella vita politica due patrie, a custodire gelosamente nel cuore la perenne memoria del loro patrimonio spirituale che doveva alimentare l'esplosione rigogliosa dell'apostolato e della poesia di Girolamo De Rada e ad agire, inserendosi con il loro innato amore per la libertà, nel tessuto vivo delle fervide esperienze risorgimentali della patria d'adozione.

Oggi le sei comunità sono dei ridenti paesi che, pur nel clima di progresso

detit që përbënte në atë kohë një rrezik të qëndrueshëm, ndoshta edhe për shkak sentimental (kujtimi i atdheut të tyre), ata u zhvendosën drejt kodrinave pranë. (f. XI)

Lindën kështu gjashtë komunitetet tona. Është e qartë se refugjatët në fillim, në këtë zonë ndjenë pasojat e gjendjes së veçantë historiko-sociale të vendit që po i priste, duke u futur midis strukturave feudale të kohës, është e qartë se duhej të dilnin kontradikta për çështje fetare, duke qenë ata të rritit greko-bizantin.

Por shumë shpejt krijuan forma jetese më dinjitoze, caktuan detyrimet e tyre karshi pronarëve të tokave qoftë laikë qoftë karshi kishës nëpërmjet akteve të rregullta juridike, pakteve të vendosura në marrëveshje.

Më vonë grupet e qendrave të banimit u ngritën në nivelin e komunave, duke u zhdukur çdo dallim, në përputhje me zhvillimin e shoqërisë dhe të jetës kombëtare italiane: fryma e ideve të reja, që ngrinin lart respektin dhe dinjitetin njerëzor, hodhi tutje paragjykimet dhe privilegjet feudale.

Dhe atëherë shqiptarët e Italisë filluan të kenë në art dy shpirtëra dhe në jetën politike dy atdhe, që të ruanin me xhelozë në zemër kujtesën shumëvjeçare të pasurisë së tyre shpirtërore që duhej të ushqente shpërthimin e fuqishëm të veprimtarisë dhe të poezisë së Jeronim De Radës dhe të vepronin, duke u futur me dashurinë e tyre të lindur për lirinë, në kuadrin e gjallë të përvojave të zjarra të rilindjes të atdheut të ri.

Sot gjashtë komunitetet janë fshatra të lumtur që, edhe në frymën e përparimit të jetës qytetare të krahinës, ruajnë të paprekura tiparet e tyre të prejardhjes. (f. XII)

della vita civile della regione, conservano intatte le loro impronte d'origine. (p. XII)

Il rito greco-bizantino nella religione, le originali avite tradizioni in ogni manifestazione della vita privata e pubblica, i fulgidi e policroni costumi, espressione di raffinata civiltà, la lingua che suona sempre viva nella bocca degli abitanti, la letteratura popolare in prosa e in versi sempre di perenne vitalità, sono ancora oggi, nelle sei comunità, prova del loro secolare attaccamento all'origine e un titolo di merito per la nobile e gloriosa nazione che li ha ospitati.

Eliminata la cronaca e le scorie immancabili di assestamento proprie di ogni processo storico vitale, rimane questa luminosa realtà, la loro presenza dopo cinque secoli in queste pittoresche colline calabresi.

Riti fetar greko-bizantin, traditat origjinale të stërgjyshërve në çdo fushë të jetës private dhe publike, kostumet e shndritshme dhe shumëngjyrëshe, shprehje e një qytetërimi të sofistikuar, gjuha që tingëllon gjithmonë e gjallë në gojën e banorëve, letërsia popullore në prozë dhe në vargje gjithmonë me një gjallëri të përjetshme, janë ende sot, në gjashtë komunitetet, një provë e lidhjes së tyre shekullore me origjinën dhe një meritë për kombin fisnik dhe të lavdishëm që i ka pritur.

Po të lëmë mënjane kronikën dhe mbeturinat tipike të sistemimit që nuk mund të mungojnë në çdo proces historik plot jetë, mbetet ky realitet i shkëlqyer, prania e tyre pas pesë shekujsh në këto kodrina piktoreske kalabreze.

IV. Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia. Vol. III: Novellistica italo-albanese. Racconti popolari di Greci (Katundi) in provincia di Avellino e di Barile (Barili) in provincia di Potenza, a cura di Martin Camaj.

Në parathënien e vëllimit (Premessa) Camaj jep menjëherë përmbajtjen e vëllimit:

Questo volume comprende testi orali delle comunità albanesi che si trovano alla periferia dei due grossi nuclei di oasi linguistiche albanesi, situate nelle province di Campobasso e Cosenza. Esso come mole di ricchezza di motivi – non però per quanto riguarda l'invenzione stilistica e particolarità dialettali – non tiene il passo con i due primi volumi della stessa collana. Alla mancanza di testi nelle altre due località albanesi, Maschito e Ginestra, che con Barile compongono anche linguisticamente il gruppo dei cosiddetti paesi albanesi del Vulture, si deve attribuire l'esigua mole di questo volume¹⁰.

Ky botim lidhet me dy vëllimet e tjera të botuara para tij:

I testi sono stati classificati ed ordinati per la stampa avendo per modelli i due primi volumi, sotto la cura del professor Ernesto Koliqi: gliene siamo grati¹¹.

¹⁰ CAMAJ, 1972, f. V.

¹¹ CAMAJ, 1972, f. VI.

Pjesën e parë të hyrjes (Introduzione) “Cenni storici sui racconti popolari albanesi” mund ta ndajmë në dy pjesë. Në fillim Camaj kujton edhe një herë lidhjen e vëllimit me dy librat e tjerë:

La collana già nota sotto la denominazione Novellistica italo-albanese continua una lunga tradizione di raccolta di prosa popolare albanese. I primi due volumi, come abbiamo notato in altra sede, furono predisposti adeguandosi ai metodi della moderna ricerca della favola e del racconto popolare. Essi furono segnalati e giudicati come accurate edizioni anche dalla critica specializzata...

Furono tra i primi i linguisti quelli che “scoprirono” questo genere di creazione popolare, attraverso cui si poteva penetrare a fondo nei problemi specifici della lingua albanese. Come i due precedenti, il presente volume segue questa tradizione, in quanto si propone di contribuire alla conoscenza dell’arbëresh di Greci e di Barile, paesi periferici ai principali stanziamenti italo-albanesi nell’Italia meridionale¹².

Në vijim bën një historik të shkurtër por të plotë të botimeve të krijmtarisë popullore në prozë:

La narrativa popolare albanese è stata da parecchio tempo trascurata anche dagli stessi folcloristi albanesi, così che la predetta tradizione fu interrotta diverse volte forse anche a causa dell’interesse maggiore o, piuttosto, della preferenza accordata dagli studiosi all’indagine e alla raccolta della poesia popolare, di contenuto “più eletto e nobile”¹³.

Këto tri vëllime janë botime me rëndësi: aty është transkriptuar, përmbledhur dhe përkthyer në italishte pjesa në prozë e pasurisë së krijmtarisë popullore të arbëreshëve të Italisë. Shkrimet në hyrje të vëllimeve kanë një rëndësi të

¹² CAMAJ, 1972, f. VII.

¹³ CAMAJ, 1972, f. VII. Na kujton se “La prosa popolare albanese cominciò ad essere registrata per la prima volta verso la metà dello scorso secolo, quando Georg von Hahn pubblicò cinque racconti, raccolti a Labova dall’insegnante Apostolis G. Panajotidis”; CAMAJ 1972, ff. VII-VIII. E gjithë faqja VIII ka rëndësi për bibliografinë e cituar dhe për referimet e sakta për të në shënimet në fund të faqes. Shiko edhe shënimet 11-24 në ff. IX-X. Camaj thekson rëndësinë e studimit të strukturës të përrallave shqiptare: “Una rilevante quantità di favole e racconti, specie dall’inizio di questo secolo in poi, furono pubblicati in giornali, oggi non facilmente reperibili, in riviste e calendari, come p. es. in *Albania* di Konica e in *Kalendari* della società studentesca di Vienna, chiamata *Dija*. Si tratta spesso di varianti, importantissime per lo studio strutturale della favola albanese in sé e nei suoi rapporti comparativi, soprattutto nell’area balcanica. Gli editori di favole e racconti burleschi popolari partivano dal principio di non pubblicare narrazioni che avessero lo stesso motivo; ma siccome essi non avevano una visione esatta di quello che era stato pubblicato prima, per fortuna non possiamo oggi disporre di un repertorio abbastanza ricco di varianti e di motivi analoghi. Oggi prevalgono altri criteri, per cui le varianti, anche se non si danno alla luce, vengono conservate negli archivi degli istituti, come si suole fare del resto anche all’istituto di Studi Albanesi di Roma”, CAMAJ 1972, f. IX.

madhe jo vetëm për paraqitjen e materialit të botuar aty, por edhe si studime me vlerë në sistemin e përgjithshëm të letrave shqipe.

Bibliografia

1. CAMAJ, Martin (1972), *Premessa – Introduzione*, nw RACCONTI POPOLARI DI GRECI (KATUNDI) IN PROVINCIA DI AVELLINO E DI BARILE (BARILI) IN PROVINCIA DI POTENZA, “STUDI ALBANESI” PUBBLICATI DALL’ISTITUTO DI STUDI ALBANESI DELL’UNIVERSITA’ DI ROMA SOTTO LA DIREZIONE DEL PROF. ERNESTO KOLIQI, Tradizioni popolari degli Albanesi d’Italia Vol. III, NOVELLISTICA ITALO-ALBANESE, Roma, f. 190, f. V-XXX.
2. GRADILONE, Giuseppe (1970), *Premessa-Introduzione*, në RACCONTI POPOLARI DI S. SOFIA D’EPIRO - S. DEMETRIO CORONE - MACCHIA ALBANESE - S. COSMO ALB. – VACARIZZO ALB. – S. GIORGIO ALB., “STUDI ALBANESI” PUBBLICATI DALL’ISTITUTO DI STUDI ALBANESI DELL’UNIVERSITA’ DI ROMA SOTTO LA DIREZIONE DEL PROF. ERNESTO KOLIQI, Tradizioni popolari degli Albanesi d’Italia Vol. II, NOVELLISTICA ITALO-ALBANESE, Roma, f. 446, f. XXX, f. V-XXIX.
3. KOLIQI, Ernesto (1966), *Introduzione*, në NOVELLISTICA ITALO-ALBANESE, Testi orali raccolti dal prof. Luca Perrone ordinati e tradotti in italiano a cura dell’Istituto di Studi Albanesi della Università di Roma; “STUDI ALBANESI”, PUBBLICATI DALL’ISTITUTO DI STUDI ALBANESI DELL’UNIVERSITÀ DI ROMA SOTTO LA DIREZIONE DEL PROF. ERNESTO KOLIQI, Tradizioni popolari degli Albanesi d’Italia, Vol. I; Firenze, Leo S. Olschki Editore, 1966, f. XXV, 601, f. IX-XXIV.
4. KOLIQI, Ernesto (1999), *Kritikë dhe estetikë*, Tiranë, f. 316.
5. KOLIQI, Ernesto (2003a), *E para bijë e letërsisë gojore është poezija popullore*, në *Vepra 5, Syzime letrare. Shkrime kritike*, Prishtinë, f. 134-142, [parathënia e librit *Poesia popolare albanese*].
6. KOLIQI, Ernesto (2003b), *Zanafilla e një fjalë historike, Zgjimi i zânave arbreshe, Doke e zakone, gojdhana e kangë popullore t’italo-shqiptarëvet*, në *Vepra 6, Palci etnik arbnuer*, Publicistikë, Prishtinë, f. 287-307.
7. MIRACCO, Elio (1985), *Premessa-Avvertenza ortografica-Introduzione*, në FAVOLE FIABE RACCONTI DI S. NICOLA DELL’ALTO-CARFIZI-PALLAGORIO-MARCEDUSA-ANDALI-CARAFFA-VENA DI MAIDA-ZANGARONA raccolti, trascritti e tradotti da ELIO MIRACCO, ISTITUTO DI STUDI ALBANESI DELL’UNIVERSITA’ DEGLI STUDI DI ROMA “LA SAPIENZA”, LETTERATURA ORALE DEGLI ALBANESI D’ITALIA NOVELLISTICA, BULZONI EDITORE, Roma, f. 368, f. V-XV.

8. RUGOVA, Ibrahim (2005), *Kritika e arbëreshëve të Italisë*, në *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, f. 527, f. 301-303.
9. RUGOVA, Ibrahim (2007), *Kritika*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, f. 596.
10. TODOROV, Tzvetan (1986), *Critica della critica Un romanzo di apprendistato*, Einaudi, Torino, 1986, f. 198.

Zamira SHKRELI

ANALIZË PSIKOLINGUISTIKE MBI ZHVILLIMIN GJUHËSOR TË FËMIJËVE PARASHKOLLORË NËN NDIKIMIN E LETËRSISË PËR FËMIJË

Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve nga moshë 2-5 vjeç, vështruar nga teoritë e reja gjuhësore të shek. XX.

Fjalët kyçe: përvetësim gjuhësor, leksik mendor, input, output.

Argumenti:

- Gjuha fëminore,
- Pasurimi i fjalorit nga një fazë në tjetrën

Abstrakt

Temë që do të trajtohet është mjaft e gjerë dhe ka vend për shumë hulumtime, por ne jemi ndalur vetëm në një aspekt dhe në një moshë mjaft të kufizuar, moshë 2 – 5 vjeç.

Trajtesa do të përmbajë një përmbledhje të shkurtër teorike në të cilën jemi mbështetur:

- Përvetësimi gjuhësor të të vegjlit bazuar në pikëpamjet teorike të Çomskit, Skinnerit dhe Piaget.

- Leksiku mendor dhe dy procese input- output.

Dhe më pas kjo temë synon që të nxjerrë në pah efektet që jep fabula për pasurimin e leksikut tek fëmijët e kësaj moshe.

Trajtesa është bërë duke marrë për bazë materialin e vjelë nga subjekte të caktuara: fëmijë të moshave 2 – 3 dhe 4 – 5 vjeç.

Përvetësimi gjuhësor (Acquisizione linguistica)

Përvetësimi gjuhësor është term që tregon procesin përmes të cilit mësohet një gjuhë natyrore, si një gjuhë amtare apo si një gjuhë e dytë (respektivisht, L1 dhe

L2), për të shmangur dykuptimësi në terminologjinë në vitet e fundit, parapëlqehet të përdoret në lidhje me përfitimin gjuhësor L1 dhe L2.

Në kuptimin e parë, procesi i përvetësimit gjuhësor është thjesht spontan dhe pa dyshim i përket mënyrës në të cilën fëmija mëson të flasë, pra për të zhvilluar aftësitë, si ato pasive dhe aktive në gjuhën amtare. Nga pikëpamja teorike, tri janë në thelb udhëzimet mbizotëruese mbi përvetësimin gjuhësor:

a) bihejviorizmi (Skinner 1957) paraqet modelin e komunikimit gjuhësor, i cili quhet *modeli i sjelljes*, kontekstin dhe të shkaktojë imitim të mësuarit, si të përshkruara nga stimul/ përgjigja (reaksioni);

b) maturacional ose universale (Chomsky 1965 dhe 1975) qeniet njerëzore trashëgojnë gjenetiksht një aftësi gjuhësore, e cila i ndihmon ata të mësojnë gjuhën. Ky mekanizëm i lindur, të cilin Çomski e quan LAD (Language acquisition device), mendohet prej tij si një gramatikë e brendshme. Pikërisht, kjo aftësi e lindur të trurit të njeriut apo kjo *gramatikë e brendshme*, e cila gjendet në trurin e fëmijës së porsalindur, quhet *gramatikë universale*;

c) konstruktivizëm ose teori e evolucionit [Piaget 1926]: Procesi i përvetësimit gjuhësor është dinamik dhe është hap pas hapi në një bashkëveprim të vazhdueshëm mes zhvillimit fizik dhe zhvillimit njohës të fëmijëve.

Paraqitja e konceptit *përftim gjuhësor* (marrje gjuhësore), nëpër fjalorë e studime të kësaj natyre, përcaktohet si procesi me anën e të cilit mësohet një gjuhë e, sidomos, gjuha e parë (për të tjerat flitet më tepër për *mësim*). Një palë psikolinguistësh, gjatë përftimit (marrjes) si të një gjuhe dallojnë disa faza të ndryshme, si:

Faza paragjuhësore, ose lalaizmi (deri në 12 muaj), është periudha e prodhimit (artikulimit), kur fëmija arrin të nxjerrë rrokje të përsëritura, si: *ma-ma-ma; ta-ta-ta, la-la-la* etj..

Faza holofrastike – term që lidhet me rastet kur fjala qëndron në vend të një fjalie të tërë;¹ *phrazein* do të thotë *me thënë, me shprehë*. Kjo periudhë përfshin kohën 16 – 18 muajshe, e cila karakterizohet nga prodhimi i fjalive njëfjalëshe.

Faza e kombinuar (deri në 3 vjeç), kur fëmija arrin të përdorë fjali dyfjalëshe.

Faza e shpërthimit leksikor, kur njihet një rritje e madhe sasiore e prodhimit të fjalëve. Nga mosha 3-vjeçare artikulimi përmirësohet shkallë-shkallë deri në 6 vjeç, kur fëmija zotëron gjuhën në çdo nivel.

Interesi për përftimin (marrjen) gjuhësor është i ndezur, sidomos me debatin e gramatikanëve gjenerativistë mbi peshën që kanë në zhvillimin e gjuhës, nga njëra anë, ambienti dhe eksperiencia; nga ana tjetër, trashëgimia gjenetike. Në fakt, sipas Çomskit, shpejtësia dhe mënyra me të cilën ndodh përftimi gjuhësor tek të vegjlit, të bëjnë të mendosh që aftësia për të folur nuk është e lindur.

¹ Vjen nga greq. *olo + phrastikos*, me kuptimin “që shërben për të shpjeguar”.

Më së shumti, në rrafshin gjuhësor, nga studiuesit përdoret termi *leksik mendor*, duke u nisur nga presupozimi i ekzistencës së një leksiku mendor unik për perceptimin dhe prodhimin e të folurit, *qoftë* të shkruar, *ashtu* edhe të folur.²

Kjo premisë, në vetvete thjeshtëzuese, mund të rezultojë jo e drejtë – kërkimi psikolinguistik do të mund të demonstrojë ekzistencën e leksikëve për perceptimin dhe prodhimin e të folurit o ende më shumë, për përpunimin e fjalës së shkruar dhe për atë të folur, – por tani për tani, nuk ka arsye të mjaftueshme për ta kundërshtuar.

Duket se është e nevojshme të bëhet një dallim tjetër brenda leksikut mendor duke marrë në konsideratë nënsisteme të ndara në *input*³ dhe në *output*.⁴ Me këto terma formulohet qëllimi, synimi për të vënë në dukje se nënsistemi leksikor për njohjen e fjalëve të shkruara mund të jenë dy sisteme drejtshkrimore të ndara (një leksik inputi i përdorur në të lexuar dhe një leksik outputi i përdorur në të shkruar dhe në zberthimin në shkronja).

Studimet në lidhje me zhvillimin gjuhësor të fëmijëve në Shqipëri janë kryer nga disa studiues të njohur, ku mund të përmend këtu studiuesin A. Shashai i cili ka hulumtuar mbi të folurit e fëmijëve duke na dhuruar një libër te vyer me titull "*Të folurit e fëmijëve të moshës parashkollore*"⁵, po ashtu edhe studiuesja Rr. Draçini e cila përmes artikujve të botuar në revista shkencore shpalos arritjet e saj në lëmin e gjuhësisë, si: "*Fëmija në hapat e parë të përfutimit gjuhësor*",⁶ "*Fëmija përballë gjuhës*".⁷ Edhe studiues të tjerë janë angazhuar me fëmijët në fusha të ndryshme studimi si psikologji, pedagogji, sociologji etj.

Marrjen gjuhësore tek të vegjlit, që në hapat e parë të jetës, gjuhëtarët psikolinguistikë e kanë lidhur kurdoherë me fjalën, fjalët e para dhe pasurimin e leksikut në përgjithësi; përndryshe, dukuria që ndodh, është quajtur *inputi gjuhësor*.

Në lidhje me këtë akt të të folurit, apo ngjarje gjuhësore, siç quhet rëndomtë, psikologët e gjuhëtarët i vënë rëndësi të dorës së pare pasurimit të fjalorit tek 3 vjeçarët. Kjo fazë përkon me atë që në shkencën e përvetësimin linguistik është quajtur prej kohësh *shpërthimi gjuhësor i fëmijës*. Spiro Saqellari, një ndër eksploruesit më të rinjë të kësaj fushe në shkencën tonë gjuhësore, thekson se "*Fjalori pasurohet edhe me fjalë abstrakte, ai tani fillon e kupton foljet, mbiemrat, përemrat ndajfoljet etj. Megjithëse ai bën gjithë këto përparime në gjuhë, përsëri te shumica e fëmijëve vazhdon e "folura bebe", e cila karakterizohet nga mosshqiptimi i disa*

² M. Harris & M. Coltheart, *L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti*, il Mulino, 1991, f. 141.

³ Input – Sasi informacioni (in = në + put = vë, vendos, vë brenda), angl.

⁴ Output- prodhim (out=jashtë, put=vë), angl.

⁵ Ali Shashai, "Të folurit e fëmijëve të moshës parashkollore", Elbasan, 1996.

⁶ Rr. Draçini "Fëmija në hapat e parë të përfutimit gjuhësor", Buletin shkencor, nr. 61, Shkodër, 2011, f. 193.

⁷ Rr. Draçini, "Fëmija përballë gjuhës", Buletin shkencor, nr. 62, Shkodër, 2012, f. 153.

tingujve dhe thjeshtësimit i fjalëve me mbi dy rrokje. Kjo lloj e folure është normale deri në kufi të moshës tre vjeçare”⁸

Gjatë kësaj moshe vërehet se fëmija ligjëron me fjali të shkurtra dhe të paplotësuara (periudha holofrastike).


Në bazë të këtij shkrimi jemi mbështetur tek ushtrime dhe “provat” gjuhësore që kemi mundur të bëjmë me pak subjekte (3 të tillë), nga mosha 3 – 5 vjeç, duke i njohur me përmbajtjen e 3 fabulave (titujt e të cilave gjenden më poshtë), nëpërmjet rrëfimit (tregimit) dhe leximit të tyre 1 herë, 2 herë dhe 3 herë. Gjithashtu kemi përshkruar saktësisht lëndën gjuhësore që këta të vegjël arrijnë të riprodhojnë për çdo rast. Natyrshëm që gjatë procedimit në rrëfim e lexim, kemi shoqëruar njëkohësisht edhe me mjete jashtëgjuhësore, si: shikime, gjeste të duarve, të fytyrës etj., që bëjnë pjesë në mjetet kinetike të komunikimit.

Fabula “Dy miqtë dhe ariu”

Fjalët kyçe: dy miq, ariu, lëndinë, frikë.

Mosha 3 vjeç

Figurat e ndihmojnë fëmijën në zhvillimin gjuhësor. Përballja me to rrit fantazinë dhe i jep hov të folurit tek të vegjlit. Duke pasur parasysh se fëmija në këtë moshë përdor fjalë të veçuara, e fjali të shkurtra, kuptimi i këtyre fjalëve lidhet ngushtë edhe me figurën dhe elementet që paraqet kjo figure.



Subjekti (K.M)

Dy miq eci adina.

(Dy miq ecin në lëndinë)

Ata pa ajiun.

(Ata panë ariun)

Iken vap.

(Ikën me vrap)

Mosha 4-5 vjeç

Leksiku arrin të zgjerohet gjithnjë e më tepër, me fjalë të parme, fjalë të prejardhura duke mbërritur deri tek fraza të cilën studiuesi R. Memushaj e përkufizon “*Fraza është njësia më e madhe fonetike ,që paraqitet si një unitet intonacionor dhe*

⁸ Saqellari, Spiro, “Përballë fëmijës me probleme të foluri”, Onufri, Tranë, 2009, f. 37-38.

kumtues. Ajo është njësia e ligjërimit në gjithë së cilës realizojnë funksionet e veta gjithë mjetet prozodike të gjuhës.”⁹

Nëpërmjet këtyre fabulave i vogli arrin të përvetësojë të shprehurit me shqiptim logjik e të saktë të fjalës e dalëngadalë edhe të fjalisë.

Fëmija është përballur me fabulën më shumë se një herë, por edhe mosha dhe aftësitë riprodhuese në këtë rast janë më të mëdha, pra vogëlushi është në gjendje ta ritregojë atë në këtë mënyrë:

Subjekti (I.U)

Dy miqtë kalonin në lëndinë.

Para doli ajushi i mal.

(Para i doli një ari i madh)

Të dy shokat vapuan të tremun.

(Të dy shokët vrapuan të trembur)

Njëri hipi në pemë, tjetri u shtrinë toke si i vdekuj. (Njëri hipi në pemë, tjetri u shtri përtokë si i vdekur)

Mesazhi

Ata nuk e ndihmuan shoku shokun.

1. Dy miqtë dhe ariu

Paraqitja e mëposhtme është bërë mbi bazën metodike, duke pasur përballë subjektin dëgjues (marrës –destinator) dhe duke ia rrëfyer fabulën 1 herë, 2 herë dhe 3 herë, sipas rregullave të tregimit me gojë: me pauza të llojeve të ndryshme, me ritëm të ngadaltë dhe me ton sipas roleve të personazheve (kafshë) pjesëmarrës. Kafshët janë personazhet më të dashura për fëmijët e kësaj moshe. Në lidhje me këtë fakt shprehet kështu studiuesi Remo H. Largo: “Zërat e kafshëve gëzojnë veçanërisht interesin e fëmijëve i emërtojnë kafshët me zërat që janë karakteristike për to. Zërat e tyre janë më pranë mundësive shprehëse të fëmijëve sesa emrat e kafshëve, që përdorin të rriturit.”¹⁰

A. Me një herë të treguar

Subjekti: (M.K)

Dy mika (po kalonin)inë. (Ndërhyhet me folje)

(Dy miqtë po kalonin në lëndinë)

Eli aiu.

(Erdhi ariu)

Ata(kishin) fikë.

(Ndërhyhet me folje). (Ata kishin frikë)

B. Me dy herë të treguar.

⁹ Memushaj, Rami, “Fonetika e shqipes standarde”, Toena, Tiranë, 2010, f. 167.

¹⁰ Largo H. Remo, “Vitet e foshnjërisë”, Uegen, Tiranë, 2000, f. 134.

Subjekti (K.M)

<i>Dy mika po talonin</i> (në lëndinë). (Ndërhyhet me emër)	Dy miqtë po kalonin në lëndinë
(U shfaq)një aji.	(Ndërhyhet me folje). U shfaq një ari
<i>Mikat u temën.</i>	Miqtë u trembën
<i>Ajiu itu.</i>	Ariu iku

Ndërhyrja me folje dhe me emër mund të shoqërohet edhe me mjete jashtëgjuhësorë.

Në variantet që japim vërehet se fëmija ka nevojë të ndihmohet në fillimin e fabulës duke dhënë elementet e para gjuhësore p.sh. *Dy mika po talonin (në lëndinë)* pra kemi të bëjmë me ndërhyrje me emër, që ndihmon në përcaktimin e vendndodhjes së personazheve të fabulës. Ndërsa në fjalinë e mëposhtme ndeshemi me foljen (*U shfaq*) një aji, ndërhyrja me folje nga i rrituri ndihmon në përshkrimin e veprimeve të kafshëve (personazheve) të pyllit. Nëpërmjet varianteve të dhëna arrijmë të kuptojmë sesi merret e riprodhohet një fabul nga i vogli, si realizohet ndërhyrja me 2 fjalë, me një fjalë dhe në fund me ndërhyrjen e procesit të moralit të fabulës.

C. Me tri herë të treguar.

Subjekti : (K.M)

<i>Dy mikat po talonin në lëdinë.</i>	(Dy miqtë po kalonin në lëndinë)
<i>U duk papitur një aji.</i>	(U shfaq papitur një ari)
<i>Njëri ipi në pemë.</i>	(Njëri hipi në pemë)
<i>Tetri u shtri përtokë.</i>	(Tjetri u shtri përtokë)
<i>Ajiu iku.</i>	(Ariu iku)
<i>Shoku pyti se çfarë fa ariu</i>	(Shoku pyeti se çfarë tha ariu)
(Ndërhyhet duke ndihmuar në përfundimin e përrallës.)	
<i>Mos besoni kurrë atë që të braktis.</i>	

Tani kalojmë në një variant tjetër. Kemi të bëjmë me përballjen e fëmijës me librin dhe me leximin e fabulës nga të rriturit, sipas të gjitha rregullave të leximit me të vegjël, duke pasur parasysh ruajtjen e vëmendjes, me anë të mjeteve ekstralinguistike nëpërmjet gjesteve dhe lëvizjeve kinetike të fytyrës e trupit. Përsa i përket përballjes me librin dhe rolin që luajnë prindërit në këtë veprimtari studiuesi Remo H. Largo thekson se: “Prindërit ia përshtatin gjuhën situatës aktuale. Në situatën e jetës së përditshme, gjuha e tyre është e thjeshtë, për shembull gjatë të ngrënies ose kur e vënë fëmijën për të fjetur. Kur ata sodisin me fëmijën një libër me figura, gjuha e tyre është më e diferencuar. Kur prindërit e lidhin fjalën me veprimtari ata ia lehtësojnë fëmijës të kuptuarit. Shpesh fëmija merr përsipër

mënyrën e të shprehurit të tyre, për shembull kur sodit librat me figura: ai futet në rolin e nënës dhe komenton figurat dhe tekstin.”¹¹

A. Me një herë të lexuar.

Subjekti: (I.U)

Dy mika tatisin në jadinë. (Dy miq shëtisin në lëndinë)
Eli ajiu imal . (Erdhi një ari I madh)
Mikat vap. (Miqtë ikën me vrap)

B. Me dy herë të lexuar

Subjekti : (M.K)


Dy mika tatisin në lëdinë. (Dy miqtë shëtisin në lëndinë)
Aty eli ajiu. (Aty erdhi ariu)
Mikat (kishin) fikë. (Miqtë kishin frikë) (Ndërhyhet me folje)
Ata ikën vap. (Ata ikën me vrap)

C. Pas tri herëve lexim.

Subjekti : (K.M)

Në lëndinë shëtisin dy miq. (Aty erdhi një ari)
Njëri ipi në pemë . (Njëri nga shokët hipi në pemë)
Tjetri u shti (në tokë) (Tjetri u shtri përtokë) (Ndërhyhet me emër)
Ariu iku. (Ariu u largua)

Fabula “Fshatari dhe gjarpri”¹²



Mosha 3 vjeç

Subjekti: (K.M)

Një ditë taji eti apin. (Një ditë një fshatar gjeti një gjarpër)

¹¹ Largo H. Remo, “Vitet e foshnjërisë”, Uegen, Tiranë, 2000, f. 321.

¹² Vëllezërit Tafa, “Fabulat më të bukura të botës”, Tiranë, 2004, f. 11.

Taji moji apin. (Fshatari e mori gjarprin)
Api xoji amin me picu tajan. (Gjarpri nxori dhëmbin për të pickuar fshatarin)
Ataji e teti japin. (Fshatari e hodhi tej gjarprin)

Mosha 4-5vjeç

Subjekti: (I.U)

Një ditë dimri , fshatari gjeti gjapin akull. (Një ditë dimri, fshatari gjeti një gjarpër të ngrirë)

Ai e mori me vete për ta ngour. (Ai e mori me vete për ta ngrohur)
Gjapi nxoji dhëmbin për të pickuar fshatarin. (Gjarpri nxori dhëmbin për të pickuar fshatarin)

Fshatari e hodhi tutje gjarprin.

Fshatari dhe gjarpri

Fjalët kyçe: *fshatari, akull, gjarpër, futi.*

A. Me një herë të treguar.

Subjekti: (K.M)

Atari api akull. (Fshatari gjeti një gjarpër të ngrirë)
(E mori) *apin.* (Ndërhyhet me folje) (E mori me vete gjarprin)
Api (nxori) amin. (Ndërhyhet me folje) (Gjarpri nxori dhëmbin helmues)

Në komunikimin dhe zhvillimin e fëmijës rol të rëndësishëm luajnë prindërit dhe edukatorët, të cilët arrijnë të dialogojnë me qetësi duke e vlerësuar dhe dëgjuar pa u lodhur atë. Për sa i përket marrëdhënien fëmijë –prind S. Saqellari e përmbledh me këto rreshta “*Nxitja për të folur , përsëritja e asaj që ai mezi e tha, jo duke i dhënë të kuptojë se po e korrigjoni por ta ndiejë se po e ndihmoni , të folurit e ngadalshëm dhe plot melodi , duke e parë në sy njëri-tjetrin, janë parakushtet e një zhvillimi të mire gjuhësor*”¹³

B. Me dy herë të treguar

Subjekti: (I.U)

Fatari (gjeti)apin. (Ndërhyhet me folje)
Api (ishte) (ingrirë) (Ndërhyhet me folje dhe mbiemër)
Jatari ohu (ngrohu) apin.

¹³ Saqellari, Spiro, “Fjalët e para si hapat e pare”, Tiranë, 2006, f. 92.

Api(nxori) *amin* (helmues) (Ndërhyhet me folje dhe mbiemër).

Pra nëpërmjet këtyre fjalëve të shkëputura fëmija bën lidhjen e veprimeve me personazhet (kafshë)të fabulës. Fjalët dhe fjalitë janë të paplota , megjithatë mesazhin ato e japin. Shqiptimi dhe përdorimi i fjalëve realizohet sipas mundësive gjuhësore të fëmijës së kësaj moshe .

Prof. Gj. Shkurtaç shprehet në lidhje me të folurit e fëmijëve “*Fëmija mëson duke imituar të folurit e mjedisit rrethues ku ai lind dhe rritet , porse ai nuk bën imitime mekanike dhe pasive. Fëmija krijon duke marrë hua. Fjalori sa vjen e pasurohet gjatë moshës 2-5 me fjalë abstrakte pastaj me folje të cilat përdoren nga fëmijët në format e tyre të çrregullta*”¹⁴

C. *Me tri here të treguar.*

Subjekti : (M.K)

Një fshatar eti japin në akul.

Ai e moji në tup. (trup)

Japi (nxori) *jamin.* (Ndërhyhet me folje)

Fshatari e hoji japin.

A. *Me një here të lexuar .*

Subjekti : (K.M)

Atari (gjeti) *apin .* (Ndërhyhet me folje) (Fshatari gjeti një gjarpër)

Api (nxori) *amin.* (Ndërhyhet me folje) (Gjarpri nxori dhëmbin)

Atari hoji *apin.* (Fshatari e hodhi gjarprin)

B. *Me dy here të lexuar*

Subjekti: (L.U)

Fatari eti një apër. (Fshatari gjeti një gjarpër)

Ai e ngohu në tup. (Ai e ngrohu në trup)

Api xori amin. (Gjarpri nxori dhëmbin)

Fatari e oli apin. (Fshatari e hodhi gjarprin)

C. *Me tri here të lexuar*

Subjekti: (M.K)

Një fshatar gjeti gjapin. (Një fshatar gjeti një gjarpër)

Ai e ngohu gjapin në trup. (Ai e ngrohu gjarprin në trup)

Gjapi nxori jamin elmues (Gjarprin nxori dhëmbin helmues)

Fshatari e hodhi tej. (Fshatari e hodhi tej)

¹⁴ Shkurtaç, Gjovalin, “Sociolinguistika”, Tiranë , 2003, f. 85.

Në variantin e fundit vërejmë se i vogli ka arritur ta pasurojë gjithnjë e më tepër fabulën e në ndihmë të tij vjen gjithmonë një person i dytë, i cili vihet në dispozicion të të voglit për rritjen e këtij qëllimi. Në mbështetje të këtyre varianteve vijmë dhe fjalët e prof. Gj. Shkurtaj *Mund të thuhet se në mënyre tipike, situata e të folurit fëmëinor përcaktohen nga veprimi folës dëgjues në format e mëposhtme një i rritur flet me një fëmijë të vogël (poshtë 3-4 vjeç) ose të sapolindur.*¹⁴

Shpresoj që me këtë temë të kem ngjallur sado pak interes tek audiencia, duke pasur parasysh që kontributi im në këtë fushë është në fazat fillestare.

Si përfundim, mund të themi se gjatë realizimit të këtij materiali vëzhguam disa nga elementet që ndikojnë në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve, duke u ndalur kryesisht te fabulat dhe roli i tyre. Natyrisht në këtë zhvillim kontribuojnë mjaft prindërit dhe edukatorët, sidomos në përballjen e fëmijës me gjuhën dhe librin, si elemente të domosdoshme për zhvillimin gjuhësor të tij.

Të rriturit i përshtaten fëmijës me gjuhë, ata i thjeshtëzojnë fjalitë në mënyrë që të jenë sa më të kuptueshme për të vegjlit. Përballja me librin e bën të voglin të ligjërojë më lirshëm, të fitojë shprehi, gjithashtu të zhvillojë imagjinatën dhe të përdorë njëkohësisht gjatë të folurit gjestet e mimikën.

Bibliografia

1. Draçini, Rrezarta (2011), *Fëmija në hapat e parë të përfitimit gjuhësor*, *Buletini shkencor*, nr. 61, Shkodër, f. 193.
2. Harris, M. & Coltheart, M. (1991), *L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti*, il Mulino, f. 141.
3. Largo H. Remo (2000a), *Vitet e foshnjërisë*, Uegen, Tiranë, f. 134.
4. Largo H. Remo (2000b), *Vitet e foshnjërisë*, Uegen, Tiranë, f. 321.
5. Memushaj, Rami (2010), *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, f. 167.
6. Saqellari, Spiro (2006), *Fjalët e para si hapat e parë*, Tiranë, f. 92.
7. Saqellari, Spiro (2009), *Përballë fëmijës me probleme të foluri*, Onufri, Tiranë, f. 38.
8. Shashai, Ali (1996), *Të folurit e fëmijëve parashkollorë*, Elbasan.
9. Shkurtaj, Gjovalin (2003), *Sociolinguistika*, Tiranë, f. 85.
10. Vëllezërit Tafa (2004), *Fabulat më të bukura të botës*, Tiranë.

Edlira MANTHO

RETORIKA MODERNE NË KUADRIN E GJUHËSISË SË TEKSTIT. LIGJËRIMI ARGUMENTUES NË GJUHËN SHQIPE

1. Hyrje në Retorikën moderne. Arti i ri i bindjes.

Argumentimi është dukuri me të cilën ne përballemi përditë. Si koncept i ka rrënjët e veta shumë shekuj më parë, pikërisht në retorikën antike. Fillimisht, retorika e folur, e njohur ndryshe oratori ose e thënë shqip, gojëtarë, – arti i të folurit bukur e në mënyrë bindëse, shihej si mënyrë bindjeje në vendet publike dhe politike si: asamble apo salla gjyqi. Populli nxitej të dëgjonte fjalën e oratorit, fjala e të cilit kishte bazë forcën argumentuese të ngarkuar me emocionalitet dhe patos.

Edhe pse shumica e gojëtarëve i referohen retorikës *si një art*, kjo shihej nga shumica si një masë rregullash apo ligjesh për t'u nxënë nga përdoruesit. Aristoteli qartësoi dhe shtjelloi gjithçka lidhur me rregullat që duhet të ketë një ligjërim oratorik.¹ Sipas praktikës klasike, formimi retorik u kategorizua në *pesë rregulla* (secili i një rëndësie të barabartë), që do të bëheshin pika referimi për shekuj të tërë nga vetë qarqet akademike. Sipas kësaj formule, oratori, i cili trajton logjikën e një argumenti ose zhvillimin e një ideje, duhet të grumbullojë të gjitha këto “pjesë”, që të bindë dhe ta bëjë për vete plotësisht një audiencë. Këto rregulla qenë:

1. *Inventio (invention) – sajese, trillim, shpikje*²

2. *Dispositio (arrangement) – sistemim, rregullim, përndarje*³ – [zakonisht shoqërohet me *exordium* (parathënie)].

3. *Elocutio (style) – stil, apo pronuntiatio – prezantim*⁴

4. *Memoria (memory) – kujtesa*⁵

5. *Actio (delivery) – mbajtja e fjalimit, ligjërimi*⁶

¹ Aristoteli: “*Retorika*”, botim i eBooks@Adelaide, 2007, Libri I, parag. a 1.1.1--1354:1. Varianti origjinal në anglisht gjendet në linkun:

<http://ebooks.adelaide.edu.au/a/aristotle/a8rh/index.html>

² Është procesi që çon në gjetjen, zhvillimin dhe përpunimin e një argumenti.

³ Është procesi që vë në dispozicion argumentet, duke i renditur dhe organizuar në mënyrë të tillë që fjalimi të arrijë efektin maksimal ndikues.

⁴ Është procesi që ka të bëjë me mënyrën se si thuhet diçka, duke zgjedhur fjalët e duhura dhe artificet retorike.

⁵ Është procesi që ka të bëjë me memorizimin që folësi duhet t'i bëjë gjithë fjalimit të tij të shkruar.

Shekujt në vijim (shek. XIX) sollën një lloj zgjerimi kuptimor të vetë retorikës. Nëse në letërsi retorika u përcaktua nga retoricienët si fusha që merrej me studimin e figurave letrare (tropet), në gjuhësi filluan të shfaqeshin idetë se retorika përbënte një fushë të veçantë studimore. Kështu, tanimë retoricienët nuk e shohin më retorikën si thjesht të folurit bukur e në mënyrë bindëse e kundrejt një tërësie rregullash e normash që duhet të ndiqeshin, por më tepër se kaq. Ajo tanimë shihet si një teori e tërë argumentimi që merr vlera pragmatike, pasi ligjërimi ynë nuk është një ligjërim i shkëputur nga situata apo konteksti ku ky zhvillohet.

Vetë argumentimi, përveçse të qenët një aktivitet i folur (i shkruar) i bazuar në arsyetime të destinuara të vërtetojnë apo të kundërshtojnë një mendim të dhënë (kuptimi i parë), është njëherazi një aktivitet shoqëror që iu drejtohet të tjerëve për t'i bindur (kuptimi i dytë) si dhe një aktivitet racional që synon të mbrojë një pikëpamje në një mënyrë të tillë që është e pranueshme për një logjikë të shëndoshë. (kuptimi i tretë). Kjo do të thotë që argumentimi ka të bëjë jo vetëm me shprehjen e arsytimit tona, por njëherazi dhe me organizmin që ju bëjmë mjeteve të ndryshme gjuhësore. Gjithë kjo vlerë pragmatike e argumentimit tanimë sendërtohet në aspektin gjuhësor nga e ashtuquajtura "*Retorikë e re*", si një teori e re, si Teoria e ligjëritimit bindës, si Teoria e argumentimit. Ky argumentim nënkupton ndërveprimin e të paktën dy palëve. Nga vetë etimologjia e fjalës "ndërveprim", kuptojmë se kemi të bëjmë me një veprim të dyanshëm. Ky term përkufizohet si: "*ndikim i dyanshëm që ushtrojnë partnerët mbi veprimet e veta përkatëse, kur janë të pranishëm fizikisht njëri për tjetrin*"⁷ ose si: "*bashkëpunim dhe mbrojtje njëkohësisht, respektim i territorit të vet, por edhe i territorit të tjetrit, me qëllim që të mos rrezikohet i veti*".⁸ Ndërveprimi mund të realizohet jo vetëm në mënyrë reale, por njëherazi edhe në mënyrë imagjinare. Kjo do të thotë që partnerët mund të mos jenë aktiv realisht, por bëhen të tillë në mënyrë imagjinare.

Fusha e argumentimit përqendrohet tek analiza, vlerësimi dhe prezantimi i pikës së nisjes së një argumenti të caktuar si dhe në organizimin tërësor ligjërimor të tij. Kjo pikë nisjeje përbëhet nga premisa eksplicite dhe implicite, nga hamendësime të ndryshme që njerëzit bëjnë. Kështu nga njëra anë argumentimi merret me organizmin logjik të arsyeve të ndryshme që paraqiten gjatë një pikëpamjeje të hedhur, dhe nga ana tjetër me rrëzimin ose pranimin e vetë kësaj pikëpamjeje.

⁶ Është procesi që ka të bëjë me hapin final, me mënyrën sesi gojëtar i prezantohet audiencës në mënyrë plot hijeshi dhe bindëse, sesi ai gërsheton të gjitha elementet pjesëmarrëse përgjatë ligjëritimit të tij: gjestet, mimikën, zërin etj.

⁷ Erving Goffman (1922 – 1982, sociolog amerikan): "*Forms of Talk*", University of Pennsylvania Publications in Conduct & Communication, Mars, 1981.

⁸ David Lehman (poet, kritik amerikan i lindur më 1948): "*An alternative to speech*", Princeton University Press, 1986.

Kuptohet që në këtë analizë vijnë e hyjnë në lojë edhe logjika, edhe pragmatika, edhe shumë disiplina të tjera gjuhësore, pasi ligjërimet tona nuk janë të shkëputura nga kontekstet dhe situatat ku vetë këto ligjërimet përfshihen. Ndaj, duke qenë këtu, është e rëndësishme të theksojmë se të gjitha përfaqset moderne të argumentimit në fushë gjuhësie, të zhvilluara në dekadat e kaluara, janë mjaft të ndikuara nga dialektika, retorika klasike dhe post-klasike.

Ndër përfaqësuesit kryesorë që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ndikim në studimet gjuhësore lidhur me teorinë e argumentimit përmendim: **Stephen Toulmin**,⁹ **Chaim Perelman** dhe **Lucie Olbrechts – Tyteca**,¹⁰ **Oswald Ducrot** dhe **Jean - Claude Anscombe**,¹¹ **Jacques Moeschler** dhe **Eddy Roulet**¹² etj.

⁹ Vepra e tij: “*Përdorimet e argumentit*” (“*The uses of argument*”, Cambridge University Press, 1958), mbahet sot e kësaj dite si modeli i argumentimit. Toulmini zhvilloi teorinë e vet të bazuar në shpjegimin se si argumentimi ndodh në procesin e natyrshëm të një ligjërimi të përditshëm. Ky model i njohur ndryshe si “*Skema e argumentit*” përfaqëson formën procedurale të një ligjërimi argumentues: hapat që mund të ndjekim në mbrojtjen e një pikëpamjeje.

¹⁰ Vepra e këtyre e titulluar “*Retorika e re*” (“*La nouvelle rhétorique: Traité de l’argumentation*”, Bruxelles: l’Université de Bruxelles, 1958, përkthyer në anglisht më 1969: “*The new rhetoric. A treatise on argumentation*”, University of Notre Dame Press) ka për qëllim të vendosë themelet filozofike të kësaj të ashtuquajturë retorike të re, apo të një teorie të argumentimit. Këta i vunë theksin saktësisë argumentuese. Kjo sipas këtyre matet me mbështetjen e opinionëve (që vetë ligjëruesi parashtron) nga ana e grupit të audiencës që i drejtohet, në kuptimin që, sa më shumë mbështetet dhe përkrahet nga ky grup pikëpamja e dhënë, aq më shumë kjo pikëpamje rezulton të jetë e saktë. Ky grup i synuar mund të jetë një i vetëm - çka përbën audiencën specifike, por mund të jetë edhe një tërësi shumë e madhe njerëzish, çka përbën audiencën universale.

¹¹ Me punimet e tyre veçmas dhe të përbashkëta, (veçojmë: “*L’argumentation dans la langue*”, Bruxelles: Mardaga, 1983), autorët janë të mendimit se çdo formë e përdorimit të gjuhës ka një aspekt argumentues. Këta dy autorë kërkojnë të integrojnë në përshkrimin linguistik një retorikë të marrëdhënive argumentuese në kuadrin e një pragmatike të integruar, domethënë një teori gjithëpërfshirëse dhe jologjiciste të ligjërimet. Kështu retorika e këtyre interesohet më shumë për strategjitë e ligjërimet (discourse) bindës dhe konkretisht për mënyrat e arsyetimit joformal të folurit natyror (langage), të cilat krijojnë një lloj efekti mbi auditorin, sesa për mjetet gjuhësore që i disponon subjekti folës, përgjatë arritjes së objektivave argumentuese që i ka vënë vetes në ligjëratën e tij.

¹² Punimet e këtyre (përmendim: Jacques Moeschler: “*Argumentation et Conversation – Eléments pour une analyse pragmatique du discours*”, Paris: Hatier - Crédiff; Coll.: “*Langues et apprentissage des langues*”, 1985 dhe Eddy Roulet: “*L’articulation du discours en français contemporain*”, Berne: Peter Lang, 1985), synojnë futjen e një metode analize hierarkike, funksionale dhe argumentuese të ligjërimet. Korniza e analizës së propozuar është ajo e pragmatikës gjuhësore, që shtron si hipotezë se kuptimet e thënive përmbahen në vlerën e tyre si veprim. Kësaj i shtohet hipoteza se kuptimi ka natyrë argumentuese, se thëniet shërbejnë si argumente për përfundime nganjëherë të nënkuptuara. E gjithë pasoja e këtyre orientimeve të reja, është një rivlerësim i pasurisë antike dhe i retorikës së Aristotelit që autorët e sipërpërmendur bëjnë.

2. Ligjërimi argumentues në gjuhën shqipe. Tipare të përgjithshme

Koncepte të tilla si: *analizë ligjërimore, ligjërim, sekuencë, strukturë sekuencore, tekst, thënie (kumtim), akt kumtues, situatë kumtuese, thënës, lokutorë* janë baza e terminologjisë që zbatohen sot në praktikat e analizave të teksteve, sipas kërkesave të reja të gjuhësisë dhe në kuadrin e Gjuhësisë tekstore.¹³

Sipas kësaj retorike të re, fusha e analizës ligjërimore përfshin katër mënyra të organizimit të ligjërimit: *shprehës, narrativ, përshkrues, argumentues*. Çdonjëra nga mënyrat kryen një funksion të caktuar dhe rrjedhimisht është një tip teksti i caktuar. Interesimi ynë në këtë punim lidhet në veçanti me llojin e ligjërimit argumentues. Andaj le të shohim cilat janë tiparet që e karakterizojnë.

2.1. Teza / antiteza

Në ligjërimin argumentues ekzistojnë të paktën dy palë, çka nënkupton praninë e **një teze** dhe **të një antiteze**. Teza i kundërvihet një apo disa tezave të tjera përmes **argumenteve**. Shpalosja e kësaj teze, nga njëra palë shkakton debatin nga ana tjetër, ku pala e dytë kërkon ta kundërshtojë po me të njëjtën mënyrë - thirrjen pranë të argumenteve, që tani më janë **kundërargumente**.

a. Opinioni personal mund të jetë baza e një sprove argumentuese, por, arsyeja, të dhënat dhe informacioni faktik duhet të mbështesin këtë opinionin personal për të vërtetuar argumentin.

b. Një mënyrë për të forcuar argumentin tonë dhe që të shpalosim dije më të thellë për çështjen që mbrojmë, është të parashikojmë dhe të adresojmë kundërargumente ose kundërshtime. Ne mund të krijojmë kundërargumente duke i shtruar vetes pyetje se si mund të përgjigjet dikush, i cili kundërshton mendimin tonë.

Shembull

Argumenti

Ja ç' thotë ajo (për Diana Çulin): “Kriteri më i përhapur, më popullor dhe më i pranuar është ai i çmimeve prestigjioze që jepen nga juritë e ndryshme në Europë, si dhe kriteri i përkthimeve se sa më shumë gjuhë që fliten në kontinentin evropian.”

¹³ Nëse gjuhësia botërore përballet me emrat e studiuesve: Robert-Alain de Beaugrande, Wolfgang Dressler, Jean Michel Adam, Patric Charaudeau et al., gjuhësia shqiptare, ndonëse e vonuar në këtë disiplinë, njih ndërnismëtarët Klodeta Dibra, Nonda Varfi (Klodeta Dibra – Nonda Varfi: “Gjuhësi teksti”, Tiranë, 2005) e duke vijuar me Shezai Rrokaj: “Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme”, Tiranë, 2000, Gjovalin Shkurtaj: “Si të shkruajmë shqip”, Tiranë, 2008), Hasan Mujaj: “Gjuhësia e tekstit”, Prishtinë, 2004, Arbër Çeliku: “Koherenca tekstore”, Shkup, 2005 a ndonjë tjetër.

Kundërargumenti

Mos do të thotë kjo se përkthimet në gjuhët e popujve të Azisë dhe të Afrikës nuk mund ta përcaktojnë vlerën e veprave letrare!”¹⁴

2.2. Pohimi / mohimi

Ligjërimi argumentues ka si bazë **kuptimin e së kundërtës**. Kjo do të thotë që koncepti i argumentit ka dy anë: **pohimin** dhe **mohimin**.

Pohimet ndikojnë në të kuptuarit tonë të shkaqeve, në parashikimet që bëjmë, në mënyrën se si i vlerësojmë gjërat etj. Por, ne nuk jemi thjesht duke i shpjeguar dikujt diçka, i cili do të na dëgjojë dhe do të na i pranojë mendimin automatikisht, pasi jo gjithçka që pohojmë është e vërtetë dhe e besueshme. Si rrjedhojë lind ana tjetër e pohimit: kundërshtimi. Me anë të këtij ne synojmë të mohojmë ato që janë pohuar. Pohimet dhe mohimet vërtiten rreth diçkaje që është dyshuese. Përmes arsytimeve tona zbusim dyshimet dhe ngjallim bindje.

Shembull

Mohimi: *“Siç shihet në ligjëratën time unë kam folur jo për vlerat evropiane – se togfjalëshi vlera evropiane ka kuptime të ndryshme, por...(shih më poshtë)*

Pohimi: *“...për nivelin evropian të letërsisë shqipe. Dhe kam thënë: këtë nivel artistik, estetik, të letërsisë evropiane letërsia shqipe ende nuk e ka arritur. Pikërisht, ky pohim i ka nxitur katër shkrimtarët e sipërpërmendur të reagojnë bashkërisht kundër meje”¹⁵*

2.3. Karakteri bindës

Qëllimi kryesor i çdo ligjërimi argumentues është të bindë. Që ta bëjmë këtë, duhet të marrim parasysh opinionet e tyre dhe të përpiqemi që të kalojmë nga një nivel pranimi në tjetrin; na duhet jo vetëm që të shpjegojmë dhe mbështesim propozimin tonë, por dhe të parashikojmë e madje të tejkalojmë kundërargumentet që vetë pala tjetër mund të ketë. Pikërisht këtu qëndron sekret i argumentimit bindës. Nëse përballë nesh qëndron një marrës i pavendosur, një tjetër armiqësor a dikush tjetër që është lehtësisht i manipulueshëm, ky fakt do të përcaktojë strategjinë që ne do të zbatojmë.

Shembull

Paskal Milo:¹⁶ *“Do të fitojmë sepse jemi të gjithë bashkë. Do të fitojmë një program më të mirë, sepse kemi një orientim dhe kulturë evropiane. Do të fitojmë*

¹⁴ Rexhep Qosja: “Mjerimi i provincializmit”, tek e përditshmja “Gazeta shqiptare”, e enjte, 3 shtator, 2009.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Artikulli me titull: “Ne e ardhmja, ata e shkuara” tek e përditshmja “Zëri i popullit”, e shtunë, 17 shkurt, 2007.

sepse midis nesh tani ka unitet, ka bashkim...Ne do të fitojmë sepse ne dimë të qeverisim, ne kemi dëshmuar se dimë ta bëjmë këtë më mirë se kushdo tjetër, me vepra, punë dhe projekte...

2.4. Karakteri dyshues

Ligjërimi argumentues lëviz shpesh në të vërtetën jo të provuar si dhe në logjikën e rreme. P. sh.,: *“Ai nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit. Si rrjedhojë, nuk është ai fajtori.”* Kështu, me anën e këtij lloj arsytimi, gjukojmë të drejtën, por jo të vërtetën. Të argumentosh nuk do të thotë të thuash të vërtetën, as të tregosh karakterin logjik të vlefshëm të një arsytimi. Të argumentosh do të thotë të japësh arsye, konkluzione të atilla për të. Ndaj që është e nevojshme të dallojmë proceset: të argumentojmë dhe të logjikojmë.

Shembull

“Prej këtyre kritereve të Diana Çulit dhe të bashkëreaguesve të saj, duhet të nxjerrim përfundimin se një vepër letrare, një vepër shkencore a një vepër filozofike, e shkruar në gjuhën shqipe, ka vlerë letrare, shkencore a filozofike kombëtare dhe evropiane, vetëm në qoftë se të tjerët e çmojnë si vlerë, e përkthejnë dhe e shpërblejnë me çmime, medalje, dekorata, tituj të ndryshëm autorin e saj! Sipas kësaj logjike nuk është e rëndësishme çka mendon ti vetë për ato vepra dhe për krijuesit e tyre; e rëndësishme është çka mendojnë dhe çka thonë ata, të tjerët, ata prej të cilëve varet edhe shumëçka në shtetin tënd...”¹⁷

2.5. Karakteri dialogjik

Ligjërimi argumentues ka **karakter dialogjik**. Këtu duhet të bëjmë kujdes në mënyrë që të mos ngatërrojmë termin *“dialogjik”* me termin *“dialogor”*. Nëse ky i fundit ka të bëjë thjesht me formën e jashtme të ligjëratës, në ndryshim, termi *“dialogjik”*; ka të bëjë me funksionin e ligjëratës. Nocioni i dialogjizmit u krijua nga **Mikhail Bakhtin**¹⁸ për të përshkruar lidhjen e ndërsjellë të pohimeve në komunikim në një tekst të dhënë. Sipas **Bakhtinit**: *“konteksti përbën sfondin e ngjarjeve, të pikëpamjeve dhe të zërave.”*¹⁹ Kështu në binomin dhënës-marrës të aktit gjuhësor kemi edhe shfaqjen e zërave, të cilët gjatë gjithë ngjarjes gjuhësore bëhen protagonistët e krijimit të së ashtuquajturës polifoni.

Shembull lidhur me argumentin: *A duhet të ndryshojë standardi i shqipes, apo jo?*

¹⁷ Rexhep Qosja: “Mjerimi i provincializmit”, tek e përditshmja *“Gazeta shqiptare”*, e enjte, 3 shtator, 2009.

¹⁸ Mikhail Bakhtin: *“The dialogic imagination”*, The university of Texas Press, 1982.

¹⁹ Po aty.

Jorgo Bulo: “Është e vërtetë se gjuha zyrtare është krijuar në bazë të toskërishtes, por me shumë pjesë të marra edhe nga gegërishtja, sidomos në aspektin leksikor. Vendimi për të krijuar një gjuhë zyrtare me bazë toskërishten nuk është një përpjekje për të mbisunduar një të folme ndaj një tjetre, por thjesht një zgjedhje shkencore, që shumë mirë mund të ishte edhe anasjelltas, pra që bazë e gjuhës zyrtare të ishte gegërishtja... Nuk e besoj se duhet të ndryshojë kjo gjuhë zyrtare që kemi.”²⁰

Ardian Vehbiu: “Për mendimin tim, standardi për arsye thjesht funksionale nuk e pranon dot paskajoren geqe tale quale, e cila më mirë të mbesë atje ku gjithnjë ka qenë: në gegërishten e folur dhe në variantet letrare të gegërishtes.”²¹

Shefkije Islamaj: “Do të ishte tepër e shtrenjtë një aventurë e tillë për një popull të vogël siç janë shqiptarët, për administratën shtetërore e publike dhe për mjetet e informimit publik. Andaj, shqiptarët do të dinë cila është rruga e tyre: shqipja standarde do të vazhdojë të mbetet gjuha e përbashkët e gjithë shqiptarëve, edhe e shqiptarëve të Kosovës, sepse duke pasur një gjuhë të përbashkët e një histori gjuhësore të përbashkët, shqiptarët do të kenë një të ardhme të përbashkët përparuese dhe qytetëruese.”²²

Emil Lafe: “Pikëpamja e disave që ta nisim edhe një herë nga e para, sepse kjo gjuhë letrare u vendos në kohën e komunizmit, jo vetëm nuk është e dobishme, por madje është e dëmshme. Është pak a shumë njësoj sikur të vihet në diskutim a duhet të jetë Tirana kryeqytet i Shqipërisë? Flamuri u ngrit në Vlorë, por kryeqytet mund të kishte qenë edhe Elbasani, Durrësi ose Shkodra. Por këto punë vendosen një herë e mirë dhe nuk ka pse të bëjmë prapa!”²³

2.6. Karakteri implicit

Ligjërimi argumentues ka **karakter implicit**. Karakteri implicit lidhet me pjesën e fshehur ose të nënkuptuar të tekstit. Në ligjërimin argumentues nuk është qëllim që të gjejmë se çfarë ka në mendje në të vërtetë folësi apo autori në ato që artikulon, por të përcaktojmë pohimin që mbron ky folës apo autor në kontekstin dhe situatën e dhënë. Pjesa implicite është e vështirë të rrëmohet në ligjërim, pasi në njohjen e saj ndikojnë shumë faktorë, si: niveli kulturor i marrësit të këtij teksti, njohja me situatën dhe rrethanat ku dhe kur zhvillohet ky tekst etj.

²⁰ Jorgo Bulo: “Kulla e Babelit...ose gegnishtja e standardit” tek e përditshmja “Standard”, e shtunë, 29 mars, 2008, f. 3.

²¹ Ardian Vehbiu: “Mistika me gegënishten mjegullon problemin real” tek e përditshmja “Shekulli”, e diel, 5 gusht 2007, f. 14.

²² Shefkije Islamaj: “Shqipja standarde – vlerë kombëtare” tek “Gjuha dhe identiteti”, Tiranë, 2008, f. 69.

²³ Emil Lafe: “Gjuha dhe shkrimi” tek “Gjuha shqipe”, nr. 3, Prishtinë, 2007, f. 10.

Shembull

*“Çadrat janë disa lloje: të vogla, nga ato që mbahen për në makinë, të zakonshme nga ato të kohës së Enverit, që iu thyhen telat shpesh, të mëdha me atë butonin në fund dhe ombrellat që arrijnë të përballojnë diku rrebeshin. Më logjike do të ishte që në kohë rrebeshesh, sikurse kalojmë sot, të mos ia vinin fajin çadrës. Kështu duhej ta mendonin edhe socialistët. Nuk e ka fajin shiu, faji është i atij që mendon se rrebeshi kalohet vetëm me një çadër, pa çizme llastiku, pa mushama e kështu me radhë...Ka raste kur rrebeshë të forta nuk i duron as ombrella më e fortë, por kur bëhemi qull nuk do të thotë që fajin na e ka gjithnjë çadra”.*²⁴ (metafora çadër nënkupton konceptin e kreut, të udhëheqësit).

2.7. Karakteri polemizues

Karakteristikë e ligjëritimit argumentues është nxjerrja në pah e forcës së fjalës. Që të mbrosh një tezë apo një konkluzion, do të thotë të hedhësh poshtë një tezë apo një tjetër konkluzion, në mënyrë të tillë që mos të hyjmë në zënie, por duke qëndruar gjithmonë tek kundërgargumentet. Si rrjedhojë, nuk duhet ngatërruar argumentimi me zënie. Argumentimi është paraqitja e arsyeve për bindjen që kemi, kurse zënia mund të shihet si një luftë me fjalë. Zënia sjell humbjen e gjakftohtësisë dhe forcon egon, ajo ka të bëjë me ndjenjat, nxjerr inatet dhe sjell shpërthime. Argumentimi synon në zbulimin e së vërtetës, duke e nxjerrë bindjen nën dritën e arsytimit. Argumentimi duhet të jetë një sfidë për arsyen dhe jo një ftesë për t’u zënë.

Shembull

*“Ideja e hedhur për një gjuhë të re, të veçantë, për shqiptarët e Kosovës po përvijohet djallëzisht nëpër hapësirën tonë lehtë të lëndueshme politike, kulturore, fetare, gjuhësore, më në fund edhe kombëtare. Edhe ata më pak të informuarit e dinë dhe e kanë të qartë se gjuha standarde në Kosovë mund ta ndërrojë emrin, po jo edhe substancën e strukturën e saj...Përprjekjet për t’i çintegruar shqiptarët gjuhësisht, përprjekjet për t’i veçuar shqiptarët gjuhësisht, përprjekjet për ta përmbysur standardin për një pjesë të shqiptarëve, në të vërtetë do të thonë përprjekje për të sjellë regres gjuhësor, për të shkaktuar kaos gjuhësor e për të sjellë armiqësi gjuhësore...”*²⁵

²⁴ Fatos Baxhaku: “Sa faj ka çadra kur zë rrebeshi?”, tek e përditshmja “Shqip”, e diel, 30 gusht, 2009.

²⁵ Shefkije Islamaj: “Shqipja standarde – vlerë kombëtare”, tek “Gjuha dhe identiteti”, vep. e cituar, f. 92.

2.8. Karakteri qëllimor

Ligjërimit argumentues ka **karakter qëllimor**. Karakterin qëllimor të aktit të argumentimit mund ta shohim në dy kuptime:

a) në faktin e paraqitjes së një argumenti. Që të mbështetet ose të rrëzohet një tezë do të thotë që vetë thënies i vijnë në ndihmë qëllimtazi argumente të caktuara. Sa më bindëse është tërësia e serisë së “mbiqëllimeve” që lokutori i ka vënë vetes, e që këto të fundit s’janë veçse argumentet e ndryshme të lidhura pas një “strategjie” globale, aq më i finalizuar dhe përmbushës në qëllimin e vet do të jetë procesi i argumentimit.

b) në funksionin, në qëllimin e tij. Kështu nëse një ligjëratë A thuhet “e destinuar për t’i shërbyer një konkluzioni C”, kjo nënkupton qëllimshmërinë e vetë argumentimit, e cila i shërben arritjes së një konkluzioni të caktuar.

Shembull

Në qoftë se ABCD është romb, atëherë ABCD është paralelogram. Diagonalet e rombit janë pingule me njëra-tjetrën dhe përgjysmore të këndeve të rombit.

Në rombin ABCD këndi A e ka masën 40gradë.

Në qoftë se $AB=AD$ atëherë AB është dybrinjënjëshëm, AO është mesore e tij sepse rombi është paralelogram dhe diagonalet përgjysmohen në O.

Në qoftë se BCD është paralelogram dhe ka diagonale, atëherë ABCD është romb”.

2.9. Karakteri ndikues

Ligjërimit argumentues ka **karakter ndikues** (efektshmëria). Çdo ligjërimit argumentues finalizohet me një konkluzion të caktuar. E gjithë paraqitja strukturore argumentuese (por dhe kundërgargumentuese) bëhet në mënyrë që jo vetëm të bindim auditorin, por njëherazi të ndikojmë tek ai. Në fund ai duhet të mos ketë asnjë lloj dyshimi në argumentet (kundërgargumentet) e dhëna. Efektshmëria arrihet nëse argumentimi ynë është i organizuar.

Shembull

Pas polemikave të shumta, lidhur me çështjen e ndryshimit apo jo të standardit të shqipes **Rami Memushaj** reagon:

“Unë po e shoh këtë veprim si një atentat kundër kulturës kombëtare...Kjo sipërmarrje aventurore nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do të çoroditë shkollën, shtypin, legjislacionin dhe kushedi ç’pasoja negative do të sjellë...Nismëtarët e kësaj aventure nuk do të kenë sukses. Sepse, së pari, planifikimi gjuhësor kërkon pjesëmarrjen e planifikuesve gjuhësorë më të kualifikuar dhe nga të gjitha trevat e institucionet që merren me gjuhën të cilët nuk pajtohen me veprime të tilla. Nëse vendimet nuk merren në tubime të gjera kompetentësh siç qe Kongresi i

*Drejshkrimi, ky planifikim do të jetë i dështuar që në zanafillë. Së dyti, edhe sikur të arrihet kjo me pjesëmarrje axhaminjsh e krahinarësh, cila do të jetë forca që do ta bëjë të detyrueshëm këtë kod të ri në tri shtete? Po diasporën historike, ku do ta lëmë? Pra, rezultati do të jetë kaos gjuhësor. Sipërmarrje të tilla antishkencore dhe me dëm shumë të madh për kulturën dhe unitetin tonë kombëtar duhen denoncuar e penguar”.*²⁶

Për sa më lart, kuptueshmëria në thelb e gjithë tipareve të sipërpërmendura do të na lehtësojë punën e analizës ligjërimore argumentuese, në praktikën e analizave të teksteve, brenda kuadrit të gjuhësisë së tekstit.

Bibliografia

1. Aristoteli (2007), *Retorika*, botim i eBooks@Adelaide, Libri I, parag. a 1.1.1--1354:1. Varianti origjinal në anglisht gjendet në linkun: <http://ebooks.adelaide.edu.au/a/aristotle/a8rh/index.html>.
2. Bakhtin, Mikhail (1982), *The dialogic imagination*, The university of Texas Press.
3. Baxhaku, Fatos (2009), *Sa faj ka çadra kur zë rrebeshi?*, tek e përditshmja *Shqip*, e diel, 30 gusht 2009.
4. Bullo, Jorgo (2008), *Kulla e Babelit...ose gegnishtja e standardit*, tek e përditshmja *Standard*, e shtunë, 29 mars 2008.
5. Çeliku, Arbër (2005), *Koherenca tekstore*, Shkup.
6. Dibra, Klodeta – Varfi, Nonda (2005), *Gjuhësi teksti*, Tiranë.
7. Ducrot, Oswald e Anscombe, Jean – Claude (1983), *L'argumentation dans la langue*, Bruxelles: Mardaga.
8. Goffman, Erving (1981), *Forms of Talk*, University of Pennsylvania Publications in Conduct & Communication.
9. Islamaj, Shefikje (2008), *Shqipja standarde – vlerë kombëtare*, te *Gjuha dhe identiteti*, Tiranë, f. 69.
10. Lefe, Emil (2007), *Gjuha dhe shkrimi*, tek *Gjuha shqipe*, nr. 3, Prishtinë, 2007.
11. Lehman, David (1986), *An alternative to speech*, Princeton University Press.
12. Memushaj, Rami: Letër publike drejtuar gjithë universiteteve shqiptare.
13. Moeschler, Jacques (1985), *Argumentation et Conversation – Eléments pour une analyse pragmatique du discours*, Paris: Hatier - Crédif; Coll.: *Langues et apprentissage des langues*.
14. Mujaj, Hasan (2004), *Gjuhësia e tekstit*, Prishtinë.
15. Perelman, Chaim dhe Olbrechts, Lucie–Tyteca (1958), *La nouvelle rhétorique: Traité de l'argumentation*, Bruxelles: l'Université de Bruxelles,

²⁶ Rami Memushaj: Letër publike drejtuar gjithë universiteteve shqiptare.

- 1958, përkthyer në anglisht më 1969: “*The new rhetoric. A treatise on argumentacion*”, University of Notre Dame Press.
16. Qosja, Rexhep (2009), *Mjerimi i provincializmit*, tek e përditshmja *Gazeta shqiptare*, e enjte, 3 shtator 2009.
 17. Roulet, Eddy (1985), *L’articulation du discours en français contemporain*, Berne: Peter Lang.
 18. Rrokaj, Shezai (2000), *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë.
 19. Shkurtaj, Gjovalin (2008), *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë.
 20. Toulmin, Stephen (1958), *Përdorimet e argumentit (The uses of argument)*, Cambridge University Press.
 21. Vehbiu, Ardian (2007), *Mistika me gegënishten mjegullon problemin real*, tek e përditshmja *Shekulli*, e diel, 5 gusht 2007.
 22. *Zëri i popullit*, (gazetë e përditshme), e shtunë, 17 shkurt, 2007.

Albana DEDA - NDOJA

AT JUSTIN RROTA NË PANTEONIN E GJUHËSISË SHQIPTARE

Sot, kur në tregun mediatik dhe, për fat të keq, në ndonjë rast me një guxim të çuditshëm dhe në ndonjë debat të rretheve shkencore, shfaqen shenja krahinorizmi të pakuptimtë¹, (që në fund të fundit vjen ose nga injoranca, ose nga dashakeqësia patologjike e ushqyer për vite me radhë nga diktatura), lypset që të sjellim në vëmendjen e auditorit të interesuar kontributet e një elite të mrekullueshme, siç janë priftërinjtë katolikë shqiptarë, sidomos ata të shek. 20 (tashmë mbi bazën e analizës shkencore).

Pjesa më e madhe prej nesh e lidh këtë përcaktim më shumë me emrin e françeskanëve të mëdhenj të shek XX, të cilët me veprimtarinë e tyre politike, atdhetare, letrare, gjuhësore, didaktike etj përbënin një faktor mjaft të rëndësishëm dominimi, megjithatë pohimi i mësipërm i ka larghedhje edhe më të madhe në kohë.

Në arkivin e shtetit shqiptar të boshatisur në shumicën e rasteve mendojmë në mënyrë të qëllimshme², gjithsesi gjenden dokumente që të 1600-ës të cilat demonstrojnë se priftërinjtë katolikë punuan, jo vetëm në inductimin e ushqimit shpirtëror specifik të grigjës, por qenë njëkohësisht dhe pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i kohës, që zgjidhte duke u mbështetur jo vetëm në të drejtën fetare, por dhe atë zakonore probleme të ndryshme, në ato kohë kur historia e shtetit shqiptar shfaqet shumë e zbehtë.

Gjithashtu është po ky kontingjent që jo vetëm e dokumentoi shqipen për herë të parë, por që këmbëngulte pranë fuqive të tilla si Austro-Hungaria për fonde që do të shkonin, jo vetëm për bamirësi e nevojat e kishës, por dhe për hapjen e shkollave, në të cilat përveç lëndëve fetare kishin dhe lëndë shkencore të mirëfillta.

Kjo lloj veprimtarie erdhi dhe u intensifikua akoma dhe më shumë me formimin e shoqërive të para të themeluara nga figura të shquara erudite, atdhetare

¹ I referohemi ndonjë pohimi të ndonjë pseudointelektuali, i cili është shprehur publikisht se intelektualet me të shquar vijnë nga jugu. Me këtë nuk duam të mohojmë figura të shquara të kësaj zone, por na duket e paarsyeshme një etiketim i tillë dashakeq, që në fund të fundit nuk reflekton të vërtetën dhe të lë një shije të keqe në aspektin njerëzor.

² Një pjesë e këtyre kontributeve janë njohur dhe gjatë periudhës së diktaturës dhe mund të themi se deri diku dhe mund të jenë konsultuar e në ndonjë rast pa dhënë autorësinë.

dhe politike si Abat Preng Doçi kryetar i Shoqërisë Bashkimi (dosja e të cilit në arkivin e shtetit shqiptar është komplet e boshatisur).

Këto shoqëri financuan dhe përgatitën ato të cilat janë ndër dokumentet e vetme që fatmirësisht i kemi akoma në dorë si Hylli i Dritës, Leka, Zani i shna Ndout etj, në të cilat u shpalosën ma së pari interesat e shumanshme të këtij brezi.

Në aspektin shkencor dhe kulturor gjykojnë se ata përbëjnë një Akademi të vërtetë, e cila na ka lënë pas një trashëgimi të jashtëzakonshme.

Për arsytet e lartpërmendura dhe për faktin se ata janë shembulli i shkëlqyer i civilizimit dhe modestisë njerëzore, pavarësisht petkut fetar që mbanin, pasi kontribuuan për të mirën mbarëkombëtare, pa parë përkatësitë krahinore dhe fetare, kemi nisur një cikël punimesh, i cili lidhet me dokumentimin dhe nxjerrjen në pah të kontributit të një pjese të kësaj elite të mrekullueshme, që mendojmë se duhet njohur më mirë në dimensionet reale që ata shfaqen, si aspektin gjuhësor ashtu dhe letrar.

Në kuadrin e kësaj konference ne jemi ndalur në figurën e përkorë njerëzore, por në dimensione shumë të mëdha shkencore të at Justin Rrotës, i cili përfaqëson njërin nga trashëgimtarët e fundit të këtij brezi brilant, e më konkretisht në atë që mund të quhet testament i tij, që me modestinë e shkencëtarit ia la për botim Institutit të Gjuhësisë “Gjuha e Shkruese ase Vërejtje Gramatikore”.

Vepra shfaqet si përmbledhje studimesh në disiplinat bazë gjuhësore si fonetikë, morfologji, sintaksë, etimologji, në lidhje me historinë e alfabetëve dhe diskutimeve rreth tyre, dhe mjaft njohuri të gjuhësisë së përgjithshme. Me pak fjalë e hartuar në fund të jetës së tij (rreth viteve 60³), ai përmbledh në të dhe idetë kryesore të tij në këto disiplina.

Në këtë kumtesë ne jemi ndalur në disa çështje morfologjike dhe sintaksore (me terminologjinë tradicionale), të cilat mendojmë se përfaqësojnë përcaktime që dalin jashtë kuadrin të ngushtë tradicional.

Pjesa e morfologjisë përbën kapitullin e tretë të veprës në fjalë⁴.

Natyrisht që kemi të bëjmë me një trajtim tradicional në përgjithësi. Kështu dallohen 10 pjesë ligjërata, një prej të cilave është dhe nyja, ndërsa pjesëza futet te pasthirrma.

Shfaqen interesant përcaktimi semantik i ndonjë koncepti, pasi dhe sot në përkufizimet e Gramatikës së Akademisë kemi kriterin formal mbisundues.

Disa vite më vonë (1966) nga përfundimit veprës në fjalë nga at Justini (por jo i botimit), prof Selman Riza në “Sistemin foljor...” do të vërente faktin se zakonisht përkufizimet e deriatëhershme për pjesët e ligjërates shfaqen jo të plota, pasi përgjithësisht janë të lidhura me kriterin formal.

³ Kjo vepër e pa dritën e botimit vetëm në 2006 me përkrahjen dhe financimin e komunitetit katolik, e sidomos të At Zef Pllumit.

⁴ Në fakt Rrota pohon faktin e këtu kemi të bëjmë me një bashkëpunim me Viktor Volajn.

Përcaktimi semantik i tyre shfaqet i zbehtë, pasi mungojnë dhe studimet në lidhje me këtë përbërëse. (Fatkeqësisht një gjë e tillë vazhdon të ndihet dhe sot, kur dihet se në studimet moderne janë intensifikuar punimet në lidhje me anën semantike.).

Prof S. Riza⁵ thekson gjithashtu se është mirë që pjesët e ligjëratës të studiohen sipas një kriteri të vetëm e pastaj të sqarohen kategoritë përkatëse.

Në këtë kontekst disa përcaktime të dhëna në veprën e At Justinit shfaqen më të kujdesshme në këtë aspekt. Kështu ai shprehet: Emnat që mund t'i përshtaten secilës vetë (burrë, ushtar, vajzë), secillit frymor të paarsyeshëm (si qen gjarpën), çdo sendi të pajetë (si tokë, gruno, derë), ase mendimeve e ndjesive të shpirtit : këta quhen të gjithë emrat e përgjithët.

Nuancat e komponenteve semantike⁶ të studimeve të fundit janë të dallueshme në markimin me tiparin semantik që sot emërtohet ±frymor, apo ±sapiens.

Nga ana tjetër ka raste, kur jepet vetëm kriteri semantik si p.sh. përkufizimi i emrave përmbledhës, megjithëse dihet se ky i fundit është redondant në grupimin përkatës, ndërkohë që në ndonjë rast tjetër si të mbiemri ndodh e kundërta. Ai përcaktohet përgjithësisht formalisht.

Po ndalemi pak te folja dhe trajtimi i diatezës i bërë në këtë vepër.

Së pari duhet theksuar se folja vlerësohet si gjymtyra më e rëndësishme e fjalisë⁷. E pohojmë këtë, pasi të njëjtin pozicion i rezervojnë sot shumica e teorive moderne gjuhësore. (Kemi parasysh se trajtimet në këtë vepër janë përgjithësisht tradicionale, që shohin si gjymtyrë kryesore, kryefjalën dhe kallëzuesin.).

Në vazhdim dallohen foljet vetore dhe jovetore si dhe ato tranzitive e intransitive (kaluese, pakaluese), të cilat kategorizohen klasikisht si në Gramatikën I⁸.

Kur flitet për diatezën vihet re se, në ndryshim nga trajtimi që i bën Gramatika I, ku kriteri kryesor përcaktues është ai formal, autorët këtu fillimisht nisen nga ai semantik (megjithëse mjaft i kufizuar e nw ndonjë rast i ngatërruar me formën). Kështu kemi përcaktime të tilla : Kur vetë ban një veprë atëhere folja vetë thirret vepruese (aktive), unë lexoj, ti luen, kur kryefjala nuk ban gja, veç bart ase pëson një veprë të kryeme prej së tjerësh folja atëhere quhet pasuse (pasive). Unë jam gjithmonë i qitun në atë familje.(fq 323). (Ky përbërës semantik shënjon dhe formën në këtë rast).

Duhet thënë se në këtë trajtim nuk përjashtohet mundësia që dhe foljet pakaluese (intransitive) të kenë diatezë, vërejtje kjo e bërë dhe më vonë nga prof. Ethem Likaj⁹ dhe nga ne¹⁰.

⁵ S. Riza, Sistemi foljor i letrarishtes bashkëkohore, tiranë, 1994, f. 259.

⁶ A. Ndoja, Konferenca mbi Terminologjinë në Shkencat e Ligjërimit, Elbasan, 2012.

⁷ ...pjesa ma me randsi e fjalisë, f. 327.

⁸ Gramatika I, Tiranë 2002

Gjithashtu mjaft interesant është përcaktimi se dhe foljet pakaluese mund të kenë formë pësuese, por në vetën e tretë të njëjësit (Nuk jetohet ma kështu.), ashtu si dhe disa folje kaluese në vetën e parë nuk mund të kenë kuptim pësues. Kështu nuk mund të themi :Unë shkruhem, punohem etj. Edhe në rastet kur mund të përdoren në këtë formë ato nuk kanë kuptimin pësues (diatezë pësore), po bredhtuer (diatezë refleksive).

Nga kjo analizë mund të konstatojmë se për përcaktimin e diatezave përbërësja semantike (nëse mund ta quajmë kështu se është shumë e kufizuar) ka markuar formën e diatezës dhe rastet, kur nuk kemi përputhje të këtyre të dyjave shihen si kalime nga një diatezë në tjetrën siç e pamë më lart.

Në trajtimet tona¹¹ diateza shihet si një proces shumë më i gjerë se sa thjesht morfologjik. Ajo trajtohet si marrëdhënie specifike e rrafshit semantik dhe morfo-sintaksor të modeleve në të cilat projektohet një folje.

Në këtë proces tashmë mjaft mirë të përpunuar dhe studiuar në botën gjuhësore moderne evropiane dhe atë amerikane (produktet janë fjalorët e valencave dhe korpuset strukturore elektronike të mbledhura në bazë të kësaj teorie), një folje qoftë ajo kaluese apo pakaluese, veprorë, apo pësuese e refleksive na shfaqet e markuar semantikisht e strukturalisht. Pra koka foljore seleksionon semantikisht argumentet e saj, të cilat sillen formalisht si komplemente specifike të strukturave të caktuara që mund të ketë një kokë e caktuar (disa prej atyre strukturave të diatezave që përmendëm më lart).

Në këtë kontekst mendojmë se përcaktimet në miniaturë të diatezave të bëra në këtë vepër, megjithëse shumë të kufizuara, i japin mundësinë lexuesit të specializuar të kuptojë së pari se nuk kemi ndarje të prera foljesh, si formalisht, ashtu dhe në diatezat që mund të marrë ajo (këtu e kemi fjalën për kuptimin tradicional të konceptit), pasi secila prej tyre duhet shqyrtuar me kujdes, jo vetëm sipas një modeli strukturor. Në këtë mënyrë pohohet ekzistenca e strukturave të ndryshme në të cilat mund të shfaqen predikatët, të aftë për të pasur valencë.

Kështu një folje jokaluese mund të sillet si kaluese dhe si pësuese dhe shembujt e dhënë jepen në strukturë, ku përcaktohet dhe veta specifike në të cilën zakonisht përdoren këto folje.

Megjithatë duhet thënë se trajtimi i dhënë pavarësisht atyre që thamë më lart mbetet përsëri në kuadrin e traditës klasike, në të cilën forma bëhet elementi kryesor përcaktues dhe elementi semantik mbetet thjesht garniturë.

Do të ndalemi pak dhe te trajtimi që u bëhet parafjalëve në këtë vepër. Përkufizimi i saj është komplet formal, pra tradicional (Parafjala asht pjesë e

⁹ E.Likaj, SF,1971 I.

¹⁰ A. Deda, Diateza në gjuhën shqipe....., Seminari i Prishtinës, 2005.

¹¹ Shih A. Ndoja Diateza në gjuhën shqipe, Prishtinë, 2005

pandryshueshme e ligjëratës, pa përilm të shënjojë përpjekjet a lidhjet që mund të kenë dy emnat etj ndërmjet vetes. Vendin kjo e ka gati përherë para emnash.).

Nga ana tjetër, pavarësisht se në vepër nuk trajtohet as togfjalëshi tradicional, as sintagma, apo organizimi i fjalëve në grupe fjalësh, trajtimi i konceptit në fjalë bëhet në këto korniza.

Parafjala konceptohet si kokë drejtuese e aftë të tërheqë pas vetes një komplement specifik, me nuanca komplet origjinale semantike. Kështu shprehimisht thuhet se :Parafjalët e marrin emnin n'atë rasë që u pëlqen. "Para shpiet."

Këtë lloj marrëdhënie ai e sheh në kuadrin e reksionit, një proces ky i njohur për disa kategori të caktuara dhe i studiuar në disa gjuhë, po shumë më i ngushtë¹² si proces se valenca. Ai konceptohet përgjithësisht si raport formal sintaksor¹³ varësie zakonisht i foljes, emrit dhe parafjalës me kah drejtimi të përcaktuar.

Trajtimi që i bëhet parafjalëve këtu në radhë të parë e sheh atë gjithnjë në perspektivën e sintagmës në të cilën është një kokë, duke i përcaktuar për një pjesë të mirë parafjalësh dhe modelin valentor specifik që ato kanë, me komplementet përkatëse, natyrisht pa përdorur këtë terminologji.

Vetëm për parafjalën *për* jepen pesëmbëdhjetë struktura¹⁴ të cilat do të ishin në fund të fundit dhe rasat semantike karakteristike që ato do përfaqësonin.

Kujtojmë se Fillmor-i¹⁵, kodifikuesi i konceptit të rasës semantike, e shihte sintagmën parafjalore si një nga komplementet e detyrueshme të perspektivës foljore.

Natyrisht që një specifikim i tillë i korpusit në fjalë nuk ka qenë synim i at Justinit, po identifikimi empirik në strukturë sipërfaqësore i këtyre modeleve, na krijon mundësinë e konkluzioneve të tilla, pasi dokumentojnë modelet e ndryshme të projektimit të kokave në fjalë.

Në aspektin sintaksor jemi ndalur pak tek koncepti i kundrinës së brendshme (obiectum internum) të trajtuara në pjesën e katërt të veprës (f. 473).

Ky koncept përfaqëson: *kundrinën e drejtë në lidhni me folje pakaluese*. Shembuj të tillë: Ku verove verën o?; Kam fjetë një gjumë të randë.; Kopshtin e kemi vu gjysëm lakna. etj janë dëshmi që sistemi i shfaq në strukturë sipërfaqësore, pavarësisht se intuitivisht pranohet se këto kundrina janë pjesë e pasurisë semantike të foljes që tashmë i përzgjedh ato.

Kështu folja *fle* në shumicën e përdorimeve nuk e ka të nevojshme komplementin që këtu na del në trajtën e kundrinës së brendshme (gjumin).

¹² A. Ndoja, Teoria e Valencës dhe aplikimi i saj në gjuhën shqipe (punim doktrate), Tiranë 2012, dorëshkrim.

¹³ A. Spahiu, Reksioni dhe valenca foljore, Prishtinë, 2002

¹⁴ F. 423.

¹⁵ Fillmore, gjuhëtar amerikan që nisi punën si gjenerativit me artikullin e tij të famshëm mbi rasën semantike "Case for case", 1968, por që më vonë kaloi në deskriptivizëm.

Pohimi i këtyre strukturave pohon faktin se nuk kemi ndarje të prerë në folje transitive dhe intransitive, pasi një folje mund të ketë modele ku del si intransitive, ose një tjetër ku del si transitive në konceptin tradicional.

Të gjitha modelet e mundshme të identifikuara që mund të marrë një predikat i tillë përbëjnë fondin valentor të modeleve specifike.

Në këtë kontekst arsyetimi mund të shihet dhe sqarimi teorik në lidhje me dallimin mes kundrinës me parafjalë dhe ndajfoljorit. Ai shprehet se: ...Janë kundrina, kur folja pa këto (emna me parafjalë, sintagma parafjalore) nuk ka kuptim të plotë. Ndërsa janë ndajfoljorë, kur e përcaktojnë veprën e foljes, disi ma largtas, sipas rrethanave të kohës, mënyrës, vendit, dhe shkakut.

Në thelb ky përcaktim përbën dhe perceptimet fillestare mes komplementeve të detyrueshëm adjunkteve.

Në të dy rastet jemi prap larg një përcaktimi gjithëpërfshirës, gjë që vihet re dhe në problemet që hasen në një pjesë shembujsh të dhënë dhe në Gramatikën II të Akademisë, pasi dhe aty nuk jepen kritere të prera në dallimin e këtyre grupeve.

Po kështu dhe në Teorinë e Valencave akoma vazhdon të mbetet problematik dallimi i komplementeve dhe adjunkteve. Në studimet më të fundit kufijtë për një pjesë strukturash që ishin klasifikuar si adjunkte, sot merren si komplemente siç është rasti i foljes *banoj* që e ka të detyrueshme sintagmën parafjalore me vlerë semantike vendore.

Në tërësinë e vet vepra e at Justin Rrotës përbën më shumë se një gramatikë të mirëfilltë, pasi në të përmbledhen njohuritë shumë më të gjëra se një pjesë e mirë e gramatikave të deriatëhershme. Ajo hap serinë punimeve serioze shkencore, të mirorganizuar dhe jo fragmentare si një pjesë e traditës paraprirëse.

Stili i përdorur në hartimin e saj pavarësisht se kërkon një lexues të specializuar, i pajisur me shumë shembuj dhe vërejtje sqaruese e bën më të lehtë kuptimin dhe leximin e saj, duke e zgjeruar auditorin e interesuar.

Ai përbën një shembull nga ana metodike, pasi analiza që u bëhet shumicës së problemeve të trajtuara e nis sqarimin që në etimologji dhe më pas deri në sinkroni, me trajtat shumta e në fund jep dhe sugjerimet si rrjedhë logjike e kësaj analize.

Të interesuarit në lidhje me standardin do të gjejnë në këtë punim mjaft material për ta konsultuar me vëmendje e sidomos do kenë mundësinë të njohin metodologjinë e një analize shkencore që mbështetet në njohuri shumë të thella shkencore dhe jo në përshtypje individuale të pashoqëruara me studime shteruese.

Korpusi i bollshëm i shembujve të marrë jo vetëm nga gegnishtja, por dhe nga toskërishtja (jo vetëm format në sinkroni por dhe ato në diakroni), përgjithësisht më trajtat ligjërimore përkatëse, i ka dhënë mundësinë analizës në karakterizimin e shumë prej atyre që janë parë si raste periferike në tekstet zyrtare.

Autori është njohës mjaft i mirë i të dy dialekteve dhe të folmeve të tyre si dhe drejtimit që kishin marrë ato.

Nga ana tjetër kjo lloj metodologjie merr një rëndësi akoma më të madhe, sidomos sot që në studimet botërore, rrafshi ligjërimitor është rikonceptuar dhe po hulumtohet hollësisht, pasi prej tij kanë dalë të dhëna që ndoshta sistemi mund të mos i kishte seleksionuar si të tilla, pavarësisht ekzistencës së tyre.

Në përfundim mund të themi se e gjithë veprimtaria e At Justinit përbën një kontribut të jashtëzakonshëm shkencor nga e cila vazhdojnë të burojnë teza, ide dhe mënyra zgjidhjeje të denja për t'u marrë në konsideratë sot e në vazhdim.

Bibliografia

1. Fillmore, Charles (1968), *Case for case*, New York.
2. Fillmore, Charles (1977), *Case for case reopened*, New York.
3. Fillmore, Charles (2005), *Valency Issues in FrameNet në Valency, Theoretical, Descriptive and Cognitive Issues*.
4. *Fjalor i Gjuhës Shqipe* (1980), Tiranë.
5. *Gramatika e Gjuhës Shqipe I-II* (2002), Tiranë.
6. Likaj, E. (1970), SF, 1970/4.
7. Ndoja, A. (2011), *Teoria e Valencës dhe aplikimi i saj në gjuhën shqipe*, (punim doktrate), Tiranë.
8. Ndoja, A. (2005), *Diateza në gjuhën shqipe dhe qasja drejt saj nëpërmjet valencës*, Prishtinë.
9. Riza, S. (1994), *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave, Tiranë.
10. Rrota, J. (2006), *Gjuha e Shkrueme ase Vërejtje Gramatikore*, Shkodër.
11. Rrota, J. (2005), *Syntaksi i Shqypes*, Shkodër.
12. Spahiu, A (2002), *Reksioni dhe valenca foljore*, Prishtinë.

Oliver Jens SCHMITT

KOSOVA – MENDIME PËR STUDIMET HISTORIKE

Mbi objektin

Çfarë është historia e Kosovës dhe që kur mund të ekzistojë ajo? Titulli i kumtesës sugjeron qartësi: do të diskutohen gjendja dhe perspektivat e studimeve historike të një shteti evropian. Tashmë është e njohur se ky shtet ekziston që pak më shumë se dy vjet dhe se nuk është njohur nga të gjitha shtetet e Kombeve të Bashkuara. *Shteti* i Kosovës nuk mund të pretendojë pothuaj fare një traditë të gjatë si objekt studimesh. Pastaj do të vlejë vështrimi i një njësie shtetërore, statusi juridik i të cilit gjendet në dorën e një shteti tjetër, mund të mendohet. Pra, fillimet gjenden nën një qëndrueshmëri historike të një konstrukti hapësinor të formuar qartë: por edhe kjo zor se gjendet, kur Kosova me kufij të qartë ekziston qysh prej fundit të Luftës së Dytë Botërore, e krijuar si pjesë e një kategorie territoriale administrative brenda Jugosllavisë së Dytë. Me këtë theksohet një problem elementar i hulumtimeve historike të Kosovës: paqartësitë e mëdha të termit hapësinor. Historianët, së pari, duhet ta bëjnë të qartë se çfarë mendojnë me “Kosovë”: duke pasur parasysh mbipeshën e madhe të studimeve historike të sotme, kjo çështje paraqitet si e lënë pas dore. Nëse dikush nuk do ta reduktojë historinë në 20 ose më së shumti në 60 vjetët e fundit, duhet të merret me çështjen e një kufizimi të qartë të fushës hulumtuese. Kosova deri para pak kohe nuk ishte shtet dhe ajo po ashtu nuk ka fare traditë të mëvetësishme shtetërore; si njësi administrative me kufijtë e sotëm ajo përbëhet afërsisht që 60 vjet. Me kufijtë e sotëm Kosova madje nuk është as edhe një rajon historik. Ajo që vlen për hapësirën dhe kufijtë aktualë, nuk vlen për emrin e saj: stat magni nominis umbra, mund të thuhet me Lukanin, hija e një emri të madh shtrihet mbi shtetin e sotëm. Emri është i lashtë, por jo i stërlashtë. Ai dokumentohet qysh nga periudha e shek. 12. Se çfarë emërtonte ajo shprehje, nuk mund të sqarohet lehtë. Emri *Kosovë* shprehte qysh nga shek. 12 njësi të ndryshme hapësinore: në kuptimin e ngushtë të fjalës *Fushë-Kosova*, pra ana e vendbanimeve perëndimore të shtetit të sotëm, por jo perëndimin e pasur me manastire, të cilin serbët më vonë e quajtën Metohi, kurse shqiptarët Rrafshi i Dukagjinit. Deri më shek. 19, Kosova si shprehje hapësinore mbeti pezull. Ajo shërbente më shumë si

vend kujtuese serbe, sesa si njësi tokësore apo njësi konkrete. Kur osmanët në vitin 1877 krijuan një provincë të madhe me emrin Kosovë, kjo provincë përfshinte edhe pjesë të mëdha të Maqedonisë së sotme. Ajo, pra, kishte të bënte vetëm pjesërisht me shprehjen Kosovë. As administrata serbe mes dy luftërave botërore nuk e përdorte shprehjen Kosovë për ndarje administrative. Kështu, qartësia e shpikur e objektit hulumtues rrëshqet si rërë nëpër gishtat e historianëve. Shumë qartë del rreziku që një kornizë shumë e re hapësinore të mbushet me të kaluarën, e cila historikisht para shek. 20 nuk ka ekzistuar dhe madje as si rajon historik në të ndierit nga banorët serbë dhe shqiptarë. Një mendim perceptues shqiptar mbi Kosovën në kuptim të një ideje rajonale nuk ekziston para gjysmës së dytë të shek. 20. E njëjta vlen edhe për shoqërinë serbe (çdoherë duke mënjanuar kulturën e kujtesës për Kosovën, e cila te vetë serbët e Kosovës, siç duket, nuk ka krijuar ndjenja rajonale të theksuara, së paku jo para vitit 1912).

Mbajtësi i kësaj kumtese qëndronte vetë para pyetjes, se si mund të shkruhej një histori e Kosovës. Ai e ndihmoi veten me një koncept mënjanimi: jo shtet, jo provincë, jo rajon, por krahinë me qëllimin e papërcaktuar që duhej të sqaronte se Kosova nuk mund të paraqesë asnjë njësi të mbyllur vështrimi, por që duhej përfshirë më shumë në kontekst të Ballkanit qendror dhe perëndimor, që arrin nga Shqipëria veriore deri në Serbinë e sotme jugore, nga Sanxhaku i Novi Pazarit deri së paku te rajoni i Shkupit. Kjo nuk duhet kuptuar aspak si konstruktiv i një “Kosove të Madhe”, përkundrazi, kjo bëhet sepse vendet kufitare të Kosovës së sotme paraqitnin lidhje më të ngushta me zonat kufitare fqinje (në hartën e sotme të vendit), sesa me brendinë e Kosovës së sotme; duke pasur parasysh këtu rrugën e karvanëve nga Prizreni për në Shkodër, lidhja nga Mitrovica për në Novi Pazar, nga Kaçaniku për në Shkup, ose lidhjet e Kosovës së sotme lindore me luginën e Preshevës dhe për në Vranjë, Leskovac dhe Nish.

Historia e Kosovës është kështu një tezë e kësaj kumtese për t’u shkruar si histori rajonale e Ballkanit qendror dhe jo si histori e izoluar hapësinore, e cila merr parasysh vetëm Kosovën me kufijtë e sotëm dhe jo si do të tregohet me vonë, si pjesë e një historie kombëtare të pastër serbe apo të pastër shqiptare, duke lënë anash ose minimizuar njërin apo tjetrin.

Gjendja e studimeve: persona dhe forma të veprimitarisë shkencore për Kosovën

Faza (e gjerë) parashkencore e lëvizjes kombëtare

Për të bërë të kuptueshme çështjet kyçe hulumtuese, nevojitet një kontekstualizim politik dhe sociokulturor i zhvillimit të studimeve historike. Veprimtaria shkencore për Kosovën është e re. Nëse e ndajmë shkencën në punime

nga historianë me prejardhje nga Kosova dhe nga intelektualë jashtërajonalë, atëherë duhet marrë ndarja kronologjike, si vijon.

Një veprimtari shkencore brendarajonale shënjohej me lëvizjen kohore të punimeve serbe dhe shqiptare. Në Kosovë vetë institucionet shkencore u krijuan tek pas vitit 1945. Më i vjetër është hulumtimi serb i Kosovës, i cili lidhet ngushtë me lulëzimin e midievistikës serbe, i ndikuar nga Shkolla e Vjenës e Konstantin Jire ek-ut në fund të shek. 19. Në krahasim me këtë, hulumtimi në Shqipëri paraqet një prapambetje prej 70 vjetësh. Institucionet më të mëdha në Republikën Popullore të Shqipërisë u krijuan pas vitit 1945. Ky ndryshim zhvillimi kohor dhe përmbajtjesor mes hulumtimit serb dhe shqiptar në lidhje me Kosovën u zbut ngadalë nga fundi i shek. 20. Për kuptimin e historisë së shkencës kjo është me rëndësi vendimtare. Një hulumtim historik jashtërajonal i Kosovës në kuptimin e ngushtë të fjalës, d.m.th. jashtë Evropës juglindore, ekziston edhe sot vetëm në fillime modeste. Ky kronologjizëm sipërfaqësor, edhe nga aspekti i formave të analizave, do të thellohet në vijim.

Faza e parë e veprimtarisë për Kosovën, e dominuar krejtësisht nga ana serbe, shtrihet afërsisht nga vitet 1880 deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Kjo qëndron nën ogurin e ngjeshjes së kujtesës për Kosovën në mit kombëtar dhe shkëputje e një shkrimi historie romantike nga kritika burimore medieviste. Karshi një numri modest intelektualësh u shfaqën propagandistë kombëtarë, të cilët rezultatet shkencore i përfshinë shpesh të shtrembëruara në planet ekspanduese kombëtare. Më i njohur jashtë Serbisë është publicisti Spiridon Gop evi , i cili financohej nga qeveria serbe. Kulmi i kësaj forme gjysmëshkencore i publicistikës historiko-politike u arrit para dhe gjatë fazës së gjatë të luftës 1912 – 1918. Në anën shqiptare nuk gjendet ndonjë përgjigje e formuluar – Kosova nuk ishte pothuaj fare intelektualisht e përfshirë në lëvizjen kombëtare; madje edhe programi i të ashtuquajturës Lidhja e Prizrenit bazohej mbi mendimet e paramendimtarëve kombëtarë shqiptarë jugorë. Publicistët serbë diktuan rëndë mendimin për Kosovën para viteve 1912/18. Jashtë rajonit gjenden vetëm pak fillime të një veprimtarie historike shkencore për Kosovën: bile edhe albanologjia austro-hungareze koncentrohej te mbrojtja nga kërkesat serbe mbi Shkodrën të argumentuara historikisht dhe shumë vonë kaloi në diskutimet e pyetjes së kufirit lindor të një shteti. Këtu ajo thjesht u kalua nga rrjedhat e kohës.

Në periudhën mes luftërave botërore ndryshimet e zhvillimeve serbe – shqiptare lëvizën shumë pak. Bile, hapat serbë ecën pak më shpejt, sepse në Shqipëri para invazionit italian nuk u krijuan struktura shkencore të qëndrueshme dhe shqiptarët në Kosovë mbetën në një nivel tepër të ulët arsimor për shkak të politikës së qeverisë serbe. Në anën serbe duhen përmendur Shoqëria Intelektuale në Shkup dhe Instituti jetëshkurtër për Histori, Gjuhë dhe Etnologji Shqiptare në Beograd. Pas vitit 1929 në shtetin e riorganizuar qendror jugosllav nuk pati më vend për

hulumtime rajonale mbi Kosovën. Jashtë rajonit interes për Kosovën pati vetëm në Italinë fashiste, por vetëm si pjesë e politikës irredentiste italiane në Ballkan, e cila “Shqipërinë e Madhe“ e përdori si instrument në luftën për pushtet me Jugosllavinë.

Shkencë e ngadaltë, pothuajse krejtësisht nën ogurin e socializmit

Veprimtaria e mirëfilltë shkencore për historinë e Kosovës fillon tek pas vitit 1945; ndryshimet serbe-shqiptare vazhdonin të ndikonin, por në Jugosllavi këto ndryshime qëndronin nën një ogur të ri ideologjik. Hulumtimet deri në shkatërrimin e Jugosllavisë ndiqnin krejtësisht konjunkturën politike, sidomos ato të marrëdhënieve serbo-shqiptare. Një cezurë të qartë përbënin vitet 1948, 1966 – 1974, 1981/’89 dhe 1999.

Në fazën e shkurtër të marrëdhënieve të ngushta të të dyjave qeverive të reja në Jugosllavi dhe në Shqipëri pati shkëmbime nxitëse në fushën e arsimit, por për impulse hulumtuese të mirëfillta mungonin mjetet, stafi personal dhe sidomos koha. Në fazën represionale deri më 1966 shqiptarët ishin të përfshirë në mënyrë shumë modeste në sistemin e arsimit të lartë, studime koherente nuk u zhvilluan fare. Tek pas formimit të ri statutor dhe të shfuqizimit të mendimtarëve partiakë kombëtarë serbë më 1966 erdhi një ndryshim thelbësor: 15 vjetët deri më 1981 mund të kuptohen si fazë e eksperimentit të “Bashkim-Vëllazërimit“ në shkencë; simbolikisht kjo u realizua më 1968 në tubimin e madh shkencor me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar shqiptar – Skënderbeut me pjesëmarrjen aktive të historianëve nga mbarë Jugosllavia dhe të një delegacioni të madh nga Republika Popullore e Shqipërisë. Me vdekjen e Titos dhe rebelimin e vitit 1981 filloi faza e tensioneve ndërkombëtare, të cilat më 1989 në festimin e 600-vjetorit të betejës së Fushë-Kosovës arritën kulmin e tyre. Pastaj, pasoi ndarja e strukturave ekonomike nga politika represive serbe, sidomos nëpërmjet të serbizimit të institucioneve të rëndësishme. Kjo ndarje vazhdon edhe sot.

Shfaqja e shqiptarëve në shkencë

Përsëri në një hap të dytë synohet të thellohet përshkrimi i mësipërm kronologjik. Aty dalin në pah dy tema: shfaqja e shqiptarëve në studimet historike për Kosovën dhe pyetja e karakterit agonues të studimeve. Gjithë Kosova, sidomos pjesa e popullatës shqiptare, pas vitit 1945 përjetoi një proces të thellë modernizimi: një shoqëri paramoderne u la për dekada të pakta në dorë të eksperimentit të ndërtimit të një shoqërie socialiste, çka ndryshoi rrënjësisht shumë fusha (urbanizim, rurbanizim, industrializim, sektorë shëndetësie, transport, komunikim, emigrim pune për në Evropën perëndimore, krijim diasporash etj.). Një levë të mirëfilltë modernizimi përbënte arsimiti, i filluar me fushatë alfabetizimi, i vendosur me shfaqjen e shqiptarëve të Kosovës në fushën e shkencës së një shteti socialist. Siç u tregua më lart, para vitit 1966 këtë hap mundën ta bënin shumë pak shqiptarë

përballë regjimit; edhe ata shteti sidomos shërbimi sekret i priti me mosbesim të madh. Pas vitit 1966 integrimi i shqiptarëve në shoqërinë jugosllave ishte njëri ndër qëllimet kryesore të politikës së qeverisë. Brenda disa vitesh Kosova fitoi një sistem të përsosur shkencor (1971 – shndërrimi i fakulteteve ekzistuese në një universitet në Prishtinë, 1975 – themelimi i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve). Kuadro të reja të talentuara nuk dërgoheshin më për arsimim në Beograd, por jashtë vendit. Universiteti formalisht shpërtheu dhe studentët në numër të madh zgjidhnin lëndë shoqërore. Në fushën institucionale rëndësi i jepej zyrtarisht mendimit të “Vëllazërimit” dhe dygjuhësisë, siç shihet te revistat më të rëndësishme dhe botimet e shumta. Natyrisht, nga ana praktike, dygjuhësia ishte goxha e njëanshme, duke pasur vlerë vetëm për shqiptarët, kurse serbët nuk ishin pothuajse fare të gatshëm të mësonin shqip. Shqiptarët edhe për nga sasia arritën shkallë më të lartë arsimimi. Kështu, u rrit numri si i studentëve, ashtu edhe i profesorëve dhe i studiuesve. Në shikim të parë dukej se eksperimenti socialist për integrim ia kishte dalë mbanë.

Shkenca si luftë kombëtare

Një vështrim rreth përpunimit të studimeve nxjerr në pah se ky përfundim optimist nuk ishte i saktë. Në Jugosllavi, shkencat shoqërore, ndër to edhe historia me “shkencat ndihmëse”, arkeologjinë dhe gjuhësinë, nuk vepronin lirshëm, por në rrethana autoritare. Shkencat shoqërore ishin përfshirë në arsytimin e kërkesave politike, ndaj dhe shkencëtarë të shkencave shoqërore ndjeheshin si avangardistë kombëtarë, si të serbët ashtu edhe të shqiptarët, të cilët në radhë të parë kishin për të mbrojtur interesat e grupit përkatës. Vetëkuptohet që ky përfundim, edhe pse vlen për shumicën, nuk duhet të përgjithësohet për të gjithë intelektualët. Në anën shqiptare shkencat shoqërore ndjeheshin si projekt kombëtar, si përgjigje ndaj sundimit serb në politikë dhe shkencë. Për mëkëmbjen e një shkence kosovare shqiptare mungonte baza elementare, për çka Jugosllavia lejoi marrëdhënie të ngushta me Republikën Popullore të Shqipërisë mu në kohën kur Shqipëria po hynte në revolucionin kulturor të importuar nga Kina, që shquhej për ateizmin militant dhe për një nacionalizëm jashtëzakonisht të madh. Shqiptarët e Kosovës morën shabllone mendimesh nga Tirana pak a shumë të parishikuara. Ata e shihnin si detyrë të tyre ruajtjen e një ndërvarjeje të përgjithshme kombëtare shqiptare në histori dhe gjuhë (marrja e gjuhës së njësuar letrare shqiptare është shenjë e qartë për këtë tendencë) dhe jo formulim të mendimeve alternative historike. Përvoja e represionit me dekada të tëra nga ana e institucioneve zyrtare serbe dhe importi i nacionalizmit shqiptar nga Republika Popullore e Shqipërisë çuan deri te një lidhje, trashëgimia e së cilës po vazhdon edhe sot. Kështu, u rimor edhe izolimi vetjak i shkencës shqiptare nga Shqipëria. Marrëdhëniet me Beogradin u zbehën, por nuk u kompensua sa duhej me kontakte të reja jashtë vendit. Përjashto raste shumë të rralla, studimet shqiptare në Kosovë i karakterizonte provincializmi. Mjaftonte fakti

që shkencëtarët si bartës të afirmimit kombëtar gëzonin nam të madh dhe nuk kishin nevojë për një njohje ndërkombëtare. Shkenca ishte pjesë e luftës kombëtare dhe historianë të shumtë vepronin në front. Për shek. 19 dhe 20 më shumë formohej tipi i specialistit publicist sesa shkencëtar. Në kohën para vitit 1966 shkencëtarët i ishin më besnikë shtetit (si p. sh. osmanisti Hasan Kaleshi), kurse më vonë peshonte më shumë shkenca e orientuar në politikë. Përjashtim përbëjnë osmanistët, fusha e të cilëve kishte kërkesa më të larta dhe përgatitje më të shëndoshë filologjike. Shkencëtarët serbë në Kosovë në vitet e 70-ta marginalizoheshin tendencialisht. Pikërisht e studimeve serbe mbi Kosovën gjendej qartë në Beograd. Ato pasqyronin në thelb qëndrimin e ndryshuar të shoqërisë serbe në lidhje me çështjen e Kosovës: emocionalizimit të shtuar dhe intrumentalizimit i iknin në vitet e 80-ta shumë pak shkencëtarë.

Një ofensivë e vërtetë shkencore vërehet tek në mes të viteve të 80-ta. Për t'u përmendur është cikli i kumtesave "Ilirët dhe shqiptarët" në Beograd, ku ishin aktivë shkencëtarë me emër. Publikime të shumta ishin ideologjikisht heterogjene: afër kumtesave solide nga medievistët të dëbuar, si Sima Cirkovi ose Božidar Ferjan i ose nga osmanistja Olga Zirojevi, gjenden edhe kumtesa me një ton pak agresiv, i cili shënjon gjendjen e kohës së ngritjes së S. Miloševi-it. Hyrja në politikën apartheide të viteve të 90-ta, në konfliktin e armatosur dhe dëbimi masiv karakterizojnë prishjen e marrëdhënieve mes shqiptarëve dhe serbëve, të cilat edhe më përpara ishin tepër sipërfaqësore: në mes të viteve të 90-ta Universiteti i Prishtinës ishte serbizuar krejtësisht, shkenca shqiptare e shkëputur nga resurset u kthye mbrapsht në funksionin e manifestimit kombëtar; institucionet shkencore të Beogradit hynë me shumicë në shërbim të propagandës shtetërore – shkenca e mirëfilltë ishte ndrydhur nga agjitacioni i ojnatitur me shkencë. Në anën serbe bie në sy se me tërheqjen e gjeneratës, e cila karrierat e saj i kishte bërë në vitet e 60-ta dhe të 70-ta shpesh pas studimeve të gjata të kryera jashtë vendit, kishte ardhur një gjeneratë e re shkencëtarësh, të cilën e karakterizonte tashmë provincialiteti dhe niveli i ulët shkencor, që asokohe ishin shenja të izolimit të Serbisë në një periudhë 20-vjeçare zhvillimi në gjendje lufte e krize.

Mysafirët e paftuar: shkencëtarë jashtërajonalë dhe Kosova

Interesi jashtërajonal për Kosovën deri në mes të viteve të 90-ta nuk ndryshoi pothuajse fare. Iniciativa të rralla vinin nga diaspora shqiptaro-amerikane. Nga ana tjetër, Kosova trajtohej nga politologë të Institutit Juglindor, sidomos nëpërmjet raportimeve të tyre, por tek-tuk edhe nga ndonjë sociolog, si francezi Michel Roux. Shumë punime historike prezantoi historiani i Shqipërisë nga Munihu, Peter Bartl. Vëmendje të përkohshme tërhoqi shkoqitja e mitit të Kosovës mes historianëve dhe sllavistëve, por më pak zhvillimi historik dhe shoqëror i këtij rajoni (Frank Kämpfer); për historinë serbe në mesjetë (Konstantin Jireček, Alois Schmaus); tek-

tuk studime osmane (Hans-Jürgen Kornrumpf) paraqesin përjashtime në këtë kontekst. Por nuk mund të flitet për një shkoqitje sistematike për Kosovën jashtë rajonit. Studimet perëndimore mbi Kosovën janë rezultat ose reagim ndaj krizës së viteve të 90-ta, por jo shprehje e një interesi të gjatë dhe të mirëfilltë ndaj kësaj pjese ballkanike.

Kur filloi interesimi, nuk ishin shkencat historike, por të tjera, shkencat aktuale, të cilat analizonin Kosovën madje vetëm nën prizmin e analizës dhe kapërcimit të krizës.

Lufta prej vitit 1998 deri më 1999 dhe administrata e mëpastajme e Kombeve të Bashkuara sollli më vete një numër ta lartë analizash shkencore politike, madje të bëra edhe nga shumë shkencëtarë pa njohuri të thella për rajonin dhe gjuhët. Shumica (por jo të gjithë) merrnin si parahistori të konfliktit analiza të së kaluarës historike të Kosovës: për t'u përmendur janë këtu sidomos botimet përmbledhëse e të vëllimshme të studiuesve, si: Konrad Clewing dhe Jens Reuter dhe Karl Kaser – Robert Pichler – Wolfgang Petritsch, më vonë vëllimthi i rëndësishëm dhe praktik nga Agilolf Kesselring – Bernhard Chiari.

Në mënyrë monopole për kohë të gjatë mbizotëroi monografia *Historia e Kosovës* e Noel Malcolm-it, e përkthyer në shumë gjuhë. Bie në sy se historianët nuk merren pothuajse fare me të, duke mos e bërë as pjesë të motorëve të shkencës, as pjesë të doktoratave apo pjesë të habilitimit. Për t'u theksuar është se punimet më interesante aktuale nuk u shkruan nga ndonjë historian, por nga antropologia Stephanie Schwandner Sievers, herën e fundit në bashkëpunim me Isabel Ströhle-n. Në vitet e fundit, për periudhën e shek. 19 gjendja është përmirësuar dukshëm sidomos falë punimeve të Konrad Clewing-ut dhe Nathalie Clayer-it. Njohuri të thelluara premtojnë librat në përgatitje e sipër të Eva Frantz-it dhe Krisztián Csaplár-Degovics-it.

Arsyet për gjendjen e gjatë jo të mirë në shkencën e historisë jashtërajonale janë: pengesat gjuhësore, rrjetëzimi tepër i dobët i shkencëtarëve përkatës, mbipesha e historisë së re aktuale – ai që posedonte kompetencë gjuhësore vepronte në këtë fushë tematike – dhe së fundi edhe mosdrejtimi nga katedrat përkatëse.

Tematika dhe përmbajtja

Pas kësaj paraqitjeje për institucionet dhe strukturat shkencore pason një shikim mbi përmbajtjet kryesore, i cili do të jetë më i shkurtër, sepse disa tematika tashmë u përmendën më lart. Pyetja e shtruar në fillim për kuptimin e të shkruarit të një historie të Kosovës mund të mprehet edhe më: është punuar në një histori të Kosovës, apo donin historianët shqiptarë dhe serbë ta kuptojnë Kosovën si element integruar të një historie të pandarë kombëtare?

Nëse analizohen pikat themelore të interpretimit shqiptar dhe serb, dalin shumë pika të përbashkëta strukturore dhe tematike, por edhe dallime diametralike në vlerësim.

2.6.1. Pikat themelore të shkencës serbe janë: mbretëria serbe, kultura kishtare dhe sidomos e manastireve, historia ekonomike dhe tregtare, beteja e parë në Fushë-Kosovë, kryengritjet serbe, sidomos kryengritja e vitit 1689, imigrimi i madh, emigrimi shqiptar: d.m.th. në përgjithësi histori demografike, në kohën e socializmit: Lufta e Dytë Botërore, lufta partizane. Proporcionalisht dobët dalin në pah këto epoka: antika parasllave dhe koha osmane (me përjashtim të O. Zirojevi -it).

2.6.2. Pasqyra e kundërt shqiptare bazohet në mendimet e historisë nga Republika Popullore e Shqipërisë, që mbështetet në katër shtylla: te vazhdimësia iliro-shqiptare, te mesjeta me theksim të shtetësisë shqiptare dhe të Skënderbeut, Lëvizja Kombëtare në shek. 19 dhe në fillim të shek. 20, si dhe te Lufta e Dytë Botërore. Në krahasim ndriçohet zbehtë koha osmane; por duhet theksuar se për shkak të traditës së fortë islame arsimore Kosova nxori në kontekstin shkencor shqiptar një numër të madh osmanistësh (S. Riza, M. Tërnavë etj.), por prej tyre vetëm njëri, Hasan Kaleshi, botonte rregullisht punime në organe publikimesh ndërkombëtare.

2.6.3. Nëse ballafaqohen të dyja tërësitë e temave, kuptohet se kemi të bëjmë me interpretime historike simetrike: historiografia serbe i diktonte temat. Historianët shqiptarë ndërtuan një mendim historik, në njërin anë, të importuar nga Tirana dhe, në anën tjetër, të zhvilluar nga konflikti me mendimin serb për Kosovën: kjo bëhet e qartë sidomos me interpretimet kontroverse të kryengritjes së vitit 1689, por në përgjithësi te historia e popullsisë, temë kjo kryesore e studimeve serbe dhe shqiptare për Kosovën.

2.6.4. Që më shumë se një shekull shkencat historike shërbejnë në Kosovë dhe për Kosovën si instrumente politike, që justifikojnë kërkesa territoriale. Në këtë konkurrencë shtrohet dilema e banorëve nëse kjo do të interpretohet çdoherë etnikisht. Historiografitë rivalizuese kanë bërë investime të mëdha në hulumtimin e historisë së ngulimeve: për këtë hyri në përdorim një spektër i gjerë metodash. Arkeologjia, gjuhësia (sidomos hulumtimi i toponimeve dhe antroponimeve, po ashtu edhe hulumtimi sidomos i zhvillimit historik të gjuhës), historia, veçanërisht për mesjetën dhe kohën e re të hershme nëpërmjet përpunimit të dokumenteve mbretërore serbe dhe të defterëve osmanë. U luftua intensivisht për numra popullsie, të cilët duhej të mbështesnin kërkesat përkatëse. Një luftë e vërtetë statistikore – e cila nuk është aspak specifike për Kosovën – u zhvillua dhe zhvillohet akoma, pa marrë parasysh vështirësitë rreth bazave të burimeve historike. Histori popullsie është edhe filli i interpretimit historik deri në të kaluarën e afërt: faza e konfliktit të vërtetë etno-kombëtar, e cila u krijua me krizën e madhe orientale, perceptohet nga të dyja palët si epokë e trysni e ngulitjeve politike deri te dëbimi masiv, që rezulton

edhe me përdorim të termave tepër problematikë dhe emocionalizes, si: “gjenocid”, që del në memorandumun e akademisë serbe. Nuk është fare e tepruar, nëse historinë e popullsisë do ta quanim si disiplinë themelore të hulumtimit rajonal, për realizimin e së cilës punojnë shumë drejtime shkencore.

2.6.5. Një karakter pak të ideologjizuar – së paku pjesërisht – tregojnë punimet mbi mesjetën dhe kohën e re të hershme. Gjendja shkencore këtu është jo e barabartë. Sundimi serb dhe kultura në Kosovën mesjetare prej fundit të shek. 19 janë të hulumtuara shumë mirë; kjo vlen edhe për historinë ekonomike, në fillime edhe për arkeologjinë mesjetare (si për Novo Brdo-n). Për fazën e gjatë të sundimit osman kemi studime sociale dhe ekonomike historike në stilin e osmanistikës ndërkombëtare (Pulaha, Tërnavë, Rizaj, Zirojevi) dhe një punim solid për Patriarkatin e Pejës (Zirojevi). Fort mirë e njohur është shoqëria e vogël katolike nga aktet e botuara të Vatikanit. Më shumë nga ana gjuhësore se sa nga ana historike janë hulumtuar deri tash shkrimet e klerikut shqiptar katolik, sidomos figura simbolike e Pjetër Bogdanit.

2.6.6. Paralelisht si përsëritje të të thënave më sipër, në përfundim mund të përmendet vlera mbirajonale e Lëvizjes Kombëtare serbe dhe sidomos e asaj shqiptare, por edhe përplasia e dy grupeve etno-kombëtare, që konceptohet si politike-historike dhe realizohet si tepër faktografike.

Në përgjithësi mund të përmbliidhen këto pika: shkenca e brendshme kosovare, e zbatuar nga historianë shqiptarë dhe serbë, është e orientuar fort te kategoritë hulumtuese të qendrave shkencore të Beogradit, përkatësisht të Tiranës. Tendencë rajonale apo historike rajonale mungojnë pothuajse fare. Shkenca është politizuar rëndë dhe kufijtë mes shkencave historike dhe publicistikës janë shpesh të lëvizshëm. Lidhja me shkencën ndërkombëtare është në përgjithësi e zbehtë dhe manifestohet me mungesë botimesh përkatëse nga shkencëtarë kosovarë të të dyja gjuhëve dhe me prani të dobët në konferenca jashtërajonale.

3. Më së voni tani fillon diskutimi i deziteratave, të cilat u lajmëruan në titullin e kësaj kumtese, sepse më shumë diskutohen boshllëqe shkencore sesa rezultatet e pakta shkencore. Këto janë, për ta thënë që në fillim, të shumta, madje lista e tyre është më e gjatë se fushat e hulumtuara. Kristalizohen këto fusha kryesore:

- antika e vonë dhe mesjeta e hershme, d.m.th. shndërrimi i Dardanisë në një rajon të karakterizuar nga popullimi sllav;
- gjithë faza e sundimit osman;
- historia sociale dhe ekonomike mes dy luftërave botërore;
- Kosova në socializmin jugosllav deri më 1989.

3.1. Në veçanti kemi të bëjmë me këto problematika: mesjeta e hershme u takon fushave tematike më të diskutuara, sepse këtu përplaset teza shqiptare e

kontinuitetit të pandërprerë e popullimit me faktin e emigrimit të sllavëve. Ky kompleks temash mund të kalohet vetëm me bashkëpunimin mes gjuhëtarëve, arkeologëve dhe historianëve. Para pak kohe u botua vëllimi i parë i atlasit arkeologjik të Kosovës. Gërmime tjera sistematike premtojnë njohuri të thellësishme të transformimit në fillim të mesjetës. Për ta kuptuar këtë më mirë, nevojitet një hulumtim i tërësishëm i toponimeve, dhe atë të emrave të vendeve dhe të mikrotoponimeve. Ato mund të sjellin njoftime mbi historinë dhe sjelljen e popullimit të serbishtfolësve dhe shqipfolësve. Siç tregojnë studimet e Lumnije Jusufit për shqipfolësit në Maqedoni, studime të thelluara dialektologjike për shqipen mund të ndriqojnë strukturën komplekse të popullimit, si p. sh. koekzistenca e toskërishtes dhe gegërishtes në mikrorajone.

3.2. Njohuritë tona për kohën osmane para vitit 1875 janë me boshllëqe. Këtu shtrohet pyetja për fondin e ruajtur pas shkatërrimit masiv të materialit arkivor nga trupat e larguara dhe paramilitarët serbë në vitin 1999. Për kohën e hershme osmane do të ishte për t'u nxitur një rishqyrtim i edicionit të defterëve prej vitit 1485 nga S. Pulaha, e cila paraqet bazën për hulumtime historike të popullsisë në Kosovën e hershme osmane. Për t'u sqaruar mbetet se cilat fonde gjenden në Arkivin e Stambollit. Osmanisti turk, M. Hacısalıhoğlu, para disa vjetësh ka theksuar se duhet bërë një pasqyrë nga fondet më të rëndësishme burimore, p. sh. regjistrat e kadilerëve. Osmanistë shqiptarë nga Kosova kanë botuar tek-tuk akte gjyqi, të cilat ofrojnë të dhëna me vlerë për historinë sociale dhe historinë e mentaliteteve. Këtu duhet patjetër të merren në dorë hulumtime sistematike. Po ashtu mungon një kuptim i gjerë për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Kosovës si pjesë e Ballkanit qendror osman. Por kjo do të mbetet njëherë hëpërhë vetëm një dëshirë, sepse numri i osmanistëve shqiptarë është dukshëm i vogël.

Por nuk mund të theksohet sa duhet, se periudha osmane duhet të përbëjë objektin kryesor të një studimi të thelluar të Kosovës. Si plotësim për burimet osmane dalin qartë materialet e arkivave italiane dhe austriake, deri më tash të analizuar më mirë se të parat; por këto në radhë të parë kanë vetëm karakter plotësues, sepse ato merren me pjesë shumë të vogla, në fillim shoqërinë katolike, pastaj ngjarjet luftarake.

3.3. Probleme kyçe të historisë kulturore dhe sociale gëzojnë më pak vëmendje shkencore, siç pati konflikti etno-kombëtar dhe përplasjet pas vitit 1878 nga historianë shqiptarë dhe serbë. Padyshim duhet theksuar se edhe tema klasike gjoja të hulumtuara mirë, si Lëvizja Kombëtare etj. vuajnë nga premisa të ngushta ideologjike dhe se materiale burimore presin akoma për t'u analizuar, p. sh. arkivat e Vjenës (*Hausarchiv*, *Hofarchiv* dhe *Staatsarchiv*). Megjithatë duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike të Kosovës mes vitit 1880 dhe Luftës së Dytë Botërore. V. Jovanovi -i ka shkruar një monografi për administratën serbe mes dy luftërave botërore. E mirëpritur do të ishte edhe një

analizë e detajuar mbi kolonitë serbe dhe bashkëjetesën e ngjeshur të kolonistëve serbë, serbëve vendas dhe shqiptarëve; ose studime mbi përbërjen e tërësisë së nëpunësve shtetërorë serbë; mbi ndryshimet (e pakta) infrastruktorore; mbi historinë sociale të grupeve kryengritëse; mbi manifestimet e identiteteve fetare dhe etnike sidomos nëpër fshatra. Me rëndësi të veçantë do të ishte edhe analizimi i akteve administrative për çështje sociale dhe ekonomike historike, për të cilat do të flitet më hollësisht në vijim.

3.4. Kush e kupton historinë si mënyrë për të kuptuar më mirë të tashmen, duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi historisë së Jugosllavisë së dytë. Koha mes vitit 1945 dhe 1989 qëndron nën hijen e hulumtimeve të historisë aktuale të viteve pas 1989/'90. Kosova në këtë kontekst ballkanik nuk paraqet ndonjë rast të veçantë: te shumica e shteteve të këtij rajoni shkenca koncentrohet në hulumtimet e një ose dy dekadave të regjimeve komuniste, për të cilat në shumë shtete mbisundon një konsensus themelor i vlerësimeve (p. sh. në Rumani) – ose janë tepër të diskutueshme brenda vështrimeve historike, të cilat konkurrojnë me njëra-tjetrën dhe posedojnë udhëheqje ideologjike (p. sh. në Kroaci). Faza e konsolidimit të viteve 60-ta dhe 70-ta është relativisht më me pak interes; nëse po, atëherë bëhet histori politike. Në rastin e Kosovës historianët janë koncentruar në luftërat mes shqiptarëve dhe Jugosllavisë komuniste në zhvillim, si dhe në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të viteve 1945 – 1948, të cilat janë vlerësuar në mënyrë kontroverze. Është analizuar edhe fusha e arsimit si objekt klasik i hulumtimeve historike kombëtare. Por nuk është punuar pothuaj fare për atë proces, i cili në Kosovë vuri në lëvizje një revolucion socio-kulturor të mirëfilltë, “eksperimentin socialist” të llojit jugosllav. Dimë shumë pak për industrializimin, urbanizimin, migrimet nga vendet rurale, ndryshimet e roleve gjinore, ndryshimet e ambientit jetësor, të kulturës materiale, të botërave të medie, të sportit – kjo listë mund të zgjatet shumë. Shoqëria, ekonomia dhe jeta e përditshme kanë ndryshuar rrënjësisht dhe kërkojnë urgjentisht studime historike. Por edhe zhvillimi politik është i njohur vetëm pjesë-pjesë; shumë gjëra botohen në gazeta dhe jo në revista shkencore: nuk ekziston ndonjë histori e Lidhjes Komuniste në Kosovë; asnjë analizë e zhvillimit të njësiteve partiake dhe integrimi i tyre brenda strukturave partiake mbarëjugosllave, asnjë studim i bisedimeve të komunistëve kosovarë me Titon për përmirësimin e statusit të Kosovës, asnjë studim për diskutimet interne partiake për modernizimin e ekonomisë dhe të shoqërisë; do të ishte mirë të dihej edhe për përpjekjet e krijimit të një kombi të veçantë shqiptar në Kosovë, i cili duhej të ndahej nga shqiptarët e Shqipërisë (Rexhep Ismajli ka vënë baza solide në lidhje me hulumtimin e diskutimeve politike gjuhësore). Krahasimet me krijimet kombëtare të maqedonëve dhe myslimanëve boshnjakë, për çka politika e Jugosllavisë socialiste që e suksesshme, do të ishin shumë frytdhënëse. Kosova në Jugosllavinë e Dytë është boshllëku më me peshë dhe më urgjent. Këtu vetëm mund të theksohet se hulumtime

të tilla dhe studime të paramodernes mund të realizohen vetëm në kuadër rajonal, në këtë rast në kuadër mbarëjugosllav, por në asnjë mënyrë si histori e izoluar kombëtare apo shtetërore. Po ashtu si me rastin e paramodernes studimet duhet të përfshijnë mbarë shoqërinë e Kosovës dhe jo vetëm një komunitet kombëtar.

3.5. Dëshirat nuk janë vetëm kohore, por edhe metodike. Edhe këtu boshllëqet vetëm mund të renditen, se numri i tyre është tepër i madh. Ato lidhen ngushtë në radhë të parë me përhapjen e interesave për çështje të reja kohore të historisë kulturore dhe sociale, siç u tha më lart, por nuk duhet lënë pas dore edhe historinë politike deri më tash të privilegjuar. Edhe pse flitet dhe shkruhet kaq shumë për shtetin, shtetësia mbetet pa dyshim ideal politik. Çfarë nënkuptonte vërtet shteti ose, më mirë, sundimi në Kosovë, sa afër apo larg sundimit ishte shoqëria kosovare, nuk është studiuar deri më tash. Këtu mund të shtrohet teza, se largesa ndaj sundimit karakterizon deri më sot pjesë të shumta të shoqërisë, se glorifikimi i shtetit dhe i pavarësisë në diskutet politike me sjelljen praktike me shtetin nuk përputhen në asnjë pikë; ato bile paraqesin pothuajse botë krejt të ndara nga njëra-tjetra.

Çështje kyçe të historisë juglindore, si ndryshimet e mëdha socio-kulturore mes qytetit dhe fshatit, mes fushës dhe botës malore kanë pasur fare pak vëmendjen e shkencës – e këto tema në Kosovë mund të hulumtohen në mënyrë ideale, nëse kujtojmë, se deri në shek. 20 vetëm Prizreni posedonte karakter të mirëfilltë qytetar dhe se Malësia në përfundim të Kosovës – në kalimin për në Shqipërinë veriore dhe qendrore dhe për në Mal të Zi – është rajoni klasik për hulumtime të shoqërisë patriarkale në Ballkan; se emigrimi i shqiptarëve dhe i sllavëve të jugut nga malësia u takojnë konstanteve kryesore të historisë së Kosovës dhe blegtoria tranzumane përbënte njërën ndër shtyllat kryesore të ekonomisë, aq e fortë në shek. 16. Kundërshtitë e mentalitetit mes qytetit dhe fshatit vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot, siç tregojnë studimet antropologjike, p.sh. të Stephanie Schwandner-Sievers-it. Edhe historia e feve lë për të dëshiruar: këtu komunitetet e krishtera, ortodoksët dhe katolikët, janë më të studiuar se komuniteti mysliman – roli i të cilit për identitetin kosovar aktualisht diskutohet në mënyrë kontraverse. Studime të tilla do të konturorin më fort rolin e myslimanëve kosovarë në shoqërinë osmane.

Një fushë e rëndësishme, e cila mund të skicojë më fort kuptimin e një shoqërie paramoderne, është historia e ambientit jetësor dhe e klimës; kështu p. sh. përshtatja ekonomike, por edhe politike ndaj stinëve të vitit (prej kalendarit bujqësor nëpër tranzumancën deri te kalendari i fushatave).

Deri më sot nga historianët nuk janë bërë as studime historike për ndryshimet gjinore. Akoma mbisundon forma hulumtuese me makroperspektiva: në kundërshti me këtë mungojnë studime për qytetet, fshatrat, rajone të vogla të veçanta – çdoherë duke përjashtuar publikimet me karakter lokal pa kërkesa të rrepta shkencore. Studimet këtu ngelin shpesh në suaza të vështrimeve të përgjithshme për mbarë rajonin; përjashtim bëjnë edicionet e komentuara të dokumenteve dhe të akteve

mesjetare, përkatësisht osmane. Punime të përqendruara në persona mungojnë pothuaj fare, me përjashtim të figurave të pakta të vështruara si “trima” të Lëvizjes Kombëtare, por edhe këto nuk mund të rimerren pa kritikë. Çfarë mungon më shumë, janë punimet mbi botëkuptimet në Jugosllavinë socialiste. Do të përmend këtu disa tema të mundshme:

Historia e sektorit shëndetësor. Pas vitit 1945 në Kosovë u krijua për herë të parë një rrjet shëndetësor me spitale dhe ambulanca të vogla. U realizuan fushata vaksinimesh; epidemitë dhe sëmundjet ngjitëse (si p.sh. tuberkulozi) u reduktuan dukshëm. Mund të flitet për një revolucion shëndetësor. Por si u realizua kjo? Cilët ishin mjekët dhe infermierët, të cilët shkonin nëpër katunde dhe vaksinonin njerëzit – një veprim që në vendet e tjera evropiane nga popullata u prit gjatë me mosbesim dhe rezistencë? Kishin mjekët – si në pjesë të tjera të Evropës – një vetëdije të veçantë si modernizues të shoqërisë? Si funksiononin ambulancat në zonat rurale? Si ndryshoi higjiena, gjetja e ilaçeve dhe sjellja me trupin (p. sh. me ardhjen e sportit)? Gjithë këto pyetje duhet të bëhen çdoherë në krahasim me shoqëritë e tjera evropiane, të cilat kanë pasur zhvillime të ngjashme. Këtu ofrohet *oral history* si metodë, ngaqë shumë dëshmitarë kohe janë akoma në jetë.

Po ashtu me rëndësi është ajo që mund ta quanim revolucion komunikacioni, p. sh. historia e telefonit. Nëse në vitin 1970 përdorehin 50 telefona nga 10.000 persona, sot përdorimi i celularëve është rregull. Kosova sot bën pjesë në mesin e shfrytëzuesve më intensiv të internetit – në vitin 1945 shumica e popullatës ishte analfabete. Zhvillimi i këtyre ndryshimeve mund të studiohej po ashtu me *oral history*, pasi kemi të bëjmë me përvojë themelore: në vitin 1970 shumica e fshatrave nuk kishte instalime të rrjeteve të mëdha të komunikacionit. Sot qytetarët me anë të rrjetit celular dhe internetit janë në gjendje të kenë vërshim informacionesh për botën e jashtme.

Integrimi në rrjete më të mëdha komunikacioni pasoi edhe nëpërmjet zgjerimit të sferës rrugore: në vitin 1970 ishin dy të tretat e rrugëve të paasfaltuara; shumë fshatra izoloheshin krejtësisht kur bënte moti i keq – por në krahasim me vitin 1945 ky ishte një përparim madhështor. Nëse krahasohet gjendja e vitit 1950 me atë të vitit 2000, ndjehet dukshëm edhe këtu një ndryshim, të cilin shumica e banorëve të Kosovës e njohin nga përvoja personale, por që ende nuk është reflektuar shkencërisht. Si shembull më i ri për t’u përmendur është autostrada Tiranë – Prishtinë, e cila për herë të parë lidh Adriatikun me Kosovën – edhe kjo mund të quhet revolucion komunikacioni.

Pothuaj i pahulumtuar është tërë industrializimi i Kosovës – këtu ofrohet hulumentimi i historisë së kombineve të veçanta dhe ndikimi i ritmit të ri punues ndaj shoqërisë. Socializmi i vetëqeverisur është i njohur vetëm në teori; mënyra e të funksionuarit (ose e të jofunksionuarit) duhet hulumentuar më thellësisht, sidomos duke u krahasuar me rajonet e Jugosllavisë së hershme. Në këtë kontekst duhen

përmendur edhe tema të historisë sociale, si zhvillimi i klasës punëtore, por edhe elita e re udhëheqëse në ekonomi – edhe këtu si burime me rëndësi janë aktet dhe intervistat.

Ngushtë me industrializimin lidhet urbanizimi, i cili në Kosovë pas vitit 1945 mori një dimension të ri. Më mbresëlënëse është rritja ekstreme e Prishtinës, e cila vazhdon akoma dhe sa vjen e më shumë shpie kah ngjashmëria e Kosovës me shtetet në të cilat një pjesë e mirë e popullsisë jeton nëpër kryeqytete (si në Greqi, Shqipëri, Maqedoni dhe Bullgari). Rritja e shpejtë qytetare nënkupton edhe urbanizimin e mentaliteteve të të ardhurve, një fenomen që është i njohur edhe në shtete të tjera juglindore.

Me siguri që lista mund të zgjatet. Por kush formulon boshllëqe shkencore, duhet t'i përgjigjet edhe pyetjes, se a mund të plotësohen këto dëshira. Këtu përgjigja mund të jepet vetëm e diferencuar. Se mund të ndryshojë shpejt gjendja e shkencave osmaniste, nuk është e besueshme. Në këtë pikë duhet të ndikohet qëllimisht me anë të arsimit të osmanistëve në universitete të huaja ose me anë të krijimit të një grupi punues nga osmanistë jashtërajonalë, të cilët do të hulumtonin Kosovën osmane nga shek. 15 deri më shek. 19. Ndryshe qëndron puna me çështjet aktuale: këto mund të kalohen me pak mjete shkencore themelore. Historia e Kosovës në Jugosllavinë e dytë mund të mbështetet nga arkivat, por edhe me metoda të *oral histori-së*. Në lidhje me kujtesën e kohës së Titos hulumtime pioniere kanë bërë S. Schwandner-Sievers dhe Isabel Ströhle. Historianët për studime të ndryshimeve socio-ekonomike gjatë komunizmit jugosllav mund të përdorin studime përkatëse për shoqëritë e tjera komuniste. Për t'i përkrahur këto tema, duhen sensibilizuar mësimdhënësit universitarë në Kosovë që të jenë të gati t'u ikin kategorive interpretuese të librave shkollorë dhe mësimdhënësit që t'i përmbysin kanonet e temave nga Shqipëria e Enver Hoxhës. A do të jetë kjo e mundur në një fazë të konsolidimit shtetëror dhe debateve intensive për identitetin në vendet shqipfolëse, mbetet të pritët. Nxitje nga jashtë mund të vijjë vetëm me kusht. Krijimi i vetëdijes të shkencëtarët e rinj këtu duhet bërë vetë, ndërsa historianët jashtërajonalë mund t'i kenë vetëm si bashkëbisedues.

Kush e kalon listën e boshllëqeve shkencore, do të konstatojë se tema, si: kombi, identiteti, gjuha dhe konflikti nuk mbizotërojnë. Dhe kjo jo vetëm se ato janë pa vlerë ose të hulumtuara mirë, por edhe se mbajtësi i kësaj kumtese do t'i injorojë konfliktet. Por çfarë duan të nxjerrin në pah këto shtjellime, është fakti se historia e Kosovës deri më sot gjendet vetëm në ngushticat e ngarkuara me politikë dhe konflikte, që çon deri aty, sa që pothuaj të gjithë fenomenet historike lexohen dhe shkruhen vetëm në prizmin e përplasjes së dy kombeve, gjë që ndjehet si proces teleologjik. Ky interpretim i shkurtuar, i gabuar dhe i rrezikshëm, duke pasur parasysh *longue durée*, duhet ndërprerë; duhet përfshirë fusha të gjera të jetës njerëzore në të kaluarën, shabllonet e perceptimit kombëtar duhet ngushtuar në favor

të kornizave shkencore rajonale, për t'i dhënë historisë të drejtën vetjake si shkencë dhe jo si shërbëtore e politikës. Në këtë kontekst Kosova nuk bën ndonjë përjashtim në Ballkan. Mbetet për të shpresuar se tani, ngaqë Kosova ka arritur pavarësinë e saj, do të hapet një kapitull i ri dhe shkencëtarët do të nisen në drejtim të horizonteve tematike, që u skicuan këtu.

Bibliografia

1. Bartl, P. (1968), *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878 - 1912)*, München.
2. Bartl, P. (1977), *Die Këlmendi: zur Geschichte eines nordalbanischen Bergstammes, Shêjzat (Le Pleiadi)*, f. 123-138.
3. Bartl, P. (1984), *Kosova and Macedonia as Reflected in Ecclesiastical Reports*, In: A. Pipa - S. Repishti (Hrsg.), *Studies on Kosova*, New York, f. 23-39.
4. Bartl, P. (1988), *Die Liga von Prizren im Lichte vatikanischer Akten (Archiv der Propagandakongregation), Südostforschungen 47*, f. 145-186.
5. Baxhaku, F. – Kaser, K. (1996), *Die Stammesgesellschaften Nordalbaniens. Berichte und Forschungen österreichischer Konsuln und Gelehrter (1861- 1917)*, Wien-Köln-Weimar.
6. Baxhaku, F. (1994), *Die Bevölkerungsstruktur der ethnischen Grenzzone von Albanern, Serben und makedonischen Slawen (zweite Hälfte des 19. bis Anfang des 20. Jahrhunderts)*, *Österreichische Osthefte 36*, f. 245-264.
7. Bieber, F. (2005), *Nationalismus in Serbien vom Tode Titos bis zum Ende der Ära Milošević*, Wien.
8. Biermann, R. (2006), *Lehrjahre im Kosovo. Das Scheitern der internationalen Krisenprävention vor Kriegsausbruch*, Paderborn – München – Wien – Zürich, (grundlegend für die Diplomatiegeschichte vor allem von 1992 bis 1998).
9. Bougarel, X. – Clayer, N. (Hrsg.) (2001), *Le nouvel Islam balkanique*. Paris.
10. Braun, M. (1937), *Kosovo. Die Schlacht auf dem Amselfelde in geschichtlicher und epischer Überlieferung*, Leipzig.
11. Cana, Z. (1982), *Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908 – 1912*, Tiranë.
12. Cana, Z. (2006), *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare 1909 – 1913*, Prishtinë.
13. Chiari, B. – Kesselring, A. (Hrsg.) (2006), *Kosovo*, Paderborn.
14. Clayer, N. (2002), *Le Kosovo: berceau du nationalisme albanais au XIXe siècle?*, në: N. Clayer., *Religion et nation chez les Albanais, XIXe- XXe siècles*. Istanbul o.J. f. 197 – 220.

15. Clayer, N. (2007), *Aux origines du nationalisme albanais. La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Paris, (shqip: *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar – Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*, Tiranë, shqipëruar nga Artan Puto).
16. Clewing, K. – Reuter, J. (Hrsg.) (2003), *Der Kosovo – Konflikt*, München.
17. Clewing, K. (2005), *An den Grenzen der Geschichtswissenschaft: Albaner, Thraker und Illyrer*, në: M. Genesin – J. Matzinger (ed.), *Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler*, Hamburg, f. 215-225.
18. Clewing, K. (2006), *Religion und Nation bei den Albanern. Von Anspruch und Wirkungsmacht eines Religionen übergreifenden Nationenkonzepts*, në: A. Mosser (ed.), *Politische Kultur in Südosteuropa*, Frankfurt a.M. u.a. 2006, f. 147 – 181.
19. Csaplár-Degovics, K. (2008), *Der erste Balkankrieg und die Albaner. Ein Beitrag zur Geschichte der Unabhängigkeitserklärung Albanien (28. November 1912)*, *Südost-Forschungen* 67, f. 168 – 201.
20. Dankoff, R. – Elsie, R. (2000), *Evliya Çelebi in Albania and adjacent areas (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*, Leiden – Boston – Köln.
21. Demiraj, B. (2006/2007), „*Der Slawe*“, *shqau, im Albanischen. Eine ethnolinguistische Fallstudie zu Herkunft und Aussagekraft einer Fremdbezeichnung*, *Südost-Forschungen* 65/66.
22. Di Lellio, A. – Schwandner, S. – Sievers (2006), *The Legendary Commander: the construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo*, *Nations and Nationalism* 12/3, f. 513 – 529.
23. Duijzings, G. – Janjic, D. – Maliqi, S. (1996), *Kosovo – Kosova: Confrontation or Coexistence*, Nimwegen.
24. Duijzings, G. (2000), *Religion and the Politics of Identity in Kosovo*, London.
25. Duijzings, G. (2002), *Die Erschaffung von Ägyptern in Kosovo und Makedonien*, në: U. Brunnbauer (ed.), *Umstrittene Identitäten. Ethnizität und Nationalität in Südosteuropa*, Frankfurt a.M – Berlin – Bern u.a. 2002, f. 123 – 148.
26. Elsie, R. (1997), *In the Heart of the Powder Keg*, New York.
27. Elsie, R. (2004), *Historical Dictionary of Kosova*, Lanham u.a. 2004.
28. Frantz, E. A. (2006), *Loyalitätsoptionen und Identitätsmuster von Albanern in Kosovo in spätosmanischer Zeit (1870 - 1913). Zur Bedeutung von Religion und Familie*, in: E. Brix - A. Suppan - E. Vyslonzil (Hrsg.), *Südosteuropa. Traditionen als Macht*, Wien, f. 73 – 86.
29. Ga eša, N. L. (1984), *Agrarna reforma i kolonizacija u Jugoslaviji 1945 – 1948*, Novi Sad.
30. Islami, H. (2005), *Studime demografike. 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*, Prishtinë.

31. Kaleshi, H. – Kornrumpf, H. J. (1967), *Das Wilajet Prizren. Beitrag zur Geschichte der türkischen Staatsreform auf dem Balkan im 19. Jahrhundert*, *Südost-Forschungen* 26, f. 176 – 238.
32. Kaleshi, H. (1975), *Das türkische Vordringen auf dem Balkan und die Islamisierung- Faktoren für die Erhaltung der ethnischen und nationalen Existenz des albanischen Volkes*, in: *Südosteuropa unter dem Halbmond*, München, f. 125 – 138.
33. Kaleshi, H. (1975), *Das türkische Vordringen auf dem Balkan und die Islamisierung- Faktoren für die Erhaltung der ethnischen und nationalen Existenz des albanischen Volkes*, në: *Südosteuropa unter dem Halbmond*, München, f. 125 – 138.
34. Kaser, K. (1992), *Hirten, Kämpfer, Stammeshelden. Ursprünge und Gegenwart der balkanischen Patriarchalität*, Wien – Köln – Weimar.
35. Kaser, K. (2007), *Haradinaj contra Musaj. Gewalt und Ehre in Balkano-Anatolien: ein historisch-anthropologischer Essay*, në: U. Brunnbauer – A. Helmedach – St. Troebst (ed.), *Schnittstellen. Gesellschaft, Nation und Konflikt in Südosteuropa*, München, f. 335 – 349.
36. Keçmezi-Basha, S. (1999), *Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945 – 1947*, Shkodër.
37. Kojçini-Ukaj, S. (2006), *Zhvillimi i arsimit në Kosovë 1945 – 1952*, Prishtinë.
38. Kornrumpf, H.-J. (1995), *Territoriale Verwaltungseinheiten und Kadiamtsbezirke in der europäischen Türkei (ohne Bosnien und Ungarn)*, Ein Versuch, Stutensee-Fr.
39. Kornrumpf, H.-J. (2001), *Beiträge zur osmanischen Geschichte und Territorialverwaltung*, Istanbul.
40. Kostovicova, D. (2005), *Kosovo. The politics of identity and space*, London – New York.
41. Kostovicova, D. “Shkolla shqipe” and Nationhood. Albanians in Pursuit of Education in the Native Language in Interwar (1918-1941) and Post-Autonomy Kosovo, in: Schwandner – Sievers – Fischer, f. 157 – 171.
42. Kova evi , D. (1975), *Priština u srednjem veku. Istorijski asopis* 22, f. 45 – 75.
43. Majer, H. G. (1984), *Albaner und Bosnier in der osmanischen Armee. Ein Faktor der Reichsintegration im 17. und 18. Jahrhundert*, në: K. D. Grothusen (Hrsg.), *Jugoslawien. Integrationsprobleme in Geschichte und Gegenwart*, Göttingen, f. 105 – 117.
44. Malcolm, N. (1998), *Kosovo. A Short History*, New York.
45. Malcolm, N. (2009), *The “Great Migration” of the Serbs from Kosovo (1690): History, Myth and Ideology*, in: O.J. Schmitt – E. A. Frantz (ed.), *Albanische Geschichte – Stand und Perspektiven der Forschung*, München, f. 225 – 251.
46. Mihalj i , R. (1989), *The battle of Kosovo in history and in popular tradition*, Belgrad.
47. Miki , D. (1988), *Društvene i ekonomske prilike kosovskih Srba u XIX i po etkom XX veka (od if ijtva do bankarstva)*, Beograd.

48. Müller, D. (2005), *Staatsbürger auf Widerruf. Juden und Muslime als Alteritätspartner im rumänischen und serbischen Nationscode*, Wiesbaden.
49. Müller, St. (1999), Zur Situation der Roma in Kosovo, *Südosteuropa* 1999, f. 506 – 519.
50. Nuro, K. – Buto, N. (1982), Hasan Prishtina. Dokumente. Tiranë.
51. Palairret, M., Trep a, 1965 – 2000. Lessons Learned and Analysis Unit of the EU Pillar of UNMIK in Kosovo (<http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=49>).
52. Petritsch, W. – Kaser, K. – Pichler, R. (1999), Kosovo/Kosova: Mythen – Daten – Fakten, Klagenfurt.
53. Petritsch, W. – Pichler, R. (Hrsg.) (2004), Kosovo – Kosova. Der lange Weg zum Frieden, Klagenfurt.
54. Pipa, A. – Repishti, S. (ed.) (1984), *Studies on Kosova*, New York.
55. Popovi , T. (2003), Die Mythologisierung des Alltags. Kollektive Erinnerungen, Geschichtsbilder und Vergangenheitskultur in Serbien und Montenegro seit Mitte der 1980er Jahre, Zürich.
56. Prifti, K. (1978), *Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878 – 1881*, Tiranë.
57. Prifti, K. (1989), *Le mouvement national albanais de 1896 à 1900*, La Ligue de Pejë, Tiranë.
58. Pulaha, S. (1984), *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. 15 – 16*, Tiranë.
59. Raki , M. (1985), *Konzulska pisma 1905-1911*, Ed. A. Mitrovi , Belgrad.
60. Reuter, J. (1982), *Die Albaner in Jugoslawien*, München.
61. Reuter, J. (1983), Bildungspolitik im Kosovo, *Südosteuropa* 32/1, f. 8 – 16.
62. Reuter, J. (1983), Die aktuelle Lage im Kosovo. *Südosteuropa* 32/11 – 12, f. 629 – 637.
63. Reuter, J. (1985), Politik und Wirtschaft in Kosovo, *Südosteuropa* 1985/1, f. 10 – 23.
64. Reuter, J. (1986), Unruheherd Kosovo. Resultat einer gescheiterten Politik. *Südosteuropa* 35, f. 631 – 644.
65. Reuter, J. (1990), Die albanische Intelligenz in Kosovo. *Südosteuropa* 39/5, f. 309 – 317.
66. Rexhepagiq, J. (2003), *Dervishet dhe Teqetë në Kosovë, në Sanxhak dhe në rajonet e tjera përreth*, Pejë.
67. Rizaj, S. (1968), *Rударство Kosova i susednih krajeva*, Priština.
68. Rizaj, S. (1982), *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII: administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë.
69. Roux, M. (1992), *Les Albanais en Yougoslavie. Minorité nationale, territoire et développement*, Paris.
70. Rushiti, L. (2004), *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878 – 1941*, Prishtinë.

71. Schmitt, O. J. – Frantz, E. A. (ed.) (2009), *Albanische Geschichte – Stand und Perspektiven der Forschung*, München 2009, (përkthimi në gjuhën shqipe në përgatitje, ed. Artan Puto – Pandeli Pani, Tiranë 2011).
72. Schmitt, O. J. (2008), *Kosovo. Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft*, Wien. (Përkthimi në gjuhën shqipe në përgatitje).
73. Schwandner-Sievers, S. – Fischer, B. J. (2002), *Albanian Identities*, London.
74. Schwandner-Sievers, S. – Ströhle, I. (2007), *Der Nachhall des Sozialismus in der albanischen Erinnerungskultur im Nachkriegskosovo*, në: U. Brunnbauer- St. Troebst (ed.), *Zwischen Amnesie und Nostalgie. Die Erinnerung an den Kommunismus in Südosteuropa*, Köln – Weimar – Wien, f. 217 – 235.
75. Sundhaussen, H. (1999), Kosovo: “Himmlisches Reich“ und irdischer Kriegsschauplatz. Kontroversen über Recht, Unrecht und Gerechtigkeit. *Südosteuropa* 1999, f. 237 – 257.
76. Tërnavë, M. (1976), *Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV- XVI, Kosova – Kosova* (Enti i historisë së Kosovës – Zavod za istoriju Kosova) 5 (1976), f. 289 – 325.
77. Tërnavë, M. (1979), *Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI*, në: Onomastika e Kosovës, Prishtinë, f. 104 – 136.
78. Tönnies, B. (1980), *Sonderfall Albanien. Enver Hoxhas "eigener Weg" und die historischen Ursprünge seiner Ideologie*, München.
79. Ursinus, M. (1982), Regionale Reformen im Osmanischen Reich am Vorabend der Tanzimat. Reformen der rumelischen Provinzialgouverneure im Gerichtssprengel von Manastir (Bitola) zur Zeit der Herrschaft Sultan Mahmuds II. (1808-39), Berlin.
80. Ursinus, M. (1996), Die osmanischen Balkanprovinzen 1830-1840: Steuerreform als Modernisierungsinstrument, *Südost-Forschungen* 55 (1996), f. 129 – 160.
81. Zirojevi , O. (1974), *Tursko vojno uredjenje u Srbiji, 1459-1683*, Beograd.
82. Zirojevi , O. (1984), *Crkve i manastiri na podru ju Pe ke patriaršije do 1683 godine*, Beograd.
83. Zirojevi , O. (2007), *Srbija pod turskom vlaš u 1459 – 1804*, Beograd.

Milazim KRASNIQI

POLITIZIMI DHE GLORIFIKIMI SI IDEOLOGEMA DEFORMUESE TË HISTORISË SË LETËRISË SHQIPTARE

Studimi i letërsisë shqiptare në kontekstin e saj historik, i konceptuar si disiplinë e historisë së letërsisë, në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, më shumë ka qenë një shpërfaqje e botëkuptimit ideologjik për kombin, popullin, shtetin, partinë e shoqërinë, sesa hulumtim shkencor i fakteve mbi objektin e studimit e në funksion të zbulimit të së vërtetës shkencore. Kjo ka ndodhur për shkak të kufizimeve ideologjike të studiuesve, të cilat kanë qenë të imponuara nga regjimi totalitar. Presioni ideologjik dhe politik mbi studiuesit ka qenë i tillë që nuk ka krijuar hapësira të këndvështrimeve alternative, sado latente që të mund të ishin. Por nënshtrimin e tyre ndaj diktatit ideologjiko-politik e ka bërë më të lehtë edhe mungesa e një tradite më të konsoliduar të studimeve pararendëse historiko-letrare.¹

Edhe pse arsyet janë lehtësisht të kuptueshme, kjo nuk e zhbën faktin se rezultatet dhe pasojat e prodhuara në këtë disiplinë kanë qenë të rënda. Janë disa breza shqiptarësh që e kanë të injektuar një botëvështrim të deformuar për historinë e letërsisë shqiptare si disiplinë e prej këndeje edhe për vlerat e letërsisë shqiptare/shqipe.

Gjasat janë të vogla që mund t'u ndihmohet këtyre brezave që të korrigjojnë gjë në botëvështrimin e tyre të deformuar për trashëgiminë letrare, sepse ata tashmë i kanë të ngurosurat idetë në formë bllokadash mentale.² Por, ndërhyrja me urgjencë e me kompetencën e nevojshme shkencore, do t'i shpëtonte brezat e tashëm e të ardhshëm të lexuesve e të studiuesve të rinj nga vlerësimi pseudoshkencor i historisë së letërsisë shqiptare, e kjo mund të bëhet nëse kjo disiplinë futet plotësisht në shtratin e një discipline të mirëfilltë shkencore. “Si disiplinë të veçantë brenda shkencës mbi letërsinë do të duhej ta definojmë si drejtim njohës, i cili në mënyrë

¹ Ky tekst ka karakter epistemologjik, me synimin që të trajtohet gjendja e historisë së letërsisë si disiplinë e shkencës mbi letërsinë. Pra, ambicia e tij nuk shkon në drejtim të dhënies së vlerësimeve për letërsinë shqipe, po për vetë disiplinën.

² Do të ishte me interes të bëhej një anketim substancial me disa breza, për të përfutur “ligën” e shkrimtarëve dhe “galerinë” e veprave që ata mendojnë se janë të mëdha, në bazë të botëvështrimit të deformuar që kanë marrë nga histori të politizuara e grorifikante të letërsisë sonë. Fakti që për këto njëzet vjet nuk ka pasur reagime ndaj mësimave të ideologjizura që vazhdojnë edhe sot, është një tregues në këtë mes.

komplekse, duke pasur kujdes për të gjithë faktorët e komunikimit letrar, të hulumtojë e të prezantojë shkaqet dhe modalitetet e ndryshimeve në jetën e letërsisë - në vepra, funksionet dhe programet.³ Por, në realitetin e studimeve tona historiko-letrare, kjo nuk është ndërmarrje e lehtë, sepse ajo nuk e ka aleat as vullnetin e studuesve të konsumuar me metodën marksiste e as traditën, e cila do ta bënte më të lehtë korrigjimin e deformimit të periudhës së diktaturës.

Për shkak të mungesës së institucioneve shtetërore e kulturore, që do të nxitnin, do të financonin e do të respektonin rezultatet e arritura, studimet e mëhershme në fushën e historisë së letërsisë shqiptare, që nga fillimi i shekullit XX, kanë lindur si produkt i iniciativave personale të studuesve vullnetmirë e entuziastë. Por, studimet e tilla, përveç ndonjë rasti⁴ nuk e kanë konstituuar ndonjë shkollë studimi, e cila do të qëndronte sot në themelet e këtyre studimeve dhe do të kontribuonte për krijimin e kontinuitetit studimor.

Në rend të parë, në studimet tona të historisë së letërsisë nuk është konsoliduar me kohë e madje as me vonesë studimi i historisë së letërsisë në kuadër të koncepteve teorike të historicizmit herderian, sipas të cilit krijimi i pamjes totale të një letërsie kërkon seleksionim korrekt të materialit dhe se veprat e epokave të ndryshme letrare nuk mund të vlerësohen me një kriter të njëjtë. Mosaplikimi i kësaj teorie në studimet tona historiko-letrare ka lënë një vakum, i cili është i ngjashëm me invaliditetin.

Ky invaliditet shihet më së miri në historitë e letërsisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX⁵, në të cilat nuk vërehet synimi që të rroket pamja faktike e

3 Uvod u knjizevnost, Graficki zavod Hrvatske, Zagreb, 1983, st. 89.

4 Pikëmbështetja kryesore e traditës do të mund të ishte studimi i Eqrem Çabejt, "Për gjenezën e literaturës shqipe", i cili ngërthen në vete elemente të teorive të njohura e të mirëfillta shkencore të studimit të letërsisë. Çabej sublimon në studimin e vet elemente të qasjes pozitiviste: "Mirëpo, ç'u fitua në thellësi u humb në gjerësi. Dijetarët po mësohen tani, ndryshe nga brezi i mëparshëm, të kenë sy më shumë për pikat diferencuese se sa për pikat lidhëse". Poashtu, ndihet mjaft pulsuese teoria e F. Shlegelit për frymën e kohës: "Qëllimi i i këtyre rreshtave është që të duken vijat e mëdha, të dëftohet rruga e zhvillimit mendor të Kombit nga vija që ka ndjekur literatura, gjithmonë duke pasur par sysh gjëndjen historike e sociale të vendit. Ka rëndësi për ne që nëpër autorët të kuptojmë shpirtin e kohës, por pa harruar këshillën e Goethe-s. "Ç'quani ju shpirtin e kohës, kjo në fund është shpirti i zotërinjve vetë". Duke dalë prej këtij qëllimi do të renoncojmë a priori në një plotësi lëndore, e duke lënë më nj'anë pikat e dorës së dytë, do të theksojmë më tepër ato të rëndësiplozet. Do të këqyrim më shumë të nxjerrim në dritë, në pikat kryesore, personat e dukjet që janë themelore për vijën e zhvillimit të literaturës" (Eqrem Çabej, Studime V, Rilindja, Prishtinë, 1975, f. 113) Po të ishte ndjekur kjo rrugë e filluar së trasuari nga Çabej, studimet tona historiko-letrare do të kishin një fat shumë më të mirë.

5 Sipas Eqrem Çabejt identifikohen këto qarqe letrare: "Qarku katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku Italo-shqiptar, Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore, dhe së fundi Literatura kombëtare e shekullit XIX." Duke e injoruar këtë fakt, në historitë e letërsisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX, i gjithë produkti i të gjitha qarqeve dhe të gjitha kohëve është

letërsisë me anën e një vlerësimi korrekt të materialit të studiuar, ndërsa është aplikuar në mënyrë mjaft vulgare kriteri i barazimtarisë për vlerësimin e veprave të kohëve të ndryshme me kriterin ideologjik të aktualitetit, saktësisht sipas asaj që antropogu Xhek Gudi e ka quajtur “amnezia strukturale.” Këto histori janë hartuar duke e bërë rrafshimin arbitrar të specifikave (duke injoruar propozimin e logjikshëm të Çabejt për qarqet letrare dhe për ndikimin e fisit dhe të konfesioneve fetare në letërsi) dhe duke krijuar një pamje gjoja kontinuitive e pothuajse harmonike të rrugës së zhvillimit të letërsisë shqipe, të cilën ajo kurrë të atillë nuk e ka pasur.

Për mungesë të këndvështrimit teorik historicist, në historitë normative të letërsisë, të hartuara deri sot, nuk është provuar të gjendet përgjigje për pyetje thelbësore sikundër janë shkaqet e mungesave të formacioneve të tëra stilistike-letrare në letërsinë shqipe, që nga letërsia antike, Renesanca e Klasicizmi. “Në rastin e mungesës së teksteve letrare, që është përvoja e pjesës më të madhe të historisë së letërsisë sonë, duhet të fokusohemi më gjerësisht në studimin e atyre periudhave historike të pushtimeve, prej të cilave pastaj do të mund të nxjerrim disa përfundime për shkaqet e mosekzistimit të institucioneve dhe të një letërsie shqipe në gjirin e tyre. Studimi i tillë na mundëson që të qartësojmë rrugën e vështirë të zhvillimit kulturor e letrar dhe arsyet e lindjes së letërsisë shqipe në një realitet historik e shoqëror, sikundër ishte ajo nën Perandorinë Osmane, ku tradicionalisht mendohet se ka pasur më pak liri, se sa në pushtimet pararendëse. Por, meqë shkrimi shqip dhe letërsia shqipe kanë lindur në kohën e sundimit osman, atëherë duhet të gjendet përgjigje shkencore në pyetjen: pse nuk ka pasur shkrime shqipe e letërsi shqipe në periudhat pararendëse, të pushtimeve romake, bizantine, bullgare e serbe mbi ilirët/shqiptarët?”⁶

Ndërsa, Historia e letërsisë shqipe, për mungesë respektimi a njohurie për konceptimin historicist, i ka fshirë si me gomë periudhat e tëra historike, që kanë qenë shkaktarët e ngecjes dhe të degradimit kulturor e letrar të shqiptarëve dhe fokusohet ekskluzivisht te periudha osmane, për të shfryrë tërë vrerin vetëm mbi të. “Me përfshirjen e tokave shqiptare në kufijtë e perandorisë së sulltanëve, u ndërpre procesi i zhvillimit të natyrshëm e të pavarur politik-shoqëror e kulturor, në të cilin kishte hyrë populli shqiptar në shekujt para pushtimit osman (XII-XIV).”⁷ Prerja e këtyllë e pamjes kohore dhe historike krijon probleme në të kuptuarit logjik e kritik

paketuar si “letërsi kombëtare”, duke e falsifikuar realitetin e fakteve. Kjo ka shkaktuar pastaj edhe relativizimin e vlerave të vërteta letrare me përmasë kombëtare dhe ka shkaktuar konfuzion në vlerësimin kritik e historiko-letrar, që po vazhdon edhe sot. Qarqeve të propozuara nga Çabej, besoj mund t’i shtohet edhe propozimi i Elsit, “Letërsia myslimane e shekullit XVIII dhe e fillimit të shekullit XIX”, ndoshta me një formulim tjetër, fjala vjen, “Letërsia alamiado shqiptare”.

⁶ Milazim Krasniqi, Letërsia dhe besimet fetare, Logos A, Shkup, 2011, f.

⁷ Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 12.

të ndodhive dhe të dukurive, sepse shekujt XII-XIV janë shekuj pa asnjë gjurmë shkrimi të shqipes dhe shekuj në të cilët përndjekjet etnike, fetare dhe kulturore kundër arbërve, veçmas nga sundimtarët serbë, kanë qenë të lemerishme. Mjafton të kujtohet me këtë rast akti i qeverisjes së car Dushanit, që bie në këtë periudhë, së cilës i referohen studiuesit tanë si periudhë e “zhvillimit të natyrshëm e të pavarur politiko-shoqëror e kulturor”, për ta pasur të qartë se në atë frymë dhe praktikë përndjekjesh të lemerishme etnike, fetare e kulturore, shqiptarët nuk kanë mundur të kenë “proces të zhvillimit të natyrshëm” e brenda atij procesi të kenë edhe letërsi artistike në gjuhën e vet. E vërteta është se me zbatimin rigoroz të Zakonikut të Dushanit, në pjesën dërrmuese të trevave të banuara edhe me shqiptarë, pasojat për identitetin fetar dhe etnik të tyre kanë qenë serioze, sepse ato e kanë sforcuar asimilimin e tyre në serbë. “Duke marrë para sysh mbisundimin e serbëve ortodoksë, si edhe të gjuhës serbe në Kosovën mesjetare, ka arsye të mendohet se rrjedha e përgjithshme e asimilimit ka qenë në favorin e serbëve, me disa dallime të vogla. Konkluzioni kryesor duhet të jetë se, pa marrë para sysh se në ç’shallë ka qenë asimilimi, ai është bërë: shumë veta të cilët iu nënshtruan këtij procesi, duhet të kenë lënë gjuhën e tyre shqipe dhe janë bërë serbë.”⁸ Ka mundësi që hartuesit e historive të letërsisë shqiptare të periudhës së diktaturës hoxhiste⁹, për shkak të kufizimeve të imponuara politike, nuk i kanë pasur para sysh territoret shqiptare kontinentale, (meqë regjimi afirmonte vetëm kufijtë e Shqipërisë politike) po vetëm ato bregdetare. Mirëpo, faktet historike tregojnë se edhe territoret bregdetare pësuan pushtimin e huaj para se të pushtoheshin nga osmanët. “Ky princ fatkeq shqiptar (Gjergj Topia) më datën 8 gusht të vitit 1392 hoqi dorë nga Durrësi për t’ia dorëzuar Republikës së Venedikut.”¹⁰ Ndërsa, më 14 prill 1396, Gjergji II i Ballshajve “hiqte dorë, në favor të Republikës, nga qyteti, nga kështjella e Shkodrës, nga liqeni dhe nga ishujt e liqenit përgjatë Bunës. Hiqte dorë nga të gjitha qytetet, kështjellat dhe territoret e Drishtit, Satit e Danjës, duke mbajtur për vete dhe për trashëgimtarët e vet vetëm territorin e së ashtuquajturës Zabojanë (Përtej Bunë).”¹¹ Pra, është e qartë se këtu nuk ka mundur të bëhej fjalë për një “proces të zhvillimit të natyrshëm”, sikundër pohojnë hartuesit e Historisë së letërsisë shqiptare, po është fjala për aneksimin e territoreve shqiptare nga ana e Venedikut dhe rrënimin e përpjekjeve të

⁸ Noel Malkolm, Kosova një histori e shkurtër, Dukagjini, Pejë, f. 53.

⁹ Historia e letërsisë shqiptare, e botuar nga Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, e hartuar nga Vehbi Bala, Razi Brahimi, Klara Kodra, Ali Xhiku, Dhimitër Fullani e Shanban Çollaku, nën drejtimin e Dhimitër S. Shuteriqit, si projekti më serioz i të gjitha historive normative të letërsisë shqiptare brenda një shekulli, është pika kryesore e referimit në këtë studim. Historia e letërsisë shqipe (Romantizmi I) e Rexhep Qosjes dhe Histori e letërsisë shqiptare e Robert Elsit, deri diku, kanë dallime metodologjike me historitë normative të botuar për gjysmë shekulli në Shqipëri.

¹⁰ Giuzepe Gelcich, Zeta dhe dinastia e Ballshajve, 55, Tiranë, 2009, f. 176.

¹¹ Po aty, f. 206.

Topiajve e të Ballshajve (ndonëse të konfrontuar egërsisht ndërmjet tyre), për të krijuar ndonjë shtet arbër mbi një pjesë të rrënojave e ish Perandorisë Nemanjide. Ndërsa, historiani i famshëm, Konstantin Jireqeku, pohon se “Në Shqipëri serbët pushtuan (vjeshtë 1345) Beratin dhe Vlorën, në Maqedoni Kastorian.”¹² Noel Malkolmi nga ana tjetër pohon se territori i Kosovës së sotme u pushtua plotësisht nga serbët në vitin 1196.¹³

Po të ishte njohur më parë dhe i respektuar kriteri historicist i seleksionimit rigoroz të fakteve nga hartuesit e historive të letërsisë, në këtë rast, së paku historikisht do të konstatohej se ardhja e osmanëve në Ballkanin e sotëm, i ka gjetur shqiptarët e pjesës kontinentale në grahamat e fundit të asimilimit të tyre etnik, fetar dhe kulturor dhe të kolonizimit të tokave të tyre nga sllavët, ndërsa territoret bregdetare të pushtuara nga Venediku e jo në një “proces të zhvillimit të natyrshëm” dhe se deri sot nuk është gjetur asnjë gjurmë e teksteve letrare shqipe në shekujt XII-XIV, po as të kohëve të mëhershme, që nga periudha antike e deri te Renesanca evropiane. Kjo është mënyra e duhur e seleksionimit dhe e prezantimit të së vërtetës, për mungesën e letërsisë së shkruar shqipe në ato kohëra, e jo hipotezat dredharake sipas të cilave osmanët i shkatërruan dokumentet e shkruara letrare, për të cilat askush nuk ka lënë dëshmi, as para ardhjes së osmanëve në këto hapësira e as gjatë sundimit të tyre në to. Fundja, edhe grekët, bullgarët, rumunët e serbët kanë qenë të pushtuar nga osmanët, por dëshmitë e shkruara të gjuhëve e të letërsive të tyre kanë mbijetuar sundimin osman. Prandaj spekulimet e kësaj përmase në historinë e letërsisë shqiptare janë edhe pasojë e mungesës së traditës, e cila do të krijonte si standard profesional po ashtu edhe kodin etik në këtë lëmi.

E bashkuar me këtë mungesë të konceptimit historicist herderian, është edhe mungesa e studimit të letërsisë shqiptare në frymën shlegeliane, sipas së cilës duhet të studioheshin vetëm veprat artistike që kanë ide drejtuese dhe kanë vlerat shënjuese të epokës. Në rast se do të ishte konsumuar vlerësimi i letërsisë shqiptare me këtë koncepton teorik, sot do të ekzistonte një hierarki e saj, sado parçiale që të ishte, që do të mundësonte më lehtësisht rikontekstualizimin e vlerave artistike. Fatkeqësisht, zgjedhja e veprave letrare të studiuara në praktikën e historisë së letërsisë shqiptare nuk është bërë ndonjëherë në këtë frymë. Prandaj, sot nuk e kemi atë traditë, që do të ishte ndihmuese e sigurt në përpjekjet për konsolidimin mirëfilli shkencor të kësaj disipline. Në projektin më ambicioz të historisë së letërsisë, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, paraqiten me nota shumë solemne si shkrimtarë të shquar, autorë që realisht janë minorë e pa ide drejtuese për kohën e vet. Biografizmi militant në këtë rast është tharmi i politizimit të historisë së letërsisë, sepse në rastet kur autorët janë personalitete të shquara të ideologjisë së

¹² Konstantin Jireqek, Historia e serbëve, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2010m, fq. 426.

¹³ Noel Malkolm, vepër e cituar, f.

ndërtimit të kombit, të ndërtimit të shtetit, ose kontribuues të revolucioneve a luftërave çlirimtare, ata glorifikohen si shkrimtarë të mëdhenj, ndërsa kur nuk janë të tillë ose kur vlerësohen si kundërshtarë të regjimit apo edhe më keq si tradhtarë të kauzës kombëtare, atëherë vlerat e veprës së tyre artistike minimizohen ose përjashtohen tërësisht. Fjala vjen, në dritën e vlerësimit të lartë ideologjik për figurën e Luigj Gurakuqit, në Historinë e letërsisë shqiptare, jepen këso vlerësimesh glorifikuese: ” një nga figurat më kryesore të lëvizjes sonë patriotike dhe demokratike të kohës, L. Gurakuqi pati një veprimtari të gjerë e të dendur politike, shoqërore, kulturore e letrare, u shqua si poet në rini, pastaj si publicist e orator.”¹⁴ Ndërsa, për poezinë tij “Qëndresa’ e cila është shumë modeste sa u përket vlerave artistike, thuhet solemnisht: “ mbetet krijimi i tij më i mirë dhe një prej krijimeve më me vlerë të poezisë sonë të kohës.”¹⁵ Nëse do të kishte përpara kësaj historie një histori tjetër letërsie shqiptare, e cila do të respektonte kriterin teorik për gjetjen e veprave që dëshmojnë “frymën e epokës”, kjo poezi modeste e Gurakuqit dhe as vetë Gurakuqi nuk do të përfshiheshin në të. Për ta konkretizuar edhe më shumë këtë tezë, po sjellim edhe një fakt të njohur: në këtë histori letërsie shqiptare, të hartuar me kritere vulgare ideologjike, vepra e Gjergj Fishtës, e cila shënjon realisht “frymën e epokës”, nuk figuron askund.

Nga ana tjetër, për shkak të prirjes së metodës marksiste për manipulimin e të vërtetave, ka ndodhur një shartim i çuditshëm i teorisë së njohur të Sent Bevit, për unitetin ndërmjet autorit dhe veprës së tij dhe nevojën që studimi të respektojë këtë unitet, me metodën marksiste të studimit, duke u deformuar esenca e teorisë së Bevit. Studimi marksist/stalinist i letërsisë shqiptare e ka deformuar këtë koncept teorik, për të eliminuar shkrimtarët armiqësorë, sikundër trajtohej Fishta, e për të grorifikuar shkrimtarët e përshtatshëm. Sot mund të shkruhet një histori e gjatë dhe e dhimbshme e këtyre eliminimeve të shkrimtarëve nga historia e letërsisë dhe e deformimeve të vlerësimit për artin letrar, e maskuar me papërshtatshmërinë politike të autorit, gjë që e bën edhe më të vështirë pozitën e historisë së letërsisë si disiplinë në kuadër të studimeve shqiptare për letërsinë. Riafirmimi i konceptit teorik për studimin e ndërlidhjes së shenjave jetësore dhe botëkuptimeve të autorit dhe shenjave në veprën e tij, edhe mund të bëhet sot, por kjo nuk mund të funksionojë pa i rehabilituar plotësisht vlerat artistike të anatemuara e të eliminuara, për shkak të biografisë së autorëve të tyre. Kjo mund të jetë njëra nga sfidat më serioze të studimeve të sotme në fushën e historisë së letërsisë shqiptare.

Studimet tona historiko-letrare të këtyre njëqind vjetëve nuk janë pllenuar me kohë e në mënyrë të ndjeshme as nga aplikimi i koncepteve teorike pozitiviste të Ipolit Tenit dhe dishepujve të tij, me ç’ka do të mund të kishim një pamje

¹⁴ Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, 1989, Prishtinë, f. 370.

¹⁵ Po aty, f. 372.

“fiziologjike” të letërsisë sonë. Në atë rast së paku nuk do të ndodhnin pasaktësi si ajo ku vihet barazia ndërmjet shkrimit të gjuhës dhe shkrimit të letërsisë artistike. “Ka të dhëna të drejtpërdrejta e të tërthorta, të cilat flasin në të mirë të tezës se shqipja duhet të jetë shkruar edhe më herët, dhe duhet të ketë ekzistuar një traditë e shkrimit të saj”¹⁶ (para Mesharit-vër. jonë). E drejta, një gjuhë mund të jetë e shkruar një kohë të gjatë e të mos prodhohet në të krijimtari artistike. Kjo në fakt ka ndodhur edhe me shqipen, sepse tradita e shkrimit të saj është shumë më e lashtë se tradita e krijimtarisë artistike. Fatkeqësisht deri tash nuk është bërë ky diferencim “pozitivist” ndërmjet shkrimit të shqipes dhe lindjes së letërsisë shqipe në këtë gjuhë, që është një diferencim i domosdoshëm për ta vendosur historinë e letërsisë shqipe në shtratin e saj të vërtetë. Vendosja e letërsisë në të njëjtin shtrat me gjuhën, gjasmë e ka shtyrë më thellë në kohë lindjen e letërsisë shqipe, por duke e deformuar pamjen e saj të vërtetë. E vërteta shkencore është që “...përpara të gjithave do të kemi para sysh që, me përjashtim të ndonjë fraze vetiake t’autorit hedhur tek-tuk nëpër tekst, ky libër është fund e krye një përkthim.”¹⁷ Pra, edhe mungesa e traditës së studimit pozitivist të letërsisë sonë, ka lënë hapësirën bosh, e cila është mbushur me relativizëm shkencor e hamendësime të llojllojshme, të paketuara si shkencë.

Fatkeqësisht ne nuk kemi pasur brenda këtyre njëqind vjetëve as ndonjë histori të letërsisë shqiptare të hartuar në bazë të koncepteve teorike të mirëfillta imanente, as formaliste e as strukturaliste, para se doktrina marksiste/staliniste të bëhej dhunuese e mendimit dhe e hulumtimit të lirë shkencor.

Prandaj, futja e kësaj historie të letërsisë në shtratin e disiplinës mirëfilli shkencore nuk është një ndërmarrje e lehtë, sikundër u tha më herët. Por, diku duhet të fillohet, duke e sfiduar edhe mungesën e traditës, po edhe vullnetin e studiuesve të vjetër, bashkë me ambicien jo aq insistuese të studiuesve të rinj për këtë ndërmarrje.

Sot për sot, mjaftohemi që i dimë cilat janë mungesat teorike dhe metodologjike në hartimin e teksteve zyrtare të historisë së letërsisë dhe cila është nevoja e hartimit të teksteve më të mira. Prej këtij pozicioni mund të provohet një studim më fatlum se sa që ka qenë për këto njëqind vjet. Pikësëpari, rikthimi kreativ e kritik të propozimi i Çabejt për qarqet letrare, veçmas për periudhën parakombëtare, duhet të merret në konsideratë e të strukturohet me studime konkrete autorësh, veprash e rrethanash, sepse është e vetmja mënyrë për ta studiuar e vlerësuar atë produksion letrar brenda shtratit, natyrës dhe funksionit të vet. Ndërsa, letërsia prej romantizmit e këndeje, duhet të ketë periodizime adekuate, gjithmonë duke respektuar natyrën, funksionet e veprave artistike dhe veçantitë stilistike, e jo duke i futur kallëp brenda ngjarjeve politike e shoqërore.

¹⁶ Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 18.

¹⁷ Çabej: 25.

Në këtë njëqindvjetor të krijimit të shtetit shqiptar, i cili po na shërben kësaj radhe edhe si prerje në fushën e studimeve historiko-letrare, nuk po vërehen tendenca të krijimit të një mase kritike, e cila do të aspironte ndryshimin e gjendjes në këtë lëmi. Letargjia dhe inercioni janë më të fuqishme se sa aspirata e zbehtë e ambicies për ndryshim të gjendjes. Jam i bindur se e gjitha është pasojë e mënyrës së ndërtimit të shtetit para njëqind vjetësh, si një shtet gjysmak, i cili ka prodhuar një gjysmëkomb dhe pas njëqind vjetësh ende i ka të hapura dilemat e identitetit kulturor e kombëtar.

Botimi i Abetares së përbashkët në njëqindvjetorin e pavarësisë së Shqipërisë është ironia më therëse e gjithë kësaj letargjie dhe inercie që mban peng jetën tonë. Në vend se të ndodhte, e pakta, hartimi i një historie të re të letërsisë shqiptare me kritere të mirëfillta shkencore e duke rrokur pamjen e plotë të letërsisë shqipe, me të gjitha specifikat e saj, ndodh botimi i Abetares. Kjo Abetare shpërfaq lakuriq vonesat tragjike dhe fuqinë e energjive retarduese, por edhe mungesën e vullnetit për të funksionuar plotësisht si një njësi kombëtare në fushën e dijës.

Nëse për ta shprehur vullnetin e mirë duhet të kapemi edhe pas një fije kashte, rastin po na e jep një paradoks tipik shqiptar, lidhur me pronësinë e autorit mbi veprën e vet.

Kontesti gjyqësor ndërmjet shkrimtarit Ismail Kadare dhe Nexhmije Hoxhës për dorëshkrimin e romanit “Dimri i vetmisë së madhe”, aktualizoi një aspekt të fshehur të asaj që është historia e vërtetë e letërsisë.

Duke ndjekur fatin e këtij dorëshkrimi, mund të konstituohen disa pyetje thelbësore jo vetëm me historinë e këtij romani, po edhe me vetë historinë e letërsisë shqipe në tërësi, përgjigjet e të cilave në historitë e deritashme nuk janë dhënë: cila është historia e dorëshkrimeve dhe e veprave artistike në raport me autorin e tyre, me shoqërinë, po edhe me lexuesit? Në të vërtetë, as historia e dorëshkrimeve nuk mund të shkëputet nga historia e vetë veprave, qoftë dhe vetëm për shkak të studimit të versioneve e të redaktimeve që u janë bërë. Në këtë histori pastaj mund të nuancohen gjërat, duke hulumtuar ndërhyrjet nga autori e nga redaktorët në tekst, a janë bërë nga motivimi estetik apo nga shtysa të tjera, si autocensura apo censura. Në këtë linjë pastaj mund të hulumtohen ndryshimet leksikore, sintaksore e rrjedhimisht edhe stilistike që janë bërë, a ka pasur rrethana shtrënguese ose qoftë dhe vetëm konvenca ideologjike për lirinë e shprehjes në kohën kur vepra është shkruar e kur është botuar, cili ka qenë statusi i shkrimtarit në raport me shoqërinë, ndikimi i tij politik e shoqëror, ndikimi estetik i veprës së tij, cili ka qenë ndikimi i disa prej “faktorëve natyrorë dhe i faktorëve kulturorë” mbi shkrimtarin e veprën e tij¹⁸ e kështu me radhë. Në planin historiko-letrar mund të studiohet edhe raporti i

¹⁸ Për këtë tipologji të faktorëve që ndikojnë mbi shkrimtarin, shih studimin monumental të Arnold Hauzeri, “Sociologjia e artit”. Disa nga tekstet dhe studimet me prirje historiko-

veprës konkrete me veprat e tjera të autorit, po edhe me veprat e autorëve të tjerë¹⁹, sepse nga këto raporte mund të hetohen ndryshimet shumëplanëshe në jetën personale të autorit, po edhe në jetën letrare e në jetën shoqërore.

Në kontekstin e shumësisë së këtyre pyetjeve, për shkencën e historisë së letërsisë, historia e veprave artistike mund të jetë më e rëndësishme se sa historia e autorit të saj. Po t'i referohemi në këtë mes sa për ilustrim raportit ndërmjet romanit "Dimri i vetmisë së madhe" dhe autorit të saj, Ismail Kadare, mund të konkludojmë se sfida e romanit ndaj manipulimit të diktaturës me artin letrar është më e fortë se sa sfida që ia pati bërë autori diktaturës, me arratisjen e tij të bujshme në vitin 1990, apo edhe me padinë për kthimin e dorëshkrimit.

Romani "Dimri i vetmisë së madhe", dorëshkrimi i të cilit thuhet se ka rreth 1200 faqe shkrimi me makinë, përmes strukturimit të vet, varianteve, raportit me dokumentet zyrtare, me protagonistët që kanë qenë udhëheqës të shtetit dhe me institucionet zyrtare të kohës kur u shkrua, e shpërfaq atë histori në formë më autentike se sa autori i saj, edhe nëse ai merr përsipër të flasë e të sqarojë në formë kujtimesh a intervistash ato çështje. Prandaj, studimi i historisë së këtij romani mund të na ofrojë të dhëna që të kuptohet më fort edhe historia e asaj periudhe, edhe raporti i shkrimtarit me institucionet, edhe raporti i institucioneve me vlerat artistike (interesimi i tyre është evident për glorifikimin nga ana e një shkrimtari të njohur). Propozimi është, pra, (jo vetëm në rastin e romanit "Dimri i vetmisë së madhe"), që studimi i gjithë produksionit letrar të bëhet duke e studiuar veprën letrare si "tërësi e vlerave" (Mukarzhovski). Nëse ky studim bëhet me metodologji adekuate shkencore, atëherë mund të studiohet e të kuptohet edhe biografia e shkrimtarit e edhe rrethanat shoqërore, politike e kulturore, funksionet dhe programet e letërsisë, ndikimi i saj shoqëror dhe vlerat e saj estetike. Deri sot pothuajse në tërë historitë normative të letërsisë shqipe ka dominuar biografizmi i politizuar i jetës së shkrimtarit dhe i rrethanave shoqërore e historike, të shikuara me dioptri të rreptë ideologjike, përmes të cilave pastaj është bërë përpjekje që të depërtohet edhe në kuptimet e veprës letrare. Pra, metodologjikisht këto studime kanë qenë me skemë të përmbysur.

Përfundim bën në këtë aspekt vëllimi i parë i projektit Historia e letërsisë shqipe (Romantizmi I) i akademik Rexhep Qosjes, i cili nga pikëpamja metodologjike deri sot është studimi më komplet dhe më kompetent për periudhën e

letrare në vitet njëzet e tridhjetë mund të hyjnë pjesërisht në punë, si: "Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe me pjesë të zgjedhuna, 1936 e Eqrem Çabejt, "Naim Frashëri" e Mid'hat Frashërit, 1923, "Shkrimtarë shqiptarë I dhe II", e hartuar nga Ernest Koliqi dhe Karl Gurakuqi, 1941.

¹⁹ Për këtë shih studimin e Jan Mukarzhovsit, "Mbi strukturalizmin", ku në formë të rathëve koncentrikë e ka evidencuar ndikimin struktural të veprave të të njëjtin autorë, pastaj të bashkëkohësve, të letërsisë kombëtare e të mbarë letërsisë.

romantizmit. Por, formacionet e tjera letrare nuk kanë ende ndonjë studim të ngjashëm.

Ndërsa, “Histori e letërsisë shqiptare” e Robert Elsit, (parcialitetin e sugjeron emërimi histori e jo historia), edhe pse përfshin edhe letërsinë shqipe të Kosovës dhe është e pasuruar me disa të dhëna të reja e me një kronologji e një bibliografi shumë të vlefshme, konceptualisht ka ndjekur kryesisht klishenë e historive normative. Brenda kuadrit të studimit të letërsisë shqiptare ka përfshirë edhe “humanistët shqiptarë”, të cilët nuk kanë shkruar asgjë në shqip. “Humanistët shqiptarë” të përmendur më sipër (Gazulli, Barleti, Maruli, Tomeu, Biçikemi (plotës. imi) shkrimtarë dhe mendimtarë të shekujve të pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë, patën pak rëndësi të drejtpërdrejtë për lindjen e letërsisë shqiptare. Ata ishin produkt i kulturës humaniste të Rilindjes italiane dhe, me talentin e tyre, dhanë një ndihmesë në zhvillimin e kësaj ringjalljeje të madhe kulturore, që do të kishte një ndikim të tillë mbi qytetërimin evropian.”²⁰

E njëjta qasje e njohur si relativizëm shkencor shihet edhe kur flet për “Fillimet e letërsisë në Shqipëri- shekujt XVI e XVII”, ku me formulime të lakueshme, relativizuese, për Mesharin thotë se “është libri i parë në gjuhën shqipe e njëherazi një nga frytet më interesante në historinë e letërsisë shqiptare, (nën. imi) të paktën nga pikëpamja gjuhësore e kulturore.”²¹ Një tekst që për nga natyra dhe funksioni i tij estetik nuk është letërsi, “nuk ka si të jetë “një nga frytet më interesante në historinë e letërsisë shqiptare”, sikundër pohon Elsie, me çka ai mbetet brenda këndvështrimit të deformuar të studimeve historiko-letrare normative, në të cilin tekstet joletrare trajtohen si tekste letrare. Kjo histori e Elsit ka edhe probleme serioze sa i përket periodizimit të letërsisë shqiptare, veçmas të letërsisë moderne.”²²

A do të mundet historia e letërsisë shqipe²³ si disiplinë shkencore të shkëputet nga politizimi dhe glorifikimi pseudoshkencor i deritashëm dhe në të ardhmen ta

²⁰ Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, f. 21-22.

²¹ Po aty, f. 33.

²² Emërtimi i letërsisë së realizmit socialist si “Letërsia nën regjimin e Enver Hoxhës” është simplifikim i natyrës, përbërësve stilistikë dhe ndërlidhjes së kësaj letërsie me letërsitë e tjera të Europës Lindore dhe të Rusisë, që ishin nën ndikimin ose nën arbitraritetin e kësaj doktrine. Po ashtu, edhe letërsia shqipe e Kosovës nuk mund të shihet e ndarë nga rrjedha e përgjithshme e letërsisë shqiptare, sepse ajo i ka pasur pikëtakimet, përkimet dhe ndikimet në të, krahas ndikimeve që ka ushtruar mbi këtë pjesë të letërsisë shqiptare letërsia e popujve të ish Jugosllavisë. Por, tërësisht e shkëputur, edhe krahas izolimit politik, nuk ka qenë. Studimet e mirëfillta të veprave të autorëve shqiptarë të Kosovës mund të gjejnë ato pikëtakime, ato përkime ose ndikime, sikundër edhe shkëputjen, diskontinuitetin stilistik e tematik. Kjo edhe është njëra nga objektivat e studimeve historiko-letrare në të ardhmen.

²³ Nëse merret si themelor kriteri gjuhësor për emërtimin e disiplinës, atëherë kjo duhet të quhet histori e letërsisë shqipe e jo histori e letërsisë shqiptare. Kriteri etnik i ka hapur portat që të trajtohen si vepra shqipe edhe ato që nuk janë shkruar në gjuhën shqipe dhe ato që nuk

kryejë misionin e një disipline të veçantë të shkencës mbi letërsinë? Kjo është pyetje për një milion dollarë.

Bibliografia

1. Bart, Rolan, *Letërsia, Mitologjia, Semiologjia*
2. Bastide, Roger (1981), *Umjetnost i drustvo*, Zagreb.
3. Bibliografi e librit shqip (1913-1944), Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2010
4. Budi (1986), *Poezi*, Rilindja, Prishtinë, (Parathënia e Rexhep Ismajlit).
5. Buzuku, Gjon (1987), *Meshari*, Rilindja, Prishtinë.
6. Çabej, Eqrem (1975), *Studime gjuhësore V*, (Për gjenezën e literaturës shqipe), Rilindja, Prishtinë.
7. Eliot, Tomas S. (1982), *Ese të zgjedhura*, Rilindja, Prishtinë.
8. Elsie, Robert (1997), *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë.
9. Elsie, Robert (2005), *Letërsia shqipe (Një historie shkurtër)*, Skandebeg books, Tiranë.
10. Eskarpi, Robert (1970), *Sociologjia knjizevnosti*, Zagreb.
11. Gelcich, Giuseppe (2009), *Zeta dhe dinastia e Ballshajve*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë.
12. Gof, Zhak Ië (1998), *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, CEU&Toena, Tiranë.
13. Hamiti, Sabri, *Letërsia e vjetër shqipe*, Libri Shkollor, Prishtinë.
14. Hauzer, Arnold (1986), *Sociologjia umetnosti*, Skolska knjiga, Zagreb.
15. Historia e letërsisë shqipe I, II (1959), Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT.
16. Historia e letërsisë shqipe II (1975), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë.
17. Historia e letërsisë shqipe, (Grup autorësh) (1989), Rilindja, Prishtinë.
18. Historia e popullit shqiptar (1979), (botim i tretë), ETM/KSAK, Prishtinë.
19. Jaus, Hans R. (1978), *Estetika recepcije*, Nolit, Beograd.
20. Jireqek, Konstantrin (2010), *Historia e serbëve, I, II*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë.
21. Markjevic, Henrik (1970), *Nauka o knjizevnosti*, Beograd.
22. Medvedev, P. (1976), *Formalni metod u nauci o knjizevnosti*, Nolit, Beograd.
23. Mukarзовski, Jan (1982), *Struktura, funkcija, vrednost*, Beograd.
24. Ostrogorski, Georg (2002), *Historia e Perandorisë Bizantine*, (botim i dytë), Dituria, Tiranë.

janë fare letërsi. Ky kriter mund të jetë patriotik, me rol kompensues të mungesave që kemi në literaturë e në kulturë, por filologjikisht nuk mund të jetë shkencor.

25. Qosja, Rexep (1979), *Prej tipologjisë deri te periodizimi*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
26. Qosja, Rexhep (1984/86), *Histori e letërsisë shqipe, (Romantizmi) I-III*, Rilindja, Prishtinë.
27. Rugova, Ibrahim / Hamiti, Sabri (1979), *Kritika letrare*, Rilindja, Prishtinë.
28. Stipçeviq, Aleksandër (2000), *Historia e librit*, Toena, Tiranë.
29. Sugar, Peter (2007), *Europa Juglindore nën sundimin osman (1354-1804)*, Dituria, Tiranë.
30. Shkreb, Zdenko / Stamaq, Ante (1983), *Uvod u knjizevnost*, Grafički zavod Hrvatske.
31. Ten, Ipolit (1954), *Studije i eseji*, Beograd.
32. Todorov, Cvetan (2007), *Letërsia në rrezik*, Buzuku, Prishtinë.
33. Tomasevski, Boris (1972), *Teorija knjizevnosti*, Beograd.
34. Zheji, Gjergj (1981), *Vëzhgime metrike*, Prishtinë, Rilindja.

TRYEZA

Sala AHMETAJ

PAVARËSIA DHE METAFORA VLORE

Pavarësi! Fjalë magjike e mbështjellë me madhësi. Por që në vete përmban edhe dramën e gjatë dhe të llahtarshme shqiptare. Përvjetor që i bashkon shqiptarët në shenjë nderimi për shumë figura të shquara të kombit, të cilat me gjakun dhe me dijen e tyre bënë që gjuha shqipe, flamuri, kultura dhe arti ynë të mos zhbëheshin, të mos shpërfytyroheshin e të mos plazmoheshin nga pushtuesit. Beteja e lëvizjes kombëtare bëhej në shumë rrafshë: luftarak, diplomatik e kulturor. Dhe kështu ishte bërë e qartë se shqiptarët bashkë me luftën për pavarësi bënë edhe luftën për gjuhën dhe alfabetin, bënë edhe luftën për shkollën laike shqipe. Pikërisht, dekada e parë e shek XX shpërfaqti një elitë politike, kulturore dhe luftarake që përpiqej në vazhdimësi dhe me largpamësi t'i udhëhojë zhvillimet kulturore dhe politike të kombit, t'i kufizojë ose pamundësojë tronditjet dhe shpërfytyrimet e vlerave kombëtare, shpesh duke mos pasur mundësi që të përmirësonin cilësinë e këtyre vlerave, e as të përcaktonin statusin e tyre. Mrekullisht, në ballë të kësaj lëvizjeje qëndronin Ismail Qemali, burri i urtë dhe i mençur i Vlorës dhe Hasan Prishtina, intelektual dhe luftëtari i përmasave të pakrahasueshme kombëtare. Kështu, pas mbledhjes së taksimit, nën udhëheqjen e këtyre dy kolosëve, u morën edhe detyra të qarta. Hasan Prishtina do të vinte në Kosovë dhe do të përgatiste kryengritjen e përgjithshme. Kurse I. Qemali bashkë me L. Gurkauqin do të shkonin në Evropë për të gjetur mbështetje, armë dhe ndihma të tjera për kryengritësit. Por ata nuk arritën që t'i siguronin armët dhe paratë. Në këto rrethana, H. Prishtina vendosi që t'i shesë pronat që kishte në Shkup dhe të fillonte përgatitjet për kryengritje. Në prill të vitit 1912, H. Prishtina vuri kontakte me konsullin britanik në Shkup dhe e njoftoi se kryengritja e përgjithshme shqiptare ishte e pashmangshme. Midis datës 5 dhe 20 maj, H. Prishtina takoi të gjithë krerët e krahinave të Kosovës dhe të Malësisë së Madhe. Kështu, pas kuvendit të Junikut (21-25 Maj 1912), ndodhi fillimi i suksesshëm i kryengritjes shqiptare dhe çlirimi i Pejës, i Gjakovës dhe i Prishtinës.

Si luftëtari dhe diplomati më i spikatur, vlerësoheshin nga diplomacia dhe shtypi perëndimor. Kështu, korrespondenti i gazetës the Times do të shkruante: "H. Prishtina që ishte shpallur udhëheqës gjeneral i kryengritjes kishte hyrë me 25 mijë veta në Prishtinë dhe përmes linjave telegrafike të komunikimit kishte vendosur kontakte me krerët e tjerë, si Abdyl Beun në Tiranë dhe A. Pashën në Elbasan, që do

të zbatonin instruksionet të cilat ai do t'ua dërgonte". (The Times London, July 23, 1912). Me këto fitore i paraqiti kushte komisionit të qeverisë turke të ardhur nga Stambolli. Kërkesa më e rëndësishme e H. Prishtinës ishte që të njihen zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë Etnike. Kërkesat e tjera nuk po i përmendim. Kurse hyrja triumfale në Shkup ishte fitore e rëndësishme që i detyroi turqit të pranonin kushtet e kryengritësve shqiptarë. U çliruan shumë territore nga Turqia. Por ndodhi përmbysja e rëndë dhe fatale, lufta ballkanike. Tokat shqiptare të çliruara rishtazi u ripushtuan nga shtetet fqinje edhe për shkakun e indiferentizmit të fuqive të mëdha ndaj këtyre zhvillimeve. Në këto rrethana aspak të favorshme për shqiptarët u shpall Pavarësia në Vlorë. Dhe ajo u shpall vetëm në një copëz Shqipëri. Copëzat e tjera si Kosova, që ishte zemra dhe shpirti i kryengritjeve për çlirim, Shkupi etj., u ripushtuan nga ushtritë ballkanike. Ironike, por edhe tragjike është edhe rruga e gjatë biblike e Isa Boletinit që të merrte pjesë në shpalljen e Pavarësisë dhe të përulej para Flamurit Kombëtar bashkë me shumë luftëtarë nga Kosova. Ky flamur dhe kjo liri qenë të ndaluara për 100 vjet në tokën e tij, sepse kjo gjysmë Shqipëri asnjëherë s'arriti të bëhej e plotë. Reale. E vërtetë. Por Shqipëria natyrale vazhdoi të jetojë vetëm në ëndrrat dhe në imagjinatën e shqiptarëve të robëruar.

Simboli dhe metafora Vlorë u bënë frymëzim dhe u shpërfaqën me idealizëm të shqiptarët, të cilët historia dhe fati i dënoi të jetonin jashtë kufijve të Shqipërisë shtet. Pra, shqiptarët i jetonin disa Shqipëri: njëra imagjinare dhe e pandarë, kurse tjetra reale, e vogël, e ligë që Vlorën as e madhëronte e as e idealizonte. Dhe së cilës i mjaftonte vetvetja e tillë çfarë ishte: pa fuqi, pa ndikim, pa strategji kombëtare për korrigjim të historisë. Kështu kishim disa Shqipëri të tjera (të robëruara), ose copëza Shqipërie që atdheun e projektonin të plotë vetëm emocionalisht, vetëm në imagjinatë, sepse, siç do të shprehej Markez, "atdheu është gjendje shpirtërore emocionale e jo gjeografi". Edhe shqiptarët e robëruar atdhe dhe Shqipëri e ndjenin gjithë tokën shqiptare, edhe pse historia i kishte përballur me fatin që të mos e shijonin lirinë dhe të mos e përmbajtësonin pavarësinë. Por kjo ëndërr dhe ky ideal nuk u shuan asnjëherë, por u shfaqën me forma dhe trajta nga më të ndryshmet. Me lëvizje kulturore, me aktivitete politike, me luftë, me veprimtari artistike, sepse "Kosova është gjaku ynë që nuk falet", do të thoshte poeti ynë, A. Podrimja.

Me qëndresë epike dhe të pandërprerë, me metafora dhe simbole rifreskohej kujtesa dhe ëndrra. Dhe pikërisht një prej metaforave ishte emri Vlorë që u vihej vazhdimisht. Në Kosovë ka qindra vajza me këtë emër. Kështu, metafora Vlorë vazhdonte të frymëzonte njerëzit në një mënyrë të veçantë, duke dashur që ta sillnim Vlorën midis nesh. Në shtëpi. Në familje. Në shkollë e kudo. Qoftë edhe vetëm si emër që ka simbolikën e pavarësisë dhe të Shqipërisë natyrale. Në këtë mënyrë ky emër shndërrohej në figurë, në simbol, që na e forconte shpresën që ta kemi edhe ne një Vlorë të vërtetë. Një Vlorë që do të rilindej e të rishfaqej duke u shtrirë në Kosovë, në qenien tonë si liri, si Pavarësi, jo imagjinare çfarë e kishim, por reale dhe

natyrale çfarë e donim. Sot edhe Vlorën edhe pavarësinë i kemi të vërteta, por me emra të tjerë falë luftës së UÇK-së që si ushtri e lirisë dhe dashurisë njerëzore mjetin kryesor të luftës e kishte idealin. Sot kombi shqiptar në këtë përvjetor vjen me dy Shqipëri si pasojë e një fati historik të keq për ta. Por meqë për shumicën prej nesh atdheu dhe shqiptaria janë gjendje shpirtërore dhe jo vijë politike ne jemi një. Jam e bindur se të gjithë ne e ndjejmë njësoj thënien e Isa Boletinit: "unë jam mirë kur asht mirë Shqipëria". Ndërgjegjja duhet të na thotë se Shqipëria është mirë vetëm kur janë mirë të gjithë shqiptarët.

Lush CULAJ

QEVERI E VLORËS NË MBROJTJE TË JUGUT TË SHQIPËRISË

Historia e çështjes lindore, si njëra ndër më të rëndësishmet e diplomacisë evropiane gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, ka pasur si pjesë përbërëse fatin e krahinave të banuara me popullsi shqiptare dhe synimet e shteteve të reja të Ballkanit për t'u zgjeruar në dëm të tyre.

Kryengritjet e shumta shqiptare dhe lufta Italo-Turke e kishin dobësuar pozitën e Turqisë në Evropën Juglindore, duke u krijuar kështu popujve të kësaj hapësire rrethana favorizuese për çrrënjosjen e plotë të sundimit turk. Zgjerimi i lëvizjes shqiptare dhe ideja e saj për ta krijuar një Shqipëri autonome ose të pavarur nuk përputhej me qëllimin e shteteve të Ballkanit që mezi prisnin t'ia jepnin grushtin e fundit Turqisë për ta ndarë më pastaj trashëgiminë e saj në Ballkan. Edhe shqiptarët ishin po aq të interesuar sa edhe popujt e tjerë të shtypur të Evropës Juglindore për t'u çliruar nga zgjedha turke. Përfaqësuesit e tyre bënë përpjekje për t'u lidhur më fqinjët në luftën e përbashkët antiosmane, por këto përpjekje dështuan për faj të krerëve të aleancës ballkanike, të cilët nuk dëshironin t'i kishin shqiptarët si palë me të drejta të barabarta në këtë aleancë. Ata ishin marrë vesh ndërmjet tyre për copëtimin e Shqipërisë dhe dëshironin që shqiptarët t'i përdornin vetëm si mish për top në luftën kundër Turqisë.

Planet aneksioniste të shteteve fqinje kundër Shqipërisë, që filluan të viheshin në jetë me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, ishin rezultat i një politike të pajustificueshme armiqësore ndaj një shteti fqinj, i cili kishte bërë një luftë heroike të pandërprerë kundër sundimit shekullor osman dhe që kishte treguar se ishte aleat i sigurt në luftë kundër armikut të përbashkët. Lufta e Parë Ballkanike e krijoi në Shqipëri një gjendje shumë të ndërlikuar dhe kontradiktore. Nga njëra anë në masat popullore vazhdonte të gjallëronte fryma e luftës kundër zgjedhës turke, nga ana tjetër po bëhej gjithnjë e më i qartë rreziku që po e kërcënonte Shqipërinë nga monarkitë ballkanike. Ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Juglindore, Shqipëria u ndodh me armikun e vjetër në vatër dhe e sulmuar nga agresorë të rinj.¹

Në periudhën e luftërave Ballkanike shqiptarët nuk kishin ende shtet më vete, ndaj edhe prania e faktorit shqiptar nuk mund të shprehej në plan shtetëror. Së pari,

¹. Historia e Shqipërisë, vëllimi i dytë, 490 - 493.

nuk ekzistonte as edhe një qendër unike drejtuese me struktura adekuate organizative. Megjithatë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare po përjetonte një fazë ringjalljeje të fuqishme, që shfaqej jo vetëm në shpërthimet e kryengritjeve të armatosura, por edhe nëpërmjet një veprimtarie të ndërgjegjshme politike që shënonte rritje. Vetë rrethanat ua diktuan shqiptarëve kapërcimin e kufizimeve lokaliste dhe krijimin e ideve globale në mbrojtje të tërësisë territoriale të interesave të përgjithshme kombëtare. Viti 1912 shënon një etapë të re vendimtare në zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare. Në gjysmën e parë të korrikut situata në Shqipëri karakterizohet nga një aktivizim i përgjithshëm i forcave kryengritëse, të cilat hidhen në sulm në të gjitha anët e vendit që nga Çamëria dhe Kolonja e Korçës e deri në Malësinë e Madhe e Kosovë.²

Kryengritjet e përgjithshme shqiptare, që shpërthyen nga Veriu deri në Jug gjatë viteve 1909-1912 dhe përpjekjet e patriotëve shqiptarë për ta shpallur pavarësinë e Shqipërisë, i nxitën qeveritë ballkanike për t'i filluar veprimet luftarake kundër forcave turke në territoret e tyre, në mënyrë që pastaj t'i realizonin ëndrrat e vjetra për copëtimin e trojeve shqiptare. Fillimisht, në luftë kundër ushtrisë turke hynë Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, kurse më 17 tetor edhe Greqia. Me veprimet e tyre luftarake synohej çlirimi i Selanikut, Manastirit, Janinës e Çamërisë dhe që pastaj të marshonin drejt trojeve të tjera shqiptare. Ende pa e pritur realizimin e këtyre objektivave, më 28 tetor 1912, anijet greke hynë në gjirin e Vlorës dhe filluan bombardimin e skelës. Më 21 nëntor ushtritë greke filluan pushtimin e krahinave përreth Vlorës, por kundër këtij hapi u ngrit në këmbë popullsia vendase. Për drejtimin e veprimeve luftarake mbrojtëse u krijua një komision me qendër në Vranisht nën udhëheqjen e Eqrem Syrjait. Luftime të ashpra ndërmjet forcave shqiptare dhe agresorëve grekë u zhvilluan në Kuç, Tërbaç dhe Dukat.³

Fitoret e rrufeshme të shteteve ballkanike i detyruan Fuqitë e Mëdha të rishikonin vendimin e tyre për të mos lejuar prishjen e status quo-s në Ballkan. Në Shqipëri, ushtritë armike përparuan nga veriu, lindja dhe jugu, duke ia futur popullit tmerrin me vrasje, djegie dhe plaçkitje. Në këto kushte e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes shqiptare ishte ajo e shpalljes së pavarësisë.

Akti i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, bëri një kthesë të madhe si një ngjarje e shënuar në historinë kombëtare. Kështu përfundoi epoka prej afro pesë shekujsh e sundimit osman, e përpjekjeve dhe luftërave për çlirim kombëtar dhe u hap një epokë e re ajo e mëvetësisë së Shqipërisë.⁴ Shpallja e

² Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë, 1978, f. 98.

³ Apostol Kotani, Qëndresa popullore përballë agresorëve grekë 1912-1916, ASD, Tiranë, 2003, f. 38.

⁴ Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, (28 nëntor 1912-janar 1914), Tiranë, 1963, f. 34; Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh, Tiranë, 1982, dok. nr. 2, f. 231.

pavarësisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë ishte fitore e përbashkët për gjithë popullin shqiptar, për të gjitha forcat që kishin marrë pjesë në luftë për çlirim kombëtar me pushkë dhe me penë nga Kosova në Veri e deri në Çamëri në jug, nga Adriatiku e Joni në Perëndim e deri në Kërçovë, Shkup e në Kumanovë në Lindje, si dhe për të gjithë shqiptarët e diasporës kudo në botë.⁵ Megjithatë, Qeveria e Vlorës e filloi veprimtarinë e saj në rrethana tejet të vështira ndërkombëtare, në kohën kur Lufta e Parë Ballkanike po vazhdonte. Në fillim të dhjetorit të vitit 1912 e tërë Kosova, Shqipëria Veriore, Lindore dhe ajo e Mesme, deri në lumin Shkumbin, ishin pushtuar nga ushtritë serbe e malazeze. Vetëm Shkodra vazhdonte ende rezistencën, por edhe ajo gjendej e rrethuar. Në Jug, ushtria greke e kishte rrethuar Janinën, kishte pushtuar Çamërinë dhe po marshonte drejt territoreve të tjera të Shqipërisë së Jugut. Ushtria greke kishte zbarkuar gjithashtu në Sazan dhe Himarë, kurse flota greke e kishte bllokuar gjithë bregdetin e Jugut. Në rrethanat e krijuara Qeveria e Vlorës fillimisht e shtrinte pushtetin e saj në një territor tepër të kufizuar, që përfshinte Vlorën, Fierin, Lushnjën, Beratën dhe Gjirokastrën, ku ndodheshin ende ushtri turke të tërhequra nga fronte të ndryshme.⁶

Më 16 dhjetor 1912 grekët bombarduan Vlorën dhe prenë kabllon telegrafike Vlorë – Otranto – Bari me qëllim që t’ia pamundësojnë Qeverisë së Vlorës komunikimin me Fuqitë e Mëdha. Ndërkohë, trupat tokësore greke kishin hyrë në Himarë dhe Delvinë; ndërsa forcat serbe pasi pushtuan Manastirin, bashkë me ushtrinë greke, pushtuan edhe Pespën, Follorinën dhe depërtuan në Devoll, në zonën Bilisht -Poloskë. Fshatrat e Devollit, të banuara me shumicë nga myslimanë, iu nënshtruan plaçkitjeve, djegieve dhe masakrave. Nuk u kursyen as banorët ortodoksë që kundërshtonin planet aneksioniste të grekëve. Gjithsesi që u pengonin edhe librat shqip të Bibliotekës së qytetit të Korçës, duke djegur publikisht mijëra prej tyre. Për ta nënshtruar popullsinë, grekët organizuan në Korçë policinë, së cilës i printe oficeri Angjelidhis. Pas ca ditësh organizuan edhe pushtetin e prefekturës, gjykatës dhe policinë financiare. Përmes këtyre organeve, ata ndoqën, burgosën dhe dënuan një numër patriotësh që ishin deklaruar kundër pushtimit grek. Gjithashtu, nga popullata e varfër e qytetit filluan të vilnin edhe taksa. Grekët e shtrinë pushtimin edhe në Voskopojë, Vakëf e deri në veri të Panaritit.⁷ Në këto luftëra aleatët ballkanikë përfituan territore të mëdha. Në krahasim me periudhën e paraluftës, ndryshimet demografike në përfundim të Paqes së Bukureshtit, më 1913, të shprehura në përqindje të zgjerimit në favor të shteteve ballkanike, ishin: Bullgaria 29 për qind territor dhe 3 për qind popullsi më shumë, Mali i Zi 62 për qind territor dhe qind për qind më shumë popullsi, Greqia 68 për qind territor dhe 67 për qind popullsi më shumë, ndërsa Serbia 82 për qind territor dhe 55 për qind

⁵. Historia e popullit shqiptar për shkolla të mesme, “Rilindja”, Prishtinë, f. 135.

⁶. Po aty, f. 136.

⁷. Apostol Kotani, vep. cit., f.39.

popullsi më shumë.⁸ Këtyre përfitimeve u kishte paraprirë marrëveshja e aleatëve ballkanikë për ndarjen e territoreve shqiptare dhe maqedonase.

Me gjithë kërkesën e Qeverisë së Vlorës, as Fuqitë e Mëdha dhe as shtetet fqinje ballkanike fillimisht nuk e njohën pavarësinë e Shqipërisë. Problemi i shtetit të krijuar shqiptar dhe i shtrirjes së tij territoriale ishte në qendër të vëmendjes të shteteve ballkanike dhe evropiane dhe, për shkak të interesave të tyre të ndryshme, përbente një problem të rëndësishëm e të vështirë për ta zgjidhur. Nga Fuqitë e Mëdha interesim të veçantë për këtë problem paraqisnin Austro-Hungaria, Italia dhe Rusia. Dy të parat ishin të interesuara për një Shqipëri autonome, ose të pavarur me kufij sa më të gjerë në mënyrë që të pengohej zgjerimi i shteteve sllave drejt Ballkanit Perëndimor; kurse, nga ana tjetër, Rusia ishte e interesuar për një copëtim të ri të tokave shqiptare dhe për ndarjen e tyre ndërmjet shteteve fqinje. Përmes zgjerimit territorial të shteteve sllave, Rusia tentonte ta shtrinte ndikimin e saj në këtë pjesë të rajonit.⁹

Qeveria e Përkohshme e Vlorës e kuptoi qartë rrezikun e madh që i kanosej vendit nga ushtria greke. Sado që qeveria e Vlorës i kishte porositur krahinat e Jugut që të organizonin mbrojtjen e kufijve nga rreziku grek¹⁰, sado që Ismail Qemali, bashkë me njoftimin e shpalljes së Pavarësisë, i porosiste krahinat jugore të forconin vijën e mbrojtjes për t'u bërë ballë armiqve që synonin copëtimin e tokave shqiptare; sado që Qeveria e Vlorës ishte thellësisht e interesuar që marshimi i forcave greke drejt veriut të pengohej me të gjitha mjetet dhe që qëndresa e Janinës, ku një pjesë të garnizonit e përbënin ushtarët shqiptarë të vazhdonte sa më gjatë¹¹ – rezistenca në ato kushte ishte shumë e vështirë. Qeveria e Përkohshme e Vlorës, duke parë se Qeveria greke vazhdonte të ngulmonte gjithnjë e më shumë për ta shtënë në dorë Janinën, dërgoi atje një përfaqësi të veten të kryesuar nga Mithat Frashëri. Përfaqësia arriti në Janinë më 13 janar 1913 dhe ndërmori të gjitha masat e mundshme për ta ngritur fuqinë mbrojtëse rreth saj. Ndër masat më të rëndësishme ishte dërgimi, përkrah mbrojtësve të deriatëhershëm të Janinës, edhe i dy taborrëve të Gjirokastrës dhe Tepelenës.¹² Në gjysmën e dhjetëditëshit të tretë të janarit të vitit 1913 Ushtria greke iu afrua brezit mbrojtës të Janinës.

Përveçse ishin numerikisht të paktë, përveç pamjaftueshmërisë së municioneve, ushqimeve dhe pajisjeve të tjera të domosdoshme, shqiptarët vuanin edhe nga vendstrehimet e këqija dhe të ftohtët e madh.¹³

⁸ Paskal Milo, Shqipëria dhe Jugosllavia 1918 - 1927, Tiranë, 1992, f. 21.

⁹ Historia e popullit shqiptar për shkollat ë mesme, vep. cit., f. 138.

¹⁰ Apostol Kotani, vep. cit., f. 44.

¹¹ Abas Ermenji, vep. cit., f. 319.

¹² Ibrahim D. Hoxha, Çamëria dhe Janina 1912-1922, Tiranë, 1996, f.

¹³ Po aty, f. 42.

Luftime të ashpra vazhdonin edhe në pjesë të tjera të Çamërisë. Mirëpo dërrmimi i njësisë ushtarake greke në mes Delvinës dhe Sarandës, si dhe flakja e saj përtej ngushticës detare në Korfuz ishte një grusht tejet i rëndë për parashikimet greke. Deri në fund të vitit 1912 mbrojtja e Çamërisë u ishte lënë barrë vetëm çamëve, të cilët, duke qenë disa herë më të paktë numerikisht kundruall sulmuesve, si dhe me armatime të dobëta, po qëndronin me shpirt në dhëmbë. Në rrethana të tilla u bë edhe mbrojtja e Shkallës së Paramithisë, në të cilën përbindëshat grekë u vërtitën me ngulm, pasi ajo përbën njëjën më me rëndësi ndërmjet Çamërisë dhe Janinës, si porta kryesore e anës lindore për të hyrë në Paramithi.¹⁴

Në ndihmë të mbrojtësve të Shkallës së Paramithisë shpejtuan të vinin qindra luftëtarë nga pjesët e tjera të Çamërisë së Mesme e Veriore. Duke tentuar shpëtimin e vendit dhe popullsisë, Hamdi Bej Filati njoftoi Ismail Qemalin mbi rrezikun e pushtimit të tërë Çamërisë nga grekët, me ç’rast theksonte: “Çamëria është lënë pa ushtarë e pa municione, në duar të armikut, ka tetë ditë që po luftohet deri brenda në qytete. Në vend të shumë burrave me emër nga populli që dhanë jetën, po shtrëngohen gratë të rendin në luftë. Ndihma në municione dhe ushtarë e kërkuar nga disa përfaqësues çamë në Gjirokastër, Himarë, Berat, Sarandë nuk na erdhi. Ju bëj të ditur gjendjen e Çamërisë, e cila ndodhet në orët e fundit dhe pres të më jepni mendimin tuaj”.¹⁵ Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali, për t’u ardhur në ndihmë mbrojtësve të Janinës kishte dhënë urdhër që çeta e Salarisë, me Selamin në krye, të nisej urgjentisht në mbrojtje të Janinës.¹⁶ Nevoja urgjente e mbrojtjes së tokave shqiptare nga agresori grek e detyroi Qeverinë e Vlorës të provonte të bënte marrëveshje me komandantin e garnizonit turk të Janinës, Esat Pashë Janina, një shqiptar i turqizuar. Qeveria e Vlorës për ta bindur që ta ngriste flamurin shqiptar i premtoi atij ndihmë porsa t’i krijoheshin mundësitë. Por ky s’deshi ose s’mundi ta vazhdonte qëndresën dhe ua lëshoi Janinën grekëve më 6 mars 1913. “Komisionet e mbrojtjes që u formuan në krahina të ndryshme luajtën rol të rëndësishëm për mobilizimin e vullnetarëve për luftë. Çetat vullnetare zhvilluan luftime të përgjakshme me pushtuesit grekë, sidomos në sektorin e Oparit, ku i thyen keqas armiqtë. Këto veprime nuk ishin në gjendje ta ndalnin marshimin e trupave greke, të cilat hynë në Janinë, sepse uria dhe mungesa e municioneve e kishin dobësuar fuqinë luftarake për mbrojtjen e Janinës. Kështu, më 7 mars 1913, armata greke hyri në Janinë, ku u kapën shumë robër që ishin duke e mbrojtur atë.

Rënia e Janinës shkaktoi dhembje të madhe te mbarë populli shqiptar. Me rënien e saj iu hap rruga forcave të shumta greke që të marshonin drejt Jugut të Shqipërisë dhe kështu brenda marsit pushtuan Ersekën, Leskovikun, Permetin,

¹⁴ Po aty, f. 78.

¹⁵ Dokumente për Çamërinë 1912-1939, përgatitur nga dr. Kaliopi Naska, Tiranë, 1999, f. 1.

¹⁶ Ferhat Cakaj, Fal gjakun e vëllait dhe bashkon çetën e Selarisë, “Shekulli”, 18 qershor 2000, f. 8.

Gjirokastrën, Sarandën dhe arritën deri afër Beratit.¹⁷ Të dhënat dëshmojnë se gjatë pushtimit ushtria greke kishte vrarë, shkatërruar dhe terrorizuar popullsinë vendase. Ja ç' shkruhet në një letër të kësaj kohe: "Populli i Çamërisë thërret e kërkon ndihmë vazhdimisht që të forcohet me rezerva të mjaftueshme vullnetarësh e municionesh". Sipas letrave të kësaj kohe dëshmohej se popullsia çame e shikonte Qeverinë e Përkohshme të Vlorës si rastin e vetëm të shpëtimit nga gllabërimi i grekëve, të cilët sillleshin pa mëshirë, sidomos kundër popullatës muhamedane. Ja se si shprehet popullsia çame lidhur me veprimet e dhunshme të grekëve dhe bandave të tyre ndaj popullsisë shqiptare: "Ushtritë greke prenë telat e telegrafës, prishën gjithë urat që ndodhen në krahinën e Çamërisë dhe të Delvinës. Komitetë grekë, jo vetëm janë duke grabitur dhe shkatërruar pasuritë dhe pronat, por janë duke përdhunuar gratë, vepër të cilën nuk e kanë bërë as popujt e paqytetëruar të mesjetës, si dhe kanë vrarë dhe therur në mënyrë mizore fëmijë, para syve të prindërve të tyre".¹⁸

Pavarësisht nga depërtimi grek në trojet shqiptare, edhe pse në rrethana shumë të tendosura, Qeveria e Vlorës nuk pranonte të jepej. Ajo i porosiste krahinat e jugut që ta organizonin mbrojtjen nga rreziku grek. Në telegramin që ajo ua drejtonte krahinave jugore, ndër të tjera, porosiste: "Është e nevojshme që vija e kufirit të fortifikohet më tepër se përpara, kështu që të mbahet një qëndrim mbrojtës... Mblidhni menjëherë ushtarët që janë shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre dhe i mbani në dispozicion, në pritje të urdhrit që do të vijë së këndejmi."¹⁹ Ndërkohë Qeveria e Vlorës mori masa për shtrirjen e aktivitetit të saj edhe në krahina të tjera në jug dhe në veri të vendit. Në përgjigje të kësaj thirrjeje u ngritën në këmbë një sërë çetash patriotike në të gjitha krahinat e jugut, në Gjirokastrë, Kolonjë, Përmet, Leskovik, Korçë, Skrapar, Tepelenë, të udhëhequra nga patriotë të shquar që kishin luftuar edhe më parë kundër sundimit turk, siç ishte Kamber Bënja, ish-oficer në xhandarmëri, i cili, kur u shpall pavarësia kombëtare, u vu në dispozicion të Qeverisë së Vlorës që e ngarkoi atë me detyrën që t'i udhëhiqte forcat e xhandarmërisë dhe të vullnetarëve kundër sulmeve greke. Luftoi me trimëri dhe tregoi aftësi të rralla ushtarake në Kolonjë të Kurveleshit, në brigjet e Alipostivanit, bashkë me Bilal Alipostivanin, me ç' rast forcat shqiptare i detyruan grekët të tërhiqen dhe të fortifikohen në Përmet.

Lesko Raça ishte njëri ndër udhëheqësit e kryengritjes antiturke të fillimit të shekullit XIX. Kur u shpall pavarësia e Shqipërisë, ai, me çetën e tij, u vu në dispozicion të Qeverisë së Vlorës dhe gjatë viteve 1913-1914 u përlesh me bandat shoviniste greke nga Skërfica në Kalasë dhe nga Delvina në Konispol.

¹⁷ Ibrahim D Hoxha, Çamëria dhe Janina, vep. cit., f. 47; Apostol Kotani, vep. cit., f. 44.

¹⁸ Dokumente për Çamërinë, vep. cit., f.1-2.

¹⁹ Historia e Shqipërisë, vëllimi i dytë, f. 152.

Muharrem Rushiti ishte njëri ndër komandantët më të shquar të luftërave për liri e kundër sundimit turk. Edhe në ngjarjet e viteve 1913-1914 tregoi trimërinë e tij kundër forcave greke që hynë në krahinën e Delvinës dhe të Konispolit.

Mirëpo, pikërisht në kohën kur Qeveria e Vlorës, nëpërmjet këtyre masave, po përpiqej që ta organizonte administratën shtetërore, civile dhe ushtarake, kur bashkimi i gjithë vendit rreth Qeverisë së Vlorës ishte më se i nevojshëm, Esat Pashë Toptani, duke i vënë në rend të parë interesat personale kundruall atyre kombëtare, pasi ua dorëzoi Shkodrën malazezve, nisi veprime të hapura dhe konkrete kundër Qeverisë së Vlorës, megjithëse ajo i kishte dhënë një post ministri. Më 12 tetor 1913 ai shpalli formimin e “Pleqësisë” së Shqipërisë së Mesme dhe e filloi luftën kundër Qeverisë së Vlorës, duke grumbulluar rreth vetes të gjithë elementët reaksionarë. Pozita e Qeverisë së Vlorës u bë edhe më e rëndë dhe më e ndërlikuar kur filluan presionet dhe rreziqet e jashtme. Në këto rethana përfituan edhe forcat reaksionare brenda vendit, të cilat hynë në Vlorë. Më 22 janar 1914 Qeveria e Vlorës dha dorëheqjen, e nxitur jo vetëm nga presioni i forcave të brendshme reaksionare, por edhe nga presioni i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Dorëheqje dha edhe “Pleqësia” e Durrësit. Drejtimin e vendit e mori princi gjerman Vilhelm Vidi i caktuar nga Fuqitë e Mëdha të Evropës.²⁰

Princ Vidi, posa arriti në Shqipëri, ndër probleme të tjera të shumta, u përball me tragjedinë e pjesës jugore të vendit, të cilën Greqia e kishte shndërruar në thertore të njerëzve.²¹

²⁰ Apostol Kotani, vep. cit., f. 44 - 46.

²¹ Tajar Zavalani, Histori e Shqipnis, PHOENIX, 1998, f. 238.

Xheladin SHALA

SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË DHE ROLI I KOSOVËS

Derisa në fund të verës dhe në fillim të vjeshtës së vitit 1912, nga njëra anë, shihej shkatërrimi i sistemit okupues otoman në tokat shqiptare, në anën tjetër, ushtritë e katër shteteve të Aleancës Ballkanike - të Serbisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Malit të Zi donin t'ia zinin frymën e idesë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare mu në prag të çlirimit dhe të pavarësisë së Shqipërisë natyrale. Në rrethana të tilla, udhëheqësit e popullit shqiptar, u detyruan që, nga lufta për Autonomi të kërkuar me ngulm në Kryengritjen e Madhe Shqiptare në verë të vitit 1912, të kalojnë në një fazë më të lartë të organizimit; në kërkesën për pavarësi të Shqipërisë. Ai qëndrim u shtrua si imperativ i kohës, meqenëse toka të tëra shqiptare në vjeshtë të atij viti i përfshiu papritmas pas shpine shtrëngata e re e Luftës së Parë Ballkanike, por edhe si rezultat i mosplotësimit të kërkesave të shqiptarëve pas kryengritjeve të njëpasnjëshme shekullore kundër sundimit otoman.

Kështu që, pas ngjarjeve të stuhishme të zhvilluara në muajt tetor dhe nëntor të vitit 1912, detyrë e ditës, pos rezistencës, ishte edhe organizimi për shpalljen e pavarësisë, pasi që të katër shtetet ballkanike, pa marrë parasysh faktet historike dhe etnike, i shfaqën haptas, pa të drejtë, pretendimet e tyre për pushtimin dhe zhdukjen e Shqipërisë nga harta gjeografike.

Andaj, në Mbledhjen e njohur historike të Shkupit më 14 tetor 1912, një delegacion i formuar u autorizua që në krahinat e vizituara të propagandohej për organizimin e një Kuvendi Kombëtar, i cili do të vendoste për fatin e Shqipërisë. Mirëpo, furtuna e Luftës së Parë Ballkanike i bëri pengesa të mëdha delegacionit dhe ia theu tehun e aksionit kombëtar. Duhet theksuar se, ajo ishte iniciativa e parë e brendshme, pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike më 8 tetor 1912, për organizimin e çështjes së përgjithshme shqiptare. Kështu, si nismë e tillë ka peshën dhe rëndësinë e vet kombëtare, që duhet të zërë vend meritore në historiografinë shqiptare.

Asokohe, në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, si më aktiv ishin këta propagandues atdhedashës: Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Bajram Curri, Sait

Hoxha, Bedri Pejani, Mithat Frashëri, Rexhep Mitrovica, Sali Gjuka, Rrok Berisha, Halim Gostivari, Sali Tetova, Qerim Begolli, Ymer Strazimiri etj.¹

Sigurisht, nën ndikimin e propagandës së Ismail Qemalit me bashkëpunorë dhe të “Shoqërisë së Zezë për Shpëtim” të Shkupit nga personalitetet e njohur kombëtar të sipërshënuar, që nga data 25 deri 28 nëntor, në Elbasan, Tiranë, Durrës dhe në qytetet tjera të Shqipërisë edhe para mbledhjes së Kuvendit Kombëtar në Vlorë u bë shpallja e pavarësisë, duke u ngritur flamuri kuq e zi me shqiponjën dy krenare.²

Andaj, në momentet tepër të vështira për popullin shqiptar, pasi që ideologu kryesor i Shqipërisë së Sipërme apo Shqipërisë veri-lindore, Hasan Prishtina, ishte zënë peng dhe izoluar në Kështjellën e Beogradit, ideologët e mirënjohur, Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi, vendosën t’i dalin përballë rrezikut të quajtur – Lufta e Parë Ballkanike, si veprim pushtues, dhe në bashkëpunim me patriotët tjerë e Shpallën Pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 në Vlorë. Ajo ditë, për çështjen shqiptare u konsiderua si një ogur i bardhë, si një shpresë për dalje nga errësira dhe kërcënimi shfarosës i një robërie të re më të rrezikshme se e përparmja.

Duhet theksuar se në Vlorë, në Kuvendin Kombëtar, thuaja se nëpër flakë të pushkës, morën pjesë shumica e përfaqësuesve legjitim të krahinave etnike shqiptare, duke u deklaruar lirshëm për Pavarësinë e Shqipërisë Etnike. Mirëpo, Konferenca e ambasadorëve në Londër nuk i përfilli vendimet e saj kombëtare. Megjithatë, për ne 28 Nëntori i vitit 1912, është si datë më e shënuar deri më tani në historinë e popullit tonë, datë, kur u ngrit pas shumë shekujsh flamuri kombëtar dhe Shqipëria u shpall Shtet i pavarur që, sivjet po e festojmë 100 vjetorin e saj.

Vilajeti i Kosovës, me 32.900 km², në ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, u përfaqësua nga Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Mithat Frashëri dhe Sali Gjuka.

Mirëpo, në punimet e Kuvendit Kombëtar në Vlorë, rezulton se nga Kosova konsiderohen edhe shtatë delegatë të tjerë, të cilët ishin: Isa Boletini, Mehmet Pashë Deralla, Riza Bej Gjakova, Zenel Begolli, Hajdin Draga, Qerim Begolli dhe Dervish Bej Ipeku.³

Prej personaliteteve të shquara që nuk morën pjesë për shkaqe objektive ishin: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Idriz Seferi, Sait Hoxha, Nexhip Draga, Elez Isufi, Aqif Elbasani etj.

Faktori kryesor dhe vendimtar, që solli shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë qenë lëvizjet dhe kryengritjet e shqiptarëve, sidomos ato të viteve 1908-1912, të cilat

¹ Prof. dr. Hakif Bajrami, Si e okupoj Serbia Kosovën më 1912, Prishtinë 2003, 175

² “Obzor”, 29-XI-1912, Zagreb; Prof.dr.Xheladin Shala, Çështja shqiptare dhe diplomacia serbe 1912-1913, Prishtinë 2006, 117-118.

³ Bardhosh Gaçe, Ata që shpallën pavarësinë kombëtare, Tiranë 2002, 5

për djep patën Kosovën e trimërive, vuajtjeve dhe tragjedive të mëdha si rrallë ndonjë territor e popull tjetër në rruzullin tokësor.

Me të drejtë mund të themi se faktori shqiptar, sidomos ai në Kosovë, luajti rol vendimtar, duke ia hapur rrugën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Për më tepër, ky faktor luajti një rol të rëndësishëm dhe aktiv në rrafshin ndërkombëtar. Populli shqiptar, sidomos ai në Kosovë, nuk qe një element pasiv që shikon vetëm t'u përshtatej konjunkturave. Përkundrazi, ai qe një element i gjallë dhe aktiv, i cili e elektrizoi në shkallën më të lartë gjendjen e Gadishullit Ballkanik. Aleanca famëkeqe e katër shteteve Ballkanike me luftën e tyre shpejtuan ta shfrytëzonin këtë element për interesat e veta në përputhje me interesat e ngushta, megjithëse ata, në vend që ta mbështesnin dhe ta çonin përpara Kryengritjen që shpërtheu në pranverë të vitit 1912 në Ballkanin Qendror dhe Perëndimor, shpejtuan të përfitonin nga kërkesat e shqiptarëve pa llogaritur fare interesat kombëtare të tyre.⁴

Vërtet, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja e Pejës Besa-Besë, sidomos nga lëvizjet dhe kryengritjet e mëdha shqiptare gjatë viteve 1908-1912, kundër politikës asimiluese të osmanizimit nga qeveria xhonturke, që për epiqendër e kishin Kosovën, ndikuan drejtëpërdrejtë në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Kosova ishte territori kryesor i luftës kundër pushtimit osman në Shqipëri dhe në Ballkan, gjë që praktikisht e shtroi rrugën e pavarësisë.

Me këtë rast, duhet theksuar në mënyrë të veçantë një proklamatë të lëshuar mu në vllugun më të madh të Kryengritjes në Kosovë më 17/30 korrik 1912 nga ana e atdhetarëve të vërtetë të Kosovës për liri e pavarësi. Aty theksohet se Kryengritja në Kosovë, si trevë e madhe e Shqipërisë, është e tëra në dorë të kryengritësve, gjë që kërkohet të mbahet një Mbledhje mbarëkombëtare nga shqiptarët e katër vilajeteve të Shqipërisë. Gjithashtu, kërkohet prej të gjitha qyteteve shqiptare të zgjidhen delegatët më atdhetarë që t'i jepet fund çështjes sipas dëshirës së shqiptarëve të vërtetë.⁵ Kjo proklamatë ka peshën dhe rëndësinë e veçantë për

⁴ Gazmend Shpuza, Në prag të Pavarësisë, New York 1999, 74

⁵ Eqrem Zenelaj, Çështja shqiptare nga këndvështrimi i diplomacisë dhe gjeopolitikës austro-hungareze (1699-1918), Prishtinë 2010, 330; Thirrje e atdhetarëve të vërtetë të Kosovës për liri më 1912. Vëllazën të dashtun: “Krejt Shqiptarëve q’i dhem shpirti për Atdhe e Kombësi e q’i përpiqen për fitimin e të drejtave kombëtare, jemi të sigurtë se do të interesohen me randësi për kryengritjen e soçme tuj shpresue q’i të marrin fund mbas dëshirit e qëllimit të Shqiptarëve të vërtetë. Kryengritja në Kosovë, si po shifni vëllazën, sot bani një hap të madh e krejt kjo trevë e madhe e Shqypënisë (Kosova, Xh.Sh.) asht në dorë të kryengritësve. Qeverija (Osmane, Xh.Sh.) tuj pa bashkimin e vullnetin e fortë të Shqypëtarëve, ka dërgue një komision nga Stambolli në Prishtinë me anën e të cilit don me lidhë me një pe të kalbun marrëveshje me kryengritësit, tue i rrejtun disa shqypëtarë me të shpërndamit të parlamentit e disa lajka të tjera. Mirëpo një shumicë e madhe nga kryengritësit e prisat e tyne – ata që janë shqiptarë të vërtetë – kërkojnë e dëshirojnë që të bahet një mbledhje nga shqypëtarët e katër vilajeteve të Shqypënisë, e si ta shofin me udhë delegatët e krejt Shqypënisë, ato të drejta e privilegje të kërkohen nga qeverija. Ju lutemi pra, vëllazën të dashtun në kjoftë që vendoset

historinë e popullit tonë që liria dhe pavarësia është kërkuar edhe para fillimit të luftërave ballkanike. Prandaj, kjo ngjarje gjithësesi në të ardhmen duhet të zërë një vend të merituar në historiografinë tonë kombëtare.

Bijtë e Kosovës heroike e liridashëse, të udhëhequr nga strategë të luftës popullore si Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi e shumë të tjerë, shkruan faqe lavdie e trimërie në vitet 1908 – 1912, të cilat mbeten të pashlyera në ndërgjegjen e mbarë kombit, i cili i ka përjetësuar ato në vargje epike. Shtypi i kohës, jo vetëm ai shqiptar, por edhe shtypi i huaj, i krahasoi betejat e Kaçanikut e të Carralevës me betejën e Termopileve të epokës së lashtësisë.⁶ Pra, Grykat legjendare të Kaçanikut dhe të Carralevës gjëmuan fuqishëm, zëri i të cilave i kaloi kufijtë etnikë shqiptarë dhe më gjerë në Ballkan dhe Evropë.

Me të drejtë duhet të theksojmë se lidhja e ngushtë që ekzistonte midis lëvizjeve dhe kryengritjeve të mëdha shqiptare të viteve 1908-1912 dhe shpalljes së pavarësisë nuk i është dhënë një vend me rëndësi të veçantë në historiografinë tonë, sidomos roli i Kryengritjes së Madhe Shqiptare në Kosovë më 1912 që ndikoi drejtpërdrejtë për ta merituar Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912.

Pastaj, në mbledhjen e njohur të Shkupit më 14 tetor 1912 nuk qe i lehtë dhe i thjeshtë përcaktimi i atdhetarëve të vërtetë që morën vendime jashtëzakonisht të drejta lidhur me luftën e katër shteteve ballkanike, pastaj ndaj Perandorisë Osmane dhe opinionit ndërkombëtar. Pra, u mbajt qëndrim shumë i drejtë historik dhe më realist për kohën, gjë që edhe pas 100 vitesh nuk mund të kemi asnjë vërejtje, por që pabesia e sllavo-ortodoksëve dhe forca e bëri të vetën.

Me këtë rast po e potencojmë se Shkupi, si kryeqytet i Vilajetit të Kosovës, për tetë dekada ishte qyteti më i madh i banuar me shqiptarë në Ballkan. Vetëm pas lëvizjeve demokratike në vitet 90 të shekullit të kaluar ia tejkaloi Tirana, përkatësisht pas luftës së fundit të Kosovës kundër Serbisë 1997-1999 u rradhit Prishtina si e dyta me më shumë banorë shqiptar.

Prandaj, që shqiptarët e Kosovës kanë marrë pjesë aktive në të gjitha luftërat për çlirimin dhe bashkimin në një shtet të lirë nacional të të gjithë popullit shqiptar, është një fakt historik që nuk mund të kundërshtohet nga askush. Mirëpo, pas luftës ballkanike të viteve 1912-1913, atëherë kur një pjesë e Shqipërisë merrte njëfarë independence, Kosova, kjo tokë shqiptare u dënua prej Fuqive të Mëdha të mbajë në kurriz një zgjedhë të re shumë më gjakpirëse se e përparshmja – zgjedhën militariste serbomadhe. Mjerisht, këtë popull, prej më se një milion shqiptarësh – do të thotë

nga kryengritësit këjo mbledhje, kur të grishen (thirren, Xh.Sh.) nga qyteti a viset tuaja delegatët, të përpiqeni me mish e me shpirt që të dërgoni njerëz atdhetarë me randësi që t'i jepet fund çashtjes sonë mbas dëshirit të shqypëtarëve të vërtetë. Ju përqaftim atdhetarisht: **ATDHETARËT E VËRTETË TË KOSOVËS** – Kosovë, 17/30 korrik 1912 / 1328.

⁶ Gazmend Shpuza, Në prag të Pavarësisë, New York 1999, 85-86

gjysma e tij, në vend të lirisë më se të merituar si askush tjetër në Ballkan, traktatet e Fuqive të Mëdha evropiane e lanë nën një sundim tjetër,⁷ shumëfish më të vrazhdë se ai i përparmi.

Thënë shkurt, diplomacia e fuqive evropiane e shkeli me dy këmbë popullin shqiptar në formën më tragjike më 1878 dhe më 1913, duke e lejuar ushtrinë serbo-malazeze, të ndihmuar në mënyrë të veçantë nga rusët dhe francezët etj., që ta shkretërojnë dhe djegin çdo pëllëmbë të tokës shqiptare, e cila ishte shkatërruar dhe ende tymonte nga ekspeditat e ushtrisë së Durgut Pashës.⁸

Megjithëse, “Kosova na përket (shqiptarëve dhe Shqipërisë, Xh.Sh.) nga të gjitha pikëpamjet. Nga do që ta shikosh këtë vend, nga as një anë nuk ka njollë të huaj. I mjeri parim i kombësisë kurrë nuk e kapërceu pragun e konferencës, ku u diskutue fati i ynë” – shkruante shtypi shqiptar i kohës. “Zonjës Evropë i mungon ndërgjegjja, rrënimet nuk i mohon, gjakderdhja nuk e tund, për të drejtat nuk kujdeset... Evropa fort mirë e din se si mund të qetësohet Ballkani... qetësija themelohet përgjithësisht vetëm me sjellje të vërteta, gjykim të drejtë, tuj marrë në kujdes etninë e thjeshtë, historinë e vërtetë dhe ekonominë e popullit”.⁹

Pa dyshim, politika pansllaviste e Rosisë, e ndjekur nga piunët e vet në Ballkan ngadhënjëu gjatë viteve 1912-1913. U fituan kufijtë ashtu sikur kishin ëndërruar dhe lakmuar për afro një shekull serbomédhejt dhe grekomanët. Kështu që, vështirësi të reja e të mëdha i ranë mbi supë këtij populli rreth nëntë dekada, megjithëse pas gjysmës së shekullit XIX Kosova kishte qenë toka më e përgjakshme dhe më e rëndësishme e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila dha kontribut vendimtar në lëvizjet dhe kryengritjet e njohura para dhe në prag të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912.

Kosova këmbënguli që të përfshihej brenda shtetit shqiptar, ku e meritonte të mbetej dhe ku e kishte vendin në aspektin historik e gjeografik. Mirëpo, ndaj Kosovës u bë një lojë e ndyrë, e pabesë, e mashtrimit dhe e tradhëtisë, duke ia futur këmbët në prush të ndezur rreth një shekull.

Serbia, Mali i Zi dhe Rusia që në themele të politikës së tyre i kishin synimet ekspansioniste, projektuan plane ogurzeza, duke kërkuar 80% të territorit shqiptar në Ballkan, arritën ta gllabërojnë më tepër se gjysmën e Shqipërisë etnike – do të thotë mbi 50% të tokave shqiptare.

Kosova historike dhe etnike shqiptare që, si epiqendër e lëvizjeve dhe kryengritjeve të mëdha, si asnjë pjesë tjetër e Shqipërisë, iu dhurua si peshqesh Serbisë e Malit të Zi nga Fuqitë e Mëdha evropiane. Mirëpo, dihet historikisht e gjeografikisht se shqiptarët që mbetën jashtë vendimeve të Konferencës së Londrës, ishin, e janë pjesë përbërëse e popullit shqiptar.

⁷ Ajet Haxhiu, Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës, Tiranë 1964, 102

⁸ Prof.dr.Hakif Bajrami, Si e okupoj Serbia Kosovën më 1912, Prishtinë 2003, 214

⁹ Ajet Haxhiu, Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës, Tiranë 1964, 106

Të dhënat e historisë për Kosovën kanë qenë gjithmonë në anën e popullit shqiptar, ndërsa mitet dhe legjendat kanë qenë dhe mbeten edhe tani produkt i paragjykimeve dhe koncepteve pansllaviste. Gjatë historisë së tyre serbët, sipas rastit dhe interesit janë luhatur në shumë djepa dhe zemra.¹⁰

Shqipëria, ajo që është zakon të quhet “shteti amë”, është dhe do të mbetet vendi më i afërt i Kosovës – shtet, vendi që, si do që të vijnë punët, kurrë më nuk do ta lënë në baltë njëra tjetrën.¹¹

Pra, megjithë Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, që është data më e rëndësishme kombëtare deri më tani në historinë tonë, gjë që me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 në 10.887 km², është një përmirësim me perspektivë për kombin, por, meqenëse tani për tani vetëm trugu i Kosovës është përfshirë, kurse degët në të gjitha anët i ka të ndarë, andaj me këto nuk është mbyllur çështja shqiptare, sepse edhe sot pritet zgjidhje definitive e drejtë, pra edhe pas 100 vjetësh. Plagët dhe vuajtjet tona do të shërohen vetëm atëherë, kur të realizohet dhe të pranohet Pavarësia e Plotë Kombëtare.

¹⁰ Lefter Nasi, Ripushtimi i Kosovës, Tiranë 1994, 110

¹¹ Mimoza Cika – Kelmendi, Kadare ndryshe, Tiranë 2009, 112

Xheladin SHALA

SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË DHE ROLI I KOSOVËS

Rezyme

Pas ngjarjeve të stuhishme të zhvilluara në muajt tetor dhe nëntor të vitit 1912, detyrë e ditës, pos rezistencës, ishte edhe organizimi për shpalljen e pavarësisë, pasi të katër shtetet ballkanike, pa marrë parasysh faktet historike dhe etnike, i shfaqën haptas, pa të drejtë, pretendimet e tyre për pushtimin dhe zhdukjen e Shqipërisë nga harta gjeografike.

Në momentet tepër të vështira për popullin shqiptar, pasi që ideologu kryesor i Shqipërisë së Sipërme, Hasan Prishtina, ishte zënë peng dhe izoluar në Kështjellën e Beogradit, ideologët e mirënjohur, Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi, vendosën t'i dalin përballë rrezikut të quajtur – Lufta e Parë Ballkanike, si veprim pushtues, dhe në bashkëpunim me patriotët tjerë e Shpallën Pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 në Vlorë. Ajo ditë, për çështjen shqiptare u konsiderua si një ogur i bardhë, si një shpresë për dalje nga errësira dhe kërcënimi shfarosës i një robërie të re më të rrezikshme se e përparshmja.

Duhet theksuar se në Vlorë, në Kuvendin Kombëtar, thuaja se nëpër flakë të pushkës, morën pjesë shumica e përfaqësuesve legjitimë të krahinave etnike shqiptare, duke u deklaruar lirshëm për Pavarësinë e Shqipërisë Etnike. Mirëpo, Konferenca e ambasadorëve në Londër nuk i përfilli vendimet e saj kombëtare. Megjithatë, për ne 28 Nëntori i vitit 1912, është si datë më e shënuar deri më tani në historinë e popullit tonë, datë kur u ngrit pas shumë shekujsh flamuri kombëtar dhe Shqipëria u shpall shtet i pavarur që, sivjet po e festojmë 100 vjetorin e saj.

Vilajeti i Kosovës, me 32.900 km², në ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, u përfaqësua nga Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Mitat Frashëri dhe Sali Gjuka.

Mirëpo, në punimet e Kuvendit Kombëtar në Vlorë, rezultoi se nga Kosova konsiderohen edhe shtatë delegat të tjerë, të cilët ishin: Isa Boletini, Mehmet Pashë Deralla, Riza Bej Gjakova, Zenel Begolli, Hajdin Draga, Qerim Begolli dhe Dervish Bej Ipeku.

Faktor kryesor dhe rol vendimtar, që e sollën shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë qenë lëvizjet dhe kryengritjet e shqiptarëve, sidomos ato të viteve 1908-

1912, të cilat për djep patën Kosovën e vuajtjeve dhe tragjedive të mëdha si rrallë ndonjë territor e popull tjetër në rruzullin tokësor.

Isak SHEMA

POEZI PËR ISA BOLETININ

Në vitin jubilar të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë përkujtojmë figurat e ndritura kombëtare për kontributin e dhënë dhe për sakrificat e tyre supreme për lirinë dhe pavarësinë e popullit shqiptar. Asdreni, autor i himnit kombëtar *Betimi mbi Flamur*, në poezinë patriotike "Dëshmorëve të Lirisë" me këto vargje të zgjedhura shpreh mirënjohjen dhe dashurinë e kombit për ata që u flijuan për atdhe.

*"Sot në këngë lavdërimi ,
Këngë lavdit përkujtimor,
Tërë kombi prej çdo ane,
Ndër ju sjell përjetësor."*

Në këtë frymë personalitete të shquara të historisë në mënyrë dinjitoze janë përjetësuar në letërsinë shqiptare dhe në arte të tjera. Në poezinë shqipe , si edhe për shumë patriotë të tjerë të epokës së Pavarësisë, për Isa Boletinin janë krijuar dhe janë botuar poezi patriotike, me të cilat me mjeshtri artistike paraqitet jeta dhe lufta e tij për liri dhe pavarësi kombëtare.

Në këngën popullore përkujtohet lufta në Grykën e Kaçanikut dhe ajo në Carralevë, në të cilat shquhen: Isa Boletini, Idriz Seferi etj.

*"Çka kanë retë që po vetojnë
Dy drangoj po luftojnë
N'Kaçanik deri n'Caralevë
Isa Begu, Idriz Seferi"*

Skënder Luarasi botoi monografinë "Isa Boletini". Ai ka shkruar: "Të rinjtë shqiptarë ta njohin kryetrimin e Kosovës, që brezat e ardhshëm të thonë "Lum shekulli që e njohu!"

Figura e Heroit Kombëtar frymëzoi shkrimtarët shqiptarë për të krijuar poezi dhe vepra të tjera letrare, me të cilat ky bashkëkohës i Ismail Qemalit dhe i Hasan Prishtinës përjetësohet në artin letrar. Disa poetë atij i kushtuan poezi, duke spikatur në planin artistik krenarinë kombëtare dhe luftën heroike të këtij "gjenerali kryengritës gegë", siç e ka quajtur Fan S. Noli. Poetët e Rilindjes: Risto Siliqi, Hilë Mosi, Gjergj Fishta, Asdreni etj., Isa Boletinin e çmojnë lart si "organizator dhe luftëtar të kryengritjes së

Kosovës". Në poezinë "Mbas luftimit në Kosovë"¹ Siliqi spikat figurën e luftëtarit shqiptar për liri:

*"Pushka plasi, u dha kushtrimi,
Pollaba (Toka- I.Sh.) u dridh nën kambë,
Kaçanikun e mbuloi timi,
Derdhet gjaku për gjithë pllambë!*

Hilë Mosi në tingëllimën "Isa Boletini"², të krijuar më 1910, paraqet fizionominë fizike dhe morale të trimit shqiptar, "që ishte i tëri për Shqipërinë". Në frymën e poezisë popullore poeti i drejtohet Isa Boletinit:

*"Luftar të rrebt'e trim si ty s'ban nana,
Në shesh të luftës me shum'burni luftove,
Në Kaçanik e Cernalev si zana
Me djemt e tu si një sokol qindrove."*

Nëpërmjet dialogut të imagjinuar poeti e jep portretin e Isa Boletinit, ashtu siç ishte ai në jetë dhe në luftë. Ai shquhej me virtyte të larta njerëzore të atdhetarit të flaktë për çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Masat popullore e adhuronin Isa Boletinin si një tribun popullor. Një poet tjetër, me inicialet "K.I.V.", në gazetën "Dielli" të vitit 1910, ka botuar poezinë "Kryengritësve të Veriut"³, në të cilën heroit kombëtar i njihen meritat për kontributin e dhënë në luftë për lirinë e atdheut:

*"Isa Boletin, të qofsha falë!
Qenke në botë një trim i rrallë,
Nderon Shqipërinë se qenke burrë.
Dhe emri mos t'u harroftë kurrë!"*

Fan S. Noli në artikujt "Isa Boletini"⁴ dhe "Isa Boletini në Shqipëri"⁵, përveç të tjerash, paraqet rrethanat komplekse të kohës, kur Isa Boletini njihej në botën shqiptare dhe më gjerë si personalitet i shquar i popullit shqiptar. Në një fjalim të mbajtur në Boston, Noli ka pohuar famën e Isa Boletinit:⁶

Asdreni gjithashtu e admironte veprimtarinë patriotike të Isa Boletinit. Me rastin e udhëtimit për në Shqipëri më 1937, ai kishte kaluar nëpër Kosovë. "Kureshtja e tij që të shihte vatrën e luftërave kundër Turqisë, vendin ku ishte mbajtur Lidhja e Prizrenit dhe ku kishte lindur Isa Boletini ishte aq më e madhe edhe për shkak se në shtypin

¹ Risto Siliqi: "Vepra të zgjedhura", "Rilindja", Prishtinë, f. 101.

² Hilë Mosi: "Vepra të zgjedhura", "Rilindja", Prishtinë, 1972, f.91.

³ "K.I.V.": "Kryengritësve të Veriut", cituar nga libri i Skënder Luarasi: "Isa Boletini", f. 116-117.

⁴ Fan S. Noli: "Vepra 2", Tiranë 1988, f. 349.

⁵ Po aty, f. 379.

⁶ Skënder Luarasi, vepra e cituar, f. 116.

shqiptar të Rumanisë kishte pasur rastin të lexonte se çfarë ishte jeta e kosovarëve nën sundimin e Monarkisë serbe".⁷

Në poezinë bashkëkohore shqipe, Isa Boletini është përjetësuar si hero kombëtar, ndërsa në disa vepra në prozë është realizuar si personazh letrar. Poezia e Isamil Kadaresë kushtuar figurës patriotike, mbrojtësit të pamposhtur të atdheut me titullin "Malësorit të hershëm" me vargjet: "Kur ndonjë ditë armiku / Shfaqej diku në kufi/ Kundër tij me të dyja vdekjet / Nisej ahëre ai"⁸, është realizim artistik që lë mbresa të pashlyeshme te lexuesit e sotëm shqiptarë. Përkushtimet poetike të poetëve: Enver Gjerqeku, Agim Shehu, Azem Shkreli, Muhamed Kërveshi, Halil Qendro, Jakup Ceraja, Qerim Ujkani, Musa Ramadani, Koçi Petriti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti etj.; e kanë lartësuar heroin e popullit aq sa e ka merituar edhe vetë Isa Boletini. Në poezitë: "Kokë e Isa Boletinit", "Naganti i Isa Boletinit", "Vargje me Vlorë", "Isa Boletini", "Lartësi toke", "Ku bukës i thonë bukë", "Isa Boletini", "Udhëtimi i Isa Boletinit për në Vlorë", "Isa Boletini" etj., ai është paraqitur si Anteu, i lidhur për tokën mëmë, për njerëzit, për atdheun, për historinë dhe gjeografinë kombëtare, për jetën, për flamurin, për lirinë dhe për bashkimin kombëtar, "Deri aty ku/Bukës i thonë bukë / E ujit ujë", ky luftëtar ishte në gjendje kurdoherë të sakrifikonte edhe jetën.

Bëmat heroike dhe aspektet e tjera të veprimtarisë patriotike të Isa Boletinit poeti, Enver Gjerqeku, i ka rikujtuar me krenari. Ndjenjat dhe mendimet i ka shfaqur në plan më të gjerë, të gërshetuara me përmbajtjen që evokon luftën e lavdishme për liri dhe pavarësi kombëtare:

*"Kokë e Isa Boletinit
E pashtershmja gurrë e Drinit*

*Ja kah Vlora vrapon Isa
Prapa shpinës shtatëqind plisa*

*Mblodhi shqipet mbarë Kosovës
Trima t' Shalës djem t'Gjakovës*

*N' gjunj përkulet Isa Trimi
Puth flamurin me lotë gëzimi*

Poezia e Azem Shkrelit "Vargje me Vlorë" Isa Boletinin e sjell jo vetëm në planin epik, duke e lidhur me poezinë historike të Fishtës, por edhe në atë patriotik.

*Thua se po zbriste nga ndonjë strofë fishtiane
Dilte nga epika një burrë me dy kobure*

⁷ Dr. Rexhep Qosja: "Asdreni - jeta dhe vepra e tij", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972, f.134.

⁸ Ismail Kadare: "Koha", "Naim Frashëri", Tiranë, 1976, f. 45.

*Të puthte në Shqipë; ta bënte trimërinë trime
Te Deti flisnim vetmevete unë e Ali Podrimja
Ky Zogu ynë, i uruari, dy orë dy ngjyra
Kuq e Zi Flamuri dhe Kuq e Zi Kosova
Na paç, o Shpend, dhe të paçim Tomor Malet*

(Vlorë, nëntor 1992)

Për poetin Muhamed Kërveshi Isa Boletini në poezinë me të njëjtin titull është:

*“Shkëmb i gjallë
Jehonë e shekujve*

Me sy të kombit

*dashuria valonte
kudo me flamur të përqaftuar
lirinë tonë e kishte në gjak*

*në lartësitë e Vlorës
me Isamil Qemalin
Isa Boletini
Krenari e popullit”⁹*

Figura e Isa Boletinit në planin gjithëkombëtar është realizuar me mjeshtëri artistike edhe në poezinë "Isa Boletini" të Koçi Petritit:

*"Fushë Kosova desh një mal
me Korabin tok të rrinin,
dhe mbi djep të saj u ndal,
rriti Isa Boletinin.
Dhe kur nxin e bubullin
mbi Danub e mbi Ballkan,
balli i burrit Boletin
brof e bubullimat mban".¹⁰*

Marathonomaku i kryengritjeve shqiptare sipas vizionit poetik të shkrimtarit shtegton nëpër vise të ndryshme të atdheut:

*Nëpër male ecën Drini
Rent dhe Isa Boletini
Nëpër natë çan ai borën-*

⁹ Muhamed Kërveshi: *Isa Boletin, Në përmbledhjen “Zjarri i përqaftuar”*, Pejë, 2004, f. 15.

¹⁰ Koçi Petriti: “Poezi”, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1989, f. 213.

*N' dritë t' cigares shikon orën
Kqyr kah jugu herë kah Kosova
Haj medet thotë u vonova
Përmbi vetull e çon dorën
Dhe i duket shikon Vlorën".¹¹*

Isa Boletini qëndron në piedestalin më të lartë të lavdisë kombëtare. Poeti Halil Qendro pohon me mburrje se ai është përjetësuar në këngën e popullit:

*"Ja rrëzuan shtatin te vdekja.
S'e nxente dot asnjë lloj arkivoli
Hyri në këngën e popullit"¹²*

Urtësia, trimëria dhe vigjilenca e Isa Boletinit në veprimtarinë patriotike është paraqitur në poezinë e Agim Shehut "Naganti i Isa Boletinit". Poeti, me vërtetësi historike, ka përshkruar udhëtimin e Ismail Qemalit dhe të Isa Boletinit në Angli, për të realizuar pavarësinë e Shqipërisë:

*"Bënë udhë të gjatë,
te "inglizi" vinin:
Ismail Qemali,
Isa Boletini.*

*Hynin dy shqiptarë
brenda në pallat:
njëri luftëtar
tjetri diplomat.*

*Shqipëri e tyre
kishte hall, e mjera,
"Armët, zotërinj,
rregull rrinë te dera! "*

*U ngrysi luftëtari,
sytë i shkrepën çikë.
Lere, diplomati
i tha me qerpikë.*

*Dhe ua la te dera
Isa Boletini*

¹¹ Hydajet Hyseni: "Udhëtimi i Isa Boletinit për në Vlorë" (poezi)

¹² Halil Qendro: "Loti i diellit", Tiranë, "Toena", 1995, f. 78.

*Poshtë nën brez, të voglës
sytë i shkrepitinin.
"Ja, dhe çarmatosur,
zotërinj shqiptarë !"
Si kallkan i ngrirë,
ngriu fjalë e parë.*

*Brom, aty përpara,
mu te lordi pranë:
"Madhëri, shqiptarin
kurrë se gjen pa armë!"*

*Dhe naganti ulur
rrinte siç i thuhej:
dora nga i zoti,
tyta nga t'i duhej.*

*Nxinte tytë e vogël,
brenda nxinin halle
Shqipëri e vogël
në tryezë të madhe. "¹³*

Poeti Qerim Ujkani hirmadhin, Isa Boletinin, e sheh në lartësinë më të madhe të tokës dhe të kohës: "S'ka lartësi më të madhe / se lartësia e tokës / Sa dashuri ka lindja / Që po e përgjak horizontin / □ Sa mrekullitar është dielli / □ Sa i pavdekshëm / Është mësimi i pishës/ Për të qëndruar lart/ Mbi shkëmb / Prej lartësisë së tokës".¹⁴

Në një cikël poezish të Sabri Hamitit, të titulluar "Gjaku", krahas figurave të ndritura të historisë dhe të kulturës shqiptare, siç janë: Teuta, Gjergj Kastrioti, Pjetër Bogdani, Hasan Prishtina, Eqrem Çabej, radhitet edhe Isa Boletini. Në vizionin poetik të këtij krijuesi, heroi lirik me fjalën e urtë, me gjestet dhe me veprimet e veta, "I drejtë si një Flamur", tregonte rrugën që duhej ndjekur në luftën e përgjakshme për liri. Urtësinë, guximin, ndjenjën e sakrificës e të vetëmohimit, vendosmërinë, mallin e pashuar dhe shpresën për fitore, ai i konsideronte virtyte të përbashkëta të të gjithë bashkëlufëtëtarëve, të njerëzve të thjeshtë, por me zemër të madhe, të cilët në luftën kundër armikut shekullor, gjithashtu ishin të gatshëm të jepnin edhe jetën, duke rënë dëshmorë në altarin e atdheut.

¹³ Agim Shehu: "Poezia shqipe", "Naim Frashëri", Tiranë, 1986, f. 120-123.

¹⁴ Qerim Ujkani: "Dielli që po e krijoj", "Rilindja", Prishtinë, 1983, f. 90-91.

Poeti në vetën e tretë zhvillon rrëfimin për Isa Boletinin:

"Fliste. Flitshin. I ndëgjonte,

Isa me sy plot mall

Maste largësitë e Dheut.

Me gishta të trashë

Shkruante hartën e re

Në dheun e kuq të udhës,

Isa me sy të përmalluar,

Maste largësitë e At-Dheut."¹⁵

Kanë kaluar 100 vjet nga dita kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë më 28 nëntor 1912 në Vlorën heroike. Ismail Qemali e priti me gëzim Isa Boletinin, sepse edhe ai kishte arritur ta shënojë dhe ta bëjë madhështor aktin e mëvetësisë së Atdheut të dashur - Shqipërisë . Para 96 vjetësh, më 1916 në mënyrë mizore, u vra Isa Boletini.

Kujtimi i paharruar për trimin legjendar është ruajtur me mburrje dhe është përcjellë brez pas brezi. Krijuesit popullorë ia kanë kushtuar këngët më të bukura, ndërsa poetët shqiptarë e kanë përjetësuar në krijimet e tyre artistike. Ai është skalitur me mjeshtri artistike në artin letrar si një ndër figurat e ndritura të historisë së popullit shqiptar. Prandaj edhe sot, në jubileun e Pavarësisë së Shqipërisë, së bashku me personalitetet e shquara të kombit, përkujtohet me nderime të larta dhe krenari kombëtare.

Literatura

1. Luarasi, Skënder (1962), *Ismail Qemali*, Tiranë.
2. Luarasi, Skënder (1972), *Isa Boletini*, Tiranë.
3. Musaj, Fatmira (1987), *Isa Boletini. 1864-1916*, Tiranë.
4. *Isa Boletini dhe koha e tij*, Prishtinë 1998.
5. Luarasi, Skënder (2007), *Tri jetë - Koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini*.

¹⁵ Sabri Hamiti: "Leja e njoftimit 1985", "Rilindja", Prishtinë, 1985, f. 15.

Mehmet RUKIQI

SHPALLJA E PAVARËSISË NË EPIKËN SHQIPTARE

Krijuesve dhe interpretuesve të epikës popullore shqiptare, me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, mirënjohje të veçantë e konsiderata më të larta.

Epika shqiptare, në funksion të shpalljes së pavarësisë, sajton një kapitull të veçantë të historisë gojore. Kontribuoi në përkujtimin dhe përjetësimin e shumë ngjarjeve e personaliteteve historike. Pasqyroi, në nivelin më të lartë artistik, luftrat më të përgjakshme e të panumërta kundër okupatorëve, shtypjes dhe shfrytëzimit, material dhe shpirtëror, që i sollën Shqipërisë etnike. Krijuesit dhe bartësit e epikës shqiptare, ngritën thesarin epik. Pasuruan folkloristikën shqiptare. Thelluan ndërgjegjën kombëtare, politiko-shoqërore, luftarake, artistike dhe estetike. U vunë në shërbim të popullit dhe të progresit.

Këngët epike, për Pavarësinë, “me potencialin e tyre të fuqishëm estetik, ushqyen letërsinë, artin tonë të kultivuar”¹, dhe historinë kombëtare gojore në veçanti. I cilëson forca e jashtëzakonshme e mendimit latent e figurativ dhe ngarkesa me dramacitet të ngjarjeve. Përballë gëzimit të pakrahasuar, për pavarësinë nga një okupator shekullor, del edhe hidhërimi i pakrahasuar, nga okupatorë të tjerë, shumëfish më të egër, më barbarë, shfarosës dhe të pacivilizuar. Krahas gëzimit për pavarësinë, u krijua edhe proverbi gjenial popullor: “Sa gëzim, qaq idhnim”.

Regjimi okupues serb, prej atij osman, dallonte shumë. Derisa “osmanët bënin “zullum me kanar”, Serbia ushtronte “zullum pa kanar”. Regjimi serb, mbi popullin shqiptar, krijoi “ni zaman të zi, aq sa i gjalli t’deknit me i marrë lakmi”. Pavarësia kishte për qëllim kthesën përfundimtare, pas shkëputjes nga Perandoria, ndërgjegjësimin e shqiptarëve si komb, për të zotëruar trojet e veta, për t’u mbrojtur nga pushtuesit e tjerë, shumë më të rrezikshëm se ata osmanë.

“Evropa, në këtë periudhë, tregoi se nuk ishte në anën e shqiptarëve. Nuk i njohu si komb. Tokat e tyre ua dhuroi serbëve, malazezëve e grekëve”.² Në prag të

¹ Prof. Alfred Uçi, Estetik e folklorit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2007, f. 94

² Sulltan Abdyl Hamiti II (1842-1915), sundoi prej 1876-1909.

shpalljes së pavarësisë, Shqipëria po kalonte çastet më të vështira. Pjesa më e madhe e territorit të saj, ishte pushtuar nga trupat armike. “Në këtë orë të vështirë, doli në krye të saj, njeriu më i zoti. Ky ishte Ismail Qemali (1844-1919), nga Vlora. Mendja e tij e mprehtë dhe idetë novatore, bënë që sulltan Abdyl Hamiti II³ të kishte respekt, po edhe frikë, prej tij. Disa herë, e gradoi. Ismail Qemali, për të penguar ëndrrën shekullore ruse, për marrjen e Kostandinopojës, i propozoi sulltanit që: ‘t’u jepte popujve të çdo shteti, të drejtën e vetëvendosjes dhe të përkatësisë etnike. Fuqia e Perandorisë do të qëndronte në unitetin e njerëzve, për mbrojtjen e përbashkët dhe në enërgjinë e zhvillimit ekonomik. Para shpalljes së pavarësisë, së bashku me Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtinën, etj. viziton shumë burra të shteteve evropiane, sidomos në Paris e në Londër. U konsultua me ta, për rrethanat e vështira të Shqipërisë. U përpoq t’i bindë Fuqitë e Mëdha, që të pranojnë idenë e tij, për një Shqipëri Autonome.

Programi i Ismail Qemalit ishte integriteti i territorit shqiptar, veçanërisht i Kosovës. Kërkonte përkrahjen për hapjen e shkollave shqipe; përdorimin e alfabetit latin, në vend të atyre, arab, grek, apo cirilik. Kërkonte ndihmë për zhvillim ekonomik, rrugë dhe hekurudha. I njoftonte se Shqipëria ishte shteti i fundit në Ballkan, që u nënshtrua nga turqit dhe i fundit që fitoi lirinë. Më 5 nëntor 1912, ishte në Bukuresht. Vazhdon rrugën për Vjenë e Budapest. Përkrahjen përfundimtare dhe të prerë, për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, e merr nga Bertholdi në Budapest, më 17 nëntor. Në kujtimet e tij, thotë: “Bertholdi i miratoi pikëpamjet tona, për çështjen kombëtare shqiptare”.⁴ U telegrafon miqve të tij në Durrës, që t’i thërrasin delegatët në atë qytet, ose në Vlorë. I siguron se: “Pozita e Shqipërisë është e sigurt. Nuk duhet menduar më për autonomi, por për një shtet të pavarur, që duhet të shpallet brenda pak ditësh. Shqipëria, në mbledhjen e ardhshme ndërkombëtare, do të marrë pjesë si shtet. Këtë qëndrim e kishte edhe Vjena zyrtare. Prej Budapestit, shkon në Triestë. Me një anije, nga flota e këtij qyteti, shkon në Durrës. Eqrem Bej Vlora, në prag të shpalljes së Pavarësisë, shkruante: “Një zjarr i shenjtë patriotizmi kishte pushtuar Vlorën, qytetin tim lindor. Entuziazmi dhe gëzimi na përshëndetin kudo. Në pak kohë, u gjeta i rrethuar nga tetëdhjetë e tre delegatë, myslimanë e të krishterë, të cilët kishin ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, të zaptuara ose jo, nga ushtritë luftuese”.⁵

Më 28 nëntor 1912, në orën 14, në Vlorë, u hap Kuvendi Kombëtar. Në mbledhjen e parë, marrin pjesë 37 delegatë, nga të gjitha viset shqiptare. I pari ishte Ismail Qemali. Në epikën shqiptare njihet edhe me emërtimet: Ismail Qemal Beu, Ismail Qemal Pasha dhe Ismail Qemal Vlora. Nga personalitetet e shquara ishin:

³ Edwin Jacques, Shqiptarët nga lashtësia deri në ditët e sotme, Kartë e Pendë, Tiranë, 1995, f. 357-359.

⁴ Dr. Blerim Çela, vep. e cit. 213.

⁵ Jusuf Buxhovi, vep. e cit. f. 613

Avdi Toptani (1864-1942) nga Tirana, Bedri Pejani (1885-1946) nga Peja, Dhimitër Berati (1886-1970) nga Korça, Jorgji (Dudë) Karabunara (2842-1917) nga Lushnja, Hasan Hysen Budakova nga Suhareka, Dhimitër Mbroja nga Korça, Iljaz Vrioni (1882-1932) nga Berati, Hajredin Cakrani nga Feri, Jani Mingo (1872-1947) nga Fieri, Kristo Meksi nga Gjirokastra, Luigj Gurakuqi (1878-1925) nga Shkodra, Mehmet Pashë Deralla (2847-1918) nga Tetova, Mit'hat Frashëri (1880-1940) nga Janina, Dom Nikollë Kaçorri (1862-1917) nga Shkodra, Pandeli Cale (1847-1923) nga Korça, Rexhep Mitrovica (1888-1960) nga Mitrovica, Sali Gjuka (1876-1925) nga Peja, Shefqet Verlaci (1878-1946) nga Elbasani, Vehbi Dibra-Agolli (1847-1937) nga Dibra, Xhelal Koprenca (1846-1919) nga Skrepari etj.

Kuvendi e zgjodhi Ismail Qemalin kryetar. Në të njëjtën ditë, të vitit 1443, Skënderbeu ishte shpallur kryetar i Lidhjes së Princave Shqiptarë. Tani, në po atë date, Ismail Qemali, në ballkonin e shtëpisë së tij, ngriti flamurin historik të Skënderbeut. Në fjalimin e tij, ndër të tjera, tha: “Në rrethanat të krijuara nga Lufta Ballkanike, e vetmja udhë shpëtimi, është ndarja e Shqipërisë nga Perandoria Osmane”.⁶ “Politika e Evropës ka rrëfyer se shqiptarët, në mos hapshin sytë e në mos punofshin urtë e fort, kanë për të humbur e, me ta bashkë, edhe Mbretëria turke. Andaj, për të mundur, sa më parë, ta largojë këtë rrezik, u hodha në një luftë që, nuk është kundër kanunit. I bëra theror djemtë e mi dhe shtëpinë. Dola edhe jashtë, për t’u bashkuar me atdhetarët shqiptarë. Ç’mësova në punët e politikës, miqësitë që lidha me njerëz të fuqishëm, dyzet vjet vuajtje e mundime, të gjitha i vura në shërbim të vendit. E di mirë se Shqiptari edhe më i pamësuar, ka mendime të larta e të nxehta për atdheun dhe se, gjithmonë, është gati të derdhë gjakun e vet për kombin. Shqiptarët që rrojnë tubërisht në Kosovë, në Manastir, Shkodër e Janinë, e tej e këtej në viset të tjera të Turqisë Evropiane, duhet ta njohin vetveten si një komb, pa vënë re fis e farë dhe besime. Duhet të jenë të gjithë si vëllezër. Gjëja, jeta, nderi, feja e secilit, do të jenë nën hije e nën krahë të të gjithëve.”⁷

Në Kuvend foli edhe Luigj Gurakuqi: “Mvehtësia e Shqipërisë ishte andërruar nga vjershëtorët dhe e dëshiruar nga zemrat e djegura të disa pakë atdhetarëve, që vuanin e dirgjeshn nëpër burgjet e errta; që qanin e rënkonin nëpër shkretinat e largëta; që ishin të ndjekur e të dëbuar nga Atdheu i dashun. Na dukej të gjithëve si një dëshir i paarijshëm, si një dhuratë tepër e çmueshme, për varfërinë tonë. Vlerësohej si një pemë e ambëlë dhe e shijshme, të cilën Perëndia ua kishte ndaluar shqiptarëve të mjerë. Të betohemi pra, edhe një herë, mbi lirinë e atdheut, mbi varret e dëshmorëve tanë; t’i bajmë therore, përpara altarit t’Atdheut, anmiqësitë, smirat e zilitë e poshtme. Të lidhemi e të bashkohemi të gjithë, me një ment e me një zemrë. Të përpiqëmi e të punojmë tok, si vëllezër që jemi, për të shëruar plagët e

⁶ 100 Vjet pavarësi kombëtare, Album, Eugen, Tiranë, Tiranë, 2012, f.116

⁷ Po aty

Shqipënisë; për t'i fshirë lotët e atyre që qajnë e rënkojnë mbi brengat e viseve të veta, që u ndanë nga trupi i Atdheut të përbashkët”.⁸

Isa Boletini, do të vijë në Vlorë të nesërmen, më 29 nëntor, me 400 luftëtarë. Hasan Prishtina, Idriz Seferi, Nexhip Draga, Seit Hoxha, etj. nuk morën pjesë, ngase u ndodhën në vuajtjen e dënimit, në burg, në Kalemekdan të Beogradit. Bajram Curri, ndonëse u nis për në Kuvend, rrugës, u pengua nga luftime me hordhitë serbo-malazeze. Delegatët nënshkruan dokumentin historik për Pavarësinë e Shqipërisë, ku thuhet: “Shqipëria, më sot, të bëhet me vete, e lirë dhe e mosvarme”. Shpallja e Pavarësisë ishte akt madhor historik. Ishte përmbyllje e një procesi të gjatë, shekullor, të përpjekjeve të shqiptarëve për pavarësi e liri. Hasan Prishtina paska thënë: “Lufta Ballkanike u bë shkak, që kjo nderë e famë t'i mbetet Vlorës e jo Kosovës e, në vend të një Shqipërie të Madhe, të bëhet një Shqipëri e Vogël”.⁹

Populli shqiptar, në gjiun e tij, ka pasur talente të fuqishme artistike, që kanë krijuar vlera të pavdekshme estetike”.¹⁰ Epika shqiptare, Pavarësinë e trajton si njërën nga ngjarjet më të shënuara të historisë kombëtare. Këngëtari popullor, në disa raste, shpreh nostalgji për regjimin e kaluar osman, për “babën mret” dhe don t'i tregojë “xhihanit”, botës mbarë, për masakrat e papara të okupatorëve gjakatarë serbë e malazezë:

*- Çeli sytë, o baba mret,
Se t'maroj xhihani krejt.
Na u ka kthye serbi apet,
Po na pret e po na vret.
Rob' e thmi, n'zjerm, po na i qet
Për ne, babë, krisi kjamet.*

“Baba mret”, në fillim, përgjigjet me revoltë, sepse, shqiptarët u hodhën në luftë kundër tij:

*- Le t'ju pret e le t'ju vret,
Se nuk e dojshi, ju, babën mret,
S'ma ndatë luftën katër vjet,¹¹
Tri ordi mi farut krejt.*

⁸ Ndrëçim Kulla, Antologji e mendimit shqiptar 1870-1945, Plejad, Tiranë, 2003, f. 86-89.

⁹ Jusuf Buxhovi, vep. e cit. 266.

¹⁰ Prof. Alfred Uçi, vep. e cit. f. 95.

¹¹ Koha e sundimit të xhonturqëve, sidomos në vitet 1908-1912.

Në fillim të çdo kënge epike, pasqyrohen rrethanat që kushtëzuan luftën dhe këngën për të. Para shpalljes së pavarësisë, theksohen shkaqet e kryengritjes. Ishte e pamundur vonesa e mbrojtjes, duke e shpallur pavarësinë, sepse:

*Na ra shkau në katër anë,
Dy gurë bashkë s'po don me lanë.
N't'katër anë, o haj medet,
Don' me dalë det um det.¹²*

Megjithatë, “posa e shpallëm pavarësinë nga kulshedra e Bosforit, ramë në kthetrat e çakajve të Ballkanit”.¹³ Për shqiptarët, s’u arrit asgjë, përveç ndërrimit të okupatorëve:

*Sa shkon njani, na vjen tjetri,
Shumë ma i zi i riu se i vjetri.*

Nëpërmjet të eipkës shqiptare, u madhështua historia, në përgjithësi, dhe shpallja e pavarësisë në veçanti. Krijuesit epikë, përballë rrethanave robëruese, ishin martirë të popullit. Bruno theksonte: “Një epokë njihet, më tepër, sipas karakterit të martirëve të vet, se sa të heronjve”. Poeti ynë popullor, siç ishte Dervish Goxhuli, krijoi gjatë procesit të robërisë dhe të luftës për ekzistencë, kur jeta dhe lufta shkonin paralel. Krijuesit e epikës i takonin periudhës më dramatike të historisë, të peshës më të rëndë të tradhëtisë së Fuqive të Mëdha, të pushtimit dhe të copëtimit të pjesëve më vitale të atdheut të përbashkët, të Shqipërisë etnike. Ishin përhapës të revoltës dhe të kryengritjeve kundër pushtuesit.

Epika shqiptare, kushtuar pavarësisë, u krijua nga poetët hemorikë popullorë. Ishin gjallërues të së kaluarës në vetëdijen historike. Ishin historianë që, historinë gojore dhe atë ende të pashkruar, e njihin më mirë se çdo historian. U vlerësuan si pasqyrues të denjë të rasteve dhe konflikteve tragjike. Ishin tipa të angazhuar. S’kishin qëllim vetëm të këndojnë, por edhe të nxisin. Rapsodi Rizah Bllaca, pohonte: “Kanga e mirë, edhe barin e thatë e ban t’njomë”. Krijuesi dhe interpretuesi epik ishte veshi, zëri e zemra e aktit të shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912 dhe të ngjarjeve që e përcollën, në fillim dhe pas kësaj dite të shënuar. Historia e vërtetë e popullit, nuk mund të njihet, pa e njohur krijimtarinë epike gojore.

Kënga “Ahmet Delia”, është bosht e epikës me temë të pavarësisë. Është sintezë subjektive e përmbajtësore. Pasqyron luftën e Ahmet Delisë (1850-1912), vet

¹² Detin e Zi e mori Rusia dhe detin Adriatik e kërkonte Serbia

¹³ Mark Krasniqi, kumtesë në një simpozium shkencor, ende në dorëshkrim.

i katërtri, me sëpata, kundër një bande çetnike serbe, të armatosur, në Prekaz, afërsisht më 20 dhjetor 1912, tri javë pas shpalljes së Pavarësisë në Vlorë. Sulmi u bë në shenjë të revoltës së armikut, kundër një fitoreje historike shqiptare. Ishte edhe kundër vet Ahmet Delisë, si personalitet më i rrezikshëm ndaj invazionit serb. Në kulmin e kullës së tij, shpesh kishte vuar flamurin shqiptar, edhe para se të ngritej në Vlorë. Ishte koha kur shovinistët e tërbuar mendonin se: “Vetëm kombi serb, duhet të lind, të rritet e të shtohet”.¹⁴

Ahmet Delia, më të birin Murselin, xhaxhanë Ramë Islamin dhe kushëririn Jetullahun, me sakica në dorë, vërsulen për të vdekur. Rojës që ruante para dyerve të shtëpisë, ku ishin futur kriminelët dhe urdhrit, në gjuhë serbe “stoj” (ndalou) Ahmeti i përgjegj:

*- Unë shkenishten nuk e di
Po ty kush t' tha, bre faqezi,
N'oborr t' shyptarit ti me hi
A e di këtu si i thonë Shypni.*

S'ka dyshim se, heroi i këngës, këtu aludon në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, duke i treguar se këtu, tani është regjimi tjetër, regjimi i Shqipërisë së Pavarur. Betejës për jetë a vdekje i prinë vetë plaku Ahmet Delia. Rojën çetnike e qëllon me sakicë n'lylë të ballit:

*Ahmet Delia ni trim për së tepër,
I soll sakicë shkaut për mi vetull,
Përmi vetull e bash në ballë,
T'tana trutë ja la n'shkallë.*

Nga shpina, këtë trim të rrallë, e godet, si zakonisht, pushka serbe. E fton të birin që të futet në zjarr, përkundër bindjes së “evladi asht i dhimshëm”. Krijon bindje se, kundër një armiku që e patëm, s'kursethet asgjë, madje as “evladi, bima e zemrës”.

Plagosja e babait për vdekje, në vend të panikut, Murselit, thujse, ia dha edhe një zemër. Hudhet mbi çetnikët, si lua i tërbuar, pa ditë se “çka qet pushka për gryke”:

*Ky Murseli ni djal kreshnik,
U kap me shkije fyt për fyt,
Ni mamzerrë jau ka grabit,*

¹⁴ Dimitrije Tucoviq, Serbia dhe Shqipëria, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 138.

*Qat mazerren me katër fishek,
Edhe Zoti po i jep kyvet,
Sa herë qet, ka nja p'e vret.*

Ua grabiti po atë pushkë, e cila volli plumbin vdekjeprues për babain e tij, që tani i kishte vetëm katër fishekë, dhe me të cilën katër herë do ta paguaj, në flakë, gjakun e Ahmet Delisë:

*Si Murselin ku m'e gjetë djalë,
Katër shkie i vrau për babë,
Nja e mytë Mixha Ramë,
E nji tjetër ky Jetullahi.*

Thyhet sulmi barbar. Llava çetnike, sikur e ujqve të tërbuar e të uritur për gjak shqiptari, merr vrapin nga kanë msy. Thembrat e këmbëve ua rrahin shpatullat. Para syve u del krejt Drenica:

*Ikë Jovani kolla gardhi,
Fort p'e ndjek Ramë Islami.
Banë Jovani haj medet,
Pej tetë shokëve, veç unë jam metë.
Krejt Drenica n'kamë kokan çue,
Me ditë t'sodit kemë marue.*

Vdekja e trimit është vdekje me peshë, është mësim dhe përvojë e madhe. Ajo dallohet prej vdekjeve të tjera. Deri në frymën e fundit, është me vetëdije, me qëndresë, me këshilla e porosi. Kështu ishte vdekja e Ahmet Delisë. Ai, pak par frymëmarrjes së fundit:

*Ramë Islamit ju ka ngërmue,
Kit Jovan mos m'e damtue,
N'Beligrad lëshone me shkue,
Aleksanrës me i kallxue,
Përtej votres, s'kem ku me shkue.
Nali shkiet more zotni,
Kësaj Drenice mos me ja sy,
Qebesa e Zotit jau bajmë ma zi.*

Këngëtari, edhe këtë këngë, sikur shumicën nga cikli i këngëve për çlirimin kombëtar, e përfundon me formulën karakteristike e sintetizuese:

*Kështu luftuen trimat dai,
Për atdhe e për Shqipni,
S'jau pa sherrin kurrni shpi,
Kurrni shpi as shpia e vet
Shqiptarë janë le e shqiptarë janë dekë.
Lavdi i koftë Ahmet Delisë,
Zbardhi f' tyrën e krejt Shqipnisë.*

Më së paku një këngë epike, për shpalljen e Pavarësisë, përmendën edhe shumë personalitete historike, si Ismail Qemali, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri, etj. Por, siç thuhet edhe në popull, gjithsesi, “Sakica e Prekazit e pushka e Galicës, shkruajnë n’derë t’ mretit”.¹⁵

¹⁵ Është fjala për Ahmet Delinë dhe Azem Galicën.

I. GJUHËSI

Imri BADALLAJ

STUDIMET E BOJKA SOKOLLOVËS MBI TË FOLMEN E SHQIPTARËVE TË MANDRICËS

Më 1949 një student i Universitetit të Plovdivit ia kishte dërguar Dhimitër Shuteriqit një tekst të një kënge popullore të regjistruar në katundin e Mandricës të Bullgarisë. Teksti ishte i shkruar me alfabetin bullgar dhe si i tillë nuk ishte i përshtatshëm për botim. Me këtë rast iu zgjua kërshëria Shuteriqit, që më 1959 të shkojë vetë në këtë ngulim shqiptarësh, i cili ndodhet në këndin kufitar midis Turqisë Greqisë dhe Bullgarisë, ku bëri regjistrimin e një numri këngësh dhe përrallash, por ndonjë shpjegim të duhur gjuhësor ka mundur ta bëjë vetëm me ndihmën e Mahir Domit, që vizitën e dytë e bëri me të. Mirëpo, qëndrimi i tyre në Mandricë që i shkurtër dhe materia e eksploruar nuk ishte gjithëpërfshirëse. Prandaj, studiuesja bullgare Bojka Sokolova iu qas studimit të kësaj idiome rrënjësisht, duke vënë në dukje dhe duke e shqyrtuar këtë të folme shqipe nga të gjitha këndet e linguistikës.

Bojka Sokolova për këtë idiomë dialektore botoi disa artikuj nëpër revista, herë bullgarisht, herë frëngjisht, herë gjermanisht brenda dhe jashtë Bullgarisë, por studimi i saj më i plotë u botua më 1983 në Berlin me titullin *Die albanische Mundart von Mandrica (E folmja shqipe e Mandricës)*.

Monografinë e saj Bojka e nis, duke i shtruar disa të dhëna gjeografike, historike, sociolinguistike dhe kulturore për këtë ngulim shqiptar.

Vetë informatorët e studiueses pohojnë se origjina e tyre duhet të jetë nga Vithkuqi i Korçës dhe ky ngulim u themelua më 1453, para se turqit ta merrnin Konstadinopolin (Stambollin e sotëm). Në atë kohë dhe deri në tri dekadat e shekullit 20 në afërsi të Mandricës gjallonin edhe disa ngulime të tjera, si Sulltanqoj, Ibriktepe (Qyteza), Alltëntash, Pazardere, Zallëf, Aballar dhe Karaxhakli, që me kohë banorët e këtyre ngulimeve bënë lëvizje dhe shumica e shqiptarëve orthodoksë që u zhvendosën nga vendbanimet e zëna ngoje, zunë vend në Greqi dhe siç konstaton studiuesja bullgare, shqiptarët brenda Greqisë, të cilët janë me përkatësi fetare orthodokëse janë me origjinë nga këto enklava. Mandrica sot është i vetmi ngulim shqiptar brenda Bullgarisë, i cili ka ruajtur gjuhën, folklorin dhe doket e zakonet e të parëve të tyre.

Ky studim, siç shton edhe vetë Sokolova, paraqet interes të veçantë për dialektologjinë, për leksikologjinë, për sociolinguistikën, për gjuhësinë ballkanike dhe posaçërisht për gjuhët në kontakt. Folësit e shqipes njëherit e flasin bullgarishten, greqishten dhe turqishten, çfarë tregon se rrjedha e të folurit të tyre është zhvilluar në

katër drejtime, por shqipja është zotëruesja, së paku për kohën kur Bojka i bënte hulumtimet e saj në këtë idiomë gjuhësore.

Albanologes Sokollova para së gjithash i ka interesuar vënia në shqyrtim të të gjitha veçorive të shqipes të ruajtura në këtë enklavë, që gjithsesi, vetë rezultatet tregojnë qartë, se e folmja shqipe e mandricasëve është mjaft arkaike, por edhe ndikimi në mjedisin e huaj nga disa gjuhë fqinje i ka dhënë kësaj së folmeje një fytyrë me karakteristika dhe veçori të veçanta.

studimi nis me përshkrimin dhe shpjegimin e veçorive fonetike-fonologjike, duke u pasuar me veçoritë gramatikore e leksikore. Në fund të monografisë janë shtruar edhe tekstet e regjistruara me të gjitha nuancat gjuhësore që kësaj idiome, jo vetëm që i japin një karakteristikë të veçantë, por kjo materie tekstore, u jep mundësi edhe të interesuarve të tjerë, që për këtë të folme mund të bëhen studime nga kënde të tjera gjuhësore.

Fonetika e kësaj së folmeje hapet me përshkrimin e sistemit vokalik, që pa dyshim është për t'u përmendur ruajtja e zanores *ë*, e cila ndeshet dendur si në pozicion të theksuar ashtu edhe në atë të patheksuar, por në raste sporadike alternohet në *u*: *kutu*, *kupucë*, *kushtu* etj., dukuri kjo e cila ka ndodhur edhe me *o*-në: *kullani*, *dullapi*, *duneri* (*ndonjëri*) etj.

Mirëpo, togjet e zanoreve dukshëm dallojnë nga të folmet e tjera të këtij stadi kohor, që krahas togut *uo* del paralel edhe *ua*, por shpeshherë midis dy zanoreve, të cilat formojnë togun, hyn edhe shtegorja *v*, e cila thjesht ka karakter antihiatizues, si: *gruo* > *grua* > *gruva* > *gruvë*, *dua* > *duva* > *dva* etj. Kjo dukuri gjeti shtrirje tek folësit e brezit më të ri.

Togu *uo* del më dendur, sidomos tek foljet në admirativ: *gëzuoka*, *kërkuoka*, *punuoka*,

pëshuoka, *u menduoka*, *u ndruoka* etj., por që nuk mungon edhe në trajtat foljore të aoristit, sidomos në ato folje, të cilat mbarojnë me *l*, *ll* dhe *r*: *duoll*, *muor*, *suoll* etj.

Në prezent dhe në particip shembujt me togun *uo* janë tepër të përhapur: *luojmë*, *shkruojmë*; *tërbuorë*, *vluorë*, *mësuorë*, *kënduor*, *shtruorë*, *bekuorë* etj.

Nën ndikimin e bullgarishtes pothuajse janë zhdukur bashkëtingëlloret ndërthembore *th*, *dh* dhe në vend të tyre realizohen *d* dhe *z*: *dardë*, *i bardë* ose *i barzë*, *verdë*, *erda*; *zëndër*, *uzë*, *ze*, *zëmbi*, *zjetë*, *trizjetë*. Por shpeshherë në vend të *th*-së dëgjohet *s*: *sua*, *sonj*, *sikë* (*thua*, *thonj*, *thikë*) etj.

Kjo studiuese ka gjetur shembuj, ku edhe ruhet shtegorja e shurdhët *th*: *thom*, *tha*, *ardhka* etj. Mirëpo, tek brezi i mëtejshëm janë hasur edhe shembuj me ndërthemboret e ruajtura: *edhe*, *erdhur*, *e madhe* etj.

Udhët fonetike që kanë ndjekur këto bashkëtingëllore deri në stadin e sotëm, kjo gjuhëtare i rendon sipas kësaj skeme:



Grupet e vjetra konsonantike, *kl*, *gl*, *lk* dhe *lg* nuk kanë evoluar dhe shembujt e vënë në këtë monografi, tregojnë qartë se janë të kohës, kur një dukuri e tillë ishte e njëjtë për tërë shqipen, si: *klishtë*, *glisht*, *të glatë*, *u nglimë* (*u ngimë*), *nglet* (*ngjet*), *ulk*, *helk*, *holq*, *dilgon* etj.

L-ja intervokalike gjallon edhe sot e kësaj dite, si: *bilë*, *fëmilë*, *ndalej*(*ndjej*). Ndërsa lateralja *ll* në ndikimin e bullgarishtes alternohet në *l*: *akul*, *djela*(*dielli*), *yl* etj.

Në këtë monografi kemi hasur, disa herë, që në vend të *f*-së dëgjohet *h*: *fustan* (*fustan*), *hushëra* (*fushëra*), por edhe në vend të *h*-së realizohet *f*: *glufë* (*gjuhë*), *ftoftë* (*ftohtë*), *ngroftë* (*ngrohtë*) etj.

Si në tërë toskërishten, bashkëtingëlloret e zëshme në Mandricë shurdhohen: *mble* (*mbledh*), *vënt* (*vend*), *mënt* (*mend*) *artka* (*ardhka*) etj.

Grupet konsonantike, si: *-ln-*, *-lln-*, *-rn-*, *-tn-*, *-tm-*, *-thm-*, *-thn-* dhe *-sn-*, ruhen në format e vjetra, të cilat shqipja i kishte, e sidomos toskërishtja, që edhe sot e kësaj dite në disa areale skajore i ruan, p.sh: *kalnë*, *djalnë*, *malnë*; *duollnë*, *dvollnë*, *svollnë*; *gurnë*, *gomarnë*, *muornë*; *detnë*, *u ngritnë*, *e vlojnë*; *qitmë*, *ungritmë*; *unisnë*, *pionë* etj.

Nga dukuritë fonetike është me interes të përmendim fenomenet:

të metafonisë: *plak-pleq*, *plaf-plef*, *ka-qe*; të apofonisë: *mar-mora*, *bjer-zbora*, *helk-holka*, *dal-dola* ; të palatalizimit: *zok-zogj*, *mik-miq*, *tuk-turq*;

të asimilimit: *kushtu-kështu*, *kutu-këtu*, *kushuri-kushëri*, *kuju-kjo*; të shurdhimit: *jelp-elb*, *krimp-krimb*, *vënt-vend*, *zok-zog*, *ndes-ndez*; të elizionit: *tëmblla-të ëmblla*, *togla-të vogla*, *toçkërë-të vocërr*; të aferezës: *toftë-ftophtë*, *ëngëllimë-hingëllimë*; të sinkopës: *setulla-sqetulla*, *papë-prapë*, *bati-baghti*, *shpi-shtëpi*; të apokopës: *posh-poshtë*, *përposh-përposhtë*, *katërmet-katërmbëdhjetë*; të elizionit: *tëmblla-të ëmblla*, *togla-të vogla*, *tegra-të egra*, *toçkërë-të vocërr* etj.

Në sistemin morfologjik shqipja e Mandricës ruan disa trajta të lashta, që gjithsesi dendur hasen në sistemin foljor, por hiq më pak nuk mungojnë edhe në segmente të tjera të morfologjisë të kësaj së folmeje. Disa sish shpjegohen edhe si rrjedhë e ndikimit strukturor të bullgarishtes, por nuk mungojnë edhe ndërtime të evoluimit të brendshëm të idiomës në fjalë.

Karakteristikë e veçantë janë, siç shton studiuesja bullgare, gjinia e disa emrave, të cilët në mbarë shqipen e sotme realizohen si mashkullorë, ndërsa në këtë idiomë dialektore dalin femërorë: *djella*, *pleha*, *shija* (*shiu*), *zeja* (*dheu*), *hija hiri*, *klumështa* (*qumështi*), *zëja* (*zëri*) etj., por edhe shumë emra asnjans që tregojnë lëndë kanë kaluar gjithashtu në gjininë femërore: *gjasa* (*djathi*), *dula* (*dylli*), *uja* (*uji*) *gjalpa* (*gjalpi*), *drisa* (*drithi*), *balla* (*balli*) etj. Ndërsa i gjinisë asnjansë ka mbetur emri *glishtëtë* e ndonjë tjetër, që mund të ketë përdorim sporadik.

Rasa kallëzore ruan formën më të moçme të shqipes, si: *kazanë, Vasillaqnë: emërnë, hesapnë, kalnë, djalnë* etj., por nuk përjashtohen edhe format me mbaresën – *in(ë): vendinë, asqerllëkinë* etj.

Në shumë emra ruhen disa forma, që për historinë e shqipes janë me interes. Për këtë segment, Bojka përmend emrat: *kuol* ose edhe *kvol*, apo *vllazëra (vëllezër)*, që na kujton formën e disa të folmeve italo-arbëreshe (*vëllazëra*) dhe kjo formë, gjithsesi afron, nga njëra anë me gegërishten *vëllazën*, pa metaforë të zanores së temës, dhe nga ana tjetër me toskërishten, sepse ka rotacizmin e mbaresës së shumësit.

Në fushën e përemrave pronorë po përmendim trajtat, si: *tim veshë, timja vëlla, timja mëmë, timen motër* etj., që pa dyshim edhe këtu shihet qartë ndikimi i bullgarishtes në topikën e tyre, sepse në Mandricë kemi kudo vetëm parandëjtje të pronorëve, kur në shqipen, siç dihet kemi format e prapavendosura.

Në zgjedhimin e foljeve e folmja e Mandricës ndjek më tepër tipin e toskërishtes, por edhe në këtë segment dalin disa forma mjaft të vjetra.

Imperfekti për të gjitha foljet në vetën e parë dhe të dytë njëjës ka mbaresat –*nja*, –*nje: hapënja, hapënje*. Ndërsa në vetën e tretë kjo trajtë kohore e imperfektit del me mbaresën –*sh: klanesh, shkonish, jepish* etj.

Në aorist zotëruese janë format e formuara me mbaresën e paraprirë nga një –*t-: shkojti,, punojta, punojte , punojti* etj. Mirëpo, nuk mungojnë as edhe rastet e aoristit sigmatik: *klesha, zasha,, thasha* etj.

është e veçantë mënyra e formimit të futurit, e cila formohet me pjesëzën *o (do) + lidhoren*, ashtu si në toskërishten: *un o t’mer, nuk o t vem, o t vejsh dë klishë* etj.

Pjesorja del me mbaresat–*rë: larë, punuarë*, ose me mbaresën –*tur: këndojtur, shkrojtur, mbylltur* etj.

Në sferën e sintaksës vihet re ndikimi fort i madh i bullgarishtes, sidomos në prapavendosjen e emrave të gjinore para emrit: *djellës lule, qengjes mish, verës kupë* etj.

Pra, ndikimi i bullgarishtes në Mandricë dukshëm vërehet si në fonetikë, ashtu edhe në gramatikë e leksik.

Unë këtu i shtrova vetëm disa nga çështjet për të cilat ka bërë fjalë Bojka Sokollova, por monografia e saj gjerë e gjatë kap dhe shpjegon edhe shumë të dhëna të tjera, qoftë për veçoritë vetanake të të folmes së Mandricës ose edhe për shumë raste të ndikimeve, jo vetëm të bullgarishtes, por edhe të greqishtes e të turqishtes.

Megjithatë, sipas konstatimeve të Sokollovës ndikimi i gjuhëve bullgare, greke dhe turke në shqipen e Mandricës nuk ka arritur ta shndërrojë atë të folme në një konglomerat. Prandaj, nga kjo shihet qartë, se e folmja shqipe e Mandricës nuk është zhdukur, as edhe nuk i ka humbur tiparet qenësore, ngase deri më sot ka ruajtur fizionominë dhe strukturën e saj të vërtetë.

Teuta ABRASHI

PIKËPAMJET DHE KONTRIBUTI I HILMI AGANIT LIDHUR ME TEORINË E TOGFJALËSHIT DHE RASËS GJINORE TË GJUHËS SHQIPE

Profesor Hilmi Agani mori pjesë në mënyrë aktive në debatet e ndryshme, e sidomos në ato të cilat tentuan të vendosin bazën teorike të strukturave sintaksore të gjuhës shqipe në rrafshin sinkronik, siç janë teoria e togfjalëshit dhe numri i rasave në gjuhën shqipe. Vërejtjet apo, siç i çuan ai, objeksionet rreth këtyre çështjeve në atë kohë nuk u përfshinë tërësisht në këto çështje teorike (si p. sh. togfjalëshi), e që me kohë u dëshmuua se ishte një lëshim që duhet përmirësuar¹. Në pjesën e parë të këtij punimi do të bëhet fjalë për vërejtjet e prof. Aganit rreth teorisë së togfjalëshit: lidhjes predikative kundrejt lidhjes atributive, struktura dyfjalore kundrejt asaj dypjesore, përfshirjes apo mospërfshirjes së fjalëve funksionale në formimin e togfjalëshave etj. Në pjesën e dytë do të bëhet fjalë rreth rasës gjinore, funksioni i saj në krahasim me funksionet e rasave të tjera të zhdrejta (dhanorja dhe rrjedhorja), kontributi i kësaj rase në strukturën informative të fjalisë, statusi i saj etj.

Natyrisht, në këtë punim do të përfshihet vetëm një fragment i kontributit të prof. Aganit rreth këtyre çështjeve. Qëllimi i këtij punimi, përveç që të tërheqë vëmendjen në kontributet e profesorit, është gjithashtu të rrahë disa argumente shtesë që dalin nga objeksionet dhe diskutimet e profesorit.

1. Pikëpamjet lidhur me togfjalëshin

Teoria e togfjalëshit është teori themelore e cila në gramatikën e Akademisë përdoret për të përshkruar sintaksën e strukturave të gjuhës shqipe. Kjo teori u prezantua fillimisht si një kumtesë në Konferencën e Dytë Albanologjike më 1968 nga Spiro Floqi. Versioni fillestar i kësaj teorie të botuar në Studime Filologjike

¹ Shiko p. sh. kumtesat lidhur me qëndrimet e prof. Aganit në Seminarin e 19 përkatësisht 24:

Ahmetaj, Sala (2001): Probleme të gjymtyrëzimit të fjalisë, f. 415-420, Seminari 19, Prishtinë.

Dhima, Toma (2005): Probleme të njërive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma), Seminari 24, Prishtinë.

Memushaj (2005): Rreth orientimit teorik të gjuhësisë shqiptare, Seminari 24, Prishtinë.

(1/1968) nuk përmban më shumë se 8 (tetë) faqe. Prandaj, ajo më shumë i përngjan një skice të një programi se sa një teorie, e cila kishte për ambicie të përfshinte konceptin dhe specifikat e një strukture elementare të sintaksës së gjuhës shqipe. Përveç mungesës së të dhënave (të mjaftueshme) empirike ajo pati edhe lëshime teorike për të cilat u shprehën edhe gjuhëtarë të tjerë nga Shqipëria. Kështu, Përnaska e Bubani hodhën poshtë ekzistimin e togfjalëshit predikativ, kurse Luka dëshmoi se përemri dhe numërori duhet të merren si togfjalësha formues.

Në punimin e vet të botuar në revistën Fjala, më 1975, në Prishtinë, prof. Agani paraqiti vërejtjet e tija lidhur me këtë teori, të cilat nëpërmjet të një argumentimi shumë të mprehtë dhe bindës dalin se janë fundamentale dhe seriozisht e cenojnë teorinë e togfjalëshit ashtu si e paraqiti Floqi dhe e aprovoi shumica. Mjerisht, siç shihet nga gramatika e Akademisë, vërejtjet me vend të prof. Aganit nuk u morën parasysh, kështu që kjo teori vazhdon ende të përdoret me gjithë të metat që ka.

Modeli të cilin e sugjeron prof. Agani jo vetëm që është koherent me rrjedhat aktuale në fushën e sintaksës, por studimi i tij mundëson të kuptohen më drejt strukturat sintaksore të gjuhës shqipe e sidomos të atyre që bëjnë pjesë në domenin nominal.

Para se të paraqesim vërejtjet e prof. Aganit, në vijim po prezantojmë shkurtimisht konceptin e togfjalëshit sipas Floqit. Togfjalëshi përbëhet nga së paku dy fjalë shënuese, lidhjen e të cilave e bëjnë trajtat e fjalëve, mbaresat dhe fjalët shërbyese (nyjat, parafjalët). Ani pse togfjalëshat mund të kenë më shumë se dy fjalë (tri dhe rrallë katër fjalë), ata gjithnjë kanë strukturë dygjymtyrëshe: fjalë + fjalë, fjalë + togfjalësh dhe togfjalësh + togfjalësh. Njëra gjymtyrë është kryesore, kurse tjetra e varur. Kjo teori merr në konsideratë vetëm lidhjen nënrenditëse dhe përjashton lidhjen bashkërenditëse, sepse “uniteti gramatikor dhe kuptimor” i togfjalëshit zbulohet vetëm “në lidhjen e nënrenditjes”. Sipas Floqit, në togfjalësh shprehen marrëdhënie:

1) midis subjektit të veprimit dhe vetë veprimit (marrëdhënie predikative: *hapësira jehonte; shiu pushoi*).

2) midis veprimit dhe objektit (marrëdhënie objektore apo kundrinore: *me nisë trenin; me dëgju muzikë*, etj.)

3) Marrëdhënie atributive e përcaktore (*njëqind lekë; mot i ftohtë; shirat e vjeshhtës; bukë gruri*);


4) marrëdhënie rrethore (*punonin shumë; u nisën dje* etj.).

Varësisht nga pjesa e ligjëratës me të cilën është shprehur gjymtyra kryesore e togfjalëshit, sipas Floqit, mund të ndërtohen këto modele: (1) *togfjalëshe emërore*, (2) *togfjalëshe foljore*, (3) *togfjalëshe mbiemërore*, (4) *togfjalëshe ndajfoljore* dhe (5) *togfjalëshe përemërore*. Për të ilustruar se si paraqiten strukturat nëpërmjet togfjalëshave, ai merr edhe këtë shembull:

- (1) *Garda e Skënderbeut përfshinte një batalion prej gjashtëqind kalorësish të zgjedhur.*


Sipas përkufizimit, kjo strukturë ka këto togfjalësha: /garda e Skënderbeut/, /garda përfshinte/, /përfshinte një batalion/, /një batalion prej kalorësish/, / prej gjashtëqind kalorësish/, prej kalorësish të zgjedhur/. Skematikisht kjo do të dukej kështu:

(2)



Apo si në (3), me ç’rast togfjalëshat janë paraqitur si lidhje ndërmjet dy vijave me shigjeta:

(3)



Vërejtjet e prof. Aganit ishin këto:

- (4) ‘*Garda përfshinte*’ nuk mund të formojë njësi sintaksore, pra **togfjalësh predikativ nuk ka**.
- (5) **Dypjesëshi** e jo dyfjalëshi duhet të jetë struktura themelore togfjalëshit.
- (6) Togfjalësh nuk formojnë vetëm fjalët shënjuese, por **togfjalësh formojnë edhe fjalët funksionale** (nyjat, parafjalët, klitikët etj.)


Të fillojmë me vërejtjen e parë: pse nuk mund të ketë togfjalësh predikativ?
Sipas prof. Aganit, sintagma dhe fjalia nuk janë identike. Sintagma është statike, kurse fjalia dinamike. Për të ilustruar këtë ai merr këtë shembull:

- (7) a) **Babai është i sëmurë**
b) **Babai i sëmurë** erdhi

Dallimi ndërmjet (7a) dhe (7b) qëndron në faktin se në (7a) babai është i sëmurë në momentin e ligjërimit, kurse në (7b) babai është i sëmurë edhe para momentit të ligjërimit. Pohimin e prof. Aganit se togfjalësh predikativ nuk ka e dëshmon më së miri struktura e predikateve dytësore:

- (8) a) Agimi e hëngri supën **e ngrohtë**.
b) Agimi e hëngri supën **të ngrohtë**.

Në (8a) Agimi e hëngri supën e cila është gjithnjë e ngrohtë, para dhe gjatë pirjes së saj, pra kemi gjendje statike, kurse në (8b) supa e Agimit nuk është e thënë se është e ngrohtë gjithnjë, por ajo është gjithsesi e ngrohtë në momentin e ngrënies, pra kemi një gjendje dinamike. Prandaj, në (8a) emri *supë* dhe mbiemri *e ngrohtë* formojnë një sintagmë, por edhe togfjalësh ashtu si e përkufizoi Floqi, kurse në shembullin (8b) po këto gjymtyrë nuk formojnë një togfjalësh. Të rikujtojmë, sipas Floqit: “mbiemri ne rasën kallëzore ka njëjën ‘e’ kur fjalët janë bashkuar drejtpërdrejt midis tyre, por ka njëjën *të* kur kemi bashkimin e një togfjalëshi të tërë dhe një fjalë²”. Vërejmë se në shembullin (8b) ndërmjet emrit dhe mbiemrit është një lidhje ekuivalente me lidhjen fjalë + togfjalësh e jo fjalë + fjalë siç është në shembullin (8a). Thënë ndryshe, në shembullin (8b) kemi situatën sikur të ishte ndërkallur një gjymtyrë ndërmjet emrit dhe mbiemrit. Siç shihet në paraqitjen skematike (9), te predikatet dytësore me mbiemër ndodh pikërisht një gjë e tillë:



² Po aty, f. 79

Në shembullin (8a) *supën* dhe *e ngrohtë* formojnë sintagmën NP, kurse në (8b) ndërmjet *supën* dhe *të ngrohtë* është ndërkall PRO, subjekti i sifjalisë (SC) apo small clause, siç quhet anglisht. Ky subjekt është në fakt një përemër anaforik i heshtur, antecedent i të cilit është kundrina *supën*. PRO e merr rolin e vet (të domosdoshëm) semantik³ për t'u kualifikuar si subjekt i sifjalisë, nga mbiemri (në funksion sekondar predikativ) *të ngrohtë*.

Se lidhja ndërmjet *supën* dhe *të ngrohtë* në pikëpamje strukturore nuk është e drejtpërdrejt e thotë edhe vetë Floqi⁴, të cilën madje e përforcon me rregullën e vet të togzueshmisë⁵. Këtu po bëjmë një digresion dhe po themi (ngjashëm si Përnaska) se rregulla e mësipërme nuk është e kompletuar, sepse ajo nuk është e provuar edhe për rasat e tjera, si p.sh. emërorja:

(10) Agimi ngiste veturën **i dehur**.

Në (10) lidhja ndërmjet kundrinës *veturën* dhe mbiemrit *i dehur* nuk është e drejtpërdrejtë. Kjo është e kuptueshme sepse *vetura* nuk mund të jetë *e dehur*. Mirëpo, ani pse *i dehur* i referohet *Agimit*, këto dy gjymtyrë megjithatë mund të mos jenë të lidhura drejtpërdrejtë, por ngjashëm si në shembullin (8), mbiemri është në funksion predikativ (Agimi është i dehur në kohën e ngasjes së veturës) prandaj ai është i lidhur me kryefjalën nëpërmjet përemrit anaforik të heshtur PRO, antecedent i të cilit (në këtë rast) është kryefjala *Agimi*.

Pra, edhe formalisht treguam, duke përdor pikërisht pohimet e Floqit, se lidhja predikative në gjuhën shqipe nuk mund të formon togfjalësh. Këtu të themi gjithashtu se relacioni predikativ siç e jep Floqi nuk përputhet as me modelin tradicional gramatikor. Modeli tradicional apo aristotelian e pranon relacionin kundrinor, por jo edhe relacionin ndërmjet subjektit dhe veprimit. Përkundrazi, te ky model ndërmjet kryefjalës dhe kundrinës ekziston një asimetri strukturore. Kështu në shembullin:

(11) Babai shikon djalin⁶.

Sipas Floqit, në (11) ishte dashur të kemi këta togfjalësh: *babai shikon* dhe *shikon djalin*. Edhe për prof. Aganin, struktura në (11) ka gjithashtu dy sintagma, por njëra përmban vetëm subjektin *babai* kurse tjetra predikatin *shikon djalin*, që është identike me Fjalìa= (NP)(VP). Në figurën në (12) mund të vërejmë dallimin ndërmjet Floqit dhe prof. Aganit:


³ Apo *theta rolin* siç e quajnë gjenerativistët.

⁴ Po aty, f. 79 dhe 80

⁵ Po aty, f. 79

⁶ Shembull I marr nga Martinet të cilin e përdor edhe prof. Agani. Shiko: Martinet, Andre (1961): A Functional View of Language, Oxford University Press, London.

(12)



Në (12) vërejmë gjithashtu se përkundrejt përkufizimit ekskluzivisht nënrenditës të togfjalëshit struktura e fjalisë e paraqitur nëpërmjet të togfjalëshave ka konfiguracion bashkërenditës, për dallim nga prof. Agani të cilin edhe pa këtë ekskluzivitet përkufizues struktura e fjalisë ka konfiguracion nënrenditës, pra mu ashtu si është rasti në gjuhën shqipe. Sepse të rikujtojmë, rolin semantik apo theta të subjektit nuk e përcakton folja, por folja + kundrina:

- (13) a) Beni theu dritaren
 b) Beni theu dorën

Duke ndërruar kundrinën (nga *dritaren* në *dorën*) Beni nga roli i agensit apo shkaktarit (13a) merr rolin e patientsit apo pësuesit (13b). Një asimetri e tillë ndërmjet subjektit dhe foljes nga njëra anë dhe foljes e kundrinës nga ana tjetër të Floqi nuk ekziston. Siç shihet në (12), të Floqi këto relacione janë plotësisht simetrike, andaj edhe konfiguracioni i fjalisë është bashkërenditës e jo nënrenditës si është në gjuhën shqipe. Ky fakt dëshmon se përkufizimi dhe analiza e drejtë e njësisë themelore sintaksore drejtpërdrejt reflekton edhe të strukturat më të përbëra.

Vërejtja e dytë e prof. Aganit ka të bëjë me vëllimin e togfjalëshit, e cila thotë se togfjalëshi duhet të ketë së paku dy fjalë. Prof. Agani e sfidon këtë pjesë të përkufizimit me një pyetje: si do të trajtohen fjalët siç janë foljet e vetës së dytë njëjës ose shumës të lidhore+trajta e shkurtër e përemrit vetor, që në gjuhën e folur s'kanë përdorim aq të rrallë?" Me këtë rast ai na rikujton shkrimet e Mahir Domit se "në analizën logjike trajtat si këto duhen të zbërthehen e analizohen veçan folja e veçan përemri":

- (14) Foli atij djali që të vijë këtu. Fol i atij djali që të vijë këtu.

Shembulli (14) është logjikisht ekuivalent me shembullin (15):

(15) I fol atij djali që të vijë këtu.

Pra, foli = fol+ i = folja + përemri vetor, që me fjalë të tjera, ani pse në dukje *foli* është një fjalë ajo në vete ngërthen dy gjymtyrë. Prandaj, prof. Agani propozon modifikimin e përkufizimit të vëllimit të togfjalëshit nga së paku dy fjalë në së paku dy njësi apo dy pjesë. Një konstatim i tillë i prof. Aganit është koherent edhe me zhvillimet e sotme lidhur me klitikët e imperativit (shiko p. sh. punimet e Rivero, Kallulli etj.).

Vërejtja e tretë ka të bëjë me statusin e fjalëve funksionale. Prof. Agani fjalët funksionale i sheh si shprehje gjuhësore të cilat nuk shënojnë ndonjë send, entitet apo veprim, por ato shprehin marrëdhënie nocionore apo konceptuale. P. sh. *nyja* e shquar e konkretizon pjesëmarrësin në një veprim, mbaresat eptuese të foljes e përcaktojnë kohën e ngjarjes, parafjalët përcaktojnë marrëdhëniet hapësinore etj. Të fillojmë me *nyjat*. *Nyja* postpozitive, e cila është ekuivalente me dëftorin deiktik dhe anaforik (*ky djalë, ai djalë, djal-i* etj.) përveç që individualizon emrin, ajo i jep (të shprehem në frymën e Martinet) autonomi në topikë. Së bashku me *nyjën*, emri fiton liri më të gjerë të pozicionimit sintaksor varësisht nga nevoja e kumtimit. Për *nyjat* e prepositive apo të parme ai apelon për një analizë të diferencuar të tyre, sepse ato nuk kanë kuptim unik në të gjitha përdorimet. Kështu, *nyja* e parme të numërorët, për dallim nga *nyja* e parme e mbiemrit apo e disa emrave si p. sh. i Matjan, i Pejan etj. ende se ka humbur kuptimin dhe funksionin e saj të dikurshëm për të shënuar totalitetin si p. sh. *të tre, të katërt* etj. Ai e pranon se kuptimi aktual është i dobësuar në krahasim me kuptimin e saj të dikurshëm, andaj sot përdoren format *që të tre, që të katërt* të cilat prania e *që* me kuptimin *gjithë* përforcon totalitetin. Por, ai thekson se një situatë e tillë nuk është gjithnjë e pranishme sepse në “pyetjen a erdhën tre apo katër?” përgjigjja mund të jetë “erdhën të shtatë” që nënkupton *gjithë të shtatë*. Duke u mbështetur te Demiraj, prof. Agani ngjashëm konkludon edhe lidhur me *nyjën* e gjinore e cila e ka kuptimin logjik të një përemri:

(16) Librin tim e kam harruar, prandaj do të mësoj me *të shokut*

Në shembullin (16) ekuivalenca logjike e *të shokut* është me atë të *shokut*.

Lidhur me parafjalët prof Agani merr shembullin e parafjalëve emërore. Sipas tij:

- (17) a) Në krye të rrugës
 b) krye të rrugës
 c) * të rrugës

kanë kuptim identik. Kjo vlen edhe për *në mes të pyllit* dhe *mes pyllit*, sepse gjuha shqipe lejon ekuivalenca të tilla siç është p. sh. *nëpër pazar* dhe *pazarit*. Por, problemi është se sipas përkufizimit (17a) është togfjalësh, kurse (17b) nuk është, sepse *krye* në (17a) është emër, kurse në (17b) është parafjalë. Sipas Aganit, nëse parafjala e ka aftësinë që ti mundëson një fjale të kryej një funksion sintaksor, atëherë ato duhet të jenë të afta të ndërtojnë edhe togfjalësha. Gjithashtu, ai na rikujton pohimin e Martinet se përfshirja e parafjalëve në fjalë togfjalësh- formuese i mundëson folësit që për nevoja të kumtimit të zhvendosë këtë strukturë kudo brenda fjalisë.

Në fund, lidhur me fjalët funksionale, po themi se propozimi i prof. Agani është në përputhje me zhvillimet aktuale në shkencat gjuhësore. Kështu p. sh. modeli i gramatikës gjenerative njih dy lloj fraza (sintagma): leksikore dhe funksionale, të cilat drejtpërdrejt konfigurojnë strukturën sintaksore të shprehjeve gjuhësore.

2. Pikëpamjet rreth rasës gjinore

Pikëpamjet e veta rreth rasës gjinore, të cilat paevitueshëm ngrehin edhe çështjen qëndrueshmërisë së sistemit rasor në gjuhën shqipe, prof. Agani i shkroi në një punim të titulluar: *Rreth një sinkretizmi në shqipe*, i cili u botua në *Gjurmime Albanologjike VII*, më 1977, në Prishtinë. Për shkak të formanteve të njëjta që kanë gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja disa gjuhëtarë mendojnë se këto tri rasa duhet të shkrihen në një rasë të vetme, e quajtur rasë e zhdrejtë⁷. Nëse abstraktohet nyja e parme e gjinore dhe mbaresa *-sh* e shumësit të rrjedhores, atëherë nga ana formale nuk mbetet asnjë arsye të mbahet sistemi aktual pesërasësh i gjuhës shqipe. Mirëpo, prof. Agani kujton se ruajtja e sistemit pesërasësh mbështetet në elementë kuptimorë dhe funksionalë që kanë një peshë, e cila e arsyeton mbajtjen këtij sistemi⁸. Kështu p.sh. funksioni i gjinore në gjuhën shqipe është pikë së pari përcaktimi i emrit, kurse funksioni i dhanore është të plotëson kuptimin e foljes-kallëzues. Por, nga ana tjetër, duhet të kihet parasysh se nëse sistemi i rasave nuk është treguar edhe “aq i aftë për shprehjen e raporteve të caktuara e për precizim të substancës në relacionet mendim– gjuhë të asaj që kërkohet të shprehet zë e humb pjesërisht peshën që kishte për procesin e komunikimit, e elemente të tjera nisin të zhvillohen...në dëm të sistemit në fjalë..., por disa fenomene shfaqen ...për të kryer funksione

⁷ Prifti, Stefan (1975): Mendime për disa çështje të rasave në gjuhën shqipe, *Studime Filologjike* 1975/3, Tiranë dhe së fundi Spencer, Andrew (2009): The possessum-agreement construction or Does Albanian have a genitive case? Në: Malchukov, Andrej & Spencer, Andrew: *The Oxford Handbook of Case*, Oxford University Press, Oxford

⁸ Po aty, f. 84

kompenzatore...”⁹. Për prof. Aganin, faktorët që sollën deri te pakësimi i numrit të rasave (në shqipe dhe evropeshite) janë po ata të cilët u listuan nga Demiraj: (i) paraqitja dhe zhvillimi i parafjalëve, (ii) revolucioni, rënia e tingujve fundorë të fjalëve dhe (iii) veprimi rrafshues i analogjisë. Prandaj, para se të merret ndonjë vendim për turrje të mëtutjeshme të këtij sistemi, ishte dashur të analizohet së pari gjendja aktuale e këtij procesi, i cili lidhet ngushtë me funksionet e këtyre rasave në procesin e komunikimit. Nëse, përveç formës, ka edhe përputhje të funksioneve ndërmjet këtyre rasave, atëherë turrja e sistemit rasor do të jetë e paevitueshme.

Se çfarë funksioni do të kryejë një emër varet nga mënyra se si ai lidhet me gjymtyrë të tjera. Nëse lidhja është adnominale atëherë funksioni i tij duhet të kërkohet brenda sintagmës, kurse nëse lidhja është adverbiale atëherë funksioni i tij duhet kërkuar brenda fjalisë. Thënë ndryshe, emri ka aftësi të ketë lidhje atributive (sintagma) dhe predikative (fjalë). Rrjedhimisht, meqë secili emër karakterizohet me një rasë të caktuar, atëherë (parimisht) themi se rasat mund të realizojnë funksionet e tyre brenda sintagmës dhe brenda fjalisë. Se a do të realizohen vërtet këto funksione varet nga kërkesa të cilën e parashtron sintagma apo fjala bosht e saj (emri) gjegjësisht fjalë apo fjala bosht e saj (folja). Pra, jo secila rasë i realizon funksionet e veta në sintagmë dhe në fjali. Por, meqenëse sintagma është pjesë e fjalisë, kurse fjalë nuk është pjesë përbërëse e sintagmës, themi se ato rasë të cilat i realizojnë funksionet e veta brenda sintagmës, në mos drejtpërdrejt, atëherë tërthorazi, i realizojnë funksionet e veta edhe brenda fjalisë. Kjo njëkohësisht implikon se nxjerrja e këtyre funksioneve (të tërthorta) është më e ndërlikuar dhe më heterogjene se sa të funksioneve të drejtpërdrejta. Për këtë arsye prof. Agani konstaton se “ e përbashkëta e heterogjenisë funksionale të emrit në rasën gjinore” është pikërisht për shkak se gjinorja është përcaktuese e emrit¹⁰.

Funksionet rasore të emrave janë specifike për secilën gjuhë, prandaj gjuhët dallohen edhe për nga mënyra se si dhe ku i realizojnë funksionet e tyre rasat e asaj gjuhe. Kështu, në gjuhën shqipe gjinorja është vetëm adnominale dhe asnjë parafjalë (e mirëfilltë) nuk e kërkon një rasë të tillë. Në gjuhën gjermane, ka gjinore adnominale, gjinore adverbiale (për jo më shumë se 16 folje) dhe një numër i konsiderueshëm i parafjalëve të cilat e kërkojnë gjinoren.

Për prof. Aganin funksioni primar i gjinores në gjuhën shqipe është përcaktimi i emrit, kurse për rrjedhoren ai kujton se pohimi i Demiraj se një emër në rasën rrjedhore (pa parafjalë) nuk mund të shërbejë si përcaktor i një emri tjetër është i diskutueshëm. Në shembullin në vijim:

(18) Foli fjalë burrash.

⁹ Po aty, f. 85

¹⁰ Po aty, f. 111

Në shembullin (18) trajta *burrash* është edhe në rrjedhore edhe përcaktor. Prandaj në sintagmat si *ujë mali, ullinj Berati, mish qengji*¹¹ etj. emri përcaktues nuk është në gjinore, por në rrjedhore, sepse kur *foli fjalë burrash* kthehet në njëjës “është vështirë të pohohet se po ajo gjymtyrë në po at fjali ...në njëjës...*foli fjalë burri* nuk është në rrjedhore dhe nuk është përcaktuese”¹². Sipas prof. Aganit rrjedhorja është rasë bifunkionale ajo përcakton emrin (me ose pa parafjalë) dhe të plotëson foljen-kallëzues (me ose pa parafjalë). Si përcaktor rrjedhorja i afrohet gjinores, e cila ka vetëm këtë funksion, kurse si plotës apo kundrinë i afrohet dhanores, e cila paraqitet vetëm në këtë funksion. Prandaj, kjo mund të jetë arsyeja e luhatjes së kategorizimit të parafjalëve sipas reaksionit (me dhanoren apo me rrjedhoren, për shkak të formave identike)¹³ dhe mbase burim i formimit të lokucioneve foljore-emërore të kësaj rase.

Siç u tha edhe në pjesën e parë të këtij punimi dhe më vonë edhe në pjesën e dytë, sintagmën prof. Agani e sheh ndryshe nga Sosyri¹⁴. Sintagmën dhe fjalinë ai i merr si dy njësi të ndryshme sintaksore me lidhje të veçanta dhe të ndryshme. Funksioni i gjinores brenda sintagmës është përcaktimi i emrit, i cili jep raporte kuptimore të ndryshme. Prof. Agani liston tetë prej tyre, pa pretendime se lista është e kompletuar. Karakteristike për lidhjen atributive të emrit në gjinore është:

- (i) Emri në gjinore mund të jetë përcaktuesi dhe i përcaktuari, numri i gjymtyrëve atributive të renditura në këtë mënyrë nuk është i kufizuar,
- (ii) Emri në gjinore në funksion atributiv mund të jetë në secilën rasë. Karakteristika e fundit është edhe dallimi esencial ndërmjet gjinores dhe dhanores¹⁵
- (iii) Topika e emrit në gjinore zakonisht është pas emrit. Emri në gjinore para emrit bosht nuk mund të takohet as në gjuhën e folme e as në prozën e shkruar¹⁶. Por, një inversioni i tillë në poezinë shqipe mund të ndeshet, shembujt e marr nga Mjeda e Gurakuqi e dëshmojnë një fakt të tillë.

¹¹ Sipas Demiraj përcaktuesi te këta togfjalësh është gjinorja, sepse gjymtyra e dytë e këtyre togfjalëshave detyrimisht kthehet në gjinore “të shquar” të paranyjzuar, në rast se emri përdoret në trajtë të shquar (uji i malit, ullinj të Beratit). Lidhur me këtë prof. Agani shtron këtë pyetje: “po emri në shumës, me mbaresën -sh të rrjedhores, a nuk kthehet njësoj detyrimisht në gjinore të paranyjzuar, të shquar kur edhe e përcaktuara është e shquar?” (f. 89). Ai më tutje shton: “... kjo do të thoshte se gjendja e vjetër e gjinores pa nyje është ruajtur deri vonë; por kjo do të thoshte edhe se njëjtësimi i formanteve të emrave në gjinore e dhanore dhe ruajtja e asaj gjendjeje një kohë të gjatë kanë qenë të mundshme edhe pa një faktor diferencues çfarë është nyja e gjinores. E kjo s’duket fort bindëse”. (f. 94)

¹² Po aty, f. 88

¹³ Po aty, f. 89

¹⁴ Po aty, f. 89

¹⁵ Po aty, f. 87

¹⁶ Po aty, f. 96

Madje, sipas profesorit, kur është i suksesshëm, i jep bukuri vargut dhe jo vetëm që plotëson nevojat e tij (ritmi, rima, metrika) por i jep edhe mundësi të zbrzjes emocionale¹⁷. Gjinatorja përcaktuese nuk mund t'i dalë përpara gjymtyrës së përcaktuar prej saj në togfjalësh, në qoftë se gjymtyra e përcaktuar është në rasat dhanore ose rrjedhore, apo gjinore. Por gjinatorja përcaktuese mund të qëndrojë para gjymtyrës së përcaktuar në rast se gjymtyra e përcaktuar është në rasën emërore ose në rasën kallëzore. Në këto raste togfjalëshi mund të thuhet me gjymtyrë të tjera të fjalisë. (*Që t'Tepelenit* iu pat kendue *Luanin*). Në rastin fjalë + togfjalësh, i tërë togfjalëshi del para fjalës (*t'qytetit mretnuer* rrethin). Në rastin e togfjalësh + togfjalësh, i tërë togfjalëshi i cili përmban gjinoren del përpara (*t'nji mendes kreshnike* t'gjitha zyret...). Vërejmë se nyja e gjinores ndërron nga nyja e lidhur në një të këputur të gjinores.

Brenda fjalisë, siç u parashikua, ekziston një heterogjeni funksionale e cila paraqitet me konstruktë të ndryshme:

- (i) Emri në gjinore të kallëzuesi emëror si p.sh. *Iliri është i gojës* ka këto karakteristika: (a) lidhja e gjinores me të përcaktuarën realizon komunikimin (lidhjen predikative), (b) gjinatorja në këtë rast nuk mund të përcakton asnjë gjymtyrë tjetër përveç kryefjalës, (c) për dallim nga togfjalëshorja të e cila mund ti ketë më shumë se një lidhje, të lidhja kallëzuesore mund të jetë vetëm një lidhje e tillë, (d) lidhja kallëzuesore ka përdorim më të rrallë se togfjalëshorja, (e) lidhja togfjalëshore mund të përsëritet brenda fjalisë, ajo përcakton edhe gjymtyrët e tjera përveç kryefjalës, (f) raportet kuptimore të lidhja kallëzuesore janë të ngjashme si të sintagma, por ato janë të ngarkuara edhe me elementin e kohës e të mënyrës, të domosdoshme për komunikim.
- (ii) Emri në gjinore me parafjalë emërore. Parafjalët emërore nuk janë parafjalë të mirëfillta. Në fakt ato janë lokucione të formuara nga një parafjalë e mirëfilltë dhe një emër: *me anën (e)*, *në mesin (e)*, *në krye (të)* etj. të cilat kërkojnë gjinoren. Shfaqja e këtyre parafjalëve dhe zhvillimi i tyre sidomos në gjuhën e shkruar, është një dëshmi për gjetjen e mënyrës alternative në komunikim.
- (iii) Emri në gjinore paraqitet edhe pranë parafjalëve të mirëfillta: *Në dyqanet e privatëve gjithçka shitet më shtrenjtë se në të shtetit*. Në këtë rast togfjalëshi të shtetit sipas prof. Aganit është i mangët (eliptik) sepse atij i mungon emri bosht, i cili nuk përsëritet sepse ai ende është i pranishëm në vetëdijen e dëgjuesit. Nga pikëpamja e strukturës informative vetëm

¹⁷ Po aty, f. 96-98

emri në gjinore paraqet informatën e re, prandaj përfshirja e emrit bosht në rrafshin komunikativ nuk paraqet ndonjë mangësi informative.

- (iv) Si plotës kallëzuesor (qoftë kryefjalë, qoftë kundrinë) ai është bifunksional:” edhe i plotëson kuptimin kallëzuesit edhe i referohet kryefjalës, përkatësisht kundrinës, duke i përcaktuar ato, por në mënyrë të veçantë¹⁸...ky bifunksionalitet i dallon këta plotësorë nga të gjithë të tjerat¹⁹,”

Punimin e vet prof. Agani nuk e përfundon me ndonjë sugjerim të drejtpërdrejtë se a duhet apo nuk duhet shkruar këto rase në një të vetme, mirëpo heterogjeniteti funksional sidomos i gjinore lë të kuptojë se këto funksione të këtyre rasave përputhen vetëm pjesërisht.

¹⁸ Po aty, f. 106

¹⁹ Po aty, f. 111

Linditë SEJDIU - RUGOVA

KALLËZUESI I SHQIPES

Në këtë retrospektivë të studimeve gjuhësore të shqipes në 100-vjetorin e themelimit të shtetit shqiptar vërehet një zhvillim i ngadalshëm i teorisë sintaksore të elementeve funksionale në gramatikat dhe studimet e shqipes (me përjashtim të monografive të Dhimës, Turano-Kolecit, Buxhelit etj.).

Nëse nisemi nga studiuësit më të hershëm të gramatikës së shqipes, më konkretisht të atyre të sintaksës, si: Xhuvani, Rrota, Sheperi e më vonë edhe te Prifti e Domi vërehet një ide e përbashkët e asaj kohe për përkufizimin e kallëzuesit dhe të shpjegimit të funksionit semantik të këtij elementi sintaksor. Ideja e gjithë këtyre gramatikanëve përkonte me shpjegimin që kallëzuesi është ai element i fjalisë që i referohet kryesisht kryefjalës. Përkufizimet si: *Kallëzues është fjala që tregon atë çka i pohohet ose i mohohet kryefjalës* (Prifti, 1971:60), pastaj: *kallëzuesi asht ajo pjesë e fjalisë që tregon se shka ban kryefjala*, etj. janë tejkaluar qëmoti. Aty-këtu ka edhe shpjegime që nuk janë demoduar asnjëherë, p.sh. përkufizimi i Priftit se *kallëzuesi është gjymtyra predikative e fjalisë me karakter aktiv të mundësimin të komunikimit midis njerëzve* (Prifti, 1971:61), apo se *kallëzuesi mund të jetë njëgjymtyrësh dhe shumëgjymtyrësh (monolektik dhe perifrastik)* (Prifti, 1971:63), por jo edhe ndarja e kallëzuesit në foljor dhe emëror.

Pikërisht kjo është arsyeja pse do të merremi me çështjen e kallëzuesit dhe të shtjellimit të ndërlikuar që i bëjnë atij gramatikanët tanë vazhdimisht.

Në gramatikën e Akademisë (Gjuha shqipe II, 1990:173) kallëzuesi definohet si gjymtyra kryesore e fjalisë dykryegjymtyrëshe, që hyn në marrëdhënie e në lidhje kallëzuesore me kryefjalën. Një definicion i tillë nënkupton që fjalitë e tjera që nuk janë dykryegjymtyrëshe nuk paskan kallëzues fare që shpeshherë del i nënkuptuar: p.sh. në rastet: *Ftohtë!* ose *Gjëmon!* nënkuptohet që mungon folja këpujore *është* apo kryefjala *qielli*.

Më tutje, kur shpjegohet se me çfarë shprehet kallëzuesi, thuhet: kallëzuesi shprehet me folje, me foljen *jam* (të shoqëruar nga një emër, mbiemër, përemër a numëror), mund të shprehet gjithashtu edhe me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

Veçimi i foljes *jam* nga foljet e tjera e ndërlikon shpjegimin e kallëzuesit në nivel të përkufizimit meqë edhe folja *jam* (ndonëse këpujore) është folje, nuk është

as emër e as fjalë emërore. Ndonëse e konsideruar nga disa gjuhëtarë si folje e gjymtë (duke u mbështetur në rastin e rusishtes dhe të disa gjuhëve të tjera indoevropiane, të cilat në të tashmen e dëftores foljen këpujore nuk e përdorin fare, por e nënkuptojnë: krahaso *Marija krasivaja* dhe *Marija byla krasivaja*), prapëseprapë, prania dhe vendosja e saj në listën e foljeve këpujore, bashkë me foljet e tjera të tipit *bëhem, dukem* etj., si dhe prania e saj në opozitë të vazhdueshme ndaj foljeve kalimtare bën që folja *jam* të konsiderohet, megjithatë, kallëzues. Struktura sipërfaqësore e fjalisë *Maria është e bukur*. dhe *Maria lexon libra*. duket e ndryshme, por analiza sintagmatike e këtyre dy fjalive del e njëjtë: që të dyja e kanë nga një kryefjalë dhe nga një kallëzues, i cili përbëhet nga folja / sintagma e thjeshtë foljore + komplementi i foljes apo plotësi i foljes, në rastin e parë komplementi është kallëzuesor dhe në të dytën kundrinor, por që të dyja elementet janë plotës (verb complements ose verb internal arguments). Për më tepër, në të dyja rastet strukturalisht kemi të bëjmë me emër / sintagmë të thjeshtë emërore. Është e kuptueshme që tradicionalistët nuk do ta praninin këtë përkufizim, meqë për ta struktura është e rendit të dytë gjatë analizës sintaksore, duke theksuar se kundrina (kuptimisht) në rastin *libra* i referohet një pjesëmarrësi në situatë të komunikimit që ka rol të ndryshëm nga ai i kryefjalës, ndërkaq kallëzuesori i kryefjalës i referohet një veçorie apo tipari që i përshkruhet një referenti të kryefjalës.

Megjithatë, nuk duhet harruar se një kategorizim të ngjashëm me këtë tonin është përpjekur ta sillte edhe Totoni në vitet 70-ta (Totoni, 1976: 87-113), duke theksuar se (sipas tij) studiuesit shqiptarë e kanë mbivlerësuar rëndësinë e emrit a mbiemrit me kuptim suplementar brenda kallëzuesit emëror. Ahmetaj (Dardania Sacra, 2000: 350), ndërkaq, e kundërshton Totonin, duke theksuar se folja këpujore bashkë me fjalën që e shoqëron krijojnë një tërësi semantike dhe sintaksore dhe si e tillë duhet të konsiderohet si një nocion. Çeliku, ndonëse e ka emëruar Sintaksën e tij sipas stilit blumfildian në përbërës të drejtpërdrejtë, me disa gjysmë-përpjekje të tij, sidomos gjatë shtjellimit të të ashtuquajturit kallëzues i përbërë foljor, duke e ndarë foljen e parë nga e dyta në strukturat e tipit: *filluan të ndanin, mund të vdiste*, etj. (që sipas definicionit tonë do të quhej folje shumëfjalëshe ose edhe sintagmë foljore e përbërë nga një folje gjysmëndihmëse dhe koka, duke i përjashtuar këtu shprehjet idiomatike dhe frazeologjizmat e tipit *nguli thikën në shpinë* semantikisht të barabartë me foljen *tradhtoi*) i afrohet shtjellimit strukturor të kallëzuesit në shqipen, por nuk shkon më larg se aq! Për Çelikun, si edhe për shumë studiues të tjerë të gramatikës së shqipes, rëndësia e kallëzuesit emëror përqendrohet vetëm te pjesa plotësuese e foljes këpujore. (Çeliku, 2012: 155).

Buholci / Fidleri, ndërkaq, në gramatikën e tyre të shqipes të viteve 80-ta (Buholc / Fidler, 1985: 428) kallëzuesin (predikatin) e përkufizojnë si folje drejtuese, e cila e ndërton qendrën strukturale sintaksore të fjalisë, dhe e cila, në bazë të valencës së saj (pra, varësisht se a është kalimtare apo këpujore) e përcakton

numrin e aktantëve apo të gjymtyrëve të tjera. Normalisht është pjesë obligative e SF-së (sintagmës foljore) dhe lidhjen e ngushtë predikative e krijon me plotësit e saj. Në strukturën bazë të shqipes, sipas Buholcit, kryefjala qëndron para predikatit dhe predikati para elementeve të tjera të kësaj lidhjeje të ngushtë predikative. Llojet e ndryshme të kallëzuesorëve Buholci i quan plotës predikativë njëgjymtyrësh dhe shumëgjymtyrësh

Në gramatikat e gjuhëve të tjera (i kemi parasysh kryesisht gramatikat e gjuhëve të huaja të pas vitit 2000 e kënde), kur definohet kallëzuesi, flitet për foljen në përgjithësi (Quirk at al, 2000:49) dhe foljet (verbs) nuk quhen a klasifikohen fare si gjymtyrë, por si elemente strukturore dhe funksionale të fjalisë.

Në disa gramatika të tjera (Huddleston at al, 2002:50) në zërin që bën fjalë për foljen thuhet: koka e fjalisë së thjeshtë (predikati) realizohet nëpërmjet sintagmës foljore, ndërkaq koka e sintagmës foljore (predicator) realizohet nëpërmjet foljes. Pra, kemi të bëjmë me kallëzuesin në kuptim të ngushtë dhe të gjerë të fjalës. Sipas këtij të fundit, folja është strumbullari i tërë fjalisë dhe plotësit e foljes nënkuptohen si plotës të brendshëm të saj, shumë të afërt me kallëzuesin, ndërkaq kryefjala si plotës i jashtëm i saj.¹ Një qasje e tillë është shumë e afërt me tiparet themelore të teorisë gjenerativiste transformacionale të principeve dhe të parametrave.

Pra, kallëzuesi konsiderohet element qendror, kryefjala dhe plotësit (ku hyjnë kundrinat dhe plotësit e kryefjalës dhe të kundrinës) janë më qendrorë se rrethanorët, ndërkaq rrethanorët janë elementet më periferike të fjalisë. Kur flitet për termat **qendror** dhe **periferik** merret parasysh rëndësia e tyre në shpjegimin e një akti të komunikimit, jo pozita e tyre në fjali, sepse në shqipen kjo pozitë mund të ndryshojë varësisht nga qëndrimi folës.

Grafi, gjithashtu, e dallon tiparin seleksionues që kanë foljet me rastin e kombinimit të tyre me kryefjalën a plotësit e tjerë (Graffi, 2003: 61-72). Sipas tij, është pikërisht folja ajo që pranon ndërtime me një, dy apo asnjë argument.

Kallëzuesi i shqipes do të duhej të nënklasifikohej më tutje varësisht nga lloji i foljes me të cilën përfaqësohet në fjali. Si i tillë, kallëzuesi do të realizohej me: folje këpujore të njëfishtë, kalimtare të njëfishtë, kalimtare të dyfishtë, kalimtare – këpujore apo jokalimtare. Edhe plotësit që do të merrte kallëzuesi në shqipen do të klasifikoheshin në varësi nga lloji i foljes me të cilën shprehet në fjali dhe, si pasojë, nuk do të kategorizohej si kallëzues edhe pjesa emërore që i shtohet foljes këpujore. Thjesht, do të kishim përdorim kalimtar apo këpujor të foljes, apo plotës të foljes të quajtur kallëzuesor i kryefjalës ose plotës predikativ i kryefjalës, kallëzuesor i kundrinës ose plotës predikativ i kundrinës, kundrinë e drejtë, kundrinë e zhdrejtë

¹ Për çështjen e plotësve dhe të përcaktorëve në shqipen, shih punimin e Lindita Rugovës për përcaktorët e shqipes, aktet e Seminarit 29, gusht 2010!

dhe rrethanor. Do të eliminohej ndarja e kallëzuesit në emëror dhe foljor, meqë çdo kallëzues në të vërtetë është sintagmë foljore, qoftë e thjeshtë apo e përbërë.

Një klasifikim si ky e përjashton nga përdorimi termin dhe konceptin e kallëzuesit foljor dhe të kallëzuesit emëror. Thjesht, gjuha shqipe e ka një kallëzues, kompleksiteti dhe kuptimi i të cilit plotësohen nga plotësit (komplementët) e llojeve të ndryshme.

Bibliografia

1. AHMETAJ, Sala (2000), *Foljet këpujore dhe funksioni i tyre sintaksor*, Dardania Sacra, Prishtinë.
2. ASHRSH, Instituti i gjuhësisë (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë.
3. ASHRSH, Instituti i gjuhësisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Tiranë.
4. BACH, Emmon (1974), *Syntactic Theory*, Holt, Rinehart and Winston, INC, New York.
5. BECI, Bahri (2001), *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Enti i teksteve..., Prishtinë.
6. BLAGANJE, Dana & KONTE Ivan (1979), *Modern English Grammar*, Državna Založba Slovenije, Ljubljana.
7. BOISSIN, Henri (1975), *Grammaire de l'Albanais Moderne*, Chez l'Auteur, Paris.
8. BUCHHOLZ, Oda & FIEDLER, Wilfried (1987), *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie, Leipzig.
9. BUXHELI, Ludmilla (2011), *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*, QSA, Tiranë.
10. CAMAJ, Martin (1984), *Albanian Grammar*, Wiesbaden, Otto Harrassowitz.
11. CHOMSKY, Noam (1965), *Aspects of Theory of Syntax*, The M.I.T. Press, Massachusetts.
12. ÇELIKU, Mehmet (2012), *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, ILAR, Tiranë.
13. DEMIRAJ, Shaban (1971), *Gramatika e gjuhës shqipe – fonetika dhe morfologjia*, Enti i teksteve..., Prishtinë.
14. DEMIRAJ, Shaban (1988), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
15. DOMI, M., ÇELIKU, M., TOTONI, M., PËRNASKA, R., FLOQI, S. (1991), *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe – Sintaksa e fjalisë*, Enti i teksteve..., Prishtinë.
16. DOMI, Mahir (1971), *Gramatika e gjuhës shqipe – Sintaksa*, Enti i teksteve dhe i..., Prishtinë.

17. DHIMA, Thoma (2005), *Gjuha shqipe – Sintaksa*, SHBLU, Tiranë.
18. FROMKIN, Victoria – RODMAN, Robert – HYAMS, Nina (2003), *An Introduction to Language*, Thomson – Heinle, Boston.
19. GRINDER, John & HADEN – ELGIN Suzette (1973), *Guide to Transformational Grammar (History, Theory, Practice)*, Holt, Rinehart and Winston, INC., New York.
20. HUDDLESTON, Rodney & PULLUM, Geoffrey K. (2002), *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, Cambridge.
21. JACOBS, Roderick A. (1995), *English Syntax, A Grammar for English Language Professionals*, Oxford University Press, New York.
22. KOLECI, Flora & TURANO, Giuseppina (2011), *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë.
23. LYONS, John (1968), *Introduction to Theoretical Linguistics*, Cambridge U.P., London.
24. LYONS, John (1970), *New Horizons in linguistics*, Penguin Books, Middlesex, England.
25. PRIFTI, Stefan (1971), *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve..., Prishtinë.
26. QUIRK, Randolph – GREENBAUM, Sidney – LEECH, Geoffrey – SVARTVIK, Jan (1985), *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, Essex.
27. QUIRK, Randolph – GREENBAUM, Sidney – LEECH, Geoffrey – SVARTVIK, Jan (1972), *A grammar of contemporary English*, London, Longman Group, London.
28. QUIRK, Randolph – GREENBAUM, Sidney – LEECH, Geoffrey – SVARTVIK, Jan (2000), *A comprehensive grammar of the English language*, Pearson Education, Harlow.
29. RUGOVA, Linditë (2007), *Sintagmat sintaksore të shqipes*, në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 25/1, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
30. SPAHIU, Agim (1997), *Rreth klasifikimit strukturor-semantik të fjalive komplekse në gjuhën shqipe*, Filologji 3, Prishtinë.
31. TOTONI, Menella (1976), *Përcaktori kallëzuesor*, SF, nr. 3, Tiranë.
32. TURANO, Giuseppina (1996), *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, Tiranë, Toena, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë.
33. WERLICH, Egon (1983), *A Text Grammar of English*, Quelle & Meyer, Stuttgart.

Lindita XHANARI - LATIFI

KONTRIBUTE TË STUDIUESVE SHQIPTARË NË FUSHËN E ORIENTALISTIKËS GJATË 100 VITEVE TË FUNDIT

Kur flasim për kontribute të studiuesve në fushën e orientalistikës, na duhet të bëjmë disa sqarime dhe klasifikime të veçanta, pasi megjithëse çështja në pamje të parë duket të jetë e thjeshtë dhe jo shumë e komplikuar, ajo përmban në vetvete disa nënçështje, të cilat kanë qenë dhe janë shoqëruese të pandashme të gjithë këtyre studimeve. Këto studime kanë pasur dhe kanë lidhje të drejtpërdrejtë

- së pari, me ekzistencën e të ashtuquajturës letërsi e bejtexhinjve.
- së dyti, me ndikimin e persishtes, arabishtes dhe turqishtes, më së shumti, në leksikun e gjuhës shqipe.

Për këtë arsye, studiuesit shqiptarë në fushën e orientalistikës, duhet t'i ndajmë në dy grupe:

- studiues që u morën me shkrimet e shqipes me alfabet arab.
 - studiues që u morën me evidentimin e huazimeve perse, arabe dhe turke.
- I gjithë punimi ynë është mbështetur në këtë lloj klasifikimi.

I. Studiues që u morën me shkrimet e shqipes me alfabet arab

Sa i takon grupit të parë të studiuesve na duhet të theksojmë se terreni në të cilin punuan pati problematikën e vet. Kështu, për një periudhë të gjatë kohe, shkrimet e shqipes me alfabet arab nuk u trajtuan gjuhësisht, madje as nga pikëpamja filologjike, por u emërtuan thjesht si letërsi e bejtexhinjve, duke u trajtuar vetëm si të tilla në tekstet dhe antologjitë letrare.

Brenda këtij grupi na duhet të veçojmë disa studiues që për shkak të arsimit dhe edukimit të tyre nëpër Medrese, ose studimit në degët e Orientalistikës të asaj kohe, e për rrjedhojë për shkak të njohurive të mira që kishin fituar në përvetësimin e gjuhëve orientale (arabisht, persisht, osmanishte dhe turqishte e re) u morën në mënyrë të drejtpërdrejtë me transkriptimin e tyre dhe këtu mund të përmendim sidomos Hasan Kaleshin, Osman Myderrizin, Muhamed Pirraku dhe M. Hysa, si dhe grupin e atyre studiuesve që pa qenë orientalistë të mirëfilltë, me një nuhatje të hollë filologjike ngritën çështjen e trajtimit filologjik të këtyre teksteve, si tekste të vjetra

të shqipes me alfabet arab. Këtu mund të përmendim akademik Rexhep Ismajli dhe Prof. Mahir Domini.

Akademik R. Ismajli do t'i kushtojë kësaj çështjeje, si askush tjetër, një kapitull të veçantë në monografinë e tij shkencore "Tekste të vjetra", të titulluar: Letërsia me alfabet arab/Alhamiada¹. Në këtë kapitull ai sqaron termin "alhamiada" dhe "alhamiada shqiptare", si dhe trajton thelbin e mendimit teorik të Myderrizit, Kaleshit, Pirrakut dhe Hysës në lidhje me shkrimet e vjetra të shqipes me alfabet arab.

Ndërsa prof. M. Domi me vlerësimin që u bën në tekstet e para universitare të letërsisë shqipe, sidomos shkrimeve të Nezim Frakullës, diktojmë që ai është ndër pionierët e parë që vë theksin në rëndësinë e studimit filologjik të letërsisë shqipe me alfabet arab. Kjo duket qartë në përkufizimin përgjithësues që ka lënë për Frakullën: "Si tekst i parë i rëndësishëm i toskërishtes së shekullit XVIII, vjershat e Nezimit kanë edhe një interes të veçantë gjuhësor. Alfabeti arab me të cilin u shkruan, me mungesat që ka për zanoret, e bën shpesh të pasigurt transkriptimin fonetik të tyre. Me gjithë këtë, vlera gjuhësore e poezisë së Nezimit s'është e paktë, ato na japin shumë material për historinë e gjuhës sonë, sidomos për morfologjinë e sintaksën"²

Orientalisti Hasan Kaleshi me veprën dhe kontributin e tij në fushën e Orientalistikës është vlerësuar si një nga emblemat e shquara të saj. Ai ka publikuar një sërë studimesh të tij në revista, që trajtojnë çështje të Orientalistikës dhe ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare për Orientalistikën. Më 1957-ën botoi për letërsinë e shkruar shqipe me shkrim arab, si dhe për veprën e Sami Frashërit.³ Për letërsinë shqipe me alfabet latin thekson R. Ismajli, Kaleshi mendonte se ajo kishte karakter vetëm fetar. "...Mirëpo, me shfaqjen e letërsisë shqipe me alfabet arab kemi të bëjmë jo vetëm me letërsi laike, po edhe me letërsi artistike. E lindur në gjirin e letërsisë turke, ndërsa kjo në gjirin e letërsisë klasike persiane, në radhë të parë të poezisë, ajo solli lloje të reja dhe seliti tema dhe motive të reja, të cilat seliteshin në këto dy letërsi, e që ishin më të shumta se në letërsinë e deriatëherëshme fetare. Me këtë letërsia shqipe u shkëput nga rrathët e ngushtë fetare."⁴

Kaleshi analizon imtësisht përmbajtjen e këtyre shkrimeve me alfabet arab, duke theksuar njëkohësisht nevojën e studimit të tyre. Njëkohësisht, ai jep edhe shkaqet e mos përhapjes së këtij lloj shkrimi në të gjitha trevat shqiptare në të njëjtën kohë e në të njëjtën mënyrë. Ai thekson se në këtë letërsi "gjenden poezia e vërtetë artistike, epi fetar-romantik, tregimet në vargje me karakter moral-didaktik,

¹ Ismajli, R. Tekste të vjetra, fq. 26-43.

² Domi, M. Nezim Frakulla në "Histori e letërsisë shqipe", I, fq. 254-268

³ <http://orientalizmi.wordpress.com/category/islamologji/page/2>

⁴ Ismajli, R. Tekste të vjetra, fq. 35

vjersha të gjata në të cilat mbisundon tematika shoqërore, një numër i madh mevludesh, fjalorë turqisht-shqip, tekste shkollorë-pedagogjike, vepra me karakter moral-arsimues, poezi lirike mistike (e dervishëve), ilahi dhe përkthime nga arabishtja e turqishtja. Kjo letërsi në fillim lindi në qytete të Shqipërisë ku mbisundonte gjuha shqipe, ndërsa në disa qytete të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi shfaqet gati 100 vjet më vonë, sepse aty mbisundonte turqishtja. Mund të thuhet madje se ajo nuk u shfaq fare në qytetet ku mbisundonte theksimisht turqishtja.”⁵

Orientalisti O. Myderrizi që në fillimet e studimeve të tij ka theksuar domosdoshmërinë e vlerësimit të drejtë dhe me objektivitet të shkrimeve me alfabet arab.

“Tekstet e vjetra shqip që njohim sot nuk e kalojnë shekullin XVIII. Nga mbarimi i shekullit XVII letërsia fetare katolike shqip filloi të shterë dhe vendin e saj nisi ta zërë letërsia laike e fetare shqip me alfabetin arab”.⁶ Duke studiuar këto shkrime ai përcakton edhe periudhën e zhvillimit të tyre: “Letërsia me alfabet arab vazhdoi vetëm nja 150 vjet. Me fillimin e Rilindjes dalëngadalë u shter dhe vendin e saj e zë tërësisht letërsia kombëtare. Kur filloi të shkruhet shqipja me alfabet arab? Tekstet më të vjetra që kemi gjetur deri tani i përkasin gjysmës së parë të shekullit XVIII. Poezitë që kanë data në këto tekste venë deri më 1724. Shpresa për të gjetur edhe tekste më të vjetra nuk është prerë. Letërsia me alfabet arab është pjellë e kulturës myslimane në Shqipëri. Kjo kulturë zu rrënjë mirë në Shqipëri vetëm në shekullin XVII, kështu tekste më të vjetra që e kalojnë këtë shekull nuk duhet të presim”⁷.

Myderrizi gjatë gjithë studimeve të tij mbetet tejet kritik në lidhje me vlerësimin dhe rivlerësimin që i duhej bërë teksteve të vjetra të shqipes me alfabet arab. Që në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike, mbajtur më 1962-in, ai thekson se: “Për të gjetur tekstet e vjetra me alfabet latin e grek u bënë kërkime sistematike nga albanologët e nga shqiptarët vetë dhe dalëngadalë këto tekste u zbuluan të gjitha. Mirëpo për tekstet me alfabet arab s`u bë asnjë kërkim. Intelektualët e asaj kohe kishin paragjykime për tekstet shqip me alfabetin arab dhe për autorët e tyre, të shkaktuara në radhë të parë nga shkronjat arabe e në radhë të dytë nga fjalët e kulturës që përdoren në këto tekste arabisht, persisht e turqisht”.⁸ Ai më pas do të këmbëngulë në sqarimin se: “Pavarësisht nga shkronjat e nga fjalët e huaja të kulturës tekstet shqip me alfabetin arab janë tekste të vjetra shqip. Pa

⁵ Ismajli, R. Tekste të vjetra, fq. 38.

⁶ Myderrizi, O. Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 15-21 Nëntor 1962, fq. 287

⁷ Myderrizi, O. Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 15-21 Nëntor 1962, fq. 290-291

⁸ Myderrizi, O. Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 15-21 Nëntor 1962, fq. 288-289

njohur e pa studiuar mirë këto tekste as historia letërsisë shqipe nuk mund të shkruhet, as historia e zhvillimit të gjuhës së shkruar nuk mund të kuptohet”.⁹

Nga Myderrizi nuk kemi ndonjë studim monografik në lidhje me këto çështje, por ai ka lënë pas jo vetëm transkriptime të Nezimit, Kamberit etj, por edhe një varg artikujsh studimorë në lidhje me shkrimet e këtyre autorëve. Ai thekson se fillesa të këtyre shkrimeve i gjejmë tek autorë të cilët shkruanin turqisht “Letërsia shqiptare tyrqisht në Shqipëri mbeti letërsi e një rrethi të ngushtë. Populli s`dinte tyrqisht dhe këtë letërsi s`e kuptonte.Poeti që shkroi këngë, gazele e kaside tyrqisht, nisi të shkruajë edhe këngë, gazele e kaside shqip dhe kështu filloi një letërsi e re, letërsia shqipe me alfabet arab. Kur u shkrua e nga cili u shkrua kënga e parë me të cilën nisis kjo letërsi e re shqipe, nuk e dimë. Ndoshta u shkrua nga Mesih Prishtina në shekullin XV, ndoshta nga Jahja Dukagjini, që e deshi Shqipërinë më të madhe, në shekullin e XVI”¹⁰. Si tekst të parë të gjetur ai përcakton “një lutje të çudiçme të një kafemani që aty- këtu kthehet me mjeshtri në një parodi. Lutja është shkruar më 1725 dhe autori i saj quhet Muçi Zade. Ky tekst i parëka një rëndësi të posaçme, se është shkruar në toskërisht dhe përbën dokumentin e parë që njohim gjer tashti të shkruar në Shqipëri në këtë dialekt.”¹¹

Studimet e Myderrizit në fushën e orientalistikës patën meritën se bëjnë edhe një lloj periodizimi të letërsisë shqipe me alfabet arab. Kështu, sipas tij, **periudha e parë** e kësaj letërsie e pati qendrën në Berat. “Veprën e madhe me të cilën u formua letërsia shqipe me alfabetin arab e shkroi Nezim Frakulla më 1730-1734 në Berat. Begatia e madhe e Beratit në shekujt XVII-XVIII lindi edhe veprën e madhe në letërsi. Pas Nezimit shkruan në Berat Sulejman Naibi e Ismail Pashë Velabishti. Veprat e këtyre tre poetëve të Beratit këndojnë dashurinë, këndojnë jetën e bukur dhe formojnë të parën letërsi laike çapëne në Shqipëri”¹².

Me rënien e Beratit nga fundi i shekullit XVIII, fillon **periudha e dytë** e zhvillimit të kësaj letërsie. “Periudha e dytë si poetë kryesorë ka Hasan Zyko Kamberin, Muhamed Çamin, Dalip Frashërin e Shahin Frashërin. Nga këta poetë Hasan Zyko Kamberi shkroi edhe poezi laike. Në periudhën e dytë kemi edhe disa poetë që shkruajnë a përkthejnë Mevlude si Ismail Floqin, Abdullah Konispolin, Hafiz Ali Ulqinakun etj. Disa të tjerë si sheh Sulejman Temani, sheh Ahmet Elbasani, Haxhi Ethen Tirana shkruajnë mynaxhate (lutje poetike)”¹³.

Studimi dhe klasifikimi jo vetëm në periudha, por edhe në analizën e përmbajtjes së këtyre shkrimeve bërë nga Myderrizi, ka rëndësi, pasi nëpërmjet tyre

⁹ Myderrizi, O. Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 15-21 Nëntor 1962, fq. 289

¹⁰ Myderrizi, O, Letërsia shqipe me alfabetin arab, BUSH 1955, nr. 2, fq. 150-151

¹¹ Myderrizi, O, Letërsia shqipe me alfabetin arab, BUSH 1955, nr. 2, fq. 151

¹² Myderrizi, O, Letërsia shqipe me alfabetin arab, BUSH 1955, nr. 2, fq. 152

¹³ Myderrizi, O, Letërsia shqipe me alfabetin arab, BUSH 1955, nr. 2, fq. 152

diktojmë se kur i kanë fillësat lutjet në gjuhën shqipe në kultet e ritit mysliman. “ Duhet shënuar se në këtë periudhë letërsia e re me Mevludin shqip futi një këmbë në xhami dhe me predikimet e hytben shqip qe duke u bërë një letërsi fetare e zakonshme për myslimanët shqiptarë. ...Zëvendësimi i tyrqishtes në mevludin dhe i arabishtes në hytben kishte rëndësi se sillte me vete një konsakrim të gjuhës dhe të shkrimit shqip”¹⁴

Më pas studiuesi do të sqarojë në artikuj të veçantë veçori të përmbajtjes, të gjuhës dhe të vargut në shkrimet me alfabet arab të veprës së:

- Nezim Frakullës¹⁵
- Hasan Zyko Kamberit¹⁶
- Dorëshkrime të Vjetra Shqip të Panjohura të Gjirokastrës¹⁷, të cilat paraqiten si një antologji me 25 vjersha dhe prozë të zgjedhura nga autorë të ndryshëm, të shkruar në Gjirokastrë me alfabetin arab e që i përkasin shekujve XVIII-XIX.
- Letërsia Fetare e Bektashive¹⁸, ku trajtohet “Hadikaja” e Dalip Frashërit, etj

Në analizën që i bën studiuesi gjuhës shqipe të shkruar me alfabet arab në të gjitha këto vepra, ai thekson se këta autorë janë mbështetur shumë në gjuhën e folur dhe në folklorin shqiptar. “Letërsia me alfabetin arab përdori metrikën popullore shqiptare dhe metrikës së hua, metrikës arabe e persiane, i ndenji shumë larg. Edhe teknikën e ndërtimit të vargut kjo letërsi e mori nga folklori ynë. Letërsia e Rilindjes në fazën e parë si teknikën e ndërtimit të vargut ashtu edhe metrikën e kësaj letërsie i mbajti me kujdes gjithë ku mund të mbaheshin. Veprat e mëdha të Naimit si Historia e Skënderbeut e Qerbelaja nuk ndërrojnë për varg dhe për teknikë të ndërtimit të vargut nga veprat e Nezim Frakullës, Hasan Zyko Kamberit e Muhamed Çamit”¹⁹.

Studiuesi gjithashtu thekson se studimi i gjuhës së këtyre autorëve ka një rëndësi të madhe, pasi kështu marrim të dhëna edhe mbi të folme të ndryshme të shqipes. Kështu Nezimi na jep të dhëna për gjuhën e Beratit, Hasan Zyko Kamberi për gjuhën e Kolonjës, Dalip Frashëri për të folmen e Përmetit, antologjia me poezi e prozë nga Gjirokastra, për të folmen e Gjirokastrës gjatë shekujve XVII dhe XVIII etj.

¹⁴ Myderrizi, O, Letërsia shqipe me alfabetin arab, BUSH 1955, nr. 2, fq. 153

¹⁵ Myderrizi, O, Nezim Frakulla (1690-1750), BSHSH, 1954/ nr. 4, fq. 56-76

¹⁶ Myderrizi, O, Hasan Zyko Kamberi (1690-1750), BUSH, 1955/ nr. 1, fq. 93-109

¹⁷ Myderrizi, O, Dorëshkrime të Vjetra Shqip të Panjohura të Gjirokastrës, BUSH, 1959/ nr. 2, fq. 159-189

¹⁸ Myderrizi, O, Letërsia Fetare e Bektashive, BUSH, 1955/ nr. 3, fq. 131-142

¹⁹ Myderrizi, O, Letërsia shqipe me alfabetin arab, BUSH 1955, nr. 2, fq. 153

II. Studiues që u morën me evidentimin e huazimeve perse, arabe dhe turke

Me studimin e tyre janë marrë shumë gjuhëtarë shqiptarë e këtu mund të përmendim: T. Dizdari²⁰, E. Çabej²¹, A. Kostallari²², A. Krajni²³, M. Samara²⁴, etj.

Edhe në këtë grup, ashtu si dhe në grupin e parë na duhet të bëjmë një nëndarje tjetër, pasi na duhet të veçojmë kontributet në lëmin e leksikografisë, nga kontributet teorike për analizimin e këtyre huazimeve. Çështja e turqizmeve dhe e orientalizmeve ka paraqitur gjithmonë interes për gjuhëtarët shqiptarë. Në punimet e tyre është hedhur dritë kryesisht për çështje që kanë të bëjnë me historikun e depërtimit të turqizmeve dhe orientalizmeve në gjuhën shqipe, faktorët që kanë luajtur rol në depërtimin e tyre, klasifikimin semantik si dhe ndikime të karakterit gramatikor të tyre në gjuhën shqipe. Mund të përmendim:

- “Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke”, E. Çabej
- “Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII”, A. Kostallari
- “Hymje e turqizmeve në shqipe dhe përpjekje për zëvendësimin e tyre”, A. Krajni
- “Për historinë e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-persiane”, J. Kastrati
- “Zhvillime leksiko-semantike të turqizmeve në gjuhën shqipe”, M. Samara, etj.

Vlerë të veçantë paraqet punimi i profesor **E. Çabej**, i cili arrin të bëjë edhe kronologjinë e hyrjes së huazimeve nga turqishtja **në gjuhën shqipe**. Kështu, në punimin e tij **“Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes”**, ai thekson se: “Sikundër dihet, para edhe gjatë kohës së luftërave të para të popullit me turqit nën prijën e Skënderbeut, dhe sidomos pas pushtimit të vendit nga osmanët, në Shqipëri pati një shpërngulje kryesisht për në Italinë Jugore e në Sicili, e cila në njëfarë pikëpamjeje paraqet një vazhdim të shtegtimit shqiptar në drejtim të jugut për në Greqi. Ndërsa ky i fundit u krye më fort në kohën para turke dhe në kohën e parë turke, ai tjetri në drejtim të Italisë, është afërsisht një shekull më i ri. Ai u krye me valë e dyndje të ndryshme kryesisht rreth mesit dhe gjysmës së dytë të shekullit

²⁰ Dizdari, T.: Fjalor i Orientalizmeve, Tiranë, 2006

²¹ Çabej, E., Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes, SF,1975,1.

²² Kostallari, A., Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII”, Gjurmime albanologjike, SSHF, Prishtinë 1978.

²³ Krajni, A., Hymja e turqizmeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre, SF, 1965,1.

²⁴ Samara, M., Zhvillime leksiko-semantike të turqizmeve në gjuhën shqipe, SF,1995, 1-4.

XV. Aty pati më vonë dhe disa dyndje për një pjesë të madhe prej Greqie (Moreje), gjatë gjysmës së parë të shekullit XVI si dhe gjatë XVII. Grupet etnike që zunë vend kështu në caqe kohe të ndryshme në trojet e Italisë, sollën me vete secili, në ngulimet e reja ku u vendosën, ato huazime turke që kishin depërtuar në dialektet e atdheut të tyre të vjetër gjer në kohën e shkulljes së tyre për në dhe të huaj”. Një pjesë e studiuesve janë shprehur se kjo pjesë e popullsisë në një farë mënyre i “shpëtoi” ndikimeve të gjuhëve turko-orientale.

Por, kudo dhe kurdoherë ekzistojnë studiues, qenia e të cilëve i jep nder dhe i rrit vlerës kulturës së një vendi. I përmasave të tilla është Tahir Dizdari.

Në këtë mori studiuesish merita më e madhe i takon **T. Dizdarit**²⁵, i cili la në dorëshkrim veprën e mrekullueshme: **Fjalorin e orientalizmeve**, që sot për sot përbën punimin më të saktë e më shkencor në fushë të huazimeve turke.

Fjalori përmban **4406** huazime, që autori i quan huazime të drejtpërdrejta nga gjuha turke. Dizdari dallon cilësisht nga të gjithë studiuesit ballkanas, pasi jo vetëm përcakton saktë fjalët e huazuara nga turqishtja, por jep edhe të dhëna me rëndësi për studime të mëtejshme në lidhje me kuptimet leksikore që përmbajnë fjalët e huazuara, në lidhje me ndryshimet fonetike që kanë pësuar këto fjalë duke iu përshtatur shqipes, si dhe në lidhje me përhapjen e tyre në dialektet e shqipes dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit.

Fjalori për fat të keq arriti të botohej vetëm pas 32 vjetësh të ndarjes nga jeta të studiuesit të mirënjohur, jo nga institucione shkencore gjuhësore shqiptare, por nga një fondacion.

Për rëndësinë e kësaj vepre janë shprehur mjaft studiues të huaj dhe këtu mjafton të përmendim një copëz nga letra që i shkruante Dizdarit, profesori J. Nemeth, i Akademisë së Shkencave të Hungarisë: “Nga vepra juaj do të përfitojnë turkologët e botës. Materiali që keni mbledhur është jashtëzakonisht i pasur dhe me vlerë, kështu që meritoni gjithë besimin. Në asnjërën prej gjuhëve të Ballkanit s`janë mbledhur elementet turke në mënyrë kaq të përkryer”²⁶.

Gjithashtu veç këtyre studiuesve tashmë të njohur, na duhet të theksojmë se duhet të quajmë kontribute dorëmbara edhe punimet e doktorantëve në fushën e orientalistikës, të mbrojtura në Degën e Orientalistikës së Universitetit të Prishtinës, të Turkologjisë në Universitetin e Tiranës e kështu me radhë.

Si përfundim, mund të theksojmë se me gjithë vështirësitë objektive dhe subjektive në fushën e studimeve orientale, vështirësi që përcaktohen si nga mosnjohja e gjuhëve të orientit nga ana e studiuesve të rinj dhe këtu mjafton të them se Universiteti i Tiranës nuk ka pasur asnjëherë Degë të Orientalistikës, ashtu edhe nga pamundësia ndonjëherë për t`i gjetur shkrimet e vjetra të shqipes me alfabet

²⁵ Dizdari, T.: Fjalor i Orientalizmave, Tiranë, 2006

²⁶ Dizdari, T.: Fjalor i Orientalizmave, Tiranë, 2006

arab, studimet orientale kanë arritur suksese të dukshme, të cilat do të ishte mirë të mos mbeteshin vetëm me kaq, por të çoheshin edhe më tej.

Bibliografia

1. Çabej, E. (1975), *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, SF, 1.
2. Demiraj, Sh. (2004), *Gjuhësi Ballkanike*, Tiranë.
3. Dizdari, T. (2005), *Fjalor i orientalizmave*, Tiranë.
4. Domi, M. *Nezim Frakulla në "Histori e letërsisë shqipe"*
5. Ismajli, R. (2000), *Tekste të vjetra*, Pejë.
6. Kostallari, A. (1978), *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*", Gjurmime albanologjike, SSHF, Prishtinë.
7. Krajni, A. (1965), *Hymja e turqizmeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre*, SF, 1.
8. Latifi, L. (2006), *Huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*, Tiranë.
9. Myderrizi, O. (1954), *Nezim Frakulla (1690-1750)*, BSHSH, 1954/ nr. 4.
10. Myderrizi, O. (1955), *Hasan Zyko Kamberi (1690-1750)*, BUSH, 1955/ nr. 1.
11. Myderrizi, O. (1955), *Letërsia Fetare e Bektashive*, BUSH, 1955/ nr. 3.
12. Myderrizi, O. (1955), *Letërsia shqipe me alfabetin arab*, BUSH 1955, nr. 2.
13. Myderrizi, O. (1959), *Dorëshkrime të Vjetra Shqip të Panjohura të Gjirokastrës*, BUSH, 1959/ nr. 2.
14. Myderrizi, O. (1962). *Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike*", Tiranë, 15-21 Nëntor 1962.
15. Samara, M. (1995), *Zhvillime leksiko-semantike të turqizmeve në gjuhën shqipe*, SF, 1995, 1-4.
16. Xhuvani, A. & Çabej, E. (1962), *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.

Sedat KUÇI

**SHKOLLA ALBANOLOGJIKE E AGNIA VASILEVNA
DESNICKAJAS**

Arsyeja pse e mora temën në fjalë ka të bëjë me faktin se sivjet janë mbushur plot 100 vjet nga lindja e A. V. Desnickajas, saktësisht pardje më 23 gusht 1912. Kjo përputhet edhe me 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me temën bosht të këtij Seminari.

Krijimi i një shkolle është një vepër e madhe. Në mesin e emrave që ka bërë një vepër të tillë është, pa dyshim, edhe emri i albanologes së shquar Agnia Vasilevna Desnickaja. E lindur në një familje intelektualësh, me babain historian dhe letrar dhe nënën mjeke, Desnickaja trashëgoi një bibliotekë të pasur (një pasuri intelektuale) nga shkencat shoqërore dhe nga ato mjekësore. Në zgjedhjen e profesionit të saj ndikim kishte babai. Kështu ajo u orientua në fushën e shkencave shoqërore, më saktësisht, në shkencat filologjike. E përgatitur për gjuhën dhe letërsinë gjermane, të cilat studime i kreu në Universitetin Shtetëror të Shën Peterburgut, pas një vizite në Shqipëri në vitin 1946, tek ajo u shfaq edhe një dëshirë për studimin e gjuhës, letërsisë, historisë, folklorit, etnografisë, artit dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Që nga ajo kohë e deri në ditët e fundit të jetës Desnickaja u mor me studimet e albanologjisë. Po a ka pasur para Desnickajas studiues që janë marrë me shqiptarët? Përgjigja është po. Akademiku Nikolaj S. Derzhavin,¹ duke hulumtuar historinë e vendbanimeve bullgare në jug të Bashkimit Sovjetik, në fshatrat ukrainase hasi edhe në banorë shqiptarë të vendosur aty me kohë. Ai u kushtoi vëmendje të posaçme gjuhës, folklorit dhe etnografisë së tyre. Në studimin " Nga hulumtimi në fushën e emigracionit shqiptar në territorin e Rusisë dhe RSS të Ukrainës"² paraqiti disa tekste të vjela nga vendësit e këtyre fshatrave dhe i pari mblodhi materialet historike që kanë të bëjnë me këto vendbanime. Po ky autor boton studimin: "Shqiptarët - arnautët në

¹ N.S. Derzhavin ishte akademik rus i shek. XX. Ishte i afërt me N. Ja. Marrin dhe mbante ligjërata në lëndën Hyrje në filologjinë sllave në Universitetin Shtetëror të Moskës.

² Derzhavin N.S. Iz issledovanij v oblasti albanskoj imigracii na teritorii Rossii i USSR. "Sbornik v cest' prof. L. Miletic", Sofia, 1934; Derzhavin N.S. "Jan'i i Janak'i", Sbornik Sergeju Fjodorovicu Oldenburgu. ANSSSR, 1934.

Priazovje të RSS të Ukrainës".³ Aty përshkruan disa zakone popullore të shqiptarëve të Ukrainës lidhur me lindjen, dasmën dhe varrimin.

Mirëpo, studimet albanologjike të mirëfillta sovjetike filluan pas Luftës së Dytë Botërore dhe ato lidhen ngushtë me emrin e albanologes së shquar, anëtare-korrespondente e Akademisë së Shkencave të BRSS-së - profesor Agnija Vasilevna Desnickajas.

Meritë e madhe e saj është krijimi i shkollës shkencore të albanologëve në Bashkimin Sovjetik, si dhe hapja e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin Shtetëror të Peterburgut (Leningradit të atëhershëm), pastaj formimi i qendrave të ndryshme shkencore, ku thellohen studimet albanologjike, siç janë: Instituti i Gjuhësisë në Akademinë e Shkencave të Bashkimit Sovjetik (dega e Peterburgut), Universiteti Shtetëror i Peterburgut, Universiteti Shtetëror i Moskës, Instituti i Gjuhësisë i Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik në Moskë e të disa qendrave të tjera.

Përgatitja e kuadrit

Prof. Agnija V. Desnickaja e dinte fare mirë se krijimi i shkollës nënkupton, para se gjithash, krijimin e kuadrit profesional, hulumtues, prandaj ajo bëri një punë të madhe në përgatitjen e kuadrit shkencor, i cili bashkë me te do t'i rreken më vonë hulumtimit të gjuhësisë e letërsisë shqiptare si: Gertruda Ejntrej, Alvina Zhugra, Irina Voronina, Aleksej Sitov, Juri Llopashov, Mark Gabinski, të cilët bashkë do të përgatitnin brezin e mesëm si Aleksandar Rusakov, Andrej Sobolev, Larisa Kaminskaja, Aleksandar Novik, dhe brezin më të ri si: Marija Morozova, Albina Girfanova, Aleksandra Dugushina, Denis Ermolin, Matvej Lomonosov e të tjerë.

Këta emra, që kanë zënë një vend të rëndësishëm në albanologjinë e krijuar jashtë arealit shqiptar, të dëshmojnë faktin se Desnickaja ka bërë një punë shumë të rëndësishme në krijimin e mundësive për lëvrimin e albanologjisë dhe afirmimin e saj jo vetëm në vendin e tyre por edhe më gjerë.

Programi

Desnickaja jo vetëm që ka krijuar kuadrin shkencor, por ajo ka meritë të madhe edhe në përcaktimin e drejtimit të zhvillimit të albanologjisë sovjetike. Kontributi i Shkollës albanologjike të A. V. Desnickajas është i madh në fushën e gjuhësisë, letërsisë, dialektologjisë dhe folklorit shqiptar. Me këtë rast po i përmendim vetëm disa nga temat bosht nga fusha e albanistikës që janë trajtuar dhe trajtohen si: prejardhja e gjuhës shqipe, dialektologjia, fonetika me fonologji, etnolinguistika, gramatika e gjuhës shqipe, kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera, etj.

³ Derzhavin N.S. Albancy-arnauty na Priazovje Ukrainskoj SSR. Sovetskaja etnografija, 1948, nom. 2.

Në bazë të një hulumtimi të literaturës dhe të analizës së rezultateve kemi ardhur në përfundim se gramatika e gjuhës shqipe nga përfaqësuesit e Shkollës albanologjike të Desnickajas është studiuar në tri drejtime:

1. Morfologjia dhe sintaksa e gjuhës së sotme shqipe;
2. Gramatika shqipe në kuadër të unitetit strukturor - tipologjik të gjuhëve të Ballkanit dhe
3. Gramatika historike e gjuhës shqipe dhe lidhjet e saj me gjuhë të tjera indoevropiane.

Si përfundim: Pjesa më e madhe e studimeve në kërkimet albanologjike, përkatësisht albanistike, në ish BRSS dhe në Rusinë e sotme i përkasin morfologjisë dhe sintaksës së gjuhës së sotme shqipe me një tendencë kah pasurimi i tyre me hulumtime në fushën e fonetikës, etnolinguistikës dhe sociolinguistikës.

Shkolla albanologjike e Desnickajas me rezultatet e arritura deri më tash dhe me kontinuitetin e kuadrit shkencor paraqet një vlerë të madhe kulturore e shkencore jo vetëm për albanologjinë, por edhe për etnokulturat e tjera.

Naser PAJAZITI

NDIHMESA E ALBANOLOGËVE TË HUAJ PËR DIALEKTOLOGJINË E GJUHËS SHQIPE

Ashtu si edhe në shumë fusha të dijeve albanologjike, edhe në sferën e studimeve dialektologjike, janë studiuesit e huaj ata që kanë hedhur hullitë të parët në këtë fushë gjuhësore. Studimet dialektologjike hartuar nga albanologë të huaj janë përqendruar kryesisht në studimin e të folmeve të diasporës shqiptare e shumë më pak në studimin e të folmeve shqipe brenda truallit të saj.

Studimet e para kanë filluar nga G. V. Hani, H. Pedersen, G. Vajgandi, P. Furiqi me studime gjuhësore rreth të folmeve shqipe të arbëreshëve të Greqisë dhe për të folmet e arbëreshëve të Italisë nga M. Lamberci, ndërsa për të folmen e arbëreshëve të Zarës të dhënat e para i dalin qysh në vitin 1868 te Stjepan Buzoviç pastaj te Tulio Erberi, Franjo Mikloshiq e në mënyrë të veçantë te G. Vajgandi e te Karlo Taliavini. Në gramatikën e Hanit gjejmë të dhëna për të folmen e Rrëzës së Përmetit, në gramatikën e Dozonit gjejmë të dhëna për të folmen e Përmetit e të Zagorisë, ashtu si edhe në gramatikën e Vajgandit na pasqyrohet e folmja e Shqipërisë së Mesme ¹.

J. G. Hani, albanolog, i cili ka shërbyer konsull austriak në Janinë na ka lënë të parat shënime për historinë e gjendjes gjuhësore të arbëreshëve të Greqisë. Në vëllimin e dytë *Studime shqiptare* Hani merret me strukturën gramatikore të shqipes nga pikëpamja fonetike dhe morfologjike mbi bazën e toskërishtes, duke e titulluar *Kontribut për një gramatikë të dialektit toskë*. Në këtë studim autori u përpoq të paraqesë në mënyrë sa më të plotë e gjithëpërfshirëse fonetikën dhe morfologjinë e toskërishtes².

Kjo vepër nis me një parathënie e pastaj vjen alfabeti shqip me 33 shkronja greke, ku jepen të dhëna dhe shënime për zanoret dhe bashkëtingëlloret, me ç'rast autori bën dallimi midis diftongut dhe togut zanor. Një hapësirë i ka dhënë po ashtu edhe shndërrimit të **a**-së në **ë** në sistemin vokalik dhe të alternimit të **ll**-së në **dh** në sistemin konsonantik. Në pjesën e fonetikës vend të veçantë i ka kushtuar *theksit* dhe dukurive fonetike, si: metateza, proteza, epenteza, metafoia, apofonia, hiati, kontraksioni, diftongu, rotacizmi etj. Pjesa e morfologjisë fillon me nyjën, pastaj

¹ Jorgji Gjinari-Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2000. f . 99.

² Jup Kastrati, *Historia e albanologjisë*, Tiranë, 2000, f. 777.

analizon emrin duke, duke dalluar tri lakime, mbiemrin, përemrin dhe numërorët. Në kapitullin kushtuar foljes ka dalluar dy zgjedhime e disa klasa foljesh. Në zgjedhimin e parë i klasifikon foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore, ndërsa në zgjedhimin e dytë i klasifikon ato që mbarojnë me zanore. Në grupin e foljeve të parregullta autori i përfshin 18 folje. Sa u përket mënyrave të foljeve, Hani njih mënyrën dëftore, lidhore dhe urdhërore.

Një trajtim të gjerë autori ua ka bërë edhe parafjalëve dhe ndajfoljeve, duke i klasifikuar në bazë të kriterit sintaksor.

Kapitull i veçantë u kushtohet ndajfoljeve dhe lidhëzave. Në këtë kapitull autori ka marrë në shqyrtim edhe lokucionet ndajfoljore të formuara nga përsëritja e së njëjtës fjalë. Sipas autorit, për të hartuar këtë vepër kishte bërë katër vjet punë, në kohën kur ishte konsull austriak në Janinë.

Më 1955 K. H. Reinholdi botoi një gramatikë të shkurtër të shoqëruar edhe me disa tekste të së folmes arbëreshe të Greqisë ishullore.

Njëri ndër albanologët e huaj që ka dhënë kontribut të çmueshëm e me vlerë për studimin e dialekteve të shqipes është pa dyshim edhe M. Lamercit. Ai ishte njohës i mirë i të folmeve arbëreshe të Italisë dhe autor i shumë studimeve rreth tyre, ndërsa kishte mendim se arbëreshët “përbëhen prej familjesh që kanë ardhur nga viset të ndryshme. Këtë na e tregojnë edhe emrat e familjeve të cilat na çojnë në krahina të ndryshme të Shqipërisë, por edhe arsyeja e vërtetë, mbase kishin ardhur bashkë me Skënderbeun dhe kështu i kishte bashkuar rasti. Prandaj, duhet të pranojmë se këto familje, që ishin nga krahina të ndryshme të Shqipërisë së Mesme e Jugore, në jetën e tyre të re dhe të përbashkët në një vend të huaj, krijuan një gjuhë të re, të përbashkët, e cila në një mënyrë nuk i përngjan asnjë dialekti prej atyre që fliten në atdhe.”³

Sipas Lamercit, siç i kishin treguar disa pleq, nëpër kolonitë shqiptare të Molizës deri në vitin 1860 ishin të paktë ata banorë që i dinin të dyja gjuhët, pra të cilët e zotëronin mirë gjuhën italiane, ndërsa sot të gjithë e zotërojnë mirë edhe italishten në përjashtim të atyre fëmijëve që nuk janë në shkollë⁴.

Një pasqyrë të parë të gjendjes së dialekteve të shqipes brenda trojeve kompakte shqiptare e bëri më 1916 studiuesi austriak M. Lamercit në artikullin e tij të mirënjohur “*Relacione rreth studimeve të mia gjuhësore në Shqipëri prej mesit të majit deri në fund të gushtit 1916*”⁵ dhe disa vjet me vonë në të “*Folmet e shqipes*”⁶.

Për të folmet e gegërishtes verilindore e lindore kishte bërë hulumtim edhe Norbert Jokli përmes kontakteve që kishte në Vjenë me shqiptarët nga Tetova e

³ Cituar sipas: Jorgji Gjinari-Gjovalin Shkurta, *Dialektologjia*, Tiranë, 2000. f. 261

⁴ Jorgji Gjinari-Gjovalin Shkurta, *Dialektologjia*, Tiranë, 2000. f. 270.

⁵ Maximilian Lambertz, *Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien von Mittel Mai August 1916*, Anzeiger der Akad. Wissenschaft in Wien, Ph.hist. classes, XX, 1917.

⁶ Jorgji Gjinari-Gjovalin Shkurta, *Dialektologjia*, Tiranë, 2000. f. 100.

Gostivari, kurse në mënyrë të veçantë hulumtimet e tij në bazë të kontakteve që kishte me një shqiptar nga Rapshishti i Gostivarit në Hungarinë e Jugut⁷.

Materiale të vlefshme dhe me interes për dialektologjinë e gjuhës shqipe gjejmë edhe në përmbledhje tekste dialektore (“Përralla shqiptare”), botuar më 1922, nga Akademia e Vjenës.

Xhokomo Jung ,nga Trendo i Italisë, erdhi në Shkodër, ku u emërua mësues në Kolegjin Saferian të Etënve në Shkodër⁸, gjatë kësaj kohe, për nevoja praktike të shkollës, ai hartoi një vepër me titull *Rregulla gramatikore të gjuhës shqipe*, e cila u botua në italisht më 1889. Bazë e kësaj vepre ishte *E folmja e Shkodrës (e Gropës së Shkodrës)*. Në këtë vepër jepen të dhëna për shqiptimin e zanorëve dhe të bashkëtingëlloreve për të vazhduar pastaj me çështje të fushës së morfologjisë. Vepra në fjalë, si e tillë, ka rëndësi të madhe edhe për dialektologjinë historike të shqipes.

Gustav Vajgandi, albanolog gjerman, i cili ishte ithtar i teorisë trake të burimit të shqipes në artikullin *A janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo trakasve*, parashtrori dymbëdhjetë argumente në favor të burimit të shqipes nga trakishtja. Vajgandi, përpos që u mor me problemin e burimit të shqipes dhe të prejardhjes së shqiptarëve, ka dhënë ndihmesën e tij edhe në fushën e dialektologjisë. Në mënyrë të veçantë vlen të përmendet studimi me titull “*Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien*”. Në këtë studim Vajgandi u përpoq të jepte disa tipare fonetike dhe morfologjike dhe pjesa e fjalorit etimologjik e falë këtij fjalori i tërë libri ruan vlerën e tij të qëndrueshme me gjithë pasaktësitë e përshkrim dialektor të kësaj së folmeje⁹. Për këtë studiuesi Karlo Taliavini konstaton se faktet gjuhësore të paraqitura në monografinë e Vajgandit nuk japin saktë dhe për pasojë japin një pasqyrë plotësisht të gabuar për këtë të folme.¹⁰

Më 1913 albanisti i shquar, Gustav Vajgandi, botoi në Lejpcig veprën *Albanesische grammatik im Sudgegischen Dialekt (Gramatika e parë e dialektit të gegërishtes jugore)*. Kjo gramatikë që fyt i punës së tij kërkimore gjatë kohës sa qëndroi në Tiranë, Durrës dhe sidomos në Elbasan, ku 1909 dhe 1912 mbledhi materiale me rëndësi nga këto të folme. Kjo gramatikë ndahet në tri pjesë: në pjesën e parë fonetika dhe morfologjia, në pjesën e dytë zgjedhimi i foljeve dhe në pjesën e tretë ushtrime dhe tekste.

⁷ Rexhep Ismajli, në Parathënie të veprës: Norbert Jokl, *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip*, Prishtinë, 2011, f. 8.

⁸ Xheladin Gusturani, *Historia e albanologjisë*, Tiranë, 1999, f. 172.

⁹ Vaclaw Cimochovski, *Për studimin e Idriz Ajetit*, në *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2004, f. 388.

¹⁰ Carlo Tagliavini, *L'albanese di Dalmazia. Contributi alla conoscenza del dialetto zhego di Borgo Erizzo presso Zara*, Firenze, 1937, cituar sipas: Vaclaw Cimochovski, *Për studimin e Idriz Ajetit*, në *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2004, f. 388.

Interesimet e tij për dialektologjinë e shqipes u zgjeruan edhe më tepër me publikimin e veprës së tij *Das Albanesische im Atika (Shqipja në Atikë)*, botuar më 1926.

Një përpjekje, sidomos sa i përket problemit të ndarjeve dialektore të shqipes, e ka bërë edhe gjuhëtari V. Polaku në artikullin të botuar në *Albanie aslavene*¹¹, ku trajton probleme që lidhen me historinë e degëzimit të dialekteve të shqipes, duke e shpjeguar ndarjen dialekteve të shqipes në mënyrë të gabuar dhe të ndikimit, sipas tij, të substratit sllav të dyfishtë: të bullgarishtes në Jug, ku është formuar dialekti toskë dhe të ndikimit serbishtes në veri, ku u formua gegërishtja. Kjo teori, sipas së cilës dy dialektet janë formuar në ndikimit të gjuhëve të huaja nuk ka gjetur përkrahje të shumica e gjuhëtarëve, ngase autori nuk jep argumente bindëse për teorinë e tij, e cila është mbështetur kryesisht në fakte jashtëgjuhësore.

Më 1939 albanologu italian, Karlo Taliavini, kishte bërë një studim për të folmet arbëreshe “*L’ albanese di Dalmazia*” (*Shqipja e Dalmacisë*). Ky studim më vonë u kritikua ashpër nga Jokli në “*Zur erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo*”). Me këtë studim ai ka dhënë një ndihmesë të çmueshme për njohjen e kësaj së folmeje. Në mënyrë të veçantë, ai u përqendrua në mbledhjen e lëndës leksikore nga arbëreshët e Zarës, e cila është studiuar në aspektin etimologjik. Pjesa më e madhe e studimit në fjalë është rezervuar për fjalorin etimologjik¹².

Me interes për të folmet shqipe në Maqedoni është edhe studimi i Carlo Tagliavinit¹³ “*Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore (Dardania e Maqedonia Veriperëndimore)*” që u botua në edicionin e Akademisë italiane të Romës, më 1924, në të cilin është bërë një përshkrim i të folmeve të Kosovës e të Maqedonisë, duke na dhënë kështu një pasqyrë mbi të folmet kryesore shqiptare në ish-Jugosllavi. Ky studim u përqendrua kryesisht në studimin e dukurive gjuhësore fonetike e shumë më pak në ato morfologjike. Për ta hartuar këtë studim Carlo Tagliavini ishte mbështetur në vështrimet e veta, që i ka bërë gjatë udhëtimit nëpër “Serbinë e vjetër” e Maqedoni më 1927 dhe po ashtu ai ka përdorur materiale tekstesh folklorike të botuara deri më 1942 si dhe shënime shumë të shkurtra të Mlladenovit.¹⁴

M. Bartoli, gjuhëtar italian, kishte botuar studime kushtuar gjuhës shqipe edhe një studimin *Le relique del dialetto Albanese nell Istra (Mbetje të dialektit shqiptar të Istrës)*.

¹¹ V. Polak, *Albanie aslavene (vznikapocatky dnesnchnarccnich variant albanskych; në “ në ”Casopis pro moderni filologii*”, XXXIX, 2-3. Cituar sipas Jorgji Gjinarit, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 61-64.

¹² Idriz Ajeti, *Vepra 5*, Prishtinë, 2002, f. 68.

¹³ Carlo Tagliavini, “*Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore (Dardania e Maqedonia Veriperëndimore)*” në *Studime gjuhësore I (Dialektologji)*, Prishtinë, 1978, f. 105-152.

¹⁴ A. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972, f. 110

Romanisti kroat, Petar Skok, botoi studimin “*Hulumtime gjuhësore të popullsitë josllave të Luginës së Shkupit*”¹⁵. Këtu autori spikat këto dukuri gjuhësore, siç janë: Diftongimi i zanores **i** të theksuari në **ai, ëi, oi: vaiç (viç) mair** (mirë), **dhai** (dhi), **shpai** (shpi) **thaik** (thik), **maik** (mik), **mëi** (mi), **hadhëi** (hardhi), **karshoi** (karshi); diftongimi i zanores **u** të theksuar në **au, ëu, ou: cauc** (cucë), **rraush** (rrush) **ftaue** (ftue) **nauk** (nuk) **nause** (nuse), **e shtaun** (e shtunë), **kshtau** (kështu); labializimi i zanores **ã** hundore, por edhe i zanores **a** në pozicion pranë konsonanteve nazale: **mong** (mãng), **dhanore** (dhãndër), **dhom** (dhãmb), **kom** (kam); pastaj kalimi i bashkëtingëllores **g** në **gj: gjardh** (gardh) **gjuri** (guri); kalimi i grupeve konsonantike **pl** në **pç, ç** dhe **bl** në **bç, ç: pçot** (plot), **çak** (plak), **çeshta** (pleshta), **çet** (bletë) etj.

Në fushën e dialektologjisë është për t’u theksuar edhe studiuesi G. Uhlisht, i cili botoi punimin me titull “*Ndikimi në fjalorin e dialektit shqiptar në Atikë*”.

Për të folmet e Kosovës rëndësi ka botimi i Fjalorit serbokroatisht-shqip (Beograd, 1902) i Lubomir Kujunxhiçit, të cilit ia ka bërë një studim të thelluar e gjithëpërfshirës gjuhëtari Hilmi Agani. Ky fjalor pasqyron një trevë gjuhësore që kap posaçërisht të folmen e Rahovecit e të elementit katolik të Prizrenit dhe në elemente të caktuara edhe të folmen e qytetit të Gjakovës. Sipas Aganit¹⁶, ndonëse për nga begatia leksikore modest dhe i ngarkuar me gabime në aspekte të ndryshme, ky fjalor u shërbeu studiuesve të shqipes, të cilët, duke shtruar pikëpamjet e tyre për çështje të ndryshme të shqipes, mbështetjen nga një trevë e caktuar e gjetën shpesh në këtë fjalor.

Për të folmet e Kosovës është për t’u përmendur edhe publikimi i një *Fjalori të dialektit të Kosovës* nga Glissha Elezoviqi në vitin 1932 dhe më pas në vitin 1955 botimi i një studimi me titull *Veçoritë fonetike të dialektit shqiptar të Dibrës e rrethinave të saj*.

Ndihmesë të çmueshme në fushë të studimeve albanologjike ka dhënë edhe Budimir Petroviqi me studimet për arbneshtet e Zarës në studimet e tij “*Një vështrim mbi trajtat e së ardhmes në të folmet arbneshe të Zarës*” (1954); “*Foljet ndihmëtare në të folmet e arbneshtëve të Zarës*” (1960).

Studiuesja Irena Sawicka, pos disa studimeve të tjera për gjuhën shqipe, ka shkruar edhe një studim dialektologjik për arbëreshet e Italisë me titullin “*Veçoritë tipologjike fonetike të arbëreshëve të Italisë*”.

Një studim me vlerë për të folmet e diasporës është pa dyshim monografia për shqiptarët e Bullgarisë, hartuar nga B. Sokolova¹⁷. Sipas saj, *E folmja e Mandricës* ka ruajtur një varg tiparësh arkaike të shqipes dhe një njëkohësisht kjo e folme ka

¹⁵ Petar Skok “*Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të Luginës së Shkupit*” *Studime gjuhësore I (Dialektologji)*, Prishtinë, 1978, f. 81-103.

¹⁶ Hilmi Agani, *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, Prishtinë, 1981, f. 9, 350.

¹⁷ Bojko Sokolova, *Die albanische Mundart von Mandrica*, Berlin, 1983.

ndjekur një rrugë të zhvillimit të ndryshme nga të folmet tjera të shqipes, por edhe nga ndikimet që ajo ka pasur nga gjuhët në kontakt.

Për të folmen e shqiptarëve të Ukrainës vlen të përmendet studimi “*E folmja e shqiptarëve të fshatit Karakurt*” nga autorja nga L. Demku, e cila është mbrojtur si temë disertacioni. Ky studim nga autorja, më vonë, u botua në 10 artikuj. “*Kategoritë gramatikore të gjinisë në këtë të folmen e shqiptarëve të Ukrainës*” nga L. Sharpova, pastaj “*Funksionet sintaksore të mbiemrave në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës*” të I. Voroninës (I. Voroninës 1970) dhe sidomos monografia “*E folmja e shqiptarëve të Ukrainës*” nga Irina Voronina-Marina Domosileckaja-Lubov Sharpova.¹⁸ Në këtë studim monografik janë marrë në shqyrtim një varg tiparesh gjuhësore të kësaj së folmeje, duke vënë në spikamë ato veçori që janë më karakteristike për këtë të folme dhe në mënyrë të veçantë elementet konservuese të së folmes në fjalë. Më këtë monografi autorët na japin një pasqyrë të plotë për të folmen e shqiptarëve të Ukrainës. Këtu autorët vënë në dukje këto dukuri gjuhësore, siç janë: zhdukja e zanores **y** dhe shqiptimi vend të saj i zanores **u**: *du* (dy), *su* (sy), *tu* (ty); (këtë ndryshim autorët e shikojnë si ndikim bullgarishtes e të rusishtes); kalimi i zanores **y** në **u** shoqërohet edhe me palatalizimin e bashkëtingëllores që i paraprinë **y**-së: *jull* (yll) *juni* (yni); monoftongimi i grupeve të zanorëve *ua*, *ye*, *ie* në *u*, *e*, *i*: *gru* (grua), *du* (dua), *muj* (muaj) *dur* (dyer), *dill* (diell), *mill* (miell), *zin* (ziej) *dim* (djem), *lun* (luan) *thu* (thua). Një tipar arkaik, të cilin e kanë vë në dukje autorët në fjalë, është edhe ruajtja e zanores **ë** të patheksuar, pa marrë parasysh numrin e rrokjeve, p.sh.: *gdhihet*, *të mëdhenjë*, *gërgërit*, *i ngroftë*, *të kositurët*, *të zbadhurtë* etj. Në sistemin konsonantik duhet theksuar ruajtja e bashkëtingëllores të vjetra **kl,gl, lk, lg**: *klumsht*, *klan*, *klinka* (qenka), *gluhë*, *a glat*, *zglihdh* (zgjijdh), *ulk*, *ndëlgon* (dëgjjon); ruajtja e grupeve **mb, ng, nd**: *mbledh*, *vend*, *hëngra*, si dhe kalimin e tyre, në disa raste, në **b, d, g**: *bë* (mbë), *bë kalë* (mbi kalë), *ga klisha* (nga kisha), *ga premit* (nga e premtja), *doniher* (ndonjëherë); ruajtja palatales së vjetër **l** në pozicionin intervokalik: *bilë* (bijë), *golë* (gojë) *fëmil* (fëmijë), *mil* (mijë); neutralizimi i kundërvënies së fonemave **r/-lrr/**: *rall* (rrallë), *fur* (furrë), ëndër (ëndërr), ridh (rrjedh); shurdhimi i konsonanteve të zëshme: *i lik* (i ligë), *dhëmp* (dhëmbë) *prak* (prag) dhe bjerrja e bashkëtingëllores **h**: *ajvan* (hajvan) *she* (sheh), ndërsa në disa raste ajo ka kaluar në **f**, *i ftoftë* (i ftohtë), *i ngroftë* (i ngrohtë). Në sistemin morfologjik do të veçonim: një grup emrash femëror trajtën e shquar e formojnë me nyjën **i** p.sh: *nusi* (nuse), *maci* (mace), *luli* (lule) etj; emrat e gjinisë asnjane, ndonëse kanë filluar të pakësohen ata ruhen ende sot e kësaj dite, p.sh. *mishtë*, *ujtë*, *mielltë*, *djathtë*, *gajlpët*; ruhet rasa vendore, ku tregues të rasës janë mbaresat **-t** dhe **n’i** e cila përdoret në funksion të plotësisë rrethanor, duke treguar

¹⁸ Irina Voronina, Marina Domosileckaja, Lubov Sharpova, *E folmja e shqiptarëve të Ukrainës*, Shkup, 1996.

vendin, p.sh.: *lujtkan ni udhët me pluhur. Aju sheh n'i ujtë të bukur çupë*; mbiemri në të folmen e Ukrainës vendoset para emrit *O bukurë cupë, plakë gru, taze gjalpë, i madhi bir, i bukur trim* etj. Në sistemin foljor do të veçonim vetën e tretë të kohës së pakryer, e cila del me mbaresën **ej** dhe **ij**: *jajnej shkonij, sillnij, zallahitnji*, po kështu duhet vihen në pah edhe mbaresat e kohës së kryer të thjeshtë **-jta (-e)**, **-jta (-e)**, **-jti** për njëjës dhe **-jtim-jtít**, **-jtin** për shumës, si: *shkejta, shkejta, shkejti; shkejtim shkejtit, shkejtin*.

Ndihmesë të rëndësishme në fushën e studimeve të dialekteve të shqipes gjithsesi ka dhënë edhe albanologia ruse A. Desnickaja. Nga studimet e saj, do të veçonim studimin monografik “*Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*”, ku jepen të dhëna të rëndësishme për dialektet e gjuhës shqipe.

Prej studimeve dialektologjike, të cilat janë pjesë e trullit të shqipes do ta veçonim monografinë shteruese, të realizuar me mjaft mjeshtëri nga albanologu polak Vaclav Cimohovski “*E folmja e Dushmanit*”¹⁹, në të cilën autori bën një përshkrim të hollësishëm të sistemit fonetik, morfologjik dhe sintaksor, duke na dhënë kështu një pasqyrë të qartë të pamjes gjuhësore të kësaj së folmeje, kryesisht në aspektin sinkronik.

Më 1965, albanologu Klaus Hebler botoi një “*Gramatikë të së folmes arbëreshe të Selaminës*”²⁰, në të cilën janë trajtuar më hollësi veçoritë fonologjike dhe gramatikore të së folmes së Selaminës, duke u përqendruar në përshkrimin e kësaj së folmeje vetëm në aspektin sinkronik. Sipas Heblerit, E folmja e Selaminës në inventarin e fonemave ka **6** fonema zanore dhe **32** fonema bashkëtingëllore. Në këtë studim autori ka spikatur një varg veçorish fonologjike dhe morfologjike. Nga tiparet fonologjike që ka trajtuar Hebleri do të veçonim: zhdukjen e kundërvënies fonologjike të gjatësisë së zanoreve, mungesën e zanores *y*; shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicion në fund të fjalës *zgz (zog), i math*; ruajtja e grupeve të vjetra konsonantike **ki, gl, lk**: *klumsht, gluh, ulk*; ekzistimi i tre tipave të konsonantit *l*; shqiptimi i bashkëtingëllores *rr*; shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicion në fund të fjalës, si p.sh. *zok (zog), i math (i madh) dhëmp (dhëmb)*; rënia e elementi të parë te grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj dihmë (ndihmë), brëmë (mbrëmë), grënë (ngrënë) etj. Në fusha të morfologjisë do të veçonim: ruajtjen e gjinisë asnjane tek emrat që emërtojnë lëndë, si: *mish, kos, djathë, mjaltë*; tek emrat e tipit, *krie*; tek emrat prejmbiemërorë: *të thellë, te gjjat, të mirë* dhe tek emrat prejpjesorë: *të vajtur, të ardhur, te marrë* etj; emrat që mbarojnë me zanore të theksuar e qp në kallëzore marrin mbaresën **në**: *vëllanë, thonë, ftonë, njerinë*; ruajtja e gjinisë te numërorët tre (për mashkullorë) dhe tri (për femërorë); prania e nyjës së përparme tek emrat e farefisnisë: *e ëma, i jati, i vëllaj e motra*.**

¹⁹ Vaclav Cimochovski, *E folmja e Dushmanit*, në: *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2004.

²⁰ Claus Haebler, *Gramatik der albanischen mundart von Salamin*, Wiesbaden, 1965.

Studiuesi gjerman, H. J Sase, është përqendruar në studimin e të folmeve të arbëreshëve të Greqisë. Ai më 1982, botoi një artikull me titullin *Një dialekt arkaik shqiptar në Ishullin Andros (Greqi)*-1982 dhe më pas, më 1983, botoi studimin *Sistemi foljori dialektit të Vurkotit*.

Sistemi fonologjik i së folmes së Vakarricos është bërë objekt studimi nga studiuesi amerikan Erih Hamb²¹, i cili është shkruar më 1952, ndërsa është botuar në vitin 1993.

Ndonëse shumica e studimeve dialektologjike janë botuar qe disa dekada, , e një pjesë e tyre madje edhe para një shekulli e më shumë, ato edhe sot e kësaj dite mund të shërbejnë si një bazë e mirë për njohjen më të thellë të fenomeneve të ndryshme gjuhësore, jo vetëm për përhapjen dialektore të tyre, por edhe për zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

²¹ Jorgji Gjinari-Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 2000. f. 242

Mimoza KARAGJOZI - KORE

KONTRIBUTI I A. V. DESNICKAJAS PËR GJUHËN SHQIPE

Ky vit përkon me 100-vjetorin e lindjes (1912) së A. V. Desnickajas, albanologes ruse, e cila i kushtoi një pjesë të rëndësishme të punës së saj shkencore njohjes, hulumtimit dhe studimit të gjuhës shqipe në gjysmën e dytë të shekullit që lamë pas.

Qëndrimi në Shqipëri prej 1956-1959, ardhjet e herëpashershme deri më 1991 si dhe pjesëmarrja në aktivitetet shkencore në vendin tonë e Kosovë, i dhanë mundësinë që të njihet mirë me situatën gjuhësore, me marrëdhëniet reciproke aktuale të trajtave dialektore dhe letrare të gjuhës shqipe. Njohja e thellë e shqipes si dhe përgatitja e lartë shkencore bëri që A. Desnickaja të përfshihet, krahas shumë albanologëve të huaj e vendas, në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare, duke prekur pothuajse të gjitha fushat, si historinë e gjuhës shqipe, fonetikën historike, morfologjinë, dialektologjinë si dhe atë të gjuhës letrare. Po përveç kontributit, në fushat e mësipërme, të cilat përkojnë me aspekte të brendshme të shqipes, A.V. Desnickaja e ka parë gjuhën tonë në një plan edhe më të gjerë, si gjuhë ballkanike dhe indoevropiane. Kjo ndihmesë komplekse, por mbi të gjitha aftësia shkencore me të cilën kontribuoi në zgjidhjen e problemeve e rreshtojnë atë, pa ngurrim, përkrah albanologëve të huaj më të shquar.

Duke ecur në hullinë e Boppit, A. Desnickaja¹ pohon se shqipja është gjuhë indoevropiane, e cila nuk është e lidhur gjenetikiisht me asnjë grup linguistik të kohës së sotme, por e ngjashme me greqishten e armenishten zë një vend të veçantë në këtë familje. Çështja e etnogjenezës, mbetet nga më të vështirat për të, për sa kohë, sipas saj, ka një mungesë të plotë të trashëgimisë ilire, apo trakase, megjithatë ajo me maturi thotë: “Në epokën antike territorin e Shqipërisë e kanë banuar fiset ilire, pasardhësit e të cilëve sipas gjaseve, janë shqiptarët”²

Në këtë fushë të dijes, një nga çështjet që ka tërhequr vëmendjen e albanologëve, e në mes të tyre edhe të A. Desnickajas është periodizimi i zhvillimit historik të gjuhës shqipe. Ky është një problem i rëndësishëm për t’u zgjidhur dhe

¹ A. V. Desnickaja, Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë, 1972, f.10

² A. V. Desnickaja, po aty.f. 58

përbën ende edhe në ditët e sotme një sfidë shkencore për studiuesit. Para Desnickajas me këtë çështje ishin marrë Holger Pedersen³, Eqrem. Çabej⁴,

Selman Riza⁵, e pas saj edhe studiues të tjerë, si: Besim Bokshi⁶ e Shaban Demiraj⁷, të cilët pavarësisht nga njëri-tjetri përdorën kritere të ndryshme për të zgjidhur problemin, prandaj arritën jo në të njëjtat përfundime. A. Desnickaja⁸ dalloi këto periudha të evolucionit historik të shqipes: 1. Periudha protoshqipe, që përfshin një rrugë të gjatë të zhvillimit parahistorik, e cila fillon nga ndarja e saj prej bashkësisë i.e. e deri në fillimet e kontakteve gjuhësore me Romën. 2. Periudha e vjetër e shqipes, e cila përafërsisht përfshin shekullin e parë të epokës sonë, pikërisht epokën e ndikimeve të hershme gjuhësore romake, bizantine dhe sllave. 3. Periudha e mesme që përfshin shek. XI-XV. 4. Periudha e re e shqipes që shtrihet nga shek XV deri në ditët tona (brenda kësaj ajo dallon një fazë të hershme shek. XVI-XVIII). Desnickaja e shoqëroi periudhën e dytë, *shqipja e vjetër* edhe me argument gjuhësore të cilat bëjnë të mundur interpretimin e kujdesshëm shkencor të dukurive gjuhësore që mund të kenë ndodhur në shtjellat e mugëta të historisë së padokumentuar të shqipes, duke futur kështu e para kritere gjuhësore.

Në këtë fushë të dijes, ajo dha ndihmesën e saj edhe në sqarimin e përpjesëtimit të elementit të huaj në leksikon historik të shqipes ndaj atij vendas. Sipas saj⁹ pjesën më të rëndësishme të leksikut të shqipes e përbëjnë fjalët e trashëguara, të cilat shënojnë koncepte elementare dhe që formojnë pjesën dërmuese të çerdheve fjalëformuese. Nga ana tjetër Desnickaja vëren se shqipja po pasurohet me njësi të reja nëpërmjet dy rrugëve: zhvillimit të shtresave të reja që zënë fill në thellësitë e kulturës gjuhësore të popullit shqiptar dhe që hyjnë nëpërmjet dialekteve dhe e dyta nëpërmjet krijimit të fjalëve të reja, të ndërtuara sipas modeleve strukturale që ekzistojnë. Duke kritikuar G. Meyerin për statistikën e dhënë në Fjalorin etimologjik (*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Wien, 1891), në dëm të elementit vendas, Desnickaja parashton edhe arsyet që e çuan gjuhëtarin e madh në rrugë të gabuar, si: numri i kufizuar i materialeve të botuara që ai njihte një shekull më parë, mungesa e ekspeditave linguistike në Shqipëri dhe përdorimi i teksteve të të folmeve periferike. Për sa i përket huazimeve, ajo nuk i

³ H. Pedersen, *Gutturale*, KZ 36, 340

⁴ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1976, f.13.

⁵ S. Riza, *Simbas cilëvet kritere duhet periodizuar historia e gjuhës shqipe*, Emrat në gjuhën shqipe, sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit, Vepra të zgjedhura, Tiranë, 2009, f. 229-231

⁶ B. Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980

⁷ Sh. Demiraj, *Rreth periodizimit të historisë së gjuhës shqipe* në Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë, 1988, f.205

⁸ A. V. Desnickaja, *Rekonstrukcija elementov drevnjealbanskogo jezika i obščebalskanskije lingvističeskie problemy* në Perviy congress balkanskijh issledovanij. M. 1966 dhe në Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë, 1972, f. 44 (shënime në fundfaqe)

⁹ A. V. Desnickaja Gjuha shqipe dhe dialektet e saj. f. 11-12

shih si rrezik për shqipen për sa kohë ato kanë vlerë kuantitative dhe nuk dëmtojnë specifikën kualitative të strukturës së gjuhës sonë. Ajo arrin në përfundimin se për shqipen nuk mund të flitet si për një gjuhë “të përzier”

Po në këtë lëmë të dijës ajo gjurmoi edhe ngulimet shqiptare në Greqi, Bullgari, Ukrainë e Itali, duke vërejtur trajta e hershme të dialektit toskë në to. Ajo theksoi se ngulimet më të hershme janë ato të Greqisë.

Desnickaja ka lënë studime me vlerë edhe në fushën e morfologjisë së shqipes, prej të cilave do të përmendim në këtë artikull vetëm disa. Ajo mbrojtiti idenë se sistemi morfologjik u organizua në mënyrë të plotë në periudhën nga shekujt e fundit p.e.s. deri në fund të mijëvjeçarit të parë të e.s. Në strukturën morfologjike të shqipes ajo dallonte ende mbeturina të fleksionit i.e., i cili për shkak të proceseve të ndryshme fonetike që kanë ndodhur, dallohet vetëm në disa elemente formale të fjalës.¹⁰

Ndër çështjet e shumta që trajtoi në këtë fushë, ishte edhe rruga e formimit të mënyrës habitore në gjuhën shqipe. Në shqyrtimin që i bën kësaj çështjeje Sh. Demiraj¹¹ vëren se shpjegimi më i drejtë për mënyrën e formimit të habitores (në kundërshtim me Joklin) është ai që dha për herë të parë Dozoni, i cili thoshte se habitortja është formuar nga pjesorja e shkurtuar (apokopuar) dhe nga ndihmësja *kam*. Këtë argument mbështetën edhe Meyeri, Pekmezi, Weigandi, Domi, Fiedleri e Çabej. Duke e quajtur habitoren “admirativ”, me intuitën e shkencëtares dhe me argumente u bashkua me studiuesit e lartpërmendur edhe Desnickaja në “Vaprosy Jazykoznanija” (5, 1958, 13) dhe në “Gjuha shqipe dhe dialektet e saj”, (Prishtinë 1972: 16) ku thotë: “Këto trajta janë formuar me të ngjiturit e participit të shkurtuar *punua-*, *hap(ë)-* dhe të foljes ndihmëtare që zgjedhohet nëpër veta”.

Një çështje tjetër që ka trajtuar Desnickaja dhe që po tërheq ende sot vëmendjen e gjuhëtarëve është infinitivi i shqipes. Desnickaja pranon që shqipja ka paskajore¹². “Në gegërishte ajo shprehet me formën speciale *me hap(ë)*, kurse në toskërishte me anën e trajtave të mënyrës lidhore”. Sikurse gjuhëtarët, A. Xhuvani, E. Çabej, M. Domi, I. Ajeti etj. edhe A. Desnickaja pranon se tipi i paskajores *me ba* në zanafillë ka qenë një pjesore, por për sa i përket shtrirjes gjeografike të këtij tipi edhe në toskërishten e lashtë albanologia jonë shprehet me rezervë: “Trajatat e tipit të infinitivit gegë, sipas gjaseve, dikur janë përdorur edhe në toskërishte”. Këtë fakt ajo e mbështet edhe me ndonjë argument “Për këtë mund të supozojmë në bazë të

¹⁰ A. V. Desnickaja *Struktura morfologjike*, në vep. e cit. f. 15

¹¹ Sh. Demiraj, *Habitortja dhe moshja e saj*, në Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 396

¹² Ka pasur edhe studiues që kanë pohuar se shqipes i mungon paskajortja. Shih për më tej Sh. Demiraj, *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe* në Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 421

sintagmës së ngurosur *domethënë*, prej *do me thënë*, e gjithashtu në bazë të sintagmave që kanë kuptim të adverbialit – *duk me punuar, duk me thënë*.¹³

Në fushën e morfologjisë ajo trajtoi tek emri kategorinë e gjinisë, veçanërisht atë asnjënjësore, apo ambigjeninë, kategorinë e numrit e tipat e lakimit. Për sa i përket mbijemrit A. Desnickaja ka ndihmesë në klasifikimin e tipave morfologjikë të kësaj pjese të ligjëratës duke i cilësuar mbijemrat e njëjshëm si “grupin kryesor në gjuhën shqipe”. Duke argumentuar klasifikimin morfologjik të mbijemrave, A. Dhrimo¹⁴ përmend të parën A. Desnickajën për këtë problem, duke theksuar se “bashkohemi me mendimin e A. Desnickajas”. Nga gjuhësia shqiptare, është përkrahur përsëri ideja e saj “që prejardhja e mbijemrave pa artikull, përfaqëson një formim të ri, i cili duket qartë se është i mëvonshëm në sistemin morfologjik të gjuhës shqipe”¹⁵

Desnickaja kontribuoi edhe në fushën e dialektologjisë me një varg artikujsh, por veçanërisht me veprën “Gjuha shqipe dhe dialektet e saj,” botuar fillimisht në rusisht (1968) e më vonë edhe në shqip (1972). Qysh në fillim të punimit thekson rëndësinë e studimeve dialektore për të hedhur dritë edhe mbi fazat e padokumentuara të historisë së shqipes: “Dialektologjia historike për një gjuhë me tradita shkrimi relativisht të vona është një burim i çmueshëm njohurish për t’i njohur etapat e mëparshme të zhvillimit të saj, veçanërisht kur ka mundësi të krahasohet ndarja linguistike e arealeve dialektore me faktet e historisë së popullit, i cili e flet atë gjuhë”. (Parathënie e veprës). Nga ana tjetër autorja nënvizon se studimi i problemeve konkrete të dialektologjisë “...është kusht i domosdoshëm dhe paraprak për përpunimin e historisë së gjuhës letrare shqipe dhe për përcaktimin e zhvillimit të mëtejshëm të saj.” (Po aty) Kjo ide e çmuar e saj bëri që Desnickaja të zbatonte në vepër dy metoda studimi, atë diakronike dhe sinkronike. Ajo përshkruan dallimet në planin fonetik e gramatikor midis dy dialekteve të shqipes, duke shfrytëzuar edhe punimet e studiuesve para saj¹⁶ dhe arrin në përfundimin e rëndësishëm se “...dallimet në mes dy tipeve kryesore dialektore, në përgjithësi, nuk janë aq të mëdha.” (vep e cit, f. 40) Ndryshe nga studiuesit shqiptarë, që në studimet e tyre dialektore përshkruanin thjesht dukuritë gjuhësore, për herë të parë, A. Desnickaja i vendosi këto dukuri brenda një konteksti historik, gjeografik dhe etnolinguistik, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në konfigurimin e hartës linguistike dialektore të shqipes.

Në këtë vepër, por dhe në punimet “*Rreth premisave të formimit të gjuhës letrare shqipe*” (1973) si dhe në “*Roli i koineve gojore në historinë e formimit të*

¹³ A. Desnickaja, *Çështje të përgjithshme të dialektologjisë shqiptare*, në Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë, 1972, f. 39

¹⁴ A. Dhrimo, *Për shqipen dhe shqiptarët*, I, Tiranë 2008, f. 31

¹⁵ A. Dhrimo, vep.cit., f. 32

¹⁶ Ajo përmend, G.von Hahn, H. Pedersen, N. Joklin, E,Çabej, M. Lamberc, E. Durham, N. Gazulin (Galasius) etj.

gjuhës letrare shqipe” (1974), autorja parashtron idetë e saj edhe në lidhje me gjuhën letrare, traktatet normative të së cilës ende nuk ishin hartuar në kohën kur Desnickaja shkruan këtë vepër. Megjithatë, me intuitën e gjuhëtares së formuar, ajo vëren se ka baza tashmë të flitet për formimin e normës së njësuar të gjuhës letrare në variantin e Jugut që është mjaft e përgjithësuar. Por Desnickaja¹⁷ nëvizon se në të ardhmen e zhvillimit të gjuhës letrare duhen pasur parasysh disa faktorë, siç është afria e madhe e të dyja trajtave dialektore me njëra-tjetrën, e cila bën që të evoluojnë drejt afrimit më të madh dhe proceset e përqendrimit gjuhësor, të cilat nuk janë më krahinore, por në to është pjesëmarrës i gjithë populli.

Studimet e A. Desnickajas për gjuhën shqipe vijojnë edhe në një plan më të gjerë, në atë ballkanik. Gjuhën tonë e sheh në lidhje linguistike regjionale me gjuhët e tjera të Ballkanit e sipas saj shkakun për këtë lidhje duhet ta kërkojmë në histori. Sqarimi i kësaj çështjeje e çoi studiuesen në hullinë e Thunmanit, Leakut, Xylanderit, Hahnit, Miklosichit, Meyerit, Pedersenit, Çabejt, Cimochofskit etj, të cilët burimin e shqipes në Ballkanin e lashtë, e shihnin si evolucion të njërit prej dialekteve të ilirishtes¹⁸. Për të mbetet interesant fakti i bashkëpërkimeve të disa trajtave gramatikore midis shqipes, rumanishtes, bullgarishtes, greqishtes (më pak) dhe serbishtes. Ajo vëren se në sqarimin e unitetit gjuhësor ballkanik “...materialet linguistike të shqipes kanë rëndësi të veçantë”.¹⁹ Me shumë interes janë punimet që ka lënë albanologia kushtuar marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera të familjes i.e.v., veçanërisht me gjermanishten, gjuhët baltike e në plan më të ngushtë me sllavishten.²⁰

Është meritë e A. Desnickajas që ndërmori edhe nismën e çeljes pranë Institutit të Gjuhësisë në Shën Petërburg (ish Leningrad) të degës së albanologjisë. Kjo degë e Albanologjisë funksionon deri në ditët tona e prej saj kanë dalë një varg studiuesish të njohur për kontributet e tyre shkencore, si: A. P. Sitov, A.V. Zhurga, L. A. Llapashov, L.V. Sharapova, L.I. Veronina, A. Y. Rusakov etj.

Desnickaja u paraqit me punimet e saj shkencore, në lidhje me gjuhën shqipe, jo vetëm në trojet shqiptare, por edhe në simpoziume, konferenca e kongrese ndërkombëtare duke kontribuar kështu, në njohjen e shqipes dhe problemeve të saj edhe në botë.

¹⁷ A.V.Desnickaja, *Gjuha shqipe*, f. 33

¹⁸ Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 52

¹⁹ A. Desnickaja vep. cit.f.10

²⁰ A. Desnickaja, *Lidhjet gjuhësore të hershmen gjermano-shqiptare në dritën e problemeve të gjuhësisë areale i.e.v.*(1980), *Edhe një herë për çështjen e prejardhjes veriore të shqipes: Marrëdhëniet e vjetra gjuhësore shqiptaro-balte dhe shqiptaro-gjermane (1981)*, *Huazimet sllave në shqipe* (1963) etj

Për gjithë këtë kontribut të vyer, A. V. Desnickaja do të kujtohet e nderohet gjithmonë si një nga albanologët që me punën e vet i kushtoi rëndësi shqipes e shqiptarëve.

Anila ÇEPANI

GJYMTYRËT E FJALISË NË TRADITËN E GRAMATIKAVE TË SHQIPES

Gjymtyra e fjalisë përbën një rënë nga njësitë sintaksore me të cilën është operuar deri më sot në studimet për sintaksën e shqipes, ndonëse kohët e fundit janë shfaqur mendime për të hequr dorë nga teoria e gjymtyrës. Qysh në gramatikat e hershme që kishin si objekt morfologjinë janë dhënë në mënyrë sporadike disa njohuri sintaksore, të cilat marrin formë dhe trajtohen të strukturuar në gramatikat e mirëfillta për sintaksën. Në këtë kumtesë do të ndalemi te disa sintaksa¹ të shkruara nga autorë shqiptarë që në krye të herës e deri më sot për të parë se si shfaqet gjymtyra e fjalisë². Sa i përket termit për këtë koncept, vihet re se në sintaksat e para përdoren termat *elementet e fjalisë* ose *pjesët e fjalisë* herë-herë të alternuar me njëri-tjetrin edhe brenda së njëjtës gramatikë deri në shfaqjen e termit *gjymtyrë*, i cili vijon të përdoret nga të gjithë. Pothuajse në të gjitha këto sintaksa kryefjala dhe

¹ Xhuvani, A., *Njohurit e para të sintaksës shqipe*, Shtypshkronja “Teknike”, Tiranë, 1933; Sheperi, I. D., *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927; Cipo, K., *Sintaksa*. Instituti i Shkencave. Tiranë, 1952, 124 f.; Rrota, Justin Át: *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*. Botimi I. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Biblioteka françeskane “At Gjergj Fishta” Kolana e shkrimtarëve françeskanë. Botime Françeskane. Shkodër, 2006, 612 p.; Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa II. Sintaksa. Tekst për shkollat tetëvjeçare e shkollat e mesme, Tiranë. 1954; Prifti, S., *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Prishtinë, 1971; *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 2002, 484 f.; Dhima, Th.; *Gjuha shqipe Sintaksa (Tekst për studentët e fakulteteve të gjuhëve të huaja dhe të shkencave të edukimit)*. SHBLU, Tiranë, 2005, 211 p.; Çeliku, M.; Karapinjalli, M.; Stringa, R., *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Ilar, 2007; Memushaj, R., *Bukuria e gjuhës - Gjuha shqipe 3* (për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2009; Topalli, T., *Gramatika e gjuhës shqipe – sintaksa e fjalisë (sprovë monografike)*, Shkodër, 2011, 746 f.

² Duhet të vëmë në dukje se në gramatikën e M. Çelikut si bashkautor bëhen përpjekje për t'i parë marrëdhëniet e ndryshme në fjali, bie fjala ato kallëzore etj. jo të kufizuara vetëm te gjymtyra, por edhe më tej, te fjalitë dhe te periudha, pra, marrëdhëniet e vendosura brenda një gjymtyre trajtohen paralelisht me marrëdhëniet e ngjashme të vendosura midis pjesëve të një periudhe për të cilat përdoret termi i ri *sifjali*. E mira e këtij lloj trajtimi është se marrëdhëniet e ndryshme sintaksore shihen në sistem, por nuk krijohet mundësia për të dalluar llojet e ndryshme të një gjymtyre, p.sh. llojet e kallëzuesit (foljor apo emëror; i thjeshtë apo i përbërë etj.), pavarësisht se shembujt e dhënë mbulojnë çdo mundësi të shprehjes së një gjymtyre të caktuar.

kallëzuesi janë trajtuar si dy gjymtyrë kryesore të fjalisë apo pjesët kryesore e herë-herë paralelisht nën termin *kryegjymtyrët* e fjalisë. Vetëm te sintaksa e K. Cipos vihet re se ka një mendim të ndryshëm nga ai i përgjithshmi lidhur me gjymtyrët kryesore. Sipas tij, në grupin e elementeve kryesore është edhe kundrina e drejtë: “Më sipër pamë se elementet kryesore të një fjalie ishin *kryefjala* (subjekti), *predikati* dhe *kundrina e drejtë* (objekti).”³ Me këtë pohim ai bën një veçim të kundrinës së drejtë nga ajo e zhdrejtë, të cilën e radhit në grupin e elementeve të dorës së dytë, siç i quan ai gjymtyrët e dyta të fjalisë. Studiuesi R. Memushaj në tekstin e tij shkollor për sintaksën vë në dukje se “... gramatika e sotme u bën gjymtyrëve të fjalisë një ndarje tjetër. Ndër dy gjymtyrët kryesore të fjalisë, ajo vlerëson si më kryesore kallëzuesin, kurse gjymtyrët e tjera që lidhen me të ndahen në dy grupe: *argumente*, të cilat janë gjymtyrë që lidhen ngushtë me foljen e fjalisë, dhe *plotësa*, që nuk lidhen ngushtë me foljen.”⁴ Por më tej i përshkruan gjymtyrët e fjalisë sipas gramatikës tradicionale, duke i përfshirë si kryefjalën, të cilën e quan argument të jashtëm të foljes, dhe kallëzuesin në gjymtyrët kryesore të fjalisë kallëzuesore. Th. Dhima, ndikuar nga gramatika gjenerative, e nis përshkrimin e gjymtyrëve të fjalisë duke bërë ndarjen e fjalisë së thjeshtë në dy grupe apo sintagma kryesore: *emërore*, në të cilën qendra organizuese e saj është kryefjala, dhe *foljore* e cila ka si qendër organizuese kallëzuesin⁵ e më tej vazhdon me gjymtyrët e tjera.

Përshkrimi i gjymtyrëve të fjalisë në të gjitha këto sintaksa nis me kryefjalën për të cilën disa studiues, si J. Rrota, K. Cipo dhe S. Prifti, përdorin paralelisht edhe termin *subjekt*. Trajtimi i kësaj gjymtyre është pak a shumë i njëjtë duke nisur me një përkufizim dhe më tej duke konkretizuar me shembull çdo rast kur kryefjala shprehet me pjesë të ndryshme të ligjëratës ose me grupe fjalësh.

Për kallëzuesin vihet re se në sintaksa të ndryshme nuk ka qëndrime të njëjta lidhur me ndarjen e mëtejshme të tij. Në sintaksat e vëzhguara prej nesh ka tre lloj klasifikimesh: 1) Në sintaksën e Xhuvanit, Sheperit, Cipos, Rrotës, Domit dhe Priftit kallëzuesi ndahet në foljor dhe në atë emëror; 2) Th. Dhima dhe R. Memushaj njohin vetëm kallëzuesin foljor dhe atë me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, por të dy dallojnë në mënyrën se si i trajtojnë ato elemente që nga shumica pranohen si kallëzues emëror (Më poshtë do të ndalemi më hollësisht në problematikat që shfaq pranimi ose jo i kallëzuesit emëror dhe argumentet që sjell secili studiues); 3) Në sintaksën e Akademisë, Çelikut dhe Topallit dallohen tri klasa kallëzuesish: foljor, emëror dhe me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

³ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952, f. 64.

⁴ R. Memushaj, *Bukuria e gjuhës - Gjuha shqipe 3* (për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2009.

⁵ Th. Dhima, *Gjuha shqipe Sintaksa (Tekst për studentët e fakulteteve të gjuhëve të huaja dhe të shkencave të edukimit)*. SHBLU, Tiranë, 2005, f. 69.

Qëndrim i ndryshëm mbahet edhe për funksionin sintaksor të formave të pashtjelluara të foljes: S. Prifti është i mendimit se format e pashtjelluara janë një lloj kallëzuesi të cilin ai e quan *kallëzues të papërcaktuar*, përkundër kallëzuesve të përcaktuar që shprehen me forma të shtjelluara të foljeve.⁶ Cipoja, ndonëse në paragrafin për kallëzuesin nuk përmend kallëzues me forma të pashtjelluara të foljes, më tej, në kreun për fjalitë e nënrenditura pranon se fjali të ndryshme, si ajo shkakore, kushtore, mënyrore etj. kanë edhe trajta të pashtjella. Sipas Sintaksës së Akademisë format e pashtjelluara luajnë rolin e kallëzuesit vetëm kur kanë një kryefjalë të ndryshme nga kryefjala e foljes së shtjelluar. Këtë qëndrim e mbështesin dhe sintaksologët Topalli e Dhima. Studiuesi M. Çeliku mendon se format e pashtjelluara funksionojnë vetëm si element plotësues në fjali dhe asnjëherë si kallëzues, pasi ato nuk mund të kenë kryefjalë të veçantë.

Një çështje të diskutueshme në gjuhësinë tonë përbëjnë ato gjymtyrë të fjalisë që në *Sintaksën e Akademisë* trajtohen si kallëzues emërorë dhe përcaktorë kallëzuesorë të kryefjalës apo të kundrinës së drejtë. Ajo që i lidh këto gjymtyrë me njëra-tjetrën është pjesa e dytë emërore, e cila është e njëjtë në të dyja rastet. Pjesa e parë e kallëzuesit emëror është folja *jam* që shërben si këpujë për të lidhur kryefjalën me pjesën emërore të kallëzuesit, kurse te përcaktorët kallëzuesorë janë disa folje, si *bëj, dukem, mbaj, mbetem, caktoj, emëroj* etj., të cilat nuk mund të qëndrojnë më vete, pasi nuk kanë kuptim të plotë. Për këtë problem në sintaksat e vëzhguara paraqiten disa qëndrime të ndryshme:

Në Sintaksën e Akademisë dhe në sintaksat e Xhuvanit, Sheperit, Cipos, Rrotës, Domit, Priftit dhe Topallit, siç e përmendëm më lart, pranohet kategoria e kallëzuesit emëror. Ajo që i dallon ata është çështja e këpujës: në Sintaksën e Akademisë, të Xhuvanit dhe të Domit pranohet si këpujë vetëm folja *jam*, kurse Sheperi, Cipo, Rrota, Prifti dhe Topalli e zgjerojnë kategorinë e këpujës duke pranuar si të tilla edhe disa folje të tjera që i afrohen foljes *jam*. Te K. Cipoja vihet re një luhatje vetëm në përcaktimin e foljeve që ndërtojnë pjesën e parë të kallëzuesit emëror. Në fillim të sintaksës ai përmend vetëm foljen *jam*. Më tej, kur trajton predikatin si një pjesë kryesore të fjalisë, ai e zgjeron këtë grup foljesh: “*Predikati emëror është një emër a një mbiemër që lidhet me kryefjalën me anë të foljes substantive: me qenë ose dhe me aso foljesh, që nuk janë në gjëndje të përcaktojnë, vetëm për vetëm, një veprim, siç janë për shëmbëll foljet: duket, mbet.*”⁷ Rrota nuk përdor ndonjë emërtim për të dhe vetëm nga përshkrimi që i bëhet grupit të dytë të kallëzuesve kuptohet që bëhet fjalë për kallëzuesin emëror. Ashtu si dhe Cipoja, përveç foljes *jam*, ai përmend edhe disa folje të tjera: *mbes, thirrem, quhem, emnohem, dukem, mbahem, zgjidhem, gjykohe, gjindem, vëhem*

⁶ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 69.

⁷ Po aty, f. 62.

etj. Pak a shumë po këto folje dalin dhe te Sheperi në cilësinë e këpujës përveç foljes *jam*.⁸ Ky i fundit e quan *atribut*⁹ apo dhe *kallëzues* emrin ose mbiemrin që i lidhet kryefjalës me anën e këpujës, pra atë që në Sintaksën e Akademisë emërtohet pjesë emërore e kallëzuesit emëror.

M. Çeliku është i mendimit për zgjerimin e mëtejshëm të kategorisë së këpujës, duke përfshirë në kallëzuesit emërorë edhe të ashtuquajturit përcaktorë kallëzuesorë “Interpretimi i këtyre foljeve (*dukem, emërohem, bëj* etj. - shën. ynë), por edhe i shumë foljeve të tjera, si këpujë, të afërta por jo aq të çkuptimësuara sa këpuja *jam*, zgjeron kallëzuesin emëror dhe mënjanon përcaktorin kallëzuesor a kallëzuesorin si gjymtyrë e veçantë e fjalisë”¹⁰.

Një mendim krejt të kundërt me të ka Th. Dhima i cili i fut të dyja këto struktura nën gjymtyrën e quajtur *kallëzuesor*, që sipas tij: “... shfaqet me dy variante: kallëzuesori pranë foljes *jam* dhe kallëzuesori pranë disa foljeve të tjera”¹¹. Ai e argumenton këtë qëndrim me faktin nisur nga materiali konkret se midis ndërtimeve me foljen *jam + një emër a mbiemër (kallëzues emëror)* dhe ndërtimeve me *folje të tjera + një emër a mbiemër (përcaktor kallëzuesor)* nuk ka dallime as strukturore, as kuptimore. Ndryshe nga Th. Dhima, R. Memushaj i përfshin të dyja këto elemente të kallëzuesi i përbërë: “Kjo do të thotë se në të gjitha këto raste kemi kallëzues të përbërë dhe, si rrjedhim, termat *kallëzues emëror* dhe *përcaktor kallëzuesor* janë të panevojshëm.”¹²

Qëndrime të ndryshme mbahen nga këta autorë për gjymtyrët e dyta. Sheperi përfshin në të ashtuquajturat gjymtyrë të dyta të cilat i quan *plotës*¹³ të gjitha fjalët e tjera që plotësojnë kryefjalën dhe kallëzuesin. Në ndarjen që u bën plotësve në emërorë, ndajfoljorë dhe plotës me fjalë, nga shembujt e dhënë (Bujku punon *arën*) për plotësit emërorë duket që i fut kundrinat në këtë kategori, por më tej ai e trajton kundrinën jashtë kategorisë së plotësve.

Në të njëjtën mënyrë vepron Cipoja duke i emërtuar *plotës* të gjitha elementet e dorës së dytë që hyjnë në punë për të plotësuar kuptimin. Sipas tij “Një plotës është një pjesë e ligjëratës, si për shëmbëll një emër, i cili mund të gjëndet vetëm ose shoqëruar me parafjalë, një mbiemër i substantivuar, një përemër, një ndajfolje ose një pashirrmë që shërben për të zgjeruar, përcaktuar një fjalë.”¹⁴ Vihet re një luhatie

⁸ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 149.

⁹ Po aty, f. 148.

¹⁰ M. Çeliku, *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)*, Tiranë, 2007, f. 89.

¹¹ Th. Dhima, *Gjuha shqipe Sintaksa (Tekst për studentët e fakulteteve të gjuhëve të huaja dhe të shkencave të edukimit)*. SHBLU, Tiranë, 2005., f. 125.

¹² R. Memushaj, *Bukuria e gjuhës III*, tekst i gjuhës shqipe për shkollat e mesme të përgjithshme të Malit të Zi, Podgoricë, 2009.

¹³ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 145.

¹⁴ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952, f. 64.

në mënyrën e grupimit të këtyre elementeve prej K. Cipos. Në faqet e para të sintaksës, gjatë përshkrimit të fjalisë së zgjeruar ai i ndan në tri grupe, ku përveç plotësve *atributorë* dhe *ndajfoljorë*, fut edhe plotësit *objektorë*, me të cilët ka parasysh kundrinat e drejta të foljeve transitive. Këto të fundit, siç e vumë në dukje më sipër, ai i përfshin te elementet kryesore të fjalisë në një radhë me subjektin dhe predikatin në paragrafin kur flet për elementet e dorës së dytë. Në këtë pjesë të sintaksës vihet re se grupet e plotësve rrudhen dhe mbeten dy, vetëm ata atributorë dhe ndajfoljorë.

Po ashtu edhe Rrota i përfshin të gjitha gjymtyrët e dyta nën një emërtim të vetëm, *plotësorë* dhe i ndan më tej në tri grupe: *cilSORI* (atributi)¹⁵, *kundrina* (objekti), *ndajfoljori* (adverbjali).

S. Prifti përdor të dy termat, *plotësor* e *plotës*, për të gjitha gjymtyrët e dyta të fjalisë dhe i ndan në plotësorë emërorë dhe në plotësorë ndajfoljorë. Në grupin e plotësorëve emërorë përfshin edhe kundrinën, duke argumentuar se "... Nga ana tjetër, këta plotësorë shprehen rregullisht me kategoritë nominale ose me pjesë të substantivuara të ligjëratës, prandaj, duke u nisur nga kjo anë thjesht gramatikore, i quajmë edhe *emërorë*. Edhe kur ndonjë plotësor i tillë shprehet me ndajfolje apo në formë të plotësorit ndajfoljor, funksioni i tij është jo për të treguar rrethana të veprimit, por për të përcaktuar sende a tipare sendesh."¹⁶

Edhe Domi e përdor termin *plotës*, por tashmë nën këtë emërtim përfshin të gjitha elementet plotësuese të fjalisë, përjashtuar *kundrinat* dhe *fjalët përcaktuese* (cilësori dhe ndajshtimi) të cilët dalin si grupime më vete¹⁷. Sipas tij, kur plotësojnë emra, plotësit janë *emërorë* ose *plotës dallimi* dhe, kur plotësojnë folje, quhen *plotës të rrethanës* ose *plotës ndajfoljorë*.

Në gramatikat e mëvonshme nuk ka ndonjë emërtim përmblendhës për të gjitha gjymtyrët e dyta. Në to përfshihen kundrinat apo kundrinorët, përcaktorët (si një lloj përcaktori trajtohet ndajshtimi dhe përcaktori kallëzuesor) dhe rrethanorët. Në këto gramatika përshkruhen edhe disa gjymtyrë të tjera që zënë një vend të veçantë në mes gjymtyrëve të dyta, duke qëndruar në periferi të tyre për natyrën e raporteve që vendosin me gjymtyrët e tjera të fjalisë.

Më sipër, kur folëm për kallëzuesin dhe llojet e tij, pohuam se disa autorë kanë mendime të ndryshme lidhur me kallëzuesin emëror dhe këto qëndrime të ndryshme pasqyrohen edhe në pranimin ose jo të përcaktorit kallëzuesor. Te Xhuvani kjo gjymtyrë nuk përmendet fare, por nga shembujt e dhënë për cilësorin kuptohet se ai nuk e dallon atë nga cilësori i zakonshëm që përmendet dhe në

¹⁵ Nga përshkrimi që i bën kësaj gjymtyre dhe nga shembujt e dhënë duket qartë që bëhet fjalë për përcaktorin e sintaksës së Akademisë.

¹⁶ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 79.

¹⁷ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa II. Sintaksa. Tekst për shkollat tetëvjeçare e shkollat e mesme, Tiranë. 1954, f. 45.

sintaksat e tjera. M. Çeliku nuk e sheh përcaktorin kallëzuesor si gjymtyrë fjalie, por argumenton se përse e përfshin te kallëzuesit emërorë. R. Memushaj nuk pranon përveç kallëzuesit emëror, edhe përcaktorin kallëzuesor, të cilët i sheh si kallëzues të përbërë. Ndërsa i një mendimi krejt ndryshe shfaqet Th. Dhima, i cili jo vetëm që e pranon përcaktorin kallëzuesor apo kallëzuesorin, siç e quan ai, por e zgjeron edhe më tej, duke përfshirë në të edhe strukturat me këpujën *jam + pjesën emërore*. Në sintaksat që e veçojnë këtë gjymtyrë, përskrimi i saj herë bëhet pranë përcaktorit apo cilësorit e herë brenda grupit të plotësve a plotësorëve dhe del me emërtime të veçanta në autorë të ndryshëm, si: *kallëzues i kundrinës* ose *i kryefjalës* te Sheperi; *cilësor kallëzojues* (atributi predikativ) te Rrota; paralelisht me termat *plotës predikativ* i *objektit* ose *i subjektit* K. Cipoja përdor termat *kallëxore predikative*, përkatesisht *emërore predikative*; *plotës kallëzuesor* (predikativ) i kryefjalës ose *emërore kallëzuesore a predikative* dhe *plotës kallëzuesor (predikativ) i kundrinës* te Domi; *plotësor kallëzuesor (predikativ) i kryefjalës dhe i kundrinës* te Prifti¹⁸; *kallëzuesor* te Th. Dhima dhe *përcaktor kallëzuesor* te sintaksa e Akademisë dhe T. Topalli. Qëndrimet e ndryshme dhe termat e shumtë për këtë gjymtyrë flasin për një gjymtyrë të diskutueshme e cila ende shihet si e tillë edhe në sintaksat e sotme.

U ndalëm fillimisht e më gjatë te përcaktori kallëzuesor për vetë problematikën që shfaq kjo gjymtyrë, problematikë e cila është e lidhur ngushtë me gjymtyrën kryesore të kallëzuesit.

Për të mos kaluar caqet e një kumtese, për gjymtyrët e tjera të dyta nuk do të flasim hollësisht për karakteristikat, por do të shohim se ç'vend ka zënë secila prej tyre në grupin e gjymtyrëve të dyta sipas secilit autor.

Përfshijuar sintaksat e kohëve të fundit ku pak a shumë është i njëjti grupim i gjymtyrëve të dyta (*kundrinë* ose *kundrinor*, *përcaktor*, *përcaktor kallëzuesor* ose *kallëzuesor* dhe *rrethanor*) dhe i njëjti pozicionim midis njëra-tjetrës, në sintaksat më të hershme, që në përgjithësi operojnë me termin *plotës* apo *plotësor* për gjymtyrët e dyta vërehen këto gjymtyrë: *kundrinë (kundrinor)*, *cilësor*, *ndajshim (apozicion)*, *lloje të plotësve emërorë e ndajfoljorë*. Lidhur me vendin që zënë *cilësori*, *ndajshimi* dhe *kundrinori* në secilën prej këtyre sintaksave, mund të bëhet ky klasifikim:

Për nga vendi që zënë *cilësori* dhe *ndajshimi* midis gjymtyrëve kemi:

1. *Cilësori* dhe *ndajshimi* jashtë plotësve (plotësorëve) në përgjithësi dhe atyre emërorë në veçanti (Xhuvani i trajton këto gjymtyrë jashtë plotësorëve. Këta të fundit nuk i ndan në plotësor emëror apo foljor, por dallon pesë syresh, ku katër të parët duken nga shembujt që janë ndajfoljorë, dhe i fundit, i *çfarësisë dhe plotësorë*

¹⁸ Ky autor veçon edhe plotësorin kallëzuesor (predikativ) për gjymtyrë të tjera të dyta. *Vep. e cit.*, f. 89.

të tjerë, është përcaktori i shprehur me emër; Domi i trajton jashtë plotësve këto gjymtyrë dhe përdor për to termin *fjalë përcaktuese*).

2. *Cilësori* dhe *ndajshtimi* si një lloj plotësi emëror. (Sheperi i trajton këto gjymtyrë si një nga grupet e plotësve emërorë, plotës që marrin rasën e emrit që përcaktojnë, duke i dalluar nga plotësit e tjerë emërorë të cilët kanë rasë të caktuar; Cipoja i përshkruan këto gjymtyrë në grupin e plotësve atributorë; Prifti i shtjellon para llojeve të tjerë të plotësve emërorë por argumenton se edhe këta janë një lloj plotësi emëror: “Cilësori komunikon anë të ndryshme të sendeve dhe të fenomeneve, prandaj ai radhitet ndër plotësorët *emërorë*.”¹⁹ “Ndajshtimi, me fjalë të tjera, është një *plotësor emëror*, me që tregon sende apo tipare sendesh.”²⁰)

Për nga vendi që zë kundrina midis gjymtyrëve të tjera të dyta kemi:

1. *Kundrina* apo *kundrinori* si një lloj plotësi emëror (Prifti siç e kemi përmendur më sipër, e konsideron *kundrinën* si plotësor emëror “sepse, në raport me foljen kryesisht, ajo ose është një rezultat i vetë veprimtimit të foljes (p.sh., shkrova një *letër*, hapëm një *rrugë*, etj.”²¹ dhe është i vetmi nga sintaksologët e tjerë që e vendos kundrinën në këtë pozicion; Cipoja ndonëse kundrinën e drejtë, siç e kemi përmendur, e fut në grupin e elementeve kryesore, *objektin e çdrejtë* ose *kundrinën e çdrejtë*, e shtjellon në një paragraf të shkurtër brenda grupit të plotësve).

2. *Kundrina* jashtë plotësit emëror. (Si një gjymtyrë më vete jashtë kategorisë së plotësve trajtohet kundrina te sintaksa e Xhuvanit, Sheperit dhe Domit).

Jashtë këtij grupimi mbetet Rrota, i cili në sintaksën e tij dallon tri gjymtyrë të dyta: *cilsorin* (atributin - i cili i përgjigjet pak a shumë përcaktorit të Sintaksës së Akademisë), *kundrinën* (objektin) dhe *ndajfoljorin* (adverbialin).

Sa u përket *plotësve ndajfoljorë*, *rrethanorë* apo *adverbiali* siç i quan Rrota, vihet re se ka një larushi të llojeve të tij nga një autor te një tjetër.

Nga vështrimi që u hodhëm disa prej sintaksave më të rëndësishme të shkruara për gjuhën shqipe deri sot, lidhur me mënyrën se si janë trajtuar gjymtyrët e fjalisë, duke cekur vetëm llojet e gjymtyrëve që dilnin në secilën prej tyre dhe vendin që zënë në kuadrin e së tërës, arrijmë në përfundimin se ende ka çështje të diskutueshme në gjymtyrimin e fjalisë, të cilat mund të bëhen objekt i studimeve të mëtejshme të posaçme për të ndihmuar në shohitjen e tyre.

Bibliografia

1. Cipo, K. (1952), *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, f. 124.
2. Çeliku, M. – Karapinjalli, M.– Stringa, R. (2007), *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Ilar.

¹⁹ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 90.

²⁰ Po aty, f. 98.

²¹ Po aty, f. 104.

3. Domi, M. (1954), *Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa II. Sintaksa*, Tekst për shkollat tetëvjeçare e shkollat e mesme, Tiranë.
4. Dhima, Th. (2005), *Gjuha shqipe Sintaksa (Tekst për studentët e fakulteteve të gjuhëve të huaja dhe të shkencave të edukimit)*, SHBLU, Tiranë, 211 p.
5. *Gramatika e gjuhës shqipe II* (2002), Tiranë, f. 484.
6. Memushaj, R. (2009), *Bukuria e gjuhës - Gjuha shqipe 3* (për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë.
7. Prifti, S. (1971), *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Prishtinë. ???
8. Rrota, Justin Át (2005), *Sintaksi i shqipes*. Botimi III. Biblioteka françeskane “At Gjergj Fishta” Kolana e shkrimtarëve françeskanë. Botime Françeskane. Shkodër, 141 p.
9. Sheperi, I. D. (1927), *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë.
10. Topalli, T. (2011), *Gramatika e gjuhës shqipe – sintaksa e fjalisë (sprovë monografike)*, Shkodër, f. 746.
11. Xhuvani, A. (1933), *Njohnit e para të sintaksës shqipe*, Shtypshkronja “Teknike”, Tiranë.

Bahri KOSKOVIKU

STRUKTURA SINTAKSORE E FJALIVE LIDHORE

Në këtë punim shkencor, struktura sintaksore e fjalive lidhor synohet të përshkruhet përmes një relacioni kombinatorik, duke pasur si kriter fillestar analizën strukturale, e kombinuar me sintaksën funksionale, e cila nga pikëpamja teorike objektin e sheh në relacionin formë- përmbajtje, duke synuar që analiza të jetë sa më e plotë dhe tërësore. Kjo duhet të shihet si një rivlerësim i pozicionit metodologjik, kur merren parasysh studimet e deritanishme sintaksore në këtë fushë të shqipes.

Kjo do të thotë që ky rivlerësim i pozicionit teorik, nëse mund të quhet kështu, synon ta vërë si pikëvështrim fillestar analizën strukturore si një vrojtim empirik i problemit dhe aspektin semantiko-funksional si një thellim i mëtejme i studimit të frazës së përbërë me gjithë kompleksitetin e saj.

Kështu, fjalia: *shumë shpejt u kuptua se kjo punë nuk mbetej me kaq*, sipas sintaksës funksionale shihet si kryefjalore gjë që është e saktë, duke e parë fjalinë e nënrenditur si një plotës funksional të një foljeje në fjalinë kryesore. Praktikisht, analogjia me një gjymtyrë të fjalisë së thjeshtë ka bazë funksionale dhe mbështetet në veçoritë gramatikore të foljes në fjalinë kryesore, e cila determinon funksionin e fjalisë-gjymtyrë dhe me formën e saj morfologjike si pësore dhe jokalimtare, bën të pamundur prezencën e gjymtyrës kryefjalë, funksionin e së cilës e kryen fjalia e nënrenditur¹. Pak a shumë ky është thelbi i analogjisë për të cilën flitet edhe në gramatikën e Akademisë.

Te fjalitë lidhore të mirëfillta çështja është më e thjeshtë; struktura e fjalisë kryesore e përcakton qartë funksionin e fjalisë së nënrenditur, si p.sh:

*Beni takoi një mik që s'e kishte parë për shumë vjet.
Ai është një njeri që nuk e honeps askënd.*

Kur lidhja është e domosdoshme, fjalitë e nënrenditura kryejnë funksionin e një modifikuesi ndaj paraprijësit në fjalinë kryesore që shërben si kokë e saj². Paraprijësi përfaqësohet në fjalinë e nënrenditur nga lidhori *që*, i cili, në mënyrë eksplicite, lidhet me fjalinë e nënrenditur, funksioni i të cilit, duke qenë pjesë e

¹ Grup autorësh "Gramatika e gjuhës shqipe 2", ASHSH, Tiranë, f. 492

² Giorgio Graffi, "Sintaksa", SH.B."Dituria"

fjalisë së nënrenditur, përcaktohet nga baza e saj. Strukturimi i fjalisë së përbërë është i tillë që përcakton rolin e elementeve të strukturës: paraprijësi është gjymtyra që kërkon të përcaktohet, ndërsa fjalia e varur përcaktori i saj, e cila, në raport me paraprijësin, semantikisht mund të jetë e domosdoshme si në shembujt që sapo morëm apo si një lidhje komplementare e saj, si në fjalinë: *Dreni takoi drejtuesin e fabrikës, i cili sapo erdhi me makinë.*

Te fjalitë lidhore të tipit joanaforik, thënie me vlerë të përgjithshme, funksioni i fjalisë së nënrenditur kushtëzohet nga folja e fjalisë kryesore dhe mjetet e lidhjes, si:

Kush punon, fiton. (Shembulli është marrë nga gramatika e Akademisë).

Një analizë e tillë është e njëtrajtshme dhe i tërë koncepti i analizës sintaksore është i tillë. Kjo njëanshmëri sintaksore i emërton këto gramatika si *kuptimore*, meqë zbulojnë lidhjet kuptimore midis dy pjesëve të një fjalie të përbërë, duke vënë në pah funksionin e fjalisë nënrenditur ndaj fjalës referuese dhe përcakton llojin e kësaj lidhjeje mbi këtë bazë.

Kurse subordinatori i këtyre lidhjeve sintaksore apo edhe elementet tjera që janë të rëndësishme për organizimin strukturor të frazës, duke mos i parë ato si specifike kryesore, nuk vihen në dukje fare. Përkundrazi një analizë që fillon me realien dhe më pas futet në thelbin e saj, është më e plotë dhe tërësore. Kështu nëse e vëmë në zbatim relacionin kombinatorik: struktura dhe funksioni apo struktura së pari pastaj funksioni në fjalinë që përdorëm më sipër: *shumë shpejt u kuptua se kjo punë nuk mbetet me kaq*, fjalia në plan të parë është lidhëzore, kurse në plan të dytë fthilluese-kryefjalore. Mendojmë se ky është koncepti më i drejtë mbi të cilën duhet të bazohet analiza dhe ndarja e fjalisë së përbërë me nënrenditje në përgjithësi e jo vetëm të fjalive lidhore, sepse analiza është gjithëpërfshirëse, më tërësor në kompleksitetin e saj: vihet në dukje së pari tipi strukturor i frazës, pastaj funksioni i fjalisë nënrenditur në raport me një element bazë apo me gjithë fjalinë kryesore prej së cilës varet gramatikisht.

Por, sikundër dihet, në gramatikat shqipe, nëse flasim për bazën teorike, fjalitë lidhore nuk konceptohen në pajtim me natyrën e tyre strukturore, por semantiko-funksionale. Sipas këtij koncepti, mungesën e domosdoshme të një gjymtyre në fjalinë kryesore, mbi bazën e një paralelizmi funksional, e plotëson fjalia e nënrenditur.

Në fakt, si realizohet ky paralelizëm funksional në gramatikat shqipe? Sa i përket fjalive lidhëzore-fthilluese janë dy arsye gramatikore që kanë të bëjnë me bazën e fjalisë kryesore, me foljen që determinon rolin dhe funksionin e fjalisë së nënrenditur. Të tilla janë: kuptimi vetor ose pavetor, diateza, kuptimi kalimtar ose jokalimtar i foljes së fjalisë kryesore dhe mungesa e konkretësisë së saj si

përmbajtje, që shtron nevojën për t'u konkretizuar nga një fjali e nënrenditur. p.sh: *Thuhet se Besa nuk kishte qenë e vetmë atë ditë*, veta e tretë njëjës, diateza pësore dhe karakteri jokalimtar i foljes, nga aspekti strukturor e pamundësojnë prezencën e një kryefjale në fjalinë kryesore dhe, përveç kësaj, mungesa e konkretësisë së saj si përmbajtje (si rezultat i kësaj mungese në fjalinë kryesore), kërkojnë që fjalia e nënrenditur ta konkretizojë semantikisht foljen, e cila e determinon funksionin e saj si kryefjalë. Apo në një fjali të përbërë më nënrenditje, fjalia kryesore me strukturë: Ekr + Fk si: *Të gjithë mendonin se ai nuk do të kthehej më*, kuptimi vetor e kalimtar i foljes në fjalinë kryesore kërkon një kundrinë të drejtë që mungon në fjalinë kryesore, rolin e së cilës funksionalisht e kryen fjalia-gjymtyrë “*se ai nuk do të kthehej më*”.

Konceptimi logjiko-semantik në funksion të një taksinomie për fjalinë e përbërë heterogjenizon strukturën e fjalive lidhore në përgjithësi dhe ajo del mjaft e shpërndarë; fjalia nuk shihet si strukturë që ka një përmbajtje të caktuar, por si një përmbajtje që ka një strukturë të caktuar. Pra faktet gjuhësore nuk mbështeten në një qasje empirike, por në një qasje logjike e semantike. Kjo ka shkaktuar shumë kufizime dhe pasaktësi edhe në mënyrën e interpretimit të fakteve edhe në rrafshin semantiko-funksional. P.sh. fjalitë e nënrenditura që përcaktojnë një përemër dëftor ose të pacaktuar, si: *Ai që rri atje, nuk është i lagjes sonë. Kushdo që të fitonte do të ngulte këmbë*, shihen në gramatikat shqipe si një kapërcyell midis fjalive kryefjalore, kundrinore e përcaktore.

Duke e parë fjalinë vetëm në rrafshin përmbajtësor, ndërsa elementet strukturore që e veçojnë atë si strukturë në plan të dytë apo të tretë, roli i të cilëve është dytësor dhe i brendshëm, shërben vetëm për nënndarje të brendshme, kurse parësor është funksioni, i cili për nga natyra është heterogjen dhe, duke e vënë atë në plan të parë, nuk mund të bëhet një ndarje homogjene dhe kjo bën të mundur që ndërtohet një taksinomi, e cila ka për bazë vetëm heterogjenitetin funksional të fjalive.

Duke e parë përmbajtjen si qëllimin dhe thelbin e analizës sintaksore dhe duke mos marrë parasysh të gjitha ato elemente që vënë në dukje veçantitë strukturore e një lloji të caktuar të fjalive domosdo interpretimi shpesh herë del me shumë ngjyrimë e mbase edhe i gabuar dhe mbi të gjitha jo i plotë.

Një interpretim të tillë kemi, edhe tek fjalitë e varura që saktësojnë kuptimin e një ndajfoljeje vendi a kohe në fjalinë kryesore, të njohura në gramatikat shqipe si fjali rrethore korrelative, p.sh: *Ata rrinin aty ku Qemali kishte fshehur thesarin. Ajo erdhi vetëm atëherë kur Ramizi qe kthyer në shtëpi*. Fjalia kryesore nuk lidhet me foljen, por me një ndajfolje, që në kontekstin e dhënë del si kokë e fjalisë së nënrenditur, kuptimin e së cilës e përcakton fjalia e nënrenditur. Fjalitë e tilla Totoni

i quan fraza me fjalë mbështetëse ndajfolje³ Duke pare se ana semantike e funksionale e frazës gjen shprehje në strukturën e saj atëherë shtrohet pyetja, meqë lidhëzat sintaksore **se** e **që** përdoren në fjalitë me strukturë të njëjtë, i referohen një foljeje të caktuar në fjalinë kryesore të karakterit kalimtar ose jokalimtar duke e fthillëzuar semantikisht përmbajtjen e tyre pse duhet të jenë të kategorizuara në grupe strukturalisht të ndryshme, p.sh fjalitë:

Ishte e qartë se atyre s'u kishte rënë në sy një gjë e tillë.

Skënderbeu dëgjoi nga goja e sulltanit vetë që i ati kishte vdekur.

Barinjte i treguan se kishin parë një njëri se kishin parë një njëri aty afër.

Po menjëherë m'u kujtua se të djeshmen, përmbi fshat, ishte bërë luftë.

Nga ana strukturore, fjalitë e tilla janë të njëjta dhe mjaft homogjene, ndonëse nga ana semantiko-funksionale janë të ndryshme. Një konceptim i tillë i problemit kushtëzon edhe analizën e tyre në rrafshin semantiko-funksional, ose anasjelltas fjalitë me strukturë të ndryshme, si: *Kush punon, fiton. Thuhet se ai kishte qenë nevrik atë moment*, vihen në një rubrikë. M. Totoni më së miri e identifikon këtë situatë, kur thotë se “ struktura të ndryshme me semantikë të ndryshme, përfshihen në të njëjtën rubrikë, përkundrazi struktura të njëjta ndahen në rubrika të ndryshme”⁴ Relacioni kombinatorik për të vënë në dukje dhe interpretuar saktësisht strukturën sintaksore të fjalive lidhore, homogjenitetin e tyre strukturor dhe heterogjenitetin e tyre funksional besojmë se do të del më i realizuar si metodë dhe koncept dhe do të pasqyrojë më saktë këtë problematikë shkencore.

Përfundim

Analiza gjuhësore e bazuar në këtë relacion kombinatorik na bën të mundur që t'i konkludojmë disa të dhëna që janë karakteristikë ndërtimore dhe funksionale e fjalive lidhore.

Fjalitë lidhore në gramatikat shqipe duke i konceptuar në planin semantiko-funksional kanë një strukturë mjaft heterogjene. Ato vështrohen mbi bazën e një sinonimie funksionale, e cila në rrafshin praktik është e pjesshme dhe shumë e përgjithshme dhe më tepër është e natyrës logjike.

Pikëvështrimi fillestar i analizës sintaksore nuk bazohet në fakte të vrojtueshme, d.m.th. analiza dhe studimi bazohen në relacionet përmbajtje –formë dhe jo anasjelltas formë-përmbajtje.

Kjo do të thotë se funksioni si pikëvështrim fillestar i analizës në kuadër të një fjalie të përbërë përcakton jo vetëm tipin e frazës, por edhe strukturën e tyre.

³ Shih “Fraza me nënrenditje”, f. 51, Sh.B e Librit Universitar, Tiranë, 2000, f. 151

⁴ M. Totoni, “Fraza me nënrenditje”, ..., f. 11.

Konceptimi logjiko-semantik i raporteve në kuadër të një fjalie të përbërë, mosvënia në pah e faktorëve strukturorë shkakton vështirësi edhe në përcaktimin e funksionit të një fjalie të nënrenditur dhe nuk e vlerëson njësoj semantikën e frazës përkundrazi një fjali e vështruar në planin strukturor si pikëvështrim fillestar e përcakton më qartë aspektin semantiko-funksional të saj.

Fakti nëse një folje është vetore ose jovetore, pësore ose veprore, kalimtare ose jokalimtare janë faktorët themelorë gramatikorë që determinojnë funksionin e një fraze të nënrenditur.

Sikundër dihet kriteri funksional për nga natyra është heterogjen dhe si i tillë ai nuk mund të përdoret si kriter bazë për ndarjen dhe klasifikimin e fjalive lidhore.

Duke parë problemin njëanshëm, duke mos përfshirë të gjitha faktet gjuhësore njëherazi gramatika shqipe mund të përkufizohet si një postulat shkencor njëdimensional dhe nevoja për të lëvizur gurët në rrafshin teorik është e ngutshme.

Me gjithë përpjekjet individuale të atyketushme, arritjet në kuptimin sistematik që nga vitet e 70-ta, kur ky sektor i gjuhësisë u konsolidua me emrat e mëdhenj, si Domi, Prifti, Totoni e shumë tjerë, ende janë në pikën fillestare.

Bibliografia

1. ASHARSH, Instituti i gjuhësisë (1995), *Gramatika e Gjuhës Shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë.
2. ASHARSH, Instituti i gjuhësisë (1997), *Gramatika e Gjuhës Shqipe II (Sintaksa)*, Tiranë.
3. ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002), *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2 (Sintaksa)*, Tiranë.
4. DOMI, Mahir (1971), *Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore..., Prishtinë.
5. PRIFTI, Stefan (1971), *Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore..., Prishtinë.
6. TOTONI, Menella (2000), *Fraza me nënrenditje*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
7. FLOQI, S., ÇELIKU, M., TOTONI, M., PËRNASKA, R., FLOQI, S. (1971), *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe - Sintaksa e fjalisë*, Enti i teksteve..., Prishtinë.
8. FLOQI, S., DOMI, M., MANSAKU, S., ÇELIKU, M., PRIFTI, S. (1991), *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe – Sintaksa e periudhës*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore..., Prishtinë.
9. BECI, Bahri (2001), *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore..., Prishtinë.
10. CIPO, Kostaq (1952), *Gramatika dhe Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë.
11. TOTONI, M. (1972), *Klasifikimi strukturor – semantik i frazave me fjali të nënrenditur*, Studime filologjike, nr. 2, Tiranë.

12. FLOQI, Spiro (1972), *Klasifikimi i fjalive të varura*, Studime filologjike, nr. 2, f. 137-151, Tiranë.
13. XHUVANI, Aleksandër (1938), *Njohnit' e para të sintaksës shqipe*, Tiranë.
14. SHEPERI, Ilija Dillo (2001), *Gramatika dhe Sintaksa*, ASHASH, (ribotim), Tiranë.

Rozana RUSHITI

**PERIUDHA HIPOTETIKE SI NJËSI FUNKSIONALE NGA
LAMBERTZ-I TE SINTAKSAT E PARA TË SHQIPES**

Periudhës hipotetike nuk i është kushtuar ndonjë studim a monografi e veçantë në gjuhën shqipe. I vetmi punim i hollësishëm e shterues në lidhje me këtë kategori sintaksore të shqipes si nga ana strukturore, ashtu edhe nga ana kuptimore, është monografia në gjermanisht e M. Lambertzit, që, siç është pohuar e pranuar prej gjuhëtarëve dhe profesorëve tanë të nderuar: E. Çabej, J. Kastrati, E. Lafe, S. Mansaku etj., është e para e kësaj fare. Edhe pas gati 100 vjetësh, që prej botimit të tij, studimi ka mbetur punimi më i plotë që është shkruar për këtë kategori sintaksore të shqipes.

Por, pavarësisht vlerave që mbart ky hulumtim i shkruar në gjermanisht, (gjithsej 164 faqe) në vitet 1914-1915, ai erdhi për herë të parë në gjuhën shqipe në vitin 2011, nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë, në bashkëpunim dhe redaktim të T. Topallit¹, që e ka shoqëruar botimin edhe me një studim shumë të hollësishëm. Duke qenë i pari punim në këto përmasa ai ka shërbyer dhe ka kontribuar edhe si pikë mbështetëse në trajtimin e kësaj kategorie në shumë gramatika të mëvonshme të shqipes.

Mjafton të ndalemi, shkurtimisht, në sintaksat e para të shqipes të një periudhe 30-vjeçare, 1914-1954, ku do të shihet se kjo kategori sintaksore, ashtu si edhe të tjerat, është trajtuar jo gjerësisht, për arsien e vetme se këto tekste u hartuan si tekste shkollore, të thjeshta, në përputhje me kërkesat e zhvillimit të arsimit të asaj kohe.

Karakteristikë e këtyre sintaksave është mbështetja e tyre në fjalinë e varur e jo në tërësinë e periudhës, frazës a fjalisë së përbërë. Kjo mënyrë trajtimi, vë në dukje Totoni² në monografinë e tij “Fraza me nënrenditje”, ka ndikuar edhe në klasifikimin e këtyre frazave, megjithëse pas studimeve të S. Floqit ky konceptim është kapërcyer. Përqendrimi i vëmendjes në një drejtim, nuk ka lejuar që të

¹ T. Topalli, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe e M. Lambertz-it*, përcjellje e botimit, M. Lambertz, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, f. 269-289

² M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Shblu, Tiranë, 2000, f. 9

zbulohen të gjitha veçoritë strukturore e semantike të frazës, në mënyrë aq të gjerë sa shihen në monografinë e albanologut austriak, M. Lambertz.

A. Xhuvani (Njohunit e para të Syndaksës Shqipe (pjes' e parë për klasët e nalta të Filllore), Vlorë, 1922: f. 45) e rendit këtë kategori sintaksore në vargun e *fjalive të varme*, që mund të dëftojnë *kohë, kusht, shkak, qëllim* etj duke sjellë një shembull të vetëm: *Në qoftë se nuk kishte njerëz të ligj. Në dallim nga Xhuvani, Sheperi, në sintaksën e tij (1927: 176) ndalet kryesisht në mjetet lidhëse dhe në përdorimin e mënyrave të foljeve kur shfaqen fjalit kushtore, që bëjnë të mundur që kushti i shprehur të jetë i vërtetë, i mundshëm, apo i paralizuar. Të dy këta studiues nisen nga kriteri funksional, nga funksioni që kryejnë në fjalinë drejtuese gjymtyrët e saj, ndaj Sheperi thekson se kjo fjali mund të shërbejnë në të si plotës kushti.*

Periodha hipotetike, si term përmendet për herë të parë te sintaksi i J. Rrotës (1942: f. 93-94), ku thuhet *se fjalija qyshkore e cila përfshihet në fjalinë e advëbjarit dhe dallohet për llojet e saj simbas mënyrës në të cilën kryehet a mund të kryhet qyshku i vûm, bashkë me kryefjalín përbajn perjudhën hipotetike.*

Duhet theksuar se në tekstin e tij, në dallim nga sintaksat pararendëse, vihen re përdorimi i një mori shembujsh dhe ushtrimesh praktike, të shkëputura nga shkrimtarë të kohës: Fishta, Konica, Mjeda, Migjeni, Noli, por edhe nga foklori ku, nëpërmjet tyre, shtjellohen e dallohen *fjalit qyshkore të nimendëta (rreale); fjali qyshkore të mundëshme (potencjale) dhe fjali qyshkore të pamundëshme (irreale)*. Këtë mision të tij e tregon që në hyrje të veprës, ku ai shprehet: *“Shembujt mësuesi do të mundohet t’i nxjerrë nga një copë e mirë leximi, a ma mirë do t’i qëmtojë nga gjuha e popullit, e cila te ne asht shpesh herë ma e bukur se sa gjuha e shkrimtarit”*.

Në një syth të veçantë të sintaksës së Cipos (1952: f. 95) me titull “Farët e fjalive të pavaruara” gjendet e renditur e parafundit *hipotetikja*, e cila shfaqet me anë të shprehjeve: *po e zëmë se, ta zëmë se, ta marim me mënt se, ta përfytyrojmë se*. Më pas, në shpjegimin që i bën periodës, ai trajton periudhën hipotetike me fjalinë kushtore (me protazën dhe apodozën), të cilën si edhe të tjerët e ndan në tri lloje. Këtu, përmenden, por edhe sqarohen për herë të parë njësitë kallëzuesore *protazë* dhe *apodozë*, mbi të cilat mbështetet Lambertz-i në studimin e tij. *Fjalialia e varur që tregon kushtin- trajton Cipoja- quhet protasë; kryesorja që përmban rrjedhimin quhet apodosë. Në shqipet protasa munt të dalë e të rrijë përpara apodosës ose pas kësaj. Protasa me gjithë apodosën formon periudhën hipotetike. Dëshirojmë të vëmë në dukje se fjalitë hipotetike më të bukura të tipit të pamundësisë, Cipoja i gjen vetëm në veprat poetike të Naimit, si dhe përfshin te mjetet lidhëse edhe lidhëzën me kusht që tregon hipotezë të mundësisë. P.sh.: I jap të holla me kusht që të m’i*

këthejë. S.Floqi³ këtë lidhëz me kusht që (*me konditë që*), së bashku me në rast se (që e shohim te sintaksa e Domit), në qoftë se, i quan më vonë, lidhëza speciale kushti, që ndryshojnë vetëm nga nuanca e kushtëzimit ose nga stili. M. Totoni (Fraza me nënrenditje, 2000: f. 99) i sheh si lidhëza me kuptim të diferencuar apo të padiferencuar.

Në pjesën e dytë të Sintaksës së Domit, (1954:f. 239) ai vetë ka sqaruar se për kapitullin ku përfshihet *kushtorja*, është përdorur edhe studimi monografik i prof. M. Lambertz-it “Periudha hipotetike në shqipet”. *Fjalitë kushtore*, -pohohet nga Domijanë nga më të pasurat e gjuhës sonë për format me të cilat çfaqet dhe kuptimet që ato shprehin. Edhe kjo fjali shpjegohet nëpërmjet shembujve të shumtë të shkëputur nga veprat e autorëve të kohës: Dh. Shuteriqi, F. Gjata, Fan Noli, K. Jakova, Migjeni, M. Grameno, Ndre Mjeda, S. Spasse etj.

Siç shihet, studimi i kësaj kategorie sintaksore që nga sintaksi i J. Rrotës, është e lidhur ngushtësisht me monografinë e plotë shkencore të albanologut të shquar M. Lambertz, i cili nëpërmjet 8 kapitujve ka pasqyruar:

- të gjitha rastet e ndërtimit të periudhave me fjali të varura kushtore;
- mjetet e shumta konjuktive për lidhjen e protazës dhe apodozës, por edhe fjalinë kushtore pa lidhëza;
- format foljore dhe raportet kohore që shënojnë këto lidhur me kryerjen e veprimit në fjalinë drejtuese dhe në ato të nënrenditura kushtore;
- zëvendësimin e fjalisë kushtore me ndërtime të tjera;
- si në rastet kur periudhat janë reale ashtu edhe kur ato janë potenciale apo ireale.

Në dallim nga sintaksat e përmendura më lart, studimin e tij e nis me lidhëzat (konjuksionet) që i prijnë fjalisë kondicionale dhe mënyrat e përdorimit të tyre, gjithsej rendit 17 (*ndë (në), për në, ndë qoftë se, ndë qoftë që, ndë se, ndë që, andë, po, po që, pokka, kur, siku, sikurse, masi, kah, ku, neke*), ku, në krye të tyre, për nga përdorimi vendos lidhësin hipotetik *ndë (në)*, që sipas tij, përdoret ma shumë në gjuhën shqipe duke e krahasuar funksionin e këtij mjete edhe me mjaft gjuhë të tjera, si greqishten, latinishten, gjermanishten. Vetëm për këtë mjet, të pranishëm, në të gjitha gramatikat me përjashtim të sintaksës së Xhuvanit, Lambertz-i sjell 20 shembuj nga vepra dhe autorë të ndryshëm, duke u bazuar në gramatika e studime si ato të Gj. Pekmezit, Brugmanit, Thumbit, Hermanit etj., si dhe shembuj përdorimi nga gjuha e gjallë popullore dhe variantet e shkruara më të mira të Kalabrisë, Sicilisë, të dialektit të toskërishtes. Mjaft shembuj vijnë edhe nga shkrimet e vjetra, Bogdani etj. Disa prej këtyre mjeteve lidhëse, si lokucioni *për në* (ndjekur prej një foljeje në mënyrën dëshirore), që sot pothuajse nuk përdoret fare, ka qenë një

³ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukture të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, SF, 1967/3, f. 28

konjuktiv mjaft i dendur, në folklor dhe në poezinë e kultivuar në kohën kur është hartuar ky punim apo *andë, pokka*, ku, për të fundmin autori sqaron se në dialektin italo-shqiptar ka kuptimin *pra. Pokka Zot të do ashtu (J. Baribova: 108)*. Ajo përbahet prej *po* të shqipes me një *ka* (=ital *che*; disa dialekte shqiptare të Kalabrisë dhe të Molisës kanë në vend të *e* një *a* të theksueme) dhe është identike me *po që*.

Ai njih edhe lokucionet sinonimike si: *ndë qoftë se, ndë qoftë që, ndë se, ndë që*, duke renditur edhe mënyrat foljore me të cilat shoqërohen. Krahas tyre në gramatikat e lartpërmendura shohim edhe lokucione të tjera: *po kjo se/po kjo që* (J. Rrotës: Sintaksi i shqipes, Shkodër 2005, ribotim) ose *po qe se/ po qe që* (M. Domi, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa, Tiranë: 1954) që për nga kuptimi janë sinonimike, por që dallohen nga denduria e përdorimit. Ky kapitull mbushet me mjete të tjera të lidhjes sintaksore të drejtpërdrejta kushtore dhe me ngjyrimë të tilla, si: *po që, kur, sikur, sikur në, si, masi, kah, ku, nekë, që* në kuptimin origjinal janë ndajfolje vendi, që shihen, siç thuhet nga T. Topalli, si dëshmi të parataksës së vjetër në ligjërimin njerëzor⁴.

I rëndësishëm është pohimi i Lambertz-it se fjalitë e këtyre periudhave, kanë dalë nga fjalitë kondicionale parataktike, argument që është mbështetur edhe nga prof. E. Çabej në leksionet e tij të Prishtinës (E. Çabej, Hyrje në indoeuropianistikë: f. 226), ku ai thotë lidhur me bashkërenditjen dhe me nënrenditjen se *në periodat e para mbizotëronte bashkërenditja, koordinimi. Nënrenditja e fjalisë paravendon, presupozon një zhvillim mendor mjaft të përparuar*.

Gjithashtu, Lambertz-i përmend fjalinë kondicionale pa konjunksion, duke treguar se nuk ekziston vetëm në shqipen, por edhe në gjermanishte dhe rumanishte, sidomos në rumanishten popullore si dhe në gjuhët e reja romane. Në të tilla raste me mjet lidhëzën zero, rolin e bashkimit të njësive predikative e merr pjesëza të e lidhore. (*Të qenkësja si ti, djalë, Muratit i pinja gjanë*). Këto raste janë trajtuar edhe në sintaksat e mësipërme, te Sheperi, kjo pjesëz është përshfirë në grupin e lidhëzave, krahas *në-së* dhe *po-së* (*Të pëskëshe punuar, do të keshe fituar*). Për këto struktura, Lambertz-i ndalet me hollësi me modele të ndryshme të bashkëpërkimit të kohëve foljore dhe trajtave mënyrore tek protaza dhe apodoza, edhe në rastet kur predikativiteti nuk takon me praninë e foljes.

Një vend të veçantë zënë në këtë studim edhe periudhat që ndërtohen me *paskajoren gege*, me shprehësi të veçantë, sidomos kur janë prepozitive: *Me t'pvetë kush se ç'ishte jeta*. Shumë gjuhë të lashta e moderne, shkruan autori, fjalitë kondicionale i zëvendësojnë me një fjali relative si në greqisht, latinisht, gjermanisht, gjuhët romane; në gramatikat tona këto struktura trajtohen në grupin e fjalive ftilluese. Në të gjitha gramatikat e lartpërmendura, sikundër edhe në

⁴ T. Topalli, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe e M. Lambertz-it*, përcjellje e botimit, M. Lambertz, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, f. 286

monografinë e Lambertz-it, format e pashtjelluara, që nga J. Rrota janë pjesë e *fjalive të pazgidhuna* ku njësitë kallëzuesore ndërtohen me paskajoren geqe, me pjesoren dhe me përcjelloren e këtij dialekti. *Verbi në mënyrën paskajore sidomos në gegnishte- posë se shpesh në vend të gjymtyrvet të fjalit së thjeshtë, mund të rrijë edhe në vend të fjalivet të vërteta-* janë trajtuar gjuhësisht si të afta për të shprehur njësi predikative, ndërsa sot statusi i tyre është i diskutueshëm. Lambertz-i ndalet te vargjet e Naim Frashërit për të shpjeguar bashkimin e shumë fjalive pjesore kondicionale pa kopula. Në një pjesë të veçantë të veprës së tij, ai merret me pozicionin e fjalës në periudhën hipotetike, duke dhënë ngjyrimet ligjërimore që përftohen nga topika e fjalëve.

Në monografinë e tij janë vënë në dukje me mprehtësi edhe gërshetimet funksionale e kuptimore të marrëdhënieve kushtore me ato me përdorim temporal, koncesiv apo me kuptim kauzal. *Fjalit e varme, thotë ai- përmban edhe një të shtrueme të konditës, e cila duhet ta pengonte realizimin e asaj që thuhet në fjalit e kondicionueme, por me gjithatë nuk ushtron ndonji influencë mbi atë.* Shprehja e marrëdhënieve kushtore në gjuhën shqipe është në krahasim me shprehjen e raporteve kushtore edhe në gjuhë të tjera indoevropiane, prandaj, studimi, shprehet prof. Mansaku⁵, herë-herë ka marrë pamjen e një studimi krahasues.

Mbështetur në këto çështje, por edhe në të tjera problematika që nuk patëm mundësi t'i trajtojmë në këtë kumtesë, mund të thuhet se monografia e Lambertz-it (megjithëse e shkruar jo në gjuhën shqipe) shërbeu si pikënisje për studimet e mirëfillta sintaksore në gjuhën shqipe, dhe që do të vazhdojë të shërbejë si e tillë edhe në studime të mëtejshme në këtë fushë.

⁵ S. Mansaku, *Dy fjalë vlerësues për studimin 'Periudha hipotetike në gjuhën shqipe të M. Lambertz'*, Tiranë, 2011, f. 298

Ismet OSMANI

MEDIUMET NË GJUHËN SHQIPE DHE PRIRJET E PËRGJITHSHME GJUHËSORE

Prirjet e përgjithshme gjuhësore përbëjnë një fushë studimi me interes, që kanë tërhequr vëmendjen dhe janë bërë objekt kërkimesh e hulumtimesh nga shumë gjuhëtarë gjatë viteve. Objekt trajtimi janë prirjet gjuhësore në dy varietetet: varietetin e gjuhës së folur dhe të shkruar, posaçërisht në gjuhën e publicistikës, medimeve, dhe konkretisht atyre radio-televizive, si varietet ndërmjet gjuhës së folur (media e folur) dhe të shkruar. Këtu, vihen në dukje prirjet e përgjithshme gjuhësore, zhvillimi i tyre në rrjedhën e kohës, prurje të varieteteve gjuhësore të marra nën vëzhgim, kahet e lëvizjeve të këtyre ndryshimeve si dhe perspektivat e tyre.

Mes analizave të bëra jemi përpjekur t'i trajtojmë veçoritë gjuhësore të medimeve (elektronike apo të shkruara). Nga materiali i analizuar ashtu si vjen në redaksinë e lajmeve dhe si transmetohet nga goja e folësve televizivë, ose e shkruar nëpër gazeta, konstatohen mbartje të shumta dialektore, përkthim i keq i mbarur bashkë me strukturën e fjalisë nga gjuha e përkthyer, interpretime që devijojnë standardin, ose trajta dysorësh që ecin paralelisht me standardin.

Ndërkaq, ndërtimet e pasakta sintaksore të cilat devijojnë ligjet e sintaksës së shqipes dhe kulturën kombëtare të ligjërimit në përgjithësi, krijojnë devijime, përkatësisht pasaktësi në ligjërimitin e shkruar dhe bisedimor.

Kështu, për të kuptuar një fjali është e nevojshme të ndërtohet prezantimi i saj në çdo nivel, duke përfshirë këtu nivelin transformues ku fjalitë bërthamë që theksojnë një fjali të dhënë mendohen si 'elemente të përmbajtjes elementare' nga ku formohet kjo fjali¹.

Nga shembujt e marrë në shqyrtim vërehen:

a) gabime të shumta të karakterit teknik: 1) *përdorimi jokorrekt i ë –së, e cila shpesh sillet si e dhe lexohet ë, duke mos respektuar parimin fonetik të shqipes; 2) përdorimi i c-së në vend të ç-së; Mediat si Cajupi ;3) përdorimi i c-së në vend të k-së.*

¹ Noam Chomsky, *Strukturat sintaksore*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë, 2011, f. 128.

Kështu, shtimi ose heqja e tingujve, shkrimi vend e pavend i shkronjës së madhe, presjes, dy pikave janë gabime të shumta që hasen nëpër faqe të gazetave të ndryshme.

b) Përdorimi i gabuar i nyjës ose mospërdorimi i saj: 1) *Ulet çmimi i bukës.* 2) *Arrestohet në kohë rekord grabitësi (i) bankës.* 3) *Fabrika tullave.*;4) *Mosrespektimi i të drejtës e autorit vazhdon t'i shqetësojë krijuesit dhe shtëpitë botuese;*

c) Mospërdorimi i drejtë i kohëve të foljes: 1) Shumë shpejt do te kemi (identifikohet) emrin e autorit; 2) *Sot kemi pasur (pasur) një mbledhje te fundit ku u analizuan veprimet për ngjarjen.* 3) *Cana ka nënshkruar (nënshkroi) një kontratë 2-vjeçare e vlefshme deri në 30 qershor të 2014.*

ç) Përdorimi i gabuar i lidhëzave, ose raste të ndërtimeve të gabuara të fjalive, të cilat shpesh fillojnë me lidhëza, ose pranëvënia e dy a më shumë lidhëzave: 1) *Ashtu sikurse për sa i përket çështjes se vizave unë dua te shpreh mbështetjen time te madhe. Megjithatë, automjetet e qytetareve do te duhet te presin 15 majin për te kaluar lirisht.....;* 2) *Respektimi i te drejtës e autorit vazhdon te jete një çështje e pazgjdhur dhe që shqetëson krijuesit dhe kompanitë serioze që zhvillojnë aktivitet ne vendin tone.*

d) Përdorime të gabuara të pjesëzave: 1) *Nata e ndërrimit te viteve në Shkup ka shkaktuar edhe viktimën e pare te vitit 2010.* 2) *Agim Hoxha vetëm 20 vjeç ka humbur jetën pasi është përplasur me motor ne një mure pranë universitetit Aleksandër Xhuvani.* 3. *Sipas policisë shkak ka qene shpejtësia e madhe dhe konsumimi i alkoolit.*

Redundandet gjuhësore

Fjala redunad është ndërkombëtarizëm (rrjedh nga latinishtja dhe nga anglisht) dhe do të thotë fjalë të tepërta. Linguistët kanë llogaritur se 40 deri 60 për qind të fjalëve dhe elementeve në gjuhën e folur janë redundande gjuhësore. Por, shumica e tyre sigurojnë bartjen e shpejtë dhe të sigurt të informacioneve. Megjithatë, shkurtimi në vija të përgjithshme, është proces i cili zhvillohet për një arsye të vetme: *për lehtësim përdorimi e shkurtimi shprehesh, të cilat, si të tilla, përdoren shpesh në të folurin tonë.* Ekonomia e një gjuhe është kërkesë dhe nevojë e përhershme e shkurtimit të pamëshirshëm të secilës fjalë të tepruar në fjali, të cilat në mënyrë eksplicite janë redundande, pa të cilat teksti nuk humb asgjë. Përkundrazi, këto fjalë e ngarkojnë fjalinë, e bëjnë joekonomike, dhe ndonjëherë edhe të paqartë. Për shembull, nuk ka nevojë të shkruhet periudhë kohore, sepse fjala periudhë ndërthen në vete deh mbiemrin kohore – çdo periudhë është kohore; Biletë hyrëse (nuk ka biletë dalëse, ka vetëm hyrëse). Këtu, domethënë, bëhet fjalë për pleonazma klasike, të cilat konsiderohen si gabime stilistike.

Mjeshtrit e vërtetë të fjalës i zbulojnë redundandet gjuhësore edhe në fjalitë ku nuk zbulohen lehtë. Kështu ë fjalinë: *I lënduari është dërguar në spital, ku pas ndihmës së ofruar mjekësore është lëshuar për mjekim shtëpiak*. Në shikim të parë, këtu nuk ka ndonjë të pazakonshme. Megjithatë, të mendojmë pak pse duhet të themi se *të lënduarit i është ofruar ndihmë mjekësore* (pastaj është lëshuar në shtëpi)? Ç'duhet bërë të lënduarit në spital? T'i përgatitet një drekë të majme? Të luaj ndonjë lojë shahu? Fjalja nuk humb asgjë, po qe se do të shkruhej qartë: *I lënduari është dërguar në spital, pastaj është lëshuar për kurim shtëpiak.*; Turistët të cilët gjenden në plazhin e Velipojës janë shumë të kënaqur. A ka turistë që nuk gjenden në plazh.

Zhvillimi i mëtejshëm i gjuhës është një proces i pandalshëm, por rrugët që do të ndiqen, duhet të lidhen me nevojën për të ruajtur strukturën dhe tiparet e saj, duke përpunuar sidomos brumin e vetë gjuhësor, për t'ia përshtatur situatave dhe kushteve të reja.

Huazimet

Të gjitha gjuhët bashkëkohore janë kodifikuar dhe normëzuar, domethënë janë standardizuar. Kështu, ndodh edhe me gjuhën letrare shqipe - fjalët e gjuhës standarde gjenden në fjalorin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Për fat të keq, regjistrimi i inventarit të plotë të njësive leksikore në gjuhë shqipe nuk ka përfunduar, prandaj është e mu-ndshme që shumë fjalë të cilat hasim në përditshmëri të mos gjenden në fjalorin e drejtshkrimit.

Rrethana historike të zhvillimit të gjuhës së sotme shqipe, kanë imponuar ndikimin e fjalëve të huazuara nga gjuhë të huaja. Kjo nuk ndodh vetëm me gjuhën shqipe. Globalizimi i botës kontribuon që të gjitha gjuhët moderne t'u nënshtrohen ndërkombëtarizmave. P.sh. po t'u bësh një vështrim sipërfaqësor gjuhësor mjeteve të informacionit, qoftë elektronike apo të shkuara, do të vëresh një numër tepër të madh të fjalëve të tipit: *luk, bend, bodi, bos, kesh, fanki, doping, hard disk, xinse, laptop, link, live, lobist, party, roler*, etj. I madh është edhe numri i fjalëve të huaja që nuk u gjendet lehtë prejardhja ose përkthimi, si p.sh. *attachment, chat billboard, bluetooth, bookmark, boyband, site, broëser, fashion, netëork, reality shoë* etj. Numri i fjalëve të tilla është edhe më i madh, sidomos i atyre me burim latin: *fondacion, destinacion, klientelë, konzorcium, mandat, mobil, aplikacion, koalicion* etj.; se leksiku abstrakt e konkret është shumë më i gjerë dhe shumë më i larmishëm.

Përfundimi

Gabimet dhe shmangiet nga norma dëmtojnë qartësinë e saktësinë e kumtimit, sidomos në ligjërimin e shkruar, ku prodhimi i mesazhit nuk përkon pothuajse kurrë

me marrjen e tij, as në kohë e as në hapësirë, ku mungesa e elementeve të situatës së komunikimit dhe e mjeteve plotësuese (mimika, gjestet, etj.) kërkojnë domosdoshmërisht funksionimin me shumë saktësi të mjeteve të referencës kontekstuale të thënies.

Bibliografia

1. Agalliu, F. (1972), *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë.
2. ASHSH (2002), *Gramatikë e gjuhës shqipe 2*, Tiranë.
3. Chomsky, N. (2011), *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë.
drejtshkrimi të saj, në: “Kongresi i Drejtshkrimi të Gjuhës Shqipe”, 20 – 25 nëntor 1972.
4. Graffi, G. (2003), *Sintaksa - Strukturat e ligjëritimit*, Dituria, Tiranë.
5. Hysa, E. *Probleme të drejtshkrimi të ë-së*.
6. Kostallari, A. (1972), *Gjuha e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të*
7. Likaj, E. (2003), *Për dysorët morfologjikë dhe format jonormative*, në: “Konferenca shkencore – Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Shtëpia botuese “Shkenca”, Tiranë, 2003. 10.
8. Lloshi, Xh. (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë.
9. Mansaku, S. (1985), *Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare*, në: Gjuha jonë, nr.1, Tiranë.
10. Memushaj, R. (2004), *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë.
11. Mërkuri, Nexhip (2008), *Gjuhë shqipe 1*, Vlorë.
12. Shkurtaç, Gj. (2006), *Kultura e gjuhës*, Tiranë.
13. Thomai, J. (2005), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.

Mensur VOKRRI

KATEGORIA GRAMATIKORE E NYJËS TE GJUHËTARË TË VEÇANTË TË GJUHËSISË SHQIPTARE

Probleme të veçanta të nyjave në shqipe

Hyrje

Në këtë kumtesë do të trajtohen disa probleme të veçanta të kategorisë së nyjës në gjuhën shqipe, duke mos u ndalur në disa çështje të cilat i kemi trajtuar edhe më përpara.

Ndër problemet të cilat do të trajtohen këtu janë: tri funksionet e pretenduar të nyjës së parme, lidhjet sintaksore të nyjave të mbiemrave me emrat dhe të dëftorthëve me emrat në gjinoren e re, trajtat e prapme të nyjës shquese, variantet e trajtave nyjore dhe vlerësimi kritik i përdorimit të tyre, “gara” midis trajtës nyjore “të” dhe “e”, trajtat nyjore shquese të prapme në ndeshje me të njëjtat të përparme, varësia formale e dëftorthit, me cilin nga dy emrat prijës akordohet dëftorthi dhe a bëhet gabim kur ndodh mospërsëritja e tij, mënjanimi i gjinores mbi gjinoren.

1. Tri funksionet e pretenduara të nyjës së parme

Sipas Rizës, pikërisht duke mos e hetuar karakterin *reliktor* të sintaksës parandejtuese të nyjës së caktuar në të kështuquajturit mbiemra të nyjshëm të shqipes bashkëkohore, për pasojë duke mos qenë në gjendje që të pajtohen patjetër me faktin e pazakonshëm se, në këta mbiemra, nyja e parme, si e këtillë d.m.th si element caktues, është bërë me kohë *kuptimisht e kotë*, gramatikanët e shqipes, herë të gjithë bashkë herë palë-palë, kësaj nyje i kanë mbathur tre funksione gramatikorë vërtet të ndryshëm, por barabar të paqenë:”1) një funksion (*sintaktik*) *lidhës*, 2) një funksion (*morfologjik*) *dallimi gjinie dhe numri*, 3) një funksion (*etimologjik të brendshëm*) *adjektivimi ndajfoljesh*.¹

¹ S. Riza, Vepra 3 dhe Vepra 5, ASHAK, Botime të veçanta XLIV, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Prishtinë, 2002 & 2009, fq. 185; 307

Për këto funksione të parme të nyjave, duke shpjeguar teorinë e Rizës, shpjegohet Ismajli në vijim të punimit të tij²

2. Lidhjet sintaksore të mbiemrave me emrat dhe të dëftorthëve me emrat në gjinoren e re

Sa i takon lidhjeve sintaksore të mbiemrave të nyjshëm dhe të dëftorthit me emrat, Riza shpjegonte se, në togfjalëshat e shqipes së sotme “*drejtori i aftë, studentesha e zellshme*” nyjat **i,e** të mbiemrave, sot e kanë humbur aftësinë shquese dhe në shqipen e lashtë donin të thoshin “*i afti, e zellshmja*”. Ndërsa në togfjalëshat e tjerë të shqipes së sotme “*drejtori i shkollës pedagogjike dhe studentesha e institutit pedagogjik*” nyjat **i, e** paraqesin të njëjtën përbërje fonetike porse dallohen qartë kuptimisht, të cilat s’duhet të konsiderohen si mbeturi të nyjave të parme, por mbeturi të dëftorthit. Te togfjalëshat e parë nyjat **i, e** akordohen drejtpërdrejt me trupat pasues të mbiemrave dhe pastaj akordohen an blok edhe me emrat prijës (drejtori i aftë, studentesha e zellshme), ndërkaq te togfjalëshat e dytë nyjat e emrave në gjinore akordohen vetëm me emrat prijës dhe nuk lidhen formalisht me emrat pasues të përcaktuar (drejtori i shkollës pedagogjike, studentesha e institutit pedagogjik).³

Me këtë mendim të S. Rizës pajtohet edhe B. Bokshi⁴, i cili në analizën shkencore të tij, bërë sistemit nominal të shqipes në veprën *Rruga e formimit të fleksionit nominal të shqipes*, e nxjerr të qëndrueshëm shpjegimin e Rizës për këtë problematikë.

3. Trajtat e prapme të nyjës shquese

Lidhur me trajtat e nyjave shquese të prapme në gjendjen e sotme do të shqyrtohen ato më kryesoret dhe që paraqesin interes e dallime. Siç dihet, nga ndeshja e mbaresës *ë* me nyjën **ie** (p.sh. punë – e) ka rezultuar një (*puna*), të cilën –*a* përshkruesi i shqipes mund ta quajë *nyjë* pa tjetër, meqë kjo –*a* paraqitet si nyjë edhe në mungesë të mbaresës –*ë* (p.sh. lul(e)-j-a). Mirëpo kjo paraqitje përbën vetëm një përgjithësim analogjik; kështu që kjo –*a*, historikisht, mbetet që mbetet rezultat i ndeshjes së mbaresës –*ë* me nyjën –*e*”, prandaj, ne, për shkak të kësaj së vërtete historike, e sidomos me qëllim që të theksohet *identiteti morfologjik i të dy*

² R. Ismajli, Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës, ASHAK, Botime të veçanta CV, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Libri 44, Prishtinë, 2009, fq. 238-239

³ S. Riza, Vepra 3 & vepra 5, fq. 185-188; 307-311

⁴ Shih. B. Bokshin në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*

aspekteve sintaktike të nyjës së caktuar, do të lejohemi që këtë –a ta pagëzojmë me emrin e përbërë: *mbaresë-nyjë*⁵.

Riza vlerësonte se, “në këto kondita, na edhe mbaresën kallëzore të emrave të caktuar do ta shikojmë si një *mbaresë – nyjë*, duke dalluar *mbaresë – nyjën primare –n(ë)* p.sh. vajzën, lirinë nga *mbaresë – nyjën sekundare: –in, –un* p.sh. lisiin, dheun, mikun”⁶

Sipas tij, ndaj dhanores së pacaktuar të një emri mashkullor p.sh. *një lis-i*, kemi të caktuarën: *lis-i-it*; kurse ndaj dhanores së pacaktuar të një emri femëror p.sh. *një pun-e*., kemi të caktuarën: *punës*⁷. Riza sqaronte se: “ja sepse, kur synohet së bashku, edhe e dhëna gjuhësore: *-ës* përbën, simbas nesh, një *mbaresë – nyjë*”⁸.

Këtë teori të Rizës e përkrahin edhe gjuhëtarë të tjerë si Çabej, Bokshi Demiraj etj.⁹

Ndërkaq “rreth rasavet te emrave në shqipen bashkëkohore, do të vërejmë se gjindorja *e re* dhe rrjedhorja *e re* nga dhanorja dallohen vetëm nëpër dëftorthin: *i, e, të* përkatësisht nëpër parafjalën: prej”¹⁰

Samiu përkufizonte se, emër’ *i* – çquar s’është gjë tjetërë përveç emëri *i* bashkuarë me nyjetë q’i ngjitenë në funtt. Nyjet janë tre, si do t’i shohëmë më poshtë, mashkulli *i*, femëra *e*, asjatëri edhe shumësi *të*; prapë guri është gur edhe *i*, puna është punë edhe *ë*, gjalpëtë është gjalpë edhe *të*, miqtë është miq edhe *të*”¹¹

Gjithashtu Pedersen shprehte mendimin se, në rasën emërore nyjat janë për gjininë mashkullore *i*, për femëroren *e*, për asnjansën *të* ose *e*; në rasën kallëzore për gjininë mashkullore dhe femërore: *të* ose *e*; në emërore kallëzore shumësi *të* ose *e*; rasat e tjera kanë *të* ose *së*. Raporti midis *të* dhe *e*, si këto trajta qëndrojnë njëra pranë tjetrës del në shesh nga shembujt pasues: *të* bilënë *të* bukurënë vajzë, por vajzën *e* bukurë, bilën *e* mbretit; djalëë shumë *të* bukurë (M) vënd i babait tim edhe *të* dajkos tim (M)”¹².

Cipoja vëren: “e përdorur pas emrave, si thërrime enklitike, ngjitet e bëhet si një trup me të, p.sh. *plep+i = plepi*; *patë+a = pata*”¹³. Sipas tij, duke qënë që kjo farë nyje rri gjithnjë pas emrit, quhet edhe nyj’ e sprasme.

Në këtë kuadër shprehet edhe A. Xhuvani: “Rregulla – Nyjë quhen zanoret **a, i, u**, që ngjiten prapa emrave e mbiemrave: këto quhen *nyjë të mbrapme*, pse vehen

⁵ Po aty, fq. 188;312

⁶ Po aty

⁷ Po aty

⁸ Po aty

⁹ Shih. Çabej, Bokshi, Demiraj në veprat e tyre lidhur me këtë çështje

¹⁰ Po aty

¹¹ S. Frashëri, Shkronjëto e gjuhës shqip, Bukuresht, 1886, fq. 22

¹² H. Pedersen, Studime për gjuhën shqipe, ASHAK, Botime të veçanta XLVIII, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Libri 20, Prishtinë, 2003, fq. 16

¹³ Kostaq Cipo, Gramatika shqipe, fq. 68

prapa këtyreve”¹⁴. Sipas tij, emrat e mbiemrat që kanë këto nyjë mbrapa quhen të shquem a të skâjuem; ata që janë pa nyjë quhen të pashquem a të paskâjuem.

Cimohowski jep mendimin e tij se, nyja që del pas emrave në trajtat e shquara fleksive shkrihet me to duke formuar një tërësi dhe trajtat që janë formuar në këtë mënyrë kanë në mbaresat e tyre jo vetëm format e ndryshme të nyjës, por edhe disa elemente që vijnë nga përgjithësimi analogjik ose elemente që janë gjurmë të mbaresave të vjetra indoevropiane”¹⁵.

Topalli shpjegonte qw, gjuha shqipe, në periudhën e saj të dokumentuar, paraqitet me dy palë nyja, që dallohen sipas gjinisë, numrit e rasës. Nyjat e prapme janë: -i, -u, -a, -ja, -t(ë), -s(ë), -n(ë), që ndahen në këtë mënyrë: -i, -u janë të gjinisë mashkullore për rasën emërore (lisi, kau); nyjat -a, -ja janë të gjinisë femërore për rasën emërore (fusha, luleja, shëndedja); nyja -së është e gjinisë femërore për rasat gjinore-dhanore-rrjedhore (fushësë), kurse për gjininë mashkullore në këto rasa përdoret nyja -t (malit); nyja -në përdoret në rasën kallëzore për të dyja gjinitë (malinë, fushënë). Në numrin shumës dhe në gjininë asnjane del vetëm nyja -të për të gjitha rasat (maletë, fushatë, ujëtë, uejratë)¹⁶.

4. Variantet e trajtave nyjore dhe vlerësimi kritik i përdorimit të tyre

Në gjendjen e tij bashkëkohore, sistemi nyjor i shqipes së shkruar paraqet tri lloje variantesh: A.variantet arkaikë, B.variantet inovues dhe C.variantet diferenciale; A. *Variantet arkaikë* a) *E caktuara e prapme* -T në rrjedhoren sintetike. Rrjedhorja “analitike” e re (të cilën, siç dihet, e përbën dhanorja prirë nga parafjala: prej) dhe rrjedhorja sintetike e vjetër ndryshojnë prej më se një pikëpamjeje, b) *E caktuara e parme SË në rrjedhoren sintetike* pa dallim gjinie dhe numri – tek tuk takohet edhe sot e kësaj dite në gegërishte: “E kam ndie prej SË parësh” (simbas J. Rr.), “guri S(Ë) latuem” (Martesa e Halilit) etj.; kurse në toskërishte ka rënë krejt në harresë p.sh. “Rreth lindjes së tij imagjinata popullore endi një qerthull legjendash TË çuditëshme”. (Fan Noli) etj.; B. *Variantet inovues*. Përkrah mbaresë-nyjës së konservuar e për pasojë primare – N(Ë) p.sh. bariNË etj.fikNË etj., në shqipen bashkëkohore përdoret edhe mbaresë-nyja e inovuar e për pasojë sekondare – UN p.sh. bariUN etj. fikUN etj. C.*Variantet diferenciale*. Dëftori I THJESHTË bënte në kallëzore njëjës mashkullor femëror: aTË, në emërore-kallëzore njëjës asnjane: aTA, shumës mashkullor aTA dhe shumës femëror aTO. Prandaj, në këto rasa, edhe nyja e caktuar e parme paraqet trajtën primare TË, e cila asgjëmangu, shndërrohet në

¹⁴ Aleksandër Xhuvani, Libri i gjuhës shqipe, Pjesa e dytë, Për klasët e nalta të fillores e të parat e qytetses, Shpallje e përmirësime, Shtëpia botonjësë “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1938, fq. 12

¹⁵ W. Cimochowski, Gjuha shqipe & Për gjuhën shqipe, fq. 43-44; fq. 422-23

¹⁶ K. Topalli, Nyjat e shqipes, fq. 47-48

trajtën sekondare E, kur njëherazi plotësohen këto katër kushte që mbiemri të jetë: 1) *epitet* (e jo predikat emëror ose plotës predikativ), 2-3 që mbiemri epitet të mos i prijë emrit, por *ta ndjekë*, e *ta ndjekë pandërmjetshëm* d.m.th. pa ndërhyrë ndonjë fjalë tjetër midis tyre, dhe 4) që emri të jetë *i caktuar*.¹⁷

5. Gara midis trajtës nyjore “të” dhe “e”

Në lidhje me garën për parësinë dhe përdorimin dominues të trajtës nyjore **të** apo **e**, Riza shpjegonte se, me një anë mospajtimi i logjikës me anomalinë e dy trajtave nyjore për një kuptim të vetëm, e n’anë tjetër dëshira e oratorit për të theksuar shumësinë e gjymtyrëve të një numërimi, këta dy faktorë shpjegojnë prirjen e sotme drejt përgjithësimi të trajtës sekondare E në dëm të primares TË, - prirje, e cila mjerisht sa vete po bëhet gjithnjë më e ndjeshme në shqipen e shkruar. Këtë shpjegim e japin edhe Bokshi e Demiraj. Arsyeja e shndërrimit të primares TË në sekondaren E nuk mund të ketë qenë tjetër veçse *fonetike*. Ndërkaq në shqipen bashkëkohore mund të thuhet se shndërrimi i dhanores SË në TË përbën rregull sa herë që midis emrit femëror dhe nyjës së parme SË ndërhyrë ndonjë fjalë tjetër, e për pasojë edhe sa herë që nyja shfaqet për së dyti p.sh. “Rini, thueja kangës ma TË bukur që di” (Migjeni).¹⁸

6. Trajtat nyjore shquese të prapme në ndeshje me të përparmet

Kur e caktuara e prapme dhe e parmeja ndeshen njëra me tjetrën në shqiptim e sipër, atëherë – simbas trajtavet të ndryshme dhe simbas dialektevet të ndryshëm – herë hahet (prkt tjetërsohet) njëra, herë tjetra”. Kështu p.sh. në të folurën e Gjirokastrës më një anë zhduket e prapmeja –A dhe ruhet e parmeja E: “vajz’ E madhe”, “vajz’ E botës” etj.; e n’anë tjetër ruhet e prapmeja –U dhe zhduket e parmeja I: “Kau zi” “Kau parmendës” etj. Përkundrazi p.sh. në të folurën e Gjakovës, edhe në shqiptim të mbërthyer e prapmeja, ciladoqoftë, ruhet gjithmonë, kurse e parmeja I ruhet gjithashtu: “KaU I zi” etj.; herë semivokalizohet: “djali jamadh” etj. (E parmeja duket se hahet gati krejt: “udhA gat” etj.). Sipas tij, më përgjithësisht, mund të thuhet se, në gegërishten e folur, mbizotëron prirja drejt ruajtjes së nyjës së prapme në ndeshje me të parmen, kurse në të folurat jugore është më e fortë prirja drejt mosshqiptimit të njërës nga të dyja nyjat që ndeshen njëra me tjetrën.¹⁹

¹⁷ S. Riza, Vepra 3 & Vepra 5, fq. 192-193;317-320-324

¹⁸ S. Riza, Vepra 3 & Vepra 5, fq. 194-196;324

¹⁹ Po aty, fq. 196-197;324-326

7. Varësia formale e dëftorthit

Shpjegimi i Rizës lidhur me këtë çështje është kështu: “pra, në shqipen e sotme, i njëjti element gjuhësor dmth. dëftorthi lidhet përnga akordimi formal me emrin pris, kurse përnga shërbimi kuptimor me emrin pasues” p.sh.²⁰

(Lidhje trajte)

DREJTORI I SHKOLLËS PEDAGOGJIKE

(Lidhje kuptimi)

Sipas tij, kuptohet vetiu se në përkufizimin e dëftorthit duhet të përmendet, pa tjetër ky mospajtim midis mvarësisë së tij formale dhe shërbimit të tij kuptimor.²¹

Po i njëjti sqaron: “mirëpo kush përshekruan trajtat lakore të dëftorthit, duhet, në lakim e sipër, të abstrahojë nga lidhja e kuptimit të tij me emrin pasues, dhe të konstatojë vetëm lidhjen e trajtës së tij me emrin pris”²².

Ai shpjegonte se: “prandaj, për ne, është i papërshtatshëm lakimi tradicional i dëftorthit së bashku me emrin pasues p.sh. “gur’I malit..., gurit Të malit etj.” “balt’E fushësë,... baltës SË fushësë etj.” (Shkronjëto e Samiut, f. 27)”²³.

Për këto arsye na jemi të mendimit se dëftorthi duhet lakuar në bashkëvajtje vetëm e vetëm me emrin pris (duke figuruar me një trepikësh emrin pasues në gjindoren e vjetër prkt në dhanoren e re) p.sh.²⁴

	mask.	femër	shumës pa dallim gjinije
emër. Një drejtor:		një studenteshë:	ca drejtorë: TË...
	drejtori: I...	studentesha: E...	drejtorët: E...
dhan. një drejtor: TË...		një studenteshe: SË...	ca drejtorëve: TË...
	drejtorit:	studenteshës:	drejtorëvet:
kall. një drejtor: TË...		një studenteshë: TË...	ca drejtorë: TË...
	drejtorin: E...	studenteshën: E...	drejtorët: E...
	etj.	etj.	etj.

8. Me cilin nga dy emrat prijës akordohet dëftorthi?

Kur, në vend të një emri prijës kemi dy të këtillë, nga të cilët i dyti cakton të parin, atëherë me cilin prej këtyre dy emrave prijës akordohet dëftorthi i emrit të

²⁰ Po aty, fq. 197;325

²¹ Po aty

²² Po aty

²³ Po aty, fq. 197;325-26

²⁴ Po aty, fq. 198;326

tretë? Sipas Rizës, dëftorthi i emrit të tretë akordohet me emrin e parë, në qoftë se vlera gramatikore e emrit të dytë është e barazueshme me vlerën gramatikore të një mbiemri p.sh. “Ky është lajmi *i fundit i* Agjensisë Telegrafike shqiptare”. (= lajmi i mbramë i Agjensisë etj., lajmi më i ri i Agjensisë etj.). Përkundrazi, kur vlera e emrit të dytë nuk barazohet dot me vlerën e një mbiemri, atëherë dëftorthi i emrit të tretë akordohet me emrin e dytë p.sh. “Është bërë e nevojshme përtëritja e fundit TË kazanit”.²⁵

9. A përbën gabim mospërsëritja e dëftorthit?

Në shqipen bashkëkohore, nyja e parme është bërë komponente e pamungueshme e të kështuquajturve mbiemra të nyjshëm. Prandaj, kur bashkërenditen dy mbiemra të nyjshëm, nyja e parme e mbiemrit të dytë përsëritet *detyrimisht* si në shqiptim ashtu në shkrim p.sh. “Atje tej dëgjohej hingëllimi i dëshpëruar, I mallëngjyer, I ngjirur, I këputur i një kali.” (F. N.)”. Sipas tij, përkundrazi, në gjuhën e sotme të shkrimit konstatohet një prirje, vërtet për t’u vlerësuar në mënyrë kritike, por gjithmonë një prirje drejt mospërsëritjes së dëftorthit kur bashkërenditen dy emra në gjinore; - mospërsëritje, të cilën na këtu po e shënojmë me një vijë oblike p.sh. “...‘shtë fjala për lirinë e qfrytëzimit të njeriut nga njeriu, për lirinë e terrorit, për lirinë E reaksionit dhe/ fashizmit.” (Zëri i Popullit” 30.XII.56, fr. 4 sht. 5 nga fundi). Kështu, simbas nesh, mospërsëritja e dëftorthit TË nuk përbën gabim në këta shembuj: “Punuar nga komisioni i fjalorit rusisht-shqip i seksionit TË gjuhës e letërsisë”.²⁶

10. Mënjanimi i shpërdorjes së “gjindores mbi gjindoren”

Shmangia e përdorimit të gjinore mbi gjinoren, sipas Rizës, është e këshillueshme, sepse përdorja e një emri të tretë në gjinore për të përcaktuar një emër të dytë gjithashtu në gjinore, i cili në radhën e tij cakton një emër të parë në një rasë tjetër, përbën një ndërtim jo vetëm monoton por shpeshherë edhe të dykuptimshëm. Sipas tij, një ndërtim i këtillë është aq më i kritikueshëm në një gjuhë si shqipja, ku i njëjti dëftorth, përsëritet përpara së njëjtës rasë, e ku për më tepër shtrohet pyetja e akordimit të dëftorthit të dytë. Prandaj, sa herë që ka mundësi, është e këshillueshme që me ndihmën e ndonjë parafjale të shmangemi nga ndërtimi i “gjindores mbi gjindoren”; - mundësi që ekziston në këta shembuj:

²⁵ Po aty, fq. 198-199;327

²⁶ Po aty, fq. 198-200;328-330

“punuar nga komisioni I fjalorit rusisht-shqip I seksionit të gjuhës e letërsisë” (= “... nga komisioni i fjalorit rusisht-shqip PRANË seksionit...”).²⁷

Bibliografia

1. Besim, Bokshi (2005), *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, ASHAK, Prishtinë.
2. Çabej, Eqrem (1977), *Studime gjuhësore IV*, Rilindja, Prishtinë.
3. Cimochofski, Waclaw (1988), *Gjuha shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
4. Cimochofski, Waclaw (2004), *Për gjuhën shqipe*, AHAK, Prishtinë.
5. Cipo, Kostaq (1949), *Gramatika shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë.
6. Demiraj, Shaban (1979), *Morfologjia historike e gjuhës shqipe, Pjesa I dhe II*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Prishtinë.
7. Demiraj, Shaban (1988), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
8. Pedersen, Holger (2003), *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë.
9. Rexhep, Ismajli (2009), *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*, ASHAK, Prishtinë.
10. Selman, Riza (2002), *Vepra 3*, ASHAK, Prishtinë.
11. Selman, Riza (2009), *Vepra 5*, ASHAK, Prishtinë.
12. Xhuvani, Aleksandër (1938), *Libri i gjuhës shqipe*, Pjesa e dytë, Për klasët e nalta të filllores e të parat e qytetses, Kristo Luarasi, Tiranë.

²⁷ Po aty

Tomor OSMANI

HISTORIA E SHKRIMIT TË SHQIPES NË PENDËN E STUDIUESVE SHQIPTARË

Në 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë, Shqipëria ka arritur mjaft tregues pozitiv edhe në fushën e kulturës. Historia e shkrimit të shqipes dhe ngjarjet që lidhen me të, nuk mund t'i marrim si një veprim i shkëputur nga rrethanat historike të popullit tonë, nga përpjekjet e patriotëve tanë, të luftës së tyre si në rrafshin politik, kulturor dhe arsimor që u finalizuan me organizimin e Kongresit të Manastirit (1908) që qe një moment kyç, i cili kontribuoi drejt shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

* * *

Fillimi i shekullit XX zgjidhi përfundimisht një ndër çështjet më të debatueshme gjatë viteve, alfabetin e përbashkët të gjuhës sonë. Kjo ngjarje e madhe ka tërhequr vëmendjen e studiuesve shqiptarë, të cilët nga viti 1844 deri në vitin 2008 kanë botuar më shumë se 1600 studime, artikuj etj. Janë hartuar dhe botuar monografi me vlera të veçanta shkencore, por edhe njohëse për historinë e shkrimit të shqipes jo me të njëjtat përmasa, dhe jo me të njëjtën vlerë. Përmendim kronologjikisht monografitë e hartuara nga Justin Rrota (1936, 1978, 2005)¹, Selma Riza (1944, 1996)², Petro Janura, (1969)³ Sh. Demiraj – Kristaq Prifti (1968, 1978, 2004, 2008)⁴, Tomor Osmani (1987, 1999, 2008)⁵ Ibrahim D. Hoxha⁶, Ali Vishka⁷, Xhevat Lloshi⁸, Fadil Raka⁹.

Një ndihmesë të veçantë dhe me shumë vlerë kanë dhënë me studimet e tyre për historinë e shkrimit të shqipes E. Çabej, M. Domi, J. Kastrati, Dh. S. Shuteriqi, R. Ismajli, S. Skendo, K. Ashta, B. Demiraj, A. Omari, M. Quku, N. Alpan, R. Nexhibi etj. Ndonëse studimet e tyre me shumë interes nga pikëpamja shkencore dhe disa prej tyre shteruese, nuk janë përfshirë në një vëllim të posaçëm, ata janë një kontribut i veçantë për t'u njohur me sistemin grafik të një autori, si për Buzukun, Bogdanin, Kazazin, gramatikën e parë të gjuhës shqipe, për Kuvendin e Arbënit, për të pesë autorët e vjetër etj. Shumë e rëndësishme është puna e bërë nga një radhë studiuesish arbëreshë për historinë e shkrimit të shqipes, të cilët janë përqendruar te sistemi grafik kryesisht i autorëve të tyre të njohur apo edhe të zbuluar gjatë viteve.

Janë organizuar konferenca shkencore me këtë tematikë në disa përvjetorë, por kulmin do ta arrinin me kremtimin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit, të cilat u shoqëruan me botimet përkatëse në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Kroaci, Gjermani, Mal të Zi, Itali etj. Janë hapur ekspozita për historinë e shkrimit shqip në disa shtete. Tashti studiuesit tanë kanë në dorë me dhjetëra botime, studime, artikuj etj, që do të jenë në të ardhmen një burim i mirë edhe për pajisjen e një muzeumi që mund të ngrihet në Manastir.

* * *

Dy probleme kanë qenë shqetësuese për historinë e shkrimit shqip: e para të zgjidhej një alfabet i përbashkët, me botimet që do të bëheshin, do t'i shërbenin lëvizjes sonë kombëtare për çlirim nga Turqia dhe e dyta, pasi u hartua dhe u miratua alfabeti që kemi sot, diskutimi u përqendrua në, mes të tjerash, se vepër e kujt është alfabeti i dalë nga Kongresi i Manastirit. Dhe mendimin më të saktë shkencërisht do t'i jepnin studiuesit shqiptarë.

* * *

Ndonëse shqipja është një gjuhë e lashtë, ajo ka një alfabet të ri. Priti shumë që nga libri i parë “*Meshari*” i Gjon Buzukut 1555, të cilin e shoqëruan sakrifica pa fund, ndjekje, reprezalje, vrasje dhe internime, saqë mund të themi pa ndrojtje se nuk mund të gjejmë shembuj të tillë në historinë e popujve të tjerë ku u pagua aq shtrenjtë e drejta për të pasur shkrimin e vet, se sa te populli ynë. Ky kalvar i gjatë prej afro katër shekujsh nuk i gjunjëzoi patriotët tanë. Ata ditën të luftojnë për një qëllim të lartë, i përjetësuan ato, por edhe ditën që këto përpjekje t’ua trashëgonin brezave. Dhe sot gjithnjë studiuesit shqiptarë kërkojnë që zanafillën e shkrimit të shqipes të mos e pranojnë në ato kufij të njohur, por ta përcjellin edhe ndonjë shekull më parë. Dëshmitë e ndryshme me karakter gjuhësor dhe jashtëgjuhësor na bindin se duhet të kemi një trashëgimi shkrimi më të hershme se ajo që njohim deri më sot, por mungojnë dokumentet e shkruara.

* * *

Në këtë kumtesë do të merremi vetëm me disa monografi për historinë e shkrimit të shqipes dhe jo me gjitha ato botime që janë bërë për historinë e shkrimit të gjuhës sonë.

U deshën 28 vjet nga përfundimi i Kongresit të Manastirit që të botohet një monografi në vitin 1936 me titull “*Për historin e alfabetit shqyp*” nga Justin Rrota, e cila do të shërbente si tekst për shkollat e mesme. Autori, siç e shënon në parathënie, kishte dy qëllime, së pari, “*të kishim një dokument sado të përgjithtë përmbi*

zhvillimin e shkrimit të shqypes rrokull shekujvet”, së dyti, të silleshin për ilustrim brenda një antologjie të vogël “*shembuj prej shkrimesh e shkrimtarësh ma në shej të të gjithë kohëve*.” Ndonëse ky libër prej 92 faqesh, përfshirë edhe shembuj për ilustrim, për mendimin tim në ato pak rreshta, hedh ide të cilat shumë prej tyre u kanë qëndruar kohëve. E nisë këtë botim me një pohim të D. G. Jakovës, që shkruante: “*E thashtë Zoti që ta vijë shpejt ajo ditë në të cilën një libër , shtypë në gjuhë shqype, të mujë m’u këndue pa vishtërsi në tanë Shqypnin*”. Prandaj për Rrotën ishte e domosdoshme të sjellim kokën prapa e të shohim ato mozaike grafie për një periudhë 353-vjeçare. Nuk qëndron problemi se në këtë libër paraqiti shenjat grafike, të përdorura që te Buzuku dhe deri në Kongresin e Manastirit, por risitë që solli në ato pak rreshta. Rrota shtron pyetjen ku i morën autorët e vjetër gërmat e posaçme për të shprehur tingujt e gjuhë sonë. Për autorin ishte një punë jo e përgatitur nga autorët e vjetër, pasi ata “*as kishin ngé e as kishin gatimin e duhun të merreshin me krijimin e tyne*.” Kështu vazhdon autori me ato 22 zëra të trajtuara. E mbyll monografinë me zgjidhjen, që u arrit në Kongresin e Manastirit për miratimin e alfabetit të përbashkët, që për të ajo “*duel një gja qi pështetej jo aq mbi arsye dijtunore,sa dukej ma fort një vendim i marrun në themel të një kompromisi*.” Ai shënon edhe grafemat, që alfabeti ynë, mori nga alfabeti i Stambollit, i shoqërisë “*Bashkimi*” dhe i De Radës. Artikujt që u botuan më pas për këtë problem, qenë të shumtë, por jo të gjithë miratuan pikëpamjet e J.Rrotës.

Në vitin 1944 prof. Selman Riza botoi librit “*Tri monografi albanologjike*”. Kjo vepër çel kolonën e botimeve të prof. Selman Rizës që ende nuk i kishte mbushur 35 vjetët. Studimi i parë titullohet “*Abeceja*” që shpreh me kompetencë e saktësi shkencore pikëpamjet e tij, duke rivështruar disa përfundime të Kongresit të Manastirit. Autori nuk merret me të gjitha sistemet shkrimore, por ndalet në ato që kanë lënë gjurmë edhe në alfabetin e sotëm, duke paraqitur edhe katër alternative që duhet t’i kishte pasur parasysh komisioni i hartimit të alfabetit në Kongresin e Manastirit. Për Rizën, në disa zgjidhje të Kongresit të Manastirit, ka pasur paragjykime dhe interpretime. Njëkohësisht nuk e pranon përfundimin e Rrotës për burimin e alfabetin e sotëm. Pavarësisht nga sugjerimet, puna e delegatëve të këtij Kongresi çmohej nga Riza pasi realizuan “*për faqe të bardhë*” objektivin që kishin. Në vitin 1961 Riza botoi një krestomaci gjuhësore që e titullon “*Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*”, ku në mes të tjerash analizon sistemin grafik të Buzukut, të Matrëngës, të Budit, të Bardhit dhe të Bogdanit. Shtron probleme dhe jep shpjegimin e tij për shumë grafema të autorëve të vjetër. Më pas kemi edhe botime nga autorë të tjerë jo me ndonjë vlerë të veçantë.¹⁰

Monografia e parë pas Luftës së Dytë Botërore është ajo e Petro Janurës, botuar në Shkup, më 1969, me titull “*Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*”. Është një përpjekje modeste për të paraqitur rrugën e zhvillimit të alfabetit të shqipes gjatë katër shekujve. Duhet theksuar se nga vitet ‘50 të shekullit të kaluar

interesi për problemet e historikut të alfabetit të shqipes ka fituar zhvillime të reja, ndonëse ka pasur kufizime në trajtimin me vërtetësi historike për disa figura që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në Kongresin e Manastirit. Dhe kjo ka vazhduar deri me përmbysjen e regjimit monist në Shqipëri. Mendoj se 60-vjetori i këtij Kongresi (1968) nxiti studiuesit tanë të merreshin, më gjerësisht me një temë të tillë gjatë gjithë viteve që vinin pas. Për herë të parë botohen në një vëllim studime, dokumente e materiale kushtuar kësaj ngjarjeje të rëndësishme të lëvizjes politike e kulturore shqiptare -Kongresit të Manastirit të vitit 1908, të titulluar “*Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*”, Tiranë, 1972, ¹¹. Kështu një punim serioz me vlera shkencore dhe historike që hap këtë vëllim, është studimi i gjatë i prof. Mahir Domit “*Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*” (14-22 nëntor 1908). Jepet një histori e alfabetit të shqipes, e rivështruar, e përpunuar dhe e interpretuar me një akribi shkencore, duke sqaruar dhe saktësuar shumë probleme të ngritura deri në atë kohë dhe duke e lidhur historinë e alfabetit me historinë e popullit tonë. Autori ka sjellë mjaft materiale e dokumente të papublikuara deri në atë kohë, duke ia rritur vlerën studimit. Ai nuk është mjaftuar me ata që kishin arritur dhe thënë studiuesit tanë për probleme të ndryshme të historisë së alfabetit tonë, por ka vlerësime, saktësime dhe interpretime të reja. Nga përshkrimi i gjithë kësaj historie, ai për burimet e para të këtij alfabeti, nuk bashkohet me mendimin e paraardhësve, por duke pasur parasysh edhe arritjet e tyre, shpreh mendimin se ata duhen kërkuar në shekullin XIX, në alfabetet e Dhimitër Kamardës e të Pashko Vasës e nga fundi i shekullit të “*Albanisë*” së Brukselit e të “*Shqipërisë*” së Bukureshtit dhe në alfabetet që u përpunuan e u zhvilluan më tej në vitet e para të shekullit XX në mjaft organe të shtypit shqiptar të kohës. Për ne ky është punimi më i arrirë për historinë e alfabetit të shqipes deri në atë kohë, pasi ka gjetje dhe një trajtim të mirëfilltë shkencor. Për M. Domin Kongresi i Manastirit ndihmoi në përforcimin e bashkimit midis shqiptarëve, në vendosjen e një bashkëpunimi midis tyre në nivelin kombëtar, në kanalizimin e veprimtarisë drejt disa synimesh të përbashkëta.

Me rastin e 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit prof. Shaban Demiraj dhe prof. Kristaq Prifti botuan libërthrin “*Kongresi i Manastirit ngjarje me rëndësi në lëvizjen kombëtare shqiptare*”, Tiranë, 1968 dhe më pas kemi një ribotim të përmirësuar me rastin e 70-vjetorit, Tiranë, 1978. Autorët e trajtojnë problemin e shkrimit të shqipes në rrafsh gjuhësor – historik. Jepen të dhëna për historinë e shkrimit të shqipes deri në Kongresin e Manastirit, shoqëruar me dokumente të reja që hedhin dritë për këtë ngjarje, kryesisht nga Arkivi i Vjenës. Është një studim problemor i autorëve. Gjithnjë kjo histori është parë lidhur me kushtet historike që kalonte vendi ynë. Kështu në këtë veprë një kapitull përbën lëvizja politike-kulturore në Shqipëri në pragun e Kongresit të Manastirit. Rrethanat politike kulturore po përgatitnin kushtet për t’u mbledhur një kongres për të zgjidhur

çështjen e alfabetit të përbashkët. Dhe pasi analizohen këto kushte, mbështetur në burime arkivore dhe bibliotekare, flitet për zhvillimin e punimeve të Kongresit të Manastirit, duke u përpjekur për një trajtim sa më të ri dhe njëkohësisht për t'iu dhënë përgjigje disa problemeve që janë shtruar për diskutim gjatë viteve. Autorët kanë përfshirë në këtë botim si kapitull të veçantë luftën e popullit shqiptar kundër reaksionit xhonturk për shkrimin dhe shkollën e shqipe pas Kongresit të Manastirit. Ata janë ndalur në punimet e Kongresit të Elbasanit, në përpjekjet që u bënë për të ruajtur alfabetin e miratuar nga Kongresi i Manastirit në luftë me pushtuesin dhe elementët arrivistë që kundërshtonin shkrimin me këtë alfabet dhe përhapjen e tij. Përpjekjet e tyre u neutralizuan dhe alfabeti i dalë nga Kongresi i Manastirit mbeti sot e gjithë ditën alfabeti i shqipes. Sh. Demiraj dhe K. Prifti nuk u mjaftuan me kaq, por me rastin e 95-vjetorit të këtij kuvendi, ndërmorën një botim të ri “*Kongresi i Manastirit*” Tiranë, 2004 në të cilën u pasqyruan arritjet e shkencës shqiptare deri në atë kohë për këtë problem. Përveç informacionit të ri, në këtë botim janë bërë ndryshime edhe në interpretimin e dukurive, veçanërisht të figurave historike. Siç thuhet në parathënie është shmangur edhe denigrimi i disa personaliteteve e figurave të periudhës së Rilindjes, diktuar nga kritere jashtëshkencore “ideologjike” dhe u është dhënë vendi që meritojnë në historinë e Kongresit të Manastirit dhe në atë të kulturës shqiptare në tërësi. E veçanta është se këtë botim është përfshirë një shtojcë me dokumente, nxjerrë nga Arkivi Qendror i Shtetit dhe arkivat e huaja, si dhe janë shqipëruar disa prej tyre. U ribotua në vitin 2008 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit.¹²

Në vitin 1987 qarkullon monografia e Tomor Osmanit “*Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*”, Tiranë, 1987, ndërsa në vitin 1999 u botua “*Udha e shkronjave shqipe*”. Kjo monografi nuk është një ribotim i librit të mëparshëm të vitit 1987, ndonëse në vija të përgjithshme ajo ruan të njëjtën strukturë. Botimi i ri është pasuruar në përmbajtje, me të dhëna të reja, me vlerësime, është zgjeruar me interpretime të një konceptimi të ri. Në këtë botim pasqyrohen edhe disa të dhëna e fakte që më parë, për arsye që dihen, nuk janë përfshirë, si dhe janë pasur parasysh botimet e studimet e bëra viteve të fundit. Kjo monografi shoqërohet, përveç faksimileve të ndryshme, edhe me 80 pasqyra që përfshijnë mbi 150 alfabete, variante dhe nënvariate, pa të cilat nuk mund të konceptohej udha e gjatë e shkronjave shqipe, ndryshimet që kanë pësuar alfabetet dhe variantet e tyre, kriteret e ndjekura nga hartuesit, krahasimet etj. Me të drejtë është theksuar se kërkimet e reja dyfishuan lëndën e kësaj monografie, e zgjeruan optikën e trajtimit të saj jo vetëm thjesht si histori alfabeti, por edhe si histori kulture, si përpjekje emancipuese, si pjesë e historisë së zhvillimeve politike, që përgatitën Shpalljen e Pavarësisë.¹³ Në monografi u është dhënë përgjigje shumë pyetjeve të diskutueshme, si cilët janë burimet dhe autorët e alfabetit të shqipes, cilat qenë ato shkaqe të përjashtme që i detyruan anëtarët e komisionit të kthehen prapa dhe të miratojnë dy alfabete. Në këtë

monografi trajtohet për herë të parë pse u zgjodh Fishta kryetar i komisionit për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe cili qe roli I tij në Kongresin e Manastirit. Këto çështje dhe të tjera si këto kanë nevojë që edhe në ardhmen të vazhdojnë studimet në këtë fushë, duke i dhënë një zgjidhje problemeve ende të pazgjidhura në mënyrë përfundimtare dhe të pranueshme nga shkencë jonë gjuhësore dhe historike. Me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit Akademia e Shkencave e Shqipërisë e ribotoi, duke i bërë autori disa shtesa që tashmë arriti në një vëllim prej 630 faqesh. Një vepër tjetër e këtyre viteve është monografia e I. D. Hoxhës “*Nëpër udhën e penës shqiptare .Nga historiku i ABC-së dhe i shkrimit “shqip”*”. Autori trajton përpjekjet që u bënë për shkrimin e shqipes, shoqëruar me faksimile dhe pasqyra alfabetesh. U vazhdua edhe me botime të tjera.¹⁴

Xhevat Lloshi me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit botoi monografinë “*Rreth alfabetit të shqipes*”, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2008. Autori fillimisht përshkruan përpjekjet për një alfabet të përbashkët, përgatitjen e kongresit të alfabetit, shoqëruar me dokumente të përkthyer. Vazhdon me pjesëmarrësit në Kongresin e Elbasanit, shoqëruar përsëri me dokumente, përdorimin e shkronjave të greqishtes për alfabetin e shqipes, shkrimi në trevat shqiptare etj. Autori sjell dokumente angleze për shumë nga temat që trajton në këtë monografi. Ai gjithashtu bën vërejtje kur shkronjat greke janë transkriptuar gabim për shqipen ose edhe për probleme të tjera që kanë lidhje me greqishten dhe janë interpretuar në mënyrë jo të saktë.

Në vitin 2008 Fadil Raka botoi në Prishtinë studimin “*100 vjet të Kongresit të Manastirit*”. Është një përpjekje e autorit, mbështetur në literaturën e botuar, të trajtojë historinë e alfabetit të shqipes që nga fillimet e derisa u zgjidh përfundimisht alfabeti i përbashkët i shqipes.

* * *

Kjo histori e gjatë, e mundimshme dhe plot sakrifica e shkrimit të shqipes, ka zgjuar interes në të kaluarën, por vazhdon sot e kësaj dite, ku studiuesit po gjurmojnë e hulumtojnë për të zbuluar të dhëna të reja, që do të ndriçojnë këtë rrugë 353-vjeçare të shkrimit të gjuhës sonë. Gjetja e dorëshkrimeve të së shkuarës të panjohura do të jetë një burim i mirë për të saktësuar shumë çështje që edhe sot mbeten gati enigmatike.

Bibliografia

1. Demiraj, Shaban – Prifti, Kristaq (1968), *Kongresi i Manastirit-ngjarje e rëndësishme në lëvizjen kombëtare shqiptare*, Tiranë, 1968, f. 71; Po ata, *Kongresi i Manastirit...*, (ribotim i përmirësuar), Tiranë, 1978, f. 117; Po

- ata, *Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 2004, f. 203; *Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 2008 (ribotim).
2. Hoxha, Ibrahim D. *Nëpër udhën e penës shqiptare. Nga historiku i ABC-së dhe i shkrimit shqip*, Tiranë, f. 329.
 3. Janura, Petro (1969), *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, f. 125.
 4. Lafe, E. (2008), Parathënie e monografisë së T. Osmanit “*Udha e shkronjave shqipe*”, Tiranë, f. 12.
 5. Lloshi, Xhevat (2008), *Rreth alfabetit të shqipes*, Shkup, Prishtinë, Tiranë, f. 321.
 6. Në vitin 1992 në Shkup Ali Vishko botoi “*Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*”, f. 142. Këtë botim ia kushton 4 kongreseve: Kongresit të Manastirit, Kongresit të Dibrës, Kongresit të Elbasanit dhe Kongresit të dytë të Manastirit.
 7. Osmani, Tomor (1987), *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 295; Po ai, *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999, f. 576; Po ai, *Udha...* (ribotim i përmirësuar), Tiranë, 2008, f. 630.
 8. Raka, Fadil (2008), *100 vjet të Kongresit të Manastirit*, Prishtinë, f. 141.
 9. Reshat Nexhipi botoi “*Prespa dhe Manastiri nëpër shekuj*”, Kërçovë, 2003. Dy kapituj ia kushton Kongresit të Manastirit dhe familjes Qiriazit.
 10. Riza, Selman (1944), *Tri monografi albanologjike*, Tiranë, 1944, f. 13-34; Po ai, *Tri monografi...* Vepra 1, Prishtinë, 1996 (rib.), f. 11-37; Po ai, “*Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*”, krestomaci thjesht gjuhësore, Tiranë, 1961.
 11. Rrota, P. Justin O. F. M (1936), *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1936, f. 92; Po ai, *Për historin...*, Prishtinë, 1968 (rib.); *Për historin...*, Shkodër, 2005 (rib.), f. 92.
 12. Stavri Skendo botoi në revistën “*Sudost-Forschungen*” XIX, 1960, studimin “*Historia e abecesë shqipe. Një rasë zhvillimi kulturor dhe politik të ndërlikuar*” në anglisht dhe u botua e u përkthye në shqip në vitin 1962, f. 20. Është një historik i shkurtër ku për çështje të veçanta ka shfrytëzuar edhe Arkivin e Vjenës.
 13. Studiuesi Necip Alban botoi në Ankara në vitin 1979 një broshurë me titull “*Arnavut albanesi nasil do du?* (Si lindi alfabeti shqip? 100-vjetori i abecesë shqipe), f. 49, me shkrime shqip dhe turqisht.
 14. Universiteti i Tiranës (1972), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit* (Studime, materiale, dokumente), Tiranë, f. 447.
 15. Vishka, Ali (1992), *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*, Shkup, f. 141.

Skënder GASHI

VENDI I FORMIMIT TË GJUHËS SHQIPE SIPAS GJUHËSISË EUOPERËNDIMORE DHE ASAJ SHQIPTARE

Çështja e prejardhjes së etnosit shqiptar, e kontinuitetit shqiptar të etnisë ilire dhe të trashëgimisë gjuhësore e (sidomos onomastike) të ilirishtes nuk është e rëndësishme qendrore vetëm për shqipen e për shqiptarët dhe nuk është vetëm çështje thjesht filologjike. Zgjidhja e këtij problemi është e pandashme si nga çështja e prejardhjes së rumunëve e të vendit të formimit të rumanishtes ashtu edhe nga çështja se ç'popullata (ilirë të mirëfilltë dhe sish të romanizuar) gjetën në krye të herës ardhësit sllavë, kur këta u ngulën në hapësira të Ballkanit dhe e bënë këtë për atdhe të tyrin të dytë.

Sadoqë indoeuropeistë, ilirologë e albanologë euoperëndimorë, kryesisht gjermanofonë, e dëshmuar birësinë ilire të gjuhës shqipe dhe kontinuitetin shqiptar të toponimisë pararomake jo vetëm të hapësirës së *Illyrii proprie dicti* „Ilirët e mirëfilltë” porse edhe të Dardanisë, filologjia shqiptare e lavruar në Shqipëri ishte përqendruar vetëm në dëshmimin e autoktonisë së shqiptarëve në Shqipëri duke e nënkuptuar këtu edhe vendin e formimit të gjuhës shqipe.

Duket se kjo ndodhi, vështruar në rrafshin politik, për hir të “korrektësisë ndaj fqinjëve në kuadrin e doktrinës së asokohshme marksiste-leniniste dhe, në rrafshin filologjik, për shkak të apatisë ndaj tezës thrakase. Pikërisht pse kjo doktrinë kërkonte, pra, një komb shqiptar të formuar vetëm përbrenda kufinjëve të Shqipërisë së 1912-ës, filologjia shqiptare e mohoi vetë praktikisht origjinën ilire të dardanëve e të pasardhësve të tyre: shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë Veriperëndimore e të Luginës së Preshevës.

Kësi qëndrimi shfaqet para jo me larg se tri vitesh edhe dijetari shqiptar Bardhyl Demiraj. Në kumtesën e tij të lexuar dhe në diskutimin e tij në një takim pune të mbajtur më 24 prill, 2009 në Regensburg, autori arriti në përfundim që “Në mbështetje të gjuhësisë historike ka pra mjaft arsye të ngulet këmbë që atdheu “i jetimave” (= shqiptarëve) në mesjetën e hershme duhet të kërkohet në anën perëndimore të Ballkanit [...] duke vazhduar me pyetjen „dhe - pse jo edhe në hapësirën e sotme gjuhësore e të banimit të shqiptarëve. “Mirëpo, këtë pyetje e anuloi vete autori duke tumirë mendimin e Weithmann se, si pasojë e ardhjes së sllavëve, Kosova, si shumë regjione të tjera të Ballkanit, nuk ka histori të mesjetës së

hershme. Demiraj shtoi në këtë mes edhe se “*Për shkak të cilësisë shumë marginale të burimeve përkitazi me raportet në Kosovë në mesjetën e hershme*” kjo hapësirë duhet të lihet jashtë përsiatjeve përkitazi me temën e atdheut të shqiptarëve në shekujt 6-9.”

Pas përjashtimit të Dardanisë për si pjesë të hapësirës në të cilën shqiptarët janë autoktonë Demiraj deklaroi se “*Ta shtyesh këtë hapësirë (SG. dmth jashtë kufinjëve të Shqipërisë së sotme) për rreth 200 km. në drejtim të lindjes nuk do to ishte, çok, kurrëfarë mëkati, veçse duhet pasur arsye dhe duhet të sillen argumentet përkatëse*”.

Qëndrimi i dijetarëve shqiptarë përputhet me mendimin e indoeuropeistit Joachim Matzinger nga Vjena, i cili vlerëson se “*teza e prejardhjes ilire e përcjellur me autoktoninë është në Shqipëri shumë e dashur ; ajo e ka funksionin e murosjes së identitetit dhe është për shqiptarët, si të thuash, doktrinë shtetërore. Një variant i kësaj është hipoteza e prejardhjes dardane në paravendimin e një kontinuiteti linear ilir-shqiptar. Kjo teze është postuluar në Kosovë dhe është e politizuar meqë synon t’i arsyetojë pretendimet territoriale të shqiptarëve.*”

Duke u frikësuar, pra, si lugati nga agu i dritës nga emri thrakas i etnisë e nga thrakishtja si gjuhë, filologjia e lavruar në Shqipëri, gati edhe e anatemoi gabimisht dhe e injoroi kështu me kokëfortësi në rend të parë karakterin ilir të dardanëve e të dardanishtes e me këtë edhe Dardaninë si pjesë integrale të hapësirës së formimit të gjuhës shqipe e të etnisë së shqiptarëve. Ky qëndrim është i pakuptueshëm sidomos sa kohë që dihet se askush, madje as dijetarët serbë e bullgarë, nuk ka thënë se dardanët ishin thrakas apo që Dardania të ketë qenë pjesë e hapësirës etnolinguistike thrakase ose të asaj dako-mize.

Prandaj e kësaj frike e të këtij aversioni qëndrojnë tek rrethana që po u pranua teza e mbështetur mirë se vend i formimit të gjuhës shqipe është në të vërtetë (edhe) Dardania do të lëkundej autoktonia e shqiptarëve në Shqipërinë e sotme. Filologjia shqiptare nuk e pati parasysh faktin që psh. dijetari më i merituar për historinë e gjuhës shqipe N. Jokl vërente se „*Sido që të jetë, shohim se mbetjet nga lënda gjuhësore e gjuhëve të lashta të Ballkanit, si ato të ilirishtes ashtu edhe të thrakishtes, janë të lidhura ngushtë me gjuhën e shqiptarëve. Kjo lidhje e dyfishtë mund të shpjegohet vetëm nga bashkëjetesa midis ilirëve e thrakasve*”.

Përsa i bie autoktonisë së shqiptarëve Jokl, thënë shkurt, mendonte se vendbanimi i hershëm i shqiptarëve dhe djepi i tyre i formimit etnik e gjuhësor do (duhet) të kërkohet në Dardani. Në të vërtetë Jokl kishte thënë më shumë se një herë se pararendësit e shqiptarëve e banonin në të vërtetë në një hapësirë shumë më të madhe se kjo e sotmja e shtetit të Shqipërisë. Ata e banonin hapësirën që shtrihej përafërsisht në Dardani, pra në zona të skajshme ku këta ishin në kontakt me pararendësit e rumunëve dhe shtriheshin deri në detin Adriatik. Mendimin e Joklit e

pranuan, ndër të tjerë, P. Skok, M. Lambertz, Carlo Tagliavini, M. Friedwagner, J. Hubschmidt, H. Mih escu e shumë të tjerë.

Kështu psh., italiani C. Tagilavini konstatonte se “...në pjesën më qendrore, në një regjion që pak a shumë i përgjigjet Dardanisë antike, jetonte një popull indoeuropian, i formuar nga ilirë e thrakas, që gjuhësisht ishte romanizuar. Ky popull është populli i shqiptarëve”. Edhe M. Lambertz, si edhe H. Mih escu më vonë, vendin e formimit të shqipes dhe autoktoninë e shqiptarëve e shihte në trevën e Dardanisë së lashtë; M. Friedwagner, në punimin e tij monumental përkitazi me vendin e formimit të gjuhës e të etnisë së rumunëve konstatonte se “Këtu pra në Dardani, rrethrotull kryeqytetit (SG: Scupi) të provincës kishëtare dhe autoriteteve qeverisëse jetonte një popull nga gjuha pjesërisht e romanizuar e te cilit u zhvillua gjuha shqipe. Ky popull merret për autokton, ndërsa J. Hubschmidt arrin në përfundimin se “Në Dardanië e lashtë, në verilindjen e skajshme të hapësirës së sotme gjuhësore të shqipes, ndodhej qendra e reflektimit të një latiniteti të ri i cili ishte formësuar ndryshe nga ai i Dardanisë së romanizuar më heret [...] Ky latinitet i ri ndikoi mbi **dardano-ilirishten** dhe krijoi kështu nëmos më shumë atëherë së pakut pjesërisht bazën për rumanishten e sotme. Këtu ku për kohë të gjatë jetuan protoshqiptarët e protorumunët...”

Asnjëri nga dijetarët e sipërpërmendur nuk bie në atë grupin e vogël të atyre që e mohojnë as prejardhjen ilire të shqipes e të shqiptarëve e as autoktoninë e tyre në gjithë hapësirën aktuale të gjuhës shqipe. Përkundrazi, të gjithë këta e shumë e shumë të tjerë konsiderojnë se vendi i formimit të gjuhës e të etnisë së shqiptarëve të kohës së para ardhjes së sllavëve në Ballkan është, jo vetëm në hapësirën e të ashtuquajturve *Illyrii proprie dicti* “Ilirët e mirëfilltë” porse që këtu duhet të përfshihet edhe Dardania, me variantin dardan të ilirishtes.

II.

Megjithëse jo vetëm i injoronin porse gati edhe i anatemonin përkrasit e tezës së prejardhjes thrakase të shqipes e të shqiptarëve, të gjithë gjuhëtarët e Shqipërisë i pranuan për të vyeshme, kur kjo u duhej vetëm si ilustrim në margjina të mbështetjes së autoktonisë së shqiptarëve në Shqipërinë e sotme, pikërisht zbërthimet nga ata të emrave si Nish, Shkup, Shtip, Shar, Ohër që nuk bien në hapësirën e Shqipërisë së sotme porse në atë të Dardanisë.

Pikërisht ky tabor dijetarësh dëshmoi se edhe në hapësirën e Dardanisë ka, në mos më shumë, së pakut po aq toponime pararomake, siç janë psh. emrat e dy qyteteve më të mëdha: i kryeqytetit *Scupi* dhe i qytetit *Naissus* si dhe emri *Scardus* i maleve më të larta të Dardanisë dhe emri *Drinus* i lumit, trajtat moderne *Skopje*, *Niš* e *Šar-planina* e *Drim* të emrave të të cilëve, ashtu si edhe ato *Štip* e *Ohrid* të emrave *Astibos* të qytetit dhe *Lychnidos* të liqenit sllavët e ardhur i morën gjithashtu nga

goja e shqipfolësve. Asnjëri nga këta dijetarë nuk tha porse as që këta emra pararomakë ishin me prejardhje thrakase e as që ato qytete, mal e lume apo liqe ndodheshin në hapësirën etnolinguiostike të thrakasve.

Përveç dëshmimeve të kontinuitetit gjuhësor shqiptar të emrave të mësipërm të Dardanisë, këtu mund të inkuadrohet mbase edhe emri Ulpiana i qytetit të rrethinës së Prishtinës, emri pararomak i të cilit, sipas iliologut kroat A. Mayer, do të ketë qenë *Ulciana* (Ulkiana) i cili për nder të perandorit pushtues Traian, u ripagëzua në Ulpiana.

Për sa i bie Kosovës, e gjithë pesha e këtij segmenti të historisë së Dardanisë dhe të popullatës së saj përbrenda universit ilir ra mbi shpatullat e filologut të mirëfilltë kosovar Zef Mirdita, i cili, me studimet e tij të lëndës antroponomike e historike, e dëshmoi karakterin ilir të dardanëve dhe të antroponomisë se tyre bashkë me disa antroponime karakteristike dardane që i mbanin mbretër të shtetit të dardanëve. Përveç dijetarit të merituar kroat (mësuesit tim) Radoslav Kati i , meritë të veçantë ka në këtë mes dijetarja beogradase Fanula Papazoglu e cila në librin e saj mbi fiset e Ballkanit Qendror në kohën pararomake dhe sidomos në studimin e saj për antroponiminë e banorëve të Dardanisë tregoi shume bindshëm se antroponomia e banorëve të Dardanisë së para pushtimit romak ishte krejtësisht ilire.

Dijetaret Ivan Popovi i Serbisë dhe Ivan Duridanov i Bullgarisë treguan se, si rezultat i pranisë së elementit etnik e gjuhësor ilir toponime ilire, përkatësisht dardane ka deri edhe në rrethina të Beogradit dhe në gjithë pjesën e sotme lindore të Serbisë.

Pasi kishte konstatuar se “ne kemi dëshmi të sigurta se në sterenë gjerm. *Binnenland*, së pakut në lindje, praktikisht në territorin e Bullgarisë, sllavët nuk e morën materialin gjuhësor gjithmonë nga grekët e nga romakët, porse edhe drejtpërdrejt nga popuj të tjerë dmth. nga barbarët autoktonë [...]

“Më i besueshëm duket (për autorin tonë) toponimi Bra in i Vërsar-it në rrethina të Beogradit to cilin ky e krahason me emrin “dardan” B á tek i cili autori gjen një prapashtesë thjesht shqipe sh- sepse tingulli * i shqipes u shndërrua në s vetëm pas marrjes së huazimeve më të vjetra sllave.” - shkruante në vazhdim I. Popovi .

Dijetari bullgar Ivan Duridanov tregoi në një punim të tijin se emra ilirë të lumenjëve, të zbërthyeshëm me brumë leksikor të ilirishtes përkatësisht të shqipes, ka edhe në regionin përgjatë rrjedhës së sistemit ujqor të lumit të Kollubarës në pjesën lindore të Serbisë e cila në antikitet ishte pjesë e Dardanisë.

Kur po i trajtonte variantet e mundshme për zbërthimin e emrit *Ljig*, gjin. *Ljiga*, të lumit të rrethinave to Valjevo-s autori e sheh për të mundshme lidhjen e këtij emri me ieur. *(s)leig- “llucw; rrëshqas”, me një zgjerim në *lei- “tokë e rrëshqitshme për shkak të lagështisë”.

Për emrin e lumit *Ka er*, dega më e madhe e lumit Ljig, Duridanov e hedh kategorikisht poshtë mundësinë e prejardhjes së tij nga fjala slave ka a “gjarpër”. Më e mundshme i duket autorit tonë që ky emër të rrjedh nga një trajtë e kryeherëshme ilire **Kuk-er-us* që lidhet me rrënjën ieur. **kuk-*: **keuk*„lakoj; kthese”. Tek emri *Ka er* i kwtij lumi, me prejardhje ilire është edhe prapashtesa -er, e cila është dëshmuar ndër emra ilirë të lumenjve e të vendeve, khs. psh. *Iader*, *Rider*.

Me peshë të madhe për çështjen që po trajtohet në këtë kumtesë janë 3 përfundimet që autorit i rezultojnë pas trajtimit në rrafshin etimologjik të hidronimisë së sistemit të Kollubarës:

“1. Popullata më e vjetër e kësaj hapësire ishte popullata ilire.

2. Në kohën e dyndjes sllave në tokat në jug të Danubit e të Savës, për afërsisht nga fundi i shek. VI, popullata ilire i ishte nënshtruar një procesi intensiv të romanizimit, rrethanë kjo që mund të dëshmohet mbi bazën e trajtës romane *Kolumbar(i)a* të emrit të lumit kryesor *Kolubara* të këtij regjioni.

3. Kur sllavët (serbët) u bënë banorë vendës të regjionit të Kollubarës, këta i morën pjesërisht emrat ilirë të lumenjve dhe pjesërisht krijuan trajta sllave të tyre. Rrethana që (në këtë hapësirë) u ruajtën 9 emra ilirë të lumenjëve, (*Bosuta*, *Ka er*, *Kolubara*, *Ljig*, *Marica*, *Obnica*, *Onjeg*, *Rabas* e *Ub*) mund të shpjegohet si rezultat i një bashkëjetese paqësore të sllaveve me ilirë të romanizuar, të cilët u bashkëshkrinë me këta të fundit, përkatësisht në sllavë.”

Përfundim

Nga sa u tha me lart ka shumë arsye që Dardania e lashtë të mbahet për vend të formimit të gjuhës shqipe e të etnisë shqiptare po aq sa edhe hapësira që sot e zë shteti i Shqipërisë.

Kjo teze nuk është e politizuar. E kishte politizuar sistemi monist i Shqipërisë që donte të ruante harmoninë e taborit të Internacionales Komuniste e jo dijetarët e pavarur indoeuropeistë të Perëndimit të Europës e ata kosovarë që u mbështetën tek ajo tezë.

Rrethana e konstatuar njëherë e mirë që sllavët e ardhur gjetën e vazhduan emra qytetesh të mëdha, liqenesh e lumenjsh të mëdhenj nga goja e shqipfolësve pikërisht në hapësirat e Dardanisë është, për mendimin tim, dëshmi po aq bindëse dhe e rëndësishme në të mirë si të prejardhjes ilire të dardanëve ashtu edhe të autoktonisë së shqiptarëve në Dardani, aq sa edhe kontinuiteti shqiptar i toponimeve, oronimeve e hidronimeve pararomake të territorit të Shqipërisë së sotme.

Valter MEMISHA

QASJE PËR DISA RIARDHJE TË DITËVE TË SOTME NË LEKSIKOGRAFINË SHQIPTARE

Leksikografia e shqipes ka një moshë gati 400-vjeçare dhe një fond të vyer me rreth 500 fjalorë, hartimi dhe botimi i shumicës së të cilëve u përket 60-70 vjetëve të fundit. Ky fond përfshin fjalorë njëgjuhësh e dy- a më shumëgjuhësh dhe për këta të fundit leksikografia jonë mund të krahasohet me ato të vendeve tepër të zhvilluar, evropiane a më gjerë.

Dhjetëvjeçarin e fundit, në gjuhësinë shqiptare kemi ardhjen e shumë veprave shkencore të dinjitetshme, vepra kolektive a vetjake, monografike a përmbledhje studimesh. Një pjesë e madhe prej tyre janë vepra leksikografike. Në këtë shumësi të tërheq vëmendjen ardhja / riardhja e disa veprave të traditës, d.m.th. botimi a ribotimi i fjalorëve të hartuar para shumë vjetësh, madje edhe para disa shekujsh. Tipologjikisht botimet e tilla mund të jenë disa llojesh: botime anastatike, integrale, kritike, përktimore etj. Ardhja / riardhja e një veprave shkencore të tillë, edhe pse e ka parë më parë dritën e botimit, është ngjarje. Përse?

1. Veprat e riardhura ripohojnë vlerat që mbartin, gjurmët e kohës kur janë hartuar, nivelin dhe gjendjen e leksikografisë sonë një prerje të caktuar.

2. Veprat e riardhura tregojnë rrugën në të cilën ka ecur leksikografia shqiptare njëgjuhëshe e dygjuhëshe, si dhe vetë shkenca e mendimi gjuhësor shqiptar.

3. Veprat e riardhura shfaqen si gjendje gjuhësore, mbi të cilat mund e duhet të kryhen punime që u përkasin të gjitha rrafshëve. Tipologjia e ribotimit të disa prej veprave që kemi në duar, e pohojnë fuqishëm këtë vlerë, sidomos botimet kritike dhe ato integrale.

4. Veprat e riardhura i bëjnë thirrje botës akademike dhe asaj universitare (por edhe më gjerë) që procesi i botimit / ribotimit të jetë i pandërprershëm, i organizuar dhe një nga drejtimet kryesore të kërkimeve e të studimeve gjuhësore.

Po japim disa nga veprat më në zë, të ardhura / të riardhura kohët e fundit, së shumti përmes një qasjeje paraqitëse, informuese:

A. Së pari, këtë fillimshkull kemi riardhjen në një formë a në tjetrën të disa fjalorëve njëgjuhësh, përkatësia kohore e hartimit dhe e botimit të parë të të cilëve lidhet me shekullin XX. Duke ruajtur kronologjinë e riardhjes së tyre, përmendim:

Në vitin 2002, ribotohet *Fjalori i shqipes së sotme*, i ripunuar pjesërisht dhe i përditësuar, gjatë disa vjet pune nga një grup leksikografësh profesionistë (J. Thomai, M. Samara, J. Kole, P. Haxhillazi, H. Shehu, Th. Feka, K. Sima), të cilët

kanë qenë pjesëtarë të grupit hartues të botimit të parë Fjalorit, më 1984¹. Vepra e ribotuar synonte t'u përgjigjej kërkesave dhe detyrave që shoqëria dhe gjuhësia shqiptare shtronte në fund të shekullit të kaluar (fillimi i ripunimit dhe i përditësimit daton vitin 1996) për kodifikimin e zhvillimeve më të reja leksiko - semantike. Ky fjalor, sipas *Parathënies*, vetjakësohet për *pasurimin e korpusit me fjalë dhe kuptime te reja*, të cilat kanë tashmë përdorim të përgjithshëm dhe mungojnë në botimin e parë, sidomos ato që lidhen me koncepte të reja për sistemin e ri demokratiko - pluralist, të vendosur në Shqipëri në vitet '90 të shekullit të kaluar; vetjakësohet për *përmirësimin e shpjegimeve e të përkufizimeve të fjalëve dhe termave*, duke i shkarkuar nga ngarkesat e panevojshme a ngarkesat me karakter politizues dhe ideologjizues; *për harrjen e një pjese të vogël të frazeologjisë etj.*² Për ardhjen e këtij botimi, ndër të tjera, kemi një punim kritik serioz nga studiuesi M. Çeliku³.

Në vitin 2005, nga Shtëpia botuese "Çabej", ribotohet *në mënyrë anastatike Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954, e para vepër kolektive kombëtare, hartuar nga personalitete shkencore më në zë në gjuhësinë shqiptare të asaj kohe: K. Cipo, E. Çabej, O. Myderizi, A. Krajni. Njihen tashmë vlerat e këtij fjalori, për të cilin ka shumë punime serioze nga mendimi e kritika shkencore, duke pohuar e ripohuar qasje vlerësuese. Vepra kishte dhjetëvjetësha të tërë që u mungonte bibliotekave, studiuesve e studentëve, por edhe dashamirësve të kulturës kombëtare e qytetarëve të thjeshtë. Ardhja e saj si ribotim shënoi përsëri ngjarje. Veç lëndës së vitit 1954, Fjalori përdhet edhe me një Fjalë nga studiuesja Ledi Shamku, në të cilën jepen vlerat dhe vendin që ai zuri në fondin e veprave madhore të kulturës sonë, por edhe me synimin për të pohuar vlera të reja dhe për të rivlerësuar ato që, sipas saj, ishin anashkaluar apo sa ishin cekur më parë, sidomos në vitet '50-'80 të shekullit të kaluar.

Dhjetëvjeçari i parë i shekullit XXI njihet riardhjen e dy veprave të tjera në fushën e leksikografisë njëgjuhëshe të traditës. Në vitin 2006 botohet Fjalori i Pano Tases, me titullin *Fjalor dialektor (me fjalë dhe shprehje nga Jugu i Shqipërisë)*, jo si *botim anastatik*, por si *botim integral* i Fjalorthit të Ri, 1942. Vepra është një prurje tjetër nën kujdesin e studiueses L. Shamku, dhe ngërthen brenda një *Parathënie* (35 faqe) "Fjalori që këndon", hartuar nga kjo studiuese dhe *lëndën gjuhësore* të vjelë nga P. Tase, të strukturuar në dy pjesë: pjesa e parë: fjalësi dhe shpjegimet; pjesa e dytë: urime, ngushëllime, mallkime, fjalë fyese, përkëdhelëse, lutëse kanosëse, si dhe cilësime, krahasime dhe epitete njerëzish, kafshësh e ngjyrash; frazeologji popullore e folklorike, proverba e gjëgjëza, përdorime gjuhësore për zbavitje; raste shumëfish emërorë, çerdhe fjalësh me prapashtesim, emra përmbledhës dhe shprehje ndajfoljore me përsëritje si dhe emërtesa vepërimtarish e zejesh të ndryshme.⁴

Fjalori integral (nëse pranohet një term të tillë) i vitit 2006, tashmë më i plotë dhe me lëndë të re (ai ngërthen gati shterueshëm gjithë punën gjuhësore të P. Tases),

¹ *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002

² Shih më gjerë, *Parathënie e botimit të dytë*, në "Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë, 2002.

³ M. Çeliku, "Fjalor i shqipes së sotme", 2002, dhe *leksikografia shqiptare e ditëve të sotme*, në "Çështje të shqipes standarde", Tiranë, 2009, f. 336 - 362

⁴ P. Tase, *Fjalor dialektor (me fjalë dhe shprehje nga Jugu i Shqipërisë)*, Çabej, Tiranë, 2006

nëse përqaset me lëndën e botimit të parë, të vitit 1942, është mirëpritur dhe mbi të janë ndërmarrë studime të ndryshme.

Katër vjet më vonë, në vitin 2010 (nisur më 2005) po nën kujdesin e studiueses Ledi Shmaku, del si *botim anastatik*, *Fjalorthi i ri (fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnisë*, hartuar nga D. Nikoll Gazulli. Vepra i jepet përdoruesit me ndryshime në ballinë me emërtimin Fjalori i Gazullit (nuk e dimë përse i është larguar titulli të originalit të vitit, 1942, në një kohë kur është botim anastatik) dhe më një Parathënie prej Ledi Shamkut, *Fjalori i Gazullit dhe gegneshitja e papërmbushur*. Vepra është mirëpritur, sidomos në rrethet shkencore e universitare. Edhe rreth saj janë ndërmarrë studime të ndryshme dhe ajo po zë vendin, gati të mohuar, si një nga fjalorët më të arrirë njëgjuhësh të traditës leksikografike shqiptare, sidomos për pasqyrimin shkencor të terminologjisë (duke dhënë edhe emërtimet në latinisht), çka e bën këtë fjalor model pune edhe sot.

Një ngjarje shkencore, në kuptimin më të mirëfilltë të kësaj fjale, ka qenë ardhja në shqip i *Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe* të G. Majerit (botimi i parë më 1891), i përkthyer nga studiuesja Anila Omari. Fjalori përcillet te përdoruesi me një *Parathënie të botimit shqip* nga studiuesi Seit Mansaku dhe me *Shënimet e përkthyesit*⁵. Vepra i mungonte, në këtë lloj formati, gjuhësisë shqiptare. Fjalori i G. Majerit, siç thotë Seit Mansaku “me gjithë vlerat e jashtëzakonshme të tij, është një vepër e kohës së tij, si për nga kriteret që përdori dhe zbatoi në studimin etimologjik të shqipes, si për lëndën e shqipes që ka përfshirë në të, për shkallën e njohjes së saj dhe për përfundimet që ka nxjerrë lidhur me përbërjen e leksikut të kësaj gjuhe pas analizave etimologjike”.⁶ Megjithatë dihet vendi, roli dhe pesha që ka luajtur ky Fjalor në studimet tona të gjithanshme, sidomos ato të historike.

Në ardhjen cilësore shkencore të Fjalorit, meritë ka dhe përkthyesja gjuhëtare Anila Omari, e cila njihet mirë jo vetëm gjermanishten dhe gjuhë të tjera që ka përdorur autori për shpjegimin fjalëve të shqipes, ose të fjalëve të tjera që sillen për krahasim, por edhe lëndën e etimologjisë. Në këtë mënyrë ajo ka qenë në gjendje t’i transmetojë lexuesit shqiptar përmbajtjen, formën dhe frymën e veprës së autorit. Ka qenë për përkthyesen një punë e imtë dhe e vështirë profesionale gjetja e kuptimeve të rralla e të vjetra, ngjyrimet e tyre dhe transkriptimi i saktë i fjalëve *lema*, zbërthimi i shkurtimeve të ndryshme, interpretimi fonetik i shenjave grafike etj.⁷

B. Së dyti, këtë fillimshkull kultura jonë kombëtare njohu disa ardhje të spikatura të veprave që kanë zënë vend të rëndësishëm në traditën e leksikografisë dygjuhëshe:

Në vitin 2006, me rastin e 400-vjetorit të lindjes së Frang Bardhit, Shtëpia botuese “Çabej”, bën një tjetër botim të fjalorit të parë të shqipes, që kemi në dorë deri më tani. Studiuesit dhe jo vetëm ata, sidomos ata kosovarë, kishin në dorë botimin anastatik, *Frang Bardhi Fjalor latinisht – shqip* të realizuar në vitin 1983 në Prishtinë nga Shtëpia botuese Rilindja, përgatitur për botim dhe pajisur me një

⁵ G. Meyer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, 1891*, Çabej, Tiranë, 2007

⁶ S. Mansaku, *Parathënie e botimit shqip*, në “Gustav Meyer, Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, 1891”, Çabej, Tiranë, 2007, f. 9

⁷ S. Mansaku, *Parathënie e botimit shqip*, në “Gustav Meyer, Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, 1891”, Çabej, Tiranë, 2007, f. 13

studim të hollësishëm (63 faqe) nga Engjëll Sejda⁸. Edhe botimi i Shtëpia botuese “Çabej”, i menduar fillimisht si një botim mekanik, është *anastatik*. Por vepra, që në ballinë vjen ndryshe nga botimi i Prishtinës. Ajo është më pranë origjinalit, sepse ruan pak a shumë emrin e hartuesit dhe emërtimin e veprës më 1635: Franciscus Blanchus *Dictonarium latino - epiroticum*. Nëse botimi i Prishtinës veç Parathënies (në fund të së cilës vijnë edhe 113 proverba në shqip) dhe lëndës anastatike, ka edhe Fjalorin shqip-latinisht të nxjerrë nga vepra (një punë e admirueshme e E. Sejda), “Dictonariumi” i 2006, ka në brendësi një Parashtresë a një fjalë përcjellëse të veprës nga studiuesja L. Shamku që e sheh veprën si “rojë e continuum-it tonë kombëtar”, *Parathënien* e Mario Rokut (Mario Roques) të botimit anastatik frëng të vitit 1932, e cila është përkthyer prej Èilly Kasmit dhe *lëndën anastatike* prej 223 faqesh⁹.

Në vitin 2008, në kolanën “Botime françeskane”, studiuesi Bardhyl Demiraj sjell një punim të vetin që ka në qendër po këtë vepër, ardhur po në mënyrë anastatike (autori pëlqen termin *riprodhim fotografik*)¹⁰. Punimi vetjakësohet si model i punës shkencore filologjike mbi një vepër të traditës. Vepra, ashtu si botimi i anastatik i Shtëpisë botuese “Çabej”, ka në brendësi, *Hyrjen* e botimit të parë anastatik, të hartuar nga Mario Roques e të përkthyer nga Èilly Kasmi, por pa shtojcat e këtij përkthyesi dhe me dy shtojca të reja të B. Demiraj: *Vërejtje shtesë rreth grafisë së tekstit*, *Vërejtje rreth botimit kritik të tekstit shqip*. Mandej vjen *Fjalori*, i cili është paraqitur teknikisht: në faqen e majtë jepet *botimi fotografik* (në një kolonë), kurse në faqen e djathtë (në dy kolona) jepen *riprodhimi diplomatik i zgjeruar* dhe *botimi kritik*. Mandej vijnë 222 *shënime*, që ftillojnë dukuri *grafemore*, *fonetike*, *gramatikore*, *leksikore semantike*. Në vijim, në 184 faqe jepen *konkordanca leksikore*. Punimi ka indeksin e fjalëve shqip të fjalorit, me gjeqjësën në shqipen standarde, dhënë alfabetikisht, duke bërë grupime në tri fusha: *fondi leksikor*, *toponime dhe hidronime*, *emra njerëzish dhe qeniesh mitologjike*. Punimi është pajisur dhe me *shkurtime*, *simbolet* e *literaturën shkencore*.

Fillimi i shekullit XXI e pasuron kulturën kombëtare shqiptare me tri ardhje / riardhje leksikografike nën kujdesin e N. Stylos, *personalitet* me prurje interesante e të mirëpritura, edhe pse shpesh të debatueshme e të diskutueshme. N. Stylos njohës i shumë alfabeteve, sidomos i atyre që lidhen me arealin gjeografik të Epirit të vjetër, mëton të sjellë të lexuesi shkencor dhe joshkencor lëndë gjuhësore dhe këndvështrime të reja.

Në vitin 2007, ky studiues boton *integralisht Fjalorin e M. Boçarit*¹¹. Vepra kishte njohur një riardhje më 1993, si botim kritik (jo *anastatik*) nga njëri prej personaliteteve më në zë të botës arvanitase e të kulturës shqiptare sot, Tito Johallas, me titulline origjinalit *Μαρκου Μποτσάρη, Λεξικόν της Ρωμαϊκής και Αρβανιτικής*

⁸ Frang Bardhi, *Fjalor latinisht – shqip*, Prishtinë, Rilindja, 1983

⁹ Franciscus Blanchus, *Dictonarium latino-epiroticum*, Çabej, Tiranë, 2006

¹⁰ B. Demiraj, *Dictonarium latino-epiroticum* (Romæ 1635) *per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime françeskane, Shkodër, 2008

¹¹ N. Stylos, *Fjalori i Marko Boçarit*, Arbëria, Tiranë, 2007

απλής, Εκδόσεις Τ. Γ¹², Ky botim i drejtohej përdoruesit greqishtfolës, por ka shërbyer si burim kryesor për botimin e N. Stylos.

Merita e N. Stylos, për këtë vepër dhe për ato që do të shohim në vijim, ndër të tjera, qëndron se ai botimet / ribotimet e fjalorëve të traditës ku greqishtja është gjuhë e parë, ii sjell për mjedisin shqipfolës. N. Stylos ka bërë një punë të mirë, për të ruajtur origjinalin dhe për ta bërë fjalorin “miqësor” me përdoruesin e studiuesin. Vepra ngërthen në brendësi të saj një *Parathënie* me 134 faqe nga ky studiues (që mund të shihet si një trajtesë teorike e gjerë për shqipen dhe vlerat e fjalorit). Mandej vjen pjesa e dytë me emërtimin *Dorëshkrimi i M. Boçarit, botim anastatik* i ndërthurur me atë kritik. Siç thotë N. Stylos aty “jepet fotokopja e tekstit në dorëshkrim e Fjalorit të M. Boçarit dhe, përbri, mënyra e drejtë e shkrimit në greqisht, si dhe shkrimi i drejtë në *arvanite*, sipas *alfabetit toskë* me germa latine. Pjesa e tretë, *Fjalor greqisht – arvanite e thjeshtë* është botimi kritik i fjalorit ku jepen edhe numri i faqeve për fjalët e pasqyruar në origjinal. Puna e Stylos në këtë botim vlerësohet edhe për pajisjen e veprës me *Fjalorin arvanite – greqisht*, që formon pjesën e katërt të veprës dhe si dhe për pjesën e pestë *Fjalë të dialektit të greqishtes së Epirit* (studiuesi veçon 206 lema). Fjalori i M. Boçarit ka vlerat e veta, edhe pse nuk është vepër leksikografike e mirëfilltë, sepse hartuesi i tij nuk synoi të hartonte një fjalor dygjuhësh shqip - greqisht, por më shumë një metodikë për mësimin e greqishtes nga popullsia shqipfolëse e Korfuzit dhe më tej, në territorin helen.

Në vitin 2011, po prej Niko Stylos sheh dritën e botimit, në formë integrale, një tjetër vepër përfaqësuese e historisë së kulturës sonë: *Fjalori katërgjuhësh i Daniil Voskopojarit*¹³, vepër që ashtu si Fjalori i M. Boçarit, nuk është fjalor i mirëfilltë, por një metodë për mësimin e gjuhëve të huaja për qëllime praktike. Botimi që kemi në dorë është shumëpërmasor. Ai përfshin së pari një *Hyrje* nga N. Stylos, të cilën e ndjek botimi anastatik jo i Fjalorit origjinal, të hartuar e të botuar më 1770, por i botimit të dytë të vitit 1802 (në përbërje të librit *Hyrje në mësimdhënie*) me titull *Fjalori katërgjuhësh i katër dialekteve popullore apo të romejes së thjeshtë, vllahishtes së Moisisias, të bullgarishtes dhe të shqipes* (fotokopjimi, 36 faqe dhe 1072 fjalë, shoqërohet me numrin e faqes për fjalët). Pas kësaj vjen kreu *Alfabetet epirote*, në të cilin krijohen hapësira interpretuese e argumentuese që do të shfrytëzohen pjesët e tjera të botimit integral, sidomos në botimin kritik me titullin *Tabelë krahasuese tekstesh greqisht dhe shqip*, në të cilën jepen 1235 fjalë, në tri kolona në secilën gjuhë, duke përqasur në mënyrë kritike tekstin - fjalor të vitit 1802, tekstin e Papa-Nastasit dhe atë të Ë. M. Leak-ut. Pjesa e fundit të librit të botuar prej N. Stylos përfshin fotokopjet e tekstit – fjalor të Fletores së Papa-Nastasit, por vetëm ndy gjuhë: greqisht dhe shqip.

Kështu, *Fjalori* i Daniil Voskopojarit, 2011 nuk është thjesht një qasje në shekullin e ri të një veprë që mungonte në bibliotekat tona të punës. Si një punim përfshirës i botimeve e ribotimeve të Fjalorit në një udhëtimin mbi 250-vjeçar, herë si vepër e plotë e herë në përbërje të punimeve të studiuesve a albanologëve të

¹² T. Γιοχάλας, Μαρκου Μποτσάρη, Λεξικόν της Ρωμαϊκής και Αρβανιτικής απλής, Εκδόσεις Γιοχάλα, Αθήνα, 1993

¹³ N. Stylos, *Fjalori katërgjuhësh të Daniil Voskopojarit*, Arbëria, Tiranë, 2011

ndryshëm, ai shpërfaq edhe përjasje krahasime, plotësime, korigjime dhe vlerësime. Ardhja e veprës në përmasa me kwto pwrmasa, nderon studiuesin N. Stylos për punën e kryer, por, njwherzai pasuron kulturën tonë kombëtare bashkëkohore dhe lehtëson punën e studiuesve.

Po në vitin 2011, N. Stylos, boton në Tiranë *Fjalorin greqisht - shqip* të Panajot Kupitorit (*To Έλληνο - Αλβανικό*)¹⁴. Bota shkencore kish njohur, në shekullin që lamë pas, botimin e kësaj vepre në Athinë, një punë e jashtëzakonshme dhe me akribi shkencore e bërë nga Tito Johallas¹⁵. Duhet të themi se botimi i vitit 2011 ka në bazë këtë botim. Por ndryshe nga botimi i studiuesit T. Johallas, ku fjalët e të dyja gjuhëve janë përgjithësisht në greqisht, prurja shkencore e N. Stylos del më në pah, sepse jo vetëm e adreson Fjalorin te përdoruesi shqipfolës, por ka bërë një punën të vlerësueshme për të transkriptuar me alfabet latin a, më saktë, me alfabetin e shqipes së sotme, fjalësin shqip të fjalorit. Lënda e veprës së P. Kupitorit tashmë vjen në dy forma lehtësisht të përqasshme: në një kolonë jepet *fjalori greqisht – shqip*, përgjithësisht me shkronja greke, sipas Fjalorit të botuar prej T. Johallasit dhe në kolonën tjetër jepet *fjalori greqisht- shqip* me alfabetin e shqipes, por edhe me gjetje të reja grafemore, që t’u përgjigjen tipave tingullorë të shqipe. Kjo përbën edhe ana më të spikatur të veprës dhe të punës së N. Stylosit.

Ngjarje vëmendjetërheqëse në jetën shkencore leksikografike, por edhe më gjerë, vitet e fundit krijoi edhe botimi kritik më 2009 prej Gëzim Gurgës i *Fjalorit shqip – italisht* të Da Leçes (At’ Francesco Maria Da Lecce O.F.M. *Dittionario italiano – Albanese*, 1702), nën kujdesin e Bibliotekës françeskane “At’ Gjergj Fishta”, Kolona e shkrimtarëve françeskanë¹⁶. Vepra origjinale nuk arriti të shtypej të dilte si botim, ajo mbeti thjesht mbeti dorëshkrim. Ajo është riprodhuar (kopjuar) disa herë nga nxënësit e kolegjit San Pietro Motorio. Vepra, si botimi kritik nga G. Gurga, vjen në formatin e ri pas 300 e ca vjetwsh dhe strukturohet në tri pjesë: *Hyrje* (rreth 80 faqe), hartuar nga G. Gurga, e cila është një studim i mirëfilltë shkencor dhe me vlera të verifikuara, *Teksti kritik* dhe *Fjalësi shqip*. Vepra ka një edhe *Parathënie*, ku bëhet me dije se botimi kritik është pjesë e një projekti të Universitetit të Palermos, “që parashikon, ndër të tjera, botimin kritik të gjithë veprave të mbetura në dorëshkrim ndër arbëreshët e Sicilisë, siç janë, sa për të përmendur ato më të rëndësishmet, *Fjalori italisht - shqip* dhe *Fjalori etimologjik*, hartuar nga Nikollë Keta, variantet e ndryshme në dorëshkrim me *fjalorë italisht - shqip* e *shqip - italisht* të familjes Dara etj. Edhe pse Da Leçe këtë Fjalor e shkroi për vetëve (Gurga shprehet se Da Lecce e shkroi fjalorin për misionarët italianë që shërbenin në Shqipëri), botimi kritik që kemi në dorë, mundëson studime të gjithanshme, gjuhësore e jashtëgjuhësore, por së pari leksikore e semantike, sepse Fjalori përmban “një pasuri leksikore që nga përmasat, gjerësia dhe larmia i tejkalon

¹⁴ N. Stylos, *To Έλληνο - Αλβανικό*
shqip i Panajot Kupitorit, Tiranë, 2011

¹⁵ *To Έλληνο - Αλβανικό*
γλώσσα, Αθήνα, 2006

¹⁶ At’ Francesco Maria Da Lecce O.F.M., *Dittionario italiano – Albanese*, 1702, botim kritik nga G. Gurga, Shkodër, 2009

ndjeshëm synimet didaktike të shpallur nga autori, madje mund të themi pa frikë se *e vetme* kjo vepër dëshmon një leksik shumë më të gjerë dhe shumë më të pasur se ai që përmbajnë të gjitha veprat e traditës së vjetër shkrimore të marra së bashku”.¹⁷

Këto ishin disa nga veprat leksikografike të riardhura kwta 10 vjetwt e fundit, që menduam të veçonim për këtë veprimtari shkencore mbarëkombëtare, që përkon edhe me 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Ato me shumësinë dhe plotësinë e vlerave që mbartin, e kanë zënë vendin e tyre në kulturën tonë. Të tjera vepra gjuhësore, jo vetëm leksikografike, të hartuara nga albanologë të huaj a shqiptarë, sidomos ato të hartuara para Luftës së Dytë Botërore, janë në proces ardhjeje a presin për të ardhur në duart e studiuesve.

¹⁷ At’ *Francesco Maria Da Lecce O.F.M., Dittionario italiano – Albanese, 1702*, botim kritik nga G. Gurga, Shkodër, 2009, f. 39

Shefkije ISLAMAJ

LEKSIKOGRAFIA SHQIPE NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË

Çka mund të thuhet në këtë përvjetor të madh për zhvillimin e leksikografisë shqipe në pak rreshta. Sigurisht fare pak. Për këtë arsye nga një vështrim dukshëm i gjerë janë nxjerrë disa përfundime të përgjithësuara me përpjekjen që ato të përfushin sado pak objektivin e kësaj kumtese.

E para. - Gjuhësia shqiptare e shekullit 20 u zhvillua shkallëshkallshëm në pajtim me zhvillimin shoqëror-politik, në pajtim me proceset shoqërore-politike e ekonomike që e kanë karakterizuar shoqërinë shqiptare në përgjithësi përgjatë një shekull pavarësie. Zhvillim të përshpejtuar ajo e njuh në gjysmën e dytë të shekullit 20. Arsyet e shpërpjesëtimit të këtij zhvillimi nuk janë të natyrës shkencore, por janë, para se gjithash, arsye historike dhe shoqërore-politike. Shekulli 20 është shekulli i ngjarjeve të mëdha për kombin shqiptar dhe, rrjedhimisht, për gjuhësinë shqiptare.

E dyta. - Gjuhësia shqiptare, prandaj, është relativisht e re, konsolidimi i saj është pak a shumë i vonshëm në raport me ato të gjuhëve të tjera evropiane. Njëqind vjet të gjuhësisë shqiptare, të sistemuar e të vendosur në rrugë të mbarë vetëm këtu e më pak se 70 vjet, nuk kanë mjaftuar për trajtimin e aq shumë problemeve që lidhen me gjuhën shqipe, me historinë e strukturën e saj, me korpusin e me ligjërimin shqip. Detyra të mëdha në kushte të kufizuara, shkëputja nga tradicionalja dhe nxitimi nga bashkëkohorja - janë vetëm disa nga karakteristikat e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare. Po rikujtojmë se kur në gjuhësinë shqiptare po vendoseshin fillimet e studimit institucional, në Evropë gjuhësia moderne, e filluar me strukturalistët dhe pak më pas me Shkollën e Pragës, po mbushte katër dekada dhe tashmë ishin formuar edhe shkolla të tjera, ndërsa shumësia e ideve të reja në shumë fusha gjuhësore kishte përmbysur shumëçka të ndritshme të shekujve pararendës të traditës së pasur të hulumtimit e të studimit të problemeve të gjuhës e të gjuhëve në përgjithësi

Megjithatë, do të ishte plotësisht e padrejtë të mos spikateshin rezultatet mëdha të arritura në gjuhësinë shqiptare për një shekull në shumë fusha të dijes gjuhësore.

E treta. - Shekulli 20 është shekulli i studiuesve shqiptarë. Puna e madhe dhe rezultatet e arritura shkencore nën drejtimin e prijatarëve tanë – Aleksandër

Xhuvani, Eqrem Çabej, Kostaq Cipa, Selman Riza, Mahir Domi, Shaban Demiraj dhe e studiuesve të brezit të dytë e të tretë, bënë që të vihen themelet e një gjuhësie bashkëkohore, e cila do të formësojë qartë detyrat e kohës dhe do të përvijojë rrugën për studime të pandalshme në të gjitha fushat e albanologjisë gjuhësore.

E katërta. - Gjuhësia shqiptare që prej fillimeve të saj ka qenë, para së gjithash, shkencë mbi gjuhën shqipe, dhe kjo vazhdon edhe sot, edhe pse ndërkohë, brenda saj, janë zhvilluar më shumë a më pak edhe degë të tjera të gjuhësisë, natyrisht zhvillime këto të kufizuara e të kushtëzuara nga shumë faktorë e nga shumë rrethana. Veçantitë e zhvillimit të saj përgjatë një shekulli, po kështu, janë përcaktuar nga zhvillimi i përgjithshëm i shkencës shqiptare dhe i albanologjisë në përgjithësi. Shumësia dhe larmia e teorive dhe e metodologjive bashkëkohore linguistike nuk i kanë shkuar për shtati kërkesave reale të gjuhësisë shqiptare për arsyet e mirënjohura. Mund të thuhet se në tre dhjetëvjetëshat e fundit ka pasur përpjekje që këto teori e metodologji të modifikohen e t'i përshtaten lëndës gjuhësore të shqipes. Nëse përgjatë shtatëdhjetë vjetëve kanë mbizotëruar studimet etimologjike, dialektologjike e onomastike, studimet mbi strukturën fonetike, morfologjike e sintaksore, studimet e dhjetëvjetëshave të fundit do të shtrojnë edhe çështje semasiologjike, çështje të gjuhësisë së tekstit, të gjuhësisë kontekstuale, të analizës së diskursit, të pragmatikës, të teorisë së aktit ligjërimor, të sociolinguistikës, e të tjerat më pak; përgjatë dhjetëvjetëshave të fundit mbizotërojnë studimet mbi gjuhën standarde dhe kulturën e gjuhës; hetohet rritje e interesimit për studimet, bazën empirike të të cilave në rend të parë e përbën lënda gjuhësore e shqipes; por hetohet edhe mungesë e lidhjes së qëndrueshme teoriko-metodologjike, e lidhjes me ndonjë shkollë a drejtim të caktuar linguistik. *Në këto procese zhvilluese leksikografia zë vend të rëndësishëm, dhe sa vjen e zgjeron rrethin e interesimit të gjuhëtarëve dhe të studiuesve të tjerë.*

E pesta, ngritja e instituteve a institucioneve shkencore albanologjike në vitet 50 të shekullit të kaluar ishte nxitje tepër e rëndësishme për zhvillimin e një veprimtarie të organizuar, të pasur e të gjerë e krahas saj edhe për përgatitjen e kuadrit për shumë fusha të dijes gjuhësore në veçanti për leksikografinë. Siç na është e njohur gjuhësia shqiptare ka trashëguar nga e kaluara një trashëgimi modeste studimesh albanologjike dhe veprash leksikografike të kryera kryesisht nga studiues të huaj që kanë meritën e pamohueshme në këto studime (Bopi, Mikloshiqi, Pedersen, Majeri, Jokli e të tjerë), ndërsa tashmë kishte ardhur koha që këto studime t'i merrnin në duar studiuesit shqiptarë dhe t'i çonin më tej bashmë me profilizimin e tyre.

E gjashta. - Në fillimet e veta gjuhësisë shqiptare i ra hise më shumë të shtronte detyra sesa t'i realizonte e t'i zgjidhte ato. Do të duhej të kalonin disa dhjetëvjetëshat që ajo të merrte përpjetën e vet e të konsolidohej si shkencë me vete me objekt të qartë e me metodologji të mirëfilltë shkencore. Gjuhësia shqiptare

kishte detyrat dhe përgjegjësitë jo vetëm të vlerësimit të trashëgimisë modeste të studimeve shqiptare, brenda tyre edhe të trashëgimisë leksikografike, por edhe të plotësonte kërkesat e reja e të ngutshme të arsimit e të kulturës shqiptare – me tekste bazë gjuhësore për të gjitha nivelet e arsimit shqiptar dhe të fillonte të shtrinte kërkimet shkencore edhe në fusha të reja e të pastudiuara deri atëherë. Të kësaj moshe mund të konsiderohen si shkenca të mëvetëvetësishme fonetika, gramatika dhe leksikologjia shqipe. Kështu studimet e gramatikës kanë ecur krahas studimeve në fushën e historisë së gjuhës dhe të dialektologjisë. Hov marrin më pas edhe semantika e stilistika. Gjuhëtarët tanë dhanë ndihmesën në hartimin e rregullave të drejtshkrimit. Studiuesit Xhuvani, Çabej, Kostallari, Domi e Lafe bartën peshën e përgjegjësinë e madhe në këtë drejtim. Krahas drejtshkrimit dhe problemeve të tjera që lidhen drejtpërdrejt me problematikën e drejtshkrimit, normativistika shqiptare, ka qenë objekt i shumë studimeve dhe botimeve të veçanta, përfshirë këtu edhe terminologjinë e leksikonit. Gjuhësia shqiptare kishte nevoja të mëdha edhe në fushën e leksikografisë. Mbi traditën e pasur leksikografike e me angazhimin e madh të prijtarëve tanë Xhuvani, Çabej, Kostallari e Domi u ndërtua Kartoteka e leksikut me mbi katër milionë skeda, mbi të cilën kartotekë do të nisë fazë e re e hartimit të fjalorëve të gjuhës shqipe, e fjalorëve terminologjikë dhe e atyre dygjuhësorë. Rezultate të mira u arritën në të gjitha këto fusha dhe ato u materializuan me botime të veçanta, për t’u zgjeruar e plotësuar deri në ditët tona. Merita e nismës dhe e zhvillimit të këtyre studimeve u takon studiuesve shqiptarë që punuan me zellin e rilindasve duke pasur përgatitjen e duhur, gatishmërinë e pashoqe dhe sakrificën e rrallë. Në këtë 100 vjetor nderimi e mirënjohja për zhvillimin e gjuhësisë shqiptare deri në shkallën që e bëjnë atë të krahasueshme me gjuhësinë rajonale u shkojnë një numri të madh studiuesish shqiptarë brenda e jashtë Shqipërisë dhe studiuesish të huaj. Më vjen keq që po lë pa përmendur emrat e më të merituarve në këtë mes.

E shtata. - Brenda gjuhësinë shqiptare mund të thuhet u krijua një “shkollë leksikografike shqiptare” në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, në aspektin teorik e praktik. Por, a mund të thuhet se leksikografia shqiptare sot përcjell zhvillimin gjuhësor të shqipes, se përcjell zhvillimin e shumanshëm e të shumëfishtë kulturor e ekonomik në përmasën shqiptare dhe në përmasën botërore? Dhe më tej: a mund të thuhet se leksikografia shqiptare, në rrethanat e reja, para gjithë kësaj shumësie ideore e nocionore, objektore e konceptore që shprehet në jetën e kombit e në gjuhën e tij, është shprehëse e mirëfilltë e saj? Mendoj se një përgjigje mund ta japim e ajo është: Leksikografia shqipe qëndron brenda rrjedhave të leksikografisë evropiane si me metodologjinë e parimet hartuese, ashtu edhe me synimet e realizimet në këtë rrafsh, ndonëse duhet ta pranojmë se hetohet një shpërpjesëtim i vërejtshëm më shumë sasior e në llojllojshmëri, sesa cilësor, në raport me të. Ngecja ka të bëjë më shumë me fjalorët gjuhësorë sesa me ata specialë. Kur them kështu kam parasysh

sidomos mungesën e fjalorit të mbarë shqipes dhe pasurimin substancial e strukturor të FGJSSH, si dhe hartimin e botimin e fjalorëve të veçantë terminologjikë.

E teta. - Kur analizohet zhvillimi i leksikografisë shqipe duhet të thuhet edhe kjo: asnjë leksikografi nuk mund t'i bëjë ballë kërkesave të kohës me punë individuale. Puna ekipore e leksikografëve shqiptarë i ka sjellë gjuhësisë shqiptare fjalorë të vlefshëm, duke filluar me FGJSSH e me një numër të konsiderueshëm fjalorësh terminologjikë e fjalorësh të veçantë. Fatkeqësisht leksikografia e dhjetë-vjetëshit të fundit ka tregues më shumë punën individuale sesa atë kolektive. Ajo që duhet të bëhet në këtë drejtim, prandaj, është bashkërendimi i punëve në shkallë kombëtare, institucionale e individuale. Hartimin e fjalorëve me rëndësi të madhe kombëtare e gjuhësore nuk duhet t'ia lëmë vullnetit e entuziazmit individual. Duhet ta kemi një makroprojekt afatgjatë të planifikuar bashkërisht dhe me strategji të mirë të punës e të përparësive leksikografike. Pse e them këtë? E them sepse kërkesat për fjalorë të rinj dhe për pasurimin e përsosjen e atyre ekzistues janë të mëdha.

E nënta. - Zhvillimi i hovshëm i leksikografisë botërore i detyrohet zhvillimit të leksikografisë kompjuterike. Leksikografia shqipe duhet të modernizohet, kjo domethënë duhet të kompjuterizohet. Integrimi i shqiptarëve në rrjedhat e sotme evropiane duhet të bëhet edhe përmes fjalorëve. Leksikografia jashtë teknologjisë kompjuterike nuk mund të quhet e modernizuar, prandaj zhvillimi i leksikografisë elektronike në mënyrë institucionale duhet të bëhet prioritet në shkencën shqiptare. Gjuhët e popujve të zhvilluar tashmë janë futur në garë për integritet të tilla. Standardizimi dhe njësimi sidomos i terminologjisë në fusha të caktuara me interes për integritet në shumë fusha të jetës, tashmë janë materializuar në botime të ndryshme leksikografike.

E dhjeta. - Studimet gjuhësore në botë nuk janë më vetëm gjuhësore: ato janë shumëdisiplinore. Në këtë kontekst, leksikografia është bërë shkencë moderne, e kjo domethënë shkencë efikase, shkencë praktike: ajo kërkon, pos të tjerash, globalizimin dhe internacionalizimin e dijeve. Leksikografia shqipe duhet të niset në këtë rrugë, ndërsa kushte të favorshme për këtë mund të krijohen.

E njëmbëdhjeta. - Shkollës leksikografike shqiptare i mungon përgatitja e planifikuar e kuadrit të ri leksikografik – një bazë solide në këtë rrafsh e përbën bashkëpunimi i ndërsjellë i akademive dhe i institucioneve tona universitare e shkencore. Puna në këtë drejtim duhet të pasurohet e të vazhdojë pa shkëputje.

E dymbëdhjeta. - Institutet shkencore, Akademitë e shkencave, Katedrat albanologjike, Seminarat albanologjike janë bartëset kryesore të zhvillimit të shumanshëm të gjuhësisë shqiptare. Gjuhësisë shqiptare i duhet një strategji e përbashkët mbarëkombëtare, një strategji reale, funksionale e parimore, për hapësirën tonë të përbashkët gjuhësore. Mbetet shpresa se do të kapërcehen pengesat jashtëgjuhësore, socio-politike dhe socio-linguistike në hapësirën shqiptare dhe se do të nisë një praktikë e re e bashkëpunimit ndërakademik e ndërinstitutional në

shtrirjen mbarëkombëtare për ta bërë gjuhësinë shqiptare një shkencë moderne mbi gjuhën shqipe, mbi historinë, mbi të sotmen e mbi të ardhmen e saj, rrjedhimisht edhe leksikografinë shqipe.

Literatura

1. Mehmet, Çeliku (2005), *Disa detyra të leksikografisë së sotme shqipe*, “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, ASHSH - ASHAK, Tiranë.
2. Samara, Miço (2002), *Arritje të leksikologjisë dhe leksikografisë shqiptare*, “Hulumtime në leksikografi”, SHB.“Panteon”, Tiranë, f. 9.
3. Samara, Miço (2002), *Leksikografia shqiptare me arritje e probleme të reja*, Arritje të leksikologjisë dhe leksikografisë shqiptare, “Hulumtime në leksikografi”, SHB.“Panteon”, Tiranë, f. 27.
4. Shefkije, Islamaj (2004), *Leksikografia shqipe sot*, në përmbledhjen “50 vjet studime albanologjike”, IA, Prishtinë.
5. Shefkije, Islamaj (2004), *Leksikografia shqiptare në rrethanat e reja*, “Zëri ditor”, Prishtinë, botuar në shtatë vazhdime prej 25 shkurt deri 2 mars 2004; “Gjuha, ligjërimi dhe fjala”, IA, Prishtinë, 2004, f. 125.
6. Shefkije, Islamaj (2004/2005), *Për një leksikografi bashkëkohore*, “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, ASHSH - ASHAK, Tiranë, 2005, f. 26; *Gjuha dhe identiteti*, Toena, Tiranë, 2004, f. 101.
7. Shefkije, Islamaj (2012), *Gjuhësia shqiptare në 100-vjetorin e Pavarësisë*, “Java e Albanologjisë”, 3, IA, Prishtinë.
8. Shehu, Hajri (2012), *Androkli Kostallari, pse fle sirtarëve puna e tij kolosale*, “Gazeta shqiptare”, Tiranë, 23. 3. 2012.
9. Thomai, Jani (2005), *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, ASHSH - ASHAK, Tiranë, f. 11.

Bade BAJRAMI

ÇËSHTJE KLASIFIKIMI TË NJËSIVE FRAZELOGJIKE

I. Hyrje

Problematika e frazeologjisë gjendet në tipologjinë e saj. Të klasifikosh do të thotë të identifikosh njësitë gjuhësore që paraqesin tipare të përbashkëta. Nëse mënyrat e qasjes ndaj NF ndryshojnë shumë sipas punimeve që u kushtohen, klasifikimi në vetvete del si një element i qëndrueshëm të hulumtimeve në frazeologji. Megjithatë kjo qëndrueshmëri nuk do të thotë uniformitet, sepse nëse bëjmë një analizë të punimeve të ndryshme në frazeologji, na dalin një mori klasifikimesh. Para se të shqyrtojmë disa klasifikime të propozuara nga gjuhëtarë me origjina të ndryshme, do të paraqesim arsyet e përgjithshme të vështirësisë së klasifikimit të NF dhe dallimet e rëndësishme në kategorizimin e tyre. Në fakt, parametrat që drejtojnë natyrën dhe funksionimin e njësive polileksikore janë të shumtë dhe përparësia që i jepet njërit apo disa parametrave do ta formojë klasifikimin. Në pjesën e tretë do të shohim parametrat kryesore që përbëjnë bazat e tipologjisë së NF, shpesh të konsideruar si kritere. Do të shohim se me gjithë heterogjeneitetin e vëzhguar klasifikues një model mbizotërues mund të nxirret, model ky i pranuar me disa nuanca nga disa gjuhëtarë si Howarth dhe Mel'cuk. Ky model mbështetet mbi parimin e kontinuumit dhe atij do t i qasemi në pjesën e fundit të kësaj kumtese.

II. Problem klasifikimi të NF-së

Shpesh klasifikimet tradicionale në gjuhë rishqyrtohen, precizohen, madje hidhen poshtë. Megjithatë ato janë pikënisje e qëndrueshme për studime që hulumtojnë natyrën dhe funksionimin e elementeve gjuhësore. Në frazeologji, qasja sipas së cilës elementet gjuhësore ndahen në pjesë të ligjëratës është e paparamendueshme. Një grumbull njësisish frazeologjike kërkon analiza gjuhësore të holla që të riorganizohen në klasa. Klasifikimi i elementeve vijuese, po aq të pranishëm në gjuhë sa ata të ndarë në pjesë të ligjëratës, nuk është një akt banal: *ëndrra në diell, mish e thua, s'le dy gurë bashkë, marrje parasysh, dhënie llogari, pikë loti, u bë erë, shkel e shko, qesh e ngjesh, hesapi i dëlirë, miqësia e mirë, pas pak, në prani të etj.*

A duhet t'i klasifikojmë sipas strukturës së tyre sintaksore dhe të nxjerrim, për afërsisht, togfjalëshat vijues: ndërtime me bazë emërore: *marrje parasysht, dhënie llogari, pike loti*, ndërtime me bazë foljore: *vë dorë, fut hundët, s'le dy gurë bashkë*, ndërtimet me bazë parafjalore: *pas pak, në prani të*, fjali të gatshme: *hesapi i dëlirë, miqësia e mire* ose sipas kriterit të patejdukshmërisë së tyre semantike duke dalluar gjithnjë për afërsisht, grupet vijuese: shprehjet semantike të dukshme apo transparente: *nxjerr përfundim, së shpejti*, dhe ato semantike të patejdukshme ose të errëta: *flet kodra pas bregut, shkoi dushk për gogla*

Në fakt, NF formojnë një bashkësi shumë komplekse dhe shumë pak homogjene dhe pikërisht ky dallim e vështirëson klasifikimin e tyre. Anasjelltas, kjo vështirësi e klasifikimit të tyre merret shpesh si dëshmi e kompleksitetit të natyrës së tyre.

Që të shohim më mirë heterogjeneitetin që mbretëron në klasifikimin e njësisve komplekse të gjuhës pjesa vijuese synon qasjet në disa klasifikime nga autorë me prejardhje të ndryshme, duke vënë në pah objektivin e tyre gjuhësor.

III. Klasifikim sipas disa autorëve

Shqyrtojmë klasifikimet në punimet e gjuhëtarëve shqiptarë, anglofonë dhe frankofonë, duke diskutuar klasifikimet e propozuara nga Gross-i dhe Mel'cuk-u (1993, 1998) për frëngjishten, nga Howarth-i (1996, 1998) dhe Gläser-i (1988) për anglishten dhe nga Thomai (1981) për shqipen.

1. Tipologjia e Gläser-it (1988)

Tipologjia e NF-së e propozuar nga Gläser-i¹ (1988) synon të paraqesë një vizion globalizues të frazeologjisë në gjuhën angleze. Gläser-i ndan botën frazeologjike angleze në tri sfera: «sfera qendrore» (centre), «sfera transitore» (transitional area) dhe «sfera periferike» (periphery).

Në qendër të sistemit frazeologjik gjenden njësitë që kanë një funksion emëror» d.m.th. njësitë që sillen si njësitë monoleksikore. Kjo pjesë qendrore e sistemit frazeologjik i nënshtrohet një nënkategorizimi të bazuar mbi kriterin funksional. Gläser-i vë në pah kështu njësitë që luajnë një rol emëror (*bread and butter*), mbiemëror (*born under a lucky star*), foljor (*to have a swim*) etj.

Zona tranzitore përmban njësitë që gjenden në mes të monoleksemave dhe fjalive. Fjala është disi për pjesë apo copa fjalish që Gläser quan "idiomat me formë fjalie". Ajo shti aty elipsat e proverbave (*a rolling stone*), binomet e pakthyeshem

¹ Gläser, R. „The grading of idiomaticity as a presupposition for a taxonomy of idioms; f. 264-279.

(*the ups and downs*), krahasimet e stereotipuara (*as proud as a peacock*), etj. Sfera e jashtme përfshin njësitë që përbëjnë fjali. Aty hyjnë proverbat (*All roads lead to Rome.*), klishtë (*How do you do?*), citacionet (*Speak softly and carry a big stick; you will get far.*) etj

Duke ndjekur traditën ruse, Gläser-i themelon tipologjinë e saj të NF-së mbi dallimin në mes të njësive të llojit fjalë dhe njësitë e llojit fjali. Në një mënyrë më të përgjithshme, tipologjia e saj mbështetet edhe në çështjen e frekuencës së përdorimit të NF. Njësitë e qendrës janë më të zakonshme se ato që gjenden në zonat transitore dhe periferike. Frekuenca është një parametër lidhur me përsëritjen në procesin e identifikimit të njësive polileksikore.

Gross-i, përkundër Gläser-it, vë në qendër të studimit të tij kriterin e ngurosjes apo të kristalizimit dhe atë të patejdukshmërisë semantike.

2. Tipologjia e Gross-it (1996)

Me titullin e tij të librit², *Les expressions figées en français : noms composés et autres locutions*, Gross-i (1996) në analizën e tij të NF-së bën të qartë se tipari kryesor që e intereson është ai i ngurosjes. Gross-i pohon se njësitë polileksikore janë të ngurosurat në shkallë të ndryshme dhe ia shtron detyrë vetes të përcaktojë shkallën e tyre të ngurosjes. Për të arritur këtë qëllim, ai i nënshtron ato në transformime sintaksore të shumta duke ndjekur rregullat e gramatikes transformacionale dhe duke llogaritur shkallën e ngurosjes së NF sipas kufizimit të saj transformacional. Kriterit të ngurosjes, Gross-i ia asocon atë të patejdukshmërisë semantike, duke sqaruar se ngurosjat, patejdukshmëria semantike, jo kompozicionaliteti dhe restriksionet sintaksore shkojnë tok. Ai jep si shembull lokucionin foljor *prendre la tangente* dhe emrin e përbërë *un cordon bleu*, ku asnjëri prej elementeve nuk lë të parashikohet kuptimi i tërësisë dhe asnjëri nuk pranon transformimet sintaksore dhe të cilëve ia kundërvë dy shembuj : *l'enfant a lu ce livre* dhe *un livre difficile*, kuptimi i të cilëve është i tejdokshëm dhe që i nënshtrohen pa vështirësi llojeve të njëjta të transformimeve .

Megjithatë, ky lloj testi duket në mënyrë të përgjithshme i vështirë për zbatim sistematik mbi një korpus më të rëndësishëm.

Shumë gjuhëtarë të tjerë kanë përdorur testet sintaksore në identifikimin e nën grupeve të ndryshme të kombinimeve leksikore, mungesa transformacionale, duke qenë më të vërtetë e lidhur me kristalizimin e NF-së. Është rasti ky i Howarth-it.

3. Tipologjia e Howarth-it (1996-1998)

² Gross, *Les expressions figées en français : noms composés et autres locutions*, 1996.

Howarth-i³ (1996; 1998: 164) klasifikon NF-në angleze sipas asaj se asociacioni i fjalëve brenda njësisë mbështetet mbi një kombinim të lirë (free combination), ose mbi një kombinim të ngushtuar (restricted collocation), ose është një shprehje idiomatike figurative (figurative idiom), ose një shprehje idiomatike e pastër (pure idiom), duke nxjerrë kështu katër kategori të NF-së:

1. free combination (*blow a trumpet*), 2. restricted collocation (*blow a fuse*), 3. figurative idiom (*blow your own trumpet*, dhe 4. pure idiom (*blow the gaff*)

Në bazën e këtij klasifikimi gjendet një analizë e veçorive të ndryshme esenciale të NF. Në fakt, Howarth-i (1996 : 46-47) paraqet hiç më pak se 6 parametra për të vlerësuar statusin specifik të secilës NF dhe për përkatësinë e saj ndonjëres prej klasave. Këta janë: forma e njohur (well-formed), institucionalizimi (institutionalized), speci-alizimi (specialized element), restrikcioni kolokativ (collocationally restricted), njësimi semantik (semantically unitary), jo motivim (unmotivated).

Pas një analize të këtyre parametrave, del e qartë se me gjithë përpjekjet e Howarth-it që të mos kufizojë klasifikimin e tij në disa veçori më dalluese të NF, tipologjia e tij mbështetet më në fund në 3 parametra vetëm. Kriteri i formës së njohur «nuk mundëson asnjë dallim. Kriteri i «institucionalizimit» paraqitet si i paqëndrueshëm ose dështues. Sa u përket kriterëve të «specializimit» dhe të «restriksionit kolokativ », ata përputhen. Parametrat që mbeten janë pra «restriksioni kolokativ » (ngurosja, shih f. 137), «njësimi semantik» (jokompozicionaliteti shih f. 138) dhe «mungesa e motivimit» (shih. 139). Është përpjekja e parë e klasifikimit të NF-së bazuar mbi një analizë të gërshetuar dhe eksplicite të disa kriterëve.

4. Tipologjia e Mel'cuk-ut (1993-1998)

Klasifikimi i NF-së sipas Mel'cuk-ut⁴ është mjaft identik me klasifikimin e Howarth-it, me dallimin se ai ndërfit një kategori shtesë, kategorinë e pragmatemave. Pragmatema përfshin sekuencat e ngurosura krahasuar me një kontekst situacional (p.sh., sipas Mel'cuk-ut, *c'est pour toi* është i vetmi variant i mundshëm që përdoret në një situatë kur kërkohet dikush në telefon; (variantet *#c'est toi qu'on demande* ose *#c'est à toi* janë të papranueshme në një situatë të tillë).

³ Howarth, P. A. (1996) *Phraseology in English Academic Writing: Some Implications for Language Learning and Dictionary Making*, f. 33, 46-47

Howarth, P. A. (1998) *The Phraseology of Learners' Academic Writing*. In Cowie, A. P. (Ed.), *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: OUP, f. 164

⁴ Mel'cuk, I. A. (1993) *La phraseologie et son rôle dans l'enseignement/apprentissage d'une langue étrangère.*, f. 84

Mel'uk, I. A. (1998) *Collocations and lexical functions*, f.;30

Mel'cuk-u flet për kufizim («*déficience*») pragmatik (shënuar me #), kur një njësi është gramatikusht dhe semantikusht e pranueshme, por nuk është e përshtatshme me situatën në të cilën përdoret (ibid.: 83). Paraqesim klasifikimin e frazemave sipas Mel'cuk-ut⁵.

Phrasèmes			
phrasèmes pragmatiques	phrasèmes semantiques		
Pragmatèmes	Idiomes	Collocations	Quasi-idiomes

Përveç klasës së pragmatemave, është e mundshme të barazojmë «idiomat» e Mel'cuk-ut me «idiomat e pastra» të Howarth-it, «kolokacionet» me «kolokacionet e ngushtuara» të Howarth-it dhe «pothuajse idiomat» me «idiomat figurative» të Howarth-it.

5. Tipologjia e Thomait (1981)

Thomai⁶ pranon për NF të gjuhës shqipe tri lloje klasifikimi, duke u mbështetur në kriteret e ndryshme, siç janë struktura, vlera leksiko-semantike dhe shkalla e motivimit.

Sipas kriterit të strukturës, ndarja bëhet në NF me strukturë togfjalëshi *këngën e Mukës, i bie këmbës, e bën qimën tra* dhe ata me strukturë fjalie (*s'e vlen barra qiranë, kthen nga të fryjë era, etj.*). Nëse mbështetemi në kriterin e dytë, atë të vlerës leksiko-semantike, shohim se afrohet nga pjesët e ligjëratës si nga kuptimi ashtu edhe nga funksioni në gjuhë. Ky, sipas tij, është themelor për gjuhën shqipe dhe ai nxjerr grupet vijuese: NF emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore me nëngrupe të ndryshme. Kurse ai sipas shkallës së motivimit mbështetet në zbulimin e kuptimit të NF-së, ku komponentet përbërëse të saj kanë shkallë të ndryshme të ngjizjes kuptimore, kështu që ato ndahen në përngjitjet frazeologjike ose idiomat (njëkuptimshmëri) *jap fjalën, bëri emër*; njësitë frazeologjike (dykuptimshmëri) *ra nga fiku, plas zemrën, etj.* dhe bashkimet frazeologjike, ku njëri element është me kuptim të figurshëm dhe tjetri me kuptim të drejtpërdrejtë (*jap fund, theu qafën, marr vesh etj.*).

⁵ Mel' uk, I. A. (1993) La phraséologie et son rôle dans l'enseignement/apprentissage d'une langue étrangère., f. 84

⁶ Thomai, J.(1981), Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Tiranë.

IV. Kriteret e tipologjisë së NF-së

Treguam se llojllojshmëria e tipologjive të NF-së lidhet me llojllojshmërinë e ndërtimeve të prekura nga fenomeni i frazeologjisë. Në fakt, NF-të kanë veçori të shumta dhe klasifikimet e ndryshme lindin sipas asaj se vëzhgimi i asaj apo kësaj veçorie privilegohet në dëm të të tjerave. Në suazat e klasifikimit, këto veçori merren si kritere që drejtojnë klasifikimin. Në vijim do t'i qasemi kritereve kryesore.

1. Frekuenca

Frekuenca e përdorimit e një togfjalëshi është më pak një parametër klasifikimi se identifikimi i NF. Ai ia vlen megjithatë të përmendet këtu sepse është një parametër shumë shpesh i përdorur në rastin e njohjes automatike të NF të kryera me anë të programeve të ndryshme që mundësojnë klasifikimin e tyre sipas frekuencës, pra edhe të hartimit të listave të frekuencave në statistikën leksikore.

2. Ngurosjë

Ngurosjë apo kristalizimi është një nga veçoritë në të cilën mbështetemi më së shpeshti për të përshkruar NF-në në dallim nga elementet e tjera leksikore të gjuhës. Dallojmë p.sh. shprehjet e llojit *shkel e shko* dhe *flet kodra pas bregut* nga sekuenca të llojit *shikoj një film* dhe *shkruaj një letër*. Argumenti në të cilin duhet bazuar në klasifikimin sipas kriterit të ngurosjes është se shprehjet e llojit të parë nuk pranojnë transformime sintaksore (**shkel por shko*, **shko dhe shkel*, **flet kodra në breg, etj.*), kurse të dytat i pranojnë pa kurrfarë vështirësie (*është duke shikuar një film, filmin që e ka shikuar*).

3. Zëvendësueshmëria e elementeve përbërëse

Kriteri i zëvendësueshmërisë së elementeve përbërëse funksionon së bashku me kriterin e ngurosjes. Dallojmë p.sh. kombinimet e llojit *Kashta e kumtërit* për të cilat është e pamundur të bëhet substitucioni i njërit prej elementeve pa ndryshuar kuptimin global të shprehjes, nga togfjalëshat e llojit *kashta e grurit*, ku kuptimi i tërësisë ndryshon sipas semantizmit të veçantë të elementit që është zëvendësuar.

4. Patejdukshmëri semantike

Në mënyrë të përgjithshme, kundërvëmë njësitë polileksikore, kuptimi i të cilave mund të nxirret falë kuptimit që përmban çdo element përbërës i njësisë, me njësitë polileksikore, kuptimi i të cilave nuk është i llogaritshëm. Të parat cilësohen si semantikisht transparente (*laj duart/ se laver les mains*) dhe të dytat si

semantikisht të errëta (*marr në bisht të lahutës / faire des gorges chaudes*). Dallimi në mes të një NF-je semantikisht të patejdukshme dhe një NF-je semantikisht transparente mund të çojë te mendimi se lidhen më tepër me vlerësime subjektive se objektive. Në qendër të këtyre vlerësimeve gjendet çështja e kompetencës gjuhësore dhe e statusit të folësit.

5. Kompozicionaliteti

Kriteri i kompozicionalitetit është pandan i kriterit të patejdukshmërisë semantike. Konsiderohet se një njësi leksikore ka një kuptim kompozicional nëse domethënia e saj globale është shuma e secilit element marrë veç e veç.⁷ Kështu pra në togfjalëshin *maqinë për larje* kuptimi është kompozicional pasi që kuptimi i *i saj* është përbërës i kuptimeve të fjalëve *maqinë, për* dhe *larje*, kurse te togfjalëshat *teneqe e shpuar, Voie Lactée* ose *black ice* nuk është kompozicional, sepse togfjalëshi *teneqe e shpuar* s'ka lidhje me ndonjë teneqe, por tregon një njeri llafazan, *Voie Lactée* nuk tregon ndonjë udhë me përbërje të qumështit, por një bashkësi yjesh, kurse *black ice* nuk shpie te një akull i zi, por te ngrica.

Ky kriter i kompozicionalitetit mundëson të vihet në pah një çështje mjaft delikate për trajtimin e NF-së. Fjala është për vështirësinë e dallimit në mes të kuptimit të fjalëpërfjalshëm dhe atij figurativ të njësive leksikore.

6. Motivimi

Për disa frazeologë është relevant dallimi që mbështetet tek aftësia e folësve *nativë* për të sqaruar ose jo origjinën a motivimin e një njësie polileksikore. Kështu, të gjithë folësit shqiptarë janë në gjendje të rinjohin origjinën motivacionale të njësisë *e do si macja peshkun*. Njohim pa vështirësi asociacionin e ëndjes të maces ndaj peshkut. Anasjelltas, të kërkosin origjinën motivacionale të *e shkyu macën me kokë* (u kujdes në kohën e duhur) është detyrë e gjuhëtarit.

Sikur te kriteri i patejdukshmërisë semantike, aftësia që të zbulohet motivimi i një shprehje mbështetet si në aftësitë intuitive të folësve, ashtu edhe në statutin e tyre, moshën dhe origjinën shoqëro-kulturore.

7. Strukturat sintaksore

Klasifikimi i frazeologjizmave sipas strukturës së tyre sintaksore përdoret shpesh në studimet frazeologjike. Ai kryen identifikimin e kallëpeve të ndryshme sintaksore që mundësojnë të formohen ndërtimet komplekse. Gjedhet duke qenë të

⁷ Shih. Gross G., f. 103.

shumta është lehtë të gjenden strukturat e njëjta të shembujve si në shqip, anglisht po ashtu edhe në frëngjisht, ashti siç e tregon tabela vijuese:

Strukturat	Shembuj frëngjisht	Shembuj shqip	Shembuj anglisht
F+ emër	Prendre part, rendre grâce	Bëj qejf, marr vesh	<i>to run a restaurant, to book a ticket</i>
E+paraf.+ E	Salaire de misère, Moulin à paroles	Petulla në ujë, stan me lepuj,	<i>word of honour, burst of laughter</i>
E+mb.	Enfant gâté ,	Fëmijë i lazdruar	<i>pitch black, stone deaf</i>

8. Funkzioni

Të bazosh një klasifikim të ndërtimeve polileksikore mbi kriterin funksional mundëson të shfrytëzohet një informatë shtesë lidhur me NF-në. Ajo është interesante sa në pikëpamjen sintaksore, aq edhe në atë semantike, sepse lidhet drejtpërsëdrejti me rolin e NF-së në fjali. Kështu, është e mundshme të dallohen njësitë sipas aftësisë së tyre që luajnë në fjali një rol: foljor, emëror, mbiemëror, ndajfoljor etj.

9. Etimologji

Kriteri i fundit është ai i etimologjisë. Ky klasifikim mbështetet në origjinën e NF, qoftë ajo historike, gjeografike ose kronologjike. Ai mund të paraqitet nën këtë formë, p.sh.: mitologjike (*kali i Trojës*), religjioze (*Toka e premtuar*), popullore (*si dhitë e rromsit*), letrare, historike.

Në fund të kësaj paraqitjeje të kriterëve qenësore të përdorura në klasifikimin e NF-së, konstatojmë se zbatimi i secilit kriter jep një orientim të ri për të kuptuar fenomenet frazeologjike. Me gjithë llojllojshmërinë e kriterëve që udhëheqin tipologjinë e NF-së si dhe llojllojshmërinë klasifikuese të vëzhguar, mund të nxjerrim një model dominues që duket se është pranuar nga disa frazeologë.

V. Modeli dominues

Më herët, gjuhëtarët konsideronin se format e stereotipuara përbënin një klasë e cila i kundërvihet kombinimeve të lira të fjalëve, sot të shumtë janë frazeologët të cilët konsiderojnë se ka një vazhdimësi në mes të formave të lira dhe formave të ngurosurat. Ky model klasifikimi mund të shihet si një ndarje e parë e sasisë së madhe të njësisve polileksikore që ka çdo gjuhë. Ky model bazohet mbi parimin e kontinuumit: në një skaj të kontinuumit kemi idiomat dhe në tjetrin ndërtimet e lira.

Në mes tyre figurojnë idiomat figurative dhe kolokacionet restriktive. Ky model propozohet me disa nuanca, nga gjuhëtarë si Howarth, Mel'cuk dhe Thomaj.

idiomat e mirëfillta	idiomat figurative	kolokacionet restriktive	kombinimet e lira
<i>dal zot, vë re, miza nën kësulë, kur të bëjë shelgu rrush, il pleut des cordes, it is raining cats and dogs, tous les 36 du mois,</i>	<i>M'i hëngri paret, marr me mend, Faire un virage en épingle à cheveux, to make a U-turn, avoir les jetons ,</i>	<i>Jap fund, Kam kujdes,faire attention, to pay attention</i>	<i>vë një kapelë, mettre un chapeau, to put on a hat;</i>

Idiomat janë shprehje plotësisht të ngurosura. Kombinimet e lira nuk kanë asnjë detyrim kombinatorik përveç atij të pajtueshmërisë kombinatorike në mes të njësive në fjalë. Idiomat figurative kanë një përdorim të dyfishtë (njësitë frazeologjike të Thomait): një përdorim të lirë me një kuptim kompozicional dhe një përdorim të ngurosur ku kuptimi i tërësisë është figurativ. Kështu *ia mbyll derën* mund të përdoret në kuptimin e fjalëpërfjalshëm, togfjalëshi ka atëherë një kuptim kompozicional dhe dmth se dikujt ia mbyllim derën me të vërtetë dhe një kuptim figurativ (*vdiq e s'la më njeri pas vetes*). Sa u përket kolokacioneve restriktive (bashkimet frazeologjike), ato kanë të bëjnë me raportet preferenciale apo prirjet që bëhen në mes të njësive leksikore.

Megjithatë, edhe pse shtrohet ky tipar universal i klasifikimit, disa NF vështirë se do ta gjejnë vendin e tyre, sidomos kategoria e pragmatemave e klasifikimit të Mel'cuk-ut, ato të llojit fjalë të urta, slogane etj., sikur edhe ajo e fjalëve shërbyese, siç janë lokucionet parafjalore *në prani të, në mungesë të, për arsye se në kuadër të*, etj. vetëm nëse konsiderojmë se këto elemente janë pjesë e idiomave të pastra, rast në të cilin do të ishim të detyruar të prananim këtë bashkëjetesë të çuditshme në mes të proverbave dhe lidhëzave p.sh. Do të ishte interesante atëherë të zgjerohej ky model në mënyrë që të futen klasat që mungojnë.

VI. Përfundim

Nga ky vështrim i tipologjisë së NF-së del qartë se ekziston një hulumtim i një modeli klasifikimi që do të përfshinte tërësinë e fenomeneve frazeologjike. Megjithatë ky hulumtim nuk do të duhej të maskonte rëndësinë e mundësisë së

klasifikimeve të shumta në frazeologji. Klasifikimet sipas frekuencës, shkallës së nguroshjes, patejdukshmërisë semantike, klasifikimet sintaksore, semantike, etimologjike etj. janë të gjitha komplementare, sepse sjellin informata shtesë mbi natyrën dhe funksionin e NF-së. Prandaj duhet pranuar se në frazeologji tipologjia nuk është vetëm mjet vëzhgimi i fakteve gjuhësore, por gjithashtu edhe lëmi mendimi në vete. Kështu, rëndësia e klasifikimit në frazeologji është e madhe, pasi vetë procesi i klasifikimit është bazë e të kuptuarit të natyrës dhe të funksionimit të njësive të vëzhguara. Kështu, klasifikimi i fakteve të vëzhguara mund të shihet si një metodë pune paraprake dhe e domosdoshme për çdo analizë të mëtutjeshme të fenomeneve frazeologjike. Ai është gjithashtu një metodë e dobishme për qasjen e njësive polileksikore qoftë në kuadër të nxënies së NF-së, qoftë në atë të përkthimit.

Bibliografi

1. Cowie, A. P. (1998a), Introduction. In Cowie, A. P. (Ed.) *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: OUP, pp. 1-20.
2. Gläser, R. (1988), The grading of idiomaticity as a presupposition for a taxonomy of idioms. In Hüllen, Werner & Schulze, Rainer (Eds.) *Understanding the Lexicon*, Tübingen: Max Niemeyer, pp. 264-279.
3. Gläser, R. (1998), The stylistic potential of phraseological units in the light of genre analysis. In Cowie, A. P. (Ed.), *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: OUP, pp. 125-143
4. Gross, G. (1996), *Les expressions figées en français : noms composés et autres locutions*, Paris/Gap : Ophrys, coll. L'essentiel français.
5. Howarth, P. A. (1996), *Phraseology in English Academic Writing: Some Implications for Language Learning and Dictionary Making*, Niemeyer, Tübingen.
6. Howarth, P. A. (1998), The Phraseology of Learners' Academic Writing. In Cowie, A. P. (Ed.), *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: OUP, pp. 161-186.
7. Mel'čuk, I. A. (1993), La phraséologie et son rôle dans l'enseignement/apprentissage d'une langue étrangère. *Etudes de Linguistique Appliquée*, vol. 92, pp. 82-113.
8. Mel' uk, I. A. (1998), Collocations and lexical functions. In Cowie, A. P. (Ed.), *Phraseology: Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: OUP, pp. 23-53.
9. Thomai, J. (1981), *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë.
10. <http://fr.scribd.com/doc/57516940/Phraseology-Theory-Analysis-And-Applications>

Idriz METANI

STUDIME NË FUSHËN E SEMANTIKËS LEKSIKORE TË SHQIPES

Arritjet e gjuhësisë shqiptare në fushën e semantikës leksikore, megjithëse të pakta e disi të vonuara, nuk janë bërë ende, me sa dimë deri tani, objekt i ndonjë trajtесе të veçantë, ku të vlerësohen rezultatet e arritura, të përgjithësohet përvoja shkencore dhe të shtrohen detyra për të ardhmen. C`është shkruar për to deri më sot në mënyrë të tërthortë sidomos në disa punime me karakter vlerësues¹ për zhvillimin e leksikologjisë dhe të leksikografisë shqiptare² ndër vite, në ndonjë artikull³,

¹ Në përgjithësi, artikujt e shkruar deri më sot për zhvillimin e leksikologjisë dhe leksikografisë shqiptare përqipen të japin vijën themelore të zhvillimit të këtyre dy shkencave duke iu drejtuar pikësëpari ngjarjeve më të mëdha dhe veprave më të rëndësishme. Në gji të këtyre artikujve gjendet edhe vlerësimi i studiuesve të ndryshëm për trajtimin e çështjeve të veçanta të semantikës leksikore në fushë të shqipes. Shih ndër të tjera, J. Thomai, Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas çlirimit, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, 1972, f. 367-389; Xh. Lloshi, Mbi rezultatet kryesore në studimin e leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas Çlirimit, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, 1972, f. 477-487; M. Samara, Arritje të leksikologjisë dhe të leksikografisë shqiptare, Hulumtime në leksikografi, f. 9-19. Në artikullin tonë me titull "Studimi i leksikut të shqipes dhe teoria e fushave leksikore e semantike", mbajtur në seminarin e tretë të albanologjisë, bëhet një përgjithësim i thukët i zhvillimit të shkencës leksikologjike shqiptare duke u ndalur më tepër dhe kryesisht në vlerat kryesore dhe në tipologjinë e studimeve që janë bërë deri tani për leksikun e shqipes. Shih, I. Metani, Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë, Shkup, 2009, f. 83-89.

² Vlerësimin më të plotë të trashëgimisë gjuhësore në fushën e leksikografisë e ka bërë konferenca shkencore organizuar në Tiranë në dhjetor të vitit 2004 nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Shih, Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005. Në konferencë u trajtuan një varg çështjesh të rëndësishme të teorisë dhe të praktikës leksikografike dhe u përcaktuan edhe disa detyra kryesore që duhet ti sendërtojë shkenca leksikologjike shqiptare në të ardhmen.

³ Fjala është për artikullin e Jani Thomait "Studimet në semasiologji-detyrë me rëndësi për gjuhësinë tonë", botuar më 1988 në numrin 1 të revistës "Gjuha jonë" në të cilin autori, pasi jep një vështrim të shkurtër rreth zhvillimit të semantikës si disiplinë gjuhësore në botë, tregon rrugët nëpërmjet të cilave është zhvilluar mendimi shkencor semasiologjik shqiptar duke tërhequr njëherazi vëmendjen e gjuhësisë shqiptare për ta kthyer fytyrën e saj nga semantika e për të studiuar kësisoj shqipen në rrafshin semantik..

monografi ⁴apo botim universitar⁵, nuk mjaftojnë, megjithatë, për të bërë një vlerësim të plotë e kritik të trashëgimisë sonë gjuhësore në këtë fushë, sado e paktë qoftë ajo. Një gjë të tillë mëton ta bëjë kumtesa e pranishme.

Pas viteve '60-'70 të shekullit të XX, kur semantika në përgjithësi si disiplinë a degë me vete e gjuhësisë ishte futur në një fazë të re zhvillimi, që në historinë e saj njihet si periudha e formalizimit⁶ ose e gjedheve semantike, në gjuhësinë shqiptare semantika leksikore **sapo kishte nisur të trajtohej edhe teorikisht**. Themi kështu, pra **sapo kishte nisur**, sepse është i njohur tashmë fakti që, për arsye të kohës, gjuhësia shqiptare në raport me shkollat apo drejtimet gjuhësore ka qenë përgjithësisht e vonuar, jo vetëm për ti zbatuar ato, por, madje, edhe për ti njohur, ndonëse në fushën e semantikës leksikore vonesa nuk është aq e madhe së paku për dy arsye kryesore: **e para**, sepse, edhe në rrafshin e gjuhësisë së përgjithshme, semantika në përgjithësi dhe ajo leksikore në veçanti, ka lindur vonë, **e dyta**, në fushën e semantikës leksikore gjuhësia shqiptare ka hyrë më shpejt me studime se sa në fushat e tjera gjuhësore.

Nëse i vështrojmë këto studime në aspektin tipologjik, mund ti ndajmë ato, së paku, në dy grupe kryesore: a) Studime që prekin tërthorazi a në mënyrë jo të drejtpërdrejtë çështje të semantikës leksikore të shqipes, d.m.th. studime me karakter jo të mirëfilltë semasiologjik, b) Studime që trajtojnë drejtpërsëdrejti çështje të ndryshme të semantikës leksikore në fushë të shqipes, pra, studime të njëmendta semasiologjike.

⁴ Në monografinë e J. Thomait, Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantikë leksikore), botim i ripunuar dhe i përmirësuar, Tiranë, 2009, bëhet një sintezë e arritjeve dhe e problemeve që dalin në semantikë bashkë me një vështrim teorik të çështjeve themelore të kësaj shkence në përgjithësi. Shih edhe V. Memishaj, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999.

⁵ Në kreun për semantikën leksikore nën titullin "Semasiologjia leksikore e gjuhës shqipe" f. 72-78, të tekstit universitar "Leksikologjia e gjuhës shqipe", botim i vitit 2006, autori përshkruan dy rrugët nëpërmjet të cilave, sipas tij, është zhvilluar semantika leksikore në gjuhën shqipe: a) Hartimi i fjalorëve të ndryshëm, b) Studimi i dukurive leksikologjike. Duke folur për rrugën e dytë J. Thomai bën vetëm disa përgjithësime për ndihmesat që sjellin në semantikë studimet etimologjike në fushë të shqipes të kryera sidomos nga Eqrem Çabej dhe studimet për fjalëformimin.

⁶ Përgjithësisht studiuesit që janë marrë me historinë e zhvillimit të semantikës si disiplinë me vete gjuhësore i njohin asaj tri periudha kryesore zhvillimi: a) periudha evolucioniste, në të cilën zhvillohet më shumë semantika historike ose, siç quhet ndryshe, semantika diakronike, b) periudha mikse, në të cilën zhvillohen pranë e pranë edhe semantika historike edhe ajo leksikore, c) periudha e teorive të formalizuara ku përparësi merr semantika e frazës dhe e aktit kumtues. Në rrafshin kohor, periudha e parë ose periudha kur studiohet historia e fjalëve, nis prej vitit 1883 dhe përfundon në vitin 1931, periudha e dytë, ose periudha kur në fokusin e studimeve semasiologjike vendoset historia e fjalëve dhe strukturimi i leksikut njëkohësisht mbyllet, sipas mendimit të shumicës së studiuesve, në vitin 1963, vit kur fillon periudha e tretë ose periudha e modeleve semantike, e cila vazhdon sot e gjithë ditën.

a) Në grupin e parë futen **së pari** studimet etimologjike të bëra sidomos nga Eqrem Çabej⁷, të cilat, edhe pse i përkasin semantikës diakronike, na japin mjaft të dhëna për lëvizjet kuptimore që kanë ndodhur në leksikon e gjuhës shqipe ndër vite, duke dhënë kështu një ndihmesë të rëndësishme në studimet semasiologjike shqiptare, **së dyti**, studimet për formimin e fjalëve⁸ në gjuhën shqipe të kryera nga Aleksandër Xhuvani, Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Emil Lafe, Enver Hysa, Idriz Ajeti, Kostaq Cipo, Latif Mulaku, Ludmilla Buxheli, Mahir Domi, Shaban Demiraj etj., në të cilat, përveç aspektit fjalëformues, trajtohen edhe dukuri të ndryshme të semantikës së fjalëve, **së treti**, studimet për klasa të veçanta leksikore, ku gërshetohet vështrimi gramatikor me atë leksiko-semantik për të zbuluar tek klasat e fjalëve çështje gramatikore dhe çështje leksikore njëkohësisht. Si të tilla mund të përmendim, ndër të tjera, studimin për pjesëzat si kategori leksiko-semantike të kryer nga Josif Kole⁹, si dhe studimin për ndajfoljet dhe atë për parafjalët të bërë gjegjësisht nga studiuesit Jani Thomai¹⁰ dhe Miço Samara¹¹, **së katërti**, studimet për fusha tematike fjalësh, të kryera nga një numër jo i vogël studiuesish. Si të tilla mund të përmendim, ndër të tjera, studimet për emërtimet e gjallesave në gjuhën shqipe, konkretisht, për emërtimet e kafshëve në mbarë shqipen¹² apo në treva të veçanta të saj si Labëria¹³, Tomorrica e Skraparit¹⁴ etj. të peshqve dhe të disa organizmave të tjerë ujorë¹⁵, të zvarranikëve¹⁶ (Gjovalin

⁷ Eqrem Çabej, Studime gjuhësore, Prishtinë, I, II, III, 1976, IV, 1977, V, 1975, VI, 1977

⁸ Shih, ndër të tjera, Aleksandër Xhuvani, Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në gjuhën shqipe, BISH, 1949, 2, Aleksandër Xhuvani-Eqrem Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe, BShSh, 1956, 4, Prapashtesat e gjuhës shqipe, BUSH, SShSh, 1962; Androkli Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, BUSH, SShSh, 1961, 3, Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese, BUSH, SShSh, 1962, 3; Emil Lafe, Gramatika e gjuhës shqipe, I (shih kreun për fjalëformimin); Enver Hysa, Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, 2004; Idriz Ajeti, Kërkime gjuhësore, 1978, Kostaq Cipo, Rreth disa kompozitave, BISH, 1948, 1, Kompozitat determinative, BISH, 1948, 2-3; Latif Mulaku, Mbi disa çështje të gjuhës letrare shqipe, GjA, SShF, 1978; Ludmilla Buxheli, Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe, 2008; Mahir Domi, Rreth fondit kryesor të fjalëve të fjalorit të shqipes, BShSh, 1952, 4; Shaban Demiraj, Emrat prejfoljorë asnjans dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre, SF, 1969, 2.

⁹ Josif Kole, Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, 1972, f. 315-344

¹⁰ Jani Thomai, Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe, 2004

¹¹ Mico Samara, Parafjalët në shqipen e sotme (Vështrim leksiko-semantik), 1999

¹² Gjovalin Shkurtaç, Emërtimet e kafshëve sipas ngjyrës, SF, 1971, 1

¹³ Valter Memisha, Rreth emërtimeve të kafshëve në Labëri, Studime për fjalën shqipe, 2011, f. 47-58

¹⁴ Hajredin Xhaferi, Fjalë e frazeologji që lidhen me botën shtazore në krahinën e Tomoricës, SF, 2, 1982

¹⁵ Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara, SF, 1967, 1; Ndoc Rrakaj, Emrat e peshqve dhe e organizmave të ujit, BUSH, SShSh, 1970, 1

Shkurtaj, Valter Memisha, Hajredin Xhaferri, Lirak Dodbiba, Idriz Hazhiu, Ndoc Rakaj), për fitoniminë shqipe në Kosovë¹⁷ e për leksikun bimor në krahina të ndryshme të Shqipërisë (Shefki Sejdiu, Simon Pepa, Nexhip Mërkurri), për leksikun politiko-shoqëror¹⁸ (Miço Samara), për emërtimet e njerëzve sipas profesionit¹⁹ Vaskë Milkani, Kornelja Sima) etj.

Po kështu, duhet thënë se, në një varg studimesh për leksikun e shqipes standarde, për leksikun dialektor²⁰ dhe krahinor²¹ të saj, si edhe në studimet me karakter dialektor që janë kryer deri më tani, gjejmë të trajtuara, çështje të semantikës leksikore.

Me një fjalë, studimet e përmendura më lart, por edhe të tjerat të kësaj natyre që u lanë pa përmendur në këtë kumtesë, edhe pse jo me karakter të mirëfilltë semasiologjik, duke trajtuar në gji të tyre dukuri të semantikës leksikore, japin, megjithatë, ndihmesë jo të parëndësishme për studimet semasiologjike shqiptare.

b) Me botimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, 1980, por, sidomos pas daljes në dritë, në vitin 1989, të monografisë “Prejardhja semantike në gjuhën shqipe”²² me autor studiuesin e njohur Jani Thomai, një studim i përveçëm në gjuhësinë shqiptare me përmasat e një kodi shkencor të mirëfilltë, që kodifikon teorikisht konceptet themelore të semantikës leksikore dhe që tregon qartazi se si mund të shfrytëzohen e të zbatohen me origjinalitet të spikatur, arritjet e gjuhësisë botërore, sidomos të asaj strukturaliste²³, në fushë të shqipes, për semantikën

¹⁶ Idriz Haxhiu, Emërtime popullore të zvarranikëve, SF, 1981, 3

¹⁷ Shefki Sejdiu, Fitonimia shqipe e Kosovës, 2002

¹⁸ Miço Samara, Mbi leksikun politiko-shoqëror të shqipes dhe mbi zhvillimin e tij pas çlirimit, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, 1972, f. 275-283

¹⁹ Vaskë Milkani, Vëzhgime mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit; Kornelja Sima, Vëzhgime mbi emërtimet e reja të grave sipas profesionit në fushën e prodhimit industrial pas Çlirimit, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, 1972, gjegjësisht, f. 285-293, 297-314

²⁰ Jani Thomai, Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme, 2001

²¹ Shih, ndër të tjera, Agim Poloska, Leksiku dialektor në regjionin e Prespës, Shkup, 2003

²² Vlerësime për këtë vepër dhe për autorin e saj janë bërë, përveç të tjerave, edhe në dy konferenca shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër dhe nga Universiteti “Fan Noli”, Korçë. Shih, Kërkime universitare, 2009, 22; Konferenca shkencore “Akademiku Jani Thomai në 75-vjetorin e lindjes”, Korçë, 2010

²³ Pavarësisht se, për arsye që dihen tashmë, gjuhësia shqiptare e para viteve `90 u ka qëndruar larg shkollave apo drejtimeve gjuhësore të kohës, në studimet shqiptare të fushës së semantikës në punimet teorike dhe në hartimin e fjalorëve, veçanërisht të atyre shpjegues, njëri nga drejtimit gjuhësore, strukturalizmi, ka gjetur zbatim jo të paktë. Për të argumentuar sadopak këtë pohim, mund të sjellim një shembull: Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, 1980, strukturat kuptimore të fjalëve u ndërtuan sipas sistemit konceptor strukturalist, ndarja e kuptimeve, formulimi i tyre u sendërtua mbi bazën e pesë njësive të semantikës (sema ose përbërësi kuptimor minimal, nuanca kuptimore, kuptimi leksikor, si njësi semantike themelore, nyja semantike dhe struktura kuptimore) të njohura dhe të pranuar tashmë nga

leksikore të shqipes fillon një periudhë e re zhvillimi: **ajo hyn tashmë në gjuhësinë shqiptare si një fushë e rëndësishme studimi**. Nis të dalë në këtë periudhë, ndonëse në numër të vogël, një tip i ri studimesh me karakter të njëmendët semasiologjik që, në aspektin tipologjik, mund të ndahen në dy grupe: a) studime për dukuri të semantikës, si lëvizja kuptimore dhe tropet gjuhësore, shumëkuptimësia, paradigmata e fjalëve, pra homonimet, sinonimet, antonimet etj. të kryera nga Jani Thomai, Mico Samara, Xhevat Lloshi, b) studime për grupe të ndryshme paradigmatiche të fjalëve të njësuara nga pikëpamja leksiko-gramatikore, leksiko-fjalëformuese dhe leksiko-semantike dhe që paraqesin interes në rrafshin përmbajtësor. Kështu, në gjurmët e sprovave të para të gjuhësisë shqiptare për të studiuar semantikën leksikore të fjalëve të bëra sidomos nga Androkli Kostallari me studimet e tij për kompozitat urdhërore e dëshirore dhe për veçoritë e strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes, Jani Thomai sjell në gji të monografisë së përmendur pak më lart, një model vetjak analize semantike që tregon se si mund të studiohet një klasë leksikore fjalësh, siç është ajo e emrave të lëndës²⁴, nga pikëpamja kuptimore. Disa vite më vonë, objekt studimi në rrafshin semantik bëhen dy grupe të tjera paradigmatiche fjalësh ose dy fusha të tjera leksiko-semantike: mbiemrat prejpjesorë²⁵ të shqipes nga Valter Memisha dhe emërtimet e njerëzve sipas tipareve fizike e morale²⁶ nga Idriz Metani.

Mendoj se duhen përmendur këtu, gjithashtu, si tregues i shtrirjes së semantikës leksikore, edhe ato dhjetëra e dhjetëra tema diplome të nivelit të parë, punime masteri dhe teza doktorate në Fakultetin Filologjik të Prishtinës dhe në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si edhe një numër jo i vogël syresh me vështrim krahasimtar në fushën e semantikës leksikore, ndërmjet shqipes dhe gjuhëve të tjera tek Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Le ti kthehem tani pohimit tonë të bërë në krye të kumtesës për të sqaruar shkurt përmbajtjen e tij sipas të cilit në vitet '60-70 të shekullit të kaluar semantika leksikore në fushë të shqipes nis të konceptohet edhe teorikisht. Themi teorikisht, sepse, praktikisht ajo kishte gjetur zbatim, në hartimin e fjalorëve të shqipes,

kjo shkollë gjuhësore punimet. Po ashtu, kemi mendimin se koncepti strukturalist për njësitë e semantikës i pranishëm në studimet teorike dhe i zbatuar në fushë të shqipes është një shembull tjetër që dëshmon se ndërsa gjuhësia shqiptare kishte mbyllur derën për shkollat apo drejtimit gjuhësore, ato kishin hyrë, si të thuash, nga dritarja.

²⁴ Shih, Jani Thomai, Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantikë leksikore, botim i ripunuar dhe i përmirësuar), Tiranë, 2009, f. 124-135

²⁵ Valter Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999

²⁶ Idriz Metani, Vështrim leksiko-semantik i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe, SF, 1-2, 2004, f. 93-122

sidomos të fjalorëve shpjegues të saj²⁷. Dihet që një hartues fjalori nuk mund të ndërtojë makrosistemet e njësive leksikor, pra të fjalëve, as mikrosistemet e njësive themelore të semantikës, d.m.th të kuptimeve, madje ai nuk mund të japë edhe shpjegimin për çdo kuptim, nëse nuk ka një formim të caktuar në fushën e semantikës leksikore.

Si përfundim, mund të themi se studimet shqiptare në fushën e semantikës leksikore, ndonëse të pakta e disi të vonuara, janë e ardhmja e shkencës albanologjike shqiptare. Ato duhet të bëjnë objekt analize e shqyrtimi rrafshin përmbajtësor të shqipes, e cila ka sot me dhjetëra klasa leksikore, semantike e fjalëformuese fjalësh, përveç atyre që u përmendën shkurt në këtë kumtesë, që presin të studiohen në këtë rrafsh, pra në rrafshin semantik.

Njëherazi dëshiroj që, në këtë 100-vjetor të Pavarësisë së shtetit shqiptar, t'i bëj dy propozime këtij tubimi të nderuar shkencor, të cilat mund të jenë edhe detyra që shkenca albanologjike shqiptare t'i përmbushë në të ardhmen: **së pari**, të bashkojmë forcat dhe vullnetet tona shkencore për të organizuar në të ardhmen një konferencë shkencore në fushën e semantikës; **së dyti**, mendoj se janë të gjitha mundësitë që të kompaktësojmë studimet tona në fushën e semantikës për të përgatitur dora-dorës një grup studiuesish semasiologë të mirëfilltë që do të kenë në dorë studimin e shqipes në rrafshin semantik.

²⁷ Për rrugët nëpërmjet të cilave është zhvilluar semantika leksikore e shqipes, shih, ndër të tjera dhe Jani Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2006, f. 72-78

Rrahman PAÇARIZI

ÇËSHTJE TË TERMINOLOGJISË NË PSIKOLINGUISTIKË – QASJA KOGNITIVE NDAJ TERMINOLOGJISË

Duke qenë një disiplinë e re shkencore e gjuhësisë dhe për shkak të natyrës interdisiplinare të saj, Psikolinguistika në shqip përballet me probleme të shumta terminologjike, në njërin anë për shkak se nuk është popullarizuar mjaft dhe nuk është bërë pjesë e programeve studimore të gjuhësisë dhe të psikologjisë në Universitetet shqiptare e në anë tjetër, për shkakun se studimeve mbi terminologjinë nuk u është kushtuar kujdesi dhe vëmendja e duhur.

Që në fillim dua të theksoj përkufizimin mbizotërues për terminologjinë në studimet moderne. Terminologjia është gjuhë e specializuar.

Sidoqoftë, tani që shkenca shqiptare ka nisur të hyjë në rrjedhat e shkencës botërore, nevoja për një qasje shkencore ndaj terminologjisë është e pashmangshme, pasi qasja e deritashme nuk i përmbush nevojat, madje as për shkencat albanologjike, të cilat tashmë nuk mund të kundrohen të ndara nga shkenca botërore. Meqenëse ka bazë semantike, terminologjia tradicionale është shikuar nga tri këndvështrime të ndryshme- këndvështrimi referent (duke u mbështetur në subjektin të cilit i referohemi), këndvështrimi i dizajnit referent (mbështetur në ndërtimin e rrethanave dhe mjedisit për referentin e perceptuar si të tillë) dhe këndvështrimi i kombinuar - kur vihet shenja e barazisë ndërmjet dizajnit dhe referentit, por gjithnjë dhe të gjitha janë të mbështetura mbi konceptin dhe mbi terminologjinë tradicionale ndërtuar mbi bazën e fjalëve të latinishtes dhe greqishtes së vjetër.

Sager (1990:13) ka identifikuar tri dimensione të teorisë së terminologjisë, ndër të cilat dimensionin kognitiv që ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet formës linguistike dhe përmbajtjes konceptuale (referenti në botën reale); dimensionin gjuhësor që ekzaminon format ekzistuese dhe potenciale të përfaqësimit të terminologjisë dhe dimensionin komunikativ që ka të bëjë me përdorimin e terminologjisë dhe duhet të arsyetojë aktivitetin njerëzor të prodhimit dhe kompi-limit të terminologjisë.

Terminologjia si disiplinë ka nisur më 1930 me Eugen Wüster, autor i Fjalorit Ndërgjuhësor të Koncepteve Themelore (1968). Inxhinieri dhe industrialisti Wüster, kishte zhvilluar konceptin e terminologjisë tradicionale sipas të cilit parimet e shkollës së Vjenës janë ndërtuar mbështetur në disa perspektiva ndër të cilat më shumti kanë gjetur shprehjen-perspektiva onomasiologjike, perspektiva semasi-

ologjike dhe qartësia konceptuale. Sipas Wusterit, mbështetur në perspektivën onomasiologjike “Terminologjia nis me konceptin dhe synimin për përkufizimin e qartë të secilit koncept. Me këtë rast do pasur parasysh se dallimi kryesor në leksikologji ekziston në perspektivën semasiologjike dhe onomasiologjike – e para nisët nga aspekti formal, apo nga fjala, ndërsa e dyta nisët nga aspekti përmbajtësor i shenjës ose kuptimi. Mirëpo, Wuster thekson se ka një dallim esencial ndërmjet qasjes linguistike dhe asaj terminologjike. Madje, pasuesi i tij, Felber (1984) shkon edhe më larg duke vënë shenja dallimi ndërmjet studimit të koncepteve (që e quan konceptuologji) dhe semantikës si të tillë çfarë e njohim ne.

Sipas tij, konceptet janë të qarta (clear-cut) - ato nuk duhen studiuar si të izoluar, por më shumë si elemente në një sistem koncepti që mund të nxirret mbështetur në studimin e afërt të karakteristikave të një koncepti (Fleber, 1984: 120) “Mëqenëse konceptet përbëhen nga karakteristikat, ato kanë marrëdhënie direkte me konceptet e tjera të cilat kanë karakteristika të njëjta me logjikën e qëllimit të tyre, që do të thotë, përafërsisht, se vetë karakteristika në njëfarë mënyre është edhe koncept (Fleber, 1984:117).

Por, a është e mjaftueshme një qasje e tillë? Rita Temmerman mendon se kjo nuk mjafton në rrethanat e sotme të globalizmit dhe nuk përmbush nevojat e komunikimit dinamik global. Për këtë arsye ajo ka zhvilluar konceptin e ashtuquajtur sociokognitiv, i cili mbështetet në metodologji të kombinuar të përpilimit të terminologjisë. Esencial në këtë kuptim është mbështetja jo në kuptimin a domethënien, si qasje tradicionale, por në të kuptuarit e termit si qasje socio-kognitive dhe krejt kjo e mbështetur në polisemi më shumë sesa në qartësi terminologjike, pikërisht për shkak të tendencës interdisiplinare.

Temmerman (2000: 16) ndër zhvillueset e qasjes sociokognitive në terminologji, ka kritikuar Teorinë e Terminologjisë së Përgjithshme dhe ofron shembuj se parimet e kësaj teorie janë jorealiste dhe nuk kanë kapacitet për të përshkruar apo shpjeguar gjuhën e specializuar ashtu siç përdoret në situatat komunikative si përshkthimi i specializuar.

	Teoria e Terminologjisë së Përgjithshme Felber	Qasja Sociokognitive Temmerman
1	Konceptet kanë rol qendror në raport me dizajnimin e tyre linguistik	Gjuha nuk mund të konsiderohet si e shkëputur nga konceptet përderisa luan rol crucial në konceptimin e kategorive
2	Konceptet dhe kategoritë kanë kufij qartë të dallueshëm	Shumë kategori kanë kufij të paqartë dhe nuk mund të definohen
3	Definicionet terminografike gjithmonë duhet të jenë intensionale (me referencë të qartë)	Struktura dhe lloji optimal i definicionit nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në një mënyrë dhe përfundimisht kjo varet nga koncepti të cilin e definon

4	Referencat monosemike janë rregull në terminologji kur ka një marrëdhënie një me një ndërmjet termit dhe konceptit	Polisemia dhe sinonimia ndodhin shpesh në gjuhën e specializuar dhe duhen përfshirë në analizat realiste terminologjike
5	Gjuha e specializuar mund të studiohet vetëm në aspektin sinkronik	Kategoritë, konceptet si dhe termat që zhvillohen me kalimin e kohës, duhet të studiohen në aspektin diakronik. Në këtë kuptim, modelet kognitive luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ideve të reja

Tab. *Krahasim ndërmjet parimeve të Teorisë së Terminologjisë së Përgjithshme (GTT) dhe Qasjes Sociokognitive në terminologji*

Fakti që studiuesi nga fillimi i këtij punimi pati përdorur termin zhargon në vend të argo, e shpjegon më së miri gjendjen e terminologjisë së mbështetur në teorinë e terminologjisë së përgjithshme apo tradicionale të njohur si GTT, pasi sipas kësaj qasjeje termi nuk trajtohej si njësi gjuhësore dhe në vende nuk përmbante tiparet e konceptit të synuar dhe së këndejmi vlera semantike ishte arbitrare dhe e ngulitur dhe jo heuristike, në mënyrë që të kishte një kuptim i cili krijon parakushte për të gjetur kuptimin themelor. Pra, termi zhargon ashtu si argo përderisa nuk arrijnë të dëshmojnë sjellje të kuptimshme dhe përmbajtjesore brenda tekstit apo të folurit të lidhur, rrezikojnë që në mënyrë ciklike të përdoren në vend të njëri-tjetrit. Terminologjia tradicionale vendosen shenja dalluese ndërmjet termave dhe fjalëve, pra nuk i trajtonte termat si njësi gjuhësore.

Përpyekja për të gjetur dallime ndërmjet termave dhe fjalëve nuk është më e frytshme dhe e vlefshme, prandaj mënyra më e mirë e studimit të njësive të dijes së specializuar është studimi i sjelljes së tyre brenda tekstit. Meqenëse funksioni i përgjithshëm i teksteve të specializuara gjuhësore është transmetimi i dijes, tekstet e tilla synojnë të formësohen në modele (yrrneqe) me qëllim të sigurimit të kuptimit dhe përgjithësisht karakterizohen nga një përsëritje më e madhe sesa termat e zakonshëm, frazat, fjalitë dhe madje edhe paragrafët e tërë. Tekstet shkencore dhe teknike zakonisht janë më të pasura në aspektin e terminologjisë, për shkak të sasisë së njësive të specializuara gjuhësore që përmbajnë. Përqendrimi i madh i njësive të tilla në tekst çon kah një aktivizim i sektorëve në domene specifike të dijes dhe si rrjedhojë, të kuptuarit e tekstit të pasur me terminologji, kërkon njohje të domenit, të koncepteve brenda tij dhe raporteve prepozicionale në kuadër të tekstit, si dhe të marrëdhënieve konceptuale në kuadër të domenit. Ky është hapi i parë drejt krijimit të një teksti të synuar që është i pranueshëm. Të gjitha këto elemente janë të synuara nga terminologjia e mbështetur në kornizën kuptimore.

Sipas Pamela Faber-it (2009), terminologjia e kornizuar përqendrohet në: (1) organizimin konceptual; (2) natyrën shumëdimensionale të njësive terminologjike; dhe (3) ekstraktimin e informacionit semantik dhe sintaksor përmes përdorimit të korpusit multilingual. Në terminologjinë e kornizuar, rrjetet konceptuale mbështeten në një domen i cili prodhon yrrneqe për veprimet dhe proceset që ndodhin në fushën e specializuar, si dhe për entitetet që marrin pjesë në të.

Studimi i gjuhës së specializuar po kalon nëpër një ndryshimi kognitiv që çon kah një përqendrim i theksuar në kuptimin si dhe në strukturën konceptuale të cilës i nënshtrohen teksti dhe gjuha në përgjithësi. Duket se teoria mbi terminologjinë po zhvillohet nga preskriptive në deskriptive me fokus të shtuar në studimin e njësive të gjuhës së specializuar nga perspektiva sociale, linguistike dhe kognitive.

Si fushë studimi me premisa të shkoqitura, terminologjia del nga nevoja e teknikëve dhe shkencëtarëve për të njësuar konceptet dhe termat e fushave të tyre studimore me qëllim të realizimit të komunikimit profesional dhe bartjes së dijes. (Cabré 2000: 37).

Kognitivistët si Faber, Temmerman e të tjerë mendojnë në se terminologjia është veprimtari linguistike dhe kognitive, pasi termat janë njësi gjuhësore që përmbajnë kuptime konceptuale në kuadër të kornizës së teksteve të dijes së specializuar. Në kuptim të natyrës së termit, ky proces i transmetimit të kuptimit është po aq i rëndësishëm sa edhe koncepti të cilin ai e dizajnon. Një qasje e tillë, sipas tyre, duhet të jetë leksikocentrike dhe e mbështetur në përdorim, si dhe e fokusuar në përfaqësimin kuptimor dhe konceptual. Në të vërtetë, kjo është esenca teorike e qasjes kognitive gjuhësore.

Në të kaluarën, Terminologjia dhe Linguistika kryesisht kanë injoruar njëra-tjetrën. Në fazat fillestare, Terminologjia ka qenë e interesuar për pavarësim nga fushat e tjera të dijes, me synimin për të krijuar një disiplinë krejtësisht të pavarur. Terminologët kanë shkuar aq larg sa kanë thënë se termat nuk janë fjalë. Njëjtë është sjellë edhe linguistika duke sforcuar idenë se gjuha e specializuar është konsideruar si rast i vecantë i gjuhësisë së përgjithshme.

Sipas Pamela Faber-it, teoritë kognitive përqendrohen në aspekte sociale, komunikative dhe kognitive të terminologjisë. Vizioni që ofrojnë është më realist, pasi ata analizojnë termat ashtu siç përdoren dhe ashtu siç sillen në tekst. Ky prandaj, është ndërrimi kognitiv në qasjen ndaj terminologjisë.

Përkthimi i fjalëpërfjalshëm nuk na con askund, pasi ekzistojnë korniza të ndryshme referenciale. Prandaj, thotë studiuesja ruse, Natalya Gvishani, duhet njohur sistemi si tërësi për të qenë në gjendje të gjejmë ekuivalentin e qëndrueshëm në gjuhën e synuar nacionale, për termin e huaj, pasi analiza kontrastive e terminologjive nacionale mbështetet në përparësinë e përmbajtjes. Ne nuk mund ta kufizojmë vetveten vetëm tek emrat pa pasur parasysh edhe vetë subjektin – konceptet dhe nocionet themelore të tij. Interesimi për faktet dhe idetë na shtyn të ndërmarrim një qasje kognitive, me përqendrim në dijen enciklopedike. Ne fillojmë me konceptin, pasi besojmë se duke identifikuar konceptin, mund ta zgjidhim së paku një pjesë të problemit- të ofrojmë një definicion të qartë për atë që bëhet fjalë, pra për nocionin në shqyrtim. Problemi tjetër është se si ne flasim për këtë nocion, pasi mund të ketë më shumë se një term për një koncept të vetëm dhe ky është një nga premiset me të cilat Timmerman i kundërvihet Teorisë së Terminologjisë së Përgjithshme.

Për këtë arsye, analiza kontrastive përmes metadialekteve na mundëson të krijojmë një ide se si përdoret termi. Ne nivelin metataksomik, shqetësimi ynë kryesor është aspekti heuristik i subjektit – metodologjia e marrjes me termin dhe sistemin terminologjik me qëllim të standardizimit dhe optimalizimit të mëtejshëm:

“Dimensioni ndërkombëtar” i përdorimit të termave përbën majën e kërkimeve në këtë fushë. Qasja heuristike është e pandashme nga ajo ontologjike: nëse formuluesi i termit merr parasysh strukturën dhe përbërjen e termit (plani ekspresiv), më pas ai është përgjegjës edhe për përmbajtjen.

Çështja del te qasja që duhet adoptuar për t’iu qasur terminologjisë. Si të veprohet me traditën terminologjike të shkencës botërore, që është një qasja standardizuese optimalizuese e mbështetur në latinishten dhe në greqishten e vjetër. Akhmanova (1977, 91-92) thotë se fjalët ndërkombëtare (me origjinë latine ose greke) që na kthejnë në retorikën e lashtë nuk sigurojnë transmetim direkt dhe të tërësishëm të informatës, por në të njëjtën kohë sigurojnë korrespondencën më të plotë të mundshme ndërmjet shprehjes origjinale dhe asaj metalinguistike të përkthyer.

Tani, qasja kognitive kërkon që të përdoret një term i cili vihet në funksion të informatës dhe të komunikimit, dhe jo që të jetë term për vetveten, sic janë termat latine. Kjo qasje siguron komunikim më efikas dhe më përmbajtjesor, rrjedhimisht edhe më te gjerë, brenda një komuniteti gjuhësor, pasi termat e latinishtes dhe te greqishtes së vjetër, jo vetëm që kanë probabilitet më të lartë të të qenit të pakuptueshëm, por duke qenë se vijnë nga gjuhë tashmë të vdekura, nuk arrijnë të jenë krejtësisht të përputhshme me nevojat e komunikimit, pra nuk e krijojnë maksimalizimin e përputhjes konceptuale me rastin e të kuptuarit të gjuhës në secilin domen përdorimi. Mirëpo, përparësia e përdorimit të këtyre termave vazhdon të mbetet në standardizimin e tyre, si dhe në faktin që kapërcejnë në masë të madhe barrierat ndërmjet gjuhëve, duke realizuar në një masë edhe dimensionin e optimalitetit standardizues. Për shembull, në rastin e shqipes kemi emërtime shqipe për rasat, por mosnjohja e termave latine për rasat respektive nuk na siguron absorbimin e rezultateve jashtë gjuhësisë shqiptare. Së këndejmi jemi të obliguar që në gramatika të përdorim edhe terminologjinë ndërkombëtare nga kjo fushë. Mirëpo, nëse ndërtojmë një qasje kognitive a duhet të përdorim termin gjinore për genitivin? Sigurisht që jo, pasi gjinia është komponentë fakultative e kësaj rase dhe nuk shpreh tiparin kryesor të saj që është përkatësia. Në një qasje kognitive kjo rasë do të quhej përkatësore, për shembull.

Dhe, ndërkohë që zgjedhja e metodologjisë së definimit dhe kompilimit të terminologjisë mbetet të diskutohet, disiplinat e reja linguistike janë ndeshur tashmë më nevojën e së paku përkthimit të terminologjisë në rastet kur kjo është e mundshme, apo më mirë me thënë, kur kjo është e domosdoshme, pasi që përdorimi i terminologjisë nga gjuhët referente është problematik dhe mund të pengojë kanalet e komunikimit. Zëvendësimi i gjuhës së terminologjisë së shkencës botërore nga latinishtja e greqishtja e vjetër në anglishte ka nxjerrë në shesh probleme të tjera. Për shembull psikolinguistika duke mos gjetur terma korrespondues brenda gjuhësisë tradicionale është detyruar të krijojë terminologji të re, mbi bazën gjuhësore të anglishtes, pikërisht mbështetur në qasjen sociokognitive që i jep përparësi domethënies përpara kuptimit. Në shqipen, së paku deri tash termat e anglishtes janë përkthyer, më shumë mbështetur në dijen dhe vullnetin e vetë atyre që kanë përkthyer nga kjo fushë e që fatkeqësisht janë paktë. Në këtë situatë nuk mund të flitet për një qëndrueshmëri terminologjike në këtë fushë, e aq më pak për ndonjë qasje të avancuar metodologjike sa i përket terminologjisë.

Në rastin e shqipes ka edhe probleme të tjera që lidhen me gjuhësinë normative tradicionale. Tani ka nevojë të shihet se sa kjo është në pajtueshmëri me gjuhësinë tradicionale dhe sa mund të interferojë terminologjia e Psikolinguistikës në pjesën që ajo ka të bëjë me nocione të gjuhësisë së përgjithshme, para së gjithash në morfologji, sintaksë, leksikologji e fonetikë, për shkakun se këto disiplina në librat normativë, metodologjikisht vazhdojnë të jenë të mbështetura në shkencën sovjetike.

Diskutimet e viteve të fundit mbi terminologjinë në sintaksë, leksikologji, gjuhësi teksti etj, që nuk kanë arritur ende të hyjnë në librat normativë kanë nxjerr në shesh telashet lidhur me emërtimin e gjymtyrëve të fjalisë, njësave tekstore, natyrës së diskursit, mikrostrukturave dialektologjike, situatave, regjistrave etj., dhe në këtë plan Psikolinguistika nuk arrin të gjejë një term të qëndrueshëm për sintagmën apo togfjalëshin, me rastin e një studimi eventual lidhur me marrjen e perspektivës.

Interdisiplinariteti shkencor, rrit edhe më shumë nevojën për standardizim terminologjik. Rainer Arntz (1993:5) thekson se parimi rrënjësor në shkencë dhe metodologji si dhe në mjetet e komunikimit, sa i përket terminologjisë kërkon rregulla strikte dhe një standardizim më rrënjësor të gjuhës. Për të qenë në gjendje të sistematizojmë informatat që futen në bazat e të dhënave apo për të analizuar sasi të konsiderueshme të të dhënash nxjerrë nga sistem të ndryshme, vokabulari i fushave të caktuara duhet të kontrollohet. Të kontrollohet në këtë kuptim do të thotë se ka shumë nevojë për përpjekje për zhvillim të vokabularit që na mban në linjë me zhvillimet në fushat e caktuara dhe që ndihmojnë për të ndërtuar vokabularë të qëndrueshëm.

Në punimin e tij “Terminological equivalence and translation”, Arntz flet për ekuivalencën ndër-gjuhësore, me rastin e marrjes me punë shkencore, ku involvohen më shumë se një gjuhë, qoftë për shkak të literaturës së shfrytëzuar, qoftë për shkak të gjuhës së korpusit të hulumtuar në shkencat humane. “Problemi bëhet edhe më i komplikuar kur krahasohen njësi më të mëdha si fjalitë, pjesët e tekstit apo tekste të tëra. Së këndejmi, nuk është befasuese se çështja e ekuivalencës interlinguale luan rol qendror në teorinë e përkthimit”. Mirëpo, thotë Arntz kushtet për krahasim ndër-gjuhësor janë shumë të favorshme në fushën e terminologjisë, pasi “termat e definueshëm apo të definuar janë në qendër të interesit, ndërkohë që konotacionet luajnë rol dytësor”.

Konkretisht, nëse shikojmë për shembull një fjalor terminologjik të Psikolinguistikës të Universitetit Victory, gjejmë rreth 470 njësi terminologjike, shumica dërrmuese e të cilave nuk janë përdorur aq shumë në studimet në shqip sa të jenë bërë pjesë lehtë e absorbueshme në planin terminologjik. Sidoqoftë, një pjesë e mirë e tyre janë të përkthyeshme, por disa të tjera paraqesin problem, prandaj, në përvojën time si ligjërues i psikolinguistikës jam detyruar që konceptet e njëjta të autorëve të ndryshëm, në rastet ku ata kanë përdorur terminologji të ndryshme, studentëve të përpiqem t’ua përkthej në shqip dhe t’ua jap edhe ekuivalentët e tyre në anglisht, në mënyrë që të mund të orientohen brenda literaturës eventuale shtesë që mund të kenë nevojë për ta lexuar. Për shembull nuk kam gjetur një fjalë të përshtatshme shqipe për të emërtuar fazën e përzgjedhjes leksikore nga qasja leksikore deri te përzgjedhja e lemës, dhe e kam përdorur termin latencë nga

anglishtja “latency”, pastaj articulation edhe mund të quhet nyjëtim, por a mund ta quajmë pauzë nyjëtuese termin “articulative pause” (heshtje që rrjedh nga procesi i artikulimit më shumë sesa pauzë që indikon procesin e planifikimit). A mjafton të quhet konceptualizim (anglisht conceptualization) faza nistore e prodhimit gjuhësor, kur prodhohet mesazhi paraverbal në bazë të synimit të folësit apo shkruarit dhe si të përkthehet saktë për të përmbushur nevojat semasiologjike të shqipes termi constituent assembly, që është formimi i kornizës sintaksore gjatë procesit të kodimit gramatikor.

Gjithsesi, ne rastin e shqyrtimit metodologjik, do pasur parasysh ndikimi dhe shtrirja e anglishtes edhe në fushë të terminologjisë dhe nevoja për standardizimin global të terminologjisë dhe qasjen që do të ndërtojë shqipja në këtë mjedis, mendoj, natyrisht duke marrë parasysh edhe qasjen sociokognitive, procesin e globalizimit dhe natyrën interdisiplinare të gjuhësisë aplikative, përfshirë dhe psikolinguistikën. Meqë latinishtja e ndonjëherë edhe greqishtja e vjetër përgjatë shekujsh kanë shërbyer si referentë linguistike për terminologjinë, shmangia e tyre e menjëhershme dhe zëvendësimi i tyre nga anglishtja është i pamundur. Tani, anglishtja po e zë vendin e saj në terminologjinë e përgjithshme të shkencës dhe të komunikimit për arsye shkencore, krejtësisht për të njëjtën arsye për të cilën latinishtja u ngrit në nivelin e gjuhës së shkencës, pasi shkenca me dinamikën e saj të zhvillimit dhe nevojën për të qenë në shërbim të të gjithëve, duhet të ketë një kod të standardizuar komunikimi, për të pasur shtrirje (që do të ishte qëllim në vetvete i shkencës), apo për t’u shfrytëzuar të arriturat e saj në planin global. Dhe, pikërisht arsyeja e dytë del të jetë baza mbi të cilën mbështetet qasja sociokognitive në terminologji. Aktualisht vetëm anglishtja i ka kapacitetet për të ofruar një logjistike efikase dhe të mjaftueshme për realizimin e këtij synimi, meqë ajo është lingua franca globale.

Literatura

1. Akhmanova, O. S. (1966), *A dictionary of linguistic terms*, Sovetskaja ènciklopedija, Moscow.
2. Atkins, S.; M. Rundell & S. Hiroaki. (2003), *The contribution of Framenet to*
3. Barsalou, L. W. (2003), *Situated simulation in the human conceptual system*, Language and Cognitive Processes 18. pp. 513-562.
4. Cabré Castellví, M.T. (2000a), *Elements for a theory of terminology: Towards an alternative paradigm*, Terminology 6(1). pp. 35-57.
5. FABer, P. (2002), *Terminographic definition and concept representation*, In: Maia, B. (ed.) *Training the Language Services Provider for the Neë Millennium*. Oporto (Portugal): University of Oporto. pp. 343-354.
6. Faber, Pamela. (2009), *The cognitive shift in terminology and specialized translation*, *MonTI. Monografías de Traducción e Interpretación*, no. 1: 107-134
7. FelBer, H. (1984), *Terminology Manual*. París: UNESCO & INFOTERM.

8. Felber, Helmut, Terminology Manual, Prep. H. Felber/General Information Programme and UNISIST/ International Information Centre for Terminology, Paris; UNESCO and Infoterm, 1984:31
9. Fillmore, C. J. (1976), *Frame semantics and the nature of language*, In: Harnad, S. R.; H. D. Steklis & J. Lancaster (eds.) *Origins and Evolution of Language and Speech*. Annals of the NY Academy of Sciences, 280. pp. 20-32.
10. Natalya B. Gvishiani, Terminology as knowledge banks: the cognitive approach (with special reference to multilingual lexicography) në: [http://www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex1992_1/023_Natalya%20B.%20Gvishiani%20-Terminology%20as%20knowledge%20banks-%20the%20cognitive%20approach%20\(with%20special%20re.pdf](http://www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex1992_1/023_Natalya%20B.%20Gvishiani%20-Terminology%20as%20knowledge%20banks-%20the%20cognitive%20approach%20(with%20special%20re.pdf)
11. Sager, J. C. , *A practical course in terminology* Process, Amsterdam/Philadelphia, Benjamins 1990
12. Temmerman, R. (1997), “Questioning the univocity ideal. The difference between sociocognitive Terminology and traditional Terminology”. *Hermes. Journal of Linguistics* 18. pp. 51-91.
13. Temmerman, R. (2000), *Towards New Ways of Terminology Description*, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.
14. Temmerman, R. (2001) “Sociocognitive terminology theory”. In: Cabré, M.T. & J. Feliu (eds.) *Terminología y Cognición*. Barcelona: Universitat Pompeu Fabra. pp. 75-92.
15. Wüster, E. (1968), *The Machine Tool. An interlingual dictionary of basic concepts*, London: Technical Press.

Rezearta MURATI

POLITIKA GJUHËSORE NË SHQIPËRI NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XX

Gjuha mund të shihet njëkohësisht si një kod që mundëson komunikimin në një shoqëri dhe si një sjellje shoqërore. Si një kod konvencional ajo është një sistem rregullash i përbërë nga subsistemet e saj. Të gjitha gjuhët dhe varietetet janë të përshtatshme përderisa i mundësojnë përdoruesve të tyre dhënien e kuptimeve, paraqitjen e proceseve logjike, të proceseve të menduarit dhe në mënyrë të përgjithshme i lejojnë atyre komunikimin me njëri-tjetrin. Por gjuha është më shumë se një kod, përfshin edhe sjellje shoqërore. Si një sjellje shoqërore gjuha hyn në një sferë që ka normat e saj, të cilat bazohen në një marrëveshje për sa i përket sjelljes gjuhësore të përshtatshme ashtu edhe në aftësinë dhe mundësinë e disa individëve t'u imponojnë standardin e tyre të tjerëve.

Politika gjuhësore mund përkufizohet si *“aktivitet i ndërgjegjshëm me të cilin shteti ose pushteti vendos të ndërhyjë në mënyrë sistematike dhe të rregullt me qëllim që të modifikojë një gjuhë, ose raportet që ekzistojnë midis varianteve të ndryshme gjuhësore në një territor të dhënë”*¹, ose ndryshe mund të përcaktohet si *“tërësia e zgjedhjeve të ndërgjegjshme të kryera në fushën e raporteve ndërmjet gjuhës dhe jetës kombëtare”* ose *“tërësia e zgjedhjeve në rrafshin e gjuhës dhe të jetës kombëtare”*.²

Politika gjuhësore përfshin jo vetëm modelin e vetëm të zgjedhjes mes varieteteve të gjuhës, por edhe besimet rreth përzgjedhjeve dhe vlerat e varieteteve dhe varianteve, gjithashtu në mënyrë më të spikatur përfshin përpjekjet e bërë nga disa për të ndryshuar zgjedhjen dhe besimet e të tjerëve.

Grafikalizimi është hapi i parë në standardizimin e një gjuhe. Është një proces i kthimit të një gjuhe të folur në gjuhë të shkruar dhe me zhvillimin e saj. Grafikalizimi fillon me një përshkrim fonetik të gjuhës e mbi bazën e këtij përshkrimi projektohet ortografia duke përdorur konceptin e një alfabeti. Kjo formon themelin mbi të cilin vendosen materialet e shkrimit dhe leximit që si

¹ Ch.Baylon, Sociolinguistique, Societé, Langue et Discour, Paris, 1991, f. 184.

² Louis-Jean Clavet, La guerre des langues et les politiques linguistiques, Paris, Payot, f. 154.

rrjedhojë redukton ndryshueshmëritë gjuhësore. Në këtë mënyrë mospërputhjet gjuhësore mes varieteteve dhe gjuhëve bërthamë do të reduktohen.

Përdorimi i shkrimit në një komunitet folësish të një gjuhe mund të ketë efekte sociokulturore të përhershme, që përfshijnë transmetimin më të lehtë të materialeve ndërmjet brezave, komunikimin me një numër më të madh njerëzish dhe një standard me të cilin shpesh varietetet e tjera të folura mund të krahasohen.³

Në Shqipëri përpjekja e parë për hartimin dhe zbatimin e një politike gjuhësore kombëtare dhe për zgjidhjen e problemit të një gjuhe letrare shqipe i takon Kongresit të Manastirit. Nga data 14 deri me 20 nëntor 1908 për herë të parë u mbledhën në Manastir përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Të pranishëm në Kongres ishin delegatë të ardhur nga të gjitha viset shqiptare dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Egjipt, Amerikë, etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri. Kongresi përfundoi me një kompromis duke lejuar përdorimin e dy alfabeleve; alfabetit që kemi sot dhe alfabetit të shoqërisë së Stambollit, por koha shpejt tregoi epërsisë e alfabetit me 36 shkronja që përdorim ne sot. B. Beci shprehet se: *ky Kongres dëshmoi edhe një herë orientimin perëndimor të politikës kulturore e gjuhësore kombëtare shqiptare*⁴

Por me një vendim të vitit 1909 qeveria turke mbylli të gjitha shkollat shqipe dhe dha urdhër të prerë të shuhen në zjarr të gjitha librat, dokumentet dhe letërsia shqipe.

Si rrjedhojë e kundërvënies e këtij urdhri, po në vitin 1909 u mbajt Kongresi i Elbasanit, i cili mori vendim që shqiptarët do të përpiqeshin të futnin gjuhën shqipe në çdo mësonjëtorë të huaj që gjendej në Shqipëri, dhe do të kërkohej që gjuha shqipe të ishte gjuhë e mësimëve në mësonjëtorët e para e në të dyta të qeverisë që gjendej në Shqipëri, gjithashtu Kongresi u kërkonte të gjithë shkrimtarëve që të përdornin në shkrimet e tyre, me sa të mundën dialektin e Elbasanit me arsyetimin se është dialekti që kuptohet në të gjitha anët e Shqipërisë. T. Plangarica shprehet se ky kongres: *“me të drejtën dhe statusin e një përfaqësie mbarëkombëtare të institucionalizuar, përcaktoi një linjë të qartë të politikës gjuhësore për kohën”*⁵ Mund të themi se ky Kongres është një hap i rëndësishëm në formulimin dhe aplikimin e një politike gjuhësore për shqipen dhe i parapriu denjësisht Komisionit Letrarez Shqipe.

³ Ferguson, Charles A. (1968). “Language Development”, in Charles A. Ferguson, Thom Huebner (1996), *Sociolinguistic Perspectives: papers on language in society, 1959-1994* Oxford University Press US, pp 40-47.

⁴ B. Beci, f. 55

⁵ Plangarica (1997), 75-85; Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i manastirit, 1972, 249-251.

Në një situatë të nderë politike e kulturore në vitin 1910 u thirr Kongresi i dytë i Manastirit, gjatë punimeve të të cilit u vendos të vazhdojë përdorimi i alfabetit kombëtar me shkronja latine.

Zgjedhja e normës, përveç aspektit thjeshtë gjuhësor që nënkupton përzgjedhjen e një varianti të një gjuhë mbi bazën e të cilit do të ndërtohet një gjuhë standarde, ngërthen në vete edhe aspektin shoqëror, që manifestohet me mbajtjen e qëndrimeve dhe parapëlqime të caktuara ndaj një varianti gjuhësor nga grupet e caktuara shoqërore dhe këto qëndrime dhe parapëlqime janë kryesisht arbitrare dhe me prapavijë politike, ideologjike, kulturore e regjionale. Por zgjedhja e një gjuhe nuk duhet të shkaktojë përçarjen e strukturës shoqërore prandaj politika jashtë-gjuhësore duhet të merret parasysh. Statusi i një gjuhe është një koncept relativ i funksioneve të gjuhës, por është edhe relativ i gjuhëve të tjera dhe përshtatshmërisë e pranueshmërisë së tyre për të përmbushur funksione të caktuara në një komunitet.

Hapin e parë për përzgjedhjen dhe vendosjen e një norme gjuhësore në Shqipëri e ndeshim tek Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës.

Sipas të përkohshmes “Lajmet e Komisionit Letrare Shqipe”, 1918 mësojmë se Komisia filloi veprimtarinë e saj me 1 shtator 1916. Por sipas T. Osmanit nga të dhënat e dala në dritë mund të themi se puna përgatitore kishte filluar edhe më herët me marrjen e lejes nga autoritetet e komandës austriake, sepse për një organizim të tillë nuk mjaftonte vetëm dëshira e pjesëmarrësve të saj. Me 30 korrik të vitit 1916 ishte marrë vendimi për miratimin e Komisionit, pasi autoritetet austriake kishin dhënë koncesion edhe për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, sipas këtij vendimi Komisia do të mblidhej në selinë e komandës austriake. Një tjetër version për fillimin e Komisionit është dhënë nga Pal Dukagjini i cili në monografinë e tij “Gjergj Fishta jeta dhe vepra” (Tiranë, 1992, fq. 100) shprehet “*Dishiri dhe përkrahja e Austrisë për të mëkambë gjuhën shqipe i dhanë zemër veteranëve të kombit për punë përherë e ma të vlershme në këtë drejtim. Kjo përkrahje trimënoi L.Gurakuqin të themelonte , më 3 gusht 1916, nën mbrojtjen e autoriteteve ushtarake të kryesueme nga gjeneral Trollman dhe i ndikuem nga Dr. R. Nachtigal, studiues ky i gjuhës sonë, si dhe nga dr. Gjergj Pekmezi Komisionit Letrare*”

Nga sa shohim nga dokumentet dhe dëshmitë përgatitja dhe mbajtja e Komisionit Letrare Shqipe në Shkodër ishte një qëndrim dhe veprim i mirëfilltë politik me ndikim të pa diskutueshëm në kulturë dhe në gjuhë. Dëshira e studiuesve shqiptarë dhe të huaj si dhe e atdhetarëve nuk mund të arrinte në një përfundim të tillë pa mbështetjen dhe miratimin e autoriteteve austriake të cilat nuk kishin shumë kohë që ishin vendosur në Shkodër. R. Elsie në “Historia e letërsisë Shqiptare” (Tiranë-Pejë, 1997, fq.285.) shprehet “*Fishta luajti një rol udhëheqës në Komisionin Letrare Shqipe, të ngritur prej austro-hungarezëve me sugjerimin e konsullit të përgjithshëm August Ritter von Kral për të vendosur në lidhje me çështjen e*

përdorimit zyrtar të drejtshkrimit, si dhe për të nxitur botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe.”

Themeluesit e KLSH ishin personalitete në fushën e letrave shqipe të asaj periudhe, Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Sotir Peci, Ndre Mjeda, Mati Logoreci dhe Ambroz Marlaskaj. Pjesëmarrës të tjerë të mbledhjeve të mëvonshme të Komisionit ishin emra të tillë si: Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Maksimilian Lamberg, Aleksandër Xhuvani, Rajko Nahtigal, etj.. Prej tyre Mjeda, Fishta, Gurakuqi dhe Peci kishin qenë pjesëmarrës edhe në kongresin e Manastirit.

Mund të themi se Komisioni ishte e mirëkualifikuar për një hulumtim shkencor rreth çështjes së një gjuhe letrare të përbashkët. Vendimi i saj ishte vendosja e të folmes së gego-jugore të Elbasanit “me disa përmirësime” si bazë për konvergimin e dy dialekteve. Konvergimi duhet të ishte i shkallëshkallshëm dhe rezultat i një kompromisi të arsyeshëm, siç ishte arritur edhe në Kongresin e Alfabetit. Vendimet e Komisionit patën më shumë karakter tendencë-tregues sesa natyrë normative.

Ky Komision gjuhëtarësh dhe shkrimtarësh, i krijuar për të ndihmuar në formimin e një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, e vlerësoi variantin letrar të mesëm si një urë lidhëse mes toskërishtes dhe gegërishtes si dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e tij.

B. Beci shprehet se: “Komisioni Letrare shqipe në Shkodër ishte nismëtarja e planifikimit gjuhësor në shqipen që në të vërtetë mund të vlerësohet si përpjekja e parë serioze dhe me një arritje të dukshme e zbatimit të një politike kulturore gjuhësore kombëtare që synonte, jo vetëm zgjidhjen e problemit madhor të gjuhës letrare shqipe a të shqipes standard, por edhe atë të zhvillimit të kulturës dhe të arsimit tonë kombëtar.”⁶

Me 27 janar 1917 u aprovuan nga Komisioni rregullat e drejtshkrimit të shqipes me emërtimin “Parime e rregulla mbi orthografinë e gjuhës shqipe të shkrueme”.

Menjëherë pas miratimit me 24 shkurt 1917 komanda e vendit vendos që “Që prej datës së këtij urdhëni, këjo mënyrë shkrimi e diftume me anë t’atyne rregullave do të ketë fuqi zyrtare dhe do të shtihet përdorimi i kësaj, pa kurrnji jashtërrregullim, në të gjitha aktet, në të përgjigjunit e në të kryemit e këtyneve, n’urdhënimet, në botimet, etj”⁷

Vendimet e Komisionit për gjuhën letrare e për drejtshkrimin e saj u miratuan më vonë edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës, i cili zhvilloi punimet në gusht të vitit 1920 dhe vendosi që gjuhë zyrtare e teksteve shkollore të ishte ajo e pranuar nga Komisioni Letrare e Shkodrës, pra që e folmja e Elbasanit me disa përmirësime të ishte gjuhë zyrtare shqipe. Vendimi i këtij kongresi përbën edhe standardizimin e parë zyrtar të gjuhës shqipe, atë të vitit 1920.

⁶ B. Beci, Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri, Pejë 2000, f. 73.

⁷ Laimet e Komisionit Letrare Shqipe në Shkodër, V. I, n. 1, kallënduer, 1918, 20-26

Standardizimi si një aktivitet i motivuar dhe i qëllimshëm për të normëzuar një variant gjuhësor, në asnjë mënyrë nuk është një proces i njëtrajtshëm, statik dhe që kryhet aty për aty. Interesat e grupeve të ndryshme shoqërore për të pasur një standard gjuhësor, i cili, përveç që do të shërbente si një instrument bashkimi dhe mjet identifikimi për grupet e ndryshme shoqërore, që ndjejnë afërsi me një variacion të caktuar gjuhësor, do të kryente edhe funksionet praktike duke u përdorur në ligjërim në fusha të ndryshme shkencore, arsimore, politike-administrative etj. Ka interesa që dominojnë gjatë gjithë procesit të standardizimit. Këto interesa mund të ndryshojnë me ndryshimin e raporteve midis grupeve shoqërore dhe me epërsinë që kanë ato në raport me njëra tjetrën.

Procesi i standardizimit të një gjuhe ka një shtrirje dhe një vazhdimësi në kohë dhe në hapësirë. Ky proces kalon nëpër etapa të caktuara, duke ngërthyer në vete gjurmët e secilës etapë nëpër të cilën ka kaluar e njëkohësisht duke u përshtatur me karakteristikat e çdo etape të re.

Procesi i standardizimit në thelb konsiston në krijimin e një modeli për imitim dhe për promovimin e këtij modeli kundrejt modeleve rivale.

Si rrjedhojë e vendimeve të parashtruara më lart në vitin 1923 në urdhëresat qeveritare të shpallura nga kryeministria përcaktohet se si gjuhë shkrimi e administratës shtetërore do të përdorej dialekti i Elbasanit “*i cili asht pranue si dialekt i përbashkët zyrtar për shtetin tonë*”⁸

Për të vazhduar punën e filluar në vitin 1916, Ministria e Arsimit në nëntor të vitit 1928 krijoi një Komisi ose Komision Letrar, i cili kishte për detyrë të vazhdonte punën e nisur nga Komisia Letrare e Shkodrës për unifikimin e gjuhës zyrtare.

Në vitin 1935 u parashtrua nevoja për themelimin e një Komisioni i Posaçëm për Çështje të Ortografisë dhe të Gjuhës së Shkruar, në të cilin ishin caktuar të punonin E. Çabej, A. Xhuvani, N. Resuli, etj..

Me themelimin e Institutit të Studimeve Shqiptare një vit pas pushtimit nga Italia, në vitin 1940 në Tiranë u organizua Kuvendi i parë Albanologjik, në të cilin u konfirmua përsëri që: “*dialekti i përbashkët zyrtar për shtetin do të ishte gegërishtja letrare*”

Është e rëndësishme të theksojmë se gjuha dhe politika gjuhësore të dyja së bashku ekzistojnë në një kontekst të ndërlikuar, kompleks, ndërveprues dhe dinamik, ndryshimi i secilës pjesë të tij mund të ketë si rrjedhojë efekt në pjesën tjetër. Një mori faktorësh jogjuhësorë (politikë, demografikë, socialë, fetarë, kulturorë, psikologjikë, burokratikë, etj.) ndikojnë në çdo përpjekje të individëve ose grupeve për të ndërhyrë në praktikën gjuhësore të personave ose grupeve të tjera.

⁸ Fletore zyrtare, 1923/21.3., vendimi 148

Gjuha krijon një sistem kulturor që ka një kompleksitet të pabesueshëm dhe është mrekullisht fleksibile.

Bibliografi

1. Baylon. Ch. (1991), *Sociolinguistique, Societé, Langue et Discour*, Paris.
2. Beci, B. (2000), *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Pejë.
3. Beci, B. (2010), *Historia e standardizimit të shqipes “politika dhe planifikimi gjuhësor në Shqipëri*.
4. Ferguson, Charles A. (1968), *Language Development*, in: Charles A. Ferguson, Thom Huebner (1996), *Sociolinguistic Perspectives: papers on language in society, 1959-1994* Oxford University Press US.
5. Fletore zyrtare, 1923/21.3., vendimi 148.
6. Ismajli, R. (2003), *Standarde dhe identitete*, Pejë.
7. Ismajli, R. (2005), *Drejtskrimet e Shqipes*, Prishtinë.
8. Laimet e Komisis Letrare Shqipe në Shkodër, V. I, n. 1, kallënduer, 1918.
9. Louis-Jean Clavet, *La guerre des langues et les politiques linguistiques*, Paris.
10. Lloshi, Xh. (2008), *Rreth alfabetit të shqipes*, Shkup, Prishtinë, Tiranë.
11. Osmani, T. (1999), *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër.
12. Osmani, T. (2004), *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)*, Shkodër.
13. Pipa, A. (2010), *Politika e Gjuhës në Shqipërinë Socialiste*, Tiranë.
14. Plangarica, T. (1972), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*.
15. Samara, M. (1989), *Formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe*, Tiranë.

Adelina ÇERPJA

NJË VËSHTRIM PËR GRAMATIKAT SHKOLLORE TË SHQIPES TË PERIUdhËS 1913 – 1944

1. Gramatikat e gjuhës shqipe të hartuara në vite dhe të përdorura si tekste mësimore, së bashku me shkrimet e tjera të autorëve të tyre, kanë ushtruar një ndikim të ndryshëm në zhvillimin e shqipes letrare gjatë periudhave të ndryshme. Këto gramatika, një pjesë e të cilave janë përdorur në formë tekstesh shkollore në rajone të ndryshme të Shqipërisë, kanë pasur një rol me rëndësi në pasqyrimin e sistemit gramatikor të shqipes e të dialekteve të saj për kohën kur janë hartuar.

Sipas J. Kastratit, gjatë periudhës 1913-1944 janë shkruar rreth 36 gramatika, si nga të huajt, ashtu edhe nga arbëreshët e nga studiuesit vendës. Nga kjo larmi gramatikash kemi menduar që në këtë kumtesë të bëjmë një vështrim të përgjithshëm të gramatikave shkollore, e konkretisht të teksteve të hartuara nga: Shoqnia “Dija”, G. Mikeli, S. Q. Dako, I. J. Permeti, A. Xhuvani, K. Konomi, J. Minga, I. D. Sheperi, J. Rrota e O. Myderrizi.

2. Në fillim të kësaj periudhe shoqëria “Dija” paraqitet aktive me botimin e dy vëllimeve të gramatikës së shqipes.

Vëllimi I prej 27 faqesh “Grammatika apo Folmarmja Shqype I”¹ është shkruar në gegërishte, por gjatë njohurive e shembujve që jepen vihet re një prirje për normëzimin e trajtave të ndryshme fonetike. Pjesa e parë nis me njohuri për alfabetin shqip, për zanoret e bashkëtingëlloret, për diftongjet e për rrokjet. Më tej vijohet me drejtshkrimin e një liste fjalësh që në një farë mënyrë janë si fjalorth ortografik dhe sipas J. Kastratit “... qenë si parathënie ose mbështetje për Komisinë Letrare të Shkodrës”². Në pjesën tjetër jepen njohuri të përgjithshme për emrin, për nyjën, për përemrin vector, për foljen, si dhe për mbiemrin. Ndërthurur me to janë dhënë dhe disa njohuri për fjalinë, për kryefjalën e kallëzuesin.

¹ *Grammatika apo Folmarmja Shqype* për shkolla të para të Shqypnisë e dame në katër pjesë mbas methodës t’Josef Lehmann-it. I. Prej Shoqnisë “Dija”, Vjenë Wien St. Norbertus Druckerei, 1914 (botimi i parë 1912).

² J. Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare*, Prishtinë, 1980, f. 305.

Vëllimi i dytë³ prej 55 faqesh nis me njohuri dialektologjike të konkretizuara me shembuj të shumtë nga të dyja dialektet e shqipes, duke u ndalur në dallimet kryesore fonetike: gjatësia, hundorësia, rotacizmi, etj., si dhe në dallime morfologjike, p.sh. të formave emërore e foljore gjatë lakimit e zgjedhimit. Njohuritë morfologjike e sintaksore të nisura në vëllimin e parë këtu zgjerohen, sërish duke ruajtur ndërthurjen e tyre. Vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe fjalëtormimit, dallimit mes fjalëve të prejardhura me prapashtesa dhe atyre të përbëra. Të gjitha këto njohuri gjuhësore janë shoqëruar me ushtrime të ndryshme.

3. Teksti mësimor i G. Mikelit⁴ e pa dritën e botimit në vitin 1916. Ai është shkruar për shkollat fillore, kryesisht për rrethin e Shkodrës. Në përgjithësi gjuha e këtij teksti ka për bazë të folmen e Shkodrës, ndonëse tek-tuk vihen re dhe forma të të folmeve jugore, që, sipas J. Kastratit, “shprehin paqartësinë gjuhësore të autorit lidhur me kristalizimin dhe normalizimin e mëtejshëm të gjuhës së tekstit”⁵.

Teksti prej 138 faqesh është strukturuar në dy pjesë kryesore: në pjesën e parë jepen njohuri fonetike e morfologjike. Në krye flitet shkurt për zanoret e bashkëtingëlloret, për grupet e zanoreve e diftongjet që autori i quan me të njëjtin emër *dyzâne*, për rrokjet etj. Nuk mungojnë në këtë tekst dhe shënimet drejtshkrimore e dialektore, por vendin kryesor e zë trajtimi i morfologjisë: pjesët e ligjëratës me kategoritë përkatëse leksiko-gramatikore, lakimi i emrit, shkallët e mbiemrit, llojet e ndryshme të përemrave, zgjedhimi i foljes etj.

Në pjesën e dytë, të sintaksës, që zë vetëm 10 faqe (krahasuar me 124 faqe që zë pjesa e parë) autori ndalet në fjalinë e llojet e saj e më pas jep dhe modelin e analizës morfologjike (ose gramatike siç e quan ai) dhe të asaj sintaksore (ose logjike). Në katër faqet e fundit autori ka shpjeguar rregullat e përdorimit të shenjave të pikësimit në fjali.

Në këtë gramatikë vihet re se, krahas terminologjisë shqipe, ai ka përdorur terma me bazë latine, ndoshta sepse në Shkodër mësimi i latinishtes dhe i italishtes kishte traditë dhe termat e këtyre gjuhëve ndihmonin për të kuptuar termin përkatës shqip.

Ndryshe nga tekstet e tjera shkollore, në gramatikën e G. Mikelit njohuritë teorike nuk janë shoqëruar me ushtrimet përkatëse, por duket se autori e ka ndier nevojën e tyre, sepse pas shtatë vjetësh botoi një tekst vetëm me ushtrime.

³ *Grammatika apo Folmarmja Shqype* për shkolla të para të Shqipërisë e dame në katër pjesë mbas methodës t’Josef Lehmann-it. II. Prej Shoqinjes “Dija” në Vjenë Wien St. Norbertus Druckerei, 1913.

⁴ G. Mikelit, *Gramatika e giuhës shqype*, Shtypshkroja “Nikaj”, Shkodër, 1916.

⁵ J. Kastrati, *Histori e gramatologjisë ...*, vep. e cit., f. 338.

4. Gramatika e autores S. Q. Dako⁶ është një tekst për shkollat fillore i hartuar në bazë të përvojës 19-vjeçare të autores si mësuese në shkollën e vajzave në Korçë. Në hyrje autorja jep njohuri të përgjithshme për gjuhën si mjet komunikimi e më tej kalon në origjinën e shqipes, si një gjuhë e pasur indogjermanike. Gramatika është strukturuar në katër pjesë: ortografi, etimologji, sintaksë dhe prodosi.

Pjesa e parë përmban njohuri të përgjithshme dhe nis me informacion për fjalinë e llojet e saj, për të cilat sqaron dhe pikësimin që duhet përdorur. Më tej autorja vijon shumë shkurt me dy gjymtyrët kryesore të fjalisë: me subjektin dhe predikatin. Një vend të veçantë në gramatikë zë dhe pjesa për tingujt e shqipes, zanoret e bashkëtingëlloret, klasifikimin e këtyre të fundit sipas nyjetimit, si dhe për rrokjet.

Pjesa tjetër e tekstit, që i kushtohet morfologjisë, zë pjesën kryesore të gramatikës dhe nis me pjesët e ligjëratës e përkufizimet përkatëse. Emri dhe folja janë trajtuar në mënyrë më të hollësishme. Krahas kategorive të tyre leksiko-gramatikore, ajo jep dhe funksionet sintaksore që kanë në fjali. Njohuritë për emrin ndërthuren me informacione për përemrat e llojet e tyre. Gramatika mbyllet me njohuri për ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat e pasthirrmat.

Gjatë shfletimit të tekstit është i dukshëm ndikimi i theksuar nga terminologjia e S. Frashërit. Megjithëse kjo gramatikë ka luajtur një rol të rëndësishëm, veçanërisht në shkollën fillore të vajzave, bie në sy se teksti prej 95 faqesh karakterizohet nga disa përsëritje njohurish, të cilat nuk mund të justifikohen me nevojën për përsëritje që vë në dukje vetë autorja në hyrje, si dhe nga një organizim jo i mirë i lëndës.

5. Ndër gramatikat shkollore të kësaj periudhe përmendim dhe atë të I. J. Permetit⁷. Në parathënien e saj autori shpjegon arsyet që e shtynë të hartonte këtë tekst, si dhe ngre lart me një mungesë të dukshme modestie vlerat e veprës së vet. Sipas J. Kastratit, bazë e kësaj gramatike janë shënimet që autori ka marrë prej mësuesit të tij L. Gurakuqi gjatë kohës së studimeve në Shkollën Normale të Elbasanit⁸.

Njohuritë e dhëna në 134 faqe janë strukturuar në paragrafë, brenda të cilëve bën dhe shënimet e nevojshme, të pashoqëruara me ushtrime. Herë pas here ai bën vërejtje për dallime të ndryshme midis toskërishtes e gegërishtes. Në 12 faqet e para jep njohuri fonetike, duke u ndalur te zanoret e bashkëtingëlloret dhe klasifikimi i

⁶ S. Q. Dako, *Gramatikë elementare për shkollat fillore*, printed by The Davis Press, Worcester Mass., U.S.A., 1916. Botimi i parë në Manastir, Shtypëshkronja "Tregëtare Ndërkombëtare", 1912.

⁷ I. J. Permeti, *Fillime të gramatikës shqipe për shkollat premetare*, Boston, Mass, 1917.

⁸ Për më shumë shih: J. Kastrati, "Gramatikat e shqipes", III, *Buletin shkencor*, III, 4, Shkodër, 1966.

tyre sipas nyjëtimit, te ndarja e fjalëve në rrokje, te ndarja e fjalëve sipas pozicionit të theksit dhe sidomos te përdorimi i zanores ë.

Autori ka vijuar me njohuritë për sintaksën, së cilës i ka kushtuar 5 faqe dhe është ndalur në fjalinë e llojet e saj sipas kritereve të ndryshme, në gjymtyrët kryesore e të dyta etj. Sipas studiuesit V. Memisha në këtë pjesë "... nuk kemi as strukturalisht ndarje të posaçme, as emërtim për korpusin e njohurive, por dhe trajtimi lë shumë për të dëshiruar"⁹.

Pjesa tjetër prej 111 faqesh i takon kapitullit të morfologjisë, në të cilin janë trajtuar pjesët e ligjëratës, ndarja në të ndryshueshme e të pandryshueshme, kategoritë e tyre gramatikore, si dhe janë dhënë paradigma të lakimit e të zgjedhimit.

Për sa i përket terminologjisë së këtij teksti mund të themi se I. J. Permeti është ndikuar nga terminologjia e përdorur prej gramatologëve të tjerë të asaj kohe, por është përpjekur të krijojë dhe vetë neologjizma gramatikorë.

6. A. Xhuvani, si një ndër figurat më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare, ka dhënë një kontribut të madh në gramatologjinë e gjysmës së parë të shek. XX. Ai hartoi dhe ribotoi disa tekste për shkollat fillore e të mesme, të cilat u përdorën për një kohë relativisht të gjatë krahasuar me tekstet e autorëve të tjerë të asaj periudhe.

Në vitin 1919 botoi "Libri i gjuhës a gramatikë", pjesa e parë, për rendin e tretë të shkollës fillore, Elbasan, të cilin e ribotoi në vitet 1924, 1930, 1934, 1939. Për klasën IV të shkollës fillore A. Xhuvani botoi "Libri i gjuhës shqipe" në vitet 1920, 1922, 1924, 1926, 1929, 1933. Një tjetër tekst nga Xhuvani, "Libri i gjuhës shqipe për klasët e nalta të Fillores e të parat e Qytetses", është një gramatikë shkollë e botuar në dy pjesë: pjesa e parë në vitin 1934 e ribotuar në 1937 dhe pjesa e dytë në vitin 1939 e ribotuar në 1942. Në parathënien e tekstit të tij të parë autori thekson se është përpjekur të ruajë atje ku ka qenë e mundur terminologjinë dhe drejtshkrimin e vendosur në Komisinë Letrare të Shkodrës e në raste të tjera të bazohet në të folmen e Elbasanit¹⁰.

Si tekst sintaksor më vete ai nxori: "Njohnit e para te syntaksës shqipe, pjesë e parë, për klasët e nalta të fillores", botuar në vitin 1922 dhe ribotuar në vitet 1925, 1933, 1935, si dhe "Sintaksa shqipe, pjesë e dyte, për klasat e ulta të shkollave të mesme", botuar në Tiranë në vitin 1934 dhe ribotuar në 1938. Duhet theksuar se në përgjithësi, në gramatikat e hartuara më parë, njohuritë sintaksore zënë një vend të vogël krahasuar me ato morfologjike dhe janë dhënë ose të shkëputura në fillim të teksteve, ose të ndërthurura me njohuritë morfologjike, ndërsa me A. Xhuvanin zë fill trajtimi i plotë i sintaksës së gjuhës shqipe. Bie në sy se tekstet e tij kanë pasur disa ribotime, në të cilat autori ka bërë plotësime e përmirësime të njëpasnjëshme,

⁹ V. Memisha, "Disa përvijime për "Fillime të Gramatikës shqipe për shkollat premetare" të Ilias Jahja Permetit", *Studime albanologjike*, 2002 / 7, 1, f. 27.

¹⁰ A. Xhuvani, *Libri i gjuhës a gramatikë*, pjesa e parë, për rendin e tretë të shkollës fillore, Elbasan, 1919, f. 5.

duke luajtur një rol të rëndësishëm në mësimin e gjuhës shqipe në shkollat tonë gjatë periudhës 1919-1942.

Ai niset nga shembujt për të kaluar te informacioni i ri, e më pas te ushtrimet praktike. Në përgjithësi, librat e tij plotësojnë kriteret e nevojshme të një teksti shkollor si nga ana shkencore, dhe nga ajo metodologjike. Ajo çka duhet theksuar është se njohuritë e dhëna në tekstet e A. Xhuvanit në përgjithësi u pranuan dhe u përvetësuan nga shkolla shqiptare. Gramatikat e tij nuk mbetën brenda kufijve të një teksti shkollor, autori me vetëdije shmangu format e shumta dialektore, duke bërë që kjo gramatikë të luante një rol të rëndësishëm në normëzimin e gjuhës letrare të bazuar në gegërishten jugore, sidomos në elbasanishten, që ishte edhe dialekti amtar i autorit.

7. Një tjetër gramatikë për shkollat fillore është dhe ajo e autorit Kiço Konomi¹¹. Pas parathënies, në të cilën sqaron arsyet pse e hartoi këtë tekst, dhe disa informacioneve të përcipta për fjalën e fjalinë, shkronjat e rrokjet, autori vijon me njohuri për klasifikimin e zanoreve e të bashkëtingëlloreve, për ndarjen e fjalëve në rrokje etj. Më tej ai ka dhënë disa njohuri sintaksore për fjalinë e frazën, por pjesën më të madhe të gramatikës prej 72 faqesh ia ka kushtuar morfologjisë: trajtimit të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës, kategorive përkatëse leksiko-gramatikore, dhe të atyre të pandryshueshme. Teksti mbyllet me njohuri për fjalëformimin e për analizën sintaksore të fjalisë.

Lidhur me terminologjinë e përdorur, autori është përpjekur të jetë sa më origjinal. Krahas terminologjisë së përcaktuar në Kongresin Arësivor të Lushnjës, ai ka përdorur neologjizma të tij ose të marra prej gramatologëve të tjerë.

Me gjithë rëndësinë që pati teksti në kohën kur u përdor, nuk mund të mos përmendim se nëpër të hasen trajta e ndërtime të gabuara, si dhe gabime të ndryshme shkencore, si në p.sh. në shpjegimin e kuptimeve kohore dhe të formave përkatëse etj.

8. J. Minga do të hartojë gjatë kësaj periudhe një tjetër gramatikë shkollorë¹². Megjithëse në titull vihet në dukje se teksti është shkruar në toskërishte, herë pas here ndeshim elemente gjuhësore të gegërishtes. Në parathënie autori sqaron se një ndër motivet që e shtynë për hartimin e kësaj gramatike ishte mosnjohja në shkallën e duhur të gramatikës së shqipes prej vetë arsimitarëve të kohës, e sidomos mosnjohja e pasurisë që ofronte gjuha e gjallë e popullit.

Në 14 faqet e para trajtohet rasa, koncepti i fjalisë, i gjymtyrëve të fjalisë, i llojeve të fjalisë sipas ndërtimit; e më tej jepen njohuri nga fonetika, duke u ndalur te

¹¹ K. A. Konomi, *Grammatikë e gjuhës shqipe, Për Shkollat fillore edhe më shumë për rendet të IIIin edhe të IVin*, Shtyp. & Libraria Dhorë Koti, Korçë, 1921.

¹² J. K. Minga, *Grammatik' e gjuhës shqip në toskërishtet e perpluame pas parimeve të pedagogjikës e te psikologjisë me shumë ushtrime për rrjeshtën e IV-të të shkollave fillore*, Vlorë, 1925.

zanoret e bashkëtingëlloret, te grupet e zanoreve, te rrokja e ndarja e fjalëve në rrokje. Në pjesën më të madhe të tekstit (99 faqe) autori është ndalur në njohuritë morfologjike, për të cilat bie në sy se është përpjekur t'i ndërthurë rregullisht me ato sintaksore: krahas pjesëve të ndryshme të ligjëratës dhe kategorive gramatikore, të japë dhe funksionin sintaksor përkatës. Në fund autori jep disa njohuri për analizën gramatikore e sintaksore, si dhe për pikësimin.

Kjo gramatikë është e pasur me material gjuhësor, me ushtrime të shumta, por çka e rëndon tekstin dhe e bën jo shumë të përshtatshëm për klasën IV fillore është mungesa e shkallëzimit në dhënien e njohurive të ndryshme gjuhësore.

9. Ndryshe nga shumica e gramatikave të hartuara gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, I. D. Sheperi e ka hartuar posaçërisht për shkollat e mesme gramatikën e tij¹³ dhe si nxitje për të ka qenë pikërisht mungesa e teksteve të këtij lloji për gjuhën shqipe. Në parathënien e gramatikës autori pohon se veprën e ka shkruar në dialektin e vet (pra në toskërishte), por nuk mungojnë dhe shënimet për dukuri e forma të veçanta nga gegërishtja, pa pretenduar për një ballafaqim të plotë të këtyre dy dialekteve. Po në parathënie ai ka shprehur dhe mendimet e tij për formimin e gjuhës së përbashkët shqipe dhe ky vizion sipas N. Joklit është një traktat i tejngjeshur për gjuhën letrare.

Të gjithë lëndën teorike dhe shembujt përkatës të marrë nga gjuha e folur autori i ka shpërndarë në 710 paragrafë të grupuar në katër pjesë: fonologji, morfologji, etimologji (fjalëformim) dhe sintaksë. Ndryshe nga shumica e teksteve shkollore, këtu mungojnë ushtrimet praktike.

Në 17 faqet e para të pjesës së parë, të fonologjisë, autori ka trajtuar zanoret e bashkëtingëlloret e shqipes, diftongjet etj. Ai ka dhënë njohuri për alfabetin e shqipes, për pikësimin e drejtshkrimin, si dhe për ndryshimet në shqiptim midis gegërishtes e toskërishtes.

Morfologjia zë një vend të rëndësishëm në tekstin e I. D. Sheperit (100 faqe). Në ndarjen e pjesëve të ligjëratës në të ndryshueshme e të pandryshueshme ai e ka shtuar njësi si pjesë të mëvetësishme, ndërsa pjesëzën e ka përfshirë te ndajfoljet, duke dhënë dhe nuancat e ndryshme kuptimore që ajo ka. Ndryshe nga sa ka vepruar për pjesët e ndryshueshme, për të cilat ka dhënë hollësisht kategoritë leksiko-gramatikore e paradigmat përkatëse, autori, me përjashtim të ndajfoljeve, i ka kaluar përciptazi pjesët e pandryshueshme.

Pjesa e tretë e gramatikës përbën një trajtim të hollësishëm të fjalëformimit në gjuhën shqipe. Autori e ka ndarë në dy paragrafë kryesorë, në të cilët trajtohet prejardhja dhe përngjitja. Pasi shpjegon fjalët e thjeshta e të prejardhura, ai është ndalur në formimin me prejardhje, në përdorimin e njësi si mjet fjalëformues, si dhe

¹³ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomòs e toskënishtes* (për shkolla të mesme), Vlorë, Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C., 1927.

në formimin me përngjitje. Sipas A. Dhrimos, “Ai është i pari që e sheh më gjerë emërzimin e mbiemrave në të dy aspektet e tij (të fjalëformimit dhe të përdorimit emëror në një kontekst të dhënë)”¹⁴.

Pjesa e fundit e gramatikës i kushtohet sintaksës së shqipes. Në krye autori ka trajtuar gjymtyrët e fjalisë: kryefjalën, kallëzuesin emëror e foljor, plotësin emëror dhe ndajfoljor; ndërsa në pjesën tjetër është ndalur te fjalia dhe llojet e saj. Interes të veçantë këtu paraqet trajtimi origjinal që Sheperi i ka bërë (mos)përdorimit të trajtave të shkurtra e (mos)theksimit të kundrinës së drejtë, funksionit sintaksor të rasave etj. Kjo pjesë mbyllet me dy shtesa: në të parën autori ka dhënë shkurtimeisht njohuri për rendin e gjymtyrëve dhe të pjesëve të fjalisë; në të dytën është ndalur në shenjat e pikësimit.

Lidhur me terminologjinë e përdorur, vetë autori në parathënie sqaron se ka përdorur kryesisht termat e ngulitur në atë kohë, duke mos e quajtur të arsyeshme “... të ndërròj sa mbase nuk janë aqë të goditurë, ose të krijòj të tjerë pa punë dhe pa nevojë të domosdoshme”¹⁵.

Gramatika e Sheperit është e ngjeshur me lëndë gjuhësore, e cila i jepet nxënësit në mënyrë të qartë e të sistemuar. Përdorimi i saj si tekst mësimor ka qenë i kufizuar, duke pasur parasysh se dhe numri i shkollave të mesme në atë kohë ishte i vogël, por, siç është shprehur dhe Sh. Demiraj, ajo ka shërbyer “... edhe si një mbështetje e mirë për zhvillimin e hulumtimeve të mëtejshme në fushën e fonetikës dhe të gjuhës shqipe”¹⁶.

10. J. Rrota ka luajtur një rol të rëndësishëm në gramatologjinë shqiptare të asaj kohe e veçanërisht në fushën e sintaksës me botimin e tekstit “Sintaksi i shqipes”¹⁷ dhe ribotimin e tij¹⁸. Ashtu si dhe gramatikat e autorëve të tjerë të periudhës 1912-1944, ajo mbështetet fort në dialektin amtar të autorit. Meqenëse kjo ishte një disiplinë jo fort e rrahur në atë kohë, autori ka përdorur rregullisht terminologjinë latine paralelisht me atë shqipe. Në ushtrime ka përzgjedhur fragmente nga autorë shqiptarë e të huaj.

Ai ka qenë i ndërgjegjshëm për punën e madhe që duhet të bëjë gramatologu, të cilit, siç shprehet dhe vetë, “i bje barra, t’i mbledhë, t’i shqyrtojë me ndërgjegje dhe krejt i pa-anshëm, të gjitha trajtat, mundsisht, të gjitha skanjet e mënyrët e së folmes, që mund të ndihen kudo, mbrendë apor jashta Shqipëni; pa lanë m’anësh

¹⁴ Për më shumë, shih: A. Dhrimo, “Substantivimi i mbiemrave”, *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1972.

¹⁵ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa ...*, vep. e cit., f. XII.

¹⁶ Sh. Demiraj, “Pak fjalë rreth Gramatikës së Ilija Dilo Sheperit”, *Gjuha jonë*, 27/2007, 1-4, f. 174.

¹⁷ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes për klasen II, III, IV*, K.U. të shkollave të mjesme, Shkodër, 1942.

¹⁸ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes për klasen II, III, IV*, K.U. të shkollave të mjesme, botimi i dytë, Shkodër, 1943.

karakteristikat djalektore”¹⁹. Autori ka shfrytëzuar jo rastësisht pasurinë e folklorit, madje ka bërë dhe krahasime me gjuhë të tjera, si dhe është përpjekur të japë format më të pastra e të qarta, duke shmangur kështu pështjellimin e nxënësve dhe duke qenë i sigurt se format e tjera, të mbetura jashtë veprës së tij, do të ishin një material i mirë për gramatikat historike apo studime të tjera gjuhësore.

Në këtë tekst J. Rrota ka trajtuar fjalinë e llojet e saj dhe përbërësit kryesorë të fjalisë: kryefjalën e kallëzuesin, gjymtyrët e dyta, si dhe grupin e plotësorëve. Një vend të veçantë zë dhe ligjërata e drejtë dhe ajo e zhdrejtë, si dhe kalimi nga njëra në tjetrën. Autori e mbyll veprën me dy shtesa në të cilat, me anë të 40 vërejtjeve gjuhësore, ka dhënë ndryshimet fonetike, leksikologjike, morfologjike e sintaksore midis gegërishtes e toskërishtes, si dhe ka shpjeguar ortografinë e përdorur në veprën e vet, përpjekjet e tij për të respektuar vendimet e Komisionit Letrar të Shkodrës.

Sipas T. Topallit, *Sintaksa* e J. Rrotës është “... teksti më i kompletuar për këtë nivel gjuhësor që është hartuar deri në gjysmën e parë të shekullit XX, por mund të thuhet se mbetet edhe nga më të mirët deri në vitin 1955, kur shkenca jonë gjuhësore njohu hapa të tjerë zhvillimi”²⁰.

11. “Gramatika e ré e shqipes”²¹ e O. Myderrizit është një gramatikë shkollore normative për ciklin e mesëm, e cila, siç vë në dukje autori në parathënie, është hartuar sipas programit zyrtar të kohës. Po aty autori sqaron se gjuha bazë e gramatikës së tij është gjuha e Shqipërisë së mesme e vendosur më 1909 në Kongresin e Elbasanit dhe e pranuar më 1917 edhe nga Komisioni Letrar e Shkodrës. Duke qenë gramatikë shkollore, çdo informacion i ri është shoqëruar me ushtrimet përkatëse, të cilat ilustrohen me pjesë të zgjedhura nga shkrimtarë shqiptarë, por në gjuhën e të cilave autori ka ndërhyrë herë pas herë për ta sjellë në pajtim me paradigmat gjuhësore që ka dhënë.

Autori është përpjekur të ruajë terminologjinë shqipe, duke vijuar në një masë të mirë terminologjinë shqipe të përdorur nga A. Xhuvani. Megjithatë dhe te ai kemi përdorimin e termave latinë krahas termave shqip, të vendosur rregullisht në kllapa, kjo ndoshta për të bërë më të qartë për përdoruesit e gramatikës kuptimin e termit në shqipe.

Ashtu si dhe në përgjithësi në gramatikat e tjera, edhe teksti i O. Myderrizit nis me njohuri nga fonologjia: nga alfabeti i shqipes, zanoret e bashkëtingëlloret, diftongjet dhe grupet e zanoreve, hundorësia, hiatusi, theksi, ndarja e fjalëve në

¹⁹ At J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botime françeskane, Shkodër, 2006, f. 12.

²⁰ T. Topalli, “Tradita e studimeve sintaksore dhe sintaksa e Atë Justin Rrotës”, *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare*, 23/1, Prishtinë, 2004, f. 300.

²¹ O. Myderrizi, *Gramatika e ré e shqipes, për shkollat e mesme, vëllimi I, Fonologji e morfologji*, Tiranë, 1944. Shtypur në shtyp. “Gutenberg”, Tiranë, 1944.

rrokje, pikësimi, përdorimi i shkronjës së madhe, elizioni e metateza. Autori i ka trajtuar shumë përciptazi njohuritë sintaksore në këtë tekst (në vetëm 6 faqe), duke u ndalur te fjalía, gjymtyrët e llojet e saj.

Në rreth 257 faqe autori është ndalur te morfologjia. Përveç njohurive rreth pjesëve të ligjëratës, kategorive të tyre leksiko-gramatikore dhe të paradigmave të ndryshme, e reja që sjell autori në këtë kapitull, ndryshe nga gramatikanët e tjerë, është trajtimi i hollësishtëm që u bën nyjave të përparme e të prapme të shqipes, duke u ndalur dhe në prejardhjen e tyre.

Gramatika e O. Myderrizit dallohet dhe për përpjekjet e autorit në shpjegimin e dukurive të ndryshme morfologjike me procese historike të zhvillimit të gjuhës. S. Mansaku e ka vlerësuar këtë gramatikë për gjerësinë e përmbajtjes dhe të analizës, si dhe për nivelin shkencor të trajtimit të kategorive gramatikore.²²

12. Siç vihet re, me përjashtim të teksteve të A. Xhuvanit dhe të J. Rrotës që janë sintaksa të mirëfillta, tekstet e tjera kanë pak ose shumë pak njohuri nga kjo disiplinë. Në përgjithësi tekstet nisin me disa njohuri fonetike e sintaksore dhe vijnë me pjesën e morfologjisë, e cila zë pjesën më të madhe të teksteve. Tek-tuk hasen dhe njohuri nga fjalëformimi e drejtshkrimi, si dhe njohuri dialektologjike.

Gramatikanët shqiptarë në këtë periudhë të paraluftës kanë pasur parasysh si gjuhën e folur, dhe atë të shkruar. Ata i kanë hartuar gramatikat e tyre duke u mbështetur secili kryesisht në dialektin e vet. Krahas përpjekjeve për të përcaktuar një formë më të këshillueshme, vërehet edhe prirja për të pasqyruar në shkallë të ndryshme pasurinë e formave të dialekteve, në mënyrë që çdokush ta identifikonte dhe ta krahasonte ligjërimin e tij me modelin gjuhësor që parashtronte gramatika.

Në përgjithësi në hartimin e pjesës më të madhe të gramatikave të kësaj periudhe një ndikim të madh ka luajtur Komisia Letrare e Shkodrës (Shkodër, 1917), vendimet e së cilës u miratuan dhe nga Kongresi i Arsimitarëve në Lushnjë (1920).

Këto gramatika shkollore të gjuhës shqipe kanë ndikuar jo vetëm në përhapjen e përvetësimin sa më mirë të gjuhës shqipe në brezat e asaj kohe, por dhe në zhvillimin e shqipes letrare të asaj periudhe.

Bibliografi

1. Dako, S. Q. (1912), *Gramatikë elementare për shkollat fillore*, printed by The Davis Press, Worcester Mass., U.S.A., 1916. Manastir, Shtypëshkronja “Tregëtare Ndërkombëtare”, 1912.
2. Demiraj, Sh. (2007), *Pak fjalë rreth Gramatikës së Ilia Dilo Sheperit*, në: *Gjuha jonë*, 27/2007, 1-4.

²² Shih S. Mansaku, “Ndihmesat e Osman Myderrizit në fushën e gjuhësisë”, *Gjuha jonë*, 1994/1-4, f. 104.

3. Dhrimo, A. (1972), "Substantivimi i mbiemrave", *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë.
4. *Grammatika apo Folmarmja Shqype* për shkolla të para të Shqypnisë e dame në katër pjesë mbas methodës t'Josef Lehmann-it. I. Prej Shoqnijes "Dija" në Vjenë Wien St. Norbertus Druckerei, 1914 (botimi i parë në vitin 1912).
5. *Grammatika apo Folmarmja Shqype* për shkolla të para të Shqypnisë e dame në katër pjesë mbas methodës t'Josef Lehmann-it. II. Prej Shoqnijes "Dija" në Vjenë Wien St. Norbertus Druckerei, 1913.
6. Kastrati, J. (1980), *Histori e gramatologjisë shqiptare*, Prishtinë.
7. Konomi, K. A. (1921), *Grammatikë e gjuhës shqipe*, Për Shkollat fillore edhe më shumë për rendet të IIIin edhe të IVin, Shtyp. & Libraria Dhori Koti, Korçë.
8. Mansaku, S. (1994), *Ndihmesat e Osman Myderrizit në fushën e gjuhësisë*, në: *Gjuha jonë*, 1994/1-4.
9. Memisha, V. (2002), *Disa përvijime për "Fillime të Gramatikës shqipe për shkollat premetare" të Ilias Jahja Përmetit*, në: *Studime albanologjike*, 2002/7, 1.
10. Mikeli, G. (1916), *Gramatika e giuhës shqype*, Shtypshkroja "Nikaj", Shkodër.
11. Minga, J. K. (1925), *Grammatik' e gjuhës shqip në toskerishtet e perpiluame pas parimeve të pedhagogjikës e te psikologjisë me shumë ushtrime për rrjeshtën e IV-të të shkollavet fillore*, Shtypshkronja G. Direttore, Vlorë.
12. Myderrizi, O. (1944), *Gramatika e ré e shqipes, për shkollat e mesme, vëllimi I, Fonologji e morfologji*, Tiranë, 1944. Shtypur në shtyp. "Gutenberg", Tiranë, 1944.
13. Permeti, I. J. (1917), *Fillime të gramatikës shqipe per shkollat premetare*, Boston, Mass.
14. Rrota, At J. (2006), *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botime françeskane, Shkodër.
15. Rrota, J. (1942), *Sintaksi i shqipes për klasen II, III, IV*, K.U. të shkollavet të mjesme, Shkodër, 1942 (botimi i dytë në vitin 1943).
16. Sheperi, I. D. (1927), *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomòs e toskënishtes* (për shkolla të mesme), Vlorë, Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C.
17. Topalli, T. (2004), *Tradita e studimeve sintaksore dhe sintaksa e Atë Justin Rrotës*, në: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare*, 23/1, Prishtinë, 2004, f. 300.
18. Xhuvani, A. (1919), *Libri i gjuhës a gramatikë*, pjesa e parë, për rendin e tretë të shkollës fillore, Elbasan.
19. Xhuvani, A. (1942), *Libri i gjuhës shqipe*, Pjesa e dytë, për klasët e nalta të Fillores e të parat e Qytetses. Shtëpia botonjëse "Kristo Luarasi", Tiranë.

Merita HYSA

ELEMENTE TË GRAFEMATIKËS NË GJUHËSINË SHQIPTARE

Statusi i grafematikës si disiplinë që studion shprehjen grafike të gjuhës është ende i pastrukturuar mirë, dhe si disiplinë, ajo ende nuk është pranuar në kuadrin e shkencave gjuhësore. Në qoftë se një situatë e tillë vërehet kryesisht në studimet gjuhësore perëndimore, në vendin tonë kjo fushë është studiuar pjesërisht. Ndoshta, sistemi ynë grafik paraqitet disi i thjeshtëzuar dhe për këtë arsye, breza gjuhëtarësh kanë dhënë konsiderata për korrespondencën e afërt mes formës së shkruar dhe formës së folur të shqipes.

Jo më kot, pjesa më e madhe e studimeve grafematike vijnë nga studiues anglofonë dhe frankofonë, në gjuhët e të cilëve, vërehet një mospërputhje flagrante mes formës së folur dhe të shkruar të gjuhës. Për këtë arsye ndihet nevoja që sistemet e shkrimit të mos i shohim vetëm nën dritën e studimeve historike dhe didaktike, por në kuadrin e një discipline e cila përfshin të gjitha format e studimit të shenjave grafike, pra grafematikës.

Përfaqësimi i një gjuhe nëpërmjet shkrimit është fryt i një bashkëpunimi të gjatë historik, i diferencuar brenda traditave gjuhësore dhe kulturore që çdo popull ka krijuar gjatë evolucionit të tij, duke kaluar kështu nga njësimi i traditës shkrimore në vetë realitetin fonik të gjuhës.¹

Arsyet për të cilat krijohet një standard ortografik janë të ndryshme. Në kontekstin tonë historiko-social, kushtet lidheshin me njësimin e gjuhës dhe më pas krijimin e një identiteti të përbashkët kombëtar, për të favorizuar një pavarësi kulturore dhe vetëdijesim të bashkësisë shqipfolëse.

Alfabeti është sistemi themelor i paraqitjes grafike të një gjuhe. Ai përkrah evolucionin gjuhësor dhe është i rëndësishëm sidomos në procesin e kodifikimit, standardizimit dhe aspektit didaktik gjatë mësimdhënies së gjuhës.

Kriteri alfabetik në paraqitjen e një sistemi shkrimor është më i sofistikuar se ai silabik apo logografik, gjë që i dha shtysë së madhe përhapjes së tij në traditën shkrimore të shumë gjuhëve.

Këtu dallojmë dy tipa ortografish:

¹ G.C. Vincenzi, *Linguistica*, Bologna, 1999, f. 38.

- *Ortografitë transparente*, pra ato me përkime të rregullta mes fonemës dhe grafemës, siç është rasti i shqipës ose deri diku i italishtes apo spanjishtes. Këto paraqesin lehtësi në përvetësimin e shpejtë të ortografisë së gjuhëve; dhe

- *ortografitë opake*, tek të cilat kemi mospërkime të dukshme mes dy formave të gjuhës, të shkruar dhe të folur, që lidhen me numrin e zhdrejtë të grafemave dhe fonemave, si në frëngjishte apo anglishte.

❖ Ç'është grafematika?

Pa dyshim është e vështirë të jepet një përkufizim rreptësisht i përcaktuar për këtë term. Ne do të përqendrohemi vetëm në disa aspekte të këtij koncepti, më saktë, në ato çështje të praktikës shkrimore që lidhen me gjuhën njerëzore.

Grafematikën mund ta përkufizojmë si shkenca që merret me studimin e sistemeve shkrimore që përfaqësojnë në planin grafik një gjuhë të caktuar, duke ia lënë studimin e shenjave të tjera grafike jo gjuhësore, disiplinave të tjera si semiotika.

Shkrimi përgjithësisht është kuptuar si një seri shenjash grafike, që zënë një hapësirë të caktuar, dhe ka një rend dhe një sekuence logjike, që e bën të interpretueshëm nga një ose më shumë destinatarë, të cilët njohin dhe zbërthejnë të njëjtin sistem shenjash. Sekuencat grafike mund të tejçojnë njësi kuptimore, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose përmes një filtri gjuhësor.

Sipas Florian Coulmas², një sistem shkrimor mund të jetë *pleremik* (i bazuar në koncepte, fjalë ose morfema), ose *cenemik* (i bazuar në rrokje ose fonema).

E thënë ndryshe, një sistem pleremik synon të paraqesë grafikisht njësi të planit të përmbajtjes, ndërsa një sistem cenemik nxjerr në pah njësitë e planit të shprehjes.

Një sistem pleremik mund të jetë:

- *piktografik*, në qoftë se njësitë e tij përfaqësojnë një objekt, dhe forma e tyre grafike i ngjan pak a shumë, në mënyrë të stilizuar atij objekti. Piktograma vërejmë në sistemet shkrimore të Egjiptit të lashtë, ndërsa në ditët e sotme, shenjat e qarkullimit rrugor janë të pasura me të tilla simbole.

- *ideografik*, në qoftë se elementët e tij përfaqësojnë koncepte abstrakte. Ideogramat që e përbëjnë këtë sistem, kanë një raport ikonik me idenë që transmetojnë, por kjo lidhje është më konvencionale se tek piktogramat. Këtë lloj shkrimi e vërejmë në kinezishten moderne.

- *logografik*, në qoftë se çdo elementi të sistemit i përkon një fjalë (nqs. mund të flasim për fjalë në konfigurimet analitike) ose një morfemë, në mënyrë që ndarja e

² F., Coulmas, *The writing systems of the world*, Oxford, Blackwell, 1989, f. 38-39

kuptimeve, që aktualizohet nga sistemi i shkrimit, të jetë e barasvlershme me atë që ka gjuha e përdorur.

Ndërsa në shkrimin piktografik dhe ideografik, njësitë me kuptim specifik që jepen përmes shenjave grafike, janë më të gjera se ato që identifikon gjuha, në shkrimin logografik këto përkojnë pak a shumë.

Një sistem cenemik mund të jetë:

-*silabik*, ku çdo njësie grafike i korrespondon një rrokje e gjuhës përkatëse, zakonisht e tipit CV;

-*konsonantik*, duke ndjekur sistemin e propozuar nga Peter T. Daniels³, ky sistem vë në dukje më tepër bashkëtingëlloret, edhe pse, zanoret mund të shtohen si shenja diakritike, për të shmangur vështirësitë në njëtimin e vazhdueshëm të bashkëtingëlloreve. Ky sistem është tipik për gjuhët semite, të cilat kanë karakteristikë të zotërojnë rrënjë leksikore trikonsonantike, nga të cilat formohen emrat, foljet dhe mbiemrat, si me ndërftjen e sekuencave zanore, ashtu edhe me metoda të ndryshme fjalëformimi. Kështu, për ata që i njohin këto gjuhë, është e lehtë të zbrërthejnë bërthamën semantike të fjalëve, edhe pa u theksuar natyra e tyre vokalike.

- *alfabetik-silabik*; Bëhet fjalë për një sistem rrokjesor, në të cilin janë lehtësisht të identifikueshëm elementet grafike që nxjerrin në pah si bashkëtingëlloret, ashtu edhe zanoret.

- *alfabetik*; Në këtë lloj shkrimi diferencohen qartë si zanoret, ashtu edhe bashkëtingëlloret. Baza mund të jetë fonologjike (merren në konsideratë vetëm fonemat, ose më saktë, njësitë fonetike me vlerë dalluese) ose fonetike (ku vërehen edhe alofonet, edhe pse realizimi i tyre është i parashikueshëm për ata që njohin qartë transkriptimin). Dihet që forma e parë e shkrimit alfabetik u krijua nga grekët e lashtë, të cilët përshtatën shkrimin silabik të fenikasve me strukturën e gjuhës së tyre. Më pas, ky lloj alfabeti u përhap në gjuhë të tjera, nga të cilët, më të njohurit janë alfabeti latin dhe ai cirilik.

❖ *Njësitë minimale*

Pas viteve '50, filloi të përdorej termi grafemë, i cili shënonte njësinë grafike minimale dhe që nuk përkonte gjithmonë me fonemën si njësi gjuhësore. Teoria strukturaliste dhe poststrukturaliste që ishte marrë gjerësisht me termin fonemë, e preku në mënyrë sipërfaqësore krahasimin fonemë-grafemë, e grafemë-fonemë, më tepër u vu re se në ç' masë fonema dhe grafema mund të konsideroheshin homologe në sisteme të ndryshme gjuhësore.

³ P.T. Daniels, *The world's writing systems*, New York, Oxford University Press, 1996.

Eduart Pulgram⁴, vendos një paralele mes fonemës dhe grafemës, duke e përkufizuar grafemën si njësi minimale të alfabetit me karakteristika specifike në sisteme të ndryshme gjuhësore. Ai thekson më tej ekzistencën e grafit (përkundrejt fonit), si realizimin e shkruar në një çast të caktuar ligjërimor të një grafeme, si dhe të alografit, si variant të një grafeme pa vlerë dalluese, duke krijuar kështu një kalk semantik të termit alofon.

Analiza që bën Giuseppe Cardona⁵ për konceptin grafemë është disi më e plotë. Sipas tij :

a- mund të quhet grafemë çdo element grafik i dallueshëm në çdo sistem gjuhësor;

b- mund të quhet grafemë çdo element grafik që i korrespondon një foneme në zinxhirin e folur;

c- mund të përpiqemi të identifikojmë njësitë minimale, mbi bazën e kundërvënieve të pranishme në planin grafik.

Natyrisht që pohimi i tretë do të ishte më i motivueshëm, duke pasur parasysh faktin, që analiza mbi bazën e tipareve dalluese, ka qenë një prej më të rëndësishmeve edhe në planin fonematik.

Tiparet minimale që përbëjnë grafemën, nuk kanë përkime të dukshme, veçse terminologjike, me tiparet fonologjike të dhëna nga strukturalistët për fonemat. Në shqipe, tiparet grafematike, mund të vërehen në disa forma të transkriptuara, kur përdoren simbole të IPA-s, p.sh.: në rastin e velarizimit të alveolares /n/, në këtë rast, përdoret një simbol grafik i cili jep tingullin me artikulum të ndërmjetëm /ŋ/, në fjalë si [*praŋga*] [*eŋkas*] etj. Në këtë rast, tipari grafematik, jepet për të shënuar një tipar fonologjik. Por në qoftë se fonemat (tiparet fonologjike) krahasohen nga gjuha në gjuhë, grafemat (si rrjedhojë edhe tiparet grafemore) nuk mund të krahasohen mes tyre, si për nga inventari, ashtu edhe për nga natyra komplekse.

Studimet psikolinguistike që janë marrë me aftësitë e të lexuarit dhe të shkruarit, kanë arritur në përfundimin se ekziston një realitet psikologjik i tipareve grafemore. Sipas ‘*Modelit interaktiv të ndërvëprimit*’, i sjellë nga Mc Clelland & Rumelhart, gjatë njohjes së fjalës së shkruar, vërehen tri nivele: ***niveli i tipareve, i shkronjave dhe i fjalëve***.⁶

Në nivelin e tipareve, shkronjat zërthehen në tipare ortografike primare. Është provuar fakti që shkronjat që kanë tipare të ngjashme, ngatërrohen lehtësisht (p.sh.: P-R, E-F, C-G, M-N, O-Q etj), për shkak të një aktivizimi të parakohshëm njohës që përhapet në të gjitha shkronjat që i përmbajnë.

⁴ Pulgram, E., “Phoneme and grapheme: a parallel”, in *Word*, n. 7, 1951.

⁵ Cardona, G. R., *Antropologia della scrittura*, Torino, Loescher, 1981, f. 29.

⁶ Interactive Interaction Model - Mc. Clelland, J. & L., Rumelhart, D. E., “An interactive activation model of context effects in letter perception: Part 1. An account of basic findings”, in *Psychological Review*, n. 88, 1982.

Në nivel të grafemave, ato interpretohen si entitete abstrakte, të pavarura nga realizimet e tyre të mundshme grafike (dhe kjo duket se konfirmon, përveç realitetit psikologjik të tipareve, edhe realitetin psikologjik të grafemës, si element i dallueshëm nga grafi).

Modele të ndryshme teorike pohojnë se ndodh një kodifikim paralel, si i shkronjës, ashtu edhe i pozicionit të saj në fjalë. Një zonë specifike në hemisferën e majtë, i përgjigjet në mënyrë specifike më shumë shenjave gjuhësore, sesa simboleve të tjera si figurave gjeometrike ose numrave arabë etj. Në nivel të fjalëve, një varg tiparësh dhe fjalësh, bëhet i njohur dhe u përshtatet veçorive gjuhësore të asaj fjale në nivel fonologjik, morfologjik, sintaksor dhe semantik. Gjithsesi, mund të pohojmë se tiparet grafemike zënë një vend të rëndësishëm për njohjen e fjalës.⁷

❖ *Shkrimi dhe të perceptuarit e gjuhës*

Tradita shkrimore ndikohet padyshim nga sistemet e shkrimit që përdoren. Vizioni konstant i një serie simbolesh, që përkohet me fonemat e gjuhës, të vendosura njëra pas tjetrës, të jep idenë se edhe komunikimi gojor është linear ose segmentor (sikurse pohon gjuhësia strukturaliste). Dekadat e fundit, duke qenë se dukuritë prozodike dhe gjuhët tonike nuk mund të analizoheshin në këtë mënyrë, në fushën e fonologjisë u hartuan teoritë mbisegmentore që e analizojnë të folurit si një bashkëprani elementesh të ndryshme, jo si një seri e vazhdueshme. Brenda këtij kuadri, u ritheksua roli i prozodisë edhe në formën e shkruar të gjuhës dhe marrëdhëniet që vendoste ajo me planin fonosintaksor.

Parimi alfabetik përqendrohet mbi fonemën, si njësi e gjuhës (element mbi të cilin ndërtohen njësi si rrokja, morfema, fjala). Në pamje të parë duket sikur parimi alfabetik dhe ortografia transparente (një fonemë-një grafemë) pasqyrojnë në mënyrë të saktë njësitë e gjuhës së folur, por, realisht nuk ndodh kështu, pasi nuk ekzistojnë ortografi të pastra fonetike. Edhe në të ashtuquajturat ortografi transparente, vërejmë raste të mospërkimit absolut mes fonemës dhe grafemës, mospërkime këto që thellohen në ortografitë e përziera si ajo e anglishtes dhe frëngjishtes, ku format e transkriptimit janë shpesh të ndryshme nga ato ortografike.

Mënyra e ndërtimit të alfabetit tonë, na shpie në një qasje thujse identike të grafemës me fonemën, dhe shpesh devijimet nga kjo rregullsi vërehen si forma aberrante, ose përligjen me zbatimin e parimeve të tjera drejtshkrimore.

Historia e shkrimit të gjuhës shqipe ka kaluar nëpër një kalvar të gjatë, dhe falë punës së figurave të ndritura të kombit tonë, para, gjatë Rilindjes dhe sidomos pas saj, u arrit të pranohej një formë e përbashkët ortografike (që nga modelet e

⁷ Cardona, G. R., *I linguaggi del sapere*, Roma/Bari, Laterza, 2002, f. 156-157.

vendosura nga Kongresi i Manastirit, Komisia Letrare⁸, deri në formën e përpunuar që kemi sot).

Kur flasim për njësim të drejtshkrimit, njëkohësisht kemi parasysh kristalizimin e strukturës fonetike dhe gramatikore të gjuhës. Në këtë fazë, mund të themi se formës së njësuar ortoepike, i ka paraprirë një drejtshkrim i qëndrueshëm, gjë që e ka lejuar edhe parimi alfabetik që mbizotëron në gjuhën tonë.

Po ti referoheshim edhe traditës shkrimore të shqipes dhe parimeve që kanë vepruar mbi të, do të vërenim se që nga shkrimet e para shqipe, si Formula e Pagëzimit, më pas Meshari e me radhë, shkrimi ka synuar gjithmonë të paraqesë format shqiptimore, pak a shumë sipas parimit një fonemë-një grafemë. Pas Buzukut, alfabetet e përdorura për rreth dy shekuj, kanë qenë pak a shumë të ngjashëm me të, domethënë, alfabetet me bazë latine dhe me një parim thuajse alfabetik. Duket sikur në shqipe nuk kemi gjurmë të dukshme të ndonjë faze ku zotërues të ishte tipi etimologjik në shkrimin e fjalëve, ndërsa parimi morfologjik zuri më tepër vend në kohën kur filluan të konsolidoheshin format gramatikore dhe u kristalizuan strukturat fjalëformuese të gjuhës .

Për sa i përket funksionimit të përgjithshëm të ortografisë në shqipe, mund të themi se bazohet në një marrëdhënie të ekuilibruar mes grafisë dhe fonisë, si rezultat një folës i lindur i shqipes e di thuajse gjithmonë si shkruhet apo si lexohet një fjalë e re, që nuk e njeh, mjafton të krahasohet trajta fonike me atë grafike. Ndryshe nga forma e folur, që është bërë shpesh objekt i ndryshëm diskutimesh, për formën e shkruar nuk ka ndonjë problem të dukshëm dhe për më tepër nuk është folur për reforma masive që të prekin këtë nivel të gjuhës. Diskutimet, përveç përdorimit ose jo të disa fonemave të veçanta, kanë prekur më tepër format e reja leksikore që kanë hyrë në shqipe dhe mënyrën e drejtshkrimit të tyre, sidomos atyre nga anglishtja apo frëngjishtja. Megjithëse çështja shtrohet vetëm në nivel drejtshkrimi dhe në transkriptim, fakti që sistemi ynë grafik është i pasur me grafema lejon që huazimet të kufizohen vetëm në nivel fonoleksikor, pa pësuar ndërhyrje në atë grafemor. Në këtë mënyrë mund të flasim për një pastërti të shqipes, të paktën në nivel të përzgjedhjes grafemore.

❖ *Përvetësimi i ortografisë në nivelin didaktik*

Thamë që në shqipe, sistemi grafemor është i njësuar dhe koherent, si në paraqitjen grafike, ashtu edhe në marrëdhëniet që vendos me nivelin shqiptimor. Vetë ortografia transparente që ka shqipja, e bën alfabetin lehtësisht të përvetësueshëm në nivel përdoruesish. Shpesh mendohet se në rastin e ortografive transparente, të mësuarit e shkrimit dhe të leximit, kufizohet thjesht në paraqitjen e

⁸ T. Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë, 2008, f. 533-535.

inventarit grafemor dhe të përkimit rigoroz fonemë-grafemë dhe grafemë-fonemë. Megjithatë, në këtë plan, nuk duhet anashkaluar kompetenca fonologjike, e cila luan një rol të rëndësishëm në përvetësimin e gjuhës dhe krijimin e proceseve konjitive që lidhen më identifikimin e tingujve-fonema dhe grafemave si njësi të pavarura që u përkasin rrafsheve të ndryshme të perceptimit gjuhësor.

Identifikohen katër faza në përvetësimin e ortografisë⁹:

a- përkimi i rregullt grafemë-fonemë;

b- përkimi grafemë-fonemë që varet nga konteksti

c- përvetësimi i elementeve që kanë vlerë morfologjike

d- përvetësimi i shkrimeve logospesifikë (që kryesisht kanë vetëm një inserim leksikor)

Përkimi i rregullt mes fonemës dhe grafemës, përbën një nga rastet më të përgjithshme në shqipe dhe nuk lë vend për asnjë lloj keqkuptimi në nivel të përvetësimit të gjuhës. Në pjesën më të madhe, në fazën shkollore, të mësuarit e sistemit grafemor përqendrohet pikërisht në këtë isomorfi mes dy trajtave të gjuhës, të shkruarit dhe të folurit, në këtë mënyrë supozohet se gabimet ortografike të shfaqen më rrallë, sesa në rastin e ortografive të zbehta (opache).

Në shqipe përkimet kontekstuale janë më të rralla, ato lidhen me forma grafike të ngjashme, sidomos në rastin e takimit të grafemave të ngjashme në kufij morfemash, duke krijuar imazhin e bigrafeve ekzistuese në shqipe, p.sh.: *shtathedhur, Mithat, moshapje* etj. Kontekstualisht i mbetet folësit të zgjedhë format e sakta drejtshqiptimore, për ortogramet e dhëna.

Zbërthimi në kontekst i përbërjes grafemore, shpesh ka të bëjë edhe me dukuri fonetike që veprojnë mbi formën e folur. Kështu rastet e asimilimit sipas pjesëmarrjes së zërit, që vërehen shpesh gjatë të folurit, mund të ndikojnë në përzgjedhjen e gabuar të njërive grafike që përbëjnë një ortogram, p.sh.: *asgjë, [azgjë]¹⁰, ekzistoj [egzistoj], mëngjes[mënjgjes], absurd [apsurd]* etj. Këto fjalë shpesh shkruhen gabim pikërisht për shkak të këtij përkimi thujse të përhershëm mes fonisë dhe grafisë së njërive gjuhësore në shqipe.

Përvetësimi i elementeve që kanë vlerë morfologjike lidhet me zbatimin e një parimi tjetër në drejtshkrimin e shqipes, atij morfologjik. Ortogramet që shkruhen sipas këtij parimi, paraqesin raste të mospërkimit identik mes përbërjes fonemore dhe asaj grafemore. Kjo fazë duket sikur e zbeh paksa parimin e transparencës në shqipe. Nuk bëhet fjalë për një mënjanim të parimit fonetik, por ai lidhet më tepër me veçoritë në planin gramatikor të gjuhës, si dhe mënyrës së krijimit të

⁹ Müller, K., Brady, S., “Correlates of Early Reading Performance in a Transparent Orthography”, in *Reading and Writing: An Interdisciplinary Journal*, n. 14, Kluwer Academic Publishers, Netherlands, 2001, f. 757-799.

¹⁰ lexo: *forma e transkriptuar*.

fjalëformave. E vëmë re në drejtshkrimin e fjalëve të tilla si *botëror [botror]*, *punëtor [puntor]*, *copëtoj [coptoj]* etj.

Faza e fundit ka të bëjë me gjuhët speciale ose të programimit, ku logogramat zënë vendin kryesor, por edhe në këtë rast, përkimi mes planit grafik që ato përcjellin dhe kuptimeve që bartin është i njëanshëm, çdo logogram bart vetëm një kuptim leksikor.

Shpesh e kemi përkufizuar gjuhësinë si disiplinë shkencore, pasi studion dukuritë e lidhura me gjuhën në pikëpamje shkencore, por nuk mund ta konsiderojmë si një shkencë ekzakte, përballë gjithë masës amorfe e disi kaotike të prodhimeve individuale të miliona folësve. Ajo thjesht mund të parashikojë, të prodhojë modele ose të formulojë hipoteza. Kjo situatë nuk varet aq nga paradigmat e analizave, të cilat përsosen gjithnjë e më shumë, sa nga objekti i studimit, vetë gjuha, e cila duket sikur i ikën çfarëdo skematizimi të ngurtë në planin e shprehjes.

Përkundrazi, shkrimi, duke qenë një lloj teknologjie *sui generis*, priret të jetë një krijim i planifikuar, modifikuar dhe i përsosur gjatë gjithë historisë së zhvillimit të gjuhëve. Përmes ngulitjes së një forme të shkruar, studiuesit përpiqen të vendosin njëfarë rregullsie dhe koherence, në një sistem që në nivel përdorimi paraqitet inkohorent, pikërisht gjuhës së folur. Kështu, është gati e pamundur ti imponosh një bashkësie gjuhësore të përdorë menjëherë një fonemë X në vend të një foneme Y, ose të ndryshoje rendin sintaksor themelor në gjuhë. Duket më e thjeshtë të mendohet përsosja e sistemit shkrimor, qoftë edhe duke zëvendësuar ose mënjanuar disi nga përdorimi një grafemë, në mënyrë që të shmangen inkoherencat në përputhjen mes trajtës fonike dhe asaj grafike të gjuhës.

Në pikëpamje gjuhësore, duhet të pretendojmë që ortografia të pasqyrojë kënaqshëm strukturën e gjuhës së folur, duke respektuar format e transkriptuara dhe pohojmë se në shqipe nuk është e nevojshme të ndërmerren reforma ortografike, përveç disa ndryshimeve që do të lejonin që parimi i transparencës grafike të ishte më efikas. Bëhet fjalë për drejtshkrimin e disa grafemave, të cilat nuk pasqyrohen qartë në trajtën fonike, siç është rasti i ë-së, në pozicion para dhe pastheksor (siç e pamë më lart). Modelet e mospërputhjes sigurisht nuk dalin nga moszbatimi i parimit fonetik, por nga bashkëprania në shqipe e tri parimeve drejtshkrimore.

Në këtë trajtim pamë shkurtimisht disa veçori të disiplinës së grafematikës, që lidhen jo vetëm me konceptimin e saj si shkencë, por edhe me gjurmë të saj në traditën shkrimore shqiptare. Grafematika shqiptare, mund të quhet sistematike, sepse që në dokumentet e para të shkruara, ajo është përpjekur të pasqyrojë raportet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, bile kjo e fundit është mbështetur në trajtën fonike, për vetë datimin e vonë që ka pasur gjuha shqipe. Në këtë këndvështrim, gjuha e folur e popullit i ka paraprirë modeleve shkrimore që u ndeshën në shqipe, deri në vendosjen e alfabetit të njësuar, i cili i udhëhoqi

përhapjen e një forme të përbashkët grafike, që u përdor dhe përdoret në mbarë trojet shqiptare.

Të pohosh se gjuha e shkruar dhe gjuha e folur diferencohen vetëm nga ndryshimi i substancës, mund të mos jetë një argument i mjaftueshëm për ti dalluar këto dy forma, mbi të gjitha sepse nuk ka asnjë interes edhe nga pikëpamja gjuhësore që ato të studiohen veçmas, edhe në qoftë se mund të jenë thuajse identike. Edhe në ortografitë transparente, siç është ajo e shqipes raporti mes grafemës dhe fonemës është paralel, shkojnë krahas, por nuk përputhen.

Gjuhë të ndryshme bashkëndajnë pak a shumë të njëjtat fonema, si rrjedhim edhe tiparet fonologjike janë universale, ndërsa grafemat dhe tradita e ndryshme grafike diferencohen dukshëm, duke qenë se janë të lidhura me forma të tjera paraqitjeje, nuk u nënshtrohen të njëjtave procese fiziologjike të planit fonik. Pra është e rëndësishme ti konsiderojmë njësitë minimale të grafematikës, në mënyrë të pavarur nga ato të fonologjisë, sepse tiparet grafemore mund të kenë korrespondencë artikulatore vetëm në një grafi, ose të realizohen në *scripte*¹¹ të ndryshme bigrafesh.

Në analogji me nyjëtimin e dyfishtë të ligjërit, tiparet grafemore u përkasin nyjëtimin të dytë të shkrimit, ndërsa grafema i korrespondon nyjëtimin të parë. Grafema mund të ketë vlerë gjuhësore, si në rastin e logogramave, ose vlerë fonike, si pjesa më e madhe e grafemave në ortografitë transparente. Psikologjikisht, qeniet humane piren ti atribuojnë një grafeme ose një sekuenca grafematike, më parë një korrelativ në planin e përmbajtjes, e më pas në atë fonik¹².

Nga shumë studiues, alfabeti konceptohet si sistemi ideal i të shkruarit, sepse përmes një numri të kufizuar njësisish gjenerohen një pafundësi kombinimesh, pra realizohet parimi i ekonomisë gjuhësore.

Sipas Gelb¹³, historikisht, sistemet e shkrimit kanë kaluar nga një fazë piktografike në atë alfabetike (duke kaluar fazën e shkrimit ideografik, logografik dhe silabik), pa pasur mundësi të ktheheshin pas. Në shqipe nuk është i dokumentuar një kalim i tillë, për arsye që njihen tanimë, dhe orientimi drejt një sistemi fonografik, mund të shpjegohet me domosdoshmërinë e bashkësisë shqiptare për të komunikuar më shoqëritë dhe kulturat përreth, duke përshtatur sistemet e tyre grafike me format autentike të gjuhës.

Një tjetër faktor që ndikoi në përhapjen e fonografisë ishte pa diskutim lehtësia e përhapjes. Një shkrim i ngarkuar me logograma ose ideograma ishte i

¹¹ një script (ose tip grafie) seleksionon mënyrat e shprehjes grafike në lidhje të ngushtë me gjuhën që përfaqëson, p.sh.: shqipja dhe greqishtja, edhe pse bashkëndajnë të njëjtin sistem shkrimor, atë alfabetik, shfryzojnë *scripte* të ndryshme : a, b, c, d, e...< përkundrejt , , , ,

¹² Morton, J., "The interaction of information on word recognition", in *Psychological Review* , n. 76, 1969.

¹³ Gelb, I.J., *A study of writing*, Chicago, University of Chicago Press, 1952 (ribot.1963)

përvetësueshëm vetëm nga një numër i kufizuar njerëzish, ndërsa inventari i grafemave që përmban një alfabet, është sistemi më efikas për sa i përket gjerësisë së inventarit të njërive (pak elementë për tu mbajtur mend) dhe lehtësisë për tu riprodhuar (mungesa e karaktereve komplekse në shqiptim).

Nën këtë konceptim, shqipja na paraqitet si një gjuhë e qëndrueshme në pikëpamje të veçorive grafike dhe gjatë gjithë evolucionit të saj, vërejmë një vijimësi të perceptimit grafik, brenda kuadrit të parimit alfabetik.

Procesi i standardizimit në nivel grafik mund të themi që ka nisur herët, që në fazat e para të dokumentimit të shqipes e në vijim, synimi ishte të krijohej një formë e përbashkët shkrimore, me të cilën mund të njësohej gjuha jonë në të gjitha trevat shqipfolëse, gjë që u arrit pas një kalvari disa shekullor përpjekjesh, të cilat u finalizuan me krijimin e normës ortografike që kemi sot.

Bibliografia

1. Cardona, G. R. (1981), *Antropologia della scrittura*, Torino, Loescher.
2. Cardona, G. R. (2002), *I linguaggi del sapere*, Roma/Bari, Laterza.
3. Coulmas, F. (1989), *The writing systems of the world*, Oxford, Blackwell.
4. Daniels, P. T., Brigh, W. (1996), *The world's writing systems*, New York, Oxford University Press.
5. Gelb, I. J. (1952), *A study of writing*, Chicago, University of Chicago Press, 1952 (ribot. 1963).
6. Ismajli, R. (2005), *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë.
7. Mc. Clelland, J. & L., Rumelhart, D. E. (1982), *An interactive activation model of context effects in letter perception: Part 1. An account of basic findings*, in: *Psychological Review*, n. 88, 1982.
8. Morton, J. (1969), *The interaction of information on word recognition*, in: *Psychological Review*, n. 76.
9. Müller, K., Brady, S. (2001), *Correlates of Early Reading Performance in a Transparent Orthography*, in: *Reading and Writing: An Interdisciplinary Journal*, n. 14, Kluwer Academic Publishers, Netherlands.
10. Osmani, T. (2008), *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë.
11. Pulgram, E. (1951), *Phoneme and grapheme: a parallel*, in: *Word*, n. 7.
12. Vincenzi, G. C. (1999), *Linguistica*, Bologna, f. 38.

Vjosa HAMITI

SELMAN RIZA PËR MODALITETIN E FOLJEVE MODALE

1. Hyrje

Gjatë punimit të magistraturës “Analizë kontrastive e foljeve modale të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane, por edhe gjatë punimit të doktoraturës “Modaliteti epsitemik- mundësitë e shprehjes së tij në gjuhën gjermane dhe ekuivalentet në gjuhën shqipe” kam trajtuar dhe shtjelluar gjerësisht modalitetin e pjesëve të ligjëratës të gjermanishtes, por edhe të gjuhës shqipe. Interesi im i shtuar për foljet modale ka të bëjë para së gjithash me rolin shumë të rëndësishëm që kjo kategori e foljeve ka luajtur dhe luan akoma në këtë fushë. Kështu, edhe në këtë punim, do të shkojë më tej interesi im për foljet modale, por këtë herë duke u ndalur në një përshkrim të detajuar të studimit të foljeve modale nga gjuhëtari Selman Riza, sidomos për modalitetet që shprehen përmes tyre. Në fund do të paraqitet folja modale e gjuhës gjermane **KÖNNEN**, ekuivalentja e së cilës në gjuhën shqipe është **MUNDEM**. Interesimi im do të ndalet edhe në përdorimin e tyre me këto dy modalitete.

2. Foljet modale të gjuhës shqipe

Foljet gjysmëndihmëse¹ modale në gjuhën shqipe janë foljet të cilat shprehin modalitetin apo ndryshe qëndrimin e folësit, apo edhe shkruarit ndaj veprimit, të cilin e tregon folja kryesore. Foljet e mirëfillta modale të gjuhës shqipe janë: *mund*, *duhet* (*ose lipset*) dhe *do*. Folësi, i përdor foljet modale, sigurisht me një qëllim të caktuar, i cili ka të bëjë me dëshirën e folësit për të shprehur mendimin e tij se veprimi ose gjendja (e cila pra tregohet me foljen kryesore) është i mundshëm për t’u realizuar, është i detyrueshëm, i lejueshëm, i domosdoshëm etj. Foljet modale në

¹ Bucholz, O. / Fiedler, W.: *Albanische Grammatik* 987:60”Foljet gjysmëndihmëse paraqiten në ndërtime, të cilat në shkallë të ndryshme janë të morfologjizuara. Ato me një folje të plotë formojnë një njësi semantike, mirëpo tipologjikisht nuk janë të lidhura me to: Foljet modale: d.m.th. janë folje të cilat sinjalizojnë modalitete të veçanta (lidhorja, paskajorja e gegnishtes, paskajorja e ashtuquajtur, P.sh. Des Müssens (Nezessitativ është/mbetet/bëhet + paskajorja e ashtuquajtur, des wollen (Voitativ, Des Könnens (Possiblativ) des Zögerns oder der Furcht, der Disposition (Vjen= paskajorja e ashtuquajtur).

gjuhën shqipe, nuk përdoren si folje të veçuara, por gjithmonë të shoqëruara me një folje, e cila zakonisht është në mënyrën lidhore, ndërsa shumë më rrallë folja shoqëruese është në formë të pashtjelluar. Po ta shohësh nga pikëpamja leksikore, folja modale, e cila morfologjikisht nuk mund të quhet e tillë nëse nuk shoqërohet me një folje në lidhore apo në formë të pashtjelluar, në një togfjalësh të tillë nuk merr kuptim të pavarur leksikor. Nga pikëpamja sintaksore ajo nuk e luan funksionin e kallëzuesit në një fjali, por është folja e mënyrës lidhore apo e një forme të pashtjelluar ajo që ka kuptim të plotë leksikor, ndërsa po ashtu e luan edhe rolin e kallëzuesit në fjali. Sa i përket aspektit morfologjik, foljet modale përdoren kryesisht në kohën e tashme dhe gati gjithmonë në vetën e tretë njëjës. Kjo nuk vlen për foljet kryesore që në mënyrën lidhore pasojnë foljet modale, pasi ato zgjedhohen, duke iu nënshtruar kështu të gjitha kategorive gramatikore të foljes, çka do të thotë se përdoren në të gjitha kohët, vetat, diatezat dhe po ashtu në dy numrat.

3. Foljet modale sipas Selman Rizës

Gjuhëtarët, apo specifikisht ata që kanë hartuar apo kanë marrë pjesë në hartimin e gramatikave të gjuhës shqipe bien të gjithë në një mendje kur thonë se gjuha shqipe ka vetëm tri folje të mirëfillta modale, ndërsa sikurse në gjuhën gjermane edhe në gjuhën shqipe, nuk mungojnë foljet që reflektojnë vlerë apo nuancim modal. Përjashtim të vetëm bëjnë Newmark L., Prifti, P., Hubbard, Ph Prifti², të cilët e përjashtojnë foljen *do* nga grupi i modaleve. Bahri Beci³ nga ana tjetër i quan *folje modale* dhe i trajton gjerësisht *mund* dhe *duhet*, mirëpo sipas tij folja modale *do* përdoret në gjuhën e folur dhe tregon detyrim⁴.

Në vitet e 60-ta Selman Riza në studimin monografik “Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore”, i cili fatkeqësisht, për shkaqe të njohura, u botua tridhjetë vjet më vonë, për herë të parë në literaturën shqiptare foljet modale, sidomos modalitetet e ndryshme, i bën objekt studimi.

Riza këto folje i quan *folje të pavetmjaftueshme*, të cilat nuk kanë kuptim të plotë leksikor në vete. Riza përshkruan mënyrën e trajtimit dhe emërtimin e këtyre foljeve në praktikën gjuhësore të vendeve evropiane: këto folje nga gjermani W. Jung quheshin “*foljet ndihmëse mënyrore*”; nga rusi A. N. Gvozdev quheshin “*folje çfaqëse të mënyrorësisë*”, kurse nga francezi A. Dauzat quheshin “*ndihmëse sekondare (të rastit)*”⁵

² Newmark L., Prifti, P., Hubbard, Ph. *Standard Albanian*, 1982:106 Sipas tyre gjuha shqipe ka vetëm dy folje modale: *mund* dhe *duhet* (apo *lipset*)

³ Beci, B.: *Gramatika e gjuhës shqipe* 2005: 159

⁴ Beci, B.: *Gramatika e gjuhës shqipe* 2005: 161

⁵ Riza, S.: *Libri 13- Vepra 2* 1997: 89

Riza jep edhe një propozim për emërtimin e këtyre foljeve të cilat sipas tij duhej të quheshin “*folje të pavetmjaftueshme marrëdhënore*”. Ai i pagëzon kështu foljet modale, pra të **pavetmjaftueshme marrëdhënore**, pasi konstaton se foljet e këtilla nuk mund të jenë gjysmëndihmëse dhe as modale, sepse nuk shfaqin ndonjë mënyrë zhvillimi të foljes me të cilën shoqërohen. Ato në fakt shfaqin vullnetin, aftësinë dhe nevojën për t’u realizuar veprimi i foljes kryesore, i cili është hëpërhë si diçka materialisht i zbatueshëm. Foljet *mund*, *duhet* dhe *dua* shfaqin vullnetin, aftësinë dhe nevojën jo në vetvete dhe për vetveten, por në lidhje e marrëdhënie me një fenomen të dytë, i cili hëpërhë është i menduar dhe shndërrimin e të cilit në një fenomen efektiv, foljet modale e paraqesin si të vendosur, të mundshëm a të duhur.

Mirëpo propozimi i Selman Rizës për këtë emërtim nuk u përfill nga hartuesit e gramatikave të gjuhës shqipe që pasuan me tutje. Në Gramatikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë⁶ foljet e tilla u quajtën *folje me vlerë modale*.

4. Aspekti leksikor dhe sintaksor i foljeve modale sipas Rizës

Thamë se foljet *mund*, *duhet* dhe *do* në gjuhën shqipe janë folje modale. Përdorimi i tyre me kuptim të plotë leksikor në shqipen e sotme, gjithmonë bëhet fjalë për gjuhën e standardizuar, është zbehur dhe rrudhur së tepërmi. Mëvetësia e tyre si folje të plota, veçmas e foljeve *duhet* dhe *do*, ka filluar të humbasë me kohë⁷. Pra, këto folje, duke iu nënshtruar një procesi ndërrimesh dhe ndryshimesh gjuhësore, me kohë e kanë humbur kështu pavarësinë e tyre si folje të plota, për t’u “ngurtësuar” të themi kështu, në gjuhën standarde si folje modale. Pra, në fjali, në kuptimin e tyre modal, këto folje nuk mund të përdoren të pavarura, pra si folje të plota, por gjithmonë në togfjalësha, të shoqëruara nga folje të plota në mënyrën lidhore apo edhe (më rrallë ndeshet kjo formë) folje të formës së pashtjelluar.

Lidhur me aspektin leksikor të foljeve modale, Selman Riza⁸ thotë: “*Në planin leksikor, këto folje çfaqin koncepte psikologjiko-moralë praktikisht materialo-objektive nga më të përgjithshëmit, siç janë: koncepti i të dashurit (në kuptimin jo të dashurisë, por të dashjes a vullnetit); koncepti i të mundurit (në kuptimin jo të mposhtjes së kundërshtarit në ndeshje, por të aftësisë fizike apo mendore prat. të mundshmërisë objektive); koncepti i duhurisë morale, i detyrimit*

⁶ ASHSH: *Gramatika e Gjuhës Shqipe I* 1995: 262, ku thuhet se këto folje shërbejnë për të shprehur modalitetet. Spjegimi për modalitetin shënohet në fusnotë: “*Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimit të folësit ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Ky qëndrim i folësit mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore: më anë të mënyrave të foljes, me anë të foljeve me vlerë modale, më anë të pjesëzave modale.*”

⁷ Karapinjalli, M., “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 21/2”, 2003: 329

⁸ Riza, S.: *Libri 13-Vepra 2*, 1997: 89

shoqëror apo i nevojshmërisë objektive; koncepti i të lënit (në kuptimin jo të mosmarrjes me vehte, por të të mospenguarit prkt .të të lejuarit”.

Në aspektin sintaksor foljet modale nuk e kryejnë funksionin e kallëzuesit në fjali. Përkundrazi këtë funksion e kryen folja e plotë që e shoqëron në togfjalëshin të themi modal. Lidhur me ndërtimin sintaksor të këtyre foljeve , Selman Riza thotë⁹: “Në sintaksë, kallëzuesit e ndërtuar me këto folje janë të pavetmjaftueshëm. Prandaj secila prej këtyre foljeve plotësohet nga **një fjali e mvarur**, e cila kundrejt foljes së plotësuar luan rolin e kundrinës së drejt prkt. të kryefjalës psh.

“Unë **due me shëtitë**” ose “unë **dua të shetit**”; “ti **mundesh me shetitë**” ose “ti **mund të shetitësh**”; “ai **duhet me shetitë**” ose “ai **duhet të shetitë**”; ajo më **le me shetitë**” ose “ajo më **le të shetit**” etj.”

Meritë e Rizës është se, i shndërroi foljet modale apo edhe ato me nuancim modal në objekt studimi edhe sa i përket aspektit leksikor dhe atij sintaksor.

5. Riza dhe përdorimi me modalitetin epistemik dhe joepistemik i KÖNNEN/ MUNDEM

Modaliti epistemik shpreh mënyrën, se si folësi sillet apo qëndron ndaj veprimit të përshkruar, sidomos vlerësimi ndaj realitetit të këtij veprimi p.sh. supozime apo mendime të huaja Në gjuhën shqipe këto shprehen kryesisht përmes mënyrave të foljes (kushtorja (1), habitorja (2),dëshirorja (3) dhe urdhërorja (4), që Riza i emërton **mënyra foljore joobjektive**)

(1) *Nëqoftëse ndodh gjë, **duhet t’i** paguajmë faturat familjes, tha gjenerali¹⁰.*

(Jemi të detyruar që ta paguajmë nëse ndodh gjë).

(2) *”Gatishmëria jote ma mbush zemrën me gëzim, por thuamë, si **qenkësh e mundur** kjo? Si **paskësh mundësi** që mësimi i Gotamës, qysh përpara se ne ta dëgjojmë atë, të na ketë dhuruar, tashmë, më të mirin fryt?”¹¹*

(3) *“Ashtu **qoftë**, o mësuesja ime! Gjithmonë të **pëlqeftë** vështrimi im më **ndjektiv** gjithmonë prej teje fati i bardhë!”¹²*

(4) *Tani **duhet të gjendet** nëse ka gjë. (tani është e domosdoshme të gjendet)¹³*

Selman Riza pas tejpagëzimit të foljeve modale në *folje të pavetmjaftueshme marrëdhënore* thotë:

*Në dritë të këtij tejkonceptimi dhe tejpagëzimi do të mund të shpjegohej edhe analogjia funksionale e foljeve “**ndihmëse mënyrore**” me natyrën e mënyrave foljore **jo-objektive** siç janë kushtorja, urdhërorja, lidhorja .*

⁹ Riza,S.: *Libri 13-Vepra 2*, 1997: 89

¹⁰ Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:183

¹¹ Hesse, H.:*Siddharta*, 2005: 23

¹² Hesse, H.:*Siddharta*, 2005: 52

¹³ Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:30

Edhe më të vërtet, këto mënyra foljore t'egzistencës jo-objektive, në vendë që të çfaqin gjithashtu marrëdhënie të këtij fenomeni si diçka vetëm e menduar me të njëjtin fenomen si diçka objektivisht ekzistuese.

Ja sepse i tërë ndryshimi midis foljeve ndihmëse mënyrore dhe mënyrave foljore të egzistencës jo-objektive- praktikisht qëndron vetëm këtu që funksionet, të çfaqur leksikalisht nga të parat faqen gramatikisht nga të dytat.¹⁴

Kjo tregon se Riza qysh atëherë pati vërejtur modalitete të ndryshme të foljet modale. Sipas kësaj del, që funksionet e modalitetit jo-objektiv shfaqen leksikisht përmes foljeve ndihmëse mënyrore, kurse gramatikisht nga mënyra foljore të egzistencës jo objektive (kushtorja, habitorja dhe urdhërorja) që në gjuhën gjermane shprehen përmes modalitet epistemik.

Duke pasur parasysh këtë, në vijim në këtë analizë kontrastive të shkurtë do t'i paraqes foljet modale të gjermanishtes dhe shqipes *können dhe mund* në përdorimin e tyre me modalitet joepistemik dhe epistemik. Shembujt janë paraqitur nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

5.1. Përdorimi i foljeve modale können dhe mund me modalitet joepistemik

Kjo folje e ka gjeqjësën në gjuhën shqipe dhe mund të thuhet se te këto dy folje ekziston një përputhshmëri e plotë. Këto folje kanë si kuptim kryesor në të dy gjuhët mundësinë:

- (1) *Ich kann nicht mehr weiter schreiben...mir ist so dumpf im Kopfe... die Glieder tun mir weh.....¹⁵*
- (1.a) *Nuk mund të të shkruaj më...koka më është turbulluar...gjymtyrët më dhembin.....¹⁶ (nuk ka mundësi të shkruaj më tutje.)*

Edhe në përkthimin nga gjuha shqipe në atë gjermane ka përputhshmëri të plotë.

- (2) *Ai ishte kryesori dhe mund të hapte çfarë bisede që të donte: për konjakët, kryeqytetet, cigaret. (ai ka mundësi ...ai mundet që të hapë çfarëdo bisede)¹⁷*
- (2.a) *Er är die Hauptperson, und als solche konnte er nach Belieben die Gesprächsthemen betimmen: Kognaksorten, Hauptstädte, Zigarettenmarken.¹⁸*

¹⁴ Riza, S.: *Libri 13- Vepra 2*; 1997: 90

¹⁵ Zweig ,S.: *Briefe einer Unbekannten*, 1996: 197

¹⁶ Zweig , S: *Letra e një të panjohure* 1989: 328

¹⁷ Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:24

aftësi (dhunti)

- (3) Nur einsame Kinder **können** ganz ihre Leidenschaft zusammenhalten: die andern zerschätzen ihre Gefühle in Geselligkeit..¹⁹
- (3.a) Vetëm fëmijët e vetmuar **mund** ta ruajnë të gjithë pasionin e tyre: të tjerët i nxjerrin të gjithë pasionin e tyre,...²⁰
- (4) Unë **mund të fitoja** me ta shumë beteja²¹.
- (4.a) Ich hätte mit ihm viele Schlachten geëinnen **können**..²²

Lejim

- (5) Aber Du fragst mich vielleicht, wie ich das Kind so im Luxus erziehen **konnte**, wie ich es vermochte..²³
- (5.a) Por ti do të më pyetesh, ndoshta, se si **munda**, ta rris këtë fëmijë me këtë mirëqenie, se si arrita t'ia siguroj.....²⁴ (si ja lejova vetës...)
- (6) Tani mundësia e provokimit kaloi, dhe ai **mund të ndiqte** i shkujdesur zhvillimin e dasmës dhe **mund të pinte** sa të donte.²⁵
- (6.a) Er **konnte** unbekümmert den weiteren Fortgang der Feier verfolgen und trinken, sowiel er wollte.²⁶

Kur foljet modale **können** përdoret me një pjesëz të mohores në shumicën e rasteve përdoret në gjuhën shqipe pjesëza **dot**:

- (7) Am nächsten Tag zogst Du ein, aber trotzallem Spähens **konnte** ich Dich **nicht** zu Gesicht bekommen-Das steigerte nur meine Neugier.²⁷
- (7.a) Të nesërmen ti erdhe, por, megjithëse, të përgjova, s'të pashë **dot**-kjo ma shtoi edhe më tepër kureshtjen.²⁸
- (8) Margën e kisha dashur tërë jetën, asnjë grua tjetër nuk e kishte zënë **dot** vendin e saj.²⁹
- (8.a)dass, ich Marga mein Leben lang geliebt habe und dass **keine** andere Frau sie von irem Platz hätte verdrängen **können**.³⁰

¹⁸ Kadare.I : *Der General der toten Armee* 1977:11

¹⁹ Zweig ,S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 162

²⁰ Zweig, S: *Letra e një të panjohure* 1989: 288

²¹ Kadare .I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:139

²² Kadare .I : *Der General der toten Armee* 1977:134

²³ Zweig ,S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 186

²⁴ Zweig , S: *Letra e një të panjohure* 1989: 315

²⁵ Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:206

²⁶ Kadare .I : *Der General der toten Armee* 1977:203

²⁷ Zëig,S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 159

²⁸ Zëig , S: *Letra e një të panjohure* 1989: 284

²⁹ Kongoli ,F.: *Lëkura e qenit*, 2005: 11

³⁰ Kongoli,F.: *Hundehaut*, 2006: 13

5.2. Përdorimi i foljeve modale *können* dhe *mund* me modalitet epistemik

Supozimin

- (9) *Vielleicht kann ich nicht ganz deutlich zu Dir sprechen, vielleicht verstehst Du mich nicht...*³¹
- (9.a) *Ndoshta s' do të mundem të flas fare qartë me ty, ndoshta ti s'po më kupton...*³²
- (10) *"Sa i bukur që është!" Dhe ndoshta s'u besohej që e keqja mund të vinte andej.*³³
- (10.a) *"Wie schön!" und wollten es gar nicht glauben, dass das Böse von dort gekommen sein könnte.*³⁴

Nga shembujt del se foljet modale *können/mund* përputhen tërësisht si në përdorimin e tyre me modalitet joepistemik, ashtu edhe në përdorimin e tyre me modalitet epistemik,

6. Përfundim

Si përfundim i këtij punimi mund të thuhet se Selman Riza ka meritën e pamohueshme që arriti ta shndërrojë modalitetin e foljeve dhe gjegjësisht foljet modale në objekt studimi, ndërsa e pati filluar këtë studim me ndarjen e modaliteteve, duke u bazuar në gjuhëtarët e huaj (gjermanë etj.) dhe analogjinë e studimeve të tyre me gjuhën shqipe. Por fatkeqësisht nuk gjeti mbështetje. Shpresoj që në të ardhmen do të ketë studime edhe më të gjera për modalitetin jo vetëm tek foljet modale, por edhe te pjesët e tjera të ligjëratës, përmes të cilave shprehen keto modalitete. Gjuhësia shqiptare ka shumë nevojë për studime të tilla.

Literatura

1. Agalliu, F./Angoni, E./Demiraj, Sh./ Dhrimo, A./ Hysa, E./ Lafe, E. Likaj, E. (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë.
2. Beci, B. (2005), *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Shkodër.
3. Buchholz, O./ Fiedler, W. (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig.
4. Hesse, H. (2003), *Siddharta*, Leipzig.
5. Hesse, H. (2005), *Siddharta*, Prishtinë 2005: 105.

³¹ Zëeig, S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 197

³² Zëeig, S: *Letra e një të panjohure* 1989: 279

³³ Kadare .I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:166

³⁴ Kadare .I : *Der General der toten Armee* 1977:163

6. Kadare, I. (1977), *Der General der toten Armee*, Berlin.
7. Kadare, I. (2005), *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Prishtinë.
8. Karapinjalli, M. (2003), Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 21/2.
9. Kongoli, Fatos (2005), *Lëkura e qenit*, Tiranë.
10. Kongoli, Fatos (2006), *Hundehaut*, Zürich.
11. Newmark, L./ Hubbard, Ph./ Prifti, P. (1980), *Standard Albanian*. Stanford.
12. Riza, Selman (1997), *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Vepra 2, Prishtinë.
13. Zweig, Stefan (1989), *Novela*, Prishtinë.
14. Zweig, Stefan (1996), *Praterfrühling Erzählungen*, Frankfurt.

Shkëlqim MILLAKU

MËSIMI I ANGLISHTES NGA KLASA E PARË NË KOSOVË

Mësimi i gjuhës angleze nga klasa e parë në Kosovë është një hap i ri sfidues për arsimin fillor “bërthamë”, apo është një propozim për të na sfiduar dhe ngarkuar plan-programin obligativ të niveli bazik, të shkollimit fillestar dhe thelbësor në shkollë vendi. Andaj, duke ju referuar “Kornizës së **Kurrikulës**¹ të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës”, ku thuhet: “*Gjuha angleze fillon nga **shkalla e parë** dhe mësohet deri në klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë. Në shkollën e parë kjo gjuhë mësohet kryesisht nëpërmjet **lojës, vizatimeve dhe këngëve**, për të vazhduar me leximin dhe shkrimin në shkollët e tjera të Kurrikulës. Gjuha angleze, në nivel shkollës së mesme, në dy shkollët e fundit të kurrikulës, do të mësohet si lëndë e aplikuar në fushat e tjera dhe kjo sidomos në shkollat e arsimit profesional*”².

Mësimi i anglishtes në klasën e parë qenka planifikuar kryesisht nëpërmjet **lojës, vizatimeve dhe këngëve**, për të vazhduar përfundimisht me lexim dhe shkrim në shkollët e tjera. Mirëpo, duke u bazuar në plan-programin (Programi i lëndës së gjuhës angleze, për klasën e tretë) e *Ministrit të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë*, e cila, gjuhën angleze e ka menduar të hynë si lëndë obligative nga klasa e tretë, ku në atë program thuhet: “*Në kuadrin e reformimit të sistemit tonë arsimor për përmirësimin dhe përshtatjen e tij më shumë me sistemet përkatëse evropiane, zbatimi i një metodologjie më aktive më pranë interesave të nxënësit, mbështetur nga përvoja pozitive të krijuar nga përfshirja e mësimit të gjuhës së huaj në ciklin e ulët, gjuha e huaj angleze do të mësohet si gjuhë e huaj e parë në shkollë vendi, duke filluar në klasën e tretë të CF të arsimit nëntë vjeçar*”³.

Një vendim të ngjashëm nga ai i citatit të dytë është paraqitur dhe menduar edhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Maqedoni. Në program mësimor të tyre, të institucionit në fjalë thuhet: “*Lënda e gjuhës angleze si gjuhë e huaj e parë*

¹ Kjo fjalë është e përdorur gabimisht si risimtari e paarsyeshme, sepse në vend të saj do të duhej të përdoret “fjalë” që semantikisht ka zënë vend në shoqërinë tonë si fjalë e përbërë kuptimplote që është e njohur “*plan-program*”.

² Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011, f. 38

³ Luan Memushi, Programi i lëndës së gjuhës angleze, Klasa e tretë, Tiranë, 2005, f. 3

është e përfshirë në planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçarë në të gjithë tri periudhat zhvillimore në arsimin fillor nëntëvjeçarë duke filluar nga klasa e parë e deri në fund të arsimit fillor”⁴.

Për të pasur model krahasimi me shtetet fqinje, për përdorimin e gjuhës angleze, konsiderojmë se është e mjaftueshme paraqitja e dy vendimeve të Ministrive në fjalë, njëra nga klasa e tretë, kurse tjetra nga klasa e parë, të cilat e kanë planifikuar në shkallë vendi, përfshirjen e anglishtes. Andaj, duke i kuptuar rrethanat socio-ekonomike në vendin tonë, dhe ato të infrastrukturës se përgjithshme të arsimit në Kosovë, nuk e paraqesim si të arsyeshme për ta krahasuar me ndonjë shtet Evropian apo me gjerë, se nga cili vit akademik ata e kanë menduar gjuhën e huaj të dytë, për t’u përdorur në shkallë vendi.

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, në faqe 29 paraqet përmbajtjen e arsimit fillor (I-V), i cili mendim është i përgjithshëm dhe nuk është i saktësuar se çka duhet punuar, mësuar dhe arritur nxënësi në klasën e parë deri në klasën e pestë. Në vazhdim paraqes një mendim, i cili nuk i përgjigjet mundësisë së realizimit socio-kulturorë, real as për gjuhën angleze dhe as për gjuhën amtare (shqipe) si: “Gjatë nivelit të arsimit fillor puna edukativo-arsimore përqendrohet në përvetësimin e shkrim-leximit themelor, në vendosjen e një baze të shëndoshë për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik. Kujdes të veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit si bazë për zhvillimin e shprehive themelore për të nxënë, “mësimi për të nxënë”.

Kjo “Kurrikulë” paraqet mendime të ndryshme kontrastive dhe të pamenduara apo studiuara si duhet. Në faqe 38 thuhet: “Gjuha shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare mësohet që nga shkalla e dytë e Kurrikulës. Mirëpo, gjuha e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasën e gjashtë). Si gjuhë e dytë mund të jetë: njëra nga gjuhët e mjedisit (gjuha serbe, boshnjake, turke) zgjedhje e lirë e nxënësit dhe/ose gjuhë gjermane, gjuhë frënge, gjuhë italiane dhe të tjera?”. Këtu, ku bëhet fjalë për pakicat që jetojnë në Kosovë, që janë të komunitetit joshqiptar, mund të interpretohet se nuk janë të detyruar ta mësojnë gjuhën angleze. Mirëpo, kontrasti i dytë dhe aspak i logjikshëm është për komunitetin joshqiptar, sepse ata gjuhën e dytë mund ta mësojnë nga shkalla e tretë. Për ne shqiptarët, shtrohet pyetja, pse nga shkalla e parë?

Pjesa e vështirësive apo dallimeve të paraqitura na mundësojnë hapjen e dilemave se kjo “Kurrikulë” duhet rishikuar, veçanërisht ku bëhet fjalë për gjuhët, qoftë amtare apo për gjuhën e dytë, në këtë rast për anglishten.

⁴ Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Maqedoni (Shkup) 2008, Programi mësimor, Gjuhë angleze, f. 4

Në klasën e parë, në Kosovë është menduar se gjuha angleze mund të mësohet përmes **lojës, vizatimeve dhe këngëve**. Këto fjalë orientuese mundësojnë krijimin e disa pyetjeve diskutuese si:

- Fëmijët në klasën e parë, a mund ta përballojnë, konceptojnë dhe zhvillojnë lojën, të vizatojnë dhe të këndojnë në gjuhën angleze?
- A kemi plan-program (nga MASHT-i) të detajizuar, i cili i parasheh tekstet e mundshme dhe të pranueshme si objektive?
- A kemi kuadër mësimdhënësish të përgatitur për këtë nivel dhe a jemi duke menduar për krijimin e tyre?
- A do të anashkalohet interesimi i mësimit të gjuhës shqipe, normative (duke pasur parasysh se nxënësit flasin trajtat dialektore të tyre)?

Këto pyetje dhe të tjera të ngjashme meritojnë përgjigjeje argumentuese në vazhdim të studimit, por edhe analizë studimore në nivel të lartë shtetëror.

Në klasën parë, nxënësi apo nxënësja mund të mëson për t'i shqiptuar fjalët e dikujt që i ka dëgjuar, qofshin në gjuhën angleze apo në ndonjë gjuhë tjetër dhe mund të mëson përmes vizatimeve, lojës, këngëve etj., mirëpo tani ata/ato do të kenë një ngarkesë të dyfishtë, sepse do të kenë edhe gjera të ngjashme nga lënda e gjuhës (-ve) amtare.

Mësimdhënësi do të ketë shumë vështirësi për ta realizuar vitin akademik, në një situatë të tillë, ku plan-programi nuk është e detajizuar saktësisht për shkallën e parë, mirëpo nuk kemi akoma tekste orientuese në shkallë vendi, për t'u orientuar në realizimin e programit javor, mujor dhe atij vjetor.

Andaj, ligjëruesit e lëndës se gjuhës angleze do të duhej të jenë të drejtimit mësimor dhe njëherazi njohës i mirë edhe i gjuhës amtare, në mënyrë që lojën, vizatimin apo ndonjë aktivitet tjetër, në raste të caktuara ta krahasojnë kuptimisht atë më aktivitet në gjuhën shqipe.

Interesimi i mësimit të gjuhës angleze nuk konsiderojmë se do ta rrezikon interesimin e mësimit të gjuhës shqipe, mirëpo në shoqërinë tonë kemi edhe një pengesë mjaft serioze për moshën e fëmijëve të klasës së parë. Ata vijnë dhe jetojnë në zona të ndryshme ku flasin trajtat dialektore, dhe në kohën kur për herë të parë ballafaqohen më mësuesin, detyrohen të përshtatën në ndryshimet e lehta dhe të lehtë-kuptueshme të shqipes standarde mirëpo, pikërisht në atë kohë, ata fillojnë ta mësojnë gjuhën e dytë, në këtë rast anglishten. Kështu që, këtu fillon krijimi i ngarkesës psiko-fizike të fëmijëve.

Mësimi i gjuhës angleze në klasën e parë është mjaft i vështirë për t'u realizuar, për disa arsye:

- a. Mungon plani dhe programi i saktësuar për këtë nivel në shkallë vendi. Ai i punuar nga MASHT-i duhet ripunuar dhe ristudiuar.
- b. Mungon infrastruktura e brendshme për realizimin e orës mësimore.

- c. Mungojnë mësimdhënësit e kualifikuar për këtë moshë.
- d. Vështirësitë e punës se vlerësimit janë dhe do të jenë të mundshme si ato **diagnostike, formative, i jashtëm, i nxënies, parashikues, selektiv, sumativ, holistike** etj. Këto mënyra të vlerësimit janë të vështira të vlerësohen edhe kur nuk mungojnë kushtet standarde të mësimdhënies, por të mos flasim për fillimin e qëllimit tonë, ku dihet fakti i standardit tonë arsimor.

Këto arsye dhe shumë të tjera mund të paraqesin një fillim të vështirë dhe sfidues për t'u realizuar.

Studiuesi i zellshëm **Vesël Nuh** ka thënë: “Çdo gjuhë që pranon elemente të huaja gjuhësore, qoftë fjalë, qoftë emra, pothuaj menjëherë, e me siguri pas një kohe, fillon të bëjë përshtatjen e tyre sipas sistemit fonologjik dhe gramatikor të saj”⁵.

Andaj, në qoftë se është menduar të mësohet anglishtja përmes **lojës, vizatimit, këngëve** dhe aktiviteteve të tjera na kujton studimin e studiuesit **Leonard Blumfeld** me temë “Të huazuarit intim”. Ai ka paraqitur një studim të detaizuar duke i dalluar raportet e gjuhës superiore, mbizotëruese dhe inferiore apo të ulëta.

Si gjuha, ashtu edhe kultura në përgjithësi e një shoqërie, rrallë herë është dëshmuar se janë të mjaftueshme për vetveten. Për këtë synim është dëshmuar në studimin “Si ndikojnë gjuhët mbi njëra tjetrën” të autorit **Eduard Sapir**. Autori në fjalë ka dëshmuar me kontributin e tij për rolin dhe funksionin e huazimeve.

Qysh në vitin 1886 **Herman Paul** vuri në dukje rëndësinë e çështjeve të huazimeve. Andaj, raportet e gjuhës shqipe me atë të gjuhës angleze janë kontrastive. Shqipja siç dihet është familje në vete dhe e lashtë, kurse anglishtja buron nga gjermanikishtja.

Të dy gjuhët në fjalë ka ngjashmëri dhe dallime ndërmjet tyre. Siç dihet, shqipja ashtu si i shqipton fjalët, fjalitë gjithashtu edhe mund të shkruhen, mirëpo kjo nuk është e ngjashme me anglishten. Fjala shkruhet p.sh. /**book**/ dhe shqiptohet /**b k**/, ndryshe në krahasim me shqipen, e cila, të njëjtën fjalë shqiptuese mund ta ketë /**bukë**/, por me kuptim krejt tjetër. Këto dy fjalë, fëmija apo fëmijët në klasën e parë nuk e ka lehtë t'i dallojnë kuptimisht, sepse e para përshkruan librin për ta lexuar, kurse shqiptimi i krahasuar në gjuhën shqip tregon për bukën që shërben për t'u ngrënë. Fjalë të ngjashme në shqiptim dhe dallimet e tyre kuptimore ndërmjet dy gjuhëve në fjalë ka shumë dhe janë sfiduese për mësimdhënësin për t'i bindur mësimnxënësit për dallimet e tyre kuptimore.

Dallimet strukturore janë shumë shpesh të thella ndërmjet shqipes dhe anglishtes qoftë në konceptin leksikor apo edhe atë gramatikor. Për fjalën e fundit, dihet fakti se ata nuk do të mësojnë, por nënkuptohet mësimi i saj.

⁵ Shaqir Berani (...), Gjuha shqipe 3, Prishtinë, 1987, f. 51

Realizimi i mësimit të gjuhës angleze në klasën e parë do të jetë mjaft i vështirë, sfidues i brezave të ardhshëm, për ta ruajtur dhe mbrojtur gjuhën shqipe. Mësimi i gjuhës angleze nga klasa e parë është një rrugë e garantuar për të siguruar fjalë të huaja (të anglishtes) në gjuhën shqipe dhe mbi gjitha pamundësia e fëmijëve për t'i përballuar ngarkesat psiko-fizike që do t'i kenë në klasën e parë në moshën thelbësore të tyre.

Mimoza PRIKU

100 VJET STUDIME PËR SHQIPEN NGA FILOLOGËT ITALIANË

Studimet albanologjike nga filologët italianë kanë nisur relativisht pak më vonë se ato gjermane apo ndonjë tjetër. Ato kanë njohur zhvillim sidomos pas viteve '30 të shekullit të kaluar duke u karakterizuar me ngritje në disa fusha, si histori, letërsi, por sidomos në gjuhësi. “Në Itali studimet për albanistikën, jo vetëm që kanë qenë të qëndrueshme në përkushtimin për kërkime nga gjuhëtarë të shumtë të shkollave të ndryshme gjuhësore,- shkruan F. Altimari,-...por gjatë shek. XX morën një hov të ri vendimtar falë formimit të katedrave universitare për gjuhën dhe letërsinë shqipe”.¹ Me të drejtë është vënë re se “më të suksesshme janë arritjet në fushën e gjuhësisë, ku dhe tradita e studimeve është më e ndritur”.² Për këtë kontribut të vyer kanë shkruar studiues të njohur, si: J. Kastrati,³ Sh. Demiraj,⁴ Giovan Battista Pellegrini,⁵ M. Camaj.⁶ Një pasqyrë të plotë të këtyre studimeve duke u përqendruar sidomos për të folmet arbëreshe të Italisë ka bërë F. Altimari.⁷ Në vitin 1996 është organizuar edhe një konferencë shkencore me titull “Kontributi i albanologëve italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare” organizuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.⁸ Për zhvillime në fusha të caktuara të

¹ F. Altimari, “Qasje historisë së dialektologjisë arbëreshe”, në *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002, f. 92.

² T. Osmani & S. Çapaliku, “Vëzhgime mbi studimet shqiptare në Itali”, *Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, në “Studime shqiptare” 7, Shkodër 1997, f. 15.

³ *Histori e albanologjisë I*, Tiranë, 2000; “Gjuha e shkruar shqipe ndër arbëreshët e Italisë pas Luftës së Dytë Botërore”, Konferenca shkencore *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot* (20-21 nëntor 1992), f. 189-209; “Ndihmesa të arbëreshëve dhe të studiuesve të tjerë në Itali për gjuhësinë shqiptare, *Gjuha jonë*, 1-4/ 1996, f. 72-77 etj.

⁴ Sh. Demiraj, “Sugli studi albanologici in Italia”, *Zjarri*, (Il fuoco), nr. 35/36, 1991.

⁵ “Gli studi di albanologia in Italia”, në *Nuovi orientamenti della linguistica e della letteratura albanese*, Atti del XVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, 1992, botuar më 1996, f. 23-39.

⁶ “Indirizzi di studi albanesi in Italia”, në *Scritti linguistici in onore di Giovan Battista Pellegrini*, Pacini, Pisa, 1983, f. 1315-1319.

⁷ F. Altimari, “Qasje historisë së dialektologjisë arbëreshe”, në *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002.

⁸ botuar me titull “Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, në *Studime shqiptare* 7, Shkodër 1997.

lëvruara nga studiuesit italianë kanë shkruar I. Ajeti,⁹ T. Osmani,¹⁰ S. Mansaku, I. Badallaj, Gj. Shkurtaj, Sh. Rrokaj etj. e studiues të tjerë të rinj.¹¹

Këtë herë do të kufizohemi vetëm tek filologët italianë dhe jo ato italo-arbëreshë, pasi do të na duhej më shumë hapësirë diskutimi.

Ishte fat që me albanologji u morën emra të njohur, si Carlo Tagliavini, M. Bartoli, V. Pisani, Giovan Battista Pellegrini e deri tek ato më të vonë si L. M. Savoia, A. Landi, M. Genesin e shumë të tjerë që ndihmuan të depëronte fryma e studimeve bashkëkohore me drejtime, si neolingvistika italiane përmes studimeve të V. Pisanit, gjuhësia gjenerative, fonetika gjenerative (J. Trumper) psikolingvistika e sintaksa gjenerative (L. M. Savoia, Rita Manzini) arritjet e reja në sociolingvistikë etj.

Fillimisht në albanistikë këto gjuhëtarë janë marrë jo drejtpërsëdrejti me çështje të ndryshme të shqipes ose me disa çështje praktike të saj, si hartime fjalorësh apo gramatikash (Rossi, Jung, Busseti, Leotti, Cordignano).

Më tej problemet që kanë shqetësuar albanologë italianë fillimisht janë lidhur me prejardhjen e shqipes, origjinën e saj, vendin që zë në familjen gjuhësore IE, marrëdhëniet me gjuhët e tjera sidomos me ato ballkanike. Më vonë një interes të veçantë kanë treguar për ngulmimet arbëreshe në Itali në pikëpamje të ndryshme. Padyshim këtu një rol kryesor kanë luajtur studiuesit arbëreshë të cilët bënë të mundur që të zgjohet ky interes jo vetëm tek studiuesit shqiptarë a arbëreshë, por edhe ato italianë, gjermanë e më gjerë. Pikërisht me kërkimet e Marko La Pianës “filloi në Itali studimi shkencor i të folmeve arbëreshe”¹²

Për të bërë një historik të studimeve për albanologjinë në duhet parë zanafilla e tyre për t’u ndjekur në kohë.

Me Tagliavinin u përvijua një rrugë e re për studimet albanologjike që do të pasurohej e ndiqej nga shumë dijetarë të tjerë. “In Italia, ...si è creata una buona tradizione di studi albanologici. Una tale tradizione che risale a G. I. Ascoli, ha avuto degli illustri rappresentanti, come C. Tagliavini, M. Bartoli, Vittore Pisani, Giuliano Bonfante, G. B. Pellegrini, Carlo de Simone ecc.”¹³ Nisur edhe nga kontributet e veçanta në albanologji këtë studim do ta nisim me filologun C.

⁹ I. Ajeti, “Vështrim i shkurtër i punës në studimet etimologjike të gjuhës shqipe”, *Vepra 3*, Prishtinë, 1998, f. 244-255.

¹⁰ T. Osmani, “Albanologu dhe filologu i dëgjuar italian Giovan Battista Pellegrini”, *Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, në “Studime shqiptare” 7, Shkodër 1997, f. 109-117; “Albanologu dhe leksikografi Angelo Leotti” *Gjuha jonë*, 3-4, 2003, f. 107-113 etj.

¹¹ E. Koperaj, “Neolingvistët dhe çështja e prejardhjes së shqipes dhe e popullit shqiptar”, *Buletin shkencor* (Seria e Shkencave Shoqërore) nr. 50, Shkodër, 2009, f. 39-55.

¹² F. Altimari, “Qasje historisë së dialektologjisë arbëreshe”, në *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002, f. 88.

¹³ Sh. Demiraj, “Sugli studi albanologici in Italia”, *Zjarri*, (Il fuoco), nr. 35/36, 1991, f. 28.

Tagliavini, për të cilin është shkruar jo pak në studimet albanistike¹⁴. Punimi kryesor i Tagliavinit në albanologji në përgjithësi dhe në veçanti në dialektologji është monografia *Shqipja e Dalmacisë. Kontribute në njohjen e dialektit geg të Borgo Erizzos pranë Zarës*. (“L’Albanese di Dalmazia. Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara”).¹⁵ Ndërsa studimi *Të folmet shqipe të tipit gege perëndimore. (Dardania dhe Maqedonia Veriperëndimore)*¹⁶ është konsideruar një nga punimet më sintetizuese të veçorive sidomos fonetike, por edhe morfologjike që është bërë për këto të folme.¹⁷ Punime të tjera të rëndësishme janë: *Gjuha shqipe* (“La lingua albanese”)¹⁸, *Shtresëzimi i leksikut të shqipes. Elemente indoeuropiane* (“La stratificazione del lessico albanese. Elementi indoeuropei”, Casa Editrice Pàtron, Bologna, 1965) që u përdor edhe si tekst bazë në Universitetin e Padovës për kurset e gjuhës dhe letërsisë shqipe pranë Seminarit të filologjisë ballkanike, të themeluar nga vetë Tagliavini, seminar që qëndroi i hapur deri në vitin 1991 nga ndjekësi i Tagliavinit, Giovan Battista Pellegrini. “Në albanistikë, -shkruan akademik I. Ajeti, - Tagliavini la gjurmë të shënueshme me vlera të pakrahasueshme dhe të përhershme; një numër jo i vogël i etimologjive të tij të trajtuara kanë gjetur zgjidhje, ... kjo vlen veçanërisht për venecianizmat e pranishme në gjuhën shqipe”.¹⁹

Kontributet e Tagliavinit rrokin shtresëzimin e leksikut të shqipes, identifikimin e elementit latin në gjuhën shqipe, bashkëpërkimet me shqipes e gjuhëve të tjera e sidomos me rumanishten, etimologji ku luajti një rol kryesor në identifikimin e elementit vendas, duke i konsideruar si të shqipes ose zhvillime brenda kësaj gjuhe apo edhe si të trashëguara nga fondi IE fjalë, si: *amë, dylmer, dosë*, etj., shpjegime që shpesh kanë gjetur edhe përkrahje nga gjuhësia shqiptare. Një tjetër fushë ku la gjurmë në albanologji është edhe bibliografia në revista *Rivista d’Albania* (1940-1943, bibliografia i takon viteve 1937-1939) me rreth 128

¹⁴ I. Ajeti, “Kontributi i Carlo Tagliavinit në studimet e historisë së gjuhës shqipe”, *Vepra* 5, Prishtinë, 2002, J. Kastrati, “Prof. Dr. Karlo Taljavini për gjuhën shqipe”, *Shkenca dhe jeta*, Nr.4, 1989, f. 76-80; I. Badallaj, “Carlo Tagliavini, gjuhëtar me përmasa të mëdha”, *Jeta Arbëreshe*, Nr. 40, IV, Shënmitër, tetor, 2005; M. Priku, *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes* (monografi), Shtëpia Botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2011; E. Prifti, “Carlo Tagliavini dhe albanologjia”, mbajtur në *Seminari XXIII ndërkombëtar për gjuhën. Letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 2004; botuar në përmbledhjen *Seminari XXIII ndërkombëtar për gjuhën. Letërsinë dhe kulturën shqiptare*; edhe në *Analet e Alb-Shkencës*, Viti I, nr. 2, dhjetor, 2006, f. 35-37.

¹⁵ Firenze, 1937, L. Olschi, 132 faqe.

¹⁶ “Le parlate albanesi di tipo ghego orientale (Dardania e Macedonia nord-occidentale)”, në *Le Terre albanesi redente. I. Cossovo*, Roma, 1942, f. 1-82. [R. Accademia d’Italia – Centro Studi per l’Albania – 3].

¹⁷ I. Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f. 41.

¹⁸ Prolosure al corso ufficiale di Lingua e Letteratura albanese letta nella R. Università di Padova, botuar në *Studi albanesi*, V-VI, 1935-1936, f. 5-33.

¹⁹ I. Ajeti, “Vështrim i shkurtër i punës në studimet etimologjike të gjuhës shqipe”, *Vepra* 3, Prishtinë, 1998, f. 248.

zëra dhe *Indogermanisches Jahrbuch* (sesioni VII). Meritë e Tagliavinit është se na ka lënë pas jo vetëm një bibliografi përshtetëse, por një bibliografi të arsyetuar.²⁰ Nuk duhen lënë pa përmendur edhe përpjekjet e Carlo Tagliavinit dhe disa gjuhëtarëve italianë për hartimin e Atlasit Dialektologjik të shqipes.

Ndërsa si “Njohësi më i mirë i një dege të ilirishtes të shpërngulur në Italinë Jugore - të quajtur mesapishte, është linguisti Francesco Ribezzo”.²¹

F. Ribezzo kishte botuar edhe një monografi për gjuhën e mesapëve me titull *La lingua degli Messapi* (1907). Në punimin “Premesse storico-linguistiche sull’autoctonia illirica degli albanesi”²² pohoi “tutti tentativi di staccare l’albanese dal illirico antico sono in precedenza votati al fallimento”,²³ pohim i cili gjeti përkrahjen edhe të albanologut Carlo Tagliavini në shënimet bibliografike²⁴ dhe më pas ai trakët dhe ilirët i konsideron si përfaqësues të të njëjtit etnos.²⁵ Punime të tjera që lidhen drejtpërdrejt ose jo me albanistikën janë: *Italia e Illiria preromana* (në Italia e Croazia, Roma, 1942, pp. 21-83); “Problemi glottologici illirico-albanesi (a proposito di una recensione di C. Tagliavini) etj.”²⁶

Një tjetër filolog i njohur italian i njohur edhe për kontribute në albanologji është **M. Bartoli** që iu referua shqipes nisur nga studimet e tij për gjuhët romane, fillimisht me veprën *Das Dalmatische* (1906) “Linguisti italian kësaj gjuhe, në studimet e tij gjuhësore,- shkruan akademik I. Ajeti,- nuk i është afruar më së brendshmi, porse në disa punime të tij linguistike, me karakter komperativ, shqipen e rrokte duke trajtuar ndonjë problem teorik të gjuhësisë indoeuropiane”.²⁷

Matteo Bartoli i klasifikoi gjuhët indoeuropiane në gjuhë *qendrore* dhe *anësore*. Sipas Bartolit shqipja piqet me baltishten më fort në konservime sesa në inovacione, me greqishten më fort në inovacione sesa në konservime”.²⁸ Në albanologji meritë e Bartolit është nxjerrja në dritë, megjithëse pa e transkriptuar e materialit *Djali plëngprishës*, shkruar në dialektin e Istrias. Kontribute në albanologji janë edhe punimet: “Accordi antichi fra l’albanese e le lingue sorelle”

²⁰ M. Prik, *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*, Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2011, f. 203.

²¹ I. Ajeti, “Kontributi i Carlo Tagliavinit në studimet e historisë së gjuhës shqipe”, *Vepra 5*, Prishtinë, 2002, f. 64.

²² *Rivista d’Albania*, fasc. II, 1940 (XVIII), f. 114-141.

²³ F. Ribezzo, “Premesse storico-linguistiche sull’autoctonia illirica degli albanesi”, *Rivista d’Albania*, fasc. II, 1940 (XVIII), f. 127.

²⁴ C. Tagliavini, “Linguistica”, *Rivista d’Albania*, fasc. II, 1941, f. 187.

²⁵ “Traci e Illiri rapresentino nomi dello stesso ethnos”; F. Ribezzo, “Premesse storico-linguistiche sull’autoctonia illirica degli albanesi”, *Rivista d’Albania*, fasc. II, 1940 (XVIII), f. 139.

²⁶ *Rivista d’Albania*, fasc. IV, 1941, f. 334-346.

²⁷ I. Ajeti, “Kontributi i Carlo Tagliavinit në studimet e historisë së gjuhës shqipe”, *Vepra 5*, Prishtinë, 2002, f. 65.

²⁸ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Pjesa e parë, Botime Çabej, 2008, f. 32.

(Studi albanesi II, 1936), “La questione delle velari ario-europee e la lingua albanese” (*Rivista d’Albania*, fasc. 4, 1943, f. 217-234). Bartoli u mor edhe pak me etimologji.²⁹

Metodat neolinguistike depërtuan fuqishëm në albanistikë sidomos përmes punimeve të gjuhëtarit **Vitore Pisani**. Temat më të preferuara të tij ishin ato që lidheshin me burimin e gjuhës shqipe, marrëdhëniet mes gjuhëve ballkanike, por ai ka bërë edhe shqyrtime me karakter etimologjik. Vepra e njohur e tij në studimet indoeuropiane është “Geolinguistica indoeuropeo” (1940). Pozicionin e origjinën e shqipes si dhe karakteristikat indoeuropiane të saj, V. Pisani i ka trajtuar në shkrime, si “L’albanais et les autres langues indoeuropiennes” (1950),³⁰ “Sulla genesi dell’albanese”³¹ i ndjekur nga një punim tjetër nga fusha leksikore “Lexikalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indogermanischen Sprachen” (1955, pp. 115-136). Punimi “Les origines de la langue albanaise. Questions de principes et de methode” (*Studia Albanica* I, 1, 1964, pp. 61-68), është konsideruar si origjinal për albanologjinë nga një tjetër albanolog italian, Giovan Battista Pellegrini.³² Pavarësisht dilemave rreth origjinës së shqipes Pellegrini vëren se “nel complesso il Pisani è un sostenitore della tesi illirica”.³³

V. Pisani ka qenë pjesëmarrës edhe në disa konferenca ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri me disa kontribute origjinale. “Ilirët në Itali”³⁴ me të cilën Pisani kërkoi të zbulonte elementet ilire jo vetëm brenda mesapishtes, por brenda asaj që ai quante lidhje gjuhësore italice. “Mjerisht, përveç mesapishtes, që nga ana tjetër njihet pak nga monumentet e saj të shkurtra dhe jo të bollshme, mund të përmendim vetëm shqipen, të cilën e njohim vetëm që nga shek. XVI dhe që, gjatë intervalit të gjatë kohor ka ardhur duke u formuar, përveç me elemente ilire, edhe nga elementet me origjinë tjetër- latine, romane, sllave, greke, turke,- të cilat në një pjesë të mirë, kanë zëvendësuar ose ndryshuar elementet ilire...”³⁵

Shkrime të tjera me interes për albanologjië janë edhe: “Origjina e gjuhës shqipe” (*Konferenca I e Studimeve albanologjike*); “Nyja e mbrapme në shqipen dhe çështje të lidhura me të” (në *Konferenca II e studimeve albanologjike*, vëll. III, Tiranë, 1969, f. 123-125).

²⁹ “L’etimologia di γλώττα e la lingua labanese”, *Rivista d’Albania*, fasc. I, 1944, f. 3-10.

³⁰ ribotuar në *Saggi di linguistica storica*, Torino, 1059, pp. 96-114,

³¹ *Akten des Internacionalen Albanologischen Kolloquiums*, Innsbruck, 1972.

³² “varie volte è intervenuto con visioni originali su problemi di albanologia”, Giovan Battista Pellegrini, *Avviamento alla linguistica albanese* (Centro Editoriale e Librario, Università degli Studi della Calabria, Rende, 1998, pp.69.

³³ Giovan Battista Pellegrini, *Avviamento alla linguistica albanese* (Centro Editoriale e Librario, Università degli Studi della Calabria, Rende, 1998, pp. 70.

³⁴ *Kuvendi I i Studimeve Ilire* (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, f. 81-89.

³⁵ V. Pisani “Ilirët në Itali” (*Kuvendi I i Studimeve Ilire* (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, f. 83.

Albanologjia e ka tërhequr jo pak edhe gjuhëtarin tjetër italian **Giuliano Bonfante**, si për origjinën e shqipes, ashtu edhe pozicionin e saj mes gjuhëve të tjera IE.³⁶ Në “Shqipja dhe ilirishnja” (*Kuvendi I i Studimeve Ilire* (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, f. 99-102) ai ndan mendimin se shqipja duhet afruar më shumë me trakishten se ilirishten.

Në punimin “Premesse e problemi per un dizionario etimologico albanese” (Udine, 1950) zë në gojë edhe dy punime të tjerë nga fusha e etimologjisë.

Një figurë e shquar në albanologji që u shua vetëm pak vite më parë është **Giovan Battista Pellegrini**. Pas mësuesit të tij në albanologji, Carlo Tagliavini, Pellegrini i ka kushtuar vëmendje shqipes shpesh edhe në spektrin e gjerë ballkanik. Një kontribut përbën vepra *Introduzione allo studio della lingua albanese* (Padova, 1977) e ribotuar nën titullin *Avviamento alla linguistica albanese* (Centro Editoriale e Librario, Università degli Studi della Calabria, Rende, 1998). Për Pellegrinin “Interesante per la preistoria dell’albanese è il nome della Dardania, cioè di una regione che corrisponde ad un dipresso all’attuale provincia del Kosovo”.³⁷

Pa përmendur recensionet për botime të ndryshme, punime origjinale të tij janë ato që prekin elementin latin në leksikun e shqipes, temë e rrahur në disa punime: “I rapporti linguistici interadriatici e l’elemento latino dell’albanese”, (në Abruzzo, XIX, 1980, f. 379-384); “Disa vëzhgime mbi elementin latin të shqipes”, “Sull’ elemento latino dell’albanese (Ricerche linguistiche balcanico-danubiane, Roma 1992, pp. 101-151).

Me interes janë edhe vëzhgimet e Pellegrinit për leksikun e të folmeve arbëreshe: “Il lessico dell’arbëresh e i turchismi” (në *Le minoranze etniche linguistiche*, Atti del II Congresso Internazionale, Piana degli Albanesi, Palermo, 1989) etj.³⁸

Për lidhjen gjuhësore ballkanike shquhet, pasuesi e dishepulli i V. Pisanit, **E. Banfi** i njohur në fushën e ballkanologjisë me veprën *Linguistica balcanica* (Bologna, 1985). Problemet e ballkanologjisë, por edhe ato të shqipes ai i tajtoi në një sërë artikujsh: “Storia linguistica del Sud-Est europeo. Crisi della Romania balcanica tra alto e basso medioevo” (Pavia, 1991). Në vitin 2008 ai mbajti në Universitetin Oriental të Napolit ligjëratën me titull “L’albanese, lingua balcanica: considerazioni storico e tipologico-linguistiche”.³⁹

³⁶ G. Bonfante, “La posizione linguistica dell’Albanese tra le lingue indoeuropee” (Palermo, 1978, pp. 25-58).

³⁷ Giovan Battista Pellegrini, *Avviamento alla linguistica albanese* (Centro Editoriale e Librario, Università degli Studi della Calabria, Rende, 1998, f. 62).

³⁸ Pellegrini ka shkruar edhe për kontributin e Tagliavinit në albanologji “Carlo Tagliavini e gli studi albanologici, “Studiuesit italianë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, *Studime shqiptare* 7, 1996, f. 21-25.

³⁹ Karakteristika të përgjithshme të gjuhës shqipe kanë bërë R. Ambrosini “Elementi conservativi ed innovativi nella struttura dell’albanese”, (në *Enia albanese*, Palermo, 1983, pp. 159-169).

Disa kërkime me interes, sidomos për elementin latin kanë bërë **Paolo Di Giovine, Adolorata Landi**. Paolo Di Giovine në vitin 1981 botoi monografinë *Il gruppo CT latino in albanese* (Roma, Università, Istituto di Glottologia). Për këtë kontribut D. Luka shkruan “është monografia e parë që trajton në mënyrë të plotë e tërësore një ndër dukuritë e vështira të fonetikës historike të shqipes e më tej edhe të ballkanistikës e të romanistikës”.⁴⁰ Edhe **Adolorata Landi** është një emër i njohur për studimet e saj nga fusha e leksikut të shqipes, sidomos për veprën me titull *Gli elementi latini nella lingua albanese* (1989), por edhe mjaft shkrime të tjera me karakter albanologjik.⁴¹

Një ish-studente e Pellegrinit në albanologji dhe sot një emër i afirmuar në studimet për shqipen është **Monika Genesin**, e cila është bërë e njohur me një sërë studimesh,⁴² shpeshherë edhe në bashkëpunim me Joachim Matzinger⁴³. Së fundi, së bashku me Donato Martucci kanë sjellë disa fakte në lidhje me funksionimin dhe kontributet e Qendrës së Studimeve për Shqipërinë (Centro Studi per l’Albania, 1939-1944)⁴⁴ në krye të së cilës ishte Francesco Merlo. “Kjo Qendër,-sipas studiuesve,- pati një rëndësi të dorës së parë edhe për kërkimet në lëmin e gjuhësisë shqiptare, si përmes botimit të veprës *Le terre albanesi redente*.....ashtu edhe për përpjekjet për të hartuar një atlas dialektologjik të shqipes”⁴⁵. U hartua edhe një pyetësor për të cilin punuan C. Merlo, M. Bartoli dhe C. Tagliavini sipas modeleve të kohës i cili mbeti pa u botuar, por një përmbledhje të tij e prezantuan Monica Genesin & Donato Martucci në punimin e tyre.⁴⁶

Për vite me radhë në universitetin e Kalabrisë kanë dhënë kontributin e tyre **J. Trumper e L.M. Savoia** të cilët “nxitur nga qëndrimi në mjedisin arbëresh të Kalabrisë...filluan të hulumtojnë fusha të reja të gjuhësisë dhe dialektologjisë

⁴⁰ D. Luka, “Shënime rreth monografisë “Grupi CT i italishtes në shqipe” i Paolo di Giovine”, “Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, në *Studime shqiptare* 7, Shkodër 1997, f. 65.

⁴¹ A. Landi, “Ancora sull’evoluzione a>e nel latino tardo? Alcuni prestiti latini in albanese” në *Zjarri (Il fuoco)*, nr. 31, f. 18-26).

⁴² “Kontributi i A. Leotit në Albanologji”, në “Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, në *Studime shqiptare* 7, Shkodër 1997, f. 91-103; “Shqipja “gjuhë në përpunim” (1918-1941), *Gjuha jonë*, 3-4/2003, f. 13-31.

⁴³ “Il bestiario buzukiano tra onomasiologia e etimologia”, në *Hylli i dritës*, 3/ 2007, f. 150-194; “Das Lexem *turk* bei den altabaischen Autoren”, në *Sritti i n onore di Ercic Pratt Hamp* (per il suo 90. compleanno), Università della Calabria, Rende, Italia, 2010.

⁴⁴ Monica Genesin & Donato Martucci “Gjuha dhe kultura shqipe në veprimtarinë e Qendrës së Studimeve për Shqipërinë (Centro Studi per l’Albania, 1939-1944)” në *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit* (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011), Prishtinë 2012, f. 595-607.

⁴⁵ Po aty, f. 595.

⁴⁶ Vëllimi i parë i *Le Terre albanesi redente. I. Cossovo* u botua në vitin 1942, ndërsa vëllimi i dytë për Çamërinë mbeti i pabotuar.

arbëreshe, duke zbatuar për këtë mjete të reja metodologjike të disa drejtimeve për studime të gjuhësisë bashkëkohore”.⁴⁷

Emri i profesorit të Universitetit të Firences, **L. Savoia** lidhet me shumë punime disa herë në bashkëpunim me kolegen e tij Rita Manzini.⁴⁸ Për vite me radhë ai ka zbatuar metoda kryesisht gjenerative në studimin e shqipes dhe rezultati i fundit i kërkimeve të tij është studimi “Case as denotational property: the interaction of dom and discourse-linking in Shkodër. Pronouns” në konferencën *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit* (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011, Prishtinë, 2012, f. 411-432). Savoia u interesua për shumë dialekte albanofone, sidomos për komunitetin e Mezogiornos⁴⁹ për të cilin “è riusciti a determinare nuovi e proficui percorsi scientifici all’interno dell’albanistica, e non solo di quella italiana, e a favorire nel nostro Paese un sempre maggiore interesse per l’albanese e i suoi dialetti”.⁵⁰ Savoia ka interes edhe për marrjen gjuhësore duke përfshirë edhe kontekstin arbëresh.⁵¹ Ai vazhdon me përkushtim rrugën e shkencës dhe atë të albanologjisë.

Me përkushtim edhe për disa aspekte të albanologjisë punon edhe **J. Trumper**, profesor i cili prej vitesh kontribon edhe për disa çështje të albanistikës. Ai me bashkëpunëtorët e tij realizuan analizat e para nga fonetika akustike për të folme të ndryshme arbëreshe.⁵²

Nga ky përshkrim i shkurtër i një pjese të kontributit të filologëve italianë për shqipen mund të themi se ky interes qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë ka njohur ngritje, sidomos në gjysmën e dytë të shek. XX. Natyrisht për një nxitje të këtyre

⁴⁷ F. Altimari, “Qasje historisë së dialektologjisë arbëreshe”, në *Vëzhgime gjuhësore dhe letare arbëreshe*, Prishtinë, 2002, f. 112.

⁴⁸ R. M. Manzini & L. M. Savoia, “Reducing “case” to “agreement”: Nominal inflections in the Geg Albanian variety of Shkodër”, *Linguistic Variation Yearbook* 11, 1: 76-120; Manzini, R. M. -L. M. Savoia, “Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës”, *Studime filologjike*, nr. 3-4, Tiranë, 2003 etj.

⁴⁹ L. M. Savoia, “La parlata albanese di S. Marzano di S. Giuseppe: appunti fonologici e morfologici” në *Zjari* (Il fuoco), nr. 27, anno XII, S. Demetri Corone, 1980.

⁵⁰ F. Altimari, “Prefazione”, në *Studi sulle varietà arbëreshe*, Università della Calabria, Cosenza, 2008.

⁵¹ Punime të tjera të tij janë: “Ristrutturazione analogica: sviluppi in alcune parlate albanesi” në *Scritti linguistici in onore di Giovan Battista Pellegrini*, Pacini Editore, Pisa, 1983; “Etimologji dhe gjuhë kombëtare. Shënime mbi një aspekt të gjuhësisë së Eqrem Çabejt (Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Gjirokastër, 2004) etj.

⁵² J. Trumper & Xh. Belusho “A first acoustic-perceptual study of the vowel systems of Frasnita, Ungra and Shën Vasili”, në *Atti del Congresso Internazionale di Studi sulla Lingua, la Storia e la Cultura degli Albanesi d’Italia* (Mannheim, 25-26 qershor 1987), Rende 1991, f. 257-294; J. Trumper, “A proposito di alcuni albanesismi in un gergo calabrese dei mestieranti”, në *Zjari* (Il fuoco), anno XVIII, nr. 30, S. Demetri Corone, 1986, f. 35-40; J. Trumper & L. Romito, “Vocalismi arbëreshë a confronto: uno studio acustico comparativo” në *Dialetti italo-albanesi e letteratura*, Palermo 1992, f. 205-228.

studimeve kanë ndihmuar dijetarët italo-arbëreshë, si Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Marko La Piana, të cilët vendosën themelet për studime gjuhësore tek arbëreshët.

Në fushën e gjuhësisë arbëreshët e Italisë në këta pesëdhjetë vjetët e fundit kanë lëvruar me sukses leksikografinë, leksikologjinë, dialektologjinë, tekstologjinë, toponiminë, historinë e gjuhësisë, gramatologjinë dhe studimet për gjuhën e shkruar shqipe të shkrimtarëve të traditës dhe të letrarëve bashkëkohës⁵³ pa harruar fonologjinë e sidomos filologjinë. Një ndihmë e madhe ka qenë edhe hapja e qendrave albanologjike në Napoli, Palermo, Padova, Romë e më vonë në Bari e Kozencë. Forcimi i dy qendrave, Palermos e Kozencës, jo vetëm si qendra mësimdhënëse, por edhe kërkimore-shkencore me organizmin e mjaft seminareve ndërkombëtare me karakter albanologjik, botimin e thesarit të trashëguar arbëresh me metoda bashkëkohore, kanë luajtur rol jo vetëm për studimet e dialekteve arbëreshe, por për shqipen mbarë.

Bibliografi

1. Ajeti I. (1978), *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë.
2. Ajeti, I. (1998/2002), *Vepra 3*, Prishtinë, 1998; *Vepra 5*, Prishtinë, 2002.
3. Altimari, F. (2002), *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë.
4. ASHAK (2012), *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit* (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011), Prishtinë.
5. Çabej, E. (2008), *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Pjesa e parë, Botime Çabej.
6. Demiraj, Sh. (1991), *Sugli studi albanologici in Italia, Zjarri*, (Il fuoco), nr. 35/36, 1991.
7. Pellegrini, G. Battista (1998), *Avviamento alla linguistica albanese* (Centro Editoriale e Librario, Università degli Studi della Calabria, Rende).
8. Priku, M. (2011), *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes* (monografi), Shtëpia Botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër.
9. *Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, “Studime shqiptare” 7, Shkodër 1997.

⁵³ J. Kastrioti, “Ndihmesa të arbëreshëve dhe të studiueve të tjerë në Itali për gjuhësinë shqiptare”, *Gjuha jonë*, 1-4, 1996, f. 72.

Julie M. KOLGJINI

**NXËNIA E DY GJUHËVE SI GJUHË E PARË SI DHE IVERGJENCA,
KONVERGJENCA E INOVACIONET GJUHËSORE: SHQIP DHE
ANGLISHT**

1. Hyrje

Ndonëse një numër i madh investigimesh akademike janë publikuar gjatë dekadave të fundit, në fushën e dygjuhësisë (shih Bialystok 1999, 2007; Bosch & Sebastián-Gallés 2003; Döpke 2000; Koppe & Miesel 1995; Miesel 2009; Nicoladis & Genesee 1996; Paradis, J. 2010; Paradis, M. 2004; etj.), deri tani, pak prej tyre janë marrë me **DY GJUHËSINË SIMULTANTE** (d.m.th. nxënien e dy gjuhëve si gjuhë e parë, N2Gj1 ose 2Gj1), duke përfshirë gjuhën shqipe. Pavarësisht nga mungesa e studimeve rreth 2Gj1-së për shqipen, në vitet e fundit disa studiues janë përqendruar në të tjera aspekte të nxënies¹ gjuhësore nga folësit e shqipes, sidomos tek nxënia e gjuhës së parë në shqip nga fëmijët (fGj1 nxënia, p.sh. Cenko 2009; Kapia 2010: 163-164), si dhe nxënia e gjuhës së dytë (Gj2) dhe mësimi i anglishtes si gjuhë e dytë nga fëmijët në moshë më të rritur/adoleshencë dhe të rriturit (shih Rista-Dema 2006, 2008; Dushku 1998a, 1998b, 2000; Kola 2011). Megjithëse Cenko (2009) merret me nxënien gjuhësore të hershme të konstruktit foljor në shqip, fokusuar kryesisht në fëmijët monolingual (ndërmjet moshës dy deri në tre; shih gjithashtu Cenko & Budwig 2007). Ngjashëm, Kapia (2010: 163-164) flet rreth nxënies së gjuhës së parë (nga moshë dy deri në katër vjeç, krahasuar me folësit e rritur me shqipen si Gj1, prej moshës 19;4-64) duke analizuar edhe rimarrjen e kundrinave në shqipe, por këtu prapë për fëmijët monolingual që kanë kontakt të kufizuar me gjuhë të tjera (shih gjithashtu Kallulli 1999, 2000 e 2008). Më tej, Rista-Dema (2006, 2008) investigon renditjen e anasjelltë të konstruktit në anglishten e shqip-folësve (p.sh. Folje-Kryefjalë, F-K; khs. K-F) që predominon tek të rriturit bilingual (rrGj2 anglisht, Gj1 shqip) ku si shembuj janë përdorë individët të cilët e kanë anglishten si gjuhë të dytë, të huaj ose si gjuhë tjetër, por jo si gjuhë të lindur dhe paralelisht me shqipen (siç ndodh me 2Gj1; shih Meisel 2009). Ky studim eksploron elemente të ndryshme në fushën e dygjuhësisë simultante (2Gj1, khs. dygjuhësia konsekuative, sekuenciale ose suksesive) në të folurit e një shqip- dhe anglisht-folësi duke përdorë vëzhgim natyralistik, dhe në veçanti në përshtatje me MODELIN E KONKURENCËS

(MacWhinney 1987; Bates & MacWhinney 1989; shih gjithashtu Langacker 1987), sidomos në kuptimin e transferimit gjuhësor (p.sh. PËRZIERJE KODESH) dhe të HIPOTEZËS SË BALLAFAQIMIT, kryesisht në lidhje me ballafaqimin sintaksë-pragmatikë (të diskursit).

2. Dygjuhësia simultante

Disa tipa të bilingualizmit, më saktë bilingualizmi simultant (d.m.th. 2Gj1) dhe bilingualizmi suksesiv (p.sh. fGj2) ndoshta mund të kuptohen më mirë nëse e shohim në prizmin e nxënies së gjuhës së parë dhe të dytë (d.m.th. Gj1 dhe Gj2, respektivisht). Sipas Meisel (2009:5): “Ka një konsensus të gjerë në literaturën kërkimore mbi nxënien dygjuhësore që nxënja simultante e dy (ose më shumë) gjuhëve mund të konsiderohet si një instancë e zhvillimit të dy gjuhëve [njëkohësisht] si gjuhë e parë.” Meisel (2009:5) shton që: “fëmijët me 2Gj1 [(d.m.th. me dy gjuhë si gjuhët të parë)] dallohen nga [fëmijët që fillojnë më vonë, por gjithsesi herët të mësojnë një gjuhë tjetër] në sistemet e gjuhëve tek të cilat janë të ekspozuar...,...vazhdon në të njëjtat faza zhvillimi respektivisht si [fëmijët] monolingual dhe...mund të arrijnë kompetencën si në gjuhën amtare.” Në kontrast, dygjuhësia suksesive përfshin nxënien ose të mësuarit e gjuhës së dytë më vonë gjatë jetës (p.sh. në moshën 10 vjeçare), jo prej lindjes, duke rezultuar në dallime në nxënien e gjuhës në krahasim me zhvillimin gjuhësor të folëseve monolingual dhe këtyre të cilët janë 2Gj1, pra ngajjnë më shumë si Gj2. Meisel (2009:5-6) shkruan:ⁱⁱ “[N]xënia suksesive e bilingualizmit qartas paraqet dallime substanciale, krahasuar me zhvillimin monolingual si edhe bilingual si gjuhë e parë, nëse fillimi i nxënies ndodh në moshën dhjetë vjeçare ose më vonë, d.m.th. në atë që zakonisht quhet nxënia e gjuhës si gjuhë e dytë nga të rriturit (rrGj2).” 2Gj1 dhe bilingualizmi fGj2/rrGj2 dallojnë për nga fazat fillestare të procesit të zhvillimit të cilët janë konsiderueshëm të ndryshme (ndoshta për shkak të ndikimeve ndërgjuhësore dhe transferimeve prej gjuhës së parë në të dytën); gjithashtu paraqiten sequenca konstante (të palëvizshme, invariante) të zhvillimit në Gj2 (të cilat nuk janë të njëjta tek monolingualët). Shtrirja e variacionit për folësit Gj2 është shumë më e gjerë së tek fëmijët 2Gj1 (Meisel 2009:6).

Në studimet rreth nxënies së gjuhës dhe të mësuarit, nocioni i periudhës kritike ose sensitive (p.sh. HIPOTEZA E PERIUDHËS KRITIKE, HPK,ⁱⁱⁱ shih Singleton 2005, 2007 për diskutim rreth Penfield & Roberts 1959, Lenneberg 1967, Long 1990, Johnson & Newport 1989, etj.; shih gjithashtu Meisel 2009), d.m.th. moshës, kur nxënia e gjuhës së dytë duhet të fillojë për të arritur në nivelin e lartë të kompetencës si në gjuhën amtare mbetet ende e pazgjidhur (e pa përcaktuar), edhe pse shumë hipoteza janë hedhur.^{iv} Ndërsa disa shkencëtarë argumentojnë se për nxënien e gjuhës së dytë, në moshë më të re është më mirë (sepse plasticiteti

cerebral fillon të ngurtësohet për shkak të lateralizimit të trurit në moshën e pubertetit, 10-15 vjeç, nëse jo më herët, p.sh. 2-4 vjeç), sepse pas kësaj periudhe kritike vështirësohet nxënia (implicite) dhe të mësuarit e gjuhës (Lenneberg 1967; Molfese 1977; Long 1990; Meisel 2009; Johnson & Newport 1989; Weber-Fox & Neville; Eubank & Gregg; Hurford & Kirby), disa të tjerë sugjerojnë të kundërtën, se në moshë më të rritur është më mirë (p.sh. pas-pubertetit) për nxënien e gjuhës së dytë, duke argumentuar se matura mentale (kognitive) ndihmon në të mësuarit (eksplicid) të gjuhës (shih e.g. Flege et al. 1999; Bongaerts 1999; Birdsong 1992, 1997; shih gjithashtu Bialystok & Miller 1999, Birdsong & Molis 2001; Pallier et al. 2003); por gjithashtu edhe një mendim tjetër që duhet përmendur, është që faktorë motivues-afektiv, aspekti psiko-social, pedagogjia, mjedisi, metodat e të mësuarit, atituda, funksionimi i kujtesës dhe tipologjia e gjuhës së parë (Gj1) dhe gjuhës së dytë (Gj2) luajnë rol të konsiderueshëm (shih p.sh. Krashen 1982: 216; Schumann 1975:229; Bialystok & Hakuta 1994). Më tej, shumë ithtarë të HPK i referohen neurobiologjisë (Singleton 2005:275). Por duhet theksuar se, “[N]uk ka konsensus’ për sa i përket interpretimeve me anë të neurobiologjisë në lidhje me efektet e moshës” në të mësuarit e gjuhës ndërmjet avokatëve dhe skeptikëve të HPK-së (Hylénstam & Abrahamsson 2003a: 563 në Singleton 2005:276).

2.1. Investigimi ynë: shqip-anglisht 2Gj1

Në lidhje me nxënien e dy gjuhëve si gjuhë e parë (2Gj1), ky studim përqendrohet në aspekte të ndryshme vëzhguese të divergjencës, konvergencës dhe inovacioneve (p.sh. ndikimi i ballafaqimit të gjuhëve, ^v d.m.th. transferimi, duke përfshirë: 1) në leksik (përzjerje kodesh) dhe 2) në sintaksë-pragmatikë, p.sh. i) renditja e fjalëve në funksion të diskursit, ii) mungesa e foljes ndihmëse **do** (në anglisht) dhe iii) mungesa e kryefjalës në anglisht në konvergencë me strukturën e shqipes; si edhe iv) mbipërgjithësimi i formave të rregullta të foljeve në të shkuarën dhe v) përemrat vetor disjunktiv, ku dy të fundit janë të zakonshme në të folurit e fëmijëve monolingualë të anglishtes) në të folmen e një fëmije (vajzë) katër-vjeçare e cila është bilinguale simultante në shqip dhe anglisht, në kushtet e një mjedisi natyral gjatë një periudhë tremujore. Këto vëzhgime mund të shpjegohen të paktën pjesërisht nëpërmjet elementeve të ndryshme të modelit të konkurrencës, p.sh. kodet dhe transferimet (MacWhinney 2005^{vi}), dhe me hipotezën e ballafaqimit. Metoda një-prind-një-gjuhë është përdorë me këtë fëmijë qysh në lindje, ku nëna e saj përdor anglishten (standarde, me aksentin *midwestern*) dhe babai i saj përdor shqipen (me bazë gegnishten) kur komunikojnë me fëmijën. Të dy prindërit janë folës të gjuhëve amtare përkatëse. Prindërit, gjithashtu, përpiqen të shmangin përzjerjen e kodeve (ndërmjet shqipes dhe anglishtes) në komunikimin me fëmijën. Më tej, fëmija është rritur në çerdhe-kopsht parashkollor në Prishtinë (Kosovë),

duke filluar prej moshës 1;6 gjatë vitit shkollor (shtator-maj); pasditeve dhe gjatë fundjavave ajo komunikonte me nënën e saj (Gj1 anglisht) në anglisht në mënyrë të vazhdueshme. Duhet shënuar gjithashtu se fëmija kalonte shumë fundjavë gjatë vitit akademik me familjen e babait në Kukës (Shqipëri) ku përdoret shqipja (gegërishtja). Gjithashtu, subjekti ka kaluar stinën e verës në ShBA prej lindjes. Pra, gjatë vitit shkollor gjuha e saj dominante (dhe e komunitetit më të gjerë) është shqipja; gjatë verës gjuha e saj dominante (dhe e komunitetit më të gjerë, duke përfshirë komunikimin brenda shtëpisë) është anglishtja.

2.1.1. Modeli i konkurrencës (MacWhinney): transferimi

Ashtu si MacWhinney (2005:76) shënon, kur përpiqet të formulojë një model përgjithësues rreth nxënies së gjuhës së dytë dhe bilinguizmit simultant, elementet ndërgjuhësore, pikërisht transferimet dhe përzjerja e kodeve (përzjerja e dy gjuhëve ose dialekteve në një fjali/frazë, p.sh. *du me bike* ‘I want to bike’), duhet marrë në konsideratë. Transferimi (shih gjithashtu Odlin 1990 ne Rista-Dema 2006:57-61, 62-64) ndodh kur elementet gjuhësore (si fonologjia, leksiku dhe morfo-sintaksa) prej njëres gjuhë (p.sh. shqipes) shfaqen në tjetrën (në anglisht; shih MacWhinney 2005:76). Si MacWhinney (2005:76-77) shkruan: “Pretendimi themelor i modelit të konkurrencës është çfarëdo që mund të transferohet do të [transferohet]...Për bilingualët në moshë të re të cilët janë duke nxënë dy gjuhë njëkohësisht, ruajtje e balancës relative midis dy gjuhëve mund të minimizojë transferimet dhe të shmangë situatën në të cilat njëra gjuhë bëhet parazitare mbi tjetrën. Por qoftë edhe ndërrimet e vogla në dominancën gjuhësore në fëmijëri mund të rezultojnë në efekte të forta transferimesh (Döpke, ne shtyp).” Me fjalë të tjera, për bilingualët simultant, transferimet gjuhësore prej njëres gjuhe në tjetrën janë të pritshme.

2.1.2. Transferimi leksikor: përzjerja e kodeve

Gjatë ndërkomunikimit me fëmijët bilingual simultante (2Gj1), përzjerja e kodeve është njëri nga elementet më të dukshme si produkt gjuhësor prej atij fëmijë^{vii} (shih Kolgjini 2011 për detaje mbi përzjerjen gjuhësore në shqip).^{viii} Disa shembuj të përzjerjes gjuhësore paraqiten në tabelën 1, ku baza e fjalisë është shqip me mbivendosje në anglisht.

Është e rëndësishme të shënohet që ky fenomen gjuhësor është paraqitur kur subjekti ishte duke komunikuar me babain e saj, që e ka shqipen gjuhe amtare dhe që përdor vetëm shqipen kur komunikon me subjektin në fjalë, në prezencë të nënës bilinguale (anglisht–shqip) si dhe pjesës tjetër të familjes së nënës monolinguale (folës të anglishtes) të moshës prej 16-68 vjeç prej dy gjinive. Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet që përzjerja e kodeve ndodhi gjatë qershorit dhe fillimit të

korrikut gjatë periudhës transitore kur subjektit bilingual po i ndryshonte dominanca gjuhësore prej njëres gjuhe në tjetrën d.m.th. prej shqipes në anglisht.

Në disa fjali me përzierje kodesh që vihen re në të folurin e subjektit, p.sh. *në car wash kena shkue*, huazimet ose përzierja e kodeve prej anglishtes paraqitet jo për shkak të mungesës leksikore nga vokabulari aktiv i shqipes së subjektit (sidomos duke pasur parasysh që subjekti i ka përdorë rregullisht fjalët *lavazh* dhe *lamje/larje makinash/makinë lamje/larje* gjatë vitit shkollor), por sepse ishte pjesë e diskursit aktual, në përgjigje të asaj çka gjyshja e saj monolinguale (Gj1 anglisht) i kishte kërkuar, p.sh. “Hana, tell your Babi where we went”; me fjalë të tjera, pyetja në anglisht që i ishte drejtuar në diskurs të menjihershëm prej bashkëbiseduesit (Gj1 anglisht) ka shërbyer si një lloj kod-aktivizimi për intrigimin e ridaljes së anglishtes d.m.th. transferimit leksikor (shih MacWhinney 2005:72 për me shumë detaje në modelin e konkurrencës, transferimin dhe aktivizimin e kodeve). Ky KOD-AKTIVIZIM në diskursin e mjedisit rrethues mund të shihet si një prej shkaqeve motivuese mbrapa frazave të tjera me përzierje kodesh, gjithashtu. Në një tjetër shembull: *e hear-a nji...*, përzierja e kodeve, ose transferimi morfo-sintaksor dhe leksikor, shfaqen midis morfemave brenda-fjalës, ku rrënja e foljes është në anglisht dhe shënimi morfologjik për vetën, numrin dhe kohën është në shqip. Kjo përgjigje i ishte drejtuar babait të saj por ishte përgjigje e pyetjes së drejtuar nga teza e saj monolinguale (Gj1 anglisht): “Hana, did you hear the fireworks?” Tjetër shembull i përzierjes së kodeve që është vënë re tek e folura e subjektit është: *kur kena shkue shopping*; fjala-fundore e frazës është huazim shumë i shpeshtë nga anglishtja në të foluren e shqip-anglisht folësve, që nuk reflekton doemos mungesë leksikore të folësit por ndoshta mungesën e fjalës ekuivalente në gjuhën shqipe (khs. *pazar*, në aspektin semantik dhe të konotacionit nuk shpreh plotësisht të njëjtin kuptim).

2.1.3. Transferimi sintaksor dhe pragmatik^{ix} (si Enrichment): inovacionet

Transferimi sintaksor në kuptimin e renditjes së fjalëve mund të vëzhgohet gjithashtu në rastin në fjalë në përdorimin gjuhësor, veçanërisht në vendosjen e kryefjalës (p.sh. pas foljes kryesore, khs. para foljes kryesore) në formulimet e saj të disa pyetjeve *po/jo* dhe *wh-* kur ajo flet anglisht (veçanërisht kur folja ndihmëse është komponent i foljes *jam*). Konstrukti inovativ i vëzhguar ndoshta mund të shpjegohet duke ndjekur renditjen e fjalëve të shqipes, konkretisht vendosjen e kryefjalës në kombinim me TOPIK-PROMINENCË (përkundër KRYEFJALË-PROMINENCË në anglisht), e cila duhet marrë në konsideratë.

Të fillojmë me renditjen e fjalëve. Ngjashëm me anglishten ku kryefjala para foljes në formulime deklarative, përbërësi i pashënuar në renditje në shqip është gjithashtu Kryefjalë-Folje-(Objekt) KF(O) (i.e. SV(O); shih Kapia 2010:82; Kallulli 1995:6-8 p.sh. *Beni shkruante një letër*; *Ana këndoi një këngë*; *Andi ndihmoi*

*shokët; Ana i bleu Benit një libër; khs. Një libër i bleu Benit Ana; shih gjithashtu Camaj 1984). Por, ashtu si Rista-Dema (2006:88) shkruan, “Kryefjalët në shqip mund të paraqiten si para foljes ashtu dhe pas foljes dhe si në formën aktive edhe atë pasive, bile edhe si në konstrukt foljor me një-argument.” Gjithashtu Kallulli (1995:6-7) shënon: “Fenomeni i paraqitjes së kryefjalës pas foljes nganjëherë referohet si renditje e lirë” siç na paraqitet në disa prej shembujve të mëposhtëm e.g. *një këngë këndoi Ana* (‘Ana sang a song’ Kallulli 1995:6-7); *mbërritën shumë miq* (‘Many guests arrived.’ Kallulli 1995:6-7); *një libër i bleu Benit Ana* (‘Ana bought Beni a book’ Kallulli 1995). Duke e bazuar argumentin e saj tek King 1993 (i cili diskuton për rusishten), Rista-Dema (2006:95-96) shënon se në gjuhën shqipe pozicioni i diskursit-neutral të kryefjalës ndjek foljen finite, në vend që ta paraprijë atë, dhe për shkak të sasisë së konsiderueshme të konstrukteve të foljeve në ballë që paraqiten në gjuhën shqipe, “kjo mund të na çojë në përfundimin se gjuha shqipe është një gjuhë FOK [(VOS)].”^x Më tej, shqipja, ndryshe nga anglishtja, zakonisht ndjek rendin pragmatik të fjalëve e cila thekson një perspektivë ligjërimit-ngjarje dhe organizim të diskursit, në krahasim me mënyrën e renditjes gramatikore të fjalëve siç është në rastin e anglishtes, ku është e pritshme renditja rigoroze e caktuar e fjalëve KF(O) (SV(O)); d.m.th. ndërsa shqipja është gjuhë me **topik-prominencë**,^{xi} anglishtja është gjuhë me **subjekt-dominancë**^{xii} (shih gjithashtu Kallulli 1999, 2000, 2008; Rista-Dema 2006:64-80; 2008; Kapia 2010; Kola 2011). Në gjuhën shqipe vendosja gramatikore e kryefjalës shumë herë është në fund të fjalisë (shih gjithashtu end-focus, Quirk Greenbaum 1973). Në aspektin e renditjes së fjalëve në format pyetëse në gjuhën shqipe, pozicioni i anasjelltë i KF (SV) është gjithashtu i pranishëm; pyetjet *po/jo* janë të shënuara nga një klauzolë-fillestare, pjesëza *a* (p.sh. *A erdhi Konstantini?* ‘Did Kostantin come?’ Camaj 1984:234).^{xiii}*

Gjithashtu duhet shënuar se shqipja është gjuhë me KRYEFJALË NUL (Kallulli 1995:6; p.sh. *Lexonte një libër* ‘He/she was reading a book’), ndërsa anglishtja jo; ajo e kërkon prezencën e kryefjalës (shih Celce-Murcia, Larsen-Freeman, & Williams 1999). Në shqip kryefjala nuk është prezent në rastet që nënkuptohet prej diskutimit. Në rastet kur kryefjala përmendet (shfaqet) në shqip, zakonisht ndodh ose kur njësia paraqitet për herë të parë në diskutim (si fokusim) ose është theksimi në kryefjalë (EMPHATIK), kjo e dyta ndeshet shpesh në të folurin e subjektit konkret 2Gj1 gjatë investigimit, veçanërisht në lidhje me përemrat.^{xiv}

Tani le të marrim në konsideratë disa nga shprehjet që janë përdorur nga subjekti aktual 2Gj1 në investigim. Duke pasur parasysh se shumë nga shprehjet që janë shqiptuar përbëheshin prej pyetjeve, duhet gjithashtu të marrim në konsideratë renditjen e fjalëve. Në përgjithësi në pyetjet *po/jo* (interrogativi, khs. deklarativi) në anglisht ndodh anasjelltas - kryefjalë-folje; posaçërisht kur funksionon aspekti progresiv, kryefjala vendoset në pozitën e dytë pas një foljeje ndihmëse si tregues gramatikor për vetën dhe kohën, dhe ku folja kryesore është treguesi për aspektin që

ndjek kryefjalën (Folja ndihmëse-K-Folja kryesore), p.sh. KF (SV, deklarativ): *You are coming*. FK (VS) anasjelltas (zhvendosje, pyetëse): *Are you coming?* (shih Celce-Murcia, Larsen-Freeman, & Williams 1999). Siç mund të shihet në tabelën 1, shprehja e fëmijës aktual në investigim 2Gj1 *Are playing you?* (khs. *Are you playing?*) ilustron diskursin-neutral (FK (VS), khs., KF (SV) të pashënuar dhe, në të njëjtën kohë, renditjen e fjalëve në formën pyetëse të gjuhës shqipe, ku kryefjala është në pozicionin e klauzolës-finale (pas-foljes, **POST-POSED**), por që me përmendjen e kryefjalës (ndoshta për arsye të fokusimit), duke qenë se shprehja është në anglisht. Vendosja pas-foljore dhe klauzola-fundore e kryefjalës mund të vërehet edhe në shembuj të tjerë, p.sh. *Where are going you?* (khs. *Where are you going?*). Vini re se në këto shembuj folja ndihmëse është kopula (angl. *COPULA* p.sh. angl. folja *to be, am, are; me qenë, jam, asht*) dhe aspekti progresiv (i kohës së tashme) ka qenë i pranishëm.

Duhet gjithashtu të theksohet se në të folmen e subjektit aktual 2Gj1, kur fjalët pyetëse-*wh* të ndryshme (p.sh. *what* dhe *why*) ishin në pozitë klauzolë-fillestare dhe kopula nuk ishte e pranishme si ndihmëse, por në vend të saj një *DUMMY-DO* futej në konstruktin e pritur të anglishtes (kur folja ishte në të shkuarën e thjeshtë), *dummy-do* nuk futej (p.sh. targeti: *Why did you come here?*, khs. konstatimi: *Why you come here?*). Ky mosveprim *dummy-do*, gjithashtu, mund të jetë transferim nga gjuha shqipe, meqenese shqipja nuk përdor *dummy-do* apo ndonjë tjetër folje ndihmëse që shënon vetën, numrin dhe kohën, ashtu siç ndodh në raste të tilla në anglisht (shih Celce-Murcia, Larsen-Freeman, & Williams 1999); në vend të saj shqipja thjeshtë shënon veten, numrin dhe kohën në foljen kryesore, p.sh. *aorist-in* (*Pse iki/iku? Why did s/he leave? A erdhi Konstantini? 'Did Kostantin come?' Camaj 1984:234; A shkove? 'Did you go'; khs. Kush shkoi? 'Who left/went?'*), siç mund të vërehet në fjalinë e mëposhtme të shqiptuar nga 2Gj1 në fjalë, p.sh. *Why you come here?* (khs. *Why did you come here if you are not going to stay here and play with me? I want you to stay here and play with me instead of leaving to visit your friends.*). Vini re se në të foluren e subjektit aktual 2Gj1 folja kryesore, *come*, mbart kohën në vend të rregullimit gramatikor nepërmjet *dummy-do*.

Më tej, në disa raste shfaqet, opsioni i kryefjalës *nul* nga shqipja i transferuar në disa shprehje në anglisht prej subjektit 2Gj1 në fjalë, p.sh. *What is doing here?* (khs. *What is he doing here?*). Por në shumicën e rasteve, megjithatë, subjekti 2Gj1 i nënshtrohet formës gramatikore të gjuhës angleze.

2.2 RASTET JO PREJ TRANSFERIMIT GJUHËSOR: MBIPËRGJITHËSIMET E KOHËS SË KRYER TË THJESHTË NË ANGLISHT –ED TË FOLJEVE TË PARREGULLTA DHE PËREMRRAT DISJUNKTIVË (DIVERGJENCA PREJ TARGETIT DHE INOVACIONET)

Siç është e njohur, fëmijët dygjuhësh të njëkohshëm gjatë zhvillimit të tyre gjuhësor përvetësojnë konstruktet në të njëjtën mënyrë si mund ti shohim edhe tek monolingualët Gj1 gjatë nxënies, p.sh. mbipërgjithësimin e treguesve morfologjik, d.m.th. *-ed* e *aorist-it* duke i aplikuar në të dy format foljore, të rregullta dhe të parregullta (p.sh. *losed*, khs. *lost*; *taked*, khs. *took*; *winned~won'd*, khs. *won*; *leaved*, khs. *left*; *breaked~broked*, khs. *broke*), si dhe ndërtime të përemrit disjunktive, siç është vërejtur variabli në përdorimin e gjuhës nga subjekti. Për shembull, *Mami, I losed two of mine* (khs. *Mami, I lost both of my yo-yo's*), i cili u vu re ndër shembuj të tjerë. Një tjetër element që mund të gjendet në gjuhën e fëmijëve (Gj1) gjate nxënies është inkorporimi i përemrave disjunktivë, apo përfshirja e një formë të një përemri të caktuar personal, shumë herë në rasat jo-emërore (p.sh. **me**) dhe të izoluara (p.sh. me *ELLIPSIS*, *Who wants to go? Me!*; khs. *I do! I want to go!*); në anglisht disjunktiva shumë here shfaqet me kopulan (p.sh. *It is me!* khs. *It is I*). Disa shembuj në të folurën e Hanës janë si vijon: *And me I like it* (khs. *I like it, too!*). Një mënyrë e të folurit duke përfshirë përzjerje kodesh duke përdorë përemrin disjunktive, p.sh. *Me jam baby bug*. Në këtë rast, duke marrë në konsideratë shume shembuj të njëjtë të vëzhguar, gjithashtu mund të argumentohet se anglishtja ishte parazitare^{xv} në gjuhën shqipe, sidomos duke pasur parasysht fortifikimin e saj në gjuhën shqipe gjatë vitit akademik (shih Hernandez, Li dhe MacWhinney 2005:222).

Tabela 1. Divergjencat, Konvergjenat dhe Inovacionet e Observuara

transferimi leksikor ^{xvi}	përzjerja e kodeve ^{xvii}	<p>në car wash kena shkue</p> <p>hear-a një (fireworks; khs. I heard some fireworks go off)</p> <p>kur kena shkue shopping</p> <p>jam po thinking</p> <p>jam reading</p> <p>jam t' sleep (khs. jam tue fjetë, jam duke fjetur)</p> <p>na kena learned në shkollë.</p> <p>du me go</p> <p>du me bike</p> <p>kena me miss shkollën</p>
transferimi sintaksor/pragmatik	renditja e fjalëve	<p>Are playing you? (khs. Are you playing?)</p> <p>Where are going you? (khs. Where are you going?)</p> <p>Are coming now you? (khs. Are you coming now? Note: Talking on her</p>

		imaginary cell phone)
	mungesa dummy-do	Are mine these ? (khs. Are these mine?) What you have? (khs. What do you have?) Why you come here? (khs. Why did you come here if you are going to go?) But: I didn't saw them (khs. I didn't see them; 12 Aug.) She waked up? (khs. Did your foot wake up?, 18 Aug.)
	kryefjalë-nul	What is doing here? (khs. What is he doing here?) Mami, I losed two of my mine (yo-yo's) (khs. lost)
Mbigjeneralizimi i treguesve morfologjikë (te foljet)		I drewed it, Mami (khs. drew) I finded it, Maimi (khs. found) I taked it, Mami. (khs. took) I winned~won'd the race, Mami! (khs. won) You breaked~broked it, Mami. (khs. broke) My friend leaved (khs. left) They comed , Mami. (khs. came) I sawed you, Sue. (khs. saw; 13 Aug.) She waked up? (khs. Did your foot wake up?, 18 Aug.)
përemrat disjunktivë		And me I like it. (khs. I like it, too.) Me jam to/te school. (khs. I am at school.) Me jam baby bug. (khs. I am a baby bug.)

2.3. Ballafaqimi sintaksë – pragmatikë

Kur marrim në konsideratë teoritë e mundshme që mund të na shërbejnë ti shohim nën dritën e tyre divergjencat, konvergjenca dhe inovacionet e vëzhguara, nga subjekti aktual 2Gj1, përveç Modelit të Konkurrencës nga MacWhinney, Hypoteza e Ballafaqimit të Sorace dhe Filiaci-t (HB, shih Sorace 2011), ku diskutohet rreth përballjes së sintaksës dhe pragmatikës, mund gjithashtu të merret në konsideratë. HB-ja lejon që këto devijime të vëzhguara të shihen si rezultat i ndërveprimit të sintaksës dhe pragmatikës midis dy gjuhëve, ku “ballafaqimi

ndërmjet sintaksës dhe elementeve të tjera kognitive [(p.sh. pragmatikës)] ka më pak të ngjarë të jetë fituar plotësisht prej strukturave që nuk përfshijnë përballjen" (Sorace 2011:1-2), duke përfshirë këtu të folurën e bilingualëve të njëkohshëm.^{xviii} Më tej, siç thuhet nga Barnes (2006:27): "pragmatika interlinguale ... shqyrton shkallën në të cilën pragmatika e një gjuhe ndërthuret në tjetrën (tjerat)." Ashtu siç është e dukshme në disa nga shprehjet në hetimin aktual, sidomos kur është përfshirë edhe sintaksa, gjithashtu.

Pra, ku mund të shihet ballafaqimi sintaksë-pragmatikë në shprehjet e vrojtuar tek subjekti aktual 2Gj1? Përdorimi i përemrave, sidomos në aspektin e anaforave dhe antecedentave, është një komponent i rëndësishëm për Hipotezat e Ballafaqimit (Sorace 2011:3). Ndërsa pjesa më e madhe e hulumtimit që përfshin HB-në tregon se fëmijët dygjuhësh kanë tendencë të dukshme të mbipërdorimit të kryefjalës sidomos kur paraqiten si përemra. Rasti në këtë studim i nën-aplikon ato kur është duke folur anglisht, p.sh. *What is doing here?* khs. *What is he doing here?*. Ndoshta kjo nga arsyeja që shqipja është gjuhë me kryefjalë-nul, transferimi pragmatik nga shqipja ka ndikuar në riprodhimin sintaksor të anglishtes, ku kryefjala nuk është përfshirë në formën sipërfaqësore. Meqenëse përemrat paraqesin informacionin e dhënë (topikën), ndoshta 2Gj1 aktual ka zgjedhur përjashtimin e atij pak informacioni të vjetër nga fjalët e saj në anglisht, veçanërisht pasi mund të kuptohen dhe mbulohen nga diskursi. Shprehje të tjera të ballafaqimit sintaksë-pragmatikë në komunikimin e 2Gj1 aktual mund të vërehen dukshëm në rastin e vendosjes së kryefjalës në sistemin gramatikor në pozicionin klauzolë-fundore (pas-foljes, *POST-POSED*) siç u diskutua më lart, duke krijuar kështu shprehje divergjente në aspektin e gjuhës angleze, por konvergjente me gjuhën shqipe, duke rezultuar në topikë-prominencë (tipike në shqip) në krahasim me rëndësinë e subjektit (tipike në anglisht), d.m.th. një risi në anglisht. Pjesa më e madhe e kësaj dëshmie natyrale konfirmohet në gjetjet lidhur me një sistem të vonuar pragmatik, ose një ballafaqim pragmatik dhe/ose sintaksë-pragmatikë jo e zhvilluar plotësisht në përvetësimin e gjuhës shqipe (Gj1) nga fëmijët. (Kapia 2011:188).

3. Konkluzioni

Qëllimi i këtij punimi ishte shqyrtimi i teorive të ndryshme si modeli i konkurrencës (në aspektin leksikor, sintaktikor, si edhe transferimi pragmatik) gjithashtu, Hipoteza e Ballafaqimit (sintaksë – pragmatikë), të cilat mund të sqarojnë sadopak divergjencat, konvergjenat dhe inovacionet e ndryshme gjuhësore, të bilingualëve të njëkohshëm shqip-anglisht-folës, p.sh. *du me go* dhe *jam po thinking* (përzjerja e kodeve) dhe *Are playing you?* (transferimi sintaktikor), duke vërejtur me kujdes gjatë veprimtarisë së lirë dhe spontane si dhe bisedat natyrale me folës të dy gjuhëve si gjuhë amtare (shqip dhe anglisht) gjatë një periudhe tre mujore.

Gjatë shkrimit të këtij punimi, çdo ditë e më pak u vërejt dukuria e transferimit nga shqipja në anglisht, e cila nuk është befasuese duke pasur parasysh rritjen e sasisë dhe cilësisë dhënë në anglisht (nga folësit e anglishtes si gjuhë amtare) në formën e ndërveprimit të drejtpërdrejtë të ditëpërditshëm me 2Gj1 aktual. Ndërsa në fillim të verës (ashtu si edhe gjatë vitit të kaluar akademik), subjekti i tanishëm 2Gj1 në mënyrë konstante ka thënë në anglisht: *the two (of them)* (transferimi semantik nga shqipja të dy(ja) ‘the two; both’) përkundër *both (of them)* (të dyja). Pas një muaji duke u thelluar në anglisht më shumë (si gjuha e saj dominuese përgjatë verës), raste të tilla u reduktuan dhe ajo filloi të shprehë objektivin që pritet në gjuhën angleze, d.m.th. *both (of them)*. Me afrimin e vitit akademik, do të jetë interesante për tu vëzhguar nëse elemente nga anglishtja do të vërehen në gjuhën shqipe. Hulumtime të mëtejshme duke përfshirë edhe hetimet eksperimentale, të shoqëruara me vëzhgime natyrore, që investigojnë bilingualët e njëkohshëm shqip-dhe anglisht-folës janë të nevojshme në mënyrë që të çojnë më tej arritjet dhe përpjekjet e këtij punimi në këtë temë.

Referencat

1. Auer, Peter (1999), From codeswitching via language mixing to fused lects: Toward a dynamic typology of bilingual speech. *International Journal of Bilingualism* 3.309-332.
2. Barnes, Julia (2006), *Early trilingualism: A focus on questions*. Tonawanda: Multilingual Matters Ltd.
3. Bialystok, Ellen (1999), Cognitive complexity and attentional control in the bilingual mind. *Child Development* 70(3)636-644.
4. Bialystok, Ellen (2007), Acquisition of literacy in bilingual children: A framework for research. *Language learning*. 57: Suppl. 1.45-77.
5. Bley-Vroman, Robert (1990), The logical problem of foreign language learning. *Linguistic Analysis* 20.3-49.
6. Bley-Vroman, Robert, (2009), The evolving context of the fundamental difference hypothesis. *Studies in Second Language Acquisition* 31.175-198.
7. Bosch, Laura, and Núria Sebastián-Gallés (2003), Simultaneous bilingualism and the perception of a language-specific vowel contrast in the first year of life. *Language and Speech* 46(2-3)217-243.
8. Byron, Janet Leotha (1973), Selection and evaluation of alternatives in Albanian language standardization. Philadelphia, PA: University of Pennsylvania dissertation.

9. Byron, Janet Leotha (1976), *Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian*. The Hague: Mouton.
10. Byron, Janet Leotha (1978), Displacement of one standard dialect by another. *Current Anthropology* 19.613-614.
11. Byron, Janet Leotha (1979), Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia. *Word* 30(1:2).15-44.
12. Byron, Janet Leotha (1985), An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia. *International Journal of the Sociology of Language* 52.93-109.
13. Camaj, Martin (1984), *Albanian grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
14. Celce-Murcia, Marianne; Diane Larsen-Freeman; and Howard Alan Williams, (1999), *The grammar book: An ESL/EFL teacher's course*. 2nd ed. Heinle & Heinle.
15. Cenko, E. and Budwig, N. (2007), The acquisition of early verb constructions in Albanian: A first look at transitives and intransitives. In H. Caunt-Nulton, S. Kulatilake, & I. Woo (Eds.), *A supplement to the proceedings of the 31st Boston University Conference on Language*.
16. Cenko, Enila (2009), The early acquisition of verb constructions in Albanian: Evidence from children's verb use in naturalistic and experimental contexts. Dissertation Clark University: Worcester, Massachusetts.
17. Chambers, J. K. (1992), Dialect acquisition. *Language* 68(4).673-705.
18. Curtis, Matthew Cowan (2012), Slavic-Albanian language contact, convergence, and coexistence. Columbus, OH: The Ohio State University Dissertation.
19. Curtiss, Susa; Victoria Fromkin; Stephen Krashen; David Rigler; and Marilyn Rigler (1974), The linguistic development of Genie. *Language* 50(3).528-554.
20. DeKeyser, Robert (2000), The robustness of critical period effects in second language acquisition. *Studies in Second Language Acquisition* 22.499-533.
21. Döpke, Susanne (2000), Generation of and retraction from cross-linguistically motivated structures in bilingual first language acquisition.
22. Dushku, Silvana (1998a), ELT in Albania: Project evaluation and change. *System* 26.369-388.
23. Dushku, Silvana (1998b), English in Albania: Contact and convergence. *World Englishes* 17(3).369-379.

24. Dushku, Silvana (2000), An evaluation of English language teaching aid: Albania case study.
25. Genesse, Fred (2001), Bilingual first language acquisition: Exploring the limits of the language faculty. *Annual Review of Applied Linguistics* 21.153-168.
26. Gundel, Jeanette K. and Thorstein Fretheim (2006), Topic and Focus. In L. Horn, & G. Ward (Eds.), *The handbook of pragmatics* (pp. 175-198). Oxford: Blackwell.
27. Hernadez, Arturo; Ping Li; and Brian McWhinney (2005), The emergence of competing modules in bilingualism. *Trends in Cognitive Sciences* 9(5).220-225.
28. Jordan, Geoff (2004), *Theory construction in second language acquisition* (Language acquisition and language disorders). John Benjamins.
29. Kallulli, D. and Tasmowski, L. (2008), Clitic doubling, core syntax, and the interfaces. In Kallulli, D., Tasmowski, L. (Eds.) *Clitic Doubling in the Balkan Languages* (pp. 1-34). Amsterdam: John Benjamins.
30. Kallulli, Dalina (1999), The comparative syntax of Albanian. On the contribution of syntactic types to propositional interpretation. Durham, NC: University of Durham dissertation.
31. Kallulli, Dalina (2008), Clitic doubling, agreement and information structure. In Kallulli, D., Tasmowski, L. (Eds.) *Clitic Doubling in the Balkan Languages* (pp. 1-34). Amsterdam: John Benjamins.
32. Kallulli, Dalina (2010), Belief will create fact: On the relation between givenness and presupposition, and other remarks. *Theoretical Linguistics*. 36(2/3).199-208.
33. Kapia, Enkeleida (2010), The role of syntax and pragmatics in the structure and acquisition of clitic doubling in Albanian. Boston, MA: Boston University dissertation.
34. Kola, Irena (2011), Global pressures and the dynamics of local change: A case study of an English department at an Albanian university. Urbana-Champaign, ILL: University of Illinois-Urbana-Champaign dissertation.
35. Kolgjini, Julie (2011), Perspektivë sociolinguistike e devijimeve gjuhësore në gjuhën shqipe: Ndërrimi i kodeve dhe mbikorrigjimet. *Seminari XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare Universiteti i Prishtinës*.
36. Köppe, R., and J. M. Meisel (1995), Code-switching in bilingual first language acquisition, In *One speaker, two languages: Cross-*

- disciplinary perspectives on code-switching*, ed. L. Milroy and P. Muysken. 276-301. Cambridge: Cambridge University Press.
37. Krashen, Stephen D. and Herbert W. Selinger (1975), The essential contributions of formal instruction in adult second language learning. *TESOL Quarterly* 9(2).173-183.
 38. Lenneberg, Eric H. (1967), *Biological Foundations of Language*. New York: Wiley.
 39. Lieven, Elena (2010), Bilingual language acquisition: Commentary on Sebastian-Galles. *Human Development* 53.256-263.
 40. MacWhinney, Brian (2005), Extending the competition model. *International Journal of Bilingualism* 9(1).69-84.
 41. Meisel, Jürgen (2007), The weaker language in early child bilingualism: Acquiring a first language as a second language? *Applied Psycholinguistics* 28.495-514.
 42. Meisel, Jürgen (2009), Second language acquisition in early childhood. *Zeitschrift für Sprachwissenschaft* 28.5-34.
 43. Meisel, Jürgen (2011), Bilingual language acquisition and theories of diachronic change: Bilingualism as cause and effect of grammatical change. *Bilingualism: Language and Cognition* 14(2).121-145.
 44. Meng, Hairong and Tadao Miyamoto (2012), Input and output in code switching: A case study of Japanese-Chinese bilingual infant. *International Journal of Bilingual Education and Bilingualism* 15(4).393-415.
 45. Müller, Natasha (2008), Bilingual first language acquisition at the interface between syntax and pragmatics. *EUROSLA Yearbook* 8.52-78.
 46. Nicoladis, Elena and Fred Genesee (1996), A longitudinal study of pragmatic differentiation in young bilingual children. *Language Learning* 46(3).439-464.
 47. Paradis, Johanne (2009), Maturation: For better or for worse? *Zeitschrift für Sprachwissenschaft* 28.41-45.
 48. Paradis, Johanne (2010), Bilingual children's acquisition of English morphology: Effects of language exposure, structure complexity, and task type. *Language Learner* 60(3).651-680.
 49. Paradis, Johanne and Elena Nicoladis (2007), Influence of dominance and sociolinguistic context on bilingual preschoolers' language choice. *International Journal of Bilingual Education and Bilingualism* 10(3).277-297.
 50. Paradis, Michael (2004), *Studies in bilingualism*. Vol. 18. Amsterdam: John Benjamin Publishing Company.

51. Richards, J., and Schmidt, R. (2002). *Longman dictionary of language teaching & applied linguistics* (3rd ed.). NY: Pearson Education.
52. Rista-Dema, Mimoza (2006), Inverse-order constructions in Albanian English: Discourse and prototype effects. Bloomington, IN: Indiana University dissertation.
53. Rista-Dema, Mimoza (2008), Verb-subject word order in Albanian English. *World Englishes* 27(3/4).419-433.
54. Schader, Basil (2006), Who's "mixing" the languages? Statistical-sociolinguistic analyses of differently developed bilingual practice of Albanian-speaking school pupils in German-speaking Switzerland. *International Journal of the Sociology of Language* 178.75-91.
55. Singleton, David (2005), The critical period hypothesis: A coat of many colours. *International Review of Applied Linguistics in Language Teaching* 43(4).269-285.
56. Singleton, David (2007), The critical period hypothesis: Some problems. *Interlingüística* 17.48-56.
57. Song, Hyang Suk and Bonnie Schwartz (2009), Testing the Fundamental Difference Hypothesis. *Studies in Second Language Acquisition* 31.323-361.
58. Sorace, Antonella (2011), Pinning down the concept of "interface" in bilingualism. *Linguistic Approaches to Bilingualism* 1(1).1-33.
59. Topalli, Kolec (2007), *Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Dituria.
60. Urbana-Champaign, ILL: University of Illinois-Urbana-Champaign dissertation.
61. Wald, Benji (1974), Bilingualism. *Annual Review of Anthropology* 3.301-321.

According to Krashen, "[A] distinction is...made between 'learning' and 'acquisition', where the term 'learning' refers to the conscious learning of explicit rules, and 'acquisition' is used for the unconscious internalization of knowledge" (in Bley-Vroman 1990:5).

Following De Houwer (1990), the current author uses simultaneous bilingualism and bilingual first language acquisition interchangeably to refer to the simultaneous acquisition of two languages from birth. As pointed out by Barnes (2006:9-10): "McLaughlin (1978, 1984) makes a distinction between simultaneous and successive acquisition of two languages. Simultaneous acquisition occurs when a child

has been exposed to two languages before the age of three, and successive acquisition occurs when exposure to the second language has taken place after the age of three. This is also the view of Taeschner (1983). Padilla and Lindholm (1984), however, consider that simultaneous acquisition refers to exposure to two languages from birth. For a number of reasons, De Houwer (1990) rejects the term simultaneous acquisition and proposes Meisel's (1989) term 'bilingual first language acquisition'. According to De Houwer (1995:222) bilingual language acquisition or infant bilingualism refers to the 'result of the very early, simultaneous, regular and continued exposure to more than one language'. De Houwer distinguishes between bilingual first language acquisition (Meisel, 1989) - also termed 'simultaneous development of bilingualism' or 2L1 (Meisel, 2001) - in which a child is exposed to two languages from birth and 'bilingual second language acquisition' De Houwer, 1989) in which exposure to a second language takes place between the age of one month and the age of two. De Houwer (1990:4) considers that it is vital to know the exact time of first exposure to more than one language since 'although it is quite possible that differences in ... exposure patterns are irrelevant to the acquisition process...(they) might well be important'. Starting from birth also allows for full comparison with the monolingual acquisition process. De Houwer (1990) maintains that exposure to a second language at the age of one month is too late for acquisition to qualify as bilingual first language acquisition."

"The notion of CP has its origins in the biological sciences. One example of a CP that is often cited is behavior exhibited by ducklings whereby they follow the first moving object they perceive after hatching: 'The following behavior only occurs within a certain period after hatching, after which point the ducklings develop a fear of strange objects and retreat instead of following. Within these time limits is *the critical period* for the following behavior'" (De Villiers & De Villiers 1978: 210 qtd. in Singleton 2007:48).

In terms of those who argue for a critical age, namely those who adhere primarily to some version of the Critical Period Hypothesis (CPH), or "the period during which a child can acquire language easily, rapidly, perfectly, and without instruction" (Richards & Schmidt 2002:145), they tend to maintain that this sensitive period is sometime around the age of puberty. According to the proponents of CPH, the age of onset of acquisition (AOA) for intentional exposure to a second language is crucial, especially in regards to native-like fluency in the L2 (Meisel 2009). Meisel (2009:7) purports that the age of 4 is vital for the acquisition of various morpho-syntactic components: "[T]he optimal phases during which grammatical properties are easily and successfully developed by mere exposure to the primary linguistic data begin to fade out as early as around age 4;0 ... [I]nflexional morphology represents one of the areas in which cL2 learners resemble aL2 learners and differ from (2)L1 children." In other words, as Paradis (2009:41) states in terms of Meisel's proposal, "[I]f exposure to a language does not begin before 4:0, the developmental sequences will be different from (2)L1, and more like adult L2. Thus even early child L2 (cL2) can be characterized as fundamentally different from (2)L1 because the configuration of internal learning

mechanisms used to develop certain linguistic domains differs between these populations ... [W]hat was once possible is no longer possible, such as mastery of a gender system or alleged error-free acquisition of gender...I would argue in agreement with Meisel that neuro-cognitive maturation could result in fundamental differences between cL2 and (2)L1 learners ... Maturational proposals are, of course, not restricted to L2 acquisition, but have also been put forward for L1 acquisition ... Given that in the first five years of life, infants/children are undergoing extensive neuro-cognitive development, it seems only logical to consider that innate linguistic knowledge...might be undergoing changes as well ...”

Meisel (2009) adopts a revised/modified version of the Critical Period Hypothesis (CPH) originally consisting of a critical age period of around 10-12 years (see Lenneberg 1967) to the age of 4, noting that other scholars have mentioned other ages during which sensitive periods cluster, e.g. Long (1990) ages 6-7 and Johnston & Newport (1989) before age 7, perhaps even 4-6. In terms of those who argue that older is better for L2 acquisition, it has been proposed based on the findings of empirical studies where second language learners of a post-puberty age performed better than younger L2 learners (see Singleton 2005).

Another related controversy for some scholars is whether or not the Language Acquisition Device (LAD) is fully accessible to second language learners (Meisel 2009: 7-8), which is related to Brey-Vroman’s (2009:4) **Fundamental Difference Hypothesis** (FDH), which states “that child language development and adult language learning are in fact fundamentally different” (see also Chomsky 1997). In other words, as Song and Schwartz (2009:323) state, “The fundamental difference hypothesis (FDH; Bley-Vroman, 1989, 1990) contends that the nature of language in natives is fundamentally different from the nature of language in adult nonnatives.” As pointed out by Meisel (2009:7-8), Bley-Vroman’s (1990, to appear) FDH “suggests that the LAD does not remain fully accessible indefinitely. Rather,...it can be argued that UG, as the centerpiece of the LMC [Language Making Capacity], becomes partially inaccessible as a result of neurological maturation. Given the...defining properties of L1 development, e.g. success, uniformity and rate of development,...partial unavailability of these properties indeed seems to be a plausible account for the L1-L2 differences. Moreover, by referring to maturational changes as causal factors for changes in the LMC, a relationship is established between linguistic and neurocognitive developments which can, in principle, be tested empirically.”

“The development of two languages in a bilingual child may be largely autonomous, but this does not exclude the possibility that there can be influence from one language on the other. In such cases we will speak of **cross-linguistic influence**. (Hulk & Muller, 2000:227)” (qtd. in Barnes 2006:23).

“The wise reader will take these arguments for an empiricist position with a healthy grain of salt. We all know that the most reasonable and tenable positions on major issues, such as nativism versus empiricism, inevitably rest somewhere in the middle between the two extremes. However, it is often helpful to view the competing

positions in their most undiluted form, so that we can navigate between these alternatives, coming always closer to the truth' (MacWhinney, 1997: 137). Amen to that" (Jordan 2004: 240-241).

According to Meng and Miyamoto (2012:394): "Codeswitching (hereafter CS) is a widespread phenomenon in both the speech of bilingual communities and conversations between bilingual individuals. It is generally defined as the alternate use of two languages within a single utterance ('intra-sentential' CS) or within the same discourse ('inter-sentential CS') (Grosjean 1982; Hoffman 1991)...A majority of the case studies on bilingual children's language development report the occurrence of language mixing (Genesee 1989; Genesee, Nicoladis, and Paradis 1995)."

"We here use the term code-mixing, or simply mixing, to refer to the use of elements from both languages in the same utterance or stretch of conversation...Researchers customarily refer to the same phenomena in adult bilingual usage as 'code-switching.' We use the more neutral terms 'code-mixing,' because there is not sufficient evidence to establish whether these phenomena have the same formal and functional properties in child and adult language (Meisel, 1994, discussed these issues)" (Nicoladis & Genesee 1996: 442).

Rista-Dema (2006:80) writes: "A number of studies on crosslinguistic influence and discourse organization question direct syntactic transfer from L1. Instead, they show that transfer takes place at the discourse level, i.e. L2 syntax is affected by the discourse functions of L1...The studies on the devices languages use to code discourse functions show that in addition to word order manipulations, many languages, including the ones that have been in contact with Albanian for a long time, use passive and inverse constructions. These devices have been employed to render various degrees of topicality, i.e. given and new information."

As Rista-Dema notes (2006:95-96): "It may be possible that the subject in Albanian is base-generated under the VP. Based on this assumption, the **VP-internal subject hypothesis** (King 1993b) is adopted to account for certain patterns of constituent ordering in Albanian. As King points out, '[U]nder the VP-internal subject hypothesis, all arguments of the verb, including the subject, are projected into the VP at D-structure' (p. 2). With regard to Russian, King postulates that 'an *in situ* subject will follow, not precede, a finite verb ... The subject will appear in this position unless it moves to a topic or focus position; this means that **the discourse-neutral position** for the subject is after, not before the verb' (p. 3). Kallulli (1995:110) mentions: "In Albanian, if the object is fronted to clause initial position without triggering **subject-verb inversion**, the structure is ungrammatical." As Rista-Dema (2006:95) points out: "[B]ecause of the prevalence of verb-initial constructions in Albanian...and the ungrammaticality of VSO structures when one of the objects is fronted, it can be postulated that Albanian is a **VOS language**."

Albanian follows a topic-focus information structure, where the topic (old, given information) is near the clause-initial position (pre-verbal), and the focus (new information) tends to be near the clause-final position (**post-verbal, post-posed**). Thus,

if the speaker of Albanian perceives the subject to be new information, it will likely be in the post-verbal position, whereas old, given information will tend to appear in the pre-verbal position. Hence, we can say that Albanian is topic-prominent.

In English the topic (theme, old, given information) tends to be placed near the clause-initial position, and is usually the grammatical subject. According to Berk (1999:23-24): “Given information, as the term suggest, refers to information that the speaker assumes the hearer already knows...[In] English...the topic is often (but not always) expressed by the subject of the sentence. The predicate...is the comment on the topic.” Note that the comment, i.e. focus, is new information (see also Rista-Dema 2006:100-105). Prince (1992:298) writes the “subjects tend to be definite and tend to represent old information,” i.e. the preverbal position. English is usually thought to be a subject-prominent language.

Two alternative explanations could be offered for these innovative constructions. First, it could be argued that these utterances resulted from clumping together the auxiliary and main verb as one inseparable unit and then applying the subject-verb inversion. A second alternative explanation for such “unusual structures” (e.g. deviant word order) in the output of simultaneous bilinguals could be that they are merely a kind of codeswitching, as suggested by Meisel (2007: 507): “[O]ne language is activated whereas the other is inhibited. However, inhibition is never complete’ (Hulk, 2000, p. 75)...‘[U]nusual structures’ [i.e. deviant target word order] can most likely be accounted for as bilingual language use, that is a kind of ‘covert code-switching’ by which structural properties of the other language are activated, but no lexical material from that language is inserted.”

Pronouns are by definition given information in that they stand in for full nouns. “Only given items can be pronominalized” (Chafe in Rista-Dema 2006:76); according to Berk (1999:42) “personal pronouns always encode given information” (qtd. in Rista-Dema 2006:103).

“Both the child [(e.g. age 9)] and the young adult [(e.g. age 24)] start learning L2 words as parasitic associates of L1 forms” (Hernandez, Arturo, Ping Li, and Brian McWhinney 2005:222).

The matrix language is Albanian and the embedded language is English.

Note that codemixing between Geg and Tosk (ULA) also occurred in the current 2L1 speech once she started to attend daycare, e.g. *dimën~dimër*; in some cases innovative and hybrid forms resulted, e.g. *Shkolla, puna pret / Ne tash më/ma jemi/jena boar* (cf. *ba (>bo)/bërë, shku-ar*) *6-vjekar / sa shpejt do të shkojmë në klasën e parë*. See Meisel 2011 for dialect contact and simultaneous bilingualism.

As stated by Sorace (2011:1-2): “The interface Hypothesis (IH) was put forth by Sorace and colleagues as an attempt to account for patterns of non-convergence and residual optionality found at very advanced stages of adult second (L2) acquisition. The IH originally proposed that language structures involving an interface between syntax and other cognitive domains are less likely to be acquired completely than structures that do not involve interface. At the same time, the IH was extended to bilingual first

language (L1) acquisition and to the very early stages of L1 attrition, which exhibit optionality in precisely the same structures: this provides a unifying framework for the study of bilingual language development. The IH has spurred much research since its original formulation, particularly on the **syntax-pragmatics interface**; it has also raised fundamental issues concerned with the architecture of the language faculty and the interaction of linguistic, processing, and general cognitive abilities in bilinguals.”

Haki HYSENAJ

**STUDIMET EKSPERIMENTALE NË FUSHË TË FONETIKËS DHE
NORMA E FOLUR E SHQIPES STANDARDE**

Abstrakt

Në kumtesën “Studimet eksperimentale në fushë të fonetikës dhe norma e folur e shqipes standarde” trajtohen dy çështje. E para pasqyron studimet e deritashme në fushë të fonetikës eksperimentale, ndërsa e dyta çështjen e normës së shqipes së folur.

Këto dy fusha janë zgjedhur për hulumtim për faktin se gjatë shekullit të shkuar në shqipe janë bërë studime të rëndësishme eksperimentale në fonetikë, ndërkohë që shqipja e folur, edhe përkundër këtyre të studimeve, për mungesë rregullash drejtshqiptimore edhe të një modeli ortoepik, në këtë rrafsh 40 vjet pas standardizimit realizohet në formë varantesh.

Kumtesa “Studimet eksperimentale në fushë të fonetikës dhe norma e folur e shqipes standarde” mëton kështu të pasqyrojë gjendjen reale të ortoepisë së shqipes së sotme standarde.

1. Hyrje

Studimet në fushë të fonetikës eksperimentale në shqipe filluan në vitet e 60-ta. I pari që u mor me këtë fushë ishte Anastas Dodi. Në vitet 1960-1961 Dodi kishte specializuar në Universitetin e Leningradit (sot Sankt Petërsburg) dhe jo shumë kohë pas kishte botuar punimet e para, që përshkruanin sistemin vokalik të shqipes¹. Pas tij me studime të kësaj fushe u morën edhe studiues të tjerë nga Shqipëria dhe Kosova. Një përmbledhje të këtyre studimeve e ka publikuar Sedat Kuçit². Së voni edhe Bahri Beci³ ka botuar një punim të veçantë për fillet e fonetikës eksperimentale në gjuhën shqipe.

¹ Anastas Dodi, Rreth sistemit vokalik të shqipes, SF, nr. 3, Tiranë, 1976.

² Sedat Kuçi, Fonetika e shqipes në dritën e studimeve eksperimentale, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2001, nr. 19, f. 449-454.

³ Bahri Beci, Studimet fonetike në fushë të shqipes në kuadrin e gjuhësisë moderne, në Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2012, f. 47-54.

Në këto dy punime jepen të dhëna bibliografike dhe interpretime për segmentet e hulumtuara, metodologjinë dhe korpuset e përzgjedhura nga studiues që janë marrë me fonetikën eksperimentale. Kuçi dhe Beci, duke komentuar të arriturat identifikojnë edhe probleme të tjera që pritet të hulumtohen nga studiues të rinj në të ardhmen.

Aljula Jubani-Bengu, e cila po ashtu ka të botuar një punim të ngjashëm⁴, në shumë punime të tjera ka përshkruar tiparet nyjëtimore dhe akustike të fonemave të shqipes.

Ndërsa Giovanni Belluscio ka nisur një perspektivë të re në studimet eksperimentale të fonetikës së shqipes standarde. Hulumtimet e tija janë të karakterit deskriptiv dhe krahasues. Për dallim nga punimet e botuara deri vonë nga autorë të tjerë ai trajton edhe çështje të ortoepisë së shqipes standarde. Studimi i tij “*Si shqiptohet shqipja në Ballkan*”⁵ shënon fillimin e studimeve të mirëfillta në fushën e ortoepisë së shqipes standarde.

Ndërkaq, studimet fonologjike për shqipen kanë një traditë më të hershme. Në zanafillën e tyre ato kryesisht janë bërë nga studiues joshqiptarë, të cilët në gramatikat e tyre të shqipes për të huaj kanë bërë përshkrimin e sistemit fonologjik të shqipes. Këto studime⁶, kanë qenë të bazuara në teoritë e shkollave kryesore të kohës. Përfundimet e këtyre autorëve edhe sot mund të përdoren si pika referuese në studimet e këtilla, ndonëse disa nga konstatimet e dhëna, si ato për inventarin e fonemave, tiparet nyjëtimore dhe akustike të tyre ndonjëherë dalin të diskutueshme. Këtu fjala është për numrin e fonemave në shqipe⁷ dhe kriteret e përzgjedhura për klasifikim.

2. Llojet e studimeve eksperimentale, këndvështrimi

Studimet eksperimentale në fushë të fonetikës së shqipes ndahen në dy grupe. Në të parin radhiten hulumtimet që objekt trajtimi kanë përshkrimin nyjëtimor dhe akustik të fonemave të shqipes, d.m.th. tiparet e tyre fizike, ndërsa në grupin e dytë studimet krahasuese midis sistemit tingullor të shqipes dhe gjuhëve të tjera. Si grup

⁴ Aljula Jubani-Bengu, shih disertacionin: “Analizë akustike e sistemit fonologjik të shqipes standarde, me mjete të fonetikës eksperimentale”; “Rreth ecurisë së ë-së së patheksuar në shqipe” (2001); bashkautorë “Tiparet akustike të theksit në të folmen e Shën Benëditit, në Kalabri, krahasuar me shqipen standarde, Studime Filologjike, nr. 1-2, Tiranë, 2005; “Analizë akustike e bashkëtingëlloreve shtegore, Studime Filologjike, nr. 1-2, Tiranë, 2006.....

⁵ Giovanni Belluscio, Si shqiptohet shqipja në Ballkan, në “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”, ASHAK, Prishtinë, 2012, f. 443-472.

⁶ Cituar sipas Aljula Jubani-Bengu, w.w.w.fhf.edu.al, hapur për herë të fundit më 20 qershor 2012.

⁷ Po aty

në vete, siç u tha më parë, tashmë identifikohen hulumtimet eksperimentale të Belluscio-s, të cilat në fokus kanë çështje ortoepike të shqipes standarde.

Derisa në Shqipëri Dodi, Beci, Boriçi dhe tash Jubani-Bengu kanë përshkruar segmente të rëndësishme të sistemit fonologjik të shqipes standarde, në Kosovë, pos hulumtimeve të ngjashme⁸, janë realizuar edhe hulumtime krahasuese midis sistemit tingullor të shqipes dhe sistemeve tingullore të frëngjishtes e rusishtes. Halit Halimi⁹ ka bërë përshkrimin spektrografik të zanoreve të shqipes, duke i krahasuar ato me zanoret e gjuhës frënge, ndërsa Sedat Kuçi¹⁰ ka vënë në pah përkime dhe diferenca akustike midis sistemeve fonetike të gjuhës shqipe dhe ruse, gjithnjë në funksion të mësimin të rusishtes nga folësit e shqipes. Në Shqipëri studime krahasuese të kësaj natyre kanë bërë autorët e përmendur më sipër.

Anastas Dodi, duke u mbështetur edhe në metodën perceptivë, ka publikuar një sërë punimesh që lidhen me drejtshqiptimin e shqipes letrare/standarde¹¹.

Punimet e cekura nuk janë shfrytëzuar ndonjëherë si material bazë për hartimin e rregullave ortoepike të shqipes, të cilat do të ishin në funksion të përafrimit të dy ose edhe më shumë modeleve shqiptimore, që sot funksionojnë si “norma” të dallueshme mes vete për ligjërimin formal të shqipes standarde. Si rrjedhojë shqipja standarde as sot e kësaj dite nuk ka një normë ortoepike të koduar me rregulla të caktuara.

3. Standardi pa rregulla ortoepike, gjendja sot

Mungesa e rregullave ortoepike për shqipen standarde bëri që të mos kemi një model ortoepik për të gjithë shqipfolësit, pra një normë standarde për ligjërimin e folur, të paktën për situatat formale të komunikimit. Për këtë arsye shqipja standarde në ligjërimin e folur u realizua dhe realizohet në formë variantesh shqiptimore. Këto variante sot perceptohen shumë lehtë, pa pasur nevojë për matje laboratorike, çka do të thotë se krahas evoluimeve konvergjente në fushë të fonetikës së shqipes hetohen

⁸ Haki Hysenaj, Tiparet akustike dhe distribucionale të tingujve të gjuhës së sotme shqipe (punim magjistrature, 1992) i botuar pjesërisht në disa numra të revistës “Filologji”, të Fakultetit të Filologjisë.

⁹ Halit Halimi, Description phonétique et phonologique de l'albanais (Dialekte Gyegue), Prishtinë, 1994.

¹⁰ Sedat Kuçi, Perceptija fonetskih elemenata ruskog jezika kod osoba kojima je maternji jetik albanski, Prishtinë, 1995.

¹¹ Shih: Anastas Dodi, Drejtshkrimi dhe shqiptimi letrar, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, 1, Tiranë, 1973; Rreth problemeve të normës në lëmin e fonetikës së shqipes së sotme letrare, Studime filologjike, Tiranë, 1972, nr. 2; Rreth problemeve të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe, Studime filologjike, Tiranë, 1974, nr. 4; Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar, Gjuha jonë, Tiranë, 1981; Gjuha e folur letrare dhe norma e saj fonetike në etapën e sotme, Gjuha jonë, Tiranë, 1986, nr. 2; Gjuha letrare shqipe e folur, Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë, Tiranë, 1988.

edhe zhvillime divergjente. Krahas ruajtjes së shumë varianteve shqiptimore me burim dialektor në modelet ekzistuese, pas liberalizimit të shoqërisë e bashkë me të edhe të gjuhës, në ligjërimet formale gjithnjë e më shumë takohen edhe trajta të tjera dialektore që po rifunksionalizohen.

Në këtë situatë gjendja përshkruhet më e ngatërruar tek folësit e shqipes standarde, të cilët gjuhë të nënës kanë dialektin e gegë. Në të folurën formale në Kosovë dhe në vise të tjera ku flitet gegërishtja, nuk është realizuar plotësisht faza e përvetësimit të një modeli drejtshqiptimor që parapëlqehet të ishte i mbështetur në parimin fonetik. Ky realitet ka bërë që folësit e gegërishtes, në situata formale, të provojnë të riprodhojnë modelin vokalik që përdoret në të folurën formale të medimeve publike të Shqipërisë. Këtu nis një prej problemeve ortoepike për folësit e standardit në Kosovë. Folësit “eminentë” të standardit në Shqipëri në mungesë të një modeli të koduar vazhdojnë të përdorin të ashtuquajturin “*model vokalik*” të toskërishtes, duke e bërë situatën e ngatërruar dhe me prirje të shtrirjes së tij edhe tek folësit e tjerë që gjuhë të vetën kanë idioma të tjera dialektore.

Paçarizi¹² thekson se në Shqipëri mbizotëroi modeli vokalik i toskërishtes, i cili, sipas tij, “*nisi të imponohej si të ishte vetë standardi, duke u sjellë me mospërfillje ndaj vetë standardit*”.

Në këtë situatë sot mund të flitet edhe për konceptin e quajtur “*dialektizim të standardit*”¹³. Kjo vlen posaçërisht për shqipen e folur në Kosovë. Një cilësim i këtillë nuk përjashtohet as për të folurën formale në medimet e Shqipërisë, e cila përdor “*modelin vokalik*” të toskërishtes.

Dialektizimi i standardit në ligjërimin formal në Shqipëri sot ngërthen në vete shumë dukuri të toskërishtes. Të kujtojmë shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës, e cili tashmë sikur është ngritur në normë edhe në të folurën formale, ose tempin e të folurit, i cili në Shqipëri, sipas matjeve të bëra nga Belluscioi¹⁴, është më i shpejtë se në trevat e tjera ku flitet shqipja. Dukuri të këtilla dialektore në planin fonetik janë të pranishme edhe në gjuhën e folur në Kosovë. Prandaj, sot mund të shtrohet pyetja nëse shqipja e folur është duke shkuar drejt një konvergjence apo divergjence gjuhësore në rrafshin fonetik?

Munishi¹⁵, duke trajtuar këtë çështje në rrafshin sociolinguistik, teorikisht shpjegon se konvergjencia mund të ndodhë në rrafshin fonologjik/fonetik përmes

¹² Rrahman Paçarizi, *Ruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit, në Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, QSA, Tiranë, 2011, f. 97.

¹³ Shkumbin Munishi, *Gjuha standarde shqipe dhe konvergjencia e gjuhës së folur, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 2009, nr. 28/1, f. 225-265.

¹⁴ Shih: Giovanni Belluscio, *Si shqiptohet shqipja në Ballkan*, në “*Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*”, ASHAK, Prishtinë, 2012, f. 433-472.

¹⁵ Po aty.

përafrimit dhe të (shqiptimit) rrafshimit të tingujve, ndërsa zhvillimet divergjente rezultojnë me diferencimin shqiptimor të tingujve dhe me krijimin e ndryshoreve fonetike. Nga anë tjetër Belluscioi konstaton: “*Me sa duket, ashtu siç ndodh me teorinë e valëve nëse konsiderohet Shqipëria si qendër gjuhësore verifikohet se pikërisht aty veprojnë ndryshime divergjente nga rrathët periferikë ku, me sa duket ruhen trajta dhe dukuri që në qendër kanë evoluar, një risi, ose janë zhdukur, si p.sh mosnyjëtimi i h-së, neutralizimi i kundërvënies r~rr dhe shqiptimi i r-së si tingull përafrues [ɹ], reduktimi i togzanorit ua>uë>u, shqiptimi i grupit në si ën, prirja për të shqiptuar /c/ dhe /ç/ si [ts] [dz] deri në [ʃ] [ʒ], ndryshimi i ritmit në drejtimin e shpejtësisë së nyjëtimin dhe të të folurit. Kështu ndodh që shqipja e folur në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi vazhdon të ruajë disa trajta fonetike, të cilat në shqipen e Shqipërisë janë duke u zhdukur*”¹⁶.

Në sistemin e bashkëtingëlloreve, siç shihet edhe nga krahasimet e rezultateve të matjeve të bëra nga studiues të Shqipërisë dhe të Kosovës, për mungesë rregullash drejtshqiptimore, në shumë raste hetohen prirje divergjente.

Në shqipen e folur në Kosovë, në të dy regjistrat, në atë formal dhe joformal, është i pranishëm procesi i rrafshimit midis qiellzoreve q-gj dhe afrikateve c dhe xh, pastaj rrafshimi gati i plotë opozicional midis vibranteve r/R, si dhe reduktimi i grupeve konsonantike mb, nd dhe ng.

Vibrantet r/R, meqë në shqipe nuk bartin ngarkesë të madhe funksionale, pos procesit të rrafshimit në Kosovë duket prirjen të realizohen si një tingull i vetëm, me tipare fizike të ndërmjetme, të cilin grafikiqsh po e paraqesim si *ɹ*. Nyjëtimi i këtij varianti qëndron midis modeleve nyjëtimore të r-së dhe rr-së të shqipes standarde¹⁷. Te këto dy fonema nuk ka rëndësi nëse vibrantja r, siç është emërtuar nga studiuesit Dodi, Beci...realizohet me 1-2 dridhje apo, siç thekson Jubani-Bengu, “*e ashtuquajtura njëdridhëse nuk paraqitet me dridhje, por me strukturën e një aproksimanteje*”¹⁸, sa ka rëndësi funksioni dallues i saj, si në rastet: “*Sa janë këto ar(R)a?*” ose “*R(R)ruaje kokën*”. Kjo prirje, mbështetur në matjet tona, ka prekur sistemin fonematik të shqipes, pra inventarin e fonemave të saj, ndërsa rrafshimi duket se është duke ndryshuar edhe radhët e ndërlihdnive korrelative të fonemave bashkëtingëllore, duke lënë sistemin e zbrazët për një kundërvënie¹⁹. Në këtë situatë,

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Haki Hysenaj, Kundërvënia fonologjike r/R, rrafshim dhe reflekse në gjuhën e folur e të shkruar, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, nr. 28/1. f. 403-408.

¹⁸ Aljula Jubani-Bengu, Bashkëtingëlloret dridhëse, cilësitë dhe variantet e tyre, në Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2012, f. 458.

¹⁹ Haki Hysenaj, Kundërvënia fonologjike r/R, rrafshim dhe reflekse në gjuhën e folur e të shkruar, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, nr. 28/1. f. 403.

e cila tashmë ka lëkundur sistemin fonologjik të shqipes standarde, ekzistimi i rregullave ose përcaktimi për një model të caktuar drejtshqiptimore do të ndikonte në ruajtjen e inventarit të fonemave.

Pacarri²⁰, duke folur për faktorët psiko-linguistikë, të cilët sipas të tij, kanë vështirësuar kodifikimin fonetik të shqipes standarde, thekson se *aspektet psikolinguistike të pranimit të standardit duhen trajtuar ndaras për të folurit formal dhe për të folurit joformal*. Më parë Ismajli, duke trajtuar çështjen e normës ortoepike në rrafshin e planifikimit gjuhësor, ka theksuar se *thelbësore është që tjetri të na kuptojë, pra që bashkësia të funksionojë përmes këtij komunikimi*²¹. Më tutje ka shtuar se *ekzistenca e një kodi, e një norme që mëtojmë të jetë mbi rrjetin e dallimeve të tjera, paçka se në rrethana të caktuara mund të duket ngapak edhe artificiale, ngapak snobe apo diçka tjetër, mund të motivohet edhe me mundësinë që ajo të shërbejë si reper për ndërlidhjet e përmendura, si ind ndërlidhës, apo integruet, pa e mohuar ekzistencën dhe funksionimin e përdorimeve të tjera, madje duke e bërë edhe më të qartë dhe të nevojshme hapësirën e përdorimit të tyre përkatëse*²². Ismajli pohon se *në jetën e publike na duhet standardi, ndërsa në jetën e përditshme edhe varieteti organik i folur, që mund të jetë dialekti apo variacioni regjional*²³. Megjithatë, duke shtruar çështjen në rrafshin socio-linguistik, ai shton se *përtej ndonjë norme eksplicite gojore, me rëndësi janë përdorimet e manifestuara që duhen respektuar në funksion të integritit në bashkësi dhe të të kuptuarit*²⁴.

4. Inventari i fonemave

Në realitetin e sotëm gjuhësor, kur shqipja e folur realizohet në disa variante shqiptimore, në dy gjithsesi, lëkundja e inventarit të fonemave është e pranishme. Kështu, në modelet ekzistuese shqiptimore, njëri në mediumet elektronike të Shqipërisë e tjetri në mediumet e Kosovës, gabimet në realizimin e fonemave dhe varianteve të tyre janë të pranishme, njëjtë siç janë dinamike edhe reduktimet sasiore të zanoreve nga të folurit e shpejtë dhe faktorë të tjerë gjuhësorë, po edhe të vetë fonemave të ndryshme që hyjnë në raporte kundërvënëse midis tyre. Ky realitet favorizon edhe më shumë divergjencat midis modeleve ekzistuese të shqipes së folur. Prandaj, hulumtimet empirike dhe matjet eksperimentale bëhen aq shumë të nevojshme për përcaktimin e nyjëtimit standard të fonemave, varianteve të tyre dhe

²⁰ Rrahman Paçarizi: Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit, në Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit, QSA, Tiranë, 2011, f. 95-215.

²¹ Rexhep Ismajli, Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003, f. 156.

²² Rexhep Ismajli, Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003, f. 156.

²³ Po aty, f. 171.

²⁴ Po aty, f. 55.

të prozodisë përgjithësisht, elementet e të cilës shoqërohen me melodinë, shpejtësinë dhe zëshmërinë²⁵.

Lëkundjet e këtij inventari dëshmojnë në shumë raste. Rrafshimi i opozicionit *r/*, *R*, i cili sipas një hulumtimi të bërë dy vite më parë në disa zona urbane dhe rurale të Kosovës, gati se ka përfunduar, ka shkaktuar tkurrjen e këtij inventari. Ky proces, që duket se është shtrirë edhe në të folurën formale në Shqipëri, është duke varfëruar sistemin fonematik të shqipes. Kështu, sot çiftet minimale *ara/aRa*, në të dy modelet shqiptimore, mund të perceptohen semantikisht vetëm të kontekstualizuara.

Sipas Ismajlit standardi i folur lë hapësirë për lëvizje të ndryshme²⁶. Këto lëvizje do të ishin të pranueshme gjithnjë përderisa nuk mbizotërojnë prirjet divergjente në normën e një gjuhë të caktuar, në rastin tonë në standardin e folur të shqipes.

Bindja se norma e shkruar është bazë për normën e folur të shqipes standarde sot duhet rivlerësuar rrënjësisht. Ka shumë arsye gjuhësore dhe jashtëgjuhësore për t'u bërë kjo punë. Disa prej tyre tashmë janë shpjeguar më lartë në këtë punim.

John Lyons²⁷ konstaton se baza e epërsisë së gjuhës së folur ndaj gjuhës së shkruar qëndron, para së gjithash, në faktin se ligjërimi është më i vjetër dhe më i përhapur se shkrimi. Prandaj, në shqipe si edhe në shumë gjuhë të tjera, mbështetja në parimin fonetik të drejtshkrimit për arritjen e një norme ortoepike duket se nuk është treguar i suksesshëm.

Për këtë vlen përmendur edhe çështjen e gjatësisë së zanoreve. Gjatësia e zanoreve del dy llojesh: fizike dhe fonologjike. E para varet nga tiparet nyjetimore të tingujve zanorë, pozicioni fonetik dhe theksi. Koha e shqiptimit për zanoret është pjesë e përshkrimit të dimensionit kohor të të folurit²⁸. Në rrjedhë të të folurit tipi i parë nuk identifikohet nga palët në komunikim, pasi që nuk krijon efekte akustike. Ndërkaq, i dyti është e pakushtëzuar dhe ka vlerë fonologjike.

Sipas Becit²⁹, përgjithësisht pranohet që gjatësia nuk ka vlerë funksionale në gjuhën e sotme letrare kombëtare. Duke analizuar parametrat fizikë të zanores *a* dhe *i* Beci konstaton se “*Dallimet që vihen re në gjatësinë e zanoreve të theksuara të fjalëve të tipit plak-plakë janë të paqëndrueshme dhe aq të vogla sa që nuk mund të lozin rol në kundërvënien e tyre*”³⁰. Sipas të dhënave të tij gjatësia e *a*-së së theksuar në *plak-u* është 7.8 qs, ndërsa në *plakë-a* 8 të qindtat e sekondës. Ndërsa, një hulumtim yni, po për të njëjtin problem, jep këto përqindje: gjatësia e *a*-së në fjalën

²⁵ Ivo Škari, Govorne predožbe i govorne osjetne slike, në Govor, Zagreb, nr. 1, 1988, f. 8.

²⁶ Rexhep Ismajli, Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003, f. 66.

²⁷ John Lyons, Hyrje në Gjuhësinë Teorike, Dituria, 2001, f. 51.

²⁸ Juraj Bakran, Jezik, Zagreb, 1986, nr. 5, f. 144.

²⁹ Bahri Beci, Studime Filologjike, Tiranë, nr. 1, f. 104.

³⁰ Po aty, f. 106.

plak-u është 7 të qindtat e sekondës, ndërsa në fjalën *plakë-a* është 19 të qindtat e sekondës. Matjet tona tregojnë se modeli ortoepik për shqipen standarde në Kosovë njih dy shkallë gjatësish të diferencuara mirë, të cilat rrinë në raporte kundërvënëse. Bazuar në matjet perceptive të modelit shqiptimor të medimeve kryesore të Shqipërisë del se edhe në këtë model tashmë gjatësia, si kompensim i tempit të shpejtuar të të folurit, i cili prodhon reduktim cilësish të zanoreve, është tipar funksional dhe lehtë i akceptueshëm në fjalët që dallojnë vetëm mbi bazë të kësaj kundërvënieje. Ky tipar, që tashmë po shtrihet edhe në ligjërimin formal të folësve të medimeve të Shqipërisë, pavarësisht modeleve shqiptimore të përmendura, shtyn përpara prirjen e konvergencës fonetike.

Realiteti i sotëm gjuhësor është tregues se norma ortoepike e shqipes standarde për 40 vjet funksionimi në shumë raste ka përmbysur raportet gjuhë e shkruar-gjuhë e folur, për faktin se “*hapësirat për lëvizje*” në normën e shqipes së folur kanë prodhuar shqiptime të ndryshme tingullore, rrokjesore dhen lëkundje në inventarin e fonemave.

Këtu do të përmendnim vetëm “lëkundjen” e këtij inventari për një tingull të ri, për *w*-ju, e futur në shqipe nga ndikimi i gjuhës angleze. Mosrespektimi i normës së shkruar edhe për normën e folur, gjë që duket se ka qenë e pamundur meqë shqipja, pavarësisht konstatimit se është gjuhë fonetike, në jetën e saj më se 40-vjeçare nuk doli e tillë, krijoji edhe hapësirën për integrimin e tingullit e këtij tingulli. Ky tingull hyri në shqipen standarde të shkruar edhe të folur bashkë me emrat që erdhën në shqipe nga anglishtja, si rezultat i kontakteve gjuhësore direkte ose indirekte. Mosrespektimi i i drejtshkrimit ishte i mjaftueshëm të shkaktonte këtë proces. Si argument për këtë pohim po sjellim Wiliam Woker, William Labov ose reklamën televizive “White kin” të TV-Klanit. Ky tingull, ndonëse qëndron në margjinat e sistemit tingullor të shqipes, funksionalizohet sa herë që përdoren emrat dhe përgjithësisht fjalët angleze që fillojnë me këtë tingull. Hulumtimet në këtë rrafsh tregojnë se huazimet e reja në shqipe, posaçërisht ato nga anglishtja, janë duke lënë gjurmë në shqipen e shkruar e të folur.

Përfundime

Nuk ka dyshim se politikat e planifikimit gjuhësor edhe për gjuhët më të zhvilluara se shqipja, si për anglishten, gjermanishten...nuk e kanë precizuar qartë normën ortoepike të këtyre gjuhëve. Megjithatë, por në këto gjuhë janë gjendur zgjidhje optimale. Gjermanishtja ka një fjalor drejtshqiptimor (Das Aussprache Vörtebuch. Duden, nr. 6) mbi bazë të të cilit realizohet norma ortoepike, ndërsa ekspertët për normë ortoepike të anglishtes kanë zgjedhur modelin drejtshqiptimor të gjuhës së folur të spikerëve të BBS-së.

Prandaj, edhe shqipja, pas këtyre evoluimeve në rrafshin fonetik ka nevojë për një “kodifikim” drejtshqiptimor, sepse duket se mbështetja në “modelin drejtshkrimor” nuk është treguar gjithaq produktive.

Norma e folur e shqipes standarde, e cila nuk përputhet gjithnjë me normën ortografike, krahas realizimit në modele të ndryshme vokalike, është duke përjetuar edhe evoluime të tjera fonetike. Prandaj, ka nevojë për studime eksperimentale të rasteve të identifikuarra, por edhe të rasteve që lidhen me prozodinë, e cila, veç theksit, në shqipe nuk është lëvruar më shumë. Studimet e mëparshme dhe të tjerat që mund të realizohen në fushë të fonetikës eksperimentale do të pasqyronin gjendjen reale të përdorimit të shqipes standarde 40 vjet pas normimit të saj, në një rën anë, ndërsa në anën tjetër do të ndihmonin për të identifikuar lëvizjet fonetike që pengojnë përaftrimin e modeleve shqiptimore. Shqipes së standardizuar në rrafshin ortografik i duhet edhe standardizimi ortoepik.

Rexhep OSMANI

DISA PROBLEME PËR NORMËZIMIN E GJUHËS LETRARE KOMBËTARE

Gjuha shqipe gjatë zhvillimit të saj nëpër shekuj ka pasur një histori të dhimbshme. Ajo nuk kishte mundësi reale për t'u lëvruar papengueshëm. Disa studiues të shqipes historinë e gjuhës letrare e llogarisin nga mesi i shekullit XIX, d.m.th. nga koha kur pati filluar Rilindja Kombëtare Shqiptare. Çdo gjë të shkruar para kësaj kohe ata i konsiderojnë si shkrime të një gjuhe të pa normëzuar Disa studiues të tjerë këtë periudhë të zhvillimit të shqipes nuk e kanë quajtur gjuhë letrare, por gjuhë të shkruar, për ta dalluar nga e para.

Gjuha letrare shqipe, si mjet komunikimi për shqiptarët, kishte filluar të shkruhej diku para shekullit XV. Këtë e argumenton mirë vepra e parë e botuar në gjuhën shqipe "Meshari" i Gjon Buzikut¹ (1555), e cila ka një drejtshkrim stabil për kohën, që tregon se edhe para kësaj vepre do të ketë ekzistuar një traditë e shkrimit shqip. Duke qenë se veprat e para të botuara në gjuhën shqipe janë dokumente me materiale gjuhësore të kufizuara, çdo studim për gjuhën e periudhës para Rilindjes do të duhej të mbështetej në veprën e parë të shkruar në gjuhën shqipe, "Mesharin" e Gjon Buzikut¹ (1555), si dhe në veprat e Budit dhe të Bogdanit, që njihen mjaft mirë, sepse janë studiuar nga shumë studiues të huaj dhe shqiptarë. Në rrethana të këtylla Gjon Buzuku del normëzues i parë i shqipes së shkruar.

Rëndësi të veçantë për normëzimin e gjuhës shqipe ka Pjetër Budi² nga fakti se ai nuk u mbështet në gjuhën e folur të krahinës së tij, por krijoi një koine mbidialektore, të mbështetur në dy nëndialektet e gegërishtes. Ai bëri përpjekje për përdorimin e një gegërishteje të përgjithshme, një pangegërishteje, siç thotë më vonë studiuesi i njohur Selman Riza³. Edhe vepra e Bardhit ishte e përshtatshme si material pune për studime historike të gjuhës shqipe. Për përpunimin e gjuhës letrare në një shkallë mjaft të lartë dhe për begatinë e madhe leksikore ka rëndësi vepra e njohur, "Çeta e profetëve", e Pjetër Bogdanit. Niveli i përpunimit të shqipes letrare, që del në veprën e Bogdanit, do të arrihet dhe do të kapërcehet nga Konstandin Kristoforidhi dy shekuj më vonë. Ndër arbëreshët e Italisë aktivitetet për lëvrimin e

¹ R. Ismaili: Tekste të vjetra, Pejë, 2000, fq. 77.

² Dhimitër Shuteriqi: Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Prishtinë 1978, f. 61.

³ I. Zamputi: Qëmtime për Budin e Bardhin, "Studime historike", Prishtinë 1895, nr.1

gjuhës letrare shqipe kishin filluar në shekullin XVI. Normëzimi i fakteve gjuhësore si dhe studimi i drejtpërdrejtë i strukturës së gjuhës shqipe, paralelisht me gjuhën latine të kohës, bëhet fillimisht në Gramatikën shqip e latinisht të Andrea Bogdanit, nga fillimi i shekullit XVII, të cilën nipi tij Pjetër Bogdani e kishte humbur. Periudhës parakombëtare të lëvrimin të shqipes duhet t'i shtohen edhe përpjekjet e veçanta, të cilat qenë bërë në disa qendra të caktuara gjatë shekullit XVIII për zhvillimin e kulturës siç është Voskopoja. Letërsia e bejtexhinjve, e cila, edhe pse nuk kishte karakter kombëtar, kishte rëndësi për normëzimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe. Gjuha letrare shqipe para periudhës së Rilindjes funksionoi për afërsisht 400 vjet, por dilte shumë e varfër me vepra të shkruara. Pushtimet e huaja që zgjatën shekuj me radhë në këto troje, nuk krijuan asnjë mundësi për lëvrimin e papengueshëm të gjuhës shqipe .

Kisha greke me shekuj e luftoi gjuhën shqipe. Vatikani shumë kohë nuk lejoi shkrimin e veprave fetare në gjuhën shqipe.

Edhe Perandoria Osmane, që nga fillimet e sundimit të saj, kishte sjellë ligje me të cilat dënonte rëndë secilin, që provonte të shkruante në gjuhën shqipe Ndonjë veper që botohej në gjuhën shqipe dilte larg Perandorisë Osmane. humbur.

Në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare qe bërë një kapërcim cilësor edhe sa i përket lëvrimin dhe pasurimit të gjuhës letrare shqipe. Rilindësit shqiptarë normëzuan një gjuhë letrare kombëtare e cila doli në veprat e tyre të letërsisë artistike, në revistat, në gazetat dhe në tekstet shkollore të kohës dhe e bëri jetën e saj në dy variante kryesore: në toskërishten letrare dhe në gegërishten letrare. Rilindësit e parë që u përpoqën ta çonin më tej zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, qenë Naum Veqilharxhi⁴ dhe Jeronim de Rada. I pari kishte kuptuar, për shqiptarët, nevojën për një gjuhë letrare kombëtare (të njësuar). Ndërkaq, De Rada⁵ është më i merituari për nivelin e lartë të përpunimit dhe të pasurimit të gjuhës letrare shqipe.

Naum Veqilharxhi punoi shumë dhe arriti të krijonte një alfabet orgjinal, i cili me gjithë të metat që kishte, shënonte një përpjekje të rëndësishme për alfabetizimin e gjuhës shqipe (T. Osmani 1999 :179). Ai doli si nismëtar, duke çelur rrugën të reja për lëvrimin dhe normëzimin e gjuhës letrare shqipe nga mesi i shekullit XIX. Konstandin Kristoforidhi, me veprat e botuara të tij, hapi rrugën për normëzimin e gjuhës letrare shqipe dhe pasurimin e saj të cilën më pastaj e vazhduan Naimi e Samiu⁶, Pashko Vasa, Jani Vreto, De Rada, Gurakuqi, Konica, Noli, Xhuvani e shumë të tjerë, të cilët vepruan në etapat e mëvonshme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe.

⁴ Gj. Cacaj-Shushka, Gjuha në veprën e Naum Veqilharxhit, LSH, Prishtinë 1999, f. 45

⁵ R. Qosja, Histori e letësisë shqipe II, Prishtinë 1984, f. 19

⁶ F. Raka, Lëvruet dhe studius të gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë 2010, f. 67

Në rrugëtimin e gjatë për normëzimin e gjuhës letrare shqipe dolën një varg problemesh të ndryshme qofshin ata gjuhësore apo jashtëgjuhësore. Këtu më poshtë do t'i përmendim disa sosh por vetëm shkurtimisht.

1. Mungesa e alfabetit unik

Për njësimin e gjuhës letrare shqipe alfabeti unik ishte një faktor me rëndësi të madhe. Shkrimtarët e shekullit XVI-XVII përdorën pa përjashtim alfabetin latin dhe kishin krijuar një traditë të mire të përdorimit të tij në shqipen e shkruar. Edhe shkrimtarët arbëreshë përdorën dendur alfabetin latin. Mirëpo, as këta autorë, as ata, të cilët vepruan përtej Adriatikut (arbëreshët), nuk i zgjidhën problemet, që dilnin për zbatimin konsekuent të këtij alfabeti në gjuhën shqipe. Problemi kryesor qëndronte në faktin, se alfabeti latin kishte vetëm 26 tinguj dhe po aq shenja grafike për shënimin e tyre, ndërkaq gjuha shqipe kishte 36 tinguj d.m.th 30% më shumë sesa latinishtja dhe për këta tinguj dolën probleme në alfabetizimin e shqipes.

Kongresi i Manastirit, i mbajtur katër vjet para themelimit të shtetit shqiptar. më 1908, qe ngjarje e rëndësishme në kulturën shqiptare, që zgjidhi problemin e alfabetit të shqipes. Kjo krijoi mundësi reale, që të mendohej edhe për njësimin e drejtshkrimin të gjuhë shqipe dhe për formimin e një gjuhe të vetme letrare për të gjithë shqiptarët. Kongresi i Manastirit nuk respektoi një parim të rëndësishëm, të cilin e kishte zbatuar Samiu: që çdo tingull të paraqitej me një shkronjë të vetme; dhe kjo, mbeti vërragë e pashlyeshme në alfabetin e shqipes gjer në ditët tona. Megjithkëtë të metë të alfabetit tonë, ky alfabet ndikoi shumë për njësimin e gjuhës shqipe; Mirëpo,ishin disa faktorë të tjerë, që e penguan këtë njësim, për një kohë të gjatë.

2. Mospajtimet rreth bazës dialektore të shqipes së njësuar

Rreth bazës dialektore të gjuhë shqipe ka pasur mendime të ndryshme,të cilat ishin rezultat i mosnjohjes së duhur të vetë strukturës së gjuhës shqipe. Për disa studiues të shqipes dallimet që dilnin në dialektet e saj ishin të vështira për t'u kapërcyer. Këta dijetarë ose mohonin mundësinë e formimit të shqipes së njësuar në mënyrë absolute, ose, edhe kur e pohonin një mundësi të këfillë, këtë e largonin tepër, duke e paraqitur si të mjegulluar, që do të ndodhte shumë më vonë, për të mos thënë shekujsh. Përballë këtyre forcave dolën forcat demokratike e përparimtare .të cilat shihnin qartë mundësinë e formimit të një gjuhe të vetme letrare për të gjithë shqiptarët. Çështja e njësimin të shqipes letrare doli në kohën e Rilindjes Kombëtare. Për këtë qenë angazhuar edhe veteranët e Rilindjes sonë, mirëpo, vetëm kah mbarimi i shekullit të kaluar kjo çështje qe shtruar më gjërsisht në baza të qëndrueshme shkencore.

Këtë e bënë De Rada⁷, Sami Frashëri⁸, Faik Konica⁹, Luigj Gurakuqi¹⁰, Aleksandër Xhuvani¹¹ e të tjerë. Asokohe ky problem ishte shtruar mirë, por nuk kishte një mbështetje të duhur në rrethanat aktuale historike–shoqërore. Mungesa e shtetit shqiptar ishte një faktor më shumë,që. pengonte njësimin e shqipes në një periudhë më të hershme.

Kongresi drejtshkrimit për formimin e një gjuhe të vetme letrare shqipe ishte planifikuar të mbahej dy vjet pas Kongresit të Manastirit,në Janinë,mirëpo për arsye të kushteve politike, betejave të armatosura, që bënë në luftërat ballkanike (1914-1918) falë qëndrimit miqësor të Austrisë qenë krijuar disa kushte të favorshme për kulturën shqiptare dhe u organizua Komisia Letrare Shqipe në Shkodër e cila arriti ta hartonte dhe ta miratonte drejtshkrimin e gjuhës letrare shqipe mbi bazën e elbasanishtes. Kjo normë letrare nuk arriti të realizohej plotësisht sepse nuk e pranuan toskët madje as shkodranët, të cilët formalisht e kishin miratuar. Veç rregullave të drejtshkrimit nga Komisia letrare nuk u botua asnjë gramatikë normative mbi të folmen e Elbasanit dhe asnjë fjalor normative e rregullat e drejtshqiptimit si mjete të domosdoshme, që do ta përkrahnin këtë normëzim kodifikues.

Problemi i njësimin të gjuhës letrare shqipe nuk ndodhi deri në ditë tona se shumë studiues nuk kishin përgatitje të nevojshme shkencore që ta zgjidhnin këtë problem – njësimin përfundimtar të gjuhës shqipe. Disa studiues të tjerë qenë dhe mbetë në shërbim të interesave të huaja dhe me qëllim penguan zhvillimin normal të gjuhës letrare shqipe.

3. Propaganda e huaj kundër shqipes letrare

Ndasia fetare e shqiptarëve qe një ndër faktorët më të rëndësishëm gjatë tërë kohës sa u bënë përpjekjet për të njësuar gjuhën letrare shqipe. Shqiptarët të ndikua nga propaganda fetare e tri qendrave kryesore: Athinës, Romës dhe Stambollit, për shumë kohë qenë të ndarë dhe kjo ndasi u reflektua edhe në jetën politike dhe në veprimtarinë kulturore të tyre. Qarqet antishqiptare të Ballkanit të cilat kishin edhe përkrahjen e shteteve të tyre dolën në mënyrë të hapur në mjetet e tyre propagandistike duke trumbetuar në revistat dhe gazetatat e kohës, se shqiptarët nuk mund të kishin gjuhën e tyre letrare, sepse gjuha e tyre nuk qenë gjuhë orgjinale, por

⁷ A. Kostollari, Rreth një pikëpamje Të De Radës për gjuhën letrare, SF 1981, nr. 3

⁸ F. Raka.Sami Frashëri dhe shqipja e shkruar,Vëzhgime rreth shqipes së shkruar, Prishtinë 2009.f.189

⁹ M. Blaku, Rreth trajtimit të gjuhës letrare në disa nga organet e shtypit të Rilindjes, Seminari 1978, nr. 4

¹⁰ R. Ismaili, Rreth koncepteve gjuhësore të Luigj Gurakuqit, Përparimi 1978, nr. 5, f. 681

¹¹ A. Kostallari, Vepra e A.Xhuvanit për gjuhën letrare, SF 1980, nr. 1, f. 47.

qenkësh një mozaik huazimesh të marra nga gjuhët e huaja si nga latinishtja, greqishtja, gjuhët sllave, gjuhët neolatine. Turqishtja.

4. Mungesa e studimeve për strukturën e shqipes

Niveli i ultë i studimeve gjuhësore në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe më pas, gjatë periudhës së Pavarësisë, e pengoi dukshëm njësimin e gjuhës letrare shqipe. Siç dihet, gjuhëtarët e huaj, të cilët u morën me problemin e studimit të shqipes, arritën rezultate të mira në fushën e fonetikës historike, të morfologjisë historike dhe të leksikut historik të shqipes, por gjuha e gjallë e popullit, d.m.th. dialektet dhe të folmet shqipe mbetën jashtë sferës së interesimeve të tyre.

Mungesa e studimeve dialektologjike ndikoi që njohuritë e dijetarëve më të mirë të mos jepnin rezultate të dëshirueshme për normën e shqipes standarde. Veç kësaj ,elementet e veçanta gjuhësore vështroheshin të ndara dhe jo në lidhshmërinë e natyrshme të tyre..Të gjitha këto e penguan ose e ngadalësuan normëzimin e gjuhës letrare shqipe .

5. Mungesa e institucioneve të organizuara shkencore

Një problem tjetër që pengoi normëzimin më të hershëm të gjuhës së njësuar letrare shqipe, qe mungesa e institucioneve të organizuara shkencore, të cilat në mënyrë kolektive do të merreshin me trajtimin e këtij problemi (të standardizimit të shqipes) në periudhën kohore para Luftës II Botërore. Megjithëkëtë, studiuesit shqiptarë, të shtyrë nga dëshira e flakët për ta ngritur kulturën shqiptare më lartë, arrinin që të informoheshin për punën e njëri-tjetrit edhe në lëmin e normëzimit të shqipes. Në kohën e Rilindjes Kombëtare munguan institucionet arsimore dhe shkencore, të cilat do të luanin rol të rëndësishëm për arritjen e këtij qëllimi. Shkollat fillore, që ishin hapur, nuk mund të luanin këtë rol. Ky rol u plotësua sado pak me punën që bënë shoqëritë shqiptare sidomos në kolonitë e ndryshme dhe gazetat e revistat që dolën, qoftë në kuadër të këtyre shoqërive, qoftë në kuadër të veprimtarisë së pavarur të patriotëve shqiptarë.

6. Konfuzioni i shkaktuar nga teoritë dhe metodat e ndryshme gjuhësore

Konfuzioni i cili ke krijuar nga intelektualët shqiptarë në dy etapat e zhvillimit të Rilindjes Kombëtare, madje edhe në periudhën midis dy luftërave botërore, i shkaktuar nga metodat dhe teoritë e ndryshme gjuhësore evropiane, qe faktor tjetër, që nuk lejonte mundësi për njësimin e një gjuhë të vetme letrare. Shkolla linguistike evropiane, me gjithë përparimet që kishin arritur, nuk mbështeteshin në faktorët

historiko-shoqëror, pa të cilët nuk mund të kuptohej drejt asnjë histori e gjuhës letrare.

Në truallin e shqipes ky problem ishte shumë kompleks, sepse e kishin ndërlikuar rrethanat historiko-shoqërore, që e përcollën popullin shqiptar dhe gjuhën e tij. Pas Luftës II Botërore qenë krijuar kushte më të mira dhe qenë bërë parapërgatitje, që hapën rrugën për planifikimin e gjuhës së standardizuar shqipe. Pas Luftës së II Botërore, edhe në Kosovë u krijuan kushte për lëvrimin e gjuhës letrare shqipe.. Institucionet shkencore të Shqipërisë e më vonë edhe të Kosovës pas 1968-s njësimin të gjuhës shqipe i kushtuan kujdes të merituar. Merita e veçantë e të gjithë atyre që punuan drejtpërdrejt për njësimin e gjuhës letrare shqipe qëndronte aty se ditën të shfrytëzonin çdo gjë,që ishte pozitive nga e kaluara për drejtshkrimin, duke gjetur zgjidhje të drejta hap pas hapi gjer në Kongresin e Drejtshkrimit, i cili u mbajt në Tiranë më 1072. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) vendosi përfundimisht fatin e gjuhës së standardizuar shqipe, por puna për normëzimin përfundimtar të saj nuk mori fund. Ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur brenda kombit shqiptar si dhe përparimi i madh që kanë pësuar shqiptarët dhe të tjerët shtron nevojën e rimarrjes së normës së gjuhës standarde shqipe për zgjerimin e saj, sidomos në leksik dhe terminologji, për ta aftësuar atë që të kryejë me sukses të gjitha detyrat që shtrohen para saj. Kjo pasqyrë e shkurtër e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe mund shërbejë si ndihmesë për t'i kuptuar më mirë aktivitetet e zhvilluara në gjuhësinë shqiptare të cilat përfundojnë në një pike të vetme: në qëllimin për formimin e një gjuhe letrare të përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Fehmi ISMAILI

HUAZIME TË SHQIPES NË FUSHË TË ARSIMIT NË KOSOVË - LIGJET DHE FJALORI I TYRE

Fusha e arsimit, si sektori kryesor i zhvillimit të gjithëmbarshtëm të një vendi dhe i perspektivës së tij, duhet të jetë preokupim i përhershëm i institucioneve shtetërore, i institucioneve arsimore e shkencore dhe i gjithë subjekteve të tjera të tij. Edhe në rastin tonë, arsimit duhet të jetë i tillë, i reformuar, i konsoliduar dhe i integruar në nivel regjional, evropian e botëror, pasi vetëm kështu mund të bëhet promotor i të gjitha zhvillimeve tona.

Gjatë periodës së pasluftës, Kosova ka bërë ndryshime të konsiderueshme në fushën e arsimit dhe të shkencës. Këto ndryshime që janë në proces e sipër, kanë prekur në mënyrë të ndjeshme, pothuaj me gjitha aspektet e fushës së arsimit dhe të shkencës dhe të gjitha nivelet e sistemit të tanishëm arsimor: vet strukturën e tij, legjislacionin, planet mësimore, programet lëndore, tekstet shkollore, trajnimet e mësimdhënësve, etj. Këto ndryshime janë bërë gjatë procesit të reformimit të përgjithshëm të kësaj fushe dhe krahas (ri)ndërtimit pothuaj të tërë infrastrukturës fizike shkollore.

Këto ndryshime janë përcjellë me ndryshime edhe në fjalorin e përdorur në institucionet qendrore administrative të arsimit - në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MAShT); në ato lokale - në Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA); në institucionet edukativo-arsimore dhe në ato shkencore. Ato kanë ndodhur edhe si rezultat i bashkëpunimit dhe i kontakteve të përditshme të institucioneve tona me institucione profesionale e shkencore të jashtme, përmes ekspertëve të tyre që kanë punuar, në këtë periudhë kohore, në fushën e arsimit në Kosovë. Bashkëpunimi i deritanishëm me vendet e zhvilluara evropiane dhe euro-atlantike, reformat e vazhdueshme arsimore, të filluara që në fillim të viteve dymijë dhe kontaktet e përhershme me botën kanë bërë që në fjalorin e gjuhës shqipe të pasluftës të futen në përdorim një numër jo i vogël fjalësh të huaja, të fushës së arsimit, të cilat aty kanë zënë vend dhe janë duke u përdorur edhe tani.

Ky referim¹ është i kufizuar në aspektin gjeografik (vetëm në Republikën e Kosovës); në atë kohor (nga përfundimi i luftës e deri më tani) dhe sektorial (vetëm

¹ Ky referim është pjesë e një cikli punimesh kushtuar huazimeve të shqipes.

në fushën e arsimit)². Ai do të fokusohet në fjalët e reja që janë futur në ligjet e reja të fushës së arsimit, të miratuara nga Kuvendi i (Republikës së) Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore. Ai do të paraqesë një listë të këtyre fjalëve, të pranishme në ligjet e kësaj fushe dhe një vlerësim për arsyeshmërinë ose joarsyeshmërinë e huazimit të tyre³.

Reformat e filluara dhe të vazhduara deri më tani, në të gjitha segmentet, nivelet dhe aspektet arsimore në R. e Kosovës kanë kërkuar domosdoshmërisht edhe sanksionimin ligjor dhe legalizimin e tyre në mënyrë që kjo fushë të rregullohet me ligje të reja të cilat sigurojnë vazhdimësinë e zgjerimit, thellimit dhe zbatimit praktik të tyre në jetën e përditshme në këtë fushë. Për këto qëllime është hartuar legjislacioni primar⁴ dhe legjislacioni sekondar⁵ i kësaj fushe. Me këtë rast, për arsye të kuptueshme, ne do të përqendrohemi vetëm në legjislacionin primar (pra, në ligjet e reja të fushës së arsimit, të nxjerra pas luftës nga institucionet kompetente të (Republikës së) Kosovës.

Siç është praktikë, nxjerrjes së ligjeve të kësaj fushe i kanë paraprirë aktet nënligjore të cilat, në fillim të punës, janë përgatitur dhe miratuar nga Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës⁶ (DASH), si institucion qendror - kompetent për fushën e arsimit. Më vonë, me themelimin e MASHT-it si institucion shtetëror i kësaj fushe⁷, ka filluar një punë intensive në hartimin e legjislacionit sekondar (sidomos të udhëzimeve administrative) për nevoja të brendshme, por edhe i atyre për rregullimin e kompetencave dhe të përgjegjësisë të institucioneve qendrore dhe lokale të fushës së arsimit. Me kohë është ndier nevoja për legjislacionin primar të fushës së arsimit, prandaj ka filluar përgatitja dhe miratimi i tij.

Kronologjia e miratimit të ligjeve të fushës së arsimit

Në vitin 2004 janë miratuar dy ligje të reja:

1. *Ligjin nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë* (08.09.2004).
Ligji ka 10 nene dhe përcakton të drejtat, detyrat, autorizimet, përgjegjësitë dhe mënyrën e punës së Inspeksionit të Arsimit në R. e Kosovës, në të gjitha nivelet arsimore dhe
2. *Ligjin nr. 2004/42 për Veprimtarinë kërkimore-shkencore* (27.09.2004).
Ky ligj ka 80 nene dhe rregullon themelimin, veprimtarinë, organizimin, qeverisjen dhe statusin e institucioneve kërkimore-shkencore.

² Me termin arsim, në këtë referim, do të përfshijmë edhe fushën e shkencës.

³ Referimi nuk do të merret me çështjen e zëvendësimit të tyre me fjalë të shqipes.

⁴ Ligjet e reja, të miratuara pas luftës, sipas niveleve arsimore (shih Shtojcën 2).

⁵ Udhëzimet administrative, statutet, rregulloret e brendshme dhe aktet e tjera nënligjore të institucioneve.

⁶ DASH-i është themeluar në vitin 1999.

⁷ MASHT është themeluar në vitin 2002.

Në vitin 2005 është miratuar vetëm një ligj i ri:

3. *Ligjin nr. 02/L-24 për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve* (22.07.2005). Ky ligj mbulon një segment të arsimit parauniversitar, ka 41 nene dhe promovon arsimin dhe aftësimin gjatë gjithë jetës dhe për të gjithë personat e rritur dhe të interesuar.

Në vitin 2006 janë miratuar tri ligje të reja për fushën e arsimit parauniversitar:

4. *Ligjin nr. 02/L-52 mbi Edukimin parashkollor* (09.01.2006) i cili ka 51 nene dhe përfshin edukimin parashkollor; edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta; gjithëpërfshirjen; institucionet parashkollore; mbrojtjen e fëmijëve; pjesëmarrjen e prindërve; programet e edukimit parashkollor dhe standardet e tij;
5. *Ligjin nr. 02/L-42 për Arsimin dhe Aftësimin profesional* (23.02.2006). Ky ligj ka 33 nene dhe siguron rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e arsimit dhe aftësimin profesional dhe
6. *Ligjin nr. 02/L-67 për botimin e Teksteve shkollore, Mjeteve mësimore, Lekturës shkollore dhe Dokumentacionit pedagogjik* (29.06.2006). Ligji ka 16 nene dhe rregullon botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik.

Në vitin 2008 janë miratuar gjithsej tri ligje të reja:

6. *Ligjin nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës* (21.05.2008). Ligji ka 17 nene dhe rregullon organizimin e institucioneve arsimore parauniversitare në komuna, funksionimin, financimin e tyre dhe sigurimin e cilësisë;
8. *Ligjin nr. 03/L-018 për Provimin përfundimtar dhe Provimin e Maturës shtetërore*, (06.11.2008). Ligji ka 35 nene dhe rregullon mënyrën e organizimit, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe të provimit të maturës shtetërore dhe
9. *Ligjin nr. 03/L-60 për Kualifikimet kombëtare* (07.11.2008). Ky ligj ka 24 nene dhe krijon sistemin kombëtar për kualifikime, bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Ndërkaq, në vitin 2011 janë miratuar versionin e dytë të 2 ligjeve ekzistuese:

10. *Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*⁸, (29.08.2011) i cili ka gjithsej 51 nene dhe rregullon edukimin,

⁸ Versioni i dytë i *Ligjit për Arsimin fillor dhe të mesëm*, i miratuar në vitin 2002.

arsimin dhe aftësimin parauniversitar dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime të këtij niveli arsimor dhe

11. *Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës*⁹ (29.08.2011) i cili ka 38 nene dhe siguron rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në përputhje me standardet evropiane.

Në tekstet e 396 neneve të këtyre ligjeve (gjithsej 11 sosh)¹⁰, përveç fjalëve burimore të shqipes dhe fjalëve të huaja, të huazuara më parë dhe të ambientuara në fjalorin e saj, janë përdorur edhe fjalë të tjera të huaja që nuk ishin në përdorim në fjalorin e fushës së arsimit në Republikën e Kosovës ose që ishin në përdorim të kufizuar dhe jashtë kësaj fushe. Numri i tyre nuk është i vogël, ndërsa përdorimi i tyre është i dendur. Numri më i madh i këtyre fjalëve janë përdorur pothuaj në të gjitha ligjet e deritanishme të fushës së arsimit.

Futja në përdorim e fjalëve të huaja në ligjet e reja, në parim, na duket e arsyeshme, pasi gjuha shqipe, sikur edhe secila gjuhë tjetër e gjallë, në vazhdimësi, por me intensitete të ndryshme, ndien nevojën për pasurimin e fondit të saj leksikor i cili, zakonisht, realizohet përmes fjalëformimit dhe huazimit të fjalëve të huaja. Ato bëhen edhe më të nevojshme, madje edhe të domosdoshme, në rastet e reformimeve të thella sistemore dhe përbajtësore. Kështu ka ndodhur edhe në rastin tonë në vitet e pasluftës, si rezultat i reformave (të zhvilluara ose në proces), të kushtëzuara nga gjendja e përgjithshme e trashëguar, nga sistemi i mëparmë arsimor, nga pasojat e luftës, nga ndryshimet e përgjithshme në sistemin shoqëroro-politik të Republikës së Kosovës dhe nga synimet e saj për integritet evropian dhe euroatlantik.

Një numër i këtyre fjalëve të huazuara dhe të përdorura në ligjet e arsimit në R. e Kosovës si: *alokoj, akreditim, aranzhim, auditim, bachelor, eficient, evaluim, gjenerim, grant, implementim, kurrikul(um), prokurim, trust, web faqe*, etj. nuk kanë qenë fare në përdorim te ne në fjalorin e fushës së arsimit dhe si të tilla, për opinionin e gjerë, sidomos në fillim, tingëllonin si fjalë të panjohura në aspektin semantik, prandaj i konsiderojmë huazime të arsyeshme pasi gjuha shqipe nuk kishte (të paktën në atë çast) fjalë burimore të saj, semantikisht të barasvlershme me fjalët e huazuara.

Një numër tjetër i këtyre fjalëve të huazuara si: *abuzim, departament, ekspertizë, gradim, kompetencë, joprofitabil, tarifë, tranzicion*, etj. nuk ishin krejtësisht fjalë të panjohura për personelin e fushës së arsimit (ndoshta as për opinionin e gjerë) pasi ato kanë pasur një përdorim të kufizuar, por jashtë fushës së

⁹ Versioni i dytë i *Ligjit për Arsimin e lartë*, i miratuar në vitin 2002.

¹⁰ Shih Shtojcën 2 në fund të punimit (tabelë përmbledhëse e ligjeve).

interesimit tonë. Përkundër kësaj, edhe këto fjalë të huaja i konsiderojmë si huazime relativisht të arsyeshme, të paktën për një kohë të caktuar.

Një pjesë tjetër e tyre si: *aprovim, fundamental, implementim, inovativ, komunitet, limit, monitorim, participim, transparencë*, etj. i konsiderojmë si huazime të paarsyeshme pasi fjalori i gjuhës shqipe, i kësaj fushe, ka fjalët e saja burimore, semantikisht të barasvlershme me fjalët e huazuara dhe të përdorura më herët, prandaj të panevojshme.

Fjalët e huazuara, pothuaj, pa përjashtim nga gjuha angleze, që janë përdorur në ligjet e fushës së arsimit në Republikën e Kosovës, i kemi përmbledhur në një tabelë¹¹, sipas rendit alfabetik, duke shënuar¹² paraqitjen e secilës prej tyre në shtyllat¹³ e saj. Gjatë përdorimit të tyre, fjalët e huazuara, në të shumtën e rasteve, janë përdorur në togfjalësh të ndryshëm. Nga lista e fjalëve të huazuara kemi veçuar fjalët e huaja nga fjalët që i kanë shoqëruar:

abuzim; administrim (administroj, administrues); akomodim; akordoj (akorduar - i, e); akreditim (akreditoj, akredituar - i, e, akreditues); akumulim; alokim (alokoj, alokuar - i, e); alternativ; aplikacion (aplikant, aplikativ, aplikim, aplikoj, aplikueshëm - i,); aprovim (aprovuar - i, e); aranzhim, (aranzhoj); asistencë, auditim (auditoj, auditor, audituar - i, e); bachelor; balancuar i; bazhdaruar - i; bord; certifikatë¹⁴ (certifikim, certifikuar - i, e, certifikues); department; depozitoj; distribuim; diversitet; dizajn (dizajnim, dizajnoj, dizajnuar - i, e); donacion (donator); dual; efiçient; ekspertizë; ekstenziv; e-learning¹⁵; emergjent; evaluim; fond (fondacion); format, fundamental; gradim; grant; gjenerim (gjeneroj); implementim (implementoj, implementues); informal, inkorporuar - i, e; inovativ; instruktor; kapital¹⁶; involvim; jashtëkurrikular; joformal, joprofitabil (joprofitabilitet); kolegji; kompatibil; kompetencë; komunitet; konvertim (konveruar - i, e); kosto; kredi (kreditim); kurrikul (kurrikulum); legjisllacion (legjisllativ); licencë (licencim, licencoj, licencuar - i, e); limit; master; masterplan; memorandum; menaxhim (menaxhoj, menaxherial, menaxhues); kompensues; modul (modular); monitorim (monitoroj, monitorues, monitoruar - i, e); objektiv¹⁷; participim (participoj); partneritet; passekondar; performancë; profesor asistent; prokurim; ratifikim; referuar - i, e; rekrutim; resurs; revokim; rezidencial; staf; subvencion (subvencionim, subvencionuar - i, e); tarifë; termat e referencës; trajner (trajnim, trajnues); transparencë (transparent); tranzicion (transitor); trust; web faqe.

11 Shih Shtojcën 1 në fund të punimit.

12 Fjalët e një familjeje janë shënuar në trajtën e përdorur në ligje.

13 Për secilin ligj është rezervuar një kolonë e veçantë.

14 Kjo fjalë, varësisht nga ligji, është shënuar në dy trajta: *certifikatë* dhe *çertifikatë*.

15 Fjala *e-learning* është përdorur në trajtën drejtshkrimore të gjuhës dhënëse (angleze).

16 Fjala *kapital* është përdorur si mbiemër, jo si emër.

17 Fjala *objektiv* këtu është përdorur si emër, jo si mbiemër.

Përfundim

Nga shqyrtimi i mësipërm i çështjes së huazimeve mund të nxirren disa përfundime:

- huazimi i fjalëve nga një gjuhë në gjuhën tjetër është fenomen i vjetër gjuhësor, i njohur dhe i pranishëm gjithnjë e më shumë edhe në ditët e sotme,
- gjuha shqipe, si edhe çdo gjuhë tjetër e gjallë, në mënyrë të përhershme, pasuron fjalorin e saj. Ky pasurim i fjalorit, përveç përmes fjalëformimit, bëhet edhe përmes huazimit të fjalëve (nga gjuhë) të huaja,
- huazimet e shqipes në fushën e arsimit në R. e Kosovës, në vitet e pasluftës, për arsye të kuptueshme, janë bërë, kryesisht, nga gjuha angleze,
- fjalori i gjuhës shqipe, i kësaj fushe, ka huazuar një numër të konsiderueshëm fjalësh të huaja pasi ato, në rrethana të caktuara, i ka imponuar nevoja për përdorim,
- këto huazime, në pjesën më të madhe, i konsiderojmë të arsyeshme pasi gjuha shqipe, të paktën në çastin e huazimit, nuk kishte (në përdorim) fjalët përkatëse të fondit të saj leksikor,
- megjithëkëtë, disa nga këto huazime i konsiderojmë të panevojshme pasi gjuha shqipe i kishte fjalët e saja, semantikisht të barasvlershme me huazimit të fjalëve të huaja, që ishin në përdorim të gjerë para kohës së huazimit të tyre, prandaj nuk kishte nevojë për to,
- futja e këtyre huazimeve në ligjet e fushës së arsimit e ka bërë të detyrueshëm përdorimin e tyre, të paktën për aq kohë sa ato do të jenë të pranishme në to.

Shtojcat 1 dhe 2

Ligji për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës
Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës
Ligji mbi Edukimin parashkollor
Ligji për Arsimin dhe Aftësimin profesional
Ligji për Aftësimin e të rriturve
Ligji për Kualifikimet kombëtare
Ligji për Botimin e Teksteve shkollore, Mjeteve mësimore, Lekturës shkollore dhe Dokumentacionit pedagogjik
Ligji për Provimin përfundimtar dhe Provimin e Maturës shtetërore
Ligji për Inspektionin e Arsimit në Kosovë
Ligji për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës
Ligji për Veprimtarinë kërkimore-shkencore

Kledi SHEGANI

ALEKSANDËR XHUVANI DHE KONTRIBUTI I TIJ NË GJUHËSINË SHQIPTARE

Në gjuhën e çdo populli është shkruar historia e tij, është dokumentuar tradita, e tashmja dhe do të shkruhet edhe e ardhmja. Duke ecur nëpër ditë, muaj, vite, shkruhen një nga një faqet e historisë që konturojnë mendimin dhe plotësojnë identitetin e një kombi.

Dhe në një vit si ky, që shënon 100 vjet identitet, kulturë, histori, gjuhë ia vlejnë të përmenden shumë kontribute, të cilat, të gjitha bashkë kanë krijuar një identitet përfaqësues, i cili flet shqip dhe na bën të ndjehemi krenarë. Dhe kjo nuk është pak, një shekull, që promovoi identitetin tonë, një shekull që tejkalon vitet dhe mbart shumë kontribute që shumëfishojnë vlerat në këtë 100 vjetor.

Në morinë e madhe të personaliteteve gjuhësore bën pjesë edhe Aleksandër Xhuvani, emri i të cilit daton herët në kontributet filologjike shqiptare. Në fakt, Xhuvani ishte ndër të parët gjuhëtarë shqiptarë që bëri studime filologjike. Kontributi i tij përfshin: trajtime dhe analiza të problemeve të përgjithshme të gjuhës letrare¹, çështje të kulturës së gjuhës², gramatikë e formim fjalësh³, leksikologji⁴, hartime fjalorësh apo tekste shkollorë⁵, mendime për studiues të shqipes⁶, recensione për vepra te ndryshme⁷, etj.

¹ A. Xhuvani, Përmbi fjalën “kombiar”(1906), Usus norma loquendi (1924), Vërejtje gjuhësore (1944), Pastërtia e gjuhës shqipe (1950) etj Vepra I, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980

² A. Xhuvani, Parashtesat e gjuhës shqipe,(1956) Prapashtesat e gjuhës shqipe(1962), Kompozitat(1952), Pjesorja në shqipet (1954), Paskajorja në gjuhën shqipe(1960), Parafjalët(1964) etj Vepra I, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980

³ A. Xhuvani, Fjalori i Kristoforidhit(1908),Puna e fjalorit (1926), Kritikë mbi fjalorë të shqipes (1934), Fjalori i Angelo Leottit (1936), Fjalorth shqip-italisht (1941), Një fjalorth i ri (1941) etj. A. Xhuvani, Vepra II, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980

⁴ Libri i gjuhës shqipe, I dhe II (1919, 1920), Njohuritë e para të sintaksës shqipe, Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme”(1930), përshtati veprën “Histori e letërsisë greke” për kursin e lartë të Liceut (1941), përpiloi “Antologji e klasës së tretë të shkollës së mesme”, (1946) etj

⁵ A. Xhuvani, Olger Pedersen (1954), Shtatëdhjetëvjetori i prof. Gustav Veigandit (1930), Gjashtëdhjetëvjetori i prof. Norbert Joklit (1937), Vizita e prof. Maksimilian Lambercit në Shqipëri (1954) etj

Në këtë punim kemi menduar që veprën e prof. Xhuvanit ta sjellim në bazë të dy kriterëve. Së pari, sipas kriterit kronologjik dhe së dyti, sipas kriterit tematik. Vepra e prof. Xhuvanit ta lejon këtë vështrim për vetë larminë dhe vazhdimësinë që ajo ka. Studimi, sipas kriterit kronologjik pasqyron punën sistematike të prof. Xhuvanit, ndërsa, studimi, sipas kriterit tematik pasqyron larminë e kontributeve në lëmin e filologjisë dhe pedagogjisë. Për afro 6 dekada, Xhuvani dha shembullin e studiuesit, profesorit që nuk reshti së dhëni ide dhe kontribute si në aspektin shkencor, studimor edhe në atë pedagogjik e arsimor.

Si një aspekt të parë, do të vlerësonim punën e tij për kodifikimin e drejtshkrimit, duke hartuar udhëzuesit e parë drejtshkrimorë (1949, 1951, 1953, 1956). Nën kujdesin e tij u hartua: "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954), si edhe disa fjalorë dygjuhësh. Kodifikimit të drejtshkrimit, profesori i shërbeu edhe më gjuhën e veprave që botoi, me zgjedhjen e mirë të fjalëve dhe "marrëdhënieve" po aq korrekte me fjalën shqipe.

Studiuesi Mahir Domi, duke nënvizuar faktin që Xhuvani ishte nxënës i gjuhëtarit të njohur grek Haxhidhaqis "i pajisur me një logjikë të fortë dhe mendje të qartë"⁶, thekson se ai u bëri një shërbim të mirë studimeve shqiptare me përgatitjen e botimit të dytë të Fjalorit shqip-greqisht të Kostandin Kristoforidhit (1961). Ky fjalor u botua në 1904 me alfabetin grek dhe kështu mund të përdorej lirisht vetëm prej atyre që dinin greqishten. Xhuvani, përveç transkriptimit me alfabetin shqip, i bëri një renditje të re materialit, sipas radhës së shkronjave të alfabetit shqip, dhe kështu u rregulluan dhe u vunë në vendin e tyre shumë fjalë dhe shprehje. Përmendim edhe veprat "*Parashtesat e gjuhës shqipe*" dhe "*Prapashtesat e gjuhës shqipe*", në bashkautorësi me prof. E. Çabejn, të cilat janë studimet e para në këtë fushë në gjuhën shqipe.

Në "Prejardhja e pjesavet të fjalës në gjuhët shqipe", Xhuvani duke analizuar prapashtesat në sistemin e fjalëformimit të gjuhës shqipe, natyrisht që i drejtohet greqishtes apo edhe latinishtes për të përqsur këto prapashtesa dhe për të bërë një shpjegim të qartë të funksionit të tyre. Duke vëzhguar rregullat e formimit të kompozitave në gjuhën shqipe, prof. Xhuvani i referohet greqishtes shumë herë duke e cilësuar si gjuhë "që ka një shumicë të madhe gjithfarë kompozitash"⁹

Studiuesi Xhuvani, me një kontribut i cili e rendit ndër figurat më të shquara të shkollës dhe të gjuhësisë sonë, ka qenë një interpretues dhe një qëmtues i pikë

⁶ A. Xhuvani, Bibliografi : "Agimi I Gjytetnis" I Shtjef Gjecovit (1911), "Ballkan Archiv" I dr. G. Veigandit (1927), W.Cimochovski: "Mbi dialektin e Dushmanit" (1953), etj

⁷ A. Xhuvani, Vepra I, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980

⁸ Po aty, f. 349

⁹ Për më shumë: Shqipja dhe gjuhët fqinje, A.Xhuvani, Vepra I, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, II, Tiranë 1980, f. 406

takimeve midis kulturës sonë dhe kulturave të tjera, kryesisht ballkanike¹⁰. Përmendim këtu filologjinë greke, së cilës, ai i referohet edhe kur flet për themelimin e një gjuhe letrare. “Për tregim të marrim një gjuhë të vjetër: gjuha greqishte shkrimtare e sotshme, - e cila... ka ardhë nga një ligjëronjë vetëm nga dialekti i Atikës, i cili me të vërtetë nuk ishte ma i mirë e ma i naltë se dialektet e tjerë, por fuqia e madhe që kishte Athina mbi gjithë qytetet e Greqisë dhe shkëlqimi i ndrijtëshim i shkruesvet asaj- të cilët u dëftuen të emënuem e të vlerë në shkencët e në mjeshtëritë- e hypën ligjëronjën atike në shkallë të një gjuhe të përgjithëshme të gjithë kombit grek”¹¹. Për analogji, kur flet për gjuhën shqipe prof. thotë:” që nga shpirtndriturit dhe të shkëlqyeshmit atdhetarë Sami dhe Naim, të cilët me librat qi shkruen i dhanë gjuhë një gjasë shumë të bukurë dhe të posaçme, gjer në ditë të sotshme, shumica e veprave shkronjëtarake e letërare qi kanë dalë, vjersha, ditare, fletore, të përkohshme shkruhen në dialekt të toskëvet”¹². Por, Xhuvani gjithashtu thekson se “gjuha e toskëve ka disa vetija qi s i ka e motra e asaj dhe të cilat e bëjnë dialektin e Toskëvet ma të lehtë në të mësuemit se gegënishten. Për tregim, përmbledhja (sintaksa) e saj është ma e kthjellët, zanësia (fonetika) e saj ma tingëllore e ma armoniake, fjalët i ka ma të gjana e ma rrumbullake e jo fort të shkurtëna”¹³. Xhuvani mbronte tezën se gjuha letrare formohet në bazë të një dialekti, se janë përcaktuese faktorët jashtëgjuhësorë. Në këtë pikë, ia vlen të përmendim dy artikuj të botuar në revistën “Albania”, 1905 dhe “La nazione albanese”, 1906, ku ai jep mendime për gjuhën letrare kombëtare.

Duke folur për disa gramatika te vjetra të shqipes, për atë të Dilo Sheperit dhe e Osman Myderizit, të cilat kanë pranuar si rregull që mbiemrat dalin nga ndajfoljet, prof. Xhuvani jep mendimin e tij. Duke iu referuar greqishtes së vjetër, ai tregon se “një kategori e madhe ndajfoljesh dalin nga mbiemrat me anë të prapashtesës –os për greqishten, si kalos, anos etj”,¹⁴ kështu që ai argumenton që edhe në shqipe ndodh e njëjta gjë. Duke folur për një tip tjetër ndajfoljesh, ku vërehet rënia e rrokjes së fundit si: fshehtas dhe jo fshehtazi, rralla dhe jo rrallazi, Xhuvani i cili e ka vërejtur këtë dukuri edhe tek arbëreshët e Italisë, por edhe në zonat e Jugut të Shqipërisë “ku ka shumë greqizme”, me të drejtë e cilëson këtë dukuri si “një influencë të greqishtes së re”¹⁵. Kur fillon të trajtojë parafjalën, Xhuvani, i referohet përdorimit të saj, që në kohë të lashta në gjuhën greke, së pari prej gramatikanit grek Dionis Trakasit. Termi nga greqishtja u përkthye në latinisht dhe në gjuhë të tjera

¹⁰ A. Xhuvani, *Vepra I*, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980, f. 4

¹¹ A. Xhuvani, *Për themelim të një gjuhe letrare*, Studime gjuhësore, Tiranë 1956, f. 7,

¹² Po aty, f. 7

¹³ A. Xhuvani, *Vepra I*, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980, f. 239

¹⁴ Po aty, f. 241

¹⁵ Për më shumë, po aty, f. 264

dhe studiuesi Xhuvani, rikujton faktin se në shqip, ky term u përkthye së pari prej Sami Frashërit, në gramatikën e tij me fjalën parje.

Prof. Xhuvani duke folur rreth origjinës së parafjalëve dhe duke iu referuar teksteve të vjetra të gjuhëve indoevropiane,¹⁶ thotë se ato do të kenë dalë më të shumtën prej fjalësh me kuptim ndajfoljor. Profesori bën një analizë të sistemit rasor në të cilin mbaresat nuk mjaftonin më për të treguar marrëdhëniet e ndryshme logjike si p.sh: më (të bashkuar), ndër (në mes a përmes) etj. Këto marrëdhënie filloi të shfaqë gjuha në zhvillim e sipër dhe profesori vëren se: *”në gjuhën shqipe u krijuan 18 parafjalë(po aq sa edhe në gjuhën greke) dhe në latinisht 24 të tilla”*¹⁷. Në fushën e gramatikës nuk mund të lemë pa përmendur edhe mendimet e tij për ortografinë e gjuhës, çështje të alfabetit apo për pastërtinë e gjuhës.

Në aspektin e dytë, do të veçonim kontributin e prof. Xhuvanit në planin pedagogjik e didaktik, për të cilin ka meritën e veçantë se përpunoi terminologjinë shkencore për një orientim të saktë dhe të drejtë shkencor.¹⁸ Puna e kujdesshme që ai bënte edhe në hartimin e teksteve të didaktikës, psikologjisë apo edhe në fushën e historisë së letërsisë është një pasuri me vlerë ku “përveç një sintakse vërtet shqipe, gjen një fjalor të pasur që vlen të vështrohet edhe sot”¹⁹. Në veprat e tij gjenden fjalë shqipe të rralla, të cilat përbëjnë një fond të pasur dhe me vlerë edhe në ditët tona.

Një aspekt i tretë i punës së studiuesit Xhuvani është dhe puna me tekstet e letërsisë. Si një figurë me kontribut shumëplanësh, Xhuvani do ta shtrinte veprimtarinë e tij edhe në pasurimin e letërsisë shkollore, jo vetëm me tekste origjinale, por edhe të karakterit metodik e didaktik, të cilat u kthyen në manuale të domosdoshme për mësimin e gjuhës shqipe dhe për orientimin si duhet të orës së mësimin në shkollat tona.

Mjafton të përmendim këtu:” Fillime të pedagogjisë“, pj. 1, “Didaktikë dhe edukatë“ (1926). Gjithashtu, bashkë me Kostaq Cipon hartuan tekstin :”Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme” (1930), përshtati veprën “Histori e letërsisë greke” për kursin e lartë të Liceut 1941, përpiloi “Antologji e klasës së tretë të shkollës së mesme”, në vitin 1946 me pjesë të zgjedhura e shënime letrare ,apo edhe tekstin “Histori te letërsisë së vjetër arbëreshe”, botuar si dispensë për shkollën e mesme. Në fushën e letërsisë prof. Xhuvani u kushtonte shumë rëndësi edhe përkthimeve. Duke na bërë me dije se fjalët “me përkthye” dhe “përkthim” nuk janë shumë të vjetra në gjuhën shqipe²⁰, pasi na parashtron dy mënyrat e përkthimit²¹,

¹⁶ Po aty, f. 265

¹⁷ Për më shumë lexoni Bibliografi e veprave ,studimeve dhe artikujve të A. Xhuvanit, në Studime Gjuhësore, Tiranë, 1956, f. 212

¹⁸ M. Domi në parathënieën e Trashëgimi Kulturor i popullit shqiptar, Vepra Gjuhësore I, Aleksandër Xhuvani, Tiranë, 1980, f. XXV

¹⁹ A. Xhuvani, Vepra I, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1980 , f .34

²⁰ Po aty f. 35

thekson se “përkthimi, në pikëpamjen pedagogjike, asht një stërvitje e mirë e mendjes, shumë e volitshme për shtjellimin e gjuhës dhe të stilit.”²²

Si përfundim mund të themi se kontributet e prof. Xhuvanit mund t'i klasifikojmë në katër plane:

Se pari, në atë gjuhësor, ku do të veçonim kontributin e tij për tekste mirëfilli, për kodifikim të drejtshkrimit, apo për fjalëformimin dhe mbledhjen e fjalëve dhe shprehjeve popullore, të cilat përbëjnë një pasuri për gjuhën dhe kontribut me vlerë për vlerat e fjalës shqipe.

Se dyti, në fushën pedagogjiko-didaktike për të cilën pati meritën e veçantë, pasi krijoi terminologji tërësore të shkencave pedagogjike, të psikologjisë e didaktikës, duke e shoqëruar këtë kontribut me një fjalor tejet të pasur me fjalë shqip, të cilat, ia vlen të merren në konsideratë edhe sot. Profesori mori pjesë edhe në hartimin e Fjalorit të terminologjisë tekniko shkencore.

Së treti, kontributi edhe në fushën e letërsisë, jo vetëm për tekste origjinale, por edhe përshtatje në tekste të ndryshme për nxënës dhe studentë, apo recensionet që shkroi. Qartësia dhe kthjelltësia shkencore, vlera e padiskutueshme filologjike në interpretimin me kompetencë të fakteve gjuhësore dhe përshtatja më së miri me pjesët letrare, i japin profesor Xhuvanit një vend të rëndësishëm në plejadën e njerëzve që e deshën gjuhën dhe bënë më të mirën për të.

Se katërti, nuk mund të lemë pa përmendur edhe kontributin e prof. Xhuvanit në publicistikë mbi çështje të përgjithshme shoqërore, kulturore etj. Një aspekt i rëndësishëm është edhe puna e tij si redaktor në tekste apo organe të ndryshme të kohës. Mjafton të përmendim këtu Buletinin e Institutit të Shkencave, duke qenë një ndër themeluesit e këtij buletini.

Prof. Xhuvani ka shkruar një faqe të rëndësishme në librin e madh të kontributeve për shqipen. Si i tillë, në këtë 100-vjetor nuk na mbetet gjë tjetër, përveç falënderimit dhe respektit që shumëfishohet nëpër vite dhe akoma më shumë në këtë vit jubilar.

²¹ Po aty f. 40

²² Shih te Çabej – Studime gjuhësore nr. VII, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.93.

Anyla SARAÇI - MAXHE

TRAJTIME TË PROCESEVE FONETIKE NË GRAMATIKAT E SHQIPES

Gjuha në përfaqësimin e saj në të folur paraqet një sërë dukurish të cilat shpesh krijojnë probleme në gjuhën e shkruar. Proceset fonetike lidhen me një sërë shfaqjesh gjuhësore që më së shumti i përkasin gjuhës së folur. Këto procese ndodhin si rrjedhim i ndikimit të tingujve fqinjë me njëri-tjetrin dhe për shkak të pozicionit që zënë këta tinguj në fjalë. Shkaqet e veprimit të këtyre dukurive mund të jenë të ndryshme, por në përgjithësi ato shmangin vështirësitë e ligjërit dhe kakofoninë që krijohet nga shqiptimi i disa tingujve. (Topalli, 2004:40) Në të njëjtën kohë ato janë procese që vihen re në të folme dialektore dhe përcaktimi i tyre vështirësohet më tepër.

Në gramatikat e shkruara deri në vitet '40 të shekullit të kaluar përpjekjet për të pasqyruar këto procese fonetike kanë qenë të pakta. Kjo ka ndodhur për disa arsye:

Së pari, nuk janë trajtuar si një element i cili ndikon në strukturën gramatikore të shqipes.

Së dyti, janë në pjesën më të madhe të rasteve dukuritë fonetike janë trajtuar në kuadër të dallimeve midis dialekteve.

Së treti, një pjesë e mirë e tyre janë pasqyruar në gjuhën e shkruar nga vetë hartuesit e gramatikave, sepse kanë qenë pjesë e dialektit a variantit të tyre dhe, sigurisht për ta ka qenë i vështirë përcaktimi i tyre si procese të rëndësishme të mbarë gjuhës.

Në vitin 1949 K. Cipoja, i cili hartoi një pjesë të kompletuar për fonetikën në gramatikën e tij shkencore, vinte në dukje se: “Tingujt e shqipes nuk ka qenë ndonjëherë objekt studimi eksperimental të thelluar nga ana e specialistave, andaj sistemi vokalik i shtruar këtu nuk ka as më të voglin pretendim shkencor, se është i ndërtuar i tëri me vesh, e, me vesh nuk përshkruhen dot konditat fiziologjike të shqiptimit.” (Cipo, 1949: 15)

Sipas profesor K. Topallit një faktor i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në studimin e këtyre dukurive është dhe fakti se ato gërshetohen dhe ndërthuren me njëra-tjetrën duke nxjerrë ngandonjëherë dhe problem për klasifikimin e tyre. (Topalli, 2004:38)

Për të vështruar këto procese jemi fokusuar disa prej gramatikave të hartuara që në shek. XVII e deri ne fillimishekullin e kaluar. Kjo përzgjedhje u bë mbi bazën e trajtimit të këtyre proceseve në to. E theksuam më lart që në një pjesë të madhe këto gramatika përmbajnë shumë pak trajtime për dukuritë fonetike vokalike dhe konsonantike. Kjo edhe sepse një pjesë e mirë e tyre, sidomos ato të shkruara nga të huajt, janë skica a kopje të gramatikave më të hershme, të cilat nuk janë pasqyruar dukuri të tilla. Megjithatë ato paraqesin një rëndësi të veçantë për të parë dukuri të ligjëritimit gjallë në vështrim diakronik.

Proceset fonetike janë element i rëndësishëm fonetik që lidhet ngushtë me:

- problemet e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit,
- përdorimin e drejtë të trajtave gramatikore.

Duke u mbështetur në kriterin fonematik ndryshimet që pësojnë tingujt ndahen në dy kategori, në ato që ndryshime që ndodhin brenda kufijve të fonemës dhe japin vetëm ndryshime nuancash të një foneme, si dhe në ato ndryshime që i kalojnë kufijtë e fonemës, ndryshime që japin si rrjedhim një fonemë tjetër. (Gjinari, 1972:39).

Në një fazë të dhënë të historisë së një gjuhe disa ndryshime tingujsh ndodhin në fjalë të pasqyruara vetëm në shkrim, kurse disa të tjera për arsye të ndryshme ndodhin janë karakteristikë vetëm për variantin e folur. (Gjinari, 1972: 39).

Si të tilla dukuritë fonetike në një pjesë të mirë të gramatikave të shqipes u trajtuan si dallime bazë fonetike ndërmjet dy dialekteve themelore të shqipes.

M. Mandala në studimin e tij “Mbi veprën e e pabotuar të Gj. Guxetës” vë në dukje se në mbështetje të hipotezës së tij brilante (Guxetës) për kohën që shqipja “moderne” qe pasojë e menjëhershme e kontaktit të ngushtë mes dy gjuhëve, latinishtes dhe “maqedonishtes së vjetër” me një epërsi të dukshme të kësaj të fundit, Guxeta solli risinë e vërtetë që ta vërtetonte me anë shembujsh për dukuri fonetike, si: afareza, hundorësia, rotacizmi, asimilimet e bashkëtingëlloreve, reduktimet e rëniet, që karakterizonin latinizime në gjuhën shqipe. (Mandala, 2006: 81)

Për këtë ai citon vetë Guxetën nga vepra “De Albanesium Italiae rite excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint” (“Ndjekja e ritit nga Arbëreshët e Italisë për të ndihmuar veten dhe tërë Kishën”, i njohur ndryshe si Etimologjiku 1735-1756.): “Sepse shqiptarët, në veçanti kur shqiptojnë fjalët latine elidojnë gjithë zanoret për të cilat shqiptimi është përgjithësisht monosilabik, dhe mbajnë disa prej tyre (zanoreve) ose i shqiptojnë me hundë a i transformojnë në një tingull tjetër; shpesh duke shkëputur rrokje të tëra, sidomos ato fundore; bëjnë të pazëshme disa prej bashkëtingëlloreve duke i transformuar në të tjera të përngjashme ose të ndryshme” (cit. nga Mandala, 2006: 81)

Te J. G. Hahn, në trajtimin që ai i bën alfabetit të shqipes, vihet në dukje dukuria e modifikimeve të zanoreve: “Duke e ndarë *e*-në e hapur nga ajo e mbyllur, ngjyrimet e *e*-së së shqipes nuk janë shteruar ende, sepe e gjatë dhe e mbyllur (*sotë*),

sidomos në fjalët njërrrokëshe të toskërishtes, tingëllon e afërsisht si *ö-ja* e gjermanishtes, *-gjë, frë*.” (Hahn, 2008: 390). Sipas tij, në shqipe janë të pranishme edhe gjurmët e umlautit (metafonisë) gjerman *a: natë- netë*, si një dukuri gramatikore që tregon shumësin e emrave, sidoqë toni i kësaj *e* nuk paraqitet si një tingull i veçantë. (Hahn, 2008: 390)

Në vëllimin e dytë të veprës së Hahn-it “Studime shqiptare” pjesa e parë përfshin “Kontribut për një gramatikë të dialektit toskë”. Në parathënien me titull “Vërejtje paraprake” theksohet se autori i shkroi këto kontribute duke mësuar gjuhën shqipe me metodë thjesht teorike dhe gjeti pak raste për ushtrimin praktik të saj. Si rrjedhim në krijimin e fonetikës ai shkroi gjithë fjalët që përfshiheshin në përmbledhjen e kavalier Ksilanderit (Xylander) dhe i renditi ato sipas mbaresave të tyre në klasa të ndryshme. (Kastrati, 2000: 776).

Pjesa për fonetikën është përfshirë në faqet 4-27 dhe aty Hahn ka trajtuar asimilimin vokalik (*gjëmim-gjëmim, ulërij-ulurij*), buzorëzimin (*kripë-krypë, mishkonjë-mushkonjë, grurë-grynjëratë*), disimilimin (*bilbil-birbil*), zëshmimin kosonantik (*filloj-fidhoj*), shurdhimin e bashkëtingëlloreve në mes dhe në fund të fjalës (*bagëti-baktia, ungi-unq*), etj. si tipare të toskërishtes. Në të janë trajtuar dhe mjaft dukuri të tjera fonetike, si hiati, kontraksioni, metateza, proteza epenteza dhe, sipas profesor J. Kastratit, Hahn është i pari që ka shqyrtuar dukuritë dialektore midis toskërishtes dhe gegërishtes. (Kastrati 200: 778)

Edhe W. M. Liku, në pjesën e dytë të gramatikës së tij, kur analizon nyjat, te përjashtimet dallon në vërejtjen 5 dukurinë e epitezës, por pa e përmendur si term: “Kur fjala mbaron me një bashkëtingëllore, në vend të shtimit të një *i-je* (si *nyjë* e *prapme*), merr ndonjë shkronjë ose disa shkronja të tjera për rrokje shtesë, si: *zok-zonku*”. Po këtu ai thekson se përjashtimet e fundit janë të ndryshme dhe duhen mësuar nga praktika. (Leak, 2006: 155).

Në pjesën për përemrat, në trajtimin e trajtave të shkurtra që ai i quan si “një trajtë e ndryshme e këtyre tre përemrave”, ai jep dukurinë e e elizionit dhe krasit-it si rregull: “Meqë *ë* fundore e gjithë këtyre trajtave të shkurtra bie kur del përpara një zanoreje tjetër, shprehjet *të i shkruanj, ap më i* dhe *të a ap*, të cilat këtu i kemi shkruar të plota për të treguar ndërtimin e tyre, do të shqiptohen *t’i shkruanj, ap mi, ta ap*. Ndërkaq do të shënojmë se rënia e një zanoreje në krye ose në fund, kur ndeshet me një tjetër; rënia e një zanoreje fundore rastësisht pa qenë ndonjë shkak i tillë, shtimi i një bashkëtingëlloreje fundore dhe disa shmangie të tjera të vogla nga rregullat e dhëna këtu, janë të zakonshme në gjuhën shqipe për arsye të mirëtingëllimit dhe do të tregohen me shembuj në ushtrimet.” (Leak, 2006: 163)

Në “Abetaren e gjuhës shqipe” të Sami Frashërit (botuar prej shoqërisë “Drita” në Bukuresht më 1886) në mësimin 40 trajtohen shuenjëza (elizioni) (*pun’ e mirë, udh’ e mbarë ç’do, s’munt, s’di-z’di*), pjekjëza (krasis) (*ma tha, ja dha, im’më*) dhe lidhjeza si një lloj përngjitjeje (fjalë me vizë në mes) (*dorë-gjatë, sy-zi,*

krye-qytet), (Frashëri, 1988: 324-325) (Frashëri, 1988: 324-325). Ai nuk jep përkufizime për to, por shembujt e përdorur janë domethënëse.

Një nga gramatikat më të rëndësishme të fillim shekullit të kaluar është padyshim gramatika e gjuhës shqipe e Gj. Pekmezit e vitit 1908. Te kjo gramatikë përveç faktit që autori jep dallimet thelbësore ndërmjet sistemeve fonetike të dialekteve, sidomos ato që lidhen me dukuritë fonetike që janë të ndryshme nga dialekti në dialekt (rotacizmi, monoftongim i diftongjeve), por trajton në veçanti reduktimin e zanoreve apo modifikimet në shoqërimet BZ apo ZB. Ndërkohë ai trajton atë që shumë gjuhëtarë e kanë theksuar si një prirje të shqipes, metatezën e tingujve *l* dhe *r*. Një vend të veçantë i kushton asimilimit, sidomos të *-n-* në kallëzoren e shquar njëjës të emrave mashkullorë si një dukuri që vihet re sidomos në toskërishte. (Pekmezi, 1908:65)

Në “Gramatika apo e folmarmja shqype për shkolla të para të Shqipnisë” theksohet se: “Ndryshimi më i madh asht në zantoret (phonetikët) e gjuhës” (1913:3) dhe vihet në dukje se: “Nji ndryshim i madh, qi i dan këto dy ndënëfolje (djalekte) ndërmjet vedi asht shkurtimi i madh i fjalëve shqype gegnisht e gjatësija e tyre në toskënisht...”. (1913:3)

Në dallimin e shqiptimit të grupeve *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*, në këtë gramatikë përkufizohet asimilimi i johundoreve si një proces që ndodh për shkak të një tërheqjeje të veçantë të gegëve në shqiptimin e hundoreve: “Gegnisht, kur janë dy bashkzanore (konzonante) prej të cilave njana asht e tjetra e pahundake sikundër *mb*, *ng nd*, *ngj*, përzantorja hundake tuj u përdor me një dashtni ma të madhe prej Gegvet, ban qi të shkurohet apo të hupet përzantori i pahundak, e cilla punë nuk ndodh në tosknisht” (1913:5-6)

Nga ana tjetër shurdhimi i bashkëtingëlloreve në fund të fjalëve jepet si një karakteristikë themelore e toskërishtes: “Secila përzantore e zëshme në fund të fjalës apo përpara një përzantoreje bëhet tosknisht përzantore e pazëshme” (1913:8)

Në disa gramatika të botuara në fillim shekullin XX, pavarësisht kufizimeve të autorëve hasim trajtimin e veçantë të proceseve fonetike. Në “Gramatikën e gjuhës shqipe” të Kiço Ath. Konomi trajtohen elizioni, shkrirja dhe reduktimi. Kështu, për elizionin ai shprehet se *çdukja* (elizioni-shën.ynë) është “rënia e zanores fundore të një fjale kur fjala pas saj fillon me zanore, vendin e saj e zë (’)” (Konomi, 1922: 10), por vë në dukje si përjashtim pikërisht fjalët që mbarojnë me *u*, te të cilat ky proces nuk ndodh.

Si proces fonetik trajtohet dhe *trazimi* (ku përfshihen si elizioni ashtu dhe krasis): “*më a dha = ma dha; të uaj=t’uaj*...trazohen në një zanore të gjatë dhe vihet shenja (◌)”. (1922: 10)

Në përkufizimin që i bën reduktimit të *ë-së* për shkak të ndryshimit të trajtës së fjalës ai thekson se ky proces u shërben më së shumti vjershëtorëve për shkak eufonie dhe mase. (1922: 11)

A Xhuvani, megjithëse në gramatikën e tij u mor shumë me morfologjinë dhe sintaksën, në shënimet e tij drejtshkrimore jep shpjegime për elizionin: “Quhet elizion ajo trajtë shkrojtëtorake, në të cilën zantorja e fundit e një fjale shkëputet, hahet prej zantores fillore qi vjen mbrapa. Në vent të zanores qi u hoq vihet një presë, e cila quhet hijezë (*q’ashtë, djal’ i mur*). Elizioni ngjet vetëm kur hasëja e një zantoreje fundore të një fjale me zantoren fillore të një tjetër fjale bajnë një tingull të spëlqyeshëm. Nga ndonjë herë elizioni ngjet edhe ndërmjet një zantoreje e të një bashkëzantoreje, p.tr.çë do njeri=ç’do njeri.” (Xhuvani, 1990: 291).

Deri në vitet 40 gramatikat shkencore ishin shumë të kufizuara, si rrjedhim trajtimi i këtyre proceseve fonetike do të ishte po ashtu i kufizuar. Nga ana tjetër këto procese nuk u trajtuan sepse ata që hartuan gramatikat u përqendruan më tepër në problemet e alfabetit, për më tepër kur në atë periudhë diskutimet për alfabetin e shqipes ishin ende në kulmin e tyre. Të gjithë autorët e gramatikave, qoftë vendës, qoftë të huaj e kishin më të vështirë gjetjen e shenjave grafike për tinguj të shqipes që nuk i përmbanin alfabetet që ata njihnin. Edhe pas Kongresit të Manastirit autorë të ndryshëm përdornin shenja të tjera grafike që nuk i përmbante alfabeti të vendosur në këtë kongres.

Ndërkohë pjesa më e madhe e hartuesve të gramatikave ishin dhe punonin mësues, kryesisht për nivelin e shkollave fillore. Si rrjedhim ata i njihnin pak proceset fonetike që ndodhin në gjuhë, por dhe nuk kishin motiv t’i pasqyronin në gramatikat e tyre shkollore ku pjesën kryesore e zinin njohuritë nga morfologjia, pak nga sintaksa dhe diçka mbi drejtshkrimin. Por, nëse janë përpjekjet e para në këtë drejtim ato kanë një rëndësi të veçantë si për faktin që paraqesin gjendjen e gjallë të gjuhës së periudhave kur u shkruan, shumë prej tyre mund të vlerësohen dhe për përpjekjet për vendosjen e një terminologjie specifike shqip, sidomos për fonetikën.

Sipas vlerësimit të A. Xhuvanit për gramatikën e Cipos: “Pjesa e parë, fonetika, prej 30 faqesh asht pjesa ma me randësi, që s’asht trajtue ma parë në gramatikat tona shqipe dhe për të parën herë po shtjellohet shqip në këtë gramatikë në një mënyrë sistematike e të qartë.” duke vënë në dukje se tashmë kemi një fonetikë të trajtuar mbi një bazë shkencore të mirëfilltë (Xhuvani, 1980:122). Shumë herë këto gramatika të shqipes deri në vitet 1940 janë parë më me vlerë në fushën e origjinës dhe lashtësisë së shqipes dhe si përpjekje të para në fushën e gramatologjisë, dhe pothuaj të mangëta dhe me probleme për fonetikën dhe dukuritë fonetike. Në një punim vlerësues për ecurinë e gramatologjisë shqipe në periudhën 1944-1970 vihet në dukje se gramatikat e këtyre viteve janë nisur në shumicën e rasteve nga skema tradicionale të gjuhëve të tjera dhe jo nga studimi i materialit të shqipes dhe si të tilla ato paraqiten skematike dhe nuk kanë mundur të japin një përshkrim të plotë të strukturës gramatikore të shqipes. (Totoni, Hysa, 1972: 60).

Por, pavarësisht nga mangësitë dhe problemet, pajtohemi me mendimin e shprehur nga profesor Xh. Lloshi në parashkrimin që i bën veprës së Likut se: “Në

studimet gjuhësore na duhet të pranojmë se ligjërimi i gjallë ka kurdoherë një shumësi variantesh, të cilat dalin dhe te i njëjti folës. Përshkrimi pedagogjik ose shkencor i gjuhës detyrohet të largohet prej tyre, por kjo nuk do të thotë që kemi të drejtë të kritikojmë çdo përshkrues të gjuhës ose çdo autor të një teksti shqip, se ka gabuar duke dhënë një variant ose duke pasur të pranishëm në të njëjtin vend dy a më shumë variante. ... Më e drejtë është të pranojmë larminë e gjuhës së gjallë, gabimet njerëzore e ndonjëherë thjesht gabimet e shtypjes.” (Leak, 2006: 60).

Referenca

1. CIPO, K. (1949), Gramatika e gjuhës shqipe, ISH, Tiranë.
2. FRASHËRI, S. (1988), *Vepra I*, ASHSH, Tiranë.
3. GJINARI, J. (1972), *Ndërrime fonemash*, në “Çështje të fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme”, IGJL, ASHSH, Tiranë.
4. *Gramatika apo e folmarmja shqype për shkolla të para të Shqipnisë e dame në katër pjesëmbas methodhës së Joseph Lehmanit*, botimi i dytë, Wien, 1913.
5. HAHN, J. G. (2008), *Studime shqiptare*, përkth. V. Dashi e A. Koçi, Bota shqiptare, Tiranë.
6. HYSA, E. (1972), *Rezultatet në fushën e fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme gjatë 25 vjetëve të çlirimit*, në “Çështje të fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme”, IGJL, ASHSH, Tiranë.
7. KASTRATI, J. (2000), *Historia e Albanologjisë*, I, Shtëpia e Librit, Tiranë.
8. KONOMI, K. ATH. (1922), *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat fillore edhe më shumë për rendet të III-in edhe të IV-in*, shtypshkronja&libraria Dhori Koti, Korçë.
9. LEAK, W.M. (2006), *Kërkime për shqiptarët dhe gjuhën shqipe*, Bota shqiptare, Tiranë.
10. MANDALA, M. (2006), *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshë*, Çabej, Tiranë.
11. PEKMEZI, Gj. (1908), *Grammatik der albanischen Sprache (Laut-und Formenlehre)*, Dija, Jena.
12. TOPALLI, K. (2004), *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, IGJL, ASHSH, Tiranë.
13. XHUVANI, A. (1990), *Vepra I, II*, IGJL, ASHSH, Tiranë.

Abdullah ZYMBERI

GJUHËTARË TË HUAJ DHE SHQIPTARË PËR ASNJANËSIT E SHQIPES

Në këtë kumtesë do t'i paraqesim disa gjuhëtarë (kryesisht historianë gjuhe dhe dialektologë), të cilët janë marrë me asnjanesit e shqipes. Duke u mbështetur në qëndrimin e tyre rreth asnjanesve të shqipes ata i kemi ndarë në dy lagje. Në lagjen e parë do t'i përmendim ata të cilët e pranoinin praninë e asnjanesve në shqipet, ndërsa në të dytën ata që e mohonin një gjë të tillë.

Dihet se karakteristikë e gjuhëve indoevropiane është se ato kanë tri gjini-mashkulloren, femëroren dhe asnjanesen. Duke bërë fjalë për gjinitë e emrit prof. Çabej ka shtuar: “Rasku, përpara Boppit, gjeti një vërtetim për karakterin indoevropian të shqipes mu në faktin që kjo gjuhë ka tri gjini tek emri¹. Më fjalë të tjera, gjinia asnjanesë ka rënë që shqipja të përfshihet në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Sipas Pedersenit “te gramatika e Lecce-s pohohet pa asnjë rezervë se në gjuhën shqipe ka tri gjini, duke përfshirë aty edhe fjalët përcaktuese të gjinisë asnjanesë jepen rregulla të hollësishme”².

Lagjes së parë, domethënë e asaj që e pranonte praninë e gjinisë asnjanesë në gjuhën shqipe, i priu Holger Pedersen. Ai te vepra e tij “Studime për gjuhën shqipe”³ ia ka kushtuar një kapitull gjinisë asnjanesë me titull – Gjinia asnjanesë në gjuhën shqipe⁴. Pedersen këmbëngul në qëndrimin e fortë të tij se shqipja e ka edhe gjininë asnjanesë. Ne kemi mbetur pa mend kur e pamë së shtjelluari nga mendja e të mbërrishmit Pedersen pronorin e gjinisë asnjanesë të vetës së dytë njëjës – tat-, si: kriet tat.Besa, në Strelc të Deçanit edhe i emëruar – tat-it. Rrethet e Deçanit, të Pejës, e të Istogut për vetën e parë e përdorin –têmt- dhe forma e emëruar –têmtit, ndërsa për vetën e tretë njëjës – t’vet, forma e emëruar t’vet-it.

Pedersen, duke folur për asnjanesit, ndalet edhe te fjalët përcaktuese të tyre, të cilave u bie në fiçe me format – kë-ta, a-ta, të dala sipas tij “nga indoevropianishtja – **tod**”. Pra, me dallim nga Hahn-i dhe Meyer-i, Pedersen fjalët

¹ Shih te Pedersen - Studime për gjuhën shqipe –Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prish.tinë, 2003, f. 47.

² Po aty, f. 47.

³ Po aty, f.47.

⁴ Po aty f. 49.

përcaktuese –kë-ta- a-ta të pronorëve nuk i ngatërroi si forma shumësi të mashkullorëve.

Hahni bashkë me Meyerin e njihnin vetëm një tip të gjinisë asnjane, vetëm emra lënde të përdorur si kolektivë. Pedersenit rreth kësaj çështjeje pati shtuar : “ Por nuk është aspak e vërtetë që asnjansit janë vetëm emra lënde të përdorur si kolektivë”⁵. Pra, ai e dinte se ekzistojnë edhe disa tipa asnjansish veçmas prejpjesorët dhe prejmbiemërorët e emëruar.

Akademiku ynë i madh – Ajeti, i përket lagjes së parë, domethënë i ndjek gjurmët e Pedersenit për asnjansit e shqipes, duke këmbëngulur për praninë e asnjansëve në gjuhën shqipe. Për vjetërsinë e asnjansëve të shqipes Akademiku ynë ka shtuar “Përdorimi i asnjansit ishte shumë i përhapur në shqipen e periodave të hershme”⁶. Ai i ka përmendur këta tipa asnjansish:

- 1. Emra lëndësh**
- 2. Mbiemra të substantivuar**
- 3. Pjesore në formë mbiemrash të substantivuar**
- 4. Emra të tjerë të veçuar, si: krye-t, ballë-t**

Edhe Akademiku tjetër shqiptar- Akademik Demiraj, i përket lagjes së parë, duke pohuar se shqipja i ka tri gjini, pra, edhe gjininë asnjane. Rreth vjetërsisë së asnjansëve në shqipet Akademik Demiraj shton: “ Ekzistenca e gjinisë asnjane në një numër të konsiderueshëm emrash të trashëguar të tipit ballë, ujë etj. dhe të huazuar të tipit vaj, faj etj., si edhe tek disa përemra , si p.sh. tek format e dëftorëve ata, këta dëshmon qartë për vjetërsinë e madhe të kësaj gjinie, pra, për karakterin e saj indoevropian”⁷. Akademik Demiraj i ka përmendur këta tipa asnjansish:

1. Emra prejfoljorë asnjans (të folurit, të menduarit)
2. Emra asnjans të përdorur në disa togfjalësha arkaikë (ka marrë të krisur)
3. Emra prejmbiemërorë të tipit (të zi-të, të verdhë-t, të kuq-të)
4. Disa emra të parmë (ballë, brumë, djathë, drithë, krye, lesh, miell, mish, mjaltë, ujë, dyllë, dhjamë, grurë, gjalpë) etj. Diku kah fundi i asnjansëve Akademik Demiraj gjininë asnjane në shqipen e sotme e sheh në të zbehur, duke shtuar “sistemi i lashtë tri gjinish ka ardhur duke u thjeshtuar me një sistem me dy gjini kryesore dhe me disa mbeturina të gjinisë asnjane”.

⁵ Shih te Akademik Ajeti – Studime gjuhësore në fushë të shqipes, III, Prishtinë, 1985, f. 93.

⁶ Shih te Akademik Demiraj – Morfologjia historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1980, f. 38.

⁷ Shih te prof. Agani – Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 227.

Asnjanësit sipas disa dialektologëve tanë

Të folmet popullore janë mburojë (jo të gjitha njënjë) e të ruajturit të trajtave më të vjetra gjuhësore. Duke e bërë të shprushurit e asnjanësve te disa punime dialektologjike kemi hetuar se një pjesë bukur e mirë e të folmeve popullore i ka ruajtur ata fort mirë, ndërsa pjesa tjetër s'i ka fare. Për asnjanësit e shqipes në fushën e dialektologjisë punim më të rrasët se prof. Hilmi Agani s'ka shkruar kush. Ai te punimi i tij " Rreth kategorive gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës së emrit në të folmen e qytetit të Gjakovës"⁸ asnjanësit e asaj të folmeje i ka shkrirë së punuari, duke marrë shembuj e shembuj, regjistruar me siguri matematike dhe zbërthyer e ndarë shkencërisht më mirë se çdo dialektolog tjetër shqiptar. Me fjalë të tjera, prof. Agani u ka bërë të shtrydhur e jo mahi asnjanësve të folmes së Gjakovës.

Në të folmen e Gjakovës, sikurse në të folmet e tjera të Kosovës e edhe më gjerë, asnjanësit që emërtojnë lëndë qesin krye fare pak, mirëpo tipat e tjerë (prejmbiemërorët dhe prejfoljorët e emëruar) rrojnë bukur mirë edhe sot e kësaj dite. Ja tipat e asnjanësve dhe shembujt nga prof. Hilmi Agani:

1. **Emra prejmbiemërorë asnjanës:** Pi del **t'keç**; sa **d'zit** e thonit; I shkoj **t'rit**. Ja hongri **t'xhällt**; **t'lig**, **t'pakt**, **t'enxetit**, **t' thatit**, **t'höll**, **t'lët**, **t'rrällt** etj.#

2. **Nëntipi i asnjanësve i shprehjeve eliptike, që kanë formuar togje të qëndrueshme:** per **t'mir**, per **t'keç**, me **d'but**, **n't'eger**, **n't'kuç** etj.

3. **Nëntipi i asnjanësve nga rrjedhorja e ndajfoljësuar e emrave prejmbiemërorë:** pi **s'ftofti**, pi **s'kfillti**, pi **z'vronti**, pi **s'holl**, pi **strashi**, pi **s'thati**, pi **s'roni**, pi **z'vogli** etj.

4. **Emra prejfoljorë asnjanës:** **t'prem-it**, **t'thyem-it**, **t'ziem-it** etj. Ky tip është më i varfër, sepse disa syresh dalin si prejfoljorë femërorë, si: **e lanja**, **e prenja**, **e thynja**, **e zinja** etj.

Edhe prof. L. Mulaku te punimi i tij " E folmja shqipe e Shalës së Bajgorës" e ka dhënë një vistër bukur të mirë asnjanësish nga mbiemra dhe pjesore të emëruara, si: - **t'höllt**, **t'träsht**, **t'gät-t**, **t'ftoft-it**, **t'bärdht**, **t'mirt**; **si edhe:** **t'shkuemit**, **t'ardhun-it**, **t'korrun-it**, **t'nalun-it**, **t'fshim-it**, **t'lam-it** etj.

Një numër të konsiderueshëm asnjanësish e kemi ndeshur te punimi i prof. Qemal Haxhihasanit – "Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë"⁹. Me dallim nga të folmet e Gjakovës dhe të Shalës së Bajgorës në çamërishte janë ruajtur asnjanësit,që emërtojnë lëndë. Ja disa shembuj marrë nga Haxhihasani: **gjalpët**, **djathët**, **mjaltët**, **dillët**, **dhjamët**, **ujët**, **lesht**, **klumësht**, **kost**,

⁸ Shih te Qemal Haxhihasani – Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 118.

⁹ Shih te Qemal Haxhihasani – Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 119.

misht, kriet, ballt, të ftohtët, të rit, të trasht, të bardhët, etj.¹⁰ Te i njëjti punim Haxhihasani vjen në përfundim se ” nga kjo pikëpamje çamërishtja afrohet më tepër me të folmen e arbëreshëve të Greqisë”. Haxhihasani është mbështetur te Reinholdi për të folmen e arbëreshëve të Greqisë. Ja disa shembuj asnjansish të arbëreshëve të Greqisë: **lesh-të, mish-të rrush-të, ujë-të, gjalpë-të, djathë-të, dhiamë-të, brumë-të, drithë-të, grurë-të, elp-të, krie-të, ballë-të, dillë-të, të dhëmburë-ritë, të ikurë-itë,** etj.¹¹

Edhe prof. Menella Ttoni te punimi “ Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit”¹² e ka dhënë një sasi bukur të mirë asnjansish sidomos për ata që emërtojnë lëndë. Ja disa shembuj asnjansish nga punimi i Ttonit: **qumështit, misht, dhjamët, djathët, gjalpët, miellt, kosët, lesht, plëhët, ballët** etj. Kanë përdorim të dendur edhe asnjansit prejfoljorë të emëruar, si: **të shirit, të mjelurit, të verdhurit, të pjekurit, të mjelët** etj. Sipas Ttonit asnjansit prejmbiemërorë dalin shumë më rrallë.

Sipas pohimeve të Pedersenit¹³ lagjes së dytë i përkasin ata që e mohonin praninë e asnjansëve në gjuhën shqipe. Ndër ta kemi veçuar:

1. Rossin
2. Abatin e Mirëditës – Imzot Gaspër Krasniqin
3. Junggun
4. Leakeun
5. Hahn-in
6. Meyerin

Ne ia kemi zënë për të madhe Imzot Gaspër Krasniqit për moshetimin e gjinisë asnjansëve në shqipet, sepse shqipja ishte gjuhë e tij.

Në të përfunduar të këtij vështrimi po shtojmë se pohimi i disa historianëve të gjuhës dhe i gramatikanëve të shqipes se shqipja ka pak asnjans nuk na bind, sepse nuk është bërë qëmtimi i tyre nëpër të folmet popullore dhe, ç’është më e keqja, nuk janë vjelë veprat e shkrimtarëve tanë për të pasur një pasqyrë reale rreth asnjansëve të shqipes. Te Buzuku dhe te pasardhësit e tij ka plot e përplot asnjans. Kemi ndeshur në shumë asnjans edhe te Poradeci, Kuteli, Konica, Koliqi, Harapi, të cilët do të shtatonin një fjalor asnjansish në gjuhën shqipe. Vetëm te Fjalori i Mehmet Elezit janë shënuar tipa të ndryshëm asnjansish, të cilët e kapërcejnë nëntëqindëshin. Në të folmet popullore ka emra të gjinisë asnjansëve, të cilëve duhet t’u bihet mbrapa turravrap, sepse ata do të rrhojnë vetëm edhe pakëz ditë atje.

¹⁰ Shih po aty, f. 161.

¹¹ Shih te Menella Ttoni – Dialektologjia shqiptare, I, Tiranë, 1971, 31.

¹² Shih te Pedersen – po aty, f. 47.

¹³ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 120.

Asllan HAMITI

DISA DUKURI MORFONOLOGJIKE NË TË FOLMET E GEGËRISHTES

Në këtë paraqitje tonë të shkurtër, do të përpiqemi të shqyrtojmë disa aspekte morfonologjike në rrjetin dialektor të Veriut. Do të ndalemi në 3 çështje kryesore, përkatësisht në:

- a) ndërrimet morfonologjike,
- b) kundërvënien e gjatësisë së zanoreve dhe në
- c) hundorësinë e zanoreve.

Do të përpiqemi të japim edhe ndonjë vlerësim përgjithësues.

a) Ndërrimet morfonologjike në të folmet e gegërishtes

Gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe janë zhvilluar disa procese fonologjike me vlerë morfologjike, të cilat zakonisht quhen dukuri morfonologjike. Ndonjë nga dukuritë morfonologjike është shumë e vjetër, e përfutur qysh në gjuhën “nënë“ të shqipes. Por shumica e dukurive të këtilla të shqipes së dokumentuar janë, në thelb, zhvillime të brendshme të vetë kësaj gjuhe, megjithëse procesi për ndonjë prej tyre mund të ketë nisur qysh në gjuhën “nënë“ të saj.¹

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera indoevropiane me morfonologji të zhvilluar,² hasen:

- a) *ndërrime fonemore që shërbejnë si mjet i vetëm gramatikor dhe*
- b) *ndërrime fonemore që veprojnë krahas me ndajshitesat eptimore.*

Ndryshimet fonemore kanë prekur mesin ose fundin e fjalës. Ndryshimet e fonemave nistore janë tepër të rralla në shqipen e sotme, sepse ato janë më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve. Kjo është shpjeguar me atë që për ndjenjën gjuhësore të shqipfolësit, ndryshimi i fonemës nistore të një morfeme shpie në prishjen e identitetit kuptimor të saj.

Dihet se kundërvëniet morfonologjike në mbarë shqipen janë më të shpeshta në paradigmat emërore (sipas numrit, trajtës, rasës) dhe në paradigmat foljore (sipas vetave, numrit, kohëve, mënyrave dhe diatezës), e më pak në sistemin mbiemëror.³

¹ Gjuhë të tilla janë gjermanishtja, gjuhët sllave etj.

² Rahmi Memushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989, f. 86.

Në çështjen e ndërrimeve morfonologjike shqipja na del mjaft e njësuar (unike), meqë po të njëjtat këmbime kanë shtrirje të përgjithshme territoriale. Dukuri më të përhapura në të dy dialektet janë qiellzorëzimi, metafoia, apofonia si dhe disa ndërrime të tjera zanoresh e bashkëtingëlloresh.

Duhet përmendur se të folmet gege realizojnë edhe kundërvënien e gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve, që të folmet toske përgjithësisht e kanë bjerrë këtë.

Këtë shtrirje dialektore të kundërvënies së fonemave zanore të shkurtra me gjegjëset e gjata si dhe me inventarin e fonemave zanore hundore të arealeve të shqipes mjaft mirë i pasqyron Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (shih hartat: 1.a, 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 1.dh, 1.e; 2.a, 2.b, 2.c, 2.ç, 2.d; 1.a – 7., 1.a – 2.d., 1.a.- 4.).⁴

Qiellzorëzimi i fonemave si dukuri morfonologjike e ndërrimit të një foneme joqiellzore në një fonemë qiellzore ka shtrirje mbarëdialektore. Nga bashkëtingëlloret qiellzorëzohen /k/-ja në /q/, /g/-ja në /gj/, /ll/-ja, /l/-ja dhe /t/-ja në /j/. Ndërrimin e /k/ ~ /q/ e gjejmë tek emrat mashkullorë, kryesisht të burimit shqip, por edhe të huaj. Me qiellzorëzimin e /k/-së në /q/ nga forma e njëjësit shumësin e formojnë disa emra mashkullorë.

Për të parë ndërrimet e fonemave në të folmet e veriut mbështetje mund të gjejmë në skicat dhe monografitë dialektore, por kjo nuk do të ishte e mjaftueshme, pa vjeljen e materialit me vëzhgim të drejtpërdrejtë. Një ndërmarrje e këtillë kërkon punë disavjeçare ekipore të koordinuar.

Në përpjekjen tonë për ta përditësuar çështjen dhe për të nxitur studimet në këtë fushë, do të sjellim pak shembuj kryesisht nga të folmet e Kosovës dhe të Maqedonisë.

ka ~ qe (shqipja standarde): Me interes për morfonologjinë e gegërishtes është shtrirja territoriale e larmishme e formës së shumësin të emrit *ka*. Në bazë të të dhënave që kemi mundur të sigurojmë, të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore, veçmas ato të Kosovës e deri te të folmet veriore të Shkupit e ruajnë formën e vjetër të paqiellzorëzuar *kije*, me përjashtim të të folmes shqipe të Peshterit, ku krahas formës *kije* përdoret edhe forma *qe* ose *çe* (si variant territorial me afrikatizimin e [q]-së në [ç]) si dhe e folmja e Prilepit dhe e Krushevës *qie*. Në të folmet e tjera në shtrirje gjeografike në jug të Tetovës dëgjojmë formën e palatalizuar *qe*. P.sh.: *ka ~ kie* (Kosovë, Karadak i Shkupit), *qie* (Prilep e Krushevë), *çe* (Pollog), *qe* dhe *kie* (Peshter), *kije* (Moravë e Epërme dhe e Poshtme), *çie* dhe *kie* (Tetovë).

³ AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, 2007.

⁴ Ndërrimi /ll/ ~ /j/ është ndër më prodhuesit nga ndërrimet e bashkëtingëlloreve. Atë e ndeshim në një shumicë emrash mashkullorë që dalin me fundoret *-ull*, *-all*, *-ill*, *-ell*, *-*, *yell*, *-uall*, *-iell*, *-yll*, *-ëll* dhe *-oll*: *akull* ~ *akuj*, *mangall* ~ *mangaj*, *kërmill* ~ *kërmij*, *kërçell* ~ *kërcej*, *fëndyell* ~ *fëndyej*, *buall* ~ *buaj*, *truall* ~ *troje* etj. Shih: Rahmi Memushaj, *Morfonologji...*, f. 119-122.

Tek emrat *mik*, *anmik*, *plak*, *ujk*, *krushk* në të gjitha të folmet gege, ashtu si edhe në ato toske kemi qiellzorëzim të plotë të /k/-së fundore në /q/. Në të folmet e gegërishtes veriore dëgjojmë format me /q/ të afrikatizuar, ndërsa në gegërishten qendrore me /i/ dhe /u/ të diftonguar, përkatësisht në *miq*, *miç*, *mâiq*; *pleq*, *pleç*, *pqeq*, *qeq*; *uq*, *uç*, *âuq*, *ôuq*; *anmiq*, *anmiç*; *krushq*, *krushç*. Këtë mund ta dëshmojmë me shembujt:

mik ~ **miq**: *miç* (Kosovë, Karadak i Shkupit), *mâik* – *mâiq* (Prilep e Krushevë), *miç* (Pollog).

armik ~ **armiç**: *anmik* – *anmiç* (në Kosovë e Maqedoni).

plak – **pleq**: *plak* – *pleç* (në Kosovë, në Karadakun e Shkupit, në Malësinë e Sharrit të Tetovës), *pleq* në Peshter, *pqak* – *pqeq* por edhe *qak* – *qeq* (Pollog), *pleq* (Peshter), *plak* ose *qak* – *pleq* ose *qeq* (në Karadakun e Shkupit).

ujk ~ **ujq**: Edhe shumësi i fjalës *uk* na del me /k/ fundore të qiellzorëzuar. P.sh.: *uk* – *uç* (Kosovë e Maqedoni), në Prilep e Krushevë me /u/ nistore të diftonguar në [âu]: *âuk* – *âuq*, në f. Straçincë të Karadakut të Shkupit me /u/ nistore të diftonguar në [ôu]: *ôuk* – *ôuq*; *uç* (Pollog), *ujq* (Peshter), *uç* (Tetovë).

krushk ~ **krushq**: *kraushk* – *kraushq* (Prilep e Krushevë), *krushç* (Kosovë).

peshk ~ **peshq**: Shumësi i emrit *peshk* del i larmishëm në të folmet e Veriut. Kështu, në Kosovë dëgjojmë formën *peshçi*, në Karadakun e Shkupit *peshki*, në Karshiakë të Shkupit e Derven (zonë gjuhësore midis Shkupit e Tetovës) kemi formën me /i/ fundore të diftonguar *peshkâi* dhe *peshka* si dhe formën *peshqe* në Prilep e Krushevë.

Një numër emrash të tjerë, përveç ndërrimit të /k/-së fundore në /q/ > [ç], marrin edhe prapashtesën -e ose nuk e qiellzorëzojnë /k/-në dhe marrin mbaresën -a, mjaft të përhapur te të folmet e veriut, si p.sh:

bark ~ **barqe**: Te forma e shumësit *bark* po kështu ka vepruar qiellzorëzimi. Prandaj është përftuar forma *barqe*, *barçe* (në Kosovë, Preshevë, Bujanovc, Peshter e Maqedoni), ndërsa sipas të dhënave që kemi, vetëm në Derven është ruajtur /k/-ja fundore e paqiellzorëzuar, përkatësisht formës së njëjësit i shtohet mbaresa -a: *bark* - *barka*.

bllok ~ **blloqe**: *blloka* (në Kosovë e në Derven), *blloka* e *blloqe* (në Karadakun e Shkupit, në Karshiakë), *blluok* – *blluoqe* (në Prilep e Krushevë).

prag ~ **pregj**: *praga* (në Karadak, në Derven), *pragje* (në Prilep e Krushevë).

dyshek ~ **dyshekë**: Në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes njëjësi i emrit *dyshek* shqiptohet me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi me zanore fundore të gjatë, pra me kundërvënie fonologjike zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë, përkatësisht *dyshek* - *dyshe:k* (në gjithë Kosovën dhe në Karadak e Karshiakë), ose pa qiellzorëzim, duke i prapavënë njëjësit mbaresën -a: *disheka* (në Derven). por edhe me qiellzorëzim + mbaresën -e: *dysheqe* (në Prilep e Krushevë).

oxhak ~ oxhaqe: Forma më e përhapur e shumësit të emrit *oxhak* është ajo me zanoren /a:/ të gjatë: *oxha:k* por edhe *oxhaqe* (Prilep e Krushevë), si dhe *oxhaçe* e *oxheç* (Moravë e Epërme në Kosovë).

brisk ~ brisqe: Edhe forma e shumësit *brisk* është e shumëllojshme: *brisç* (në Kosovë), *briska* (në Derven), *brisqe* (në Prilep e Krushevë).

Siç dihet, në gjuhën shqipe disa emra shumësin e formojnë duke qiellzorëzuar tingullin e fundit të temës /g/ në /gj/:

zog ~ zogj: Me interes për morfonologjinë dialektore është edhe shtrirja territoriale e larmishme e emrit *zog*. Nga të dhënat që kemi arritur të sigurojmë për të folmet e veriut, kemi hetuar se në to gjallojnë 4 forma shumësi: 1. *zogj* (ose në variantet fonetike *zoq*, *zoxh*), 2. *zoj*, 3. *zoxhi* dhe 4. *zoga*. Forma më e përhapur në gjithë Kosovën e deri në veri të Shkupit është *zoxh*, por në Moravë të Epërme, në të folmen e Drinit të Bardhë (Kosovë) dhe në Pollog (zonë ndërmjet Tetovës e Gostivarit) mbizorëron forma *zoj*. Në Karshiakë të Shkupit thonë *ni zogj – shumë zogj* por edhe *zoga*, *zûog – zûoq* (Prilep e Krushevë), *zoj* (Pollog, Moravë e Epërme, Drini i Bardhë), *zoq* e *zoj* (Peshter), *zoxhi* (Tetovë).

pllug ~ pllugje: *plluga*, *pllugje* por edhe *ni pllugj – sha:m pllugja* (Tetovë dhe në f. Brest të Karadakut të Shkupit, për shkak të qiellzorëzimit të [g] > [gj]), *plluxh* (Kaçanik, Moravë e Poshtme).

breg ~ brigje: *bregje*, *brega* (Karadak, *ni bregj – sha:m bregja*, Tetovë, f. Brest të Karadakut), *brexhe* (Pollog, Moravë e Epërme), *brega* dhe *brexhe*, rrallë *brixhe* (Derven).

shteg ~ shtigje: *shtega* dhe *shteqe* (Karadak), *shtexhe* (Pollog), *shtixhe* (Kosovë), *shteqe* dhe *shtiqe* (Peshter).

varg ~ vargje: *varga* dhe *vargje* (Karadak), *varxhe* (Pollog), *varxhi*, *verxhi* (Kosovë), *vargja* (Tetovë),

Derisa në shumë të folme shqipe qiellzorëzohet edhe /-ll/-ja fundore e formës së njëjës në /-j/ te disa emra mashkullorë në shumës,⁵ në të folmet e veriut ka edhe fjalë të tipit të tillë me /ll/ të paqiellzërëzuar edhe në shumës, si p.sh.:

kungull ~ kunguj: forma më e përhapur në Kosovë është *kuñjell – kuñji*, *kungëll – kungi* në Pollog, në Derven e në Karshiakë; ndërsa *kunglla* në Karadakun e Shkupit.

yll ~ yje: *yje* në Kosovë e në Pollog, *ill – illzi*, *illa* në Karadakun e Shkupit, *yllzi* në Kaçanik.

⁵ Çifte leksikore me dallim kuptimor dhe dallime gramatikore të fjalëve në bazë të gjatësisë së zanoreve në gegërishten janë krijuar sidomos me rënien e /ë/-së fundore. Në dialektin e Veriut rënia e /ë/-së fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të gjatësisë në zanoren që gjendej para saj. Prandaj, emrat në numrin njëjës dhe të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa po të njëjtit emra në shumës dhe në gjininë femërore dalin me zanore të gjatë.

mashkull ~ meshkuj: Me interes për morfonologjinë e gegërishtes është edhe shtrirja teritoriale e larmishme e formës së shumësit të emrit mashkull: *mashkëll* – *mashklli* (Prilep e Krushevë), *mashki* (në Derven, në Karshiakë). Nuk është qiellzorëzuar /l/ -ja as te shumësi i emrit *kalli*: > ka:ll – *kalli*, *kallëi*, *kallâi* dhe *kallzi* (në Karadak e në Kaçanik), *kajzi* (në shumë të folme të Kosovës).

hamall ~ hamaj: Shumësi i emrit *hamall* bën me mbaresën -a: *hamalla* (në Kosovë, Karadak, Derven).

kalë ~ kuaj: Përgjithësisht në gegërishten veriore emri *kalë* përdoret vetëm në trajtë të shquar *kali*. Shumësin e bën në disa forma: *kali* – *kual* (Kosovë), *kval*, por edhe *kol* (në Karshiakë), *ka:l* – *kol* (në Derven, Tetovë), *kval* (Pollog).

lepur ~ lepuj: Marrë në përgjithësi, nuk qiellzorëzohet as /r/- ja fundore te shumësi i emrit *lepur*, por ose ruhet /i/-ja e moçme fundore ose merr mbaresën -a të shumësit. P.sh.; *lepër* – *lepri* por edhe *lepra* e *leprëi*, *leprâi* (në Karadak të Shkupit), *ljepër* – *ljepri* (Prilep e Krushevë), *lepri* (Pollog), *lepura* (Peshter).

b) Kundërvënia e gjatësisë së zanoreve në të folmet e Veriut

Kundërvënia zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë shërben shpesh si mjet fonologjik për të dalluar kuptimin e disa çifteve minimale fjalësh, e sidomos për diferencimin e formave morfologjike të fjalëve. Gjatësia e tipit fonologjik ruhet në sajë të mosshqiptimit të [ë]-së fundore.

Po sjellim disa shembuj nga të folmet e gegërishtes ku gjatësia ka vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve dhe i formave dallohet vetëm nga ky tipar:

1. **Gjatësia e zanoreve ka funksion leksikor** (semantik), si në çiftet *maz* ~ *ma:z* (mëz - ajkë), *çaj* ~ *ça:j* (pije e nxehtë freskuese - çaj dru), *kos* ~ *ko:s* (kosi - kosa), *boll* ~ *bo:ll* (mjaft - lloj gjarpri), *kot* ~ *ko:t* (pa dobi - dremit), *shpat* ~ *shpa:t* (shpati - shpata), *mall* ~ *ma:ll* (malli - mallëngjim), *hall* ~ *ha:ll* (brenjë - hallë-a), *shtat* ~ *shta:t* (trup - shtatë), *boj* ~ *bo:j* (trup - ngjyrë) etj.

2. **Gjatësia si mjet fonologjik ka përdorim të dendur, sidomos për dallimin e formave morfologjike.** Më të shumta janë fjalët, në përbërjen e të cilave kundërvënia e zanores së shkurtër ndaj zanores së gjatë bart me vete funksion gramatikor sesa karakter leksikor. Kështu, disa emra dallohen sipas gjinisë apo numrit, si dhe disa folje dallohen në mënyrë, kohë dhe vetë. Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve të theksuara, emrat në numrin njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë.⁶ Në të mirë të këtij konstatimi mund të sjellim disa shembuj:

⁶ Në çiftin minimal të fjalëve (një, dy, tre ...) *buk*:k ~ (një copë ose do) *buk* bëhet dallimi i një tërësie (që shqiptohet me zanore të gjatë) nga ndonjë pjesë e asaj tërësie (me zanore të shkurtër). Në shembujt (një) *gu:r* ~ (shumë) *gur* bëhet përjashtim i rregullës së përgjithshme

a) *Dallim në gjini* (mashkullore ~ femërore): *plak ~ pla:k, kunat ~ kuna:t, krushk ~ kru:shk* etj.

b) *Dallim në numër* (njëjës ~ shumë): *vesh ~ ve:sh, dham ~ dha:m, fyshek ~ fyshe:k, dyshek ~ dyshe:k, oxhak ~ oxha:k, baxhanak ~ baxhana:k, dollap ~ dolla:p* etj.⁷

c) Hunderësia e zanoreve

Për morfonologjinë e gegërishtes me interes është të shqyrtohet edhe hunderësia e zanoreve. Prania e hunderësisë së zanoreve është vërtetuar në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës, Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit, të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit, të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Gollakut, të Ferizajt, të Gjilanit, të Kaçanikut etj. Sipas tyre del se në nëndialektin verior të gegërishtes vlera fonologjike e hunderësisë së zanoreve ende ruhet, si në çiftet minimale të fjalëve:

zanore gojore ~ zanore hundore
 (djemt) *e mi ~ mĩ* “miu”
hu (une) “vetëm unë” ~ *hũ* “huri”
kam “folje ndihmëse” ~ *kām* “këmbë”
han (folje) ~ *hān* “hënë”

Përgjithësisht, në të folmen e skajshme të etnisë: të Preshevës, të Bujanovcit, të Ulqinit, të Llapit e Gollakut si dhe në të folmet lindore të gegërishtes qendrore (veçmas ato të Maqedonisë) hunderësia e zanoreve është defonologjizuar, përkatësisht aty më vështirë se nuk mund të gjejmë çifte minimale fjalësh me kundërvënie zanore gojore me zanoren hundore përkatëse.

Nga monografitë përshkruese të të folmeve gege, veçmas të atyre jashtë kufijve të Shqipërisë, lidhur me hunderësinë e zanoreve nuk mund të përftohet pasqyrë e qartë: në disa përshkrime dialektore fitohet ideja se hunderësia e zanoreve ka vlerë fonologjike, ndërsa në disa punime të tjera nuk janë sjellë dëshmi të mjaftueshme për ta pohuar ose për ta mohuar atë.

Gjatë punës sonë në të ardhmen nuk duhet të kënaqemi vetëm me konstatimin se “në një të folme gege dëgjohen apo nuk dëgjohen zanore hundore”, kur dihet se hunderësia e zanoreve është veçori e përgjithshme e dialektit Verior, por duhet analizuar vlera fonologjike e tyre, duhet përcaktuar inventari vokalik me: a) serinë e

të funksionit gramatikor të gjatësisë fonologjike të zanoreve të theksuara, sepse në këtë rast njëjësi del me zanore të gjatë, ndërsa shumësi me zanore të shkurtër.

⁷ Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009, fq. 239

zanoreve gojore të shkurtra, b) serinë e zanoreve të gjata, dhe c) serinë e zanoreve hundore për çdo të folme veç e veç.

Sido që të jetë, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera kërkojnë studime të mëtejme.

Nga ky kumtim përmbledhës si përfundim mund të thuhet se:

1. Forma e shumësit me mbaresën **-a**: *zoga, plluga, shtega, brega, varga, barka, praga, blloka, briska, peshka* ende gjallon në disa të folme të veriut, krahas shumësit me qiellzorizimin e bashkëtingëllores fundore (*zogj, shtigje, brigje, vargje, barqe, pregj, blloqe, brisqe, peshq*).

2. Në të njëjtën të folme gjallojnë 1, 2 ose më shumë forma shumësi: *breg ~ brega – bregje, brigje; bark ~ barka – barqe; bllok ~ blloka – blloqe; prag ~ praga, pragje*.

3. Në disa të folme gege shumësi bëhet me metafoni, duke i shtuar edhe mbaresën **-ni**, si *dash – desh, vllah – vlleh; kunat – kunet*, por edhe *kunet-ni, muzat – muzet dhe muzet-ni*.

4. Ruhet kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve të tipit *plak ~ pla:k, kunat ~ kuna:t, kos ~ ko:s*. Marrë në përgjithësi, emrat n[nj][s dhe ata t[gjinis] mashkullore shqiptohen me zanore t[shkurt[r, nd[r]sa shumë[s] i tyre dhe gjinia fem[rore p[r]kat[se me zanore t[gjat[.

5. Vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve në të folmet e Veriut po lëkundet. Në procesin e defonologjizimit të hundorësisë së zanoreve prijnë të folmet anësore të etnisë, veçmas ato të Maqedonisë.

6. Të folmet e gegërishtes ruajnë disa forma të vjetra të ndërmjetme të paqiellzorëzuara të shumësit të emrave. Bie fjala, mund të nxirret një përgjithësim se emrat *peshk, kungull, lepur, mashkull, ka* etj. në shumë të folme gege ende e ruajnë mbaresën e vjetër **-i**: *peshki, kungi, lepri, mashki, kie*. Kjo vërteton bindshëm pohimin se bashk[ting]lloret /q/ e /gj/ jan[p[r]ftuar n[p[r]mjet qiellzor[zimit t[prapagjuhoreve /k-/ dhe /g-/ n[n ndikimin e zanores së përparme të mbyllur /-i/. P.sh. nga forma baz[*peshk* [sht[kaluar te forma *peshq* n[p[r]mjet nj[faze t[nd[rmjetme *peshki*, pra: *peshk - peshki – peshq*. Njohja e shtrirjes gjeografike të formave morfologjike të fjalëve janë të dobishme jo vetëm për gjeografinë gjuhësore të shqipes, por edhe për historinë e gjuhës.

Vjosa OSMANI

KOHEZIONI I TEKSTIT NË PROZËN E KADARESË

Hyrje

Tekstet e Kadaresë shquhen për veçori të shumta pothuajse në të gjitha fushat e shqipes, në sintaksë, në frazeologji, në fjalëformim etj. Kadareja shquhet për stilin e vet në përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore qoftë për efekte stilistike, por edhe për “arkitekturën” e tekstit.

Së këndejmi, teksti letrar dhe gjuha në veprat e Kadaresë ka gjetur një trajtim studimor, monografik për aspekte të veçanta apo të përgjithshme në këtë drejtim.

Megjithatë, deri më tani nuk është bërë një studim i mirëfilltë dhe i plotë gjuhësor që del jashtë kufijve të fjalisë për veprën e këtij autori. Prandaj, ky punim është një përpjekje për të trajtuar pikërisht mënyrën se si ndërtohen gjuhësisht tekstet e tij, apo si realizohet lidhja gramatikore dhe leksikore midis njësive gjuhësore. Thënë më saktësisht, korpusin e hulumtimit tonë e përbën studimi i lidhjes kohezive në tekstet e Kadaresë.

Gjatë studimit kemi pasur parasysh disa synime:

1. Të hulumtohen format dhe mënyrat e lidhjeve tematike në veprën e Kadaresë.
2. Të hulumtohen mjetet e lidhjes.
3. Të klasifikohen mjetet e lidhjes.
4. Të analizohen si zgjedhje.

Vështrimi ynë ka pasur për qëllim të vërtetojë pohimin, të ngritur qysh në fillim, se tekstet e Kadaresë shquhen për përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore, jo vetëm për efekte stilistike, por edhe për “arkitekturën” e tekstit.

Laramania e mjeteve kohezive rrjedh nga laramania e tipave të ligjërimit. E meqenëse tekstet e Kadaresë jo vetëm që nuk ndërtohen mbi bazën e një tipi të vetëm e homogjen, por karakterizohen nga struktura mjaft komplekse kompozicionale dhe ligjërimore, ku narracioni, rrëfimi paralel, komentues e dokumentar, përshkrimi, dialogu dhe forma të tjera ligjërimore dalin si forma të përdorura dendur, përdorimi i mjeteve të ndryshme gjuhësore për lidhjen e sekuencave të tilla është mjaft i larmishëm dhe e shquan atë gjatë ndërtimit të tekstit.

Lidhja bëhet me mjete kohezive gramatikore dhe leksikore.

1. Kohezioni gramatikor

Kohezioni gramatikor ka të bëjë me përdorimin e mjeteve gramatikore për të lidhur mes vete njësi të ndryshme të tekstit.

Lidhja gramatikore në mes të fjalive, paragrafëve, apo sekuencave, realizohet përmes zëvendësimit, fjalëve referenciale, lidhëzave e mjeteve të tjera kohezive gramatikore.

1.1. Zëvendësimi është një nga tipat e kohezionit gramatikor, i cili realizohet kur brenda një teksti një njësi e caktuar, fjalë apo fjali e tërë, zëvendësohet me një njësi tjetër apo me një njësi zero që njihet si elipsë.

Ky tip i kohezionit paraqet një marrëdhënie gramatikore kështu që llojet e ndryshme të zëvendësimit përcaktohen më shumë nga ana gramatikore sesa semantike.¹

Në gjuhën shqipe zëvendësimi mund të jetë disa llojesh:

- Zëvendësimi i emrave, apo i fjalive të tëra me përemra
- Zëvendësimi i foljeve ose fjalive të tëra me pjesëzat *po* dhe *jo*
- Zëvendësimi i fjalive të tëra me ndajfolje të mënyrës (*ashtu, kështu*)

Ky tip koheziv është ndër më të shpeshtit në tekstet e Kadaresë. Përmes tij realizohet jo vetëm një stil i veçantë, por edhe një strukturë tekstore mjaft interesante.

Tipi mbizotërues është zëvendësimi i emrave, apo i fjalive të tëra me përemra.

P.sh.:

Disa miq të tij e këshilluan të mos merrte, sepse femra në luftë është ters. Të tjerët i thanë të kundërtën.

(“Kështjella”, fq. 10)

Zëvendësimi i fjalive të tëra me ndajfoljet e mënyrës *ashtu* dhe *kështu* është po ashtu i dendur.

P.sh.:

Thonë se këto armë të reja do të ndryshojnë këndeje e tutje natyrën e luftës dhe do të nxjerrin jashtë përdorimit kështjellat-tha kronikani.

Ashtu flitet. (“Kështjella”, fq. 32)

Në tekstet e Kadaresë e hasim mjaft shpesh edhe zëvendësimin me elipsë.

P.sh.:

Dolëm përjashta në sheshin e madh. Ishte ftohtë.

(“Kronikë në gur”, fq. 153)

¹ Halliday M.A.K., Hasan Ruqayia, *Cohesion in English*, Longman, London, 1976, fq. 31

Në këtë rast kemi zëvendësim me elipsë, meqenëse në fjalinë e dytë mungon ndajfolja e vendit "aty".

Zëvendësimin me elipsë e hasim sidomos në sekuencat e dialogut. Në këtë tip ligjërimi, zëvendësimi me elipsë përdoret me qëllim që të arrihet fuqi në shprehjen e qëndrimeve përkatëse kuptimore, të bëhet shkrimi më tërheqës dhe të përshpejtohet zhvillimi i rrëfimit.

P.sh.:

- *Domethënë ti nuk e ke parë asgjëkund në lagje?*

- *Asgjëkund.*

- *Asnjëri s'e ke parë?*

- *Asnjëri.*

- *A ka shumë puse në lagjen tuaj?*

- *Ka disa*

(*"Kronikë në gur"*, fq. 154)

Për t'u arritur një qëllim i tillë, përdoren shpesh edhe pjesëzat *po* dhe *jo*.

P.sh.

Kjo fushatë do të mbaronte dhe sido që të mbaronte ajo, ata do të vazhdonin karrierën e tyre, do të niseshin prapë nëpër marshime, do t'i ngrinin prapë çadrat përpara kështjellave të panjohura, do të ngjiteshin e do të zbritnin e prapë do të ngjiteshin në shkallët e hierarkisë shtetërore apo ushtarake. Kurse ajo jo.

(*"Kronikë në gur"*)

Siç shih, ky tip koheziv përdoret me qëllim që mendimi të shprehet më shkurt, por gjithsesi pa e vështirësuar kuptimin. Në këtë rast fjala merr përsipër të shënojë një situatë a veprim të tërë. Megjithëse njësia mungon, domethënia e tërësisë mund të kuptohet në kontekst të situatës.

1.2. Referenca është një nga tipat e kohezionit gramatikor, e cila, ndryshe nga zëvendësimi, ka të bëjë me marrëdhëniet semantike midis njësive gjuhësore.

Sipas Hollyday-it dhe Hassan-it,² në çdo gjuhë ka disa njësi të caktuara gjuhësore të cilat nuk kanë mundësi të interpretohen semantikisht vetvetiu, kështu që i referohen një njësie tjetër për interpretimin e tyre. Kohezioni fshihet në vazhdimësinë e referencës, me ç'rast e njëjta njësi hyn në ligjërim për të dytën herë.³

² Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009, 244

³ Lindita S. Rugova, *Elemente kohezive, tipike për shqipen dhe anglishten*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 27/1, Prishtinë, 2008, fq. 129

Përdoret për t'ju referuar, qoftë elementeve që gjenden të shprehura brenda tekstit (referenca endoforike), qoftë elementeve që nuk gjenden të shprehura drejtpërsëdrejti brenda tekstit, por që për interpretimin e tyre duhet t'i referohemi kontekstit situativ (referenca ekzoforike).

Në tekstet e Kadaresë lidhja kohezive nëpërmes njësive referenciale është mjaft e shpeshtë. Në kontekstin situacional shfrytëzohen mjetet përkatëse të situacionit, si: përemrat vetorë: *unë, ti, ne* dhe *ju*, si dhe elementet gjuhësore që dalin në funksione kohore. Në këtë funksion përdoren elementet kohore: *dikur, tani, atëherë*, e ndonjë tjetër, të cilat kanë përdorim të dendur dhe funksion të caktuar për ndërtimin e këtij tipi të tekstit dhe bashkë me të edhe të kontekstit.

Përemrat vetorë të vetës së parë njëjës dhe shumës: *unë* dhe *ne*, si dhe përemrat e vetës së dytë njëjës dhe shumës: *ti* dhe *ju* përdoren kryesisht pa iu referuar ndonjë njësie.

P.sh.:

- *Unë i ngatërroj vazhdimisht ato që kemi parë.*
- *Sepse tani e bëjmë rrugën së prapthi.*
- *Veç kësaj, tani e bëjmë rrugën në heshtje.*
- *Ju kujtohet kur vinim? Ç'muzikë, ç'taborre!*
- *Të merreshin mendtë nga flamurët.*
- *Ne gjithë rrugës pyesnim: si do të jetë kjo Shqipëria?*

(“Kështjella”, fq. 244-245)

Siç shihet nga shembulli i mësipërm, këta përemra nuk kanë një referues ndërtekstual, meqenëse nuk krijojnë lidhje brenda tekstit, prandaj janë tipik për lidhjen ekzoforike.

Përemrat vetorë: *ai, ajo, ata, ato*, si mjete për realizimin e referencës, janë të shpeshtë dhe të dendur në tekstet e Kadaresë. Përdoren zakonisht si përemra anaforik, për të mos përsëritur një emër që është zënë në gojë më parë.

P.sh.:

Allejbeu foli si diplomat. Ai nuk deshë të mbante ndonjë anë dhe prandaj e spostoi pak çështjen.

(“Kështjella”, fq. 37)

Jo rrallë këta përemra i hasim edhe përpara shprehjes bashkëreferuese. Kjo formë e referencës, që njihet si kataforë, shfrytëzohet për të shtuar interesin dhe kërshërinë e lexuesit, me qëllim që ta motivojë atë në vazhdimësinë e leximit.

P.sh.:

Ata fluturonin ngadalë, me krahët të shtrira dhe për një çast mua m'u duk se do të uleshin në fushën e braktisur të aeroportit, por ata papritur bënë një

kthesë dhe iu drejtuan qytetit. Krahët e tyre. Shndritën kërcënueshëm në diell. Tani ishin pothuaj mbi kokat tona, pikërisht në lartësinë prej nga binin zakonisht në pikiadë. Pasi bëne një manovrim të fundit, njëri pas tjetrit u lëshuan pothuaj pingul mbi qytet.

Kishite ardhur pranvera. Nga dritaret e katit të fundit vështroja si po vinin lejlekët.

(“Kronikë në gur”, fq. 156)

Për të realizuar aktin e referimit, përdoren dendur edhe përemrat dëftorë: *ky, kjo, këta, këto*, ndajfoljet vendore: *këtu, atje* etj., dhe ndajfoljet kohore: *tani, atëherë* etj.

Përemrat dëftore: *ky, kjo, këta, këto*, përdoren zakonisht si përemra anaforik.

P.sh.:

*Aeroplanët e hutuar ishin bërë kohët e fundit një gjë e zakonshme në qiellin e qytetit. **Këta** ishin avionë, që me sa duket, vinin vërdallë kot nëpër qiell.*

(“Kronikë në gur”, fq.123)

Ndajfoljet e vendit: *aty, këtu, atje* etj., dhe ndajfoljet e kohës *tani, atëherë* etj., i referohen njërive vendore apo hapësinore, duke u nisur nga një pikë referuese.

Për të parë se si realizohet kjo marrëdhënie në tekstet e Kadaresë po japim disa shembuj:

***Melet** ishin plot me mjegulla dimri, që rrokulliseshin gremenave si në kllapi. Partizani ishte **atje**.*

(“Kronikë në gur”, fq. 174)

- *Ku jeni ju? i pyeta.*

- *Tek ajo...ajo...**atje**.*

- *Po ti*

- *tek ...kjo **këtu**.*

*Nuk e thoshim dot fjalën **shtëpi**.*

(“Kronikë në gur”, fq. 212)

Në rastin e parë, njësia *atje*, i referohet anaforikisht njësisë *malet*, ndërsa në rastin e dytë përdoret katafora si formë e referencës, ku njësitë *atje* dhe *këtu* i referohen njësisë *shtëpi*, e cila vjen pas tyre.

Njësitë *tani* dhe *atëherë* përdoren kryesisht për të realizuar marrëdhënie endoforike.

P.sh.:

Për gjashtëdhjetë vjet rresht kishte stolitur gjithë nuset e qytetit. Tani s'mund t'i linte.

(“Kronikë në gur”, fq. 205)

Megjithatë, këto njësi i hasim shpesh edhe si elemente ekzoforike.

P.sh.:

- *Kur qëllonte kundërajrori ynë, tundej dheu.*
- *Kur?*
- *Atëherë.*

(“Kronikë në gur”, fq. 98)

Në tekstet e Kadaresë referenca realizohet edhe nëpërmjet mbiemrave ose ndajfoljeve që shprehin krahasim të caktuar, të mbështetur në ngjashmëritë ose në dallimet midis elementeve, ose nëpërmjet epiteteve.

P.sh.:

Ndërsa ndiqte me sy oficerët e lartë, ai mundohej të gjente epitetet që duhej të vinte pranë emrave të tyre në kronikën e tij, në qoftë se të gjithë ata do të tregoheshin të lavdishëm në luftë. Ata ishin si një grusht xhevahirësh që ai duhet ta hidhte me mençuri mbi gjithë atë ushtri të pafund.

(“Kështjella”, fq. 243.)

1.3. Lidhshmëria është një nga format e kohezionit gramatikor, e cila për dallim nga format e tjerat “nuk është kohezive në vetvete, por në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet kuptimeve specifike të elementeve të lidhshmërisë”.⁴ Lidhja mund të bëhet me anë të lidhëzave e mjeteve të tjera lidhëse, të cilat jo vetëm që lidhin njësitë, por shprehin edhe marrëdhënie të ndryshme, dhe garantojnë vazhdimësinë gramatikore dhe logjiko-semantike midis frazave në tekst.

Në tekstet e Kadaresë hasim një laramani të madhe në lidhjen e njësive me lidhëza e mjete të tjera lidhëse, qofshin ato bashkërenditëse apo nënrenditëse. Shumica e fjalive fillojnë me lidhëza, që shprehin raportet e nënrenditjes, por edhe me lidhëza bashkërenditëse, kryesisht shtesore.

Kur tekstet e tij karakterizohen për fjali me një strukturë më të ndërlikuar, me mbizotërim të lidhjes nënrenditëse, ato shquhen për një shkallë të lartë të vijueshmërisë logjike. Ndërkaq, ndërtimet më pak të ndërlikuara, me mbizotërim të bashkërenditjes, i hasim dendur sidomos në sekuencat e dialogut, të cilat shfrytëzohen për t'i dhënë një ritëm më të shpejtë zhvillimit të rrëfimit.

Rrëfimi, që mëton të ndjekë sistematikisht ecurinë e rrjedhës kronologjike të

⁴ Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009, fq. 245

ngjarjeve, është një nga mënyrat më të shpeshta të organizimit të ideve në tekstet e Kadaresë, prandaj shoqërohet me përdorimin e njësive kohezive që janë karakteristike për këtë tip ligjërimi, apo të lidhëzave e lokucioneve lidhëzore që shprehin marrëdhënie kohore, si: *kur, tek, ndërsa, ndërkohë, derisa, posa, pasi, sa kohë që* etj.

P.sh.:

Pastaj mori kutinë e pudrës nga tavolina, e hapi përpara robëdashambrin dhe diçka nisi të bënte me sfungjer.

Kur ajo hoqi robëdashambrin dhe u përkul të merrte ndërresat nga krevati, unë mbylla sytë. **Kur** i hapa, në trupin e saj tantellat dukeshin si ca flutura të bardha që po i uleshin radhë-radhë, në rrëzë të këmbëve, poshtë ijeve, mbi gjoks, si ato fluturat e bardha të fushave që dalin në pranverë dhe që unë i kisha ndjekur shpesh, pa mundur të zë dot kurrë asnjë prej tyre.

(“Kronikë në gur”, fq 62)

2. Kohezioni leksikor

Kohezioni leksikor ka të bëjë me zgjedhjen e përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore, semantikisht të afërta, të cilat i lidhin ose i bëjnë bashkë pjesët e tekstit. Ky tip i kohezionit nuk merret me lidhje gramatikore, as semantike, por me lidhjet e bazuara në fjalët e përdorura. Arrihet me përzgjedhje të fjalorit, duke përdorur njësi semantikisht të afërta.⁵

Kohezioni leksikor mund të realizohet nëpërmjet: dyfishimit dhe kolokimit.

Dyfishimi, i cili mund të jetë disa llojesh, përfshin:

- përsëritjen e njësisë së njëjtë leksikore (*qyteti-qyteti, kështjella-kështjella* etj.)

- sinonimet (*djall-shejtan, fëmijë- kalama, shoh-shikoj- vështroj* etj.)

- antonimet (*i madh - i vogël, atje-këtu, dritë- errësirë* etj)

- hiponiminë (ushtri-ushtar)

- metoniminë (*Ismail Kadare- “Kështjella”* etj.)

Tekstet e Kadaresë shquhen për zgjedhjen e përdorimin e këtyre mjeteve gjuhësore, të cilat i japin ligjërimin karakter të figurshëm e shprehësi të lartë, por edhe ndihmojnë për ndërtimin e një arkitekture interesante të tekstit. Prandaj, është me interes të shihet se si shfrytëzohen këto mjete gjuhësore për të arritur një qëllim të tillë.

⁵ Bardh Rugova: *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009, fq. 141

2.1. Përsëritja është një nga tipat e kohezionit leksikor e cila ka të bëjë me përsëritjen e elementeve që kanë të njëjtin referim në tekst. Ky mjet koheziv është më tipik për ligjërimin gojor, meqenëse në këtë lloj ligjërimi të folurit është më spontan dhe mundësia për t'ju shmangur përsëritjes së shpeshtë të të njëjtit element është shumë më e vogël.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se përsëritja nuk haset edhe në tekstet e shkruara, madje, në letërsi është një nga llojet kohezive më të shpeshta. Përmes përsëritjes së shpeshtë të elementeve që kanë të njëjtin referim në tekst, theksohet mendimi, tërhiqet vëmendja e lexuesit dhe në këtë mënyrë arrihet një efekt i caktuar tek ai.

Derisa zëvendësimi, sidomos ai me elipsë paraqet dinamizimin, gjallërinë e veprimeve, përsëritjet e ndalin rrëfimin, e frenojnë atë në dobi të përshkrimit.

P.sh.:

*Dy të tjerët vështronin **dritaret**. Në **dritare** dolën Nazua bashkë me nusen.*

(“Kronikë në gur”, fq. 199)

Ndërtimet e tilla, me përsëritje të shpeshtë të elementeve të njëjta, shfrytëzohen shpesh për të pasqyruar situata të tendosura, por edhe për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, e në këtë mënyrë t'i imponohet qëndrimi për një ngjarje, fenomen apo dukuri të caktuar.

P.sh.:

- *Një krah njeriu.*

- *Krahu i pilotit.*

- *Krahu i englezit. Vetëm krahu i kishte mbetur.*

- *Dora që hodhi bombën.*

- *Ah qen!*

- *I shkreti englez!*

- *Korba, mbyllni sytë!*

Aqif Kashahu e tundte vazhdimisht krahun e këputur që ta shikonin të gjithë.

Krahu e kishte dorën të hapur.

- *Paska një unazë.*

- *Shikoni një unazë në gisht.*

- *Oh unazë. Unazë në gisht.*

(“Kronikë në gur”, fq. 100)

2.2. Sinonimet janë fjalë me ndërtime të ndryshme, por me kuptim të njëjtë apo të afërt. Në tekstet letrare sinonimia u jep teksteve ngjyrimë emocionuese, pasqyron anë të ndryshme, saktëson përshkrimin, por edhe pasuron leksikon.

Në ndërtimin tërësor të tekstit këto mjete gjuhësore kanë rol të rëndësishëm

për realizimin e kohezionit leksikor. Përdoren kryesisht për të shmangur përsëritjen e shpeshtë të fjalëve të njëjta, të cilat krijojnë përshtypje të pakëndshme në tekst.

Këto mjete kohezive mund të jenë: *të plota* dhe *kontekstore*.

Çiftet sinonimike të plota, të cilat formohen kryesisht me fjalë të huaja, apo me fjalë të dialekteve dhe të gjuhës standarde, janë shumë të shpeshta në tekstet e Kadaresë.

P.sh.:

*Ishte ditë **pazari**. Nga të gjitha drejtimet fshatarët po dyndeshin drejt sheshit të **tregut**.*

(“Kronikë në gur”, fq. 21)

Këto çifte sinonimike përdoren për të karakterizuar gjuhën e personazheve, për të pasqyruar atmosferën, rrethanat, apo mjedisin në të cilin zhvillohet ngjarja.

Ndër sinonimet e shpeshta janë edhe ato që dallojnë nga nuanca kuptimore.

P.sh.:

- *Po aeroplanin a do ta **shohim** ? – pyeta*

- *Do ta **shikojmë**, - tha gjyshja. - E kanë vënë në mes të dhomës së madhe....*

- *Po nga afër a do ta **shoh**?*

- *Edhe nga afër do ta **shohësh**, vetëm mos bëj budallallëqe. Mos ngrit gjë me dorë.*

***Vështrova** duart. Ato ishin të hutuara më keq se unë. I futa në xhepa.*

(“Kronikë në gur”, fq. 95)

Në këtë rast shohim se si mjete kohezive përdoren njësitë: *shoh*, *shikoj* dhe *vështroj*, të cilat janë të afërta nga kuptimi, por që nuk përputhen në të gjithë përbërësit e tyre kuptimor. Këto njësi dallohen nga nuanca kuptimore, meqenëse njëra nga to shpreh një nuancë, kurse njësia tjetër shpreh një nuancë tjetër kuptimore.

Sinonimia realizohet edhe nëpërmjet fjalëve e njësive frazeologjike.

P.sh.:

*Ju nuk i **kuptoni** këto gjëra, se jeni akoma të vegjël, - tha Isai – Mos pyetni më mirë.*

*Ata seç thanë midis tyre në gjuhë të huaj. Gjithmonë kështu bënë që në të mos **merrnim vesh** çfarë flisnin*

(“Kronikë në gur” fq. 43)

Për të ndërtuar raporte të tilla përdoren shpesh edhe sinonimet kontekstore. Këto çifte sinonimike nuk janë të këmbyeshme në çdo kontekst, meqenëse nuk përputhen në të gjithë përbërësit e tyre kuptimorë, prandaj dalin si sinonime vetëm në kontekste të caktuara.

P.sh.

- Vetëm **krahu** i kishte mbetur.

- **Dora** që hodhi bombën.

(“Kronikë në gur”, fq. 100)

2.3. Antonimet janë mjete kohezive, të cilat po ashtu kanë të bëjnë me raportet kuptimore midis njësive leksikore. Mirëpo, ndryshe nga sinonimet të cilat dy ose më shumë forma lidhen me të njëjtin kuptim, antonimet janë fjalë me forma dhe kuptime të ndryshme.

Fjalët antonime përdoren në ligjërime e në stile të ndryshme, e sidomos në letërsinë artistike. Si mjete të fuqishme shprehjeje, këto mjete kohezive i hasim në role të ndryshme leksikore. Përmes këtyre njësive shkrimtarët ndërtojnë antiteza, duke i dhënë shprehjes forcë e qartësi dhe duke e bërë ligjërimin më të fuqishëm.

Antonimet mund të jenë: *të plota dhe kontekstore*.

Në tekstet e Kadaresë, ndër më të shpeshtat janë antonimet e plota.

P.sh.:

Partizani ishte atje. Të gjithë ishin këtu.

(“Kronikë në gur”, fq. 174)

Nga këtë rast shohim se çiftet antonimike janë të plota, meqenëse kundërvihen plotësisht në të gjithë përbërësit e tyre.

Përveç fjalëve me kuptime plotësisht të kundërta, si mjete kohezive përdoren edhe çifte fjalësh kundërvënia e të cilave bëhet vetëm brenda kontekstit.

P.sh.:

Qetësia është e gënjeshtërt. Luftën e kemi në prak.

(“Kështjella”, fq. 35)

Çiftet e këtilla antonimike krijojnë kundërvënie kuptimesh të figurshme vetëm brenda kontekstit, ndërsa jashtë kontekstit nuk arrijnë një gjë të tillë.

Lidhja antonimike realizohet edhe nëpërmjet fjalëve e njësive frazeologjike.

P.sh.:

Ai mendoi se ndoshta i kishte ardhur koha që te kalonte dite me te qeta në shtëpinë e tij. Jo, se ishte i shkuar nga mosha. Ai ishte akoma i ri dhe i fortë

...

(“Kështjella”, fq. 12)

Raportet antonimike me fjalë të formuara me parashtesa me kuptim të kundërt: *mos-*, *pa-*, *jo-*, kundër- etj, janë po ashtu të shpeshta.

P.sh.:

Qyteti ynë ishte i okupuar. Kjo do të thotë se në këtë qytet kishte ushtarë të huaj. Këtë unë e dija, por ajo që më mundonte ishte tjetër gjë. Unë nuk e kuptoja dot se si mund të jetë një qytet i paokupuar.

(“Kronikë në gur”, fq. 25)

Gëzimi ishte rreth e rrotull tij, mjaftonte që të zgjaste duart për ta prekur, megjithatë diçka e pengonte të vendoste një kontakt me të. Ç’ke kështu i tha vetës.

Asgjë, mendoi pas pak. Dhe papritur, për një grimë ju duk se e kapi shkakun e mosgëzimit.

(“Pashallëqet e mëdha”, fq. 27)

Dihet se kundërvënira me këto parashtesa është më e dobët, prandaj shfrytëzohet vetëm në situata të caktuara, në rastet kur dëshirohet të zbutet toni i ligjëritimit.

2.4. Metonimia është po ashtu një nga tipat për realizimin e kohezionit e cila ka të bëjë me raportet kuptimore midis njësive leksikore. Ky tip koheziv nënkupton shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë apo i rëndomtë, me ç’rast në vend të një fjale që ka një kuptim të caktuar përdoret një fjalë tjetër, gjegjësisht një kuptim tjetër.

Lëvizja kuptimore me metonimi bëhet duke u mbështetur në raporte të caktuara logjike. Pra, kuptimi i fjalës së dytë duhet të ketë lidhje logjike me kuptimin e fjalës së parë. Ky tip i kohezionit përdoret mjaft shpesh në tekstet letrare, kryesisht kur dëshirohet të thuhet diçka jo në mënyrë të zakonshme, por në mënyrë më të fuqishme, më ndikuese dhe më tërheqëse.

P.sh.:

- *Ku e di ti se unë kam raki?*

- *Që ke raki nuk jam i sigurtë, por, që ke pirë, duket sheshit- tha jeniçeri...*

Kur Sadedinit iu duk se u futën në hije, ai i zgjati shishen të posanjohurit. Jeniçeri vështrroi njëherë rreth e rrotull dhe, pasi i ktheu shpinën rrugës, curi shishen në gojë.

(“Kështjella”, fq. 42)

Në rastin e mësipërm shihet se kemi shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë, meqenëse në fjalinë e dytë përdoret fjala që emërton mbajtësen në vend se të përdorej fjala që emërton përmbajtjen.

2.5. Hiponimia është lloj i kohezionit leksikor, e cila nënkupton përfshirjen e një termi të veçantë brenda një termi më të përgjithshëm. Me fjalë të tjera, konceptet më të përgjithshme, që i referohen një klase më të madhe apo më gjithëpërfshirëse,

përfshijnë brenda vetes konceptet më të veçanta.

Këto njësi kanë disa tipare më specifike, tipare këto që nuk janë të përbashkëta për të gjitha njësitë. Prandaj, ato përdoren për të dhënë një shkallë më të lartë informacioni.

P.sh.:

*Në mbrëmje **ushtria** nuk kishte mbërritur akoma krejt. **Ushtarët** vazhdonin të arrinin njëri pas tjetrit.*

(“Kështjella”, fq.6)

2.6. Kolokimet janë mjete kohezive, të cilat krijojnë relacione leksiko-semantike midis njësive leksikore. Marrëdhënia që krijohet përmes kolokimeve është “jo e drejtpërdrejtë, më e vështirë për t’u definuar dhe mbështetet në asociacionet që krijohen në mendjen e lexuesit.”⁶ Kjo do të thotë se për interpretimin e tyre është i nevojshëm inventari i njohurive dhe i përvojave që kemi fituar nga jeta për një fushë të caktuar. Prandaj, sa më shumë që kemi njohuri për ato fusha, aq më lehtë e kemi t’i definojmë marrëdhëniet në mes të njësive gjuhësore.

P.sh.:

*Në **kampin** e tyre ka rënë qetësia. **Ushtarët** gjithë ditën vijnë vërdallë ose merren me rregullimin e kampit.*

(“Kështjella”, fq. 91)

Duke u mbështetur në të gjitha këto tipare, mund të përfundojmë se gjuha e tekstit letrar të Kadaresë, në të vërtetë, ka veçori apo karakteristika gjuhësore të veçanta. Në tekstet e tij raportet gramatikore dhe leksikore midis njësive gjuhësore janë të ndryshme e të llojllojshme, e në përputhje me tipat e ligjërimit.

Ato shquhen për një rrjedhshmëri të qartë, e cila realizohet falë njohurive të autorit për përdorimin e mjeteve me të cilat realizohet kohezioni.

⁶ Shih: Gazeta “Pavarësia”, Prishtinë, 11 shtator 2004, fq. 16

Xhavit BEQIRI

PIKËPAMJET E CAMAJT PËR STANDARDIN E SHQIPES

Veprimtaria gjuhësore e Martin Camajt paraqitet me mjaft interes për studimet albanologjike. Mirëpo, për shkak se Camaj jetoi gjatë jashtë vendit, kjo veprimtari nuk njihet sa duhet. Madje, meqenëse vepra e tij kryesore në fushë të gjuhësisë, “Gramatika shqipe” (1984), është botuar në gjuhë të huaj (anglisht) dhe nuk ka pasur shtrirje të gjerë si referencë në studimet albanologjike, mendimi i Camajt për shumë çështje të shqipes ka mbetur i panjohur nga qarqet e studiuesve dhe të lexuesve.

Kësodore, mund të thuhet se i panjohur ka mbetur deri-diku edhe qëndrimi i tij për standardin e gjuhës shqipe, ndonëse Camaj, më se një herë, i ka shfaqur hapur pikëpamjet e tij për këtë çështje.

Ky punim synon t’i sheshojë pikërisht disa nga pikëpamjet e këtij studiuesi për standardin e gjuhës shqipe, të cilat ai i ka paraqitur veçmas më 2 dhjetor 1991, në Universitetin e Salerno-s, ku lexoi kumtesën “*Mërgimi i gjuhës*”¹, e cila është si një lloji çelësi për t’u (ri)njohur me disa pikëpamje të tij për gjuhën shqipe dhe standardin e saj.

Që në fillim, Camaj shfaqte shpresën se “prej përmbajtjes ka me u kuptue çka don me shprehë titulli i kumtesës”, për të cilën ai vetë thoshte se është “mâ e shkurta qi unë kam lexue deritash përpara një auditori kaq të meritueshëm”. Ai sikur synonte ta përgatiste dëgjuesin se “shumë prej gjanave qi kenë me ndigjue bâjnë pjesë në qëndrimin mâ të thellë qi unë kam mundë me mbajtë ndaj ngjarjeve qi i kanë ra hise gjuhës time”.

I ndërgjegjshëm se në rastin e tij mund të pikasej fakti se të folurit për gjuhën (e vet) nuk mund t’u shmangej fort lehtë ndjenjave (çka nuk i bën mirë një studimi të ftohtë shkencor), Camaj e krahason gjendjen e tij me atë të shkrimtarit francez Goerges-Arthur Goldsmith, të cilin e citon të ketë thënë (për gjuhën e vet amtare): “Gjuha amtare âsht në fund të fundit kumbimi i formave qi fëmija zbulon për herë të parë. Gjuha amtare âsht frymëmarrja e veçantë e trupit njerëzor, âsht pragu për te elementat e hapsinës”².

¹ Gazeta e cit., po aty.

² Po aty.

Camaj vë në dukje se “ky çansim nuk është në kundërshtim me at’ çka ndërmer puna hulumtuese shkencore, historike (diakronike e sinkronike), qi në fazen e tashme të shqipes zhvillohet në dy drejtime (është viti 1991, v.j.):

A. si gjuhë natyrale e ndame në degzime dialektore e në kontakt me gjuhët tjera qi e rrethojnë.

B. si gjuhë artificiale, në t’cilën përdoren mjete kufizuese të dhunshme, krejtsisht në kundërshtim me zhvillimin e natyrshëm të vetë gjuhës.

Kur Camaj po e lexonte kumtesën e tij, Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 gati po mbushte dy dekada. Ai nuk mund ta tejkalojë këtë fakt, përkundrazi merret drejtpërdrejt me të, si dukuri (jashtë)gjuhësore, shoqërore e politike.

“Ka njiuzet vjet qi në Shqipni po vazhdon proçesi i normalizimit të gjuhës, i cili nuk merr parasysh randësinë e dialekteve e të historisë, ase të dokumentave si: dorëshkrime, tekste letrare etj. Më lejoni, tashti, me ju pru disa të dhana historike të nevojshme. Për me kuptue mirë strukturat e këthella historike të gjuhës shqipe është e domosdoshme me njohtë marrdhânjët qi ajo ka pasë me latinishten e vonshme, gjuhë me të cilën ka pasë nji periudhë afrimitetit. Llogaritet qi kontakti me latinishten të ketë fillue gjatë shekullit II p. Kr.”³

Camaj besonte se duke punuar në mënyrë paralele mbi shndërrimet që kanë ndodhur në të dyja gjuhët mund të rindërtohej historia e shndërrimeve të tingujve (Lauterverschiebung). Për më tepër, ai pohonte se duke u nisur prej këtyre shndërrimeve mund të shestoheshin rishtas trajtat që kanë përplotësuar më vonë sistemet gramatikore të shqipes. E, ndër këto rindërtime gramatikore, Camaj kërkonte që të merreshin parasysh edhe “tharmet e pëmbrendshme të gjuhës shqipe, tue i lidhë gjithmonë edhe me zhvillimet qi i kanë rranjët te baza indoevropiane”⁴.

Camajt vlerësonte se periudha prej shekujve IX – X pas Krishtit deri te shekulli XVI përfaqëson një fazë shumë të rëndësishme, atë që sot njihet si faza e “shqipes së vjetër”. Në paragrafin e gjashtë të këtij punimi, Camaj flet për *një teori me baza shkencore*, simbas së cilës shumë pjesë të Ungjillit e të Dhjatës së Vjetër të përfshira në “Meshar” të Buzukut, i përkasin një periudhe para vitit 1555. Këto pjesë, të përkthyer nga liturgjia greke, Camaj i shihte si tekste me një gjuhë e me një stil të ndryshëm në krahasim me tekstet që kishte përkthyer vetë Buzuku, ndërsa në tekstin e tij shihte *nji gjuhë koherente*. Kjo, me sa duket, lë të kuptohet se edhe Camaj, si shumica e albanologëve deri më sot, besonte për ekzistencën e një tradite të shkrimit shqip para kësaj veprë.

Në kohën e Buzukut, sipas Camajt fillojnë të duken “diferencimet ndërmjet gegnishtes, qi nuk e ka fenomenin e rotacizmit, dhe tosknishtes qi i nënshtrohet këtij

³ Po aty.

⁴ Po aty.

fenomeni”⁵. Këtë fazë të zhvillimit të shqipes, ashtu siç kishin bërë studiuesit gjermanë qënë shekullin XIX, e çmon si: Gemeinalbanisch (shqipja e përbashkët)..

Enver Hoxha nun i “gjuhës kombëtare”!

Copëzimi i dy degëve gramatikore të shqipes (Zersplitterung) nis pas pushtimit turk, në shek. XVI. Ky copëzim sjell edhe përbrenda vetë dialekteve krijimin e të folmeve të reja.

“Gegnishtja ka fatin me i pasë të dokumentueme të gjitha këto struktura gramatikore. Por, këto venome (privilegje), dialektologjia e sotshme shqipe nuk i ka shfrytzuë aspak e aq më pak ata qi gjinden në kry të procesit të krijimit të normës së saj”⁶, vërente Camaj, për të vijuar fill se *kështu, në njëzet vjet (1952-1970), është krijuë në Shqipni një gjuhë letrare, të cilën Enver Hoxha, si nun i saj, e pagzoi tue e quejtë “gjuha kombëtare”*.

Këtu, Camaj shfaq hapur mospajtimin e tij ndaj zhvillimit të procesit të krijimit të normës gjuhësore, meqë “nuk u përfill historia, pra, tradita e gjuhës shqipe, e cila, si u pà ma sipër, ka një randësi të madhe”⁷. Kundërshtim i Camajt ndaj ecurisë së këtij procesi bazohej në këtë argument: “Rruga e mënyrës së krijimit të normës së “gjuhës kombëtare” është vendosë vetëm prej politikanëve, prej një grupi të Byrosë Politike me prejardhje prej jugut të Shqipnisë. Kundërshtimet e shkencëtarëve, ndërmjet të cilëve bënë pjesë dy lavrues të vjetër të kësaj gjuha, shqiptari Aleksandër Xhuvani e gjermani Max Lambertz, nuk patën asnjë efekt. Lambertz-it i gjegji Enver Hoxha vetë, tue i thanë: “Ky është një vendim politik!”. Absurditeti i kësaj politike u kritikua për vjet me rradhë prej Arshi Pipës, ndër shkrime qi tash së fundi janë përmbledhë në një vëllim prej rreth treqind faqesh prej Columbia University Press, me titull: *Politics of Language in Socialist Albania*”⁸.

Ndoshta është vetëm një ko incidencë, por pikërisht termin absurd e përdorte edhe albanologu Robert Elsie, në një intervistë shënë emisionit “Shqip” të televizionit Top Chanell të Tiranës, e cila u botua (me shkurtime) në shtypin e Prishtinës⁹. Në fakt, Elsie epitetin *absurd* e përdor në kuptim shumë më të rëndë se Camaj. Derisa Camaj e cilëson si absurde politikën shqiptare të asaj kohe, e cila e përcaktoi rrugën që duhej të ndiqej për krijimin e normës së “gjuhës kombëtare”, Elsie, duke iu përgjigjur kureshtjes së gazetares se si e shihte ky, si i huaj, Shqipërinë e viteve shtatëdhjetë, thotë prerazi: “Kishte shumë gjëra, ishte një vend absurd, gjithë vendi ishte absurd, por njerëzit e merrnin seriozisht. Nuk e di se deri

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

⁷ Po aty.

⁸ Gazeta “Koha ditore”, Prishtinë, 9 shkurt 2012, fq. 22.

⁹ Gaz. “Koha ditore”, po aty.

në çfarë mase i merrnin seriozisht vetë njerëzit, por gjithsesi e kuptonin që jetonin në një realitet tjetër”¹⁰.

Një i huaj dhe një shqiptar i mërguar bashkohen në një pikë, në konstatimin se sistemi politik Shqipërisë së asaj kohe ishte absurd. Në rrethana të tilla, absurde pra, si mund të mendojë dikush se i ashtuquajturimi proces i krijimit të normës së “gjuhës kombëtare” mund të ketë qenë i drejtë a demokratik. Në Shqipëri vendoste sall diktatori, të cilit duhej t’i shërbenin të gjithë të tjerët. Ata që nuk i shërbenin, përfundonin në Burrel, ose edhe me keq, e pësonin si “reaksonarë”, ashtu siç e pësoi kleri katolik i Shkodrës. Sa për ndikimin e Kosovës, as që mund të bëhet fjalë. Shqiptarët në Kosovë, po edhe në hapësirat e tjera të ish-Jugosllavisë, e kishin ekzistencën në fije të perit, prandaj as që mund t’u shkonte mendja të kundërshtonin çfarëdo që vinte nga “shteti amë”. Pra, në punë të normës, Shqipëria/Enveri mati e preu vetë, ndërsa “kosovarët” dhe shqiptarët e tjerë vetëm duhej ta vishnin kostumin që u jepej sipas shijes së “rrobaqepësit”.

“Gjuha e fituesit – gjuhë e shtetit!”

Në kumtesën e tij, Camaj pohonte se *teoria themelore qi e drejtoi procesin e ndjekur në zbatimin e normës, qi në të vërtetë âsh vû me dhunë, i përket Stalinit*. “Gjuha e fituesit përgjithësohet e bâhet gjuhë e shtetit. Hoxha, në vend të gjuhës, imponoi praktikisht dialektin e vet, ase mâ mirë, një prej nëndialekteve të tosknishtes lindore. Gjuhëtarët shqiptarë duhet t’i bindeshin vetëm urdhrave qi vijoshin prej nalt. Ecunija mbështetej në mënyren induktive, pa përfillë traditen.”¹¹, - thoshte Camaj..

Se në këtë proces pati vetëm diktat dëshmojnë edhe faktet në vijim të Camajt, të cilat po i radhis, ashtu siç i ka radhitur ai:

A. *Çdo variant tjetër gjuhsor letrar u ndalue, në veçanti ai i veriut, qi si e pamë, âsht mâ i vjetri e mâ i pasuni me tekste e âsht mâ i përdoruni prej shumicës së popullit shqiptare. U pengue edhe zhvillimi i tosknishtes tradicionale letrare, në veçanti përbâsja e saj perëndimore, qi âsht zhvillue në hapsinën prej bregut shqiptar të Jonit deri në Peloponez e prej aty bashkohet me zonat arbëreshe të Italis jugore. Këtu âsht trashigue traditë letrare e zgjedhun e tanë sqimti, e ngjashme me klimen e butë mesdhetare. Gjithë kjo zonë ka karakteristika gjuhsore të përbashkëta qi e dallojnë ketë të folme prej tosknishtes perëndimore.*

B. *Për gati një gjysë shekulli para ardhjes së stalinizmit, tre variantet letrare janë zhvillue lirshëm në një simbiozë harmonike. Weigand-i, Nahtigal-i, Pekmezi, ky i fundit ishte një shqiptar me nënshtetësi austriake, Xhuvani e deri edhe autorë veriorë si Fishta e Gurakuqi (Karl), këshilluen qi unjisimi i gjuhës zyrtare të*

¹⁰ Gaz. “Pavarësia”, po aty.

¹¹ Alfred Çapaliku, “Ungareti dhe Camaj”, vështrim i botuar në revistën *Jeta e Re*, nr. 1, 1996, fq 89

mbërrihet nëpërmjet “avitjes” së dy gjuhëve letrare kryesore, gegnishtes dhe tosknishtes. Kjo gjâ duhet me u krye jo në mënyrë të vrazhdë, por në një kohë të gjatë. Në të vërtetë, deri në 1994, shoqija shqiptare zhvillohet në një reth simbioze familjare, kulturore e gjuhsore. Në veçanti në Tiranë qenë mâ të ndieshme kontaktet gjuhsore ndërmjet atyne qi përdorojshin dialekte të ndryshme. Ky afrim ishte dashtë me u ndjekë me kujdes për me e gjetë rrugën mâ të drejtë me punue për unjimin e gjuhës. Këta janë treguesit qi procesi i krijimit të një norme të udhëhequn prej parimesh të drejta, ishte dashtë me ndjekë. Por, kjo gjâ nuk qe e mundun, mbasi gjuhësia shqiptare, fatkeqsisht, nuk kishte bazat e veta të zhvilluese në mënyrë të mjaftueshme.

C. *A ka mundësi sot për me ndreqë gabimet e bâme? Kishe me thanë se po. Ne kemi sot shumë metoda dhe përvoja në fushën e gjuhësisë moderne. Do të ishte e këshillueshme për çdo komb qi, përpara se me ia hî punës për krijimin e normës themelore të gjuhës së vet, të mbante parasysh zhvillimin gjuhsor. Âsht e domosdoshme puna parapërgatitëse: duhet mbajtë mend qi për secilën pjesë të gramatikës ekzistojnë monografi të plota qi s’duhen lanë mbas dore.*

D. *Âsht e domosdoshme qi sot në Shqipni të zhvillohet një shkollë e re gjuhsore.*

Tue përfundue, uroj qi edhe në Shqipni të ketë ardhë koha në të cilën nuk kanë me qenë politikanët ata qi do të vendosin për çashtjet gjuhsore dhe letrare. Qi çdo vendim, në veçanti ata qi i përkasin tanë Kombit, të merret në përputhje me vullnesën e shumicës së popullit: idealja kishte me qenë një pëlqim i gjithanshëm, por kjo âsht e tepërt sot për sot.

* * *

Dihet tanimë botnisht: sugjerimet e Camajt gjuhësia shqiptare nuk i mori parasysh fare, ashtu siç nuk i mori as ato të Lambertz-it, Xhuvanit, Rizës e ndonjë zâni tjetër të paktë, që kishe guxim me u dëgjue së gjalli, në kohën *kur hidheshin themelet* e normës së “gjuhës kombëtare”. Ky fakt mbase e nxiti studiuesin Alfred Çapaliku të shkruante: “Me mundësitë shprehëse të dialektit gegë (sprovuar nga eposi i kreshnikëve gjer tek Mjeda, Fishta, Migjeni), me një harmoni të brendshme origjinale, Camaj e nisi vjershërimit 20 vjet para Kongresit të Drejtshkrimit dhe e mbylli 20 vjet pas tij. Ai i kushtoi atij kongresi atë vëmendje që një kalimtar plot shëndet i kushton orarit të një klinike, ku ai s’do të operohet kurrë.

Ky veprim në dukje i vetvetishëm, por në thelb i studiuar gjer në imtësi, e shpëtoi Martin Camajn nga dhimbjet e kota, por edhe Shqipërisë i shpëtoi një poet *sui generis*”¹².

¹² Aa, Nn, *Historisë së letërsisë shqipe* [1959], Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, Prishtinë, 1975, botim i tretë, fq. 18. Të gjitha citimet nga ky libër në këtë punim i referohen këtij botimi.

Besnik RAMA

BASHKËJETESA E DY DIALEKTEVE TË SHQIPES NË SHTYPIN SHQIPTAR TË FILLMSHEKULLIT XX

1. HYRJE

Kushtet historiko-shoqërore të fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX i hapën shtrat edhe lulëzimit të shtypit shqiptar, kryesisht si pjesë e veprimtarisë atdhetare, por dhe kulturore, të shoqërive e shoqatave brenda e jashtë vendit. Siç shkruan Kostë Çekrezi, në kohën e turqve të rinj “Gazeta dhe libra shqip zunë të botoheshin në çdo vent, shkolla shqip u-hapnë, dhe një dëshirë e madhe për përparim u ngjall ndër shqiptarët, kështu që dita e lirisë së plotë, nga ana tjetër, s’ish e larkme”¹. Intelektualë me zë, si: Faik Konica, Kostë çekrezi, Mithat Frashëri, Mihal Grameno, Mehmet Frashëri, Nikolla Ivanaj, Jorgj Mexsi etj., drejtonin gazeta, tematika e të cilave sa vinte e bëhej më e pasur. Kuptohet që faqet e gazetave mbusheshin me problemet që ishin në qendër të vëmendjes: zhvillimet e vullshme politike para e pas shpalljes së pavarësisë, marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët e më gjerë, roli i qeverive dhe i intelektualëve në zgjidhjen e problemeve kombëtare etj., por nuk mungonin kolona e faqe ku trajtoheshin edhe probleme ekonomiko-sociale.

Karakteristikë është se botuesit, që në numrat e parë të gazetës, e njihnin lexuesin me përmbajtjen që do të kishte organi i tyre. Kështu për shembull, gazeta “Dielli”, që botohej në Boston, në faqen 4 të numrit 1, datë 27 shkurt 1909, bën me dije se ajo do të dalë një herë në dy javë, pastaj do të nisë të dalë rregullisht çdo javë. Pajtimi ishte 3 dollarë në vit, për ata që donin të marrin vetëm gazetën, dhe 4 dollarë për ata që donin të jenë dhe anëtarë të Shoqërisë (Shoqëria “Besa-Besën”, botuesja e gazetës “Dielli”). Fillimisht, gazeta dërgohej vetëm dy herë në Amerikë dhe katër herë jashtë, si shembull për të gjithë ata të cilëve u dinin adresat. Më vonë, gazeta u dërgohej vetëm atyre që paguanin. Nuk botoheshin reklama pa pagesë. Gazeta, në numrin e parë të saj, njoftonte se nuk do të botonte as vjersha.

Për të vërejtur të përbashkëtat dhe ndryshimet me shqipen e sotme, paragrafin e mësipërm po e paraqes fjalë për fjalë si “Dielli”: ““Dielli” do te dale nje herë me dy jave, pastaj do nise te dale per jave më rregull. Pajtimi eshte 3 dollare ne mot, per

¹ Çekrezi, K. A., *Histori e Shqipërisë*, Shtypshkronja e DIELLIT, Boston 1920, faqe 189

ata që duan ta marrin vétëm gazéten, dhé 4 dollare per ata qe duan te jéne dhé anetare te Shoqerise (Shoqëria “Besa-Besën”, botuesja e gazetës “Dielli”).

Gazeta do dergohét vétëm dy hére n’ Amérike dhé kater hére jashte si shembell ner te tere sa u dime dréjtimét, pastaj do pritét dhé do dergohét vétëm ner ata qe paguajne. Réklama nuke botohén pa pagim. Viérsha s’ botohén.”² Gazeta “Telegraf”, që nisi të botohet më 11 gusht 1926, shënonte se “Boton Çdo që Vlen dhe Munt të Botohet”³.

Siç do ta trajtoj në vijim, stafet botuese dhe bashkëpunëtorët e shtypit të periudhës që kam objekt studimi, kishin platforma të qarta për t’u paraqitur sa më denjësisht para lexuesve të tyre dhe para mbarë opinionit publicistik e letrar. Aspekt më vete ishte gjuha që do të përdornin në funksion të përcjelljes te çdo shqiptar të interesuar të informacioneve jo vetëm gazetareske, po të shumëllojshme.

2. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Për të krijuar një koncept lidhur me bashkëjetesën e dy dialekteve të shqipes në shtypin shqiptar të fillimshekullit XX dhe mirëkuptimin mes shqiptarëve, kryesisht intelektualë, të krahinave të ndryshme që botonin gazetatat e atëhershme, si dhe për të nxjerrë në pah pastërtinë dhe kulturën gjuhësore në shtypin e asaj kohe, etikën dhe respektimin e gjuhës dialektore të shkruesve, kam shfletuar rreth 700 faqe të gazetave “Dielli”, “Kombi”, “Besa”, “Shpnesa e Shcypeniis”, “Lidhja ortodokse”, “Flamuri”, “Telegraf” dhe “Adriatiku”, të botuara në vitet 1908 deri 1938. Krahas gazetave, kam shfletuar dhe tre libra të K. A. Çekrezit, botime të Federatës Panshqiptare “Vatra”⁴. Në këtë material hulumtues unë bëj dhe një qasje vlerësuese të gjuhës së përdorur atëherë, krahasuar me normën sot.

Objekt të studimit kam fjalorin e përdorur në gazeta e libra, respektimin nga stafet botuese të veçorive dialektore që përmbajnë shkrimet e ardhura nga krahina të ndryshme, kujdesin e botuesve për të ruajtur etikën profesionale në rastet e polemikave dhe replikave të ndërsjella, respektimin e alfabetit dhe qëndrimin ndaj ndikimeve nga gjuhët e huaja, ndërtimet morfosintaksore, si dhe normën drejtshkrimore e pikësimin, krahasuar me rregullat e standardit të shqipes së sotme.

3. BASHKËJETESA E DY DIALEKTEVE

Është për t’u vënë në dukje se shtypi shqiptar i fillimshekullit XX, kudo ku botohej dhe nga cilido botues, ngado që të ishte ai, shpalos gjuhën, të folmen e

² Dielli, nr. 1

³ Telegraf, nr. 1

⁴ Çekrezi, K. A., *Histori e Shqipërisë*, Shtypshkronja e DIELLIT, Boston 1920; Çekrezi, K. A., *Histori e vjetër*, Shtypshkronja e DIELLIT, Boston 1921; Çekrezi, K. A., *Historia Mesjetare e Evropës*, Shtypshkronja e DIELLIT, Boston 1920

komunitetit të cilit i përkisnin botuesit si dhe autorët e artikujve e të korrespondencave të ndryshme. Gjuha e krahinës së Korçës, p.sh., mbizotëron në faqet e gjithë numrave të gazetave që botoheshin në Korçë, toskërishtja bie shumë në sy në gazetën “Dielli” (Amerikë), kurse gegërishtja vjen më e gjallë në gazetën “Shpnesa e Shcypeniis” (Romë, Itali).

Pas miratimit të alfabetit shqip nga Kongresi i Manastirit, 1908, gazetat përdorin këtë alfabet. Gazeta “Dielli”, që në numrin e parë zotohet se do të respektojë dhe do të përdorë alfabetin e miratuar, dhe, për të qenë korrekt me lexuesit e saj, në numrin 3 të datës 12 mars 1909, në faqen 1, stafi botues bën një shënim ku u kërkon ndjesë lexuesve se nuk ka mundur ta shtypë plotësisht gazetën me shkronjat e Kongresit, ngaqë ë-të me dy pika nuk i kishte bërë gati kompania ku i kishte porositur, dhe premton se, që nga numri 4 e në vazhdim, gazeta do të shtypet sipas abecesë së Kongresit. Megjithatë, në këtë gazetë, në vitin 1920 e në vazhdim, si dhe në tre librat e sipërpërmendur të K. A. Çekrezit, në vend të ë-së përdoret një shkronjë tjetër (ë latine), kurse në vitet ’30 nuk e gjejmë të përdorur ë-në⁵. Në vend të saj, “Dielli” përdorte e-në⁵.

Gazeta “Lidhja ortodokse” (Botues Mihal Grameno), një pjesë të shkronjave i ka nga greqishtja e latinishtja etj. (, , , , , , **õ**, ,).

Gazeta “Shpnesa e Shcypeniis”, që botohej në shqip e në italisht nga Nikolla Ivanaj në Romë, Itali, një pjesë të shkronjave i merrte nga italishtja (**gh** – gj, **gh** – q, **c** – k, **ch** – q, **gn** – nj, **ch** – ç), siç duket për t’iu përshtatur shqiptimit sipas fonetikës së italishtes. Po paraqes një shembull konkret, duke e cituar nga numri 1 (1908) i kësaj gazete: Në kryeartikullin “Si ghindéna sod. – Anmict ne shpii – Atedhéu ne rrëzik!”: “Ghith bota é kuptou édhé flétoresija é sajna é difton chi kjo hekuroré â’ ushtrijaké é jo trëgtaré... kjo i duhét abolla chi te mundét sheim mé é dzhvéshe, dzbathe é mandéj hjéké édhé lekuren ati popullit te shkreté ! sépésé, si dihét, sod per sod, perpara sé dikushi do t’ é marrin ndo ’i dhée (vënd) te rii, lypét chi t’ é shtijén ne dore ékonomikisht, t’ é rjepin é chgnérzójne saa most e mundét mââ kurr mé é chue kryét as mé i raa ndermënd per kombesii, lirii é véteurdhenim...”

Në kryeartikullin “Nji letër prej Kosovet. Komiteti i Zhon-Turqve”, gazeta “Dielli” e datës 15 prill 1909, boton shkrimin e një autori nga Shkupi me pseudonimin Benjamini. Në paragrafët e këtij shkrimi vërehet qartë shkrimi në gegërisht. Po veçoj disa përdorime: “tuj i ken qi...”, “...âsht përbamun...”, “me këtë parën letrën teme t’u tregoj këndonjësve kësaj flet se qysh e si âsht bâ...”, “Për me ja u tregue...”, “âsht nji shoqëni njerëzsh prej mâ të poshtme e mâ të ligjve qi jan...”, “...âsht i pështiellun prej njatyne qi kan ditë mâ mirë me çvesh botën e me bâ të liga...”, “S’po thom rexhimit vjetër, se rexhim s’kemi ndrue e konstitucion me emën kemi”, “Nji ky âsht dreqi qi na polli në votër e i cili ndë dhë ton në Shqypëni

⁵ Shih, p.sh., Dielli, nr. 5436, e premte, 12 shkurt 1937

mundohet sa më fort më i lshue ranjat e helmisna, e me mbyllet këto gjorin kombin ton qi nuk shfaq as di prej nga e ka vërbue fanatizmit e pa-ditunia. Nji her tjerë ju shkruaj përmes punës e intrigat e xhemietit në Shqipëri”.

Po në këtë faqe të “Dielli”-it, autorit me pseudonimin Shqipëtarit i botohet shkrimi “Zhon-Turqit e Shqipëtarët e Shkodrës”. Botuesi ka respektuar gjuhën shkodranishte të autorit. Në citimet që vijojnë, duken disa karakteristika leksikore e morfosintaksore të kësaj gjuhe, të pranishme në korrespondencën në fjalë: “...pas pak kohet...”, “nji za qi thoshte...”, “E këto e pëlqyne; e jo salla populli i padishim, po dhe njerz të mirë, njerz të ditun qi në kohë të guvernës tiranike ishin të çmuëmë për Shqipëtarë të flaktë e të vërtet, e qi na dune krejt ndryshe si na e gënjeu mëndja...”

... Në Shkodër kemi pasë dhe nji vjet përpara msonjtoren e natës, ku dielmënia mësoje gjuhën shqipe... Jan tuej vështruar se malcortë e Shkodrës sot s’po donë me njoftë këto sojë konstitucionit. Jo! kurr, të drejtat t’ona nuk shikohen, kurr liri për të folun e për të punue s’kena, por përpiqen enne me na mbajt rob, na ket ndrim qeveriet s’munt t’a përlejmë.

Ja ngjarjet q’u panë deri tash; çka për të ndoll për tej?”

Në “Korespondence nga Korcha”⁶, shohim të shkruhet në toskërisht: “Nisim qe sot duke shkruar pak radhe nga Atdheu yne, lajme te shkurtera qe kane pak a shume interes per shoket t’one përtej Oqeanit, dhe do te mundohemi te sjellim ne zemerat e tyre te mërguara pak ere te paster prej Shqiperie, ne forme kujtimesh, zbavitjesh dhe lajmesh, kur trupi esht i lodhur nga puna e perditeshme dhe kerkon nje prehje dhe shpirti enderon dhe fluturon lark ne viset e mallengjyera ku ay ka lindur, ne te bukuren Shqiperi”.

4. ETIKA NË POLEMIKAT DHE REPLIKAT E NDËRSJELLA

Shprehje e bashkëjetesës së dialekteve dhe nëndialekteve të gjuhës shqipe në shtypin e dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX është dhe ruajtja e etikës intelektuale, profesionale dhe njerëzore në rastet e polemikave mes individëve, shoqatave dhe botuesve. Po citoj, për ilustrim, gazetën “Telegraf” në “Shënime & Paragrafe” – Gazetari alla Noli-Faik: “Në këtë numur po botohet dishka përmes hallin e përvajtuëshëm të Shqiptarve t’ Amerikës. Atje ku mbretonte njëherë vëllazërimi, sot gjendet çartja më e shëmtuar, dhe të dy gazetat që botohen atje “DIELLI” dhe “IDEALISTI” mbushin kollonat e tyre gadi krejt me mburje për përkrahësit dhe sharje për kundërshtarët, si pas stërvitjes q’ u kanë lënë si trashëgim Kryemjeshterit e sharjeve, Fan Noli dhe Faik Konitza. Në një numur të “DIELLIT” pamë të quhet “KONE E VEZËVE” Editori i “IDEALISTIT”, dhe në një tjetër “FIÇOR I FAN

⁶ Dielli, nr. 5436, e premte, 12 shkurt 1937, faqe 1

NOLIT”. Pa dyshim q’ edhe “IDEALISTI” s’ le kusur tue i shërbye “Idealit” të vet!”⁷

Në polemikën “Dielli” dhe “Liria”, redaksia e “Dielli”-it tregohet e kujdesshme ndaj gazetës “Liria” dhe e fton atë që të reagojë pozitivisht ashtu si simotra të saj, që të vijë shpejt koha për t’u bërë miq: “Ay që dô të na apë arësye për sa shkruam kundër gazetës së Selanikut ne “Kombi” edhe ne “Dielli” munt të këndoje numurin 31 të “Lirisë”... Tani “Liria” mirë do të bëjë të na përgjigjet e të çfajësohet nga ato që e ngarkuam pas të shkrojturave të saj më parë dhe pastaj, po vetëm pastaj do të bëhemi miq... Përse motr’ e nderçime e Stambollit “Besa” qënka me tiatër mentim dhe me fialë të çkoqura e quan programin e “Dielli” fiesht kombëtar dhe artikujtë pa mërira të veçanta?” (Pesimisti)⁸ Po në gazetën “Dielli”, në editorialin “Ç’na duhet Gjuha Shqip?”, duke analizuar qëndrimet e muslimanëve, hoxhallarëve, popullit, ortodoksëve dhe dhaskenjve (mësuesve), ndër të tjera, theksohet: “Le të vijnë të gjithë më udhë të drejtë dhe le të mos thonë “ç’na duhet gjuha shqip”, se gjuhën tonë nuk e duam për ata që mundin të prishin lira shumë dhe për ata që mësojnë në Idadiet, Gjymnasiet dhe Univesitetet, po e duam për TERE POPULLIN, se me një lule nuk vjen vera.” (E Vërteta. Vlorë 28 Mars, 1909)⁹

Kostë Çekrezi, botues i “Telegraf”-it, në “Ç’do t’i Përgjigjemi ati të huaji? A munt të Rrojë një komb pa Kulturë?”, veç të tjerash, shkruan: “Në faqen e parë të këti numuri janë vënë, në formë reklame, fjalët e një të huaji përmu daljen e kësaj gazetë.

I vumë në formë reklame dhe në faqen e parë që të vihen rre më mirë, që të heqin vërejtjen e gjith atyre që do të zënë me dorë këtë gazetë, që t’i bëjmë të këndojnë këto radhë, të cilat, ndryshe, ndofta, të mos këndoheshin.

Por ato fjalë s’janë një reklamë as për gazetën, as për veten t’onë.

Përkundrazi, janë një problem që na përket të gjith neve, veçanërisht ata prej nesh që kanë lëftuar për lirin e këti kombi që në të rit e tyne, q’i kanë dedikuar kësaj Shqipërie vjetet më të mira të jetës së tyre...”;

“Që ditën e parë që po dilte gazeta,... takova udhës një njeri që qëndron shumë nalt në qarket t’ona politike. “Dëgjova se po nxirrni një gazetë, më tha: “ju përhiroj, por, po të më kishit pyetur më parë se të nxirrni gazetën, nuk do t’ju linja që t’a nxirrni!...” “Dhe përse?” e pyeta unë. “Se, këtu në vëndin t’onë, s’ka se kush të këndoje gazeta. Nuk kini venë rre”, shtoj ay zyrtar i lartë, “se si vdesin gazetatat një nga një, si miza në mes të dimrit?” “Me gazetën që do të nxjerr unë”, i thashë, “do të ndes një kandil që nuk do të shuhet!...” “E tundi kryet me mos-besim, dhe u-nda nga mua pa folur fjalë”.... Se po të provohet që nuk është e mundur që të mbahet një

⁷ Telegraf, nr. 23, e mërkurë 27 prill 1927, faqe 2

⁸ Dielli, nr. 5, faqe 3

⁹ Dielli, nr. 7, faqe 1

gazetë e tillë, ahere provohet, gjith ashtu, se ky vend s' ka arritur n' atë shkallë përparimi intelektual sa të ketë një kulturë të tijne"... (C. A. Chekrezi)¹⁰

5. FJALORI, MORFOSINTAKSA DHE DREJTSHKRIMI E PIKËSIMI

Shtypi shqiptar i fillimshkullit XX i ka kushtuar jo pak rëndësi fjalorit, gjuhës së pastër dhe të qartë për lexuesin, si dhe formës morfosintaksore, e cila, edhe pse ka ndonjë ndikim nga gjuhët e huaja që zotëronin botuesit (anglisht, frëngjisht, greqisht, turqisht, italisht etj.), është formë pranë të folurit shqip dhe krijon një urë komunikimi shumë të mirë me çdo të interesuar për informacionet e shumëllojshme që çdokush gjente, kur shfletonte gazetat e atëhershme. Po sjell të cituar dy shembuj: "KONGRESI që thotë "Lirija" se do të behet n' Elbasan, dhe se do të ketë për kërkim vetëm çështjen e shkollave ndë Shqipëri, i ka trembur Grekomanët. Fletët greqisht japin e marrin përmi këtë gjë, po e shënojnë me ca gjyrra fare të errëta të cilat rrahin t'u japin një çkëlqim si pas kallëpit të tyre..." (Gur' i Capit. Korçë, 21 mars, 1909)¹¹

"Kjo luftë, e cila quhet Luftë Trojane është mbajtur gojë me gojë për një kohë shumë të gjatë, gjersa u vu në shkrim shumë kohë më von. Asnjëri nuk di se kur ka ngjarë kjo luftë e madhe, po thuhet që këto histori i ka shkrojtur një njeri i quajtur Homer."¹²

Disa dukuri gjuhësore, të pranishme në shtypin shqiptar brenda e jashtë vendit në fillimshkullin XX, që mund të meritojnë edhe sot vëmendjen e studiuesve, gjuhëtarëve dhe albanologëve:

Ndërrime tingujsh para, në mes apo në trup të fjalës, si pasojë e shkrimit të fjalëve mbështetur në shqiptimin krahinor: *deputat* për *deputet*; *shëkon* për *shikon*; *theshte* për *thoshte*; *të mirrte* për *të merrte*; *njëri-jatrit* për *njëri-tjetrit*; *lumtëri* për *lumluri*; *dyke* për *duke*; *shëmbëll* për *shëmbull*; *kafeanë* për *kafene*; *mësonjës* për *mësues*; *i shigurtë* për *i sigurt*; *direktor* për *drejtor* (këtu kemi dhe ndikim nga frëngjishtja); *të fshehët* (të fshehtë); *rrjethte* për *rridhte*; *nalt* (lart); *i unjët* (i ulët); *chapë* (hap emër); *botojti* (botoi); *artikullat* (artikujt); *peripetitë* për *peripeçitë*; *i pajosur* (i pajisur); *i sotmë*; *kondra* (kundër); *veglë* (vegël);

t/d: *mundt* (mund), *mentim* (mendim), *vent* (vend);

d/t: *sod për sod*, *për vedi* (për vete), *gadi* (gati);

10 Telegraf, nr. 3, 18 gusht 1926, faqe 2

11 Dielli, nr. 8

12 Çekrezi, K. A., *Histori e vjetër*, Shtypshkronja e DIELLIT, Boston 1921, faqe 20

i/j: *ndiesë* (ndjesë), *piata* (pjata), *nxierrë* (nxjerrë), *tiera* (tjera), *viersha* (vjersha), *fiesht* (thjesht), *kio* (kjo), *mierisht* (mjerisht), *fialë* (fjalë), *miaft*¹³ (mjaft), *heshtie* (heshtje), *gjendia* (gjendja);

j/i: *mjell* (miell), *shtoj* (shtoi);

r/rr: *rezik*, *rezikshme* (rrezik, rrezikshme), *regullat* (rregullat); *nxjer* (nxjerr), *rallë* (rrallë), *tmerëshme* (tmerrshme), *rukullis* (rrokullis), *çregullim* (çrregullim);

rr/r: *morri* (mori);

ll/l: *reklama* (reklama), *llogjikëshme* (logjikshme), *dolli* (doli);

s/z: *gas* (gaz), *sbulojnë* (zbulojnë), *i sgjedhur* (i zgjedhur), *sbatohet* (zbatohet), *kufisohen* (kufizohen), *ndes* (ndez);

x/z: *xgjedh* (zgjedh), *xbyth* (zbyth);

f/h: *shifet* (shihet);

th/dh: *i math* (i madh), *rrjethte* (rridhte), *lith* (lidh);

p/b: *komp* (komb)¹⁴, por gjen, po brenda fjalisë edhe “*kombet e tierë*”; *mpështet* (mbështet), *mprojtje* (mbrojtje);

ë/e: *vëndi* (vendi), *zëmra* (zemra), *brëndëshme* (brendshme), *bashkalidhur* (bashkëlidhur), *me qënë se* (me qenë se), *gjër këtu* (gjer këtu), *qënka* (qenka), *të provuëshme* (të provueshme);

ç/sh: *çfajësohet* (shfajësohet), *çkoqur* (shkoqur), *i çpejtë* (i shpejtë), *çkëlqim* (shkëlqim), *çpikje* (shpikje), *çpall* (shpall), *ndiçime* (ndryshime), *çfaq* (shfaq), *çpifarak* (shpifarak), *i çqetësuem* (i shqetësuar);

sh/ç: *dishka* (diçka);

a/e: *ardhi* (erdhi), *lajmat* (lajmet);

a/ë: *kandidatat* (kandidatët), *maturanta* (maturantët);

n/r: *Gjinokastra* (Gjirokastra – edhe nga vetë gjirokastritët);

ua/o: *u mbuall* (u mboll);

ue/o: *shkolluer* (shkollor);

y/u: *refyzohet* (refuzohet);

y/i: *psikologjike* (psikologjike), *syntheza* (sinteza), *ay* (ai);

i/y: *ndiçime* (ndryshime);

nj/j: *do mbinjë* (do të mbijë), *nuk do t’ju linja* (nuk do t’ju lija);

o/a: *tradhëtor* (tradhtar);

gj/ngj: *gryra* (ngryra);

d/nd: *donjë* (ndonjë);

m/mb: *mi* (mbi); *përmi* (përmbi).

13 Dielli, nr. 5

14 Dielli, nr. 5

Mungesa e ë-së fundore: *zyr'* (zyrë), (nga) *çudit'* (çuditë), *protest* (protestë), *kombësit'* (kombësitë), *është'* dhe *asht'* (është), *ndojher* (ndonjëherë), *ma mir* (më mirë), *dëshmin* (dëshminë), *e vobeksies* (e vobeksisë), *bashkis* (bashkisë), *hollësit* (hollësitë), *për lirin* (për lirinë), *bukurit* (bukuritë), *i historis* (i historisë) etj. Kjo mungesë plotësohet zakonisht me apostrof dhe shkon në përputhje me shqiptimin fonetik të fjalëve, kryesisht kur përdoret regjistri bisedor.

Përdorim i ë-së në fund të fjalëve, kryesisht në ndajfolje, në pjesëzën *nuk* dhe në parafjalë: *aqë* (aq); *kaqë* (kaq), *pakë* (pak); *nukë* dhe *nuku* (nuk); *nënë* (nën) etj. Këtë dukuri e takojmë sidomos në shkrimet e stilit të gjuhës korçare dhe është ndikim i shqiptimit fonetik. Në parafjalën nën(ë), përdorimi i ë-së e barazon (gramatikisht) këtë fjalë me fjalën *nënë*, e cila është emër me kuptim të konsoliduar leksikor.

Përdorim i ë-së bjerrëse: *vogëla* (vogla), *ushtëria* (ushtria), *emërin* (emrin)¹⁵, *gjithënjë* (gjithnjë), *tradhëtor*¹⁶, *tmerëshme* (tmerrshme), *brëndëshme* (brendshme), *llogjikëshme* (logjikshme), e *përkohëshme* (e përkohshme), *arësim* (arsim), *vepërohet* (veprohet), *vepërim* (veprim), *arësye* (arsye).

Fjalë shqipe të vjetëruara: *këndonjës* (lexues)¹⁷, *sindikur* (sikundër), *këndova* (lexova), *gjindja* (njerëzit)¹⁸, *dhaskenj* (mësues), *dobare* (të paktën), *dielmuri* (djalëri), *plaçkë* (mall), *tefter* (letër duhani).

Mungesë e j-së në krye apo në mes të fjalës: *do të na apë* (do të na japë), *epte* (jepte), *ndojher* (ndonjëherë).

Shtim shkronje para apo në mes të fjalës: *teknej* (këndeji), *numuri* (numri) etj.

Përdorimi i një fjale për një fjalë tjetër: *nër* për *tek* (...në ambasadori i Francës...), *fletët* (gazetat), *gjindja* (njerëzit), *ndër shtylla* (në kolonat e gazetës), *kritikimet* (kritikat), *anëtarka* (anëtare), *me një lule nuk vjen vera* (me një lule nuk vjen pranvera), *punëra* (punë), *mëri* (mëri); *vjesht'* e *2-të* (tetor), *ambicioni* (ambicia), *rukullis* (rrokullis), *ven në shpallje* (shpall), *për një tok krahina* (për disa krahina), *punime bazale* (punime bazë), *sende* për *prodhime* (sende industriale) dhe *sende* për *gjëra* (di shumë sende...), *zëdhënie* (lajmërim), *kumandar* (komandant),

¹⁵ Dielli, nr. 8

¹⁶ Dielli, nr. 5

¹⁷ Dielli, nr. 3

¹⁸ Dielli, nr. 7

ushtëriak (ushtarak), *të vëndit* (nga vendi – rubrikë), *Policia po ndreqet e pa ndërtohet* (Ndërtesa e policisë...), *kishte ca pak ngatrim* (kishte disa ngatërresa), *vendoj* (vendosi), *ç’do farë pune* (çdo lloj pune), *fime dasme* (ftesa dasme), *bombardisi* (bombardoi), *radhonyës* (radhitës), *lajthim* (gabim), *përshëndoshje* (përshëndetje), *protezat* (tezat), *çartja* (çmendja), *tepër e më tepër* (gjithnjë e më shumë: ...po bëhet tepër e më tepër...).

Shkrim ndaras apo me vizë në mes i parashtesave të mbiemrave dhe i fjalëve që sot shkruhen si të përngjithura: (vegla kaqë) *të pa-dëmçime* (vegla kaq të padëmshme)¹⁹, *gojë hapur*²⁰, *si pas*²¹, *mëndje-bardhë*²², *të pa-pajtueshme*, *të padiallëzuar*²³, *të pa justifikueme*, *herë here*, *me një here*, *me njëherë*, (si) *nga here*, *vetë-qeverim*, *drejt për drejt*, *pikë-pamje*²⁴, *pathua-se*²⁵, *Mirë-se-të-na-vijë!*, *e pa-penguar*, *sod për sod*²⁶, *njëri-pas-tjetrit*²⁷, *dale-nga-dale*²⁸, *dal nga dal*, *para sysh*²⁹, *gjith’ ashtu*³⁰, *me njëherë*, *të pa justifikueme*, *bashkalidh*³¹, *ku do herë*³², *u-vu*, *bashkalidhur*, *sipërtreguem*, *do një*, *për veç se*, *kart-vizitë*, *fat keqësi*, *e pa prishur*, *mos-besim*, *Drejt-për-Drejt*, *faqe zi*, *nëntë-mbë-dhjetë*, *për-së-shpejti*, *zemër-thyer* etj.

Shkrim që përputhet me drejtshkrimin sot: *faqezi*³³, *bashkatdhetar*, *cilitdo*, *sipërtreguem*³⁴ (sipërtreguar), *kryekishë*³⁵, *të pathemelta*.

Fjalë të huaja në vend të fjalëve shqipe: *aspirajsin* (shpresojnë), *influcencë* (ndikim), *dobare* (të paktën), *sansor*³⁶ (??), *abolla*³⁷ (??), *xhemiet* (??), *governë* (qeverisje), *sall* (vetëm)³⁸.

¹⁹ Dielli, nr. 3

²⁰ Dielli, nr. 5

²¹ Dielli, nr. 8; Telegraf, nr. 3

²² Dielli, nr. 5

²³ Dielli, nr. 5

²⁴ Dielli, nr. 7

²⁵ Dielli, nr. 12

²⁶ Demakratia, nr. 1

²⁷ Demakratia, nr. 1

²⁸ Demakratia, nr. 1

²⁹ Demakratia, nr. 1, nr. 6

³⁰ Demakratia, nr. 8

³¹ Demakratia

³² Dielli, nr. 2724

³³ Dielli, nr. 5

³⁴ Demakratia, nr. 8

³⁵ Dielli nr. 2724

³⁶ Adriatiku, nr. 6

³⁷ Shpnesa e Shcypeniis, nr. 1

Përdorimi i apostrofit: *t'a, nga shkaku q'e talli..., nj'a; t'onë³⁹, s'është', kombësit' e tiera, liria t'uaj, n'Evropë⁴⁰* (në gazetat e asaj kohe, këtë fjalë e gjejmë dhe “Europë”), *ç'do pikë-pamje, ç'do* (për çdo).

Përdorimi i shkronjës së madhe: “...për deputatët e kombit Shqipëtar...”, “Mësojmë se në Vlorë djemtë Mysylmanë Shqipëtarë të Ruzhdies kërkuan një mësonjëse për gjuhën shqip.”, “...dardharët e Rinj...”, “Dhëntë Zoti..., “Ç’na duhet Gjuha Shqip?”, “...për ata që mësojnë në Idadiet, Gjymnasiet dhe Univesitetet...”, “Njëditëzaj Shoqëria “Besa-Besën” mori letrë prej z. Faik bej Konitzës...”, “...qe pati Komisioni i Qendres...” (Nxjerrë nga “Dielli” nr. 5, 7, 8 dhe viti 1937); “Qaj raca Pełazgore, / Vajto guhen Arbenore!” (Lidhja ortodokse 5); “...mbas shpalljes ne fletoren Zyrtare...”, “...e Zyrës së Gjendjes civile”, “...e Bashkis ose të Komunës...”, “Dëshmin shëndetësore prej një Komisioni Mjeksuer Zyrtare”, “...Sërbët e Grekët...”; “Ismail Qemali në 28 Nëntor 1912 ka çpallur Pamvarësinë Shqiptare në Vlorë dhe kjo çpallje është njohur nga Fuqitë e Mbëdhda të Evropës...”, “Gjithë vëllezërve t’onë Muhamedanë me rastin e Bajramit u dërgojmë urimet më të përzëmërta.” (Nxjerrë nga “Demokratia” datë 05.03.1939, nr. 567 (1937), nr. 624 (1938)); “Boton Çdo që Vlen dhe Munt të Botohet”, “...mbi Paktin e Tiranës...”, “Jugosllavia Kërkon Aliancë me Turqinë”, “Rusia Nuk Dërgon Ushtëri në Kinë”, “Dhoma Pëlqeu Vëndimin e Qeveris Passi Dëgjoj Ministrin e Jashtëm”, “Pas një lajmi të përhapun prej Agjencis s’ Athinës, Dhoma e Deputatëve votoj dhe aprovoj gjith marrveshjet që përkasin Tregtin, Nënshitetësin, Konsujt, dhe Extraditën me Shqipërin”, “Këti Dekret-Ligji i bëri një ...”, “Mbasandaj u-pranua Projekt-ligji mbi lirimin...” (Nxjerrë nga “Telegraf” nr. 1 (1926), nr. 17, nr. 22, nr. 32, nr. 119).

Fillimshekulli XX ishte periudhë zhvillimesh të vrullshme për kombin shqiptar. Përpjekjet për liri e pavarësi nuk u ndanë nga ato për mbrojtjen e gjuhës dhe për zhvillimin e arsimit shqip. Pas Kongresit të Manastirit, shqiptarët po viheshin në provë sa të zotë ishin për t’u qëndruar konsekuentë vendimeve, siç ishte ai i Kongresit.

Shtypi shqiptar i kohës, brenda e jashtë vendit, u bë pasqyrë e interesimit të shqiptarëve për të ruajtur e zhvilluar gjuhën dhe kulturën. Misioni i botuesve ishte bashkimi, gjithëpërfshirja e kulturës, e zakoneve, e traditave, si dhe bashkëjetesa e dialekteve të gjuhës nën alfabetin latin.

Gazetat “Dielli” (Boston), “Lidhja ortodokse” (Korçë), “Kombi” (Boston), “Besa” (Kostandinopojë), “Shpnesa e Shcypeniis” (Romë), “Flamuri” (Boston), “Telegraf” (Tiranë), “Adriatiku” (Korçë), si dhe libra të botuar brenda e jashtë

³⁸ Dielli, 15.04.1909

³⁹ Dielli, nr. 5

⁴⁰ Dielli, nr. 5

vendit, dëshmojnë bashkëjetesën e dy dialekteve të shqipes dhe mirëkuptimin mes shqiptarëve, kryesisht intelektualë, të krahinave të ndryshme.

Në atë kohë nuk kishte norma drejtshkrimore, as gjuhë letrare apo standarde zyrtare. Materiali i vjelë dëshmon kujdesin e botuesve për t'i dhënë shtypit fizionomi gjuhësore. Edhe në gazeta që botoheshin jashtë vendit, dallon përdorimi i gjuhës shqipe të kohës: fjalor i pasur, larg ndikimit të gjuhëve të huaja; struktura fjalish që shprehin qartë kumtimin; pikësim që mbështet intonacionin; parime gramatikore në përputhje me dialektet e nëndialektet, pavarësisht se mungonin rregullat e drejtshkrimit e të pikësimit, sidomos para Komisionit Letrare.

Ndërrimet e tingujve, mungesa apo prania e ë-së në trup a në fund të fjalës, shkrimi ndaras apo me vizë në mes i fjalëve të përbëra e të përngjitura, përdorimi i shkronjës së madhe, i apostrofit dhe i shenjave të pikësimit etj. janë tregues të ndikimit të gjuhës së folur krahinore mbi gjuhën e shkruar, shprehje e pasqyrimin të shqiptimit në shkrim, pa përjashtuar imitime të normave gjuhësore të gjuhëve të huaja. Sidoqoftë, mjaft nga shembujt e sjellë janë në përputhje me normën e sotme të gjuhës shqipe. Kjo të lejon të shprehem me plot gojë se Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 nuk ishte një ngjarje e çastit, një sajese dhe diktat për të imponuar standarde gjuhësore, po rrjedhojë e zhvillimeve dhjetërvjeçare të gjuhës shqipe, duke nisur që nga mesi i shekullit XIX me botimet didaktike e letrare. Shtypi i fillimshkullit XX ka merita për ndihmesën e tij në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare.

Hava QYQALLA

VËSHTRIM MBI STUDIMET HISTORIKE PËR STRUKTURËN E SHQIPES

Studimet për gjuhën dhe historinë e saj janë të hershme, por ato kryesisht janë bërë në fushën e etimologjisë dhe të fonetikës historike. Kurse studimet historike për strukturën e shqipes janë më të vona dhe sigurisht më të mundimshme kur kihet parasysh gjendja shkrimore e shqipes, krahas dëshmimeve se shqipja shekuj me radhë ka bashkëjetuar në fqinjësi me gjuhët e dëshmuara me shkrim shumë më herët. Megjithatë studimet për historinë e strukturës së shqipes të filluara nga studiues të huaj si: F. Bopi, G. Majeri, H. Pedersen, N. Jokli, M. la Piana, H. Bariqi, P. Skoku, A. Desnickaja etj., u vazhduan dhe u avancuan edhe nga studiues shqiptarë që nga gjysma I e shekullit XX.

Në këtë kumtesë do të vështrojmë shkurtimisht studimet historike për strukturën e shqipes, të bëra nga studiues shqiptarë, ndër të cilët duan vlerësuar: N. Mjeda, S. Riza, E. Çabej, M. Domi, A. Xhuvani, K. Cipo, Sh. Demiraj, B. Bokshi, S. Mansaku, R. Ismajli, K. Topalli, A. Omari, E. Paço etj. Por për shkak të kohës dhe natyrës së kumtesës do t'i përmend kalimthi, kurse do të ndalem vetëm në dy çështje të diskutueshme për t'i trajtuar.

Studimet e bëra nga këta studiues disa janë të pjesshme disa më gjithëpërfshirëse ku trajtohen segmente të caktuara të gramatikës historike të shqipes.

N. Mjeda në studimin "Vërejtje mbi artikuj e përemna pronës të gjuhës shqipe", të botuar më 1934 në Shkodër, trajton çështje shumë me interes për etimologjinë e përemrave pronorë, sidomos të vetës I dhe II, sepse siç dihet, ata edhe në studimet e mëvonshme duke dalë me strukturë të konglutinuar (përngjitur), shtrohen teza të diskutueshme rreth përkatësisë kategoriale të elementeve përbërëse të tyre.

Në studimet e S. Rizës zënë vend të rëndësishëm çështje të sistemit rasor, sidomos sinkretizimi i rasave dhe gjendja e sistemit rasor që nga Buzuku, çështje për nyjat e shqipes, origjinën, pzitën burimore, origjina e përemrave pronorë, diftorë, si dhe çështje të sistemit foljor (por më shumë në plan sinkronik). Studimet e bëra nga Çabej për historinë e strukturës së shqipes u dedikohen çështjeve të njave të shqipes, singularizimit të shumësit të emrave, parashtesave e prapashtesave etj.


Studime më sistimore dhe më gjithëpërfshirëse për strukturën e shqipes filluan me Morfologjitë e K. Cipos, botuar më 1948 dhe të M. Domit më 1961 të botuara në formë dispensash, dedikuar studentëve të UT. Morfologjia historike e M. Domit shënoi një hap përpara për mbarështimin më sistemor të problemeve kryesore të morfologjisë historike dhe të rezultateve që ishin arritur gjer atëherë në këtë fushë, duke përfshirë këtu edhe kontributet vetjake për çështje të ndryshme diakronike të strukturës së shqipes.

Këto studime u vazhduan dhe u pasuruan me studimet e I. Ajetit, Morfologjia historike e shqipes I (sistemi emëror), botuar më 1973, dhe Morfologjia historike e shqipes II (sistemi foljor), botuar më 1976 në Tiranë. Duke ndërjer nevojën për thellimin e studimeve historike për strukturën e shqipes, por edhe të gjithë fushës së morfonologjikë, Demiraj botoi vëllimin më voluminoz të Gramatikës historike të shqipes. Në këtë vëllim ,përveç materialeve të sistemuara për historinë e strukturës së shqipes , vend të rëndësishëm zënë edhe ato dialektore ,duke qenë shumë herë çelës për t'u ngritur në një vertikale diakronike dhe për t'u arritur rezultate më argumentuese shkencore. Ky studim përveç materialeve dhe rezultateve të arritura nga studiues të shumtë të diakronisë strukturore të shqipes, trajton edhe kontributin e vetë autorit në ndriçimin e shumë çështjeve të diskutuara të cilat nuk kishin gjetur zgjidhje të argumentuar shkencore. Këto kontribute i vazhdoi, sistemoi dhe i sintetizoi në Gramatikën historike të shqipes të botuar më 2002. Ky vëllim është një sintezë midis dy gramatikave të Demirajt, të botuara më 1976 dhe 1988, ku trajtohen tezat e kundërtezat e shumë studiuesve të strukturës historike të shqipes duke u ngritur në një nivel herë-herë vetëm diskutues, por shumë herë edhe argumentues e shkencor.

Studime gjithëpërfshirëse dhe sistimore, pas atyre të pjesshmëve, bëri edhe K. Topalli, i cili këtë vit e kurorëzoi veprimtarinë e vet në fushën e historisë së strukturës së shqipes, duke botuar një gramatikë shumë të pasur për historinë e strukturës së shqipes. Studime të pjesshme në këtë fushë bënë edhe S. Mansaku, R. Ismajli, A. Omari, E. Paço etj., por studimet më argumentuese më të avancuara dhe pothuaj gjithëpërfshirëse në këtë segment të ndjeshëm të shqipes, mendoj, i bëri akad. Besim Bokshi. Prandaj studimet e tij vlerësohen të veçanta dhe konsiderohen si një kapërcim caqesh i krijimtarisë së studiuesve pararendës së tij. Këto studime për shumë çështje janë pasqyrë reale dhe argumentuese e një vertikaleje diakronike të mbështetur në gjendjen e sotme, e të ngritur gjer në atë i.e., duke u mbështetur në të dhëna argumentuese shkencore. Andaj këtu do të trajtojmë disa çështje nga më të diskutueshmet të cilat, mendoj, janë avancuar e argumentuar me një zell e mendësi shkencore nga akad. Bokshi. Në librin “Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes”, përveç çështjeve parciales, një rëndësi të veçantë i bën konceptimit të tërësishëm të sistemit emëror të shqipes në një dimension sistemi të pashkëputur nga fazat e lashtësisë i.e. gjer në shqipen e sotme. Ky sistem është

vështruar në relacione jo vetëm homosintagmatike, por edhe heterosintagmatike, duke u arritur rezultate të avancuara shkencore për shumë çështje të sistemit emëror, si të mbaresave të shumësit, nyjës shquese (pozitës së saj burimore, krijimit të nyjës së përparme të mbiemrave, emrave të farefnisnë, emrave të ditëve të javës, sistemit rasor etj.

Në këtë kontekst një çështje më vete e krijimtarisë së Bokshit është sistemi rasor i shqipes dhe transformimi që pësoi gjatë shekujve. Në këto transformime Bokshit nuk i doli i drejtë mendimi i H. Pedersenit, N. Joklit, La Pianos, H. Bariqit, J. Rrotës, S. Rizës, Sh. Demirajt etj. se mbaresat rasore të shqipes së sotme janë reflekse të mbaresave indoevropiane. Ai duke avancuar mendimin e P. Skokut, i cili në punimin e tij të shkurtër botuar më 1926 hedh poshtë mundësinë që mbaresat rasore nominale të shqipes të jenë reflekse të drejtpërdrejta të mbaresave përkatëse indoevropiane, arriti në përfundim, sipas nesh, të drejtë, se shqipja në një fazë të thellë historike kishte humbur mbaresat rasore, d.m.th. kishte mbetur pa fleksion mbaresor rasor dhe mbaresat e sotme të rasave burojnë nga segmente të caktuara brenda grupit nominal të sintagmës nominale. Këto segmente, sipas Bokshit, ishin realizuar në renditjen e natyrshme të përbërësve të grupit nominal E+M, që ishte përfutur pas aglutinimit të nyjës shquese (pusi i thellë), sepse, siç sqaron Bokshi, renditja para krijimit të nyjës shquese ishte e detyrueshme M+E. Dhe nga renditja E+M në sintagmën gjenitivale janë përfutur mbaresat rasore që ka shqipja sot. Pra mbaresa rasore e shqipes së sotme, sipas Bokshit, u përfutua nga nyja dysegmentëshe e mbiemrit e krijuar në renditjen e mëparshme M+E, e cila pastaj përmes transformimeve kaloi në renditje të lejueshme E+M:



Pra, siç mund të shihet, ky përfutim u bë pas krijimit të nyjës shquese (shek. V), pas përfutimit të nyjave të përparme, por para përfutimit të rotacizmit, sepse emrat me temë në *-n*, këtë *-n* e kanë rotacizuar pas krijimit të mbaresës rasore *-i*, si mulliri, syri etj.

Një çështje tjetër e diskutueshme, por me zgjidhje argumentuese nga Bokshi, është pozita burimore e nyjës shquese. Edhe në ndriçimin e kësaj çështjeje Bokshi përmbys mendimet e studiuesve se nyja shquese ishte e paravendosur (Çabej, Demiraj etj.) Ai duke avancuar mendimin e Pedersenit e të S. Rizës, për pozitën burimore të paravendosur të nyjës shquese, vjen në përfutim se nyja

shqese ishte e paravendosur kur u krijua (shek. V) në grup nominal me renditje të detyrueshme M+E, e cila përmes relacioneve po ashtu sintagmatike në këtë renditje u aglutinua me mbiemrin ,por pa efekt shques,pastaj në renditjen e lejueshme kaloi tek emri dhe u aglutinua diku rreth shek. VII, para përfundimit të rotacizmit. Në këtë kumtesë do ta trajtojmë edhe një çështje të diskutueshme rreth etimologjisë së përemrave pronorë të vetës së parë dhe të dytë. Siç është e njohur nga studimet historike për këta përemra struktura e tyre është e përngjitur nga dy elemente ,përkatesia kategoriale e të cilave në studimet diakronike është e diskutueshme. Edhe në këtë çështje prof. Bokshi avancoi mendimin e F. Bopp-it, sipas të cilit elementi i parë është përemër dëftor,kurse elementi i dytë përemër vetor, por jo në gjinore, siç mendoi Bopp-i, por në rasën dhanore pra, (ai+mua>im, ai+neve >ynë, ata +neve>tanë etj.).

Në studimet historike për strukturën e shqipes ka edhe shumë çështje të diskutueshme rreth veçorive të ndryshme të sistemit emëror, përemëror a foljor, të cilat në studimet e prof. Bokshit janë avancuar dhe ngritur pranë një teze të argumentuar shkencore, të cilat do t'i trajtojmë në ndonjë kumtesë tjetër.

Majlinda BREGASI, Át Viktor DEMAJ

KONTRIBUTI FRANÇESKAN NË GJUHËSINË SHQIPTARE GJATË SHEKULLIT XX

Provinca Françeskane Shqiptare është një fenomen i rrallë për kulturën shqiptare. Ngjashëm me një zemër përherë në aktivitet, nuk ka reshtur së pompuari oksigjen për venat e kësaj kulture edhe në momentet e asfiksive të mëdha që ka kaluar.

Historia e kësaj Province Françeskane e parnia e Fretënve në tokën arbnore, simbas Át Marin Sirdanit daton: “Duka e parë prá, e Françeskanvet në Shqypní, mbas legjendet, xên fill me Shêjtin Themelues. Mbas saj, tue këthye ky prej Sirijet (1219) ndalet në Lezhe, ku i prítun me nderime prej popullit, qi i a kishte pasë ndie zânin, i vûni themel Urdhnit të vet në Shqypní¹. Po ashtu në vitin 1240, sipas një dëshmie të gdhendun mbi derën e Kuvendin françeskan të Lezhës, flet për praninë e Fraançeskanëve në ket qytet². Kështu me radhë e deri në ditët e sotme kjo Provincë paraqitet edhe më aktive duke botuar vepra të rëndësishme për fushat e ndryshme të shkencës e kulturës shqiptare, duke rivendosur autorë të rëndësishëm françeskanë në vendin që u ishte privuar. Janë botuar tashmë më shumë se 38 vepra që nga viti 2005.

Për Françeskanët ishte e natyrshme që bashkë me fenë të ruanin traditat dhe kulturën si dhe të krijonin kulturën e shkrimit te populli për ta nxjerrë nga injoranca ku kishte përfunduar gjatë pushtimit otoman. Lista e françeskanëve që dhanë ndihmesën e tyre për lëvrimin e gjuhës shqipe zë fill që me fra Palin prej Hasi ndermjet Buzukut e Budit, rreth vieti 1599³. Mbasandej kemi fra Leo da Citadella që la të shkruem Dictionarium epiroticum, 1671⁴, kjo listë është jo vetëm e gjatë, por mbi të gjitha përmban emra autorësh të rëndësishëm. Aty gjejmë që nga autori i parë i një gramatike të shqipes, fra Francesco Maria da Lecce *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese në Romë, 1716*⁵, Át Anton Santori arberesh⁶ e

¹ M. SIRDANI, *Të venduemt e Françeskajvet nepër viset e ndryshme të Shqypnís*, në: *Hylli i Dritës*, XVI (1940) f. 65.

² M. SIRDANI, *Të venduemt e Françeskajvet nepër viset e ndryshme të Shqypnís*, 65-69.

³ V. MALAJ., *Të dhana albanologjike 2*, Don Gjon Buzuku, Ulqin-Tuz, 1999, f. 317-317.

⁴ V. MALAJ., *Të dhana albanologjike 2*, 317.

⁵ J. RROTA., *Per historín e alfabetit shqyp*, 2^o ed., Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f. 34-35.

deri te autorë dinjitozë të cilët shkruajtën gramatika, fjalorë, punime themelore etimologjike etj.

Mbas ripërtëritjes së Provincës Françeskane në vitin 1906, dalin në skenë katërshja e françeskanëve: Át Gjergj Fishta, Át Shjefen Gjeçovi, Át Pashko Bardhi e Át Pal Dodaj, të cilët vunë themelet e Provincës së ardhshme Françeskane Shqiptare që do të nxirrte prej saj një plejadë shkrimtarësh e poetësh që do të hedhin bazat në shumë fusha të kulturës shqiptare.

Themelimi i zamadhes *Hylli i Dritës* në tetor të vitit 1913, pikërisht në agun e pavarësisë së Shqipërisë, i dha një shtysë të madhe e të pazëvendësueshme zhvillimit gjuhësor e letrar të shqipes. Në në vitet 30-të të shekullit që lamë mbrapa, françeskanët u morën me edukimin dhe formimin kulturor të popullit shqiptar, duke hapur shkolla, gjymnazin e parë klasik 1921, e në vitin 1930, nën drejtimin e françeskanëve, përveç Liceut numerohen të hapura edhe njëzet shkolla fillore për djem, një shkollë e mesme për vajza e drejtuar prej Motrave Stigmatine por e mbikqyrrur prej Françeskanëve dhe pesë shkolla fillore për vajza⁷. Këtu nuk po përmendim shoqata kulturore, themelimin e orkestrave e revistave të cila krijuan në Shkodër ambiente të përshtatshme për formimin kulturor të brezave të ardhshëm. Përveç sa u tha më sipër, aktiviteti shoqëror e politik i françeskanëve që prej kohës së Gjergj Kastriotit e deri më sot, është një fenomen më vete tejet i rëndësishëm i cili lyp domosdoshmërisht një studim më vete.

Në gjuhësi janë një sërë autorësh të rëndësishëm si Át Justin Rrota “lavrues i zellshem i studimeve gjuhësore e letrare shqipe”⁸, i cili ka sjellë për herë të parë në Shqipëri të fotografuar Mesharin e Gjon Buzukut. Át Justini gjatë jetës së tij, edhe pse një pjesë të saj e kaloi i paralizuar, nuk pushoi së reshturi për lëvrimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Veprat e tij tashmë janë të njohura për ne, si studimet gjuhësore të herëpashershme të botuara në Hyllin e Dritës të cilat më vonë dolën si libra me vete, studimet mbi gjuhën e Buzukut dhe autorëve të tjerë të vjetër, por vepra e cila i la emër të pazëvendësueshëm krahas korifenjve të gjuhës shqipe është Gjuha e Shkruese ase Vepra Gramatikore, botuar për herë të parë në vitin 2006, e cila ruhej për disa dekada në arkivin Akademisë së Shkencave në Tiranë. Dr. Evalda Paci, studiuese e njohur e letërsisë së vjetër shqipe dhe e gjuhësisë, njohëse shumë e mirë e Át Justin Rrotës, pohon: Justin Rrota vazhdon të jetë një pionier në fushë të studimeve mbi gjuhën shqipe, historinë e letërsisë dhe të shkrimit të saj. Ai

⁶ J. RROTA., *Per historin e alfabetit shqyp*, 51-54.

⁷ *Schizzo Storico sull'opera dei Franceskani in Albania*, (pro manuscripto), Tipografia Franciscana, Scutari, 1930, p. 30-40.

⁸ M. DOML., *Justin Rrota (17.II. 1889 – 20.XII-1964)*, në: *Studime Filologjike*, XIX (1965) f. 219-220.

përfaqëson edhe në ditët tona një model të pasionit dhe të përkushtimit për arsimin dhe dijen⁹.

Mbas tij vijjnë Át Benedikt Dema, Át Viktor Volaj, Át Donat Kurti, Át Jak Marlekaj etj, të cilët me një seri veprash themelore të imponohen për studim.

Gama tejet e gjerë e botimeve dhe gjithë ai vëllim i cili ende mbetet i mbyllur nëpër arkiva na shpjen (për lehtësi studimi) drejt një klasifikimi të tillë të kontributit françeskan në gjuhësinë shqiptare: punimet gramatikore, leksikore e etimologjike dhe studimet gjuhësore.

Një grup më vete në këtë klasifikim përbëjnë edhe përkthimet, por në këtë punim ne po u japim pak vend atyre duke u fokusuar veçanërisht te klasifikimi i mësipërm

Punimet gramatikore

Përpilimi i gramatikave të shqipes qe një domosdoshmëri mbi të gjitha për funksionimin e shkollave shqipe. Françeskanët në këtë domen sollën gjithë çka përmbante formimi i tyre arsimor, shpesh bën edhe përkthime të gramatikave të huaja, veçanërisht atyre latine, për të sjellë modele të strukturuar mirë shkencërisht. Duhet thënë se edhe gramatikat që ata (e jo vetëm ata) përpiluan për shqipen mbështeten te ky model. Për të bërë një vlerësim të saktë mbi këto gramatika duhet të ngjitemi në kohën kur ato u shkruan dhe për çfarë qëllimesh u punuan. Mjafton këtu të përmendim Át Justin Rrotën në parathënien e tij te *Gjuha e Shkrueme ase Vërejtje Gramatikore*: Nuk shkruem këtu për linguistë dhe profesorë veteraj të shqipes; as synojm me kaqë studentët e instituteve të nalta¹⁰, për të kuptuar kthjelltësinë e këtyre autorëve të cilët nuk sollën aspak një kontribut modest në gramatikologjinë shqipe.

Justin Rrota u mor edhe me probleme të morfologjisë, të sintaksës dhe të sintaksës historike, ku në mënyrë të veçantë u përqendrua te ablativi (rrjedhorja) në studimin “Analyzimi i rasavet t’emni te zhvillimi historik i tynvet” (1931). Me interes është edhe shkrimi i Rrotës “Mbi refleksin e vlerën fonike të disa tingujve të latinishtes në shqipe” (1965). Një vepër me vlerë jo vetëm në fushën e teksteve shkollore, por edhe të sintaksës në përgjithësi ka qenë “Sintaksi i shqipes” i botuar në 1942 dhe i ribotuar, në 1943¹¹.

⁹ E. PACI, *Kontributi i Justin Rotës në fushë të letrave të shqipes, Justin Rrota gramatolog, në: Hylli i Dritës, XXVIII (2009) f. 176.*

¹⁰ J. RROTA., *Gjuha e shkrueme ase Vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 11.

¹¹ T. OSMANI., *Justin Rrota dhe verpa e tij gjithësore*, në: *Studime Filologjike*, LIX (2005) f. 114-115.

Përveç ÁtJustin Rrotës, nga **Donat Kurti** (1903-1983), siç e quan Át Zef Pllumi “*Vjollca e letrave shqipe*”¹², në Arkivin e bibliotekes françeskane në Shkodër, përpos përkthimeve të testamendit të Ri, kateklizma, gjeografi etj, krijimtari poetike, Prrallat Kombëtare, vellimi i tretë, Toshku e Bosku, ditare kujtimesh e studime me karakter sociologjik e filozofik¹³, gjendet edhe një gramatike latine e përkthyer nga ai si edhe një gramatikë e shqipes, e cila ndodhet në dorëshkrim e pabotuar në Fondin e dorëshkrimeve të Át Donat Kurtit.

Gramatika është e shkruar me makinë shkrimi, si dhe përmban 140 faqe. I mungon diftojsi e parathënia. Fatkeqësisht si çdo dorëshkrim i ruajtur në kohën e komunizmit, edhe Gramatika e Át Donatit ka pësuar dëmtime, por që kursesi nuk ia ulin aspak mundin Fratit e vlerën për botimin e saj. Natyrisht Át Donat Kurti në veprat e tij spikat me stil mjaft të bukur të të shkruarit, shprehjet e frazeologjitë, çka e bëjnë veprën e tij tërheqëse për lexuesin si dhe një thesar të çmueshëm për gjuhëtarët.

Leksikologjia

Pikërisht në leksikologjinë shqipe kontributi i françeskanëve është më dominant qoftë nga aspekti sasior, ashtu edhe nga ai cilësor. Ata me të drejtë mbajnë pishtarin në këto kërkime të cilave u dedikuan shumë vjet pune qoftë në mbledhjen e fjalës burimore shqipe, përpilimit të fjalorëve, qoftë me studimet e veçanta shkencore në këtë fushë. Natyrisht se Françeskanët duke u marrë me letërsinë popullore, kanë vjelë prej gojës së popullit fjalët, shprehjet apo frazeologjitë më të spikatura, duke e shndërruar kështu gjuhën e popullit prej asaj krahinore në gjuhë kombëtare. Prandaj veprat tyre sot e gjithë ditën janë burim i pashtershëm për bukuritë e rralla të gjuhës sonë.

Si korife në këtë domen mund të vendosim **Gjeçovin** me punën e tij vëllimore të për mbledhjen e fjalës së gjallë të popullit.

Punë ta palodhshme bëri edhe **Át Bernardin Palaj** në mbledhjen e Zakove dhe të traditave, të folklorit, ku jo vetëm që ruajti etnosin shqiptar, por edhe pasuroi gjuhën shqipe me fjalë e shprehje të rralla.

Át Donat Kurtin jemi mësuar me të drejtë ta trajtojmë në pikëpamjen e folkloristit me mbledhjen e Prrallave Kombëtare, Lojve Popullore, Visareve të Kombit. Gjithë kjo punë shumëvjeçare në gjurmët e traditës shqiptare solli një vëllim të jashtëzakonshëm të fjalës burimore shqipe.

¹² Z. PLLUMI., *Françeskanët e mëdhaj, Botime Françeskane*, 125-129.

¹³ Shih. *Jetëshkrimi i Át Donat Kurtit*, në: D. KURTI, OFM., *Zakone e Doke Shqiptare*, bot. I, Botime Françeskane, Shkodër, 2010, f. 266-275.

Át **Viktor Volaj** jo vetëm që ka bërë redaktimin e disa prej veprave të Fishtës, por ka bërë një studim të rëndësishm rreth Lahutës së Malcis që përfshin më shumë se 5000¹⁴ fjalë me shpjegime e shtjellime fjalësh (shih më poshtë).

Duhet të përmendim patjetër edhe *Abetarin e Fjalorin e Bashkimit*, ku rol kryesor në botimin e tyre luajtën po françeskanët.

Át **Bendikt Dema**, gjuhëtar e përkthyes i talenuar me: *Fjalori i fjalëve të rralla si poltësim i Fjalorit të 1954*, *Fjalori Enciklopedik* disavëllimësh, *Fjalori i fjalëve të ralla i Lahutes*, si dhe *Fjalori Histrik-Gjeografik e Mitologjik* po i Lautës së Malcis.

Át Benedikt Dema (1904-1971) prej Át Zef Pllumit u quajt *enciklopediku*¹⁵ shqiptar, sepse ka lanë disa fjalorë të gjuhës shqipe. Në vitin 2005¹⁶ u botua në Tiranë Fjalori i fjalëve të ralla i Demës, të cilin Át Benedikti e kishte punuar si shtesë për fjalët që mungonin te Fjalori i 1954-s. Në Arkivin shtetëror Tiranë, në fondin Át Benedikt Dema, gjenden një mori dorëshkrimesh si dhe Fjalori enciklopedik biologjik, përgatitë në shtatë vëllime¹⁷. Me hartimin e fjalorit të Shqipes si dhe të Fjalorit biologjik, Át Dema zë një vend të nderuar në gjuhën shqipe krahas gjuhëtarëve e albanologëve më të mirë të saj. Sipas arkivistes e studiueses Lila Guxholli që ka bërë klasifikimin e fondit të Át Benedikt Demës, Fjalori enciklopedik përmban shtatë vëllime. Fjalorin ai e ka filluar që kur ishte famullitar në Bajzë dhe e përfundon në Shkodër, ku banoi së fundmi. Fjalori është i ndarë në këto tematika:

- 1.1 *trupi i njeriut*;
- 1.2 *Frymorët*;
- 1.3 *Bimët*;
- 1.4 *Bimë e frymorë*;
- 1.5 *Sëmundjet e trupit të njeriut*;
- 1.6 *Sëmundje Damtuesa bagëtish*;
- 1.7 *Fjalor i terminologjisë shkencore: mjekësi*¹⁸.

Pjesë të këtij Fjalori të domosdoshme për gjuhën shqipe gjenden edhe në Kuvendin Françeskan të Tuzit, në bibliotekën personale të Át Vinçenc Malaj-t.

¹⁴ Leter e At Viktor Volaj. Ruhet ne Arkivin e Bibliotekes Françeskane Shkoder. Fondi At Viktor Volaj.

¹⁵ Z. PLLUMI, *Françeskanët e mëdhaj, Botime Françeskane*, Tiranë, 2001, f. 131-137.

¹⁶ B. DEMA., *Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, perg. Shaban Sinani, Dom Nikë Ukgjini, Botimet Toena, Tiranë, 2005.

¹⁷ N. UKGJINI, SH. SINANI., *At Benedikt (Mark) Dema 1904-1971*, në: B. DEMA, *Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, perg. Shaban Sinani, Dom Nikë Ukgjini, Botimet Toena, Tiranë, 2005, f. 304

¹⁸ N. UKGJINI, SH. SINANI., *At Benedikt (Mark) Dema 1904-1971*, 309.

Át Benedikt Dema nuk është marrë vetëm me gjuhësi, por edhe me studime e përkthime. Ai ishte kryeredaktor i Hyllit të Dritës, ku botoi shumë studime: bibliografinë e Hyllit 1913-1839; Për një atlas të gjuhës shqipe; Kontributi i rregulltarve në rendin shoqnor, e të kulturës botnore; Shtypi Françeskan në Shqypni; Shtypshkroja Át Gjergj Fishta në 25 vjetorin e vet, 1916-1941; Vepra letrare e Át Gjergj Fishtës, etj. Transkriptoi Dorëshkrimin e dom Shtjefen Gaspari “Nji dorëshkrim i vjetës 1671”, si dhe “Shqypnija katolike në vjetë 1671”, botuar në Hyllin e Dritës në vitet 1930-1932. Át Benedikt Dema qe ndër të parë studiuese shqiptar e albanolog që u muer me çeshtjen e Atlantit të gjuhës shqipe¹⁹. Ishte nje përkthyes shumë i talentuar. Përktheu Testamendin e Ri e disa vepra të tjera fetare katekizma etj, si ushqim shpirtëror për popullin e tij. Sigursiht duke qenë një njohës i mirë i gjuhës shqipe si dhe i të folmeve të popullit, çdo vepër e përpunuar apo përkthim a krijimtari e tij, mbetet sot e gjithë ditën një thesar i pashtershëm studimi e hulumtimi.

Nëse marrim në dorë dosjen arkivore të Át Benediktit, shohim një mori studimesh me kakater historik, letrar e gjuhësor. Një trajtesë e veçantë për Benedikt Demen ka qenë studimi i veprave të auotrëve të njohur si Át Gjergj Fishtës, Át Shjtefen Gjeçovit, Át Marin Sirdanit, etj. Veprat e Poetit Kombtar qen burim studimi për shumë gjuhëtarë, por edhe Kanuni i Lekë Dukagjnit etj.

Studimet historike që i përmendem më lart, kryesisht ato të botuara në Hyllin e Dritës, jo vetëm që paraqesin objektivitet dhe njohuri historike të personave dhe të ngjarjeve prej Át Benediktit, pra erudititetin e tij në lënden e historisë, por mbeten edhe sot e kësaj dite pikë referimi për historinë si dhe aktivietin e françeskanëve në kapërcyell të XIX e deri në gjysë të shekullit XX. Paraqitet me interes krahasimi ndermjet *Fjalorit fjalësh të rralla të gjuhës shqipe* me fjalorin në dorëshkrim *Tubë fjalësh shqipe* 176 faqe, i vitit 1954, sepse disa fjalë të rralla të përpunueme në *Tubë fjalësh shqipe* mungojnë në *Fjalorin e fjalëve të rralla të gjuhës shqipe* të përgatitur për botim prej Át Benedikt Demes në vitin 1966 e të botuar në vitin 2005. Krahas botimit përkujtimor mbi Át Gjergj Fishten të vitit 1943, Át Benedikt Dema është marrë sikurse pohuam më lart me studimin e opusit fishtian, në veçanti me studime rreth Lahutës së Malcis. Një studim i rëndësishëm rreth emrave të përvetshëm në Lahutën e Malcis është edhe *Fjalori Historik -Gjeografik – Mytologjik I “Lahutes se Malcis”*, daktiloshkrim, 155 faqe. Ja çka shkruan në parathënje auotri:

Ky fjaluer i të gjithë êmnave të pervetshem të kryevepres epike t’Á. Gjergj Fishtës, “LAHUTA E MALCÍS”, qi po paraqesim nder këto fletë, ásht i perbâm në baze të studjimit të landvet perkitse mbi nji bibliografí, qi kemi me rreshtue në fund të këtij fjalori, ashtu edhe në baze të kartavet

¹⁹ B. DEMA., *Per nji “Atlant gjuhsuer” të shqipes*, Shqypshkroja Françeskane, Shkoder, 1940, 23 ff.

gjeografike, të dorëshkrimevet të pabotueme, qi kemi me i shenjue edhe këto kah fundi, e të kallximevet të njerzvet, qi kjén në perpjekje t' aferme me ndodhje e vende, qi paraqiten mbrenda fjalorit “LAHUTA E MALCÍS”²⁰.

Kjo vepër do të botohet së shpejti prej Botimeve Françeskane, e cila është mjaft e nevojshme për studimin e Lahutës fishtiane.

STUDIMET GJUHËSORE

Studimet gjuhësore të françeskanëve janë të shumta. Ato u botuan në Hyllin e Dritës, Shejzat apo edhe si libra të veçantë duke dhënë një kontribut të madh qoftë për gjuhësinë si shkencë, ashtu edhe për nevojat e shkollës shqipe. Po prezantojmë disa tituj të rëndësishëm prej tyre, qoftë ata të cilët janë botuar, qoftë ata që kanë mbetur ende dorëshkrime.

Át Justin Rrota:

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe D. Gjon Buzuku, Shkoder 1930 1555”,

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Analizimi i Rasavet t'ëmmit e zhvillimi historik i tyre, Shtypshkroja Françeskane, Shkoder, 1931.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: “Hulumtime dhe shënjime mbi Gjon Buzukun” (BSHSH e Tiranë, 1956, nr.3), duke ngritur përsëri probleme të diskutueshme, por duke i mëshuar përsëri asaj ideje të shprehur 20 vjet më parë se hartuesi i Mesharit “ka qenë prift katolik shqiptar, një gegë autentik”. Për Justin Rrotën Gjon Buzuku qe një malësor i Krajës, lokalitet i perëndimit të liqenit të Shkodrës, duke hedhur kështu poshtë versionet e tjera për veprën dhe autorin e saj²¹.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: shkrim i shkurtër me titull “Pasthirmat buzukjane “hinje” dhe pjesëza toskënishte “tuke”, BUSHT (1963, nr.2)

“Shkrimtari ma i vjetri i italo-shqiptarëve, D. Luka Matrënga (1592)”, Shkodër,

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Sintaksi i shqipes. Bot.i 3-të (anastatik). Shkodër 2005.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Rreth votrës.Bleni I. Bot. II. (anastatik). Shkodër 2005.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Per historín e alfabetit shqyp. Bot. II. (anastatik). Shkodër, 2005. (botimi I, Hylli i Dritës, 1936)

²⁰ B. DEMA., *Fjalori Historik -Gjeografik – Mytologjik i “Lahutes Se Malcís”*. Dorëshkrim. Ruhet në Arkivin e Bibliotekes françeskane Shkodër.

²¹ T. OSMANI., *Justin Rrota dhe vepra e tij gjuhësore*, në: *Studime Filologjike*, LIX (2005) f. 102-104.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Letratyra shqype per shkolla të mjesme. Bot. II. (anastatik). Shkodër, 2006.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Letratyra shqype per klasët e ulta të shkollavet të mjesme. Parime letratyret. Bot. III. (anastatik). Shkodër, 2006.

- Át Justin Rrota, o.f.m.: Ditët e mbrame të Turqisë në Shkodër ase rrethimi i qytetit 1912-1913. Bot. I. Shkodër, 2010.

Ndër punimet gjuhësore të **Át Donat Kurtit** në Hylli i Dritës përmendim: *Si t'a shkruiej*, VII (1931) f. 8-18; *Sa mâ pak rregulla*, VIII (1932) f. 175-180.

Át Volaj, mik i ngushtë me Çabejin, i cili në vitin 1966 i dedikon edhe një libër, ka bërë shumë kërkime e studime për gjuhën shqipe, si dhe na ka lënë në dorëshkrim disa studime gjuhësore, historike e etnografike.

- P. Viktor Volaj, OFM., Famullia e Bizës, Gjakovë 2005. Në këtë studim autori jo vetëm që bën një vëzhgim historik mbi këtë trevë, por studion edhe të folmen, toponomastkën si dhe zakonet e doket e atyshme.

- Ka bashkëpunue me Át Justin Rroten për përpilimin dhe redaktimin e veprës: Gjuha e shkrueme ase verejtje gramatikale, “sidomos në pjesën I përsa i përket të damit e gjuhëvet, elementeve autoktonë të shqipes dhe burimit të huazuar nga greqishtja e rumanishtja. Gjithashtu edhe në pjesën e dytë të Morfologjisë, trajtimi mbi përemrin mund të themi se ashtë punuar gati krejt prej tij” (Shënim i Át Justin Rrotës).

Një pjesë prej listës së shkrimeve te pabotuara:

Po rreshtojmë vetëm një pjesë të studimeve gjuhësore, duke lënë studimet etnografike, toponomastike, etj.

Studime gjuhësore

- Letër drejtue Androkolli Kostollartit dt. 4.10.1963. faqe. 7. Letra përmban një kritikë ndaj Kostollarit për studimin e tij mbi “kompozitat në gjuhën shqipe”. Në këtë letër trajton edhe mbi leksikun e shqipes etj. Át Viktori flet edhe për një fjalor që e ka bërë gati dhe që do ta dorëzonte në fund të vitit (v. 1967) në Institutin e Gjuhësisë në Tiranë.

- Vërejtje dhe shënime rreth rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Fq. 17. Në këtë studim Át Volaj i bën një kritikë projektit “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes, botim i Universitetit të Tiranës në vjetin 1967.

- Studim mbi: “Eqrem Cabej, në studime filologjike, nr. 3, 1964,

- Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe. Fq. 3.

- Prapashtesa karakteristike nga toponomastika. Fq. 3.

- Emna të përvetshëm kombëtar, fq. 2.

- Folje me parashtesën “për” në kuptim të kundërt (antonomik). Fq. 1.

- Huazimi latin “Sanctam Trinitatem”, fq. 1.
- Frangu I Bardhë, neologjizma, etj. Fq. 3.
- A. Kostallari, “Studime filologjike”, 2, 1968. (Studime leksikologjike).

- Lahuta e Malcisë e komentueme nga ÁtViktor Volaj. Komenti përmban më shumë se 5000 fjalë. Ketë e ka pohuar vetë Volaj në një letër dërguar A. Kostollarit. Vepra Lahuta e Malcisë e komentuar dhe e redaktuar prej ÁtViktor Volajt simbas dëshmisë së ÁtZef Pllumit aty rreth vitit 1944 është dërguar në Firence të Italisë për botim. Me hymjen e komunizmit është ndreperë gjithçka, nuk dihet fati i veprës. Në dorë kemi Lahutën botim i vitit 1937 i pajisur me shënime e shpiegime fjalësh apo ngjarjesh.

- “Fjale të daluna ... në Shirokë, fq. 1
- Disa vrejte mbi Rregullat e drejtshimit. Fq. 3
- Prejardhje emnash vendesh, personash. Fq. 2 Fillon me “Skura...”
- Neologjizma nga “Kalendari kombiar” 1915, fq.1

Një numër studimesh historike e etnografike:

- ÁtViktor Volaj, Smundja e deka, në ÁtGjergj Fishta 1871-1940, numër përkujtimmer neper kujdes t’A. Benedikt Dema O.F.M. Shkodër 1943, fq. 341-346.
- ÁtViktor Volaj, Gjon Kamsi, në Kumbona e se dieles, 1992, nr1, fq. 22-23.
- ÁtGjergj Fishta, Mrizi i Zanavet, me parathanje e komentueme prej ÁtViktor Volaj.
- ÁtGjergj Fishta, Vallja e parrizit, me parathanje e komentueme prej ÁtViktor Volaj.
- ÁtViktor Volaj, Treva e Rodonit ne Principaten e Skendrbeut, Vëzhgim historik-etnografik, në Hylli i Dritës, XXVIII (2009) f. 133-155.

Át Jak (Jakob) Marlekaj, një tjetër françeskan, bashkëkohës i Fishtës, Kurtit, Demës, Volajt, e më vonë mik i ngushtë i Koliqit, Camajt, Valentinit e Gjeçajt, u mor përgjithë jetën e tij me studime gjuhësore e historike. Dëshmi e punë së tij të palodhshme janë një numër i madh shkrimesh botuar së pari në Hyllin e Dritës, në revistën Shejzat e më vonë nëpër revista të ndryshme shkencore që botoheshin në Europë. Në arkivin e Bibliotekës Françeskane në Shkodër gjenden një mori letrash, dorëshkrimesh e studime të ndryshme leksikore dhe etimologjike të këtij lëvruesi e dijetari për historinë dhe etimologjinë e gjuhës shqipe.

Kontribut më vete i françeskanëve shqiptarë, i një rëndësie të jashtëzakonshme për gjuhën e sotme shqipe, është lëvrimi i gegnishtes letrare, vazhdimi me këmbëngulje i traditës dhe shpënia e saj në nivel të lartë artistik. Sot gegërishtja letrare ka rimarrë plotësisht statusin e një gjuhe letërsie që vazhdon të shkruhet e që nuk është veç pjesë e historisë. Pjesën më dërmuese të këtij punimi e ka bërë

ÁtViktor Volaj, rishkrimi i shqipes së tij në atë standarde, i ka hequr jo vetëm origjinalitetin, por mbi të gjitha bukurinë e kumbimit të gjuhës së tij.

Bibliografi

1. DEMA, B. (1940), *Per një "Atlant gjuhsuer" të shqipes*, Shqypshkroja Françeskane, Shkodër.
2. DEMA, B. (2005), *Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, perg. Shaban Sinani, Dom Nikë Ukgjini, Botimet Toena, Tiranë.
3. DEMA, B., *Fjalori Historik -Gjeografik – Mytologjik i "Lahutes Se Malcís"*. Dorëshkrim. Ruhet në Arkivin e Bibliotekes françeskane Shkodër.
4. DOMI, M. (1965), *Justin Rrota (17. II. 1889 – 20. XII-1964)*, në: *Studime Filologjike*, XIX, f. 219-220.
5. *Jetëshkrimi i Át Donat Kurtit* (2010), në: ÁT DONAT KURTI, OFM., *Zakone e Doke Shqiptare*, bot.I, Botime Françeskane, Shkodër, 2010, f. 266-275.
6. *Leter e Át Viktor Volaj*. Ruhet ne Arkivin e Bibliotekes Françeskane Shkoder. Fondi Át Viktor Volaj.
7. MALAJ, V. (1999), *Të dhana albanologjike 2*, Don Gjon Buzuku, Ulqin-Tuz.
8. OSMANI, T. (2005), *Justin Rrota dhe verpa e tij gjuhësore*, në: *Studime Filologjike*, LIX, f. 114-115.
9. PACI, E. (2009), *Kontributi i Justin Rotës në fushë të letrave të shqipes, Justin Rrota gramatolog*, në: *Hylli i Dritës*, XXVIII, f. 176.
10. PLLUMI, Z. (2001), *Françeskanët e mëdhaj, Botime Françeskane*, Tiranë.
11. RROTA, J. (2005), *Per historín e alfabetit shqyp*, 2° ed., Botime Françeskane, Shkodër.
12. RROTA, J. (2006), *Gjuha e shkrueme ase Vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, f. 11.
13. Schizzo Storico sull'opera dei Franceskani in Albania, (pro manuscripto), Tipografia Francescana, Scutari, 1930.
14. SIRDANI, M. (1940), *Të venduemt e Françeskajvet nepër viset e ndryshme të Shqypnis*, në: *Hylli i Dritës*, XVI, f. 65.
15. UKGJINI, N. & SINANI, SH. (2005), *Át Benedikt (Mark) Dema 1904-1971*, në: B. DEMA, *Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, perg. Shaban Sinani, Dom Nikë Ukgjini, Botimet Toena, Tiranë.
16. VOLAJ, V. (2009), *Treva e Rodonit ne Principaten e Skendrbeut, Vezhgim historik-etnografik*, në *Hylli i Drites*, XXVIII.

PËRMBAJTJA

Bardh RUGOVA, drejtor i Seminarit FJALA E MBYLLJES SË SEMINARIT XXXI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE	7
LIGJËRATA.....	9
Enver MEHMETI MITI SERB I KOSOVËS.....	11
Shkumbin MUNISHI MBI DREJTIMET E MUNDSHME TË ZHVILLIMIT TË STUDIMEVE SOCIOLOGJISTIKE TË SHQIPES.....	19
Agim VINCA	35
MIHAL HANXHARI, NJË POET NDRYSHE.....	35
Mehdi POLISI SAMI FRASHËRI NË FUSHËN E GJUHËSISË.....	63
Dhurata SHEHRI KANONI LETRAR SOT	93
REFERIME	111
Giuseppe STABILE LA ROMANITÀ SUD-EST EUROPEA VISTA DAGLI <i>ALTRI</i> : VALACCHI E VALACCHIE NEL MEDIOEVO TRA ORIENTE E OCCIDENTE.....	113
Merima KRIJEZI PËR PARAFJALËT NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE.....	129
Irena MANOVSKA KLASIFIKIMI I PARAFJALËVE SIPAS STRUKTURËS	137
Gjorgje BOZHOVIQ THEKSI I FJALËS NË MORFONOLOGJI TË SHQIPES:	143
TEORIA METRIKE DHE E OPTIMALITETIT.....	143

Maria MOROZOVA SHËNIME PËR STANDARDIN MORFOLOGJIK TË KORPUSIT NACIONAL TË SHQIPES	153
Anna KAPITANOVA “KAJ NAS” FOLËSIT E FSHATIT TË BOBOSHTICËS NË KONTAKT ME POPULLIN AUTOKTON	157
Naser FERRI POLITIKAT RELIGJIOZE TË PERANDORËVE ROMAK.....	163
Jahja DRANÇOLLI SHKOLLA E ARBËRORËVE NË VENEDIK	175
Muhamet MALA, Muhamet QERIMI	179
NDIKIMET E NDËRSJELLA KULTURORE TË BIZANTIT DHE TË SHQIPTARËVE NË MESJETË	179
Burak KABA SHQIPTARËT NË PERANDORINË OSMANE	187
Tolga DILLIOĞLU SHQIPTARET E TURQISË MODERNE.....	191
Maja ALEKSANDROVA, Rusana BEJLERI EMËRTIMET E ERËZAVE NË GJUHËT BALLKANIKE VËSHTRIM GJUHËSOR, BOTANIK DHE ETNOKULTUROR (RIGONI)	195
Martin SUROVČÁK FRAZELOGJIZMAT E GJUHËS SHQIPE QË LIDHEN ME TË FOLURIT	203
Atdhe HYKOLLI KARAKTERI RITUAL I KËNGËVE TË MOTMOTIT	207
Arbnora DUSHI PRURJE TË REJA NË FOLKLORISTIKË: MODELE NGA FINLANDA	219
Aleksandra DUGUSHINA “FËMIJË TË KRIPUR” NË TRADITËN E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS	229
Denis ERMOLIN VËSHTRIMI NGA E KALUARA: SHQIPTARËT E UKRAINËS NË FOTOGRAFI ARKIVORE.....	235
Renata HAMIDULINA KONCEPTI I TRIMIT NË KËNGËT PATRIOTIKE T Ë SHQIPËRISË MODERNE	239

Zanita HALIMI ROMANI “ LIGATINA” E MUSA RAMADANIT DHE ETNOLOGJIA	243
Aleksandër NOVIK EKSPEDITAT SHKENCORE TE SHQIPTARËT E UKRAINËS: ÇËSHTJE TË ETNOLINGUISTIKËS.....	247
Přemysl VINŠ MBRESAT NGA TROJET SHQIPTARE NË SHKRIMET E PJESËTARËVE ÇEKË TË USHTRISË AUSTRO-HUNGAREZE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE.....	251
Ewa BEKTESHI STEREOTIPI I SHQIPTARIT NË OPINIONIN PUBLIK POLAK	257
Artur STEPLEWSKI ALBANIA IN THE EYES OF POLISH TRAVELERS OF THE XIX TH CENTURY	263
Giovanna NANCI <i>DRITË QË VJEN NGA HUMNERA: ANALIZA E PËRKTHIMIT NË ITALISHTE TË DITARIT DHE TË VJERSHAVE TË DRITA ÇOMOS.....</i>	265
Shpresa HOXHA PËRKTHIMET E PASAKTA NË SERITË TELEVIZIVE NË KOSOVË	277
Valbona GASHI - BERISHA.....	285
INTERPRETIMI I MITIT MODERN – RASTI KADARE	285
Berton SULEJMANI.....	295
GAZETA “FLAKA E VËLLAZËRIMIT” DHE GJUHA SHQIPE	295
Drago FLIS.....	303
SYNERGJIA LETRARE E ÇIFTIT KADAREJA	303
Griselda DOKA.....	307
RRETH POEZIVE TË PËRKTHYERA ITALISHT TË AZEM SHKRELIT DHE TË ALI PODRIMJES.....	307
Kazuhiko YAMAMOTO	319
AN ALTERNATIVE ANALYSIS OF JAPANESE <i>WABICHA</i> IN TERMS OF THE ETHICAL STRUCTURE OF THE KANUN	319
Krenar DOLI	341
TRADITA E RENDIT - AHENGUT NË GJAKOVË.....	341
Vlora SYLAJ.....	345
KOMUNIKIMI, FAKTOR I RËNDËSISHËM NË OPTIMIZIMIN E BASHKËPUNIMIT SHKOLLË-FAMILJE	345

Illir MUHARREMI NUK KA FILM! (Kriza e kinemasë kosovare).....	353
Maciej SZYMANSKI DEGA E BALLKANISTIKËS NË POZNANJ	359
Orkida BORSHI RILINDJA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË UNIVERSITETIN E KARLIT NË PRAGË.....	363
Edmond ÇALI BOTIMET 'NOVELLISTICA ITALO-ALBANESE' TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE SHQIPTARE NË UNIVERSITETIN 'LA SAPIENZA' TË ROMËS	369
Zamira SHKRELI ANALIZË PSIKOLINGUISTIKE MBI ZHVILLIMIN GJUHËSOR TË FËMIJËVE PARASHKOLLORË NËN NDIKIMIN E LETËRSISË PËR FËMIJË	389
Edlira MANTHO RETORIKA MODERNE NË KUADRIN E GJUHËSISË SË TEKSTIT. LIGJËRIMI ARGUMENTUES NË GJUHËN SHQIPE	399
Albana DEDA - NDOJA AT JUSTIN RROTA NË PANTEONIN E GJUHËSISË SHQIPTARE	411
Oliver Jens SCHMITT KOSOVA – MENDIME PËR STUDIMET HISTORIKE.....	419
Milazim KRASNIQI	439
POLITIZIMI DHE GLORIFIKIMI SI IDEOLOGEMA DEFORMUESE TË HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE.....	439
TRYEZA	451
Sala AHMETAJ PAVARËSIA DHE METAFORA VLORË.....	453
Lush CULAJ QEVERI E VLORËS NË MBROJTJE TË JUGUT TË SHQIPËRISË	457
Xheladin SHALA SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË DHE ROLI I KOSOVËS	465
Isak SHEMA POEZI PËR ISA BOLETININ.....	473
Mehmet RUKIQI SHPALLJA E PAVARËSISË NË EPIKËN SHQIPTARE	481

I. GJUHËSI.....489

Teuta ABRASHI
PIKËPAMJET DHE KONTRIBUTI I HILMI AGANIT LIDHUR ME TEORINË
E TOGFJALËSHIT DHE RASËS GJINORE TË GJUHËS SHQIPE495

Linditë SEJDIU - RUGOVA
KALLËZUESI I SHQIPES507

Lindita XHANARI - LATIFI
KONTRIBUTE TË STUDIUESVE SHQIPTARË NË FUSHËN E
ORIENTALISTIKËS GJATË 100 VITEVE TË FUNDIT513

Sedat KUÇI
SHKOLLA ALBANOLOGJIKE E AGNIA VASILEVNA DESNICKAJAS521

Naser PAJAZITI
NDIHMEA E ALBANOLOGËVE TË HUAJ PËR DIALEKTOLOGJINË E
GJUHËS SHQIPE525

Mimoza KARAGJOZI - KORE
KONTRIBUTI I A. V. DESNICKAJAS PËR GJUHËN SHQIPE533

Anila ÇEPANI
GJYMTYRËT E FJALISË NË TRADITËN E GRAMATIKAVE TË SHQIPES .539

Bahri KOSKOVIKU
STRUKTURA SINTAKSORE E FJALIVE LIDHORE547

Rozana RUSHITI
PERIUDHA HIPOTETIKE SI NJËSI FUNKSIONALE NGA LAMBERZT-I TE
SINTAKSAT E PARA TË SHQIPES.....553

Ismet OSMANI
MEDIUMET NË GJUHËN SHQIPE DHE PRIRJET E PËRGJITHSHME
GJUHËSORE559

Mensur VOKRRI
KATEGORIA GRAMATIKORE E NYJËS TE GJUHËTARË TË VEÇANTË
TË GJUHËSISË SHQIPTARE563

Tomor OSMANI
HISTORIA E SHKRIMIT TË SHQIPES NË PENDËN E STUDIUESVE
SHQIPTARË.....571

Skënder GASHI
VENDI I FORMIMIT TË GJUHËS SHQIPE SIPAS GJUHËSISË
EUROPERËNDIMORE DHE ASAJ SHQIPTARE579

Valter MEMISHA QASJE PËR DISA RIARDHJE TË DITËVE TË SOTME NË LEKSIKOGRAFINË SHQIPTARE.....	585
Shefkije ISLAMAJ LEKSIKOGRAFIA SHQIPE NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË.....	593
Bade BAJRAMI ÇËSHTJE KLASIFIKIMI TË NJËSIVE FRAZELOGJIKE	599
Idriz METANI STUDIME NË FUSHËN E SEMANTIKËS LEKSIKORE TË SHQIPES	609
Rrahman PAÇARIZI ÇËSHTJE TË TERMINOLOGJISË NË PSIKOLINGUISTIKË – QASJA KOGNITIVE NDAJ TERMINOLOGJISË.....	615
Rezearta MURATI POLITIKA GJUHËSORE NË SHQIPËRI NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XX	623
Adelina ÇERPJA NJË VËSHTRIM PËR GRAMATIKAT SHKOLLORE TË SHQIPES TË PERIUDHËS 1913 – 1944.....	629
Merita HYSA ELEMENTE TË GRAFEMATIKËS NË GJUHËSINË SHQIPTARE	639
Vjosa HAMITI SELMAN RIZA PËR MODALITETIN E FOLJEVE MODALE	649
Shkëlqim MILLAKU MËSIMI I ANGLISHTES NGA KLASA E PARË NË KOSOVË.....	657
Mimoza PRIKU 100 VJET STUDIME PËR SHQIPEN NGA FILOLOGËT ITALIANË.....	663
Julie M. KOLGJINI NXËNIA E DY GJUHËVE SI GJUHË E PARË SI DHE DIVERGJENCA, KONVERGJENCA E INOVACIONET GJUHËSORE: SHQIP DHE ANGLISHT	673
Haki HYSENAJ STUDIMET EKSPERIMENTALE NË FUSHË TË FONETIKËS DHE NORMA E FOLUR E SHQIPES STANDARDE.....	693
Rexhep OSMANI DISA PROBLEME PËR NORMËZIMIN E GJUHËS LETRARE KOMBËTARE	703

Fehmi ISMAILI HUAZIME TË SHQIPES NË FUSHË TË ARSIMIT NË KOSOVË - LIGJET DHE FJALORI I TYRE	709
Kledi SHEGANI ALEKSANDËR XHUVANI DHE KONTRIBUTI I TIJ NË GJUHËSINË SHQIPTARE	715
Anyla SARAÇI - MAXHE TRAJTIME TË PROCESEVE FONETIKE NË GRAMATIKAT E SHQIPES	721
Abdullah ZYMBERI GJUHËTARË TË HUAJ DHE SHQIPTARË PËR ASNJANËSIT E SHQIPES ...	727
Asllan HAMITI DISA DUKURI MORFONOLOGJIKE NË TË FOLMET E GEGËRISHTES	731
Vjosa OSMANI KOHEZIONI I TEKSTIT NË PROZËN E KADARESË	739
Xhavit BEQIRI PIKËPAMJET E CAMAJT PËR STANDARDIN E SHQIPES	751
Besnik RAMA BASHKËJETESA E DY DIALEKTEVE TË SHQIPES NË SHTYPIN SHQIPTAR TË FILLMSHEKULLIT XX	757
Hava QYQALLA VËSHTRIM MBI STUDIMET HISTORIKE PËR STRUKTURËN E SHQIPES	769
Majlinda BREGASI, Át Viktor DEMAJ KONTRIBUTI FRANÇESKAN NË GJUHËSINË SHQIPTARE GJATË SHEKULLIT XX	773

Sponsorë:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës

Rektorati i Universitetit të Prishtinës

Seminari XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

31/1

Botues: Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

Tirazhi: 300 copë

